PROKURORIA E POSAÇME
TIRANË
Nr. U233/1 Prot.
Datë, më 24.11.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 131/53Akti
Datë regjistrimi 12.12.2022

Nr. 15 Vendimi
Datë vendimi 21.02.2023

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTARE: RUDINA PALLOJ
GJYQTARE: IRENA GJOKA
GJYQTAR: ERJON ÇELA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Dila Doçi,** në Tiranë, sot më datë 21.02.2023, ora 13:00, pasi morri në shqyrtimin në seancë gjyqësore publike çështjen penale me nr.**131/53** akti, datë regjistrimi **12.12.2022**, me palë:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët **Vladimir Marra** dhe **Dritan Prençi**.

I PANDEHUR: **1.Atli Jashari,** i biri i Nazmi dhe Fatime, lindur në datë 24.01.1961 në Dibër dhe banues në Tiranë, rruga "Don Bosco", me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar , hetuar nën masën e sigurimit personal "*Arrest në shtëpi*", vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati ***Av. Hysni Beti***, me nr.license 507, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.**

I PANDEHUR: **2.Lahert Sulo,** i biri i Shkëlqim dhe Rajmonda, lindur në datë 01.12.1981 në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë rruga "Kadri Roshi", lagja "Kazhar-Yzberisht", shk.2, ap.2, kati 4, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg",*** vendosur me

vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Sokol Kepi***, me nr.license 5537, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **3.Ani Hoxholli,** i biri i Xhemal dhe Vjollca, lindur në datë 29.11.1987 në Përrenjas dhe banues në Pogradec me adresë rruga "Migjeni", nd.2, h.1, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av.Dhurata Haveri***, me nr. license 1074, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **4.Emilton Asllanaj,** i biri i Ismet dhe Shpresa, lindur në datë 21.03.1989 në Pukë dhe banues në Tiranë me adresë rruga "Muhamet Deliu", nd.8, h.18, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av.Zeni Qinami***, me nr. license 3463, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **5.Halim Shehu,** i biri i Azem dhe Hurme, lindur në datë 17.05.1976, lindur dhe banues në Kukës, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Eritan Shehu,*** me nr. license 7942, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprave penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e kryer në bashkëpunim dhe "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 6.**Arben Kastrati,** i biri i Bajram dhe Gjule, lindur në datë 29.08.1970 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : Barakat, nd.10, h.1, 8501, Kukës, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokatë te zgjedhur ***Av.Shaban Nexhi,*** me nr.license 5829, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe ***av. Brixhilda Lita,***zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 7.**Arjan Sokoli,** i biri i Ahmet dhe Fatime, lindur në datë 02.09.1970 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : fshati Canaj, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Elis Bilali,*** me nr. license 8944, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 8.**Dashnor Braha,** i biri i Ali dhe Hyrie, lindur në datë 05.12.1968 në Bicaj, Kukës dhe banues në Kukës me adresë : Metralugu, nd.21, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Ilir Nerguti,*** me nr. license 1411, zgjedhur me deklarim në seancë.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **9.Elidjana Toçila,** e bija e Xhevahir dhe Vitori, lindur në datë 22.08.1981 në Gramsh dhe banuese në Tiranë me adresë : rruga "Jordan Misja", me arsim të lartë, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Luan Buzhiqi***, me nr. license 1502, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **10.Endrit Uka,** i biri i Arben dhe Luljeta, lindur në datë 13.10.1995 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "Iliria", nd.12, h.3, ap.8, Kukës, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Sokol Tahiraj***, me nr.license 6920, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **11.Fatri Iseberi,** i biri i Bari dhe Shemsije, lindur në datë 13.03.1986 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : Shtiqen, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokatët e zgjedhur ***Av. Dilaver Smanaj***, me nr.license 7952, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprave penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e kryer në bashkëpunim dhe "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **12.Fatri Braha,** i biri i Ruzhdi dhe Resmije, lindur në datë 09.04.1983 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja nr.6, nd.11, h.1,ap.11, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur në gjykim nga ***av.Marash Ibraj,*** me nr. 1454 license, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe ***av.Besim Spahiu***, me nr. 6393 license, zgjedhur me deklarim në seancë, dhe ***av.Nikolin Caka*** në seancën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare të mbrojtjes.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **13.Artan Redhaj,** i biri i Myfyt dhe Sadushe, lindur në datë 11.01.1972 në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë : Njësia Bashkiake nr.5, Lidhja e Prizrenit, me arsim të lartë, me gjendje civile i ve, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal *"Pezullim i ushtrimit të një detyre a funksioni publik"*, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Xhuljano Hoxhallari***, me nr. license 11444, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.**

I PANDEHUR: **14.Gëzim Duraku,** i biri i Haxhi dhe Hyrije, lindur në datë 12.09.1964 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "11 Tetori", nd.6, h.2, ap.2, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Bardhyl Duraku***, me nr.license 7451, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **15.Haqif Halilaj,** i biri i Elmaz dhe Lihe, lindur në datë 15.04.1964 në Kukës dhe banues në Kamës me adresë : lagja "Roma", nd.28, h.33, ap.10, Kamëz, Tiranë, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Asllan Dogjani***, me nr.license 2492, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **16.Kapllan Dogjani,** i biri i Qazim dhe Xhemile, lindur në datë 06.01.1980 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja 16, nd.2/1, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Shkëlzen Cena***, me nr. license 9925, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **17.Mimoza Shahinaj (Ismaili),** e bija e Reshat dhe Sabrije, lindur në datë 27.05.1983 në Fushë- Arrës dhe banuese në Tiranë me adresë : lagja "Altin Basha", Njësia Administrative nr.6, 1027, nd.7, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile e martuar, me gjendje gjyqësore e padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Shkëlzen Cena***, me nr. license 9925, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **18.Muhamet Cengu,** i biri i Qemal dhe Rabije, lindur në datë 26.03.1977 në Shtiqen, Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja

Meteori, nd.5, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, me gjendje civile i martuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Baftjar Rusi***, me nr. license 575 dhe ***Av. Nikolin Caka***, me nr.license 1182, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **19.Rezarta Lako,** e bija e Refat dhe Gjylo, lindur në datë 08.02.1991 në Përmet dhe banuese në Tiranë me adresë : Kashar-Yzberisht, lagja "Loni Ligori", nd.15, ap.21, Tiranë, me arsim të mesëm, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Shkëlzen Cena,*** me nr. license 9925, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **20.Urim Lami,** i biri i Islam dhe Xharije, lindur në datë 08.09.1971 në Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "Dëshmorët", nd.5, h.5, ap.4, Kukës, me arsim te mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Jurgen Vatnikaj***, me nr.license 10870, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **21.Vehbi Nerguti,** i biri i Shukri dhe Fatime, lindur në datë 12.04.1974 në Gjegjan, Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "Isa Boletini", nd.11, h.1, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me

gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Avdi Mataj***, me nr. license 425, zgjedhur me deklarim në seancë.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **22.Vojsava Selmani,** e bija e Xhevahir dhe Shpresa, lindur në datë 17.04.1988 në Bajram Curri dhe banuese në Tiranë me adresë : rruga "Mahmut Alushi", nd.29, h.1, ap.2, Dajt, Linzë, Tiranë, me gjendje civile e martuar, me gjendje gjyqësore e padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Shkëlzen Cena,*** me nr. 9925 license dhe ***av.Përparim Noka***, me nr. 1232 Li135ence, Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **23.Xhuljana Maksutaj,** e bija e Kastriot dhe Zenepe, lindur në datë 01.02.1992 në Gjergjove, Skrapar, dhe banuese në Tiranë me adresë : Shkozë, nd.319, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Jurgen Vatnikaj***, me nr.license 10870, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **24. Bedri Duraku,** i biri i Xhezair dhe Fate, lindur në datë 28.05.1969 në Morinë, Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "Dituria", nd.47, h.2, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e

sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Dilaver Smanaj***, me nr.license 7952, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 25. **Avni Tërshalla,** i biri i Hajredin dhe Hane, lindur në datë 28.10.1969 Kukës dhe banues në Kukës me adresë : Krenz, nd.18, h.1, ap.5, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal *"Pezullim i ushtrimit të një detyra a funksioni publik"*, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Ilir Nerguti***, me nr. license 1411, zgjedhur me deklarim në seancë.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 26. **Arben Goçi,** i biri i Man dhe Mire, lindur në datë 06.08.1968 në Vlahen, Kukës dhe banues në Kukës me adresë : lagja "Ushtarakët", nd.18, h.1,ap.5, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, me gjendje civile i martuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokatët e zgjedhur ***Av. Dritan Peka***me nr. license 3210dhe ***Av. Renaldi Meka***me nr. license 478, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: 27. **Reni Dokolli,** i biri i Isuf dhe Nazmije, lindur në datë 14.02.1993 në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë : rruga "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në burg"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës

së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Sokol Tahiraj***, me nr.license 6920, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **28. Shpëtim Cenaj,** i biri i Qemal dhe Kadime, lindur në datë 30.12.1964 në Kukës dhe banues në rruga "Pasho Hysa", nd.26/1, h.1. Njësia Administrative 1, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal "*Arrest në shtëpi*", vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Sokol Tahiraj***, me nr.license 6920, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.**

I PANDEHUR: **29. Sulë Osmani,** i biri i Demit dhe Sheme, lindur në datë 01.06.1967 në Nangë dhe banues në Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal *"Pezullim i ushtrimit të një detyre a funksioni publik"*, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Dritan Trifka***, me nr. license 3716, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.**

I PANDEHUR: **30. Klevis Salkurti,** i biri i Gani dhe Tefta, lindur në datë 22.05.1990 në Rashnapojë, Dibër dhe banues në Dibër, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi",*** vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Ismail Uka,*** me nr.license 2910, anëtar i Dhomës së

Avokatisë Dibër, zgjedhur me deklarim si dhe nëpërmjet prokurës së posaçme nr. 3278 rep., nr. 1015 kol., datë 08.05.2022.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.**

I PANDEHUR: **31. Xhefaer Elezi,** i biri i Bislim dhe Shine, lindur në datë 30.08.1952 në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë : Poliklinika, nd.3, h.5, Kukës, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Ilir Nerguti,*** me nr. license 1411, zgjedhur me deklarim në seancë.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K.Penal.**

I PANDEHUR: **32. Sazan Ibra,** i biri i Eles dhe Fellanza, lindur në datë 06.03.1967 në Lezhë dhe banues në Peshkopi, me adresë : rruga "Dine Hoxha", nd.2, h.13, ap.1, Peshkopi, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, hetuar nën masën e sigurimit personal ***"Arrest në shtëpi"***, vendosur me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbrojtur nga avokati i zgjedhur ***Av. Ndriçim Çupi***, me nr. license 9735, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: **Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.**

OBJEKTI: Gjykimin e çështjes penale me nr. 272, të vitit 2020, ndaj të pandehurve dhe akuzuat përkatëse, si më sipër.

BAZA LIGJORE: Neni i Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata pasi administroi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra gjatë gjykimit si dhe dëgjoi palët në konkluzione përfundimtare të cilat kërkuan:

Prokurorët Vladimir Marra dhe Dritan Pençi, përfundimisht kërkuan:

1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Atli Jashari** për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1(një) vit burgim.

- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Atli Jashari.
- Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Atli Jashari, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lahert Sulo** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Lahert Sulo.

-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Lahert Sulo ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Lahert Sulo, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ani Hoxholli**për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Ani Hoxholli.

-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Ani Hoxholli ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Ani Hoxholli, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Emilton Asllanaj** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Emilton Asllanaj.

-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Emilton Asllanaj ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Emilton Asllanaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Halim Shehu** për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Halim Shehu për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal kërkojmë bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej 3(tre) vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Halim Shehu.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Halim Shehu ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Halim Shehu, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
6.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Kastrati** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Arben Kastrati.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Arben Kastrati ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Arben Kastrati, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
7.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arjan Sokoli** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Arjan Sokoli.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Arjan Sokoli ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Arjan Sokol, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
8.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dashnor Braha** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Dashnor Braha.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin Dashnor Braha, për një periudhë kohore prej

4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Dashnor Braha, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
9.Deklarimin fajtor të të pandehurës **Elidjana Toçila** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurën Elidjana Toçila.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurën Elidjana Toçila, për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Elidjana Toçila, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
10.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Endrit Uka** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Endrit Uka.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin Endrit Uka, për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Endrit Uka, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Iseberi** për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.
-Deklarimin fajtor të të pandehurit Fatri Iseberi për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal kërkojmë bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej 3(tre) vjet burgim
Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Fatri Iseberi.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Fatri Iseberi ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Fatri Iseberi, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

13. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Braha** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Fatri Braha.

-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Fatri Braha ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Fatri Braha, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

14. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Artan Redhaj** për veprën penale "*Shpërdorim detyre*", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Artan Redhaj.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Artan Redhaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin Artan Redhaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.

15. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Duraku**, për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Gëzim Duraku.

-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin Gëzim Duraku, për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.

-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Gëzim Duraku, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

16. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Haqif Halilaj,** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Haqif Halilaj.

-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin Haqif Halilaj, për një periudhë kohore prej

4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Haqif Halilaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
17.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Kapllan Dogjani** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Kapllan Dogjani.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Kapllan Dogjani ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Kapllan Dogjani, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
18.Deklarimin fajtor të të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurën Mimoza Shahinaj (Ismaili).
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurën Mimoza Shahinaj (Ismaili), për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Mimoza Shahinaj (Ismaili), për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
18.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Muhamet Cengu** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Muhamet Cengu.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Muhamet Cengu ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Muhamet Cengu, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
19.Deklarimin fajtor të të pandehurës **Rezarta Lako** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurën Rezarta Lako.

-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurën Rezarta Lako për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Rezarta Lako, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
20.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Urim Lami** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Urim Lami.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Urim Lami ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Urim Lami, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
21.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vehbi Nergutipër** veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Vehbi Nerguti.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Vehbi Nerguti ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Vehbi Nerguti, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
22.Deklarimin fajtor të të pandehurës **Vojsava Selmani** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurën Vojsava Selmani.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurën Vojsava Selmani për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Vojsava Selmani, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
23.Deklarimin fajtor të të pandehurës **Xhuliana Maksutaj** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurën Xhuliana Maksutaj.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurën Xhuliana Maksutaj për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Xhuliana Maksutaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
24.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bedri Duraku** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Bedri Duraku.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Bedri Duraku ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Bedri Duraku, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
25.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Avni Tërshalla** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin **Avni Tërshalla.**
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin Avni Tërshalla për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin **Avni Tërshalla**, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
26. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Goçi** për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Arben Goçi.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Bedri Duraku ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Arben Goçi, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.

27. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Reni Dokolli**, për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Reni Dokolli.
-Në aplikim të nenit 14 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 " Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i pandehuri Bedri Duraku ta vuajë dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Reni Dokolli, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
28. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Shpëtim Cenaj**, për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Shpëtim Cenaj.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin Shpëtim Cenaj për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Shpëtim Cenaj, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
29. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Sulë Onuzi**, për veprën penale "*Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Sulë Onuzi.
-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin Sulë Onuzi për një periudhë kohore prej 4(katër) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe të mos kryejë vepër penale tjetër.
-Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, kërkojmë heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Sulë Onuzi, për një periudhë kohore prej 5(pesë) vjet.
30-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Klevis Salkurti** për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1(një) vit burgim.
-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Klevis Salkurti.
31-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhafer Elezi** për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1(një) vit burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për të pandehurin Xhafer Elezi.

32-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Sazan Ibra** për veprën penale "*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1(një) vit burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, t'í zbritet 1/3 e masës së dënimit me burgim për tëpandehurin Sazan Ibra.

-Pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për kryerjen e përgjimit ambiental nga ana e policisë gjyqësore, ti kthehen Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

- Bazuar në kërkesat e nenit 190 pika 1 gërma '' a'' të K.Pr.Penale, provat materiale te sekuestruara dhe konkretisht, një aparat telefoni celular i markës "Olimpia", me ekran me ngjyrë të zezë dhe tastiere me ngjyre të kuqe, me kartën SIM 0694106825 i shtetasit Gëzim Duraku,një aparat telefoni celular i markës "Apple", model S6, me ekran dhe kapak ngjyrë të zezë me kartë sim 0699736530 i shtetases Vojsava Selmani, një aparat telefoni celular i markës "Iphone 11", me ngjyrë të zezë, me numër IMEI: 35392210450993, me kartë sim 0684033558 i shtetasit Vehbi Nerguti, një aparat telefoni celular i markës "Samsung", tip A12, ngjyrë i zi, me nr. IMEI 356086275344074, me kartë sim 0694106383 si dhe 0682411704 i shtetasit Arben Kastrati, një aparat telefoni celular i markës "Samsung", tip A70, ngjyrë i zi, me nr. IMEI1-352029112718047/01, me kartë sim 0694115447 i shtetasit Fatri Iseberi, një portofol ngjyrë të zezë e shtetasit Fatri Iseberi, një aparat celular i markës "Samsung Galaxy A31", me nr. IMEI 355871115432101 dhe nr. IMEI 355872115432109, me kartë sim 0688815000 në emër të shtetasit Endrit Uka, një aparat celular i markës "Iphone S6", me ngjyrë të bardhë përpara në emër të shtetasit Atli Jashari, një aparat celular i markës "Redmi", me ngjyrë blu, me nr.sim 0693200288, në emër të shtetasit Artan Redhaj, një aparat celular i markës "Samsung Galaxy", në emër të shtetases Xhuljana Maksutaj, një Aparat celular i markës "Samsung A70", me sim kartë 0694447565, në emër të shtetasit Arjan Sokoli, një aparat celular i markës "Samsung A10", ngjyrë e zezë, me këllëf të zi, me nr. IMEI 352696110327730 në emër të shtetasit Erjon Saraçi, një aparat celular i markës "Samsung", me ngjyrë të zezë, me IMEI 351832194975505, me sim kartë 0676466593, në emër të shtetasit Shpëtim Cenaj, një aparat celular i markës "Samsung" me ngjyrë të zezë, në emër të shtetasit Sazan Ibra, një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit Bedri Duraku, një aparat celular në emër të shtetasit Arben Goçi, një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit Muhamet Cengu, një aparat celular i markës "Nokia", në emër të shtetasit Haqif Halilaj, një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit Haqif Halilaj, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.

- Bazuar në kërkesat e nenit 190 pika 1 gërma '' a'' të K.Pr.Penale, provat materiale te sekuestruara dhe konkretisht shumën e parave prej 51,200(pesëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë dhe 800(tetëqind) euro sekuestruar shtetasit Arben Kastrati, shumën e parave prej 4,600(katër mijë e gjashtëqind) lekë sekuestruar shtetasit Urim Lami, shumën e parave prej 105 (njëqind e pesë mijë) lekë, 230 (dyqind e tridhjetë) euro, 100 (njëqind) Rial dhe 100(njëqind dollar) sekuestruar shtetasit Fatri Iseberi, shumën e parave prej 1700 (një mijë e shtatëqind) lekë

sekuestruar shtetasit Arben Goçi, shumën e parave prej 11, 300(njëmbëdhjetë mije e treqind lekë) dhe 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro sekuestruar shtetasit Vehbi Nerguti, shumën e parave prej 6000 (gjashtë mijë lekë sekuestruar shtetasit Fatri Braha, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.

-Në mbështetje të nenit 485/3 të K.Pr.Penale shpenzimet procedurale t'ju lihen në mënyrë solidare në ngarkim të të pandehurve.

1)Mbrojtësi i të pandehurit Lahert Sulo, av. Sokol Kepi: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Lahert Sulo, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal, pasi fajësia e tij nuk provohet.

I pandehuri Lahert Sulo: Jam dakord me avokatin.

2)Mbrojtësi i të pandehurit Ani Hoxholli, av. Dhurata Haveri: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Ani Hoxholli, për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal, ose në alternativë, marrjen parasysh të rrethanave lehtësuese në funksion të individualizimit të dënimit të të pandehurit Hoxholli dhe pezullimin e pjesës së pavuajtur të dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal.

I pandehuri Ani Hoxholli: Nga dosja e paraqitur nga organi i akuzës nuk u provua që me veprime të miat, i vetëm apo në grup, të jem bërë pjesë e mekanizmit të mbledhjes së parave nga kontrollorët, për të përfituar për vetë apo për të përcjellë tek eproret e mi këto përfitime. Nuk u soll asnjë provë e vetme për të më fajësuar, nuk u dha asnjë detaj për kohën, vlerat monetare apo personat e përfshirë. Si i ri në këtë detyrë dhe për herë të parë në këtë funksion, për më pak se tre muaj punë, përfundova në burg me insinuata dhe pa asnjë provë.

3)Mbrojtësi i të pandehurit Emilton Asllanaj, av. Zeni Qinami: Mbështetur në nenin 388, pika 1, germat a dhe d, fakti nuk ekziston dhe nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i ngarkohet. Për këto arsye mbrojtja argumenton se gjykata duhet të vendosë pafajësi për të pandehurin Emilton Asllanaj për akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal.

I pandehuri Emilton Asllanaj: Jam dakord me avokatin. Dua të thekson se prokuroria bën sqarime të përgjithshme, me një arsyetim fut të gjithë personat e akuzuar dhe thotë kanë vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, duke sqaruar se me ndërgjegje kanë vepruar. Ndërkohë provohet e kundërta, se unë vetëm për të vepruar që nuk kam vepruar, nuk ka veprim timin, po ashtu nuk ka as ndërgjegjësim pasi nuk kam dijeni për ndonjë veprim.

4)Mbrojtësi i të pandehurit Halim Shehu, av. Eritan Shehu: Kërkoj deklarimin e pafajshëm të të mbrojturit prej meje për veprën penale të korrupsionit pasiv pasi nuk provohet në asnjë rast se ai ka marrë ndonjë përfitim të paligjshëm, pasi as organi i akuzës nuk thotë në konkluzionet e tij se sa është shuma që ka përfituar, kush ka dhënë e aq me pak të ketë prova materiale për përfitimin e kësaj shume. Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të shtetasit Halim Shehu për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, pasi nuk provohet që i mbrojturi prej meje të ketë kryer këtë vepër penale. Në rast se nga ana juaj arrihet në konkluzionin se i mbrojturi prej meje i ka kryer

veprat penale për të cilat akuzohet, atëherë ne si mbrojtje kërkojmë aplikimin e nenit 59 të K. Penal, për mënyrën e vuajtjes së dënimit, bazuar në të dhënat dhe dokumentet mbi personalitetin, gjendje shëndetësore dhe familjare të të pandehurit.

I pandehuri Halim Shehu: Jam dakord me avokatin.

5)Mbrojtësi i të pandehurit Arben Kastrati, av. Shaban Nexhi: Kërkojmë pushimin e akuzës së ngritur ndaj të pandehurit Arben Kastrati, për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, sipas paragrafit 1, të nenit 328, pika dh) të K.Pr.Penale. Kthimin e sendeve të sekuestruara në momentin e arrestimit pasi ato sende/para, nuk kanë shërbyer si mjet për kryerjen e krimit dhe në telefon ndodhen foto dhe video, kujtime familjare dhe shoqërore.

I pandehuri Arben Kastrati: Jam dakord me avokatin.

6)Mbrojtësi i të pandehurit Arjan Sokoli, av. Elis Bilali: Vërtetimi i akuzës në fjalë, sa i përket veprimeve të të pandehurit Arjan Sokol, nuk ka kaluar standardin ligjor të provimit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, rrjedhimisht, i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm. Në eventualitetet të vlerësimit se rrethanat e faktit përbëjnë vepër penale, vlerësojmë se gjykata, nisur nga marzhi i dënimit që përcakton dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, koha e gjatë e paraburgimit, faktit që i pandehuri është i padënuar më parë dhe është baba i dy fëmijëve, vlerësojmë se ekzistojnë të gjitha rekuizitat ligjore që gjykata të pezullojë ekzekutimin e vendimit me burgim dhe të aplikojë nenin 59 të Kodit Penal.

I pandehuri Arjan Sokoli: Jam dakord me avokatin.

7)Mbrojtësi i të pandehurit Dashnor Braha, av. Ilir Nerguti: Shtetasi Dashnor Braha nuk rezulton të ketë asnjë kërkim ryshfeti siç është relatuar nga prokuroria në materialet e saj. Kartëmonedhat e evidentuara nga përgjimi ambiental janë të natyrës së dhuratave të dhëna prej shtetasve kosovarë pa iu kërkuar dhe vlera e tyre si në veçanti por edhe të mbledhura në total, nuk e kalojnë vlerën 10.000 lekë. Dhurata si koncept, lidhur me rastet që mund të pranohet nga nëpunësit publike është përkufizuar në aktet nënligjore, VKM nr. 874, datë 29.09.2021. Në të gjitha episodet e sjella nga prokuroria si fakte penale në ngarkim të të pandehurit Dashnor Braha, nuk përbëjnë raste kërkimi, mit marrje, por gjendemi përballë dhënies nga shtetasit kosovare të një dhurate simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normale të traditës, zakoneve, dhe të praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit. Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Dashnor Braha i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259 e 25 i Kodit Penal, shuarjen e masës së sigurimit.

I pandehuri Dashnor Braha: Jam dakord me avokatin.

8)Mbrojtësi i të pandehurës Elidjana Toçila, av. Luan Buzhiqi: Referuar rrethanave të çështjes, analizës së fakteve dhe provave në seancë gjyqësore, në mbështetje të nenit 388, pika 1, shkronja d), nenit 389, pika 1, nenit 261 shkronja a) si dhe nenet 217 pika 1 dhe 218 pika 1 të K.Pr.Penale, kërkoj pafajësi për të pandehurën Elidiana Toçila, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet që e pandehura e ka kryer veprën që akuzohet. Shuarjen e masës së sigurimit dhe kthimin e sendeve të sekuestruara.

E pandehura Elidjana Toçila: Jam dakord me avokatin.

9)Mbrojtësi i të pandehurit Endrit Uka, av. Sokol Tahiraj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Endrit Uka, për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i kodit Penal. Nëse gjykata e gjen fajtor të pandehurin kërkojmë një dënim mëlehtëdhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

I pandehuri Endrit Uka: Jam dakord me avokatin.

10)Mbrojtësi i të pandehurit Fatri Iseberi, av. Dilaver Smanaj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Fatri Iseberi, i dyshuar se ka kryer veprën penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 159 e 25 të Kodit Penal, pasi nuk provohet se e ka kryer atë.

I pandehuri Fatri Iseberi: Jam dakord me avokatin.

11)Mbrojtësi i të pandehurit Fatri Braha, av. Nikolin Caka: Përfundimisht kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Fatri Braha, nuk provohet që të ketë kryer veprën penale që i atribuohet.

I pandehuri Fatri Braha: Jam dakord me avokatin.

12)Mbrojtësi i të pandehurit Artan Rredhaj, av. Xhuljano Hoxhallari: Nuk është konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ashtu siç kemi kërkuar në fazën e hetimit paraprak por edhe në këtë fazë, në rastin objekt shqyrtimi, për sa i përket hetimit të të pandehurit Artan Rredhaj, në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, rezulton se fakti i pretenduar nuk parashikohet nga ligji se vepre penale, mbi të cilin SPAK ka kryer hetime për të pandehurin Artan Rredhaj, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", ndaj në mbështetje të nenit 328/1, shkronja b) të K.Pr.P, çështja penale në lidhje me këtë vepër penale duhet të pushohet.

I pandehuri Artan Rredhaj: Jam dakord me avokatin. Dua të sqaroj edhe dy gjera teknike. Në atë detyrë kisha tre muaj punë, si unë si Ani Hoxholli dhe Emilton Asllanaj, dhe një i katërt që vazhdon punën. Ligji për shpërdorimin e detyrës thotë që duhet të kesh përfitime morale dhe monetare ose dëmtim të interesit të shtetit. Në këtë rast nuk ka asnjë lloj dëmtimi as përfitim. Kërkoj pushimin e çështjes, kam një të mitur në shtëpi, në rast se nuk punoj unë, nuk e di si mund të jetojë fëmija im.

13)Mbrojtësi i të pandehurit Gëzim Duraku, av. Bardhyl Duraku: Kërkojmë rrëzimin e akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal për shtetasin Gëzim Duraku.

I pandehuri Gëzim Duraku: Jam dakord me avokatin.

14)Mbrojtësi i të pandehurit Haqif Halilaj, av. Asllan Dogjani: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të mbrojturit prej meje Haqif Halilaj pasi nuk provohet se ka konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe 25 i Kodit Penal. Në rast se gjykata nuk e gjen të pafajshëm, kërkojmë pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit. Shuarjen e masës së sigurimit dhe provat materiale të sekuestruara ti kthehen të pandehurit Haqif Halilaj.

I pandehuri Haqif Halilaj: Jam dakord me avokatin.

15)Mbrojtësi i të pandehurit Kapllan Dogjani, av. Shkëlzen Cena Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Kapllan Dogjani, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të

parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal. Shuarjen e masës së sigurimit. Në rastin konkret nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i mbrojturi prej meje ka kryer veprën penale, prandaj kërkojmë që ai të deklarohet i pafajshëm, pasi nuk provohet që ai e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Kërkimi për dhënien e dënimit plotësueses, sipas neneve 30 dhe 35 të K. Penal nuk është i mbështetur në këtë dispozita.

I pandehuri Kapllan Dogjani : Jam dakord me avokatin.

16)Mbrojtësi i të pandehurës Mimoza Shahinaj, av. Shkëlzen Cena Kërkojmë deklarimin e pafajshme të të pandehurës Mimiza Shahinaj, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal. Edhe sikur për një moment të bashkohemi me aludimet e prokurorisë, ekzistenca e faktit penal mbetet vetëm në kuadrin e dyshimit të arsyeshëm dhe nuk e kalon konceptin "përtej". Në nenin 390/1 të K.Pr.P është parashikuar se, kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimit të arsyeshëm gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit. Në rastin konkret nuk provohet tek çdo dyshimi të arsyeshëm se e mbrojtura prej meje Mimoza Shahinaj e ka kryer veprën penale, prandaj duhet të deklarohet e pafajshme. Kërkimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit për një periudhë prej katet vitesh nuk është i bazuar në nenin 59 të K. Penal. Edhe kërkimi i prokurorisë për heqjen e drejtës për të ushtruar funksione publike për pesë vjet është i pabazuar në nenin 30 dhe 35 të K. Penal. Kërkojmë shuarjen e masës së sigurimit dhe po ashtu kthimin e sendeve të sekuestruara me procesverbalin e datës 08.04.2022.

E pandehura Mimoza Shahinaj: Jam dakord me avokatin.

17)Mbrojtësi i të pandehurit Muhamet Cengu, av. Nikolin Caka: Gjykata i ka të gjitha mundësitë që të pranojë qëndrimin e mbrojtjes, nisur edhe nga përmbajtja e nenit 49 të K. Penal që thotë se gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethana të tjera për sa kohë i quaj të tilla që të justifikojnë lehtësimin e dënimit, që në rastin konkret konkurrojnë ndjeshëm, dhe dënimi me paraburgim, ja ka arritur qëllimit që i akuzuari të rehabilitohet dhe të kthehet në gjirin e familjes. Në përfundim i kërkojmë gjykatës që duke e deklaruar fajtor dhe dënimin me 16 muaj burgim për nenin 259/1 të K. Penal, te akuzuarin Muhamet Cengu, ta dënojë me kohën e paraburgimit, duke i dhënë një dënim prej dy vitesh burgim dhe në aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke i zbritur një të tretën e dënimit, ta dënojë me një vit e katër muaj burgim ose me kohen e paraburgimit dhe të urdhërojë lirimin e tij nga paraburgimi pasi nuk mbahet për ndonjë dënim tjetër ose masë sigurimi.

I pandehuri Muhamet Cengu: Nuk jam dakord me qëndrimin dhe kërkimet e avokatit. Jam i pafajshëm dhe kërkoj pafajësi dhe kthimin e telefonit të sekuestruar.

18)Mbrojtësi i të pandehurës Rezarta Lako, av. Shkëlzen Cena Kërkojmë deklarimin e pafajshme të të pandehurës Rezarta Lako, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal. Edhe sikur për një moment të bashkohemi me aludimet e prokurorisë, ekzistenca e faktit penal mbetet vetëm në kuadrin e dyshimit të arsyeshëm dhe nuk e kalon konceptin "përtej". Në nenin 390/1 të K.Pr.P është parashikuar se, kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimit të arsyeshëm gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar

llojin dhe masën e dënimit. Në rastin konkret nuk provohet tek çdo dyshimi të arsyeshëm se e mbrojtura prej meje Mimoza Shahinaj e ka kryer veprën penale, prandaj duhet të deklarohet e pafajshme. Kërkimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit për një periudhë prej katet vitesh nuk është i bazuar në nenin 59 të K. Penal. Edhe kërkimi i prokurorisë për heqjen e drejtës për të ushtruar funksione publike për pesë vjet është i pabazuar në nenin 30 dhe 35 të K. Penal. Kërkojmë shuarjen e masës së sigurimit dhe po ashtu kthimin e sendeve të sekuestruara me procesverbalin e datës 03.04.2022.

E pandehura Rezarta Lako: Jam dakord me avokatin.

19)Mbrojtësi i të pandehurit Urim Lami, av. Jurgen Vatnikaj: Sipas konkluzioneve të paraqitura nga ana jonë dhe në gjendjen që janë aktet e organit të akuzës, gjykata i ka të gjitha provat dhe nga analiza e tyre do të sjellë bindjen për pafajësinë e të mbrojturit prej meje, konform nenit 388/1, d) sepse nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Urim Lami për shkak se nuk provohet se e ka kryer veprën. Kërkojmë kthimin e sendeve të sekuestruara. Në alternative dhënien e një dënimi sa më të butë për këtë të pandehur.

I pandehuri Urim Lami: Jam dakord me avokatin.

20)Mbrojtësi i të pandehurit Vehbi Nerguti, av. Avdi Mataj: Kërkojmë dekarimin fajtor të të pandehurit Vehbi Nerguti pasi provohet që e ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me minimumin e mundshëm. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal te pezullohet ekzekutimi i dënimit të mësipërm duke e zëvendësuar me detyrimin për të pandehurin Vehbi Nerguti të paraqitet pranë shërbimit të provës. Kërkojmë aplikimin e nenit 59 të K. Penal. pasi plotësohen kushtet. Kërkojmë kthimin e sendit te sekuestruar telefon dhe shumes 11.300 leke dhe 175 euro.

I pandehuri Vehbi Nerguti: Jam dakord me avokatin.

21)Mbrojtësi i të pandehurës Vojsava Selmani, av. Përparim Noka: Rezulton se e pandehura nuk provohet se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 259 dhe 25 i K. Penal. Fajësia e të pandehurës nuk u arrit të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Prandaj bazuar në nenin 388, pika 1, shkronja d të K.Pr.Penale. Kërkojmë deklarimin e pafajshme të të pandehurës Vojsava Selmani. Në alternativë, nëse gjykata krijon bindjen se akuza në ngarkim të saj është e provuar tej çdo dyshimi te arsyeshëm, atëherë kërkojmë që në llojin dhe masën e dënimit të mbajë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të parashikuara në nenet 48 dhe 49 të K. Penal, duke dhënë një dënim të barabartë me kohën e zbatimit të masës së sigurimit "arrest në shtëpi". Kërkojmë kthimin e sendeve të sekuestruara të pandehurës.

E pandehura Vojsava Selmani: Jam dakord me avokatin.

22)Mbrojtësi i të pandehurës Xhuljana Maksutaj, av. Jurgen Vatnikaj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të shtetases Xhuljana Maksutaj për shkak se nuk provohet se e ka kryer veprën. Kërkojmë kthimin e sendeve të sekuestruara. Në alternative kërkojmë dënimin e saj me minimumin që parashikon dispozita ligjore, në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale ti ulet 1/3 e dënimit dhe në aplikim të nenit 59 të K. Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë të kësaj shtetase për dyfishin e kohës së mbetur të dënimit..

E pandehura Xhuljana Maksutaj: Jam dakord me avokatin.

23)Mbrojtësi i të pandehurit Bedri Duraku, av. Dilaver Smanaj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të te pandehurit Bedri Duraku si i dyshuar se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 259 e 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer atë.

I pandehuri Bedri Duraku: Jam dakord me avokatin.

24)Mbrojtësi i të pandehurit Avni Tërshalla, av. Ilir Nerguti: Nga shtetasi Avni Tërshalla nuk rezulton të ketë një kërkim ryshfeti siç është relatuar nga prokuroria në materialet e saj. Nga veprimet e të pandehurit Avni Tërshalla te fiksuara në kamera dhe përgjimi, të vetmin episod të datës 12.02.2022, nuk konstatohet asnjë element i konfigurimit të veprës penale për të cilën ai është akuzuar. Duke qenë para parashikimet ligjor të bërë në nenin 377 të K.Pr.Penale, jemi të mendimit që gjykata për të pandehurin Avni Tërshalla duket te deklarojë pafajësinë e tij për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259-25 i K. Penal.

I pandehuri Avni Tërshalla: Jam dakord me avokatin.

25)Mbrojtësi i të pandehurit Arben Goçi, av. Relandi Meka: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arben Goçi. për veprën penale të parashikuar nga neni 259 e 25 i Kodit Penal. Në rast se gjykata e gjen fajtor të pandehurin, kërkojmë dënimin e tij me kohën e vuajtur të paraburgimit.

I pandehuri Arben Goçi: Jam dakord me avokatin.

26)Mbrojtësi i të pandehurit Reni Dokolli, av. Sokol Tahiraj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Reni Dokolli për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal. Nëse gjykata e gjen fajtor të pandehurin kërkojmë një dënim më të lehtë dhe aplikimin e nenit 59 tëK. Penal.

I pandehuri Reni Dokolli: Jam dakord me avokatin.

27)Mbrojtësi i të pandehurit Shpëtim Cenaj, av. Sokol Tahiraj: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të te pandehurit Shpëtim Cenaj për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal.

I pandehuri Shpëtim Cenaj: Kërkoj deklarimin e pafajshëm të personit tim për akuzën e Korrupsionit pasiv të personave të ushtrojnë funksione publike, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 259/1 e 25 i Kodit Penal. Duke pasur bësim të ndjenjën tuaj humanitare, profesionalizmin, objektivitetin ligjor të drejtësisë që ju përfaqësoni dhe zbatoni, kam besim që këto arsyetimi do të gjejnë mbështetje nga ana juaj.

28)Mbrojtësi i të pandehurit Sulë Onuzi, av. Dritan Trifka: Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të mbrojturit prej meje Sulë Onuzi, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 251/1 e 25 i Kodit Penal, pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri Sulë Onuzi: Jam dakord me avokatin.

29)Mbrojtësi i të pandehurit Klevis Salkurti, av. Ismail Uka: Përfundimisht kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Klevis Salkurti për akuzën e veprës penale të parashikuar nga neni 145/1 i Kodit Penal, për shkakun se nuk provohet që i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale. Heqjen e masës së sigurimit, për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit.

I pandehuri Klevis Salkurti: Jam dakord me avokatin.

30)Mbrojtësi i të pandehurit Xhafer Elezi, av. Ilir Nerguti: Ndaj shtetasit Xhafer Elezi nuk rezulton asnjë kërkim ryshfeti siç është relatuar nga prokuroria ne materialët e saj. Në veprimet e të pandehurit Xhafer Elezi të fiksuara nga përgjimi telefonik (jo drejtpërdrejt i numrit të tij) në të vetmin episod të një date të vetme, nuk konstatohet asnjë element i konfigurimit të veprës penale për të cilën ai është akuzuar. Duke qene para parashikimit ligjor të bërë në nenin 377 të K.Pr.Penale, jemi te mendimit që gjykata për të pandehurin Xhafer Elezi duhet të deklarojë pafajësinë e tij për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

I pandehuri Xhafer Elezi: Jam dakord me avokatin.

31)Mbrojtësi i të pandehurit Sazan Ibra, av. Ndriçim Çupi: Duam të theksojmë se kemi vetëm mbi bazën e indicieve dhe nuk ka asnjë prove konkrete që kjo vepër penale të jetë ekzekutuar në të gjithë elementet e saj dhe ti ketë cenuar marrëdhëniet juridike që janë në mbrojtje të këtyre normave. Në rastin konkret duket sikur këto indicie kanë vlerë të paracaktuar dhe mbi të gjitha janë marrë si prova në kundërshtim me dispozitën konkrete, nenin 152 të K.Pr.Penale. Kemi vetëm disa përgjime që nuk vërtetojnë për asnjë moment ekzistencën e veprës penale apo akoma më shumë të vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm për të dënuar të pandehurin. Kërkojmë deklarimin e pafajshëm të të pandehurit dhe shuarjen e masës së sigurimit.

I pandehuri Sazan Ibra: Jam dakord me avokatin.

32)Mbrojtësi i të pandehurit Atli Jashari, av. Hysni Beti: Kërkojmë pushimin e akuzës dhe të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Atli Jashari për akuzën e "ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal si dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Atli Jashari. Shuarjen e masës së sigurimit. Urdhërimin e lirimit te menjëhershëm të të pandehurit Atli Jashari. Shprehim bindjen se arsyetimit tona ligjore dhe logjike do te gjejnë mbështetje nga ana juaj, duke u bazuat në ndjenjën e humanizmit, të objektivitetit, të paanshmërisë në funksion të dhënies së një drejtësie sa më funksionale në zbatim të parimeve humanitare themelore të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

I pandehuri Atli Jashari: Jam dakord me avokatin.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në datë 25.10.2022, kërkesën penale me nr. 123 regj.them., datë regjistrimi 25.10.2022, me objekt: **Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 272, të vitit 2020**, në ngarkim të të pandehurve: **1.** ***Fran Kaçorri***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; **2.** ***Atli Jashari***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit

Penal; **3.** ***Lahert Sulo***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. **4.** ***Ani Hoxholli***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **5.** ***Emilton Asllanaj***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **6.** ***Halim Shehu***, akuzuar për kryerjen e veprave penale "Shpërdorim detyre" e kryer në bashkëpunim dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **7.** ***Arben Kastrati***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **8.** ***Arjan Sokoli***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**9.** ***Dashnor Braha***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **10.** ***Elidjana Toçila***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**11.*****Endrit Uka***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **12.** ***Fatri Iseberi***, akuzuar për kryerjen e veprave penale "Shpërdorim detyre" e kryer në bashkëpunim dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**13.** ***Fatri Braha***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **14.** ***Artan Redhaj***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; **15.** ***Gëzim Duraku***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**16.** ***Haqif Halilaj***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **17.** ***Kapllan Dogjani***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **18.*****Mimoza Ismaili (Shahinaj)***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**19.** ***Muhamet Cengu***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**20.** ***Rezarta Lako***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i

personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **21.** ***Urim Lami***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **22.** ***Vehbi Nerguti***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **23.** ***Vojsava Selmani***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **24.** ***Xhuljana Maksutaj***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **25.** ***Bedri Duraku***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **26.** ***Avni Tërshalla***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal; **27.** ***Arben Goçi***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**28.** ***Reni Dokolli***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**29.** ***Shpëtim Cenaj***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**30.** ***Sulë Onuzi***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal;**31.** ***Klevis Salkurti***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal;**32.** ***Xhafer Elezi***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal; **33.** ***Sazan Ibra***, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal dhe 34. ***Ylber Hoxha (Istrefi),*** akuzuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Çështja ndaj të pandehurit Ylber Hoxha (Istrefi) rezulton të jetë ndarë në fazën e seancës paraprake.

2. Gjykata, në përfundim të seancës paraprake, me vendimin nr. 123 regj., datë 02.12.2022, ka disponuar për pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 272, të vitit 2020 kundër të pandehurve të referuar më sipër, me akuzat respektive të ngritura nga Prokuroria e Posaçme, pa ndryshime, përveç të pandehurit Ylber Hoxha, për të cilin është bërë ndarja e çështjes në seancë paraprake për shkak të mos gjetjes së tij. Në pikën e tretë të vendimit gjykata ka disponuar si vijon: " *III. Së bashku me kërkesën e*

Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohet edhe kërkesa e të pandehurve: Atli Jashari, Lahert Sulo, Ani Hoxholli, Emilton Asllanaj, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Iseberi, Fatri Braha, Artan Redhaj, Gëzim Duraku (Gjuta), Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuliana Maksutaj, Bedri Duraku, Avni Tërshalla, Arben Goçi, Reni Dokolli, Shpëtim Cenaj, Sulë Onuzi, Klevis Salkurti, Xhaferr Elezi dhe Sazan Ibra, ***për gjykim të shkurtuar.***"

3. Me shortin e datës 16.12.2022 kjo çështje është caktuar për gjykim pranë trupit gjykues që procedon. Në seancën gjyqësore të datës 10.01.2023, disa nga mbrojtësit[1] dhe të pandehurit prezent në seancë, kërkuan deklarimin e mos kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes pranë gjykatës kompetente, në këtë rast Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Po ashtu, disa prej tyre kërkuan edhe ndarjen e çështjes. Prokurorët lidhur me këtë kërkim parashtruan se ai është i pabazuar pasi procedimi penal është regjistruar para ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021 në drejtim të përcaktimit të kompetencës lëndore të Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme.

4. Gjykata, pasi dëgjoi palët dhe shqyrtoi aktet e çështjes, vlerësoi se kjo kërkesë nuk ishte e bazuar në ligj për sa vijon: Kompetenca lëndore, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ, nenit 42 të

---

[1]***Av.Ardian Leka, mbrojtësi i të pandehurit Fran Kaçorri,*** *paraqiti kërkesë me shkrim për deklarimin e mos kompetencës lëndore të gjykatës në kushtet kur i pandehurit Fran Kaçorri akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal, dhe në kuptim të nenit 75/a dhe 83 të K.Pr.P GJKKO nuk është kompetente për gjykimin e çështjes ndaj këtij të pandehuri;****Av. Hysni Beti, mbrojtës i të pandehurit Atli Jashari,*** *bazuar në parashikimet e nenit 93 dhe 354 të K.Pr.Penale kërkoi ndarjen e çështjes në ngarkim të të pandehurit Atli Jashari i cili akuzohet vetëm për veprën penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", jo në bashkëpunim dhe për këto arsye, duke qenë se nuk ka asnjë lidhje me të pandehurit e tjerë, nuk ka asnjë pengesë si dhe për ekonomi gjyqësore, të ndahet çështja ndaj tij dhe të gjykohet me vete nga po kjo gjykatë;* ***Av. Ismail Uka, mbrojtësi i të pandehurit Klevis Salkurti,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës për gjykimin e çështjes ndaj këtij të pandehurit me arsyetimin se ai nuk akuzohet për kryerjen e ndonjë vepre penale në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë si dhe fakti penal për të cilin akuzohet nuk ka lidhje me atë për të cilin akuzohen të pandehurit e tjerë. Po ashtu çështja ndaj tij është gjykuar dhe zgjidhur me vendimin nr. 1531/503 datë 29.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës nëpërmjet të cilit është pushuar çështja ndaj shtetasit Robert Saraçi, që lidhet me të njëjtin fakt penal që i atribuohet të pandehurit Klevis Salkurti. Bazuar në nenet 75 dhe 98 të K.Pr.Penale kërkoi ndarjen e çështjes dhe deklarimin e mos kompetencës, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.* ***Av. Ndriçim Çupi, mbrojtës i të pandehurit Sazan Ibra,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës lëndore të GJKKO për gjykimin e çështjes ndaj këtij të pandehuri i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 pg.1 i K. Penal, vepër e cila nuk është në kompetence të GJKKO;****Av.Zeni Qinami, mbrojtësi i të pandehurit Emilton Asllani,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës lëndore të GJKKO pasi i pandehurit Emilton Asllani akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1, në bashkëpunim, e cila nuk është në kompetencën lëndorë të kësaj gjykate;****Av. Baftjar Rusi, mbrojtësi i të pandehurit Muhamet Cengu,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës lëndore të GJKKO me argumentin se akuza ndaj të pandehurit të mbrojtur prej tij është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;****Av. Shaban Nexhi, mbrojtësi i të pandehurit Arben Kastrati,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës lëndore të GJKKO me argumentin se akuza ndaj të pandehurit të mbrojtur prej tij është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;* ***I pandehuri Ani Hoxholli, asistuar nga mbrojtësja e zgjedhur prej tij,*** *kërkoi deklarimin e mos kompetencës lëndore të GJKKO pasi ligji procedural ka ndryshuar ne datë 01.06.2021 dhe për pasojë kjo çështje nuk duhet të gjykohet nga kjo gjykatë.*

Kushtetutës si dhe nenit 83, pika 1 të K.Pr.Penale, në funksion të respektimit të parimit të ligjshmërisë dhe parimit të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht në drejtim të vlerësimit të konceptit të "*gjykatës së krijuar me ligj*" përbën çështje e cila ngrihet dhe vlerësohet, me kërkesë të palëve ose kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Par pasojë, në aspektin procedural, parashtrimi i kërkesave në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës në fazën e kërkesave paraprake në kuptim te nenit 405/5 apo 354 të K.Pr.Penale, vlerësohet nga gjykata se është bërë në fazën e duhur procedurale dhe për pasojë duhet ti nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit të saj. Po ashtu, lidhur me kërkesat par ndarjen e çështjes, gjykata vlerësoi se ato bëjnë pjesë në natyrën e kërkesave paraprake, në kuptim të nenit 354 të K.Pr.Penale dhe për pasojë, u vlerësua se ishin paraqitur në fazën e duhur procedurale.

5. ***Lidhur me vlerësimin e çështjes së kompetencës lëndore,*** gjykata referuar dispozitave procedurale penale që rregullojnë kompetencën lëndore të gjykatës, duke pasur në vëmendje edhe qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në të cilën është theksuar se mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit.[2], vlerëson se e drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore, përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit[3].Kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar parashikohet në nenin 75/a të K.Pr.Penale, në shkronjën a) të të cilit parashikohet se: "*Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b,233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245,* ***245/1, paragrafët 2 dhe 4****, 257, 258, paragrafi 2,****259, paragrafi 2****, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe328/b të Kodit Penal.*"[4] Formulimi i këtij paragrafi ka ndryshuar me ligjin nr. 41/2021 datë 23.03.2021, duke përcaktuar se Gjykata e Posaçme është kompetente në aspektin lëndor, ndër të tjera, për gjykimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 245/1 pg 2 dhe 4 dhe 259 pg 2 i Kodit Penal. Rrjedhimisht, për veprat penale të kualifikuara sipas paragrafëve të tjerë të këtyre dy neneve të Kodit Penal (*përkatësisht 245/1 pg 1 dhe 3 dhe 259 pg 1 i K. Penal*) kompetente në aspektin lëndor është gjykata penale e juridiksionit të përgjithshëm. Para këtij ndryshimi, i cili

---

[2] *Shih vendimin Nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.*

[3] *Shih vendimin Nr. 31, datë 01.12.2005 dhe vendimin nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.*

[4] *Neni 75/a, pika 1 , shkronja a) i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve të bëra me ligjin41/2021 ka pasur këtë përmbajtje: "Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a,* ***245****, 245/1, 257, 258,* ***259****, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.".*

ka hyrë në fuqi në datë 01.06.2021[5], veprat penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 245/1 të Kodit Penal ishin në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme, pavarësisht paragrafit sipas të cilit ishte kualifikuar fakti penal, duke mbajtur në konsideratë këtu edhe faktin se veprat penale të parashikuara nga nenet 245/1 dhe 259 të Kodit Penal, janë ndryshuar tërësisht në formulim, me ligjin nr. 43/2021 i cili po ashtu ka hyrë në fuqi në datë 01.06.2021, sipas përcaktimeve të nenit 5 të po këtij ligji.

6. Po ashtu, ligji nr. 41/2021, datë 23.3.2021, lidhur me efektet e ndryshimeve procedurale të parashikuara prej tij, ndër të cilat edhe ndryshimet për kompetencën lëndore të gjykatave, përmban një dispozitë tranzitore, përcaktuar në nenin 38, pika 3 të tij, me këtë përmbajtje: "3. *Çështjet që janë në kompetencën e Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimit të nenit 75/a përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që janë regjistruar përpara datës 1 qershor 2021 hetohen dhe gjykohen nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pavarësisht ndryshimit të kompetencës lëndore, sipas nenit 7 të këtij ligji*.". Referuar dispozitës kalimtare, rezulton se në të është materializuar qartë vullneti i ligjvënësit për të përcaktuar vijueshmërinë e hetimit dhe gjykimit të çështjeve për të cilat procedimi penal është regjistruar para datës 01.06.2021 nga Prokuroria e Posaçme, pranë kësaj të fundit dhe gjykimi i këtyre çështjeve të hetuara nga prokuroria kompetente sipas kësaj dispozite, nga gjykata kompetente e cila është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë par Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky qëllim i ligjvënësit, përveçse rezulton i qartë nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar, materializohet edhe në relacionin shoqërues të projektligjit përkatës, në të cilin përcaktohet se: "*...Po ashtu, neni 38 ka parashikuar qe çështjet te cilat janë ne kompetencën lëndore te Prokurorisë dhe Gjykatave te Posaçme, sipas përmbajtjes se nenit 75/a, përpara ndryshimeve nëpërmjet këtij projektligji, dhe qe regjistrohen përpara datës 1 qershor 2021, do te vijojnë te hetohen dhe gjykohen nga Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme. Nëpërmjet këtij rregullimi tranzitor, garantohet përmbushja e ruajtja e kompetencës lëndore te Prokurorisë dhe Gjykatave te Posaçme, për çështjet qe janë regjistruar ne këto organe.*"[6]. Referuar sa më sipër, gjykata vlerëson se qëllimi i ligjvënësit, nëpërmjet kësaj dispozite kalimtare, ka qenë që të garantohet përmbushja e ruajtja e kompetencës lëndore te Prokurorisë dhe Gjykatave te Posaçme, për çështjet të cilat *(i)* janë regjistruar para datës 01.06.2021 dhe *(ii)* në momentin e regjistrimit kanë qenë në kompetencë të prokurorisë/gjykatës së posaçme.

7. Në rastin konkret rezulton se procedimi penal me nr. 272, i vitit 2020 është regjistruar në datë **10.11.2020**, për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, dhe për pasojë, në kushtet kur ky procedim është regjistruar **para datës 01.06.2021**, nga prokuroria kompetente sipas parashikimeve të ligjit procedural penal të kohës, dhe dispozita kalimtare e ligjit nr.41/2021

---

[5] *Në nenin 39 të ligjit nr. 41/2021, lidhur me hyrjen në fuqi të dispozitës që ndryshon formulimin e nenit 75/a të K.Pr.Penale, në lidhje me kompetencën lëndore, parashikon se :"1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç sa është parashikuar në pikën 2 të këtij neni.**2. Neni 7 i këtij ligji hyn në fuqi më 1 qershor 2021.**".*

[6] *Shih http://ëëë.parlament.al:5000/Files/20210227124120Relacion%207905.pdf*

parashikon shprehimisht se procedimet e regjistruara do të vijojnë të hetohen nga Prokuroria e Posaçme dhe për pasojë, të gjykohen nga gjykata e posaçme, kjo gjykatë vlerëson se është kompetente në aspektin lëndor për gjykimin e çështjes, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar neni 75/a i K.Pr.P lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës, duke reflektuar edhe ndryshimet që vetë ligji penal material ka pësuar në disa nene (*posaçërisht edhe në nenet 259 dhe 245/1 të K. Penal*) duke përcaktuar ndarjen e kompetencës lëndore për këto figura të veprës penale, referuar paragrafëve të caktuar, mes gjykatave të posaçme dhe gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

8. Gjykata vlerëson se përcaktimi i ligjvënësit nëpërmjet dispozitës tranzitore është i qartë dhe i referohet si datës së regjistrimit të procedimit penal, për çështjet që në atë datë kanë qenë në hetim, ashtu edhe datës së regjistrimit në gjykatë, për çështjet që kanë qenë në fazën e gjykimit. Ndarja e këtij momenti, në rastin e çështjeve që në datë 01.06.2021 kanë qenë në hetim dhe vijimi i hetimeve për to nga Prokuroria e Posaçme ndërkohë që në momentin e regjistrimit të po atyre çështjeve në gjykatë (*nëpërmjet kërkimit par dërgimin e çështjes në gjyq apo kërkesës par pushimin e procedimit*) nuk do të kishte kuptim logjik dhe ligjor pasi për një çështje nuk mund të jetë kompetente Prokuroria e Posaçme dhe të lejohet të vijojë hetime dhe ndërkohë që në momentin e gjykimit të saj, pasi ndryshimet ligjore kanë hyrë në fuqi që gjatë hetimit, çështja të kërkohej të dërgohej për gjykim pranë gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm. Ky rregullim ligjor, i materializuar në dispozitën tranzitore, ka për qëllim pikërisht përmbushjen e qëllimit të ligjvënësit për të garantuar ruajtjen e kompetencës lëndore të Prokurorisë së Posaçme, për pasojë edhe të Gjykatës së Posaçme pranë se cilës ajo vepron, për çështjet të cilat janë regjistruar para datës 01.06.2021 dhe për të cilat, për shkak të ligjit nr. 41/2021 kompetenca lëndore ka pësuar ndryshime.

9. ***Sa më sipër***, gjykata çmoi se është kompetente për shqyrtimin e çështjes, pasi kjo çështje është në kompetencën lëndore të hetimit të Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe në kompetencën lëndore për gjykim të Gjykatës së Posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 75/a, përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 41/2021, si dhe procedimi objekt gjykimi është regjistruar përpara datës *1 qershor 2021*, duke bërë që në këtë rast të gjejë zbatim dispozita tranzitore e ligjit përkatës, konkretisht nenet 38 dhe 39të këtij ligji.

10. ***Lidhur me kërkimet e të pandehurve*** të cilët akuzohen për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, vepër e cila nuk ka qenë dhe nuk është në kompetencë të Prokurorisë dhe Gjykatës së Posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a , shkronja a) të K.Pr.P, si para edhe pas ndryshimeve që kjo dispozitë ka pësuar me ligjin nr. 42/2021, gjykata vlerëson se është kompetente në aspektin lëndor, në referim të nenit 80 të K.Pr.Penale, në kuadër të procedimeve të lidhura, pasi në rastin konkret, pavarësisht akuzave për të cilat procedohen disa prej të pandehurve, rezulton se: *(i)* për dy prej tyre dhe konkretisht të pandehurit Halim Shehu dhe Fatri Iseberi, rezulton se akuzohen për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 248 në lidhje me nenin 25 si dhe neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, duke qenë në këtë rast në kushtet e një procedimi të lidhur, për shkak të procedimit për dy vepra penale, një prej të cilave është në kompetencë të Gjykatës së Posaçme, si dhe në kushtet e akuzës për kryerjen e veprave penale respektive në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, të cilët

akuzohen për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, e cila siç u referuar më sipër, është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme;*(ii)*për dy prej tyre dhe konkretisht për të pandehurit Fran Kaçorri dhe Artan Rredhaj, rezulton se akuzohen vetëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, vepër e cila nuk është në kompetence të gjykatës së posaçme, por procedimi penal i tyre konsiderohet i lidhur me atë ndaj të pandehurve të tjerë, pasi jemi para të njëjtit procedim penal dhe ndarja e tij, në këtë fazë të procesit, vlerësohet nga gjykata se mund të dëmtojë vërtetimin e fakteve në kuptim të neneve 80 dhe 93 të K.Pr.Penale.

11. *Lidhur me kërkimin e paraqitur nga disa prej të pandehurve dhe konkretisht nga të pandehurit Atli Jashari dhe Klevis Salkurti për ndarjen e çështjes* në ngarkim të tyre me argumentimin se fakti penal për secilin prej tyre nuk ka lidhje me faktin penal për të cilin procedohen të pandehurit e tjerë, në raport me parashikimet e nenit 79, 80 dhe 93 të K.Pr.Penale, u vlerësua nga gjykata si një kërkim i pabazuar në ligj. Në rastin konkret, për secilin prej këtyre të pandehurve nuk rezulton të jenë prezent rastet që ligji procedural parashikon në nenin 93 të tij për ndarjen e çështjeve, në të cilin parashikohen si rrethana që diktojnë ndarjen e çështjeve, me kusht që të mos dëmtohet vërtetimi i fakteve, rastet kur : *(i)* për një a më shumë të pandehur apo për një a më shumë akuza është vendosur pezullimi i procedimit; *(ii)* për shkak të mosparaqitjes së një a më shumë të pandehurve për shkaqe që lidhen me njoftimin e tyre ose *(iii)* për një a më shumë të pandehur apo një a më shumë akuza hetimi është i plotë ndërsa par të tjerët është e nevojshme të kryhen veprime të tjera. Ndarja e çështjeve ndaj të pandehurve të ndryshëm apo për fakte penale të ndryshme, kur ato janë hetuar dhe dërguar për gjykim në kuadër të të njëjtit procedim penal, nëse nga ndarja nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve, mund të diktohet vetëm nga rrethana specifike të karakterit procedural, sikurse parashikon neni 93 i K.Pr.P. Në rastet kur për një më shumë të pandehur janë kushtet par pezullimin e çështjes në referim të nenit 352 të K.Pr.P ndërkohë që për të tjerët, gjykimi duhet të vijojë apo në rastet kur për një a disa të pandehur janë kushtet për procedimin me ritin e gjykimit të shkurtuar ndërkohë që për një a disa të pandehur procedohet me ritin e gjykimit të zakonshëm, dhe par pasojë vazhdimin i gjykimit të tyre në të njëjtën çështje rezulton i pamundur me dy rite të ndryshme gjykimi.

12. Sa më sipër, Gjykata në seancën e datës 25.01.2023, bazuar në parashikimet e neneve 405/5, 354, 83, 75/a, 92, 93 të Kodit të Procedurës penale dhe nenit 38 të ligjit nr. 41/2021, vendosi: *1) Mospranimin e kërkesës së të pandehurve Fran Kaçorri, Alti Jashari, Klevis Salkurti, Sazan Ibra, Emilton Asllani, Muhamet Cengu, Arben Kastrati dhe Ani Hoxholli për deklarimin e mos kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Pare par Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar par gjykimin e çështjes penale në ngarkim të tyre. 2) Mospranimin e kërkesës së të pandehurve Atli Jashari dhe Klevis Salkurti par ndarjen e çështjes në ngarkim të secilit prej tyre dhe gjykimin më vetë. 3) Kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës mund të bëhet ankim bashkë me vendimin përfundimtar.*

13. Lidhur me kompetencën lëndore, veç sa u analizua më sipër, gjykata kryesisht vlerëson se çështja, në referim të parashikimeve të nenit 69 të K.Pr.Penale, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor penal dhe në referim të neneve 74, 80, 75/a, pika 1, shkronja a) të K.Pr.Penale, nenit 8,

të ligjit nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", si dhe neneve 7, 38 dhe 39, pika 2 të ligjit nr. 41/2021, është në kompetencën e saj lëndore dhe tokësore. Sa i përket përbërjes së gjykatës që gjykon çështjen në themel, në respektim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sipas parashikimeve të nenit 13, pika 3/1 të K.Pr.Penale, gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

14. Në seancën gjyqësore të datës 25.02.2023, ora 09.00, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe konstatimit të prezencës së Prokurorisë së Posaçme si dhe të 33 të pandehurve, së bashku me mbrojtësit e zgjedhur prej tyre, në referim të parashikimeve të nenit 405/5 të K.Pr.P, pas shqyrtimit të kërkesave paraprake të ndryshme nga kërkesa për procedim me gjykim të shkurtuar, Gjykata pyeti të gjithë pandehurit që ishin të pranishëm, asistuar nga mbrojtësit e zgjedhur, nëse i qëndronin kërkesës për gjykim të shkurtuar të bërë përpara gjyqtarit të seancës paraprake. Me përjashtim të të pandehurit Fran Kaçorri i cili kërkoi të procedohej me gjykim të zakonshëm, sikurse kishte kërkuar me herët në seancë paraprake, dhe të ndahej çështja në ngarkim të tij për këtë shkak, të pandehurit e tjerë personalisht dhe nëpërmjet mbrojtësve kërkuan të procedohej me gjykim të shkurtuar.

15. Lidhur me këtë kërkesë, gjykata, pasi dëgjoi parashtresën e prokurorit, mori në analizë mundësinë e shqyrtimit të çështjes në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e paraqitura nga organi i akuzës, pasi kjo përbën në thelb ritin e gjykimit të shkurtuar, në respektim të nenit 405, pika 7, në lidhje me nenin 403 të K.Pr.Penale, Vendimin nr. 4, datë 10.02.2012[7] të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 2, datë 29.01.2003, vendosi pranimin e kërkesës së 32 pandehurve, përveç të pandehurit Fran Kaçorri, që në themel të procedohej me gjykim të shkurtuar, duke vlerësuar se:

16. ***Së pari,*** kërkesa për gjykimin e shkurtuar ishte paraqitur nga 32 të pandehurit në momentin e duhur procedural, konkretisht në seancë paraprake nga vetë të pandehurit, asistuar nga avokatët e zgjedhur prej tyre, në respektim të nenit 403, pika 1 të K.Pr.Penale, në të cilin parashikohet se "*Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancë paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3 të nenit 406/ç të këtij Kodi, me pasojë mospranimi.*" Kjo kërkesë u konfirmua prej tyre edhe para gjykatës që gjykon çështjen në themel.

---

[7] *Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, ka arsyetuar se: " Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, ka arsyetuar se: "...ndonëse, gjatë gjykimit të zakonshëm, është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, në gjykimet e posaçme, siç konsiderohet dhe gjykimi i shkurtuar, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në përputhje me veçoritë e këtij gjykimi e, në veçanti me faktin se për të proceduar me këtë lloj gjykimi, përveç kërkesës së të pandehurit kërkohet detyrimisht edhe vendimi/miratimi i gjyqtarit (shih paragrafin 18 të këtij vendimi). E thënë ndryshe, gjyqtari në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (shih paragrafin 19 të këtij vendimi), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori. Si pasojë, nëse ka dyshime mbi këtë cilësim, ky element mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme duke respektuar kështu të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, si kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes, etj."*

17. ***Së dyti,*** veprat penale për të cilat akuzohen të pandehurit që paraqitën kërkesë për procedim me gjykim të shkurtuar, nuk bëjnë pjesë në ato vepra penale për të cilat nuk lejohet të procedohet me ketë rit të posaçëm gjykimi, referuar parashikimeve të nenit 403, pika 2 të K.Pr.Penale, në të cilin përcaktohet se: *"Nuk pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm"*. Në rastin konkret të gjithë të pandehurit që paraqitën kërkesë për procedim me gjykim të shkurtuar akuzohen për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 248 në lidhje me nenin 25, 244/1/1 ose 259/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, vepra të cilat nuk parashikojnë masa dënimi të tilla që të ndalojnë aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar.

18. ***Së treti,*** gjatë fazës së kërkesave paraprake, të pandehurit apo mbrojtësit e tyre nuk ngritën pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, si dhe nuk kërkuan marrjen e provave të reja në gjykim. Verifikimi mbi vlefshmërinë e akteve të hetimit dhe prezencën e shkaqeve që sjellin papërdorshmëri të provave, shqyrtohet nga gjykata kryesisht (*mbi pavlefshmërinë absolute të akteve dhe papërdorshmërinë e provave*) ose me kërkesë të palëve (*mbi pavlefshmërinë absolute ose relative të akteve dhe papërdorshmërinë e provave*). Në drejtim të vlerësimit mbi prezencën e elementeve që bëjnë absolutisht të pavlefshme aktet e hetimit apo verifikimit dhe vlerësimit mbi ligjshmërinë e marrjes së provave, gjykata kryesisht nuk konstatoi pavlefshmëri absolute të akteve të hetimit ose papërdorshmëri të provave. Në lidhje me pavlefshmërinë e akteve neni 128 dhe 128/a i K.Pr.P, ka përcaktuar në mënyrë taksative rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve duke parashikuar se: " *Aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ky Kod.*" Ndërkohë në nenin 128/a të K.Pr.P janë përcaktuar tri rastet që pasjellin pavlefshmëri absolute të akteve dhe në rastin konkret, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që përmbajnë fashikujt e hetimit, nuk rezulton të jetë prezent asnjë prej tyre. Në lidhje me papërdorshmërinë e provave, institut u cili evokon parimin e ligjshmërisë në procedimin penal, po ashtu është trajtuar nga jurisprudenca si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës. Në këtë këndvështrim, është detyrë e gjykatës të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ka qenë e drejtë dhe e ligjshme. Në nenin 151, pika 3 të K.Pr.Penale parashikohet se: *"Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren."*. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se është parashikuar sanksioni i papërdorshmërisë së provave, duke nënkuptuar se gjykatat nuk mund të bazojnë vendimin e tyre në prova të papërdorshme. Po kështu, me qëllim mosdhënien e një vendimi mbi prova të papërdorshme, legjislatori ka parashikuar se nuk ka asnjë kufizim kohor në lidhje me ngritjen e një pretendimi të tillë, pavarësisht gjendjes apo shkallës ku ndodhet procedimi. Në kuptim të parimit të disponimit, gjykata merr në shqyrtim kryesisht papërdorshmërinë në proces, duke shtrirë papërdorshmërinë edhe për fazën e hetimeve paraprake apo edhe në procedurën e masave të sigurimit. Gjykata vlerëson se, duke qenë se papërdorshmëria është një *lloj pavlefshmërie/paligjshmërie* që nuk godet aktin në vetvete, por provën që merret në saje të tij,

ajo (*papërdorshmëria*) është një sanksion procedural me karakter të veçantë pasi godet vetëm ato *akte* që përmbajnë apo në sajë të të cilave janë marrë prova. *Në referim të sa më sipër, gjykata kryesisht,* vlerëson se nga tërësia e provave të marra gjatë fazës së hetimit, rezulton se ato janë marrë në respektim të dispozitave ligjore procedurale që përcaktojnë burimet e provës në procesin penal dhe normojnë procesin e ligjshëm të marrjes së secilës prej tyre. Për pasojë, në referim të nenit 151 të K.Pr.P, në raport me dispozitat që normojnë llojet e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre sipas dispozitave konkrete të përcaktuara në nenet 149-197 (Titulli IV, Kreu I) si dhe mjetet e kërkimit të provës rregulluar nga ligjvënësi në nenet 198-225 (Titulli IV, Krei II) i K.Pr.P, provat mbi të cilat prokuroria mbështet akuzën ndaj të pandehurve, nuk përmbajnë "defekte" që cenojnë përdorshmërinë e tyre.

19. ***Së katërti,*** gjykata çmoi se hetimet paraprake të kryera nga Prokuroria e Posaçme, në kuadër të këtij procedimi penal, mundësojnë gjykimin dhe zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, duke disponuar për pranimin e kërkesës së të pandehurve *Lahert Sulo, Ani Hoxholli, Emilton Asllanaj, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Iseberi, Fatri Braha, Artan Redhaj, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj, Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku, Avni Tërshalla, Arben Goçi, Reni Dokolli, Shpëtim Cenaj, Sulë Onuzi, Klevis Salkurti, Xhafer Elezi, Sazan Ibra, dhe Atli Jashari* dhe vijimin e gjykimit të çështjes me procedurën e gjykimit të shkurtuar, në referim të parashikimeve të nenit 403 dhe 405 të K.Pr.Penale.

20. Duke konsideruar se gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, eviton fazën e hetimit gjyqësor dhe në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to, me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit u kthye në dosje gjyqësore dhe shërbeu si bazë në parashtrimin e diskutimeve përfundimtare të palëve *(neni 405, pika 8 të K.Pr.Penale)* dhe për dhënien e vendimit nga gjykata. Gjykimi u zhvillua vetëm mbi bazën e provave të siguruara gjatë fazës së hetimeve paraprake, të cilat nuk iu nënshtruan debatit gjyqësor, nuk u administruan gjatë gjykimit prova të reja (*me përjashtim të akteve lidhur me personalitetin e të pandehurve, apo gjendjen e tyre personale, shëndetësore, familjare ose ekonomike që nuk përbëjnë prova në referim të nenit 405, pika 7 të K.Pr.Penale*), analiza e elementëve të figurës së veprës penale u bazua vetëm mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës, duke respektuar në këtë mënyrë kërkesat procedurale të gjykimit të shkurtuar të sanksionuara në nenin 405 të K.Pr.Penale dhe të interpretuara në vendimin nr. 2, datë 29.01.2003[8] të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

---

[8] *Vendimi nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka interpretuar se: "Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb te tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazën e hetimit gjyqësor ... Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata. ...Gjykimi i* ***shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit*** *dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në një 1/3 e masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm".*

21. Pas pranimit të kërkesës së 32 të pandehurve për procedim më gjykim të shkurtuar, gjykata në referim të parashikimeve të nenit 93, pika 2 të K.PrP, ku përcaktohet se: "*2. Përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi 1, ndarja mund të vendoset edhe me marrëveshje të palëve, kur gjykata e çmon të dobishme për qëllimet e shpejtësisë së gjykimit.*", dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku thuhet shprehimisht se: "*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke unifikuar praktiken gjyqësore arrijnë në përfundimin se në një gjykim me disa të pandehur nuk mund të procedohet për disa me gjykim të posaçëm dhe për të tjerët me gjykim të zakonshëm. Vetëm në rastin kur në kushtet e nenit 93 të K.Pr.P., vendoset ndarja e çështjes, mund të lejohet gjykimi i shkurtuar për të pandehurit që e kanë kërkuar një gjykim të tille dhe çështja të veçohet për të pandehurit e tjerë që kërkojnë gjykimin e zakonshëm. Është konceptualisht e gabuar kur gjykimi i shkurtuar aplikohet vetëm si përfitim për të pandehurin, pavarësisht nga fakti se është proceduar me gjykim të zakonshëm.*", vendosi: "*Ndarjen e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Fran Kaçorri, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak të pranimit të kërkesës dhe vijimin e gjykimit me ritin e gjykimit të shkurtuar për të pandehurit e tjerë.* ".

22. Në këto kushte, gjykata shqyrtoi çështjen e kompetencës lëndore për vijimin e gjykimit për çështjen tashmë të ndarë ndaj të pandehurit Fran Kaçorri, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K. Penal, dhe referuar neneve 93/1/ç, nenit 93/2, nenet 13, 28, 29, 75/a, 83, 85 dhe 112 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 248 të Kodit Penal dhe Vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, vendosi :"*1) Shpalljen e mos kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në lidhje me shqyrtimin e çështjes penale të ndarë në ngarkim të të pandehurit Fran Kaçorri, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. 2) Dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës si gjykatë që ka kompetencë lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje. 3) Ngarkohet sekretaria gjyqësore dhe sekretaria regjistruese për të kryer veprimet administrative për regjistrimin e çështjes së ndarë dhe formimin e fashikullit përkatës në të cilin do të vendoset kopje e akteve të depozituara nga Prokuroria si dhe kopje të të gjitha akteve që përmban fashikulli i gjykimit deri në momentin e ndarjes së çështjes. 4) Kundërshtimi i këtij vendimi mund të bëhet në Gjykatën e Lartë nëpërmjet parashtrimit të mosmarrëveshjes së kompetencës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës*[9]".

II. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROVAT

23. Nga aktet e administruara gjatë gjykimit, rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi informacionin për referimin e veprës penale të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Policisë së Shtetit, ka regjistruar procedimin penal nr. 272, me datë 10.11.2020, për veprën penale "*Korrupsioni pasiv i personave*

[9] *Në dosjen gjyqësore administrohet vendimi i arsyetuar me nr.9, datë 25.01.2023 për shpalljen e mos kompetencës lëndore të gjykatës dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente.*

që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në informacionin për referimin e veprës penale dhe urdhrin për regjistrimin e procedimit penal me datë 10.11.2020, referohet se Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (*SHÇBA*), në bashkëpunim me shërbimet partnere brenda dhe jashtë vendit, në muajin dhjetor 2020 ka administruar të dhëna për veprimtari të kundërligjshme të disa punonjësve të policisë kufitare në pikën e kalimit kufitar Morinë, Kukës, të cilët në bashkëpunim me shtetas të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, referohej se favorizonin kalimin e mallrave kontrabandë me qëllim përfitimin monetar. Sipas informacioneve dhe të dhënave paraprake të administruara nga SHÇBA-ja referohet se në fshatin Shajnë-Dragash, të Kosovës, ndodhet një fabrikë grumbullimi dhe përpunimi e bimëve medicinale, e cila në të njëjtën kohë dyshohet se përdoret si vend magazinimi dhe pikë nisje e sasive të konsiderueshme të kafesë, e cila hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë kontrabandë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Morinë. Po ashtu, sipas të dhënave paraprake thuhej se në fshatin Shkozë-Zhur ndodhej një magazinë, e cila dyshohet se përdorej për depozitim të mallrave të ndryshëm, përfshirë edhe lëndë narkotike. Kjo magazinë është në pronësi të një shtetasi kosovar i quajtur Manush Arifaj.

24. Po ashtu, para regjistrimit të procedimit penal si më sipër, në datë 29.10.2020 shtetasi Nikollë Alija ka paraqitur një kallëzim penal për veprime korruptive të punonjësve të policisë kufitare në P.K.K Morinë. Sipas kallëzuesit, rreth orës 12:00, të datës 28.10.2020, ai së bashku me dy djemtë e tij dhe djalin e baxhanakut kanë qenë duke u kthyer nga Kosova për në Shqipëri nëpërmjet P.K.K Morinë. Në kohën kur kanë qenë duke kryer procedurat e kontrollit në hyrje të R.Sh, nga punonjësit e policisë së P.K.K Morinë i është kërkuar që t'i nënshtrohen kontrollit të veçantë në vijën e dytë së bashku me bagazhet e tyre, pa ndonjë argument bindës të komunikuar nga punonjësit e policisë në detyrë. Njëri prej punonjësve që ka kryer kontrollin e tyre dhe të bagazheve i lejoi që të vazhdonin me procedurat e mëtejshme pasi nuk kishin probleme ndërsa në këtë kohë afër tyre afrohet një tjetër punonjës policie, i cili urdhëroi ri kontroll të tyre, të bagazheve dhe të automjetit. Ky punonjës pasi ka konstatuar se në automjetin e tyre gjendeshin disa lule artificiale, me vlerë monetare të vogël, sipas kallëzuesit ka filluar të ushtrojë presion e po ashtu duke i thënë se ka probleme për kalimin e kufirit pasi ndaj tij në sistemin TIMS ekzistonte një ekspuls. Kallëzuesi i ka sqaruar se ky ekspuls e ka humbur vlefshmërinë e tij që ne vitin 2016, por pavarësisht sqarimeve punonjësi i policisë ka këmbëngulur se për të kaluar duhet të paguante me doemos diçka. Në këto rrethana sipas kallëzuesit e kanë detyruar t'i japë 10 euro, por duke parë shumën e tyre punonjësi i policisë nuk ka ngelur i kënaqur. Kallëzuesi i ka nxjerrë dhe një kartëmonedhë dhjetë mijë lekëshe, por që sipas tij punonjësi i policisë nuk i ka marrë. Po ashtu, sipas shpjegimeve të tjera që ka dhënë kallëzuesi sqaron se gjatë ditëve të mërkura në qytetin e Prizrenit, bëhet një pazar i madh me çmime të lira dhe për këtë arsye shumë shtetas shqiptarë shkojnë aty e blejnë produkte me çmime të lira, por gjatë kalimit të tyre në kufi bëhen objekt i veprimeve korruptive të punonjësve të policisë në kufi.

25. Në lidhje me faktin e kallëzuar nga shtetasi Nikollë Alija, janë kryer verifikime për të parë se cilët punonjës policie kanë qenë të planizuar me shërbim në P.K.K. Morinë dhe ata që kanë marrë pjesë në veprimet kontrolluese të vijës së dytë me këtë shtetas. Nga të dhënat e

sistemit, ka rezultuar se kallëzuesi Nikollë Alija është regjistruar në hyrje të R.Sh së bashku me shtetasit Ani Alija, Kevin Alija dhe Ramazan Musi në orën 11:52 min, të datës 28.10.2020 dhe janë përpunuar në sistem nga përdoruesi "BRAHAD". Po kështu rezulton nga shënimet e sistemit se shtetasi Nikollë Alija është kaluar për kontroll në vijën e dytë dhe është përpunuar nga "DURAKUG". Nga verifikimet e mëtejshme ka rezultuar se në datë 28.10.2020 në intervalin kohor ora 08:00 deri në orën 20:00 kanë qenë të planizuar me shërbim punonjësit e policisë, Ideal Lami me detyrë përgjegjës turni, Azem Nerguti, Kapllan Dogjani, Dashnor Braha, Gëzim Beqiraj dhe Arben Kastrati me detyrë trup shërbimi fizik dhe Ermal Muça, Armelino Bendaj, Avni Tershalla dhe Ardit Shira, me detyrë trup shërbimi.

26. Përveç rastit të mësipërm, SHÇBA, ka vijuar bashkëpunimin me autoritetet kosovare dhe referohet në materialet e dosjes se janë identifikuar punonjësit e policisë që kryenin aktivitet të paligjshëm në drejtim të *trafikimit të narkotikëve, favorizimit të mallrave kontrabandë, trafiku i qenieve njerëzore dhe favorizimet e shtetasve të ndryshëm, të cilët kanë problematika në vendet e Bashkimit Evropian (shkurt B.E.), kundrejt përfitimeve monetare,* por nuk rezulton që në vijim të hetimit të këtë arritur të provohet veprimtaria e ndonjë punonjësi policisë të pikës së Kalimit Kufitar në drejtim të favorizimit apo bashkëpunimit në trafikimin e lëndëve narkotike apo trafikimin e qenieve njerëzore, siç referohet në kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq.

27. Hetimet kanë vijuar me metoda speciale dhe konkretisht, me vendimet nr. 982 akti, datë 25.11.2020, nr. 1022 akti, datë 10.12.2020, nr.1070 akti, datë 25.12.2020, nr. 14 akti, datë 09.01.2021, nr. 18 akti, datë 09.01.2021, nr.98 akti, datë 09.02.2021, nr.150 akti, datë 23.02.2021 nr. 165 akti, datë 25.02.2021, nr. 222 akti, datë 10.03.2021, nr. 219 akti, datë 09.03.2021, nr.46 akti, datë 02.02.2022, nr. 47, datë 02.02.2022, , nr.82 akti, datë 16.02.2022, nr. 83 akti, datë 16.02.2022, nr. 81 akti, datë 16.02.2022, nr. 121 akti, datë 03.03.2022, nr.122, datë 03.03.2022, nr. 123, datë 03.03.2022,nr. 218 akti, datë 09.03.2021, nr. 178, datë 18.03.2022, nr. 185, nr. 444, datë 26.04.2021, nr. 529 akti, datë 20.05.2021, nr. 529, datë 20.05.2021, nr. 608 akti, datë 08.06.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është lejuar përgjimi i komunikimeve dhe bisedave të personave të dyshuar në kuadër të këtij procedimi. Nga përgjimi i komunikimeve mes personave të dyshuar dhe subjekteve të tjerë që komunikojnë me ta janë evidentuar, ndër të tjera, komunikime të punonjësve të policisë së Pikës së Kalimit Kufitar Morinë Fatri Iseberi, Halim Shehu, Sulë Onuzi, si dhe personave të tjerë, ndër të cilët rezulton edhe shtetasi Ardian Çali (Iseberi), vëllai i shtetasit Fatri Iseberi, si dhe shtetas të tjerë të cilët komunikojnë me ta mbi veprimtari të ndryshme. Referuar procesverbaleve të transkriptimit të komunikimeve telefonike të zhvilluara mes personave të dyshuar dhe personave që komunikojnë me ta, rezulton si më poshtë[10]:

28. Në procesverbalet e transkriptimit të komunikimeve të zhvilluara prej datës 29.11.2020 e në vijim, kryesisht gjatë muajve nëntor- dhjetor 2020 dhe janar 2021, rezultojnë komunikime

---

[10]*Në referimin e fakteve dhe të dhënave, mbahet në konsideratë, për shkak të volumit, paraqitja sipas rendit kronologjik të ngjarjeve si dhe grupimit logjik të tyre, për shkak të përmbajtjes.*

mes punonjësve të PKK Morinë Halim Shehu dhe Fatri Iseberi, mes këtij të fundit dhe vëllait të tij Ardian Çali (Iseberi) si dhe persona të tjerë të komunikojnë me ta, si më poshtë:

- Në bisedën e zhvilluar në datë **29.11.2020**, ora 20.15.34, rezulton se mes punonjësve të PKK Morinë dhe konkretisht shtetasit Fatri Iseberi, përdorues i numrave të telefonit 069 41 15 447 dhe 068 51 82 004, dhe shtetasit Halim Shehu, përdorues i numrit të telefonit 0688531000) është zhvilluar biseda si më poshtë:

A (Fatri Iseberi): *Po...*

B (Halim Shehu): *O mik, nga ora nëntë kismet, nga ora nëntë kismet vjen.*

A:Ok. Ok....

B*: Edhe pastaj e ndajmë... Duhet me ma nda, o tresh o katërsh, o majtas o djathtas...*

A: Po, po pa problem.

B*: Hajt babuç, e ta çoj edhe një foto të makinës në whatsapp*

A:Po, hajt, hajt...

29. Nga procesverbali i transkriptimit të komunikimeve të datës **30.11.2020** ora 12:04:37 min, rezulton se përdoruesi i numrit 0685182004, punonjësi i PKK Morinë Fatri Iseberi ka zhvilluar këtë bisedë me përdoruesin e numrit 0698705235, shtetasin Ardjan Iseberi, vëllai i tij, me përmbajtjen si më poshtë:

0698705235 (A.Iseberi): *Do më kthente mbrapa....*

0685182004 (F.Iseberi): *Oooooo*

0698705235:*Po dol ai Syla dhe më tha mua hape bagazhin, thashë s'ka goma kam, më tha mua hape hape. Ja hapa tha mbrapa. Nji ti dol Sula mbrapa tha bojmë ndonjë letër. Jam tu e kthe mbrapa se s'jom tu ti dhonë letrat . Edhe dul Sula para më tha mua tha jepi letrat (bisede nuk kuptohet) kujt i thu..*

0685182004: *Pse po bon llafe...*

0698705235: *Me tha Albani mu që e takova mbas anaj, më tha mu tha kthehu mbrapoa se s'bon me kalu kshu tha, mos hajt tha për nji javë, s'bon that i jap unë njizet mijë lekë. Unë s'jam tu u kthe mbrapa or burr i dheut i thashë. S'bon tha me kalu tha.*

0685182004: *Mos ban llafe pa lidhje or ti.*

30. Sipas procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve të zhvilluara në datë **02.12.2020**, *ora* 9:59:22, i pandehuri Fatri Iseberi komunikon me të pandehurin **Halim Shehun,** me përmbajtje si vijon:

A* (Fatri Iseberi): Hë bablok.*

B(Halim Shehu): *O mik, ç`aty e ke Urimin, a ndal diku me një Audi A6, Audi i vet*

A*: Erdha ç`e, dola dy minuta*

B*: Ku je?*

A*: Ç`e sa jam ul në kafe, shkova. Tre minuta shkova..*

B*:Hajt, një Aud aty e ke të ndalun. Audi i vet asht.*

A*: Po, po hajt.*

Në vijim të bisedës si më sipër, po në datë **02.12.2020**, *ora* 10:01:12, rezulton se i pandehuri Fatri Iseberi komunikon me të pandehurin Halim Shehun, me përmbajtje si vijon:

A (Fatri Iseberi): Hë.
B(Halim Shehu): *A ke dalë, se o tu ja bë një i kabinës me dorë, kujton se o tu prit ne radhë.*
A: Ku o më?
B: Nja pesëmbëdhjetë metra tha pa shku te pika jam
A: Me çar? A, me Audin e zi?
B:Një Audi i zi, po..
A:Po.....
B:Hajt.

31. Në komunikimin e datës **09.12.2020**, *ora* 10:09:51, i pandehuri Fatri Iseberi komunikon me shtetasin Ardian Iseberi (Çali) me numër telefoni **+355698705235,** i cili është vëllai i tij, me përmbajtje si vijon:

A (Fatri Iseberi):Hë....
B(Ardian Iseberi (Çali)): *A tu më thonë ai me shku me ja kalu qat motorr bre... Të shkoj t'ia kaloj mos t'ia thotë...Astritit. T'ia dh.. atij Astritit, të shkoj t'ia kaloj unë... A thu më thonë naj send?.*
Fatriu: *Jo mor, s`thonë gjë, shko fol me Ndokën.*
B: *Fundja fundit, njëzet mijë lekë ja tu ja dhonë doganierëve... S`kam ça me ju thonë. Bo mos, mos më bojn naj send..*
Fatriu: *Po bre.*
B: *Policët s`më thoj gjo, t'ia kaloj atë motorr e çat pjesë që të marr... P.sh., atë diferencialin, jam tu e marr me bë një karrocë për vete do ju them...*
Fatriu: *Po brë, qashtu thuj.*
B: *Hajt..*
Fatriu: *Hajt.*

32. Gjatë përgjimit, në komunikimin e datës **10.12.2020**, *ora* 9:57:08, i pandehuri Fatri Iseberi komunikon me shtetasin Abdullah Domi, me numër telefoni +355694148067,me përmbajtje si vijon:

A (Fatriu): Inxhinier, a fjete?.
B(Abdullah Domi): Fatri, hë mor si je?.
Fatriu: *Mirë... Qysh je ti?.*
B: *Mirë. .*
Fatriu: *A je lodh?..*
B: *Diçka vallaj. Si ja çove?.....*
Fatriu: *Mirë, te puna jam po thash po mos ke harru a gjo a.*
B: *Jo s`kam harru veç, se deshta me të marr po...kam qenë në Peshkopi e kam ardh vonë e sot nuk të shqetësova.....*
Fatriu: *Aaaa, jo thashë unë se s`kam harru, veç se nga data dhjetë për ata.....*
B: *Po pra..*
Fatriu: *N` daç jepja numrin tem çëta, në daç...qysh të dush..*
B: *Jo, a je në punë me një fjalë deri në tetë ë?*

***Fatriu**: Po deri në tetë jam në punë.*
***B**: Ë... se ka mundësi të vi me të unë të të takoj atje.*
***Fatriu**: Ok,...s`ka hiç problem...*
***B**: Po pra se do vinte... Mbas orës tetë vjen, a merr vesht?*
***Fatriu**: Ooo.*
***B**: E pra...ç 'ajo asht problemi.*
***Fatriu**: Po ani, se mbas orës tetë shkojmë bashkë*
***Fatriu**: Shkojmë bashkë e...*
***B**: Hë se ka mundësi të vi unë nga dreka, vimë pimë një kafe aty me të*
***Fatriu**: Ok. .*
***B**: Ok..*
***Fatriu**: Mirë pra, hajt.*
***B**: Faleminderit..hajt.*

33. Në komunikimin e datës **10/12/2020** *ora* 12:30:23, i pandehuri **Fatri Iseberi** komunikon me personin e paidentifikuar me numër telefoni +355682032007, të cilit i drejtohet me biseda me emrin "Bledi", me përmbajtje si vijon:
***Fatriu**: Hë Bled*
***B**: Ku je o?..*
***Fatriu**: Te kabina, te kamionat..*
***B**: A... A të vi njaty?*
***Fatriu**: Po hajde*
***B**: Hajde.*
***Fatriu**: Eeee...(nuk kuptohet)*
- Komunikimi mes tyre vijon dhe pak minuta më pas ku në datë **10/12/2020** *ora* 12:42:49, **Fatri Iseberi** merr një mesazh nga personin i paidentifikuar me numër telefoni **+355682032007**, me të cilin ka komunikuar pak minuta me herët, me këtë tekst:
B- sms tekst: "JHD5322".
34. Po në datë **10.12.2020,** *ora* 18:41:58, i pandehuri **Fatri Iseberi** komunikon me një person të paidentifikuar me numër telefoni +355698705235, me përmbajtje si vijon:
***A: Fatriu**: Ku je më*
***B**: Te shpija*
***A: Fatriu**: Po mos ka ardh ai me maqin të vet, se mu duk si maqina e tij që kaloj q`tu...*
***B**: Po ndoshta e ka, po a ka pas gjo m`ta a?*
***A: Fatriu**: Ku di unë, s`mu duk.. Si me llamarina...(nuk kuptohet qartë).*
***B**: A, se di...Ta pyes një herë se ka pas me marr do sene...po ta pyes. I ka marrë do dërrasa, do sene.....*
***A: Fatriu**: Nuk e di...*
***B**: (nuk kuptohet qartë)*
***Fatriu A: Fatriu**: Hajt*
***B**: Hajt.*

35. Në ditët në vijim, në komunikimin e datës **14.12.2020**, *ora* 8:44:35, i pandehuri **Fatri Iseberi** komunikon me të pandehurin **Halim Shehun**, me numër telefoni +355688531000, me përmbajtje si vijon:

***Halimi**: Hë mik*

***Fatriu**: A të thirri.*

***Halimi**: Jo, hala jo.*

***Fatriu**: Se ika me hëngër një pilaf thashë, që ti kallzojsh.*

***Halimi**: A... Sa ndalesh?.*

***Fatriu**: Po aq dhjetë minuta se...(nuk kuptohet qartë)*

Pas disa minutash, mes tyre zhvillohet biseda e datës **14.12.2020**, ora 8:54:44, me përmbajtje si vijon:

***Fatriu**: Hë.*

***Halimi**: Ka mbaru punë ai shoki...*

***Fatriu**: Jo bre vallaj*

***Halimi**:Po vallaj... E marr në telefon un q`tash, thash kur të afrohesh, se ja çova numrin tand, emrin... Edhe...*

***Fatriu**: Ee.*

***Halimi**: Për besë, për besë tha, kam ken në zbritje të Kçirë tha, telefoni s`bëjke me thirr... Po unë të kom thirr dhjetë herë thashë bre... Unë jam agjent doganor tha, kam kry punë... Thash, a përmend gjë emra aty? Për kokë të djalit tha jo tha s`kam përmend emrin tand hiç, veç tha se sun u lidhëm me telefon. Unë thashë ta lo porosi, ta lo njërin aty bre... Edhe...(nuk kuptohet qartë) sun prita... Varja. Po veç kqyr në darkë një herë... Mos u përmend gjo atyne se nuk del mire me ju thonë, po...kqyr në darkë një herë, a po... (nuk kuptohet qartë) a jo*

***Fatriu**: Tash sa...(nuk kuptohet qartë) Hajt.*

***Halimi**: Hajt.* ***Shumë mos me rënë në sy jo kaloj, jo kush e ka kalu, se veç ashtu.**.*

***Fatriu:** Jo, jo hajt...*

Në komunikimin e datës **14.12.2020**, *ora* 12:57:07, i pandehuri **Fatri Iseberi** komunikon sërish me të pandehurin **Halim Shehun,** me përmbajtje bisede si vijon:

***Fatriu**: A je kund bre?.*

***Halimi**: O mik, ç`e në Lezhë vallaj jam, me dhëndër, me at (nuk kuptohet qartë) patentën. Ç`a bone ti?*

***Fatriu**: Aa... Hiç vallaj, kesh tu dal e takova at legenin...Engjllin (kështu dëgjohet), edhe*

***Halimi**: Cilin?*

***Fatriu**: Engjëllin, edhe... Erdh vetë bre...edhe si aj, tha u bofsh njëqind eurosh. Jo or daj thash. Nuk o mirë qishtu thashë. I respektoi gjithë doganat e doganierët e u morr me ta e... Ku u`a q*** rr***. Shkova piva një kafe me të thash, qishtu nuk ban thash. Me mu thashë, kur morrësh dyqind e pesëdhjetë veç thashë hajde, ndrysh thash, jo. Tash unë mirrem edhe me ato, edhe me këto, mirrem me ç`aq thashë...vetë. A jo s`mundem tha, me njëqind e pesëdhjetë. Thashë, jo.*

***Halimi**:* ***Njëqind e pesëdhjetëshe nuk a keq thu**. Gjendja ka degjeneru prapë..(nuk kuptohet qartë)..i degjenerum.*

***Fatriu**: Jo, njëqind e pesëdhjetë tha do me mbulu dhe doganierët or ti....Jo or ti thash..*
***Halimi**: Ani, shumë mirë... Jo, a e di pse a mirë?*
***Fatriu**: Hë...*
***Halimi**: Se pesëdhjetëshja shkon në pension, kjo tjetra ngel për ktu a kupton*
***Fatriu**: Po po, po hajde merru me këto se pale a dëgjojnë këto or ti..*
***Halimi**: Jo jo, o standard. Jo, jo o standard. Vi miki ta zgjidhi atë punë. Se a e zgjidhun prej nalt, s`ka problem.*
***Fatriu**:A?*
***Halimi**: Po... Domethënë, mujsh me më kuptu... Nëse a njëzet...*
***Fatriu**: Po..*
***Halimi**: I bie pesëmbëdhjetë na, e pesë ato. Nëse a pesëmbëdhjetë, pesë ato.. Ato vetëm pesë kanë. S`ka lidhje fare. .*
***Fatriu**: Ok..*
***Halimi**: Pa marak hiç.*
***Fatriu**: (nuk kuptohet qartë).*
***Halimi**: Mikin mos e harro në darkë se janë, janë... janë sendet e mira ato... (nuk kuptohet qartë).*
***Fatriu**: E po prapë pak janë... (nuk kuptohet qartë)*
***Halimi**: Pesëmbëdhjetëshi duhet patjetër. Mbasandej..*
***Fatriu**:Unë s`rashë prapë dakord or ti*
***Halimi**:Hajt, hajt se shihna...*

Në bisedën e datës **14.12.2020**, *ora* 13:42:10, i pandehuri **Fatri Iseberi** komunikon me të pandehurin **Halim Shehun,** me përmbajtje si vijon:
***Halimi**: Hë mik*
***Fatriu**: E.*
***Halimi**: Hë.*
***Fatriu**: Kaloi ai mor.*
***Halimi**: Kush?.*
***Fatriu**: Ai...Shqipërim a qysh e pat emrin*
***Halimi**: Po*
Fatriu**: Me nji...këta...(nuk kuptohet qartë)Tiguan, i q rropt.....*
***Halimi**: Varja...edhe*
***Fatriu**: Edhe më thirri.*
***Halimi**: Ëhë...*
***Fatriu**: Ku je mor, ke hup krejt thash or ti..? Ha..tha ja këtu, tu ik deri ne Tiranë e në Durrës, s`di ku më tha... A ka shkrujt më? Ka hup kret a?*
***Halimi**: Jo...Me pyeti për një send...Bo me Fatrin kur të dush thashë, hajde pimë kafe, s`ka problem fare..*
***Fatriu**: Eee... Jo kish hup krejt kish hup..*
***Halimi**: Hajt mos u streso, hajt. A s`ki punë...?*

***Fatriu**: Hajt...*

36. Në komunikimin e datës **29.12.2020**, ora 18:29:26, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me personin që përdor numrin e telefonit+355683806667, numër i cili pasi është verifikuar ka rezultuar i regjistruar dhe në përdorim të shtetasit Fatmir Allaraj, me përmbajtje bisede si vijon:

***Halimi**: O Fatmir djali, ho mër..*

*+6667**(F.Allaraj)**: Mirëmbrëma shef Halimi. Si të kam, si je, a je burrë i fortë?.*

***Halimi**: Po mor, kalojmë. Si je ti shok?.*

+6667: Po hajt mo, kalojmë, qashtu....

***Halimi**: Hë, si i keni hallet?....*

*6667: Po **gjindna gjallë, gjindna gjallë.***

***Halimi**: Si janë çunat? A u mërzitët mor për babën?.*

+6667: Vallaj u mërzitëm o Halim, ç`a të bëjmë..

***Halimi**: *Nuk dëgjohet mirë*..*

+6667: Po bre kemi fol me to, kemi fol, mirë thonë. Po ju, si i keni hallet? Qish i ke pas?

***Halimi**: Hajt, qashtu bre...kalojmë..*

*+6667: Mirë, ç`a me bo. **Nesër, ka ora nëntë, a je në punë, të vi të të shohi?***

Halimi**: **Nëntë e sabahit e?

*+6667: **E nga ora nëntë, se në tetë vjen djali...Ismetit andej edhe, nga ora nëntë kismet thojna se jena aty.***

Halimi**: **Unë në orën tetë mbaroj, por po të pres deri në nëntë, s`ka problem..

*+6667: **Në tetë ato shtipin, e ke parasysh se s`po përmendi shumë..***

Halimi**: **E di e di. Jo, jo s`ka problem, mos u bën merak, e kuptoj po unë në tetë mbaroj, po po të pres. Unë të pres atje, kur të mbaroj punë, po të pres, s`ka problem...

+6667: Qysh të dush o shef, nesër kismet.....

***Halimi**: Atje më shkruni një mesazh, a kur të jeni afër a..*

*+6667: Nejse, kur të...*nuk kuptohet qartë*...se unë vi herët.*

*.**Halimi**:Të pres aty, pa merak, hajt.....*

*+6667: **Unë vi herët kur të shkoj atje, takohena....***

Halimi**: **Pa merak, hajt mirë ardhsh. S`ka nevojë hiç, veç kur te kthehesh këndej takohena.

+6667: Mirë, mirë, hajt, se edhe kur të vi, ta shoh, ose ta baj një telefon kur të vi aty edhe....

***Halimi**: Hiç, veç kur të vish këtej më thuj jam afru edhe mjafton. Hajt...*

+6667: Mirë, shef mirë.

***Halimi**: Hajt.*

37. Një ditë më pas, në datë **30.12.2020**, ora 6:51:49, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me përdoruesin e numrit të telefonit**+355683806667,** i cili ka rezultuar se përdoret nga shtetasi Fatmir Allaraj me të cilin ka zhvilluar një ditë më parë bisedën e referuar më sipër, me përmbajtje si vijon:

***Halimi**: O Mir, ho mër.....*

+6667: O Halim, a flejte hiç e?.

***Halimi**: Hë babush....*

*+6667: **Çe, çetu jam....***
***Halimi** : Hë, a do me u ndal a don me ec?*
+6667: Jo, veç do të takoj, do të shof...Do të them një mirëmëngjesi edhe po iki..
***Halimi**: Dola..*
*+6667: *nuk kuptohet qartë**
***Halimi**: **Kalo, kalo Kosovën edhe erdha...Hajt.**.*
*+6667: **A të kaloj andej matanë?***
Halimi**: **Po hajt....
*+6667: **Po hi mrena aty.***
***Halimi**: Hajt.*

Po në datë **30.12.2020**, ora 6:55:50, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me këtë shtetas që përdor numrin **+355683806667,** me përmbajtje bisede si vijon:

***Halimi**: O Mir, ku je mër?....*
*+6667: **Ja këtu, sa kalum kënej në Kosovë...***
***Halim**:Erdha, erdha në këmbë jam tu ec, erdha....*
+666:: Po pse në këmbë or ti? Pse s`na kallzove? O babush... Te ML-ja jam.....
***Halimi** : Hajt, hajt, çao...*

Përsëri ne datë **30.12.2020**, ora 9.08.41, i pandehuri **Halim Shehu** komunikon me personin me numër telefoni +355683806667, numër i cili ka rezultuar i regjistruar në emër të shtetasit Fatmir Allaraj, me përmbajtje si vijon:

***Halimi**: O Mir, ku je mër?*
+6667: Urno Halim, çe, mbas kamionit çetu... Një kamion i madh.. A e shef?
***Halimi**: **Jo, jo do të ikish andej...Do të ikësh te**... A është parku a?*
+6667: O nji kamion, çetu në rrugë, përpara... A më shef?.
Halimi**: **Jo, jo, ki me kalu majtas andej, linja e Kosovës, anej majtas..
*+6667: **Knej nga Kosova?***
Halimi**: **Te na, o Fatmir, te na. Ç'vjen për linja që a majtas...në kufi me Kosovën, linja e fundit..
*+6667: **Ëhëhë...ngjit, andej, po, po po.... A je ti aty në.....kabinë?**.*
Halimi**: **Hec vazhdo se jam tu të prit këtu unë. Është tjetër kush aty.... Jam tu të prit, jam në oborr tu të prit. Hec, kalo...
*+6667: (jashtë telefonate) **Futu atje te kabina te cepi, hec.***
Halimi**: **Është e fundit..
+6667: ok, ok, ok...
***Halimi**:...për Kosovë. Janë tre,*
*+6667: **Po, po... Ok, ok, ok, ok, ja u nisa....***
***Halimi**: Bravo, bravo....*

Në orën 9:11:59, të po kësaj date **30.12.2020,** i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me shtetasin Fatmir Allaraj me numër telefoni **+355683806667,** me përmbajtje bisede si vijon:

***Halimi**: Pse u ndale?*

+6667: Ku po pret ti?
***Halimi**: Hajde mor se jam para une..*
+6667: Ku je or ti? A e sheh ML kun a?
***Halimi**: Me ç'kët passatin blu jam, hajde...*
+6667: Aa! Ah aaa! Ku ndalna? Ku pimë kafe?
Halimi**: **Po hajde bre rrugës ndalna diku, hajde....
*+6667: **Hec, ndalu para ku të dush.***
Sërish në datë **30/12/2020** ora 9:13:30 PD, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me këtë person me numër telefoni **+355683806667,** me përmbajtje bisede si vijon:
+6667: Po shef
***Halimi**: Rrugës jam përpara unë, ë.....*
+6667: Po, po se tash jena tu të pa...Po, po, kemi një makinë të bardhë para, tani u futëm mbrapa....
***Halimi**: Ok, mirë ardhshi*
+6667: (jashtë telefonate) Ec, futju mbrapa passatit....

38. Lidhur me këto komunikime me shtetasin Fatmir Allaraj dhe lëvizjet e tij në kufi, referuar bisedave, janë administruar të dhënat e këqyrura dhe të marra nga sistemi TIMS nëpërmjet procesverbalit me datë 03.06.2022. Nga përmbajtja e tyre, në rubrikën "Sektori i personit", rezultojnë dy rubrika të regjistruara me të dhënat e shtetasit Fatmir Sulejman Allaraj i datëlindjes 17.07.1970, lindur në Xhaferraj, Kukës dhe banues në Farkë, Tiranë. Janë verifikuar hyrjet dhe daljet e tij në sistemin TIMS dhe ka rezultuar se ky shtetas nuk ka të regjistruara hyrje-dalje nga Shqipëria që prej datës 01.09.2019, ndërkohë që nga bisedat telefonike të regjistruara mes tij dhe të pandehurit Halim Shehu si dhe vetë deklarimet e tij në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, rezultojnë të dhëna për daljen e tij nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Morinë në datë 30.12.2020.

39. Me përdoruesin e numrit të telefonit**+355683806667,** identifikuar si shtetasi Fatmir Allaraj, janë evidentuar komunikime të punonjësit të PKK Morinë Halim Shehu, edhe në muajin janar të vitit 2021, dhe konkretisht, sipas procesverbaleve të transkriptimit të përgjimeve, referohen komunikimet si vijon: Më datë **12/01/2021, ora 21:49:49,** ***Halim Shehu*** komunikon me personin e identifikuar si Fatmir Allaraj,me numër telefoni **+355683806667,**por në fakt nga përmbajta e bisedës rezulton komunikimi me djalin e tij dhe flitet mbi kalimin e tyre në drejtim të Kosovës. Mes tyre veçohet komunikimi si vijon:
***Halimi**:Hë Mir*
+6667:Hë...jam, djali i Fatmirit
***Halimi**: Kur e ke pre biletën o shok?*
+6667: Unë biletën e kam për në tre të natës.
***Halimi**: Në tre të natës.*
+6667:Po, në... para, katërmbëdhjetë në sabah. E po mu më duhet me hi, me bo tamponin në Kosovë.
***Halimi**: Testi të duhet në Kosovë ë?...*

+6667: Po, nesër në orën tre duhet me qenë atje se kam lënë takim me bo tamponin.
***Halimi**:Ku e ke lënë, atje në Fushë Kosovë te ajo "Olive Laboratori" a ça?*
+6667: Po çajo, te Dragodam, s`di ç`a e kishte.
***Halimi**:Po, çajo është...*
+6667:Edhe më duhet me qenë...
***Halimi**:E....Ndigjo qetash... Thuji babës, thuji babës, prishe terezinë ma mirë... Nisu nga ora pesë në sabah në Tiranë, e të ikni para orës tetë të mëngjesit, se turrni që e merr në tetë të mëngjesit deri në tetë të darkës nuk o i hajrit hiç. Janë legena. E unë nuk jam*
këtu nesër, jam në Tiranë.
+6667: Ëhë..
***Halimi**: *nuk kuptohet qartë* Sepse...se është edhe një problem tjetër. Ti duhet me konë fizikisht atje, se me pa vu një tampon kshu thjesht, formal.*
+6667:Ëhë
***Halimi**:E kish bo gati ai, ti ishe nis në tetë të darkës këtu, në nëntë atje, e kishe morr, prapë në tre je fiks për me lëviz.*
.+6667:Mua më duhet.
***Halimi**:Nuk janë të përshtatshëm. Ti si shkove, në dymbëdhjetë të drekës, si shkove në nëntë të sabahit, unë thom njëlloj a...Vetëm qëllimi a me kalu te kufini nga ora shtatë e gjys e sabahit.*
+6667:Po më rregull atëherë, në qoftë se ke tamam domethënë.
***Halimi**:Kur të thom s`bën, s`bën. Se i shoh sendet vet unë qysh janë aty.....*
+6667: Jo, jo po normal, ti e di atëherë. Në qoftë se bohet...po shkojmë na atëherë në shtat e gjysëm atje.
***Halimi**:Tash ka qëllu ç`i ki turn problem, se me qenë, me qenë tre të tjerë, po...Po njoni është shumë negativ.*
+6667: Mirë atëherë, ti e din më mirë, e ke parasysh.
***Halimi**:Tash çe po bëj një telefonatë unë edhe në shtatë e gjys pastaj kismet po e bëj gati. Veç i them Fatmirit kë me taku edhe e kryn. Hajt.*
+6667:Po dhe a të shkojmë aty ne...a të dali të na shofi. Thuji a nji makinë e bardhë.
***Halimi**:Pa merak, hajt.....*
+6667:Ok atëherë, mirupafshim se ndëgjohena nesër. Natën.

40. Po gjatë asaj dite, në komunikimin datës **12/01/2021, ora 22:37:55**, shtetasi **Halim Shehu** komunikon me personin e identifikuar si Fatmir Allaraj, me numër telefoni **+355683806667,**dhe mes tyre biseda si më poshtë vijon:

+6667: Alo
***Halimi**: Me ça makine je nesër?*
+6667: Ë shef?
***Halimi**: Çarë makine je nesër?*
+6667: Me ML-në e bardhë.
***Halimi**: ML-në e bardhë. OK.*
+6667: Tre.

***Halimi**: Njëqind metra pa shku atje,*
+6667: Po
***Halimi**: Në krah të djathtë a nji shesh atje. Sikur...e di ti, ku nalesh përherë.*
+6667: Te ai betoni atje. A e di ku ndalshim,,,? Sa herë që ndalshim.
***Halimi**: Aty...del e pin një cigare e vjen e të gjen vetë ai.*
+6667: E, ML-ja e bardhë, ***AB 307 AG...***
Halimi**: 307 ML* ***e bardhë. Edhe nji ashtu, nji ashtu...nji, nji tridhjetëshe, euro, jo ma shumë...
+6667: ***Sa të thush ti...***
Halimi**:* ***Një tridhjetëshe. Qysh qitash jam tu të thon unë...
*+6667: *nuk kuptohet qartë**
Halimi**:* ***Në një flij, një njëzetëshe, një dhjetëshe...jo ma shumë. Hajt..
+6667: Po bre, ni flij, ni flij.
***Halimi**: Hajde shok, të përshëndes.*
+6667: Faleminderit, rrofsh rrofsh.
***Halimi**: *nuk kuptohet qartë** **Brahim...** *nuk kuptohet qartë* e ka emrin ai...*
+6667: Në kthim, bën vaki..
***Halimi**: Të përshëndes..*
+6667: Pimë një kafe...si të kthehesh andej.
***Halimi**:Të përshëndes...*
+6667: Ok, ok natën.

41. Një ditë me pas, në komunikimin e datës **<u>13/01/2021</u>ora 7:06:49**, shtetasi ***Halim Shehu*** komunikon sërish me përdoruesin e numrit të telefonit **+355683806667,** duke zhvilluar bisedën si më poshtë:

***+6667 (F.Allaraj)**: Alo*
***Halimi**: O Fatmir, hë..*
6667: ***Po ML-ja kaloi, na... Unë jam mbrapa me Golf-in.***
Halimi**:* ***A...a e takove atë shokun?
+6667: ***Nuk e di tash, se me ML-në ke vëllai në timon, nuk ashtu, nuk patëm gjë. Në rregull..***
***Halimi**: Hajt.*
+6667: Hajt, hajt ciao
Halimi**:* ***Kur të kthehena... *Ku je ti, në Tironë a?*
+6667: Jo, nisem edhe pak në Tiranë.
***Halimi**: A keni mbaru a jo? A keni kalu?*
+6667: ***Ë...ML-ja kaloi. Unë jam më Golf-in me krushkin tim. Më regull jemi edhe ne..***
***Halimi**: *nuk kuptohet qartë*...do ta kthejë dikush atë sikur të thashë.*
+6667: Po, po, po... Po shef Po. Hajt cao. ***Kalume dhe na****. Hajt.*

- Në vijim, në komunikimin e datës **13/01/2021** nga ora **7:13** deri në orën **07.14**, shtetasi ***Halim Shehu*** komunikon me **sms** me personin e identifikuar si Fatmir Allaraj, me numër telefoni **+355683806667,**dhe mes tyre zhvillohet komunikimi si vijon: ***Halimi***: "Kur te arrish tek sheshi" ***Halimi***: "Me trego". ***Halimi***: "Dil pi një cigare"

42. Komunikimet e të pandehurit **Halim Shehu** me shtetasin Fatmir Allaraj vijojnë edhe në fund të muajit janar 2021, kohë në të cilën janë regjistruar komunikimet si vijon: Me datë **24/01/2021**, ora 20:19:14, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri 0688531000, zhvillon bisedën me personin tjetër, përdorues i numrit 0683806667, identifikuar me herët si shtetasi Fatmir Allaraj, ku rezulton se ky shtetas interesohet për të kaluar persona në kufi, por paraprakisht, i duhet që të bisedojë me punonjësin e policisë Halimin dhe për këtë e telefonon para se të shkojë në doganë. Në vijim, punonjësi i policisë Halim Shehu ju thotë se do të dalë punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** që t'i presë.

Në bisedat midis punonjësve të policisë dhe përdoruesit të numrit të mësipërm rezulton se personi që thirret me emrin "Bledi" është shtetasi Bledar Allaraj, djali i shtetasit Fatmir Allaraj dhe në datë 24.01.2021 mes tij dhe punonjësit të policisë Halim Shehu, zhvillohet biseda së më poshtë:

355683806667 (F.Allaraj):*Mirëmbrëma*

355688531000 (H.Shehu):*Mirëmbrëma ca bone?*

355683806667:Desha me ardhënesër nga sabahi me pi një kafe...

355688531000: Në carë ore mor në sabah...

355683806667: *Nga ora shtatë, shtatë e gjys e shumta. (bisede ambientale dëgjohet duke folur një person tjetër....neë tetë) ose në të dia, se ne katër niset djali i Ismetit, Bledi.*

355688531000: *Mbas orës tete sban*

355683806667: *Mbas orës tete nuk ban aaa? Me një fjalë shtatë e gjysmë me kenë aty tek betoni ke vendi?*

355688531000: *Shtatë e gjys atje po*

355683806667: A je ti dikush tjetër apo i di vetë ato gjona...

355688531000: *Po vjen deri atje ska problem*

355683806667:Mirë pra në shtatë e gjys. *Pyet personin tjetër...**Me ca makine do ashu?.....Me një audi A-4. Ca ngjyre o Bled?.....Bledi...E zeze...Audi A-4 ngjyrë e zezë***

355688531000: *E pra jepja cat numër ska problem*

355683806667: *Po bre numrin se e ka djali i Ismetit e të marrin këto kur të afrona orën shtatë e gjys*

355688531000:Edhe me herët me kenë ska problem ma mirë

355683806667: *Shtatë me shtatë e gjysmë maksimumi. Ok se ka ora gjashte e gjysëm e sabahut po afrohemi e po te marrim ne telefon.*

Më tej Halim Shehu i dërgon një mesazh të shkruar përdoruesit të numrit të telefonit*0683806667 me këtë përmbajtje:* ***"Me tregoni kur janë tek sheshi, del Fatria ju merr".***

Në orën 20:59:09, po të datës **24.01.2021**, vijojnë bisedën si më poshtë:

355688531000: *Hë Fatmir*

355683806667:*E mora mesazhin*

355688531000: *Në kohën kur të jenë ato aty veç me lajmëron mu e del ai shoki i merr*

355683806667: *Ok hajt natën.*

43. Është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit përdoruesi i numrit celular, 355683806667 shtetasi ***Fatmir Sulejman Allaraj,*** i cili, sipas procesverbalit me datë 03.06.2022, në lidhje me bisedat e kryera me punonjësin e policisë Halim Shehu ka deklaruar se: *"...Unë Halimin e njoh dhe çunin e xhajës të Halim Shehut e kam patur shok në Greqi dhe e njoh nëpërmjet tij...Po unë e kam telefonuar Halimin pasi djali tim Bedri Allaraj ishte duke ardhur nga Sh.B.A-ja dhe më duhet të shkoja në Kosovë për ta pritur. Për shkak se djali tim dokumentet në shtetin Amerikan i ka bërë si i përndjekur politik, nuk duhet të regjistrohej as në hyrje dhe as në dalje të R.Sh-së për shkak të dokumenteve. Për këtë arsye, unë kam kërkuar ndihmën e punonjësit Halim Shehu. Kam udhëtuar për në Kosovë i vetëm, me një automjet tip, ML, ngjyrë e bardhë me targa, "AB307AG" e cila është në emër të bashkëshortes time. Në Morinë kam takuar Halim Shehun, i cili më ka përcjelle në kufi* ***dhe në hyrje dhe në dalje****. Kur kam marrë djalin dhe jam kthyer përsëri kam kërkuar ndihmën e Halimit për të mos e regjistruar në kufi. Djali ka ardhur vetëm për shkak se mua më duhet të bëja një operacion në zemër dhe ka ikur mbas pesë gjashtë ditësh, në dijeninë time me sa mbaj mend përsëri nga e njëjta pikë kalimi... Jo nuk i kam dhënë para pasi unë e konsideroja mik edhe për shkak të rrethanave të njohjes...Jo ka ardhur vetëm Bedriu dhe ashtu siç e sqarova më sipër ka ardhur për shkak se më duhet të kryeja një operacion në zemër dhe më duheshin para...".*

44. Nga këqyrja dhe marrja e të dhënave në sistemin TIMS të informacionit, dokumentuar në procesverbalin me datë 03.06.2022, janë administruar të dhënat e hyrje-daljeve në kufi të shtetasve Fatmir Sulejman Allaraj i cili rezulton të mos ketë të regjistruara në sistemin TIMS të informacionit për vitin 2020 dhe vitin 2021, asnjë hyrje dhe/ose dalje nga R.Sh, ndërkohë që sipas bisedave telefonike të regjistruara dhe deklarimeve të tij, shtetasi Fatmir Allaraj ka kaluar kufirin pa u regjistruar në sistemin TIMS në muajin janar 2021, me destinacion Kosovën pa u regjistruar në kufi. Po ashtu djali i tij Bedri Allaraj, sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, rezulton se datat e fundit të regjistrimit të hyrje daljeve në R.SH I ka në vitin vitin 2013 dhe nuk ka asnjë hyrje apo dalje në vitin 2021 ndërkohë që sipas komunikimeve telefonike të regjistruara dhe deklarimeve të shtetasit Fatmir Allaraj rezulton se Bledar Allaraj në muajin janar 2021 ka ardhur në Shqipëri, duke kaluar nga pika e kalimit kufitar Morinë dhe nuk rezulton që ky fakt të jetë regjistruar në sistem.

45. Duke u rikthyer sërish në komunikimet e përgjuara që nga muaji dhjetor 2020, rezulton se në komunikimin e datës **30/12/2020**, ora 8:05:39, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me Fatri Iseberin me numër telefoni **+355694115447,**duke zhvilluar bisedën si vijon:

+5447 ***(F.Iseberi)****: Hë*

Halimi*: A je tu ardh me pi një çaj te Tekia a jo..*

+5447 : ***Ore, hina në kabinë or ti. S`.....***

Halimi*: Në kabinë... Po pse, a ka radhë shumë a?....*

*+5447: Po jo bre burrë, tre-katër makina po, ai rob**mi nuk ndigjon me hi ai...*

Halimi*: Calli s`ndigjon me hi?*

+5447: Astriti...

Halimi*: Po ku e ko ai për me hi?..*

+5447: Te dishi...
***Halimi**: Po te di... Kur s`do te treshi ai... Ai te dishi s`... Apo i takon atij me shku atje?...*
*+5447: Po se ai...edhe Shpëtimi...*nuk kuptohet qartë* me u spostu, edhe me vë mu te katra* pastaj ai s`ndigjon me hi.....
***Halimi**: *nuk kuptohet qartë*..Bedria te katra... Te pesa kush o?.*
+5447: Arbeni.....
***Halimi** : A... *nuk kuptohet qartë*....*
+5447: Po..
***Halimi**: Hajt, mbaroi e hajde. Vetë këtu të Tekia jam..*
+5447: Ani hajt.

46. Po atë ditë, në komunikimin e datës **30/12/2020**, ora 9:12:14 PD, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me të pandehurin ***Fatri Iseberi*** me numër telefoni +355694115447, me përmbajtje si vijon:
***Halimi**: Hë mik....*
***Fatriu**:Te unë.... *nuk kuptohet qartë*.*
***Halimi**: Ani, ani hec se e ndreqi mik, hec se jena tu pi kafe diku, hajt.....*
***Fatriu**: Hajt.*

47. Në vijim, në komunikimin e datës **31/12/2020**, ora 12:49:51 MD, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me të pandehurin ***Fatri Iseberi***me numër telefoni +355694115447, me përmbajtje si vijon:
***Halimi**: Hë më, sa u mbështeta*
***Fatriu**: Po ca u mbështete.... A e lamë me u taku or ti?*
***Halimi**: Me të taku jam mbejt tu ti ra telefonit or ti... Se ti s`je në terezi...*
***Fatriu**: Kur i ke run telefonit or?*
***Halimi**: Dje paraz mor..*
Fatriu**: **Po se... *nuk kuptohet qartë* kam ardh prej Kosove. Qaq, katërdhet minuta.....
***Halimi**:*nuk kuptohet qartë*gjithë ditën.*
***Fatriu**: Ka je tu dal nji herë...*
***Halimi**: Hajt, shko ha bukë një herë, shko ha bukë se mbrapa dalim..*
***Fatriu**: Jo, s`dal mo un, s`dal mo se kam me ik në punë unë masanej...*
***Halimi**: Del, del, kur të bëhesh me ik në punë, hajt....*
***Fatriu**: Jo, o babush, hajde këtej, leje kur të dal në punë.....*
***Halimi**:Vallaj se jam mbështet vallaj bre, se jam te mberdhi....*
Fatriu**: **Hajde bre se jam shpenzu e thash me më shpërbly thash nanji gjo.....
Halimi**: **Po s`bëhet fjalë bre, ce, të tuat janë ato. Hajt..
***Fatriu**: Ani bre, hajt. Po jo bre se atëherë *nuk kuptohet qartë*...*
***Halimi**: Prit pak, prit pak...*

48. Nga këqyrja e sistemit TIMS, referuar rrethanave që rezultojnë nga biseda si më sipër mes Fatri Iseberit dhe Halim Shehut, është bërë këqyrja në lidhje me verifikimin mbi hyrje-dalje të shtetasit Fatri Iseberi, dhe ka rezultuar se ai nuk ka hyrje dhe dalje drejt Kosovës në datën

31.12.2020 në të cilën referon biseda e zhvilluar mes tij dhe shtetasit Halim Shehu, pasi shënimi i fundit në sistemin TIMS është dalja e tij në datë 03.05.2019.

49. Po atë ditë, në datë **31/12/2020** 12:51:48 MD, i pandehuri ***Halim Shehu*** komunikon me të pandehurin ***Fatri Iseberi***me numër telefoni **+355694115447,** me përmbajtje si vijon:

Fatriu: *Hë bre*

Halimi: *Shko merre te djali i Haxhisë një porosi atje bre?*

Fatriu: *Po jo bre jo, kur të ashtu, kur të dalësh po leje...*

Halimi: *E kom mor në telefon, hajt..*

Fatriu: *Jo, jo kur të dalsh. Leje, s`jam t`u u marr me ato unë, me tu direkt, s`kam punë me atë... hec.*

Halimi: *Kalo qaty, hajt..*

Fatriu: *Jo, jo...hajt, në darkë...*

Halimi: *E kom mor në telefon or ti...*

Fatriu: *Po lere or ti, s`jam tu u marr me atë unë, s`kam punë me atë. Hajt..*

Halimi: *Për zotin, i thashë në telefon bre...*

Fatriu: *Po jo jo leje, ik hajt.*

Halimi: *Fundi, s`do me dit gjo ai, ajo osh porosia jeme...*

Fatriu: *Po jo, jo, takohena në darkë bashkë, hajt.*

50. Më datë **07/01/2021**, ora 16:03:48, i pandehuri ***Halim Shehu,*** nga numri celular **355688531000,** komunikon me të pandehurin **Fatri Iseberi** me numër telefoni **+355694115447,** me përmbajtje bisede si vijon:

Halimi: *O mik.*

Fatriu: *Hë*

Halimi: ***O tu ardh Besi, ai bosi që ka ato vilat, ato të hotelit...***

Fatriu: *Po*

Halimi: *O me nja di mikeshat, të vetat.*

Fatriu: *Po.*

Halimi: ***Janë rroba të vetat, personale tha, veç tha mos me hi me hallakat atje me bë figurë kot.. Thash, e ke Fatrinë në punë aty...***

Fatriu: *Po ku, ku ta përgjoj unë?*

Halimi: *Ti e përgjon të gabina bre..*

Fatriu: *Po ani, kallzoja ku jam unë.*

Halimi: *A e ke numrin e Besës e fol me të në telefon?*

Fatriu: *S`e kam më duket numrin e Besit.*

Halimi: *Çe ta çoj unë menjëherë, edhe me pas nevojë të dogana, thuj or ti thuj...mik i Halimit o thuj, serioz a thuj, veç thuj janë gjona personale, nuk ka...*

Fatriu: *Ok, hajt. Ok hajt..*

Halimi: ***Edhe...edhe... ti je i shkathët vet, a kupton...***

Fatriu: *Ok, ok hajt..*

Halimi: *Hajt ta çoj numrin, e fol direkt me të, thuji ku je...Hajt...*

***Fatriu**: Hajt..*

51. Gjatë përgjimit të komunikimeve dhe bisedave telefonike, të lejuara me vendim gjyqësor, rezultojnë të jenë zhvilluar biseda nga edhe nga shtetasi Ardjan Çali (Iseberi), vëllai i të pandehurit Fatri Iseberi, të cilat japin të dhëna mbi veprimtari për kalimin e mallrave kontrabandë nga Kosova në drejtim të Shqipërisë. Në bisedat e zhvilluara prej tij rezultojnë komunikime mes tij dhe personave të tjerë për futjen e mallrave të tilla si pjese këmbimi, goma makinash, etj., veprimtari për të cilën ai komunikon edhe me shtetasin Robert Saraçi dhe persona të tjerë që janë lidhje e këtij të fundit. Konkretisht, nga procesverbalet e transkriptimit të komunikimeve të përgjuara, rezultojnë komunikimet si vijon:

52. Midis përdoruesit të numrit te telefonit 698705235 që i përket shtetasit Ardian Iseberi dhe përdoruesit te numrit të telefonit 0685182004, që i përket vëllait të tij, punonjësit të PKK Morinë Fatri Iseberi, më datë **28.11.2020** është zhvilluar biseda si më poshtë vijon:

***0698705235 (A.Iseberi)**: Ca je tu bo?*

***0685182004 (F.Iseberi):** Te puna...*

0698705235:A se më kanë mbetur nja gjashtë copë të vogla, dy të mëdhaja për emi.....a je tu shku ma?

***0685182004**: S'po e di vallahi*

***0698705235:** Kush asht atje?*

0685182004:Zeneli bre aj te ha k.....

***0698705235:** A tha noj gja kshu apo ....me Albanin se Albani vete s'thotë gjo, se kam me ja thonë dy fjale Albanit...*

***0685182004:** Jo bre burrë hec po mos ashu , ik ka dish e ka Astriti hajt se ke autobuzat jena hajt.*

53. Më datë **06.12.2020** ora 12:16 min, Fatri Iseberi nga numri i telefonit celular 0685182004 ka zhvilluar këtë bisedë me vëllain e tij shtetasin Ardjan Cali (Iseberi) me numër telefoni celular 0698705235, ku flitet lidhur me kalimin e një mjeti, me përmbajtje si më poshtë:

***0698705235 (A.Iseberi):** Ta çova nji fotografi ne ëhatcup tek ky numër bre shi a nji fugon i (variem- nuk kuptohet qartë). Ka letrat krejt me letra me krejt aa*

***0685182004 (F.Iseberi):** Hajde ta shoh nji herë.*

54. Më datë **07.12.2020** ora 08:37 përdoruesi i numrit cel 0685182004 Fatri Iseberi ka zhvilluar këtë bisedë me numrin 0698705235, në përdorim të shtetasit Ardjan Cali (Iseberi), vëllai i tij, me përmbajtje si më poshtë:

***0698705235 (A.Iseberi) :** Ku je?*

***0685182004 (F.Iseberi)**: Te Amerika*

0698705235:Kam nji kamionçinë që a dmth siguracion veç, qysh me ja ba a mun ta kaloj sot a thua, se më ka thënë me ja kalu sot..

***0685182004:** Jo vallaj, s'mun ja kalo:*

***0698705235:**Veç siguracion thotë aj ska i ka senet e tjera ku di gja unë letrat vari l...*

***0685182004:** Kur s'ka siguracion s'ka as kontroll teknik, sa ta shohin ata direkt...*

0698705235:Ai fugoni asht shumë copë copë ai dmth ai hec po asht cope ai se di...

0685182004:Leje për në darke or ti...

0698705235:*Kamionçinë po aj du me i marr të dyja ...*
0685182004:Po le për në darkë or ti në tetë*...*
0698705235:Po i thom për në tetë. *Hajt se po thom për në tetë ...*
0685182004: *Se di kush asht sot atje...*
0698705235: *Pyet një herë kot, sa mund të vejë funja fundit se ai vjen prej axhies, se më tha siguromë tha se mos më ashu mas anaj ...*
0685182004: *Hajt.*

55. Gjatë përgjimit të bisedave telefonike, rezulton se më datë **08/01/2021**, ora 10:15:12, shtetasi ***Ardjan Çali (Iseberi)*** komunikon me shtetasin **Robert Saraçi**, me numër telefoni **+355686770943,** me përmbajtje si vijon:

Ardjani*: M...*
+09431(Robert Saraçi)*: Alo...*
Ardjani*: Si je Bert?*
+0943*: Mirë, si je ti?*
Ardjani*: Ç`a bone? A flejte a pushove, a si kalove?*
+0943*: A u lodhe?*
Ardjani*: Mirë...mirë. Ç`a ke bo?*
+0943*: Mirë... Si kini qenë ju andej?*
Ardjani*: Mirë...tu kalu. A je kon mirë ti?*
+0943*: Boll mo, shyqyr zotit...*
Ardjani*: A naj gjo a naj llaf a?* ***Se du të iki deri në Kosovë e nuk e di se sa vonohem, për çët punë thashë që të të kallëzoj thash për naj gjo...A ke naj gjo?***
+0943*:*nuk kuptohet qartë*...me pas punë nisem andej...*
Ardjani*: A do vish sot domethënë ë?..*
+0943*: Po, me zotin para...ta mbarojmë at...*
Ardjani*: Po, mirë ti më shkruj mesazh, kshu me shkruj mesazh donmethënë edhe më trego se unë do rri në Kosovë edhe domethënë jam...se di sa vonoj..*
+0943*: O figurë... S`kam çfarë të shkruj..*
Ardjani*: Në çfarë orë do vish për shëmbull ti që ta di pak a shumë....*
+0943*:Unë nga ora dymbëdhjetë do nisem që këtu..*
Ardjani*: Aha...ishalla po hajde tash..ta lo si punë të mbarume domethënë...cila??* ***Ajo..aa....o në rregull ajo, a hec në rregull?..***
+0943*:* ***Po mor burrë...***
Ardjani*:* ***Hajt po ishalla ta kryjmë kët bre....***
+0943*:* ***Unë i dhashë...*** **nuk kuptohet qartë*.*
Ardjani*: Hajt se folim..*
+0943*: Shëndet..*
Ardjani*: Hajt se kam njerëz...*

56. Gjatë përgjimit, rezulton se më datë **09/01/2021**, ora 10:11:54, shtetasi ***Ardjan Çali(Iseberi)*** komunikon me shtetasin Hebib Kovaqi, me numër telefoni **+355685441044,** me

përmbajtje vijon:
+01044: Hë mar....
***Ardjani**: Sa je tu i morr çato...a të interesojna a jo....*
*+01044: O s`di gjë bre, me fol me të *nuk kuptohet qartë*....*
***Ardjani**: E...domethënë, ka..domethënë, ki i ka marr 255 euro copën atje op daj....*
+01044: A?..
***Ardjani**: 255 euro copën i ka marr atje ai.....*
*+01044: Po fol me..fol me... *nuk kuptohet qartë*..*
***Ardjani**: Hajt pra se folim hajt...*
Gjatë përgjimit, në komunikimin e datës **09/01/2021,** ora 10:28:38, shtetasi ***Ardjan Çali (Iseberi)*** komunikon me sms me një person të paidentifikuar, me numër telefoni **+355685305323,** me përmbajtje si vijon:
+5323: A ka instagram o zotri...
+5323: Apo kot është mi shkrujt...
***Ardjani**: Kujt po thu...*
*+5323: **Asaj te dogana**...*
***Ardjani**: Nuk ben...*
*+5323: **Me prish pun mu**...*
***Ardjani**: Se na ka pa bashk...*
+5323: Po me e gjet diku tjetër...
+5323: Njëllojështë o zotri...
***Ardjani**: Na ka pa bashke pz..*
+5323: Ok se e gjej diku tjetër o zotri..
***Ardjani**: Pz nuk ben mor burr.*
57. Gjatë përgjimit, për komunikimet në vijim, rezulton se më datë **09/01/2021,** ora 14:11:55, shtetasi ***Ardjan Çali*** (Iseberi) komunikon me sms me një person të pa identifikuar, me numër telefoni **+355695227556,** mbi kalimin e një mjeti kamionçinë, me përmbajtje si vijon:
+7556: Jasu e re byrazer...
***Ardjani**: Ç`a bone a je mirë?*
+7556: Mirë, t`u ardh andej jam..
***Ardjani**: A.. po mirë. Hë, ç`a plani ke?..*
*+7556: **Kamionçinën sonte...***
***Ardjani**: Do me e afru apo ça do me bë më të?*
+7556: A?.....
***Ardjani**: A e ka afru ai a jo?..*
*+7556: **Do e afroje...t`u e afru osht.**.*
***Ardjani**: Po mirë pra, duhet me e pa, duhet me e pa se ku do të ma lonë, se duhet me e pa se kur do ta bëjmë rrugën...se sonte, pale a mund të bohet..*
*+7556: **Ponormal, tani me e pa. Kur e bën rrugën e din tej**...ti kthesh kamionçinën te karburanti e të ma bish në Kukës.*

Ardjani**: **Duhet me e lonë kamionçinën te Agroni ose te karburanti bre..
+7556: Ku ke Agroni? Te karburanti më, kamionçinën te karburanti.
Ardjani**: **A e ka pru ai te karburanti a?
*+7556: **Se ka pru ala ai, te e pru poshtë, ta shofim**...*nuk kuptohet qartë*..**ta bi ai aty, ti kthehesh ktej**... ...*nuk kuptohet qartë* **e do ma bish në Kukës**...*
***Ardjani**: **Po jo jo se sonte nuk bohet fjalë me ardh ai një herë**...*
*+7556:**Pse?***
Ardjani**: **Po s`duhet bo rruga o byrazer, nuk osht aq kollaj. A kupton? A je tu ndigju?
Komunikimi mes tyre vijon sërish në datë **09/01/2021**, ora 14:13:33, ku shtetasi ***Ardjan Çali (Iseberi)*** komunikon me shtetasin me numër telefoni **+355695227556,** me përmbajtje si vijon:
+7556: Hë.
Ardjani**: **T 'kaloj ajo, duhet me e lonë aty, duhet me e lonë aty afër edhe me pa kur bohet rruga me u kalu, a kupton?
+7556: ***Po normale, te karburanti do na a lej ai karrotreci...***
Ardjani**: **Po dakord, po a hec vetë ajo makinë a jo?
+7556: *Hec i shkë.... nonën..Po unë vetë do vi për Peshkopi me të?*
Ardjani: Dakord, dakord, ta shofim një herë, po tjetër gjë, a ke me marrë ti a jo?
+7556: ***Po, do iki të marr dhe do goma.***
Ardjani**: **Po mirë tashi ti, hajde në Kukës, tako mue, merr..të jap pesëdhjetë euroshin për me ja dhonë atij të karrotrecit.
+7556: *Qysh të bëj?*
Ardjani**: **Hajde ti në Kukës.
+7556: Po
Ardjani**: **Ta jap pesëdhjetë euroshin unë...
+7556: *Po*
Ardjani**: **Jepja atij të karrotrecit
+7556: Po...

58. Në bisedat në vijim, rezulton se Ardian Iseberi, përdoruesi i numrit ***0698705235*** flet me një person të afërt të shtetasit Robert Saraçi, i cili është dërguar për të transportuar mallin (gomat) në drejtim të Peshkopisë. Telefonuesi, shtetasi Rasim Spata, shkon për të marrë gomat, të cilat Ardian Iseberi i ka grumbulluar tek shtëpia e tij dhe prej andej, t'i dërgojë tek servisi i Robertit. Konkretisht mes tyre në datë**26/12/2020**është̈zhvilluar biseda si vijon:
***684455503 (R.Spata)**: A je tek shtëpia?*
***698705235 (A. Iseberi):** Po kush je ti?*
***684455503**: Jam ai kushnini i Bertit*
***698705235**: Cili?*
***684455503:** Kushërini i Bertit or ti.*
***698705235**: Aha ca bone mor?*
684455503:Vij ti marr a ato .. A i ke ato ke shpia?
***698705235**: A do marish ato si kam sot aa?*

684455503: Po
698705235: Unë kam marrë vetëm tetë copë kam marrë unë sot.
684455503: Qato qi ke marrë tit e vij ti marr
698705235: A situ shku atje me i afru ato?
684455503: Po s'ja vlen ato me i marr hiç ato ishin të marume krejt or burrë.
698705235:Po ca të ka thënë Berti të ka thënë me ardh me marrë vetëm ato tetë copë apo ca?...
684455503: Po…….
698705235:Oooo po Berti më tha do shkojë të vijë me i afru ato të tjerat mor burrë
684455503: Ose do vij në mëngjes unë ti afroj në mëngjes, do vij në mëngjes herët.
698705235: Po mire pra, ca veni je ti? Se unë jam në Kukës
684455503: Kur të afrohem unë ke shpia jote të marr në telefon.

59. Biseda e datës **26/12/2020**, ora 17:54:33, vjen më vijim të bisedave midis shtetasit **Ardian Iseberit** dhe përdoruesit të numrit *0684455503,*regjistruar në emër të shtetasit Rasim Spata, me përmbajtje si më poshtë:

684455503 (R.Spata): *O vella ca bane?*
698705235 (A.Iseberi): *Mire ke je*
684455503: Tash jam këtu ke ky karburanti
698705235:Prit ke karburanti se erdha asnjë minute nuk vonohem. A je tek karburanti a jo?..
684455503: Po pot u dale aty, tu u afru jam.

Po në datë **26/12/2020**, ora 17:43:08, shtetasi **Ardian Iseberi**, nga numri i telefonit 698705235, zhvillon një bisedë me bashkëpunëtorin e shtetasit **Robert Saraçi**, përdorues i numrit 684455503, regjistruar në emër të shtetasit Rasim Spata, banues në Dibër, në lidhje me kalimin e mallrave në kufi, me përmbajtje si më poshtë:

684455503: A je tek shtepia?
698705235 (A.Iseberi)*: Po kush je ti?..*
684455503: ***Jam ai kushnini i Bertit….***
698705235: ***Cili?****...*
684455503: Kusherini i Bertit or ti
698705235: Aha ca bone mor?.
684455503: Vij ti marr a ato qi.. A i ke ato ke shpia?...
698705235: A do marish ato si kam sot aa?.
684455503: Po……
698705235:Une kam marre vetem tete cope kam marre une sot
684455503: Qato qi ke marre tit e vij ti marr
698705235: A sit u shku atje me i afru ato?
684455503: Po sja vlen ato me i marr hic ato ishin te marume krejt or burre…
698705235:Po cate ka thene Berti te ka thene me ardh me marre vetëm ato tete cope apo ca?
684455503: po.
698705235: Oooo po Berti me tha do shkoje te vije me i afru ato te tjerat mor burre…

684455503: *Ose do vij nemengjes une ti afroj ne mengjes, do vij ne mengjes heret.*
698705235: *Po mire pra, ca veni je ti? Se une jam ne Kukes*
684455503: *Kurt e afrohem une ke shpia jote te marr ne telefon.*

60. Nga verifikimi i bërë mbi përkatësinë e numrit të telefonit te personit që bashkëbisedon me Ardian Iseberin në komunikimet e referuar më sipër, dhe nga verifikimi nëpërmjet kompanisë telefonike "*One-Telecomunitacion*" ka rezultuar se përdoruesi numrit celular 0684455503, është shtetasi Rasim Spata banues në Dibër, i cili në datë **26.12.2020**, për llogari të shtetasit Robert Saraçi referohet nga ana e Prokurorisë se ka kryer kalimin e mallrave kontrabandë në kufi, në bashkëpunim me shtetasin Ardian Iseberi.

61. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit për marrjen e te dhënave, rezulton se në datë **26.12.2020** shtetasi Rasim Spata ka kaluar kufirin tokësor dhe është regjistruar nga pala Kosovare në kufi me automjetin me targa, "AB954BE" në pronësi të shtetasit Robert Saraçi.

Këto të dhëna lidhur me ngjarjet e datës 26.12.2020, parkojnë edhe me komunikimet e kësaj datë që zhvillohen midis shtetasit Robert Saraçi, Ardian Iseberit dhe Rasim Spata si dhe bisedat mes Ardian Iseberit dhe vëllait të tij, të pandehurit Fatri Iseberi.

Konkretisht biseda e datës **26/12/2020**, ora 18:34:04, midis të pandehurit **Fatri Iseberit**, përdorues i numrit 694115447 dhe vëllait të tij, **Ardian Çali (Iseberi),** përdorues i numrit 698705235, me përmbajtje si vijon:

694115447(F.Iseberi)*: Ku je mor?*
698705235(A.Iseberi): *Te shpia*
694115447: *A te ka thirr ai Dibrani?*
698705235: *Jo jo pse*
694115447: ***Po a kap nje djal tezes vet.....(bisede qe nuk kuptohet)....bosh po tha i kam lane tek karburanti tha...***
698705235: *Mu me tha skam lane mo...*
694115447: *Su ba as nizete minuta ai djali qe kaloi...*
698705235: *Jo me moren ne telefon me tha skam lane gja...*
694115447: *Ah mire leje.*

62. Në vijim datë **26.12.2020**, ora19:06:51, Ardiani nëpërmjet numrit 0**698705235** vijon të zhvillojë këtë bisedë me përdoruesin e numrit celular **355684455503,** identifikuar si shtetasi Rasim Spata, me përmbajtje:

698705235 (A.Iseberi): *A e kje kalu Kolosanin ee?*
698705235: *A ke shume me shku ee?*
684455503 (R.Spata)*: E ha sa te dush...*
698705235:A te ndali ndonjë polic atje e dogane aaa?...
684455503:Vellai jot mor ishte aty tek sporteli...
698705235: Po pse i ka thane qe kam afru goma tek karburanti...
684455503:Jo kam afru, katër goma ke karburanti ke ai Agron a ce ka...
698705235: *Ai me tha ka afru goma mor me tha a ste ka thirr a ku di gje.*

684455503**: **Jo mor shok, katër goma, tha a e ke gja ne makine? Jo i thashë gomat i merr vëllai jot i thashë...
***698705235:** A e njofte qa asht vëllai im aa?...*
***684455503:** Tu e pa tu e pa, kur me thirri ku asht Berti, se e pata pare nji herë me Bertin dhe atëherë mu kujtu...*
698705235:Sa goma kishe tee?..
684455503:Janë do mor burrë por se di do i marr a s'do i marr se smëpëlqentepër zotin se për 15 euro ato goma s'ja vlente. S'mund ti shesësh ma shumë se njëzet mijë lekë në Peshkopi a e kupton...
698705235:A i the Bertit qës'mora asnji gjo?
***684455503:** Po e din mor burrë Berti, ça janë këto pyetje mor shokë...*
***698705235:** Jo thashë a i tregove Bertit se i rashe telefonit e sa hapi mor burrë...*
***684455503:** Po Berti asht ne gjumë, po ku me afru mor shoke ku me nejt këtugjithënatën, unë mor zor jam tu hik knej, për malore tu xhiru, me nejt gjithënatën ne Kosovë...*
698705235:Po mu me tha Berti qa asht nis, se nuk bon seunë kamshku sot kam ba debat me ata atje
***684455503:** O shoku nuk e di se ca boni ju...*
***698705235**: Po jo nuk ban me punu, nuk ban me shku vetëm atje ky asht problem...*
***684455503:** Po s'jam shku mor shoku skam marre asnjë gome*
698705235**: **Po nuk ka lidhje se asht prone e huj. Uni sot kam shku atje i kam thane, kur ka me ardh e marre te tregoj, a u nisem rrugën e pare ne bashke...
***684455503:** Po mire mor shok*
***698705235:** A i rashe telefonit i kam thane o zotëriunë nuk vij pa te tregu. I kam ra s'asht përgjigj, kam shku aty i kam thanë.*
***684455503:** Po mire mor shok tashi ca problem ke me mu?*
***698705235:** Po jo ca problem ke se ti shkon atje dy sekonda. Ai hun e te gjen aty e te thotë kush je ti të thotë, se ai nuk të njef ty.*
***684455503:** Po skam shku mor shok.*

63. Një ditë më pas, në datë **27.12.2020**, ora 16:54:32, midis shtetasit **Ardian Iseberi**, përdorues i numrit cel 355698705235 dhe shtetasit Robert Saraçi, me numër 355686770943, zhvillohet me përmbajtje si vijon:

***355686770943 (A.Iseberi):** Merrem pak ke ai numri tjeter merrem...*
***355698705235 (R.Saraçi)**: Ok.*

Po në datë **27.12.2020**, ora 16:55:21, shtetasi Ardian Iseberi, përdorues i numrit 0698705235, ka zhvilluar këtë bisedë një person tjetër, përdorues i numrit 355682615921, mbi kalimin e mallrave kontrabandë (goma) nga Kosova në drejtim të Shqipërisë. Nga verifikimi i kryer, me shkresën nr. 8650 prot., datë 01.11.2021, të kompanisë telefonike "*One-Comunication*", rezulton se ky numër është i regjistruar në emër të shtetases **Lirije Saraçi**, banuese në Dibër, nëna e shtetasve Robert Saraçi dhe Erion Saraçi. Rezulton se ky numër celular është përdorur nga shtetasi Erion Saraçi, i cili bashkëpunon në këtë veprimtari me vëllain e tij Robert Saraçi. Konkretisht, nga

përgjimi i bisedave të subjekteve të mësipërm, në datë**27.12.2020**, kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:

0698705235 (A.Iseberi): *Jam ken tu u nxeh shume keq me tyja sot ne sabah. Kam kenë tu të marr në telefon. Nuk je tu me dal korrekt ne kuptimin e fjalës po meqë je tu ardhë hajt takona një herë e pimë një kafe.* ***A ikim në Kosove a ke me marrë ndonjë gjë tek Agroni apo ca?***

355682615921 (E.Saraçi): *Po*

0698705235: *Hajt se po vi njëherë ta shofim situatën tamam qysh ashte, po ku te pres pra?*

355682615921:I thashë byrazerit tim ai e di ku aaa

0698705235: *Ai byrazerit tat asht ftoh prej teje...*

355682615921: *Dje kam qene gjithëditën ke sprinteri kam lanë leshte...*

698705235:O ti zotëri ai ty dje te ka prit për kafe, biles e kish pas nal edhe atë kushëririn tand atje dje, me tha mu nuk të ka thirr tha. Jo i thashë nuk ka thirr. Kur vjen ai kushëriri tat, shkon tek prona e atij Kosovarit pa me tregu mu ka ardh a ska ardhë. A de se është gabim se me ka çu mesazh, mos me ardh atje pa më tregu mu. I kam thanë nuk të vjen kush pa të lajmëruar, shkon ai atje, ai kushërini yt me pa gomat, as gomat nuk i afron

355682615921: *Nigjo njëherë se ca boni me ket kushërinin tim ju ja futni kot. Unë i thashë shko tako Ardianin edhe shkoni me Ardianin atje. Ai më tha ka qenë me nusen e vet.*

698705235: *Ai s'ja ardh me më taku. Jo s'ka qene me nusen e vet.*

355682615921: *Me vëllain e nuses se vet ka qene.*

698705235: *O ti zotni unë heci me fjale me korrektësi, nuk heci unë me u tall shkon ai atje. Ca veni je një here hajt takohena ne Kukës edhe ikim bashke anej hajde.*

35568261592:*Unë skam pune tjetërvetëm do shkoj ke ia plaku ai i gomave ene të pimë kafe me Fatriun. Hajde mere një rruge ti tani atje ke Agroni hajde.*

64. Po në datë **27/12/2020**, ora 17:07:24, shtetasi **Ardian Çali (Iseberi),** përdorues i numrit celular +355698705235, ka zhvilluar bisede më një shtetas, përdorues i numrit celular +355682615921, ku flitet mbi kalimin e mallrave (goma) kontrabandë nga Kosova në drejtim të Shqipërisë.

Sms Text: *Hajde shifi tani se jam me ta qetu ne Kukës.*

Sms Text: *E ikim direkt për Kosov shife a te bëjnë a jo.*

Po ashtu rezulton biseda e datës **27/12/2020**, ora 17:10:08, bërë midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi)** dhe përdoruesit të numrit celular 0682615921, si më poshtë vijon:

698705235 (A.Iseberi): *E ju tu ardh tani te takohena, qitu ne Kukës, shifi edhe të ikim.*

682615921: *Po ku je*

698705235: *unë jam mu te axhensia dmth këtu tek karburanti sa bën me shku te shpia ime.*

682615921: *Erdha.*

698705235: *Sa vonon.*

682615921: *Kam kalu bistr, tu u fut ne aeroport.*

698705235: *Ala s;ke hy në aeroport aa?*

682615921: *Jo po s'do vritem rrugëve se skam fëmijët pa buke.*

698705235: ***Po mirë pra hajt se të pres, shifi të paktën oi merr e çoji te shpia të bëjë ça te dojë,***

shifi thashë se për qet punë. A të bëjnë a stëbëjnë.
***682615921**: Po pastaj desha tu u kthy nga Kosova po mi ndërron dy bidona vaj mi ban dy bidona te mi mbushesh me ujë.*
***698705235**: Aj qat pune nuk ndodh te unë, nuk ndodh, nuk ndodh me mue, unë tëthashëveç shifi a i merr a si merr . Te pres këtu se jam me gjithë ta qe ta di te paktën qe ta çoj tek shtëpia dhe i kam ne makine teme.*
***682615921**: Erdha, erdha.*

65. Biseda e datës **27/12/2020**, ora 17:22:47, midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi)**, përdorues i numrit celular 0698705235 dhe një shtetasi me numër 0693887833, regjistruar në emër të shtetasit Bari Iseberi, të cilët flasin për vendin e lënies së gomave, me përmbajtje si më poshtë:
698705235 (A.Iseberi):Ky thotë me i lanë diku me diskutu manaj të kthej përgjigje qysh me ja ba, a i çojmë një herë tek shtëpia edhe mas anaj?...
***693887833:** Jo ça me diskutu në qofte se si merr sa nevoja i thuj leje ik...*
698705235:Hajt pra ti sjell te shpia, ku je ti sjell ke shpia, hajt se jam tu hik për Kosove hajt...
***693887833:** (bisede qe nuk mund te deshifrohet)...*
698705235:Ku or ti se s'ban me i lanë aty se i shofin njerëzit e qashtu
Po në datë **27/12/2020**, ora 20:35:06, shtetasi Ardian Çali (Iseberi), përdorues i numrit 698705235 zhvillon këtë bisedë me një shtetase përdoruese e numrit 0699279417, regjistruar në emër të shtetases Esmeralda Alia, të cilën e informon se do të shkojë në Kosovë për të marrë goma kamioni, me përmbajtje si më poshtë:
698705235**: **Ka shku me marr ja dy goma kamioni, thote hajde merri tash. I thashe me lej nje makine tanden se vij i kaloj në darkë...
***699279417:** Po ti qe tash?*
698705235:Po qe tash duhet me shku me e kalu...
***699279417:** (...Fjale qe nuk kuptohen.....)*
***698705235:** Jo që tash kur të vijë në doganë*
***699279417:** Sa vonon?*
***698705235:** Nuk e di për zotin...*
***699279417:** Qate tha?*
***698705235:** Kur te vij atje that e bej telefon. Ok i thashe kur te vish tek dogana ma ban telefon.*

66. Në datë **27.12.2020**, ora 21:13:27, janë zhvilluar disa biseda me interes midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi)** dhe vëllait të tij, të pandehurit **Fatri Iseberi,** përdorues i numrit 355685182004, me përmbajtje si vijon:
Sms Text Ardian Iseberi: "M'thirri ai flokshi mja kalue nja 2 goma kamioni a te vij tja kaloj me makij te atij renxhroverin se makina ime si zen." Summary item 103: ***Sms Text 685182004 (F.Iseberi): "hajde".*** Summary item 104: ***Sms Text Ardiani: "Ok";*** Summary item 105: ***Sms Text685182004:*** "***te 4 jam aty ku hyn ka 2***";Summary item 106: ***Sms Text Ardiani: "Ok se hala sa afrue aty";***Summary item 107: ***Sms Text 685182004: "para ores 11:30 se bi me pushu pastaj";***Summary item 108: ***Sms Text Ardiani: "Ishalla po vjen deri qat here se me thirri tha nuk vonohem".***

67. Në datë **27/12/2020**, ora 22:47:21, midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi),** përdorues i numrit 0698705235 dhe shtetasit **Robert Saraçi**, përdorues i numrit 0686770943, zhvillohet me përmbajtje si më poshtë:

698705235(A.Iseberi): *Ku je?*

686770943(R.Saraçi): *A je ke shpia apo te iki?*

698705235:*Unë ke shpia jam po ku je ti?.* ***A kalove a jo?..***

686770943: *Po...*

698705235: *A i kalove ato te tjerat a jo?..*

686770943: *Po jo or burrë jo. Hajd se erdha aty ajt.*

68. Në datë **28/12/2020**, ora 11:35:08, midis shtetasit Ardian Çali (Iseberi), nëpërmjet numrit ***698705235*** dhe një shtetasi, të identifikuar si Rasim Spada, i cili punon për llogari të shtetasit Robert Saraçit, përdorues i numrit celular ***684455503***, zhvillohet biseda me përmbajtje si më poshtë:

698705235 (A.Iseberi)*: Mir ca bone. Kush je?* ***Aaa me ca ke ardhe me Sharonin***

684455503 (R.Spada)*: Me sharonin dhe me Fiatin.*

698705235*: A po ca me ba, a me shku atje, doni me i afru tek karburanti?*

684455503: Do sjell një herë ti afrojmë e të lemë sharonin ty këtu

698705235*: Po mirë ta shofim afrohni një herë edhe ta shofim nase asht puna.* ***Ta shof njëherë se kush asht atje në Kosovë lejeni atë Fiatin e ngarkum, ndoshta lidhu me internet, se ndoshta e kalojmë atë Fiatin direkt.***

684455503*: Të lëmë fiatin të çojmë keto gomat e mëdhaja apo të lemëgomat e vogla?*

698705235*: Po gomat e vogla ku i ke*

684455503: Janë ne malisheve...

698705235*: A ki me afru edhe te voglat edhe te medhajat ee?*

684455503*: O vëlla neve me shume na duhen gomat e vogla a kupton*

698705235*:* ***Po mire ti afroji të vogla afroji dhe të mëdhajat sa të munesh, se shofim se ca mund të bëjmë. Mos e le makinë e ngarkume, vetëm afroji dhe leji aty ok...***

684455503*: Ok . Ne rregull edhe folim ne telefon.* Biseda midis tyre vijon po në datë **28/12/2020**, ora 11:31:58, ku shtetasi Ardian Çali(Iseberi) i thotë përdoruesit të numrit 355684455503, shtetasit Rasim Spada, për mënyrën sesi të kalojnë gomat në kufi me përmbajtje si më poshtë : "... ***njeni ti ngarkoj ....sharonin hiqi sediljen ..... kur ti afrojm të themi në tel ... të njofton Berti....".***

69. Në ditën që zhvillohen komunikimet dhe ngjarjet si më sipër, pra në datë **28/12/2020**, ora 11:57:26, shtetasi Ardian Çali (Iseberi), përdorues i numrit 698705235, komunikon në telefon me vëllain e tij, punonjësin e PKK Morinë **Fatri Iseberi**, përdorues i numrit celular **685182004,** të cilin e informon mbi mënyrën e kalimit të mallrave kontrabandë në kufi, me përmbajtje si vijon: ***698705235(A.Iseberi)****: Me bone zile...*

685182004(F.Iseberi)*: Me kishe marre ne telefon ti bre, ne sabah.*

698705235*:* ***Se radha pra se i kane lenë atje dy copë si ka marrë, ka kalu veç katër copë te vogla.***

685182004: Në ca ore ka kalu ai që se kam pa unë?..
698705235: E i thashë pra e habitshme, ka kalu para orës 11;30, dmth, me ranxhe rover vet i trete i kishte marre katër cope .....po me Ranxhe Rover i ka kalu, me renxhin e zi, ky ka ken pasagjer aty mbrapa mos me .....(fjale qe nuk kuptohet). I kisha marre katër cope se erdhi aty ke shpia bre...
685182004: Se di.
698705235: Vari lesht se i thashë para orës 11:00 dmth si ka marre te mdhaja se janë shumëtë mëdhaja ato janë pa lidhje.
685182004: Mos i merr as ti.
698705235: Po joato te mdhajat mi ka lënë, me ka pru nji Sharon me i kalu me Sharon, janë nja shtate tete cope, po duhet me shku dy tre here .

70. Po në datë **28/12/2020**, ora 11:59:07, shtetasi **Ardian Çali (Iseberi)** nga numri celular 0698705235, zhvillon këtë bisedë me vëllain e tij, të pandehurin **Fatri Iseberi**, në të cilën komunikohet se ka disa mallra për të kaluar dhe e pyet vëllain se kush është me shërbim në kufi, me përmbajtje si vijon:
***698705235(A.Iseberi)**: Pse e fike mor?*
***685182004 (F.Iseberi)**: Po jam te shpia or ti...*
698705235: A po se kush ka le atje ne pune?
685182004: Halimi apo Gjergji. Xheferr Shaja...
698705235: Aha me shku me vone nji rruge...
685182004: Shko bre bone....(fjale qe nuk kuptohen)

71. Në datë **28/12/2020**, ora 12:12:49, shtetasi Ardian Iseberi nga numri celular 698705235, zhvillon këtë bisedë me interes me personin tjetër që përdor numrin 696244448, me përmbajtje si më poshtë:
698705235: Ke je mo?
696244448: Me pi një kafe
698705235: A je kan te Ladi?
696244448: Kadal kadal se tash fola me ta. Skam kenë hala.
698705235: S'ka qene hala ke Ladi o zoti prokuror. Se di thotë. Ca ti them a ti them të shkojë? Urgjent thotë shko te Ladi thotë.
696244448: Po hajt se shkoj unë.

72. Në datë **28/12/2020,** ora 18:05:28, midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi)**, përdorues i numrit 698705235 dhe shtetasit **Robert Saraçi,** përdorues i numrit celular 0682615921, zhvillohet një bisedë ku flitet për kalimin e mallrave, me përmbajtje si vijon:
698705235 (A.Iseberi): Ca janë ata mor burrë ata invalida, shtatë orë kanë, tetë goma me zor kanë afrue.
***682615921 (R.Saraçi)**: Po e di mor.*
698705235: Po ti më the i kanë bërë dyshe, i kanë bërë treshe.Ca janë ata invalda or burrë...
682615921: E mirë
698705235: Sharoni pa xhama te zi...

682615921: Tani dëgjo, dëgjo
698705235: Jo tani, unë tani kalova, s'ka problem, mezi ja vuna, ma ka ba makinën krejt ujë. Tashi ti më the goma të vogla, unë...
682615921: Sharonin e kam pru për atë pune.
698705235: Ato të mdhajat duhet gjet koha or Bert. Sa kur dum unë ene ti. Ajo duhet gjet koha për ato të mdhajat se bjen makina, tre burra me zor e kena ngrit një gomë. Sa bëj unë tashi me e shkarku vetëm...
682615921: Do vinë ata do vinë po hë.
698705235: Tashi a duhet me shku me marr të tjerat unë si e shkarkoj kët gomën?
682615921: Po shko të tjerat merri me Sharon futi ne Sharon edhe venin je batanije persiper
698705235: Po më kë shkoj në Kosovë unë or ti?
682615921: Merre mor burrë edhe makinën tande, mere një shok se ai, tani unë nuk jam i vetëm o Ardian se unë punoj me njerëz me vëlla me kushëri
698705235: Nuk ka kush terezi më mas meje or ti Bert. Gjithkush ka hallet e veta, ka punët e veta.
682615921: Aty më një karburant hidhi aty më një cep edhe iki...
698705235: Jo jo tek shtëpia se skam ku i le në karburant këtu rrugëve...
682615921: Jo mor burrë tek shtëpia, mos zbrit poshtë leni ne një karburant...
698705235: Po mor burrë tek shtëpia se kam me marrë edhe atë pjesë.

73. Në datë **28/12/2020**, ora 19:00:18 zhvillohet kjo bisedë midis shtetasit **Ardian Çali (Iseberi)** 355698705235 dhe vëllait të tij, të pandehurit **Fatri Iseberi,** përdorues i numrit celular 355685182004. Në këtë bisede Ardiani e informon Fatriun për mënyrën sesi do të kalojë gomat në kufi dhe problematikat që has, me përmbajtje si vijon:

685182004 (F.Iseberi): A dole?
698705235(A.Iseberi): Jo s'dola janë këto të mdhajat nuk ngarkohen vetëm
685182004: Po si i kanë nda ça thonë ata...
698705235: Me zor i shkarkova, më thotë shko merr të vogla dalin të mdhaja, gjashtë orë kanë afru vetëm tetë goma të mdhaja, dy veta, janë me dy makina.
685182004: Kur të ketë të vogla shko vetë mos u merr me të...
698705235: Do me i kalu kaloj i thashë mos me acaro më ....e lashë këtej poshtë, mu këputën krahët...
685182004: Po lera punëtoret or ti...
698705235: po punëtoret lashë unë or nuk hipën or ti, ka shku me marr at te vogla, ku di gjë unë i marrin a si marrin, pale kur bëhen vonë s'ja vlen me shkue
685182004: Ka me i dhëne Kardiut, (fjale qe nuk kuptohet)...
698705235: Se di pale kur vene ato të voglat.....(bisede qe nuk kuptohet).

Në datë **28/12/2020**, ora 20:20:26 Ardiani në bisedën që ka me një vajzë, e informon se është për të ikur në Kosovë dhe për të marrë goma makine.

698705235: Jam tu u vesh se kam për me ik në Kosovë
699279417: Alo

698705235**: **Jam tu u vesh se kam për me ik për Kosovë, kam me marrë ca goma të vogla
Në datë **28/12/2020**, ora 21:29:03, është zhvilluar sërish një bisedë midis shtetasit Ardian Çala (Iseberi) me numër 698705235, dhe bashkëpunëtorit të shtetasit Robert Saraçi, shtatasin Rasim Spata, përdorues i numrit 684455503, me përmbajtje:
***698705235 (A.Iseberi)**: Ku je?*
684455503 (R.Spada):Jam tu ardh a je ke shpia
698705235: Bjer anej ka di ti a e kupton?
***684455503**: Po pra anej poshtë.*
74. Pas ngjarjeve të zhvilluara në datë **28/12/2020**, ditë gjatë së cilës janë zhvilluar edhe komunikimet e referuara më sipër, në një bisedë të datës 29/12/2020, ora 13:28:49, shtetasi Ardian Çali (Iseberi) nga numri 698705235, zhvillon këtë bisedë me një shtetas, përdorues i numrit 355699279417, të cilin e informon për sasinë dhe gomat që ka kaluar në kufi, me përmbajtje si më poshtë: "*ishalla marr 10 cop se patën ngelën ato të voglat se të mëdhat vërshtir me i kalu .....kam e të mëdha po të shof nesër ..... do shkoj tek shokët në Kaçanik ... në darke me i kalu vl ... nesër një mundësi ato të mëdhat një nga nji*". Po në datë**29/12/2020**, ora 16:05:16, shtetasi Ardian Çali (Iseberi) informon bashkëpunëtorin e shtetasit Robert Saraçi, shtetasin Rasim Spata, për sasinë e gomave që ka kaluar një natë më parë dhe për pjesën tjetër të mbetur, me përmbajtje si vijon:
***698705235 (A.Iseberi)**: Hiç vallahi ka je ka bohesh*
***684455503 (R.Spada)**: Unë jam në Kukës.*
***698705235**: A ke ardhe me marr ndonjë?*
684455503**: **Po. A i kalove ato te paktën?
698705235**: **Po i kam kalu ato të voglat krejt...
***684455503**: **Ok te shohim te zgjedhim nja dy rrugë më të mëdhaja**...*
***698705235**: Kush the*
684455503**: **Berti...
698705235**: **A me Bertin je?
684455503**: **Jo s'jam me Bertin jo. Berti ka hik për në Tiranë. Me kalu ndonjë te madhe me e marr edhe atë
***698705235**: Se di vallahi këto të mëdhajat sot nuk bëhet fjalë nje here. Ok*
***684455503**: Ne rregull, po morëm ndonjë gjë tjetër të morin në telefon.*
***698705235**: **Do ta menoj më vonë, nese mund me marr mirë nëse smunen skam ca bej**.*
***684455503**: Ok ne rregull.*
***698705235**: A duhet me shku me marre te tjera?*
***684455503**: Ta shofim nëse na pëlqejnë te marrim ne telefon.*
Disa minuta më vonë zhvillojnë përsëri këtë bisedë:
***684455503 (R.Spada)**: He mo plak...*
698705235 (A.Iseberi)**: I **kam sistemu pak ato gomat e mdhaja se ka fol ai pronari i karburantit. Mos i le ma gomat e hallakatme këtu. Duhet me i sistemu gomat se me ka thënë sot ne mëngjes.

684455503**: **Gomat i lashë se do i kalosh jo se do rrinë gomat aty...
***698705235**: Si si?*
***684455503**: Ne i lame se pate me i kalu mbramë...*
698705235**: **Gomat mos i le me të hallaktme ashtu se ka fol ai pronari i karburantit, që ta kesh parasysh se prish punë aty.

75. Në bisedën më poshtë, zhvilluar ne datë **29/12/2020**, ora 19:16:39, shtetasi **Ardian Çali (Iseberi)** informon vëllain e vet, të pandehurin **Fatri Iseberi** se njëri nga doganierët i quajtur Shpendi nuk e ka lënë të kalojë me mallin e ngarkuar në mjet duke i kërkuar të kthehet mbrapsht, me përmbajtje si vijon:

***685182004 (F.Iseberi):** A dole mor?*
698705235 (A.Iseberi)**: **Jo pra Sajmiri thotë kthehu mbrapa, fola me Shpendin ai me thote mu kthehu, masi dola unë ktheje mbrapa tha...
***685182004:** Kush të tha ktheje mbrapa?*
***698705235:** Sajmiri*
685182004**: **Hajde mor ktheje vari..
***698705235:** Se di ja te shof.*

Në datë **29/12/2020**, ora 19:31:54, shtetasi Ardian Çali (Iseberi) zhvillon këtë bisedë më përdoruesin e numrit celular ***0695227556***, me përmbajtje si më poshtë:

***695227556**: He mo dajo çish bane.*
698705235**: **Ku je ti se hala me kane kthy mbrapa një here se s'bëhet gjo se është shume problem një herë.
***695227556**: A po ca të bëj unë jam kenë këtu.*
698705235**: **Ku je ti? A ke dale andej nga dogana.
***695227556**: Jo mo kthehu këtej ne krah te majte shife mo...*
***698705235**: Ku je?*
***695227556**: Knej knej kam kalu doganën ne krah tjetër me ke.*
***698705235**: Hajt ne rregull, ne rregull hajt.*
***695227556**: A te pres këtu ku jam...*
***698705235**: Hajt prit një here prit.*

Pas disa minutash, po në datë **29/12/2020**, ora 19:50:59, shtetasi Ardian Çala (Iseberi) komunikon përsëri me ketë person, me përmbajtje si vijon:

***695227556**: Ha.*
***698705235**: Prit or burrëpër pak një herë.*
***695227556**: Me ranjënumërkështu maqedons apo çfarë ishte se nuk e njifsha...*
***698705235**: Po jo or burrë se si kam ra unë, a e ka kaluar doganën?. Prit një here pije një kafe sa te dal unë.*

Po në datë **29/12/2020**, ora 19:55:18, shtetasi **Ardian Çali(Iseberi)** komunikon më vëllain e tij, të pandehurin **Fatri Iseberi,** të cilit i thotë se ka paguar tridhjetë mijë lekë për kalimin e mallit në doganë.

***685182004 (F.Iseberi)**: He mor.*

***698705235 (A.Iseberi)**: Kallezoj Halimit thuj mbaje (fjalë që nuk kuptohet) tridhjetë mijë lekë ban po mos i thu.*
***685182004**: A kalove?*
698705235**: **Kalova ja dhashë 30 mijë lekëshin.

76. Në datë **30.12.2020**, shtetasi **Ardian Çali (Iseberi)** komunikon me shtetasin **Robert Saraçi** në lidhje me kalimin e gomave dhe bisedojnë në lidhje me një punëtor të tyre i cili ju ka vjedhur goma, me përmbajtje si më poshtë:...*atë dite kan ardh 25 goma, jan nxjerrë që atë ditë jan lënë në kamionçin e katër 29 ... 26 i kam lënë në Kosovë dhe i kam marrë në dark ... ai mashtruesi na ka fshehur 4 copë .....po shkoj ti marrë ato tjerat .... do mundohet ti fus tek njëra tjetra të marrim sa më shumë.. unë iki lart ti shko mbrapa merri .. ishalla po i kalojmë nesër në mëngjes të gjitha ... fol me atë me syze .....".* Në datë **30/12/2020**, ora 20:25:17, përsëri shtetasi Ardian Çala (Iseberi) dhe shtetasi Robert Saraçi vijojnë të diskutojnë lidhur me problemin e punëtorit, i cili ju ka vjedhur gomat, dhe gjatë kësaj bisede ata deklarojnë edhe vendin ku mbahen gomat në Kosovë para se të kalojnë kontrabandë në Shqipëri, me përmbajtje si vijon: ***698705235**: Nuk e hap tel o Bert, sapo i rashe nuk e hap telefonin*
686770943**: **Atij duhet me ja mbyll ata traun e doganës andej mos ta shkeli me kembe, se ai njeh krejt Kosovaret nga puna jonë. Do shkojë të më fusi në ndonjë borxh të madh andej...
***698705235**: Mos bej gabim o Bert se po na Benndonjë gjo tek karburanti pashe kokrren e ku i ke. Po na bënndonjë tek karburanti pashe zotin e madh or burrë se e bllokoj ne dogane pashe allahin e futi brenda për zotin.....(bisede pa interes)...*
686770943**: **Unë do vij nëmëngjes aty nja pesëdhjetë copë goma tek Agroni do ti bej gati edhe...
***698705235**: Po mirë tek Agroni kur do me i kalue?*
686770943**: Se po shkon me merr ndonjë gome edhe tek Agroni edhe me fut ne **698705235**: **Edhe tek Agroni edhe tek karburanti thuaj mos me ma lëne me u afru aty tek kolla...
***686770943**: Se ai po vjen po mbush makinën plot me karburant leket me thote mue hajde kur te vish rrugën tjetër, po unë s'jam mësue ashtu. Këta kujtojnë se janë makinat e mia edhe..*
***698705235**: Amanet hiqna qafe mos na ngatërro me të or burrë...*
***686770943**: Unë tani s'mund te flas po do takohemi të bëjmë një llaf për një diçka. Dac dil ena tako dy minuta*
***698705235**: Ku je ti bre?*
***686770943**: unë jam ne Vushtricë tek hidrocentrali duke rene poshtë...*
***698705235**: A e din ku do dal me te takue?*
***686770943**: Dila ty ne autostrade se nuk futem ne Kukës se asht kufizim orari*
***698705235**: ok ne rregull e din ku do me presësh, aty te.... Te kallëzoj unë.*
Në vijim përsëri vazhdon biseda midis shtetasit Ardian Çali (Iseberi) dhe Robert Saraçi, me përmbajtje si vijon:
***698705235**: O Bert he se me re*
686770943**: **E vetëm thuj me tha ai i karburantit thuaj shkova me marr goma
***698705235**:Për atë muhabetin ee?*

686770943: Po thuj me kerkoi numrin e telefonit tend thuj
698705235: A ti them se per cfare me tha, apo jo most i them?
686770943: Historinë thuaj, i ke lene nje porosi pa cu i thuaj sot.
698705235: Po qashtu nëse po ma hap telefonin se po i bie prapë tani.

77. Po në datë **30/12/2020**, ora 21:35:21, shtetasi Ardian Çali (Iseberi) komunikon me përdoruesin e numrit celular 684455503, transportues i mallit, identifikuar me herët si shtetasi Rasim Spata, në lidhje me problematikën e gomave që kanë kaluar në kufi, për llogari të shtetasit Robert Saraçi, me përmbajtje si më poshtë:

***698705235 (A.Iseberi)**: Me morën në telefon se ata të karburantit, nuk e di ca ke folë a ca ke bo me ta.*
***684455503 (R.Spata)**: Po*
698705235: Me kane dale ne rruge thotë. Ku di gjë unë ca ke pat një porosi ti ca ke diskutu ti me te. Kërkuan këtë numrin tand të kerkuejten ty.
684455503: Po fola mo me te unë...
698705235: Me ke fole?
684455503: Me ate plakun.
698705235: E ca tha?
684455503: Asnjë send. Po ca pune pat me ty ai, për çfarë te donte ty?
698705235: Po me doli ne rruge mor burrë se unë aty shkoj e i marr gomat mor burrë. Pyete vete mor burrë ai me doli në rrugë më kërkoi numrin tat e me tha qishtu qishtu për diçka që ke pat me i pru ti.
684455503: Po mirë moj dajë po ca pune ka me ty ai?
698705235: Ca pune ka e mue? Une kaq di me te thane qe dy fjale qe mi tha ai një, e dyta. Gomat qe i ke marre pse me ngatërron me Bertin mu, kane qene 29 goma krejt, Bertit i ke cu 25 goma, për ca me ngatërron mu me Bertin me hymë i ba be me ashtu?
684455503: O daku përata zot nuk di çfarë bën me gomat, pasi janë shkarku gomat kam ardh ne Kosove unë, jam kthy prape me kane dalë gomat mangut ku di gjë unë ca ***698705235: Gomat qe këna marrë atë natë 25 të miat e 4 që i ke marrë më Sharon, janë kane 29. Per cfare me ngatërron mu. Gomat e fundit i ka fiks ai, qe ate nate qe ke ik ti me te nuk i ke çu gomat. Për çfarë me ngatërron mu me te?***
684455503: Ti tashi për çfarë më merr në telefon mu për të më bërë presion
698705235: S'po të bëj presion unë po avash një herë, me mu shumë kujdes. Ti a i ke marre gomat tamam tek unë?
684455503: O Daku unë skam numëru goma, kur u ngarkuan gomat tek ti o daku
698705235: I ke numeru se ti kam numeru unë prezent teje, kujdes me mu
684455503: Kët hiqe kët kujdes, gomat nuk janë numëru, ato goma...
698705235:Ej kujdes kur te folesh me mu edhe nje here jam tu thane. Ej kujdes kur tefolesh me mu mos i ngaterro gjonat...
684455503: Flasim në mëngjes.

78. Veprimtaria e shtetasit Ardian Iseberi ka vijuar edhe ne vitin 2021, siç rezulton nga

përgjimi i komunikimeve të tij te referuara në procesverbalet e transkriptimit, duke veçuar bisedat si vijon: Më datë **10/01/2021**, ora 16:35:08, shtetasi **Ardian Iseberi** zhvillon bisedë me vëllain e tij, punonjësin e policisë **Fatri Iseberi**, me përmbajtje si më poshtë:

698705235: *Ku je?*

685182004: *Te Amerika*

698705235:Kur te pyesi une me mbrapa per gomat edhe i thuj qe sun ti marr me shume se 700 euro 750 ato gomat se i ka njoni edhe mos perfitoj do leke, se i merr njoni me shume dhe. Jam tu fol me Jeminin se i kam thane Jemin Iseberit

685182004: *A 700 -750 me i thone aa?*

698705235: *Po i kame thene une 600 po Jermini i ka thene 175 euro, me fitu ja njeqind euro edhe ti thuj, pot ha o kusho sa je tu e bo per mu ti thuj max 750 qish thom une ashtu thuj hajt.*

Më datë **10/01/2021**, ora 17:01:00, shtetasi **Ardian Iseberi** me numrin 0698705235, zhvillon bisedë me një shtetas tjetër, por që komunikon me numrin e punonjësit të policisë **Fatri Iseberi** 0685182004, me përmbajtje si vijon:

698705235: *O kusho ca bone?*

685182004: *Si je?*

698705235: *Jam me kete shokun me 700 a te leverdisin mei marre krejt a jo?*

85182004: *Po job re kusho bane 750 e dhe hajde mere*

698705235: *700 euro kater here kater i ke ato ti bie neser merri krejt*

685182004: *Ani se vij i marr pra hajt*

698705235: *Ti bie neser*

685182004: *Po po hajt shendet.*

79. Më datë **11/01/2021**, ora 10:14:55, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0685182004, ka zhvilluar bisedë me personin tjetër me numrin 0692244843, me përmbajtje si më poshtë:

692244843: *A u lodhe bre?*

685182004: *Si kalove?*

692244843: *Ne pune je ?*

685182004:*Po bre*

692244843: *A e ke komandant Halimin aty?*

685182004:*Jo.*

685182004: ***Po pra po hala sna ka kthyer pergjigje per njonin qe e ka pas nje te Maqedonise ta shohim edhe ate te atij edhe te kallezoj***

692244843: *Ani po ky është shok më i mirë se ai i Maqedonisë, se ai i Maqedonisë është edhe me i fortë se ne...*

685182004: *Ok...*

692244843: *Hajt ne rregull ok veç mos e harro si variant hajt.*

80. Me datë **12/01/2021**, ora 22:23:17, personi që ka përdorur numrin *0699834805*, ka zhvilluar bisedë me punonjësin e policisë **Fatri Iseberi,** në numrin 0685182004, ku bisedohet për dhënie parash nga personi përdorues i numrit 0699834805, përpara se të kalojë në kufi me

ndihmën e shtetasit Ardian Iseberi, vëllait të punonjësit të policisë Fatri Iseberi, me përmbajtje, si më poshtë: ***699834805:*** *Alo përshëndetje. Për pak aty jam unë sa kaluam Kukësin*
685182004 (F.Iseberi): *Ok kur te afrohesh me merr ne telefon.*
699834805:Ok ne rregull, edhe me thuaj si te ta jap atë porosinë, se unë s'para i di këto gjëra...
685182004:Ok ta ardh atje tee. Atje do te takoj nja pesëdhjetë metra me para...
699834805:Dmth 50 metra para se me u fut te te marr ne telefon...
685182004: *Po pa u afru me merr ne telefon.*
Po atë ditë, në datë **12/01/2021**, në orën 22:28:30, pasi, siç rezulton nga bisedat, kanë shkuar në kufi, zhvillojnë bisedën si më poshtë:
699834805:Alo këtu jemi ne mbrapa këtyre kamionëve. Te presim këtu apo te futemi?.
685182004 (F.Iseberi): *Vij ju takoj atje dy minuta.*
81. Me datë **20/01/2021**, ora 10:30:13 deri më 10:30:54 P.D, shtetasi Ardian Cali (Iseberi), përdorues i numrit 0698705235, komunikon me personin e thirrur "Sajmir", me të cilin bisedojnë për veprimtarinë e transportimit dhe shitjes së gomave, me përmbajtje bisede si më poshtë:
Sajmiri- *He ore Dan?*
Ardian: *O Sajmir a je kthye a hala jo?*
Sajmiri- *Jo, jo jam këtu, tek pazari hala*
Ardiani: ***Ej kur te kthehesh janë vetëm dy goma se i mora nja 22 copa janë vetëm dy goma a je tuj me kuptue...A di ku i kije ?***
Sajmiri: *Pala a munt i ve mo ne ta se e kam mush plot*
Ardiani: *O dy goma ja ben hallin po mos me qit pune për dy goma, pajsh zotin e madh*
Sajmiri: *Po a mush...Ore po te them o mush plot me tapete, karrige, divane...qe ki me e pa vetë ti bre*
Ardiani: *Po ja bën hallin për dy cope ti mo burri i dheut:*
Sajmiri: *Po ta shoh se dhe unë meta pa marre vetë se e musha plot*
Ardiani: *Hajde Hajde*
Sajmiri: *Shi ta shoh!*
82. Me datë **20/01/2021**, ora 11:47:55, shtetasi Ardian Iseberi, përdorues i numrit 0698705235, zhvillon bisedë me vëllain e tij Fatri Iseberi, përdorues i numrit 069411544, si vijon:
Fatriu: *Ha mor?*
Ardiani: *Ku shkove mor?*
Fatriu: *Unë para gjimnazit jam*
Ardiani: *Po makinën pse e le aty je me njeri aaa?*
Fatriu: *Cilën makine mor*
Ardiani: *Atë pasatin te Amerika*
Fatriu: *Tuj hec na këmbe jam. Ku je ti?*

***Ardiani**: Jo unë këtu, qesh te Amerika, tuj dale jam..po me tha musia leni makinat se mos i shes tek pallatet tha se i lypin njerëzit..si di sit e bej me ja cub= a jo*

***Fatriu:** Me qënë te tane a*

***Ardiani**: S'di gjë unë pse po me pyet mua ti...ato, siç i di ti ke fol vete ti pse po me pyet mu..*

***Fatriu:** Jo mo, po them se mos po i fut ne pune ndokund edhe*

***Ardiani:** Ai si fut ne pune ai nuk me tha me i funt ne pune ai me tha me i lëne tek pallatet ...e një këtu tha dhe një atje*

***Fatriu:** E se ka cu ate audin e Armandit që ka bere aksident ene ka menu me hap si pike varrezash.*

***Ardiani:** Vallahi s'di gjë është pak problem se prishesh nesër me te eee*

***Fatriu:** Po jo more me pa maqinen tuj levis ,tuj punu i thu a e ma maroe me ma fut ne pune apo me mashit:.*

***Ardiani**: Car me thënë, ti e di qysh shkojnë senet...Menoje kete pune studjoje se s'te ka thene ai te ka thene kryesori...nuk o se ai e fut me shfrytezu nese, bëjnë ndonjë sen bojn nonjë sen kujtojnë se...Ti se di që i ke krejt borxhë ata.*

***Fatriu:** Po tashi Bashkimi e di mire se njana është komplet borxh.*

***Ardiani**: E di ti se nuk shkojnë me transetu llafet keshtu siç menon ti...Se mos e ngatro vetin..ma mire.*

***Fatriu:** Bashkimi, Bashkimi mka hap ca biseda Ardjani a di ç'eshtu,unë i thashë qe mor ta shof se...*

***Ardiani:** Me m'nigju mu mos e ngaterro vetin..Ti bon c'ar te dushe, mo lal ,mos e ngaterro vetin.*

***Fatriu:** se di nje here.*

Ardiani:E ngaterron veten bon c'te dushe...une te theme mos e ngaterro veten...Mamire ta thirri ate djalin ti theme merri 1700, 1600 (njemije e gjashteqind euro)

Fatriu:Po jo mor burre si do i jap 1600 euro..une do i jap ..as leket e mija mos me i nxjerre a...po jo mor burre.

***Ardiani:** Mire ben c'ar te dushe shi mos e ngaterron veten se e ngatërron veten..se neser beon noj sen hip noje sen ne ta ...ti thu jo pse e bote, jo po se u prishe...u prish se hekra jane ata*

***Fatriu:** Hajt.*

83. Po në datë **<u>20/01/2021</u>**, ora 6:04:34, shtetasi Ardian Iseberi, përdorues i numrit cel 698705235, zhvillon bisedë me personin tjetër, përdorues i numrit 0695227556, ku diskutojnë për të shkuar në Kosovë për të marrë përsëri goma.

***355695227556:** Jasu*

***Ardiani:** Ku je mo...*

***355695227556:** Une tuj bo je dore letra ketu ne kat te pare...*

***Ardiani:** Car ke bo a je mire...A s'dole sot me i marre ato tjrerat a...*

***355695227556:** Jo sjam nis...A i more ato që le mrome...*

Ardiani:Dmth 23 i kam mare dy lash atje..s'shkova per dy copa...

355695227556:Epo mire, shume mire se shkohet per dy copa...thashe te pushoj mor nje nate, te fleje nje nate gjume...

Ardiani:Kur do me u nis ti se neser jam i zanem une per shembull, deri mbas dite jam i zanun...
355695227556: *Po u nisa ne darke neser...*
Ardiani:A në darkë mirë, ok po folim...
355695227556: *Hajde pra kalofsh mire.*

84. Me datë **20/01/2021**, ora 13:24:35, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri 0688531000 ka zhvilluar bisedë me punonjësin tjetër të policisë **Fatri Iseberi**, në numrin 355694115447, me përmbajtje si më poshtë:

688531000 (H.Shehu): *A paska radhe o Fatri?*
355694115447 (F.Iseberi): *Po mor ...Se di nja dy makina jane ne radhe, e katërta e pesta hyn ajo*
688531000: *Hajt se po e lej ke Pëllumbi pra, gati asht tai.*
355694115447: *Oo e jotja esht ne radhe*
688531000: *Ai para gjys ore me tha hajde pas gjys ore ai duhet te jete gati tashi...(bisede qe nuk kuptohet)*
355694115447; *Mbas temes e jotja duhet te jete ne radhe or ti*
688531000: *Po mbas jotes temja duhet me kane or ti*
355694115447: *Po hajt pra se e ndërrojmë.*

85. Me datë **21/01/2021**, ora 6:28:02 PM, shtetasi **Ardian Iseberi,** nëpërmjet numrit 0698705235, zhvillon bisedë me një shtetas kosovar gjatë së cilës flasin për marrjen e gomave në Kosovë, të cilat paraprakisht grumbullohen në një pikë karburanti, pa kaluar Pikën e Kalimit Kufitar Morinë (në hyrje të Pikës së Kalimit Kufitar Morinë).

Ardiani: *Përshëndetje zotëri...ç'ar bone mire?*
Shtetasi kosovar nr.355695227556: *Mire vallai, ku je?*
Ardiani: Unë jam t'uj ardh andej nga ti, te marr c'ato goma
Shtetasi kosovar nr.355695227556: *A... ku je tani ?*
Ardiani: Une tani jam...kam kalu doganën, domethënë ketu ke keto dritat e para ne autostrade...
Shtetasi Kosovar nr.355695227556: *E po mire, me ka je ?*
Ardiani:Jam me ate kushurinin e atij... ene një tjeter...
Shtetasi Kosovar nr.355695227556:Po ka qet, apo patet nonje pune, as more... a s'afrove nonje gome, a i more c'ato du goma
Ardiani:Jo, jo unë kam qon...lashe renxhin per servis,se i nderrova do fshirse e do stopa e ne fiatit ene s'kam ardh ishte mshel dhe Agroni...
Shtetasi Kosovar nr.355695227556: *Po a si more ja dy goma ke karburanti*
Ardiani: *Jo sme tha kush gje mu...*
Shtetasi Kosovar nr.355695227556: *Po te cova mesazh unë merri dy goma pastaj të kam thene merri dy goma.*
Ardiani: *Po nejse vari leshin, se do marrim tjera prap...*
Shtetasi Kosovar nr.355695227556: *Hajt pra hajt bjeri ketej shkurt e kupton e e di ate rrugen...*

Ardiani: *Po mor e di mor rrugen, m'rregull, mire hajt.*

86. Me datë **23/01/2021**, ora 11:15:11 AM, shtetasi Ardian Iseberi zhvillon një bisedë më njëperson që përdor numrin 0699279417, me përmbajtje si vijon:

55699279417: *C'ar bon...*

Ardiani:Sa kalova doganën...

55699279417: *E c'ar je tuj marre ti per vede ?*

Ardiani:Kot mor asnje euro s'kam me vete, kot jam tuj dale

55699279417: *Po pse si more...*

Ardiani: *C'ar je tuj thone?.*

55699279417: *Po se s'more thashe me marr noj gja*

Ardiani: *skam c'fare me marre une thashe qe kot jam tuj dale...*

55699279417: *Mire pra mire...*

Ardiani:Hajd pra hajd. Pe ç'do gjë me shkruaj në qoftëse ngelin ata aty.

87. Me datë **24/01/2021**, ora 8:39:50 AM, shtetasi Ardian Iseberi, nëpërmjet numrit 0698705235, bën bisedë me personin tjetër me numër 0682080236, i cili pasi ka parë në internet dy automjete kamionçina, të cilat janë publikuar për t'u shitur nga shtetasi Ardian Iseberi, ka telefonuar për të mare informacion për çmimin e tyre dhe në lidhje me dokumentacionin që disponojnë dhe nga biseda thuhet se të dyja mjetet janë pa dokumentacionin përkatës. Konkretisht mes tyre zhvillohet biseda si më poshtë:

355682080236:*Mirëmëngjesi, me fal se po te bezdis...*

Ardiani: *Mirëmëngjesi...Jo aspak, po urdhëro*

355682080236:Pashe nje kamionçine e kishe hedhur aty, ne shitje...është e jotja ?.

Ardiani: *Po...*

355682080236: *E sa e ka c'mimin fiks?*

Ardiani: ***Cilen ke pare ti, se une kam dy...***

355682080236: *Ate me tende, me tende...*

Ardiani:Ajo e ka 1600 euro, 1500 euro te fundit...

355682080236: *A është me dokumenta?*

Ardiani -Pa dokumenta...

355682080236:A i behen dokumentet ?

Ardiani:Vallahi, se di...

355682080236: ***Nejse a eshte me dogane, a keshtu ?***

Ardiani:Jo s'ka dogane, s'ka asi gjo...

355682080236: *Ku e kem atje... ai bahet dogana me dasht?*

Ardiani:Nuk e di vallahi a i bohet, a si buhet, po normal qe i bohet dmth...

355682080236: *Po tjetren ..A ke tjetren.....*

Ardiani: ***Po kam dhe nje tjeter është nje e bardhe dhe ajo nuk ka letra c'ashtu... eshte pa tendë ajo.....***

355682080236: *Ok, puna e letrave more burre se mua me intereson me letra ,se une rri ne Lezhe...Jam nga Mirdita po rri ne Lezhe...*

Ardiani:S'ka jo dhe ajo, s'ka letra...
355682080236: *A i bohen me dasht, me i bo.....*
Ardiani:Nuk e di per zotin, mua nuk me ka interese, c'ashtu e kam majt ...a e kupton a po jo...
355682080236: *Mire se pa flasim, se ku është numri i kontaktit, po ti po asht ne qofte se pyet ndonje, nese i bohen ja boj vete une dhe e kisha marre njonen.....*
Ardiani: *Vallahi pyet vete se une nuk kam se ke me pyet , une c'ashtu e kam pa letra makinën a e merr vesh a jo..*
355682080236: *Po ajo tjetra c'fare cmimi ka ?*
Ardiani:Ajo tjetra e ka 1300 euro...
355682080236: *Apo ma nis tek whatsapp, jem një ktu...*
Ardiani: *Jo vallahi, shume njerës me kan marre, nisma ktu nismat aty..kush e ka per imen nuk te thote nisma kteu, nisma aty.. ai që e ka per imen o interesu, vjen e shef makinen,vjen e e shef...te dyja kamioncinat...Une i kam te dyja po te interesoj hajde shifi, post e interesoj...*
355682080236: *Me tek gome jane te dyja a?*
Ardiani: *Po të dyja tek gome janë.....*
355682080236: *Mire mire. Numrin e kontaktit jam tuje e majt.Të rujtë zoti...*
Ardiani: *Hajd, hajd.*

88. Me datë **27/01/2021**, ora 3:08:04, shtetasi Ardian Iseberi, nga numri 0698705235, zhvillon bisedën me personin tjetër që përdor numrin 0694142968,ku rezulton se shtetasi Ardian Iseberi interesohet për mos bllokimin e një kamionçinë, e cila transporton goma, dhe ju thotë punonjësve të policisë që është e tij.

Ardiani: *Alo car bone....O Petrit ati je a...*
355694142968: *Jo jam Ladi...*
Ardiani: *O Lad a je tek puna?* ***Dil caty se ma ka blloku nje karrotrec policia, shi kush është polici dhe me kallzo dhe thuju që ështe makina e Ardijanit thuju në qofte se i njeh..***
355694142968: *Kush ten je ty more?*
Ardiani: *Po thuaju...po shih kush eshte polici more, vec kallzom kush eshte, mos u thuaj gje shih vec kush esht pash zotin...*
355694142968: *Ishte ai Cengi mo se di me ke ishte ...*
Ardiani: *Altin Cendgi me ke?*
355694142968: *Se di ate tjetrin se pashe...*
Ardiani: *Shih pash zotin e madh nje here...*
355694142968: ***Car ka karrotreci është pa letra...***
Ardiani:Po jo mor karrotresi eshte ne rregull, por ka marre nje kamionçinë temen dhe thuaj o e Ardijanit mor burre thuaj...
355694142968: *A ta jane larg or burre...*
Ardiani: *A je tuj i pa a..Po pate mundesi shko thuaju nje fjale o burre...thuaju eshte e Ardijanit o burre...*
355694142968: *Kush o Ardjeni ao burre me thene*

***Ardiani**: Ardjan Yseberi, vëllai i Fatrisë o burrë...ne thote që se nje thuaj ok me fal thuaj jane te Ardian Yseberit thuaj jane...Me fale thuaj që të thash po të tha se njoh...Jane njerez te Ardian Yseberit thuaj ti c'e kaq thuaj ti dhe masanaj le te thote se jo.*

Po në datë **27/01/2021**, ora 3:13:20 pm, shtetasi **Ardian Iseberi**, nga numri i tij në përdorim 698705235, bën bisedë me vëllain e tij, punonjësin e policisë **Fatri Iseberi**, ky i fundit përdor numrin 694115447.

***Fatriu:** Kuje more*

***Ardiani:** Qe ke shpija*

***Fatriu:** Po maqinen pse e ke lene aty more ?*

***Ardiani:** Cilen maqine mor?*

***Fatriu:** Fordin...*

***Ardiani:** Ku mor?*

***Fatriu:** Tek Ardian Trota...*

Ardiani:Po qësh deri ne Kosove pse...

***Fatriu:** S me tha bilbili ...se eshte ngusht per autobuzat se di se c'me tha...*

***Ardiani:** Po bre spata ku me e lene se qesh tij ik shpejt...*

***Fatriu:** A e ke hek ti a...*

***Ardiani:** Po more e kam hek moti ka dy ore...*

***Fatriu:** A te thirri Roberti...*

Ardiani:Jo mor thirre ne telefon se kemi kaluar ten ato goma me tjeter ken dhe ska maru pune me llogarite...Thuj nje here që kaq maje men thuj se je tuj bo gafe mas gafe thuj.....

***Fatriu:** Hajt se e mar rune*

***Ardiani:** Thirre nje here ne telefon thirre.*

89. Me datë **28/01/2021**, ora 10:11:12 AM, shtetasi **Ardian Iseberi** nëpërmjet numrit 0698705235, zhvillon bisedë me vëllain e tij, punonjësin e policisë **Fatri Iseberi**, me numrin 0685182004, me përmbajtje si më poshtë:

***Ardiani:** Fole me ate rob...*

***Fatriu:** Fola dhe tha me eshte prish makina dhe ku di une anej ketej...*

***Ardiani**: A i the a do me punu me ta a s'do me punu gjid te tha ?...*

Fatriu:Jo mor thash ka kalu goma per ty, jo mor tha ka kalu per ate vellain per ate tjetrin tha, jo për mu... edhe i thashe sikur kish met pa leke ai vellai i thashe, se ska ardh me mtaku me dhen lekt tha shit i jap lekt une sa te takon se sa te bej rrugen e pare tha, do i takoj tha...

Ardiani: Po a pyet per nje kamioncine te 88 sa i shkon dagana, a pritet a jo...

***Fatriu:** Me targa te Kosovës me e pre me targa te Shqipërisë a....*

***Ardiani:** Po more me e bo me e regjistru ka ardh prej italie o fur ne kosove...Sa i shkon dogana thuj ti e 88 thuaj ti, motor tremishi e ka...*

***Fatriu:** Makine bujqësore a qysh eshte kjo...*

***Ardiani:** Po makine une e di se e kap kjo bujqësorja...behet pa leke, zero dogana mund te behet...Po pyet nje here aty se ndodhta kush e di thuaj kam nje kamionçine thuaj e kam per puna*

thuaj anej ketej, thuaj du me i pre doganën thuaj, ***jam me libreze Italie****, s'ka ardh dmth...e 88-tes motor tre mish...*
Fatriu: *Qe ta pyes njeher, hajd...*
Ardiani: *Pyet ndonje, hajd.*
Me datë **28/01/2021**, ora 5:00:22 pm, shtetasi Ardian Iseberi, nëpërmjet numrit 0698705235 zhvillon bisedë me personin tjetër, përdorues i numrit 0696244448, me përmbajtje si vijon:
696244448: *Alo...*
Ardian: *A u the atyre mo me mi pru lekt...*
696244448: *Ore s'bohet fhjale ajo...15% jam tuj pagju...*
Ardian*: Nje mij paund i jap une dymbedhjete mije te mi bjere tekho...*
696244448: *Nuk e di kush i bie tekhe nuk e di Myslija...*
Ardian: *Ore* ***dymbedhjetë mij..ore njembedhjete me mi dhene****...*
696244448*: Se di te foli nje here me nje tjeter nje here nuk e di...*
Ardian: *Hajd, hajd.*
90. Me datë **01/02/2021**, ora 5:07:35 PM, shtetasi **Ardian Iseberi**, nëpërmjet numrit 0698705235, zhvillon këtë bisedë me vëllain e tij, punonjësin e policisë **Fatri Iseberi**, me numrin 0685182004 lidhur me kalimin e një automjet pa kryer procedurat doganore dhe për këtë kërkojnë për të gjetur doganierin e duhur për t'i ndihmuar, ku midis të tjera përmendin doganierin me emrin "Ermal".
Fatriu*: Gjit bone bre?*
Ardiani: *Ku je ti...*
Fatriu: *Ne Tiranë*
Ardiani: *Po pse shkove ne Tirane?*
Fatriu: *Pata punë...si shkom e dhe e merr pa therr...gjit bon bre...*
Ardiani: *Ore pata pune, kur e mora ecte normal eca tre ore dhe u prish midis udhes u prish...Ju prish transmesioni ju prish...*
Fatriu: *Po gjid me bo*
Ardiani: *Se di shtahi, kur je ne pune ti?*
Fatriu: *Leje kur jam ne pune une or ti A te pyeta ne sabah. Pse me thirre mu kur jam me njerez une...*
Ardiani: *Isha tuj e marre une me afru vec aty or ti, se ke tuj hes mire...*
Fatriu: *Pse me thu nale karrotrecin pse s'flet ne telefon...*
Ardiani:Thashe se me met ne autostrade se po leviz policia thashe te vin korrotreci se skishte ec hic as para as mrapa...Po ate te vije sone Ermali a kalon ajo te pakten ta kalojme sonte me karrotrec...
Fatriu: *A fol vete me te thuaj me ka cua Fatria.*
Ardiani*: Kujt?*
Fatriu: *Ne karrotrec...se nuk e di kush.*
Ardiani:Po jo sot mas ores 8 ta leme.
Fatriu: *Nuk e di se kush eshte aty, po...*

Ardiani:A sje sonte ne darke ti...
Fatriu: *Po,* ***po or ti po nuk e di se kush se kush o ke disqe (Keshtu degjohet)***
Ardiani:Me ja marre nje pale targa cashtu...vari lesht...
Fatriu: S'nigjojne doganjeret po haj...
Ardiani:A thu, po Ermali tha se s'ka no nje gjo...
Fatriu: *E mire shko fol me Ermali nje her ene hajt...*
Ardiani:Ermali tha veç pas ores 8..a ta marr nje here që ti theme te vije... ...
Fatriu: *Shko fol me Ermalin...*
Ardiani:Se i thashe atij Sherifit, ta leme te Sherifi...Ermali vjen, po shihe aty që ta marojme si pune te paktën...
Fatriu: *E mire, shko fol me Ermalin po haj.*

91. Në datë **02.02.2021** ora 13:37 min, nga nr. cel 0684183697, në përdorim të vëllait të **Robert Saraçit**, shtetasi **Erjon Saraçi**, referuar mënyrës së si bashkëbiseduesit i drejtohen njëri tjetrit në komunikim pasi nga konfirmimi i marrë nga kompania *One-Telecomunitacion* ka rezultuar se ky numër cel rezulton i regjistruar në emër të shtetasit **Artur Dishi** i datëlindjes, 23.05.1976, banues në Gjirokastër, zhvillohet me **Ardian Iseberin** tek numri cel 355698705235, biseda si vijon:

0684183697 (E. Saraçi): Kam lënë para nja tre netësh do goma aty nja 11 copë
355698705235 (A.Iseberi):Ku i ke lënë?
0684183697:Ke karburanti me Arditin.
355698705235:A me Arditin i ke lënë?
0684183697: Po qeshë unë para katër netësh dhe qesh sot dhe fola me njerin aty dhe tha i ka marrë
355698705235: Kush i ka marrë?
0684183697:Me tha për ty
355698705235: Jo jo skam marrë goma
0684183697: Thuj për zotin
355698705235: Jo jo pashë kryt e familjes unë jo
0684183697:Po jo më tha i ka marrë njëri me Ford prandaj të them
355698705235:Jo të paska rrejt për zotin. A i ka thenë tjetër kujt Bertit?
0684183697: Jo jo Berti unë i lashë dhe i thashë që do vijë ti marrë njëni direkt do vij njoni pi këtu
355698705235:Hap kamera thuj se nuk ti ka marrë.....kush qenka ai që I ka marrë?
0684183697: Ai i karburantit i kishte thënë që i ka marrë njëri me Ford,...na fal për shqetësimin...është një furgon bre që mi bie deri këtu, prandaj
355698705235:Me kë ke fol ti?
0684183697: Me një shok që bi kështu vezë e gjona
355698705235: A ke qenë atë ditë me Bertin a me kë ke qenë?
0684183697: Jo jo me Arditin i lashë aty nja 11 copë të miat
355698705235:Arditi sa copë ka pas të tjera?

0684183697:Arditi ska pas atë ditë ja 6 copë
355698705235: Po me kë I ka kalu Arditi?
0684183697: Se di ai i la vec dhe ne I patëm lënë në një cep mbrapa
355698705235: Vallahi, bilahi unë nuk kam marrë gjë or ti.....kur të marrësh goma ti më thuaj mua,për çfarë u thu të tjerve?.
0684183697: Po jo mor se mi binte gjer këtu prandaj
355698705235: Po kur të kesh goma ti, mos merr, mos më tradhëto mor burrë.....po e zgjidh ai atë punë hap kamerat dhe e shef ai se kush e ka marrë...A fole me Bertin se....
0684183697:Jo mo se Berti se ka dit hic
355698705235: A se ka dit Berti.....prandaj të mora ty....hajde me mu më tako se mua gjithmonë më ke pas korrekt....nuk e di historinë e Bertit më tha mua kaloma një një kamionçinë, ja kalova kamionçinën dhe pa e dit unë ka pas dy motorra, më ka pre në besë midis doganës.....Unë jam burrë e çarë të më tregosh unë e krye.....
0684183697: Unë nuk e di se kam marrë këtej në Maqedoni unë për momentin.
355698705235: O vëlla çfarë të kesh në doganë, çfarë të kesh në Kosovë me mu e ke korrekt, nuk të lë unë një diçka çeta tek unë e kie.....unë kam gjet goma shumë të lira, pazari i makinës se s'po di me e marrë se unë edhe atje se kam gjet dhe goma të mira i kam gjet me thundra, unë nuk po di sit ë leverdis ty me i marrë, po unë tani nuk po i di bah mirë.....se janë të nxira dhe në pazare se o hap pazari i makinave dhe janë të nxirë dhe në pazare të mërkurave dhe të shtunave.....
0684183697: Po mirë se të marr prapë.

92. Në lidhje me episodet e evidentuara për komunikimet e numrit cel *0684183697,* me persona të tjerë, numër i cili është përdorur nga shtetasi ***Erjon Fejzi Saraçi***, i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale në datë 30.05.2022, ka deklaruar, ndër të tjera se :"...*Unë Ardian Iseberin e kam takuar një ditë rastësisht, kur kam qenë në Prizren dhe kam patur dy goma ML-je për të sjelle. E kam takuar në stacion në Prizren pasi unë isha kthyer mbrapsht sepse nuk më linin të kaloja në kufi. I thashë Ardianit që do të mi kalosh këto dy goma, pasi ishte aty tek stacioni i taksive. Më thotë mirë dhe i kaloi me makinë të vet deri në Kukës. Unë kisha ikur me makinën time dhe nuk e di nëse i ka deklaruar në doganë. E kam takuar në Kukës në kryqëzimin e rrugës që të çon për Dibër. E kam paguar dy mijë leke për transportin dhe jam larguar. Nuk e kam takuar më pas këtij rasti....Në fund të vitit 2021 kam shkuar një herë në Kosovë se kam çuar një makinë për ta rregulluar në Pejë. Unë kam shkuar në Kosovë dhe kam marrë me raste goma nga dy apo tre copë, dhe i kam çuar tek puna ime...Nuk kam shkuar ndonjëherë në Kosovë me Viviana Saraçin për të marrë goma, por kam shkuar vetëm për të rregulluar makinën....Shtetasin Altin Rushit Laçi, e njoh pasi e kam djalin e dajës, por nuk kam bërë asnjëherë transport mallrash me këtë shtetas....po ashtu nuk ka kryer asnjëherë transport gomash apo mallrash as për llogarinë time dhe as për vëllain tim, thjesht kam shkuar në Kosovë për të marrë zogj fshati.....Shtetasin Ardit Merdini e njoh pasi është shok i vëllait tim Robertit. Ky shtetas punon me një automjet për transport pasagjerësh duke kryer rrugë fshati, nga Dibra në fshatin Sohodoll....Mallra nga Kosova nuk ka sjellë asnjëherë, por në një rast ka*

marrë vetëm makinën që ka shkuar dhe ka rregulluar në Kosovë, bëhet fjalë për makinën tip, "Fiat", me targa, "AB954..." e Robert Saraçit.....Altin Laçi nuk ka transportuar në asnjë rast goma nga Kosova në Shqipëri për mua dhe për vëllain tim Robertin. Në një rast që e ka kapur policia në Kukës vjet në muajin Maj ka patur disa goma të cilat i ka marrë në Tiranë dhe i ka mbajtur në bagazh të makinës...". Pyetjes nëse në muajin maj 2021 ka qenë edhe ai në Kosovë dhe nëse ka transportuar goma, i është përgjigjur se nuk ka qenë ne Kosovë në muajin maj 2021 dhe po ashtu ka sqaruar se në lidhje me ndonjë rast të mundshëm për kontrabandë gomash, nuk është marrë në pyetje asnjëherë nga policia gjyqësore. Me shtetasin Rasim Dik Spata ka deklaruar se ka njohje me të pasi e ka kushëri të tretë dhe Rasimi banon në fshatin Bllicaj-Dibër, duke shtuar se *:" Kemi shkuar në një rast në Kosovë rreth muajit prill 2021, nuk më kujtohet me saktësi, kemi marrë katër goma dhe dy grupe balestre, për servisin tim. Kemi qenë me makinën time automjeti tip, "Benz', ngjyrë blu me targa, "AA290LR".Mallra të cilat nuk i kemi deklaruar në kufi. Shtetasin Pajtim Dogjani nuk e njoh dhe nuk kam komunikuar asnjëherë me të.".* Pyetjes nëse ka patur raste të tjera që ka shkuar në Kosove dhe ka marrë mallra për servisin e tij ai i është përgjigjur*:"...Po kam shkuar në një rast dhe kam marrë një grup motori me vlerën 65 euro, kam qenë së bashku me Vivianën rreth muajit maj 2021dhe herë tjetër nuk kam shkuar fare në Kosovë. Mallra të cilat nuk i kam deklaruar në doganë....gomat që kemi marrë në Kosovë neve i kemi marrë pa lekë fare, ne një servis pjesë këmbimi automjetesh në Pejë dhe i shisnim rreth 20-të mijë lekë, por që nuk më kujtohet emri i pronarit. Unë kam patur një servis në lagjen, Dobrovë në Peshkopi por kam rreth dy muaj që e kam mbyllur".*

93. Me datë **05/02/2021**, ora 09:55:18, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** nga numri 685182004, telefonon një shtetas te referuar si kolegun e tij, **Kasem Maksuti** me numer 0685533420, me përmbajtje bisede si më poshtë:

355685182004: *A je kund bre? A ku hujt tej poshtë bre?*

0685533420: *Jo*

355685182004: *A po pyet kush asht doganier sot?*

0685533420: *Perparimi mor.*

355685182004:Thuj mos ashu thuj, ruj ndonje per ne.

94. Më datë **06/02/2021**, ora 17:07:32 personi që ka në përdorim numrin celular 355695227556, zhvillon këtë bisedë me shtetasin **Robert Saraçi** në lidhje me sasinë e gomave që do të shkonte për t'i marrë në në Kosovë, me përmbajtje si më poshtë:

355695227556:Ej i ka ai o daje, 10 cope do i zgjedhi une keshtu me dmth 195, 95, 16-ce aa.

686770943 (R. Saraçi): *Po*

355695227556:Dhjete cope do i zgjedhi une edhe sa jane te reja qe do te me jape te reja

686770943*: 6 cope*

355695227556:Dmth leke vetem 300 euro i jap

686770943: *Po*

355695227556:Po ketij qe do i kaloje?.

686770943:Asnje

355695227556: *Ne rregull ta ve ne dijeni Astritin.*

95. Më datë **07/02/2021**, ora 08:31:49, shtetasi Robert Saraçi, me numrin celular të tij në përdorim *355686770943*, zhvillon bisedë me shtetasin Astrit Gashi, ky i fundit përdorues i numrit **0686528650,** të cilët bisedojnë për kalimin e mallrave nga Kosova drejt Shqipërisë.

355686770943 (R.Saraci): *Mirëmëngjesi*

0686528650 (A.Gashi):O Bert mirëmëngjesi…..(bisede pa interes) ne vijim: Ka lënë ai vëllai im atje mbrëmë nja 20 cope….shko mbas dite po merr…

355686770943*:* ***Shiko tani se ska lidhje me mu, Pagesën si unë ai ta bëjmë ne, po mëri mos ti marre ai. P…tjetër se pz do ten a fusi ne ngatërrese…***

0686528650: *A thua shkon e ei merr pa*

355686770943: *Atje u ka thënë ai se i kemi lenë për ty se kemi fole me Astritin,*

0686528650:Po pra vajta i mora nja nente cope 11(njëmbëdhjetë) i lashë për ne darke për mbas dite

355686770943:A i ke marre nja 9 cope?..

0686528650: *Po i mora c'tash mbasdite*

355686770943: *Po a ju the atyne se vetëm ti do i marrish?*

0686528650:Mire tha Ardiani paskam fole me te ai me pasat te bardhe ti marrin mos ja jep tjetërkujt. I kam thënë atij te karburantit

355686770943: *Pz vetëm ti i merr se pz me vëllain do me besh lesh mo*

0686528650: *A po e ka emrin Ardian ai vëllai jot*

355686770943*: Arditi…*

0686528650:Arditi tha kam fole tha me ato te karburantit vec ai i merr ai me pasat te bardhe i ka mane nja 11 cope.

96. Me datë **11/02/2021**, ora 18:06:52, shtetasi **Robert Saraçi** nëpërmjet numrit 686770943, kryen bisedë me personin përdorues i numrit 355695227556, ku ndër të tjera shtetasi Robert Saraçi porosit bashkëbiseduesin që 50 euro t'ia japë shtetasit **Ardian Iseberi.**

355695227556:Me mur ai mor ne telefon. Ka kohe qe me ka marre…

686770943 (R. Saraçi)*: Kush mor?*

355695227556*: Ardiani*

686770943:Qysh thosh

355695227556: Me tha thuaj Bertit hape telefonin, te shkoje puna më keq se pastaj thuj kushdo qe te jete me makine thuja kam per tja djeg makinat

686770943: *Qysh do beje?*

355695227556: *Djega makinen. Thuaj ta hape tha ose mos ti*

686770943: *Te vije mo dera asht tete meter e gjere*

355695227556: *Vec tha thuj te marri ne telefon, po qe se do shkoj andej i thashe te marr.*

686770943: *Po a i the ti njehere se kam qene andej unë…vari mo k… i thuj se vje vete atje te takon i thuj…a do shkosh neser ti te mbarosh do pune?*

355695227556: *Çish te bej?.*

686770943: *Po te shkosh te marresh do gjona…*

355695227556: *Po pra po kam frike se po me djeg makinen aj*

686770943: *Jo mor burre mos ta degjoje kush ate llaf se ska lidhje ai rob.Merre dhe Leksin me vete mere...*
355695227556: *Aleksi ka dore te bie direkt.*
686770943:Mire mire ec te jap 50 euro une edhe jepja që ka dhëna the në doganë edhe thuaj më ka thënë Berti mos i bjer me telefonit tim se sme rruhet t....
355695227556: *Mire mire hajt se folim.*

97. Me datë **08/02/2021**, ora 16:23:21, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, nga numri 0685182004, zhvillon bisedë me shtetasin **Robert Saraçi**, në numrin 0686770943, me përmbajtje si me poshtë:

685182004 (F.Iseberi): *Urdhëro Robert*
355686770943 (R.Saraçi): *Fatri këtu jam*
685182004: *Ku je bre?*
355686770943: *Jam mu ketu ne dalje, ketu ke kjo e skanerit*
685182004: *Qe se vij te takoj une. Prit te lokali.*

Po në datë **08/02/2021**, ora 16:24:08 para se të zhvillojë takimin me Robert Saraçin, Fatri Iseberi zhvillon këtë bisedë me vëllain e tij Ardian Iseberi.

355685182004 (F.Iseberi): *Sa leke ti them ketij djalit sa lek dogana?*
355698705235 (A.Iseberi): *Dyqind mije leke e katërdhjete euro...*
355685182004: *Hajt te foli nje here me te*
355698705235: *A ka ardhe?*
355685182004: *Po po ka ardhe ke dogana*
355698705235: *Foo nje here me te e thuj a do me punu a sdo me punu i thuaj kllzoj*
355685182004: *Po tha se do me punu tja ulim 50 euro, pesëdhjetë mije leke*
355698705235: *Ulja 50 mije leke se i ka pas harxhu a ba problem e di unë i thuj. Edhe thuj puno korrekt me te se ai nxehet veç se është korrekt i thuj.*

98. Me datë **10/02/2021**, ora 08:36:33, punonjësi i policisë **Halim Shehu,** nëpërmjet numrit 0688531000, zhvillon bisedë me punonjësin tjetër të policisë, **Fatri Iseberi**, në numrin 0694115447. Gjatë bisedës, Halimi i kërkon Fatriut, që vëllai i tij, Ardiani, të çojë në Tiranë një shtetase, e cila është në kufi dhe ka qenë e shoqëruar me një person, ndaj të cilit janë bërë procedurat e ndalimit në kufi. Gjatë udhëtimi për në Tirana, punonjësi i policisë Fatri Iseberi telefonon vëllain e tij, Ardianin dhe nëpërmjet numrit të vëllait komunikon me këtë shtetase, ku ndër të tjera i kërkon që nëse e ndalon policia, të thotë që nuk kanë pasur telefona me vete në kufi. Biseda në vijim mes tyre, me datë **10/02/2021**, ora 08:37:43, me përmbajtje:

355694115447 (F.Iseberi): *Makinën qe e ndalum ne mengjes a munesh me e cu ket vajzen ne Tiranë se ka një varrim, para ores 11...*
0688531000 (H.Shehu): *Duhet me i thane atij vellait...*
355694115447: *Du me e dit sakte edhe sa shpejtë. Po u vonu mos ta marrim ne qafe*
688531000: *Po jo ajo do me pagu taksi...*
355694115447: *Po or ti puna është me e cu, para orës 11:00 ku ka problemin kjo...*
688531000: *Ti merr 70 euro thuj, deri në Tiranë...*

355694115447: A bën pazar vetë me atë shpoferin pastaj, 70 euro do në Tiranë ai.
Ora 08:38 min të po kësaj date vazhdojnë këtë bisedë si më poshtë:
355694115447 (F.Iseberi):A i thu vëllait për 15 min me ardhë, ose nëse vonohet mos të vijë hic. Për 15 min për me ardhe tek pika.
688531000 (H.Shehu): *Jo mos se svonohet.*
99. Me datë **10/02/2021**, ora 08:49:17, shtetasi Ardian Iseberi ka zhvilluara bisedë me vëllain e tij, punonjësin e policisë Fatri Iseberi, në lidhje me shumën e parave, me përmbajte si më poshtë:
355685182004 (F.Iseberi): *Ku desha te dal ndac merrja leket tashi ndac ne Tirane kur te dush;*
355698705235 (A.Iseberi): *Pse a thu se spo me jep leket aa?.....*
355685182004: *Jo ku i dihet*
355698705235: *Po ja marr une ndac ne fillim ndac atehere. Thuj Halimit, ne bardhoc, ne bardhoc a thuje*
355685182004: *Po mos ashu se ndoshta si dihet se ndoshta e ka burre ate që ka kalu ne system*
355698705235: *A pse ka ra burri i vet ne ta eee?*
355685182004: *Po. Edhe si dihet..... (fjalë që nuk kuptohen).*
Më datë **10/02/2021**, ora 20:11:58, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** nga numri 0694115447, zhvillon këtë bisedë me vëllain e tij, **Ardian Iseberin** në numrin 0698705235, me përmbajtje:
694115447(F.Iseberi): *Pse smi prune leket?*
355698705235(A.Iseberi): *Sa leke mor?*
694115447: *Hajde nje here tej poshtë hajt*
355698705235: *Sa leke mor burrë.*
694115447: *Qysh or ti..... a do me te bo çyrek*
355698705235:Po 70 ero mor burrë 70 ero kam marre
694115447:Or ti djali shite kamionçinën s'na dhe një leke or ti.
355698705235: *Skam fitu me kamionçinën.*
694115447: ***Si s'dite ma thane një here u knaqa or ti hajde knej një here.***
100. Lidhur me komunikimet si më sipër, në datë 25.05.2022, është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi **Astrit Veli Gashi**, i cili ndër të tjera ka deklaruar se :"...*Unë shtetasin Robert Saraçi e njoh që rreth prej nja viti. Mbaj mend që kam qenë në stacion të Prizrenit në Kosovë dhe aty jam takuar me këtë shtetas. Unë kam në pronësinë time një automjet tip, "Pezho" ngjyrë gri, me targa, "AA142EI" e cila është regjistruar në emër të djalit tim. Unë më herët kam punuar për rreth tetë vite në Policinë e Burgjeve dhe pastaj nga viti 2016 deri në vitin 2018 kam punuar emigrant në Greqi. Kam hapur një lavazh në Kukës dhe punoj me lavazhin. Në dijeninë time Robert Saraçi ka një servis automjetesh dhe kohën kur e kam takuar në stacion ne Prizren ai ka patur një furgon, të cilin e kishte ngarkuar me goma të marra në Kosovë. Me thotë që do të ndihmosh të çoj këto goma në Shqipëri pasi vetë nuk mund ti kaloj në kufi të gjitha për shkak të pagesës në dogane dhe në këtë mënyrë ky shtetas detyrohej që ti shpërndante në makina të vogla pak e nga pak dhe pasi hapja krahun diku Roberti vinte me fugon i merrte diku sipas rastit, here vinte vete dhe herë dërgonte persona të tjerë. Unë për këtë*

kalim mallrash kam rënë dakord me të që të fitoja nga dy mijë lekë të vjetra për çdo gome që kaloja. Kalimin e këtyre mallrave gomave unë e kam realizuar edhe me makina të tjera, sipas rastit sipas personave që gjeja vendosja nga 4-5 goma në makinë dhe i kaloja në kufi. Me shpesh këtë punë e kam kryer për të dy-tre muajt e dimrit që nuk para kishte punë në lavazh dhe detyrohesha të punoja me ndonjë pasagjer Shqipëri-Kosovë apo ndonjë punë të tillë për të nxjerrë shpenzimet. Në lidhje me këto kalime ne kufi, policia nuk na ka bezdisur jo se nuk ka qenë në dijeni të asaj që neve po bënim, por kjo është një situate e përgjithshme që ndodh dhe ata e kanë ditur se neve punojmë thjesht për të nxjerre shpenzimet ditore... ". I pyetur në lidhje me bisedën e datës 07/02/2021, ora 08:31:49 në të cilën Robert Saraçi, nga numri cel *355686770943*, e ka telefonuar në numrin cel 0686528650 dhe i ka kërkuar që të merrte disa goma në Kosovë, të cilat i ka lënë në një karburant ai ka deklaruar se:"...*Po më kujtohet si rast për këtë punë më ka kontaktuar Berti dhe me kërkon të shkoj të marr 20 a 30 goma nuk me kujtohen saktë, të cilat i kishte grumbulluar tek karburanti në Prizren. Është një karburant tek rrethi i parë ku merr rruga për në Prizren. Berti i grumbullonte aty pasi kishte njohje me atë person dhe pastaj sipas personave që pajtonte i sillte në Shqipëri. Në këtë rast me sa më kujtohet Berti, ka patur frikë se mos ja merrte një person tjetër i cili quhej Ardian Iseberi, pasi sipas bisedës që kam bërë me të më ka sqaruar se kishin patur një konflikt. Konflikti kishte ardhur për shkak se sipas Bertit, Ardiani i kishte vjedhur 2-3 goma dhe nuk ja kishte kryer punën e porositur në rregull. Unë këtë kalim të gomave në këtë rast e kam kryer së bashku me një person tjetër i cili punon si taksixhi dhe është banues në Kukës e quajnë Xhelal Xhaja dhe ka numër telefoni 068 21 27 788.Unë kisha njëkohësisht edhe lavazhin prandaj nuk mund të kryeja i vetëm këtë pune...Automjeti me targa, "AA130LD" është në pronësi të djalit tim Ervis Gashi dhe në këtë kohë ka qënë në gjende pune, ndërsa më mbrapa dhe aktualisht është nxjerrë jashtë përdorimit. Në lidhje me kalimet këtë datë sqaroj se edhe mund të kem kaluar goma edhe vetë për të ndihmuar Xhelalin. Mbasi kemi kaluar kufirin me mallrat e tij gomat të cilat i kalonim pjesë pjesë edhe në këtë rast i kam çuar tek shtëpia në Nangë-Bicaj dhe aty Berti ka dërguar persona të tjerë për ti marrë por që unë i njoh si fytyra, shpesh vinte edhe bashkëshortja e tij një shtetase e huaj. Gjatë vitit 2021 ka patur edhe raste të tjera që kam kaluar mallra për llogari të Bertit por vetëm goma dhe është ndjekur po e njëjta mënyrë për ti kaluar në kufi.Po ashtu dua të sqaroj se automjetin tip passat unë ja kam shitur shtetasit Sokol Gjuta banues në Shtiqen Kukës por që ai nuk e ka ndryshuar pronësinë e mjetit, por di që është nxjerrë jashtë përdorimit...Së fundmi edhe gjatë vitit 2022, nuk mbaj mend me saktësi para dy tre muajsh dhe më thotë që a po mundesh të shkosh të marrësh ndonjë gome, por nuk kam rënë dakord me të e kam refuzuar kërkesën e tij pasi nuk me dilte llogaria për shkak të rritjes edhe të çmimit të naftës...."*

Nga këqyrja dhe marrja e të dhënave në sistemin Tims, ka rezultuar se shtetasi Astrit Gashi në datë 08.02.2021 ka dy hyrje-dalje nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas me automjetin e tij furgon me targa "AA130LD".

101. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit më datë 25.05.2022, shtetasi **Astrit Gashi**, ndër të tjera ka deklaruar se :"*Unë e njoh Robert Saraçin që rreth prej një viti. Mbaj mend që ka qenë në stacion të Prizrenit në Kosovë dhe aty jam takuar me të...Në dijeninë*

time Robert Saraçi ka një servis automjetesh dhe në kohën kur e kam takuar në stacionin e Prizrenit ai ka patur një fugon të cilin e ka ngarkuar me goma të marra në Kosovë. Më thotë që do me ndihmosh të çoj këto goma në Shqipëri pasi nuk mund ti kaloj në kufi të gjitha për shkak të pagesës në doganë, dhe në këtë mënyrë ky shtetas detyrohej ti shpërndante në makina pak e nga pak.... Unë për këtë kalim mallrash kam rënë dakord me të që të fitoja nga dy mijë lekë të vjetra për çdo gomë që kaloja. Kalimin e këtyre mallrave, gomave unë e kam realizuar edhe me makina të tjera, sipas rastit, sipas personave që gjeja, vendosja 4-5 goma në makinë dhe i kaloja në kufi....".Me tej ai shpjegon se e ka bërë disa herë këtë veprimtari në marrëveshje me shtetasin Robert Saraçi.

* * *

102. Po ashtu, nga përgjimi i komunikimeve telefonike, kanë rezultuar komunikime të tjera të të pandehurit **Halim Shehu**, me detyrë përgjegjës turni në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, në të cilat janë evidentuar komunikime me persona të tjerë për kalimin e kufirit pa u regjistruar he veprimtari të tjera të ngjashme. Konkretisht, gjatë vitit 2021 janë regjistruar, ndër të tjera, komunikimet si vijon: Më datë **21/01/2021**, ora 20:56:22, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri cel 688531000, zhvillon bisedë me personin që përdor numrin 0698811811, regjistruar në emër të shtetasit Aurel Jazxhi i datëlindjes 24.09.1972, ku nga biseda rezulton se ky i fundit interesohet për të kaluar një person tjetër jashtë shtetit.

355698811811: *E ke parasysh kur isha atëherë qe te mora ne telefon per atë shokun qe te thashë ka ardhur edhe nuk është regjistruar.*

688531000 (H.Shehu): *Po.*

355698811811:Tani ka ardhur, do iki keto dite po dua e ke parasysh që ta kem këtu.

688531000: *Ok...*

355698811811: *Sdi a kemi mundësi te bëjmë diçka a jo aa?*

688531000: *Do qe te shëtisim me te, ta sjellim prape si thu?*

355698811811:Po pra te iki e pastaj te mos vije me le te ashtu. Thjesht te iki po do jete këtu për momentin e ke parasysh.

688531000: *Ok ok vjen ti me mu e përcjellim kthehna, ska problem.*

355698811811: *Do vij mo do vij patjetër do vij, si s'do vij.*

688531000: *Ja do vij nesër ne Tiranë unë edhe mi thuj me ne detaje*

355698811811: *Nesër mire atëherë*

688531000: *Mere ate shokun ne telefon se na duhet nja dy pika si informacion se ai e ka tamam.*

355698811811:Ate shokun e kemi këtu mor burrë ti mjafton te vish edhe kaq

688531000: *Ok ok.*

355698811811: *Ishalla te vish shpejt*

688531000: *Po tani nuk e di se oraret, besoj te kemi kohe një ore dy para se te them unë ta organizojmë.*

355698811811: *Meqë është e premte edhe mos ikën ai kund ne fundjave prandaj them*

688531000: *Mere pyete ndac thuj ne çfarë ore je i mundshëm*

355698811811: *C'rendësi ka kurdo qe te vish ti do te dëgjohemi edhe do jemi ne kontakt*
688531000:Sa te nisem unë tek e fundit ta lej ty për detyrë se ca me duhet edhe ti te takohesh vete me ta s'ka problem, thjesht na duhen ca gjona te sakta dy informacione
355698811811: *Hajde mire ardh nesër te pres.*

103. Njëri nga subjektet e tjerë të vendosur në përgjim është edhe punonjësi i pikës së kalimit kufitar Morinë **Shpëtim Cenaj,** me detyrë përgjegjës turni pranë P.K.K Morinë, në bisedat e së cilit rezultojnë komunikime mbi komandimin e tij në pozicionin e shefit të Pikës së Kalimit Kufitar Morinë në muajin dhjetor të vitit 2020. Konkretisht për të pandehurin Shpëtim Cenaj, janë evidentuar në komunikime e tij, referuar procesverbaleve të transkriptimit të komunikimeve, janë veçuar komunikimet si më poshtë:

- Në datë **09/12/2020** ora 10:36:09 **Shpëtim Cenaj** tek numri celular 355676466593, telefonohet nga **Altin Beqiri**, identifikuar si epror i tij, dhe zhvillojnë këtë bisedë me interes:

355695189200 (A.Beqiri)*: Ça bone si kalove?*
355676466593 (Sh.Cenaj): *Hic mire.*
355695189200:Nga sot deri ne date 23 je ne drejtim Shpetim
355676466593: *Deri ne date 23 aa. Sa është data sot?*
355695189200: ***Sot nante. Nga sot deri ne 23 je shef istacionit te pikes se kalimit kufitar Morine***
355676466593: *Mire, mire. A jam edhe pergjegjes turni?*
355695189200: Jo, ***jo je shef i stacionit te thashe, une ste thashë se je përgjegjës turni…***
355676466593: Atë e zgjidh vete ee? Po mire moshef mire, dakord…
355695189200: *Me thote Drejtori kur te jesh ashu hajde takomë nje cike…*
355676466593: Me shku tek drejtori. Po mor, hajt se po vishem avash, avash e po shkoj.

- Një ditë me pas, në datë**10/12/2020**, ora 07:58:14 **Shpëtim Cenaj** nga numri celular 355676466593, ka zhvilluar këtë bisedë me bashkëshorten e tij, përdoruese e numrit celular 355693754963.

355676466593 (Sh.Cenaj): *Takova Halimin pak tani aty. Halimi tha mirë o tha për ne të katërt pak më mirë. E i thashë po për mu. Për ty tha do bëhet zgjidhja atje, ai në qoftë se tashi tha.****Ai në qoftë se ju thotë mi rujni lekët, ajo është cmenduri e atit. Me zorr se ua merr po zgjidhja do bëhet e plotë që ti… Të shohim njëhere mos të nxitohemi, bre se si dihet…***
355693754963 (Bashkëshortja e Sh.Cenaj): *E pra mos të nxitohemi…*
355676466593: *Edi atë punë, keshtu që të rrimë të qetë…..(bisede pa interes ne vazhdim per marrje kredi ne nje banke)……..*

- Po në datë **10/12/2020,** ora 08:13:16 **Shpëtim Cenaj** komunikon me shtetasin **Altin Beqiri**, duke zhvilluar bisedën si vijon:

355676466593 (Sh.Cenaj): *Mirëmëngjesi shef*
355695189200 (A.Beqiri)*: Ca bane ?*
355676466593*: Hic vallaj, te puna, qysh dje jam nis, erdha sa u ndava…*
355695189200: *E di e di…*
355676466593*: Jo po ai e that troç, une të du atje tha. Per me m'thane jam ne gjume, sa e lashe,*

u cova, sa e mora sa rashe edheee, ***shi ndonjë lëvizje ndonjë gjë mos me kurse te lutem...***
355695189200: *Patjeter...*
355676466593:*Edheee qeee, nesje, doshta te thotë vete ai...*
355695189200: *Ok.ok.*
355676466593: *Ne qofte se shkon neee, kujtoja thuj....se di po ndoshta gaboj ....edhe pat shku njehere anej nga Gezimi ne zyre ai...*
355695189200: *Ku mor?*
355676466593: *A e kuptove?*
355695189200: *Po po.*
355676466593: *Po nese te thote vete e ke parasysh se me i thane ti, me tha Shpetimi thote pse e ka ba kshu a e kupton?*
355695189200: *Ok ok*
355676466593: ***Ai nuk kujtohet vete. E ke gati, vec shkon e i thua ti, vec shkon e merr. A kupton a kam ba ne jete heret qe ne gusht.***
355695189200: *Ok me rregull*
- Po në datë **10/12/2020**, ora 09:40:44 Shpëtimi Cenaj vijon komunikimet me bashkëshorten e tij përdoruese e numrit cel 3556764665939, komunikim gjatë së cilit është zhvilluar biseda si më poshtë:
3556764665939 (Sh.Cenaj): *A je i zanun tani ne lokal je?*
355693754963: *Po ha nji pilaf*
3556764665939: *Me kan je?*
355693754963: *Jam me nja dy cuna, ska gja fol*
3556764665939: *Ok jo jo flasim edhe*
355693754963: *Ok te mar rune.*
3556764665939:Ta zgjidhshim atë problemin, nje ti një ai, nje tin je ai kshu. Njoni diten tjetri naten...
355693754963:Ai me ka thane mos ki merak...
3556764665939:Jo mos ki meraj cat i teket atij, jo? I thuj e lemë kështu një ti një unë kaq...
355693754963: *Ai sma hap telefonin është ne Korçe. Ishalla i ha*
3556764665939:*Po mblidhi ti ato e jepja atij mbrapa no nje qind*

355693754963: *Eh po, hajt hajt se folim.*
104. Në vijim, në datë **11/12/2020** ora 08:41:02 **Shpëtim Cenaj** vijon përsëri komunikimet telefonike me bashkëshorten e tij , duke zhvilluar bisedën si më poshtë: ***355676466593 (Sh.Cenaj):*** *Pres ndonje telefonate nga drejtori nëse me thirr poshtë*
355693754963: *Do gjo ska lujt?*
355676466593: *Ca gjo?.*
355693754963:Ndonje respekte apo ndonje marifet...
355676466593:Jo qashtu respekte te vogla po
355693754963: *Jo tamam, tamam*
355676466593: *Jo ate te madhin ma tha pak a shumë atë ditë ai në telefon, ai thashë më ka vu i*

thashë në drejtim. Po kush tha dha këtë ide? Atë ide i tashë e dha ai i madhi, duhej nje atje, bile bile une perkundrazi jo thashë kam vendin tim atje. Mire tha mire do bisedoj atje mos ki merak mos u ndje keq tha. Kete fjale ma tha tashi. A mi llogarit a smi llogarit aa, mi ban a smi ban aa

355693754963: *E mire mire, shërbimet dolen...*

355676466593:Shërbimet e mia do ti marr mos ki merak qato të miat që më takojnë. Qato gjashtë shërbime kam me i nreq unë mirë, me një mijë për qind. <u>Për ato të tjerat se di ndonjë gjë të vogel do e marr</u>....(fjale qe nuk kuptohen). *krejt menjehere, tu zune vend*

355693754963: *Jo e (fjale qe nuk kuptohen)....**thuj jam borxh me kredi, te pakten ato shpenzimet e mia te shpise ...***

355676466593: *Ato të miat nuk diskutohet..unë sjam tu i thanë tash në telefon...ai me zor tu fol e ke parasysh ...*

355693754963: *Ta gushtojne pak friken e ene ato.....qetësohu o Shpëtim, rri pa merak mere ti ate se ti je atje ne drejtim...*

355676466593: ***<u>Ai deshte me ju thana, shiko nja kater pergjegjesa që i marrin lekët këta...edhe me ju thane që do i jepni nga pjesa ime kaq në ditë edhe e disha atë pjesën time</u>***

355693754963: *Atij deshe me ju thanae, te dites tit e natës unë, turnin e natës unë.*

355676466593: ***Ai i ka porosit të gjithë, që atë ditë që ka ik i ka marrë në telefon tak, tak, tak u ka thanë. -Me atë pjesën time mos të luj njeri hajt njatjeta....tha njoni se shava une, nga keta policet qysh mor tha asht tu na ardh turp per me te lane pa gja tha, sdi gja tha baj ca të dush, sdi do ta bajme dicka. Me e pa dit kasha mbush edhe 15 ditet e lejes...***

355693754963: *Jo jo kur te marrin ne telefon ndonje dite...*

355676466593: *Po po....jo e e pat fjalen qato 15-dite qe u komandova me pat marr lejen, edhe me leje edhe i komandu, që një muj një shërbim kam bo, a e kupton.....*

355693754963: *Jo jo thuj atij kur te dalin ne telefon. Ore i thuj une te pakten te marr si përgjegjës turni. Edhe ai tu ja fut kot tashi, une baj punen tane edhe,,..ai duhet ta kuptoj qe sje tu marr gja, përmbledhja or ti nuk asht e hijshme kjo. Ta dije ai që sje budall ti...*

355676466593: *Absolutisht po...*

355693754963:*Une te marr te paktën shërbimet e mia...*

355676466593: *Ato te miat po ato i gjej, ato i kam të padiskutueshme. Ani, ani ani. Cou rregullohu...*

355693754963: *Ti sdin me kerku te drejtën tende, ti din veç me me bertit mu, ti din me beritit e me vepru me arrogance e me më ndërhy mu në fjalë. Ça të porosita dje te thashë, kur foli une mos fol, mos nderhy.*

105. Në datë **<u>13/12/2020</u>** ora 09:40:39 **Shpëtim Cenaj** komunikon përsëri me bashkëshorten e tij , duke zhvilluar bisedën si më poshtë:

355676466593 (Sh.Cenaj): *Muar prapë në telefon ai, Drejtori edhe tha do vij andej. As lëvizje as gjë.* ***Atë planin e realizova unë atë që të thashë.....<u>një dyshe nga tonat mi dhanë a kupton?</u>...***

355693754963: *Ani mirë...*

355676466593: *Mirë mirë, zemra ime ca të të them a fole me çunat, me gocat aaa?*

355693754963: Ke fole me Nisën të shkruaj aa...
355676466593:U më fal .....(bisedë pa interes në vijim).

106. Në bisedat e përgjuara gjatë muajit janar të vitit 2021, janë evidentuar edhe komunikime të punonjësit të policisë në pikën e kalimit kufitar Morinë **Shpëtim Cenaj.** Konkretisht, më datë **23/01/2021**, ora 18:06:50 PM, Shpëtim Cenaj me numrin **067 64 66 593** komunikon me poseduesin e numrit të telefonit 067 25 53 077,me përmbajtje si më poshtë:

Shpëtimi: *Po*
067 25 53 077: *He mo*
Shpëtimi: *Ku je.?*
067 25 53 077:Une për një minute e gjysme.. dy minuta, jam aty
Shpëtimi: *Ku je mo?*
067 25 53 077: A me dëgjon?
Shpëtimi: Që mo, këtu jam unë, hajde
067 25 53 077: Për një minute, jam tek Dogana e Kosovës,.. erdha e po kaloj ne këmbë.
Shpëtimi: Po ..po.. hajde.

Pak minuta më vonë, po në datë **23.01.2021**, ora 18:08:44 PM, punonjësi i policisë, **Shpëtim Cenaj** komunikon sërish me poseduesin e numrit **067 25 53 077**, me përmbajtje si më poshtë:

067 25 53 077 : *He*
Shpëtimi: Po erdha, jo te dy.. ore burri i dheut,..veç.. futu këtu, prapa kamionit...futu..

107. Me datë **24.01.2021**,ora 09:54:42 AM, punonjësi i policisë Shpëtim Cenaj komunikon me poseduesin e numrit 067 63 52 704, me përmbajtje si më poshtë:

067 63 52 704: *Alo.*
Shpëtimi: *Ça bane ?*
067 63 52 704: *Si ia çove mirë...?*
Shpëtim: A po del aty para.. te jap një porosi!
067 63 52 704: Po..po..

108. Me datë **30.01.2021**ora 18:20:20 PM, në numrin e telefonit të punonjësit të policisë **Shpëtim Cenaj,** i vjen një mesazh nga poseduesi i numrit **068 20 37 960**, me përmbajtje si më poshtë: ***"Si kalove, e verifikon dot Alan Henrique Ferreira Bastos Soares".*** Me datë 30.01.2021,**ora 18:20:21 PM**, punonjësi i policisë Shpëtim Cenaj i kthen përgjigje personit që përdor numrin **068 20 37 960**, me përmbajtje: "***Në ç'farë date është larguar nga Shqipëria".*** Me datë 30.01.2021, **ora 18:32:06 PM**, punonjësi i policisë **Shpëtim Cena** komunikon me poseduesin e numrit **068 20 37 960, me përmbajtje,** si më poshtë:

068 20 37 960: *Alo*
Shpetim: *O dajë ça bëre?*
068 20 37 960: *Hiç ne Librazhd, ne autobus duke u kthyer*
Shpetim: *Ku ishit?*
068 20 37 960: *Ne Korçë ore ti.*
Shpetim: *Sa mbaroi...?*
068 20 37 960: *4 me 0 mbaroi, e dogjem*

Shpetim: *Rrahmani i bën keto...*
068 20 37 960: Ça bane?
Shpetim:Hiç e lexova atë.. po të hënen, jam ne punë...
068 20 37 960: Ani te hënën...
Shpetim: Burrash ma bëjnë ata mo ...ma shkruaj datëlindjen është elementare, e te hënën e hapi .. e me hi me i thëne tjetrit ...thotë .. se ta shoh une e ..pse...
068 20 37 960: Jo jo, të hënën,..ta shkruaj datëlindjen...

109. Me datë **30.01.2021 ora 18:42:02 PM**, punonjësi i policisë **Shpëtim Cenaj** në numrin e telefonit te tij, i vjen mesazh nga poseduesi i numrit **068 20 37 960**, me përmbajtje si më poshtë: ***"19.06.1991".*** Me datë **06.02.2021,ora 18:19:39 AM**, punonjësi i policisë **Shpëtim Cena** komunikon me poseduesin e numrit 069 41 13 765, **me përmbajtje** si më poshtë:

069 41 13 765: *Urdhëro*
069 41 06 344 (Sh.Cenaj): *Mirëmëngjesi, me fal se të shqetësova, Morina jam*
069 41 13 765: *He*
069 41 06 344: Kam këtë Edmondin se di.....
069 41 13 765: Hiqe vëlla, lere vëlla, ke nxjerre urdhër-arresti, lere mbajeni.., unë s'ju kam njoftuar për arrest, me njoftuat faleminderit, vureni një shënim, mos ti bini me telefonit...
069 41 06 344: *E kuptova...*
069 41 13 765: Megjithatë do mundohem unë t'ju bie një shkresë...
069 41 06 344: Nuk ndërhyjmë dot ne Sistem, për te bere shënime
069 41 13 765: *Nuk thashë ne Sistem, keni regjistër tjetër ju përveç qe u fut e doli, apo vetëm kompjuterikun?*
069 41 06 344: *Vetëm Sistemin...*
069 41 13 765: Lereni more.. të hyjë e të dali sa herë ti dojë qejfi...
069 41 06 344: *Të kuptova..*

110. Me datë **06.02.2021, ora 18:36:50 AM**, punonjësi i policisë **Shpëtim Cenaj** komunikon me poseduesin e numrit **069 23 42 642**,si më poshtë:

Shpëtimi: *He Azem*
069 23 42 642: *He shef...*
Shpëtimi: *Jam gjithë ditën ne këmbe,* ***tuj u marre me kete histori, me te tregu Vaiberin,*** *ti luan mendsh, nuk kam fytyrë, me i thanë më kujt...*
069 23 42 642: *Ore dëgjo*
Shpëtimi: Nuk kam fytyrë me i thane kujt, bjeri Fatmir Brahas, t'ja japi telefonin Azem Limaj .. atij Avdise... e me vjen keq...
069 23 42 642: *Mire ma jap Avdiun..njëherë me ka ra ne qafë e mos me ia zgjidh... me jep Avdiun.*

111. Nga përmbajtja e procesverbaleve të transkriptimit të përgjimit të komunikimeve, janë evidentuar dhe bërë pjesë e faktit penal të dërguar për gjykim, edhe komunikime të shtetasit Guxim Hajdinaj të zhvilluara në muajt nëntor-dhjetor 2020, me persona të tjerë, por ndërkohë qe ky person, pra Guxim Hajdinaj apo bashkëbiseduesit e tij nuk janë subjekte të këtij procedimi

pasi nuk rezulton që ndaj tyre të kenë vijuar hetimet apo te jetë ngritur akuzë nga ana e Prokurorisë së Posaçme. Po ashtu në këtë komunikime nuk evidentohen elementë që kanë lidhje me faktet objekt akuze ndaj të pandehurve të tjerë të këtij procedimi. Konkretisht evidentohen bisedat e zhvilluara në **datë 27.11.2020**, i cili përmban komunikime të punonjësit të policisë Guxim Hajdinaj me shtetasin Edmond Sallahu, por që nuk lidhen me ndonjë elemente të faktit objekt akuze ndaj të pandehurve të këtij procedimi.

112. Përveç komunikimeve të referuara në kontekstin si më sipër, gjatë vitit 2021, për punonjësit e PKK Morinë, dhe kryesisht për shtetasit Halim Shehu, Fatri Iseberi, janë regjistruar edhe një sërë bisedash të tjera në të cilat bëhet fjalë për kalimin e shtetasve në kufi apo kalimin e mallrave, dhe konkretisht: Më datë **24/01/2021**, ora 12:42:07, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri 0688531000, zhvillon bisedë me një shtetas, i cili prezantohet me emrin "Selam", përdorues i numrit 0696508688, bisedë në të cilën ky i fundit i kërkon ta ndihmojë për një shtetas, me qëllim të kalojë kufirin pa u regjistruar në sistem, kjo me qëllim që të mos lërë gjurmë, pasi sipas bashkëbiseduesit ky shtetas nëse regjistrohet në sistemin Tims, duhet të paguajë gjobë.

***696508688 (Selami)**: Foli pak ketij.....Personi tjetër-Alo o Halim*

***355688531000 (H.Shehu)**: Po.*

696508688**: **Selmani jam Jetoni ma dha numrin...

***355688531000**: O Selman si je si ke qene ti babush u be kohe e gjate pa te pa*

696508688**: **Për zotin kam nje shok te vëllait edhe ka ardhe mbrëmë nga Anglia. Do me ik me nusen sonte për Kosove edhe i kane thëne qe nëse kalon kufirin brenda 14 ditesh do te veme gjobe.

***355688531000**: Ai do me ik per Angli apo si e ka problemin?*

***696508688**: Jo do me shku e me nejt nje nate a dy nete ku di une e kthehet prape ne Shqiperi nje muj a dy muj.*

***355688531000**: Çfare dokumentesh ka?*

***696508688**: Shqiptare*

***355688531000**: Nusja?*

***696508688**: Shqiptare. Nusja asht prej Kalisi ky eshte prej ky eshte prej Berati me thane*

***355688531000**: Nëse ik nga Kosova nuk ka problem, nese ik nga Rinasi ato e mbajne per evidence kur ka hy e kur ka dale se i gjejnë ne sistem ato.*

***696508688**: Ai vetëm se do te iki ne Kosove sonte edhe do te futi ca letra e do te kthehet prape.*

***355688531000**: Nuk ka rendesi sistemi funksionon hyrje-dalje dhe e shohin ata ne Rinas menjëherë.*

***696508688**: Po po po.*

355688531000**: **Ideja asht se duhet me hik anej pa u regjistru e dyhet me hy pa u regjistru.

696508688**: **Te lumte ajo ishte e gjithe nese ka mundësi dmth nese ka mundësi kjo qe thu ti dakord nëse ska mundësi le te beje çfarë te doje...

***355688531000**: Ca e ke ti atë*

***696508688**: Nuk e kam asnjë send vëllai tim e ka shok atë*

***355688531000**: Epo Selman duhet me e prish terezinë me shku atje fizikisht po ai ashtu. Edhe unë e forte se jam me leje nuk jam as tek puna. I teshë Tonit jam me leje edhe i thashë jepja Selmanit numrin. Tash ku asht ai djali*

***696508688**: Asht ketu ne Tirane edhe do niset sonte ne darke sonte mbasdite e pat me mend me ik andej edhe i thashë unë kshu kshu kam per ty edhe me tha mu fol e tani cfare ti them une atij ose nisu ose mos u nis se skam ca me i ba une a me kupton?*

***355688531000**: Ai sikur me ardhe e zëmë nga ora tete i darkës edhe me u kthy nesër mbasdite, pyete nje here a munet a smunet?*

***696508688**: Po te them une tani*

***355688531000**: Degjo çfarë dokumentesh dorëzon ai atje mos i duhet me kenë i regjistrum apo ska rendësi*

***696508688**: Nuk e di sjam i sigurte per zotin...*

***355688531000**: Ne munohena me i ba ner e marrim ne qafe. Duhet me dit nese ai atje ban intervist edhe e shohin nase asht i regjistrum apo jo mos i del problem. Atje kua ka me shku me dorezu dokumentet.*

***696508688**: Dokumentet ka me shku me i dorezu per nusen e vet ne Kosove edhe pastaj me prit kur di ta dali viza per me ik ne Angli.*

***355688531000**: Nuses se vet ban me i thane ata a ke hy ne Kosove, Po. A je regjistru po. Apo nusja e vet ska problem le te regjistrohet nusja e vet.*

***696508688**:Po keshtu me i thane une atij Le te regjistrohet nusja e vet se ska problem se vetëm ky ka ardh nga Anglia.*

***355688531000**: Atehere nusja duhet me u regjistru se sban pra. Nusja per efekt te letres duhet me u regjistru edhe kur te iki edhe kur te vije. Ne oren le te niset nga ora 05:30 në Tiranë. Ne oren tete. Ai djali rri ne Angli aa?*

***696508688**: Po ky 60 vjec, se ky ka letra Shqiptare po ka vize Angleze si me thene, a je tu kuptu?*

***355688531000**:Po ky 60 vec kan a martu s'asht or ti aa*

***696508688**: Po nuk e di se ka gocen atje ne Angli me ka thene vellai del e mere mbreme ne Aeroport kam dale e kam marre e kam cu mbreme tek shtepia edhe u interesova une sot per ket pune*

***355688531000**: A do ta marresh ti me ardh ketej me ta a jo?*

***696508688**: Jo jo skam mundesi per zotin vet a me makine nuk di gja. Do iki ne Kosove me nusen e vet do te dorezoje dokumentat atje e do kthehet prape nga Kosova neser e do rrije ne berat a Tirane ku di une.Duhet me nejt nja dy jave a nje muj ku e di une sa e ka me nejt edhe kshu*

***355688531000**: Nuk e di Selman vetëm sqaroje kete pjesen mos i duhet edhe ketij me kene i regjistrum atje ku dorëzon dokumentet ajo a se mos bojme ndonje perplasje nonje gje qe i kushton shume atij pastaj o pune e ketij e rregullojmë ne hatri jot duhet me shku atje ne oren tete te darkes e me ja lene porosi dikujt kur te kthehet*

***696508688**: Dakord pra Halim te lajmëroj une.*

113. Me datë **24/01/2021**, ora 12:51:51, punonjësi i policisë **Halim Shehu** dhe personi i

quajtur "Selam" vijojnë bisedën si më poshtë:
***696508688**: O Halim degjo*
***355688531000**: Po*
***696508688**: Ai me thote mu mos e vu ne siklet thote e leme nje dite kur kur te jesh ne pune, lajmeroje qe te vije ai atje edhe te kaloje anej edhe ketej po nusen me e regjistru hem kur te futet ne Kosove hem me dale me ardhe ketu*
***355688531000**: Ok babaush degjo une dal ne pune javen tjeter e kena nje djale axhe semure edhe nese sjam nese atij i afrohet afati une e humbi nje ore per ta menxhu me e marre*
***696508688**: Flm Halim dakord.*
114. Në datë **27/01/2021**, ora 19:24:12 Halim Shehu nga numri cel 68853100, bazuar në bisedën paraprake të kryer midis tyre për kalimin në kufi në vijim zhvillon këtë bisedë me shtetasin përdorues të numrit 696508688 të cilit i drejtohet me emrin "Selam":
***355688531000 (H.Shehu):** He Selman?*
***696508688 (Selami):** Si ja cove?*
***355688531000**: A ke ate testin me vete?*
***696508688:** Po*
***355688531000:** Sonte e ke fluturimin aa?*
***696508688:** Nesër ne mëngjes nga ora tre e natës*
***355688531000:** Stamboll anbej aa?*
***696508688:** Per Stamboll e kam po*
355688531000:Hic mos e ki problem hic shko atje ne kufi per çdo problem nese te bezdisin me pyetje ke Vullnetin, shef Vullnetin te Kosovës e kam shok ate
***696508688:** Une kam hallin me keto te Shqipnise*
355688531000:Nuk ke lidhje me Shqipnine une punoj atje o Selman mos e vrit mendjen. Ne moment qe ke testin me vete nuk ju intereson fare atyne se ku je tu shku. Kur te kalosh knej me thuj mas anaj. Problemin me te vogel qe del ti ne telefon.
Në vijim ata kanë komunikuar me mesazhe dhe konkretisht ***: Sms Text Selmani**: "Me mfal desha me te tha un ka 8 dit ne Shqipri edhe me kan thon qe pa bo 14 dit nuk lejohet me dal jasht pranaj thash un qe ndoshta me bajn problem te dogana."*
***Halimi sms tekst**: "Selman vazhdo. Cdo pengese me thuaj."*
***Selmani sms tekst**: "Shum faleminderit tme falesh je i nderum".*
Halimi sms tekst: "Ti po shkon me taku nji shok. Ne Prizren...Dhe do kthehesh...Kaq."
Ora 08: 12 min Selmani sms tekst:"Faleminderit kaluam pa problem."
115. Në vijim në datë **11.01.2021**, shtetasi përdorues i numrit të telefonit 692244843, i telefonon punonjësit të policisë **Fatri Iseberi** dhe mes tyre zhvillohet komunikimi si vijon:
***355685182004**: Ku hy ke autobuzat thuj, ulu ke ajo tabela e autobuzave edhe përmend emrin e Fatrise, ka fol Fatri Iseberi me*
***355692244843**: Ok ke shenjat e autobuzit. Ku hyne autobuzat...*
355685182004:Po ke korsia e autobuzave
***355692244843:** Asht ke lokali ai per momentin...*

355685182004: *Ku eshte tek lokali mos u nal shume i thuaj se*
355692244843: *Ku jena kane mbrame tash po i them une*
355685182004:Hajt kallëzoje emrin e Fatriut dhe te atij policit qe te ka porosit i thuaj
355692244843: *Po mor po...*
355685182004: *A mi prune ato shampot ajo?*
355692244843: *Po i kam ne makine or bush*

116. I pyetur në datë 30.05.2022, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi **Gazmend Jonuz Nerguti** ka deklaruar, ndër të tjera, se: ***"...****Po u njoha me bisedat e kryera dhe dua të sqaroj se në lidhje me bisedën e datës 09.01.2021, unë kam telefonuar Fatriun pasi kam patur një mikun tim nga Tirana të cilin e thërrisnin Loli, emrin e babait e ka Barjam, por emrin e vërtetë nuk ja mbaj mend. Ky miku im nuk kishte kartë identiteti me vete dhe unë kam komunikuar me Fatriun për këtë problem. Personi kishte Leje Drejtimi automjeti, por nuk kishte karte identiteti. Tek pala kosovare kam shkuar vetë dhe kam folur me punonjësit e policisë, ndërsa Fatriu është interesuar kur ka hyrë në R.SH. Kam komunikuar me Fatriun dhe me thotë që kam folur unë me dikë, por pa ma thënë se me kë punonjës policie kishte folur. Në hyrje kur kanë ardhur për në Shqipëri, unë skam qenë fare prezent në Morinë. Miku im, të cilin unë e thërras me emrin Loli, ka numër 0682099916. Kanë qenë disa veta bashkë, por vetëm ky shtetas nuk ka patur dokumente me vete.. Unë kam shkuar deri në kufi e kam përcjellë dhe kam qëndruar aty derisa ka kaluar kufirin duke parë se mos e kthenin mbrapsht dhe ditën e nesërme ky shtetas është kthyer.Në lidhje me bisedën e datës 11.01.2021, unë kam biseduar me Fatriun për një problem të një miku tim, i cili quhej Albert Cengu i dtl 04.06.1984, i cili po ashtu është shofer tek drejtoria e Spitalit Kukës. Këtë shtetas sa herë kalonte në kufi e ndalonin dhe e mbanin për verifikim rreth gjysmë ore, pasi merrnin konfirmim nga Tirana e lejonin të udhëtonte. I kërkoj Fatrisë që të di se çfarë problemi ka dhe Fatriu me thotë që ka një shënim në sistem ne lidhje me një kalim që ka dashur të kryejë për në Angli. Maqedonia është përmendur në këtë bisedë pasi, Fatriu me kishte thënë veç të tjerash se këtë problem që ka Alberti e ka edhe një i Maqedonisë. Fatriu na thotë se duhet të bëjë një kërkesë tek Drejtoria e Kufirit. Pasi Alberti ka bërë kërkesën i ka ardhur përgjigja dhe nuk është ndaluar më në kufi. Edhe biseda në vijim e datës 27.02.2021, ora 08:47 min është interesim po të njëjtin person për Albertin, por Fatriu me sqaronte që nëse i hiqet atij të Maqedonisë i hiqet edhe këtij. Pasi ka qenë edhe një shtetas tjetër maqedonas që kishte një problem të tillë. Unë nuk e njoh kush është shtetasi i Maqedonisë Ndërsa për sa i përket emrit të shtetasit për të cilin unë jam interesuar në kufi për të kaluar në Kosovë sipas sqarimit që ju kam dhënë më sipër sqaroj se emrin e plotë të tij do t'jua konfirmoj me sms.*

117. Lidhur me përdoruesin e numrit të telefonit 0682099916 të referuar në deklarimet e shtetasit Gazmend Nerguti, nga verifikimi i kryer në aplikacionin "*Truecaller*" ka rezultuar se përdorues i numrit cel 0682099916 është shtetasi Amarildo Hajdini, i cili, sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, rezulton të mos ketë regjistrim hyrje dalje pas vitit 2020 në dhe nga R.Sh-ja. Po ashtu nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se shtetasi Albert Cengu, ka hyrje dhe dalje të shpeshta në kufi të jetë regjistruar në dalje të R.Sh-së, por nuk është regjistruar në hyrje.

118. Për sa i përket bisedës së kryer me Fatriun, për shtetasin me emrin Albert Cengu, nga verifikimi në sistemin TIMS, dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve me datë 03.06.2022, rezulton se ky shtetas është regjistruar në dalje të R.Sh-së në datë 11.01.2021, por nuk është regjistruar në hyrje të R.Sh-së. Nga verifikimi në sistemin TIMS, shtetasi Albert Cengu tek rubrika "Shënime", ka një regjistrim pasi ka tentuar të udhëtojë me dokumente të falsifikuara për në Mbretërinë e Bashkuar.

* * *

119. Nga përgjimi i komunikimeve dhe bisedave telefonikë zhvilluar në muajin janar 2021, janë evidentuar komunikime edhe për punonjësit të PKK Morinë, shtetasit **Gëzim Duraku**, me persona të ndryshëm, si vijon: - Me datë **22/01/2021**, ora 18:11:45, është zhvilluar një bisedë mes punonjësit të policisë në pikën e kalimit kufitar Morinë **Gëzim Duraku,** nga numri 0694106325, më një person tjetër që përdor numrin *0683270741,* ku rezulton se bisedojnë për kalimin në kufi të një shtetasi. Nga të dhënat e marra nga Kompania Telefonike "*One-Comunication*", rezulton se numri i mësipërm i bashkëbiseduesit të punonjësit të policisë Gëzim Duraku, është i regjistruar në emër të shtetasit Alban Uku, i datëlindjes 05.06.1996. Nga verifikimi dhe këqyrja e marrja e të dhënave nga sistemi Tims, ka rezultuar se shtetasi Alban Uku nuk rezulton të jetë i regjistruar as në hyrje dhe as në dalje të Republikës së Shqipërisë në datën 24.01.2021, ditën e diele siç referohet në biseda ndërkohë që bisedat janë zhvilluar në datë 22.01.2021 e cila ka qenë ditë e premte. Në bisedën e regjistruar mes tyre lidhur me kalimin në kufi ditën e dielë, që përkon me datën 24.01.2021, komunikohet sa vijon:

355694106325 (G.Duraku): *Te dielën jam ne pune unë...*

683270741 (A.Uku): Super, shyqyr qe je ne pune sepse shiko tashi. Gocës se dajës tem i ka mbaru karta e Identitetit...

355694106325: *Po...*

683270741:Ene kam hall se ato mos kërkojnë me kalu ne Kosove edhe me kalu pa u regjistru or burrë e ke parasysh? Edhe unë s'regjistrohem dot...

355694106325:Pa problem jam unë ne pune, jam tanë ditën ne pune unë...

683270741:Se mos ashtu mos me del prej llafi ee...

355694106325:Ca flet or ti. O Alban zënë se je vete or ti...

683270741: *Për zotin e madh ta kam borxh...*

355694106325:Gjeja me e lehte qe mund te bej ...

683270741:Me kalu pa u regjistru se as unë s'regjistrohem dot or burrë se me qisin peseqind pune tek puna

355694106325: *Po jo or ti cke mos e vra trunin ti hajde.*

120. Komunikimi mes tyre ka vijuar ne datë **24/01/2021**, ora 11:02:21, ku rezulton se punonjësi i policisë **Gëzim Duraku**, nga numri 0694106325, zhvillon bisedë me personin që ka përdorur numrin 0683270741, ku bisedojnë për kalimin në kufi të një shtetasi.

355694106325 (G.Duraku): *Po Alban*

683270741 (A.Uku): *O Gëzim tashi jam tu u nis une o Gezim...*
355694106325:Hajde, hajde këtu jam te puna hajd. Me ca makine je mor?
683270741:Une jam me golfin tim-5 dhe është dhe ky baftjari me makinën e vet
355694106325: *Ok pa problem hajd.*

121. Në datë 25.05.2022, pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi ***Alban Uku*** lidhur me faktet si më sipër dhe, ndër të tjera ka deklaruar se :"*...Po unë e kam kryer këtë bisedë dhe me thënë të drejtën unë për shkak se isha duke kryer procedurat e fejesës në Kukës kisha menduar që të shkoja deri në Kosovë që të respektoja familjaret e gruas dhe familjen time me një drekë, por për shkak se nuk e kisha të sigurt nëse do të shkoja nuk e kisha diskutuar me eproret, këtë edhe për shkak se ceremonia e fejesës është diçka familjare dhe nuk kam dëshirë që të merrej vesh. Unë thjesht e kisha në plan që të shkoja, por në të vërtetë nuk kam shkuar dhe nuk kam udhëtuar për në Kosovë. Dua të sqaroj se kjo bisedë me Gëzim Durakun është kryer edhe për shkak se unë si punonjës policie i ri në atë moment nuk kisha dijeni që për të udhëtuar 24 orë në Kosove duhej marrë leje direkt nga eprori dhe udhëton lirshëm. Jam informuar po atë ditë dhe e kisha lënë që nëse do të shkoja në Kosovë do njoftoja eprorin tim për të marrë leje por në të vërtetë nuk ka m shkuar.*

* * *

122. Nga komunikimet e transkriptuara, si rezultat i përgjimit të komunikimeve të përgjuara pas lejimit me vendim të gjykatës, kanë rezultuar edhe biseda të bëra mes punonjësit të policisë **Halim Shehu** dhe punonjësit së policisë **Sule Onuzi**, me detyrë punonjës trup shërbimi, kontrollor pranë Pikës së Kalimit Kufitar Morinë, i cili rezulton se ka përdorur numrin 0682344575. Gjatë bisedave të regjistruara rezulton se ata debatojnë në lidhje me një shumë parash për të cilën punonjësi i policisë Halim Shehu i kërkon që pjesën t'ia lërë tek servisi i shtetasit Besim Cerës. Konkretisht mes tyre është regjistruar biseda si vijon:
688531000 (H.Shehu): *O Lacul?*
0682344575 (S.Onuzi): *He Halim*
688531000:Ky nuk ka ndonjë ero or shok, veç nje sen a mun e kujton bre pashe zotin e madh. Ky ate dite kur ka kalu ky, a ka lene gja ke une a tek ti i ka lene?
0682344575:Jo jo mu ka pa i ka lene..
688531000:A ti ka lane ne dore tuj kur ka kalu atehere pra..
0682344575: *Po une i kam pa ne xhep....Po ca mor jam tut e thene une skam nevoje une me bo be...*
688531000:Bane be thote ne kry tuj qe si ke marre lekt ti ky zotnia.
0682344575:Jo mor jo jam tu te thene une i kam marre lek tune ca do ky thashë....(.bisedë ambinetale *degjohet Halimi qe flet me personin tjeter.....pse me thu mu i ke marre ti or ti) ...O halim halim mos e zgjat ma ne telefon neser te vijne leket e hajt njatjeta se kam qene i semure per vete une skam pa ...te q.. qeni nanen me gjithe ato leke thuj.*
355688531000: *Sone te vij ti marri po .....*

355682344575:Kur te vej te shpia te vij se ja jap une qito……
355688531000: *Qaty tek ai servisi Cene…*
355682344575: *Tek Besim Cera ……*
355688531000: *Taksirat po hajt.*

* * *

123. Komunikimet e shtetasve Halim Shehu, Fatri Iseberi, Shpëtim Cenaj, etj, kanë vijuar dhe gjatë muajve shkurt – maj 2021, kohë në të ciline, në rend kronologjik, janë regjistruar komunikimet si më poshtë: Biseda e datës **24.02.2021**, bërë midis punonjësit të policisë **Halim Shehu** dhe punonjësit të policisë, i thirrur "Agim", me numër 0694106135, i cili i kërkon të komunikojë me nipin e vetë. Nga biseda për shkak se ajo kryhet në telefon, Halimi stepet dhe nuk i jep një përgjigje për udhëtimin e tij në drejtim të shtetit kanadez, me përmbajtje:
694106135 (Agimi): *Si kalon?*
355694106344 (H.Shehu): *Mire*
694106135:Do të marrë ai djali i motrës ne telefon se do më të pyet për disa gjona, edhe ma sqaro.
355694106344: *Po mire*
694106135: *Kudo qe te jesh vjen*
355694106344: *Jo unë nuk jam atje tek puna, momentalisht*
694106135: *Ska problem aty është ai. Diku këtej. Ne Kukës bre diku anej, mirepo don një asistencë të vogel me të pyet për një procedurë. Edhe do të marri për dy minuta te merr ne telefon ai*
355694106344: *Hajde ciao.*

124. Në vijim, midis punonjësit të policisë **Halim Shehu** dhe nipit të *Agimit* me numër 677263320 kryhet kjo bisedë:
677263320 (Agimi): *Jam nipi i Agimit……..*
355694106344 (H.Shehu): *Po me tha hë si është puna?……*
677263320: *A ke kohë me pi ndonjë kafe apo..?….*
355694106344: *Jo ca kafe jam ne Tiranë……*
677263320:Desha me te pyet se du me kalu anej nga Kosova, po pa ma shkrujt emrin
355694106344:Me ato policet e Kosovës jam larg une tashi, sdi cte të them. Sdi cte te them, ato ato shko bisedo me ato policet e Kosoves sdi cfare te te them. Nuk kemi ne lidhje fare me. Shko atje bisedo me ta. Pse ku do me shku ti?……
677263320: *Po du me dal andej se kam me hy në Kanada*
355694106344:A nuk e kami dene, Te lutem po flasim per dicka ne telefon qe nuk me takon të flas të lutem…
677263320: *Ok.*
125. Biseda midis punonjësit të policisë **Halim Shehu** dhe një shtetasi tjetër, përdorues i numrit celular, *0699541424, regjistruar në emër të shtetasit Lavdi Matmuja, i datëlindjes*

02.03.1970) të cilit, Halimi i thërret "daje" dhe i kërkon të lejojë udhëtimin për një shtetas së cilit i ka kaluar afati i vlefshmërisë, si vijon:

688531000 (H.Shehu): *Ca bone daje*

355699541424(L.Matmuja): *Ku je?*

688531000: *Te puna, te puna...*

355699541424:Po qysh me bo me e cu djalin*?Me....pasaporte.....(fjale qe nuk kuptohen) se ketu tek drejtoria nuk hik ajo pasaporte e me e pru (fjale qe nuk kuptohem)...*

688531000:Bjema bre se ketu jam deri ne tete te darkes...

355699541424: *Ti them ti hipi nje fugoni e te vije...*

688531000: *Po te vije knej ka ne te vije...*

355699541424: ...(fjale qe nuk kuptohen).....

688531000: *Po mo daje dal une ska problem.*

126. Me datë **18.02.2021**, ora 09:25, personi që ka përdorur numrin **0696244448,** numër i cili ka rezultuar i regjistruar në emër të shtetasit Ndriçim Iseberi, i datëlindjes 24.10.1987, i ka dërguar këtë mesazh punonjësit të policisë **Fatri Iseberi** tek numri 0685182004 me tekst: "***1 mi ero e ka si shofer shkoj unë".*** Në orën 09:25:34 të po kësaj datë, punonjësi i policisë Fatri Iseberi i dërgon këtë "sms" nga numri **0685182004**, në drejtim të personit që përdor numrin **06962444448** (*Ndriçim Iseberi),* me tekst: "***Nuk kam vet të shof a mos i gjej borgj".***

Biseda e datës **23.02.2021**, bërë midis punonjësit të policisë **Fatri Iseberi** dhe një shtetasi me numër 0696244448, me përmbajtje si më poshtë: 355696244448 sms "***Ku je mor bemi lekt sot se nesër iki 1200 ero se i kam zan venet ok***".

127. Më datë **28.02.2021**, ora 16:31:17, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, tek numri 355694115447, telefonohet nga personi, përdorues i numrit 355685959989, ku i prezantohet si shtetasi Arjan Domi, dhe mes tyre zhvillohet biseda me përmbajtje si më poshtë:

355685959989 (A.Domi): *Oshef a u lodhe bre?*

355694115447 (F.Iseberi)*: Si kalove?*

355685959989: *Ca bëne, Arjani jam ej*

355694115447: *Kush?*

355685959989*: Arjani jam, Arjan Domi*

35569411544: *Hë Arjan*

355685959989: *E a mos mori në telefon Cimi bre?*

355694115447:Po ka kalue.

355685959989:Po bre po mori në telefon tha dil e jepja 300 euro dikujt që me ja lënë një atyne se tha jam pa lek, jam andej doganës, sdi gjë se gjit..

355694115447: *Kujt me ja dhënë?*

355685959989:Po dil e leja diku në nji te agjensia njënit e ti them unë atij djalit për me ja cue...

355694115447:Po jepja ti se ti jap un bre burr kur të jesh te ai djali ti jap unë tuj jepja thuj pa merak.

355685959989*: Hajt..*

355694115447: Hajt.

128. Me datë **01/03/2021**, ora 07:58:35, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi,** nga numri 355694115447 zhvillon bisedë me një shtetas tjetër, përdorues të numrit 355696244448, ku nga komunikimet me "sms", rezulton se kanë shkëmbyer bisedat si më poshtë: Përdoruesi i numirit 355696244448 i dërgon sms Fati Iseberit në numrin 355694115447, më këtë përmbajtje: "***Ne Nuremberg na kthyen s'na la gjermani jemi ta provu ka krahi tjetër dun tampona në Austri jena te shku".***

129. Me datë 01.03.2021, ora 07:59, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit 355696244448, "***Si të shkosh në Austri shko te ky shoku im se ka djem aty".*** Me datë 01.03.2021, ora 08:01, personi që përdor numrin 355696244448, i përgjigjet punonjësit të policisë Fatri Iseberi tek numri 0694115447, me "sms" me tekst, "***Thuj tem dalin ne linëz e tem qojë deri në Gjermani".*** Ora 08:01, data 01.03.2021, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447, i përgjigjet me "sms" numrit 355696244448 me tekst: ***"Qe te foli me ta"*** 355696244448 sms kundrejt 0694115447, ***"Po".*** Ora 08:04, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit 355696244448, "***Ah me qen me të huja nuk ju nal kush"...*** 355696244448 sms kundrejt 0694115447, ***"Fol, e kallxom ej".*** Ora 08:14:29, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit 355696244448, "***Me thuaj ne qa vendi je fiks se vjen e të merr aty ku je"*** 355696244448 "sms" në drejtim të numrit 0694115447, ***"Ne linz te stacioni i trenit per 2 or jam aty.".*** Ora 08:24:15, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit355696244448, "***E ai esht ne Vjen qenka 2 or e sa larg stacio po ky thot le ti hypin trenit se shkojnë pa merak".*** 355696244448 sms kundrejt 0694115447, ***"Nuk ljn thuj me tren ceq me makin edhe un 2 or bej me shku ne Hofbanhof ne Linz".*** Ora 08:26:46, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit355696244448, ***"Po shkoni ne Vjen edhe va ben tamponat pa lek edhe ikni pastaj me tren ose makin"*** . Ora 08:43:04, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit 355696244448, ***"E po me boh pra testin ku e ke boh e ma va qu me fax".*** Numri 355696244448 kthen përgjigje me "sms" në drejtim të numrit 0694115447, ***"E kam ble ka 50 er".*** Më datë 01.03.2021, ora 10:18, personi që përdor numrin 355696244448, i përgjigjet punonjësit të policisë Fatri Iseberi tek numri 0694115447, me "sms" me tekst, "***Jo jo në Linz tash jam te prit a mos po shkon nai tren në Gjermani po veshtir me lan ej, duhet makine e vol".*** Ora 10:21:24, personi që përdor numrin 355696244448, i përgjigjet punonjësit të policisë Fatri Iseberi tek numri 0694115447, me "sms" me tekst, "***O sjam tu kthy mrapsht ej me shku ne Vjen se e kam 170 kil".*** Ora 10:28:10, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit 355696244448, "***Mi qo me foto ato test kovidit tja qoj atij shokut" ....." Ku i bene ne Austri ah".*** Më datë 01.03.2021 ora 08:00, punonjësi i policisë Fatri Iseberi, nga numri 0694115447 dërgon "sms" në drejtim të numrit355696244448," ***Me dokumente".***

130. Përdoruesi i numrit të telefonit 0696244448, evidentuar në komunikimet si më sipër, shtetasi **Ndriçim Iseberi**, i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale në datë

30.05.2022, në lidhje me bisedat e kryera ka sqaruar se :".....*Ladi është Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe unë kam patur një çështje penale, për të cilën unë kisha për të marrë disa dokumente në lidhje me një çështje që ka qenë pandehur nga ky prokuror për shkak të një aksidenti automobilistik që unë kisha kryer. por që nuk kam pas qenë unë fajtor kjo sipas veprimeve hetimore. Bëhet fjalë për automjetin tip Benz ngjyrë të zezë me targa, "AB973AX", në pronësinë time.....*". Ne lidhje me episodin e komunikimeve kur është duke udhëtuar drejt Gjermanisë ka shpjeguar ndër të tjera se :"... *rast ku unë kërkoja për të ikur ne Angli dhe për të shkuar aty shtetasi që do të më ndihmonte një shoku im nga Anglia Shpend Ademi më thotë që të gjej unë para borxh dhe të ndihmoj unë që të vish. Unë mundohesha të siguroja një shumë prej 13 mijë paund britanikë, dhe nuk kam arritur ti siguroj. Tek biseda që kam bërë me Ardianin në këtë datë, vellai tim Ardiani më thotë që një mijë do të mi jepte ai dhe të tjerat do të mi dërgonte një shoku tim që e përmenda më sipër. Para të cilat unë ja kisha kërkuar borxh, por nuk mi dërgoi. Ndërsa shuma prej 15% është shuma që do të mbahej nga dërgesa e parave që do të më dërgonte shoku nga Anglia. Unë nuk është se kisha gjetur ndonjë njeri konkret për të ikur në Angli por shoku tim Shpendi më tha që shko në Belgjike se aty gjen njerëz që të sjellin në Angli, dhe kjo shumë parash mua do të nevojitej për personat që do të gjeja për të më çuar në Angli. Por kjo mbeti thjesht një bisedë pasi unë nuk shkova pasi nuk munda që ti grumbulloj paratë...ka qenë koha e pandemisë dhe nuk lejoheshin lëvizjet për në Europë, përveçse duke sajuar ndonjë gjë si shofer apo me furgona, drejtuesit e të cilëve i rregullonin vetë letrat, pasi në kufirin Evropian kjo ka qenë e vështirë për të kaluar. Mua më nevojitej një shumë prej 1000 mijë eurosh pasi kunati tim Besnik Mustafa kishte kaluar disa ditë më parë dhe kishte paguar një shumë prej 1000 mijë euro, duke kaluar në kufi gjasme si shofer automjeti. Unë fola me Besnikun në telefon dhe me jep numrin e një shoferi nga Shkodra të cilit aktualisht nuk ja kam numrin. Unë u lidha me këtë shoferin, dhe kam shkuar deri në Linzë të Austrisë pa shkuar në Gjermani, pastaj kam bërë disa tentative për të shkuar në Gjermani duke provuar rrugë të ndryshme dhe në fund munda të shkoj në Gjermani. Në kufi në Morinë kam kaluar me automjetin e këtij shtetasi Shkodran dhe vetë shoferi e kishte rregulluar sikur do kalonim tranzit. Unë kam patur vetëm pasaportë me vete. Jemi regjistruar rregullisht ne kufi dhe kemi zbritur ne Linzë ku dhe i ke paguar 1000 mijë euro këtij shtetasi. Gjatë rrugës kam komunikuar vazhdimisht me vëllain tim Fatri Iseberin me sms. Drejtuesit të furonit nuk ja kujtoj emrin dhe as targat e mjetit. Deri në Gjermani kam shkuar më pas me trena. Bashkë me mua në të njëjtin automjet kemi qenë rreth 4-5 persona, automjet tip, "Sharon", ngjyrë kafe. Edhe personat e tjerë kanë ikur duke paguar para por shumën e saktë nuk e di për secilin. Kam ndenjur në Gjermani rreth dy muaj e njëzetë ditë dhe pastaj jam kthyer mbrapsht në Shqipëri...*".Në lidhje me pyetjen se kush është Arjani, personi me te cilin do të udhëtonte drejt Gjermanisë ka sqaruar:"... *Është një shok tjetër i imi te cilin e quajnë Arjan Domi, nuk jam i sigurt për mbiemrin, dhe me kishte thënë se mund te me gjente ndonjë për te ikur. Kjo bisede është para se te gjeja shoferin nga Shkodra. Për shkak te kushteve të vështira ekonomike uni kam tentuar te gjej persona dhe te iki ne emigracion pasi ne atë periudhë Kovidi është bere shume i vështire udhëtimi për në Evropë prandaj dhe shoferet merrnin shuma kaq te mëdha parash...*".

131. Në lidhje me komunikimet si më sipër, në datë 01.06.2022, është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi **Arian Vehap Domi** i cili ka deklaruar se: "... *Unë aktualisht punoj shofer fugoni dhe bej linjën Kukës Tiranë. Kam një fugon sprinter, "Mercedez-Benz", me targa, "AF729T" dhe jam i pajisur me licencë të rregullt për transport udhëtarësh. Unë nga shtetasi Fatri Iseberi kam marrë në një rast një porosi një zarf të mbyllur dhe më ka lënë porosi që ta çoj tek Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Ndërsa rasti që ka kam zhvilluar edhe bisedën telefonike bëhet fjalë për një shumë prej 300 eurosh. Mua më kishte telefonuar vëllai i Fatriut, Ndriçim Iseberi i cili atë kohë kishte ikur në Gjermani dhe kishte ngelur pa lekë. Kam komunikuar me të në mesenxher dhe më thotë që lekët jepja Rrezart Domit personi me të cilin Ndriçimi kishte udhëtuar kur kishte ikur në Gjermani. Unë Rezartin e njoh pasi e kam kushëri dhe ai ka një furgon dhe bën rrugën për në Gjermani me pasagjerë. Më duket se ka dy tre furgona që e kryen këtë rrugë. 300 euroshin e lekëve unë ja kam dhënë Rezartit pasi ishte shuma që i takonte atij, pasi kur kishte udhëtuar me të Ndriçimi kishte ngelur debitor ndaj tij. Kjo bisedë sipas thënieve të Ndriçimit...* ". Pyetjes nëse e njeh shtetasin me emrin Xhevat Muja apo Halim Shehu ai është përgjigjur: "... *Një Xhevat që e njoh unë merret me tregti tapetash dhe banon në Kukës. Ka një dyqan ne treg dhe shet perde e tapeta. Unë i kam transportuar dy herë tapeta shtëpie nga Tirana në Kukës, të blera prej tij të cilat i donte për ti shitur, ndërsa Halimin e njoh pasi ka një kioske përballë stacionit në Kukës e cila gjendet afër Farmacisë së Zenun Mujës ka patur një pikë shumice si dhe po të njëjtin vend e ka dhënë aktualisht me qera. Qëndrojmë aty shpesh prandaj e njoh.* ".

132. Me datë **24.02.2021**, gjatë kohës që punonjësi i policisë **Halim Shehu** ka telefonuar kolegun e tij me numër 0686899410, dhe gjatë këtij komunikimi është regjistruar kjo bisedë ambientale: ***Sintesi (bisede ambientale = kush guxon me marr lekët e grupit or ti a aka ftyre ai ....personi tjetër: i ka lënë ai r.q për punët e veta, degjenerata...Halimi: Unë s'du e ja pa surratin or ti.***

133. Më datë **02/03/2021**, ora 13:40:10 punonjësi i PKK Morinë **Shpëtim Cenaj** zhvillon këtë bisedë me një shtetas.

355676466593 (Sh.Cenaj): *O shef Gezimi*

355674415000: *A je larg aa?*

355676466593: *Jo sa ika pse?*

355674415000: *Shko se janë tepër*

355676466593: aaa?.....

355674415000: ***Shko mere nji 6-mijë lekësh***

355676466593: 108 të lashe mo mos të kam lënë më pak?

355674415000: Shko mere një 106 mijë lekësh mere

355676466593: *O ti faleminderit sa i mirë që je.*

134. Në datë **05/03/2021** 11:30:50 punonjësi i policisë **Shpëtim Cenaj** zhvillon këtë bisedë me një shtetas nga Shkodra, i cili do të shkojë në Kosovë, por kërkon ndihmën e Shpëtimit për të kaluar kufirin. **Konkretisht mes tyre zhvillohet biseda si më poshtë:**

355676466593 (Sh.Cenaj): *Po se di pra tashi ja t*

355672553077: *Aaa*
355676466593*: Nuk kam ashtu njeri unë jo*
355672553077: *A thu ma kryejnë mu ata?*
355676466593: *aaa?*
355672553077: *A thu ma kryejnë mu Kosovaret?*
355676466593: *Po se di pra shko ke Arbrin aty*
355672553077: *Po nesër është e shtune mor...Jo kam hall me i cu mor skam hallin e rrugës, kam hall me i cu……*
355676466593: *E mar vesh e marr vesh. Ca të them unë, kur do me shku ti?.....*
355672553077: *Unë nesër me u nis nga ora shtatë e gjys prej Shkodre, tetë e gjys*
355676466593*: Flasim për nesër flasim, për sot jo*
355672553077: *Po sot s'duhet mo nesër……*
355676466593: *Nesër flasim, ca boni Gëzimi me ata çunat aa u rregullu aa*
355672553077: *Nuk dëgjojnë hiç, ja kanë lënë shtetit, kanë marrë një avokat, ja kanë çu tash ekspertizën ja kanë çu privatit se s'ka pas besë avokati dhe jaka çu e ka kerku ekspertizën me e ba privat. Tash presim me dal përgjigja e ekspertizës private. A të marr nesër në shtatë e gjys pra në telefon……*
355676466593: *Po edhe unë, bo muhabetin paraprakisht .....*
355672553077: *Hajt bane ciao, ciao.*

135. Në datë **06/03/2021**, ora 07:57:41 **Shpëtim Cenaj** kryen këtë bisedë me kolegun e tij **Halim Shehu.**

355676466593 (Sh.Cenaj): *O Halim mirëmëngjesi*
355688531000 (H.Shehu): *Mirëmëngjesi, me thuj*
355676466593: *E di që sja ke nis hala punës.* ***Është një shok i joni i përbashkët, shok i Gezimës Llojës edhe shefin tone e njeh edhe ty. Do vijë atje do të takojë***
355688531000*: Edhe një herë të lutem*
355676466593*: Do vijë të të takojë një person bre*
355688531000: *Po*
355676466593:Është një shok i joni bre është nga Shkodra. Shife se është i mirë edhe për ty
355688531000: *Ok.*

Po në datë 06/03/2021, ora 07:53:17 **Shpëtim Cenaj** informon shtetasin në lidhje me bisedën e kryer me Halimin.

355672553077*: O gjeneral*
355676466593 (Sh.Cenaj): *Se e pashë unë atë isha tu u përpjeke me gjet numrin e tij. Shko atje ke Halimin. Është ne punë Halimi është në turn është përgjegjës turni. Shko takoje. A më kupton?*
355672553077: *A ke fol ti me të*
355676466593: *Flas unë me të tani se isha tu e gjet numrin se sat u marr shërbimin është se s'ka shku tetë ora.*
355672553077: *I tash jam në Kukës unë*

355676466593:Shko takoje pa pikë meraku e ke. Sa të shkosh ti e merr shërbimin ai. Shko takojë kshu kshu i thuj, më ka çu Shpëtimi. Përmendja dhe Arbrin dhe krejt i thuj, i kam shokë i thuj .....
355672553077: Thuj ti a tu ardh një mik i jemi.
355676466593: Ja se po e marr se me atë isha tu marr për kokë të fëmijëve.

136. Në datë **15.04.2021** punonjësi i policisë **Shpëtim Cenaj,** nga numri cel 0676466593 ka zhvilluar këtë bisedë me përdoruesin e numrit 0682055066, në përdorim të shtetasit Saliko Dautaj sipas konfirmimit të kompanisë telefonike *One-Telecomunicaion*, me të cilin diskuton për të kaluar në kufi një shtetas i cili nuk disponon dokumente udhëtimi. Mes tyre zhvillohet biseda si më poshtë:
0682055066 (S.Dautaj):Asht një miku im do me ardh në Kosove sot, do me marrë çunin me vete, por çunit te vet i ka skaduar pasaporta Shqiptare, a udhëton dot një tre orësh do te rrije ne Prizren edhe kthehet prape?
Shpëtimi: Absolutisht po.....
0682055066: *Ta marri pasaportën e vjetër me vete?.....*
Shpëtimi: *Tani unë e le shërbimin do marr kontakt me përgjegjësin e turnit Gentian Hoxha. Genci se di a e ke numrin 03, 073 më duket.....*
0682055066: *E kam unë e kam*
Shpëtimi: *Gencin e ke këtu, absolutisht po*
0682055066: *Thuji Gencit ti se shoku jonë është edhe polic, është.....*
Shpëtimi: *Mos mo as nuk diskutohet fare, a të vij prej Kukësi unë të ta kaloj?*
0682055066: *Ai ta marri pasaportën me vete që ta ketë dhe*
Shpëtimi: *Po normal bre normal...*
0682055066: *Dakord mo thuj Gencit ti se e mor dhe unë Gencin.....*
Shpëtimi: *Ok, ok pa problem.*
0682055066: *Numër privat të Gencit ke ti?*
Shpëtimi: *Qat 067 që të çova vetë, Qat ku e kam Gencin foli vetë një herë gojarisht*
Genci: *Alo.*
0682055066: *Genco si je mo?*
Genci: *Si të kam?*
0682055066: *Kam një mikun tim ja shpjegova edhe Shpëtimit po e që je ti.....ai do me shku nja tre orë në Prizren mirë po djalit të vet i ka skaduar pasaporta.....*
Genci: *Po hajt mo kur të vijë, mos vrit mendjen, jepi numrin tim dhe të më marrë mua.....thuji mos të më marrë fiks fare kur të jetë këtu, të më marri cik para.*
0682055066:Jo jot ë marri afër o vëlla të marri afër, të marri kur të jetë te aeroporti ai se do vijë me avion ai.
137. Është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit, në datë 19.08.2022, shtetasi ***Saliko Dautaj,*** i cili ndër të tjera, ka deklaruar se :"...*Mua nuk më kujtohet të kem kryer një bisedë të tillë më këtë punonjës policie, me Shpëtimin apo me ndonjë punonjës tjetër të quajtur Genci, ashtu siç përmendet në këtë bisedë. Numri i telefonit 0682055066, ashtu si shumë*

numra të tjerë është i regjistruar në emrin tim por janë në përdorim nga shoqëria e sigurisë që unë kam dhe për pasojë përdoren nga një numër i madh punonjësish, ku në përbërje të tyre mund të ketë edhe ish punonjës të policisë...".

138. Në datë **16.03.2021**, ora 08:49:47 min **Shpëtim Cenaj** tek numri cel *355676466593,* është telefonuar nga një shtetas përdorues i numrit cel 0686477459 dhe zhvillojnë këtë bisedë :

0686477459: *Mirëmëngjesi*

355676466593 (Sh.Cenaj): *Mirëmëngjesi*

0686477459: *Shoku i Gëzimit jam*

355676466593: *Po ku je?*

0686477459: *Unë jam këtu ke kafja ne dalje, këtu ke*

355676466593: *Ne cilën dalje o vëlla a je në Morinë?*

0686477459: *Dmth në krah të djathtë kur ikën ne Kukës Morinë*

355676466593: *Te këto kafet këtu afër? Po mirë po hajde pak këtu, te sheshi me telefon në dorë të të takoj dy minuta*

0686477459: *ok..*

139. Po në këtë datë **16/03/2021**,**Shpëtim Cenaj** telefonohet në numrin *355676466593,* nga shtetasi Gëzim Goçi, përdorues i numrit 0694134579 dhe të dy zhvillojnë këtë bisedë në vijim të bisedave dhe takimit të zhvilluar midis Shpëtimit dhe shtetasit përdorues i numrit të telefonit 0686477459, të cilët kanë problematika në kufi dhe për këtë ju duhet ndërmjetësimi i Shpëtimit, si vijon:

0694134579: *Hë more?*

355676466593 (Sh.Cenaj): *O kolonel e takova atë shokun...*

0694134579: *E mirë po thuju atyne çunave mos janë ata Hasjanët*

355676466593: *Shiko për vlerë hë për hë jam tu e cu tek Ed Poga*

0694134579: *Cofja Edit dhe thuj jam miku i Gëzimit*

355676466593: *Është përgjegjës në emrin tënd...*

0694134579: *Po po në emrin tem e ka cu filani edhe ja bëj një telefon Edit unë*

355676466593: *Ëee se këtë pjesën tonë nuk diskutohet që mos e*

0694134579: *Shto te Edi se i bëj unë tel*

355676466593: *Hajt pra hajde.*

140. Në vijim po në datë **16.03.2021**, ora 09:39:11 min përsëri Shpëtimi dhe Gëzimi Goçi zhvillojnë një bisedë telefonike nga ku referohet se porosia për kalimin e shtetasve është kryer dhe ndër të tjera thuhet që është bërë për nder të Gëzimit, pasi ky i fundit e ka kërkuar si favor. Midis tyre, është zhvilluar ndër të tjera biseda si më poshtë:

355676466593 (Sh.Cenaj): *O kolonel, tashi me shef Edin e kam taku, pa merak i ka thënë ai, tashi vetëm pritet të ardhjes. Ajde e din një kafe, ca kafe thash shko pije me Gëzimin, mos e përmend më i thashë.....*

0694134579:*Ej ndigjo ky Gëzimi e ka bërë të fortë se punon në një kompani Italiane, ka qenë polic, punonjës policie dhe tashi atë pronarin Italianin e ka zënë policia diku nga ora 5 e mëngjesit, edhe problem se e kishin vra atë djalin. Edhe ky Gëzimi I thotë po ma jep atë policin*

se ai i kishte thënë Gëzim karabinieri, po hë mo ca ka bërë ai pronari? Ky ka bërë shkelje shumë të rëndë. Po ca të ha kujtova se ka bërë aksident kur po ca ka bërë, ka shkel orën policore, po vrite q...nënën, vrite i ka thënë.....

***355676466593**: Se ka nigju se.....*

0694134579**:**Ore tha polici do vij të jap kafe në Fushë-Krujë, shkelje e rëndë tha, unë thashë cfarë ka bërë.....

***355676466593**: O kolonel puna e atij është zgjidh unë ika, një kafe sun ja dhamë atij se s'patëm vakt, për zotin. Pasha zotin 99% nuk jam në punë, kam ardhur vetëm për atë. Më shumë se të thashë do jem. Hajde të përshëndes dhe të falënderoj shumë...*

***0694134579**: Hajd shëndet.*

141. Në datë **14.04.2021, Shpëtim Cenaj** nga numri celular 0676466593 ka zhvilluar një bisedë me përdoruesin e numrit të telefonit 0694106349, referuar si punonjësi i policisë me emrin ***Ajet Refik Halili.***

***Shpëtimi**: A u lodhe natën?.....*

***0694106349:** Jo ata e kam kry e ke qaty ke.....*

Shpëtimi:** A e di je, **je jet o te kisha pas unë ty atu me bo dy punë, t'kisha pas n'grup dëgjove.

142. I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi **Shpëtim Cenaj** nuk ka dhënë deklarime. Nga këqyrja e aparatit telefonik celular në përdorim të tij, sekuestruar në cilësinë e provës materiale, sipas procesverbalit të këqyrjes me datë 28.06.2022, janë konstatuar një sërë bisedash si më poshtë vijon:

***Zija Sula**: Mirëmëngjesi Shpëtim....02-583-CJ, kjo targë është e një miku im..do vijë tek unë...kur të kaloj Prizrenin do të them unë...po mundë mos të vonohet.....*

***Shpëtimi**: Dakord Z.Drejtor.....*

***Zija Sula**: Shpëtim për pesë minuta është aty, nxirr një njeri aty të lutem, targa, "02159 FB", Të lutem është me këtë targë, Audi i bardhë.....*

***Shpëtimi:** Po...Kaloi pa problem Z.Drejtor.*

Në datë **18.04.2021** ora 11:14 min Zija Sula ka dërguar një sms me tekst kundrejt Shpëtimit, *"...AB549AH" targa, ...**Shpëtim Cenaj:** Dakord.*

Në datë **10.09.2021** Shpëtim Cenaj dhe Zija Sula zhvillojnë përsëri këtë bisedë me interes në rrjetin social ëhatsapp me sms.

***Shpetim Cenaj**: Z.Drejtor Mirëmbrëma. Me shkruan një Orikumit më thotë që është miku juaj nr. Tel0694323908.....*

***Zija Sula:** Një min.....Po miku im është. Ça ka ai?.....*

***Shpëtim Cenaj**; Jo më thotë rreth orës 24:00 do jem në Morinë.....*

***Zija Sula:** Ok shikoje se po përcjell disa njerëz për në Prishtinë me duket.....vetëm për radhën besoj se ka problem,...ndihmoje.....*

***Shpëtim Cenaj**: Dakord Z.Drejtor.*

Në datë datë **06.10.2021** ora 07:41 min Zija Sula kryen këtë bisedë me Shpëtim Cenaj ne aplikacionin ëhatsapp.

***Zija Sula:** Shpetim mirmëngjes, te lutem po vjen nje miku im nga Vlora për në Kosovë*

"AA681FM", dili pak se është aty..Dili pak se është aty……Shpëtim fole?……
Shpëtimi:*Po ja kam dhënë edhe targën Halimit po e pret……*
Zija Sula: *Ok..*
Shpëtimi ora 08:34: *eshte kryer Z.Drejtor.*
Zija Sula:*Ok flm.*

143. Në datë **06.02.2021 Halim Shehu** i ka dërguar sms ne rrjetin social whatsapp **Shpëtim Cenajt** me tekst : *AA480TS, AA909YG, janë afër Morinës…Këto targa janë në dalje…..Porosi e shef Arbenit….Janë koleget tanë…".*

144. Në datë **10.11.2021** *Shkumbin G Muja* kryen përsëri këtë bisedë me Shpëtimin ne rrjetin social Ëhtacup:*"përshëndetje daje si je a je mirë? Shpëtimi: Mire si je? Shkumbin G Muja: Mire faleminderit, një shok ka me udhtu për Tiran nesër po i ka skadu ID karta a mund te kalojmë patent shofer? Shpetim Cenaj: Po."*

145. Në datë **<u>20.12.2020</u> Shpëtim Cenaj**, në rrjetin social whatsapp i është dërguar kjo sms nga shtetasi *Shkumbin G Muja* me tekst: *"…A mund të shikojmë në sistem…..sa a kam ndales vetëm në Danimarkë apo ter Evropën.* ***Shpetim Cenaj:*** *Sot jam pushim ma dergo foton ta shoh nesër a jam te puna.* ***Shkumbin G Muja****: Ne rregull faleminderit shum..".* Në datë **21.12.2021** Shpëtim Cenaj ka dërguar sms kundrejt Shkumbin G Mujës me tekst:"….*Mirëmëngjesi. sipas shënimeve në sistemin tonë ke ndales dy vite nga data 03.07.2020 pasi je deportuar. Shënimi bëhet në bazë të dokumenteve të ardhura nga Danimarka. Për vendet e tjera të B.E-së varet nga sistemi që kanë mes shteteve të BE-së…****Shkumbin G Muja****: Në rregull faleminderit shumë dajë.".*

146. **Në datë <u>20.04.2021</u>, Fatri Iseberi** nga numri celular 0694115447 ka zhvilluar këtë bisedë me një shtetas i cili posedon numrin celular 0685782217 si më poshtë vijon:
Fatri Iseberi*: He Lad.*
0685782217: A mos je i lire me pi një kafe se kam pak pune?
Fatri Iseberi*: Vallahi e leme mbas dite, po fol thuj ca ke?*
0685782217: E kam pak kshu unë a ban me ta thane ne telefon?
Fatri Iseberi*: Po fol mor burrë fol*
0685782217: Kam nje kamioncine, du me e kalu ne dogane qysh mundem me te?
Fatri Iseberi*: Me fol me doganierin kush asht me i baa to letrat edhe e Kalojme pa merak*
0685782217: Du me e kalu tek te Kosovës i ka te marume letrat..
Fatri Iseberi*: Ani mor burrë se folim me dike aty, s'asht problem, por jo sot nesër…*
0685782217: Apo shkon…..<u>po ti jap 10 euro</u>……
Fatri Iseberi*: Jo s'ke pune me mu, ke pune me doganën foli me dike nesër unë aty edhe ta kryj….."*

147. Në komunikimet e zhvilluara gjatë muajit mars 2021, rezulton se mes punonjësve të policisë **Fatri Iseberi dhe Halim Shehu** zhvillohen edhe një serë bisedash lidhur me regjistrimin e një sipërfaqe toke e cila, sipas komunikimeve të tyre, nuk përputhet me atë çfarë është deklaruar në letra. Në këto biseda rezultojnë komunikime që tregojnë se ndërmjetës ka hyrë Fatri Iseberi, i cili ka bërë lidhjen midis Halimit me një punonjës të administratës të cilin e

thërrasin "Inxhinier" dhe disponon numrin cel 0694603965. Në komunikimet mes këtyre tre shtetasve lidhur me këtë çështje, janë veçuar bisedat e zhvilluara në datat 24 dhe 25 mars 2021, si më poshtë:

148. Në datë **11.03.2021**, ora 12:59:01 min **Halim Shehu** nga numri cel *068531000,* kryen këtë bisedë me Fatri Iseberin në numrin cel *0694115447,* gjatë së cilës flitet lidhur me cështjen e regjistrimit të pronës në hipotekë. Biseda në formë të përmbledhur është si më poshtë vijon:

068531000: *Ë a të zu a?*
0694115447: *Jo te shpia se mbrina se erdha në këmbë..*
068531000: ***Ska problem jam tu ja shkrujt një mesazh atij njeriut tënd. Me i thënë po mujte krejt fute oborrin.***
0694115447: *Po bre thuj.*
0688531000: *Ok.*
0694115447: *Ashtu thuj që ku ë, qoshe më qoshe deri ke dera.*
0688531000: *Po po brenda oborrit..*
0694115447: *Ndac vij thuj e të takoj ndac coji mesazhin..*
0688531000: *Spo di qysh e qysh e ka më mirë, Jo mo sësht ndonjë gjë e madhe rejt ta bëjë.*
0694115447:Fute krejt e veç kallëzomë sa shtu thuj..
0688531000: *Qysh sa ashtu?*
0694115447: ***Do me pagu ndonjë send.***
0688531000: *Jo s'ka lidhje jo.*
0694115447: *Po thuj fute krejt veç që kaq bëj. Bëne krejt thuj.*

149. Më datë **11.03.2021**, ora 11:00:06 min **Halim Shehu** nga numri cel. 0688531000 ka zhvilluar këtë bisedë me numrin cel 0684074740, i cili interesohet për një të afërmin e tij për të kaluar kufirin pa dokumente identifikimi, për të cilin flet me Halimin ku ky i fundit i thotë të kalojë mbas dite në turnin e tij. Biseda në formë të përmbledhur është si më poshtë vijon:

0684074740: *Me zotin Halim Shehu po flas?*
0688531000: *Po.*
0684074740: *Si je a je mirë?*
0688531000: *po..*
0684074740: *Nga shtëpia si ke qenë?*
0688531000: *Mirë vëlla...*
0684074740: *Petriti jam Petriti. Ca bene a je mirë?*
0688531000: *O Tit si je mo babush?.*
0684074740: *Si të kam a je mirë?*
0688531000: *I ke ndërru këta telefona pa lidhje.*
0684074740: *Unë me një numër të punës, Ckemi? Si i ke pas hallet?*
0688531000: *Po është numri jot ky?Kalojmë kështu ankesa të vogla?*
0684074740:E desha me të pyet dicka....
068531000:Fol Babush..

0684074740:E një shok ka me kalu për Kosovë por tha më ka skadu pasaporta, a mund të kalojë dot?.
0688531000: *Kur* ***do me shku kismet?***
0684074740: *Po do me shku ka një punë e me u kthy prapë..*
0688531000*: Kur?*
0684074740: *Sot.*
0688531000: *Sot?*
0684074740*:* ***Po i ka skadu atij po di gjë unë kalon a jo? Me dit para se të niset mos me shku kot.***
0688531000*:* ***Kur niset ai në darkë, jam vetë unë mbas orës 7 (shtatë) të darkës****. Apo me hik më herët ai?*
0684074740: A mund kalon, a bëhet?
0688531000:Jo jo si ligj jo. Po marrim dikë në telefon e ndihmon ska lidhje.
0684074740*: Epo mirë, pra kështu.....*
0688531000: *Ca ke bërë ti?*
0684074740: *Vec si ligj donte me dit. Hic vallahi ja në punë...*
0688531000: *A mos je fejuar or ti?*
0684074740: *Jo bre sgjeta ndonjë gocë të mirë, ska të mira ka mbaru. Një të hajrit do me marrë ndejtëm de ndejtëm.....(bisedë pa interes në vijim).*

150. Më datë **12.03.2021** ora 19:09:07 min, **Halim Shehu** tek numri cel 0688531000 është telefonuar nga numri 0682426693, i cili i kërkon verifikimin e të dhënave në sistemin TIMS për të verifikuar nëse i është hequr ekspulsi që ka patur në Hollandë apo jo. Biseda në formë të përmbledhur rezulton si më poshtë:
0688531000 (H.Shehu): *O dajë Kamber ë se kam kën në punë e krejt kam haru. Ckena?*
0682426693*: Hic ca bëne si të kam?.....*
0688531000: *Si jeni a jeni mirë?.....*
0682426693:Thashë mbasi je te shpia po flas unë. Thashë ty për me pa atë expulsin.<u>Mirëpo ky tani ka pague më nji, me</u> një fjalë i ka bërë letrat që ja ka heq fjala e atij. Një në Fier. E tha vetëm me pa i është heq a si është heq. Ai i ka heq prej sistemit..
0688531000*: Ska pas gjë hic ky paq ka qenë ca me i heq.*
0682426693: *A i ka heq expulsin a jo që e ka pas në Hollandë..*
0688531000: *Sna ka ka dhënë asnjë send në paq na i ka dhënë*
0682426693: *Po po or ti se ti më the e ka ok. Ma dhe ok tamam se e ka the.*
0688531000:Jo jo të kam thënë ok është i pastë, por jo ok e ka..
0682426693: *Thashë se e ka e fjeta mendjen.*
0688531000: *Jo asnjë send. Paq aty sistemi jonë e jep paq. Që ka gjë aty se e dimë në gjë tjetër*
0682426693: *Jo jo e di më mirë, se e jep a se jep se e di ti më mirë, unë sdi nga ajo punë.*
0688531000*: Asnjë gjë hiq paq e jep..*
0682426693: Ne Hollandë.

0688531000: *Asn jë gjë hic, shtettin je tu ma kallzu ti se atje sjep asnjë send, sikur të futdokumentin tem..*
0682426693*: A mirë.*
151. Më datë **15.03.2021** ora 13:10:36 min Fatri Iseberi dhe Halim Shehu zhvillojnë këtë bisedë me njëri-tjetrin e cila bën fjalë për ndalimin e një shtetasi me makinë të vjedhur, ku midis të tjerash Halimi i thotë Fatriut, "***Ti di ca me fol".***
152. Në datë **24.03.2021**, ora 15:31 min, zhvillohet një bisedë nëpërmjet numrit të telefonit 0684371744, numër i cili nga verifikimi nëpërmjet kompanisë *One-Telecomunication* rezulton se është i regjistruar në emër të shtetasit Sadik Shehu i datëlindjes 10.10.1978, vëllai i Halim Shehut. Biseda që zhvillohet është si më poshtë:
0685331000 (H.Shehu): *Olti mos ta tha emrin.*
0684371744 (S.Shehu): *Se mbaj mend vallahi.*
0685331000: *Hajt se po i shkruaj hajt. Ca të tha konkretisht? Saktësisht?*
0684371744: *Hajd knej tha dy formalitete tha. Po se ke urgjence ndac hajde neser tha*
0685331000: *Mirë e rregullojmë hajt..*
0684371744:*..a ban punë nesër.....*
0685331000*: Po po hajt.*
Po në datë **24.03.2021** ora 15:38 min **Halim Shehu** nga numri cel 0685331000, zhvillon këtë bisedë me shtetasin përdorues të numrit cel 0696608100 të cilin e thërret inxhiner.
0685331000 (H.Shehu): *O inxhiner hë mo si kalove?*
0696608100: *mirë ca bone?*
0685331000: *Halim Shehi jam vëllai i Sadikit, Ca bone ti? Si kalove se më tha vëllai e ke marrë në telefon. A* ***duhet me sjëllë ndonjë gjë nesër apo vetëm me u paraqit?***
0696608100*: Duhet me ardhë këtu me të tregu se ca me bo?.....*
0685331000: *Ok faleminderit hajt.*
153. Po në datë **24.03.2021** ora 15:29 min, Halim Shehu, nga numri cel 0685331000 zhvillon këtë bisedë me Fatri Iseberin në numrin 0684371744:
0684371744 (F.Iseberi)*: Alo.*
0685331000 *(H.Shehu): He Fatri.*
0684371744:Mori ai djali i legalizimeve.
0685331000: *Po.*
0684371744: *Ai Bushka, tha po vjen tha ca formalitete të vogla, i thashë epo mir, Tha ku je? Larg je?Larg jam. Tha munesh me ardhë dhe nesër tha. Thashë qysh ta kesh më mirë.*
0685331000: *Po.*
0684371744: *A tha ndac nesër qysh të duash.*
0685331000 *:Hajt pra shifna nesër.*
0684371744*: edhe mendova se di po* ***përgatitesh ndonjë sen dhe thashë*** *spo di a me shku a po presim?*
0685331000: *Shkojme bashkë nesër*

***0684371744**: Nesër po tha po shkojmë bashkë nesër. E lëmë kështu, deri në katër e gjysëm jam atje tha hajde.*
***0685331000:** Kush qysh ta tha emrin?*
***0684371744:** Sadiki qysh ashuu?.....*
0685331000:Bre ermin qysh ta tha?.....
***0684371744:** Gusha bre burrë ai djali i Aurorës.*
***0685331000**: Nuk a ai o vllau im, ashtë tjetër kush, prandaj thashë ta tha emrin apo ja fute kot jam filani...*
***0684371744:** Ma dha emrin po ja harrova, Gushka tu menu qe ai djali që kena taku..*
***0685331000:** Jo pra sa ai robq.....*
0684371744: *Prit ta shikoj si e ka emrin e ta kallëzoj*

154. Biseda e datës **25.03.2021** ora 14:09 min Halim Shehu zhvillon këtë bisedë me përdoruesin e numrit cel 0694603965, regjistruar në emër të shtetasit Saimir Onuzi i datëlindjes 21.08.1974.***Halim Shehu:** O Inxhiner?*
***0694603965**: Njatjeta.*
***Halim Shehu:** At e ke tek dera veç takoje dy minuta.*
***0694603965:** Te shoh se jam ne një sportel. Çoja ta përcjelli.*
Halim Shehu**: **E ke te dera se pat ni...nji sen me vete
***0694603965:** Çojë çoje ta percjelli se jam nalt.....*

155. Po në datë **25.03.2021** ora 11:05 min, Halim Shehu nga numri cel 0685331000 zhvillon këtë bisedë me shtetasin përdorues të numrit cel 0699608100 të cilin e thërret inxhinier e është në vazhdimësi të bisedave që ka kryer edhe me Fatri Iseberin dhe bëhet fjalë për regjistrimin e një prone në hipotekë, e cila është përtej sipërfaqes reale në terren.
***0685331000:** O inxhiner si kalove?*
***0699608100:** Mirë*
***0685331000:** A të vijë ai vëllai i Sadikit që tash? A je i lirë a je tek zyra?*
***0699608100:** tek zyra jam.*
***0685331000:** Atje në kat të tretë ëëë?*
***0699608100:** Jo jo tek hipoteka mbrapa Bashkisë.*
***0685331000:** Ok hajde të përshëndes.*
***0684371744**: Hajt të sqaroj njëherë me të se ti kujton se..*

156. Në datë **28.04.2021** midis **Halim Sheshu** dhe një shtetasi me numrin celular 0682039715, identifikuar si shtetasi Besim Gjoka i datëlindjes 01.01.1975, është zhvilluar një komunikim gjatë të cilit bisedojnë për kalimin e një shtetasi lidhje e bashkëbiseduesit, i cili vjen nga Amerika, për këtë kërkon ndihmën e Halimit për ta kaluar në kufi. Lënë takim ditën e nesërme që Halimi është në punë. Biseda zhvillohet si më poshtë:
0682039715:Mire mire, o Halim do të shkoj, a je në punë, a je tek dogana?
***0688531000:** Nesër jam o shok..*
***0682039715:** Po pra nesër do të shkoj në Kosovë unë dhe kthehem nga ora 10 desha të të takoj pak.*

0688531000: *Pa merak hic.*
0682039715*: A je aty?*
0688531000: *Kurdo që të vish që të kthehesh vec ndalo ne kufi atje jam gjithë ditën..*
0682039715: *Ok* ***mund të jëm me një, me vjen një cun xhaje, e njeh, ti duhet ta njohësh, me vjën një cun xhaje prej Amerike e ke parasysh e thashë të të takoj pak.***
0688531000:Me këto problemet ëë. Ok s'është problem vetëm kur të afrohesh afër më thuaj.
0682039715: *Ok ok se ndalem aty dhe vij vetë unë e të them. Ose ca ore e merr shërbimin ti se vjen në orën 08:30 me vjen mua ai, nga ora 07:30 mund të kaloj unë aty me të taku kur të iki andej.*
0688531000: *Po unë në orën tetë e marr, ne orën 07:30 dal prej shpije e takohena diku rrugës ne ku ta mendojmë.*
0682039715: *Ok hajt se të bëj një telefon unë po..*
0688531000: *Hajt Sandri nga është a knej aa?*
0682039715: *E jo jo andej andej ee*
0688531000*: Hajt babush te përshëndes mirë ardhsh.*

157. **Gjatë muajit maj 2021**, janë regjistruar disa biseda të punonjësit të policisë **Halim Shehu** me shtetas të tjerë, në të cilat bisedohet për kalimin e disa mallrave për në Shqipëri. Më konkretisht në datë **01.05.2021** ora 21:37 min përdoruesi i numrit cel 0685145111, i cili në bisedë thirret me emrin Xhevat, telefonon punonjësin e policisë Halim Shehu në numrin celular 0688531000, ku midis të tjerash bisedojnë edhe për kalimin e disa mallrave, tapeta në doganë.
Halimi: *Paska postu një diçka ai njeri në Anglisht se vuna re, veç mu kujtua ajo puna e asaj gruas e lekve të vet. A ka komuniku më ajo gruaja a jo?*
0685145111*: Jo bre ishte mashtrues një herë e kam marrë unë dy herë mbrapa me ka marrë ajo,..pa lidhje bla, bla, bla, po mirë ja ke bërë ishte mashtruese tipike.*
Halimi: *E nuk kena ca me përzi ne unë, veç jam në Tiranë, ja kish ble ku të jetë..*
0685145111: *Ik mo posi se 600 euro ishin ato bre..*
Halimi: *E interesant po dhe ky ufo bre burrë hajde pi prish pa lidhje..*
0685145111:Po do tapeta mi ka çu ai, si do të gomës, ai Besimi tha fol me Halimin dhe qe kaq kile janë, prej atyre të gomës tha se na e merr?.
Halimi: prej ku e ku?
0685145111: Me i qit në Kosovë bre
Halimi: E ktej për andej?
0685145111: Po.
Halimi: A ja vlejke a kish sasi a ca?
0685145111: Se di vallai, s'janë shumë bre s'ishin shumë më duket. Qe ti çoj me foto..
Halimi: Çfarë makine?.
0685145111: *Unë hem i kam shkrue hem, mi pru me foto ato tapetat, janë tapeta gome.*
Halimi: *Po po çfarë sasie a ban makina jem a ca?.*
0685145111*: Jo or ti duhet fugon.*
Halimi: *Fugon ëëë?.....*

0685145111: *E hajt çomi ca të ketë veç çomi një herë hajt.....*
0685145111: *Po, po.*
Po në datë **01.05.2021** ora 13:04 min, Halim Shehu zhvillon këtë bisede me shtetasin që përdor numrin e telefonit +38349550333, referuar në biseda si *Vllaznim Maloku.* Midis tyre zhvillohet biseda si më poshtë:
38349550333:Mirmengjesi Komandant. Vllaznim Maloki shoku i Aurelit. Ça bone a u lodhe?
Halimi: *Po vëlla më thuaj.*
38349550333: *Këtu në kufi në pjesën e Kosovës knejna, jam me targa Shqiptare.*
Halimi: *Po.*
38349550333: *A je aty në punë?*
Halimi: *Unë te pika jam. A je në Kosovë tu ardh këtej a ku je?*
38349550333: Po në Kosovë ka vij andej a të kaloj majtas e të vij atje me targa Shqiptare.
Halimi: Hajde nga Kosova ti babush ne krah te kundërt dhe kur te vish te dal te pres
38349550333*: Dhe një minute jam atje.*
158. Nga këqyrja e sistemit TIMS të informacionit, administruar me procesverbalin e datës 13.01.2021, me të dhënat e shtetasit Vllaznim Maloku rezulton se ky shtetas nuk ka hyrje të regjistruara në sistemin TIMS për datën **01.05.2021** ora 06:54 min, kohë kur ka kryer bisedën si më sipër, por pas kësaj datë ka një dalje nga Republika e Shqipërisë në datë 03.05.2021 nga pika kufitare Qafë-Prush me automjetin me targa, "AA902NJ", i cili nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS rubrika *E-Gjoba* për këtë periudhë kohore rezulton të ketë qenë i regjistruar në emër të shtetasit Vllaznim Maloku shtetas kosovar.
159. Në datë **02.05.2021** ora 08:33 min, **Xhevati** përdorues i numrit cel 0685145111 ka zhvilluar këtë bisedë me interes me **Halim Shehun** në numrin cel 0688531000, në vijim të **bisedës për kalimin e mallrave tapeta në doganë si dhe flitet edhe për llojin e mallrave dhe pagesën që mund të kërkohet për to.** Biseda është si më poshtë vijon:
0685145111: *O Halim.*
0688531000: *O Xhevat a fjete?*
0685145111: *Boll e po ju?*
0688531000:Cpunë ka ai me u marrë me mallin e Besit ai joti?
0685145111: *Po janë këto targat e privatit që i merr ai joti psh, mund të ketë marrë shumë edhe andej ku di unë, e do me i marrë që tash dihet sesi e ka hapur sallonin atje të madhin, e do me u marrë shet për vete.*
0688531000: *Po shtaj, shtaj pazarin, kush e ban a Besi apo ky rrop q....gabeli?..*
0685145111: *Po ik mo c'pune ka ai, Besi përderisa asht tu marrë Besi, Besi duhet me ia duhet me i thanë sa për copë, se ke interes ti se unë nuk të njoh, s'kane kalu, skena kalu ndonjëherë kesi sendesh. Sa jep për copë e njatjeta në ta merr mendja, ne s'ta martë hajt ngjatjeta....*
0688531000: *Po unë s'jam tu kuptu gjit janë mo Xhevat ato, se si tapeta e kam idenë unë qe kështu.*
0685145111: *Po qe mo burrë që kur erdhën, a s'mund të vish me ti kallxu se këtu tek puna i kam..*

0688531000: *eee po çfarë gjatësie janë ato?*
0685145111: *Po i kam sipas llojeve, janë 160 x 220 me 2.5 duhet të jenë 180 x 280 qeshtu bre*
0688531000: *Ee a ka dhe të mdhej e?*
0685145111: *Po bre të madhej janë 180x280 po janë shumë të lehtë e janë gjithë ajo kapo 280 kile bre.*
0688531000: *Po pse veç një kapo është?*
0685145111: *Po s'po di ai tha 280 kg janë tha..*
0688531000: *O Xhevat po ai numrin duhet me e dit se s'është Ufo.....*
0685145111: *Po normal që e di numrin or ti nuk ka nevojë për kile thoj se kile nuk e....mos mi përmend kilet se kilet me (fjale që nuk kuptohet)e mbushi bagazhin. Ai duhet me thanë sa lekë copa?. Sa lekë në copë e hajt ngjatjeta. Sa ke interes në të ngjatjeta nuk bëhet llaf...*
0688531000: ***Po kishin lënë ato çunat unë, vec me ju marrë ndonjë lek e hic mos me u marrë me të...***
0685145111: *Po bre, po bre burrë .....*
0688531000:Janë pare të lehtë ato i kalojnë me njëherë. Këto e puna një i vogël, një i madh, një çfarë vlere me i vënë çfarë.
0685145111: *Mesataren, mesataren i madh i vogël, vetëm thuj për numur, plus minus i bi mjedisit se sa për numër.*
0688531000: *Veç me i thanë sa copë janë e qe kaq.*
0685145111: *Po bre sa copë janë, sa, sa?*
0688531000: *Qe kjo forme kjo model e?*
0685145111: *Qe ajo forme ee, po deshe me ta cu, qe ajo forme, ejanë shumë te lehta ato.*
0688531000: *E kuptoj 160 the më i madhi..*
0685145111: *160 me 220 ose 2 me 2e gjys ose 2 me 3, 180x280 qeshtu them unë...*
0688531000: *180/280 ee fugoni dmth i merr ee? Fugoni i merr?*
0685145111: *Po qysh.*
0688531000: *Me dit sa është numri e masandaj e llogarit se sa?*
0685145111: *Po bre si rrugë, si fugon e si send*
0688531000: *E më ka cu mu me foto skrin kështu të Odit, po unë turp me e marrë, skam lidhje fare..*
0685145111: *Jo mo duhet me i thanë skam punë me Odin, mos na përzi me ato sene.*
0688531000: *Jo mo s'jam tu i thanë, vec jam tu i thanë mirëmëngjesi, vetëm më trego sa copë janë.* ***0685145111:*** *Po ore, me Odin mos më ngatërro thuaj mu, skam punë me Odin o burrë thuaj. A janë për Odin a për tuj, po janë për Odin skam punë, unë me ty kam punë.*
0688531000: *Jo ore ska lidhje. Ai do të thotë që duhet me ashku me marrë tek Odi, se këto me monstra s'ka. Ai gjit ska fol për të, të shkoj unë tek Odi pa lidhje hic.*
0685145111: *Të presin në besë, për zotin e madh. Jo ore se ka kohë që Odi dhe me mua me re kështu se jena taku..*
0688531000: *Jo jo se është rob q.... Ka kalu një ditë në doganë aty me nusen e vet e tu ma qit dorën e..Unë as nuk e kisha mendjen atry. Kur e kqyra mbrapa ja bana, ja ngrejta dorën, i*

thashë atij policie hajt mos e nal e iki. Ai tap, tap borisë. Thashë ai rob q... ka kalu për rrethi e ska folë fare.
0685145111: *Po bre po janë interesaxhinj rob...varja bre ec ci ... nënën e me pa mare ndonjë send kështu më pas.*
0688531000: *Jam tu i thanë Besit, o Bes veç kallzomë.*
0685145111: *Diskutoje vetë thuaj sa kini interes ju, e unë a marr mendja mirë, s'ma martë mendja qe kaq. Nuk kemi kalu në kësi lloji që me dit as as një lloj, ju e dini interesin tuaj. E dinë shumë mirë interesin ata po leje.*
0688531000: *Absolutisht i them unë Besit diskutoje vetë me Otin edhe më trego te lutëm sa copë janë?*
0685145111: *Sa copë janë edhe sa pagu ti?*
0688531000: *edhe me i tanë atij sa pagun ee?*
0685145111: *Po or ti sa paguni për copë?*
0688531000:Sa copë janë e sa paguni, sa jeni të gatshëm paguni për cope?
0685145111: *Po leje peshe e kg thuaj, s'ka lidhje*
0688531000: *Mirë e ke ti sa copë janë?*
0685145111:Or ti sa paguani për copë thuaj, njatjeta. Se ku merren, qysh merren?.
0688531000: Ta diskutojmë vetë mirë e ke ti.
0685145111: *Po qysh ta diskutojnë ndër vedi ata, S'ke zor..*
0688531000: *Ok hajt.*
0685145111: *E kane interesin të vet ata po leje.*
0688531000: *As bëhet fjalë na u shter një herë, njëherë na u ul çmimi mbasandaj tha lije e lashë krejt. Ai ishte me prit me pa durim veç.....Na e futi 7-8 mijë euro pisi i poshtër.*
0685145111: Po bre hera e parë ke bet, ai vet na pat thënë qi kaq..
0688531000: *Krejt investimi për një vit. Ik ore se janë monstra. Na a ardh kaq ditë ka lozi do me u mar me keto..*
0685145111: *Po bre a je hala në Tiranë.....(bisedë pa interes ne vijim).*
Midis tyre vijon komunikimi edhe në ditët në vijim. Konkretisht në datë **04.05.2021** ora 13:54 min Halim Shehu komunikon me numrin 0685145111, regjistruar në emër të shtetasit Ergys Muja, por që përdoret nga shtetasi me emrin Xhevat, bisendë në të cilën komunikojnë për kalimin në kufi te disa mallrave, si më poshtë:
Halimi: Ai *rrob ....o otit ko 4 unë ja futa 4.5 e di.*
0685145111: *Po pse si the 5 te thashe me i thane.*
Halimi:Degjo mik edhe tash thote, unë fola me atë klientin, klienti ka me ashtu 200 une dhe 200 nuk ban, po ashtu fol edhe nje here me te. Une qi tash po ja jap Otit i them direkt nuk mundem..
0685145111:Ore ti se janë tapeta nuk janë tu kalu i thuaj pak. Paguaje doganën i thuaj te shikojmë sa te bëjnë.
Halimi:Jo jo jam tu pa mos me ja kry si pune*.....(vijon biseda).*

160. Më tej, në datë **03.05.2021**, mes shtetasve Halim Shehu dhe Fatri Iseberi është zhvilluar biseda si vijon: ***0684371744 (F.Iseberi):*** *E Halim?*
0688531000 (H.Shehu): *Ca i ke thënë o Sadik Milazimit?* ***Te kam dhënë lek e mi ke kthy pse përzin ashtu?***
0684371744: *Kurrgjë ja ktheva, e ai më thotë mua mashtrues.*
0688531000: *Eeee.*
0684371744: ***Ke mar leke e smë ke kallzu, se kena pa me i nda për gjysëm...***
0688531000: *Qysh?*
0684371744: *Kështu se përzi gjë. Qe kaq i kishe pas shkru ti i ka marrë smi ka kthy.*
0688531000: *Po shumë mirë i ke marë ti gjit i ke dhene ti?*
0684371744: *Po tash ja ktheva i kam thënë qysh atë ditë, ja ktheva....të liroj prej pune..*
0688531000: *Qysh mo zotni për punë unë i thashë i kam dhënë 450 paund e 50 euro..*
0684371744: *Po po unë i thashë ja ktheva se unë i thashë ja dhashë Halimit...*
0688531000: *Po pse rri cera cera me të. Pse vazhdon prapë kështu ti or çfarë halli ke?*
0684371744: *Asnjë hall mo..*
0688531000: *Pse mor s'bëhesh burrë, pse rri tu lyo le nëpër njerëz or ti?*
161. Më datë **05.05.2021** ora 13:09 Halim Shehu komunikon me një shtetas me numrin cel 0685452973, i cili përdoret nga shtetasi Andrin Shehu i datëlindjes 25.06.1976, banues në Kukës, dhe zhvillon këtë bisede:
Halimi: O Din.....qe te kabina se kam hyre vete se ka shume pune, hajde këtu dhe pyet ku është Halimi, te çoj me kry qat punën tende hajt..
0685452973: *Ok*
162. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rezulton se shtetasi Andrin Shehu në datë **05.05.2021** kur është kryer biseda me punonjësin Halim Shehu nuk ka të regjistruara në sistemin TIMS hyrje dalje ne kufi. Në bisedat më sipër rezulton se **Halim Shehu** është duke biseduar me këtë shtetas i cili ka hyrë ndërmjetës për favorizimin e një shtetasi të quajtur Oti i cili kërkon të kalojë mall, konkretisht tapeta kontrabandë. Rezulton nga bisedat se për këtë nuk kanë rënë dakord sa i përket pagesave që referohen në biseda me Halimin dhe për këtë arsye ky i fundit thotë se nuk ja merr përsipër si punë. Personi bashkëbisedues quhet Xhevat dhe në vijim në datë **06.05.2021** ora 11:19 min komunikojnë përsëri. Biseda është si më poshtë:
Halimi:Po shtoj pazarin, kush e ben ai Besi apo ky r... ky gabeli?
Xhevati: *Po ik c'pune ka Besi, Besi* ***duhet me i thane sa cope, se ke interes ti se unë nuk te njoh, skena kalu ndonjëherë kësi sendesh.*** *Sa jep për copë njatjeta, ne ta merr mendja, ne s'ta merr hajt njatjeta.....(biseda vijon).*
163. Në datë **06.05.2021** ora 05:13 min Halim Shehu zhvillon përsëri disa biseda me shtetasin Besim Gjoka i cili përdor numrin e telefonit 0682039715, si vijon:
0682039715 (B.Gjoka): *Mirëmëngjesi.*
0688531000 (H.Shehu): *Mirëmëngjesi....*
0682039715: *O Bush se jam me makinë, hyna në Milot..*
0688531000: *E ne Milot nga ora gjashtë du këtu e ngreji pak.*

0682039715: *Po, po hajt, 6-6 e 10 qeshtu jam aty.*
0688531000: *Nuk du m kalu 6:15 jepi.*
0682039715: *Ok ok hajt.*
0682039715: *Hë Halim.*
0688531000: *E babush.*
0682039715: *Në uzinë jam.*
0688531000:Ani punë shtatë minutash vjen besoj.
0682039715**Ora 06:11:25** min zhvillojnë përsëri këtë bisedë:
: Po bre.
0688531000:Qatje ku jam unë në këmbë, atje vjen direkt ti dhe vetëm dokumentin tënd, e ato të tjerët, ini tu shku me përcjellë juve, vetëm një është prej atyre tu shku në Angli qekaq.
0682039715: *Ok, ok hajt.*

164. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje-dalje rezulton se shtetasi Besim Gjoka nuk është regjistruar në sistemin TIMS të informacionit në dalje të R.Sh as nga pala shqiptare dhe as nga pala kosovare. Po në të njëjtën ditë figuron i regjistruar në hyrje të R.Sh-së datë 06.05.2021 ora 09:21 min me automjetin me targa,"AA467LY". Nga verifikimi i mëtejshme në rubrikën raporte dhe statistika të policisë kufitare dhe migracionit rezulton se në dalje të R.Sh-së si pasagjer në të njëjtin automjet nuk është regjistruar asnjë shtetas, ndërkohë që në bisedat e zhvilluara mes tij dhe Halim Shehut, si më sipër, referohet se ka pasur me vete, pra pasagjerë, persona të tjerë, të cilët sipas bisedave të tyre, kanë si destinacion shtetin anglez.
Sapo arrijnë në doganën e Morinës, Besim Gjoka zhvillon përsëri këtë bisedë me Halim Shehun:
0682039715 (B.Gjoka): *erdha qe.*
0688531000 (H.Shehu): *O babush..*
0682039715: *Erdha unë, ku je ku je?. Ee te shof te shof.*
0688531000: *Ec drejt qaty ku ndalem unë qaty me ardh.....*
0682039715: *Ok hajt.*
Në orën 06:13:48 min zhvillojnë përsëri këtë bisedë:
0682039715: *Po.*
0688531000: *O Bes.*
0682039715: *Eee*
0688531000: *A do të....deri kur ikin 11a, deri në 11 duhet të rrish në aeroport.*
0682039715: *Jo në orën 09:30 se kanë me u cue.*
0688531000: *deri atëherë dhe ti atje deri në orën 9 a?*
0682039715: *Them se po....po do i pres këto dëri atëhere..*
0688531000: Eee po hajt se shihena në aeroprt pra, ti mos u vono me këta se e kryej unë punën me këta, vec të takohena atje..
0682039715: *Pse do vish në aeroport ti?*
0688531000: *Po do të vi të marr një shok të Francës unë, skam punë me ty po vec takohena aty.*
0682039715: *Ok hajt.*

0688531000:Ajt babuc. Këto vetëm të vij ti jap dorën unë tek kabina dhe ik në punën tënde ti dhe takohena atje në aeroport.
0682039715:Emo se ti lëshoj në dorë unë mos e ki merak..
0688531000: Jo jo se është kabinë e huaj atje skena lidhje, ti veç përshëndetje e ik, takohena atje pastaj.....
0682039715: Ok hajt.

165. Nga verifikimi dhe këqyrja ne sistemin TIMS të informacionit, rubrika hyrje-dalje, rezulton se shtetasi Besim Gjoka nuk është regjistruar në sistemin TIMS të informacionit në dalje të R.Sh as nga pala shqiptare dhe as nga pala kosovare në dalje ndërkohë që po në të njëjtën ditë figuron i regjistruar në hyrje të R.Sh-së, me datë 06.05.2021 ora 09:21 min me automjetin me targa, "AA467LY". Nga verifikimi i mëtejshëm në rubrikën raporte dhe statistika të policisë kufitare dhe migracionit rezulton se në dalje të R.Sh-së, si pasagjer në të njëjtin automjet nuk është regjistruar asnjë shtetas. Po nga verifikimi në sistemin TIMS, administruar nëpërmjet procesverbalit për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave, rezulton se shtetasi Halim Shehu nuk është regjistruar as në hyrje dhe as në dalje të R.Sh-së në datë 06.05.2021, ndërkohë në bisedën e zhvilluar me shtetasin Besim Gjoka ata komunikojnë për tu takuar në aeroportin e Prishtinës.

166. Gjatë hetimit është thirrur për tu pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi Besim Sait Gjoka, por nga procesverbali i përpiluar nga punonjësit e policisë thuhet se nuk është gjendur në banesë.

167. Më datë **13.05.2021**, ora 08:37 min **Fatri Iseberi** nga numri cel 068 51 82 004 telefonohet nga një shtetas i cili ka në përdorim numrin 0682647291, regjistruar në emër të shtetasit Hysni Hamit Klosi i datëlindjes 27.09.1961, banues në Urake -Burrel, dhe zhvillojnë këtë bisedë: ***068 51 82 004 (F.Iseberi):*** *Mengjes..*
0682647291: *Mëngjes si të kanë ec punët.....**ndëgjo a mund të takoj nesër në orën 5 në doganë?***
068 51 82 004: *Mbasdite aa?*
068 26 47 291: *Jo në 5 të mëngjesit*
068 51 82 004: ***Jo vallai se jam pushim, veç me ardhë kastile.***
068 26 47 291:Kastile e veç do na kalosh matanë edhe në gjashtë e gjysëm duhet të jenë atje.
068 51 82 004:A s'bën me shku një ditë më para?
068 26 47 291: *Jo pashë zotin se kemi festën....jo jo sonte n pesë të mëngjesit sa me kalu matanë e atëherë.*
068 51 82 004:Hajd kismet se do ta bëjmë të mundur.
068 26 47 291: ***Hajd se do takohemi dhe ashtu...kur të takoj.,,***
068 51 82 004: *Jo se në pesë të mëngjesit çohem vetë . Ciao, ciao.*

* * *

168. Në datë **11.05.2021** rreth orës 22.00 shërbimet e policisë së Komisariatit të Policisë Kukës, gjatë kontrollit rutinë kanë ndaluar automjetin me targa "AB954BE" "Fiat-Dobro" në përdorim nga shtetasi **Altin Rushit Laçi** dhe kanë kryer kontroll. Nga kontrolli ka rezultuar se brenda në fugon gjendeshin 24 (*njëzetë e katër*) copë goma automjetesh, të cilat ishin pa fature

tatimore. Për ngjarjen janë kryer veprimet hetimore nga D.V.P Kukës dhe sipas informacionit të marrë rezulton se janë referuar materialet në ngarkim të shtetasit Altin Rushit Laçi për veprën penale "*Tregtimi dhe transportimi i mallrave qe janë kontrabandë*", parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal. Rezulton nga përgjimi i komunikimeve telefonike se gjatë ndalimit nga policia shtetasi Altin Laçi ka komunikuar në telefon me shtetasin Robert Saraçi, duke e vënë në dijeni se e ka ndaluar policia dhe duhet të vijë të sqarojë problemin duke deklaruar se i ka marrë tek personi në Bicaj. Roberti i thotë që do vijë ta sqaroje vetë këtë punë por e porosit që mos të deklarojë versionin e vërtetë të ngjarjes, duke komunikuar nga numri celular 0685322086.

169. Pas këtij momenti, shtetasi Robert Saraçi komunikon me shtetasin Pajtim Dogjani në numrin cel 0695200300 dhe i kërkon të shkojë në polici dhe të sqarojë këtë problem duke thënë se janë mallra të vjetra dhe nuk i kanë marrë në Kosovë. Pajtimi nuk pranon dhe Roberti komunikon me persona të tjerë mbi këtë problematikë. Rezulton se ka komunikuar me një shtetas me nr. cel 0685585056, identifikuar si Imer Lusha i datëlindjes 26.06.1977, banues në Dibër, i cili ndërmjetëson lidhje me një shtetas tjetër në qytetin e Kukësit për të cilin i thotë se është punonjës i shërbimit informativ dhe ka në përdorim numrin celular 0685039826 i cili i prezantohet si punonjës policie, lidhje e Gëzim Carës me nr tel 0694134240 i cili prezantohet si Sazani. Referohet se Roberti ka shkuar në Kukës dhe ka takuar punonjësin Gëzim Cara dhe nga bisedat e mëtejshme rezulton se Roberti ndër të tjera thotë se për nderin që i ka bërë edhe do ta respektojë duke nënkuptuar kështu hetimin në gjendje të lirë të shtetasit të kapur me mallra kontrabande, transportuesin e Robertit, ndër të tjera thotë se fugonin do ta marrë mbrapsht ditën e premte.

170. Rezulton se në datë **17.05.2021** shtetasi Robert Saraçi ka bërë biseda në telefon me personin ka në përdorim numrin **069 41 34 240** dhe thirret me emrin "Sazan", identifikuar u Sazan Ibra, dhe kanë lënë një takim me njëri-tjetrin. Pasi kanë përfunduar takimin ku do të bisedonin për hetimin e gomave kontrabandë dhe kthimin e mjetit tip fugon të sekuestruar në kuadër të hetimit, Roberti ka komunikuar me personin, i cili ka në përdorim numrin celular **068 55 55 661,** identifikuar si Klevis Salkurti dhe e ka informuar në lidhje me rrethana të takimit, ku ndër të tjera i thotë se *me atë vlerë që i ka kërkuar ai me marrë, blen fugon të ri.* Ky i fundit e pyet se sa i ka kërkuar dhe Roberti i thotë *se janë shumë, janë mbi 500 mijë lekë*, kjo për të ndihmuar për të marrë mbrapsht fugonin. Në këtë kuadër bashkëbiseduesi me numrin celular **068 55 55 661 Klevis Salkurti** i ka thënë se do të gjejnë tjetër person për ta mbyllur këtë punë dhe pak më vonë i telefonon përsëri duke i dhënë numrin Oficerit të Policisë Gjyqësore **Atli Jashari** me numër **068 50 39 826**. Roberti ka komunikuar me këtë të fundit dhe kanë lënë të takohen në Kukës.

171. Pasi kanë përfunduar takimin, fakt që del nga konteksti i bisedës së zhvilluar, Roberti Saraçi telefonon vëllain e tij Erion Saraçi në numrin cel **068 41 03 697** dhe në mënyrë të përmbledhur i thotë:

Roberti: *Më thotë ky oficeri që nuk do të bisedojmë me asnjë, do ta mbyllë ai çdo gjë edhe me prokurorin e çështjes do të flasë ai.* ***Unë po i lë paraprakisht një 300 mijë lekësh.***

Erjoni:Jo 200 lëri njëherë..

Roberti:Po ca 200 ai do shkojë të flasë edhe me Prokurorin.....
Erjoni:Ok leri 300....".
Në vijim sqaron se Roberti do të kryejë edhe takime të tjera në vijim të bisedimeve të takimit me punonjësin e policisë Atli Jashari.
172. Në datë **16.05.2021** ora 13:07 min, **Sazan Ibra**, përdorues i numrit cel 0694134240 i con këtë sms përdoruesit të numrit cel 0684087150, identifikuar si shtetasi **Xhafer Elezi**, me tekst: ***"Drejtor si kalove. A te vimë nesër, mos e nxjerrim atë makinën bisedo një her me atë shefin edhe kafen e keni..".*** Në datë **16.05.2021, ora 13:58** min, **Sazan Ibra** nga numri cel 069 41 34 240 i dërgon këtë sms Robert Saraçit tek numri 068 67 70 943: ***"O Bert letrat e tua i paskan qu në prokori tashi sa fola me atë mikun".***
173. Shtetasi **Sazan Ibra** nga numri celular 069 41 34 240 komunikon me shtetasin **Xhafer Elezi** i cili ka në përdorim numrin celular 068 40 87 150, bisedojnë për të ndërhyrë tek një punonjës i cili quhet Atli në D.V.P Kukës. Biseda e datës **16.05.2021, ora 15.40** zhvillohet si më poshtë vijon:
Xhaferi: *Hë mo Sazan?*
Sazani: *Ca bane mo a ishe në gjumë?*
Xhaferi: *Si kalove? Jo në gjumë? Mbështet kesh po tashti e pashë mesazhin Hë ckemi?*
Sazani:A të vij nesër me të mos bejmë ndonjë punë.
Xhaferi: *Po nesër sikur vonohet më shumë se ditët e tjera Sazan se është.*
Sazani: *Po mirë kur të dush ti, 11, 12 or ti...*
Xhaferi: *po mirë mbas orës 12 e mbas nise, s'mbaroj dot përpara.*
Sazani:Po mirë bisedoje njëherë atë dhe një kafe tha i japim..
Xhaferi:Po po me kë më Atlinë?
Sazani: *Po ai e ka në dorë se ka ba atë. Nuk i ka bo ato letrat më duket.*
Xhaferi: *Si ka be e?*
Sazani: *Jo shif një herë mos ja nxjerim se.*
Xhaferi:Qe po hy në lidhje me Atlinë një herë ti them.
Sazani: ***Shife një herë dhe thua, premtoji ndonjë gjë ndonjë kafe.***
Xhaferi: *Mirë, mirë ajde ti them të më dalë me një numër tjetër në telefon..*
Sazani: *Po hajde Drejtor, ose takoje kështu*
Xhaferi: *Po se di, nuk e di a është këtu a jo? A ka ik se është ditë e dile sot.*
Sazani: *Po ai rrin në Kukës, Ku rrin ai? Në Kukës rrin mo.*
Xhaferi: *Po në Kukës rrin po me ken pushim, shkon të dielën.Qe po hy në lidhje me të.*
Sazani: *Po shife një herë edhe ta shtu.*
Xhaferi: *hajt..*
Sazani: *Fole me atë shokun mos vjen nesër.*
Xhaferi: *Po mirë mir, ani po foli unë.*
174. Në datë **16.05.2021**, ora **15.45** min, **Sazan Ibra** nga numri celular 069 41 34 240 ka komunikuar përsëri me **Xhafer Elezin** në numrin celular 068 40 87 150 dhe sipas bisedës paraprake me sms, e kanë vijuar komunikimin me tej si më poshtë:

Sazani: *Hë Drejtor.*
Xhaferi:Degjo, nesër jo. Atlia është te shtëpia.
Sazani: *po.*
Xhaferi: *Po i paska cu në prokurori ato ai.*
Sazani: *Pse i ka cu në prokurori aaa?*
Xhaferi:Po në prokurori, po duhet, nesër jo tha të kallzoj unë se kur me ashtu, se do me mar urdhërin e prokurorit, tha se pa marrë urdhërin se bëj dot.
Sazani: *Dakord, mirë pra që ti them edhe ketij.*
Xhaferi: *Po thuj atij që të do bisedojmë, do jemi në kontakt tha të kallzoj unë tha Atlia vetë.*
Sazani: *Po mirë dakord.*
Xhaferi: *Se i paska cuar me kohë në Prokurori.*
Sazani: *e ba ba.*
Xhaferi: *Po kështu.*
Sazani: *Mirë kur të ashtu folim.*
Xhaferi: *Ajt të njoftoj vetë mbasandaj unë.*

175. Shtetasi Robert Saraçi nëpërmjet numrit celular 0686770943 bisedon me një shtetas me emrin **Sazan,** identifikuar si shtetasi Sazan Ibra, me numrin celular 069 41 34 240 për problemin e tij që në lidhje me çështjen penale në D.V.P.Kukës, ku disa ditë më parë njëri prej furgonave të tij është kapur në flagrancë duke transportuar mallra kontrabandë (goma), të cilat Roberti i përdor tek servisi i vet në Peshkopi. Mallra të kaluara nëpërmjet P.K.K Morinë. Biseda e datës **17.05.2021**, **ora 07.20 a.m**, zhvillohet mes Robert Saraçit dhe Sazan Ibrës si vijon:

Sazani: *O Bert*
Roberti: *Mirëmëngjesi*
Sazani: *Mirëmëngjesi, a fjete?*
Roberti: *Si u gdhive ti burrë i fortë?*
Sazani: Nga je?
Roberti: Unë ke puna.
Sazani: *Unë jam në punë e*
Roberti: *Po hë gjit more vesh kur mbaron?.*
Sazani: Po i kanë shkuar letrat në gjykatë se ti smë the mua. Ai i ka cu atje që atë ditë që është blloku makina or ti. Edhe drejtori tha të vijë ai personi por ej andej e ta bisedojmë një herë ça do bëjmë.
Roberti: *Po kur e bisedojmë?*
Sazani: *Eshte ne shtepi ai.*
Roberti: *A sot a kur?*
Sazani: *Po sot, mo sot, sa të vijë se i ka thënë sa të vijë prej Tirane. A kupton ca do bëjmë?*
Roberti: *Po e çfarë mund të bëjmë.*
Sazani: Po
Roberti: Ja a mund të bëjmë gjë a jo?

*Sazani: **Po po mor se gjykata sa të na japë vendimin ta marim atë letrën e del makina me gjithë ato. A e kupton?***
***Roberti:** A e nxjerr gjykata direkt tani?*
***Sazani:** Po direkt gjykata se atje i ka cu mor letrat ai psikopati ai Inspektori.*
Roberti:Po thashë mo atë natë që të mora ty në telefon, thashë unë fol thashë, hape gojën thashë, Jo tha se e rregulojmë, e rregullojmë edhe.....
***Sazani:** hajt se folim.*
Roberti: Hajt mirupafshim.

176. Po në datë **17.05.2021** ora 7.58 min Sazan Ibra nga numri cel 069 41 34 240 i dërgon këtë sms Robert Saraçit tek numri 0686770943, ***"O Bert jam me Kastriotin na gjeje makinën të takojmë prokurorin e Kuksit".*** Në vijim në datë **17.05.2021, ora 08.53 a.m, Sazan Ibra** nga numri i telefonit 069 41 34 240 komunikon me përdoruesin e numrit të telefonit 068 55 55 661 në përdorim të shtetasit **Klevis Salkurti**, dhe zhvillojnë bisedën si vijon:

***Klevisi:** O Bac.*
***Sazani:** Mirëmëngjesi o Bac ça bone?*
***Klevisi:** Mirë ç'kemi?*
***Sazani:** Isha tu u la prandaj ee.*
Klevisi:Jo më mori ai Berti në telefon.
***Sazani:** Po jam tu shku një herë se i kanë kaluar letrat në Prokurori o burr.*
***Klevisi:** Po leje se i kanë kaluar letrat sun të bëjmë gjë atje neve..... i:Pse?*
Klevisi:** **Edhe ai nuk përgjigjet më shumë sesa e diskutuam dje neve...
Sazani:Jo jo jam tu shku ta takoj se kam fut një shok tek prokurori.
***Klevisi:Jo mor burrë mos u lodh se nuk jep me shumë sesa aq, se aq i bën makina atij, leje mos u lodh fare**..*
***Sazani:** Epo mirë pra.....*
***Klevisi:** Se më tha kshu, kshu tha, unë tha aq e kam ble makinën, le ta mbajnë makinën, s'po më duhet.*
Sazani:Mirë o komandant hajt..
***Klevisi:** Hajt shifemi më vone shnet.*

177. Në vijim, gjatë muajit qershor 2021, nga përgjimi i konsumimeve të shtetasit Alti Jashari dhe Robert Saraçi, rezultojnë disa komunikime dhe biseda midis tyre, paraqitur në rend kronologjik, si më poshtë: Konkretisht, në datë **01.06.2021** ora 09:24 min, **Atli Jashari** nga numri *0685038826,* zhvillon këtë bisedë me Robert Saraçin, i cili rezulton se komunikon nga numri i bashkëshortes së tij Vivianes, me nr.cel 0682258239, regjistruar në emër të bashkëshortit Robert Saraçi, dhe në kuadër komunikimeve për nxjerrjen e mjetit dhe mbylljen e çështjes, zhvillojnë këtë bisedë me interes:

***0682258239 (R.Saraçi):** Alo.*
***0685038826 (A.Jashari):** Po alo mirëdita*
***0682258239:** Si je a je mire?*
***0685038826:** Mirë si jeni ju?*

0682258239: *Burrë i fortë?*
0685038826: *Mirë ca bane?*
0682258239: *Mirë mo me shëndetin mirë të gjithë?*
0685038826: *Mirë mo hiç.*
0682258239:Qysh bohet mo shoku im më kanë thërrit ditën e enjte andej?
0685038826:...Ja se do të them unë se e kanë, tashi dalin vendimet se e kanë pushuar..
0682258239:A të vij të takoj ditën e enjte njëherë të pimë kafe?
0685038826: Kur ditën e enjte?
0682258239: *Po ditën e enjte ne orën dhjete me thonë..*
0685038826: *Kush të tha?*
0682258239: *Po më kanë pru një letër prej Prokurorisë.*
0685038826: *Po mirë hajde ditën e enjte pra..*
0682258239: *Mirë vëlla faleminderit.*

178. Në datë **03.06.2021** ora 09:16 min, e cila ka qënë **ditë e enjte** sipas bisedës së zhvilluar më sipër, **Atli Jashari** tek numri cel *0685038826*, është telefonuar nga Robert Saraçi, nëpërmjet numrit te tij *0686770943* dhe zhvillojnë këtë bisedë:

0686770943 (R.Saraçi): *Alo.*
0685038826 (A.Jashari): *He mo Bert ca bone?*
0686770943:Hiç mo vëlla jam tu ra poshtë, jam këtu, ai thotë tani ai oficeri tjetërthotë jo po do të thirri një dite tjetër.
0685038826: *E hala s'ke ardh në Kukës?*
0686770943: *Tek teqja. Çfarë bëjmë tani?*
0685038826: *A je tu ardh ti.*
0686770943:Po jam tu ardh te takohemi njëherë nga afër. Ku do takohemi?
0685038826: *Në çfarë ore ke pas me ardhë?*
0686770943: *Po ne 10 e kam pas.*
0685038826: *Po 10 e ke pas, e mire hajde.*
0686770943: *Te vij të takoj njëherë.*
0685038826: *Hajde mo.*

179. Në vijim, në po këtë datë, **Atli Jashari** dhe **Robert Saraçi** zhvillojnë biseda të tjera ku Roberti e njofton se ka ardhur në Kukës dhe lënë për t'u takuar afër Prokurorisë ku dhe kryejnë takimin, përballë Bashkisë Kukës.

180. Nga përgjimi i komunikimeve telefonike në vijim të muajit maj 2021, kanë rezultuar disa komunikime të shtetasit Alti Jashari, në lidhje me një çështje që lidhet me procedimin penal të shtetasit Edison Skënderi pranë Prokurorisë së Rrethit Kukës si dhe komunikime të tij në lidhje me fakte që lidhen me shtetasin Rasim Llapashtica. Konkretisht komunikimet, në rend kronologjik, në datat 21.05.2021 dhe 25.05.2021, rezultojnë si vijon: Më datë **21.05.2021**, ora 09:57 min **Atli Jashari** me numrin cel 0685038826, zhvillon këtë bisedë me interes me një shtetas përdorues i numrit cel 0694839633, si vijon:

0685038826 (Alti Jashari): *Alo.*

0694839633: *O Adli, degjo. Isha tek Prokurore Farija.*
0685038826: *Po.*
0694839633:Dhe ju keni atë dosjen e atij Llapashtices, atij kosovarit Rasimit.
0685038826: *Po unë e kam.*
0694839633: *me tha thuaj Atlisë e gjithë dosje të ë vijë ne zyrë.*
0685038826:A i doli apeli të erdhi?
0694839633: *E kam të hënën po aty në dosje kam atë autorizimin të përkthyer, të noterizuar dhe atë kërkon të ma japë, se e kam të hënën në apel. Dmth ti dosjen siç është hajde tek Prokurore Farija*
0685038826: *Mire, mire.*
0694839633: *hajde mirë ardhsh.*
Po më datë **21.05.2021** ora 11:19, i pandehuri Atli Jashari nga numri cel 0685038826 zhvillon këtë bisedë me një shtetas përdorues i numrit celular +38349112905 si më poshtë:
38349112905: *Shef Atli mos po të shqetësoj?*
0685038826: *Jo mirë ca nene?*
38349112905: *Si je si kalove?.*
0685038826: *Mire.*
38349112905: *A u lodhe hiç a jo aa?*
0685038826: *Hajd pak.*
38349112905: *Si po shkon, si e kemi gjendjen?*
0685038826:Tani jam tu shku andej, sa të bëj llaf me atë prokuroren.
38349112905: *Po a?*
0685038826: *Po*
38349112905: *Hajde Atli ishalla përfundoje se ti munesh me e bo ket pune. Përfundoje që të..*
0685038826: *Po.*
181. Në datë **21.05.2021**, ora 12:56, i pandehuri **Atli Jashari** nga numri 0685038826 zhvillon këtë bisedë me një shtetas përdorues i numrit celular, +38349112905, si më poshtë:
38349112905: *O Atli.*
0685038826: *O Ilmi.*
38349112905: *Se më duket pak të shqetësova, po mbasi më the gjys ore tani.*
0685038826: Jo po e kam marrë në telefon, ai është tu fol me Prokuroren aty. Isha ke zyra. A keni ardh këtej a jeni andej.
38349112905: *Eee jo jo këtu jam në servis*
0685038826: *Po.*
38349112905: *Atë e lamë dakord që ta, që ta marrish. Po me e be ditën e hënë me bo qeto shkresa.*
38349112905: *Po po vij deri aty që të mos flasim në telefon.*
0685038826: *E mirë hajd.*
Po në datë **21.05.2021**, i pandehuri **Atli Jashari** sipas bisedave, takohet para Komisariatit të Policisë me shtetasin kosovar Rasim Llapashtica dhe bisedojnë si më poshtë:

0685038826: *Hë Ylli.*
38349112905: *Adli para Komisariatit jam*
0685038826: *Po dola.*
38349112905: *hajt, hajt.*
182. Në datë **25.05.2021**, ora 10:25 min **Atli Jashari**, në numrin e tij celular që ka në përdorim 068 50 39 826 telefonohet nga numri celular 069 39 38 468 dhe zhvillojnë këtë bisedë:
069 39 38 468: *Alo.*
068 50 39 826 (Alti Jashari): *Ca bane?*
069 39 38 468: *Po shyqyr që më more një herë or ti.*
068 50 39 826: *Po pse u merzite?*
069 39 38 468: *Po umërzita po hë ku je? Qysh je?*
068 50 39 826:Mirë këtej nga puna jam.
069 39 38 468:Çfarë ke ba? A je tek puna? Pa hë ca e tu u bë me Pajtimin or ti?.
068 50 39 826: *Po o këtë javë do e nxjerrin aty në gjyq kështu tha Prokurori.*
069 39 38 468: *Eeee?*
068 50 39 826:Do e nxjerrin në gjyq këtë javë...
069 39 38 468: *E nxjerrin në gjyq?*
068 50 39 826: *Po.*
069 39 38 468: *Kur?*
068 50 39 826: *Po nuk e dimë tashi, do vendosin, hala se kanë vendos, se është me short.*
069 39 38 468: *Po ne gjyq tani ca bahet?*
068 50 39 826: *Po të shohim tani kesmet.*
069 39 38 468:Po thashë unë, se thashë po ndron atë prokuroren or ti, a ti japim nje send?
068 50 39 826: *Jo jo do të the unë nesër.*
069 39 38 468: *Eeee.*
068 50 39 826:Do t'them unë nesër.
069 39 38 468:E mirë pra, lajmëromë or ti lajmëromë se po bëhet hataja e po e dënojnë.
068 50 39 826: *Mirë, mirë.*
069 39 38 468: *Po pse se morët këtu në Tiranë or ti?*
068 50 39 826: *Po nuk e di pse se kanë mbajt në Tiranë*
069 39 38 468: *Po interesohu një herë bre.*
068 50 39 826: *Po mirë hajt se po interesohem unë nesër e të them*
069 39 38 468: *Hajt mirë.*
183. Po në datë **25.05.2021** i pandehuri **Atli Jashari** nga numri cel *0694111263*, zhvillon këtë bisedë me shtetasin **Tonin Kaci,** përdorues i numrit 0694132321,:
0694132321: *Ku je gjigand?*
06941112631: *Këtej nga Prokuroria*
0694132321: *Aaa do vish këtej nga zyra.*
0694111263: *Po*
0694132321: *Kam ca miqtë e mij nga Rrogozhina e ke thirr njërin ti, ka ardh sot i shkreti.*

0694111263: *Kush është ai?*
0694132321: *Nipi i një kolegut tonë në Durrës.*
0694111263: *Për ca është?.*
0694132321:Po kalim të paligjshëm
0694111263: *Si e ka emrin?*
0694132321: *Si e ke emrin e vërtetë, emrin e gjatë?(pyet personin që ka afër)....* ***Edison Skenderaj***
0694111263: *A mirë se erdha.*
0694132321: *hajde gjigand, hajde këtu përballë jemi.*

184. Me shkresën nr. 1763/1 prot., datë 20.06.2022 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, është dërguar kopje e akteve lidhur me procedimin penal nr. 248/2021, regjistruar me datë 18.05.2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, mbi ngjarjen e ndodhur në datë 11.05.2021. Nga aktet e vëna në dispozicion rezulton se procedimi penal mbi faktin e referuar është regjistruar me urdhrin e datës 18.05.2021, mbi bazën e materialeve të përcjella nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës me shkresën nr. 1527 prot., datë 12.05.2021. Nga këto akte rezulton se veprimet hetimore, deri në momentin e referimit të tyre në Prokurori janë kryer nga oficerët e policisë gjyqësore Atli Jashari dhe Kreshnik Çakraj. Konkretisht i pandehuri Atli Jashari, në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, ka hartuar aktet: (i) procesverbal kontrolli i automjetit, me datë 10.05.2021, ora 23.00; (ii) procesverbal për sekuestrimin e provave materiale datë 10.05.2021; (iii) procesverbal me datë 10.05.2021 për lënien në ruajtje të provës materiale automjet tip fiat dublo me targë AB 954 BE. Veprimet e tjera hetimore deri në përfundim të këtij procedimi rezulton se janë kryer nga persona të tjerë dhe jo nga i pandehuri Atli Jashari.

185. Në përfundim të hetimit mbi këtë procedim penal, me kërkesën e datës 03.11.2021 Prokuroria e Rrethit Kukës ka kërkuar pushimin e çështjes penale me nr. 248, viti 2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal. Kjo kërkesë e Prokurorisë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e cila me vendimin nr. 1531/503, datë 29.12.2021 ka vendosur :"- *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. – Pushimin e procedimit penal nr. 248, datë regjistrimi 18.05.2021, për veprën penale "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë", parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. – Provat materiale 24 goma të përdorura automjeti, të sekuestruara sipas procesverbalit të datës 10.05.2021, ti kthehen pronarit të ligjshëm, pasi vendimi të marrë formë të prerë....*". Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës rezulton se ka marrë formë të prerë për shkak të mosankimimit në datë 13.01.2022.

186. Në dosjen hetimore, lidhur me automjetin e sekuestruar dhe kthimin e tij, administrohet një kërkesë me shkrim e paraqitur nga shtetasi Robert Saraçi me datë15.07.2021 për kthimin e mjetit të sekuestruar bashkë me dokumentacionin, e cila është depozituar në Prokurori në datë 19.07.2021, me nr. 248/1 prot. Pas depozitimit të kësaj kërkesë, po në datë 19.07.2021 prokurorja e çështjes ka urdhëruar kthimin e mjetit me targa AB 954 BE së bashku me çelësat

dhe dokumentacionin, shtetasit Robert Saraçi. Për zbatimin e këtij urdhri nga prokurorja është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore Kreshnik Cakraj.

187. Me shkresën nr. 762/1 prot., datë 21.04.2022 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, rezulton se janë përcjellë materialet e kërkuara nga Prokuroria e Posaçme, lidhur me procedimin penal 176/2021, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror". Sipas akteve të kësaj dosje hetimore rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në datë 17.03.2021 ka regjistruar procedimin penal mbi materialin kallëzues nr. 2896, viti 2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, lidhur me ngjarjen e datës 05.03.2021 kur shtetasi Edison Skënderi është kthyer në Republikën e Shqipërisë si person i depërtuar nga Belgjika dhe nga verifikimet ne sistemin TIMS nuk kanë rezultuar dalje të tij, ndërkohë që në deklarimet e tij ai referon se ka dale në datë 19.01.2019 nga Pika e Kalimit Kufitar Morinë, Kukës. Pas shpalljes së mos kompetencës lëndore nga Prokuroria e Rrethit Tiranë me vendimin e datës 19.03.2021, materialet i janë dërguar Prokurorisë së Rrethit Kukës e cila ka vijuar hetimet. Sipas urdhrit me datë 09.04.2021 të Prokurorit, rezulton se për kryerjen e veprimeve hetimore të këtij procedimi penal është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore Atli Jashari. Në përfundim të veprimeve hetimore, me relacionin e datës 25.05.2021 oficeri i policisë gjyqësore Atli Jashari ka sugjeruar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 179/2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Edison Skenderi. Rezulton se Prokuroria e Rrethit Kukës për këtë procedim penal ka nxjerre urdhrin penal nr. 27, datë 25.05.2021, duke urdhëruar : "*Deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit Edison Skënderi, me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë, e cila do të paguhet brenda afatit gjashtë mujor.*". Pas nxjerrjes së këtij urdhri, Prokuroria i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës me kërkesë për miratimin e tij.

188. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 07.06.2022, shtetasi **Tonin Kaçi**, i punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, ka shpjeguar se :"*Unë Atli Jasharin e njoh pasi për një periudhë kohë, nga viti 2019 deri në nëntor të vitit 2021 kam qënë i punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, me detyrë OPGj pranë Komisariatit të Policisë Kukës, dhe Atliun e njoh si koleg. Në lidhje me bisedën që kam zhvilluar dhe ju më vutë në dijeni, mua nuk më kujtohet as shtetasi dhe as për çfarë bëhet fjalë. Jo as kolegu nuk më kujtohet për momentin.*".

189. I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime **Atli Jashari** ka deklaruar se: "*Fillimisht ju sqaroj se jam me detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, Sektori i Hetimit të Narkotikeve dhe Trafiqeve, me detyrë Specialist i Hetimit. Lidhur me këto biseda ju sqaroj se me datën 10.05.2021, unë kam qenë Oficer i gatshëm pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës. Nga shërbimet e patrullave të policisë së kësaj drejtorie, është bërë ndalimi i një automjetit tip Fiat minifurgon i vogël, në vendin e quajtur fshati Bicaj me drejtim për në kalanë e Dodës. Ku mjet drejtohej nga shtetasi Altin Laçi dhe në mjet i ishin gjetur disa goma të përdorura. Pasi është shoqëruar në ambientet e DVP Kukës, i është bërë dhe kontrolli më imtësisht dhe ka rezultuar se kishte 24 goma të përdorura pa faturë tatimore apo dokument tjetër justifikues. Në këto kushte, pasi jam konsultuar dhe me prokurorin*

e gatshëm, kam kryer veprimet hetimore si sekuestron e mjetit dhe gomave, deklarime, etj., kam lënë të lirë drejtuesin e mjetit dhe kam raportuar tek salla duke i dhënë rastit dhe numrin unik. Personi i dyshuar pasi është pyetur nga ana ime është lënë në gjendje të lirë, duke e informuar se rasti do referohej në prokurori. Unë e kam lënë të lirë këtë shtetas pasi jam konsultuar me prokurorin e gatshëm i cili me orientoi që rasti të ndiqet në gjendje të lirë. Me kaq unë nuk kam kryer veprime të tjera me këtë ngjarje sepse materialin ja kam kaluar oficerit Kreshnik Çakrri të seksioni kundër krimit ekonomik, pasi kjo vepër ndiqet nga ky sektor, kjo në miratim dhe dijeni të eprorëve të mi. Më pas sa kam dijeni me këtë çështje është marrë opgj i krimit ekonomik, i cili ka ndjekur rastin nga referimi deri në dërgimin e çështjes në gjykatë. Referuar bisedave që janë interceptuar nga Sektori përkatës, nuk kanë të bëjnë më personin përsa i përket dhënies të ndonjë ndihme për mënyrën e përfundimit të këtij përfundimi. Të gjitha ato biseda përmbajtjen e të cilave e kam mësuar nga gjykata, janë biseda të bëra mes punonjësit dhe ish punonjësit të policisë, ku kam njohje vetëm me shtetasin Xhaferr Elezi, pasi ka qenë punonjës policie. Unë konstatoj se personat, Klevis Salkurti, Zazan Ibra, unë nuk i njoh dhe as kam komunikuar ndonjëherë me ta, ndërsa shtetasin Robert Saraçi, e kam njohur më vonë pasi ka lidhje me çështjen në fjalë. Ata kanë bërë mes tyre biseda për dhënie ryshfeti, por ato biseda s'kanë të bëjnë fare me personin tim, pasi nga ana ime as është biseduar dhe as i kam takuar ndonjë herë për këtë çështje. Unë kam komunikuar me shtetasin Xhaferr Elezi, ish drejtor policie në Kukës, dhe më pyet në lidhje me një makinë me goma çfarë është bërë, unë i kam thënë materiali ka shkuar në prokurori. Me sa shikoj tek bisedat personat e interesuar më kanë ofenduar, pasi u ka thënë Xhaferri që materiali ka shkuar në prokurori. Pra të gjitha bisedat e bëra mes tyre të transkriptuara për rastin e gomave, nuk kanë të bëjnë fare me personin tim, dhe nuk jam i implikuar fare në marrje ryshfeti, në këtë rast unë kam kryer veprimet procedurale konform kodit të procedurës penale. Shtetasi Robert Saraçi, i cili ishte dhe pronari i mjetit tip Fiat i bllokuar me 24 goma, është thirrur për deklarim, nga oficeri i policisë gjyqësore i prokurorisë Kukës, me emrin Klevis ose Elvis, s'me kujtohet, i cili u transferuar më vonë. Në datën 01.06.2021, më ka telefonuar shtetasi Robert Saraçi, me numrin 0682258239, i cili më sqaron se më kanë thirrur në prokurori e do vinte të enjten andej, nga Peshkopia në Kukës. Unë i them që më duket se tashi dalin vendimet se e kanë pushuar çështjen. Por Roberti më thotë që do vij të enjten dh do takoheshim për kafe. Unë i them pse do vish? Ai më thotë se më kanë prurë një letër nga prokuroria dhe do paraqitej të enjten. Unë i them ok hajde. Në datën 03.06.2021 ora 09.16 jam telefonuar përsëri nga Roberti nga 0686770943, ku në më thotë që po afrohej në qytet por oficeri që do kryente veprimet i kishte thënë hajde ditë tjetër, meqë kishte ardhë në Kukës donte të më takonte. Unë e kam takuar Robertin tek kafja përballë bashkisë, ai ishte vetëm dhe në bisedë me të më tha që e kishte thirrë opgj-ja dhe e kishte lënë për ditë tjetër, me kaq kemi pirë kafe dhe ai u largua. Dua të sqaroj se shtetasin Robert Saraçi unë e njoha në kohen që nga prokurori i çështjes më është kërkuar që ti gjeja dhe njoftoja për paraqitje në prokurori të shtetase Robert Saraçi, nënën e tij si dhe bashkëshorten. Në kohën që ata kanë ardhur në Kukës, ata kanë komunikuar me mua si pikë kontakti, e më pas i kam shoqëruar në prokurorinë e Kukësit. Ata i kam futur deri tek korridori para zyrës së prokurorit të çështjes, e më pas jam larguar. Pra

Roberti e ka pasur numrin tim për këtë arsye siç e sqarova më lart. Pra kjo është arsyeja dhe s'ka asnjë arsye tjetër antiligjore, kontakti im me këtë shtetas.
Përsa i përket bisedave në lidhje me shtetasin Edison Skenderi, të bëra nga unë me punonjësin e policisë Tonin Kaci, me detyrë në opgj K.P.Kukës, ju sqaroj se, ai më telefonon dhe më pyet se ku isha, unë i përgjigjem se isha në Prokurori, ai më thotë se ka ardhur një person që kisha thirrur nga Durrësi. Tonin më thotë që është nipi i një kolegu tonë në Durrës dhe ka ardhur sepse e ke thirr ti, unë i thashë që po vij. Këtë shtetas unë e kisha thirrur në lidhje me një procedim nr.176/2021, me veprime të deleguara, për kalim të paligjshëm kufirit shtetëror neni 297 të K.Penal. Unë me këtë procedim i kam kryer të gjitha veprimet e deleguara nga prokurori i çështjes ku më pas i ka kaluar dhe relacionin përkatës, të çështjes. Më pas jam vënë në dijeni se prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhrin penal nr.27 datë 25.05.2021, si pas të cilëve ka urdhëruar deklarimin fajtor të shtetasit Edison Skënderaj dhe dënimin me 50 mij lek gjobë. Pra për këtë rast verifikimi i kryer nga ju për çështjen nr.272 nuk është i saktë pasi ky shtetas është dënuar dhe nuk duhet të ishit mjaftuar vetëm me një verifikim në sistemin TIMS. Pra në lidhje me këtë shtetas unë jam korrekt me ligjin dhe skam asnjë veprim të kundra ligjshëm. Në lidhje me bisedën e datës 21.05.2021, ora 09.57 me numrin e cel.0694839633, ju sqaroj se është numri i Avokatit të shtetasit Rasim Llapashtica, shtetas kosovar, i cili akuzohej për kryerjen e veprës penale të trafikut të mjeteve motorike, dhe çështjen e kisha unë me veprime të deleguara, dosja penale nr.179 /2021. Siç del dhe në bisedën e transkriptuar avokati pasi kishte biseduar me prokuroren e çështjes, kërkonte të merrte një autorizim që ishte në dosje, për të marrë kopje të tij sepse i duhej në Gjykatën e Apelit. Në këtë rast unë kam dërguar dosjen tek prokurorja, çdo veprim në këtë rast është monitoruar nga prokurorja. Pra në këtë bisedë s'ka asgjë të kundërligjshme. Lidhur me dy bisedat me nmrin +383491112905, shtetasi me emrin Ilmi me sa kujtoj ishte nga Kosova dhe interesohej dhe ky për çështjen e shtetasit Rasim Llapashtica, sepse mjeti i bllokuar kishte lidhje dhe me këtë person dhe kjo ishte dhe arsyeja e bisedës. Në bisedë nuk shoh asgjë të kundërligjshme por thjesht kontakte telefonike për afatet e kryerjes së veprimeve procedurale, ku mes të tjerash kujtoj se dhe ky shtetas kishte detyrim paraqitje dhe garanci pasurore. Dhe në këtë rast nga ana ime nuk ka asnjë veprim të kundërligjshëm apo korruptiv.

190. Në datë 28.06.2022, është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi **Xhaferr Elezi,** në lidhje me bisedat më sipër ka deklaruar se :"*Të drejtat e mia i kuptova dhe do të jap sqarime në praninë e mbrojtësit ligjor, av.Ilir Neguti me nr. license, "1411". Në lidhje me akuzen që më është ngritur unë jam njohur me vendimin e Gjykatës dhe për çfarë me atribuohet sqaroj si më poshtë: Rreth para një viti e gjysmë unë jam telefonuar nga një ish kolegu tim punonjës policie të cilin e quajnë Sazan Ibra, i cili më thotë. Na është bllokuar një makinë e një ish shoku tonë, duke në kuptuar që është shoku i tij dhe më thotë të lutem interesohu se çfarë problemi ka në Drejtorinë e policisë së qarkut Kukës, sepse nuk na del dhe në telefon . Kush është oficeri i them a e njihni ju? Po më thotë është Atli Jashari. Numrin e telefonit të oficerit unë nuk e kisha, jam interesuar dhe i kam gjetur numrin. E kam marrë në telefon Atliun nga numri që kam aktualisht në përdorim. Përshëndetje i them dhe i prezantohem. Të mora për*

një problem i them. Është një makinë e Dibrës që është blloku si është problemi. Më thotë që makina ka patur rreth 25 goma të vjetra dhe i është shmangur taksave. Është bllokuar i kemi kryer të gjitha veprimet dhe materialet i kemi dërguar në Prokurori. Mirë i them mirupafshim. Më pas i kam kthyer përgjigje palës së Dibrës Sazanit që më kishte marrë në telefon. I them që unë u interesova makina është bllokuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, janë kryer të gjitha veprimet nga O.P.Gj dhe materialet kanë kaluar në Prokurori. Në kohën që e kam marrë në telefon Atliu më thotë që jam në Tiranë dhe nuk ishte në Kukës. Sazani më thotë që çfarë të bëjmë që ta takojmë. I them që ai është në Tiranë janë kryer veprimet dhe s'kemi pse e takojmë. Kjo ka qenë biseda që unë kam kryer me Sazanin dhe me Atliun unë nuk i kam premtuar që do të jap gjë apo të kem ndikuar tek ai."

191. **Në vijim, në datë 04.06.2021**, janë regjistruar komunikime mes shtetasve Robert Saraçi dhe Erjon Saraçi lidhur me marrjen e një kompresori (pjesë automjeti) në Kosovë, por nga këto komunikime duket se nuk implikohet ndonjëri prej të pandehurve në këtë procedim penal dhe po ashtu nuk kanë ndikim mbi faktet objekt procedimi. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 30.05.2022, shtetasi **Erion Saraçi**, ndër të tjera, ka deklaruar: *"Unë Ardian Iseberin e kam takuar një dite rastësisht kur kam qenë në Prizren dhe kam patur dy goma ML-je për të sjelle. E kam takuar në stacion në Prizren pasi unë isha kthyer mbrapsht sepse nuk më linin të kaloja në kufi. I the Ardianit qe do te mi kalosh këto dy goma, pasi ishte aty tek stacioni i taksive. Me thotë mire dhe i kaloi me makine te vet deri ne Kukës. Unë kisha ikur me makine time dhe nuk e di nëse i ka deklaruar në doganë. E kam takuar në Kukës në kryqëzimin e rrugës që të çon për në Dibër. E kam paguar dy mije leke për transportin dhe jam larguar. Nuk e kam takuar me pas këtij rasti.* "Pyetjes nëse është furnizuar në Kosovë me mallra për servisin e vëllait tuaj Robert Saraçi, nëse po me çfarë automjetesh keni udhëtuar dhe me cilin person tjetër keni qenë, dhe sa raste, ai është përgjigjur*: "Në fund të vitit 2021 kam shkuar një herë në Kosovë se kam çuar një makinë për ta rregulluar në Pejë. Unë kam shkuar në Kosovë dhe kam marre me raste goma nga dy apo tre cope, dhe i kam çuar tek puna ime. ....Jo nuk kam shkuar fare për ketë pune ne Kosove me Vivianen, vetëm kam shkuar me makine dhe e kam rregulluar. Altin Rushit Laçin, e njoh dhe e kam djalin e dajës. Nuk kam bere asnjëherë transport mallrash me këtë shtetas....ky shtetas nuk ka kryer asnjëherë transport gomash as për mua dhe as për vëllain tim por me sa di unë ky ka shkuar dhe ka marre zogj fshati. Shtetasin Ardit Merdini e njoh dhe është një shok i vëllait Robertit. Ky punon me një automjet për transport pasagjeresh ne rruge fshati ne Diber fshatin Sohodoll. Mallra nga Kosova dhe anasjelltas nuk ka sjellë asnjë herë por në një rast ka marrë vetëm makinën qe ka shkuar dhe e ka rregulluar ne Kosove, behet fjale për makinën tip, 'Fiat", me targa, "AB954...."e Robert Saraçit. Altin Laci, nuk ka ka transportuar në asnjë rast mallra për llogarinë tonë, nga Kosova në Shqipëri edhe në një rast qe e ka kapur policia ne Kukës vjet në muajin maj ka patur disa goma të cilat i ka marre në Tiranë dhe i ka mbajtur ne bagazh te makinës. .....Unë nuk kam qenë në Kosovë në muajin maj 2021(rasti i kalimit te 25 gomave kontrabandë).Unë nuk jam thirrur nga policia gjyqësore e Kukësit dhe të jem pyetur për këtë gjë, në lidhje me rastin e ndalimit të shtetasit Altin Rushit Laçi. Shtetasin Rasim Dik Spata e kam kushëri te trete dhe banon ne fshatin Bllicaj Dibër."* Pyetjes nëse ka

kryer ky shtetas transport mallrash për ju dhe për vëllain e tij Robertin nga Kosova ne Shqipëri, kryesisht goma, ai është përgjigjur: *"Po kemi shkuar ne një rast bashke ne Kosove rreth muajit prill 2021 nuk me kujtohet se saktësi dhe kemi marre katër goma dhe dy grupe balestre, për servisin tim. Kemi qene me makine time automjet tip, Benz", ngjyre blu me targa, "AA290LR", mallra të cilat nuk i kam deklaruar në doganë. Shtetasin Pajtim Dogjani nuk e njoh dhe nuk kam komunikuar ndonjëherë me të. Kam shkuar edhe në një rast dhe kam marrë nja grup motori ne vlerën 65 euro, kam qene se bashku me Vivianen rreth muajit Maj 2021 dhe me here tjetër nuk kam shkuar ne Kosove. As këtë nuk e kam deklaruar ne dogane. Gomat në Kosovë, neve i kemi marre pa lekë fare dhe i kemi marre në një servis pjesë këmbimi automjetesh në Peje dhe i shisnin rreth njëzetë mije leke, por që nuk me kujtohet emri i pronarit".*

* * *

192. Në vijim të përgjimit të komunikimeve, gjatë muajit maj 2021, kanë rezultuar komunikime të shtetasit **Halim Shehu** dhe shtetasit **Fatri Iseberi**, me persona të tjerë, lidhur me veprimtarinë e këtyre dy personave gjatë ushtrimit të detyrës në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, dhe konkretisht: Në datë **17.05.2021 Halim Shehu** nëpërmjet numrit të tij 068 53 31 000 zhvillon një bisedë me një shtetas tjetër i cili ka në përdorim numrin celular 068 21 84 457, identifikuar në aplikacionin "Trucaller" dhe nga konfirmimi i kompanisë telefonike, "*One-Telecomunications*" si shtetasi ***Gazmend Thaçi***, me përmbajtje si vijon:

068 53 31 000 (Halim Shehu): *Po Gaz.*
0682184457 (Gazmend Thaçi): *Ku je mo?*
Halimi: *E shok më thuaj..*
Gazi: *Ca bane ku je?*
Halimi: *Hic te puna jam i zënën më thuaj*
Gazi:Jo desha me të taku pak.
Halimi: *Po qysh ke me taku sot. Unë në Morinë jam.*
Gazi: Me ardh deri në Morinë bre kam një njeri për andej.
Halimi: *E a e pret puna për në darkë a jo?*
Gazi: *A në darkë ee?*
Halimi: *Se sben se qashtu a puna.*
Gazi: *Ok hajt, hajt.....*
Halimi:Në darkë në orën tetë fiks të jesh këtu..
Gazi:Po e kanë, paska një ashtu ai.....s'duhet me e fut hiç në sistem.
Halimi: *Tani mos më ngatërro mua me ato sene, a janë këto puna e këtyre të jashtme a jo?*
Gazi: *Shqiptare.*
Halimi:Nejse a është punë azili a problem tjetër.
Gazi:jo jo një problem tjetër.
Halimi: *Se di.* ***Në tetë shihena, hajde me mend në krye.***

Në po këtë datë, Halim Shehu nëpërmjet numrit celular *068 53 31 000* dhe Fatri Iseberi nëpërmjet numrit celular 069 41 15 447 kanë zhvilluar këtë bisedë:
Fatriu: *A të thashë për herë të fundit kur erdh?*
Halimi: *Eeee.*
Fatriu: *E lashë tu përgju deri në drekë.*
Halimi: *A si e refuzuam ne aa?*
Fatriu:Jo jo qe ajo ditë i thashë sjam në punë i thashë se di kur hy. Ja bëra të vështirë e kur erdhi masandaj qe tha pije një kafe tha. Për zotin...
Halimi: *Legeni, qashtu, qashtu pak aa..*
Fatriu: *Po bre si përherë.*
Fatriu: *Po edhe thashë le bre le të hamë ndonjë drekë i thashë. Hajde hajd se e pini tha me shefin.*
Halimi: *Ik bre s sjam tu i kthy hic përgjigjen, ej harova me të thënë.* ***Thuaj tha Bari na e përshpejto pak thuaj or ti se është shumë vonë është shumë delikat mbrapa problemi i atij dhëndërrit.***
Fatriu: *Se di vallahi takum me të se do i them prapë.*
Halimi: thuj, thuj ta ndajmë o po, o jo e thuj të paktën se të kqyri ndonjë tjetër ai e mos të na i lej prapë ne..
Fatriu: *Po pra mos na thoj se keni kry ju të paktën.*
Halimi: *e delikat koha jo për gjë tjetër*
Fatriu: *Po pra.*
Halimi: *Koha është shumë problem andej se ato.....hajd të përshëndes.*
193. Me datë **19.05.2021**, ora 16:26, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri celular 0688531000, zhvillon bisedë me shtetasin **Arsen Zejneli** me numër 0684063013, me përmbajtje bisede si më poshtë:
Arseni: *O Kusho a je në Tiranë a?*
Haimi: *Jo në punë jam kusho i zenëm ajt.*
Arseni:E dëgjo një sekondë, mos më thuaj ajt mua, se kam më shumë vlera unë se ato që ke atje ti. Më vjen një shoku im që është Shqiptar jeton në Kanada.
Halimi: *Po.*
Arseni:Po nga shteti Shqiptar ka kërkuar azil politik në kanada dhe nuk i korrespondon me hy.
Halimi:Kur vjen e kështu me fol tamam shpejt e shpejt, e kuptoj, fol.
Arseni:Më datë 04 qershor do me hy në Shqipëri, a e kalojmë dot? Më thuaj cfarë duhet, cfare sduhet edhe.
Halimi:Pa problem, pa problem fare, ne për të qesim, hajde mirupafshim. Më shkruaj në Ëatcupp.
194. Me datë **19.05.2021**, ora 09:24, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, nga numri celular 0694115447, zhvillon bisedë me personin që përdor numrin 0682189990, identifikuar me emrin

Genti Daja, por regjistruar në emër të shtetases Burbuqe Iseberi, banuese në Kukës, me përmbajtje, si më poshtë:

Fatriu: *He.*

0682189990*: Jam* ***tu i thënë Adriatikit të pagojë ndonjë lek jo vec naftë.***

Fatriu: *Po mir thuje se i ka hap thuj udhën thuaja. A do me gjet ndonjë e Lulit thuaja të dyve.*

0682189990:Po lekt or djale të kalojnë ato, këto duhet me ju thënë ktyne. Të tjerve jo po këta janë tu kalu. Këto sndalen janë djemtë e mixhës. Sbëhem budall unë me thënë pse smë kë thënë.

Fatriu:Ani e thuj aj.

195. Me datë **21.05.2021**, ora 19:41, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri celular 0688531000 ka zhvilluar bisedë me Fatri Iseberin në numrin celular 0694115447 si më poshtë vijon:

Halimi: *Hë.*

Fatriu: *E di ai shoki i Durrsit që cum nënën e motren që e përcollëm andej.*

Halimi: *Po, po.*

Fatriu:I Belgjikës, e vete tashi me fugon mirë është ndal me e taku vetë ti aty edhe me e përcjellpër andej nga Kosova.

Halimi: *Po.*

Fatriu:Po bre m emakinë e, është i rregullt e ke parasysh po vec me shku se nuk e di se nuk ak siguracion për makinën, ti shko e bisedo vetë me të tek ura.

Halimi: ku në cfarë vendi?

Fatriu: Tu ardh te tuneli tashi ti jap numrin e të të marri ty në telefon

Halimi*: Po në ëatcap a ca te munesh.*

Fatriu: *po, po.*

196. Po në date **21.05.2021**, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi,** nga numri 068 51 82 004, ka zhvilluar bisedë me personin që përdor numrin 069 32 34 794, të cilin e orienton që të telefonojë kolegun e tij, punonjësin e policisë **Halim Shehu**, me qëllim për t'a ndihmuar dhe të kalojë kufirin pa u regjistruar, me përmbajtje si vijon:

068 51 82 004 (F. Iseberi) : *O hi...met.*

069 32 34 794: *Po*

068 51 82 004: *Merre tel e shkruaj pak cët numer.*

069 32 34 794: *Ma jep.*

068 51 82 004:I thuaj që jam miku i Fatriut, mik shpie se më ka vdek axha dije, takoje, ku je tani?

069 32 34 794: *Jam tu shku tek tuneli.*

068 51 82 004: *Kur të afrohesh i shkruaj a mere në Ëacap a ku të duash ti, i thuaj jam miku i Fatriut.*

069 32 34 794: *e mirë ashtu e bëjmë.*

Sapo përfundojnë bisedën e mësipërme, punonjësi i policisë Halimi Shehu, tek numri celular 0688531000, telefonohet nga një shtetas me numrin 0693234794, të cilin e thërret me emrin

Jetmir, ndërsa numri rezulton i regjistruar në emër të shtetasit *Judmir Kashari*, i datëlindjes 03.09.1987, i cili i prezantohet si lidhje miqësore i punonjësit të policisë Fatri Iseberi, duke e sqaruar se ka ndaluar sapo ka kaluar "Urën" në Kukës, me një fugon tranzit me targa belge, rrugës për në autostradë, diku afër oxhakut. *Ndër të tjera, i thotë se është me prindërit dhe i thotë në lidhje me problematikën që ka, me përmbajtje si më poshtë:*

794: *Kam një kshu fugon..*

Halimi:Vetëm nusja e ka problemin?

794:Jo prindërit janë se unë e kam marrë shtetësinë, po skam kalu akoma që ta kaloj keshtu që ta shkel e kupton? Thashë ta lejoj vetëm për prindërit. Po me makinë jam duhet me kalu unë me makinë.

Halimi: *Si është problemi fol në telefon sështë problem*

794: *prinderit i kam vetëm*

Halimi:Janë të dy prindërit që duan të ikin andej?

794: *Po.*

Halimi: *Ti vetë ske probleme?*

794:Unë vetë skam problem, mirë është që as unë mos me u shkrujt me kalu kështu sic kam kalu gjithmonë.

Halimi: *Po Fatriu ka një fatkeqësi dhe mua ai më tha për nusen prandaj..*

794: *Po ndoshta e ka keqkuptu në telefon se thashë mos ndoshta mos te flas shumë ne telefon prandaj.*

Halimi: *Vetem kaloje uren e Kukesit nja tre km dhe ndalo diku, cfare makine ke edhe nje here çfare targash..*

794:Targa Belgjike Ford Tranzit.

Halimi: *Vetem hape krahun se erdha menjëherë.*

197. Me datë **21.05.2021**, ora 20:31, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri 0688531000 komunikon përsëri në telefon me shtetasi Judmir Kashari, me numër 0693234794, me përmbajtje bisede si më poshtë:

Halimi: *Jetmir?*

794: *Urdhëro....*

Halimi:dëgjo vëllain është shumë e rëndësishme, ti mos e nxjerr dokumentin tënd, vetëm të atij nipit a ca pate të kushëririt..

794: *Po.*

Halimi:Edhe nëse nuk merresh vesh se vij unë fizikisht atje

Halimi:Vetëm do ta mbash mend atje ku ndalem unë, numëroji kabinat 1.2.3 Atje ku hy unë fiksoje..

794: *Në rregulll ska problem..*

Halimi: *Edhe mbaje telefonin gati kur të thirri unë. Mbaje mend vendin se ku do të shkosh. Edhekur të shkosh te kabina* ***do thuash a je Shefkiu? Unë jam djali i tezes së Halimit kushëriri.***

794: *Ok hajt.*

Halimi:Vëlla, vëlla dokumentin e kushëririt jo tendin, fare tëndin nuk do e nxjerrësh...
794:Ok në rregull.

198. Po në datë **21.05.2021**, ora 20:42, punonjësi i policisë Halim Shehu e telefonon përsëri personin e mësipërm dhe e porosit: *"....**Kushëriri i Halimit jam thuaj, unë s'duhet me u regjistru thuaj fare, këtë kushëririn thuaj regjistroje**....."*. Nga verifikimi i kryer në sistemin Tims, dokumentuar më procesverbalin me datë 22.08.2022, rezulton se shtetasi **Judmir Besim Kashari**, i datëlindjes 03.09.1987, nuk figuron i regjistruar gjatë muajit Maj 2021, as në hyrje dhe as në dalje të Shqipërisë nga Pika e Kalimit Kufitar Morinë, Kukës.

199. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 21.05.2021, shtetasi **Judmir Kashari** ka deklaruar: *".....Po më kujtohet kjo bisedë, e kam bërë nga telefoni im. Unë që nga viti 2013 jetoj dhe punoj në shtetin e Belgjikë. Në këtë shtet unë kam përfituar shtetësinë Belge. Në vitin 2021 kur është kryer kjo bisedë e kisha përfituar shtetësinë. Në vitin 2021 muaji maj kam ardhur në Shqipëri së bashku me prindërit e mi, për tu interesuar për shtëpinë e cila ishte dëmtuar nga tërmeti në Durrës si dhe kam takuar të afërmit e mi. Në Shqipëri kemi qëndruar rreth 20 ditë dhe më pas jemi larguar nga RSH, nëpërmjet PKK Morinë. Unë dhe prindërit nuk kishim probleme për tu regjistruar në hyrje dhe dalje në R.Sh-së, por kur hyra në territorin e RSH-së nuk na regjistruan në PKK Morinë. Për shkak se nuk doja që të regjistrohesha i kam kërkuar punonjësit të policisë mos të më regjistronte në sistemin TIMS. Nuk kisha njohje me atë punonjës police që ka qenë aty por thjesht Ka qenë punonjësi i policisë që ka rastisur në kabinë. Kur doja të dilja nga R.Sh kisha frikë se ndoshta më krijoheshin probleme se nuk kisha vulë hyrëse. Unë në atë pikë kalimi kufitar kam pat njohur një punonjës policie i cili quhej Fatri, te cilin e kisha njohur para shumë vitësh në Belgjikë dhe kur kaloj në kufi në P.K.K Morinë e kam takuar rastësisht duke shkëmbyer edhe numrat e telefonit. Kur kam bërë në plan për të ikur përsëri pas rreth njëzetë ditësh pasi kisha hyrë, ditën që do të ikja kam telefonuar Fatriun dhe i them se dua të kaloj në P.K.K Morinë, dhe nuk kisha dëshirë të regjistrohesha në sistem, pasi kisha hyrë pa vendosur shënime në pasaportë dhe sistem. Atë ditë po udhëtoj me automjetin tip Ford me targa Belge, "XKT177". Automjeti ka qenë i imi dhe bashkë me mua kanë qenë të dy prindërit e mi dhe një kushëriri tim i cili quhej Alban Shaholli. Fatriu kur i telefonova më thotë që jam në një vaki por do lidhesh me një kushëririn tim duke më dhënë edhe numrin e telefonit i cili quhej Halim. Halimi më ndihmoi të kaloja tek kontrolli kufitar Kosovar pasi me sa kuptova ai kishte komunikuar më parë dhe nuk punonjësit e policisë Kosovare nuk më ushtruan asnjë kontroll. Me sa më kujtohet është regjistruar vetëm kushëriri tim Alban Shaholli ndërsa unë me prindërit e mi nuk jemi regjistruar".* Me tej ai sqaron se para se të kalonte kufirin në hyrje të R.Sh-së nuk ka komunikuar me asnjë punonjës policie me qëllim që ti kërkonte ndihmë për mos regjistrimin në kufi, por kur ka hyrë në territorin shqiptar ka takuar një shtetas që sipas tij numrin e kontaktit ja ka dhënë Fatri Iseberi, por që nuk kishte dijeni nëse ishte punonjës policie apo jo, por ky person ishte ai që kishte folur me palën Kosovare për të ndikuar me qëllim mos regjistrimin e tij në sistemin TIMS, por nuk ka paguar rryshfet.

200. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rezulton se shtetasi Judmir Kashari nuk është regjistruar as në hyrje dhe as në dalje të R.Sh-së dhe po ashtu edhe shtetasi me emrin Alban

Shoholli. Nga biseda e zhvilluar midis tij dhe punonjësve të policisë rezulton se problemi është për mos regjistrimin e prindërve të tij. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rezulton se Besim Gani Kashari dhe Manushaqe Ahmet Kashari, nuk rezultojnë të regjistruar në sistemin TIMS as në hyrje dhe as në dalje të R.Sh-së për periudhën kohore që është kryer biseda.

201. Më datë **21.05.2021**, ora 08:21, punonjësi i policisë **Halim Shehu** zhvillon bisedë nga numri 0688531000 me personin tjetër që përdor numrin 0685145111, regjistruar në emër të shtetasit **Ergys Muja**, banues në Kukës, por nga bisedat e zhvilluara konstatohet ta thërrasë me emrin Xhevat, me përmbajtje si më poshtë:

Halimi:Edhe do ikim sonte ne Prishtinë deri në aeroport bashkë me maqinën tënde.

111: *po mor ca ore psh?*

Halimi:Ikim bashkë nga ora 8 Nga ora 7 Nisna, nga ora 8 duhet me kenë atje.

111: *Po besoj se varet kur mbaroj unë. Se më ka thirr ai atje, duhet me shku deri atje në Kosovëunë..*

Halimi: *Ku me shku?*

111:Ne Kosovë mundem me shku sot.

Halimi: *Ee mbasdite.*

111: *Vallahi nga ora 1.2 a 3.....*

Halimi *: Epo thu deri qatere mbaron ti aa?*

111: *Jo ka ora 2 a 3 mundtë vijë Reni se unë mbaroj punë mënjëherë skam problem se vetem jam.*

Halimi:Po e nisim o Azemin do e marrim me vete se qashtu a puna.

111: *Sprish punë mo bur absolutisht, ca je tu thane?*

Halimi:A Nisin, bile Nisin më mirë se asht i madh.

111: *S'ashtë problemai me kene ta shoh një herë se cfare ore e ka lene me mu se më kllazon qe tash se marr ne telefon unë çfarë ore me ka lenë e në rast se duhet maqina jeme duhet me e lene maqinën jeme ta le ket unë.*

Halimi: *Jo mirë është me shku bashkë ska lidhje me maqinën.*

111: *Aaa.....*

Halimi: *Maqina thotë unë kam maqinë...*

111:Hajt se nga ora 7 e kryejme..

Halimi:E kam njeri të rëndësishëm prandaj.

111: *Po po pa problem.*

Gjatë bisedave rezulton se Halim Shehu bashkëbiseduesin e thërret me emrin Xhevat, i cili është babai i shtetasit Ergys Muja, personi ne emër të të cilit është regjistruar numri i telefonit nëpërmjet të cilit janë realizuar komunikimet si më sipër.

202. I pyetur ne cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 07.06.2022, shtetasi **Xhevat Zenel Muja** ka deklaruar: *"Unë Halim Shehun e kam kunat pasi ka marrë motrën time për nuse..... Unë me shtetasin Odise Cërriku që e thërrasin shkurt Odi jam takuar dhe njohur në panair në Stamboll së bashku me Besim Murturi shtetas Kosovar dhe jeton në Prishtine, ndërsa Odi jeton në Elbasan dhe ka një dyqan që shet tapeta dhe perde. Edhe unë vete kam një dyqan në*

Kukës dhe merrem duke shitur perde dhe rrugica. Për sa i përket bisedës së kryer unë e kam telefonuar Halimin dhe sepse e kam pyetur sesi mund ta bëjmë për ta ndihmuar pasi Odi me kishte thënë se Odit i kishte ardhur një pjesë malli nga Stambolli ne Elbasan dhe një pjesë prej 200 e ca kg duhet të çohej në Kosovë tek Besi dhe unë e kam pyetur Halimin se si mund t'ia bënin për ta ndihmuar. Me sa mbaj mend unë kjo punë nuk është kryer, pasi Halimi më tha që nuk bëhet..... Jo nuk kam bërë Pazar për dhënie ryshfeti, unë vetëm ju kam thënë që do ta pyes kunatin për në dogane si mund ta bëjmë që ti ndihmojmë... Numri cel që unë përdor është regjistruar në emër të djalit tim Ergys Muja, ndërsa në përdorim ka qenë gjatë gjithë kohës nga ana ime.." Në përgjigje të pyetjes, nëse në datë datë 21.05.2021, ora 08:21, Halimi ju ka telefonuar dhe ju ka kërkuar që të shkoni bashkë në Kosovë për të pritur një person të rëndësishëm në aeroport. Për të mos rënë në sy ai sqaron se do marri edhe një nga fëmijët e tij, dhe për këtë duhet te udhëtonit me makinën tuaj. A keni shkuar atë ditë në Prishtinë dhe kë person keni marrë në aeroport, ai ka sqaruar se:*". Unë kam shkuar shumë herë në Kosove me Halimin por nuk me kujtohet si rast nëse kam shkuar apo jo ne këtë datë, apo kë kemi pritur...".*

203. Gjithashtu, më datë **21.05.2021**, ora 21:52, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, tek numri 0688531000, telefonohet nga shtetasi **Gerti Xhanari**, me numër 0674069111 dhe bisedojnë në lidhje me favorizimin e kalimit të paligjshëm të kufirit, pa dokumentacionin përkatës të identifikimit, kartë identiteti ose pasaportë, me përmbajtje si vijon:

0688531000 (H.Shehu): *Mërzitur shumë, lodhur shyqyr zotit familjen e kam mirë, nuk kemi ndonjë problem.*

0674069111 (G.Xhanari): *Shyqyr, shyqyr.*

0688531000: *Fol vëlla.*

0674069111: *Tani dëgjo për çfarë të mora unë. Sepse ti je aty dhe ndoshta e di. Unë kam futur edhe atë.....kartën edhe pasaportën se më sja duan për ti bërë..*

0688531000: *Po.*

0674069111:Dhe jam pa karte dhe pa pasaportë, ose më saktë e kam pasaportën po e kam e ke parasysh ti ata të bëjnë një prerje në fund të pasaportës.

0688531000: *Po, po.*

0674069111:Një pyetje dal dot për Kosovë?

0688531000:Ligjërisht jo, por kur do me dalë shoqërisht e ke të hapur derën.

0674069111:E kam ndonjë problem nëse dal dhe kthehem pasnesër? Dua të iki në Prizren me familjen, me nusen, me djalin, nëse na mbushet mendja.

0688531000: *Nëse del nesër, vetëm do më thuash që u nisa dhe jam rrugës. Edhe krejt familja e ka të tillë problem apo vetëm ti?*

0674069111: *Jo jo vetem, unë, vetëm unë*

0688531000:Pa merak profesor, nëse nisesh vetëm më thuaj, që Halim jam nis, vetëm kaq.

0674069111: *Ok dmth nuk kemi probleme, të nisem pa problem nesër nga mbasditja?*

0688531000: *Unë aty punoj, profesori i themi unë, nuk është problem besoj pa merak.*

0674069111: *Ok edhe kur të kthehem e njëjta gjë se mos më thonë.*

0688531000: *Kur të kthehesh je në kokën tënde, vetëm i thuaj që jam profesori shefit tuaj, jam profesori i Halimit dhe nuk ka problem fare.*
0674069111: *Ok atëherë do të bëj të ditur nesër në mëngjes.*
204. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 08.06.2022, shtetasi **Gerdjan Xhanari**, ka pranuar faktin e kryerjes së bisedës me punonjësin e policisë Halim Shehu, pasi me të ka një njohje të vjetër që në kohen kur Gerdiani ka dhënë mësim në Akademinë e Policisë. Ndër të tjera ai ka deklaruar se : *"...Për sa i përket bisedës në fjalë, sqaroj se unë e kam patur në plan që të shkoj në Kosovë së bashku me familjen, pasi udhëtoj shpesh për në Kosovë. Ndoshta atë kohë nuk kam patur ndonjë nga dokumentet e udhëtimit aktive prandaj nuk jam nisur. Kam pritur sa kam marrë dokumentet dhe kam udhëtuar pasi kam marrë dokumentet. Unë sa herë shkoja në Kosovë komunikoja me Halimin dhe shpesh herë bëhesha gati për të ikur por e anuloja planin. Edhe në këtë rast me sa më kujtohet e kam anuluar dhe nuk kam ikur atë ditë. Por gjithmonë në kufi kam paraqitur dokumentet e udhëtimit dhe jam regjistruar rregullisht....."*
205. Me datë **22.05.2021**, ora 08:10, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, telefonohet nga një shtetas me numrin 0682889047, të cilin e thërrasin "Drejtor", identifikuar nga policia gjyqësore, shtetasi **Amir Onuzi,** por që numri rezulton i regjistruar në emër te shtetasit Sinan Onuzi, i datëlindjes 10.04.1978, banues në Nangë, Kukës, i cili i kërkon që ta ndihmojë për të kaluar në kufi një koleg, punonjës policie pranë Akademisë së Sigurisë, pa u regjistruar në sistem, pasi i ka përfunduar afati i dokumentit pasaportë, me përmbajtje si më poshtë:
Halimi: *Mirëmëngjes Drejtor.*
0682889047: *Tungjatjeta.*
Halimi:Një mësuesit të Akademisë edhe shok edhe mësues i kish kalu afati i pasaportës dhe tu ik për në Kosovë edhe ja dhashë emrin tënd edhe të dajës Ahmet, Daja Ahmet e kryen ndoshta po vec kot me e pas nese ka nevojë.
0682889047: *Po në paca mundësi me dal prej këtuji, se skam dalë prej këtu.*
Halimi: *Jo jo sjam tu thanë me dalë bre burrë vec i kam shkrujt mesazh i kam thënë ke Amirin dhe Ahmet Kabashin, Edhe i shkrujta dajës Ahmet, tha pa problem thjesht po të them mos u bëj bajat se je njeri i nderum.*
0682889047: *U kry hajt.*
206. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 08.06.2022, punonjësi i policisë **Amir Onuzi** me detyrë Ndihmës Specialist Kontrollor në P.K.K Morinë ka deklaruar:".....*Sqaroj se unë Halim Shehun e kam patur epror, pasi ka qenë përgjegjes turni në P.K.K Morinë. Në lidhje me bisedën dua të sqaroj se nuk më kujtohet si rast, pasi ka kaluar shumë kohë dhe nuk më kujtohet asnjë emër personi se kush mund të ketë qenë..*". I pyetur nëse ka njohje me shtetasin Ahmet Kabashi ai ka deklaruar se:"... *Është ish punonjës i policisë së Kosovës, pasi në dijeninë time ky punonjës është arrestuar gjatë operacionit të kryer së fundmi nga pala Kosovare..... E njoh si punonjës policie por rastisnim të ishim shpesh bashkë në një turn gjatë shërbimit.....* "

207. Me datë datë **25.05.2021**, ora 19:39, punonjësi i policisë **Halim Shehu** telefonohet nga shtetasi **Armir Gjikolaj**, me numrin celular 0694106199, me përmbajtje si më poshtë:
Halimi: *Po Drejtor.*
Armiri:Ai thote 250 m 300 ore?
Halimi: *Mos ja fut kot.*
Armiri: *Po.*
Halimi: ani vëlla thuaj se tash kosto janë, vjen një shoku jem me i marrë, rrespektoje dhe hajt mos i beso shumë.
Armiri: *A ti jap numrin. Kur je ne pune ti?*
Halimi:Ai i ka gati?
Armiri: *Po besoj se duhet ti ketë gati mor burrë.*
Halimi:Po mirë jepja numrin në ëhatcup të komunikoj me të.
Armiri: *Kur, kur e ke kur?*
Halimi:A i rregullojme ne se ska lidhje se pjese fare
Armiri:Ok ati them ashtu mo është në Fushë-Krujë ai po vec kur të jesh ti që të vijë ai po them.
Halimi: *Po mirë, mirë a i ke bërë këtj ti nga Kosova?*
Armiri:Po pra do vijë nga Kosova do vijë ai.
Halimi:Po pra komunikojmë me të e rregullojmë ne ska problem
Armiri: *Ok.*
208. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 30.05.2022, shtetasi ***Amir Gjikolaj***, ka deklaruar se :"*Unë Halim Shehun e njoh pasi kemi mbaruar shkollën e lartë, Akademinë e Policisë, dhe kemi punuar bashkë në Kukës dhe që atëherë kemi mbajtur lidhje. Në lidhje me bisedën telefonike që unë sapo u njoha, sqaroj se nuk më kujtohet për çfarë bën fjalë biseda. Nuk më kujtohet si bisedë pasi unë kam komunikuar shumë herë me të dhe nuk mund të sqaroj se për çfarë bëhet fjalë.*".
209. Në datë **<u>26.05.2021</u>,** ora 10:52, mes punonjësit të policisë Halim Shehu dhe personit tjetër që përdor numrin 068 53 43 546, regjistruar në emër të shtetasit Shpëtim Halilaj, i datëlindjes 15.03.1979, banues në Kukës, zhvillohet biseda me përmbajtje si më poshtë:
546: *A je në punë a pushim?*
Halimi: *Vallahi në mëngjes kam mbaru elbete.*
546: Jo bre qesh tu kalu këtu po pata një njeri, një shoq pa dokumenta
Halimi:Janë shokë të mirë krejt ke Armirin Arjanin
546: *Këto që janë kryesorët ëë?*
Haimi: *Përmend emrin e kujt të duash po ke Hysenin, Ahmetin Zeqirin, krejt çuna të mirë janë.*
546: *Zeqiri cili është një i dobët i thatë qenka?*
Halimi: *Jo një i dobët jo s'është ai...duhet të jetë tjetër kush*
546: *Si e ka emrin ai që është këtu?*
Halimi: *Ke Ahmet, ke Zeqir.*
546: *A ta takoj ndonjërin?.....*

Halimi:Po i thu bre si e ke emrin, Shef Halimi asht ne telefon.
546:Një sekondë e fol me të vetë. O shoko si ja kalut? A me te pyet qyshbe ke emrin?(flet nje person tjetër) Jo unë jam mbikqyrësi i këtijna shefi i këtijna. A po i fol Halimit se është Halim Shehi?.....
Personi tjetër: për ca problemi halli te thashe?
546: *Për me kalu bre desha me i cu deri në Kosovë.*
Personi tjeter: *Me ca je?*
546: *Me makinë.*
Personi tjeter: *Ku e ke makinen kue problemi?*
546: Foli dy minuta Halimit.
Tjetri: *O me ty po foli une pa fol me Halimin.* ***Ku e problemi?.***
546: Dokumentin e kam harru skam dokument.
Tjetri:Vec dokument ske hall tjeter ske?
546: *Jo asnje hall hic.*
Tjetri: *Hajde te makina dhe ecim dhe i thuaj Halimit të mësojë të sillet, une për paret skam nevojë..*
546: *O* ***Halim.***
Halimi: *He Tim..*
546:Zeneli kenka..
Halimi: *Hio po është shef i madh or ti thuaj o shef Zeneli me na falë*
Ora 10:58, personat e mësipërm bisedojnë përsëri, me përmbajtje si më poshtë:
Halimi: *Hë Tim.*
546:O halim kalova o shoq se problem bre veç mos me e pas kartën me vete me e be
Halim: *E bre nuk e dita se e Zeneli sot.*
546: *Eshte i madh ai?*
Halimi: *He?*
546:Tha ca problemi ke? Vec se se kam dokumentin me vete.
Halimi: *He.*
546:Tha me kalu mos me ta ndi hic..
Halimi: *E bre është shefi, shefi si unë këndej është ai andej.*
210. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit, rezulton se ky shtetas nuk është regjistruar në dalje të Shqipërisë, ndërkohë që nga bisedat rezulton se ai ka kërkuar ndihmë për kalim pa u regjistruar në kufi nga punonjësi i policisë Halim Shehu, jo vetëm për veten e tij por edhe për një pasagjer tjetër të paidentifikuar, i cili udhëtonte me të në mjetin e tij.
211. I pyetur në datë 08.06.2022, në cilësinë e personit që tregon rrethana te hetimit, sipas procesverbalit me datë 08.06.2022, përdoruesi i numrit celular 0685343546, shtetasi **Shpëtim Halilaj** ka deklaruar:".... *Unë jam i vetëpunësuar, pasi kam zanat rregullimin e dyerve dhe dritareve.... Po më kujtohet rasti unë kam komunikuar me Halimin në telefon, dhe u njoha me bisedën dhe sqaroj se po e kam telefonuar dhe ja kam kërkuar një nder të tillë, pasi me sa më kujtohet në një rast unë kam çuar në Kosovë vajzën e tezes dhe tezen time te dyja të cilat i*

quajnë, Vjollca Shehu dhe Sherife Shehu. Do të shkonin në Kosovë tek dentisti dhe me sa kujtoj nuk jam dhe aq i sigurt më duket se Sherife Shehu nuk ka patur dokument udhëtimi me vete..... Unë njoh vetëm një punonjës policie të cilin e quajnë Zenel Grosha dhe punon në Morinë, ndërsa, punonjës policie Kosovar nuk njoh asnjërin prej tyre. Në rastin konkret nuk e di se cili Zenel ka qenë.... Jo nuk çoj pasagjerë, por unë shkoj shpesh zakonisht të martave kur është tregu në Kosovë... Ka një pikë shumice aty në Kukës, për aluminin ndërsa për plastiken e marr këtu në Tiranë, tek "Cubi-Shpk" në Lapurakë."

212. Me datë **26.05.2021**, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, tek numri 0685331000, ka zhvilluar bisedë me personin që ka përdorur numrin 0682002296, identifikuar si shtetasi **Ndue Beci**, i datëlindjes 30.04.1996, me përmbajtje si më poshtë:

0682002296: *Nje shok i Gjikolës jam.*
0685331000*: ee si je vëlla si kalon?*
0682002296: *Unë jam këtu tek dogana në Kukës..*
0685331000: *Do ikësh andej ti?.....*
0682002296: *Jam këtu jo, jo. Vetëm deri këtu jam skam për të ik andej. A je këtu afër ti?*
0685331000: *Jo mo kam mbaru punë unë jam tu pushu.*
0682002296:Për zotin ee ca të bëj unë si mendon ti?.
0685331000:Po sa afër je ti andej?
0682002296*: Jam këtu mo në Bardhoc jam tani.*
0685331000*: Do ikësh andej aa?*
0682002296: *Jo jo sdo iki fare andej deri këtu tek ti.*
0685331000: *Ca të them mo vëlla jam në qytet jam në Kukës. Do ikësh për andej ti që të takohen atje?*
0682002296*: Jo jo.....*
0685331000: *Je nis për me më taku?*
0682002296: Po.po.
0685331000:*A vjen dot deri në qytet?*
0682002296:Po mor vij po e problemi, aka njeri këtu, që të më.... është një shok i imi që ka ardh ktej
0685331000:Ku është ai?
0682002296:Është atje ne kufi matanë.
0685331000: *Cfarë makine është?*
0682002296: *Një veturë të vogël mo ka i Kosovës*
0685331000: *Hajt pra mos u mërzit, shko dil andej, dil andej, dil andej përtej ti.*
0682002296:Jo sdal se kam harru kam mar makinën tjetër i kam letrat krejt në makinë tjetër.Po pres në klub këtu.
0685331000: *Shko afër punës ti diku, pi kafe këndej ai të pijë andej pertej te Universi, thuaj shko pi kafe..*
0682002296*: Po, po..*
0685331000: *Edhe nuk vonohem, Hajde të përshëndes*

213. Me datë **31.05.2021**, ora 09:10, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, nga numri 0694115447 ka zhvilluar bisedë me punonjësin e policisë **Halim Shehu**, që përdor numrin 0688531000 të cilët zhvillojnë bisedë në lidhje me regjistrimin fiktiv hyrje-dalje të një shtetasi në kufi pa qenë prezent fizikisht, me përmbajtje si më poshtë:
Fatriu: *He mik.*
Halimi: *He mik a fjete?*
Fatriu: *Boll ca bane ti?*
Halimi: *te puna je?*
Fatriu: *Po te puna*
Halimi:Hajde atë foton mos ma harro ta kam cu
Fatriu:Po po qtaj ja bej mirupafshim.
Halimi:Aaa mik shpie pa problem.
Fatriu: *Qe taj ja bej direkt pa problem, mos ta harroj.*
Halimi: *Avash, avash.*
214. Në datë **02.06.2021**, ora 10:45, **Fatri Iseberi** nga numri cel 0694115447 ka zhvilluar një bisedë me numrin 0688531000 ne përdorim nga punonjësi i policisë **Halim Shehu** zhvillohet biseda si më poshtë:
Halimi: *Nga je?*
Fatriu: *Hic në Kukës tu la makinën*
Halimi: *Aa për nja një orë vjen?*
Fatriu: *Ani po e pres unë një orë deri në 12 aaa?*
Halimi: *Po besoj se është nis prej Miloti*
Fatriu: *Po hajt se deri në 12 po e përgjoj pra. A të dal te ura 6 metroshe a ku me e prit*
Halimi: *Po ku ta takosh tek ura te Uruci në e pac më mbarë.*
Fatriu: *po hajt ndac te Uruçi dal hajt*
Hajt te ashtu jepja numrin tem e të më marri
Halimi: *hajt.*

215. Me datë **04.06.2021**, ora 18:59, punonjësi i policisë **Halim Shehu**, nga numri 0688531000 zhvillon bisedë me numrin 0685312916, regjistruar në emër të shtetasit Xhelil Dulla, i datëlindjes 19.12.1997, banues në lagjen Gjok-Doci, Dibër, ndryshuar emri në Xhelil Dulla, me përmbajtje si më poshtë:
916: *Qenke i zënë sjam tu të shqetësu pra*
Halimi: *Jo kam dalë prej teje, vec më thuaj vëlla ca problemi ke?*
916: Unë desha me lëviz vallahi e thashë mos ke ndonjë kontakt me ndonjë andej, e thashë desha me ik dhe unë..
Halimi: *vëllai a është në Gjermani po ëë?*
916: *Po vëllai po.*
Halimi: *A shtë rehatu a send?*
916: *Po mirë është ai , ai e ka punën e krejt.*

Halimi: *Po e kena një shok hala mo atje hala me probleme se e kishna kry, ku do me shku larg aa?*

916:Unë do me ik për në Spanjë, për andej pra nga Anglia a fjala.

Halimi: E di e di, A ke ndonjë shënim atje ti jo?

916: *Ca kam?*

Halimi: A ke ndonjë shënim

916: ***Unë vec sa kam ndërru mbiemrin o vëlla.***

Halimi:Shife do më çosh një fotokopje të pasaportës në ëatcup në këtë numër.

916: *Po.*

Halimi:Edhe kismet vetëm të mërkurën kur të flasim.

916: *Mirë vëlla ok.*

Halimi: *Ok shok nuk është larg të mërjurën tre katër ditë janë.*

916: *Ok po me të pyet një gjë tjetër unë po qe se u futëm në Europë a mund të lëviz me avion nga shteti në shtet .....(bisedë pa interes në vijim)*

216. Nga verifikimi në sistemin Tims, rezulton se ky shtetas ka ndryshuar mbiemrin nga "Dulia" në "Dulla", për shkak të problematikave që ka në sistemin Tims, konkretisht "*shënimeve të datës 14.04.2021, refuzuar dalja pasi rezultoni kthyer deportiv nga Franca, datë 06.11.2021 refuzuar dalja nga P.K.K Kapshticë, pasi rezulton i kthyer deportiv dhe datë 13.10.2020, kthyer si Deportiv në P.K.K Rinas, pasi është kapur në furgon mallrash në tentativë për kalim në mënyrë ilegale drejt Anglisë*". Ky shtetas rezulton të ketë kaluar në Kosovë me datë **06.06.2021** dhe është kthyer në Shqipëri me datë **06.09.2021**, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Rinas.

* * *

217. Në vijim të hetimeve, me vendimin nr. 47, datë 02.02.2022 të Gjykatës së Posaçme, është lejuar përgjimi ambiental audio dhe video i bisedave të punonjësve të policisë, bërë në vendin e ushtrimit të detyrës së tyre, në kabinat në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, zgjatur disa herë me vendim të gjykatë. Nga përmbajtja e procesverbaleve të transkriptimit të këtyre regjistrimeve audio dhe video si dhe përmbajtja e komunikimeve të administruara në kuadër të këtyre regjistrimeve, janë evidentuar veprime të punonjësve të policisë së PKK Morinë, nga muaji shkurt 2022 dhe në vijim, paraqitur në mënyrë kronologjike, si më poshtë:

DATË 08.02.2022

218. Në orën 15:26 të datës **08.02.2022** në kabinën nr. 4 ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, rezulton se është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Braha**. Në këtë moment paraqiten në sportel disa shtetas kosovarë të cilëve, përveç dokumenteve të identifikimit ju kërkon edhe autorizim për mjetin si dhe testet e vaksinës kundër Covid-19. Gjatë komunikimit me shtetasin të cilin e konstaton me mungese testesh covidi dhe mungese autorizim për mjetin rezulton mes tyre të jetë zhvilluar biseda si vijon:

Fatri Braha: *A keni ba vaksina ju?....Bjer vaksinat.*

Shtetasi KS:*...(Nuk dëgjohet përgjigja)*

***Fatri Braha**: Autorizimin për makinën. Ça ka makina?*
***Shtetasi KS:** Urdhëro, makina ka motorin ka defekt*
***Fatri Braha**: Do me nderru ee?*
***Shtetasi KS**: Po.*
***Fatri Braha**: Kur e keni ba këtë testin?*
***Shtetasi Ks:** Tashi e kena ba.*
***Fatri Braha**: S'ban ky. Ku është data të q....r.. data, data, dat 4. Jo or daje. Ka mbaru sot.....ke PCR.....ky asht test i thjeshte.*
***Shtetasi KS**: - Nuk kuptohen fjalët - .*
Fatri Braha**: **Ku e ki autorizimin për makinën?..Je shume i parregullt, hape krahun një herë
Shtetasin KS:A ban ne libreze me i fut?
Fatri Braha:Po or ti.

219. Nga pamjet filmike si dhe procesverbali i transkriptimit të komunikimeve dhe përshkrimit të pamjeve të regjistruara, rezulton se janë fiksuar veprimet e shtetasit kosovar që është në sportel duke i dhënë një kartëmonedhë 5 euro, të cilën punonjësi i policisë Fatri Braha e vendos para pajisjes skaner për dokumentet dhe sapo largohet shtetasi nga sporteli, e tërheq me dorë. Në intervalin kohor prej dy minutash që ka përpunuar këtë dokument në sistem, nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, në rubrikën e hyrjes për shtetasit e huaj rezulton se punonjësi i policisë Fatri Braha ka përpunuar dokumentet e shtetasit ***Lavdrim Halili*** i datëlindjes 19.09.1994, drejtues i automjetit auto veturë me targa *"04206IT/04194XC"*, e po ashtu në vijim regjistruar përsëri hyrje një minutë më vonë edhe me automjetin auto veturë me targa "04548GR", automjet i cili referuar bisedës si më sipër mbi defektet e mjetit, mund të ketë qënë i rimorkiuar në kushtet kur rezulton se të dy mjetet në një interval të shkurtër kohor kanë kaluar në drejtimin e të njëjtit shtetas, shtetasit Lavdrim Halili.

220. Në vijim, po në datë 08.02.2022, në orën 15:28 punonjësi i policisë Fatri Braha, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit respektiv, është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi tjetër kosovar, i cili i thotë gjatë bisedës se ka harruar edhe dokumente në shtëpi. Biseda mes tyre zhvillohet si vijon:

***BRAHAF**: Nuk du patentën, du vetëm kartën ose pasaportën.*
Shtetasi KS**: Kur nxora dokumentet, **goca si ka marrë.
***BRAHAF**: Ça me te bo?*
***ShtetasiKS**: ..i ka harrue.*
***BRAHAF**: Duhet një autorizim një here?*
***Shtetasi KS**: Po*
***BRAHAF**:Kthehu merre...ka jeni ju?*
***ShtetasiKS**: Ka harru dokumentet e vaksinën ...**pa test pa dokumentacion**?*
***BRAHAF**:Ça me bo? Këtë e ke po kartën s'ka vajza....*
***ShtetasiKS**: Aaa?*
***BRAHAF**: Ajo çika nuk ka karte me vete.*
***ShtetasiKS**;.....- nuk kuptohen fjalët-*

***BRAHAF**: Ça të kesh dëshirë, me zor jo...me dëshirë po.*

Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes, shoqëruar me fotografi, rezulton se në këtë moment shtetasi kosovar, brenda një flete të bardhë i vendos një kartëmonedhë në dukje si ajo 10-te euro, të cilën Fatri Braha e hedh para pajisjes skaner. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se Fatri Braha nga ora 15:28 min deri në orën 15:30 min ka përpunuar dokumentin e shtetasit kosovar ***Ardian Balaj*** i dtl 28.11.1980, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "01851LP", i vetëm, pa pasagjer. Pra rezulton të jetë regjistruar ndonjë pasagjere femër së bashku me të, ndërkohë që nga biseda si më sipër, rezulton se ai ka qenë i shoqëruar me një vajzë e cila nuk ka pasur dokument me vete.

221. **Në orën 16:21 min, të datës 08.02.2022**, punonjësi i policisë Fatri Braha është duke përpunuar dokumente shqiptare dhe shtetasi në sportel i thotë punonjësit të policisë Fatri Braha se do të ikë përsëri në Gjermani se ka makinë tjetër për të sjellë. Në kabinë hyn edhe një koleg tjetër të cilin Fatriu e thërret Arben, identifikuar si punonjësi i policisë Arben Goçi, pasqyruar me fotografi në procesverbalin e këqyrjes dhe në këto momente, është zhvilluar biseda si më poshtë:

***Shtetasi (shtetasi në sportel)**: Du me ik prape për në Gjermani, në Hungari.....(-fjalë që nuk kupohen-)*

***Polici (F.Braha)**: Po.*

***Shtetasi**: A je ne rregull. Du me ik prapë atje se kam makinëtjetërpër të sjellë. A e shef dot ti a duket gjë.*

***Polici**: Janë hi shume makina or djalë. Sa makina ke pru në Shqipëri ti?*

***Shtetasi**: - Përgjigje qe nuk kuptohet -*

Polici**: **Po s'lejohet mbi tre or mik.

***Shtetasi**: Po si s'lejohet o*

***Polici**: 1.2.3.4.5.6 çi ke këto makina vari .....r.....(në vijim bisedë që nuk kuptohet....)*

***Polici**: Ke ndonjë gjë në makinë?*

***Shtetasi** : Urdhëro?*

***Polici**: Në makinë ndonjë gjë që nuk lejohet ke?*

***Shtetasi**:....-fjalë që nuk kuptohet-*

***Polici**: ...do qesësh kafe.....a nuk ke gjë?*

***Shtetasi**: j..*

***Polici**: Shyqyr.*

Ndërkohë që është duke përpunuar dokumentin e dytë të identifikimit dhe është duke skanuar pasaportën në pajisjen skaner të vendosur mbi tavolinë, në kabinë hyn një tjetër punonjës policie, ndërkohë që Fatri Braha zhvillon me shtetasin në sportel:

***Polici (F.Braha)**: Ky djali a ka dokumente.. të tjera?*

***Shtetasi**: Po, pra ka leje qëndrimi për makinën.*

***Polici**: Ku e ka?.*

***Shtetasi**: Ta dhashë mor burrë.*

***Polici**: Çfarë dhe ti..??..*

Në vijim, për disa sekonda nga ora 16:24:18 min deri në orën 16:24:41 punonjësi i policisë thërret një shtetas tjetër, koleg, duke zhvilluar me të bisedën si vijon:
Polici (F.Braha): *O Arben....ee ka prure krej makina ky...sjell makina ky.*
Kolegu tjetër Arbeni: *Nuk kuptohet përgjigja*
Polici: *O Arben?*
Arbeni Goçi i drejtohet qytetarit: *Nga je ti?*
Shtetasi: *Nga Burreli (ne vijim bisedë qe nuk mund të transkriptohet).....deri në orën 16:25:49 min.*
Polici: *Ku është ai djali?*
Shtetasi: *Iku ne makinë.*
Në vijim punonjësi i policisë Fatri Braha i shpjegon kolegut të tij me emrin Arben që hyn në kabinë duke iu drejtuar me këto fjalë: "*I thashë tre makina nuk lejohet.*", dhe ndërkohë vijon bisedën me pasagjerin. Gjatë kësaj kohe pasagjeri që komunikon me të hedh një dokument, në dukje pasaportë, mbi tavolinën e punonjësit të policisë Fatri Braha, të mbyllur. Punonjësi i policisë Fatri Braha e merr dhe pasi e hap, nga brenda pasaportës bie një kartëmonedhe në dukje prerje 10-euro.

222. Sipas pamjeve filmike dhe bisedës së zhvilluar, dhënia e kartëmonedhës nëpërmjet futjes së saj në pasaportë, është bere nga shtetasi, ndërkohë që prezent në kabinë ka qenë edhe kolegu i Fatriut të cilit ai i drejtohet me emrin Arben, pasi, sipas bisedave është konstatuar se qytetari brenda periudhës gjashtë mujore ka kryer hyrje në R.Sh të disa mjeteve të cilat rezultojnë të pa zhdoganuara ka detyrimin që shtetasin në fjale menjëherë sa e konstatojnë ta dërgojnë të shoqëruar në ambientet e doganës për kryerjen e procedurave doganore. Në sistemin TIMS është bërë shënimi "*Ju kalua doganës për veprim*", ndërsa në rubrikën "hyrje shtetas shqiptare", në këtë interval kohor (*ora 16:21 deri ne orën 16:25 min*), janë përpunuar dokumentet e shtetasve *Rigert Agurim Lleshi* i datëlindjes 18.09.1997, drejtues i automjetit auto veturë me targa "IK506A" dhe shtetasit *Enes Agurim Lleshi* i datëlindjes 06.05.2002, pasagjer në të njëjtin automjet.

223. I pyetur në datë 18.07.2022, në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi ***Rigert Agurim Lleshi*** ka deklaruar se:"....*Unë në datë 08.02.2022 vija nga Gjermania së bashku me vëllain tim Enes Lleshi, nga Kosova për në Shqipëri nëpërmjet P.K.K Morinë. Automjeti me të cilin neve udhëtonim ishte tip "Ëolsvagen-Golf-5", dhe ishte me letra të regjistruara në emër të vëllait. Kur jemi paraqitur tek kabinat e punonjësve të policisë dorëzuam dokumentet, pasaportat tona, letrat e makinës, siguracionin dhe punonjësi i policisë më pyet se nga vini. Më pas kaloi biseda pak shoqërore dhe punonjësi i policisë me thotë që ke sjellë shtatë ose tetë makina. Pasi verifikoi dokumentet tona të udhëtimit aty kaluam për tek dogana, ku më kërkuan tranzitin e makinës. Aty tek tranziti agjenti doganor i Kosovës kishte bërë një gabim në lidhje me destinacionin e mjetit pasi kishte bërë Vorë-Tiranë e pastaj Kosovë dhe aty nuk e nxirrte me ngjyrë jeshile në sistem mjetin. Fola me agjentin doganor në Kosovë që kishte bërë tranzitin duke i sqaruar gabimin që kishte bërë dhe se duhej ti shkruante doganës shqiptare me e-mail që të ndryshonin shtetin e mbërritjes së tranzitit. Në doganë u vonuam dy orë derisa të kthenin*

përgjigje, pastaj më lejuan që të kaloja për në Shqipëri, pasi ktheu përgjigje pala Kosovare. Pasi kam pritur rreth katër orë në doganë në Morinë nga ora 12:00 jam nisur për në Tiranë së bashke më vëllain tim.....unë kam udhëtuar me automjetin "IK503A", ngjyrë e kuqe, ndoshta është hedhur gabimisht nga punonjësi i policisë, dhe kam kryer vetëm një hyrje në R.Sh me këtë mjet dhe e kam dorëzuar direkt tek personi që e kishte porositur për të blerë, kjo e dokumentuar me akt shit blerje.....nuk jam shoqëruar nga punonjësit e policisë për në doganë për të kryer veprimet doganore.....unë jam personi që i kam dorëzuar dokumentet punonjësit të policisë, por nuk i kam dhënë ryshfet. Nuk disponoj licencë për shitje automjetesh por thjesht sjell automjete për ndonjë të njohur". Të dhënat e paraqitura në deklarimin e shtetasit Rigert Lleshi nuk përputhen me ato të përftuara nëpërmjet përgjimit ambiental me audio dhe video, pasi gjatë komunikimit me punonjësin e policisë rezulton se është vetë Rigerti që i thotë se do shkoj të marr një makinë tjetër dhe gjatë dorëzimit të dokumenteve dokumentohet qarte nga pamjet filmike dhënia e një kartëmonedhë e prerjes 10-tëshe euro.

224. **Në orën 17:11 po të datës 08.02.2022,** në kabinën ku ende është duke punuar punonjësi i policisë **Fatri Braha** paraqiten disa shtetas kosovarë. Biseda e zhvilluar midis tyre dhe punonjësit të policisë, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve mes tyre, është si më poshtë vijon:

BRAHAF: *Ti je Arsimi ëë?*
Shtetasi KS: *Po*
BRAHAF: *Si e ke emrin ti?.*
Shtetasi tjetër Kosovar: ***Bajrush****.....dokumenti ka mbaru krejt*
BRAHAF*:A jeni tre veta?.*
Shtetasi KS: *Katër jemi*
BRAHAF: *Hape krahun pak uli xhamat se je me xhama te zi....****ma jep dokumentin ti***
Shtetasi KS:E ka harru
BRAHAF*: Shko mere qa ku e ki.....a e di familja që ka ik?*
ShtetasiKS: *E di*
BRAHAF:A keni bo vaksina ju? Testin?
Shtetasi KS*; Po e kemi...*
BRAHAF*: Po ato mbrapa? (për disa sekonda fjale qe nuk kuptohen ndërkohe që ju merr dhe telefonat e kontrollon vaksinat)*
ShtetasiKS; *Jo vaksinat i kena krejt te tre*
BRAHAF*: Njoni se ka as dokumentin as atë*
Shtetasi KS*; për nji kafe...*
Në këtë moment, nga pamjet filmike konstatohet se Fatri Braha merr në dore një dokument në dukje pasaportë, brenda së cilës është një kartëmonedhë prerje 10-te euro dhe e vendos para pajisjes skaner *dhe vijon duke pyetur :* ***Deri ku jeni tu shku mor?***
Shtetasi KS: *Deri te ditëlindja e axhes.*

Më pas marrin dokumentet dhe vijojnë udhëtimin për në Shqipëri. Sa më sipër, nga biseda e zhvilluar dhe pamjet filmike rezulton se njëri nga udhëtarët nuk ka pasur dokument identifikimi

me vete dhe po ashtu testet e Covid-it dhe është lejuar të kalojë, duke dhënë një kartëmonedhë prerje 10- euro punonjësit të policisë Fatri Braha.

225. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIM, rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se në këtë interval kohor nga punonjësi i policisë Fatri Braha janë përpunuar dokumentet e shtetasve kosovare *Arsim Jakupi* i datëlindjes 03.08.2000, *Bleon Hajdini* i datëlindjes 21.07.2000 i cili është edhe drejtues i automjetit me të cilin udhëtojnë të katërt shtetasit, auto veturë me targa, "05796FL", *Bajrush Zabelaj* i datëlindjes 22.12.1987, ndërkohe që pasagjeri i katërt nuk rezulton të jetë i regjistruar në sistemin TIMS pasi siç rezulton nga biseda dhe veprimet e ndodhura sipas pamjeve filmike, ai nuk ka pasur dokument identifikimi për të lejuar udhëtimin dhe megjithatë është lejuar të kalojë pa u regjistruar hyrja e tij në kufi.

226. Në vijim të veprimeve të kryera në datë **08.02.2022**në kabinën nr.2 ku është instaluar pajisja përgjuese audio dhe video ka kryer shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** i cili **në orën 17:34 min** është zëvendësuar në vendin e tij të shërbimit nga punonjësi **Dashnor Braha.** Punonjësi i policisë, i cili është i ulur në këtë kabinë Muhamet Cengu, identifikuar nga përpunimi i pasagjerit Florim Mustafa në orën 16:14, ngrihet nga karrigia e tij dhe i liron vendin kolegut të vet, **Dashnor Brahës**. Nga pamjet filmike është konstatuar se pasi çohet nga karrigia, fut dorën në xhepin e pantallonave dhe pasi nxjerr dorën në të mban një sasi monedhash, në dukje euro. Pasi e kalon atë shumë parash, prerje euro të palosura, në dorën tjetër, fut përsëri dorën e majtë në xhep dhe prej andej nxjerr një sasi monedhash në dukje hekuri, të cilat më pas i hedh në një çantë e cila gjendet mbi tavoline, me ngjyrë jeshile dhe material në dukje rrobë, çantë, e cila mbahet gjatë gjithë kohës nga punonjësi Dashnor Braha. Po ashtu, pasi fut dorën në xhep për herë të dytë, zbraz monedhat përsëri tek çanta ngjyrë jeshile. Në përfundim të këtyre veprimeve Muhamet Cengu del jashtë, ndërsa punonjësi i policisë i cili është i ulur para kompjuterit, çantën jeshile e vendos mbi çantën ngjyrë të zezë, të cilën e mbante në dorë kur hyri në kabinë, ndërsa çantën ngjyrë jeshile e kishte brenda në kabine mbi tavolinë punonjësi i policisë, i cili u largua. Midis tyre në këtë kohë zhvillohet biseda si më poshtë:

***M. Cengu**-O Dash?*

***Dashnor Braha**: He*

***M. Cengu:** hapi qat çantë bre me fut ca hekra.*

***M. Cengu**:...fillimisht fjale qe nuk kuptohen...Futi qitu(duke i zgjatur çantën ngjyre jeshile dhe duke e mbajtur hapur)*

227. **Në orën 17:54,** në po të njëjtën kabinë ku kryen shërbimin Dashnor Braha, hyn një shtetas i veshur me veshje civile dhe menjëherë shkon dhe prek çantën ngjyrë jeshile të vendosur mbi çantën e zezë mbi tavolinë. Nuk e hap çantën por ulet në gjunjë në kabinë. Bashkë me të shikohet të ketë hyrë edhe një punonjës policie identifikuar si Muhamet Cengu, i cili qëndron tek dera e kabinës dhe zhvillohet mes tyre biseda si më poshtë:

***Polici**: Hajde futi aty brenda ne çantë*

***Shtetasi**: **100 mije lekë pjesën tjetër euro do ti jap më pas**...(fjalë që nuk kuptohen). A nigjove.*

***Polici**: **Jo jo 100 mije lek. 9** (Pasi i jep lekët punonjësit të policisë që qëndron tek dera, shtetasi çohet në këmbë. Ndërkohë dëgjohet të bisedojnë)*

***Polici**: 100 mije lekë.....(fjalë që nuk kuptohen).*
Polici**: **edhe dhete mijë të tjera ma tepër.
***Shtetasi**: S'kam mo.*
Mbas këtij veprimi shtetasi lëviz edhe dy hapa me afër punonjësit të policisë që qëndron në këmbë (Muhamet Cengu), pasi nxjerr një telefon nga xhepi i majtë fut dorën edhe kontrollon në xhepa. Në vijim punonjësi i policisë **Dashnor Braha** i merr pasaportën e tij e mban mbi tavolinë. Shtetasi që është prezent në kabinën e shërbimit të punonjësit të policisë Muhamet Cengu, në të cilën në hyrje të saj qëndron edhe kolegu i tij Dashnor Braha, është identifikuar se është shtetasi *Ahmet Osman Ferati*, i datëlindjes 01.05.1984, i cili është përpunuar në sistem nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu dhe ka udhëtuar me automjetin tip fugon "AB480ET". Nga verifikimi i hyrje daljeve te këtij shtetasi rezulton se ai ka udhëtime të shpeshta me automjete të tipit fugon nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas, e ndër të tjera ka një shënim në sistemin TIMS si person i proceduar penalisht e i shpallur në kërkim (anuluar) për veprën penale *"Trafikim të armëve e municioneve"*.

DATË 09.02.2022

228. **Në datën 09.02.2022ora 21:35 min**, në kabinën nr. 4, ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, është duke punuar punonjësi i policisë **Dashnor Braha** dhe konstatohet që në sportel të jepen tre karta identiteti dhe një dokument në fletë formati A-4. Punonjësi i policisë merr një kartëmonedhë prerje 10-euro, e cila gjendej brenda fletës së formatit e vendos para pajisjes skaner dhe pasi i hedh një sy dokumentit sipas fletës së formatit A-4, diskuton pak me shtetasin por nuk rezulton se kryen veprime në sistem. Biseda mes tyre është si më poshtë vijon:
***Dashnor Braha**: Ku je tu shku ti?*
***Shtetasi Ks:** Në Vlorë*
***Dashnor Braha:** Avash, avash mos ik atje. E kam seriozisht, me u nal kush rrugës jo..ban ndonjë gabim rrugës edhe ke lloj lloj budallenjsh...**Sami eee.....**Ke marrë kopje ti vari lesht..*
Në këtë moment sipas pamjeve filmike punonjësi i policisë shikon dokumentin në fletën A-4" dhe shprehet :
***Dashnor Braha:** nuk pyet kerkush për këto fare,... vaksinat...*
Nga këqyrja e pamjeve filmike rezulton se shtetasit i ka dhënë një kartëmonedhë me prerje 10-euro punonjësit të policisë Dashnor Braha dhe nga këqyrja e sistemit TIMs si dhe nga veprimet e fiksuara në pamjet filmike nuk rezulton që ai ti ketë regjistruar në sistemin TIMS krahasuar me orën kur janë paraqitur këta shtetas në sportel orës që mban filmimi i kamerave.

DATË 10.02.2022

229. **Në orën 16 e 31 min të datës 10.02.2022** punonjësja e policisë **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** është duke komunikuar në telefon me sms ndërkohe që në përpunim pasagjerësh është ulur një punonjës tjetër i identifikuar si punonjësi i policisë **Arjan Sokoli.**Nga pamjet filmike rezulton se Mimoza qëndron brenda kabinës ndërkohë që mes tyre zhvillohet një bisedë, nga e cila është mundësuar transkriptimi në procesverbal i disa fragmenteve dhe konkretisht:

***Mimoza Shahinaj**: Me shkrujti prapë ai po....(fjalë që nuk kuptohen).....para datës 20, ka tre muj ky muhabet*
***Kolegu Arjan Sokoli**: - Fjalë që nuk kuptohen-*
***Mimoza**:**Në 29 i bie edhe me ka thënë 300 mije lekë**, ndërsa ai thotë për një javë thotë...sa i bie dhjetor, janar po dy muaj e gjysmë, e kam llafin që tha për një javë*
***Kolegu**: A nuk vjen aa?*
***Mimoza**: **S'di gjë unë mor nuk di gj....**djali i atij ..e ke nigju*
***Kolegu**: Po po e kam nigju....*
***Mimoza**: Nuk asht puna se hyrje dalje, kam familjar me të. **Po 300 mijë lekë**...po pse 300 mije lekë kaq e kam gjobën une...300 mije lekë i bëj ditëlindjen gocës ....ja blej dhuratë asaj pse t'ja fal këtij*
***Kolegu**: Bleja vajzës....(bisedë pa interes në vijim).*

230. **Në orën 16:47** në kabinë është ulur kontrollori me emrin **Arjan Sokoli** dhe ndërkohë vjen një shtetas kosovar i cili sqaron se ka marrë një makinë me qira dhe ju tregon dokumentacionin fotokopje. Ne vijim e vazhdon përpunimin e tij kolegia e tij Mimoza Shahinaj e cila ulet para kompjuterit dhe vazhdon shfletimin e kontrollin e dokumentacionit. Mimoza dhe kolegu i saj i kërkojnë librezën origjinale të mjetit të cilën shtetasi e kishte marrë me qira në Zvicër dhe kishte një kontratë qiraje fotokopje. Në komunikimin mes tyre shtetasi kosovar i shpjegon se nuk e ka dokumentin origjinal pasi asnjë kompani dhëniesh mjete me qira nuk të jep librezën origjinale të mjetit për shkak te tjetërsimit nga këta të fundit. Pas këtyre shpjegimeve ata i thonë shtetasit të hapë krahun dhe vijojnë përpunimin me pasagjerët e tjerë.

231. **Në orën 16:54:06 min**, në kabinën ku punon punonjësja **Mimoza Shahinaj** paraqitet një pasagjer i cili dorëzon dokumentet. Gjatë marrjes së dokumentit pasaportë Mimoza heq diçka, të ngjashme me kartëmonedhë 5 -euro, nga mezi i pasaportës dhe e fut poshtë tastierës së kompjuterit ndërkohë që vijon me regjistrimin e dokumenteve në sistem. Gjatë përpunimit të pasagjerit dëgjohet vetëm një përshëndetje nga ana e punonjëses së policisë Mimoza Shahinaj (Ismaili) dhe nuk ka kryer komunikime të tjera. Dokumenti i përpunuar këtë interval kohor është një pasaporte shqiptare dhe nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS rezulton se në orën 16:54 Mimoza Shahinaj (Ismailaj), ka përpunuar dokumentin e shtetasit *Ahmet Osman Ferati* i datëlindjes 01.05.1984 i cili udhëton me automjetin auto veturë me targa, "AB751CJ", banues në fshatin Bardhoc, Kukës i cili është i njëjti shtetas që është përpunuar edhe në datë 08.02.2022 nga punonjësit Dashnor Braha dhe Muhamet Cengu, pasqyruar më sipër. Nga verifikimi i hyrje daljeve të këtij shtetasi në sistemin TIMS ka rezultuar se ky shtetas udhëton pothuajse përditë me automjete fugon nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas, e ndër të tjera ka një shënim në sistemin TIMS si person i proceduar penalisht e i shpallur në kërkim (anuluar) për veprën penale "*Trafikim të armëve e municioneve*".

232. **Në orën 18:19:57** në kabinë paraqiten pasagjerë të tjerë të cilët i dorëzojnë dokumentet punonjëses së policisë **Mimoza Shahinaj**. Gjatë kësaj kohe dëgjohet kjo bisedë: ***Mimoza Shahinaj**: Sa veta jeni? **Shtetasi**: Tre **Mimoza**: Tre?...*

Në këtë moment Mimoza konstatohet se nxjerr nga dokumentet një kartëmonedhë prerje **10-euro** dhe e fut poshtë tastierës së kompjuterit, referuar pamjeve filmike dhe procesverbalit qe ka përshkruar këto pamje dhe transkriptuar bisedën si më sipër me datë 10.02.2022. Po ashtu konstatohet se në dorë mban një kartë identiteti shqiptare, por nga pamjet filmike nuk rezulton të kryeje veprime verifikuese apo regjistruese ne sistem mbi këtë dokument dhe udhëtarin që e ka dorëzuar atë dhe ka zhvilluar bisedën si më sipër.

233. **Në orën 17:03:49** të po kësaj date midis punonjëses së policisë **Mimoza Shahinaj** e cila është duke përpunuar pasagjerë në hyrje të R.Sh-së dhe një shtetasi tjetër, udhëtar, është zhvilluar kjo bisedë:

***Mimoza**: Atë e kam kthy. E kam kthy ate tha ca ti bej, i thashë di gjë unë, vetëm me këtë lloj dokumentacioni nuk të kaloj dot*

***Shtetasi Kosovar**: Dmth s'mund të kalojë?*

***Mimoza**: Vallahi s'di ça të them, me fotokopje....hajde mirupafshim*

***Kolegu i Mimozës**....-fjalë që nuk kuptohen-*

***Mimoza**: është ajo makina me targa të Zvicrës, Porchi*

***Kolegu**: Porshi?*

***Mimoza**: Po ai porshi aty.....*

Në vijim kolegu largohet dhe punonjësja Mimoza Shahinaj vijon bisedën dhe përpunimin me shtetas të tjerë, udhëtarë te radhës.

234. **Në orën 17:15:15 min të datës 10.02.2022** zhvillojnë këtë bisedë ne vijim:

***Mimoza**: Po ti ke hall mor burrë...si mun unë me të kalu ty amun të ma shpjegosh një cikë*

***Shtetasi Kosovar**: Jo në hall ty sdu me të kalu të paktën.*

Mimoza**: **Me fotokopje dokumenti pa siguracion, makina me targa të Zvicrës

***Shtetasi Kosovar**: ...në qoftë se atë siguracion e ka pas.*

***Mimoza**:**Tani i bie të të shpëtoj ty edhe të fus veten në qorrsokak**...*

***Shtetasi Kosovar**: Jo ashu...*

***Mimoza**: Po tani ca me të thanë*

***Shtetasi Kosovar**: Po tani brenda mundësive nëse munesh...*

***Mimoza**: Asnjë makinë nuk kalon me fotokopje ta them me sinqeritet.*

***Shtetasi Kosovar**: Ok e kuptoj e mora vesh, jam ka ta kuptu shumë në rregull*

Mimoza**:**tani nuk e di a ta shpjeguan edhe koleget e mi.

***Shtetasi Kosovar**: Po po ma shpjegoi edhe ai...nuk asht hera e parë kam qenë edhe para një muaji nëse mundesh me e shef aty. E atë kopje jam dalë 20 herë. Ngaqë kam familjen .....të njoftur, dal vij nuk më ka hap kush një problem edhe në Zvicër nuk ta japin origjinalin ngaqë munesh me e shet makinën.*

***Mimoza**: Mirë pra mirë në rregull e kuptojmë ne këtë pjesën edhe ajo me fotokopje edhe unë s'di ta ndaj tashi....Po të paktën e ke siguracionin se ai që ta jep makinën me qira, në rregull të paktën këtë pjesën e garancisë, se kur vinë nga jashtë makinat i shesin në Shqipëri...A jemi dakord tek kjo pjesa.*

***Shtetasi Kosovar:** E kuptoj e kuptoj ketë.*

***Mimoza**; Shife tani unë mbase potë akuzoj kot se as nuk të njof as një gjë, problem është si puna e asaj që afër të thatit digjet edhe i njomi. Mbase ty po të akuzoj kot nuk ke asnjë lloj qëllimi tek kjo pjesa po është kjo puna e kësaj.*
***Shtetasi Kosovar**: Shyqyr zotit as e kam menjen aty shyqyr*
***Mimoza**:Jam dakord ti je me pasaportë zviceriane. Ti tani nga po shkon?..*
***Shtetasi Kosovar**: Unë jam tu hik deri në Elbasan. Në Elbasan do lë makinën e nesër që në mëngjes do i hypi makinës unë edhe do shkoj deri në aeroport e do lëviz deri në Dubai , kam edhe biletat që i kam pre edhe ato mund ti shikosh*
***Mimoza**: ore*
***Shtetasi Kosovar**: Në datë 17 do marr makinën e do hik për Gjakovë e më pas për Zvicër*
Në kohën që zhvillohet kjo bisedë, vjen punonjës tjetër policie po ndërhyn, duke vijuar biseda si më poshtë:
***Kolegu**: Ca problem ka?.*
***Mimoza**: Është ky djali që kishte atë porshin*
Kolegu**: **Edhe ca? Ça problem. Mos u merr me. Tash a në punë kjo
***Mimoza**: Ka hall....*
Në vijim kolegu dhe shtetasi kosovar bisedojnë veç por nuk mund te transkriptohet kjo pjesë pasi është e paqartë. Biseda që dëgjohet vijon si më poshtë:
***Mimoza**; Rri rri mos e ngacmo*
***Kolegu**: Aaa?*
***Mimoza**: Mos e ngacmo*
***Shtetasi Kosovar**: Oj motër do me lejosh apo s'do më lejosh? Unë jam tutë respektu as bohet fjalë po meqenëse se ke brena mundësive.....(disa fjale qe nuk kuptohen)*
***Mimoza**: Aaaa. Po mirë ti herë të tjera nga ke kaluar?*
***ShtetasiKosovar**: Për zotin....(fjale që nuk kuptohen)*
***Kolegu**:... te thote, tek dhoima, tek dhoma ..*
***Mimoza**: E po thuaj atij hajvanit mor burrë. O Albert.*
***Kolegu**: Po*
Mimoza**: Po thuaj një herë Arjanit mor....O Arjan hajde pak bre.....Prit mor një herë duro se flas me Arjanin....Shife se i kam thënë jo unë e tashi ngul kamë edhe Alberti . **Është me fotokopje të dokumentit, makinën e ka me qira ..ka hy mo ka hy disa herë, ka hy më datë 6, ka hy më datë** 1..**jep tashi ore jep** ..**ti tashi...foli
***Kolegu**: - Fjalë që nuk kuptohen-*
***Mimoza**: Eeeee*
***Kolegu**: Ha*
***Mimoza**: I thashë Arjanit unë le të kaloje tek Arjani mos u ngatërro*
***Kolegu**: Aj tha s'kaloj tha....(fjalë që nuk kuptohen)*
Mimoza**: E **di mor burrë tashi unë i thashë do kaloj tek Arjani, pse ngul këmbe kot allah. Sipas bisedës të përgjuar shtetasin kosovar e ka marre përsipër për ta përpunuar punonjësi i policisë Arjan Sokoli dhe nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në këtë interval kohor që përkon

me bisedën, punonjësi **Arjan Sokoli** ka kryer përpunimin e vetëm një shtetasi pasqyruar më sipër dhe rezulton se në rubrikën "Shënime" në sistemin TIMS është bërë shënimi nga punonjësi i policisë Arjan Sokoli se *"Makina nuk disponon librezën origjinale nga është marrur me qera"*.

235. **Në orën 20:05 min, të datës 10.02.2022** në kabinën ku vijon shërbimin punonjësja e policisë Mimoza Shahinaj vjen një punonjës policie i shtetit kosovar, ku kryejnë bisedë mbi regjistrimin në kufi të një shtetasi maqedonas dalje dhe hyrje ne Shqipëri. Biseda e kryer midis Mimozës dhe policit kosovar është si më poshtë vijon:

***Polici KS**; Ça ke bërë mirë?*

***Mimoza**: Ça ke bërë ti mirë. Eee do na bësh ndonjë kshu si ato, si gjithmonë?*

***Polici KS:** Nuk e di qysh të them*

***Mimoza**: Ta marr një çikë atë unë ta shikosh edhe .....mos më rri sipër sa ti marr çikë ato të dhënat ....S'di për ku i ka në fakt, dalje a hyrje po ja ta shoh?.*

***Mimoza**: - Flet ne telefon- dhe dëgjohen ndër të tjera fjalët : i ke dalje a hyrje, aloooo...(disa fjale që nuk kuptohen).....ok në rregull*

***Polici** KS: He?..*

***Mimoza**: Dalje*

***Polici KS**:për mua?*

***Mimoza**: Tani ...me pasaportë maqedonase ...(fjalë që nuk kuptohen pasi ul volumin e zërit)*

***Polici Ks**: S' marr vesh*

***Mimoza**: Ule atë xhamin...është me pasaportë maqedonase do një dalje. Tani a me pagesë a pa pagesë nuk e di, po më ka thënë a di ndonjë që e bën. I thashë unë e rregulloj unë. A e ke njeri tatin tha.I thashë unë , pa problem s'mund të të jap ty ....Tani me pagesë apo pa pagesë, nuk të premtoj. Nqs ai më jep i ke të garantuara*

Polici KS**; Pore mos u merr me atë punë, mos e rr

***Mimoza**: Ai ..... se i thashë leja një kafe po nuk e di ça boni, se më vinte një çikë kështu me.... Po i thashë.*

***Polici Ks**: ...-fjale që nuk kuptohen-*

***Mimoza**: I thashë unë s'jam vetë se potë isha vetë të respektoja ....Ideja është që kur ti sjell ti sjell tamam. Kur e kam kështu që për të respektuar Ok. Kur s'ka*

***Polici KS:** ...-fjalë që nuk kuptohen-...*

Mimoza**: A e kuptove?* ***Se unë i thashë atij që të lutem ma respekto i thashë se ai e bën, jepi një kafe të vogël mos u ngushto i thashë

***Polici KS:**...-fjalë që nuk kuptohen-...poti ça ke bërë mirë nga shpia krejt*

Nga pamjet filmike, për bashkëbiseduesin si më sipër, në krahun e djathtë të uniformës dallohen simbolet e policisë kosovare, por nuk mund të dallohet fytyra e punonjësit të policisë dhe për pasojë nuk ka rezultuar i mundur identifikimi i tij.

236. **Në orën 07:16 min, po të datës 10.02.2022**, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, dhe është duke punuar punonjësi i policisë **Dashnor Braha** në sportel paraqitet një shtetas kosovar, ku brenda njërit prej dokumenteve që ata i vënë në dispozicion dallohet edhe një kartëmonedhë prerje 5- euro. Nuk zhvillohen bisedë midis tyre. Nga verifikimi në sistemin

TIMS rezulton se punonjësi i policisë Dashnor Braha në orën 07:17 min ka përpunuar dokumentin e shtetasit kosovar *Selami Dvorani* i datëlindjes 06.12.1977, drejtues i automjetit tip auto veturë me targa, "BEHD276", i cili është personi që i ka dhënë dokumentin e përshkruar me sipër dhe kartëmonedhën e prejes 5 euro.

237. **Në datë 10.02.2022, ora 08:31:03**, në kabinën ku është instaluar kamera nr. 7 që përkon me kabinën nr. 4, hyrje në R.Sh, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Dashnor Braha**, (BRAHAD). Gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi kosovar punonjësi i policisë konstatohet t'ju kërkojë dokumentacion mbi dozat e vaksinës kundër Covi-19, të cilat nga biseda rezulton se shtetasit kosovarë nuk i disponojnë. Në prezencë të kolegut të tij identifikuar me numrin"06420", Dashnor Braha merr prej tyre një shumë 10-euro, sipas pamjeve filmike. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se dokumenti i përpunuar, kohe gjatë së cilës është dhënë kjo shumë, i përket shtetasit kosovar *Kadri Krasniqi* i datëlindjes 20.02.1972, drejtues i mjetit me targë "05890FN". Ndër të tjera gjatë intervistimit, Dashnor Braha dëgjohet t'i thotë shtetasit kosovar fjalët: *"...kushton 35 euro.."*. Nga regjistrimi video kontrollori Dashnor Braha konstatohet pasi hap një dokument, në dukje si libreza e mjetit, nxjerr prej andej një kartëmonedhë të prerjes 10 euro të cilën e mban në dorë. Gjatë kësaj kohe zhvillohet biseda si vijon: ***Dashnor Braha*** *: Vaksinë ke?* ***Shtetasi kosovar:-*** *Nuk dëgjohet përgjigja-* ***Dashnor Braha:*** *Po duhen dy vëlla bëj testin.* ***Shtetasi kosovar****: Bej testii.* ***Dashnor Braha:*** *po kushton 35 euro.....je pa qejf aaa?..."* Ndërkohë, sipas pamjeve filmike vërehet se i kthen mbrapsht dokumentet dhe dallohet në dorën e majtë të tij një kartëmonedhë euro prerje 10-euro. Punonjësi i policisë që ka qenë prezent gjatë këtyre ngjarjeve, i cili sipas pamjeve filmike rezulton se mban numrin identifikues "06420", sipas verifikimeve rezulton se është Kapllan Dogjani, me detyrë trup shërbimi në stacionin e Policisë Kufitare Morinë.

238. Në datë **10.02.2022, ora 08:56,** në kabinën nr .4 hyrje R.SH ku është instaluar kamera nr. 7, ndodhet një punonjës policie me numrin identifikues "06598" dhe po ashtu në postin e punës në sportel gjendet punonjësja **Mimoza Shahinaj (Ismaili).** Sipas pamjeve filmike, në një moment punonjësi i policisë identifikuar nga numri i sipërcituar me emrin Elbert Palushi konstatohet duke i dhënë kontrollores të ulur në sportel një kartëmonedhë 5-euro dhe dëgjohet t'i thotë: "*Nji kafe*", ndërkohe që Mimoza e falënderon. Konkretisht zhvillohet kjo bisedë:

Mimoza: *u lodhe sot?*

Kolegu (Elbert Palushi)*: po ça të bëjmë punë.... Të kam çuar email*

Mimoza*: po, po*

Kolegu*: të kam çuar një kafe*

Dhe ndërkohë hap portofolin dhe nxjerr kartëmonedhë dhe ja jep operatores Mimoza Shahnaj.

Mimoza*: faleminderit.*

239. Në datë **10.02.2022, ora 10:18:47**, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh, konstatohet punonjësja e policisë **Mimoza Ismaili** gjatë përpunimit të dokumenteve të pasagjerëve, të cilët sipas verifikimet të kryer në sistemin TIMS, rezulton të jenë shtetasi *Naser Krasniqi*i datëlindjes 25.10.1982, drejtues i mjetit me targë "04466GF" dhe shtetasja *Qendrese Buzhala,* e datëlindjes 22.12.1982 pasagjere në të njëjtin automjet. Gjatë bisedës së zhvilluar mes tyre dëgjohet t'ju

kërkojë një kafe. Mimoza pasi hap një pasaportë të dokumenteve që ka në përpunim e sipër, nxjerr një kartëmonedhë në dukje e prerjes 5-eurodhe e vendos para aparatit të skanimit të pasaportave dhe kartave të identitetit. Kur i kthen dokumentet pasagjerit, kontrollorja Mimoza e merr këtë kartëmonedhë dhe e fut në xhepin e djathtë. Këto veprime shoqërohen me zhvillimin e bisedës si vijon:

Mimoza: *Makina e kujt është?*

Shtetasi: *e nipit*

Mimoza: *Ndonjë autorizim nuk ke ?*

Shtetasi: *nuk kuptohet*

Mimoza: *Po nga po shkoni?.....Shtetasi: Në Tiranë ...(fjale qe nuk kuptohen..)*

Mimoza: *Ndonjë vaksinë a keni?*

Shtetasi:- *nuk kuptohet-*

Mimoza: *Ah po ti paske për të na dhënë kafe paske për të martu, deri këtu në rregull, kur e ke dasmën mor?*

Shtetasi:..... *(nuk kuptohen fjalët)*

Mimoza: *Në tre Korrik?*

Shtetasi: *po*

Mimoza: *paske kohë, na meri çito (i jep disa dokumente) Vaksinat i patët mo?*

Shtetasi: *- Nuk kuptohet-*

Mimoza: *Nejse.*

Ndërkohë sipas pamjeve filmike rezulton se hap një pasaportë dhe nga ajo nxjerr një prerje kartëmonedhe ngjyrë jeshile dhe e hedh para aparatit të skanimit i kthen pasaportën duke i thënë: *Të trashëgohesh dhe mos ja nxi jetën burrit.*

240. **Në datë 10.02.2022, ora 10:29:38**, në kabinën ku punon kontrollorja **Mimoza Shahinaj (Ismaili)**me nr. 4, në hyrje në R.SH, hyn një punonjës tjetër policie i cili bisedon me Mimozën dhe del nga pjesa pas ekranit të kompjuterit dhe hedh një letër në kosh, duke sharë. Në këtë moment Mimoza hap disa dokumente për të përpunuar. Duke hapur këto dokumente, nga pasaporta lëshon në tavolinën e punës një kartëmonedhë të palosur e cila identifikohet se çfarë prerje është, e po në vijim pamjet filmike pengohen nga veprimet e kolegut të saj brenda në kabinë. Duke iu referuar minutazhit të pamjeve filmike me të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar se punonjësja Mimoza Shahinaj ka përpunuar dokumentin e shtetasit shqiptar *Gazmir Mehmet Gjoka* i datëlindjes 06.02.1986, drejtues i mjetit me targë "AA443OU".

241. **Në datë 10.02.2022. ora 10:37:31** në kabinën nr .4 ku është vendosur kamera nr.7 është fiksuar prezent edhe një punonjës tjetër policie i cili mban kodin identifikues"06912". Në këtë moment në sportel paraqiten tre shtetas për të përpunuar dokumentacionin e udhëtimit, shtetas kosovarë të cilët dorëzojnë tre karta identiteti kosovare. Midis të tjerash dëgjohet kontrollori kur i thotë se "***më kë borxhë një birrë***", duke i folur për mangësi dhe procedura dhe më pas përdor fjalor fyes në prezencë të punonjësit me kod identifikues 06912, identifikuar si Namik Idriz Mata. Biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë identifikuar si **Arjan Sokoli** dhe shtetasve kosovarë, ndërkohë që ndodhin veprimet si më sipër, është si më poshtë:

Polici Arjan Sokoli: *Makina në emer të kujt është ?.*
Shtetasi: *"…..Nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *Bjeni vaksinat, po, nga po shkoni?*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *Ca gjykate ëëë?*
Shtetasi *:…." nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *Vaksinat i kini ç'aty ,duhen të tre …… makinën e keni me qira*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *Ca problem ka ai zotnia në gjykatë ëëë?*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *Naimi njëtash duhet me e hap krahnë, Naimi dhe duhet me pa procedurat atje te …- nuk kuptohet- …mjetet . Ku e kini takimin ju në çfarë gjykate ju?*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *të bëj procedurat…ti shkruaj informacionin Tiranës oseee, skam catë bëj*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…*
Polici: *I shkruaj procedurat i çoj te shefi, i shkoj në Rinas atje… -nuk kuptohet-..*
Shtetasi: *Vonojnë?*
Polici: *Atë nuk e di unë, ça me bë dajë, procedurat janë procedura…ta kishit bërë më parë ju*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici:*Ça me bë unë ,unë nuk dyshoj un ,nuk kam asnjë problem unë me të , do shkojë në Tiranë, procedurat janë procedura*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici: *maksimumi një orë vonojn, sa shkojnë në Tiranë*
Shtetasi: *"…nuk kuptohen fjalët…"*
Polici:*Çatë bëj o dajë,ai i dini problemet ju? Ça me thënë daj një tash*
Në vijim zhvillohet debat i pa transkiptueshem.
Polici: *Në qoftë se kini po nuk kini ma kini borxhë një birrë.. u ….. robt…*
Rezulton sipas pamjeve filmike se punonjësi i policisë Arjan Sokoli e fillon verifikimin e dokumentacionit në orën 10:37 dhe e përfundon në orën 10:41. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj, nga intervali kohor ora 10:37 min deri në orën 10:41 min, rezulton të jenë përpunuar tre dokumente që i përkasin shtetasve *Muslija Kurteshi, Rrahim Berisha dhe Fatmir Berisha*, nga punonjësi i policisë **Arjan Sokoli**.

242. **Në datë 10.02.2022,ora 06:29:54**, sipas pamjeve të kamerës nr.207, rezulton se në kabinën ku është vendosur kjo kamer kontrollori i identifikuar si **Dashnor Braha,** gjatë përpunimit të dokumentacionit, merr një kartëmonedhë të prerjes 5-euro të vendosur brenda pasaportës në orën 06:29:53. Këtë kartëmonedhë kontrollori e heq nga pasaporta dhe e vendos mbi tavolinën e punës dhe më pas e merr me dorën e majtë dhe e vendos në xhep. Biseda e zhvilluar nga kontrollori Dashnor Braha me shtetasin kosovar, verifikuar në sistem si shtetasi *Arian Sopi* i datëlindjes 18.01.1985, drejtues i automjetit me targë 05991FH, është si vijon:
Polici Dashnor Braha : *kush është babagjyshi për shembull?*

***Shtetasi**: Baba i këti*
***Polici:**Ça punon ti vëlla me ca merresh*
***Shtetasi**: " Nuk kuptohen fjalët.... "*
***Polici:** Ti je bos o vëlla ....- nuk kuptohet-, kush të ka lyp valixhen ty?*
***Shtetasi**: " Nuk kuptohen fjalët"*
***Polici:** nuk e merr ti pamë vjedh një kamer.....*
***Shtetasi:** ëëë.....*
***Polici**: Nuk e merr ti pa më vjedh një kamer, tu rrit ndera rrugë të mbarë .*
Pas kësaj bisede, nga pamjet filmike rezulton se ai zgjat dorën, mer një pasaportë e hap dhe brenda saj ndodhet një kartëmonedhe e prerjes 5 euro, të cilën e heq nga pasaporta e lëshon në tavolinën e punës, duke iu drejtuar me fjalët: *Polici: Ik mos e vraj mendjen, tu rrit ndera rrugë të mbarë... pastaj shprehet ik o të q***".*
243. Në datë **10.02.2022. ora 10:58:47,** nga kamera nr. 207është regjistruar biseda audio midis kontrollorit **Arjan Sokoli** me një shtetas të paraqitur në sportelin ku ai po kryen shërbimin. Në këtë bisedë shtetasi i kërkon kontrollorit që të kalojë disa mallra për llogari të një shtetasi i cili thirret në bisedë si Flor Camaj. Kontrollori i thotë bashkëbiseduesit në sportel se:..."*mos bëj telefon se e kam gjithë natën ne përgjim, ça malli të kesh hajde dhe më thuaj mos më merr në telefon. Kur i kam mundësit hajde kalo".* Gjithashtu Arjan Sokoli i thotë këtij shtetasi se e njoh Florin dhe këmbëngul që të mos ta marrë në telefon. Shtetasi dëgjohet kur i thotë se: *"i paguan Flori".* Arjani dëgjohet kur i thotë *"Unë sot jam hajde kaloj kur të duash, nesër nuk kam shanse", "Mos me mer në telefon mos ja .... nënën", "unë të ndihmoj sa jam këtu, nuk hyj në pazar".* Shtetasi i thotë *"sa lek"* dhe Arjan Sokoli i përgjigjet: *" 10 lek, 1000 unë sa kam mundësi",* dhe biseda vijon:Arjani: *O zotëri sa herë të vish hape krahun e bisedojmë, telefonat i kemi në përgjim gjithë natën. Në qoftë se të ka çu me çu mallin hajde sa jam unë këtu jo në telefon, unë të shërbej sa kam mundësi, sot jam unë der në 8 të të darkës.* Në këtë kohë që është kryer kjo bisedë, nga verifikimi në sistemin TIMS ka rezultuar se kanë kryer veprime për përpunimin e dokumentacionit shtetasit Liridon Bajrami i datëlindjes 04.09.1991 drejtues i mjetit Fugon me targë 01583NJ dhe shtetasi Milot Pozhegu i datëlindjes 25.11.1981,drejtues i automjetit me targë 07630DR.Nga verifikimi i hyrje daljeve rezulton se ky shtetas kryen kalime të shpeshta drejt Kosovës me automjetin tip fugon.
244. **Data 10.02.2022, ora 06:33:53,** nga kamera 207 është regjistruar audio dhe video momenti kur zhvillohet një bisedë midis punonjësit të policisë i identifikuar si BRAHAD , **Dashnor Braha** dhe një shtetasi i verifikuar në sistemin TIMS ne rubrikën hyrje shtetas të huaj si *Faton Dragusha,* i datëlindjes 23.03.1983, drejtues i automjetit me targë, "01854SA", cili është paraqitur në sportelin e kësaj kabine për kryerjen e praktikës së udhëtimit dhe pasagjer në të njëjtin automjet shtetasi *Elis Zega* i datëlindjes 13.04.1989. Gjatë kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë **Dashnor Braha** dhe shtetasve kosovarë është si vijon:
***BrahaD**: Ç'e këtë kartë Astrit Gashi, këtu thotë Nazmi Maloku, unë su ni bie në të vëlla se ku e ke marrë këtë makinë ti? Këtu thotë Elbasan Unik. A mundesh me ma sqaru*

***Shtetasi**: Po, unë këtë kerr e kam marrë vella... - nuk kuptohet- ... do shkoj në ambasadë*
***BrahaD**: Unë të besoj,ju paguani lek se s'ta jep kush pa lek dhe nuk shifni se çfarë merrni, hajde ulu ti në vendin tim shif Astrit Gashi, thot Astrit Gashi nuk ekziston kurrkund, këtu thotë Elbasan UNIK shif ça thotë këtu, duhet të shkruaj dhe në librezë citu ,këtu thotë Nazmi Maloku, këtu Astrit Gashi. Suni bie në të kësaj makine ju ini tu shkue për hall ,unë pa fol me shefin këtë makinë nuk e nxjerr. Kam pas rast që e kanë gjet në Shkodër dhe më kanë pyet mue pse e ke lëshuar ti zotri*
***Shtetasi:** Normal normal*
***BrahaD**: I kanë çuar makinat në Shkodër dhe i kanë shit, hape krahun atje dhe do flas me shefin*
***Shtetasi:**....**ka kamera** ..-nuk dëgjohet-...*
***BrahaD:** Unë e di që shkon për hall, nuk e... ke fajin ti or, nuk shikojmë se japim lek dhe çfarë marrim, do ta zgjidhim.*
Në këtë bisedë, sipas bisedës punonjësi i policisë **Dashnor Braha** konstaton parregullsi në dokumentacionin e mjetit dhe merr dokumentet dhe i vendos në krahun e djathtë të tavolinës së punës dhe shtetasit i thotë të hap krahun. Në vijim të kësaj praktike të përpunimit të dokumenteve, në orën 06:52:56 ky shtetas është paraqitur në kabinë dhe i ka dhënë kontrollorit Dashnor Braha një kartëmonedhë të prerjes 5 euro të cilën Dashnori në fillim e ka vendosur poshtë tastierës dhe gjatë kësaj kohe zhvillohet biseda si vijon:
***Braha:** Ti në ambasade je tu shku or babush s'di qysh me ja bo me tle këtu....*
Ndërkohë, sipas pamjeve filmike rezulton se vazhdon të kryejë veprimet në sistem me kartën e identitetit të shtetasit dhe biseda vijon:
***Shtetasi KS**: Aa*
***Braha:** Bonja qysh të dush, edhe ik o babush, ca me te bo me te lenë këtu*
Shtetasi KS:....nuk kam shumë
Braha:Aaa po shif sa të dush o babush
ShtetasiKS:A mi jep dokumentet...
245. Në datë **10.02.2021 ora 06:53:03**, në kabinën nr. 4 është regjistruar audio dhe video një bisedë midis punonjësit të policisë Dashnor Braha (BRAHAD) dhe një shtetasi shqiptar i verifikuar në sistemin TIMS si *Hashim Qemal Jorgji* i datëlindjes 12.06.1960 drejtues i automjetit me targë AA826EY,i cili i jep për përpunim dy pasaporta. Në pamjet filmike konstatohet se Dashnor Braha pasi ka hapur njërën prej pasaportave dhe tjetra është e vendosur te aparati i skanimit, ka nxjerrë një kartëmonedhë por nga pamjet rezulton e pamundur të identifikohet se çfarë prerje dhe e ka vendosur mbi tavolinë. Dashnori dëgjohet kur thotë *"fute një dhjetëshe aty një dhjetëshe të kuqe"* dhe më pas *"ik mor burrë bjer makinën atje"*, po kështu dëgjohet edhe zëri i një femre nga sporteli por që nuk transkriptohet. Biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë Dashnor Braha dhe shtetasit me emrin Hashim Jorgji është si më poshtë:
***Dashnor Braha**: Futi një dhjetëshe aty një dhjetëshe të kuqe, kthehu mbrapsht (duke iu drejtuar shtetasit Hashim Jorgji)*
***Dashnor Braha**: A po imer dhe këto aaa.. pa hile e kam (duke iu drejtuar shtetasit Faton Dragusha, të cilit i kish marrë dokumentet dhe i mori 5 euro sic përshkruhet në rastin më sipër)*

***Shtetasi**: jooo, yyy*
***Dashnor Braha**: Tu rrit ndera (drejtuar shtetasit Faton Dragusha, dhe ndërkohë me dorën e majtë merr të dyja kartëmonedhat duke mos e shkëputur dorën nga tavolina)*
246. Sipas pamjeve filmike të fiksuara nga kamera nr. 207, në date 10.02.2022, ora 07:25 min është filmuar punonjësi i policisë Dashnor Braha duke numëruar një shumë eurosh, dhe ndërkohë dëgjohet të shprehet me fjalët : *Dashnor Braha: Nuk më ka bërë vaki robtë e shtëpisë që tetë vjetë sot ... dhjet, pesëmbëdhjete, tridhjetë..".*

DATË 11.02.2022

247. **Në orën 14:49:06 min,** në kabinën në hyrje të R.Sh-së paraqiten tre shtetas të cilët i dorëzojnë dokumentet punonjësit të policisë në shërbim identifikuar si Bedri Duraku. Gjatë marrjes së këtyre, nga pamjet filmike, dokumenteve konstatohet se në mesin e njërës pasaportë është një kartëmonedhë në dukje euro ngjyre jeshile. Punonjësi i policisë pasi e merr dhe e vendos në cepin e sipërm të tastierës, para pajisjes skaner dhe pasi kryen regjistrimin e dokumenteve dhe jua dorëzon pasagjereve, i tërheq drejt vetes këto para. Po ashtu është dokumentuar me fotografi edhe momenti kur tërheq eurot. Biseda midis tyre ka qenë thjesht pyetje për destinacionin e udhëtimit dhe përshëndetje. Në orën 14:59 e cila përkon dhe me përpunimin e tre dokumenteve në sistem dhe ne pajisjen skanuese, rezulton si veprim të jetë kryer nga punonjësi i policisë Bedri Duraku dhe dokumentet i përkasin shtetasve kosovare *Burim Bajrami* i datëlindjes07.11.1984, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "01675QI", pasagjerë më të në të njëjtin automjet janë shtetasit *Naim Metolli* i datëlindjes 14.05.1976 dhe *Vlamir Gashi* i datëlindjes 19.06.1983.
248. Në orën **13:41 të datës 11.02.2022**, në kabinën ku është instaluar kamera nr. 7 dhe është duke punuar punonjësi i policisë Berdi Duraku (DURAKUB), paraqitet një pasagjer i cili fillimisht jep kartën e identitetit e me pas një dokument ngjyrë jeshile brenda së cilës, sipas pamjeve filmike, dallohet një kartëmonedhë me prerje 50 euro. Nga mënyra e komunikimit kuptohet se shtetasi është i huaj dhe nuk kupton mirë shqip. Punonjësi i policisë i kërkon vaksinën edhe kartonin dhe nga biseda dhe veprimet në vijim kuptohet se ky shtetas nuk i disponon. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në orën 13:41 min nga punonjësi i policisë Bedri Duraku është përpunuar dokumenti i shtetasit çek *Dejan Ristic*, i datëlindjes 29.08.1975, drejtues i automjetit auto veturë me targa, KS173ZD. Punonjësi i policisë pasi merr dokumentin, e hap me kujdes me të dyja duart dhe kartëmonedha hidhet para pajisjes skaner.
249. Në orën **15:47:51 të datës 11.02.2022** paraqiten në sportel pasagjerë dhe i japin punonjësit të policisë **Bedri Duraku** disa dokumente të cilat dallohen nga pamjet filmike dhe procesverbali i transkriptimit shoqëruar me fotografi, të jenë pasaporta dhe disa letra të bardha. Pasi kryen kontrollin e tyre, punonjësi i policisë hap njërën prej pasaportave dhe prej saj del një kartëmonedhe prerje 10-euro. Biseda e kryer midis punonjësit të policisë Bedri Duraku dhe shtetasit drejtues të automjetit, sipas procesverbalit ë transkriptimit të komunikimeve të regjistruara audio dhe video, rezulton si më poshtë:
***Bedri Duraku**: A ke letërnjoftim a pasaporte aa*

***Shtetasi**: Kam .A munesh me na nimu mos me na regjistru*
***Bedri Duraku**: Te tre mo?*
***Shtetasi**: Po*
***Bedri Duraku**: Pa 100.....jo shok jo*
***Bedri Duraku**: Po bjere mo.....(për disa sekonda bisedë që nuk kuptohet)*
Ne pamjet filmike dallohen se punonjësi i policisë kryen kontroll për tre dokumente pasaporta.
Bedri Duraku**: Tre vete tre pasaporta, mos me të regjistru tre vete?* ***Një person jo tre. Je shumë larg. Shumë larg je.
Sipas pamjeve filmike këto fjalë thuhen pasi shikon shumën e parave që i është dhënë nga tre shtetasit dhe ndërkohë që i thotë këto fjalë hap njërën prej pasaportave. Pasi i shtyn paratë me dorë para pajisje skaner dhe ndërkohë i thotë... *"Je larg, larg je","O djalë je shumë larg një person mos me u regjistru 50 euro bën".*
***Bedri Duraku:**O djalë unë s'po du me ju prish punë, po një person mos me u regjistru 50-euro bën, ik kësaj rradhe ....nuk ke hy në Shqipni, kështu që një person për mos me teee...*-(fjalë që nuk kuptohen)-*..50 euro.Kështu që ju tre veta .....*
Pas këtij veprimi, sipas pamjeve filmike shihet se tërheq lekët duke i futur poshtë tastierës që ka vendosur tek skaneri ndërkohë që pasaportat jua ka dhënë, pasi erdhi pasagjeri i radhës. Përpunon pasagjerin e radhës dhe paratë që ka vendosur në cep të tastierës i tërheq në vijim. Nga këqyrja e sistemit TIMS në fashën orare që kanë ndodhur pamjet si më sipër sipas kamerave, nuk është e mundur të kryhet verifikimi i shtetasve pasi nuk janë kryer regjistrime në sistemin, duke qenë, sipas bisedës së transkriptuar më sipër, kjo arsyeja pse është dhënë shuma e parave.
250. **Në orën 13:10 min të datës 11.02.2022** në kabinën nr. 4, ku është instaluar kamera nr. 7, punonjësi i policisë që kryen shërbim në këtë kabinë, identifikuar si **Bedri Duraku**, gjatë përpunimit të dokumenteve, në njërin prej tyre (pasaportë) nxjerr një kartëmonedhë 5-euro dhe e vendos para pajisjes skaner. Duke krahasuar orën dhe numrin e dokumenteve që ka përpunuar në këtë interval kohor, sipas pamjeve filmike, me veprimet verifikuese të kryera në sistemin TIMS, sipas informacionit nga rubrika hyrje shtetas të huaj *(katër dokumente),* rezulton se verifikimet i ka kryer punonjësi i policisë ***Bedri Duraku*** dhe shtetasit që janë përpunuar në këtë hark kohor janë: *Granit Popova* i datëlindjes 22.07.1991, drejtues i automjeti auto veturë me targa "01444GQ" dhe pasagjerë shtetasit, *Auron Popova* i datëlindjes 30.06.2000, *Gentian Ajazii* datëlindjes 24.11.1993 dhe *Faton Halimi* i datëlindjes 11.10.2000. Rezulton se dokumentet e përpunuara të këtyre tre shtetasve janë tre karta identiteti dhe një pasaporte, në të cilën është konstatuar edhe shuma prej 5- euro, si më sipër, dokumenti i cili, krahasuar me veprimet në sistem rezulton se shtetasi i fundit që është përpunuar dhe mban këtë dokument është Faton Halimi.
251. **Në datë 11.02.2022 ora 08:23:19** në kabinën në hyrje të R.Sh, ku është instaluar pajisja përgjuese me nr. 6, kabina nr. 2, dhe nga regjistrimi audio dëgjohet të diskutohet midis punonjësit të policisë në shërbim dhe një shtetasi, për regjistrimin e një pasagjereje e cila nuk ka dokument, por që në vijim punonjësi i policisë e pyet shtetasin që diskuton nëse ja ka shkruar emrin në listë. Nga verifikimi në sistemin TIMS mbi veprimet e kryera në këtë hark kohor që

përkon me pamjet dhe regjistrimin audio dhe video rezulton se punonjësi i policisë në shërbim është **Endrit Uka**. Midis tij dhe shtetasit është regjistruar kjo bisedë:
***E.Uka**: Si e ke emrin ajo?*
***Shtetasi**: ...-Nuk dëgjohet-..*
***Polici**: Mbiemrin?*
***Shtetasi**....- nuk kuptohet-..*
***Polici**: Hajde u kry eeee.*
Shtetasi: Këto me ditët e qëndrimit mos i regjistro, se kur të shkoj në Rinas del i paregjistrum
Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se këto veprime janë kryer nga punonjësi i policisë **Endrit Uka** dhe shtetasja e pasqyruar në fotografi, sipas pamjeve filmike, fiksuar edhe në procesverbalin e këqyrjes, nuk rezulton të jetë e regjistruar në hyrje të Republikës se Shqipërisë në datë 11.02.2022 ora 08:25 min, pasi në atë orë në sistem nuk janë kryer veprime regjistruese në hyrje nga punonjësi i policisë Endrit Uka.

DATË 12.02.2022

252. **Në datë 12.02.2022, ora 15:00:21,** në kabinën nr. 4 ku është instaluar pajisja përgjuese në hyrje të R.Sh-së është regjistruar audio dhe video momenti kur kontrollori **Muhamet Cengu,** pasi i ka marrë dokumentet për përpunim, bisedon me një shtetas nga Kosova të cilin nuk e regjistron, por i merr një kartëmonedhë të prerjes 10-euro pasi ai e kishte vaksinën në celular dhe Muhameti dëgjohet kur i thotë: *"S'bën në celular se na duan me fotokopje".*
Sipas pamjeve filmike, kontrollori Muhamet Cengu, pasi ka marrë pasaportën për përpunim ka lëshuar në tavolinën e punës një kartëmonedhë të prerjes 10-euro dhe pasi disa sekondash e ka marrë më dorën e majtë këtë kartëmonedhë duke e futur në xhep. Nga regjistrimi video rezulton se kontrollori nuk vendos asnjë dokument në skanim, gjë që ka bërë të pamundur identifikimin e shtetasit që ka kaluar kufirin në këtë moment dhe që ka dhënë shumën prej 10 euro në drejtim të punonjësit të policisë Muhamet Cengu. Biseda e zhvilluar mes tyre gjatë këtij episodi është si më poshtë:
***Muhamet Cengu**: A je tu shku për të xhiru ndonjë film aaa?*
***Shtetasi:** po.*
***Muhamet:** Ca filmi aa?*
***Shtetasi**: Jo film... -nuk kuptohet-*
***Muhamet**: Hotel Tirana aaa. Rrugë e mbarë*
253. **Në datën 12.02.2022, ora 15:08:14,** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH, ku është instaluar kamera nr. 7, në sportel është paraqitur një shtetas kosovar duke udhëtuar me automjet. **Kontrollori Muhamet Cengu**, i cili rezulton në shërbim në këtë moment, sipas veprimeve të kryera në sistemin TIMS, dëgjohet kur i pyet shtetasit: "***Nga po shkoni o gjiganta",***dhe njëherësh duke marrë dokumentet për përpunim i pyet dhe për vaksinat duke iu drejtuar me fjalët: "***Nga tre apo nga dy? " dhe "Autorizim të makinës.".*** Po ashtu, në vijim të komunikimit, pyet për një pasagjer me kapele për të cilin shtetasit nga Kosova i thonë që është futbollist. Sipas

pamjeve filmike kontrollit është fiksuar kur hap dokumentet dhe nxjerr një kartëmonedhë të prerjes 20-euro të cilën e lëshon para tastierës së kompjuterit dhe pas disa sekondave e tërheq drejt vetes. Shtetasit nga Kosova kontrollori nuk i regjistron në aparatin e skanimit, gjë që e ka bërë të pa mundur identifikimin e tyre. Biseda mes tyre zhvillohet si më poshtë:

Muhamet Cengu : *Si kaluat o gjiganda... nuk kuptohet...nga po shkoni? A i keni vaksinat?*

Shtetasi: *Po po*

Muhamet: *Nga tre a nga dy?.*

Shtetasit: *- Nuk kuptohet-*

Muhamet:*...Makina, autorizim*

Shtetasit: *Nga Kosova*

Muhamet: *Ku punoni ju, ca pune bëni?*

Shtetasit:*-Nuk kuptohet-*

Muhamet: *Oooë po ai rrepisti me kapele*

Shtetasit: *Ky lun futbollin.*

Muhameti: *Rregulloje ni diçka (duke i dhënë dokumentin mbrapsht)*

Muhamet: *Sa ka shkuar kilja e mishit në Kosovë?*

Ndërkohë sipas pamjeve filmike në këtë moment merr mbrapsht dokumentin dhe brenda tij konstatohet të jetë vendosur një kartëmonedhë 20-euro e cila vendoset para pajisjes skaner.

Shtetasi: *-Nuk kuptohet-*

Polici: *Më keq se në Shqipëri ëëë*

Polici: *Krejt Kuksi e mer.. nuk kuptohet*

Pas kësaj bisede u jep dokumentet e përpunuara. Menjëherë pas këtyre shtetasve për të cilët Muhameti rezulton se nuk kryen regjistrime në sistem dhe përkojnë me intervalin kohor 15:05 deri në orën 15:07 min, punonjësi i policisë Muhamet Cengu përpunon dy pasagjerë të tjerë, shtetas kosovarë, një shtetase femër dhe një shtetas mashkull. Duke krahasuar veprimet e tij në sistemin TIMS nga ora 15:05 deri në orën 15:08 që ka regjistruar këta dy udhëtare, nuk konstatohet të jenë kryer regjistrime shtetasish në hyrje pavarësisht se nga pamjet filmike është konstatuar përpunimi i tyre dhe marrja e shumës 20 euro, si më sipër.

254. **Në datën 12.02.2022,në orën 09:46:58**, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se në kabinë vijon ende të kryejë shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** dhe ndërkohë i pranishëm është edhe një koleg i tij me nr. identifikues **05657**. Gjatë kësaj kohe konstatohet të kalojnë një numër i konsiderueshëm shtetasish për të cilët punonjësi i policisë nuk kryen veprime verifikuese për dokumentacionin në sistemin TIMS por i pyet verbalisht nëse kanë vaksinat dhe pasagjerët i thonë po, ndërsa ai ju përgjigjet, ***"Ec, ec".*** Gjatë kohës që në sportel paraqitet një shtetas për përpunim të dokumentacionit, punonjësi i policisë Muhamet Cengu e pyet nëse i kanë bërë të dyja dozat e vaksinës. Pastaj e pyet nëse testet i disponojnë edhe fëmijët, mbi gjashtë. Pasi merr një shumë prej 5 euro, kontrollori i porosit që po të kapi kush në rrugë t'i thotë i kam harruar te policia ose më kanë humb edhe dokumentet. Pastaj vendos dokumentet në krahun e djathtë të tavolinës së punës në afërsi të pultit të kondicionerit dhe këto dokumente i merr kolegu dhe kur largohet nga kabina dëgjohet

kur i thotë kontrollorit *"pi një kafe"* dhe kontrollori ka në dorën e majtë një kartëmonedhë të prerjes 5-euro. Kolegu i tij prezent në kabinë është verifikuar të jetë punonjësi i policisë Avni Tërshalla. Sipas verifikimeve në sistemin TIMS, në këtë kohë kur është kryer ky veprim nuk ka persona të regjistruar në sistem nga kontrollori **Muhamet Cengu**. Biseda e regjistruar mes kontrollit Muhamet Cengu dhe shtetasve, paraqitet si më poshtë:

M.Cengu: *A i keni nga dy vaksina krejt, kret aa?*

Shtetasi Ks: *Po.*

M.Cengu:*Fëmijët mbi 6 vjeç, a ni, a ka test, jo ëë?*

Shtetasi KS: *...-nuk kuptohen fjalët-*

M.Cengu: *Nëse asht mbi gjashtë duhet test, kontroll...test.....Ku punoni ju?*

Shtetasi KS: *...-nuk kuptohen fjalë-*

M.Cengu: *Dmth mbi 6-shtë a është mbi gjashtë. Duhet një test me e pas se ka kontroll rrugës ....Eee sot s'jam tu të kthy mbrapa.* ***Nëse të ndalon kush rrugës thuaj e kam pas testin atje tek policia thuaj, më ka ngel aty ose më ka humb****....Hec më para e hajde merri dokumentet hajt....*(ndërkohë i mban dokumentet dhe i kalon ne krahun e djathte te tavolinës së punës në cepin e saj). Ndërkohe ju thotë udhëtareve të tjerë për të cilët nuk kryen kontroll, ***"Ec, ec".....".....Si kalove ec".....tjetri, "Ec".....".....Ec".*** Pasi pyet edhe një udhëtar tjetër për dokumentet por që sërish nuk kryen veprime në sistem nga dera e brendshme e kabinës hyn shtetasi të cilit i ka mbajtur dokumentet të cilit dëgjohet t'i thotë: ***"Se kam regjistruar"***

Shtetasi: Të lutem një kafe.....

M.Cengu: Hajt shet.....

Avniu: Rruga mbare..

255. Menjëherë pas këtij rasti **në orën 09:49 min** punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** kryen të njëjtin veprim me një shtetas tjetër kosovar të cilin e pyet nëse ka testet kundër Covid e në mungesë i mban dokumentet. Shtetasi në vijim vjen tek sporteli dhe i jep një kartëmonedhë. Biseda e zhvilluar me të është si vijon:

M.Cengu: *Si kalut? A i keni vaksinat*

Shtetasi: ***Testin se kom ba vlla e kam harru pasaportën ne shpi ...pasha t'madhin zot***

M.Cengu: *Ku punon ti?*

Shtetasi: *Në bankë*

M.Cengu: *Ca pune bën në bankë?*

Shtetasi: *unë jam supervizues banke*

M.Cengu: *Hec përpara hajde merri dokumentet këtu (njëkohësisht i mban dokumentet e udhëtimit)*

Sipas pamjeve filmike rezulton se vijon duke mos regjistruar dhe duke mos verifikuar dokumentet e udhëtareve të tjerë të cilëve iu drejtohet me fjalët: ***"A i keni vaksinat Ec....".....".....Ec"....".....Ec".....".....A i keni vaksinat, po ëë, ec".*** Në vijim shtetasi të cilit i janë mbajtur dokumentet vjen tek sporteli dhe dëgjohet t'i thotë policit Muhamet Cengu: ***"40 ero hajt,"*** ***Polici:*** Faleminderit. Ky moment është fiksuar vetëm nëpërmjet regjistrimit audio pasi nuk pasqyrohet në pamjet filmike.

256. **Në datë 12.02.2022, ora 09:52:36** në kabinën nr. 4 hyrje në R.Sh vijon të kryejë shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu.** Midis kontrollorit Muhamet Cengu dhe një shtetasi shqiptar i verifikuar në sistem si *Ardit Bajaziti* i datëlindjes 07.09.1990 drejtues i automjetit me targë AG329417 zhvillohet një bisedë gjatë së cilës qytetari i kërkon kontrollorit të kalojë një auto veturë pa targa dhe pa doganë. Në bisedë dëgjohet që Arditi i thotë kontrollorit ***"...të jap dhe një kafe tjetër".*** Arditi kërkon të kalojë një makinë pa targa pasi targat i ka kthyer mbrapsht. Gjithashtu, Arditi i thotë, ***"o vëlla doli makina iku".*** Po kështu, kalon dhe automjetin e tij me targa shqiptare të cilën e drejton një shtetas tjetër. Në pamjet video rezulton se kontrollori Muhamet Cengu merr një kartëmonedhë e cila nuk mund të identifikohet se çfarë prerje ka dhe e vendos fillimisht poshtë tastierës dhe më pas çon tastierën dhe e merr me dorën të mbyllur. Nga verifikimi në sistemit TIMS rezulton se shtetasi Ardit Bajaziti kishte shkelur afatet e qëndrimit në vendet e BE. Midis këtyre shtetasve është kryer biseda si më poshtë që fillon në orën 09:52:36:

Muhamet Cengu: *Pa doganë aaa?*
Ardit Bajaziti: *pa doganë tani u futa.....nuk kuptohet*
Muhamet Cengu: *E ke të noterizue*
Ardit: *Po*
Muhamet Cengu: *në sa kopje?*
Ardit: *Unë tani e mora timen.*
Muhamet Cengu: *Ku e ke marë mo?*
Shtetasi: *... nuk kuptohet*
Muhamet Cengu: *A ke autorizim a no një gjëë ooo?.*
Ardit: *nuk kam se.... nuk kuptohet*
Muhamet Cengu: *Jooo, joo*
Ardit: *Ore do ta bëj me doganë për zotin se andej jam liçens në Shqipëri unë*
Muhamet Cengu: *Ej o njësh se nuk lejohet kështu o njësh*
Ardit: *do ta bëj me doganë për zotin*
Muhamet Cengu: Qysh me ja bëa do me u regjistru ky këtu?..
Ardit: po pra do ta regjistrosh në emrin e atij jo në emrin tim
Muhamet Cengu: *Po në emrin e atij po nuk lejohet pa autorizim*
Ardit: E di unë që nuk lejohet pa autorizim
Muhamet Cengu: Ç'a me bë unë
Ardit: Të jap dhe ndonjë kafe tjetër unë pa le të ikim mos na vono për zotin, pa me atë punoj unë me Gjermanin, Luksenburgun
Muhamet Cengu: Ma jep pak, fut diçka këtu kujdes dil ka dera, a është me targa makina a pa targa?
Ardit:Pa targa
Muhamet Cengu: *Pa targa ë*
Ardit:O vëlla doli makina iku
Muhamet Cengu: *po targat ku i ke?*

Ardit: *Po targat i mori mbrapa ai në Kosovë*
Muhamet Cengu*: po qysh me e regjistru do e ndal dogana makinën pa targa,*
Arditi*: në emrin e atij shkruaje... nuk kuptohet, ore ta kaloj ai kosovari makina ime me targa shqiptare.*
Muhamet Cengu*: Hajde lënë një kafe, ku i ke targat*
Arditi:*.... Jam me targa prove*
Muhamet Cengu*:Ç'jan ato targa prove*
Arditi*: jan ato me liçensë që punoj, që ka makina*
Muhamet Cengu: *Ooo*
Arditi*; po ore*
Muhamet Cengu*: këtu është targa AK në Shqipni aa?..*
Arditi*: nuk kuptohet... I ve targë prove jam me liçensë*
Muhamet Cengu: *Ik mbarove.*

257. **Data 12.02.2022, ora 13:55:23,** sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio dhe video rezulton se midis kontrollorit i cili ndodhet në këtë kabinë i verifikuar në sistem **BRAHAF, Fatri Braha**dhe një shtetasi i cili është paraqitur në sportel i pa regjistruar dhe pa automjet. Shtetasi dëgjohet kur thotë se pret autobusin, ndërsa kontrollori Fatri Braha dëgjohet kur i thotë: "*...për mua ik, je i lirë po gjete autobuz...*". Nga pamjet video është fiksuar kontrollori Fatri Braha duke marrë një kartëmonedhe 10 euro të cilat duken së bashku me disa dokumente në krahun e djathtë të tavolinës së punës.

258. **Datë 12.02.2022 ora 13:58:01,**në kabinën nr. 4 ku është instaluar pajisja përgjuese konstatohet se është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Braha** dhe në sportel është paraqitur shtetasi kosovar, identifikuar sipas veprimeve në sistemin TIMS si shtetasi *Driton Palucan* i ditëlindjes 10.10.1998 drejtues i automjetit me targë "04188FS" dhe shtetasi *Liridon Paluca* i datëlindjes 03.11.1991 pasagjer, kjo sipas të dhënave të sistemit TIMS hyrje shtetas të huaj krahasuar veprimet nga pamjet në video me sistemin TIMS sipas orës përkatëse të kryerjes së veprimeve. Punonjësi i policisë Fatri Braha, pasi ka marrë dokumentet, ka hapur njërën prej pasaportave dhe prej tyre ka marrë një kartëmonedhë 10 euro. Biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë Fatri Braha dhe shtetasit kosovar është me përmbajtje si vijon:
Fatri Braha: *A i kini bërë vaksinën*
Shtetasi*: Po*
Fatri B*: Ti shofim pak.... -Nuk kuptohet-*
Shtetasi*;...-nuk transkiptohet-*
Fatri B:Ai kini harru apo humb... faleminderit, t'u rrit ndera
Nga pamjet filmike rezulton se pasi hap dokumentet mbi tavolinë dhe nxjerr prej tyre 10 euro, i hedh në tavolinë në krahun e majtë, vendos dorën e majtë dhe i merr. Nga bisedat e zhvilluara rezulton se shtetasit nuk i disponojnë dokumentet e vaksinimit dhe për këtë arsye kanë dhënë edhe shumën prej 10-të euro punonjësit të policisë.

259. **Në datë 12.02.2022, ora 16:47,** në kabinën nr. 4 është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu,**i cili gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit kosovar *Dritan*

*Latifi,*i datëlindjes 09.03.1984, drejtues i automjetit me targë "01730PM" (mitëdhënës) dhe shtetases kosovare *Majlinda Sahliu,* e datëlindjes 09.03.1984, pasagjere. Nga pamjet filmike rezulton se, bashkë me dokumentet, shtetasi kosovar në fjalë i ka dhënë kontrollorit edhe një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe gjatë këtyre momenteve mes këtyre shtetasve është zhvilluar biseda, si më poshtë:

Muhamet Cengu : *Si e ke emrin(duke futur pasaportën në skaner)*

Dritani: *Dritan*

Muhameti: *Dritan Prifti (Qesh)*

Dritani:*Dritan Latifi (qesh)*

Muhameti: *Vaksinat a i ke ? Xhamat e zinj a i ka të shënuar kund në librezë .*

Dritani: *...nuk kuptohet...*

Muhameti: *Xhamat e zinj në librezë, vaksina a i ke të dyja ?*

Në këtë moment sipas pamjeve filmike ai hap pasaportën dhe nxjerr një kartëmonedhë 5 euro dhe e vendos në tavolinën e punës në krahun e majtë.

Muhameti: *Ta gëzosh, sa e more?*

Dritani: *30*

Muhameti: *30 mijë, hajd të përshëndes, e gëzofsh.*

260. **Po në datë 12.02.2022, ora 18:52:04,** për shkak se në këtë kabinë ka fluks pasagjerësh shërbimi nga punonjësit e policisë kryhet me rotacion dhe në këtë kohë është duke punuar punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** me detyrë ndihmës Specialist Kontrollor në P.K.K Morinë. Në këtë orë është dokumentuar marrja e një shumë prej 5 euro nga një shtetas kosovar i verifikuar në sistemin TIMS me gjeneralitetet *Granit Binjaku* i datëlindjes 134.05.1994, i cili ndodhet në sportel për përpunimin e dokumentacionit. Kartëmonedhën në dukje e prerjes 5-euro, punonjësi i policisë Kapllan Dogjani fillimisht e ka fshehur poshtë aparaturës së skanimit dhe më pas e ka marrë prej andej. Biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë dhe shtetasit Granit Binjaku është si vijon:

Graniti: ***Kafe kafe*** *...(nuk kuptohet biseda ne vijim)*

Kapllan Dogjani: *Mua mu duk si e dyshimtë, unë pata fut dhe ...nuk kuptohet një herë, e para*

Graniti: *...nuk kuptohet*

Dogjani: *Shokët e tu ahha (qesh)*

Graniti: *...nuk kuptohet*

Dogjani: *A keni punuar?*

Graniti: *Jo keq*

Dogjani: *Ti je bizesmen a..... q....r...t aaaa*

Graniti: *.... Nuk ta harroj fytyrën*

Dogjani: *A e shkruajte në defter aty ahahah (qesh).*

Graniti: *Nuk kuptohet...*

Dogjani:*Ik,ik*

Graniti: *Shumë faleminderit prej teje*

261. **Në datë 12.02.2022, ora 18:54:53** është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, i cili ka zëvendësuar punonjësin e policisë Kapllan Dogjani, duke marrë turnin nënë orën 18:54:28, sipas pamjeve filmike. Ky punonjës policie është fiksuar nga regjistrimi audio dhe video duke marrë një kartëmonedhë të prerjes 10-euro nga një shtetas, i cili udhëtonte për Gjermani dhe në këmbim nuk regjistrohet në sistem nga ana e tij. Ky shtetas së bashku me dokumentet i ka dhënë edhe një kartëmonedhë të prerjes 10-euro punonjësit të policisë **Muhamet Cengu**, i cili e ka vendosur para pajisjes skaner. Biseda e zhvilluar midis tyre në formë të përmbledhur është si vijon:

***M. Cengu**: Si kalut, nga po shkoni?*

***Shtetasi**: Gjermani*

***M. Cengu**: Kalofshi mirë*

***M. Cengu**: Jo or ça je tu bë jo or burrë*

***Shtetasi**: Nuk kuptohet*

Sipas pamjeve filmike rezulton se ai lëshon mbi tavolinë dy karta identiteti të Kosovës si dhe një kartëmonedhë e prerjes 10 euro.

***M. Cengu**: Qesh (e merr kartëmonedhën)...Mirupafshim.*

262. **Në datë 12.02.2022, ora 19:09:11** në kabinën nr. 4 është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** dhe në këtë moment në sportel është paraqitur një shtetas i evidentuar në sistem si *Arbër Ejupi* i datëlindjes 16.01.2001, drejtues i mjetit me targe 01570KH, i cili sipas pamjeve filmike i ka dhënë kontrollorit një kartëmonedhë 5-euro, pasi nuk i paraqiti dokumentet e vaksinimit. Biseda e kryer midis tyre është si vijon:

***Muhamet Cengu:** O Arbër a ke letërnjoftim?*

***Arbëri:..** nuk dëgjohet*

***Muhamet Cengu:** Vaksina i keni?*

***Arbri**: Nuk dëgjohet*

***Muhamet Cengu**: Të tre aaa*

***Arbri:** .. ..(nuk dëgjohen fjalët)*

Muhamet Cengu** : **A i kini këtu a te shtëpia? Ti shof

***Arbri:** ... nuk dëgjohet*

Muhamet Cengu:Po duhet me i pas këtu mor Arbër. Ka po shkon?

***Arbëri:** nuk dëgjohet*

***Muhamet Cengu:** ...nuk dëgjohet*

Gjatë zhvillimit të kësaj bisede sipas pamjeve filmike është fiskuar se kontrollori zgjat dorën në sportel dhe duket duke mbajtur në dorë një kartëmonedhë 5 euro të cilën e vendos para aparaturës së skanerit dhe i jep dokumentet qytetarit.

263. **Në datë 12.02.2022,ora 19:12:35,** në kabinën nr. 4 vijon të kryejë shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** dhe ndërkohë nga pamjet filmike konstatohet të paraqitet në sportel një shtetas kosovar, i verifikuar nëpërmjet sistemit TIMS si shtetasi *Besart Spanca* i datëlindjes 03.10.1997 drejtues i mjetit me targë 01510SS, për përpunim të dokumenteve. Punonjësi i policisë i evidentuar si Muhamet Cengu i kërkon vaksinën dhe është fiksuar duke marrë një

kartëmonedhë në dukje 5 Euro. Nga pamjet janë fiksuar veprimet e kontrollorit ku ai i kthen dokumentet shtetasit duke i thënë fjalët *"rregullojini pak këto"*, ndërsa në momentin që ka marrë ketë kartëmonedhë ka vendosur mbi te dorën për të mos u parë veprimi. Biseda e zhvilluar është si më poshtë:

***Cengu M**: Nga po shkoni a nga po vini?*

***Besarti:**...(Nuk kuptohen fjalët...)*

***Cengu M**: A i keni vaksinat?*

***Besarti:** ...Nuk dëgjohet...*

***Cengu M**: Nga dy krejtë? Duhet me i pas kshu me letra, me letra duhet, ka dozën me lek...*

***Besarti**: Nuk dëgjohet*

***Cengu M**: Besarti kush është, ma jep pasaportën... nga po shkoni ju*

***Besarti**: ...nuk kuptohet.....*

***Cengu M**: Rregulloni këto*

Nga pamjet filmike në këtë moment ai merr dokumentet nga tavolina dhe i kthen në sportel duke i thënë fjalët "rregullojini këto", si më sipër.

***Cengu M**: Natën e mirë.*

Në këtë moment Besarti i kthen dokumentet të dhe Muhamet Cengu ja kthen prape dhe nga pamjet që sjellin regjistrimet video, nga pasqyrimi në xhamin e sportelit, duket në tavolinën e kontrollorit, para kompjuterit një kartëmonedhë euro të cilën, pasi ju thotë natën e mirë, e merr duke e tërhequr me dorën të vendosur sipër saj. Nga pamjet filmike dhe biseda e zhvilluar si më sipër shuma e eurove është marrë për shkak të mungesës që ky qytetar ka pasur për dokumentacionin e testit kundër Covid-19.

264. **Në datë 12.02.2022, ora 17:41:20**, në kabinën nr. 4 është duke vijuar shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** i cili është fiksuar nga pamjet filmike se, pasi ka marrë pasaporta të shtetasve kosovare për përpunim, të cilët nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton të jenë shtetasit *Dardan Arifi* i datëlindjes 26.06.94 drejtues i automjetit me targa "05333FE" dhe *Marigona Shaqiri* e datëlindjes 09.10.96. Gjatë përpunimit të dokumenteve njëri prej shtetasve, ka hedhur një kartëmonedhë në dukje 5-euro në tavolinën e punës së kontrollorit, të cilën ai, pasi ka përfunduar përpunimin e dokumenteve e ka marrë. Me këta shtetas nuk ka zhvilluar bisedë.

265. **Në datë 12.02.2022, ora 11:22: 35**, vijon shërbimin kontrollori Muhamet Cengu. Nga regjistrimet audio dhe video rezulton se ai ka është duke përpunuar në këtë hark kohor dhe në bisedë me ta përmend edhe fjalën ***"kafe"***. Shtetasit kosovarë, sipas bisedës së zhvilluar rezulton se nuk dispononinin dokumentin e vaksinimit fizikisht por e kishin atë fotografi në aparatin celular. Në bisedën audio dëgjohet, punonjësi i policisë Muhamet Cengu t'ju thotë:... *"Nuk dua kështu se e fotokopjojmë...., s'po ju kthej mbrapsht se është tu më ardhë keq, por fusni një kafe ç'itu"*,duke ju dhënë njërin prej dokumenteve. Shtetasit kosovarë nuk rezulton t'i ketë regjistruar në hyrje të R.Sh-së në sistemin TIMS, por është fiksuar nga pamjet filmike se ka marrë shumën prej 5-euro. Biseda e kryer midis punonjësit të policisë Muhamet Cengu dhe shtetasit kosovar është si vijon:

***Muhamet Cengu**: Makina në emër të kujt është*

Shtetasi *: Nuk kuptohet*
Cengu: *E kini marrë me qera aa?*
Shtetasi *:Po unë kam kaluar*
Cengu*: ta shohim një herë.... Vaksina a si keni kështu aaa?*
Shtetasi: *Nuk dëgjohet*
Cengu:Ka një urdhër që duhet me i fotokopju, duhet me i pa letrën dhe me i bë fotokopje
Shtetasi: *...Nuk dëgjohet*
Cengu*: Ej ik se s'jam tu të kthy mbrapa, më rregullo një kafe ç'ëtu, s'jam tu të kthy mbrapa se është tu më ardh keq....*
Nga pamjet filmike rezulton se në këtë moment zgjat dorën dhe merr një pasaportë dhe lëshon një kartëmonedhë 5 euro në tavolinë.
*Cengu:... **Hajd u krye.***
266. **Në datë 12.02.2022, ora 11:36:35,** në kabinën nr. 4 evidentohet një tjetër rast ku punonjësi i policisë ***Muhamet Cengu*** është duke përpunuar një udhëtar, shtetas kosovar, që është paraqitur në sportel. Gjatë përpunimit të dokumenteve punonjësi i policisë Muhamet Cengu i kërkon këtij shtetasi vaksinën me dy doza si dhe testin kundër Covid-19. Qytetari nuk e disponon testin e për këtë shkak punonjësi i policisë i mban dokumentet dhe i thotë: "*....**ec më para dhe hajde merri".*** Sipas pamjeve filmike, punonjësi i policisë Muhamet Cengu, pasi merr një kartëmonedhë shuma e së cilës nuk është e evidentueshme, dëgjohet me tej në vijim të bisedës të udhëzoje qytetarin se çfarë duhet të thotë nëse ndalet rrugës nga ndonjë postbllok. Po kështu shtetasi nga Kosova kthehet për të marrë dokumentet dhe e pyet punonjësin e policisë: *"Po kur të kthehem si tja bëj? A bëhet testi këtu në Shqipëri".* Nuk është i mundur verifikimi i këtyre shtetasve pasi regjistrimi i tyre nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu nuk është kryer në sistemin TIMS. Biseda e zhvilluar midis tyre në formë të përmbledhur është si vijon:
Muhamet Cengu: *A i ke vaksinat?*
Shtetasi*: Nuk kuptohet*
Muhamet Cengu: *test nuk ke aaa, duhet me pas test këtu*
Qytetari:*... nuk kuptohet*
Muhamet Cengu: *Duhet dhe për Shqipëri testi... ku punon ti ça pune bën?*
Shtetasi*: ...Nuk kuptohet*
Muhamet Cengu*: Kena kontroll rrugës, që dalin e kontrollojnë këto dhe dalin të kontrollojnë ty* ***thuaj i ka kontrollu kufiri dhe më kanë ngelë aty ose më kan ra dikund****. Ec pak para dhe hajde* ***meri dokumentet, se s'du me të kthy mbrapa...nuk kuptohet...***
Sipas pamjeve filmike, në këtë moment merr dokumentet dhe i vendos në krahun e djathtë të tavolinës së punës ngjitur me pultin e kondicionerit.
Shtetasi*: Po me dal si t'ja bëj kur të kthehem ? A behet testi ketu në Shqipëri?.*
Muhamet Cengu*: me e marr tash e me mos e harru më e me ik ...nuk kuptohet ....rruga e mbarë*

267. **Në orën 16:00:40, të datës 12.02.2022,** në kabinën nr. 4 ku është duke kryer shërbim **Muhamet Cengu,** në sportelin e kabinës ku është vendosur kamera është paraqitur një shtetas i cili i kërkon punonjësit e policisë një vërtetim fiktiv për datën 11.02.2022 ku sipas tij në këtë

vërtetim të pasqyrohej fakti se në në PKK-Morinë, ka kaluar një shtetas nga Kosova me një pjesë makinerie me qëllim për ta riparuar në Durrës, vërtetim i cili plotësohet me shkrim dore nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes. Biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë Muhamet Cengu dhe shtetasit si më sipër, është si vijon:

***Shtetasi**: Një shok...nuk kuptohet...**pimë kafe** ...a mundesh ma bë...një hekur...nuk kuptohet*

***Muhamet Cengu:**Sa kushton ajo...i them bash çitash e kam shok të ngushtë.. sa kushton ajo? Tregoma në foto*

Shtetasi :350 euro, një kafe po ta qes

***Muhamet Cengu**: Për ça është kjo..*

***Shtetasi:** ...- nuk kuptohet-..*

***Muhamet Cengu**: Si e ka emrin kjo*

***Shtetasi**: Po pjesë e pirunit...*

Muhamet Cengu: Po duhet me i thënë këtij.

Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, rezulton se ndërkohë që zhvillohet kjo bisedë, punonjësi i policisë hap derën e kabinës dhe del jashtë, kohë gjatë së cilës dëgjohen fjalët "*do mar një stilolapës dhe një letër*", dhe ndërkohë ulet dhe përpunon dokumentet e një shtetasi tjetër i cili ishte në radhë për të kaluar dhe pasi mbaron me atë shtetas merr një stilolaps dhe vazhdon të shkruaj vërtetimin.

***Muhamet Cengu**: Po sot ka kaluar?*

Shtetasi**: **Jo sot dije dije

***Muhamet Cengu:** Sot më datë njëmbëdhjet i dyti shtetasi si quhet, më jep kartën e identitetit a e ke*

***Shtetasi**: **Dritan Miloti**...*

***Muhamet Cengu**: Shtetasi kosovar (duke shkruajtur).. me ça mjeti a i ke targat*

***Shtetasi**; me çëtë që është aty KEDI pik A...*

***Muhamet Cengu**: Shtetasi kosovar me mjetin Kedi transporton për në Shqipëri në servis një pjesë, ça pjese është?.*

***Shtetasi:** Si i thoni ju atij që çon paletat?*

***Muhamet Cengu:** Pirun.. një pjesë të pirunit për servis (vazhdon duke shkruar) në Durrës*

***Muhamet Cengu**: Data e kthimit?*

***Shtetasi:** Sot*

***Muhamet Cengu**: data e kthimit nesër në datë 12.2.2022*

***Shtetasi:** A i madh je ...-(disa fjale qe nuk kuptohen)-*

Nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS të informacionit rezulton në këtë hark kohor vetëm një shtetas me emrin *Dritan Miloti* i datëlindjes 13.11.1983, i cili nuk ka hyrje dalje nga R.Sh që nga data 22.09.2021. Referuar bisedës së zhvilluar si më sipër dhe veprimeve të punonjësit të policisë Muhamet Cengu për hartimin e vërtetimit të kërkuar nga shtetasi që është në sportel, pavarësisht se nuk është fiksuar momenti i dhënies së shumës, rezulton se vërtetimi i hartuar nuk përputhet me një gjendje të ndodhur në fakt por është sipas kërkesës së qytetarit dhe

për dhënien e këtij vërtetimi midis tyre zhvillohet biseda gjatë se cilës përmenden fjalët "një kafe" dhe "350 euro".

268. **Në datë 12.02.2020,ora 14:12:38**, në kabinën nr 4 në hyrje të R.Sh-së ku është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, në sportelin e kabinës janë paraqitur shtetas kosovarë dhe gjatë intervistimit Muhameti e pyet se kush është Kushtrimi. Sipas bisedës së zhvilluar mes tyre, rezulton se për mungesën e autorizimit të mjetit nga Kushtrimi tek përdoruesi që është personi që është paraqitur në sportel, Muhameti ju merr një shumë prej 5-euro. Nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj krahasuar edhe me orarin e kryerjes së veprimeve bazuar në pamjet filmike, rezulton se në këtë kohe është përpunuar dokumentacioni i shtetasit *Shkëlqim Bajrami* i datëlindjes 27.03.1992 i cili drejtonte automjetin me targë 05361EM. Punonjësi i policisë Muhamet Cengu dëgjohet kur i thotë "*Ec bëne*", dhe merr librezën e automjetit dhe ja jep qytetarit. Pas këtij veprimi, merr librezën e automjetit, e hap dhe prej andej nxjerr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe lejon këtë shtetas të udhëtojë. Biseda e zhvilluar mes tyre rezulton si më poshtë:

Muhamet Cengu: *Po Kushtrimi kush është ?*

Shkëlqimi: *Nuk dëgjohet*

Muhamet Cengu: *Kushtrimi cili është, a i kini marrë me qera makinat*

Shkëlqimi: *...-nuk dëgjohet-*

Muhamet Cengu: *Po këtu lexon Kushtrim bre, po a ka autorizim bre?.*

Shkelqimi:*...Nuk dëgjohet*

Muhamet Cengu: *Po prandaj po të them unë bre ...*

Shkelqimi: *Jo nuk ka*

Muhamet Cengu: *Hajd bëne hajd (i jep dokumentet shtetasit dhe nxjerr një kartëmonedhë euro mbi tavolinë, siç u përshkrua më sipër).*

269. Në **datë 12.02.2022.ora 14:16:49,** në kabinën ku është vendosur kjo pajisje përgjimi audio dhe video, futet një punonjës tjetër i policisë kufitare dhe në orën 14:16:49 është regjistruar momenti kur kontrollori **Muhamet Cengu** i ka dhënë kolegut me numër identifikues 05657 , identifikuar si **Avni Tërshalla** një kartëmonedhë. Ky i fundit e ka mare kartëmonedhën, e cila nuk identifikohet për shkak se merret në grusht mbyllur duke e falënderuar dhe i drejtohet me fjalët: "*Tu lumtë krahu*". Konkretisht zhvillohet ky komunikim mes tyre:

Muhamet Cengu:*Merri këto nga unë*

Avni Tërshalla: *Hë të lumtë krahu të lumtë, hë hallall.*

270. Në datë **12.02.2022, ora 18:14:55,** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh është duke punuar punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani**. Në sportel paraqiten dy shtetas me dokumente shqiptare, një kartë Identiteti dhe një pasaportë, të cilat përpunohen tek pajisja skaner nga ora 18:15 min dhe ora 18:16 min. Pasagjerët, siç rezulton nga biseda e regjistruar, kanë në automjetin e tyre edhe një qen të cilin e kanë për ta shitur. Punonjësi i policisë Kapllan Dogjani ju thotë se një veprim i tillë është i kundërligjshëm dhe insiston disa herë. Më tej është fiksuar nga pamjet filmike se në njërin prej dokumenteve që ka në përpunim është vendosur një kartëmonedhë një mijë lek, ai i lejon të vijojnë udhëtimin. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rezulton se

shtetasit që janë përpunuar në këtë interval kohor në hyrje të R.Sh-së nga punonjësi Kapllan Dogjani janë: *Olsi Siriteanu* i datëlindjes 20.03.1989, i cili drejton automjetin me targa "AB951EJ" dhe pasagjer në po të njëjtin automjet shtetasi *Bernard Malaj* i datëlindjes 19.09.1997. Dokumentet e këtyre shtetasve janë përpunuar në orën 18:16 min krahasuar me sistemin TIMS si dhe orarin e kryerjes se veprimeve sipas pamjeve filmike. Biseda mes tyre zhvillohet si më poshtë:

Kapllan Dogjani: *Ke me vete ndonjë gjë send a jo?*
Shtetasi: *një qen*
Kapllan Dogjani: *Ça qëni?*
Shtetasi: *Qen Sharr*
Kapllan Dogjani: *Pasaportën*
Shtetasi:Jo
Kapllan Dogjani: Nuk lejohet, qeni bën 1000Euro,a do me bë trafik kafshësh ti aaa?
Shtetasi: Ç'a trafiku
Kapllan Dogjani: *E di do ta mbash për tregti ti po nuk lejohet, le qe kanë ikur dhe ata të bujqësisëtani,veterinerat*
Shtetasi: ...jap një kafe
Kapllan Dogjani: *Po s'bën o figur or ti djalë, Benardo,jo Benardo, Olsit*

Sipas pamjeve video rezulton se në këtë moment punonjës i policisë hap dokumentet dhe duket në pamje kartëmonedha e prerjes 1000 lekë.

Kapllan Dogjani:*Ku e çon qenin?*
Kapllan Dogjani: *Ec*
Shtetasi: *Natën.*

271. Në datë 28.06.2022, është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi *Olsit Sirteanu*, i cili në lidhje me episodin si më sipër, ka deklaruar se :*"... Unë në datë 12.02.2022 kam qenë së bashku me kunatin tim, Bernard Malaj, banues në Fier dhe kemi shkuar në Prishtinë, në fshatin, "Bardhyll i Madh", me sa më kujtohet. Kemi qëndruar në Kosovë rreth një orë dhe jemi kthyer nga P.K.K Morinë, pikë kufitare nga e cila edhe kishim dalë. Kur kemi ardhur në kufi tek kabina e policisë kemi dhënë dokumentet punonjësit të policisë që ka qenë në shërbim, dhe e pyetëm se çfarë procedurash bëhen për të kaluar një qen në kufi. Më thotë polici që këtu nuk ka veteriner që ta pyesim dhe nuk më kujtohet të më ketë sjellë ndonjë pengesë tjetër. Unë nuk kam patur ndonjë problematikë me dokumentacionin vetëm kur kam dalë nga P.K.K Morinë më është kërkuar testi i Covidit të cilin e kam patur fotografi në celular dhe ja kam treguar punonjësit të policisë që ka qenë me shërbim në kufi. Nuk kam patur ndonjë qen me vete dhe nuk i kam dhënë ryshfet punonjësit të policisë, por mund ti kem dhënë dhjetë mijë lekë për informacionin që më ka dhënë në lidhje me pyetjet për qenin".* Në datë **12.02.2022 ora18:36:03**, punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** i cili është duke punuar në kabinën nr. 4 hyrje R.SH, konstatohet të marrë shumën prej 10-të euro nga shtetasi i cili sipas verifikimit të kryer në sistemin TIMS rezulton të jetë *Maksim Domi* i datëlindjes 29.03.1982, drejtues i mjeti fugon me targa AB951EJ, si dhe pasagjerë në po të njëjtin automjet janë shtetasit *Omer Basha* i datëlindjes

07.11.1994 dhe *Eduart Peposhi* i datëlindjes 08.12.1992. Nga biseda e zhvilluar mes tyre kuptohet se Kapllan Dogjani ka njohje me pasi gjatë komunikimit e pyet për *familjen, nënën, përdor shprehjen fëmijët a të janë rrit, etj.* Nga pamjet filmike rezulton se duke hapur dokumentet në përpunim e sipër të shtetasve, punonjësi i policisë Kapllan Dogjani ka nxjerrë prej andej një kartëmonedhë10 euro dhe e ka vendosur para aparaturës së skanimit të cilën më pas pak sekondash e ka marrë duke përdorur dhe shprehjen: "*Tu rrit ndera, ejvalla*".

272. I pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi **Maksim Domi,** sipas procesverbalit me datë 05.07.2022, ka deklaruar se:"*...Unë aktualisht jam i punësuar si shofer dhe kryej rrugën Shqipëri-Kosovë-Hungari-Gjermani dhe kthim. Vëllai, Rezart Domi ka dy automjete tip furgon që kryejnë këtë itinerar udhëtimi dhe është i pajisur me lejen përkatëse për transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit....Unë shtetasin Arjan Domi e njoh thjesht si fytyrë por nuk kam asnjë lidhje miqësore apo fisnore me te, di që është nga Kukësi dhe kryen rrugën për jashtë shtetit me një automjeti tip, furgon...ndërsa punonjësin e policisë Kapllan Dogjani nuk e njoh....Unë kam në përdorim automjetin me targë "AB959RN"." Pyetjes lidhur me ngjarjet e datës 12.02.2022 ora18:36:03, ai i është përgjigjur duke deklaruar se: "...Unë nuk kam dhënë lekë ndonjëherë, e pranoj se të dy shtetasit kanë qenë pasagjeret e mi, por ryshfet nuk kam dhënë...nuk kam dijeni se kush mund të ketë dhënë shumën e ryshfetit prej 10-të euro".*

273. **Në datë 12.02.2022, ora 18:40:13**, në kabinën nr.4 në hyrje të R.Sh-së punonjësi i policisë që është duke kryer shërbim **Kapllan Dogjani** konstatohet duke komunikuar me disa persona që janë paraqitur në sportel, pasi njëri prej tyre nuk disponon dokumentin e vaksinimit, e disponon me fotografi në telefon por jo fizikisht, veprim i cili nuk pranohet nga punonjësi i policisë. Kapllan Dogjani dëgjohet kur i drejtohet me fjalët: *"O Flark". "Flark ki emrin"..,* "*ta gëzosh, vaksinat a i kini të tëna?"*. Nga verifikimet në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj nuk konstatohen të jenë kryer veprime me ndonjë shtetas me emrin "Flark". Gjithashtu nga verifikimi në sistem shtetasit kosovarë të cilët kanë përpunuar dokumentet janë *Andi Nuredini* i datëlindjes 11.04.2003 drejtues i mjetit me targë 01538NOdhe *Dea Kahrimani* e datëlindjes 30.01.2000 pasagjere. Midis tyre është regjistruar biseda si më poshtë:

Shtetasi: Nuk e kam me vete a mundet me telefon me ma dërgu axha?

Kapllan Dogjani: *Veç duhet prezent...ose duhet me u kthy duhet me shku me e marrë...S'është puna atje puna është se si ta regjistroj unë,* ***unë dua ta regjistroj ose duhet me shkel ligjin e ta lë pa regjistruar me të bë nder a më kupton a jo, çi kjo është mundësia ime dy ose të regjistroj ose të lë*** *pa regjistruar... Hajdeni ça me të bë duhet me kthy me e mar... Bjema dhe kartën tënde në qoftë se, hajde një udhë e dy punë.*

274. Gjatë kohës që zhvillohet ky komunikim mes tyre, nga pamjet filmike, konstatohet se punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** në kohen që është duke përpunuar dokumentet fsheh para pajisjes skaner një kartëmonedhë në dukje 5 euro. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, duke krahasuar me fashën orare gjatë së cilës është regjistruar ky komunikim, rezulton se nga tre shtetas që kanë qenë në të njëjtin automjet janë regjistruar vetëm dy, ndërkohë shtetasin të cilin e ka thirrur me emrin "Flak" nuk e ka regjistruar në sistem.

275. **Në datë 12.02.2022, ora 13:21:24** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ku është instaluar pajisja

përgjuese nr. 7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**. Ky punonjës, ka komunikuar me një shtetas të cilin rezulton se nuk e ka regjistruar dhe sipas pamjeve filmike duket se ka marrë prej tij një kartëmonedhë prej 10 eurosh, ka marrë prej tij një kartëmonedhë të prerjes 10-Euro. Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes, veprimin kontrollori e kryen para kompjuterit por reflektohet te xhami anësor ku duket qartë kartëmonedha 10-euro mbi tavolinën e punës, të cilën më pas kontrollori e merr. Shtetasi i cili i ka dhënë këtë kartëmonedhë dëgjohet duke i thënë se : "*.....a lejohet ....e kam te kunatit*". Në formë të përmbledhur, biseda e zhvilluar midis tyre është si vijon:

***Muhamet Cengu**: Vetëm me ta bë regjistrimin unë këtu për arsyeje familjare*

***Shtetasi**: Duhet ta bëj pa tjetër*

***Muhamet Cengu**: Bjer ta regjistroj unë këtu vetëm një kafe*

Sipas pamjeve filmike, në këtë moment i merr një dokument dhe nxjerr një kartëmonedhë 10 euro.

***Muhamet Cengu:** rruga e mbarë*

Rezulton se gjatë kohës që ndodhin veprimet si më sipër, kontrollori Muhamet Cengu nuk kryen asnjë regjistrim në kompjuter, dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike.

276. **Në datë 12.02.2022, ora 20:08:41,** në kabinën nr. 4 Hyrje të R.SH-së që përkon me pamjet filmike të kamerës nr.7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Gëzim Duraku**. Qytetarit kosovar që paraqitet në sportel ky punonjës i merr dokumentet dhe i kalon në krahun tjetër të tavolinës duke i thënë njëkohësisht *"hape krahun" dhe "hajde merri"*. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se ky shtetas është *Endrit Hashani* i datëlindjes 16.09.1996, drejtues i automjetit me targa "01947CU" dhe së bashku me këtë shtetas kanë udhëtuar edhe shtetasit *Agnesa Siminca* e datëlindjes 19.01.2005, *Rrezart Hasanaj* i datëlindjes 30.11.1999 dhe *Adelina Siminca*. Pasi ka hapur krahun me automjet shtetasi kosovar paraqitet në sportel dhe ndërkohë që punonjësi i policisë Gëzim Duraku i jep dokumentet, konstatohet që ky shtetas i jep edhe një kartëmonedhë në prerje 5 euro. Menjëherë pas këtij veprimi Muhamet Cengu i jep dokumentet shtetasit i cili largohet.

277. **Në datë 12.02.2022, ora 20:10:14,** në kabinën nr. 4 e cila korrespondon me pamjet filmike të regjistruara nga kamera nr. 7, vijon të kryejë shërbimin punonjësi i policisë **Gëzim Duraku** i cili konstatohet duke marrë shumën 20 euro nga shtetasi kosovar i verifikuar në sistemin TIMS si *Pjetër Gjergji* i datëlindjes 08.02.1979, drejtues i mjetit me targë "AB655FJ". Nga pamjet filmike, dokumentuar edhe në procesverbalin e këqyrjes, konstatohet se gjatë përpunimit të dokumenteve, punonjësi i policisë Gëzim Duraku hap një pasaportë dhe prej andej nxjerr një kartëmonedhë 20 euro. Dëgjohet gjatë komunikimit që njërin prej shtetasve ta thërrasë në emrin "Pjetër". Po ashtu janë fiksuar veprimet gjatë të cilave rezulton se ai kartëmonedhën e marrë nga ky shtetas, fillimisht e vendos mbi tavolinë, para tastierës së kompjuterit dhe më pas e tërheq drejt vetes me dorë. Biseda e zhvilluar midis punonjësit dhe shtetasit është si vijon:

***Gëzim Duraku:** Makinën e ke me autorizim a me qira aaa...Eduart Vukaj*

***Pjetër**:... -nuk kuptohet-*

***Gëzim Duraku**: Eduarti, Eduart Vukaj në rregull qenka*

Pjetër: *vaksinën e kam*
Gëzim Duraku: *e ke në rregull, po autorizim?*
Pjetër: *se kam për zotin*
Gëzim Duraku: *pse?*
Pjetër: *nuk e kam..... -nuk transkriptohet-*
Gëzim Duraku: *Po ke me kalu në kufi.....*
Gëzim Duraku:.. *A kini kamer aty para aa (shef kamer në makinë) a inçizon aaa?..jo*
Gëzim Duraku: ***Sa për kafe or ti****(Zgjat pasaportën) ç'e pasaportën, mere pasaportën hahah (qesh)*
Gëzim Duraku: *Ta prift zoti mbarë.*
Pas këtij komunikimi, sipas pamjeve filmike, Gëzim Duraku hap pasaportën dhe nxjerr prej saj kartëmonedhën 20 euro të dhënë nga ky shtetas, që sikurse rezulton nga biseda është dhënë për shkak të mungesës së autorizimit të automjetit nga shtetasi që është përpunuar në këtë hark kohor.

278. **Në datë 12.02.2022, ora 20:54:38** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh-së vijon të kryejë shërbim punonjësi i policisë **Gëzim Duraku**, i cili konstatohet se i ka marrë shumën prej 5 euro shtetasit kosovar *Patrik Thaqi,*i datëlindjes 31.05.1996, drejtues i automjetit me targë "03998FM". Nga këqyrja e pamjeve filmike në orën 20:51 shtetasi Patrik Thaqi ndodhet në sportel dhe dorëzon dokumentet tek punonjësi i policisë. Gjatë intervistimit dëgjohet punonjësi i policisë ta pyesë shtetasin nëse i ka të dy vaksinat. Nga përgjigja rezulton se njëri prej shtetasve kishte vetëm një vaksinë dhe testin me fotografi në celular. Punonjësi i policisë në këtë moment i mban dokumentet dhe i thotë të "*...hap krahun pastaj të vish ti maresh"*. Gjithashtu, dëgjohet kur i thotë "*Se a e di se kanë kaluar shumë për ndjekje penale këta që kanë testin në celular se nuk lejohet, testi duhet me vule origjinale, hape krahun*". Nga pamjet filmike konstatohet se punonjësi i policisë i kalon dokumentet e shtetasit në krahun e djathtë të tavolinës. Rezulton se shtetasi kosovar i verifikuar në sistemin TIMS si *Patrik Thaqi* futet brenda në kabinë dhe Gëzim Duraku i jep dokumentet duke i thënë "*...meri çato dhe ta bëftë zoti mbarë", "jo në telefon se është bërë problem*", dhe në këtë moment vendos një kartëmonedhë të prerjes 5 euro mbi një shtresë ngjyrë të kuqe mbi tavolinë.

279. **Në datë 12.02.2022, ora 20:58:42**në kabinën nr. 4 vijon kryerjen e shërbimit punonjësi i policisë **Gëzim Duraku** dhe nga pamjet filmike konstatohet se pasi hap dokumentin Librezë mjeti, shfaqen disa kartëmonedha euro të palosura, për të cilat nga pamjet filmike nuk dallohet prerja e tyre. Gjatë intervistimit dëgjohet që punonjësi i policisë Gëzim Duraku i drejtohet shtetasit në sportelin e kabinës me fjalët*: "...janë shumë or ti janë shumë ti ke fëmijë te shtëpia nuk shkon ajo punë.... "*.Në vijim nga pamjet filmike duket se palos kartëmonedhat, i vendos në librezën e automjetit dhe ja kthen këtij shtetasi duke përsëritur "*...nuk shkon ajo punë dhe unë kam fëmijë te shtëpia dhe ti", "veç për një kafe"*, duke mbajtur vetëm një kartëmonedhë 10 euro. Në vijim dëgjohet ta pyesë shtetasin se çfarë problem ke pas mbrëmë me kolegun e tij. Duke krahasuar veprimet që janë kryer nga punonjësi nëpërmjet pamjeve filmike dhe atyre të verifikuara nga sistemi, TIMS, rubrika *"Hyrje shtetas të huaj*" rezulton se në këtë orar është

përpunuar dokumenti i shtetasit kosovar *Halim Krueziui* datëlindjes 20.11.1994, drejtues i mjetit me targë "04999JJ", i cili rezulton të ketë një hyrje në R.Sh në datë 11.02.2022 e cila përkon edhe me bisedën e kryer si më sipër, por nuk ka dalje nga R.SH.

280. **Në datë 12.02.2022 ora 21:09:55, Gëzim Duraku** konstatohet në një rast tjetër duke i kërkuar një "kafe" shtetasit kosovar *Kushtrim Kryeziu,* i datëlindjes 07.10.1988 dhe drejtues i mjetit me targa, "06808FE ". Gjatë intervistimit punonjësi i policisë dëgjohet ta pyesë shtetasin: "***Nga po shkon o Kushtrim, vaksinën e ke bërë apo jo***", "***Autorizim ke bërë apo jo***", "***Pa autorizim nuk lejohet***", "***A je i Prizrenit a i Gjilanit, fut një kafe këtu***", duke i zgjatur njëkohësisht librezën e mjetit e duke i thënë po ashtu: "*.....**fut një kafe këtu me na respektu dhe hec, mos ta ndje***", dhe ndërkohë i zgjat librezën e mjetit. Nga komunikimi dhe veprimet e kryera, sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio, rezulton komunikimi dhe kërkimi i "kafes", sikurse i drejtohet, por nuk është mundësuar identifikimi i shumës së marrë, nëpërmjet futjes në dokumentin përkatës sipas komunikimit, për shkak të pamjes së kufizuar të kapur nga kamera.

281. **Në datë 12.02.2022, ora 21:42:42,** në postin e punës së kabinës nr. 4 ku gjendet ende punonjësi i policisë **Gëzim Duraku,** nga këqyrja e pamjeve filmike konstatohet që të nxjerrë një portofol nga xhepi dhe të numërojë disa shuma eurosh ku njëra prej kartëmonedhave që vendoset mbi tavoline është e prerjes **50 euro.**

282. **Në datë 12.02.2022, ora 11:46:09,** kryen shërbim në kabinën nr. 4 hyrje në R.Sh punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** i cili gjatë gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit *Mehdi Thaqi*, ka marrë një kartëmonedhë të prerjes 5 euro. Në regjistrimin video dallohet kartëmonedha të cilën punonjësi i policisë Muhamet Cengu fillimisht e vendos para aparatit të skanimit të dokumenteve dhe më pas e tërheq me dorë. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika *"Hyrje shtetas të huaj",* në orën 11:46, janë përpunuar dokumentet e shtetasit Mehdi Thaqi i datëlindjes 28.07.1967, drejtues i autobusit me targë "01520QJ". Mehdi Thaqi kur shkon në sportel dëgjohet duke i thënë Muhamet Cengut: ***"...a do vonohemi apo jo".*** Punonjësi i policisë vërehet të hapë dokumentin "Librezë mjeti", nxjerr prej andej një kartëmonedhë 5 euro të cilën e vendos para aparatit të skanerit dhe skanon vetëm një kartë identiteti. Pas këtij veprimi Muhamet Cengu i jep dokumentet shtetasit dhe i thotë*" **a do ti regjistroj apo jo"***. Nga verifikimet në sistemin TIMS, dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes, rubrika "Hyrje shtetas të huaj" për datën 12.02.2022 ora 11:46 që përkon me kryerjen e veprimeve nga punonjësi i policisë, nuk rezulton që me automjetin autobus me targa "01520QJ" të jenë regjistruar pasagjere në hyrje të R.SH-së.

283. **Në datë 12.02.2022, ora 11:55:36,** në kabinën nr. 4 ku vijon shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** konstatohet një rast tjetër rast kur ai merr shumën 5 euro gjatë komunikimit me një shtetas kosovar për të cilin përpunon dokumentet. Gjatë intervistimit dëgjohet që punonjësi i policisë Muhamet Cengu i drejtohet me fjalët: "***Nuk ka rrudha fare o Ilir***", "***Se a e lexon sistemi a se lexon***". Në këtë moment nga dokumentet nxjerr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe fillimisht e lë në tavolinë e menjëherë sa largohet shtetasi nga sporteli e tërheq me dorë drejt vetes. Nga verifikimi në sistemin TIMS, krahasuar me veprimet e konstatuara nëpërmjet këqyrjes së pamjeve filmike, rezulton se dokumenti i përpunuar në këtë

interval kohor nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu i përket shtetasit ***Ilir Halili*** i datëlindjes 20.08.1984 drejtues i mjetit me targa"BU028KI", i cili i ka dhënë edhe shumën 5 euro, dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes dhe sipas pamjeve filmike.

284. **Në datë 12.02.2022, ora 11:57:54**, në kabinën nr 4 hyrje në R.Sh, **Muhamet Cengu** konstatohet t'ju kërkojë "kafe", sipas bisedës, shtetasve kosovarë të cilët paraqesin dokumentet në sportel. Gjatë procesit të intervistimit dhe përpunimit të dokumenteve dëgjohet që ju thotë shtetasve: "***Apo më lëshoni një kafe për qejf***", "***Për qejf o gjiganta***", "*A jeni pronarët*", " ***Ku punoni***". Siç rezulton nga pamjet filmike dhe veprimet e kryera me fjalën kafe është nënkuptuar dhënia e parave, ashtu siç ndodh edhe ne vijim sipas pamjeve filmike ku dallohet se në njërin nga dokumentet nxjerr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika, "Hyrje shtetas të huaj", krahasuar veprimet e konstatuara nga pamjet filmike e po ashtu me ato në sistemin TIMS rezulton se nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu janë përpunuar dokumentet e shtetasit *Leon Abimi*, i datëlindjes 23.08.1996, drejtues automjetit me targë 01220OS, por nuk konstatohet të jenë regjistruar shtetas të tjerë pasagjerë në të njëjtin automjet edhe pse nga biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë dhe shtetasve, rezulton se ju drejtohet në numrin shumës duke u kuptuar se janë më shumë se një person që udhëtojnë në një automjet.

285. **Në datë 12.02.2022, ora 12:58:52** në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh-së vijon shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**. Gjatë intervistimit, në kohën kur shtetasit janë paraqitur në sportel, punonjësi i policisë dëgjohet t'ju thotë fjalët: "*Autorizimin e ke pa vulë*", "*Gjermania i ka me vulë ndryshe autorizimet*", "*Rregulloje, rregulloje*", duke i dhënë dokumentin që përpunonte. Shtetasi kosovar i kthen dokumentin dhe brenda tij konstatohet të jetë një kartëmonedhë 10euro. Duke krahasuar veprimet e konstatuara nëpërmjet këqyrjes së pamjeve filmike dhe verifikimeve të kryera në sistemin TIMS të informacionit rubrika "Hyrje shtetas të huaj", rezulton se në intervalin kohor 11:58 min deri në orën 12:00 punonjësi i policisë Muhamet Cengu ka kryer përpunimin e dokumenteve të shtetasit *Selim Haki Xhebexhia* i datëlindjes 10.02.1993 drejtues i automjetit me targë, "HHTF445", i cili është personi që i ka dhënë shumën 10 euro, dokumentuar me pamjet filmike dhe pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes së tyre.

286. **Në datë 12.02.2022, ora 12:08:40, Muhamet Cengu**, konstatohet në një rast tjetër ku gjatë intervistimit dhe verifikimit të dokumenteve të paraqitura në sportel nga shtetasit, dëgjohet që i drejtohet me fjalët: "*A i keni vaksinat*", si dhe "*Makina në emër të kujt është*". Gjithashtu, dëgjohet që e pyet se ku punon shtetasi i cili nuk mund të evidentohet pasi Muhameti nuk e ka regjistruar, sipas sistemit TIMS, dhe i thotë se: "*Punon në Hotel?*". Po kështu pas këtyre pyetjeve *Muhamet Cengu dëgjohet që kërkon një kafe* duke i thënë "*Lësho një kafe*" dhe "*Ta kthej kusurin, ta kthej*",. Pas këtij veprimi, Muhameti merr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro duke e lejuar shtetasin të largohet por pa kryer veprime verifikuese dhe regjistruese në sistemin TIMS, evidentuar kjo nga këqyrja e veprimeve në pamjet filmike duke i krahasuar me veprimet e kryera në sistemin TIMS, sipas orës që është paraqitur shtetasi në sportel.

DATË 13.02.2022

287. **Në datë 13.02.2022 ora 08:10:53 min,** në kabinën në hyrje të R.Sh-së ku është instaluar kamera nr. 7, paraqitet një pasagjer i cili udhëton me automjet. Pasi i jep dokumentin e identifikimit punonjësit të policisë **Gëzim Duraku**, ky i fundit i kërkon atij edhe *një kafe* të cilën shtetasi ja jep duke e futur brenda në dokumentin "Leje Qarkullimi" të automjetit një kartëmonedhë prerje 5 euro. Biseda e zhvilluar ndërkohe që kryhen veprimet si më sipër, paraqitet si vijon::

***Gëzim Duraku**: Si jeni? A je mire?*
***Shtetasi**: Mirë.*
***Gëzim Duraku**: Po e ke vaksinën?*
***Shtetasi**: Po*
***Gëzim Duraku**: O……(i përmend emrin Arton)…me ca merresh atje ti? …Aaa?*
***Shtetasi**: …-(fjalë qe nuk kuptohet)-*
***Gëzim Duraku**: A ki pat punë a jo aa?*
***Shtetasi**: Pak po*
***Gëzim Duraku**: keni pat keni punu i keni q… nanën*
***Shtetasi**: Pak mirë po*
***Gëzim Duraku**: Mirë pa problem …….Për kafe a keni punu të paktën. Ahahah shife am librezën*
***Shtetasi**: Për kafe.*
***Gëzim Duraku**: Po.*

288. **Në datë 13.02.2022, në orën 08:22 min**, sipas pamjeve filmike, në kabinën ku është duke punuar punonjësi i policisë **Gezim Duraku** hyn një tjetër punonjës policie cili menjëherë sa hyn në kabinë konstatohet duke i dhënë para kontrollorit të ulur para kompjuterit. Në vijim ata kryejnë këtë bisedë :

Polici 1**: **Gezim Duraku,
Polici 2:Hasan Kovaçi
***Polici 1**: Po se imagjinova mor*
***Polici 2:** Ooo ti o ekstrem, kalon komplet me kontrabandë ne nuk e dimë me çfarë, nuk o puna jonë*
***Polici 1:** …e kam kalu tha unë*
***Polici 2:** Po shko mor knej se ska kurrë n jetën teme*
***Polici 2:** E di u kry puna….kur po thu ti unë e kam kalu*
Polici 1:eee e di cdo me thane qe ne spo e dimë …po shkoj der tek I madhi po shkoj…….Ik bre budall
***Polici 2**: Skena shans me e nal or ti …nje sekond bre …….*
***Polici 1** i ulur: Tre muaj ka bërë burg Hasani për qito lojansh kështu (Hasan Kovaci)*
***Polici 2:** Po sun i thom jo o shok……..*
Polici 1:…me rast kondrabandë nuk ka shans në botë edhe nëse ta hedh dogana
***Polici 2:…**ka kalu qetë Bilbil Veseli*
***Polici1**: Kur e ka kalu mor*
***Polici 2**: E kan kthe e kan kalu të Kosova*

Polici 1: *Po s'ka shans mo Gëzim (duke ju referuar punonjësit në këmbë)*
Biseda vijon dhe sipas procesverbalit referohet se nuk mund të transkriptohet por janë transkriptuar fragmente të cilat paraqiten në vijim:
Gëzim Duraku*: Unë duhet me e lënë e mo na del ndonjë llaf e na e bën të vështir*
Polici:*U tha u krye*
Duraku:*Po fiki këto*
Rezulton se sipas pamjeve filmike, polici në kabinë afrohet te kompjuteri dhe shikohet dora e Gëzim Durakut mbi mausin e kompjuterit.
Polici : *po fiki*
Gëzim Duraku: *Der në ça ore?.*
Polici*: der në 8:20.... Nga posht nga posht ... çaty*
Duraku*:* ***duhet me i bë dhe nja tre të tjera...një 800.. jo nuk duhet me imagjinu se është problem me ...***
Polici*: Kush? Po s'imagjinoj or ti ooo ekstrem*
Gëzim Duraku*:...* ***me kontrabandë u pa puna jonë e keni praktik nuk gjendet kund në botë...u kry puna***
Polici H: *... Dhe unë e kam provue...(behet debat)*
Gëzim Duraku: *Ej e di çdo me thënë*
Polici H: *As unë nuk e di unë der te i madhi më çon....*
Gëzim Duraku*: unë me e dit se ka dalë gjak çatenaj thonë ik*
Polici H: *Me ke flet, se unë e di se kam bë tre muj burg ,tre muj burg, se nuk i them jo o shok se di rreshtin unë po se hyn në parkexh me kontrabandë ky është shanc i madh me jetë me jetë ta jap*
Gëzim Duraku: *edhe se ta hedh dogana*
Polici H: *Po*

289. **Në datë 13.02.2022, në orën 08:28:42 min** ndërpritet turni dhe në përpunim pasagjerësh vjen një punonjës tjetër policie. Në orën 09:32 min të datës 13.02.2022, punonjësi i cili është duke përpunuar pasagjerë në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7 është fiksuar teksa merr dokumentet e një pasagjeri për përpunim. Në mes të dokumentit pasaportë konstatohet të jetë një kartëmonedhë në dukje jeshile e lehtë, por për shkak se është e palosur nuk mund të dallohet prerja. Punonjësi i policisë e hedh përpara pajisjes skaner dhe me të përfunduar, regjistrimin e dokumenteve në sistem, e tërheq me pëllëmbë drejt vetes. Nga lloji i dokumenteve kuptohet se janë dokumente të shtetit të Kosovës dhe pasaportën të cilën e përpunon të parën ja kthen përsëri shtetasit duke i thënë:***" Rregullojë pak".*** E merr mbrapsht dhe pastaj prej saj nxjerr një kartëmonedhë të ngjashme me 5 euro. Para se të marrë pasaportën brena së cilës është shuma 5 euro, ka përpunuar tre dokumente në dukje Karta Identiteti të Kosovës. Nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të informacionit TIMS, rubrika "Raporte-Statistika", konstatohet se në këtë orar përpunimin e pasagjerëve e ka kryer punonjësi **Ylber Hoxha,** me funksion Specialist Ndihmës Kontrollor në P.K.K Morinë. Biseda e zhvilluar midis tij dhe shtetasve është si më

poshtë:
***Ylber Hoxha**: A i keni vaksinat?*
***Shtetasi**: -Nuk dëgjohet-*
***Ylber Hoxha**: Duhet me i pas vaksinat te paktën një dozë....Me ca merreni ju?.*
***Shtetasi**: -Nuk dëgjohet -*
***Ylber Hoxha**: Rregulloje pak (dhe i jep pasaportën mbrapsht) Pasi merr pasaportën si më sipër, i drejtohet me fjalët **Ylber Hoxha**: Hajde pra respekt, shnet.*
Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj ora 09:32 min deri në orën 09:33 min janë përpunuar dokumentet e shtetasve: *Altin Imeri* i datëlindjes 15.06.199 drejtues i automjetit auto veturë me targa "02437DL". Shtetasi i mësipërm është edhe drejtues i automjetit por është edhe emri i parë i përpunuar në sistem që korrespondon me pasaportën e shtetasve pasi të tjerat ishin karta identiteti. Brenda pasaportës ishte edhe shuma 5 euro. Shtetasit e tjerë pasagjerë në të njëjtin automjet janë: *Arjeta Haziri* e datëlindjes 16.04.2000, *Arber Imeri* i datëlindjes 02.06.1999 dhe *Verona Imeri* e datëlindjes 22.07. 1998, pasagjerë në të njëjtin automjet.

290. **Në orën 10:20:56 min të datës 13.02.2022** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH, ku është duke punuar punonjësi i policisë i identifikuar si përdorues i sistemit TIMS me kodin "UKAE" **Endrit Uka,** paraqitet një pasagjer dhe i dorëzon dokumentin pasaportë, ndërkohë që gjatë bisedës ju drejtohet në numrin shumës duke u kuptuar se janë disa persona në automjet. Pavarësisht kësaj konstatohet që ai përpunon vetëm një dokument pasaportë të cilën ja jep mbrapsht shtetasit, i cili fut në të një kartëmonedhë 5 euro. Biseda e zhvilluar midis tyre është
***Endrit Uka**: Vaksinat...I keni në telefon?*
***Shtetasi**:....(nuk dëgjohet)……..*
***Endrit Uka**: Nga sa keni?.....Vetëm një paske?,....Duhen dy a e di ket pune?. Unë polic që jam i kam ba dy copë……Se di qysh me ja ba se a ba problem për zotin. Rregulloje pak..*
Sipas pamjeve filmike në këtë moment i jep pasaportën e dytë mbrapsht dhe pasi e merr përsëri punonjësi i policisë nxjerr prej saj një kartëmonedhë të ngjashme me 5-euro.
Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj datë 13.02.2022 nga ora 10:20 deri në orën 10:22, që përkon me veprimet e këtyre shtetasve sipas pamjeve filmike, është përpunuar dokumenti i shtetasit *Shpëtim Avduti*, shtetas kosovar i datëlindjes 02.06.1980, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "04651IO".
291. **Në datë 13.02.2022, në orën 10:42 min, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes,** përgjegjësi i turnit Halim Shehu konstatohet në kabinën e kontrollorit dhe janë duke biseduar, ndërkohë tek sporteli paraqitet një shtetas kosovar ku nga biseda kuptohet se i thotë punonjësit që ka harruar dokumentin e tij, ndërsa dokumentet e personave që udhëton së bashku i ka dorëzuar. Punonjësi i policisë në shërbim **Ylber Hoxha** i thotë shtetasit të rrotullohet dhe të kthehet mbrapa dhe ja jep dokumentet mbrapsht. Në orën 10:45 i njëjti person vjen e paraqitet në sportel, komunikon me punonjësin e policisë **Ylber Hoxha** në prani të përgjegjësit të turnit Halim Shehu, i cili ka qenë prezent për një kohë të gjatë në kabinë. Punonjësi i policisë Ylber

Hoxha dëgjohet të pyesë përgjegjësin e turnit duke i thënë që *çfarë ti bëjmë këtij*. Përgjegjësi i turnit i thotë *merri kafen* e ndërkohë punonjësi i policisë, kontrollori Ylber Hoxha i thotë shtetasit kosovar *shko fute një kafe në dokumente*. Pas kësaj kërkesë shtetasi kosovar largohet për disa sekonda nga veprimet dallohet se diçka i jep punonjësit të policisë Ylber Hoxha, por nuk dallohet qartë. Shtetasi që ka qenë prezent në sportel në këtë interval kohor nuk rezulton i regjistruar në sistem dhe po ashtu edhe personat që udhëtonin në automjet me të. Biseda që zhvillohet sipas regjistrimit audio dhe procesverbalit të transkriptimit është si më poshtë:

***Shtetasi kosvar**: e kam harrue pasaportën:*

***Ylber Hoxha**:....prej ka je ti me ca merresh:*

***Shtetasi**: Unë jetoj në.....(fjalë që nuk mund të transkriptohen)*

***Ylber Hoxha duke iu drejtuar përgjegjësit të turnit Halim Shehu**: Ça me i ba ktij?*

Halim Shehu**: **Duhet me pagu

***Ylber Hoxha**: Shko fute një kafe qetu bre...Shko fute mor një kafe në letra*

Pas kësaj bisede, sipas pamjeve filmike, shtetasi kosovar largohet dhe kthehet disa sekonda më vonë duke i lënë dokumentet e bashkudhëtareve mbi tavolinën e kontrollorit. Ndërkohë në këtë moent largohet nga kabina edhe Halim Shehu.

292. **Në datë 13.02.2022, ora 10:46 min**, ndërkohë që është në shërbim punonjësi i policisë Ylber Hoxha, vijon me skanimin e një dokumenti pasaporte të një udhëtari tjetër. Në orën 10:47:05 vjen një shtetas kosovar që është duke pritur dhe mes tij dhe kontrollorit zhvillohet kjo bisedë:

***Ylber Hoxha:** Hajde rrofsh*

***Shtetasi KS**: Ma ba hallall, tre vete jemi, tre vete.....-(fjale te tjera qe nuk kuptohen)-*

***Ylber Hoxha:** Hec tani se s'ka gjë po hik.*

293. Në datë **13.02.2022, ora 11:27:26**,gjatë përpunimit të një pasagjeri, punonjësja e policisë me kodin e përdoruesit në sistemin TIMS, "TOCILAE", **Elidjana Toçila** dëgjohet teksa pyet një shtetas kosovar i cili ka sjellë dokumente për regjistrim në hyrje, nëse e ka vaksinën. Ai i përgjigjet që nuk e ka dhe në këtë moment **Elidjana Toçila** i thotë që të hapë krahun se kanë për ta menduar këtë punë. Në vijim, pasi ky shtetas hap krahun, punonjësja e policisë përpunon dy pasagjerë të tjerë dhe ndërkohë dëgjohet të thërrasë shefin, sipas regjistrimit audio. Shtetasi kosovar afrohet sërish dhe dëgjohet t'i pëshpëritë diçka. Ndërkohë ka shkuar në kabine përgjegjësi (shefi që ka kërkuar në bisedë me kolegen e saj), i cili sipas të dhënave që pasqyrohen në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike është identifikuar si punonjësi i policisë Halim Shehu, Elidjana i drejtohet këtij të fundit me fjalët *lëre se e mbarova vetë*. Në pamjet filmike pasqyrohet veprimi i saj duke vendosur një kartëmonedhë 5-euro në anë të pajisjes skanuese ndërsa biseda e zhvilluar është transkriptuar si vijon:

***Elidjana Toçila:** E ke vaksinën?*

***Shtetasi KS:** Jo nuk e kam*

***Elidjana Toçila:** Po po s'lejohet pa vaksine. ...edhe ajo ka një vaksinë duhet të ketë dhe testin*

***Shtetasit KS**: ...-Nuk dëgjohen fjalët-.*

Elidjana Toçila:*Urdhëro? Unë nuk e di mua më duhen dokumentet ta verifikoj.* ***Pa dokumente nuk...nuk lejohet ti s'ke fare një herë të paktën ta kishe ....****-(fjale qe nuk kuptohet)-*
Shtetasi KS:*..-fjalë që nuk kuptohen-.*
Elidjana Toçila: *jo jo....te duhet vaksina, hape krahun ta mendojmë një herë, vazhdo të lutem hape krahun*
Elidjana Toçila: *Miredita.*
Ndërkohë sipas pamjeve rezulton se vazhdon me pasagjerin tjetër, ndërsa dy shtetasit kosovarë me të cilët kishte komunikuar me herët, si më sipër, janë në pritje. Vijon përpunimin me një pasagjer tjetër dhe njëkohësisht komunikon në telefon ku dëgjohet kjo bisedë:
Elidjana Toçila*: Foli një cikë Renit të vije këtu një sekonde...*
Bashkëbiseduesja: Jenë në banjë ata...-(fjale qe nuk kuptohen)-
Elidjana Toçila*: Ditën e mirë (i drejtohet pasagjerëve që ka përpunuar ndërkohë)*
Elidjana Toçila:*(drejtuar shtetasit kosovar në pritje): Prit aty sa të vijë shefi të bisedosh me shefin*
Shtetasi KS: *A me ta qit një kafe...-(fjale qe nuk kuptohen)-...*
Ndërkohë vijon me përpunimin e tre pasaportave të tjera dhe në kabinë vjen një kolegu i saj të cilin e kishte kërkuar më parë dhe ndërsa ndodhin këto ngjarje është zhvilluar dhe biseda në vijim:
Elidjana Toçila: *Ku po shkoni?*
Shtetasi:.....*nuk kuptohen fjalët.....*
Elidjana Toçila: *Do ikni përjashtë?*
Biseda në momentin që vjen kolegu i saj vijon si më poshtë:
Kolegu: *Hë...*
Elidjana Toçila: *Mbarova punë mbarova, mbarova vetë*
Kolegu: *Mbarove vetë?.....-(fjale qe nuk kuptohen ne vijim)-*

294. **Në datë 13.02.2022, në orën 16:16** min, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7 dallohet punonjësi i policisë **Ylber Hoxha**, i cili ka disa prerje kartëmonedhash euro para kompjuterit në dukje 50-tëshe. Ky punonjës është verifikuar pasi në orën 16:11 min deri në orën 16:12 min ka përpunuar katër dokumente shtetasish kosovare me Karta Identiteti, këqyrur sipas pamjeve filmike duke u krahasuar edhe sipas sistemit TIMS, ku rezulton si i vetmi përdorues burrë, pasi dy përdorueset e tjera janë punonjëse femra. Ylber Hoxha në këto pamje që përkojnë më këtë hark kohor shfaqet duke numëruar para por nuk rezultojnë veprime të tjera.

295. **Në datë 13.02.2022, ora 15.50 min**, në kabinën nr.4 hyrje R.Sh ku është instaluar kamera nr. 7 dhe është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Ylber Hoxha**, paraqiten tre shtetas kosovarë. Nga intervistimi që ju bën punonjësi i policisë, njëri prej tyre i përgjigjet se e ka emrin Jetullah dhe është ai që i dorëzon dokumentet. Sipas bisedës së zhvilluar Jetullahu nuk disponon autorizim për mjetin pasi i thotë punonjësit që e ka në emër të nipit dhe po ashtu nuk ka dokument për dozën e dytë të vaksinave. Duke i gjetur në këtë problematikë punonjësi i policisë i jep njërën nga pasaportat mbrapsht dhe i thotë rregulloje këtë. Pasi shtetasi kosovar i jep mbrapsht pasaportën, të mbyllur, punonjësi i policisë i lejon që të vazhdojnë udhëtimin. Për

shkak se rrezja e pajisjes përgjuese/filmuese nuk kap para pajisjes kompjuterike ku është hapur edhe pasaporta nga punonjësi i policisë nuk është bërë e mundur të fiksohet se çfarë ka pasur brenda saj, ndërkohë që biseda e zhvilluar mes tyre paraqitet si vijon:

***Ylber Hoxha**: O djali si e ke emrin ti?.*

***Sht Kosovar**: Jetullah*

***Ylber Hoxha**: Makina e kujt është o Jetullah?*

***Jetullahu**: E nipit*

***Ylber Hoxha**: Autorizim ke ba?*

***Jetullahu:** I ka kalu afati bre.*

***Ylber Hoxha**: Prej ka je ti?*

***Jetullahu:** Prej .....(nuk kuptohet përgjigja)*

***Ylber Hoxha**: Ku jeni tu shku?*

***Jetullahu**: NëDibër*

***Ylber Hoxha**: O bobbo. Po vaksinat a i keni dy dozat?*

***Jetullahu**: Nji dozë po*

Ylber Hoxha**: O bo bo bo bo edhe këto nji dozë e ca me te thanë ti tash?.....**Shikoje pak rregulloje pasaportën

Sipas pamjeve filmike rezulton se ai vijon bisedën me bashkëbiseduesen që mbante hapur në linje telefonike dhe më pas i drejtohet Jetullahut me fjalët : *Ylber Hoxha : ...Respekt rruge të mbare.* Nga këqyrja dhe marrja e të dhënave të sistemit TIMS që përkojnë me harkun kohor kur zhvillohen ngjarja e regjistruar si më sipër, rezulton se janë përpunuar dokumentet e shtetasit *Jetullah Sertolli* i datëlindjes 17.01.1997, drejtues i automjetit auto veturë me targa "TG202639".

296. **Në datë 13.02.2022, ora 17.33 min**, punonjësi **Ylber Hoxha** është duke kryer shërbimin në kabinën e tij në hyrje të R.Sh-së, në të cilën paraqiten përsëri dy shtetas kosovarë. Pasi ju kërkon vaksinat që me sa duket shtetasve kosovarë ju mungon njëra dozë, i jep përsëri njërin dokument duke i thënë: ***"...mere rregulloje pak...***". Biseda e kryer midis punonjësit të policisë Ylber Hoxha dhe shtetasit kosovar është si më poshtë vijon:

***Ylber Hoxha**: Vaksinat i keni?*

***Shtetasi:**.....nuk kuptohet*

***Ylber Hoxha**: Pa vaksina jeni ee?....Me çfarë merresh?*

***Shtetasi**: Nuk kuptohet çfarë thotë.*

***Ylber Hoxha**: Vetëm me test nuk mundesh, duhet të paktën një vaksinë.*

***Shtetasi:** I kam bo...*

***Ylber Hoxha**: I ke ba o vëlla, ku po shkon?*

***Shtetasi:**.....nuk kuptohet*

***Ylber Hoxha**: Me ka je i shoqeru?*

***Shtetasi**: Me gruan...*

Ylber Hoxha**: **Kqyre pak, rregulloje pak

Ndërkohë i jep një nga dokumentet dhe është duke pritur.

Shtetasi: 10 euroshe qyshthu

Ylber Hoxha: Ok...
Ylber Hoxha:Hajde respekt
Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS ka rezultuar se nuk ka regjistruar bashkudhëtaren e shtetasit kosovar *Bajram Bojaj* i datëlindjes 08.09.1985, drejtues i automjetit auto veturë me targa "03774FT", ndërkohë që nga biseda e zhvilluar si më sipër, rezulton e qartë se ai ka qenë i shoqëruar me bashkëshorten.

297. **Në datë 13.02.2022 nëorën 17:46 min** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7 dhe është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Endrit Uka,** vjen një shtetas kosovar dhe ky punonjës konstaton se një nga dokumentet e mjetit i mungon dhe për këtë arsye shtetasi i jep e euro. Biseda e kryer midis punonjësit në shërbim Endrit Uka dhe shtetasit është si vijon:
Endrit Uka: *A ke karton të gjelbër, edhe vaksinat*
Shtetasi: *Po*
Endrit Uka: *(disa fjale qe nuk kuptohen)... ku po shkon*
Shtetasi: *Nga Tirana, pastaj....(nuk kuptohet)*
Endrit Uka: *Ky karton s'ka ndonjë targe....(flet ne telefon me dike tjetër). ...A ke tjetër?.*
Shtetasi:*....nuk kuptohen fjalët...*
Por, sipas pamjeve filmike konstatohet qe midis dokumenteve i jep 5 eurot.
Endrit Uka:E shef që na e bone dhuratën deri në fund.
Shtetasi: ***Një kafe kom me ta dhënë unë.....****(fjale qe nuk kuptohen).*
Endrit Uka: Po Po*...faleminderit hajd ciao.*
Nga verifikimi i të dhënave përftuar nga pamjet filmike dhe veprimeve të kryera në sistemin TIMS rezulton se në orën 17:47, orë e cila përkon me vendosjen e dokumentit mbi pajisjen skanuese, punonjësi i policisë **Endrit Uka** ka përpunuar dokumentin e shtetasit kosovar *Zija Rexha* i datëlindjes 15.01.1979, drejtues i automjetit auto veturë me targaËZ378HA, i cili i ka dhënë edhe shumën prej 5 euro, për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt, sipas bisedës më sipër.

DATË 14.02.2022

298. **Më datë 14.02.2022, ora 19:34:01,** në sportelin e kabinës nr. 4 hyrje R.SH, në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, në kabinë, përpara kompjuterit të punës qëndron kontrollori i policisë, i identifikuar si kontrollori **Vehbi Nerguti**. Ndërkohë në të njëjtën kabinë duke qëndruar për disa minuta bashkë me të edhe kontrollori tjetër **Urim Lami**, i cili ulet përballë Vehbi Nergutit. Nga pamjet filmike konstatohet se sapo ulet në karrige, kontrollori **Urim Lami**, nxjerr nga xhepi i pantallonave një shumë parash të prerjeve të ndryshme, si në euro e lekë dhe fillon e i numëron e pastaj iu fut përsëri në xhepin e pantallonave. Me pas kontrollori Urim Lami nxjerr një shumë tjetër parash nga xhepi i xhaketës policore dhe fillon e i numëron edhe këto. Nga pamjet filmike konstatohet se dhe kjo shumë parash është e valutave të ndryshme, ku mund të dallohen kryesisht euro dhe lekë të prerjeve të ndryshme. Pasi i numëron, i fut në xhepin e xhaketës. Në vijim biseda e transkriptuar mes kontrollorit të policisë Urim Lami që futet në kabinën e Pikës Kalimit

Kufitar Morinë-Kukës dhe kontrollorit në shërbim Vehbi Nerguti, të cilët diskutojnë për një shtetas i cili është në sportel.

***Kontrollori Urim Lami**: Numëron lekët...njëzet qind ....- nuk dëgjohet qartë-*

Kontrollori Vehbi Nerguti :Mos ka ndonjë arme pa leje

Kontrollori Urim Lami: Në rregull është pa he

***Kontrollori Vehbi Nerguti**: -Nuk dëgjohet--...po...por..*

Nga këqyrja në sistem e hyrjeve të shtetasve shqiptare në RSH, më datë 14.02.2022, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Morinë Kukës, rezulton se në orën 19:31:00, në kohën që zhvillohet biseda dhe kryhen veprime në sistem nga punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti**, janë regjistruar në hyrje të R.Sh-së, shtetasja *Siodorela Lybeshari* e datëlindjes 01.10.1995 si dhe shtetasi *Ingli Hazbi Lybeshari* i datëlindjes 07.05.1995, të cilët kanë kaluar me makinën auto veturë me targa, "AB 600 ES". Ndërsa, në orën 19:50:00 është regjistruar shtetasi *Ardian Nezir Demiri*, i datëlindjes 07.09.1980 me makinën auto veturë me targa AB784 BD. Përpunimi këtyre shtetasve, është kryer nga kontrollori **Vehbi Nerguti.**

299. **Më datë 14.02.2022, ora 18:50:03,** në kabinën në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera nr. 207 është duke punuar kontrollori **Urim Lami**. Në karrigen përpara kontrollorit futet kontrollori tjetër **Vehbi Nerguti**. Pasi futet, nxjerr nga xhepi një kartëmonedhë të prerjes 50 euro dhe i fut në portofolin e tij, në të cilin dallohen se ka një shumë tjetër parash të prerjeve dhe ngjyrave të ndryshme. Më pas kontrollori Vehbi Nerguti nxjerr nga portofoli një kartëmonedhë 20 Euro dhe merr në xhepin e djathtë edhe një kartëmonedhë 10 euro dhe i mban të palosura në dorën e djathtë. Në vijim kontrollori Vehbi Nerguti çohet në këmbë dhe me dorën e djathtë i jep shumën prej 30 eurosh që mbante në dorë kontrollorit Urim Lami që po kryen përpunimin e dokumentacionit në sportel. Nga verifikimi në sistem, krahasuar me personat e shfaqur në pamjet filmike, rezulton se në këto momente kontrollori Urim Lami, përdor fjalëkalimin e kontrollorit Vehbi Nerguti. Nga transkriptimi i regjistrimit audio rezulton se në momentin që punonjësi i policisë i jep shumën prej 30 euro kontrollorit të policisë në kabinë, nuk flasin fare.

Nga këqyrja në sistem e hyrjeve të shtetasve të huaj në RSH, më datë 14.02.2022, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Morinë Kukës, në orën 18:52:32 që nga pamjet filmike dallohet se kontrollori fut në pajisjen skanuese një Kartë Identitetit të shtetasve të Kosovës, rezulton se janë regjistruar shtetasit nga Kosova *Deljalj Demiraj*, i datelindjes 23.08.1983 me makinë auto veturë me targë ULA U594 shofer si dhe shtetasja *Sherife Demiraj* e datëlindjes 24.10.1984 me auto veturën me targe, "ULA U594".Përpunimi rezulton se është kryer nga Kontrollori Vehbi Nerguti por nga pamjet filmike të kësaj kohe rezulton se në tavolinën e punës ka qënë kontrollori Urim Lami.

300. **Po në date 14.02.2022, ora 15.15.08,** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh në Pikën e Kalimit Kufitar Morine-Kukës, ku është vendosur kamera Nr. 207, përsëri janë konstatuar veprime të kontrollorëve **Vehbi Nerguti** dhe **Urim Lami**. Në ndenjësen sipër njësisë kompjuterike, përpara kontrollorit të policisë në shërbim Vehbi Nerguti hyn serish kontrollori tjetër **Urim Lami**. Sapo ulet në karrige kontrollori Urim Lami nxjerr nga xhepi një shumë parash të prerjeve të ndryshme

në dukje euro dhe pasi i numrin bën ndarjen e tyre, një pjesë i fut në xhep përsëri dhe pjesën tjetër i mban në dorën e djathte se bashku me kapelën e policisë. Pasi qëndron për një periudhë prej disa minutash në kabinë, kontrollori Urim Lami lëviz prej saj. Në vijim biseda e transkriptuar midis punonjësit Vehbi Nerguti dhe Urim Lami paraqitet si më poshtë:

Urim Lami** (kontrollori që futet në kabinë): **Janë ba nga 40 euro

Vehbi Nerguti** (kontrollori në përpunim në kabinë):**Mos ki merak

301. **Po në datë 14.02.2022, ora 10:33:40** në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh-së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera Nr. 207, sipas pamjeve filmike rezulton se në tavolinën e kontrollorit në shërbim të identifikuar si kontrollori **Vehbi Nerguti,** në sportel paraqitet një shtetasi cili i jep dokument udhëtimi pasaportë shqiptare dhe në mesin e saj konstatohet se ka futur një kartëmonedhë te prerjes20 euro, të palosur. Kontrollori Vehbi Nerguti pasi hap pasaportën, nxjerr kartëmonedhën nga pasaporta dhe fillimisht e vendos në cep të tastierës, pastaj e merr përsëri nga cepi i tastierës dhe e fut poshtë saj. Kontrollori i policisë, nuk kryen komunikime me shtetasin në sportel. Konstatohet se pasaportën që shtetasi i fut 20 euro kontrollori Vehbi Nerguti nuk e fut në pajisjen skanuese por përpunon një pasaporte tjetër. Në vijim biseda e transkriptuar mes kontrollorit Vehbi Nerguti dhe shtetasit që ai përpunon menjëherë pas shtetasit që i jep 20 euro, paraqitet si vijon:.

***Vehbi Nerguti**: Ça bane...na fal se te vonume*

***Shtetasi**: Ça...nuk dëgjohet mire*

***Vehbi Nerguti:** Probleme te pakuptueshme;*

***Shtetasi**:....Të kuptueshme ee...*

Vehbi Nerguti**: - I flet ne emër por nuk dëgjohet qartësisht dhe dëgjohet :**Vaksinat ...vaksinat ...Kalofsh mire.

Sipas pamjeve filmike dhe bisedës së zhvilluar rezulton se arsyeja e dhënies dhe marrjes së shumës prej 20 duro nga kontrollori Vehbi Nerguti, është mos pasja e dokumentacionit për vaksinat nga shtetasi dhe po ashtu mos regjistrimi i dokumentit të njërit prej shtetasve në sistem pasi konstatohet në pamjet filmike që një pasaportë që mban në dorë dhe ja jep shtetasi nuk e kalon në pajisjen skanuese. Sipas verifikimit dhe këqyrjes së sistemit TIMS në intervalin kohor ora 10:33 min deri në orën 10:34 min, punonjësi i policisë Vehbi Nerguti rezulton të ketë përpunuar dokumente të shtetasve kosovarë. Sipas procesverbalit të transkriptimit të regjistrimit audio në orën 11:44:00, në të cilën mes kontrollorit dhe shtetasit në sportel zhvillohet kjo bisedë:

Nehbi Nerguti**:**Jo Donat jo...Shen Valentinin ktheje e beje në Kosove

Shtetasi: Jo...jo...

Nga këqyrja në sistemin TIMS rubrika hyrje-shtetas të huaj, në RSH, më datë 14.02.2022, e konkretisht në orën 11:44:00, rezulton se ka hyrë në Shqipëri, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Morinë Kukës, shtetasi nga Kosova *Donat Meholli*, i datëlindjes 11.06.2001 dhe përpunimi është kryer nga kontrollori **Vehbi Nerguti**.

302. **Më datë 14.02.2022, ora 13;03.11,** në kabinën nr. 4 hyrje, sipas pamjeve filmike, në prezencë të punonjësit të policisë **Urim Lami,** i cili qëndron në këtë kabinë, në tavolinën e

kontrollorit që është me shërbim dhe është në ato momente, duke punuar në kompjuter **Vehbi Nerguti,** në orën 13:03 min konstatohet se kolegu i tij Urim Lami i hedh në tavolinë dy kartëmonedha të prerjes 5-euro. Kontrollori **Urim Lami** nuk komunikon ndonjë gjë konkrete në lidhje me dhënien e këtyre kartëmonedhave edhe më pas bisedat janë pa interes.

303. **Më datë 14.02.2022, ora 09:35:06,** në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh-së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera Nr. 207, konstatohet se kontrollori i policisë që është me shërbim **Urim Lami** shfaqet duke nxjerr një zarf me dokumente, brenda të cilave dallohet një kartëmonedhë 5-euro të cilën e vendos në cep të tastierës. Me pas kontrollori Urim Lami e fut poshtë tastierës dhe më pas dallohet që ta tërheqë me dorë prej saj. Në orën 09:38:22 dallohet se kontrollori Urim Lami që fut në pajisjen skanuese një kartë identiteti shqiptare. Nga këqyrja e sistemit TIMS, rubrika "hyrje-shtetas shqiptarë", me datë 14.02.2022, ora 09:38:00, nga kontrollori "LAMIU"(Urim Lami)ka përpunuar dokumentin kartë identiteti të shtetasit *Arbi Gëzim Sopaj*, i datëlindjes 26.06.1997, shofer i mjetit me targa "AA889ZT".

304. **Po në datë 14.02.2022**, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera nr. 207, në orën 09:52:03 është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Urim Lami**, dhe konstatohet se hyn një punonjës tjetër policie i cili mban në dorë një telefon dhe në uniformën e tij mban numrin identifikues "26060". Nga verifikimi rezulton se është përgjegjësi i turnit në PKK Morinë **Emilton Asllanaj**. Në orën 09:51:45, kontrollori **Urim Lami**, në mes të dokumenteve që një shtetas i jep për përpunim veçon një kartëmonedhë5 euro të cilën fillimisht i vendos në cep të tastierës e më pas e merr. Në momentin që kontrollori interviston shtetasin në sportel të cilin e pyet nëse ka vaksinat e në mungesë të tyre i përmend shumën e ryshfetit 5 euro është prezent është edhe përgjegjësi i turnit Emilton Asllanaj. Në vijim biseda e transkriptuar mes kontrollorit Urim Lami e shtetasit që është në sportel, në momentin që merr shumën prej 5 euro zhvillohet i më poshtë:

Urim Lami: *Ke vaksinë e duhet me ba edhe test s'duhet me te leju me kalu pa leju me kalu pas test ...ku do ..-nuk dëgjohet-... llamarinat*

Shtetasi:*-Nuk dëgjohet-....ka test me ba këtu*

Urim Lami. *Nja 20 njezët po njëherë*

Shtetasi*...-Nuk dëgjohet-*

Urim Lami: *Hajt pra që mbaje...-Nuk dëgjohet- ...**5 euro.. për 20 shkon e bën atje***

Shtetasi:*-Nuk dëgjohet-...-*

Urim Lami:*Kur....llamarinat..*

Shtetasi: *-Nuk dëgjohet-...*

Për të identifikuar shtetasin që është duke kaluar në këtë moment dhe ka dhënë shumë 5 euro fiksuar nga pamjet filmike, është bërë këqyrja e sistemit TIMS rubrika "Hyrje shtetas të huaj" nga ku rezulton se në orën që është duke përpunuar këtë shtetas, krahasuar kjo me të dhënat e pamjeve filmike, punonjësi i policisë **Urim Lami** përpunon dokumentin e shtetasit *Dritan Hasani,* i datëlindjes 06.10.1986 shofer, me makinën furgon me targa, *"04192GR".*

305. **Po në date 14.02.2022 në orën 11:16:26,** në kabinën në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës ku është vendosur kamera Nr. 207, është regjistruar duke kryer shërbimin

punonjësi i policisë, kontrollori **Vehbi Nerguti.** Në sportel paraqitet një shtetas i huaj të cilin punonjësi i policisë gjatë bisedës e thërret me emrin *Besart*. Ndërkohë që është duke intervistuar këtë pasagjer në kabinën ku është duke kryer shërbim punonjësi i policisë Vehbi Nerguti hyn një shtetase femër, e pa identifikuar, ku gjatë bisedës duket se ka njohje me kontrollorin dhe shtetasin në sportel. Gjatë përpunimit të këtij shtetasi punonjësi i policisë konstatohet të marrë shumën 10 euro. Në vijim biseda e transkriptuar mes kontrollorit të policisë Vehbi Nerguti dhe shtetases femër e cila futet në kabinën ku është vendosur kamera nr. 207, e ku në tavolinën e kontrollorit hidhen 10 euro, duket se arsyeja e marrjes së kësaj shumë nga kontrollori Vehbi Nerguti është se shtetasi nuk disponon dokumentin e vaksinimit kundër Covid-19. Nga këqyrja në sistem e hyrjeve të shtetasve të huaj në RSH, më datë 14.02.2022, në orën 11:14:00 rezulton se ka hyrë shtetasi nga Kosova *Besart Berisha*, i datëlindjes 01.04.1986, drejtues i automjetit auto veturë më targa 01933LL.

306. **Po në datë 14.02.2022, ora 11:06:52** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera nr. 207, është sërish duke punuar kontrollori **Vehbi Nerguti.** Sipas pamjeve filmike, pasi paraqitet një shtetas kosovar në sportel, kontrollori hap një pasaportë dhe brenda saj është e palosur një kartëmonedhë prerje 5 euro. Kontrollori **Vehbi Nerguti** kartëmonedhën e heq nga pasaporta e vendos në cep të tastierës dhe me pas e fsheh poshtë saj. Gjatë kësaj kohe që ka kryer këtë veprim, punonjësi i policisë ka skanuar në pajisje dhe ka kryer veprime vetëm me karta identiteti, ndërsa pasaportën brenda së cilës gjendet dhuma 5 euro nuk e ka kaluar në pajisjen skanuese. Nga këqyrja në sistem e hyrjeve të shtetasve të huaj në RSH, më datë 14.02.2022, (në momentin që dallohen paratë prerja 5-euro në pasaportë) rezulton se në orën 11.06.00 punonjësi i policisë Vehbi Nerguti ka kryer veprime me dokumentet e këtyre shtetasve: *Adem Ajeti*, datëlindjes 08.08.1985, me makinë me targë 01726JR; *Kushtrim Ajeti*, i datëlindjes 20.10.1998 me makinë me targë "01726JR", drejtues i mjetit; *Sanije Ajeti*, e datëlindjes 22.07.1970 me makinë me targë 01726JR jo shofer dhe *Osman Ajeti* i datëlindjes 10.12.1963 me makinë me targë "01726JR".

DATË 15.02.2022

307. **Në orën 13:11 min, të datës 15.02.2022**, në kabinën nr.4 hyrje R.SH, punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** është duke përpunuar dokumentet e dy shtetasve të huaj një shtetasi italian dhe një shtetasi kinez të cilët udhëtojnë së bashku me po të njëjtin automjet me targa *"FG357BH"*. Menjëherë më pas paraqitet një shtetas me dokument kartë identiteti kosovare. Shtetasi i përpunuar nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi, sipas të dhënave të sistemit TIMS, është *Esat Ibishi* i datëlindjes 04.02.1982, drejtues i automjetit auto veturë me targa "02324ET". Ajo që konstatohet gjatë përpunimit të pasagjerëve është fakti se udhëtarët, kryesisht ata të cilët kanë mangësi të dokumentacionit (Test-Covidi) duket si ju krijohen vështirësi me qëllim që të japin ryshfet. Konkretisht biseda mes kontrollorit Fatri Braha dhe shtetasit kosovar, është transkriptuar si më poshtë:

Fatri Iseberi: *Si kalove? Pak dokumentet e makinës (pasi merr kartën e Identitetit)...Testet.....Vaksinat*

***Shtetasi Ks**: ....(nuk dëgjohen fjalët).*
***Fatri Iseberi**: Duhet me bo testet*
***Shtetasi Ks:...** (Nuk dëgjohet se çfarë i thotë)*
***Fatri Iseberi**: Pa test.....edhe ne në punë jena...njanën ta pranoj po jo të gjitha o vëlla.....se tashi.....shko bane nji test .....Nga je ti?..*
***Shtetasi Ks**: ...(nuk kuptohen fjalët)...*
***Fatri Iseberi**: Po tashi, pronar po**.....pa test as ni kafe...kështu pronar je ti aaaa**?.*
***ShtetasiKs**: **Ni kafe po**.....(nuk kuptohen fjalët e tjera).*
Fatri Iseberi**: **Hajde bre
***Shtetasi KS**: 90 për qind, një dhete për qind....(nuk kuptohet çfarë i thotë)*
***Fatri Iseberi**: Ik vazhdo tash ...*

Sipas pamjeve rezulton se merr shumën 5 euro. Nga biseda dhe veprimet e fiksuara në pamjet filmike kuptohetse punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** pasi konstaton mungesë të testeve kundër Covidit tek shtetasi i kërkon *kafen,* dhe më pas është fiksuar dhënia e shumës 5 euro.

308. **Në orën 13:21:12, po të datës 15.02.2022** paraqiten në sportelin e kabinës nr.4 hyrje R.S, shtetas të huaj dhe i dorëzojnë dokumentet punonjësit të policisë **Fatri Iseberi.** Nga biseda që zhvillohet midis tyre konstatohet se bisedojnë mbi dokumentacionin pasi atyre ju mungojnë testet anti Covid-19. Udhëtimi i tyre drejt Shqipërisë lejohet vetëm pasi paguajnë, siç rezulton nga pamjet filmike dhe biseda e zhvilluar midis tyre është si më poshtë vijon:

***Fatri Iseberi**: Helou, si kalut ju?... testet, vaksinat ?*
***Shtetasi Ks:..**(nuk kuptohet)*
***Fatri Iseberi**:...jeni krejt...duhet me shku me bo testet....Me jep dhe autorizimet....ke leje?*
***Shtetasi Ks:.....**nuk kuptohet*
Fatri Iseberi**: **Duhet me u kthy me shku me bo testet
***Shtetatsi Ks**: nuk kuptohet*
Fatri Iseberi**: Atë nuk e di ça bën ti ajo është puna jote. Duhet me u kthy me shku me rregullu e me ardh...**Pa test nuk ban
***Shtetasi KS:** nuk kuptohet*
***Fatri Iseberi**: ne ca me bo? Ne cish me thane?*
***Shtetasi Ks:** nuk kuptohet çfarë thotë*
***Fatri Iseberi**: **Ndaç shkoni bani anej, ndaç shkoni bani knej, nga të doni.. s'munem me dhanë lekë me pague test tyja**....Po unë ca me bo unë....o zotëri tashi nuk ban, nuk ban...(ndërkohë i mban dokumentet dhe nuk ja jep)*
***Shtetasi KS**:...nuk kuptohet*
***Fatri Iseberi**: Vallaj ti shko denonco...mire shko bane nji test antigjen, me test antigjen*
***Shtetasi Ks;** Ku me e bo?*
***Fatri Iseberi**: Jo knej jo andej, knej ban 20 euro.*
***Shtetasi KS**: vijon te flasë por nuk kuptohet*

***Fatri Iseberi**: Ndaç kthejuni ndaç bani ça të doni po këtë duhet me e bo....hape krahun edhe hajde këtu, mos i harxhoni katërdhetë euro, hape krahun hajde këtu për respekt... .ndaç rregulloje ndaç bane ca t'dush...a r...te q... k....r... ne (sharje, fjalë fyese).*

Sipas pamjeve filmike është fiksuar se, pasi lëviz automjetin shtetasi kosovar vjen përsëri tek dritarja e kabinës dhe pasi i jep pasaportën, në dorë konstatohet se i ka vendosur një shumë parash e cila Fatriut nuk i pëlqen fillimisht dhe ja kthen mbrapsht. Biseda zhvillohet si me poshtë:

***Fatri Iseberi**: A do me dal dikun e mos pagu asnji send aaa?.....Ku e ki kafen?.*

***Shtetasi KS:** po skam.....(nuk kuptohet çfarë thotë)....*

Shtetasi ikën he kthehet përsëri, i jep pasaportën punonjësit të policisë **Fatri Iseberi**, i cili pasi e hap nxjerr prej saj kartëmonedha prerje 5 euro dhe monedha hekuri. Menjëherë sa i shikon zhvillojnë këtë bisedë:

***Fatri Iseberi:** Jo jo nuk ban jo*

***Shtetasi Ks**: Nuk kam hiç. Ato qe kam i kam pa te them*

Fatri Iseberi:Jo vëlla jo. Shko e bane test, dy veta këtu, mos ja fut kot tashi...mos u tall me ne pasha zotin

***Shtetasi KS:** Nuk kam(për disa sekonda bisede qe nuk kuptohet)*

***Fatri Iseberi:** Hajd, hajde....*

Në këtë moment, sipas pamjeve filmike, rezulton se shtetasi kosovar largohet përsëri dhe Fatriu është duke pritur në kabinë e po ashtu vijon edhe me përpunimin e pasagjereve të tjerë. Në orën 13:29 min, shtetasi kosovar vjen përsëri dhe fillimisht dëgjohet Fatriu ti thotë "*Nuk ban*" dhe më pas hap pasaportën dhe përveç një shumë 5 euro, i bien edhe disa monedha metalike. Pas marrjes se këtyre parave Fatriu i jep dokumentet dhe shtetasi kosovar largohet, por hedhja dhe regjistrimi i dokumenteve në sistemin TIMS kishte përfunduar më herët, që në momentin kur shtetasi kosovar është paraqitur tek kabina. Fillimisht. Shtetasi drejtues i automjetit, sipas sistemit TIMS është shtetasi *Milaim Sylaj*. Nga verifikimi i pamjeve filmike rezulton se janë dorëzuar tre dokumente Karta Identiteti tek punonjësi i policisë, por njërin prej shtetasve punonjësi i policisë Fatri Iseberi e ka regjistruar dy herë, dhe ka lënë njërin prej tyre të pa regjistruar. Më konkretisht rezulton se ka regjistruar shtetasit *Milaim Sylaj* i datëlindjes 21.11.1968, drejtues i automjetit auto veturë me targa"01123PT" dhe *Besim Cani* i datëlindjes 09.02.1976.

309. **Në orën 07:45 min të datës 15.02.2022** në kabinën nr. 4 Hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese me nr.7, është ndërprerë sinjali audio dhe për këtë arsye veprimet janë pasqyruar vetëm me fotografi. Referuar pamjeve të fiksuara në procesverbalin e këqyrjes rezulton se punonjësi i policisë i cili është duke kryer shërbim merren para (euro) por për shkak se janë të mbyllura nuk mund të përcaktohet prerja e tyre. Duke krahasuar minutën e këtij veprimi (marrjen e parave) sipas pamjeve filmike me veprimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se në orën 07:45 min nga punonjësi i policisë **Haqif Halilaj** është përpunuar automjeti tip auto veturë me targa "AA102OH", me drejtues mjeti shtetasin *Musa Imer Ahmeti*.

310. **Në datë 15.02.2022, në orën 07:48:37**, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh paraqiten përsëri në sportel udhëtarë dhe i dorëzojnë dokumentet punonjësit të policisë në shërbim Haqif Halilaj.

Brenda dokumenteve konstatohet të jetë futur një shumë 5 euro. Konstatohet se janë në përpunim dy karta Identiteti Kosovare dhe nga verifikimi në sistemin TIMS, në rubrikën Raporte-Statistika, hyrje shtetas të huaj, dy shtetasit e përpunuar në këtë orë nga punonjësi i policisë **Haqif Halilaj** janë shtetasit kosovar *Luan Shala* i datëlindjes 21.04.1988 dhe shtetasi *Arbenit Beqiraj* i datëlindjes 13.08.2000 të cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa "04767GP". Arsyeja e marrjes së shumës 5 euro nga ky punonjës policie nuk mund të përcaktohet për shkak të problemit teknik në audio dhe mungesës së regjistrimit të komunikimit të tij me shtetasit e përpunuar në këtë hark kohor.

311. **Në orën 07:53:58 min, po të datës 15.02.2022**, në sportelin e kabinës nr. 4 hyrje R.Sh dorëzon dokumentet një tjetër pasagjer dhe mbi dokumente konstatohet të jetë vendosur një kartëmonedhë euro, por për shkak se punonjësi i policisë në shërbim **Haqif Halilaj** i mban dhe i tërheq para kompjuterit, nuk mund të dallohet prerja. Nga verifikimi ne rubrikën hyrje shtetas të huaj rezulton se në datë 15.02.2022 ora 07:53 min është përpunuar pasagjeri shtetasi *Jordan Qazim Memia* me automjetin me targa "AA314TB", përpunuar nga punonjësi **HALILIH.**

312. **Po në datë 15.02.2022, ora 08:13:46 min**, punonjësi i policisë **Haqif Halilaj** thërret një kolegun e tij me emrin *Arben* dhe pasi hyn kolegu në kabinë, hedh mbi tavolinë një prerje euro 50-tëshe të cilën e merr Haqifi. Mes tyre zhvillohet kjo bisedë:

***Haqif Halilaj**: Mbarova unë me Ilirin*

***Oficeri**: Atë lej unë ty këto tja japësh……(nuk kuptohet).. (koha kur i hedh mbi tavolinë 50-euro)*

***Haqif Halilaj**: Po mo lej*

***Oficeri**: Ma kryj ti mos ta nij hiç (ndërkohë i vendos edhe një 50-tëshe tjetër mbi tavolinë të cilat merren të dyja nga punonjësi **Haqif Halilaj**).*

Sipas pamjeve filmike dhe bisedës së zhvilluar mes tyre si më sipër, rezulton se ndërkohë punonjësi i policisë Haqif Halilaj është duke përpunuar një dokument pasaportë pavarësisht se nuk ka udhëtarë në sportel, duke ngritur dyshime mbi një regjistrim të mundshëm fiktiv. Oficeri i cili ka hyrë në kabinë i jep 50 eurot e dyta, të cilën punonjësi i policisë kontrollori Haqif Halilaj e kalon në anën tjetër të tavolinës, e pak momente më vonë, në kabinë vjen një punonjës *tjetër* policie, të cilin e thërret Arben dhe mes tyre zhvillohet kjo bisedë:

***Haqif Halilaj**: O Arben, O Arben*

***Arbeni**: Po*

***Haqif Halilaj**: Pasi i jep 50-teshen euro-Halimi ëëë*

Kjo bisedë dhe emri i përmendur, jep të dhëna se punonjësi i cili ka hyrë me herët në kabinë dhe ka dhënë shumat 50 euro në dy momente kundrejt kontrollorit mund të ketë qenë punonjësi i PKK Morinë Halim Shehu.

Në vijim kolegu i thirur në biseda me emrin Arben dhe kontrollori Haqif Halilaj zhvillojnë këtë bisedë me njëri-tjetrin:

***Arbeni**: Arjani?*

***Kontrollori**: Po. Unë ti, Ylberi, Halimi, No koment me tëtjerët*

***Arbeni**: Fjalë që nuk kuptohen*

Kontrollori**: Thashë unë, ti, Ylberi edhe Halimi, tjetër kush jo, Ok ne rregull.* ***Jenë dhënë.. (duke i bërë me dorë dhe treguar 4 gishta)....që mos dalim dh..ë
***Arbeni**: Jo jo edhe unë i thashë 100 mijë lekë kam bërë gjynah...e takova poshtë tek dogana*
***Kontrollori**: Po no koment me të tjerët*
***Arbeni**: Jo Jo jo.*
Referuar pamjeve filmike dhe veprimeve verifikuese të kryera, ka rezultuar se pamjet filmike punonjësi i policisë i cili thërritet Arben mban numrin identifikues "05578" dhe nga verifikimi në sistemin RMIS rezulton të jetë punonjësi i policisë **Arben Goçi.** Ndërsa kontrollori rezulton të jetë **Haqif Halilaj.**

313. **Në orën 08:29:30, datë 15.02.2022**, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH vjen një kontrollor tjetër, i identifikuar si punonjësi i policisë **Arben Kastrati** i cili vijon shërbimin. Në orën 08:54:49 konstatohet një shtetas kosovar i cili i dorëzon pasaportën dhe në mesin e saj ka të vendosur një kartmonedhë 5 euro. Nga ana kontrollorit Arben Kastrati përpunohen edhe katër pasagjerë të tjerë shtetas kosovarë të cilët udhëtojnë së bashku me të njëjtin mjet dhe nga verifikimi në sistemin TIMS, "Statistika dhe raporte", rubrika hyrje rezulton se shtetasi i cili ka dhënë shumën 5 euro dhe është përpunuar në orën 08:54:50 min deri në 08:50 min, është njëjti nga shtetasit kosovarë që kanë kaluar në kufi në këtë hark kohor, konkretisht shtetasit *Granit Ternava* dhe *Labinot Ternavaj,* të cilët kanë udhëtuar me automjetin auto veturë me targa, "01802LB" . sipas pamjeve filmike ka rezultuar se në përpunim janë dy shtetas pasi paraqiten dy karta Identiteti të cilat skanohen nga punonjësi i policisë. Gjatë këtyre ngjarjeve është zhvilluar biseda si vijon:***Arben Kastrati**: E jam tu u gëzu se e kena sot, e kam merak se skena me dasht me prish muhabet se e kena frikë ate kolegun. A more vesh?* ***Shetasi kosovar**: Faleminderit.....(fjalët e tjera nuk dëgjohen)*

314. **Në orën 12:28 min po të datës 15.02.2022** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH, ku është instaluar pajisja përgjuese me nr. 7, është duke kryer shërbim në hyrje të R.Sh-së punonjësi i policisë **Fatri Iseberi.** Gjatë përpunimit të dokumenteve të dy shtetasve kosovarë Fatri Iseberi konstatohet që të marrë shumën 5 euro. Për shkak të një problemi teknik audio është bërë e mundur të dëgjohet dhe për pasojë të transkriptohet biseda. Nga verifikimi në sistemin TIMS Raporte-statistika rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se shtetasit kosovarë të cilët janë përpunuar në hyrje të R.Sh-së, në orë 12:57 dhe orën 12:58 janë shtetasit *Qëndrim Krapi* i datëlindjes 30.03.1992 dhe *Burim Makolli* i datëlindjes 23.04.1996 të cilët udhëtonin me automjetin tip furgon, me targa "105476L".

315. **Në vijim në kabinën nr. 4 po në datë 15.02.2022** ulet për përpunim pasagjerësh punonjësi i policisë **Arben Kastrati** i cili në orën 14:14:23 min merr për përpunim dokumentet e një shtetasi kosovar. Kur hap dokumentin hedh diçka mbi tastiere që ngjajnë si euro, ngjyre e kuqërremtë. I shtyn me dorë dhe vijon me regjistrimin e dokumenteve. Pavarësisht se e pyet shtetasin për dokumentin e vaksinimit nuk rezulton se ja kontrollon. Biseda që është kryer midis tyre është si vijon:
***Arben Kastrati**: Ku shkon ti?.....A e ke autorizimin e Kerrit ti. Me fal me fal, vaksinën vaksinën*
***Shtetasi** KS: Nuk jep përgjigje*

***Arben Kastrati**: Urdhëro (i jep dokumentet)*
Në orën 14:31:11 min të datës 15.02.2022, konstatohet se punonjësi i policisë Arben Kastrati, ndërkohë që është duke pritur në kabinë dhe nuk është duke përpunuar dokumente, zgjat dorën para skanerit dhe prej andej merr eurot që ka marrë më parë.
316. **Në orën 16:03:30 min, po të datës 15.02.2022** në kabinën nr.4 hyrje R.SH ku është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Arben Kastrati** paraqesin dokumentet dy shtetas shqiptarë . Biseda që kryen ky punonjës me shtetasit është si vijon:
***Arben Kastrati**: Nga vini mo?.*
***Shtetasi:** Urdhëro.....(nuk dëgjohet)....Unë prej Norvegjie*
***Arben Kastrati:** Po ket makinën ku e keni marrë?*
***Shtetasi**: Nuk ku*
***Arben Kastrati**:..-per disa sekonda bashkëbisedim qe nuk kuptohet- ....Adam ke ndonjë leje qëndrimi kund ti Adam?*
***Shtetasi**:....nuk kuptohet*
***Arben Kastrati**: Sa kohë po rri atje?...Sa?.....Qysh në Gusht ti? Të 2019-tës?....Kështu që...*
***Shtetasi**:...me korona*
***Arben Kastrati**:Korona....a bone ndonjë gjë a ka ndonjë korona a ka fëmijë aaa?.*
Arben Kastrati**: **Po ca me i ba këtij djalit me i ban i shënim këtu?.
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari**: Jo jo*
***Arben Kastrati**: Jo ore*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari**: jo ore... ....(nuk kuptohen fjalët e tjera)*
***Arben Kastrati**: Nga jeni ju?*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari**: Mirditore e Laçianë*
Arben Kastrati**: **Mirditorë e Laçianë ee?....mendon përatë**.....(fjale qe nuk kuptohet) **me e deklaru?.....
Ndërkohë që zhvillohet kjo bisedë, sipas regjistrimit video dhe procesverbalit përkatës të këqyrjes, evidentohet se në kabinë hyn edhe punonjësja e policisë Vojsava Selmani.
***Shtetasi tjetër, bashkudhëtari**: ..... Nuk kuptohen fjalët...*
***Arben Kastrati**:Tjetër gjë?*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari**:...(Nuk kuptohen fjalët)*
Arben Kastrati**: **Do ti bëj një kontroll mjetit
***Olsi**: A je tu me çu atje prapë?*
***Shtetasi tjetër, bashkudhëtari**: Pse te kam çu një herë aaa?*
***Shtetasi tjetër, bashkudhëtari (Olsi)**: Nuk kuptohen fjalët*
***Arben Kastrati**: Ty aa?*
***Shtetasi tjetër, bashkudhëtari (Olsi)**: po jo me më çu atje në të ftoftë*
Vojsava Selmani**: **Po mos rri në të ftoftë mere xhupin veshu. Nuk është aq ftoftë me u anku në kët kohë, po kur të bëhet minus njëzetë e pesë?
***Shtetasi tjetër, bashkudhëtari (Olsi)**:....deti na....*
***Vojsava Selmani**: Jo mo se Mirdita s'ka deti*

***Arben Kastrati**: I ka kalu afati qysh në 2019-tën*
***Vojsava Selmani**: Kujt i kanë kalu afatet që në 2019-tën. Brenda....at 100 ditëshin , mbrena*
***Arben Kastrati**: Jepna vaksinat ti shohim pak*
***Vojsava Selmani**: Jo pra për pesë vite ndalim dalje nga Shqipëria*
***Arben Kastrati**: Po pra po*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari (Olsi)**: Nuk kuptohet*
***Vojsava Selmani**: Ca je tu thane ti edhe nja te bëhen dy e le te rrije ne Shqipni se iku gjithë rinia*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari (Olsi)**; ...popo pranaj me nejt ne Shqipëri*
***Arben Kastrati**: Ça me i ba?*
***Vojsava Selmani**: Mrena atje ke zyra*
***Shtetasi tjetër, bashkëudhëtari (Olsi)**:.....hajde pra atje*
***Vojsava Selmani**: .....hudhu në tokë edhe hajde këtu. Jo shefi nuk vjen shefi....Hap krahun se vjen shoferi këtu ose*
***Arben Kastrati**: Jo shoferi jo*
***Vojsava Selmani**: Ai cili do ai cili është?*
***Olsi**: unë, unë.....me na marre rrogën....(nuk kuptohen fjalët e tjera)*
***Vojsava Selmani**: Ok hajde pra...(ndërkohe presin te vije shtetasi tek sporteli)*
***Arben Kastrati**:.....burri fol si burrat ec pra ketu.....si na edukon fmite kemi fmi edhe na ...*
Komunikojnë me njeri tjetrin Vojsava dhe Arbeni, si vijon:
***Arben Kastrati**: Me mire me ja marr kështu*
***Vojsava Selmani**:.....nuk kuptohen fjalët për disa sekonda.*
Më pas konstatohet se shtetasi afrohet dhe i jep dokumentet e mjetit midis të cilave dallohet një prerje euro ngjyrë e kuqërremte por për shkak se punonjësi i policisë e mbyll përsëri dokumentin nuk mund të përcaktohet prerja e saj. Pasi se shikon shumën punonjësi i policisë Arben Kastrati dëgjohet të thotë:
***Arben Kastrati**: Jo jo **se asht shumë mik, jo jo, për zotin jo**, për zotin jo. Pash kryt janë shumë bre*
***Shtetasi**: Për kryt për këtë potë ze be po të them...- (nuk dëgjohet çfarë i thotë)-*
***Arben Kastrati**: Hajt tung*
***Shtetasi**: Mirupafshim*
***Vojsava Selmani**: **Faleminderit**- (fjalë që nuk kuptohen)- hajt rrugë të mbarë...*
***Vojsava Selmani i drejtohet kolegut**; Ee bre po ka pas makin 80 mije euro bre*
***Arben Kastrati**: Qe e vetja kjo makina*
***Vojsava Selmani**: E vetja?*
***Arben Kastrati**: Po.*
Referuar pamjeve filmike dhe biseda të zhvilluara si më sipër, rezulton se marrja e parave në këtë rast, nga ky shtetas, ndodh nga punonjësi në shërbim Arben Kastrati, me prezencën edhe të punonjës së policisë Vojsava Selmani. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika, Raporte-Statistika, hyrje shtetas Shqiptare për datën 15.02.2022 në krahasim me orën e bisedës rezulton se shtetasit me të cilët zhvillohet bashkëbisedimi janë: *Olsi Bib Syziu* i datëlindjes 28.02.1981

dhe shtetasi *Adams Gjon Bulakh* i datëlindjes 03.03.1986, të cilët kanë udhëtuar se bashku me automjetin tip auto veturë me targa, "AB585SM".

317. **Në orën 16:18 min, të datës 15.02.2022,** kur në kabinë është ulur për përpunim pasagjerësh punonjësja e policisë **Vojsava Selmani,** në sportelin e kabinës nr. 4 Hyrje R.SH paraqitet një shtetas shqiptar i cili i jep pasaportën për verifikim dhe në momentin që punonjësja e policisë e vendos pasaportën në pajisjen skaner, dallohet sipër saj një prerje 5 mije lekë. Nuk është zhvilluar ndonjë bisedë midis punonjëses së policisë dhe shtetasit që i lë kartëmonedhën 5-mijë lekëshe, por konstatohet nga pamjet që ajo nuk kryen asnjë intervistim ndaj tij. Në vijim punonjësja e policisë **Vojsva Selmani,** në po të njëjtën kabinë është duke përpunuar dokumentet e tre udhëtareve të tjerë ku njëri prej tyre e thërret me emrin *Demajl.* Nga verifikimi ne sistemin TIMS rezulton se shtetasi që është përpunuar para *Demajlit* është shtetasi shqiptar *Hamdi Mal Shahu* i datëlindjes 28.05.2001 i cili në datë 15.02.2022 ka udhëtuar i vetëm me automjetin auto veture me targa, "AA193DZ", nga ku rezulton se është edhe personi që ka dhënë shumën 5 mijë lekë.

318. **Në orën 15:13 min po të datës 15.02.2022** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Arben Kastrati** i cili është duke përpunuar në dalje dokumentet e shtetasve kosovarë, të cilëve ju kërkon vaksinat dhe kartonin jeshil por nuk që ndonjëri prej tyre ti paraqesë këto vërtetime. Gjatë përpunimit te dokumenteve pjesë-pjesë dallohet që në një rast se nga brenda një dokumenti Arben Kastrati merr një kartëmonedhe euro të mbledhur ngjyrë të kuqërremte (*nuk mund të përcaktohet prerja*) dhe në një rast tjetër mban në dorë, ku duket njëra pjesë një prerje kartëmonedhe euro ngjyrë blu si ajo e prerjes 20-tëshe. Pavarësisht se dokumentet e vaksinimit i kërkon verbalisht nuk konstatohet kontroll i tyre po ashtu edhe e kartonit jeshil për automjetin.

Nga verifikimi në sistemin TIMS hyrje shtetas të huaj, në këtë orar rezulton se nga punonjësi i policisë **Arben Kastrati** ka përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë *Zoje Alimetaj* e datëlindjes 11.01.1999, *Granit Maliqi* i datëlindjes 26.06.1998, *Dion Kaçiu* i datëlindjes 08.05.2000 dhe *Elvis Maliqi* i datëlindjes 23.12.199, të cilët udhëtonin së bashku me automjetin auto veture me targa, "NR316KG", dhe sipas shënimit në sistemin TIMS, drejtues mjeti ka qenë shtetasi Granit Maliqi. Dëgjohet kjo bisedë e zhvilluar midis tyre:

***ShtetasiKs**: Si kalut bre?*

***Arben Kastrati**: Mirë si kalut ju? Si e ke emrin ti?*

***Shtetasi:** Granit*

Arben Kastrati** :Dioni, ku është Dioni?* ***Dion letërnjoftimin ejjjj

Graniti**: **E ka harruar

Arben Kastrati**: **Shko mere e hajde. Pasaportën a e ke?

Graniti**: **Nuk i ka ba vaksinat

***Arben Kastrati**: E vaksinat s'boni..Duhet letërnjoftim ose pasaportë.....Ah. Ku keni me shku?*

***Graniti**: Në Tiranë*

***Arben Kastrati**: Pse?*

***Graniti**:Për qef*

***Arben Kastrati**:Ashtu ëëë. Hahaha...Letërnjoftimet ti shohim pak....Te kuja e ke kerrin ooo*
***Graniti**: Asht i babës*
***Arben Kastrati**: A ke marrë ndonjë autorizim a kurrgja*
***Graniti**: Po i babës nuk ka nevojë.*
***Arben Kastrati**: mirëëë ja që ka nevojë...*
***Graniti**: A thua aaa?..*
***Arben Kastrati**:A io batë gati vaksinat mor?.....I botë mor gati?*
***Graniti**: Çfarë?*
***Arben Kastrati**: Vaksinat?*
***Graniti**: Po*
***Arben Kastrati**: Po*
Ndërkohë merr në dorë një letër të mbyllur brenda së cilës ka euro.
***Arben Kastrati:** Kartoni i gjelbër a e ke? A e ke kartonin e gjelbër oooo?*
***Graniti**: Nuk dëgjohet përgjigja*
***Arben Kastrati**: Hajt kalofshi mirë.*
Sipas veprimeve të fiksuara në pamjet video dhe bisedës audio të transkriptuar si më sipër, rezulton arsyeja e marrjes së parave nga punonjësi i policisë **Arben Kastrati** është mungesa e vaksinave dhe testeve kundër Covid-19 nga shtetasit dhe mos regjistrimi i udhëtimit për në Shqipëri të shtetasit me emrin *Dion*, i cili ka harruar letërnjoftimin ashtu siç dëgjohet edhe nga biseda e zhvilluar midis punonjësit të policisë Arben Kastrati dhe shtetasve në sportel.

DATA 16.02.2022

319. **Në orën 08:02 min të datës 16.02.2022** është duke përpunuar pasagjerë në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7, punonjësja e policisë **Xhuliana Maksutaj** dhe së bashku me të në kabinë i ulur është punonjësi i policisë **Urim Lami**. Ndërkohë, që është duke përpunuar pasagjerë, nga dera kryesore e kabinës vjen një shtetas i cili komunikon me ta dhe ju lutet që mos ta vonojnë pasi katër pasaporta të mbledhura grumbull është duke i mbajtur Xhuliana mbi tavolinë në krahun e djathtë të saj ndërkohë që vijon të përpunojë pasagjerë të tjerë. Urim Lami pyet Xhulianën duke iu drejtuar me fjalët "*qysh do ja bëjmë*" ndërsa ajo i thotë shtetasit "*prit se kam punë*". Ndërkohë shtetasi i jep nje 50- euro Urim Lamit në dorë dhe ky i fundit i jep dokumentet.
Biseda që zhvillohet midis Xhulianës dhe shtetasit në kabinë është si vijon:
***Shtetasi**: Të lutem mos na vono ma*
***Urim Lami:** O Xhul ça me bo?*
***Xhuliana Maksutaj**: Ca me bo ...(fjalë që nuk kuptohen)*
Urim Lami merr dokumentet dhe ja jep shtetasit, pasi merr eurot.
320. Në vijim, pasi largohet shtetasi Urim Lami i drejtohet koleges me fjalët *"O Xhul merri keto"*, duke i dhënë 50-eurot.**Në orën 08:05 min Xhuliana Maksutaj** zëvendësohet në kabinë nga **Urim Lami** dhe ulet në vendin që ishte ulur Urimi, hap çantën e saj ngjyre jeshile të errët dhe fillon të rregullojë eurot që ka në çante të cilat i ka future në mënyrë të çrregullt.

Nga veprimet e fiksuara në pamjet video dhe bisedat e transkriptuara, rezulton se marrja e shumës 50 euro nga shtetasit në sportel nga punonjësja e policisë Xhuljana Maksutaj bëhet në prezencë dhe me ndërmjetësimin e kolegut të saj Urim Lami. Kjo pasi rezulton nga pamjet filmike dhe biseda se Xhuliana ka vendosur dokumentet që i përkasin këtij shtetasi në cep të tavolinës, duke i krijuar vonesa dhe siç rezulton, lejohet të udhëtojnë vetëm pasi japin shumën përkatëse të eurove. Nuk është bërë e mundur të identifikohet se cili ka qënë shtetasi që ka dhënë paratë dhe ka qenë në sportel në këtë hark kohor pasi nuk është konstatuar në pamje filmike koha e përpunimit të këtyre dokumenteve në sistemin TIMS.

321. **Në orën 09:11 po të datës 16.02.2022**, në kabinën në hyrje të R.Sh-së ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Fatmir Braha.** Sipas pamjeve video dhe audio të transkriptuara në procesverbal, Fatri Braha fillimisht dëgjohet që të pyesë njërin prej shtetasve në sportel sesa vetë janë dhe ai i përgjigjet katër. Nga verifikimi i mëtejshëm në sistem rezulton që të ketë përpunuar katër dokumente Karta Identiteti kosovare. Punonjësi i policisë Fatri Braha i pyet nëse kanë kryer testet kundër Covid dhe ata i përgjigjen se kanë bërë vetëm një doze. Fatri Baha vijon bisedën me shtetasit në sportel dhe në një moment ju jep një nga dokumentet e mjetit mbrapsht ku në mesin e kësaj flete shtetasi kosovar ka vendosur një kartëmonedhë të cilin punonjësi i policisë e ka hedhur para pajisjes skaner. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj në datë 16.02.2022 ora 09:12 deri në orën 09:13 min, rezulton se janë përpunuar nga punonjësi i policisë Fatri Braha dokumentet e shtetasve kosovar *Fatmir Lushtaku* i datëlindjes 27.08.1992, drejtues i automjetit tip auto veture me targa, "02354FB", *Naser Lushtaku* i datëlindjes 25.06.1967, *Ejup Gashi* i datëlindjes 14.12.1970 dhe shtetasi *Fidan Lushtaku* i datëlindjes 06.05.1989, të cilët udhëtojnë në po të njëjtin automjet.

322. **Në orën 10:06 min, po të datës 16.02.2022** punonjësi i policisë **Fatri Braha** i cili vijon të kryejë shërbim në kabinën nr .4 hyrje R.SH, ka marrë për verifikim dokumentet e dy shtetasve kosovarë e konkretisht: *Valdrin Mehmeti* i datëlindjes 03.07.1992 dhe *Gramos Gagica* i datëlindjes 18.12.1997, të cilët udhëtonin me automjetin auto veture me targa"06964FE", me drejtues shtetasin *Valdrin Mehmeti*. Në një moment dëgjohet që Fatriu t'ju thotë hapni krahun dhe konstatohet që pak sekonda më vonë se njëri prej tyre hyn nga dera e kabinës dhe i jep një 10 euro Fatriut. Në vijim shtetasi merr dokumentet dhe largohet. Gjatë intervistimit dëgjohet të kryejnë këtë bisedë:

Fatri Braha**: **Duhen dy vaksina edhe një kafe

***Shtetasi kosovar**:Aaa*

***Fatri Braha**: Duhet një test një vaksinë, ose me dy vaksina*

***ShtetasiKs:** Nuk kuptohen fjalët*

***Fatri Braha**: Ku keni me shku ju?*

***Shtetasi KS**:....nuk kuptohen fjalët*

***Fatri Braha**: Hape pak krahun para ti djathtas edhe hajde këtu*

Nga dinamika e veprimeve sipas pamjeve filmike dhe biseda e zhvilluar kuptohet se kërkesa e rryshfetit nga punonjësi i policisë **Fatri Braha** kundrejt shtetasit në sportel duke u shprehur me fjalët ***"një kafe",*** lidhet me mungesën e dokumenteve të kërkuara të vaksinimit.

323. **Në orën 16:26 min po të datës 16.02.2022** punonjësi i policisë **Fatri Braha** është duke përpunuar dokumentin e shtetasit kosovar *Festim Hoxha* i datëlindjes 10.05.1995, i cili udhëton me auto veturën me targa, "04112IS". Nga pamjet filmike rezulton se në mungesë të testi Covid ai i jep punonjësit të policisë Fatri Braha 50 euro të cilat punonjësi i policisë, i fut poshtë tastierës e pastaj menjëherë sa largohet shtetasi me emrin *Festi,* i merr. Nuk konstatohet të kryhet ndonjë bisedë e detajuar midis tyre përveç pyetjes që i behet nga punonjësi i policisë Fatri Braha nëse i disponon dokumentet e vaksinimit, e më tej pasuar nga dhënia dhe marrja e shumës prej 50 euro sipas pamjeve filmike, të dokumentuara edhe në procesverbalin përkatës.

324. **Në orën 16:33 min të datës 16.02.2022**, paraqesin dokumentet dy shtetas të tjerë. Ne përpunim e sipër të dokumenteve, njëri prej shtetasve i jep **Fatri Brahës** edhe dokumentin "*Certifikatë mjeti*" me të cilin udhëtojnë. Për këtë dokument Fatriu kryen kërkime në sistemin TIMS dhe ju thotë se nuk ka asnjë hyrje dalje në Shqipëri, madje në një rast gjatë bisedës i pyet se mos është person në kërkim. Kur përfundon kërkimin për personin që nuk është i regjistruar dhe me dy shtetasit që ka në përpunim ata japin para, por për shkak të pasjes së pamjes së kufizuar nuk dallohet shuma dhe prerja e kartëmonedhës. Gjatë marrjes së parave Fatriu dëgjohet që t'ju thotë, "***Kaq, kaq mjafton***". Shtetasit e përpunuar në këtë orar nga punonjësi Fatri Braha janë *Fëmija Imeri* i dtl. 17.08.1984, drejtuesi i automjetit me targa, "VD158027/PG859AB", si dhe shtetasi kosovar *Enver Hajrizaj* i dtl 03.11.1975. Sipas pamjeve filmike dhe bisedës, rezulton se dhënia e ryshfetit kundrejt punonjësit të policisë konsiston në problematikën që kanë shtetasit me hyrje-daljen në R.Sh në lidhje me automjetin që udhëtojnë si dhe në mos kryerjen e testeve kundër Covid nga ana e tyre.

325. **Në orën 10:20, po të datës 16.02.2022**, punonjësi i policisë **Fatri Braha** është duke përpunuar në hyrje të R.Sh-së dy dokumente, Karta Identiteti shqiptare dhe nga verifikimi në sistemin Tims rubrika hyrje shtetas shqiptarë, në orën 10:20 janë kryer regjistrime nga **Fatri Braha** për shtetasit *Klajdi Flamur Seta* i dtl 29.04.1991, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "*AA099RR*" dhe shtetasja *Enisa Hekuran Zeneli* e dtl 02.05.1996. Në vijim, po në të njëjtën minutë, përpunon edhe një kartë identiteti tjetër shqiptare dhe e pyet shtetasin se i kujt është furgoni. Nga verifikimi në sistemin TIM, në këtë orar nga punonjësi i policisë Fatri Braha nuk gjendet i regjistruar furgon e as pasagjer që të ketë udhëtuar me furgon pasi rezultojnë të regjistruara vetëm dokumentet e dy shtetasve të përmendur më sipër. Në bisedën e zhvilluar mes tyre, para se te fillonte këtë regjistrim dëgjohet një zë në sfond që i thotë se *është porosi e Halimit*. Nga verifikimi i mëtejshëm, në orën 10:52 min rezulton ne sistemin TIMS regjistrimi një automjeti tip furgon më targa Kosovare "02136FH", në përdorim nga shtetasi *Gezim Taci* i dtl 07.11.1983, banues në Rubik, për të cilin janë kryer veprimet e regjistrimit në sistem nga punonjësi i policisë Fatri Braha. Në rastin konkret konstatohet se shtetasi edhe pse nuk ka disponuar një autorizim i cili është kërkuar gjatë bisedës nga punonjësi i policisë, është lejuar në vijim të udhëtojë.

326. **Në orën 10:27, po të datës 16.02.2022,** punonjësi i policisë **Fatri Braha** i cili vijon në shërbim është, duke shkundur para pajisjes skaner një fletë të bardhë ku nga biseda me një shtetas gjatë përpunimit të dokumenteve, rezulton se njërit prej tyre i mungonte testi kundër

Covid. Në një moment dëgjohet t'i thotë "*te tjerët le te vazhdojnë ti rri me mu*". Veprimi i shkundjes së fletës së bardhe ndodh pasi shtetasit pyeten nëse disponojnë dokumentet e vaksinimit. Menjëherë në vijim, pasi vendos kartëmonedhën para pajisjes skaner i lejon shtetasit të udhëtojë. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj, në këtë itinerar kohor, ora 10:25 deri në orën 10:27, ka përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë *Shpreson Hoti* i dtl 27.01.1996, drejtues i automjetit me targa"07754CP" ku udhëtonin edhe shtetasit e tjerë *Besjan Bylykbashi* i dtl 10.08.1992, *Vedat Mazreku* i dtl 11.01.1994 dhe *Agim Mazreku* i dtl 03.10.1980.

327. **Në orën 10:45 po të datës 16.02.2022**, punonjësi i policisë **Fatri Braha** është duke përpunuar dokumentet e dy shtetasve kosovarë. Ju kërkon vaksinat dhe me sa kuptohet shtetasit kosovare nuk i disponojnë të dyja dozat. Fatri Braha ju sqaron se duhet një dozë vaksinë dhe një test, madje në një moment përmend emrin e njërit prej personave që është duke i verifikuar dokumentin të cilin e thërret me emrin *"Armend"*. Vijon bisedën me ta dhe shtetasit i vendosin brenda një dokumenti pasaportë një kartëmonedhë 10-euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj në R.SH datë 16.02.2022 ora 10:44 deri në orën 10:46 që ka kryer bisedë me ta rezulton se punonjësi i policisë Fatri Braha ka përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë *Armend Ali* i dtl 17.04.1988, *Armend Haziri* i dtl 26.03.1989 i cili është dhe drejtues mjeti dhe *Jehon Ramadani*, të cilët udhëtonin me automjetin auto veturë me targa "01800JH".

328. Menjëherë në përfundim të këtij veprimi, **ora 10:45 min po e datës 16.02.2022**, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ku është duke vijuar shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Braha** paraqiten shtetas të tjerë të cilët nuk disponojnë testet kundër Covidit. Po ashtu punonjësi i policisë Fatri Braha përdor të njëjtën forme komunikimi dhe konstatohet se i mban dokumentet duke i vendosur në krahun e djathtë, mbi tavolinë dhe i kërkon shtetasit kosovar që është duke komunikuar të hapë krahun dhe të vijë nga brenda kabinës. Më pas dallohet që shtetasi hyn i jep 5 euro dhe Fatriu i jep dokumentet. Në orën 10:49 min konstatohet të ketë përpunuar njërin prej këtyre dokumenteve, në 10:50 dokumentin e dytë e po ashtu dokumentin e tretë. Biseda që që zhvillohet midis tij dhe shtetasve në sportel është si vijon:

***Fatri Braha**:Qysh me e ba pa vaksina pa gja?*

***Shtetasi KS:** Nuk kuptohen fjalet*

Fatri Braha**: **Ku keni me shku ju?...pa vaksina asht gjynah.....një dokument Amiri.

***Amir Rama: ...qysh me bo pa vaksina poi ken me bo test**.....nuk kalon.....hape krahun pak para edhe hajde këtu mbrapa.....shko i her hajde i her, hajde mbrapa.....*

Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se **Fatri Braha** ka përpunuar dokumentet e shtetasve *Gramoz Kosumi* i dtl 15.06.1999, drejtues i automjetit auto veturë me targa "01368PO", shtetasit *Amir Rama* i dtl 03.11.199 si dhe shtetasit *Irfan Llugaliu* i dtl 06.04.2001 të cilët udhëtojnë me po të njëjtin automjet.

329. **Në orën 10:57 po të datës 16.02.2022 min Fatri Braha** është duke kryer veprime në sistemin TIMS me Karta Identiteti të shtetasve kosovarë *Ymer Kushaj* i dtl 21.05.1987, *Criton Balaj* i dtl 31.03.1981, *Avni Gashi* i dtl 15.10.1981, *Hatip Maliqi* i dtl 27.09.1975 si dhe shtetasin

Femi Gashi i dtl 30.10.1977 i cili është edhe drejtues i automjetit me targa "04256GA". Në përfundim të veprime konstatohet se njëri nga shtetasit që udhëtonin i jep një kartëmonedhë ne dukje e ngjashme me 5 euro. Edhe me këta shtetas ka kryer një interviste rutinë duke i pyetur nëse disponojnë testet e Covidit, bisedë gjatë së cilës merr edhe shumën 5 euro.

- Në orën 11:00 dhe orën 11:01 min po të datës 16.02.2022 **Fatri Braha** është duke përpunuar dokumentet e dy shtetasve kosovarë, një kartë identiteti dhe një pasaportë, midis të tjerash ka dhe një mbajtëse ngjyre blu ku zakonisht mbahen dokumentet e automjeteve. Shtetasit e përpunuar në këtë orar janë *Florim Krasniqi* i dtl 08.04.1968 dhe *Gazmend Aliu* i dtl 05.08.1981 të cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa "02984EE" me drejtues Florin Krasniqin. Në orën 11:01 Fatri Braha hap mbajtësen ngjyre blu të dokumenteve te mjetit dhe prej andej merr 10 euro te cilat i hedh para pajisjes skaner.

330. **Në orën 11:25 min të datës 16.02.2022**, në sportel paraqitet një shtetas Shqiptar ku **Fatri Braha** ku nga biseda kuptohet se është nga qyteti i Tropojës, kjo e kuptuar pas pyetjes së drejtuar nga punonjësi i policisë. Fatriu pasi merr dokumentin, e shikon pak por nuk kryen asnjë regjistrim apo verifikim në sistem. **Në orën 11:43 mi, po të datës 16.02.2022** në sportel paraqet dokumentet një tjetër shtetas kosovar të cilin, punonjësi i policisë i cili vijon shërbimin në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh kontrollori Fatri Braha e thërret me emrin *Alban* dhe nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton të jetë shtetasi kosovar *Alban Berisha i* dtl 25.01.1992, drejtues i automjetit tip auto veturë me targa, *"07343EF"*. Me punonjësin e policisë **Fatmir Braha** është duke kryer këtë bisedë gjatë përpunimit të dokumentit të tij ku dallohet ti japë edhe shumën e parave.

***Fatri Braha**: O Alban?*
***Albani**: Urno*
***Fatri Braha**: Ku ke me shku?.*
***Albani**: nuk kuptohet*
Fatri Braha**: **A ke gjo në makinë me ta bo nji kontroll?
***Albani**: Nuk kam gjë*
***Fatri Braha**: A ke kohe me prit pak ....me shku në makine me prit pak.....aaaa? A jeni bashkë aaa?.*
***Albani**:.....fjale qe nuk kuptohen*
***Fatri Braha**: Ah ca mafiozinja kontroll te makinës atje në skaner e më prit eee*
***Albani**.....(fjale që nuk kuptohen)*
Fatri Braha**:...**me hy atje në skaner, po kam frike se ka shumë rradhë a kupton.

Sipas pamjeve filmike rezulton se Fatriu vijon bisedën dhe ndërkohë i jep një dokument, fletë e bardhë, në të cilin shtetasi kosovar vendos para. Fatri Braha pasi merr shumën e lejon te udhëtojë.

***Fatri Braha**: Keni ardh tek pullëtë dyee?*
***Albani**: Urdhëro*
***Fatri Braha**: **Keni ardh tek pulle të dy**... edhe nja e atij ee...dy me dhe ee?*

Nga verifikimi në sistemin TIMS, përveç shtetasit Alban Berisha nuk konstatohet të jetë kryer

regjistrim i ndonjë shtetasi tjetër si pasagjer në të njëjtin automjet nga punonjësi i policisë Fatri Braha por ndërkohë nga biseda rezulton se personat që udhëtojnë së bashku në këtë moment janë dy. Po ashtu për shkak se dokumenti brenda të cilit gjendet shuma e parave mbyllet menjëherë nga punonjësi i policisë dhe në mënyrë të shpejtë hidhet para pajisjes skanuese, nuk është bërë e mundur të dallohet prerja e kartëmonedhës së marrë.

331. **Në orën 12:23 deri në orën 12:24 po të datës 16.02.2022**punonjësi në shërbim **Fatri Braha** ka përpunuar dokumentet e tre shtetasve maqedonas të cilët udhëtonin me të njëjtin automjet. Përveç kërkesës për teste Covidi, Fatriu dëgjohet t'i thotë edhe njërit prej tyre që je pa test e ndër të tjera i thotë, " ***ti je pa test".....me bjer një 20-teshe mu hajt",*** por nuk mund të kuptohet se cili nga tre shtetasit ka dhënë shumën e kërkuar. Shtetasit që janë përpunuar në këtë itinerar kohor janë *Burim Temaj* i dtl 27.07.1981, *Tahir Temaj* i dtl 11.04.1975 drejtues mjeti dhe shtetasi dhe *Shkëlqim Kajdomqaj* i dtl 18.03.1981, të cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa "PLAE296". Nuk është bërë e mundur të dokumentohet momenti i marrjes së shumë së kërkuar (referuar nga kontrollori me fjalët "*një njëzetëshe*", për pas këtij momenti shtetasit maqedonas janë lejuar të vijojnë udhëtimin.

332. **Po në datën 16.02.2022 ora 12:26 Fatri Braha** konstatohet të marrë për verifikim nga sporteli i udhëtarëve dokumentet e një shtetasi. Bashkë me dokumentet është edhe një dosje ngjyrë blu. Dëgjohet qe shtetasit kosovar të cilin në një moment e thërret me emrin *Ardian* ti kërkojë edhe testin kundër Covid-19, por që ky i fundit rezulton që mos ta disponojë. Punonjësi i policisë Fatri Braha i mban dokumentet derisa shtetasi kosovar i jep para dhe më pas punonjësi i policisë e lejon që të vazhdojë udhëtimin. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj në Republikën e Shqipërisë rezulton se në orën 12:25 dhe deri në orën 12:26 min punonjësi i policisë Fatri Braha të ketë kryer përpunimin e dokumenteve të shtetasve kosovarë *Ardian Ismaili* i dtl 14.02.1992, drejtues i automjetit auto veturë me targa,"01369LL" dhe së bashku me të udhëton edhe shtetasi *Amir Kadriu* i dtl 16.04.1997.

333. **Në orën 12:29 min, po të datës 16.02.2022, Fatri Braha** është duke përpunuar dokumentet e dy shtetasve shqiptarë pasi nga pamjet filmike dokumentet dallohen të jenë pasaporta shqiptare. Shtetasit shqiptarë që janë përpunuar në këtë minutë janë: *Bajram Ali Ismailaja* i dtl 08.12.1958 drejtues i automjetit auto veturë me targa, "AE634T" si dhe pasagjere shtetasja *Sonila Selman Karameto* e dtl 22.05.1982. Nuk konstatohet ndonjë bisedë midis tyre pasi shuma e parave konstatohet të jetë vendosur brenda dokumenteve dhe është parë nga punonjësi i policisë gjatë përpunimit të tyre. Për shkak se vlera monetare është e palosur, nuk është bërë e mundur të verifikohet prerja e kartëmonedhës sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes që ka fiksuar këtë veprim.

334. **Në orën 12:37 min, të datës 16.02.2022** punonjësi i policisë **Fatri Braha** është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi kosovar të cilin e thërret në emër dhe pasi i shikon dokumentin e identifikimit shprehet "*Shyqyr*" dhe i pyet nëse i kanë vaksinat. Këta shtetas shihet se i japin Fatriut një shumë e cila duhet si kartëmonedhë prerje 5 euro. Nga verifikimi në sistemin Tims të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj, në këtë kohë janë përpunuar dokumentet e shtetasit *Shyqyri Hasani* i dtl. 01.01.1980, i cili udhëton me automjetin auto veturë

me targa"02155FB". Nga biseda që kryejnë midis tyre rezulton se Fatriu i pyet ne numrin shumës "***A i keni ba vaksinat***" duke ju drejtuar dy ose më shumë personave, por nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton të jetë përpunuar dokumenti i vetëm një shtetasi.

335. **Në orën 12:43 të datës 16.02.2022** konstatohet që ne sportel të paraqiten shtetas të tjerë dhe Fatri Braha vetëm i pyet nëse kanë kryer ndonjë vaksine apo jo, merr dokumentet e tyre dhe pasi i hap, nuk kryen regjistrime e verifikime dokumentesh në sistemin TIMS por i lejon të udhëtojnë, edhe pse nuk konstatohet fluks pasagjeresh në sportel.

336. **Në orën 15:59 min të datës 16.02.2022**, në sportel paraqiten dy shtetas kosovarë dhe nga biseda kuptohet se janë edhe me fëmijët e tyre të mitur. Njëri prej tyre thërritet nga punonjësi i policisë **Fatri Braha** me emrin *Avdi*. Në vijim të bisedës ai ju kërkon test anti covid edhe për fëmijët e mitur që janë së bashku me ta. Në mungesë të testeve, shihet nga pamjet filmike se brenda lejes se qarkullimit të mjetit, shtetasi rezulton të ketë futur 5-euro, të cilat Fatriu e hedh para pajisjes skaner dhe menjëherë sa ata largohen e merr. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton të jetë kryer regjistrimi i vetëm dy shtetasve të rritur kosovare e jo fëmijëve të tyre e konkretisht *Avdi Syla* i dtl 23.04.1984 drejtues mjeti dhe shtetasja *Magbule Syla* e dtl 11.08.1986, te cilët udhëtonin me automjetin me targa "01866PP".

337. **Në orën 13:25min të datës 16.02.2022**, në sportel paraqitet një familje kosovare e cila jep dokumentet e Identifikimit, karta identiteti për verifikim. Në bisedë e sipër me ta dëgjohet që Fatri Braha t'i thotë njërit prej tyre se dokumenti i identifikimit ka dy vjet që i ka skaduar. Pastaj ju thotë që të hapin krahun e të vijë njëri tek kabina, por pas ndërhyrjes se një shtetasi të cilit i dëgjohet vetëm zëri, jua kthen dokumentet pas disa minutash. Edhe në rastin konkret nuk janë kryer regjistrime në sistemin TIMS për këta dy shtetas nga ky punonjës policie.

338. **Në orën 13:31 min, të datës 16.02.2022, Fatri Braha** i cili vijon shërbimin në kabinën nr .4 hyrje R.Sh është duke përpunuar dokumentet e shtetasit *Beqir Mazreku* i dtl 12.01.1987 drejtues i kamionit me targa"013140B01340TA". Gjatë përpunimit të këtyre dokumenteve të cilat kryhen pa zhvilluar intervistim me shoferin e automjetit, konstatohet që në mesin e dokumenteve të jetë future një kartëmonedhë 5-euro e cila vendoset para pajisjes skanuese nga punonjësi i policisë Fatri Braha.

339. **Në orën 13:42 min të datës 16.02. 2022** në sportelin e kabinës nr 4 hyrje R.SH, paraqitet një shtetas tjetër kosovar i cili rezulton të jetë edhe me një vajzë në automjet. **Fatri Braha** i kërkon menjëherë vaksinat ose testin kundër Covid-19. Shtetasit nuk e disponojnë testin për këtë arsye **Fatri Braha** i kërkon drejtuesit të automjetit që të hapë krahun dhe të vijë të paraqitet në kabinë duke i mbajtur njëkohësisht dokumentet e duke i kaluar në krahun tjetër të tavolinës së punës. Ndërkohë që shtetasi është duke hapur krahun me automjet, në kabine vjen dhe ulet një koleg tjetër i Fatriu i cili e zëvendëson, identifikuar **si Dashnor Braha,** ndërsa Fatri Braha vijon duke qëndruar në këmbë brenda në kabinë. Në momentin që vjen, shtetasi i jep 5 euro dhe atëherë Fatri Braha ja jep dokumentet duke i mundësuar për të vijuar udhëtimin ne Shqipëri. Në prezencë të kolegut të vet, punonjësit të policisë Dashnor Braha, Fatri Braha kryen veprimin e marrjes së 5 eurove nga shtetasi të cilit i ka mbajtur dokumentet i cili hyn nga dera

kryesore e kabinës ku dallohet se i jep këtë shumë. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit, rezulton se shtetasit që janë përpunuar në këtë orë janë *Liridon Llugaliu* i dtl 02.08.1998, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "01305NB" dhe shtetasja *Shkurtesa Llugaliu* e dtl 22.05.2000 ndërsa fëmija i vogël për të cilin flitej gjatë bisedës nuk është regjistruar në sistemin TIMS. Personi që ka dhënë shumën 5 euro rezulton të jetë shtetasi Liridon Llugaliu pasi bashkëbiseduesi i Fatriut ishte burrë dhe jo grua që korrespondon me pasagjerin në të njëjtin automjet. Nga biseda e kryer dhe veprimet e konstatuara nga pamjet filmike rezulton se marrja e shumës 5 euro nga punonjësi i policisë Fatri Braha është kundrejt mungesës së testeve kundër Covid nga shtetasit dhe mungesa e dozës së dytë të vaksinës.

340. Në vijim për disa momente punonjësi i policisë Fatri Braha zëvendësohet në kabinë nga kolegu tij **Dashnor Braha.** Nga pamjet filmike është fiksuar se në oren 13:54 min, pasi bisedon me një shtetas në sportel, e pyet se ku do të shkojë jashtë shtetit dhe pa i verifikuar dokumentet dhe pa kryer regjistrime ne sistemin TIMS e lejon të vijojë, po ashtu ndodh edhe me pasagjerët pas tij në orën 13:55 min të cilëve pasi ju merr dokumentet në dorë i pyet se për ku udhëtojnë.

341. **Në orën 14:45 min, po të datës 16.02.2022** konstatohet punonjësi i policisë **Fatri Braha** i cili është duke vijuar shërbimin në kabinën nr.4 hyrje të R.Sh-së. Në orën 14:44 rezulton se ka përpunuar dokumentin e një shtetasi me të cilin , nga biseda e zhvilluar, rezulton se i kishte përfunduar afati i siguracionit të mjetit. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se, nga punonjësi i policisë Fatri Braha në orën 14:44 min është përpunuar dokumenti i shtetasit *Kazim Limanovski*, i pajisur me pasaporte italiane, i dtl 14.05.1977, drejtues i automjetit me targa "CX002NK".

342. **Në orën 16:13 min, po të datës 16.02.2022**, punonjësi i policisë **Fatri Braha** merr në sportel dokumentet e tre shtetasve kosovarë për verifikim. Konstatohet se kalon në skaner vetëm njërin dokument dhe dy të tjerë nuk i regjistron dhe ndërkohë, gjatë kësaj kohe dëgjohet t'ju thotë se *për fëmijën mbi gjashtë vjeç duhet testi i Covid-it, pasi kështu kanë urdhrin e marrë nga eprorët*. Në vijim konstatohet se shtetasi kosovar i fut brenda pasaportës një kartëmonedhë prerje 20 euro. Referuar dinamikës së veprimeve dhe komunikimit mes tyre, duket se arsyeja e marrjes së kësaj shume nga punonjësi i policisë Fatri Braha është mungesa e testeve kundër Covid për fëmijën që është bashkë me ta duke udhëtuar. Sipas verifikimit të kryer, nga ora 16:13 min deri në orën 16:15 min, rezulton se në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, punonjësi i policisë Fatri Braha ka regjistruar vetëm dokumentin e një shtetasi kosovar e konkretisht atë të shtetasit *Bajram Sinani* i dtl. 10.12.1972 i cili drejtonte automjetin auto veturë me targa "01999OE", ndërsa dy shtetasit e tjerë që kanë qenë së bashku me të nuk janë regjistruar në sistemin TIMS.

343. **Në orën 16:45, po të datës 16.02.2022**, punonjësi **Fatri Braha** konstatohet të ketë marrë nga një tjetër shtetas një shumë 5 euro, të cilat i ka futur brenda një letre të bardhë, të cilën punonjësi i policisë e hedh para pajisjes skaner por nuk konstatohet të jetë kryer veprime regjistruese ose verifikuese në sistemin TIMS nga ku mund të bëhej edhe identifikimi i shtetasit.

344. **Në datë 16.02.2022 ora 20:07 min** në kabinën nr.4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7 është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** dhe pikërisht në këtë

orar merr një grumbull dokumentesh për verifikim. I pyet shtetasit e paraqitur në sportel nëse kanë ndonjë vaksinë kundër covid dhe më tej shton se duhet bërë një test. Konstatohet se është duke përpunuar pesë dokumente të shtetasve kosovarë. Gjate kërkesës dhe intervistimit për dokumentet e vaksinimit konstatohet që shtetasi me të cilin komunikon t'i japë një kartëmonedhë të ngjashme me atë 5 euro, të cilën punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** e vendos në krah të pajisjes skanuese. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj në R.Sh rezulton se në orën për të cilën zhvillohet biseda 20:08, janë përpunuar dokumentet e shtetasve *Daver Pompaku* i dtl. 03.08.1974, drejtues automjeti dhe shtetaseve *Rezarta Pompaku* e dtl 29.01.1977, *Rea Pompaku* e dtl 22.10.2009, *Rinesa Pimapku* e dtl 04.03.2005 dhe *Rigona Pomapku* e dtl 02.2.20006 të cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa, "04748HR".

345. **Në vijim po në datë 16.02.2022**, në kabinën nr.4 hyrje R.SH punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** është duke marrë në sportel dy dokumenti të tjera për verifikim. Në orën 20:09 min dëgjohet të zhvillojë bisedë me shtetasin që i ka dorëzuar dy dokumente. Gjatë marrjes se dokumenteve të identitetit mbi tavolinën e tij konstatohet që shtetasi t'i hedhë edhe një kartëmonedhë me prerje 10-euro. Nuk është bërë e mund të identifikohen shtetasit pasi nuk janë kryer veprime për t'i verifikuar dhe regjistruar dokumentet e tyre në sistemin TIMS, e dokumentuar kjo edhe në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike. Menjëherë sa merr shumën, punonjësi i policisë pasi bisedon pak me ta, jua kthen dokumentet mbrapsht pa i hedhur në sistem.

346. **Në orën 20:17 min të po të datës 16.02.2022** në sportel dëgjohet të flasë një shtetas i cili paraqet një dokument mjeti dhe dëgjohet të zhvillojë këtë bisedë me Fatri Iseberin.

Shtetasi**: **O shef a mund ta lë një kafe?.

***Fatri Iseberi**: **Po....dy veta pa test**..... (fjalë që nuk kuptohen ne vijim)*

***Shtetasi**:....**ka 20 euro,** ...shkojm deri atje e vijmë qysh thu ti?*

***Fatri Iseberi**: Ti boll djalë i mirë je .....(fjale qe nuk kuptohen)....**shko merrni makinën erregulloni letrat e hec hajt merri këtu**. Hec vrap*

***Shtetasi** ; Me u rregullu mirë a?*

***Fatri Iseberi**: O babush ...tani hajde këtu hajde këtu, jo me u ngushtu sa të keni mundësi. Dakord, Hajd*

***Shtetasi**: Dakord*

Nga pamjet filmike rezulton se Fatri Iseberi ju mban një dokument në dukje leje qarkullimi dhe pas disa minutash shtetasi i cili komunikonte me të, vjen përsëri dhe i hedh mbi tavolinë disa fletë dokumentesh (formati A-4), midis tyre dy kartëmonedha 20-euro. Nuk konstatohen të jenë kryer veprime në sistemin TIMS, për mjetin apo dokumentet e tyre. Në orën 20:20 min shtetasi vjen dhe i hedh mbi tavolinë dokumentet midis tyre dhe dy prerjet euro.

347. **Në orën 17:53, po të datës 16.02.2022 min** në sportel paraqitet një shtetas tjetër dhe dorëzon dokumentet brenda të cilave konstatohet të ketë futur 10 euro e cila merret nga punonjësi i policisë **Fatri Braha**. Nga pamjet filmike të këqyrura konstatohet se kalohet në pajisjen skaner një kartë identiteti shqiptare si dhe brenda një dokumenti ishte kartëmonedha 10 euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje në R.SH, rezulton se në datë 16.02.2022 ora

17:53:53 është regjistruar dokumenti i shtetasit *Flamur Jonuz Kapaj* i dtl 10.11.1970 i cili udhëton me automjetin tip auto veturë me targa, *"AB360EY"*. Me datë 30.06.2022, është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi ***Flamur Jonuz Kapaj*** i cili, lidhur me këtë ngjarje, ka deklaruar: *"Unë kam një automjet tip Toyta 6-vendëshe me targa "AB360EY", të cilën e kam te licencuar për transport të përgjithshëm mallrash për të cilën paguaj edhe sigurimet dhe detyrimet përkatëse. Meqenëse me këtë automjet unë shkoj edhe jashtë shtetit në Serbi-Hungari-Belgjikë, detyrohem që marr edhe pasagjerë, ku në shumicën e rasteve i kam dërguar jashtë dhe jam kthyer bosh. Kalimin kryesisht e kam kryer nga pika kufitare e Morinës, rrugë të cilën e kryej edhe aktualisht.....për rastin që na ka ndodhur në datë 16.02.2022, po është e vërtetë që edhe kam dhënë edhe ndonjë prerje euro kartëmonedha të vogla 5-sce por meqenëse unë e bej shpesh atë rrugë, dhe për të mos na krijuar vonesa ka raste që i le dhe ndonjë kartëmonedhë të vogël të pinë kafe...*".

348. **Në orën 20:56 min, po të datës 16.02.2022** në sportel paraqiten shtetas me karta identiteti shqiptare të cilat fillojnë të verifikohen mbi pajisjen skanuese në orën 20:56 min. Sipas pamjeve filmike njërin prej shtetasve punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** e thërret gjatë intervistimit me emrin *Sefer*. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas shqiptar në R.Sh për datën 16.02.2022 ora 20:56 deri në orën 20:58 min, nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi janë përpunuar dokumentet e shtetasve *Sefer Faik Kulla* i dtl 18.07.1987, me automjetin tip auto veturë me targa "AB343DX" dhe një shtetas tjetër i cili nuk është regjistruar në sistem.

349. **Në orën 23:20 min po të datës 16.02.2022**, në sportelin e kabinës nr.4 paraqitet një shtetas të cilin punonjësi i policisë me emrin **Fatri Iseberie** pyet se *çfarë ka ngarkuar*. Ai i përgjigjet se ka ngarkuar *kabulla* dhe ndërkohë bashkë me dokumentin pasaportë i jep dhe 50 euro, duke i lënë mbi tavolinë. Biseda është si më poshtë vijon:

Fatri Iseberi: Çabere ti. Ça ke ngarkue?

Shtetasi: Kablla, kablla

Nga verifikimi ne sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas shqiptare për orën 23:21 min nuk ka regjistrim shtetasish shqiptare nga punonjësi i policisë **Fatri Iseberi** por në këtë orë ka udhëtuar me automjetin tip kamion me targa "SK0382AF/SK1527AC", shtetasi maqedonas *Tair Megdi* i dtl 01.04.1966 i cili është edhe shtetasi që ka dhënë shumën 50 euro kundrejt punonjësit të policisë Fatri Iseberi.

350. **Në orën 19:20 të datës 16.02.2022Fatri Braha** konstatohet se kryen shërbimin në po të njëjtën kabinë dhe nga pamjet filmike konstatohet të marrë për përpunim dokumente nga shtetas të huaj ku dëgjohet edhe zëri i një gruaje të cilën e pyet nëse ka bërë test, vaksinë. Në mungesë të testit kundër Covid dhe të vaksinës shtetasja konstatohet t'i vendosë brenda dokumentit pasaportë, i cili i vihet në dispozicion nga punonjësi i policisë, një kartëmonedhë euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj në orën 19:20 deri në 19:21 min, nga punonjësi i policisë **Fatri Braha** janë përpunuar dokumentet e shtetaseve kosovare *Festina Bajcinica* e dtl 14.01.2002 dhe shtetases *Klatrina Berisha* e dtl 31.10.1997 të cilat udhëtonin me automjetin auto veturë me targa "01539S".

351. **Menjëherë më pas ora 19:21 min** paraqesin dokumentet edhe tre shtetas të tjerë në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ku punonjësi i policisë **Fatri Braha** i pyet sesa veta janë dhe ata i përgjigjen tre. Pavarësisht se ka në dorë dokumentet, pasaportat e tre personave), ai kalon në sistem për regjistrim vetëm njërën prej tyre dhe ndërkohe është fiksuar në pamjet filmike se i jepen kartëmonedha euro të cilat i hedh poshtë në drejtim të monitorit të kompjuterit por për shkak se jenë të mbledhura nuk mund të përcaktohet prerja. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se nuk është hedhur në sistem asnjë nga dokumentit e tre shtetasve kosovare, ndërsa menjëherë pas tyre vjen dhe paraqet dokumentin pasaporte *Armir Gashi* i dtl 22.07.1999 i cili udhëtonte se bashku me dy të tjerë me automjetin tip auto veturë me targa "04559GF", person i cili thërritet edhe në emër nga punonjësi i policisë Fatri Braha.

352. **Menjëherë pas këtij shtetasi Fatri Braha** përpunon dy shtetas kosovare te cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa "07726 DT" dhe janë shtetasit kosovare *Shefqet Maloku* dhe *Valerjana Qestaj* të cilëve ju mban një autorizim mjeti dhe vijon bisedën duke i kërkuar të hapin krahun dhe ndërkohe një dokument automjeti jua mban në kabinë duke e kaluar në krahun e djathtë të tavolinës. **Në orën 19:27 min** vijon me tej me pasagjerët e radhës të cilët i pyet sesa vetë janë. Ata i përgjigjen 4 dhe janë shtetas kosovare. Nga verifikimi në sistem rezulton se janë regjistruar vetëm dy shtetas kosovare e konkretisht *Lumni Menxhiqi dhe Arjanit Neziri* të cilët udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa"01629MA". Vijon edhe këtyre shtetasve duke ju kërkuar vaksinat duke ju thëne se *nuk bën vetëm me test* etj. Ndërkohë hyn nga dera e kabinës shtetasi te cilit i ishte mbajtur dokumenti i automjetit me targa "07726DT", pak më parë, le sipër tavolinës diçka dhe tërheq me dorë dokumentin e mjetit të tij, ndërkohë **Fatri Braha** e falënderon.

353. **Në orën 20:45 min datë 16.02.2022** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh që përkon me pamjet filmike të kamerës nr.7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Fatri Isberi** dhe merr në dorë një mbajtëse dokumentesh me kapak ngjyre blu, brenda se cilës ka euro por që nuk mund të përcaktohet prerja e kartëmonedhës. Gjatë komunikimit me shtetasin me mbajtëse dokumentesh ngjyre blu, vijnë katër shtetas të tjerë të cilët, për shkak se nuk kishin patur vaksinat ju kishte mbajtur dokumentet më herët, dhe konkretisht dy pasaporta dhe dy karta identiteti dhe i kishte dërguar të bënin test. E pyet njërin prej tyre *si e pate emrin sepse ta harrova*, por për shkak të audios së dobët përgjigja e tij nuk mund të dëgjohet. Dokumentet e shtetasve i ka hedhur në sistem që në orën 20:39 min kur ju ka kërkuar vaksinat dhe autorizimin e mjetit të cilat ata nuk i disponinin. Rezulton se nuk ju ka dhëne "ok" në opsionin *enter* qe regjistron dokumentin në sistem pasi në orën kur janë vendosur katër dokumente njëri mbas tjetrit në pajisjen skaner, 20:39 deri ne orën 20:40, nga punonjësi **Fatri Iseberi** nuk ka të regjistruar pasagjere të huaj ne sistem. Shuma e vogël prej 10-te eurosh e dhënë nga njëri prej shtetasve ka bërë Fatri Iseberin që të vijojë të mos lejojë shtetasit kosovare të udhëtojnë. Ndërkohë nga pamjet filmike konstatohet se në krahun e majtë të tavolinës së punës mban ende dokumentet e shtetasve të cilëve ju ka kërkuar që të hapin krahun me automjet, dokumente të cilat dorëzohen prej punonjësit të policisë vetëm kur njeri prej tyre hyn brenda kabinës e i jep diçka. Me shtetasin që hyn brenda kabinës dëgjohet ti thotë:"...*Shko tek makina rregulloje dhe eja mos të shofin. Nama*

nji dokument këtu se asht pa regjistru".Nga biseda audio dëgjohet që punonjësi i policisë Fatri Iseberi gjatë kryerjes së veprimeve me shtetasit të komunikojë njëkohësisht edhe me një shtetase në telefon të cilën, pasi largohet shtetasi që kishte hyre brenda në kabinë, i thotë *të marrin letrat e ikin, këta të marrin në qafe"*, ndërkohe që dallohet se i ka mbajtur librezën e mjetit. Në orën 20:50 min afrohet përsëri tek kabina shtetasi të cilit Fatriu i kishte mbajtur dokumentet në kabinë e pasi i jep diçka dhe Fatriu i kthen dokumentet e njëkohësisht duke i thotë se *nëse e pyet njeri të thotë se i kishte pas dokumentet e vaksinimit*, çka nënkupton se janë lejuar të largohen pa i pasur këto dokumente dhe kjo ka qenë arsyeja pse janë vonuar prej tij në përpunim.

354. **Në orën 08:34 min të datës 16.02.2022 min** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh që përkon me pamjet filmike të kamerës nr. 6, është duke punuar punonjësi i policisë **Muhamet Cengu.** Gjatë kësaj kohe janë duke paraqitur dokumentet e identitetit shtetas të cilët punonjësi i policisë i pyet se ku do të shkojnë. Ata i përgjigjen se janë për të shkuar në Tiranë, në aeroport. Punonjësi i policisë i pyet nëse duan të regjistrohen apo jo pasi nga biseda e zhvilluar në numrin shumës, kuptohet që automjeti që ata udhëtojnë është edhe me pasagjerë të tjerë pasi është autobus. Biseda midis shtetasit në sportel dhe punonjësit të policisë është si vijon:

***Muhamet Cengu**: Mirëmëngjesi ka po shkoni?*
***Shtetasi**:Në Tiranë për në aeroport direkt*
Muhamet Cengu**: **Krejt për ne aeroport aaa?....A do me i regjistrue?
***Shtetasi**:Jo...*
***Muhamet Cengu**: ...kush janë këto?*
***Shtetasi**: Janë të Maqedonisë dhe të Kosovës.*
***Muhamet Cengu**: Eeee a po i mbledh ata deri sa të vijë ndonjë makinë.....thu a u duhet si dihet për në aeroport*
***Shtetasi**:...letërnjoftime s'ka...*
Muhamet Cengu**:**A s'ke lek te huj?
***Shtetasi**: Jo jo skam...*

Nga biseda e zhvilluar kuptohet se shtetasi në sportel, drejtuesi i automjetit autobus, duhet ti kete dhënë dicka punonjësit të policisë, por që ja ka dhënë lek shqiptare e për këtë arsye punonjësi i policisë e pyet nëse ka lekë *të huaj*. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj në datë 16.02.2022 ora 08:35 min, rezulton se janë papunuar vetëm dokumentet e shtetasve *Muarem Kamber*, shtetas maqedonas i dtl 16.07.1961, drejtues i automjetit autobus me targa "SK2686AJ", dhe vetëm një shtetas i regjistruar si pasagjer i ketij autobusi i cili është shtetasi *Mustafa Kaljisi* i dtl. 11.11.1985.

355. **Në orën 08:57 min po të datës 16.02.2022,** në kabinën nr.2 hyrje R.SH ku është duke përpunuar udhëtarët punonjësi i policisë **Muhamet Cengu,** paraqitet një shtetas tjetër i cili dëgjohet të zhvillojë bashkëbisedim më punonjësin e policisë duke përmendur në bisedë edhe mungesën e testeve kundër covid. Ndërkohe nga lëvizjet e duarve dhe veprimet e fiksuara në pamjet filmike, kuptohet që pasi ka marrë diçka nga dokumenti e ka futur poshtë tastierës pasi e ngre lart atë, por nuk mund të dallohet se çfarë për shkak të pamjes së kufizuar të kamerës. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas shqiptare dhe të huaj në R.Sh, rezulton se

shtetasit e përpunuar në këtë orë, duke ju referuar edhe emrave të përmendur në bisedë janë: *Lindon Bruti* (IT) i dtl 01.05.1998, drejtues i automjetit tip auto veturë me targa "AB800GC" dhe shtetasi *Gabriele Pasco* (IT) i dtl 03.05.1999, pasagjer në po të njëjtin automjet.
Në vijim dëgjohet të kryejnë këtë bisedë:
Muhamet Cengu: *...edhe 10-te...(pasi çon lart tastierën i thotë)...10-të i ke aty. I ke aty në mes të librezës...(e çon përsëri tastierën dhe pastaj e përshëndet).....Hajt shnet.*
Menjëherë sa largohen këta shtetas dëgjohet të komunikojë me shtetasit në vijim të cilët paraqiten në sportel, por që nuk kryen veprimeve verifikuese as nga dokumentacionit të tyre dhe as ndaj mjeteve që ata disponojnë. Të njëjtin veprim e përsërit edhe me pasagjeret e radhës i lejon të udhëtojnë pa kryer veprime në kompjuter (Sistemin TIMS), ora 09:00:07 min.
356. **Ora 10:51 min po e datës 16.02.2022** në sportel paraqitet një shtetas ku nga biseda kuptohet se ka autobus me pasagjerë. Punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** e pyet nëse do që të regjistrohen apo jo dhe shtetasi i thotë që regjistrojë të gjithë. Muhamet Cengu përsëri i thotë shiko nëse ka ndonjë të huaj apo jo. Pasi merr listën, nuk kryen regjistrime apo verifikime të shtetasve. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në orën 10:51 min ka kryer në sistemin TIMS hyrje në R.Sh vetëm regjistrimin e dokumentit të shtetasit *Gurse Ilmeri (KS)* i dtl 25.01.1975, drejtues i automjetit autobus me targa "04967II" dhe të asnjë pasagjeri të këtij autobusi.
357. **Në orën 12:08 min, datë 16.02.2022** punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** është duke përpunuar dokumentin e shtetasit *Suart Sinan Domi (identifikuar edhe nga fotografia në monitorin e kompjuterit)*dhe pasi regjistron dokumentin dëgjohet ti thotë shtetasit***: Muhamet Cengu: "Hajde njëherë***". Në vijim brenda në kabinë hyn një tjetër punonjës policie i cili po ashtu e thërret shtetasin që është ne sportel të hyje brenda kabinës. Nga pamjet filmike konstatohet se në kabinë hyn një shtetas i cili bisedon me punonjësin e policisë dhe ndër të tjera dëgjohet se ai betohet se nuk ka më tepër para dhe në vijim dalin jashtë bashkë me punonjësin tjetër të policisë.
Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rezulton se këtij shtetasi i është refuzuar një herë dalja nga R.SH, shënim në sistem i cili mund të ketë shërbyer si shkak për pengesën që i shkaktohet atij për të kaluar kufirin. Nga pamjet video dhe regjistrimi audio i transkriptuar, ka rezultuar se punonjësi i policisë i cili e fut shtetasin brenda në kabinë i thotë: "***Hajde hajde këtu ti ca mbarove punë"***, dhe kur hyn shtetasi në kabinë i thotë: "***Bjer 10-mijë lekë këtu***", ndërsa shtetasi i përgjigjet : ***Pasha zotin s'kam, rregullohena me vonë".*** Nga pamjet filmike nuk konstatohet t'i japë para brenda kabinës por e merr shtetasin dhe dalin jashtë serish.
Është thirrur për tu pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi **Suart Sinan Domi** i cili është shtetasi që ka qenë në përpunim dokumentacioni ndërkohe që zhvillohen ngjarjet si më sipër, dhe lidhur me këtë ngjarje, sipas procesverbalit me datë 29.06.2022, ai ka deklaruar se: "*Unë banoj ne fshatin Res të Kukësit dhe banoj së bashku me nënën, vëllain dhe motrat e mia. Unë aktualisht merrem me bagëti, kam rreth pesëmbëdhjetë krerë dele dhe kam katër lopë e katër vica. Kam një mjet tip furgon me targa "Ab732Gb", ngjyrë e bardhë, të cilin e kam blerë nga shtetasi Besnik Domi. Unë kam shkuar dhe kam hyre shpesh ne Kosove pasi marr*

bar dhe hime per bagëtitë. Barin e mbledh nga shtetas te ndryshëm ku gjej ndërsa himen e marr ne Prizren...Rasti konkret nuk me kujtohet por me pare, para se te arrestoheshin punonjësit, mua më kanë kontrolluar dhe më kanë futur edhe ne skaner dhe me kanë kontrolluar...Nuk me kane kërkuar leke ne ndonjë rast dhe nuk me kujtohet si rast."

358. **Në orën 12:27 të datës 16.02.2022** në kabinë ku është ende duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, paraqiten përsëri shtetas të tjerë ku personi me të cilin komunikon punonjësi i policisë i hedh menjëherë mbi tastierë para në duke 5 euro punonjësit të policisë. Në vijim përpunohet ky shtetas i paraqitur në fotografinë në monitorin e kompjuterit. Duke krahasuar orën e pamjeve filmike dhe veprimin e kryer ne monitorin e kompjuterit nga punonjësi i policisë, personi që ka dhëne shumën 5 euro është identifikuar si shtetasi *Fitim Kajtazi* i dtl 12.10.1979 drejtues i automjeti tip kamion me targa "01390MP/01985AX", i cili udhëton i vetëm.

359. **Në orën 13:00 po të datës 16.02.2022**, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6 hyrje R.Sh, vjen një drejtues automjeti autobus. Punonjësi i policisë e pyet sesa persona ke ndërsa ai i përgjigjet *31 ndërsa njërin e kam, për në aeroport.* **Punonjësi i policisë merr vetëm një listë pasagjeresh nuk kryen verifikim ose regjistrim në sistem edhe pse nuk ka fluks pasagjerësh dhe e lejon të vijojë udhëtimin.** I merr për regjistrim vetëm një emër të pasagjerit që është për në aeroport. Tek lista e pasagjerëve dallohet mbishkrimi, "*Arditi-Tours*" dhe veprimet janë kryer nga punonjësi i policisë **Dashnor Braha**. Shtetasi i regjistruar *Visar Breznica* i dtl 01.10.1996 drejtues i autobusit me targa, "AA899RK". Po ashtu, me të njëjtin automjet janë regjistruar edhe dy shtetas të tjerë *Daniel Smolka* i dtl 11.07.1994 dhe shtetasi *Florim Krasniqi* i dtl 08.12.1977, nga 31-pasagjere në autobus.

360. **Në orën 13:22:45 min të datës 16.02.2022**, në sportelin e kabinës ku është duke punuar punonjësi i policisë **Dashnor Braha**, paraqitet një shtetas të cilin punonjësi i policisë e pyet se për ku udhëton. Ai i përgjigjet për në Mal të Zi, ndërkohë që i jep dokumentet, mbi tastiere bie një kartëmonedhë e prerjes 20-euro, të cilën Bedriu e tërheq më pas me dore. Në foton në monitorin e kompjuterit shfaqet fotografia e personit që ka dhënë këtë shumë e cila, e krahasuar me veprimet e kryera në sistemin TIMS nga punonjësi **Dashnor Braha** në të njëjtën orë rezulton se shtetasi të cilit i përpunohet dokumenti ka qenë *Sadi Perashi* i dtl 14.01.1969 i cili udhëton me automjetin tip auto veturë me targa, "01217MD", përpunuar dokumenti nga punonjësi Dashnor Braha.

361. **Në orën 13:38 po të datës 16.02.2022** në sportelin e kabinës ku është duke punuar punonjësi i policisë **Dashnor Braha**, paraqitet një shtetas i huaj i cili menjëherë brenda dokumenteve dallohet të ketë vendosur 200-euro. Nga verifikimi i dokumentacionit të përpunuar në atë kohë, duke krahasuar veprimet e konstatuara nga këqyrja e pamjeve filmike me ato të regjistruara në sistemin TIMS sipas të njëjtës orë, rezulton se shtetasi që ka dhënë këtë shume është *Murteza Krasniqi* i dtl 01.04.1957, drejtues i automjetit kamion me targa, 01269BF/01829XB. Nuk është zhvilluar bisedë midis punonjësit të policisë Dashnor Braha dhe shtetasit i cili i dha shumën, duke bërë kështu të pamundur verifikimin e arsyes së marrjes së saj nga punonjësi i policisë.

DATË 17.02.2022

362. **Në orën 19:16 min të datës 17.02.2022**, punonjësi i policisë **Endrit Uka** është duke kryer përpunimin e pasagjerëve në hyrje te R.Sh-së në kabinën nr.4 e cila përkon me pamjet filmike të regjistruara nga kamera nr.7 dhe gjatë përpunimit dhe kontrollit të dokumentove dallohet që brenda njërit prej këtyre dokumenteve është futur një kartëmonedhë e ngjashme me prerjen 10-euro e cila merret nga punonjësi i policisë. Gjatë kësaj kohe dëgjohet kjo bisedë:
***Endrit Uka**: Qysh me ja bo qe paske veç test?*
***Shtetasi KS**: Aaaa?*
***Endrit Uka:** Qysh me ja bo qe paske veç test?*
***Shtetasi KS**: Nuk dëgjohen fjalët*
***Endrit Uka**:...(pasi merr 10-euro, fiksuar nga pamjet filmike)...Faleminderit shumë prej teje.*
Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj në datë 17.02.2022 ora 19:16 min nga punonjësi i policisë Endrit Uka janë përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë *Kastriot Hajrizi* i dtl 01.04.1986 dhe *Jeton Hajrizaj* i dtl 04.01.1992 të cilët udhëtonin me automjetin tip auto veturë me targa"02635EQ". Nga biseda e zhvilluar dhe veprimet e fiksuara në pamjet filmike rezulton se arsyeja e marrjes se shumës 10 euro nga punonjësi i policisë Endrit Uka është mungesa e testeve Covid nga shtetasit.

363. **Në datë 17.02.2022 ora 19:37 min** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6 hyrje R.Sh, vijon të kryejë shërbim punonjësi i policisë **Endrit Uka** i cili gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve kosovarë, konstaton se kanë mungesë dokumentacioni të testit Anti-Covid si dhe kryerjes së dozës së dytë të vaksinës, ku sipas punonjësit të policisë është kusht për të udhëtuar. Pasi ua përmend disa herë madje në, duke u dëgjuar në një rast edhe ti përmendë fjalën *kafe*, shtetasi i cili udhëton konstatohet se në mesin e një dokumenti të ketë futur një kartëmonedhë euro, por që nuk mund të përcaktohet prerja. Nga këqyrja e pamjeve filmike rezulton se kartëmonedha euro e marrë nga punonjësi i policisë Endrit Uka është e ngjashme me prerjen 10-euro. Nga verifikimi ne rubrikën hyrje shtetas të huaj, rezulton se në këtë interval kohor ora 19:35 deri në orën 19:36 min, punonjësi i policisë **Endrit Uka** ka përpunuar në hyrje të R.SH-së dokumentet e dy shtetasve kosovarë e konkretisht shtetasit *Albion Shabani* i dtl 23.10.1996 dhe shtetasit *Dren Rexhepi* i datëlindjes 26.04.2000 të cilët udhëtonin me automjetin tip auto veturë me targa "05641GA".

364. **Në datë 17.02.2022 ora 19:22 min** në hyrje të R.Sh-së paraqiten dy shtetas kosovarë dhe nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje rezulton të jenë shtetasit *Ramadan Morina* i dtl. 01.01.1990 dhe shtetasja *Donieta Berisha* i dtl 21.04.1993 të cilët udhëtonin me automjetin tip, auto veturë me targa, "04470HO" e cila drejtohej nga shtetasi Ramadan Morina. Nga biseda e zhvilluar dhe pamjet filmike rezulton se Ramadani i jep punonjësit të policisë në shërbim **Endrit Uka** 10 euro, për shkak të mungesës se testeve kundër Covid nga shtetasit e sipërcituar.

365. **Datë 17.02.2022 ora 08:28**, kamera 207 e vendosur në këtë kabinën nr.4 hyrje R.SH ka regjistruar bisedën e kontrollorit **Fatri Isberi** me shtetas të cilët paraqiten në sportel dhe

dorëzojnë dokumentet. Gjatë intervistës kontrollori Fatri Iseberi dëgjohet që ju thotë:..." ***nuk kini dokumente dhe do ktheheni mbrapsht për Suedi***". Në vijim punonjësi i policisë ju mban dokumentet shtetasve dhe i vendos në krahun e djathtë të tavolinës. Gjatë intervistës, ndër të tjera dëgjohet që njërin prej shtetasve ta thërrasë me emrin Florentin duke iu drejtuar me fjalët: "***Florentin kthehu në Suedi.....200 euro***". Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj janë përpunuar nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi dokumentet e shtetasve *Florentin Gajraku* i datëlindjes 04.07.1995 banues në Kosovë, i cili është pasagjer në automjetin tip furgon me targa "04411ID". Gjatë përpunimit të dokumenteve të këtij shtetasi dallohet se në mesin e njërit prej dokumenteve janë të vendosura euro por nuk mund të përcaktohet shuma. **Punonjësi i policisë Fatri Isebri pasi i shikon i drejtohet sërish shtetasit me fjalët "200, 200".**Nga biseda e zhvilluar duket se arsyeja e marrjes së parave nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi është për shkak se sipas tij, shtetasit i kishte përfunduar leja e qëndrimit.

366. **Në datë 17.02.2022 ora 08:29:11,** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh vijon të kryejë shërbim punonjësi i policisë **Fatri Iseberi.** Në sportel paraqitet një shtetas kosovar i cili dorëzon dokumentet e identifikimit. Fatriu fillon ta intervistoje duke i kërkuar edhe dokumentet e vaksinimit ose testin *Pcr*. Në vijim, në mungesë të tyre i kërkon shtetasit kosovar një kafe duke u shprehur në 10-euro. Biseda e zhvilluar midis tyre është si vijon:

***Fatri Iseberi**: Si ini ju , si kaluat ju, atëherë vaksinën testin ju lutem*
***Shtetasi**:.....(nuk kuptohen fjalët)*
***Fatri Iseberi**: hajde një ditë tjetër , veç me be testin shpejt e shpejt*
***Shtetasi**: (nuk kuptohen fjalët)*
***Fatri Iseberi**: Ec s'ke ça me bë veç me bë testin dhe me ardhë*
***Shtetasi**: ... (nuk kuptohen fjalët)*
***Fatri Iseberi**: **Ose fute një dhjetëshe këtu** (zgjat një dokument)*
***Shtetasi**:... nuk kuptohet*
Fatri Iseberi**: **Jo jo kështu ju mësoj keq ju** (zgjat dorën merr dokumente dhe eurot i vendos përballë aparaturës së skanerit) .. **mirupafshim

Në intervalin kohor ora 08:29 deri në orën 08:30 min, nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se punonjësi i policisë Fatri Iseberi, ka kryer përpunimin e dokumenteve të shtetasit *Sinan Ahmeti* i dtl 09.07.1994, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "07287EG", i cili në mungesë të testit kundre Covid i ka dhënë punonjësit të policisë Fatri Iseberi shumën 10-të euro.

367. **Në datë 17.02.2022 ora 08:37:00,** në kabinën nr.4 hyrje R.SH ku është vendosur kamera 207 ku kryen shërbimin punonjësi i policisë **Endrit Uka,** është paraqitur një shtetas kosovari cili, verifikimi në sistemin TIMS të informacionit, nxjerrë nga krahasimi i pamjeve filmike dhe veprimeve të kryera në sistem sipas minutës përkatëse është shtetasi *Edvin Mushla* i datëlindjes 20.02.1988, pasagjer dhe shtetasit *Dashnor Sokoli* i datëlindjes 14.05.1989 drejtues i mjetit me targa 07777EG dhe pasagjer në po të njëjtin automjet shtetasi *Dashnor Sokoli* i dtl 14.05.1989. Në këtë regjistrim kontrollori Endrit Uka dëgjohet gjatë bisedës duke ju kërkuar *një kafe*, në mungesë të testeve kundër Covid. Fjalë për fjalë e shprehur në formën: " ***Në daci me na i lënë një kafe mirë, se nuk bën pa vaksina, se na i kontrollojnë"***. Nga pamjet filmike konstatohet se

në mesin e njërit prej dokumenteve pasaportë shtetasit i kanë vendosur një kartëmonedhë 5 euro të cilën punonjësi i policisë e hedh para pajisjes skanuese.

368. **Po në datë 17.02.2022 ora 08:41:00**, në të njëjtën kabinë vijon shërbimin punonjësi i policisë **Endrit Uka**, dhe ndërkohë shtetasit kosovarë dokumentet e të cilëve janë përpunuar në sistem gjatë këtij momenti janë *Fatlir Hyseni* i datëlindjes 23.11.2001, drejtues i mjetit me targë 02202EL dhe shtetasi *Bleron Ahmeti* i datëlindjes 24.03.2002 pasagjer. Gjatë bisedës me ta punonjësi i policisë **Endrit Uka**, dëgjohet t'ju kërkojë dokumentet e vaksinimit e në mungesë të tyre ju kërkon ryshfet, duke ju thënë: "***një kafe mua çitu dhe ikni***". Kontrollori Endrit Uka, pasi ka hapur një dokument para aparatit të skanimit, ka hedhur prej këtij dokumenti një kartëmonedhë euro ku nga ngjyra është prerje 5 euro, të cilën, pasi janë larguar shtetasit nga Kosova e ka tërhequr pa shkëputur dorën nga tavolina.

369. **Në datë 17.02.2022 ora 09:12:2022**, kamera 207 e vendosur në këtë kabinë ka regjistruar rast audio e video, kur dallohet qartë se punonjësi i policisë **Endrit Uka**, duke iu kërkuar "***kafe*** "personave që janë në sportel. Konkretisht, në këtë moment, sipas verifikimeve ne sistem, janë duke u përpunuar dokumentet e shtetasve *Agron Ajdini*i datëlindjes 25.05.1973, shtetasi *Miran Ajdini* i datëlindjes07.12.1997 dhe *Erxhan Ajdini* i datëlindjes 07.10.2002, të cilët udhëtonin me automjetin me targa "BU029DC". Sipas bisedës së zhvilluar me kontrollorin Endrit Uka, shtetasit e dispononinin testin e vaksinimi, por kontrollori ju thotë ***se nuk lejohet me test por veç me dy vaksina*** e në vijim duke ju kërkuar mendim ***si do ja bëjmë***. Në video duket kur udhëtaret i japin një broshurë ku në brendësi është një kartëmonedhe e prerjes 10 euro. Pas këtij veprimi kontrollori i lejon të vijojnë udhëtimin.

370. **Në datë 17.02.2022, ora 10:38 min**, në sportelin e kabinës ku është vendosur kamera 207 është paraqitur shtetasi kosovar, verifikuar në sistem shtetasi *Milot Bunjaku*i datëlindjes 06.03.1996 me automjet me targa "01191OJ", i cili ka paraqitur në sportel dokumentet e identifikimit. Kamera ka regjistruar momentin video dhe audio momentet kur kontrollori në shërbim **Endrit Uka**, pasi ka marrë dokumentet për përpunim, i ka kërkuar që shtetasit të paraqesin edhe autorizimin edhe vaksinat. Në vijim punonjësi i policisë Endrit Uka dëgjohet të shprehet: "***të paktën një kafe na e jep***". Shtetasi i ka dhënë një kartëmonedhë 5 euro të futur në mes të një dokumenti.

371. **Po në datë, 17.02.2022 ora 10:47:33,** kamera 207 e vendosur në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh është regjistruar, një rast ku kontrollorja e verifikuar në sistem **Rezarta Lako** kundrejt marrjes së shumës5 euro ka lejuar të kalojë një shtetas kosovar i cili nuk kishte kartë të identitetit fizikisht, por që këtë dokument e kishte të fotografuar në celular. Në kohën që e ka refuzuar këtë shtetas, në kabinë është futur dhe një punonjës tjetër policie, oficer i identifikuar nga grada policore që mban (një yll), i cili dëgjohet ti drejtohet shtetasit në sportel me fjalët: "***ktheje mbrapsht, ktheje mbrapsht***". **Rezarta Lako** i ka kërkuar shtetasit të hap krahun me automjet dhe të sjell celularin të shikojë fotografinë e dokumentit të identifikimit e ndërkohë i mban duke i vendosur në krahun e djathtë të tavolinës, dy karta identiteti të ngjashme me ato të shtetit kosovar. Pas pak minutash shtetasi kosovar është paraqitur me celular te sporteli duke i treguar njëkohësisht edhe dokumentin në celular punonjëses së policisë Rezarta Lako. Në këtë kohë, në

kabinë bashkë me kontrolloren Rezarta Lako, ndodhet dhe një punonjëse policie e cila ka ndërhyrë në bisedë duke i thënë shtetasit *se nuk lejohet, por jepi një kafe shefes*. Pas kësaj shprehje të koleges së saj është fiksuar nga pamjet filmike kontrollorja Rezarta Lako duke vendosur një kartëmonedhë 5-euro në hapësirën midis tastierës dhe kompjuterit dhe pas disa sekondave e ka marrë. Ky shtetas është lejuar të kalojë pa u regjistruar. Po kështu dëgjohet që i thotë bëj *kujdes herë tjetër*. Nuk është bërë e mundur që të verifikohet dhe identifikohet personi që ka qenë në sportel në këtë moment pasi për shkak se nuk dispononte një dokument të vlefshëm udhëtimi nuk është regjistruar në sistem nga punonjësja Rezarta Lako dhe kjo është edhe arsyeja pse është marrë shuma 5 euro, e dhënë nga ky shtetas.

372. **Në datë 17.02.2022 ora 11:20:09**, në sportelin e kabinës nr.4 hyrje R.Sh ku është duke filmuar pajisja përgjuese nr.7, është paraqitur një shtetas kosovar. Nga sistemi është verifikuar se kontrollor është punonjësi i policisë **Endrit Uka**. Shtetasi nga Kosova pasi paraqitet në sportel, jep dokumentet për të përpunuar, por rezulton se kanë harruar një dokument. Endrit Uka ju thotë se është shumë problem dhe ju kërkon *një kafe*. Kërkimin e kafes e përsërit disa herë. Ai ju thotë që kafen ta fusin në bllok dhe merr nga shtetasit disa dokumente, ku brenda duket që ka kartëmonedha. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se në orën 11:20 min e cila përkon me pamjet filmike, punonjësi i policisë Endrit Uka ka kryer veprime për regjistrimin e dokumentacionit të shtetasve *Erblin Rexhepi* i dtl 07.12.1997, pasagjer në automjetin auto veturë me targa, "04898GL" dhe drejtues mjeti shtetasi *Fatlind Sertolli* i dtl 03.03.2000, drejtues i këtij automjeti. Ajo që kuptohet si rezultat i bisedës dhe veprimeve të kryera e të konstatuara nëpërmjet këqyrjes së pamjeve filmike, është se në mungesë të një dokumenti të automjetit, të cilin shtetasit nuk e disponojnë, punonjësi i policisë Endrit Uka ka kërkuar dhe marrë para, të kërkuara duke iu drejtuar disa herë me fjalën "kafe" dhe të marra prej tij nëpërmjet futjes në dokumentet që shtetasit kanë dorëzuar në vijim të veprimeve.

373. **Në datë 17.02.2022, ora 11:32:38,** në sportelin e kabinës nr.4 hyrje R.Sh, ku është vendosur kamera 207 është punonjësi i policisë **Endrit Uka** i cili gjatë intervistës me shtetasit që paraqiten në sportel dëgjohet që, kundrejt mungesës së vaksinës kundër Covid dhe po ashtu në mungesë të dokumenteve të automjetit i kërkon "*kafe*" shtetasit bashkëbisedues. Nga verifikimi në sistem rezulton se shtetasit, për të cilët ka kryer regjistrimin në këtë orë punonjësi i policisë Endrit Uka, janë *Altin Selmani* i datëlindjes 08.09.2000 dhe *Agim Selmani* i datëlindjes 05.07.1962 drejtues automjeti, të cilët kanë udhëtuar me automjetin auto veturë me targa "02600AI". Nga pamjet filmike të fiksuara edhe në procesverbalin e këqyrjes të shoqëruara me fotografi, rezulton se shtetasit në sportel i japin 10 euro dhe më pas largohen duke vijuar udhëtimin.

374. **Në datë 17.02.2022, ora 11:37:42**, kamera 207 ka regjistruar momentin ku në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh-së punonjësi i policisë i cili vijon të kryejë shërbimin **Endrit Uka**, vendos në aparatin e skanimit një kartë-identiteti shqiptare. Nga biseda e zhvilluar midis Endritit dhe shtetasve në sportel, rezulton se këta shtetas janë me leje qëndrimi në Zvicër. Shtetasit janë identifikuar si *Ferat Feratai* drejtues mjetit auto veturë me targa "AG474047" i dtl.15.05.1973 dhe shtetasi *Ramiz Panoxha* idatëlindjes,12.10.1972. Punonjësi Endrit Uka gjatë intervistimit në

lidhje me destinacionin e udhëtimit dhe dokumentacionin që dispononinin, dëgjohet nëpërmjet bisedës audio të diskutojë me ta për mungesën e dokumentit të kërkuar prej tij duke përmendur dokumentin "Karton jeshil" automjeti. Në vijim konstatohet që shtetasit ti japin një kartëmonedhë frangë zvicerane, e cila për shkak se është në mes të dokumentit dhe hapet vetëm një moment nga punonjësi Endrit Uka, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet prerja e saj.

375. **Në datë 17.02.2022 ora 13:36:17**, kamera 207 ka regjistruar bisedën midis kontrollorit të policisë pranë P.K.K Morinë të identifikuar nëpërmjet këqyrjes së sistemit TIMS si **Ylber Hoxha,** dhe një kolegu të tij cili ndodhej në kabinë. Nga këqyrja e pamjeve filmike konstatohet se këta punonjës kryejnë regjistrimin në sistemin TIMS të një shtetasi të huaj dhe automjetit të tij i cili dyshohet se nuk është prezent dhe regjistrimi është fiktiv pasi nuk janë konstatuar udhëtarë në sportel apo dëgjuar biseda të tjera veç punonjësve. Në përfundim të regjistrimit në sistem, dokumentet i merr kolegu i cili, për shkak të pamjes së kufizuar të filmimeve, nuk mund ë identifikohet. Biseda e zhvilluar midis tyre në formë të përmbledhur është si vijon:

***Ylber Hoxha**:Ej*

***Kolegu**: hë mo*

***Ylber Hoxha**: Ky paska njoftim*

***Kolegu**: shif njëherë targën...Ky është shoferi...nuk kuptohet*

***Ylber Hoxha**: Prit ti mbaroj (nxjerr nga aparati i skanerit një kartë identiteti dhe vendos në skaner kartë identiteti në orën 13:36:17) (nuk kuptohen fjalët)*

***Kolegu**: E mbarove*

***Ylber Hoxha**: po po*

***Kolegu:** duhet ta çojmë...nuk kuptohet ...ajo faktikisht për efekt dokumenti, hajde shikoje dokumentin një kopje e ke aty poshtë...fute dhe një herë dhe bëje ashtu (dhe kolegu ja merr nga dora kartën e identitetit dhe e vendos përsëri kartën e identitetit në aparatin e skanimit)*

376. **Në datë 17.02.2022 ora 14: 20**, po në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është vendosur kamera 207, është regjistruar rast ku punonjësi i policisë **Endrit Uka**, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit të qytetarëve të paraqitur në sportel, ju merr shtetasve shumën prej 5- euro. Shtetasit e regjistruar në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj janë *Jeton Hoti* drejtues i mjetit i datëlindjes 10.12.1992 dhe *Valdrin Hoti* i dtl.30. 08.1992 me auto veturë me targë "04442IR". Njëri prej këtyre shtetasve nuk dispononte dokumentin e vaksinimit e gjatë bisedës punonjësi i policisë Endrit Uka i thotë: "***qysh do ja bëjm***". Menjëherë në vijim i jep mbrapsht një dokument dhe i thotë: ***"ndreqe çitu***". Brenda po të njëjtit dokument i cili i jepet mbrapsht nga shtetasit Kosovar rezulton të jenë vendosur kartëmonedha prej 5-së eurosh. E në këmbim të këtij ryshfeti punonjësi i policisë i lejon të udhëtojnë.

377. **Në datë 17.02.2022 ora 14:29:22,** në sportelin e kabinës nr.4 hyrje R.SH, është regjistruar audio dhe video ku dy shtetas nga Kosova, verifikuar në sistem *Getoar Butyqi* i datëlindjes 09.01.1999, i cili është drejtuesi i mjetit me targa "04388HL" dhe *Ardit Krasniqi* i datëlindjes 09.08.1999, pasagjer ndodhen në sportel duke i dorëzuar punonjësit të policisë dokumentet e udhëtimit. Kontrollori **Endrit Uka** ju kërkon këtyre shtetasve autorizimin e mjetit dhe vaksinat. Shtetasit dëgjohen që i thonë se nuk i disponojnë vaksinat. Endriti përdor shprehjen

"qysh me ja bë" dhe ju zgjat një dokument duke ju thënë *"futi ç'itu"*, e duke marrë një kartëmonedhë 5 euro nga këta shtetas.

378. **Në datë 17.02.2022 ora 14:42:56,** kamera 207 ka regjistruar audio dhe video një rast tjetër kur punonjësi **Endrit Uka** ka marrë para nga shtetasit që përpunohen në sportel. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit duke krahasuar veprimet e kryera nga këqyrja e pamjeve filmike dhe atyre të kryera në sistem sipas minutës përkatëse, rezulton se shtetasit e regjistruar e të përpunuar nga ky kontrollor për rastin konkret janë: *Mentor Kokollari* i datëlindjes 11.07.1989 me targa të automjetit "04625IH". Nga biseda dëgjohet edhe një zë femre e cila e pyet: ***"a je lodhë".*** Shtetasja i jep dokumente ku brenda tyre ishte një kartëmonedhë 5-euro. Endriti e hap dokumentet për përpunim, shikon kartëmonedhën dhe e merr atë pastaj fillon përpunimin e dokumenteve. Bashkudhëtarja e shtetasit Mentor Kokallari nuk është e regjistruar në sistem dhe kjo mund të jetë arsyeja e dhënies dhe pranimit të shumës prej 5 euro, fiksuar nga pamjet filmike.

379. **Në datë 17.02.2022 ora 15:28** në kabinën ku është vendosur kamera 207,është regjistruar tjetër veprim i punonjësit të policisë **Endrit Uka**, i cili pasi hap dokumentet e një shtetasi që ndodhej në sportel, konstatohet të nxjerrë prej tyre një kartëmonedhë 5-së euro dhe vendos poshtë tastierës së kompjuterit. Nga verifikimet në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se nga ky punonjës janë kryer në sistem veprime me dokumentet e shtetasve kosovarë: *Fatlind Xhemajli nga Kosova i datëlindjes 11.05.2000, drejtues i automjetit me targa "01177ON".*

380. **Në datë 17.02.2022,ora 15:49:43,** kamera 207 ka regjistruar një rast tjetër të punonjësit të policisë **Endrit Uka**, i cili ka vendosur në aparatin e skanerit një kartë identiteti shqiptare. Kontrollori bisedon me shtetasin i cili pasi i jep kartën e identiteti dëgjohet që i thotë***: "ti je pa dokumente dhe i prish punë asaj...."***. Nga verifikimi në sistem shtetasi i cili bisedon me kontrollorin nuk është i regjistruar. Kontrollori ka marrë si ryshfet monedha metalike euro por që nuk mund të identifikohen se sa kanë qenë.

381. **Po në datë 17.02.2022 ora 14.06 min**, në sportelin e kabinës nr. 4 hyrje R.Sh ku është vendosur kamera 207, është regjistruar një komunikim mes kontrollorit **Endrit Uka** duke bërë edhe presion ndaj qytetarëve ne sportel për mungesë të autorizimit të automjetit. Shtetasit me të cilët janë kryer veprime në sistemin TIMS nga ky punonjës police janë***:*** *Fisnik Halimi* i datëlindjes 06.09.1978, drejtues i mjetit me targa "01866PB" dhe *Arbias Krasniqi*, i datëlindjes 06.04.1995, pasagjer në të njëjtin automjet. Kontrollori Endrit Uka konstatohet që të ketë marrë një kartëmonedhe 5 euro, e në vijim i ka lejuar këta shtetasit të udhëtojnë në drejtim të Shqipërisë.

382. **Po në datë 17.02.2022, ora 17:36:13,** në të njëjtën kabinë nr.4, punonjësi i policisë **Endrit Uka** konstatohet dukë marrë shumën 5-euro, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve kosovarë *Dielli Rizvanolli* i datëlindjes 14.08.1994, i cili udhëton me mjetin auto veturë me targa 01900IP. Kamera ka regjistruar video dhe audio kontrollorin **Endrit Uka** i cili i kërkon ryshfet në mungesë të dokumenteve të vaksinimit nga ky shtetas dhe merr prej tij shumën prej 5-eurosh.

383. **Në vijim në orën 18:01:44,** po në të njëjtën kabinë ku vijon shërbimin punonjësi i policisë **Endrit Uka** është regjistruar një tjetër rast ku punonjësi **Endrit Uka,** pasi ka vendosur në aparatin e skanerit një kartë identiteti, pyet shtetasin nëse ka autorizim për mjetin. Shtetasi i verifikuar ne sistem *Rinor Bytyci,* i datëlindjes 17.02.1996, me automjet me targe "04828HP", nuk dispononte autorizim dhe kontrollori i bën pyetjen *"si do ja bëjmë.."*. Në xhamin anësor të dritares së kabinës pasqyrohet momenti kur shtetasi i jep një dokument dhe pasi Endriti e hap duket që merr një kartëmonedhë dhe e lejon këtë shtetas të udhëtojë drejt Shqipërisë.

384. **Po në të njëjtën datë ora 18:25:26,** në sportelin e kabinës ku është vendosur kamera 207 është regjistruar audio dhe video momenti i përvetësimit të një shumë parash prej 5-eurosh nga punonjësi **Endrit Uka** për mungesën e dokumenteve të vaksinimit nga shtetasit që paraqiten në sportel. Nga verifikimi i sistemit TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, punonjësi Endrit Uka në orën 18:25 min, ka kryer veprime për regjistrimin e dokumenteve të shtetasve *Taulant Palushi i* datëlindjes 20.08.1997 dhe shtetasi *Visar Ademaj* i datëlindjes 07.02.1996, shtetas kosovarë, te cilët udhëtojnë me mjetin auto veturë me targa "04307IT". Kontrollori Endrit Uka gjatë intervistimit të këtyre shtetasve dëgjohet t'ju thotë: ***"si do ja bëjmë..."***, e ndërkohë në këtë moment shtetasi i jep një dokument ku brenda ishte një kartëmonedhe e prerjes 5 euro. Nga verifikimi në sistem rezulton se Visar Ademi është regjistruar pas Taulant Palushit dhe rezulton se ky është shtetasi i cili ka dhënë shumën prej 5 eurosh kundrejt punonjësit të policisë.

385. **Në datë 17.02.2022, ora 18:38:03**, po në të njëjtën datë dhe në të njëjtën kabinë kamera 207 ka regjistruar punonjësin e policisë **Endrit Uka**, duke marrë shumën 5-euro nga shtetasit kosovarë *Mazllum Maloku,* i datëlindjes 07.05.1995, *Shpat Tabaku* i datëlindjes 19.06.1994,*Gani Ahmeti* i datëlindjes 18.06.1992 të cilët udhëtojnë me automjetin me targë "01915QE". Këta shtetas i japin 5 euro por nuk konstatohet ndonjë arsye e thyerjes së rregullave të udhëtimit apo mungesë dokumentacioni nga ana e tyre. Nga verifikimi në sistem dhe pamjet filmike kartëmonedha 5-euro ka qenë e vendosur te pasaporta e shtetasit *Mazllum Maloku.*

386. **Në datë 17.02.2022 ora 18:50:01**,kamera 207 ka regjistruar punonjësin e policisë **Endrit Uka** i cili vijon shërbimin në kabinën nr.4 hyrje R.Sh. Në këtë kohë është regjistruar biseda mes kontrollorit Endrit Uka dhe qytetarit në sportel, i cili nga verifikimi rezulton se nuk është regjistruar në sistemin TIMS, por ndërkohe rezulton nga pamjet filmike se i jep kontrollorit një kartëmonedhë të prerjes 2000 lekë shqiptare.

387. **Po në të njëjtën datë ora 19:16** në sportelin e kabinës ku është vendosur kamera 207, ka regjistruar video dhe audio momentin kur kontrollori **Endrit Uka**, në mungesë të dokumenteve të vaksinimit i merr shumën 10 euro një shtetasi kosovar. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, në këtë minutë janë kryer veprime me dokumentet e shtetasve *Kastriot Hajrizi* i datëlindjes 01.04.1986 drejtues i automjetit më targë" 02635EQ" dhe *Jeton Hajrizi* i datëlindjes 04.01.1992 pasagjer në të njëjtin automjet.

388. **Po në të njëjtën datë ora 19:22:17**, punonjësi i policisë **Endrit Uka** konstatohet në veprimin e radhës duke përvetësuar një shumë 10-të euro në mungesë të disponimit të autorizimit për automjetin nga shtetasi *Ramadan Morina (*drejtues mjeti), i datëlindjes 01.01.1990, automjeti

me targa 04470HO dhe pasagjer *Doneta Berisha e datëlindjes 21.04.1993.* Rasti është pasqyruar në mënyrë të detajuar në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike të datës 17.02.2022.

389. **Në datë 17.02.2022 ora 21:40:11**. Në kabinën nr.4 hyrje R.Sh, gjatë përpunimit të disa dokumenteve, kontrollori i verifikuar nëpërmjet sistemit **Dashnor Brahai** kërkon dokumentin pasaportë të një shtetasi të huaj dhe pasi e merr e vendos mbi tavolinë. Gjatë përpunimit të kësaj pasaporte kontrollori nxjerr një kartëmonedhe të prerjes 10 euro dhe e fsheh poshtë tastierës së kompjuterit. Nga biseda kuptohet se brenda kabinës është dhe një person tjetër. Nga sistemi është verifikuar se personi i cili udhëtonte me shtetasit e huaj serbë është *Bujar Krasnici* i datëlindjes 16.12.1974 me auto veturë me targa "BG892IF", të cilit punonjësi i policisë **Dashnor Braha** ju drejtohet ndër të tjera me fjalët: "***...no no kthehuni mbrapa...".***

DATA 18.02.2022

390. **Në datë 18.02.2022 ora 09:21:12,** kamera 207 e vendosur në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh ka regjistruar veprimet e punonjëses së policisë **Xhuliana Maksutaj** e cila në mungesë të dokumenteve të vaksinimit, i kërkon para shtetasve kosovarë në sportel. Nga këqyrja e sistemit TIMS rezulton se në minutën 09:21, e cila përkon edhe me paraqitjen e shtetasit në sportel, kjo punonjëse ka kryer veprime me dokumentin e shtetasit kosovar ***Granit Binakaj*** i datëlindjes 13.05.1994, drejtues automjetit me targë 03606HK. Në automjet si pasagjere se bashku me Granitin udhëtonte shtetasja e verifikuar në sistem *Kaltrine Zeqiraj* e datëlindjes 13.07.1994. Nga regjistrimi video dhe audio dëgjohet se punonjësja e policisë në shërbim Xhuljaja Maksutaj i pyet nëse i kanë dokumentet e vaksinave. Graniti i thotë se vajza ka ndërsa ai jo. Kontrollorja i thotë vajza do kalojë e ti jo. Pas këtij momenti Graniti i ka dhënë diçka, të cilin kontrollorja mundohet ta fsheh si veprim. Kartëmonedhën e vendos poshtë tastierës dhe po kështu Xhuljana dëgjohet kur i thotë "***jepma me terezi".*** Pas përshëndetjes me Granitin, Xhuljana merr një çantë ngjyrë të zezë dhe e vendos në krahun e majtë të tavolinës, e hap atë dhe duket që vendos përsëri dorën poshtë tastierës dhe nxjerrë dorën të mbyllur ky dyshohet se mban kartëmonedhën e marrë pak më parë, dhe e fut te çanta ngjyre e zezë.

391. **Në datë18.02.2022 ora 09:44:00**, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është montuar kamera 207 është regjistruar audio dhe video një rast kur kontrollore **Xhuljana Maksutaj** ka marrë një kartëmonedhë 10 euro nga shtetas kosovarë te cilët po kryenin procedurat e hyrjes në RSH. Nga verifikimi në sistem ka rezultuar se shtetasit që kanë që në në sportel në këtë moment janë shtetasit kosovarë *Ibrahim Xhaferi* i datëlindjes 18.06.2000 drejtues i mjetit me targa 04793IS,*Valton Qovanaj* i datëlindjes 09.05.1983 pasagjer dhe *Hadis Xhaferi* i datëlindjes 23.05.1999. Nga pamjet filmike rezulton se Xhuljana pasi ka hapur një librezë makine, ka nxjerrë prej andej një kartëmonedhë të ngjashme me prerjen 10-të euro dhe e ka vendosur në çantën ngjyrë të zezë e cila ndodhet para pajisjes skanuese.

DATA 19.02.2022

392. **Në datë 19.02.2022 ora 14:18:33**, në sportelin e kabinës nr. 4 hyrje R.SH ku është vendosur pajisja përgjuese është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Gëzim Duraku.** Në

sportel paraqesin dokumentet shtetas Kosovarë të cilët, nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit krahasuar sipas orës përkatëse të kryerjes së veprimeve në sistemin sipas pamjeve filmike, janë identifikuar si shtetasi: *Nexhat Spahiu* i datëlindjes 28.09.1978 drejtues i mjetit më targë "02322FA". Punonjësi i policisë **Gëzim Duraku,** gjatë intervistimit e ka pyetur shtetasin nëse disponon dokumentin e vaksinimit që më sa duket këtij të fundit i mungon. Për shkak të mungesës së këtij dokumenti punonjësi i policisë Gëzim Duraku konstatohet të marrë në vijim shumën prej 5-së euro, dokumentuar me fotografi në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike.

393. **Në datë 19.02.2022 ora 10:10:10** kamera 207, në kabinën nr.4 hyrje R.Sh, ka regjistruar audio dhe video rastin kur punonjësja e policisë në shërbim **Vojsava Selmani** zëvendësohet nga një punonjës tjetër i cili ka rezultuar të jetë Fatri Iseberi. **Vojsava Selmani**, referuar pamjeve filmike, dallohet duke marrë çantën për të dalë nga kabina dhe dëgjohet që thotë *do pi kafe*. Kolegu i jep një kartëmonedhë 5 euro të cilën Vojsava e cila ndodhej poshtë tastierës. Në bisedën e regjistruar përmenden fjalët në *"tastiere"* dhe punonjësja fjalën *"veç një"*. Kartëmonedhën të cilën pasi ja jep kolegu e merr dhe largohet nga kabina.

394. **Në datë 19.02.2022 ora 13:08:38, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh** konstatohet një rast tjetër ku punonjësja e policisë me shërbim në këtë kabinë **Vojsava Selmani,** gjatë intervistës së një shtetasi që ka në sportel dëgjohet që ti thotë ***"gjeje ku të duash, pa vaksinë mos më hajd herë tjetër"*** dhe nënë këtë moment çon tastierën e kompjuterit. Në këtë rast nuk duken kartëmonedha apo biseda të tjera por është kryer i njëjti veprim në lidhej me ngritjen e tastierës, sikurse edhe në rastet e tjera kur ajo është konstatuar të vendosë poshtë saj kartëmonedhat e dhëna nga shtetas të ndryshëm në sportel.

395. **Në datë 19.02.2022,ora 13:26:14**. në sportelin e kabinës nr .4 hyrje R.SH është duke kryer shërbim punonjësja e policisë **Vojsava Selmani** e cila gjatë intervistës shtetasin e paraqitur në sportel e thërret me emrin *Ermir*. Gjatë bisedës dëgjohet të thotë: ***"pse se ke o Ermir"*** dhe në këtë moment çon tastierën dhe poshtë tastierës ka fshehur një kartëmonedhë. Nga verifikimet në sistemin TIMS personi që ka qenë në sportel në këtë hark kohor dhe është përpunuar nga kontrollorja Vojsava Selmani është shtetasi ***Ermir Zasella*** i datëlindjes 04.03.1994 i cili, sic rezulton nga komunikimi me kontrolloren, nuk dispononte dokumentet e vaksinimit si kusht për të kaluar kufirin.

396. **Në orën 13:32:57 të datës 19.02.2022** kamera 207 vendosur në kabinën nr.4, hyrje R.SH, ka regjistruar një tjetër rast ku punonjësi i policisë në shërbim **Gëzim Duraku** në prezencë edhe të punonjëses tjetër **Vojsava Selmani,** i ka marrë një shtetasi kosovar të paraqitur në këtë orë në sportel një kartëmonedhë 5 euro. Të dy punonjësit e policisë dëgjohen duke iu drejtuar shtetasit në sportel me fjalët***"…. kafe, kafe…."*** . Kontrollorja ka pyetur kolegun duke përdor shprehjen ***" Ç'far thoshte ai"***, dhe kanë dalë nga kabina. Kur është futur përsëri brenda kabinës punonjësi i policisë Gëzim Duraku ka vendosur një kartëmonedhë 5 euro, të palosur në tavolinën e punës. Nga verifikimi në sistemin TIMS, sipas orës së pamjeve filmike krahasuar me veprimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se janë përpunuar dokumentet e shtetasit *Alban Mici*, i datëlindjes 30.05.1989 drejtues i mjetit Fugon me targa "AA321LC". I pyetur në cilësinë

e personit që tregon rrethana të hetimit në datë 30 qershor 2022, shtetasi *Alban Mici*, lidhur me këtë ngjarje, ka deklaruar se :"..*Nuk merrem me transport udhëtarësh por merrem me blerje mallrash të ndryshme si ushqime apo sende të tjera.*". I pyetur nëse e njeh punonjësin e policisë Gëzim Duraku ai përgjigjet se :"*Po e njoh si punonjës të policisë kufitare që punonte në Morinë... Unë nuk i kam dhënë asnjë ryshfet këtij punonjësi, nuk jam unë që i kam dhënë para.*".

397. **Në datë 19.02.2022 ora 13:53** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh është duke vijuar shërbimin punonjësi i policisë **Gëzim Duraku** i cili konstatohet duke i marrë një kartëmonedhë 5 euro një shtetasi, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit e po ashtu nga këqyrja e pamjeve filmike me dokumentet e shtetasit, rezulton se nuk janë kryer veprime për regjistrimin e tij në sistemin TIMS. Nga biseda e zhvilluar midis tyre kuptohet se arsyeja e marrjes së kësaj shumë është mungesa e dokumenteve të vaksinimit nga ana e shtetasit.

398. **Në datë 19.02.2022 ora 11: 38:20,** kamera 207 e vendosur në këtë kabinën nr .4 hyrje R.SH ka regjistruar bisedën audio dhe video midis kontrollores **Vojsava Selmani** e cila kryen veprime në sportel me një shtetas të cilin gjatë bisedës dëgjohet ta thërrasë me emrin Ardian. Sipas komunikimit të zhvilluar mes tyre duket se Ardiani nuk disponon dokumentin e vaksinimit dhe për këtë arsye punonjësja e policisë merr një kartëmonedhë të cilën e vendos menjëherë poshtë tastierës. Para këtij veprimi punonjësja e policisë konstatohet ti mbaje dokumentet shtetasit dhe i kërkon të hapë krahun e pastaj të vijë ti marrë. Mbasi paraqitet dhe i err kartëmonedhën e vendosur poshtë tastierës, e lejon të udhëtojë. Nga këqyrja e sistemit TIMS mbi veprimet e kryera në harkun kohor që përkon me pamjet filmike si më sipër, nuk është bërë e mundur të përcaktohet se cili është shtetasi që ka qenë prezent në sportel në këtë momenti pasi punonjësja e policisë nuk ka kryer veprime regjistrimi.

399. **Në datë 19.02.2022 ora 12:48:17,** vijon duke kryer veprime në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh punonjësi i policisë **Vojsava Selmani** e cila konstatohet duke komunikuar me një shtetas në sportel i cili, nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit është shtetasja *Dijana Dragidella* e datëlindjes 11.05.1994, drejtuese e mjetit me targë 01320MJ, e cila në mes të dokumenteve ka vendosur një kartëmonedhë10-euro e cila është marrë më pas nga punonjësja e policisë.

DATA 20.02.2022

400. **Në datë 20.02.2022, në ora 16:20:**33 min, në kabinën nr.4 hyrje R.SH punonjësi i policisë në shërbim **Muhamet Cengu**, merr një kartëmonedhë ne dukje100-Paund nga një shtetas i cili paraqet dokumentet në sportel. Nga biseda e kryer midis tyre rezulton se arsyeja e marrjes së ryshfetit nga punonjësi i policisë është mos regjistrimi i gjeneraliteteve të këtij shtetasi në sistemin TIMS, fakt që ka bërë të pamundur edhe identifikimin e tij nëpërmjet veprimeve verifikuese të kryera në sistemin TIMS.

401. **Në datë 20.02.2022, ora 17:31:27,** në kabinën nr.4 hyrje R.Sh në shërbim është punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, i cili konstatohet duke i marrë 10-euro shtetasit kosovar *Kujtim Krasniqi* i datëlindjes 08.04.1976, i cili udhëton me mjetin me targe "BNSX210". Nga biseda e zhvilluar midis tyre nuk mund të përcaktohet se çfarë mungesash ka pasur ky shtetas në

dokumentacion por dëgjohet punonjësi i policisë Muhamet Cengu duke i thënë :***"Futi qitu një kafe"***, pasi e interviston dhe merr informacion se ky shtetas banon në Belgjike.

402. **Në datë 20.02.2022 ora 10:09:29,** në Pikën e Kalimit Kufitar Morine-Kukës, në kabinën nr. 2 hyrje R.SH është regjistruar me audio dhe video punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** i cili vijon të kryejë shërbim në këtë kabinë. Ky punonjës gjatë regjistrimit të dokumenteve të shtetasit, nuk kryen ndonjë intervistim të mirëfilltë ndaj tij apo ta pyesë nëse disponon dokumentet e vaksinimit, por ndërkohe rezulton nga pamjet filmike se ka marrë shumën prej 5-euro, të dokumentuar me fotografi në procesverbalin e këqyrjes, shumë e cila është vendosur ne mesin e dokumenteve. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se shtetasi që ka dhënë këtë shume është *Ilir Berisha* i datëlindjes 28.12.1997, i cili udhëton me automjetin me auto veturë me targë "038144GB".

403. **Në datë 20.02.2022, ora 10:2:24** në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH vijon shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, i cili merr një kartëmonedhë 5 euro nga një shtetas që paraqitet ne sportel në këmbim të mos regjistrimit të këtij shtetasi në sistemin TIMS, pasi edhe nga këqyrja e kryer sipas pamjeve filmike, punonjësi i policisë nuk rezulton të kryejë veprime ne kompjuter me dokumentin e këtij shtetasi.

404. **Në datë 20.02.2022, ora 11:23:24** në Piken e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, kabina nr. 4 hyrje R.SH punonjësi i policisë në shërbim **Muhamet Cengu**, është fiksuar teksa merr një kartëmonedhë 5 euro në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit nga një shtetas kosovar. Po ashtu, gjatë përpunimit të këtyre dokumenteve konstatohet se punonjësi i policisë pasi merr fillimisht një kartëmonedhë 5-euro të vendosur brenda dokumentit mbetet i pa kënaqur dhe i thotë shtetasit të futë një 10-tshe, duke i kthyer dokumentin mbrapsht me qëllim vendosjen e ryshfetit brenda tij. Shtetasi në sportel e merë dokumentin vendos një kartëmonedhe tjetër brenda dokumentit dhe ja jep punonjësit të policisë. Nga biseda e kryer rezulton se shtetasi i përmendur me emrin *Ali* nuk udhëton i vetëm por është i shoqëruar nga persona të tjerë pasi gjatë bisedës i drejtohet në numrin shumës e këtyre shtetasve ju mungojnë dokumentet e udhëtimit. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se ky punonjës në kohën kur ka marrë shumat si më sipër nga shtetasit që ndodheshin në sportel, ka kryer regjistrimin e dokumenteve vetëm të shtetasit *Fetah Sahiti*, i datëlindjes 09.10.1996, i cili udhëton me automjetin auto veturë me targa "06821FG", ndërsa shtetasit e tjerë që udhëtojnë bashkë me të nuk figurojnë të regjistruar.

405. **Në datë 20.02.2022, ora 12:43:28,** në kabinën nr.4, hyrje R.SH është regjistruar audio dhe video një rast ku punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** konstatohet duke marrë shumën 5 euro nga një shtetas kosovar për mungesë të siguracionit të mjetit, e kuptuar kjo sipas bisedës që kryejnë me njëri tjetrin. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rezulton se në kohën që është kryer biseda dhe janë paraqitur shtetasit në sportel punonjësi i policisë Kapllan Dogjani ka kryer veprime me dokumentet e shtetasve: *Daut Muharemi* i dtl 25.05.1986 drejtues i automjetit auto veturë me targa, "04240IT, *Jahir Muharremi* i dtl. 14.02.1983 pasagjer dhe *Driton Balaj* i dtl. 13.03.1981.

406. **Në datë 20.02.2022 ora 09:42:54,** në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, kabina nr. 4 hyrje R.SH punonjësi **Muhamet Cengu**, konstatohet të marrë ryshfet në shumën 5 euro nga një shtetas kosovar. Nuk mund të përcaktohet arsyeja e marrjes së ryshfetit nga ana e tij por veprimi është dokumentuar me pamje filmike në procesverbalin e këqyrjes. Dëgjohet vetëm që shtetasi në momentin që i jep dokumentin t'i thotë, "***Qyre një kafe***". Nga këqyrja e sistemit TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj, nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu është kryer regjistrimi dokumentit të shtetasit kosovar *Ruzhdi Kqiku* i datëlindjes 27.05.1949 me auto veturë me targë "05228EB" drejtues automjeti.

407. **Në datë 20.02.2022, në orën 11:46:35,** po në kabinën nr. 4 hyrje shtetas të huaj, vijon shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu.** Gjatë intervistimit të një shtetasi kosovar është marrë një kartëmonedhë në dukje e ngjashme me atë të prerjes 100 euro, të cilën Muhameti fillimisht e vendos në cep të tavolinës e me pas e merr para vetes. Gjatë kohës që vendosen paratë në tavolinë, kontrollori Muhamet Cengu përpunon në pajisjen skanuese karta identiteti të shtetasve shqiptare dhe për këtë arsye është bërë e pamundur të identifikohet shtetasi kosovar që ka dhënë shumën përkatëse, pasi nuk rezulton i regjistruar në sistem.

408. **Në datë 20.02.2022, ora 13:08:07,** në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, po në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh vijon shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** i cili konstatohet të marrë shumën 20 euro nga një shtetas kosovar, gjatë përpunimit të dokumenteve, në mungesë të autorizimit për automjetin e konstatuar kjo nga biseda e kryer midis tyre. Po ashtu, nga këqyrja e pamjeve filmike pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes rezulton se në kohën që në kabinë kryen këtë bisedë dhe veprimin për marrjen e shumës 20 euro, nuk përpunon dokumente ne sistemin TIMS të informacionit duke mos kryer regjistrim në sistemin TIMS të informacionit.

409. **Në datë 20.02.2022 ora 13:27:26,**në sportelin e kabinës, nr. 4 hyrje R.SH është regjistruar një rast tjetër rast ku kontrollori **Muhamet Cengu**, në mungesë të autorizimit për automjetin të shtetasit në sportel, i ka marrë shumën 10-të euro shtetasit kosovar që me sa duket është drejtues automjeti. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas të huaj në kohën e përvetësimit të shumës dhe regjistrimit të dokumenteve të tij, rezulton se punonjësi i policisë Muhamet Cengu ka regjistruar vetëm dokumentin e shtetasit *Edi Hoxhaj* i datëlindjes 19.10.2000 me makinë me targe "04788GS" shofer, pavarësisht se punonjësi i policisë nga biseda dëgjohet që t'ju drejtohet në shumës, por në sistemin TIMS nuk rezultojnë persona të tjerë pasagjerë në të njëjtin automjet.

410. **Po në datë 20.02.2022, ora 14:23:06** në sportelin e kabinës nr. 4 hyrje R.SH ku është duke vijuar shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu,** konstatohet të marrë dy kartëmonedha të prerjes 5 euro në mungesë të siguracionit të mjetit. Kur shtetasi i jep një kartëmonedhë 5 euro punonjësi i policisë nuk ngelet i kënaqur dhe i kërkon edhe të tjera. Në vijim shtetasi konstatohet ti japë edhe një kartëmonedhë tjetër po të prerjes 5 euro, veprime të cilat janë fiksuar nga pamjet filmike dhe janë dokumentuar me fotografi në procesverbalin e këqyrjes. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit, rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu në momentin e kryerjes së veprimit si më sipër, janë regjistruar dokumentet e shtetasve *Nehari Kryeziu*, i datëlindjes 26.04.1996, me

makine me targa 04597FG shofer dhe pasagjer në automjetin e tij shtetasja *Valentina Qoqaj* e dtl 14.04.1998.

411. **Po në datë 20.02.2022, ora 14:41:29** në sportelin e kabinën nr. 4 është duke vijuar shërbimin punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** konstatohet duke i marrë një shtetasi dy herë radhazi nga 5-së euro me qëllim mos regjistrimin e tij në sistemin TIMS. Arsyeja marrjes së shumës 10 euro, nga kontrollori Muhamet Cengu është mos regjistrimi i shtetasit shqiptar për datën 24.02.2022 në hyrje të R.Sh-së, dokumentuar me fotografi në mënyrë të detajuar në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike.

412. **Në datë 20.02.2022** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Arjan Sokoli**. Në orën 08:25 min nga shtetasit kosovarë të paraqitur në sportel i jepen dy dokumente udhëtimi, pasaporta. Gjatë pyetjes nëse i kanë vaksinat apo jo njëri prej shtetasve i përgjigjet se kanë vetëm një dozë dhe punonjësi i policisë Arjan Sokoli iu thotë se duhen të dyja, ndërkohë edhe pse e ka përpunuar pasaportën me veshje ngjyrë blu ja jep përsëri mbrapsht shtetasit, i cili pasi fut brenda në të një kartëmonedhë prerje 5-euro ja jep serish punonjësit të policisë Arjan Sokoli. Arjani i nxjerr nga pasaporta dhe pasi i merr i dorëzon dokumentet shtetasve dhe i lejon të vijojnë udhëtimin për në Shqipëri. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje sipas orës 08:25, rezulton se shtetasit kosovarë qe janë përpunuar nga ky punonjës policie në këtë orar janë *Mustaf Cerkini* i dtl 21.04.1968 dhe *Enis Cerkini* i dtl 08.08.1992(shofer) të cilët udhëtonin me automjetin tip auto veturë me targa, "05418FO". Në vijim dëgjohet që punonjësi i policisë të thërrasë emrat e Avdyl dhe Abdurrahman, udhëtarë në përpunim në vijim. Në vijim **Arjan Sokoli**, po në të njëjtën kabinë, në të njëjtën datë është duke kryer veprimet me pesë shtetas kosovarë të cilët paraqesin dokumentet në sportel dhe udhëtojnë me automjetin auto veturë me targa, "03344DI", me drejtues mjeti shtetasin *Abdurrahman Murtezaj* i dtl 07.07.1987, ndërsa pasagjerë shtetasit *Avdyl Rexhaj* i dtl 17.07.1982, *Burim Shala* idtl. 17.10.1982, *Remzi Shala* i dtl 18.06.1979 dhe *Ylber Myrtezaj* i dtl 19.10.1989. Në mungesë të testeve të Covidit, Arjani ju kërkon para dhe konstatohet se midis letrave te mjetit ata i vendosin një kartëmonedhë prerje10- euro, dokumentuar me fotografi në procesverbalin e këqyrjes. **Në vijim** në kabinë vjen punonjësi i policisë me nr. identifikues 06574, ku nga verifikimi në sistemin RMIS rezulton të jetë **Muhamet Cengu** me detyre Ndihmës Specialist kontrollor me të cilin Arjani zëvendësohet në shërbim.

413. **Në orën 08:32 po të datës 20.02.2022** kabina nr. 4 hyrje R.SH, në sportel paraqesin dokumentet shtetas të tjerë kosovare të cilët punonjësi i policisë i pyet vetëm nëse i kanë vaksinat dhe nuk konstatohen veprime regjistrimi të dokumenteve të tyre ne sistem apo me kompjuter. Pasi ju hedh një sy dokumenteve, brenda njërit dokument është një prerje euro 10-euro të cilën punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** e hedh para pajisjes skaner. Ne vijim gjatë komunikimit me udhëtarin e radhës punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** dëgjohet ta pyesë për identitetin e njërit prej shtetasve që mban dokumentin në dorë duke iu drejtuar me fjalët: "***Lutfija kush është?...***". Por nga verifikimi në sistemin TIMS si hyrje dhe dalje të R.Sh-së për këtë interval kohor nuk rezulton i regjistruar në sistem asnjë shtetas me emrin *Lutfi*. Ndërkohë

shtetasit e të cilin komunikon i jep mbrapsht një dokument dhe i thotë *rregullojë* duke i kërkuar shprehimisht edhe një ***kafe***, i cili konstatohet duke i dhënë shumën 5 euro.

414. **Në orën 08:33 të datës 20.02.2022** kabina nr. 4 hyrje R.Sh, pasi ka përpunuar disa pasagjerë dhe në sportel nuk ka njeri, konstatohet që punonjësi i policisë **MuhametCengu** të ngrejë tastierën e kompjuterit dhe nga poshtë saj të nxjerrë dhe të tërheq euro, por për shkak se i mbulon me dorë (*dallohen pjesërisht*) nuk mund të përcaktohet prerja.

415. **Në orën 09:45:56 po të datës 20.02.2022** në sportelin ku është duke përpunuar pasagjerë punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** , kabina nr. 4 hyrje R.SH, paraqitet një shtetas tjetër i cili konstatohet se i jep 5- euro. Nga verifikimi ne sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje në R.Sh, rezulton se në datë 20.02.2022 ora 09:46 min, punonjësi i policisë Muhamet Cengu ka përpunuar dokumentet e dy shtetasve kosovarë të cilët udhëtonin me një automjet auto veturë më targa Angleze"RK65XFB" me drejtues automjeti shtetasin *Besim Ramnabaja* i dtl 15.01.1974 dhe pasagjer shtetasi tjetër kosovar *Idriz Gashi* i dtl 15.05.1965. Ndërkohë gjatë bisedës konstatohet që shtetasi t'i japë edhe 5-euro të vendosura brenda dokumentit pasaportë, të kërkuara nga vetë punonjësi pa ndonjë arsye.

416. **Në orën 09:54 po të datës 20.02.2022** në sportel paraqitet një shtetas kosovar i cili i jep dokumentin për verifikim. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit në këtë orë është përpunuar dokumenti i shtetasit *Ekrem Rashica* i dtl 01.06.1985, udhëtuar me automjetin tip auto veturë me targa "01608NI". Nga pamjet filmike duket se brenda një dokumenti ai vendos një shumë monetare, në dukje prerje euro ngjyre jeshile, të cilat i jepen punonjësit të policisë **Muhamet Cengu**. Drejtues mjeti është një shtetas tjetër i cili thirret *Rustem* por që nuk ka letërnjoftim dhe për këtë arsye nuk ekziston i regjistruar në sistemin TIMS. Punonjësi i policisë Muhamet Cengu merr paratë dhe në atë moment i dorëzon dokumentin për të vijuar udhëtimin shtetasit.

DATA 21.02.2022

417. **Në datë 21.02.2022,ora 18: 56:00,** në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh e cila përkon me pamjet filmike të kamerës nr. 7 është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Ylber Hoxha,** i cili gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi Shqiptar konstatohet të marrë një kartëmonedhë të vendosur brenda pasaportës së këtij shtetasi të cilin gjatë intervistimit e thërret me emrin *Ferdinand.* Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit shtetasi me emrin Ferdinand të cilit i janë përpunuar dokumentet nga punonjësi Ylber Hoxha është *Ferdinand Lefter Hasani* i dtl 17.09.1971, drejtues ia automjeti auto veturë me targa, "AA882JE".Nga biseda e zhvilluar midis tyre shtetasi në sportel duhet të ketë pasur mallra në automjetin e tij dhe në mungesë të kontrollit të automjetit punonjësi i policisë i kërkon para.

418. **Në datë 21.02.2022 ora 20:42:31** në kabinën nr.4 hyrje R.Sh e cila përkon me regjistrimin e pamjeve filmike të kamerës nr. 207, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** i cili gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve në sportel, konstatohet duke ju kërkuar ***"kafe",*** por që nuk konstatohet veprim mitëdhënës nga shtetasi në sportel. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit rubrika hyrje shtetas tëhuaj rezulton se punonjësi i

policisë **Kapllan Dogjani** ka përpunuar dokumentet e shtetasit *Muhamer Cerkina,*i datëlindjes 16.01.1969 me automjet me targa "INMC60". Në vijim, po në **datë 21.02.2022 ora 20:17:58**, në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh vijon shërbimin punonjësi i policisë **Kapllan Dogjani** i cili konstatohet se i kërkon dhe merr shtetasve në sportel para në mungesë të dokumenteve të vaksinimit të tyre, por shuma ka rezultuar e pamundur për tu përcaktuar nga pamjet filmike. Konkretisht, bisedës së kryer punonjësi i policisë, pasi konstaton se shtetasit nuk disponojnë dokumentin e vaksinimit, ju kërkon të hapin krahun me automjet e madje duke ju thënë se do t'i kthejë mbrapsht. Ne vijim, nga pamjet filmike konstatohet t'ju japë një dokument mbrapsht dhe t'ju thotë ***"Fute nji kafe qitu" "Kafe të mirë se s'ka ça bën"***. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se ky punonjës në momentin që ka kryer edhe veprimet si më sipër, ka përpunuar dokumentet e shtetasit *Ekrem Veseli*, i datëlindjes 10.10.1995, i cili udhëtonte me automjetin me targa 02226FD. Midis të tjerash dëgjohet që punonjësi t'i thotë njërit prej pasagjereve se i ka mbaruar edhe afati i dokumentit dhe pikërisht për këtë arsye në sistem del vetëm një shtetas i regjistruar që është *Ekremi.*

419. **Në datë 21.02.2021, ora 20:20:12 kamera 207, në kabinën nr.4 hyrje R.Sh** ka regjistruar një bisedë midis punonjësit të policisë **Kapllan Dogjani** dhe shtetasve të paraqitur në sportel të identifikuar në sistemin TIMS si shtetasit: *Saimir Seferi* i datëlindjes 18.03.1988 drejtuesi mjetit fugon me targa "AB824AR", *Bledi Seferi* i datëlindjes 30.01.1984 dhe *Sulë Seferi* i datëlindjes 18.04.1976. Sipas bisedës, në fugon këta shtetas kanë pasur rroba. Kapllani Dogjani ju ka thënë të shkojnë te polici për kontroll dhe ju ka mbajtur dokumentet të cilat i ka vendosur midis ekranit të kompjuterit dhe skanerit. Pas dy minutash njëri prej shtetasve, Seferi është kthyer në sportel për të marrë dokumentet dhe në këtë moment Kapllan Dogjani dëgjohet kur i thotë: "***a ke ndonjë "kafe"*** , ***"a ke ndonjë respekt, do të çoj për kontroll poshtë...."***. Gjithashtu dëgjohet shtetasi ti thotë "***për zotin***" dhe "***për kokë të fëmijëve, do të jap unë për allahun e madh***", po nuk konstatohet veprimi i mitëdhënës për shkak të rrezes së kufizuar të filmimeve. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj në të dhënat personale të shtetasit Saimir Seferi nuk rezulton asnjë shënim i kryer nga punonjësi i policisë Kapllan Dogjani nëse ky mjet i është kaluar doganës për procedurën e mallrave që janë konstatuar prej tij me qëllim kryerjen e procedurave të zhdoganimit.

DATA 22.002.2022

420. **Në datë 22.02.2022 ora 08:05** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë i verifikuar në sistem si **Kapllan Dogjani**, i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasve Kosovarë të verifikuar në sistemin TIMS si *Liridon Pajaziti i* dtl. 29.12.1996 dhe *Hajrulla Goza* i dtl.10.04.1991, të cilët janë regjistruar si pasagjerë me automjetin me targa AA619XJ i drejtuar nga shtetasi *Skënder Halil Sadria* i dtl. 07.11.1966. Gjatë bisedës dëgjohet kontrollori Kapllan Dogjani duke i thënë shtetasit, "***..se duhet me e pas vaksinën or ti,...shumë dallavere he na...n. Liridoni?...***",dhe vazhdon duke përpunuar dokumentet dhe duke i thënë se: "***duhet me pas një test, se***" dhe më pas shtetasi Liridoni i zgjat një kartëmonedhë e cila nuk dallohet se çfarë prerje ka. Po kështu në

kabinë kur është zhvilluar kjo bisedë, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, është i pranishëm edhe një punonjës tjetër policie i verifikuar si n/komisar Halim Shehu (përgjegjës turni).

421. **Në datë 22.02.2022 ora 08:09** në kabinën nr.4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet duke kryer shërbim punonjësi i policisë i verifikuar në sistem **Kapllan Dogjani**, i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasit kosovar të verifikuar në sistem si shtetasi *Arton Sejdiu* i dtl. 06.07.1981, me automjetin me targë "01511QQ", ndaj të cilit ushtron presion për të kaluar në vijën e dytë të kontrollit dhe po ashtu dëgjohet që gjatë bisedës ti kërkojë edhe testin Covid të cilin shtetasi nuk e disponon e në përfundim punonjësi merr shumën 5-euro dhe e lejon të vijojë udhëtimin.

422. **Në datë 22.02.2022 ora 09:53** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë inspektor **Arjan Sokoli,** i cili shihet duke përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë. Menjëherë sa merr në dorë pasaportën e një shtetasi, e hap atë dhe i thotë qytetarit: "*...**pse s'ke futur në pasaportë një gjë me e nalë**"* dhe ja kthen pasaportën duke i thënë: " *...**kur të ja fusësh një gjë në mes,...futja një gjë ndërmjet e mos me e pa sistemi hiç..**",* më pas ja kthen pasaportën qytetarit. Ky i fundit ndërkohë e pyet: "*a mos është Zenel Grosha këtej*", Arjan Sokoli i thotë: "*....a Zenel Braha ...Zenel Grosha,.. jo jo nuk është*", dhe më pas qytetari ja jep pasaportën përsëri kontrollorit. Pasi e hap dhe merr kartëmonedhën që duket se është prerje 10 euro, e fut poshtë tastierës së kompjuterit dhe ja kthen përsëri pasaportën pa kryer veprime në sistem për ta regjistruar atë, duke i thënë qytetarit, ".. ***dajë, hajt rrugë të mbarë.....evallah edhe prej jush.***". Arsyeja e marrjes së shumës 10 euro nga punonjësi i policisë është mos regjistrimi i shtetasit dhe mos kryerja e procedurave verifikuese në sistemin TIMS të informacionit.

423. **Po në datë 22.02.2022ora 10:46** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Urim Lami,** i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë të verifikuar nga sistemi me emrat *Sejdi Krasniqi* i dtl. 13.05.1987 si drejtues i mjetit me targë "02968EK" dhe *Behar Bilali* i dtl.10.06.1987 si pasagjer. Sapo merr në dorë pasaportën dhe dokumentet e mjetit dhe është në vazhdim të procesit të përpunimit dokumentar, kontrollori Urim Lami, i thotë qytetarit: "*...**duhet me shku me e marrë ej ...mere në telefon a ka telefon... ça me bë duhet krye me kohë,... a si të kalosh këtu pastaj shko ku të duash, unë jam problemi këtu,....ti çfarë mundësie do?....hajde gjeje ti pra mundësinë, hajde gjejë ti pra mundësinë, qe librezën hë...***",ndërsa qytetari dëgjohet duke i thënë"***....a bën***....?" Ndërsa (kontrollori) Arjan Sokoli i thotë: "*..po hajt pra **s'po ta prishim qejfin mbasi ke qejf ti..., s'po ta prishim..***". Në këtë moment qytetari i zgjat një librezë me ngjyrë të bardhë kontrollorit Urim Lami, ku në palosjen e saj kishte një kartëmonedhë prerje 10 euro të cilën ai e lëshon në tavolinë, duke mos bërë asnjë veprim tjetër me sistemin dhe ja kthen librezën qytetarit, duke i thënë: "*..**qe librezën... hajt pra ecni me kujdes, avash – avash rrugës mos t'u ndalin të tjerët rrugës, hajt pra...***". Arsyeja e marrjes së shumë 10 euro nga punonjësi i policisë është mos regjistrimi i tij dhe mos verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS të informacionit.

424. **Në datë 22.02.2022, ora 10:46** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Urim Lami,** i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasit shqiptar i verifikuar në sistem si *Suart Sinan Domi* i dtl.30.05.2000 i regjistruar me mjetin tip fugon me targë "AA609MX" i cili i jep kontrollorit pasaportën në të cilën kishte futur disa kartëmonedha. Urim Lami pasi e hap dhe hedh kartëmonedhat në tavolinë, e kalon pasaportën në skanim dhe ndërkohë flet shtetasi Suart Domi për një problem dokumenti për mjetin duke i dhënë targën e mjetit "AA 609 MX", për të cilën nuk kishte dokumente për të ja paraqitur. Gjatë këtij momenti shtetasi në sportel i jep kontrollorit shumën 5 euro.

425. **Në datë 22.02.2022 , ora 19:12**, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Urim Lami,** i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasit kosovarë të *Fadil Berisha* i dtl.22.05.1973 dhe *Fahrije Gessner* e dtl.10.03.1975, të regjistruar me automjetin tip fugon me targë "HIEB1910" ku drejtues mjeti është shtetasi Fadil Berisha i cili pasi i jep dokumentet kontrollorit Urim Lami, ai fillon përpunimin e tyre dhe i drejtohet shtetasit, duke i thënë se "***...më ke dhënë shumë dokumente pasaportë Kosove, të Serbisë kartë të Serbisë, mjafton një dokument sepse të gjitha bëjnë..",*** më pas kontrollori Urim Lami i drejtohet shtetasit me emrin, "***...o Fadil, a keni testin kundra Covitit".*** Shtetasi nuk dëgjohet se çfarë përgjigje jep, por shikohet se i jep kontrollorit Urim Lami një dokument me ngjyrë të kuqe në të cilën ai kishte futur një kartëmonedhë që duket se është prerje 20-euro, të cilën e hedh në tavolinë dhe më pas kontrollori i kthen dokumentet shtetasit Fadil Berisha duke i uruar *natën e mirë.*

426. **Në datë 22.02.2022, ora 19:24 min**, në kabinën nr. 4 hyrje R.SH, ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Arjan Sokoli**, i cili është duke përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë të verifikuar në sistem si *Shkodran Sahiti* i dtl.03.03.1999 dhe *Gabriel Derri* i dtl.11.11.1995, të regjistruar me automjetin tip kamion me targë, " VR115EV", ku drejtues mjeti është shtetasi Shkodran Sahiti i cili pasi i jep dokumentet kontrollorit Arjan Sokoli, dhe fillon përpunimin e tyre. Kontrollori ju drejtohet shtetasve se: "***a ke licencë për transport mjetesh dhe autorizim***", te cilët duket se nuk e kanë dhe kontrollori, ju thotë se: "***nuk lejohet me kalu doganën pa licence dhe autorizim.".*** Shtetasi Shkodran është fiksuar teksa i jep kontrollorit një kartëmonedhë, e cila duket si **prerje 20 euro**, për të cilën kontrollori dëgjohet kur ju thotë se: *"ky ishte autorizimi a..??)*. Më pas kontrollori e merr kartëmonedhën dhe e fut poshtë monitorit e në momentin që shtetasit largohen, ai e merr dhe e fut në xhepin e tij.

427. **Në datë 22.02.2022 ora 08:01**, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr.6, është duke kryer shërbim punonjësi i policisë inspektor **Dashnor Braha**, i cili është duke përpunuar dokumentet e dy shtetasve kosovarë, ku njërin prej tyre gjatë bisedës dëgjohet ta thërrasë me emrin *Hajdar Nika.* Po ashtu, punonjësi i policisë Dashnor Braha gjatë verifikimit të dokumentacionit ju kërkon shtetasve që kalojnë në PKK nga dy "doza" kundër Covidit, madje i kthen mbrapsht për të bëre "testin" dhe në vijim kur është vetëm, dëgjohet duke thënë.... "***pa lekë s'ke shanc ti po hë"...,*** duke ju bërë kështu presion shtetasve, pasi testi kushton 20 euro, që

të detyrohen që të paguajnë para tij nga 5-10 euro.

428. **Në orën 12:34 po të datës 22.02.2022**, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6 është duke punuar punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti**. Në orën 12:34:12 futet në kabinën e kontrollorit një person i cili është me një dokument automjeti në dorë, ndërsa kontrollori V.Nerguti është duke biseduar në telefon dhe në përfundim të telefonatës, ai zhvillon ketë bisedë me personin:

Vehbi Nerguti: *pse ke ardhë..?*

Shtetasi: *ke dhe një birrë.*

Vehbi Nerguti: *Çaa...?*

Shtetasi: *një birrë ej..*

Kontrollori i merr dokumentin dhe pasi e hap atë, konstatohet një kartëmonedhë në cepin e saj me prerje **2 (dy) mije lëkë,** të cilën e kishte brenda dokumenteve të mjetit.

Shtetasi i thotë kontrollorit Vehbi Nergutit: Bëje në emër të atij", pasi automjeti që regjistron është mjet pa targa në sistemin TIMS, korrespondon i regjistruar me emrin *Dashmir Arif Vehapaj,* por personi që shfaqet në kabinë me sa duket nga biseda, nuk është Dashamir Vehapaj prandaj është duke bërë regjistrim fiktiv ne emrin e një shtetasi tjetër.

DATA 23.02.2022

429. **Në datë, 23.02.2022, ora 11:19:26** në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, ku është vendosur kamera Nr. 207, kabina nr. 4 hyrje R.SH është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë, **Gezim Duraku** i cili gjatë përpunimit të disa shtetasve nga Maqedonia e Veriut konstatohet që midis dokumentove, njëri prej shtetasve por që nuk mund te identifikohet se cili i ka dhënë një kartëmonedhe të prerjes 10- euro, dokumentuar kjo me fotografi në procesverbalin e këqyrjes. Gjithsej në automjet janë shtatë persona sipas regjistrimit që ka kryer punonjësi i policisë në sistemin TIMS, por drejtuesi i automjetit është shtetasi *Toni Jovchevski* i dtl 21.09.1972, drejtues i automjetit auto veturë me targa, "KP7907AB". Për shkak se shtetasit nuk komunikojnë mirë shqip nuk është bërë e mundur transkriptimi i bisedës, por nga punonjësi i policisë nuk konstatohet ndonjë intervistim në detaje për destinacionin apo nëse janë të pajisur me dokumente vaksinimi ashtu siç kryhet në rastet e tjera.

430. **Në datë 23.02.2022, ora 13:46:43** në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë-Kukës, kabina nr. 4 hyrje R.SH, është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Gezim Duraku** i cili konstatohet duke marrë shumën 5euro nga një shtetas. të cilin gjatë bisedës dëgjohet ta thërrasë me emrin *Paulo*. Nga verifikimi i hyrje daljeve të shtetasve në sistemin TIMS krahasuar me kohën kur ka kryer veprimet punonjësi i policisë Gëzim Duraku, nuk figuron të jetë regjistruar ndonjë shtetas me emrin Paulo duke nxjerrë në pah arsyen e dhënies së shumës 5 euro si më sipër, kundrejt mos regjistrimi në sistem, siç rezulton nga pamjet filmike dhe procesverbali i këqyrjes.

431. **Në datë 23.02.2022, ora16:10:56** në Pikën e Kalimit Kufitar Morine-Kukës, ku është vendosur kamera Nr. 207, është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Iseberi.** Ndërkohe hyn në kabinë edhe kolegu i tij i identifikuar si **Gezim Duraku** (*ndihmës specialist kontrollor po në shërbim në kabinë tjetër*), i cili fillon e numëron një shumë të konsiderueshme

parash të prerjeve të ndryshme. Pasi i numëron i fut në xhep e largohet. Nuk kanë kryer ndonjë bisedë me interes midis tyre.

432. **Më datë 23.02.2022, ora 17:05:13,** në Pikën e Kalimit Kufitar Morine-Kukës, ku është vendosur kamera nr. 207, kabina nr .4 hyrje R.SH është serish duke kryer shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Iseberi,** i cili është fiksuar nga pamjet filmike teksa i merr një shtetasi në sportel shumën 20-të euro pasi ky shtetas nuk dispononte kartonin jeshil të automjetit. Nuk janë kryer veprime regjistruese por verifikuese të dokumentacionit të këtij shtetasi nga ana e punonjësit të policisë në sistemin TIMS të informacionit dhe, për këtë arsye, nuk është bërë e mundur identifikimi i tij.

433. **Po në vijim në datë 23.02.2022, ora 18:25:34** është regjistruar në audio, një rast veprimi në të cilin punonjësi **Arben Kastrati** cili komunikon me kontrollorin që futet në kabinë, ku nga verifikimi rezulton se, është kontrollori **Bedri Duraku.** Këta dy punonjës flasin se i kanë marrë shtetasve nga 10-euro secili për një rast të kalimit në kufi të një skafi. Kontrollori në shërbim **Kastrati Arben,** njëherësh komunikon gjatë përpunimit të dokumentacionit identifikues me një shtetas me emrin **David**. Biseda e zhvilluar në këto momente paraqitet si vijon:

Arben Kastrati:Qati qe pat dy skafat a i more…
Bedri Duraku:Kujt…
Arben Kastrati: *Qati qe kaloj skafat*
Bedri Duraku:Qe kaloj skafet … 10 euro bre
Arben Kastrati:Ja mora edhe unë 10 euro
Bedri Duraku:Atje tek cepi.
Arben Kastrati:Kishte kenë një makinë e atij oficerit e kishte pasë karton të kuq
Bedri Duraku;Dhjetë euroshi… atje te cepi
Arben Kastrati*: Si e kalove a u lodhe (komunikon me shtetas ne sportel), me pas pyet Kontrollorrin ...Fatria a ne kafe a?*
Bedri Duraku*: Se di per zotin.*
Arben Kastrati*: Ça ke çu andej mo?*

Nuk mund të kryhet identifikimi i shtetasit mitëdhënës i cili ka kryer kalimin e skafit në kufi për shkak se punonjësit në bisedën midis tyre nuk përmendin orën se kur e kanë kryer këtë veprim apo ndonjë detaj tjetër në lidhje me shtetasin.

434. **Në datë 23.02.2022 ora 06:26,** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese audio dhe video me nr. 6, është duke punuar punonjësi i policisë **Haqif Halilaj***(identifikuar nga organi procedues nëpërmjet sistemeve Tims dhe Rims)*, i cili dëgjohet të komunikojë me disa shtetas që hyjnë në drejtim të R.Sh-së. Kontrollori Haqif Halilaj dëgjohet tek sa i interviston ata mbi numrin e udhëtarëve dhe destinacionin e tyre në Shqipëri. Pasi kryen intervistimin e tyre, kontrollori nuk kryen asnjë veprim për t'i përpunuar dhe regjistrim në sistem por i lejon të vazhdojnë të hyjnë në RSH. Në pamjet filmike, megjithëse kontrollori nuk bëri regjistrimin në sistem, nuk konstatohet të marrë para, të paktën sa konstatohet nga këqyrja e pamjeve filmike.

435. **Me datë 23.02.2022 në orën 07:56**, në kabinën ku janë instaluar mjetet e përgjimit me nr. 6, është duke punuar punonjësi i policisë kontrollori **Haqif Halilaj**. Në kabinë e kontrollorit është futur dhe një punonjës tjetër policie i cili nga uniforma e policisë që mban veshur, duket se është me gradën N/Komisar, i cili përkon me gradën e përgjegjësit të turnit. **Nga regjistrimi audio i këtij momenti dëgjohet se zhvillohet një bisedë, midis kontrollorit dhe punonjësit të policisë me gradën N/Komisar, me këtë përmbajtje:**

N/Komisari: *A s'të tha gjë, për ju të dyve pramë ai, për atë... për grupin ...**4 (katër) grupe nga 70 euro, 280 euro..... promë 170,.....20 mijë lekë,** tha...(më pas ka fjalë që nuk kuptohen mirë).*

Haqif Halilaj:*Aaa.....Halimi...(disa fjalë që nuk kuptohen)...**A do ti marri komandanti ...a do ti marri.***

N/Komisari: *-(fillimisht flet fjalë që nuk dëgjohet mirë dhe pastaj vazhdon që-**...250 euro i kam unë.***

Haqif Halilaj: ***Po pse, pak janë aaa...!***

N/Komisari: ***220 do Halimi ...***

Haqif Halilaj: ***Nga 40 (katër dhjete) lekë...ja dhashë tashti...pyete, a do ti majë komandanti, a s'do ti majë ...tashi i dhashë.***

N/Komisari: *Mirë, ti i dhe katërdhjetë (40)...*

Haqif Halilaj: *Po kallzoj (fjala është për komandantin) që unë i kam dhënë...*

N/Komisari:-- *Pasi mbaron bisedën largohet nga Kabina...*--

436. **Me datë 23.02.2022, në orën 07:41:09,** konstatohet që gjatë kohës që është duke punuar kontrollori **Haqif Halilaj** është futur një person me uniformë (punonjës policie) me gradën N/Komisar, ku në vijim biseda vazhdon:

Haqif Halilaj: *Ej, po Arjani, kishte maru punë, ne akshm promë ....promë ëëë...*

N/Komisari: *Po bre, po ...Promë...*

Haqif Halilaj:: ***Jo bre, se kaloi ai Nexhi...katër i kish marrë*** *(duke treguar dhe katër gishta të dorës së djathtë)* ***katërdhjetë mij lekë...Nexhit... ai (Arjani) i kish marrë katërdhjetë mij lekë...Nexhit me furgon...Ej shi se me që është ky ketu... Ylberi se s'vej mo, për ç'et muje, ti dajme dhe ato të SHKB-së ...atje poshtë ...Ti heqim dhe ato qafe...Qysh thu ti ? ... se bën vaki... se s'kena datë tjeter ...se data 23 është sat... 28 ka muaji, qysh thu ?***

N/Komisari: *Po a'ngjon ky, a jo!.*

Haqif Halilaj: *Po ket e vendosin na, or ti....A ti dha lekët, a jo...*

N/Komisari: *Gjysma lekë, gjysma euro....*

Haqif Halilaj: *Ok... pra që ti ndajmë....Na për ti dhënë i kena.*

N/Komisari: *Sa kemi për të dhënë... nga njëqind ëëë.....*

Haqif Halilaj: ***100 (njëqind) si grup***

N/Komisari: *Ani, ani ...**250 euro i kam unë...***

Haqif Halilaj: *Po mirë...*

437. **Me datë 23.02.2022 në orën 06:12:05** në kabinën që janë instaluar mjetet e përgjimit me nr.6 dhe ku është duke punuar kontrollori **Haqif Halilaj**. Në kabinë hyn një person me uniformë

policie dhe me gradën e N/Komisarit, i cili sipas të dhënave të referuara në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike, evidentohet se flet me dialekt jugor, dhe sapo futet brenda, zhvillon këtë bisedë:

N/Komisari: Ku kishte qenë "shqipoja" (fjala është për punonjësit e "shqipojave" të DVP Kukës)....

Haqif Halilaj: *Sa kalon Abedin Oruçin....*

N/Komisari: *Aha.. ai o...,po qe kthyer në Rinas (kështu dëgjohet që i thotë N/Komisari. kontrollorit)*

Haqif Halilaj: *Po ç'aty kishin qënë, tha... e pashë që nuk e nalën, tha...nejta, nja dy minuta tek Abedin Oruçi, tha dhe e pashë që kaloi dhe u ktheva....*

N/Komisari: *Me një fjalë, ata se ndalën...*

Haqif Halilaj: *Jo....Tre herë kanë shkuar more, me marrë një....*

N/Komisari: *Sot....*

Haqif Halilaj: *Po ore ...A shkoj një herë në darkë në orën nëntë,* ***me at Matoshin ...promë, me Shehin,*** *dy ...tash në mëngjes, tre...tre herë...* ***do me ja lënë nja 20 Euro****...Ja lomë pas darke, ma vonë...Ej nuk është djali i keq, ai...Nuk është djali keq...*

438. **Në datën 23.02.2022,ora 13:15:00, këqyrja e kameras nr.7,** në sportel, paraqitet një shtetas të cilit i jep kontrollorit në shërbim **Gëzim Duraku** tre karta identiteti. Kontrollori pasi i merr ato i thotë: *"lejen e qarkullimit ..po ma jep... ".*Pasi merr kartat dhe i vendos në tavoline dhe pret deri sa shtetasi ti japë "lejen e qarkullimit". Dokumentet e dhëna nga shtetasi në sportel kontrollori i shikon pak dhe ja jep përsëri atij duke i thënë që "*hec ik".*

439. **Në datë 23.02.2022 në orën 13:18:31** në sportelin e kabinës, ku janë instaluar mjetet përgjuese me nr.7 është paraqitur një shtetas kosovar dhe i jep kontrollorit **Gëzim Duraku** për të përpunuar dokumentet identifikues, kartën e identitetit dhe dokumentet e makinës se tij. Sipas bisedës së zhvilluar mes tyre, rezulton se në këmbim të tolerimit për certifikatat e vaksinave, punonjësi i policisë Gëzim Duraku i merr drejtuesit të mjetit një shumë në euro e cila nuk mund të përcaktohet nga pamjet filmike. Referuar orarit të veprimeve dhe bisedave dyshohet se bëhet fjalë për shtetasin *Dardan Aliu* i cili ka udhëtuar me automjetin me targë 05877 EO, nëpërmjet PKK Morinë, përpunuar nga punonjësi i policisë Gëzim Duraku (*ora e përpunimit 13:18:00*).

440. **Në datë 23.02.2022 në orën 13:22:38,** në sportelin ku është duke punuar punonjësi i policisë **Gëzim Duraku**, ky i fundit konstatohet të marrë një shumë në euro për lejimin e një mjeti me rimorkio i cili nuk kishte dokumentacionin e duhur me vete. Në këtë rast kontrollori Gëzim Duraku ka konstatuar një mangësi në dokumentacionin e rimorkios së mjetit që po përpunon, duke i thënë drejtuesit që *do të kthehesh pasi nuk lejohet*. Në këtë moment drejtuesi i ofron kontrollorit ryshfet kjo e konstatuar nga ndërveprimi mes tyre dhe nga biseda e bërë, e më pas kontrollori vazhdon me lejimin e hyrjes në RSH të mjetit dhe rimorkios së saj. Nuk ka rezultuar e mundur të evidentohet shuma e kërkuar apo e dhënë, nga pamjet filmike që lidhen me këtë ngjarje.

441. **Në orën 15:19:00 të datës 23.02.2022**, në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe që janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7 (në sportel)

paraqitet një shtetas i cili i jep kontrollorit Gëzim Duraku dokumentet identifikues dhe më pas librezën e mjetit. Kontrollori Gëzim Duraku, pasi merr librezën e mjetit e hap atë dhe prej saj nxjerr një kartëmonedhë të cilën e vendos poshtë tastierës se kompjuterit dhe i jep dokumentet shtetasit duke i thënë ***"hec...hec..hec hec.. gou"***. Shtetasi largohet, por nuk regjistrohet në sistem. Kartëmonedha që ka marrë Gëzim Duraku nga shtetasi i paraqitur në sportel, është e ngjashme me atë të 2000 lekë, sipas pamjeve filmike.

442. **Në orën 15:27:00 të datës 23.02.2022**, në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe që janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7 (në sportel), konstatohet marrja e shumës prej 10 euro prej kontrollorit, në këmbim të tolerimit të shtetasit i cili ka mungesë dokumentacioni të udhëtimit (vërtetim vaksinash).

443. **Në orën 16:08:00 min të datës 23.02.2022**, në kabinën ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7, kontrollori **Gëzim Duraku** gjatë përpunimit në sistem të një shtetasi i paraqitur në kabinë me automjetin e tij, merr një sasi parash, të cilat janë futur nga shoferi mes dokumenteve të paraqitura. Sipas pamjeve filmike, të dokumentuara edhe në procesverbalin e këqyrjes, kontrollori, pasi hedh në sistem të dhënat e shtetasit i cili i ka dhënë kartën e identitetit kosovare, hap librezën e mjetit dhe nxjerr prej saj një kartëmonedhë por që nuk dallohet mire lloji dhe shuma, dhe e fut në xhep dhe më pas lejon hyrjen në Republikën e Shqipërisë, duke përshëndetur shtetasin në fjalë.

444. **Në orën 17:34:00, të datës 23.02.2022**, në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7, gjatë përpunimit të shtetasi *Betim Sinani*, shtetas kosovar i datëlindjes 26.02.1993 që ka mjetin tip veture, me targe 01201PO, në këmbim të lejimit të hyrjes në RSH pa test covidi, sipas bisedës, i ***merr një kartëmonedhë në euro***.

445. **Në orën 17:50:16 të datës 23.02.2022,** në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7, janë fiksuar momente ku gjatë përpunimit të shtetasve kosovarë *Fatlind Morina* i dtl 24.11.1995 dhe *Mybegjel Rashica* i dtl 19.03.1995 të cilët udhëtojnë me mjetin me targë AA894ZE, u merr një shumë në euro të vendosur në lejen e qarkullimit të mjetit.

446. **Në orën 17:45:39 të datës 23.02.2022,** në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe që janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7, në këtë moment, gjatë komunikimit me një shtetas kundrejt mos regjistrimit në sistem të dokumentacionit, merr nga drejtuesi i mjetit shumën 5 euro.

447. **Në orën 17:47:00 të datës 23.02.2022,** punonjësi i policisë **Gezim Duraku** duke qenë ne vendin e punës (në kabinë), shihet teksa nxjerr nga xhepi disa kartëmonedha të prerjeve të ndryshme të cilat pasi i sistemon dhe i ndan sipas prerjeve, i palos dhe i fut përsëri në xhepin e pantallonave. Pasi përfundon këto veprime, del nga kabina.

448. **Në orën 17:54:57 të datës 23.02.2022**, në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr.7, është fiksuar nga pamjet filmike rasti ku kontrollori Gëzim Duraku merr shumën 10 euro. Konkretisht në këto momente kontrollori po kryen përpunimin e një mjeti dhe personave në të, shihet teksa i kthen

drejtuesit lejen e qarkullimit, veprim ky i kryer në mënyrë të përsëritur si në rastet e mëparshme. Në moment drejtuesi i mjetit, pasi merr lejen e qarkullimit, ja kthen përsëri kontrollorit dhe vizualisht shikohet që kontrollori Gezim Duraku pasi e hap dokumentin, nxjerr prej tij një kartëmonedhë të prerjes 10 euro, të cilën e merr dhe e vendos përballë aparatit të skanimit. Më pas Gëzimi, merr dokumentet dhe ja jep shtetasit pas pak çastesh, pasi shtetasi largohet, Gëzimi merr kartëmonedhën prej 10 eurosh dhe e fut në xhep e majtë të xhupit të tij. Rezulton se në orën 17:54:00 të datës 23.02.2022 është regjistruar ne sistemin TIMS shtetasi kosovar *Erolind Muqja* me automjetin me targë 01389PI që drejton vetë, veprimet të kryera nga kontrollori Gëzim Duraku në sistemin TIMS.

449. **Në orën 17:57:57 të datës 23.02.2022**, në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku** dhe janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr. 7 është dokumentuar një moment ku kontrollori kryen lëvizje dyshuese të marrjes së një shume parash. Konkretisht në këtë orar paraqitet një shtetas i cili i jep kontrollorit Gëzim Duraku dokumentet identifikuese dhe të mjetit. Kontrollori Gëzim Duraku, para se të marrë dokumentet, merr diçka me dorën e djathtë dhe e fut ne xhepin e djathtë të xhupit dhe më pas me dorën e majtë merr nga shtetasi dokumentet identifikues, të cilët pasi i shikon ato, ja kthen përsëri shtetasit, duke i thënë "***merri...ec... rrugë të mbarë***".

450. **Në orën 17:58:02 të datës 23.02.2022**, nga pamjet filmike është fiksuar një rast ku kontrollori **Gëzim Duraku** merr në mënyrë një kartëmonedhë të prerjes 5 euro. Konkretisht në këtë orar në sportelin ku është duke punuar **Gëzim Duraku**, paraqitet një shtetas tjetër i cili i jep kontrollorit për regjistrim pasaportën. Kontrollori pasi e merr, nxjerr prej saj një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe e fut në xhep, më pas vazhdon me veprimet në sistem. Pasi e regjistron shtetasin, i jep dokumentet, duke i thënë: "***Merri...ec...***". Pas pak çastesh, pasi ka ikur shtetasi nga sporteli, kontrollori fut dorën në xhepin e djathtë të xhupit dhe nxjerrë prej tij disa kartëmonedha. të cilat pasi i palos, i numëron dhe i sistemon, nxjerr portofolin dhe i vendos aty. Më pas, pasi sistemon kartëmonedhat e nxjerra nga xhepi i djathtë, fut dorën në xhepin e majtë të tij dhe prej andej nxjerr dy kartëmonedha eurosh të cilat i palos, një kartëmonedhë 50 euro dhe një kartëmonedhë 10 euro, të cilat i vendos në një portofol të zi me zinxhir.

451. **Në orën 18:00 të datës 23.02.2022,** është fiksuar nga pamjet filmike rasti i marrjes nga kontrollori **Gëzim Duraku**, të shumës 500 lekë. Konkretisht në këtë orar në sportel paraqitet shtetasi *Orest Behar Halili*, me automjetin auto veturë me targë AB 361 EV, i cili i jep për tu regjistruar kontrollorit në kabinë disa dokumente. Gjatë verifikimit të tyre, në një dokument i cili është i palosur, pasi e hap nxjerr prej saj një kartëmonedhë të ngjashme me atë të 500 lekëshit të cilën e lëshon në tavolinë dhe e shtyn me dorë për ta fshehur tek aparati i skanimi. Pasi hedh të dhënat në sistem, merr pasaportën dhe dokumentin ku ishin vendosur paratë dhe ja jep shtetasit në sportel. Më pas, me dorën e majtë merr kartëmonedhën qe la tek aparati i skanimit dhe e fut ne xhep. Është bërë kryerja e sistemin TIMS në rubrikën hyrje shtetas të huaj nga ku rezulton se në orën 18:01:11 të datës 23.02.2022 është regjistruar në sistem shtetasi shqiptar *Orest Behar Halili*, i datëlindjes 04.12.1995 dhe veprimet në sistem janë kryer nga punonjësi i policisë Gëzim Duraku.

452. **Në orën 18: 04 të datës 23.02.2022,** nga pamjet filmike rezulton rasti i marrjes së një shume parash nga një drejtues mjeti, ku në bisedën mes tyre kontrollori i shprehet ndër të tjera me fjalët : "***një kafe, na e qet, ëëë...***". Konkretisht në sportel paraqitet shtetasi kosovar *Eruoland Hodaj,* i datëlindjes 21.02.2003 që udhëton me automjetin tip auto veturë me targë 04115 HT i drejtuar prej tij. Kontrollori **Gezim Duraku**, gjatë intervistimit dhe kontrollit të dokumenteve ndër të tjera i merr dokumentet i vendos në tavolinën e punës dhe prej tyre ne fillim merr dokumentin që ngjan si libreze.

453. **Në orën 18:16:27 të datës 23.02.2022,** në sportelin ku janë instaluar pajisjet përgjuese audio dhe video me nr. 7, është duke punuar **Gezim Duraku.** Nga pamjet filmike është fiksuar një rast i marrjes prej tij të shumës 50 euro, pasi drejtuesi i mjetit nuk ka autorizim për mjetin që drejton. Konkretisht në kabinë paraqitet shtetasi kosovar *Artan Gashi* i dtl 22.06.1997 i cili udhëtonte me automjetin auto veturë me targë AA 341 NJ. Pasi i jep dokumentet e mjetit, kontrollori Gëzim Duraku e pyet për autorizimin mjetit të cilin ai nuk e ka. Në këtë moment kontrollori i thotë: ***Gëzimi***: ***Hajde një herë nga një kafe një herë...hajde na qit nga një kafe një herë nga një birre një here...Futi ç'tu (dhe i jep librezën e mjetit)...Hajde një herë...hajde një herë...***

Shtetasi *:Do një birrë ?*

Gezimi*: Po or ti!*

Shtetasi*: Se pi birrën une, or ti...*

Gezimi*:Vere ç'e ktu dhe i drejton librezën e mjeti.*

Shtetasi*: Merr librezën dhe i fut një katmonedhe dhe ja jep përsëri kontrollorit (bisedon diçka me të (kontrollorin) por nuk dëgjohet mire.*

Sipas pamjeve filmike, kontrollori Gëzim Duraku pasi merr dokumentin nga shtetasi e hap atë dhe prej saj nxjerr një kartëmonedhën 50 euro dhe e vendos atë përpara aparatit të skanimit të dokumenteve dhe i thotë shtetasit në sportel:

Gëzim Duraku*:...Ej, a i dhe me qef, apo jo? ...se ma dhe si me nerva ai (qesh)...*

Pas këtyre fjalëve i jep dokumente shtetasit, merr kartëmonedhën që e ka lënë aty 50 euro dhe e fut në xhepin e djathtë të xhupit.

454. **Në orën 13:15 datë 23.02.2022,** gjatë këqyrjes së kameras nr. 206, në këtë orar evidentohet një rast marrjes nga kontrollori **Gëzim Duraku** të një shumë parash. Konkretisht nga pamjet filmike rezulton se në sportel paraqitet një shtetas të cilit i jep kontrollorit tre karta identiteti. Kontrollori pasi merr kartat i drejtohet me fjalët "*...**lejen e qarkullimit...po ma jep...***", më pas merr kartat dhe i vendos në tavolinë, deri sa shtetasi ti japë "lejen e qarkullimit" të kërkuar. I shikon dokumentet pak dhe ja jep përsëri shtetasit duke i thënë që ***"hec, ik***". Nga kamerat është fiksuar që kontrollori Gëzim Duraku nuk i regjistron këta shtetas në kompjuter në sistemin TIMS.

455. **Në orën 18:56 min të datës 23.02.2022,** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, në sportel dallohet të paraqiten dokumente identifikimi të shtetasve të tjerë. Në kabinën nr.4 është duke punuar punonjësi i policisë **Gëzim Duraku** dhe dëgjohet të zhvillojë bisedë me shtetasin, të cilin e thërret me emrin *Leonit.*

Gëzim Duraku: *O Labinot. A i ke vaksinat?.*
Shtetasi: *Po*
Gëzim Duraku: *Autorizim për makinën?*
Shtetasi: *Po*
Gëzim Duraku: *Po, po*
Shtetasi:*Ok*
Gëzim Duraku: *Në rregull...edhe atij i ka mbaru regjistrimi....a e ka?*
Shtetasi: *E ka...*
Gëzim Duraku: *Ku e ka?...S'lejohet me dokument të mbarum, s'lejohet...nuk i merr sistemi...ku do shkoni?...*
Shtetasi: *....(nuk kuptohen fjalet).....*
Gëzim Duraku:*....qite kerrin atj edhe hajde ketu...*
Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes, në kohën që zhvillohet kjo bisedë, i mban dokumentet dhe i kalon nga ana tjetër e tavolinës ndërsa shtetasi hyn nga dera e kabinës dhe në këtë kohë **Gëzim Duraku** i jep dokumentet ndërsa ai dallohet t'i japë diçka, ku ky i fundit e fut në xhep, por nuk mund të përcaktohet prerja e kartëmonedhës. Shtetasit nuk gjenden të regjistruar në sistem por nga biseda kuptohet që favorizimi i bërë ndaj tyre është se janë lejuar të udhëtojnë me karta identiteti të cilave iu ka përfunduar afati i vlefshmërisë. Sipas pamjeve filmike, ndërkohë që ndodhin veprimet si më sipër, prezent në kabinën e shërbimit është një tjetër punonjës policie. Pasi përfundojnë veprimet si më sipër Gëzim Duraku dëgjohet ti drejtohet qytetarit me fjalët: ***"....Njatjeta hajt, here tjetër e di vete...".*** Punonjësi i policisë i cili gjendet brenda në kabinë, sipas pamjeve filmike mban numrin identifikues **"05583"** që i përket punonjësit **Arben Kastrati** me detyrë Kontrollor në P.K.K Morinë. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj rezulton se punonjësi i policisë **Gezim Duraku** në orën 18:55 min të ketë përpunuar dokumentin e shtetasit *Leonit Lulzim Hoxha* i dtl 27.11.1995, i cili udhëtonte me automjetin auto veturë me targa, 04272HT, ndërsa pasagjerët me të nuk i ka regjistruar. Me vonë punonjësi i policisë Gëzim Duraku shfaqet në një moment që fut dorën në xhep dhe numëron euro të cilat i nxjerr nga xhepi.

456. **Në orën 18:38 të datës 23.02.2022** min, në kabinën nr. 4 ku është instaluar pajisja përgjuese nr 7 është duke përpunuar pasagjerë punonjësi i policisë **Arben Kastrati**. Në këtë kohë konstatohet të përpunojë dokumentin pasaportë shqiptare e cila, sipas verifikimit në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas shqiptare, i përket shtetasit *Fatjon Fatmir Halilaj* i dtl 03.05.1997 i cili udhëton me automjetin auto veturë me targa "AB615CE". Punonjësi i policisë **Arben Kastrati** dëgjohet që ti thotë : ***"Kujtova se je vet i trete ti",*** ndërsa shtetasi në sportel i përgjigjet: ***"Jo mo vëlla tek pullë".*** Nga pamjet filmike rezulton që të përpunoje dy dokumente, një kartë identiteti shqiptare e cila korrespondon me shtetasin Fatjon Halilaj dhe një pasaportë e huaj, ku sipas verifikimit në sistem korrespondon me gjeneralitetet e shtetasit *Bekim Hajdin Hajdini* i dtl 02.02.1975 i cili udhëton me automjetin auto veturë me targa, "EBEDL75", ndërkohë që nga biseda e zhvilluar shtetasi Fatjon Halilaj i përgjigjet se është i vetëm dhe për pasojë, regjistrimi i pasaportës së shtetasit Bekim Hajdini ka dyshime se mund të jetë fiktiv, pra

në mungesë të vetë këtij shtetasi në këtë moment në Pikën e Kalimit Kufitar, Po ashtu gjatë bisedës mes tyre dëgjohet të bisedojnë për tejkalim ditësh qëndrimi ku punonjësi i thotë duhen 90 ditë këtej dhe 90 ditë andej. Pasi përfundon veprimet konstatohet se punonjësi Arben Kastrati zgjat dorën në sportel merr një kartëmonedhë në dukje 50 euro dhe e fut menjëherë në xhep.

457. **Në orën 21:28 min, po të datës 23.02.2022** në kabinën nr.4 ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7, është duke punuar punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti**, konstatohet se merr për verifikim dy karta identiteti të ngjashme me ato kosovare. Nuk është bërë e mundur të transkriptohet biseda audio midis tij dhe shtetasit për shkak të shkëputjes së audios. Nga pamjet filmike duket se punonjësi i policisë Vehbi Nerguti, **në prezencë të punonjësit të policisë Namik Mata,** i cili mban numrin identifikues ***"06912"*** i jep lejen e qarkullimit mbrapsht shtetasit dhe kur shtetasi ja rikthen brenda saj konstatohet të jetë një 5 euro të cilën punonjësi e hedh mbi tavoline.

458. **Në orën 21:29 po të datës 23.02.2022,** punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti** është duke përpunuar një dokument kartë identiteti dhe menjëherë më pas ja jep punonjësit që priste brenda në kabinë **Namik Mata** i cili largohet me kartën të në dorë.

459. **Në orën 20:20 të datës 23.03.2022** në sportel paraqet dokumentet një shtetas. Dokumentet duken të huaja dhe punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti** pasi i hap nxjerr prej tyre një kartëmonedhë të mbledhur me ngjyrë në dukje si 5-euro të cilat i vendos para pajisjes skaner. Pasi përpunon dokumentin e shtetasit, i tërheq me dorë drejt vetes. Nuk ka biseda të zhvilluara midis atij dhe shtetasit. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj e po ashtu hyrje shtetas shqiptare, rezulton se në intervalin kohor 20:20 min deri në orën 20:22 min, nga punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti** si ka përpunuar vetëm dokumentin e shtetasit shqiptar *Xhevdet Tahir Morina* i dtl 29.12.1967, drejtues i automjetit.

460. **Në orën 20:34 po të së njëjtës datë 23.02.2022,** në kabinën nr.4 hyrje R.SH, punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti** konstatohet të marrë nga sporteli dokumentet e identifikimit të dy shtetasve kosovarë. Gjatë bisedës dëgjohet se shtetasve *ju mungojnë testet kundër Covid-19*, për këtë arsye konstatohet që ti lenë sipër tavolinës punonjësit të policisë 5-euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika hyrje shtetas të huaj në datë 23.02.2022 ora 20:34 deri në orën 20:35, janë përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë *Tringa Gorcaj* e dtl 12.11.2002, drejtuese e automjetit auto veturë me targa "01258GQ" dhe *Nezit Hamiti* i dtl 17.07.2002. Ndërkohe që zhvillohet kjo ngjarje në kabinën konstatohet se është prezent edhe punonjësi i policisë Urim Lami.

DATË 24.02.2022

461. **Në pamjet filmike të administruara në kamerën 207, në orën 10:35:00 datë 24.02.2022**, është fiksuar kontrollori **Fatri Braha** i cili në mungesë të dokumentacionit për testin covid, i merr shtetasit kosovar *Ahmet Berisha* shumen prej **5 euro**. Dinamika e rastit , sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio, zhvillohet si më poshtë: Pasi në kabinën në hyrje të RSH paraqitet shtetasi kosovar me automjet, mes tij dhe kontrollorit zhvillohet kjo bisedë:

Fatri Braha: *Makina e kuja o? Vaksina ai i ki me vete?*

Personi: *Para pesë ditsh e ka kartelën ...*
Fatri Braha: Nji e ke bo po duhet me bo tjetrën!
Fatri Braha: *Kur do iksh vlla, qi tash o ora dhjet e gjys!* ***hape krahin te sheshi mrapa i thuj, hape krahin diku para dhe hajde ktu!***
Pas kësaj personi largohet me mjetin e tij ndërkohë që kontrollori Fatri Braha është në kabinë dhe dokumentet i ka në dorë dhe i kalon nga krahu i djathtë i tij në tavolinë.
462. **Në pamjet e administruara në kamerën 207, ora 10:39:00 datë 24.02.2022**, është fiksuar kontrollori **Fatri Braha** i pasi diskuton me shtetasit në sportel mbi mungesën e dokumentacionit mbi testin covid, i merr shtetasit kosovar *Astrit Dragusha* shumën prej 10 euro.
463. **Në vijin, në pamjet e administruara në kamerën 207, ora 10:47:10 datë 24.02.2022**, në këtë orar pamjet e kamerës kanë fiksuar kontrollorin **Fatri Braha** i cili për të njëjtat srsye si në rastin më sipër, i merr shtetasit kosovar *Liman Qenaj* shumen prej 20 euro. Konkretisht kamerat kanë fiksuar teksa në orën **10.**51.35 në kabinën e kontrollorit Fatri Braha hyn shtetasi kosovar Liman Qemaj, i cili pas një dialogu me punonjësin e policisë, i hedh në tavolinë, në krahun e djathtë të kompjuterit një kartëmonedhe prerje 20 euro, të cilën kontrollori e merr me dorën e djathtë dhe e vendos para aparatit skanerit në krahun e tij të majtë, e më pas poshtë tastierës së kompjuterit. Orari i këtij veprimi 10.51.46 deri 10.51.52. Pas verifikimeve në sistemin TIMS, rezulton se në këtë orar janë përpunuar shtetasit kosovarë *Alfred Hoti* pasagjer dhe *Liman Qenaj* shofer.
464. **Në pamjet e administruara në kamerën 207, konstatohet se në orën 11.29.47**, pamjet e kamerës kanë fiksuar kontrollorin **Fatri Braha** i cili në këmbim të shkeljes mungesës së konstatuar mbi dokumentacionin për testin covid, i merr shtetasit kosovar *Mark Gojani* shumën prej 5 euro.
465. **Nga këqyrja kamera 207 në datë 24.02.2022 në orën 09:51**, pamjet e kamerës kanë fiksuar kontrollorin **Fatri Braha** i cili në këmbim të mangësive të konstatuara për dokumentacionin autorizim mjeti, i merr shtetasit kosovar *Artan Dobroshi* shumën prej 5 euro.
466. **Në orën 09.58.00, datë 24.02.2022** kontrollori **Fatri Braha** është duke përpunuar një mjet tjetër ku drejtuesi i jep dokumentet dhe vërehet se janë dy karta identiteti dhe disa letra.Në bisedë kontrollori e pyet për personin tjetër sipas kartës Id, duke ju drejtuar me fjalët:
Fatri Braha: *Vaksinat, qysh i keni?*
Fatri Braha: ***Qysh me ja bo ?*** *Kush ësht ky?...Degjove!?....* ***veç po ta....Hajt tu rrit nera...***
Sipas pamjeve filmike, ndërsa zhvillohet ky komunikim, kontrollori Fatri Braha zgjat dorën nga sporteli dhe merr një letër të palosur, të cilin kur e hap në mes të saj është një kartëmonedhë me ngjyrë rozë në kafe, prerje 10 euro. Pasi e merr me dorën e djathtë e hedh kartëmonedhën para aparatit skaner, i mbledh dokumentet dhe ja jep personi që është në automjet, i cili largohet në drejtim të RSH. Nga verifikimi i sistemit TIMS me orarin e fiksuar në kamera 09.58.00, kohë që kontrollori skanon dhe regjistron karta ID konstatohet se nga ana e kontrollorit Fatri Braha janë përpunuar dy shtetas në të njëjtën veturë dhe konkretisht shtetasit *Arlind Jashari* shofer dhe *Jon Haliti* pasagjer. Pas këtyre momenteve, në orën 09.59.57, kontrollori Fatri Braha zgjat të dyja duart drejt kartëmonedhave që ndodhen në tavolinë, dorën e djathtë drejt kartëmonedhës 5 euro

dhe dorën e majtë drejt kartëmonedhës me ngjyrë rozë në të kafe në dukje prerje 10 euro, dhe u fut diku në trup.

467. **Nga këqyrja e kamerës 207 dt 24.02.2022 rezulton në ora 10.16** kontrollori **Fatri Braha**, merr në mënyrë të paligjshme shumën 50 euro, nga shtetasi kosovar *Edi Desku* që ka mungesë të dokumentacionit, apo nuk bën regjistrim në sistem të pasagjerit. Konkretisht kontrollori fillon përpunimin e një automjeti të paraqitur në sportel, duke marrë dokumentet, dhe e fillon me skanimin e pasaportës. Gjatë kësaj kohe kontrollori e pyet; Kontrollori Fatri Braha: *Po vaksinat, apo vari lesht, nji autorizim, mi bjer ti shof!* Kontrollori:...*dhe at shokun a?* Ndërkohë që kontrollori i jep pasaportën dhe disa letra shoferit, merr mbrapsht përsëri një pasaportë të cilën e vendos para tastierës dhe e hap me kujdes, nga ajo nxjerr një kartëmonedhë 50 euro dhe e merr e vendos para skanerit, ndërkohë ja jep përsëri pasaportën shoferit dhe e falënderon ndërkohë që kartëmonedha është në tavolinë, para skanerit e palosur në dysh, me ngjyrë rozë të hapur. Pak çaste më vonë e merr dhe e fut në xhep. Ky rast, referuar komunikimit dhe dinamikës së veprimeve të pasqyruara në pamjet filmike, duke se ka lidhje me mos regjistrim në sistem për personin që shoferi ka në automjet, ku për këtë arsye i ka dhënë punonjësit të policisë Fatri Braha shumën 50 euro. Konstatohet që kontrollori skanon dhe regjistron vetëm një pasaportë, ndërkohë që e pyet shoferin ***"po at shokun",*** duke u kuptuar se bashkë me të udhëton edhe një person tjetër i cili nuk rezulton të jetë regjistruar.

468. **Nga këqyrja e pamjeve të kamerës nr.207 data 24.02.2022,** në orën 11.49.30, në sportelin e kabinës të kontrollorit **Fatri Braha**, paraqitet një makinë ku drejtuesi i mjeti *Agron Frrokaj* sipas komunikimit të zhvilluar, ka mungesë të dokumentacionit dhe shihet se i jep kontrollorit Fatri Braha shumën 50 euro.

469. **Nga këqyrja e pamjeve të kamerës nr.207 datë 24.02.2022 ora 12.26.50,** kontrollori **Fatri Braha** është në kabinë para kompjuterit dhe në këtë moment i vjen një automjet ngjyrë e bardhë dhe shoferi kosovar *Armend Ramizi* duke qënë në mungesë të vërtetim vaksinave, i jep shumën prej 10 euro.

470. **Nga këqyrja e kamerës nr. 207 datë 24.02.2022, në orën 09.26.15**, në sportel paraqitet një mjet, ku drejtuesi *Bl* **Nga këqyrja e pamjeve të kamerës** *erim Deliu* konstatohet se i jep kontrollorit **Dashnor Braha** në këmbim të lejimit të hyrjes në RSH me mungesë të dokumentacionit (autorizim për mjetin), një kartëmonedhë.

471. **Në vijim këqyrja e pamjeve të kamerës nr.207 datë 24.02.2022 ora 09.34.50**, në sportel është me shërbim kontrollori **Dashnor Braha**, i cili merr në mënyrë dy kartëmonedha prej 20 euro nga dy shtetas kosovarë të cilët kanë mungesa në dokumentacion.

DATA 25.02.2022

472. **Nga këqyrja e kamerës 207, datë 25.02.2022, ora 20.37.45**, në sportelin e kabinës së kontrollorit **Dashnor Braha** paraqitet një mjet me drejtues shtetasin *Dren Peja*, i cili paraqet dokumentet dhe kontrollori fillon bën verifikimin. Gjatë këtij procesi mes tyre zhvillohet edhe biseda si më poshtë:

Dashnor Braha :Ideal Shala, kush është pronari tjetër? Emër kompanie? Ky thotë Ideal Shala?...po bjerma dokumentin pak!
Ndërkohë sipas pamjeve filmike shihet që zgjat dorën dhe merr një letër të palosur dhe fillon ta hapë ndërsa në kabinë futet dhe një punonjës policie me uniformë roli bazë, inspektor.
Personi: Kqyre a ka boll?
Dashnor Braha: *- i përgjigjet por nuk kuptohet- ...*
Në këtë moment, pasi ka hapur letrën merr në brendësi të saj një kartëmonedhë 10 euro dhe e hedh para skanerit, vazhdon me kontrollin e dokumenteve. **Kjo ngjarje zhvillohet në prezencë dhe të punonjësit tjetër të policisë.** Më pas kontrollori Dashnor Braha e merr kartëmonedhën 10 euro bashkë me kartën ID që është në tavolinë dhe bën lëvizje me duar në pjesën që nuk shikohet nga kamera dhe i jep dokumentet drejtuesit të mjetit, i cili vazhdon udhëtimin.
473. **Më datë 25.02.2022 ora 20.43.45**, në kabinën e kontrollorit **Dashnor Braha,** janë dhe dy punonjës të tjerë duke biseduar me njeri tjetrin. Në këtë kohë vjen një automjet, ku drejtuesi i mjetit shtetasi kosovar *Elmirion Redzepi* i jep dokumentet kontrollorit. Në momentin që kontrollori merr dokumentet ku duken një kartë ID dhe leja qarkullimit, shihen në pamjet filmike duart e kontrollorit i cili veçon mes dokumenteve një kartëmonedhë e prerjes 5 euro, dhe me shpejtësi e hedh para skanerit dhe pas kësaj vendos kartën në skaner për regjistrimin në sistem. Nga biseda rezulton se shoferi është me mjet që ka mallra të cilat po i kalon. Nga veprimi më lart rezulton se ka paguar 10 euro që mos ndalohet për kontroll dhe nga bisedat duket se ai ka njohje me punonjësit e policisë.
474. **Më datë 25.02.2022 ora 17.32,** në kabinë është me shërbim kontrollori **Haqif Halilaj**, në sportel paraqitet një person me automjet me drejtues shtetasin *Jeton Gjonpapaj*, i cili siç rezulton nga bisedat e zhvilluara, e ka makinën me mallra, e për të mos iu nënshtruar procedurave me doganën i jep kontrollorit shumën prej 20 euro.
475. **Më 25.02.2022 ora 17.34**, në sportelin e kabinës së kontrollorit **Haqif Halilaj** paraqitet një shtetasi kosovar *Brahim Samakova*, i cili është me automjet dhe paraqet një pasaportë, një kartë ID dhe dokumentet e makinës. Ndërkohë zhvillohet kjo bisedë:
Kontrollori Haqif Halilaj: *Për Itali a?.... o voc sigurimin, e s'ke ti, jo vlla,...**ke certifikate, sigurimin e gjelbër ose grinkard?,** (ndërkohë ka vënë pasaportën në skaner)...**hëëë qysh thu vet?!***
Personi: Po ta jap nji kafe...
Haqif Halilaj: *Maje..kqyre n'librez, ...a të dy jeni për Itali ...*
Ndërkohë sipas pamjeve filmike shihet teksa i jep librezën. Kontrollori në këtë moment (ora 17.36.05) hap një letër në dukje si librezë mjeti dhe nga ajo nxjerr dy kartëmonedha të prerjes euro, të cilat e hedh para skanerit dhe vazhdon veprimet me hedhjen në sistem dhe vijon duke iu drejtuar me fjalët:
Haqif Halilaj: *Në çfarë ore e keni udhëtimin, 11 a? Keni koh sa t'dush, si t'shkoshnji ora para...*
Në këtë moment ju jep dokumentet dhe ndërkohë kartëmonedhat i ka para skaneri, ku dallohet qartë që janë të prerjes 5 euro (total 10 euro). Në orën 17.26.28 i merr ato me dorën e majtë dhe i fut në xhepin e tij.

476. **Nga këqyrja e kamerës nr. 207 datë 25.02.2022, në orën 15.57**, konstatohet që kontrollori **Endrit Uka**, i cili po përpunon një mjet dhe po bisedon me shoferin i cili është shtetasi kosovar *Murat Mecini*, ku bëhet kjo bisedë:

Endrit Uka: *Po pra po, s'ke mujt po ca me t'thon shoku...19.09.21, ku je tu shku? Hec shifi dhe njiher, (i jep një dokument dhe ja merr pra në moment pas disa sekondash)*

Personi: Deri n'Fier...

Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, në këtë moment shoferi ja ka dhënë dokumentin (dallohet mbishkrimi ILIRIA) ku konstatohet që në orën 15.57.53 kontrollori nxjerr një kartëmonedhë (nuk duket shuma) dhe e hedh shpejt para skanerit. Në këtë moment kontrollori i jep të gjitha dokumentet shoferit dhe i thotë që të iki, duke iu drejtuar me fjalët "*...**hajde mirupafshim!**"*

Shtetasi: Faleminderit.

Në këtë moment kontrollori Endrit Uka shihet se me dorën e djathtë e merr kartëmonedhën dhe e fut diku në trup, nuk duket në kamera.

477. **Më datë 25.02.2022, ora 20.03.00**, kontrollori **Dashnor Braha**, fillon përpunimin e një mjeti me drejtues shtetasin kosovar *Shkelqim Mexhuani*, i cili i jep tre karta ID dhe dokumentet e mjetit. Gjatë kësaj kohe bëhet ky dialog:

Kontrollori Dashnor Braha: *Për ku udhëtoni?*

Personi: *N'Tiron.*

Dashnor Braha: *Librezën e kerrit edhe vaksinat. Librezën e kerrit njiher ma jep...si e ke emrin ti?*

Personi: *Shkëmbim.*

Dashnor Braha: *Shkëmbim....po, (ndërkohë shihet se fillon hedh të dhënat e mjetit në sistem, ku shihen dhe tre karta ID)*

Dashnor Braha: *Ça osht kjo vlla? Kastriot Krasniqi? Cili osht Kastrioti?*

Personi: *-(diçka i thotë në lidhje me vaksinat)-...*

Dashnor Braha: *Jo vallai njo m'ke dhon, është me nji dhe duhet me dy vaksina* babush....**merrni makinën dilni çaty në nji vend dhe hajde babush....**

Sipas pamjeve filmike të evidentuara edhe në procesverbalin e këqyrjes shoqëruar me fotografi, duket se kontrollori në këtë moment i vendos dokumentet e këtij mjeti dhe tre kartat në krahun e djathtë të tij mbi tavolinën. Ndërkohë që mjeti largohet vazhdon me mjetin e radhës...**në orën 20.09.40**, dëgjohet zhurma e derës së kabinës që hapet dhe dëgjohet zëri i një personi që bisedon me kontrollorin, si vijon:

Kontrollori Dashnor Braha: *Po...*

Personi: Kjo osht e atij tjetrit, e Shkëmbimit, dhe..

Dashnor Braha: *E Shkëmbimit jo e jotja!*

Personi: *Un kam ç'këtë, shoferi.*

Dashnor Braha: *Po bukur...po, kjo osht faqja e kësaja o vlla, kjo osht me nji duhet dhe nji tjetër, a jeni katër veta...tre....*

Personi: *Tre...*

Dashnor Braha: *Ty të duhet dhe njivlla, ose test pcr*
Personi: *Munja me a qysh...*
Dashnor Braha:Po si me ja bo, të nal dikush në rrug tmerr nqaf....ku po shkoni ju. ...ku keni prenotu?
Personi: Në Hotel, Privilegj, hotel Privilegji n'Tiron. Është pak mo knej se Tironës.
Dashnor Braha: *Ça me t'thon o vlla, shok jeni ju po, nga jeni ju...*
Personi: *Nga Prishtina.*
Dashnor Braha: *Ça punoni?*
Personi: *Kamarjer une , ata.....ça bohet?*
Dashnor Braha: *Si t'keni qef...*
Sipas pamjeve filmike shihet se në këtë moment i bien dokumentet poshtë tavolinës sepse i ka marrë në dorë për tja dhënë, ku duket dhe një punonjës që hyn në kabinë.
Dashnor Braha: *oooo avash o shtangist (i drejtohet kolegut)*
Personi: ***Qe nji kafe për ty...***
Dashnor Braha: Për qef?...po pate dëshir mir po s'pate
Personi: jo mor...
Dashnor Braha: Ta boft zoni mar...rrug t'mar...avash avash.
Personi: Hajt t'jesh mir.

478. **Sipas pamjeve të fiksuara nga kamera 207 data 25.02.2022, ora 17.13.50**, në kabinë është me shërbim punionjësi i policisë **Haqif Halilaj** dhe në sportel paraqitet një mjet me drejtues shtetasin *Sinan Lutfi Onuzi*, me mjetin AA146TY, i cili i dorëzon dokumentacionin, ku vërehet një pasaportë shqiptare. Kontrollori Haqif Halilaj e pyet se ku po shkon dhe personi i përgjigjet se shkon në Kukës. Kontrollori në momentin që e merr pasaportën dhe e drejton tek skaneri, fillimisht e hap dhe hedh poshtë skanerit një kartëmonedhe, në dukje 10 euro, që ishte brenda saj, më pas e kthen dhe e vendos në skaner për skanim.

479. **Në datë 25.02.2022, ora 19.**57.40, kontrollori **Haqif Halilaj** është më kabinë dhe merr në përpunim një mjet ku drejtuesi i mjetit *Ardit Zef Peqi*, shihet se i jep dokumentet e identifikimit dhe leje qarkullimi. Në momentet që po bënte regjistrimin në sistem të kartës ID, konstatohet se kur merr lejen e qarkullimit, e hap dhe brenda dallohet një kartëmonedhë 10 euro, të cilën me shpejtësi e hedh para skanerit.

480. **Nga këqyrja e kamerës nr. 207 datë 25.02.2022,** ora 13.52.05, në sportelin e kabinës kontrollorit **Haqif Halilaj**, paraqitet një mjet, ku shoferi kosovar *Dashnim Zemaj* i jep kontrollorit dokumentacionin dhe mes tyre zhvillohet biseda e transkriptuar si më poshtë:
Kontrollori Haqif Halilaj: *Si ja kalut a jeni mir, vaksinat?! a i keni vaksinat?*
Personi: *....(Dicka i thot por s'kuptohet)*
Haqif Halilaj: ***Jo pa vaksina!***
Personi:Deri n'Kukës...
Haqif Halilaj: *Po pra po por s'lejohet o njish. (ndërkohë vazhdon me regjistrimin në sistem të dokumenteve)*
Haqif Halilaj: *Ça me t'than shoki*

Personi: Apet kem me u kthy sonte.
Haqif Halilaj:Ore nuk lejohet me hi, ti rri sa të dush, nuk lejohet me hi.!
Haqif Halilaj: Hape pak krahun q'atje, ma jep pak targën t'foli me shefin.
Në këtë moment i vendos dokumentet në krahun e djathtë të tij, ndërkohë që mjeti vazhdon më tej, ndërkohë fillon me përpunimin e mjeteve të tjera, në radhën e hyrjes. Në orën 13.59.45, kontrollori i merr dokumentet e vendosura prej tij në krahun e djathtë dhe ja jep një personi që është tek dera kabinës dhe i thotë "***Dashnim hajt***...", dhe direkt pas këtij veprimi me dorën e djathtë hedh një send para printerit, kartëmonedhë, por nuk dallohet shuma, në orën 13.59.51. Në orën 14.00.28, kontrollori e fut dorën poshtë nga para skanerit dhe merr nga aty kartëmonedhën që hodhi pak më parë dhe në këtë moment e mban kartëmonedhën në dorë duke e mbledhur grusht në të, më pas e tërheq dorën dhe e fut diku në trup.

DATË 26.02.2022

481. **Data 26.02.2022 ora 15:51: 34.** Në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është vendosur kamera 207, është regjistruar biseda audio dhe video midis kontrollorit të verifikuar në sistem **Urim Lami** dhe shtetasit kosovar të verifikuar në sistemin TIMS *Butrint Islami,* i datëlindjes 21.11.1988, drejtues i mjetit me targë "01550PO" si dhe pasagjerë në këtë mjet shtetasit *Bujar Islami* i datëlindjes 23.12.1990 dhe *Rabije Veseli* e datëlindjes 03.11.1993. Kontrollori Urim Lami për shkak se shtetasi Butrint Islami nuk kishte autorizim për drejtimin e mjetit ju ka kërkuar ryshfet. Pasi ka mare diçka prej tyre, fsheh veprimin poshtë tastierës duke mbajtur dorën të mbyllur dhe me majën e gishtave fut një kartëmonedhë poshtë tastierës. Pas disa sekondash shikohet se kontrollori Urim Lami që çon tastierën, fut dorën poshtë saj dhe e tërheq të mbyllur grusht kartëmonedhën e vendosur pak momente më parë, por që nuk mund të përcaktohet shuma.
482. **Datë 26.02.2022 0ra 16:20:50** kamera 207 e vendosur në këtë kabinë ka regjistruar audio dhe video bisedën midis kontrollorit të verifikuar në sistem **Urim Lami,** me shtetasit kosovar të verifikuar në sistem *Adnan Berisha* i datëlindjes 05.06.2001, drejtues i automjetit më targë 01905NR, shtetasit *Enis Kutllovci* i datëlindjes 11.12.2001, pasagjer dhe shtetasit *Endrit Siminca* i datëlindjes 22.10.2000, të cilët ndodheshin në sportelin e kabinës për përpunimin e dokumentacionit në hyrje të RSH. Gjatë përpunimit të dokumentacionit kontrollori Urim Lami i ka pyetur këta shtetas nëse ***i kanë të dy dozat e vaksinës***. Këta shtetas nuk i kishin të dyja dozat. Kontrollori dëgjohet kur ju thotë se ***"si do ja bëjmë, ça mundësie, se nuk lejohet po beni testin e shpejt se nuk vonon 10 minuta, ça me u bë si thoni ju, apo me ju kthy ju krejt aaa",*** dhe në dorë shikohet që mban librezën e makinës. Urim Lami ju jep librezën e makinës duke ju thënë ***"shifni një kodë çitu"*** dhe pasi shtetasit kanë kthyer librezën Urimi e hap para aparatit të skanerit, ku duket se nga libreza lëshon kartëmonedhë para aparatit të skanimit të dokumenteve, të cilën me gishta e fut poshtë tastierës. Pasi i lejon të kalojnë ***Urim Lami dëgjohet që porosit shtetasit të bëjnë kujdes se mos i kontrollojnë rrugës.*** Pas disa sekondash çon tastierën për të parë kartëmonedhën dhe duket qartë kartëmonedha e palosur poshtë tastierës. Gjithashtu, kamera ka regjistruar dhe momentin kur **Urim Lami** fut dorën poshtë tastierës dhe e merr kartëmonedhën 10-euro.

483. **Data 26.02.2022 ora 16:52**:14, kamera 207 ka regjistruar audio dhe video një rast ku kontrollorja verifikuar në sistem **Mimoza Ismaili** i ka kërkuar një ***"kafe"*** shtetasit kosovar identifikuar në sistem *Xhenis Vataj* i datëlindjes 26.09.2002, drejtues i automjetit me targë 04732FP. Mimoza dëgjohet kur i thotë Xhenisit, i cili nuk kishte bërë vaksinën ***"më jep një kafe këtu"*** dhe shikohet që hap një dokument dhe prej andej nxjerr një kartëmonedhë në dukje 5 euro të cilën e vendos poshtë aparatit të celularit. Biseda e zhvilluar mes tyre është si vijon:

Mimoza Ismaili: *O Xhenis makina e kujt është*

Xhenisi: *E nënës*

Mimoza Ismaili: *ma jep pak letërnjoftimin dhe ate të vaksinës*

Xhenisi: *s'kam vaksina*

Mimoza Ismaili :*Ske vaksina aaa, test?*

Xhenisi: *Jo*

Mimoza Ismaili: *hë mos ja fut kot... nga po shkon?*

Xhenisi: *-nuk kuptohet-*

Mimoza Ismaili: *po vetëm je tu shkue?*

Xhenisi: *vetëm*

Mimoza Ismaili: ***Fut një kafe meqënse je tu shku për qetësim*** *dhe hec*

Xhenisi:*ëëë*

Mimoza Ismaili: *Fut një kafe çitu dhe hec, s'po ta prishi terezinë po faktikisht pa vaksinë pa test nuk lejohet ta them me sinqeritet, ti në daç shko bene, e bën edhe atje në qofte se do rrish gjatë, më jep edhe letërnjoftimin që të bëjmë regjistrimin (hap një dokument ku ishin vendosur 5 euro dhe i vendos poshtë aparatit celular) mirupafshim.*

484. **Në datë 26.02.2022, ora 17:05:54, kamera 207** e vendosur në këtë kabinë ka regjistruar audio dhe video momentin kur kontrollorja e verifikuar në sistem **Mimoza Ismaili** ju ka marrë një kartëmonedhë 10-euro shtetasve kosovarë verifikuar në sistem shtetasit *Armend Shabani,* i datëlindjes 01.06.1996, drejtues i automjetit më targë 02778FC, *Besart Mehmeti* i datëlindjes 26.06.1992, pasagjer dhe *Armend Shabani* i datëlindjes 01.06.1996, pasagjer, të cilët ndodheshin në sportel për të përpunuar dokumentet e udhëtimit. Dy prej këtyre shtetasve nuk e kishin bërë vaksinën dhe Mimoza jo thotë të ***ndreqeshin ndryshe pasi një test bën 17 Euro.*** Ju zgjat një portofol të dokumenteve dhe pasi ia rikthejnë atë, e hap portofolin duket një kartëmonedhë e prerjes 10-euro. Mimoza dëgjohet që ju thotë këtyre shtetasve që ***ju kam kursyer 30 euro.***

485. **Data 26.02.2022 ora 17:08:33**, kamera 207 ka regjistruar një rast ku shikohet se punonjësja e policisë në shërbim, kontrollorja **Mimoza Ismaili** pasi ka hapur një librezë automjeti ka nxjerrë një kartëmonedhë në dukje 10-euro. Nga regjistrimi audio nuk evidentohet se cili është shkaku i përfitimit të kësaj kartëmonedhë ndërsa nga regjistrimi video janë fiksuar qartë momentet kur kontrollorja **Mimoza Ismaili** hap një dokument, librezë automjeti, dhe prej andej nxjerr një kartë monedhë 10 euro dhe e vendos poshtë celularit. Shtetasit e verifikuar në sistem të cilët janë regjistruar në orarin1 7:06-17:08 janë shtetasit kosovarë *Murrlan Bucinica* i datëlindjes 10.07.1998, drejtues i mjetit me targë "01502LB" dhe shtetasi *Erdon Kaciou,* i datëlindjes 05.01.1999.

486. **Data 26.02.2022, ora 17:28:41, kamera 207** e vendosur në kabinën ku kontrollore është **Mimoza Ismaili** ka regjistruar një rast ku kontrollorja Mimoza Ismaili përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë të verifikuar në sistem *Besnik Telaku,* i datëlindjes 10.02.1991, drejtues i mjetit më targë "04109JC", *Edmond Kamberaj* i datëlindjes 27.02.1994, *Harris Krasniqi* i datëlindjes 28.06.1993 dhe *Kreshnik Kabashi*, i datëlindjes 28.06.1993. Gjatë verifikimit dëgjohet kontrollorja Mimoza Ismaili teksa ju drejtohet me fjalët: ***"më mo çuna ndonjë raport apo vaksinë nuk më dhatë, vetëm shoferi."***, ***"më mo çuna .. na futi .... këtu"*** , dhe ju zgjat një librezë automjeti. Ndërkohë që kontrollorja është duke përpunuar shtetasit e mësipërm, në kabinë futet dhe një punonjës tjetër policie me kod identifikues ***"06706".*** Më pas kjo punonjëse ka hapur librezën dhe ka nxjerrë një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe fillimisht e ka vendosur mbi celular dhe pas pak sekondash e ka marrë, veprim i kryer ndërkohë që tashmë në kabinë ka hyrë edhe punonjësi tjetër, kolegu i saj i identifikuar si kontrollori **Urim Lami.**

487. **Data 26.02.2022 ora 17:29:20, kamera 207** e vendosur në kabinën ku kontrollori i verifikuar në sistem **Urim Lami** i ka marrë një kartëmonedhë ***5 euro*** shtetasit nga Kosova i verifikuar në sistem *Mustaf Islami,* i datëlindjes 07.06.1983, i cili udhëtonte me automjetin me targë 01870PC. Në bisedën e regjistruar kontrollori **Urim Lami** i kërkon letërnjoftimin, vaksinën dhe autorizimin e mjetit. Pasi hap dokumentet dhe fillon skanimin, kontrollori Urim Lami përdor shprehjen ***"Ç'a është kjo letër kështu, se për makinat e reja ka problem kjo".*** Kontrollori duket kur hap një qese ku ishin disa dokumente të makinës dhe nxjerr një kartëmonedhë në dukje të prerjes 5 euro dhe e "fsheh" poshtë tastierës.

488. **Data 26.02.2022 ora 17:59, kamera 207 e** vendosur në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është me shërbim kontrollori **Urim Lami**, ka regjistruar video rastin kur ky punonjës policie, pasi kontrollon një pasaportë, nxjerr prej andej një kartëmonedhë të prerjes 10 euro dhe e vendos fillimisht te tavolina e punës dhe më pas e fsheh poshtë tastierës së kompjuterit. Në mungesë të regjistrimit audio nuk kuptohet se cilit shtetasi ja ka marrë këtë kartëmonedhë si dhe arsyeja e marrjes.

489. **Data 26.02.2022 ora 09:29:14, kamera 207** ka regjistruar video ku kontrollori i cili kryen shërbim në kabinën ku është vendosur kjo kamera, i verifikuar në sistem si **Urim Lami**, pasi ka hapur një librezë automjeti, ka nxjerrë prej andej një kartëmonedhë e cila nuk mund të përcaktohet lloji dhe prerja, të cilën pasi e vendos poshtë tastierës, pas disa sekondash e merr dhe kartëmonedha duket mbi tavolinë. Për shkak se regjistrimi nuk ka audio nuk mund të përcaktohet shkaku pse e ka marrë si dhe personat që e kanë dhënë këtë kartëmonedhë.

490. **Data 26.02.2022 ora 09:51:42,** kamera 207 e vendosur në këtë kabinën nr.4, në hyrje të R.SH, ka regjistruar audio dhe video një rast ku kontrollori **Urim Lami** ka marrë një kartëmonedhë të prerjes 10 euro nga shtetasit kosovarë të verifikuar në sistem si *Shpëtim Imeri,* i datëlindjes 03.10.1993, drejtues i mjetit, *Premton Sylejmani* i datëlindjes 16.04.1996 dhe *Imran Gerebeshi* i datëlindjes 21.06.1996. Kontrollori Urim Lami dëgjohet teksa ju kërkon vaksinat dhe dëgjohet kurrë ju thotë ***"ti je në rregull ai tjetri nuk është në rregull"***, ***" Po qysh do me bë hë".***

491. **Data 26.02.2022 ,ora 12:29, kamera 207** e vendosur në kabinën ku kontrollore është

Mimoza Ismaili, ka regjistruar audio dhe video një rast ku kontrollorja merr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro nga shtetasi kosovar i verifikuar në sistem si *Durim Seferi i* datëlindjes 03.05.1993, i cili udhëton me mjetin me targë "01929ND". Mimoza Ismaili i kërkon autorizimin e mjetit Durimit, por Durimi nuk e dispononte. Në regjistrim dëgjohet që kontrollore Mimoza Ismaili i drejtohet qytetarit Durim Seferi me fjalët: "***a e dini që s'lejohet pa autorizim***". Në video fiksohet momenti kur Mimoza Ismaili, pasi hap disa dokumente, nxjerr një kartëmonedhë të prerjes 5 euro dhe e fsheh poshtë aparatit të celularit në krahun e majtë të tavolinës.

492. **Data 26.02.2022 ora 13: 51: 56, kamera 207** e vendosur në kabinën, nr. 4 në hyrje R.SH, ku kryen detyrën punonjësi i policisë i verifikuar në sistem **Urim Lami,** ka regjistruar video një rast ku kontrollori **Urim Lami** pasi ka hapur dokumentin "***leje qarkullimi***", dokument i shtetit shqiptar, ka parë se brenda tij ndodhej një kartëmonedhë e prerjes 10 euro të cilën pasi e merr në dorë të palosur, e vendos përsëri në lejen e qarkullimit dhe e afron lejen te tastiera e kompjuterit. Në këtë orar shtetasit të cilët kanë kryer praktikën në sportel , të verifikuar në sistem janë *Fiqiri Cenaj*, i datëlindjes 26.03.1970, drejtues i automjetit me targë AA994 UX, *Leonard Tahiri,* udhëtar me këtë mjet, i datëlindjes 25.10.2000 dhe *Armando Tahiri,* i datëlindjes 25.08.1997, pasagjer në këtë mjet. Regjistrimi është vetëm video por jo audio.

493. **Data 26.06.2022 ora 14:35:31, kamera 207** e vendosur në këtë kabinë ka regjistruar video një rast ku kontrollori **Urim Lami** ka marrë një kartëmonedhë të prerjes 5 euro nga shtetas në sportel por për shkak se mungon regjistrimi audio, nuk mund të përcaktohet arsyeja se përse kontrollori Urim Lami ka marrë këtë kartëmonedhë. Në regjistrimin video duket se kontrollori e merr kartëmonedhën nga një dokument dhe e vendos para aparaturës së skanimit të dokumenteve dhe më pas e fsheh poshtë tastierës.

DATA 27.02.2022

494. **Në datë 27.02.2022, ora 09:15:10** në kabinën nr. 4 në hyrje R.SH, ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë i verifikuar në sistemin TIMS si inspektori **Fatri Iseberi**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të identifikuar si *Erhan Pomaku,* i dtl.08.12.1979, i cili udhëton me automjetin me targë "PGKG682". Kontrollori i kërkon dhe i merr këtij shtetasi 10 euro, ndërkohë që bisedon me të për mungesë dokumentesh.

495. **Në datë 27.02.2022 ora 09:40:50** në kabinën nr. 4, në hyrje R.SH, ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se vijon shërbimin punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të paidentifikuar të cilit i flet për parregullsi dokumentesh. Nga verifikimi në sistem nuk figuron ndonjë shtetas i regjistruar me emrin *Erzen*, siç rezulton nga biseda mes tyre, por janë regjistruar shtetasit *Bashkim Hajdini* i dtl. 25.12.1968, pasagjer në automjetin me targë "01245SC, dhe drejtues mjeti është shtetasi *Ritvan Vucitrina*, i dtl. 14.10.1996.

496. **Në datën 27.02.2022, ora 11:39:48** në kabinën nr. 4 në hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë i verifikuar në sistem si inspektori **Fatri Iseberi**, i cili i ka marrë pasaportën e një shtetasi të paidentifikuar, për shkak të filmimeve të kufizuara të pajisjes përgjuese, dhe shihet teksa ia kthen kundrejt

pagesës prej 40 euro (dy kartëmonedha 20 euro).

497. **Në datë 27.02.2022, ora 11:44:05** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të pa identifikuar, i kërkon ryshfet duke biseduar për parregullsi dokumentesh. Gjatë bisedës dëgjohet Fatriu duke i thënë shtetasit *shumë faleminderit*, por nuk është identifikuar nga pamjet shuma e marrë apo arsyeja e saktë e kërkimit të saj.

498. **Në datë 27.02.2022, ora 11:53**, kontrollori **Fatri Iseberi** është në përpunim të dokumenteve të shtetasit kosovar, të identifikuar nëpërmjet sistemit TIMS si *Ilir Morina* i dtl.25.05.1983, drejtues i automjetit auto veturë me targë '04960II'. Midis tyre zhvillohet biseda si më poshtë:

Fatri Iseberi: *..O më fal se ta harrova emrin...*

Ilir Morina: *...nuk dëgjohet...*

Fatri Iseberi:O Ilir ti e ke fut edhe kafen këtu o Ilir..

Nga pamjet filmike, dokumentuar edhe në procesverbalin e këqyrjes, dallohet në mes të pasaportës një kartëmonedhë prerje 5 euro të cilën e hedh në tavolinë, dhe më pas e merr dhe e fut në xhep.

499. **Datë 27.02.2022, ora 09:15:10** në kabinën nr. 4 hyrje R.SH ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 7, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Fatri Iseberi**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të paidentifikuar, të cilit i kërkon ryshfet duke i bërë presion për parregullsi dokumentesh. Në orën 09:54:40 futet në kabinë një shtetas dhe zhvillojnë ketë bisedë:

Shtetasi: *...a bën?.*

Fatri Iseberi: Amos janë pak apo kaq të ka bë zemra!?

Shtetasi: *Për rrugë ...*

Sipas pamjeve filmike duket shtetasi i cili fut dorën në xhep dhe nxjerr një kartëmonedhë prerje 10 euro dhe e hedh në tavolinën e punës të Fatriut.

Fatri Iseberi: *...ani* ***ani, faleminderit shumë.***

500. **Në datë 27.02.2022, ora 09:40** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë inspektor **Gëzim Duraku**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi. Ky shtetas futet në kabinë duke i treguar kontrollorit Gëzim Duraku ekranin e hapur të telefonit të tij dhe më pas, kontrollori i jep atij dokumentet që duket se janë dy karta ID dhe një librezë mjeti. Më pas shtetasi merr dokumentet, i fut në xhep dhe nxjerr nga xhepi i djathtë i tij kartëmonedhë euro, të cilat i vendos në tavolinën e punës së kontrollorit, mbrapa monitorit të kompjuterit. Kontrollori Gëzim Duraku zgjat dorën e djathtë duke i marrë dhe i fut në xhepin e tij, ndërsa shtetasi largohet nga kabina.

501. **Në datë 27.02.2022 ora 12:25:27** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Gëzim Duraku**, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të identifikuar *Osman Hoxha* i dtl.24.10.1971, shtetas kosovar me nr.ID 1809239 të cilit i kërkon ryshfet duke folur për mungesën e testin anti Covid dhe duke i thënë, ndër të tjera, se *duhet të bëni testin që ju kushton 40 euro të dyve*, dhe ju jep tre

opsionet ku njëri nga opsionet siç shprehet "*është në dorën e kontrollorit Gëzim Duraku*", për t'i lejuar të kalojnë.

502. **Në datë 27.02.2022 ora 13:57** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë **Gëzim Duraku.** Sipas pamjeve filmike duket se në kabinë futet një punonjës tjetër policie i identifikuar si **Bedri Duraku** i cili e zëvendëson kontrollorin Gëzim Duraku për një periudhë kohe të shkurtër. Sipas pamjeve filmike, por pa regjistrim audio, duket kontrollori Gëzim Duraku i cili pasi i liron postin e punës inspektori Bedri Durakut, del pas monitorit të kompjuterit dhe fut dorën e djathtë në xhepin e djathtë të tij duke nxjerrë një tufë kartëmonedhash euro dhe i hedh në shesh, poshtë këmbëve të tij dhe duke u përkulur në gjunjë fillon i merr ato një nga një duke i palosur dhe numëruar i fut përsëri në xhepin e djathtë. Më pas afrohet, merr telefonin mbi tavolinë dhe largohet nga kabina. Gjatë kohës që kontrollori Gëzim Duraku i nxjerr dhe numëron kartëmonedhat e ndryshme që i kishte grumbulluar më parë në xhepin e tij, është i pranishëm edhe punonjësi i policisë inspektor Bedri Duraku i cili e zëvendëson atë në shërbim.

DATA 28.02.2022

503. **Në orën 08:52 min të datës 28.02.2022** në kabinën nr. 4 ku është instaluar pajisja përgjuese nr.7 , punonjësi i policisë **Muhamet Cengu**, që është me shërbim, kryen një bisedë me shtetasin që paraqet në sportel një pasaportë dhe dy Karta Identiteti si dhe një certifikatë të një shtetaseje tjetër që e mban në dorë. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rezulton se dy kartat e identitetit që përpunohen nga punonjësi i policisë në orën 08:53 min se janë shtetaset *Krenare Seferaj e* dtl. 03.12.2000 dhe *Vanesa Gerxhaliu* e dtl 06.11.2002, të cilat udhëtojnë si pasagjere me automjetin auto veturë me targa "01685PM", por drejtuesi i këtij automjeti nuk është regjistruar në sistem pasi të dyja shtetaset rezultojnë si pasagjere. Regjistrimi i tij nuk është kryer për shkak të mungesës së dokumentit *Letërnjoftim* siç rezulton nga bisedat që janë zhvilluar mes tyre.

504. **Në orën 09:01, po të datës 28.12.2022** punonjësi i policisë Muhamet Cengu është duke përpunuar dokumentin e një shtetasi të huaj në hyrje të R.Sh-së. Gjatë përpunimit të dokumenteve konstatohet që shtetasi t'i japë një kartëmonedhë 5-euro, të cilën fillimisht ky punonjës e ka futur poshtë tastierës e menjëherë sa ai largohet, e merr prej saj nga ku dallohet edhe prerja 5 euro. Nuk dëgjohen biseda e plotë por vetëm momenti kur punonjësi i policisë i thotë "***Në rregull në rregull***", pasi merr shumën 5 euro, dhe më pas e përshëndet me fjalët ***"Shnet".*** Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se punonjësi i policisë Muhamet Cengu ka kryer përpunimin e dokumenteve të shtetasit kosovar *Zade Sylejmani,* i datëlindjes 26.08.1961, drejtues i automjetit auto veturë me targa 01930FN".

505. **Në orën 09:08 të datës 28.02.2022** në kabinën ku është duke punuar punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** paraqiten dy shtetas të tjerë kosovarë të cilëve ju kërkon vaksinat. Me sa duket shtetasit nuk i kanë të dyja dozat e vaksinave e po ashtu test kundër Covidit e po ashtu kanë mungesë autorizimi për mjetin. Për këtë arsye në bisedë e sipër punonjësi i policisë Muhamet Cengu ju jep një dokument mbrapsht e ju thotë: "***rregullojeni...***". Pasi merr një kartëmonedhë

prej tyre, të cilën e hedh të mbledhur para tastierën, shtetasit vijojnë udhëtimin. Nga pamjet filmike duke një kartëmonedhë me ngjyre blu, e ngjashme me atë 20 euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj në R.SH për këtë datë, nga ora 09:08 min deri në orën 09:10:25 min, nga Muhamet Cengu janë përpunuar dokumentet e shtetasve *Granit Krasniqi* i dtl. 19.03.1993, pasagjer në automjetin me targa "01638SC" dhe *Dardan Jupolli* i dtl. 06.12.1989, drejtues i po të njëjtit automjet.

506. **Në orën 10:26 min po të datës 28.02.2022, Muhamet Cengu** është duke përpunuar dokumentin e një shtetasi kosovar por të pajisur me pasaportë zvicerane e konkretisht të shtetasit *Argjent Azemi* i dtl 03.12.1994, pasagjer në automjetit auto veturë me targa "VR078EV", e po ashtu të shtetasit të pajisur me pasaportë zvicerane *Muhamed Jasari* i dtl 04.09.1993, drejtues i automjetit tip auto veturë me targa "VR078EV". Ky shtetas dyshohet të jetë edhe komunikuesi me punonjësin e policisë të cilit ky i fundit i kërkon ta respektojë me një kafe duke i thënë fjalët: ***"A ban me na respektu me një kafe tashi? Hajt".*** Menjëherë pas kërkesës së tij shtetasi i huaj i jep 5-euro.

507. **Në orën 10:47:44, datë 28.02.2022** në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Muhamet Cengu**, shihet duke hyrë një tjetër punonjës policie i cili mban në dorë një kartëmonedhë ***20 mijë lekë*** shqiptare dhe një dokument me ngjyrë të verdhë. Të dyja i merr Muhamet Cengu. Biseda që dëgjohet midis tyre është si vijon:

Polici:....maqina ai nuk e di se zhdoganon, pse mos me ja marr leket. Aj nuk e di se e ka regjistru Muhameti pse mos me ja marr leket.

Për disa sekonda zhvillojnë një bisedë me njëri tjetrin, por nuk kuptohet, ndërkohë dëgjohet punonjësi i policisë që ti thotë shtetasit nga jashtë, **"Hec or mik hec".** Në vijim ndërpritet regjistrimi audio. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në këtë orar nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu është përpunuar dokumenti i shtetasit *Armir Nazif Cengu* i dtl 15.09.1994 i cili udhëton me një auto veturë pa targa.

508. **Në orën 16:37 po të datës 28.02.2022**, nga pamjet filmike dallohet se punonjësi policisë **Muhamet Cengu** është në kabinën nr. 4 dhe duket teksa i merr dokumentet një shtetasi dhe i kalon në krahun tjetër të tavolinës duke i mbajtur aty. Më pas dallohet që punonjësi i policisë i jep dokumentet dikujt dhe në këmbim dallohet që shtetasi ti japë para por nuk është e dallueshme prerja e kartëmonedhës.

509. **Në orën 16:41 po të datës 28.02.2022** punonjësi i policisë **Muhamet Cengu** është duke përpunuar dokumentin e një shtetasi kosovar i cili brenda një flete të bardhë merr diçka dhe e vendos para pajisjes skaner. Nga verifikimi në sistemin TIMS, rubrika hyrje shtetas të huaj, rezulton se punonjësi i policisë Muhamet Cengu ka kryer verifikimin dhe përpunimin e dokumenteve të dy shtetasve kosovare e konkretisht *Nexhmedin Sopi* i dtl. 21.10.1977, pasagjer në automjet dhe dokumentin e shtetasit *Hamdi Ibrahimi* i dtl. 06.09.1983, drejtues i automjetit auto veturë me targa "01946PQ".

510. **Në orën 16:53 min po të datës 28.02.2022,** në kabinën ku kryen shërbimin **Muhamet Cengu,** paraqiten disa shtetas kosovare, vërtetuar nga dokumentet e shumta që ka mbi tavolinë kontrollori, të ngjashme me kartat e identitetit. Njërin prej tyre e therret *Ekrem* dhe i kërkon

letërnjoftim pasi, sipas tij ai i ka dhënë *Leje Qëndrimi dhe Leje Drejtimi*. Ekremi i thotë se është dokument zviceran ndërsa *Muhameti* i thotë se dokumenti zviceran është ngjyre blu dhe jo si ai që i ka dhënë. Pavarësisht kësaj, në sistem gjendet i regjistruar vetëm emri i shtetasit *Ekrem Hajdari*, i dtl 22.05.1988 i cili është drejtues i automjetit me targa "LU236001" dhe nuk janë regjistruar në sistem shtetasit e tjerë pasagjerë në automjet. Pasi ikin shtetasit **Muhamet Cengu** ngre tastierën e kompjuterit, veprim i cili kryhet mbas çdo rasti.

511. **Në datë 28.02.2022 në orën 21:09:22** në kabinën ku janë vendosur mjetet e përgjimit me nr. 7, është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku**, i cili i kërkon shtetasit kosovar *Marol Demiri,* i dtl 08.09.1998, i cili udhëton me automjetin me targë 01425 OT të drejtuar prej tij, shumën prej 20 euro, sepse ai nuk ka autorizimin e mjetit, në këmbim të lejimit për të vazhduar udhëtimin.

512. **Në datë 28.02.2022 në orën 21:22:30** në kabinën ju janë vendosur mjetet e përgjimit me nr. 7 dhe është duke punuar kontrollori **Gëzim Duraku,** në sportel është paraqitet një shtetas të cili i jep Gëzimit, dokumentet e identitetit dhe mjetet e makinës. Kontrollori pasi i merr dokumentet fillon të bëjë regjistrimin e tij në sistem dhe në vijim me shtetasin zhvillon këtë bisedë:

Kontrollori Gëzim Duraku*: E kie të ...rregull makinën ej... e kie të rregull...ta regullova e ke pa merak, kudo me shku e kie.... sikur të jeshë vetë në të ... ta futa, ta futa me numër praktike...për veten tate ta keshe ...ta dishë...*

Shtetasi*: Muhametin e kam djalë tezje.*

Kontrollori Gëzim Duraku: *Muhametin...! Djale tezje ëëë ?Me nusen e Muhametit une jam...I kem nënat motra...*

Shtetasi: *Hajt shnet...*

Kontrollori Gëzim Duraku: *N'jatjeta...*

513. **Në datë 28.02.2022 në oren 21:35:35** në sportelin ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me numrin 7 dhe ku punon kontrollori **Gëzim Duraku**, janë paraqitur dy shtetas të cilët i kanë dhënë kontrollorit dokumente e identifikimit, karta identiteti belge. Nga biseda dhe veprimet e kontrollorit si dhe biseda e zhvilluar rezulton komunikim mbi faktin se kartat e identitetit belge nuk njiheshin nga kompjuteri (sistemi) dhe për të kaluar duheshin para. Është bërë kryerja e sistemin TIMS, në rubrikën hyrje shtetas të huaj që hyjnë në territorin e R.Sh dhe nga këqyrja rezulton se në orën 21:24:00 të datës 28.02.2022, është regjistruar në sistemin TIMS shtetasi kosovar *Taulant Pira*, i datëlindjes 16.09.1992, i cili udhëton me automjetin tip auto veturë me targë 2AGU462 ne rolin e pasagjerit. Në automjet ka qenë dhe shtetasi *Agjent Pira* i datëlindjes 27.02.1999, shtetas kosovar, i cili ka qenë në drejtimin e mjetit. Këta shtetas janë regjistruar në sistemin Tims nga punonjësi i policisë Gëzim Duraku, pikërisht në orën 21:36:00 dhe 21:38:00 që përkon me veprimet e kryera nga kontrollori dhe të fiksuar dhe nga kamera e përgjimit. Nga të dhënat e hedhura në sistem për këta dy shtetas rezulton se janë regjistruar po me karta identiteti belge.

514. **Datë 28.02.2022 ora 15.42.55** në kabinën nr. 4, në hyrje R.SH, ku kryen shërbimin kontrollori **Kapllan Dogjani**, duket se po fillon përpunimin dhe regjistrimin në sistem të tre

pasaportave dhe dy kartave ID Kosovare. Në tavolinë dallohen dhe disa dokumente që janë për vaksinat covid. Gjatë përpunimit dhe kontrollit të dokumentacionit, në orën 15.45.07 dallohet kontrollori që nxjerr nga një dokumentet një kartëmonedhë të **prerjes 5 euro** dhe e hedh para skanerit, më pas në orën 15.45.14, pasi ja ka dhënë dokumentet drejtuesit të mjetit, fut dorën e djathtë para skanerit, merr kartëmonedhën dhe më pas tërheq dorën në pjesën që s'duket nga kamera duke e vendosur atë në trup (xhep). Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në këtë hark kohor është bërë përpunimi i dokumenteve të shtetasit *Dritan Gashi* i dtl 09.03.199, *Kurbin Bashota* i dtl 18.11.1999, drejtues i automjetit me targë "03642GC" dhe *Vullnet Toplana* i dtl 06.05.1999.

515. **Po në datë 28.02.2022, ora 18.37.17**, në sportel paraqitet një automjet ku shoferi e përshëndet dhe i jep dokumentet punonjësit të policisë në sportel **Kapllan Dogjani**. Mes tyre zhvillohet një dialog mbi dokumentacionin e paraqitur. Në tavolinën e kontrollorit, dallohen një pasaportë shqiptare, një kartë ID kosovare dhe dokumentet e mjetit. Nga këqyrja dhe kontrolli i dokumenteve, kontrollori i gjen dy shkelje, një që ***i ka mbaruar sigurimi i makinës dhe shkelja tjetër, shtetasja që është në mjet dhe ka pasaportë shqiptare, ka qëndruar më shumë se tre muaj jashtë territorit të RSH.*** Mes tyre zhvillohet një dialog ku kontrollori u thotë që kanë probleme dhe shtetasja në sportel duket që mundohet t'ia shpjegojë që ka qenë në Kosovë mbi tre muaj dhe nuk mund të konsiderohet si jashtë RSH. Pas kësaj, në orën 18.45.19, vërehet që kontrollori i ka kaluar dokumentet e përshkruara më lart në krahun e djathtë të tij në tavolinën e punës. Në orën 18.45.55, një person të cilit i dëgjohet zëri, i thotë..."***hë shefi***". Kontrollori i thotë "***dil para mos më rri mas shpine***", në këtë moment dëgjohet që dera mbyllet. Në orën 18.49.55, dëgjohet që kontrollori bisedon me një person dhe dokumentet e mjetit të përshkruar më parë janë në tavolinë dhe biseda bëhet për ato, si vijon:

Personi: *më ka humb për zotin*

Kontrollori Kapllan Dogjani: *Kjo vula e fundit a e ke pa (kontrollori merr ne dorë pasaportën shqiptare),* ***po ta kallzoj se e ke at njerzillik me ta kallzu*** *(kryen veprime dhe me kompjuterin)...****dalja 28.11.2021...që ka dal prej Shqipërie....edhe sot ka bo tre muj e 23 dit e 22 dit***

Personi: *Aaaaa!? un kujtova t'Kosovës. Ca me bo? ne kem tu ik deri nlaç te nji mik i joni*

Kapllan Dogjani: *Ae ja bo shënimin, ca me ja bo....(merr pasaportën në dorë)..., nji shënim duhet me e bo, ka shum neshje kjo pun, e për pes vjet si lejohet me dal prej Shqipërie....për her t'par udhton me të?.*

Personi:*...qe,* ***momir po t'rrespektoj...nuk osh dicka se na nal ajo..., t'betohena aman, për zotin.***

Në këtë moment, nga pamjet filmike duhet që mbi tavolinë hidhet një kartëmonedhë, me ngjyrë rozë, në dukje paund britanik dhe kontrollori në këtë moment merr dhe dokumentet e tjera që janë në tavolinë dhe ja jep personit duke iu drejtuar me fjalët:

Kapllan Dogjani*:...****ësht turp tashi....***

Personi: Un më shum sa ti, ma bon hallall.

Nga këqyrja në sistemin TIMS rezulton se veprimet janë kryer nga kontrollori **DOGJANIK** dhe shtetasit që kanë kaluar në kufi në këtë hark kohor janë *Uendi Dybeli dhe Arben Kurtishi*, i cili dyshohet edhe si personi që ka dhënë kartëmonedhën paund, për shkak se është drejtuesi i automjetit me targë "DAK7911".

DATË 01.03.2022

516. **Më datë 01.03.2022 ora 09:17** në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, në harkun kohor 08:43 deri ora 10:54, konstatohet se ka kryer shërbim një punonjës i policisë i cili ka qenë e pamundur të identifikohet, pasi kamera nuk e ka fiksuar, i cili ka zëvendësuar për pak çaste kontrollorin Haqif Halilaj, i cili pasi rikthehet në kabinën e shërbimit, zhvillojnë këtë bashkë bisedim:

I Paidentifikuari: *personi a?*

Haqif Halilaj: *Unë se kam parë, më ka dhënë dokumentin e Kosovës, kam si me më dhënë ky dokumentin tjetër.... e mos me e pa...aty nuk shihet se është e brendshme ....pse me bërë këtë....*

I Paidentifikuari: *u prish marrëveshja*

Haqif Halilaj: *...ë...po e kanë verifkuar atë*

I Paidentifikuari: *...e kanë verifikuar atje poshtë dmth...a*

Haqif Halilaj: *po.*

I Paidentifikuari: *a kosovare, a shqiptare..?*

Haqif Halilaj: *kosovare.....e ti q..na....(nuk dëgjohet mire pastaj, më pas vazhdon),* ***o ka qenë me dokument të tjetërsuar ka qenë***

I Paidentifikuari: *..e paska qenë r.. q...*

517. Biseda mes tyre vazhdon nga ora 09:17 deri në 09:19 dhe më pas ndërpritet audio dhe vazhdon regjistrimi video. Në orën 09:20, punonjësi i policisë i paidentifikuar largohet nga kabina dhe në orën 09:21:50, futet në kabinë punonjësja e policisë **Elidjana Toçilla**, e cila shikohet që nxjerrë nga xhepi i saj i djathtë një sasi kartëmonedhash, të palosura dhe të para përgatitura më parë të cilat ja jep kontrollorit Haqif Halilaj. Në orën 09:30 në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim kontrollori **Haqaif Halilaj**, dhe aty ndodhet edhe një punonjës tjetër policie i identifikuar si Nën/Komisar Ani Hoxholli, i cili kryen detyrën e Përgjegjësit të Grupit (turnit). Mes tij dhe kontrollorit në shërbim Haqif Halilaj zhvillohet biseda si më poshtë:

Ani Hoxholli: *.....komplet ..?*

Haqif Halilaj:*....të gjitha duke përfshirë edhe Anin, ..e ja dhashë, thashë me e heq qafet,...nga s'të shkon mendja he nanaën,..po më kërkojnë ato për deklarim e hiq*

Ani Hoxholli: *-e pa transkiptueshme-*

Haqif Halili: *...ë...edhe komandanti tha se, a ta pyes..(nuk kuptohet qartë e folura).*

Në orën 09:31:20 në kabinë futet një punonjëse policie e identifikuar si **Rezarta Lako** me detyrë kontrollore, e cila edhe kjo nxjerrë para nga xhepi dhe ja jep kontrollorit Haqif Halilaj, ku

prezent në kabinë vijon të jetë edhe përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli. Rezarta Lako zhvillon ketë bisedë me kontrollorin Haqif Halilaj:

***Haqif Halilaj**: ...në rregull, ja mora atij .....dhe ja dhashë Mondit.....me paguar arkëtarin bre, e thashë të ja qojmë, në rast se i ke..?*

Rezarta Lako është fiksuar nga pamjet filmike se nuk flet por fut dorën në xhepin e djathtë të saj dhe nxjerr një sasi kartëmonedhash të palosura dhe ja jep kontrollorit Haqif Halilaj.

Mes punonjësit Haqif Halilaj dhe përgjegjësit të turnit Ani Hoxholli është transkriptuar edhe biseda si vijon:

***Haqif Halilaj**:....se di, këto grupet tjera a mbaruan punë,.....unë mbarova me ta, se ndoshta mbaron punë sot me drejtorin...!?*

***Ani Hoxholli**: ..duhet të kenë mbaru,*

***Haqif Halilaj** :...se data 1 sot..!*

DATA 02.03.2022

518. **Në orën 14:07:23 të datës 02.03.2022**, në sportelin ku janë instaluar pajisjet përgjuese audio dhe video me nr. 6, është duke punuar kontrollori **Urim Lami**. Në këto kohë paraqitet një shtetas i cili i jep dokumentet dhe Urimi i drejtohet shtetasit duke i thënë: ***"O Lazim, nami ç'e ktu", "pa shife".*** Shtetasi, dëgjohet që i thotë dikujt tjetër qe ka në makine..."***nami njeqind euro".*** Nga këqyrja e sistemit TIMS, në rubrikën hyrje shtetas të huaj, rezulton se në orën 14:07:00 të datës 02.03.2022 është regjistruar ne sistemin TIMS shtetasja shqiptare *Florida Mark Cargu* e datëlindjes 13.06.1969, e cili udhëton me automjetin auto veturë me targë 05343GD. Kjo shtetase është regjistruar në sistem nga punonjësi i policisë Urim Lami, pikërisht në orën 14:07:00.

519. **Në orën 14:46:39 të datës 02.03.2022** nga kamera me nr. 6, vendosur në kabinën ku është duke punuar kontrollori **Urim Lami** është fiksuar momenti i orës 14:48:00 kur Urimi vendos tek mausi, përballë monitorit të kompjuterit disa monedha në euro, rreth njëzet copë, në dukje të prerjes 1 euro. Pasi i lënë për disa sekonda aty, i merr dhe i vendos në krahun e djathtë të tij.

520. **Në orën 15:52:52 datë 02.03.2022** në kabinën që janë instaluar mjetet e përgjimit audio dhe video, me nr. 6, është duke punuar një tjetër kontrollor, për shkak se Urim Lami, në orën 15:40:00 është larguar nga kabina. Kontrollori është në kabinë bashkë me një kolegun e tij (i futur në kabinë në orën 15:51:40). Në orën 15: 52:52 në sportel paraqitet një shtetas i cili përshëndetet nga kontrollori dhe zhvillojnë këtë bisedë:

***Kontrollori:** Ç'ar bone...si i ki hallet, ç'ar ke bo...krejt mirë ...a shumë mirë...mirë... krejt shnoshj mirë...*

Ndërkohë që flet me shtetasin në sportel, ja bën më shenjë kolegut të tij që ka në kabinë duke i lënë të kuptojë se duhej të dilte jashtë nga kabina, por ai nuk lëviz.

Në vijim e biseda me shtetasin, vazhdon , edhe pse kolegu i tij, është brenda në kabinë:

***Kontrollori**: Mos i ki nja 10 euro letër...?*

***Shtetasi:**Aaa.*

***Kontrollori**: Ja 10 euro letër, mos i ki...?*

Shtetasi: *Flet diçka me kontrollorin (por nuk dëgjohet mirë)*

521. **Në orë 15:55:55 të datës 02.03.2022** në kabinën që janë instaluar mjetet e përgjimit audio dhe video me nr. 6, në sportel paraqitet një shtetas tjetër dhe kontrollori i drejtohet me fjalët: "***Ç'ar bone mo...ku i ki ja 10 euro ti...hajt...ja dhjetë euro letër ku i kie***". Pasi mbaron këtë fjalë, ndërpritet regjistrimi audio. Është bërë këqyrja e sistemit TIMS, në rubrikën hyrje shtetas shqiptarë, nga ku rezulton se në orën 15:55:00 të datës 02.03.2022 është regjistruar në sistemin TIMS shtetasi shqiptar *Albert Akshi Trimi* i datëlindjes 05.06.2000, i cili udhëton me automjetin tip kamion me targë AA417YN/AHR349 të drejtuar prej tij. Ky shtetas është regjistruar në sistemin TIMS nga punonjësi i policisë **Vehbi Nerguti**, pikërisht në orën 15:55:55.

522. **Në orën 16:31:11 datë 02.03.2022** në sportelin ku janë instaluar mjetet e përgjimit audio dhe video me nr. 6 është paraqitur një shtetas, i cili pasi paraqet dokumentet identifikues tek kontrollori **që ka zëvendësuar Urim Lamin**, pasi ky është larguar nga kabina, ky i fundit i thotë:

Kontrollori: ***Ç'ar bone mo...mos i kie ja 10 euro letër... ja dhjetë euro, mos i kie... letër*** ...

523. **Në orën 17:10:46 datë 02.03.2022** në kabinën që janë instaluar mjetet e përgjimit audio dhe video, me nr. 6, nga ana e kontrollorit **Urim Lami** zhvillohet një bisedë me një shtetas të cilit i përmend edhe fjalën "kafe". Biseda e transkriptuar është si më poshtë:

Urim Lami: *Kur ka ardhur në Medare, ky kerr ?*

Shtetasi: *Aaa...*

Urim Lami: *Kur ka ardh në Merdar ?* ***Shtetasi:*** *Dje*

Urim Lami: ***Po pse, ç'kaq kafe të vogël dhe ti...*** *Car e kie këtë... pronarin e kerrit....Merdare si e ka emrin ky pronari i kerrit?*

Urim Lami: *Djalë Kukësi...I kuj kahut, je ti...****Si mo dhe ç'kaq kafen e vogël ti...pajsh zotin!...çi kaq kafe të vogel dhe ?...aaa...***

Shtetasi: *Flet (por nuk dëgjohet mirë).*

Urim Lami: *Po mos, kerri është me problem ?...Jam tuj e regjistrua unë...****me ardh kush me e verifiku me nxjerri punë...mos jetë kerri i vjedhun...?***

Referuar orarit të veprimeve rezulton shtetasi kosovar *Mirsad Rekaliu*, i dtl 05.07.1992 mjeti me targë BP 045 TV të drejtuar prej tij. Ky shtetas është regjistruar në sistemin Tims nga punonjësi i policisë **Urim Lami**, pikërisht në orën 17:12:00.

524. **Në orën 18:21:28 datë 02.03.2022**, në kabinën, ku janë instaluar mjetet e përgjimit audio dhe video me nr. 6, ku është duke punuar kontrollori **Urim Lami,** është evidentuar rasti ku ky kontrollor i kërkon para drejtuesit të mjetit, konkretisht pasi kryen veprimet me këtë drejtues mjetit në sistem i thotë këtij te fundit "***fute nji kafe***", dhe i zgjat dokumentet e makinës që janë të futur në një zarf plastik. Shtetasi thërret dikë në emër dhe i thotë "***hajde pak këtu***", që duket se është drejtuesi i një kamioni. Konkretisht nga verifikimi në TIMS, sipas orarit të veprimeve rezulton se bëhet fjalë për shtetasin shqiptar *Emin Adem Duraku* i dtl 29.01.1969, i cili udhëton me automjetin tip kamion me targë Ab315 AJ të drejtuar prej tij. Ky shtetas është regjistruar në sistemin Tims nga punonjësi i policisë Urim Lami.

525. **Në datë 02.03.2022 në orën 20:28:27**, në kabinën ju janë vendosur mjetet e përgjimit me nr. 6, është duke punuar një kontrollore **Elidjana Toçila** e cila gjatë përpunimit të një autobusi me 24 pasagjerë, kundrejt mos regjistrimit të një pjese të tyre në sistem, i kërkon ryshfet drejtuesit të autobusit e konkretisht biseda është si vijon:

Kontrollorja Elidjana Toçila:..*Me c 'farë je...*

Shtetasi: *Me autobus ...*

Kontrollorja Elidjana Toçila *: Sa veta ke?*

Shtetasi *i thotë 24 (njëzetë e katër)...*

Kontrollorja Elidjana Toçila: *O zoti i madh, ku do i çosh 24 veta...thuaj ti bëjnë gati dokumentet...**thuaj ti bëjnë gati ...se kam shefin nëpër këmbë dhe nuk ma mbanë të ikësh direkt...***

Pasi shkon shoferi, kontrollorja i jep dokumentet dhe i thotë, "***na jep një kafe këtu***", duke i drejtuar një pasaportën. Sipas sistemit TIMS dhe drejtuesi i mjetit është shtetasi *Zenel Idajet Halimi* i dtl 15.03.1076, por nuk rezultojnë të regjistruar 24 persona sa ka pasur autobusi (siç del dhe nga biseda e zhvilluar), por janë riregjistruar vetëm gjysmit e tyre. Midis shtetasve te pa regjistruar është dhe shoferi i autobusit.

DATA 03.03.2022

526. **Në datë 03.03.2022 ora 11:02,** punonjësi i policisë ***Fatri Iseberi*** me detyrë kontrollor, është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të identifikuar sipas sistemit TIMS si *Agron Berisha* i dtl.30.03.1982, me automjetin me targë 01547QO, të cilit i kërkohet doza e dytë e vaksinës. Në bisedën e tyre dëgjohet shtetasi që i drejtohet kontrollorit me fjalët *"si me ja bë tashi"* dhe përgjigja e kontrollorit Fatri Iseberi i cili i drejtohet me fjalët "*me ta lëshu pa regjistru.. apo mos me e bërë testin fare .. dhe bëj një zgjidhje ti,...apo e bëjmë zgjidhjen ne"*, por nuk rezulton të janë evidentuar veprimet konkrete pasi pamjet e kamerës kanë qenë të kufizuara. Po ashtu Fatri Iseberi dëgjohet kur i thotë se "*testi kushton 20 Euro*" si dhe shprehjen "*Djali duket shënosh e mirë*", si dhe "*E bëjmë zgjidhjen këtu vetë*".

DATA 04.03.2022

527. **Më datë 04.03.2022 në orën 11:19:30** ne sportelin ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr. 6 dhe po punon kontrollori Muhamet Cengu, nga pamjet audio dhe video është fiksuar momenti kur i ka kërkuar një shtetasi ryshfet me qëllim mos regjistrimin në sistem. Bisedat mes tyre zhvillohet si më poshtë:

Muhamet Cengu: *A ke për të ma dhënë librezën...Librezën a ke për të ma dhënë?*

Shtetasi: *Po,*

Muhamet Cengu:A ke tuj na e fut noj birre në të, a jo?

Shtetasi:*Ëeee.,*

Muhamet Cengu:A je tuj na qëras me nonje birrë ajo ?

Shtetasi: *Po, po...*

Muhamet Cengu:Po fute me libreze more...ne Kosove pse të lënë me bo dorheqje o njish ...

Shtetasi: *-(flet po nuk degjohet mirë)-.*
Nga pamjet filmike duket se, pasi merr një kartëmonedhe që shtetasi i ka futur në librezë, e fut atë në tastierën e kompjuterit që ka përpara dhe konstatohet që shtetasin nuk e regjistron në sistem.

528. **Në datë 04.03.2022 në orën 11:28:30,** në sportelin ku janë instaluar paisjet e përgjimit audi dhe video me nr. 6 dhe ku punon kontrollori **Muhamet Cengu**, gjatë kryerjes së veprimeve me një automjet pa targa, merr një sasi kartëmonedhash në këmbim të lehtësimeve të veprimeve me këtë mjet. Nga këqyrja e sistemit Tims rezulton se më datë 04.03.2022 në orën 11:36, janë përpunuar dokumentet e shtetasit *Petrit Basha* me automjet pa targa, regjistruar nga kontrollori Cengu M dhe ku është bërë shënimi *"kaluar për veprime doganore"*.

529. **Në datë 04.03.2022 në orën 12:06:30** në sportelin ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr. 6 dhe ku punon kontrollori **Muhamet Cengu,** është duke përpunuar dokumentacionin e shtetasit kosovar *Burim Kadriu*, i dtl 03.03.1983 i cili udhëton me automjetin me targë 01353OM, për të cilin sipas bisedave, flitet për mungesë dokumentacioni, konkretisht autorizimin për mjetin që nuk ishte në emër të tij. Biseda e zhvilluar mes kontrollorit dhe shtetasit në fjalë, është si më poshtë:

Muhamet Cengu: Autorizim për makinën keni ?
Shtetasi:...Jo, bre
Muhamet Cengu: Po pse s'ke marre bre ?
Muhamet Cengu: *Po mire shifet si je...apo....**Ec pak para, hajde mëri dokumentat dhe ketë radhe do të kaloj herën tjetër s'kalo**....*

Pasi kontrollori mbaron përpunimin e këtij shtetasi, pas pak çastesh kthehet dhe i jep një kartëmonedhe kontrollorit, i cili ngre tastierën e kompjuterit dhe e vendos nën të.

530. **Me datë 04.03.2022, në orën 12:06:30** në sportelin ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audio dhe video me nr. 6 dhe ku punon kontrollori Muhamet Cengu , me një shtetas që është paraqitur zhvillon ketë bisedë:

Muhamet Cengu: *Përshëndetje nji ç'ar bone?*
Shtetasi: *Unë erdha vec për at.. c'atë e numër (kështu dëgjohet)...pa kshtu...*
Muhamet Cengu: *...-Nuk flet...i flet dikujt tjetër dhe i thotë si kalute a jeni mirë...A jeni lodh...hec-,* ***dhe ndërkohë ka në dorë një kartëmonedhë të prerjes 1000 lekë të cilën e merr dhe e vendos nën tastierën e kompjuterit.***

531. **Me datë 04.03.2022, në orën 10:24:45** në sportelin ku janë instaluar pajisjet e përgjimit audi dhe video me nr. 6 dhe ku punon kontrollori Muhamet Cengu, gjatë përpunimit në këtë orar të shtetasit kosovar *Reshat Qela*, zhvillohet biseda si vijon:

Muhamet Cengu: Si kalove ç'ar bone...nga po shkon...Ç'ar eshte ai...A ka noj kafe ore...
Shtetasi: Ç'fare ?
Muhamet Cengu: Kafe, kafe a ka a?

Sapo mbaron regjistrimin në sistem të shtetasit, Muhamet Cengu ngre tastierën dhe vendos diçka nën të. Është bërë kryerja e sistemin TIMS, në rubrikën hyrje shtetas të huaj që hyjnë në territorin e R.Sh dhe nga rezulton se në orën 10:24:00 të datës 04.03.2022 është regjistruar në

sistemin TIMS shtetasi kosovar *Reshat Qela*, i datëlindjes 26.05.1979, i cili udhëton me automjetin tip kamion me targë 03870HH drejtues mjeti. Ky shtetas është regjistruar nga Kontrollori Cengu M, me të cilin vijon komunikimin si më poshtë:

Muhamet Cengu: Ka po shkon...*(Ndërkohë vazhdon dhe bën regjistrimin e shtetasit në kompjuter dhe në vijim i thotë)* ...***Hec me para o shofer dhepo s'e pate hajde merri dokumentet dhe ik ...hajd se s'jam tu ta... hajd...***

Në këtë moment dokumentet e shtetasit që regjistroi në sistem i merr dhe i vendos midis dokumenteve që ka në tavolinë. Pas rreth një minute në sportel paraqitet përsëri shtetasi të cilit pak më parë kontrollori i kishte mbajtur dokumentet dhe e pyet "***|sa do"...*** Kontrollori i thotë "***sa të kesh qef, faleminderit dhe je i nerume"***, merr nga ai diçka dhe e vendos nën tastierën e kompjuterit.

DATA 05.03.2022

532. **Datë 05.03.2022 ora 10:05**, në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6 është duke kryer shërbimin punonjësja e policisë e verifikuar në sistemin TIMS kontrollore ***Elidjana Toçilla***, e cila është duke përpunuar dokumentet e një drejtuesit të automjetit tip autobus i cili hyn nga Republika e Kosovës me destinacion në Budva, i verifikuar në sistem si shtetasi *Jener Spahiu,* i dtl.02.01.1969, drejtues i mjetit tip "autobus" me targa 05939FO. Ky shtetas dëgjohet ku i deklaron kontrollores Elidjana Toçilla se "***në mjetin e tij ka 46 persona"***. Kontrollorja Elidjana Toçilla shikohet se pasi merr dokumentin e drejtuesit të mjetit, në të cilin ai kishte futur një kartëmonedhë prerje 5 euro, e merr këtë kartëmonedhë dhe e fsheh poshtë tastierës kompjuterit. Kontrollorja regjistron vetëm drejtuesin e autobusit dhe pasagjerët nuk i regjistron. Kontrollorja Elidjana Toçilla shikohet nga regjistrimi video ku pasi i jep pasaportën drejtuesit të autobusit, çon me dorën e djathtë tastierën, merr kartëmonedhën 5 euro dhe e fut në xhep.

533. **Në datë 05.03.2022** regjistrimi dhe transmetimi i pamjeve filmike të pajisjeve përgjuese është ndërprerë për shkak të ndërhyrjes së punonjësve të policisë. Konkretisht nga këqyrja e pamjeve filmike rezulton se fillimisht kanë ndërhyrë dy punonjës të doganës pasi në veshjen e tyre (xhup) mbanin mbishkrimin dogana. Prezent njëri mbas tjetrit kanë qenë edhe punonjësit e policisë Arben Goçi dhe Haqif Halilaj. Nga pamjet filmike rezulton se ndërhyrja për heqjen e pajisjeve përgjuese është kryer në **datë 05.03.2021** dhe heqja e tyre është realizuar nga punonjës i doganës. Nga aktet e administruara rezulton se pajisjet e përgjimit janë dorëzuar nga punonjësi i policisë **Reni Dokolli** duke deklaruar njëkohësisht se është edhe ai personi që i ka gjetur, por këtyre pajise përgjuese ju janë hequr kartat e memories, për të fshehur përmbajtjen e ruajtur në kartë memorie (audio dhe video). Ky fakt rezulton edhe nga biseda e kryer në aplikacionin **whatsapp** nga punonjësi i policisë Reni Dokolli me shtetasin e regjistruar në kontakte si Jon Ramovi, përdorues i numrit 0697402456, në datë 06.03.2022, ora 08:27 min, datë të cilit i dërgon fotografi të pajisjeve përgjuese, duke i saktësuar se janë edhe me kartë memorie, dhe ndër të tjera, i thotë***: "Reni: ishte dhe me fishë kërkimi...ishte dhe me kartë memorie". Joni: Videot e sa ditëve kishte regjistru?.....Reni: ishte 32 G kishte 9-10 dite".*** Ndër të tjera e pyet nëse janë pajisje që janë të lidhura me whireless *pasi duan të sigurohen nëse janë transmetuar pamje*

filmike. Në vijim, nga këqyrja e komunikimeve në whatsapp në telefonin e të pandehurit Reni Dokolli, ndër të tjera, rezulton se në datë 08.03:2022, ora 12:38, ai zhvillon këtë bisedë me shtetasin Jon Ramovi, me përmbajtje si më poshtë:

***Reni**: Jon ajo si qark pa kart memorien, a ka shans me pas video aty të ruajtura?*

***Joni**: Se besoj. 80% do thoja jo, se prandaj ja kna vu vendin e kartës së memories.*

Reni**: Ok, rrofsh ngaqë do i dorëzojmë, për të shikuar origjinën e pajisjeve **edhe të jena të sigurt ata ta prishim qarkun apo jo?

Në rrethana të mësipërme, rezulton se punonjësi i policisë Reni Dokolli bisedon se para se të dorëzojnë pajisjen e përgjimit, duan të sigurohen nëse ka transmetuar pamje online pasi po përgatiten për t'i dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ku ishin referuar aktet për veprën penale "Ndërhyrje pa të drejtë në jetën private", parashikuar nga neni 121 i K.Penal.

534. Sipas akteve të marra me shkresën nr.767/1 Prot, datë 21.04.2022 nga Prokuroria e Rrethit Kukës, më anë të së cilës janë dërguar kopje të akteve të fashikullit të procedimit penal nr.113 viti 2022, i regjistruar për veprën penale, "*Ndërhyrje pa të drejtë në jetën private*", parashikuar nga neni 121 i K.Penal, rezulton se në kuadër të këtij procedimi është administruar një informacion drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dërguar nga Drejtori i Departamentit, i cili në këtë material informonte Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit se ishte informuar nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Kufirit & Migracionit Kukës, Fran Kaçorri, se në datë 06.03.2022, njëri nga punonjësit e policisë kufitare në P.K.K Morinë kishte konstatuar një pajisje që pulsonte ngjyrë blu. Më pas kondicionerët janë hapur nga ana e tyre duke hequr pajisjet. Këtë pajisje përgjimi, pa kartën SIM, i kishte me vete Shefi i Stacionit Lahert Sulo duke e vendosur në tavolinën e zyrës së Drejtorit, Fran Kaçorri, të cilit i ka sqaruar situatën. Me shkresën nr. 614 Prot., datë 31.03.2022, i është kërkuar dokumentacioni informues Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në lidhje me konstatimin e rastit nga ana e punonjësve të policisë kufitare Morinë. Në përgjigje të shkresës është vënë në dispozicion edhe një informacion i përpiluar nga Drejtoria e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin me informacion të datës 06.03.2022 të dhënë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Kukës, Fran Kaçorri, ku informohet se kartat e memories së këtyre pajisjeve të përgjimit janë shkatërruar kur janë gjetur nga punonjësit e policisë kufitare.

535. Nga këqyrja e komunikimeve të të pandehurit Reni Dokolli, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit me datë 21.03.2022, rezulton se ai ka dërguar me video (pamje filmike) një video, ku në sedilen e parë të një automjeti shfaqet një shumë parash prerje ***50-euro,*** të cilat ja dërgon në datë 16.03.2022, koleges se tij, punonjëses së policisë ***Elidjana Toçila,*** dhe kjo e fundit i drejtohet me fjalët: "....***Ore ruaji mos i harxho kot, se do na duhen për avokat....***". Po ashtu, konstatohet biseda e kryer me të pandehurin **Laert Sulo,** i cili në datën 08.03.2022 i ka dërguar dokumentin fotografi të pasaportës së një shtetasi dhe një kopje të dokumentit të mjetit të tij, gjatë kryerjes së procedurës për kalimin në kufirin shtetëror. Gjithashtu, në bisedën e zhvilluar me kontaktin *Cabe Duraku* me numrin 0683044216, bisedojnë për kalimin e një kushërire të

shtetasit Cabe Duraku për në Kosovë pa u regjistruar në sistem, duke i kërkuar ndihmë që Reni Dokolli të ndikojë për këtë veprim tek punonjësit e policisë kosovare. Në lidhje me ketë veprim e lënë të takohen ditën e nesërme. Po ashtu, është evidentuar në procesverbalin e këqyrjes biseda e kryer me shtetasin e shënuar në kontakte si *Valon Ahmeti Zvicër* me nr.cel +41792070363 me përmbajtje si më poshtë:

4:48 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: ***Kam nje pyetje.....***
[4:48 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: Ti qe je kufitar.
[4:49 pm, 12/02/2022] ***Reni:*** *Po vlla me thuaj*
[4:49 pm, 12/02/2022] ***Valon Ahmeti Zvicer: Shif jam tu shku Kumanove ne Maqedoni***
[4:49 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: ***Kam mar ça pluma***
[4:49 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: ***A kan skaner ne kabina ata ?..***
[4:50 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: ***Apo veq po dyshun te nalin***
[4:50 pm, 12/02/2022] Reni: ***Tani me dyshu te fusin edhe ne skaner***
[4:50 pm, 12/02/2022] Reni: ***Mesa di un kan skaner***
[4:50 pm, 12/02/2022] Reni: Po vec po dyshuan
[4:50 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: ***Dmth ne kabin nuk ka rezik***
[4:51 pm, 12/02/2022] Reni: ***Jo aty jo***
[4:51 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: E mir pra ne regull
[4:51 pm, 12/02/2022] Valon Ahmeti Zvicer: Flm Shum.

536. Nga këqyrja e aplikacionit "whatsapp" të aparatit të telefonit të punonjësit të policisë Laert Sulo, dokumentuar në procesverbalin me datë 21.03.2022, kanë rezultuar disa komunikime të tij me vartësit dhe kolegët. Konkretisht, është konstatuar një komunikim i datës 26.12.2021 kur në telefonin e tij, nga numri 0693901469, i vjen një fotografie pasaportës së shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe fotografi si dhe targa e mjetit "BL 541109" Pas fotografive të mjetit (të cilat nuk rezultojnë të jenë hapur) ky Laerti i drejtohet me fjalët : "***Sa euro i bie***", ndërsa kontakti i përgjigjet : "***60 euro***", Laerti "***Ok***" ndërsa kontakti i përgjigjet "*Faleminderit shumë shef.*". Ky komunimim zhvillohet ne harkun kohor 09.43-09.45 a.m (paradite).

537. Nga verifikimi në sistemin TIMS të informacionit, dokumentuar në procesverbalin përkatës, rubrika hyrje-dalje nga Republika e Shqipërisë, rezulton se shtetasi Ahmet Kuçanaj me automjetin me targa "BL 541109", në datën që zhvillohet komunikimi si më sipër, pikërisht në datë 26.12.2021 ora 08:23 ka hyrë në R.Sh nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan dhe po në të njëjtën datë, datë 26.12.2021, ora 12:34 min në sistemin TIMS ka shënimin se ka dalë nga P.K.K Morinë. Nga këqyrja e sistemit TIMS, në regjistrimin e kryer në P.K.K Murriqan, në hyrje, rezulton se data dhe ora e hyrjes janë të njëjta, ndërsa në regjistrimin e daljes nga Pika e Kalimit Kufitar Morinë, rezulton se data e daljes është 26.12.2021, ora 12.34 ndërsa data e regjistrimit është 28.12.2021, ora 11.26. Pra, rezulton se data e regjistrimit të dokumentit në sistem nuk përkon me datën e daljes së këtij shtetasi nga sistemi TIMS, pasi data e regjistrimit është datë 28.12.2021, ora 11:26, ndërsa data e daljes e regjistruar është 26.12.2021 ora 12:34. Rubrika e datës së daljes plotësohet manualisht nga kontrollori që kryen veprimin, ndërsa data e regjistrimit është data që plotëson automatikisht sistemi TIMS, e cila përkon me momentin që

kryhet veprimi, çka jep të dhëna se regjistrimi i daljes që ka marrë datën 28.12.2021, tregon se veprimi për regjistrimin e këtij veprimi (*daljes së shtetasit Ahmet Kuçanaj me datë 26.12.2021*) në fakt është regjistruar dy ditë më vonë.

538. Po ashtu, nga këqyrja e komunikimeve të të pandehurit Lahert Sulo, pasqyruar në procesverbalin përkatës me datë 21.03.2022, janë evidentuar edhe disa komunikime të tjera me punonjës të PKK, të cilat akuza i referon si pjesë të veprimtarisë së kundërligjshme të të pandehurit Lahert Sulo por edhe të të pandehurve të tjerë. Konkretisht rezulton se në datë

539. Në datë 21.02.2022 Fran Kaçorri, Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Kukës, në aplikacionin whatsapp i dërgon Lahert Sulos të ridërguar (forword) këto tekste mesazhesh :"*Emrat e nënvizuar janë dy volejbolliste që sic më vënë në dijeni nga Korça nuk kanë leje qëndrimi në Kosovë. Njëra është nga Cuba tjetra është nga Brazili. Ti kije parasysh për ditën e premte.*" Ndërkohë në datë 23.02.2022, pra jo në të njëjtën ditë sic referohet në faktin objekt akuze, Fran Kaçorri i dërgon Lahert Sulos të ridërguar (forword) këto tekste mesazhesh: "*Aida Topalli, Miranda Meta, Frenki Zotkaj, Marviks Shantoja. AA872NB. Nesër janë për Ks ti ndihmojnë.* "Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rubrika hyrje dalje, rezulton se këto shtetase nuk janë regjistruar as në hyrje të R.Sh e as në dalje për datat 21.02.2022 dhe datë 22.02.2022.

540. Referuar komunikimeve dhe deklarimeve të dhëna nga i pandehuri Fran Kaçorri, lidhur me faktet që lidhen me kalimin e volejbollistëve, në datë 14.09.2022, është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Arben Saliu, punonjës policie i cili ushtron funksionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i cili ndër të tjera, ka deklaruar se :"*Më sa më kujtohet, nga muaji shkurt i vitit 2022 jam vënë në dijeni nga shtetasja Tatjana Marash, në atë periudhë drejtuese e klubit shumë sportesh Skënderbeu në Korçë, se do të vinte të luante me ekipin e volejbollit Skënderbeu, një ekip kosovar në përbërje të të cilit ishin edhe dy lojtare të huaja. Sipas znj. Marashi volejbollistet e huaja, njëra nga Kuba dhe tjetra nga Brazili, nuk kishin dokumentacionin e duhet për të udhëtuar drejt vendit tonë. Ajo kërkoi që për këtë rast të zbatoheshin procedurat ligjore. Për këtë gjë unë vura në dijeni krahas Drejtorit të Policisë Kufitare në Kukës, drejtues Fran Kaçorrin, edhe homologun e tij në Korçë, nëse ekipi do të futej përmes Qafë Thanës. ...Sqaroj se nuk kam pasur asnjë komunikim tjetër nëse këto sportiste janë lejuar ose jo për të hyrë në Shqipëri, thjesht kam transmetuar këtë të dhënë tek personat kompetentë.*".

541. E pyetur në datë 25.07.2022, në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit, shtetasja **Aida Topalli** ka deklaruar se :"*Më kujtohet ky komunikim i cili ka ndodhur rreth datës 23 shkurt 2022. Në datë 24 shkurt, në funksion të një investigimi të emisionit ku unë jam e punësuar, do të udhëtonin drejt qytetit të Prizrenit në Kosovë. Për këtë udhëtim është vënë në dijeni edhe policia e Kosovës pasi investigimi që po bënim kishte rrezikshmëri të lartë dhe në kuadër të bashkëpunimit me policinë e shtetit, i kemi vënë në dijeni dhe ju kemi kërkuar të mos hasnim pengesa në PKK Morinë. Bisedën e parë e ka bërë në dijeninë time drejtuesit e emisionit. Po nga drejtuesit e emisionit na është thënë të komunikojmë me drejtuesin e policisë kufitare. Në lidhje më këtë rast, unë nga numri im i telefonit...në aplikacionin whatsapp kam dërguar emrat e*

kolegëve që do shkonim në Prizren për të realizuar emisionin. Personat që unë kam udhëtuar janë ata që ju pyesni dhe janë të gjithë kolegë të mi. Theksoj se me drejtuesin e policisë kufitare unë nuk kam njohje dhe ka qenë vetëm ky komunikim për arsye pune. Në PKK nuk na kanë sjellë pengesa dhe kemi kaluar pa u regjistruar pasi dhe kohën e kishim shumë të paktë.".

542. Po ashtu, nga këqyrja e telefonit dhe komunikimeve të realizuara në aplikacionin whatsapp, *rezulton se në datë 24.02.2022 Fran Kaçorri dërgon sms kundrejt Laertit, me tekst* ***"Hyundai Santa Fe e zeze AA818AY, Florian Budina me familjen"....per Ks*** *" e Laerti e pyet,* ***"Eshte ketu tani po vjen?"....Frani..."Po"....****Laerti ,* ***"Ok"***. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rezulton se ky shtetas nuk ka hyrje dalje nga R.Sh në datë 24.02.2022, dhe për këtë fakt akuza referon se ky shtetas, pra shtetasi Florian Budina, me ndikimin e Fran Kaçorrit dhe me veprimin e punonjësit të policisë Lahert Sulo, ju është shmangur veprimeve të regjistrimit të tyre në sistemin TIMS si në hyrje dhe në dalje të R.Sh-së.

543. Në lidhje me këtë fakt janë kryer verifikime në sistemin TIMS edhe për hyrje daljet e shtetasit Besmir Salillari dhe nuk kanë rezultuar hyrej dhe dajle të këtij shtetasi në këto data.

544. Në lidhje me këtë fakt është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi **Florian Budina,** i cili sipas procesverbalit me datë 20.09.2022, ka deklaruar se : "*Nuk më kujtohet nëse kam kaluar këtë datë për në Kosovë, por unë shkoj vazhdimisht në Kosovë, pothuajse çdo javë, ka raste dhe dy herë në javë pasi kam biznesin tim në Kosovë, një degë të kompanisë që kam edhe në Shqipëri. ..Nuk jam në dijeni përse janë përmendur të dhënat e mia në atë sms por unë nuk mbaj mend të kem patur ndonjë problem në PKK Morinë...Po automjeti është në pronësi të kompanisë time. Automjeti me targa,* ***"AA818AY"*** *është automjet në pronësi të kompanisë time.....Nuk i kam kërkuar ndonjë personi tjetër për të ndërhyrë dhe nuk kam njohje me shtetasin Pëllumb Salillari.* "Pyetjes nëse e njeh shtetasin Lehert Sulo i është përgjigjur "*Jo nuk e njoh kush është.*".

545. Lidhur me konstatimin e targës së mjetit ***AB232CK*** dërguar nga Fran Kaçori në drejtim të Lahert Sulos, ai ka shpjeguar ndër të tjera se:" "*.....Po këtë ditë që është kryer ky komunikim me shefin e stacionit, më ka telefonuar shtetasi Pëllumb Salilarri me nr tel 0682049391 dhe më ka thënë që kam vajzën me një fëmijë të sëmurë së bashku me bashkëshortin e cila është në P.K.K Morinë, dhe janë duke shkuar në Kosovë për të kryer një vizitë mjekësore për fëmijën e vogël. Bisedë e kryer në aplikacionin ëhatcup, dhe ndërkohe menjëherë sa mbyllem bisedën më dërgon me tekst të dhënat e mësipërme. Të dhëna të cilat ja kam nisur në whatsapp shefit të stacionit Lahert Sulo duke i thënë njëkohësisht që të vlerësohet dhe ti jepet përparësi meqenëse ka fëmijën e sëmurë. Biseda ka qenë vetëm telefonike unë nuk kam patur asnjë kontakt me këta persona asnjëherë dhe nuk i njoh. Dua të shtoj se unë asnjëherë nuk ju kam dhënë urdhra vartësve të mi për të mos kryer regjistrime të hyrje-daljeve të shtetasve ne kufi apo të automjeteve me të cilat ata udhëtojnë...* ".

546. Në lidhje me këtë fakt është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit edhe shtetësi **Pëllumb Salillari,** i cila sipas procesverbalit me datë 19.09.2022, ka deklaruar se :"*Nuk më kujtohet me saktësi data se kur ka ndodhur si bisedë por mbaj mend që unë e kam telefonuar Fran Kaçorrin në numrin....dhe i kam thënë që është për të ikur në Kosovë mbesa ime*

*Xhulia Gramos Rrapaj e cila udhëtonte me automjetin me targa **AB232CK**, dhe jo targa AA801AY. Unë ja kam dhënë si targë automjeti me qëllim që të mos priste në radhe dhe të vonohej por jo se ka pasur ndonjë urgjencë apo ti kem kërkuar ndonjë favor tjetër, apo ti kem kërkuar që të mos regjistrohej në sistemin TIMS. Unë nuk e kam patur problem këtë gjë pasi edhe vetë kur kaloj i jap menjëherë dokumentet e identifikimit pa ndonjë problem. ..Djali im Besmir Salillari dhe bashkëshortja e tij Elena Salillari në atë periudhë kanë qenë në SHBA dhe nuk kane qenë farë në Shqipëri....Unë nuk njoh ndonjë person me këtë emër por dhe as ndonjë punonjës në kompanitë e mia. Më sa jam interesuar kam vetëm një shofer me emrin Florian Dema por nuk ka lidhje me përdorimin e automjetit të familjes sime...Jo unë nuk kam vajzë, kam vetëm dy djem..*".

547. Në lidhje me këtë fakt është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasja **Xhulia Rrapaj**, e cila sipas procesverbalit me datë 09.09.2022, ka deklaruar se :"*Po unë kam shkuar në Kosovë diku nga muaji janar 2022, fillimi i shkurtit dhe kam udhëtuar me automjetin me targa AB232CK, që është në pronësi të firmës ku unë punoj. Unë do të shkoja në Kosovë sepse kisha një autorizim për të tërhequr një certifikatë regjistrim biznesi në Prishtinë. Për shkak se kam qenë më grip dhe jo në gjendje të mirë shëndetësore, unë i kam kërkuar shtetasit Pëllumb Salillari tek i cili edhe punoj, me qëllim për të mos mbajtur rradhë në Morinë, që mos kishte ndonjë mundësi të fliste me ndonjë në PKK Morinë. Edhe kur kam dalë edhe kur kam hyrë kam ecur shpejt pa radhë pasi mu dha prioritet nga punonjësi i policisë. ...Nuk kam dijeni nëse më kanë regjistruar ose jo në kufi. Unë kam ardhur në Kosovë dhe jam kthyer brenda ditës...*".

548. Po ashtu, nga këqyrja e komunikimeve të gjetura në telefonin e të pandehurit Lahert Sulo, është konstatuar biseda me shtetasin Naim Byberi, (punonjës policie), i cili në datë 01.01.2022 i ka dërguar targat e katër automjeteve, dhe konkretisht "*AA036TI", "AB468DH", 'AA222IA" dhe "AA728ZH"*, te cilët në datë 01.02.2022 sipas porosisë ne bisedë janë për të hyrë në R.SH. Laerti e sqaron më tej se ja ka lënë porosi vartësve të vet. Nga këqyrja e komunikimeve me punonjësin e policisë me nr tel 069 67 66 665 , numër në përdorim të të pandehurit Ani Hoxholli me detyre përgjegjës turni ne P.K.K Morine, rezulton se këto mjete ***(porosi e Naim Byberit)*** i janë lenë porosi këtij të fundit duke i thënë: "*Këto katër makinat do vijnë nesër për të kaluar do shkojnë në Kosovë. N.q.s. vijnë në turnin tënd do ti ndihmosh të kalojnë. Por do të them. Kur të jenë afër...* ".

549. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rubrika të dhëna për automjetet targa, ka rezultuar se automjet me targa *"AA036TI"*, që i përket shtetasit *Ardian Barxho* nuk ka të regjistruara hyrje dalje ne sistemin TIMS në date 02.01.2022. Automjeti me targe "AB468DH" i përket shtetasit *Sulejman Gjakrosa*, dhe nga verifikimi ne sistemin TIMS rubrika hyrje dalje, edhe ky shtetas nuk është i regjistruar në hyrje dalje nga R.Sh pas vitit 2020. Nga verifikimi në sistem nuk kanë rezultuar të dhëna për automjetin me targa *"AA222IA"*, ndërsa automjeti me targa "AA222IA" ka rezultuar se i përket shtetasit *Vladimir Lush Pepkolaj*, dhe për të nuk ka të dhëna në sistemin TIMS, dhe po ashtu nuk konstatohet regjistrim hyrje dalje ne kufi me datën e bisedës më sipër.

550. Po nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Lahert Sulo dhe komunikimeve të tij, ka rezultuar se përgjegjësit të turnit **Artan Redhaj,** shefi i stacionit **Laert Sulo**, në datë 26.12.2021 i ka dërguar me sms një targë automjeti, *"AA070NV"*, duke i thënë, "*Për 5 minuta janë atje, ndihmoje pak pe nga pala Kosovare"*. Artani ja kthen "*Ok, çfarë makine është shef?* Laerti: *Nuk e di çfarë tip mjeti është.* Artani: *Ok se jam vete ketu. Ora 10:29 min Artani ja kthen, 'Kaloi shefi"*.Laerti: "*Ok Faleminderit"*. Nga verifikimi në sistemin TIMS rubrika Raporte-Statistika dalje shtetas shqiptarë, me datë datë 26.12.2021 targa e mësipërme nuk figuron e regjistruar në sistemin TIMS.

551. Për sa i përket rastit të konstatuar në ngarkim të punonjësit të policisë ***Artan Redhaj*** me detyrë Përgjegjës turni në P.K.K Morinë, i pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në praninë e mbrojtësit ligjor, lidhur me këtë fakti, ai ka deklaruar se :" *Në lidhje me episodin e pasqyruar ne komunikimet e mia të kryera me shefin e stacionit Lahert Sulo, sqaroj se mua më është dërguar në rrjetin social whatsapp nga ana e tij me tekst"AA070NV", për pesë minuta janë aty, ndihmoji pak nga pala kosovare". Unë në cilësinë e përgjegjësit të turnit isha duke qëndruar përballë kabinave të kontrollorëve në hyrje të R.Sh-së. Duke qenë se neve se bashke me policinë Kosovare i kemi zyrat e përbashkëta në një vend shikoj se në atë moment kalon përgjegjësi i turnit të palës Kosovare që ka qenë me shërbim atë ditë të cilin e thjesht si fytyrë por që nuk ja di emrin. I them që kam një porosi të shefit që ma ka çuar me sms për ta ndihmuar pak që të kalojë, mos të ketë problem me radhën. Në moment që ka ardhur makina që më është lënë porosi nga shefi i kam thënë drejtuesit të mjetit duke e orientuar me shenjë drejt kabinës së palës Kosovare ku ishte e dhe Oficeri përgjegjësi i turnit të palës Kosovare që kisha folur pak më parë. Pasi i pashë që kaluan i kthej përgjigje shef Lahertit me sms që "Ok Kaluan".....nuk kam dijeni se çfarë përfaqësojnë këta persona as se kush ishin dhe as për ku do të udhëtonin....shtetasit në dalje regjistrohen nga pala Kosovare dhe unë nuk ju kam kërkuar atyre që të mos i regjistronin personat në kufi.....Unë e kam filluar këtë detyrë, në muajin dhjetor të vitit 2021 dhe sqaroj se dhe periudha ime kohore në këtë detyrë, ka qenë shumë e shkurtër, ndërsa në lidhje me porosinë e shefit dua të sqaroj se ajo është një porosi e dhënë nga eprori tim, dhe me qëllim për ti mbaruar një punë eprorit kam komunikuar edhe me punonjësin e policisë Kosovare, por jo me qëllim për ta favorizuar atë..... Unë kam qenë në fillimet e mia në këtë detyrë dhe unë nuk i njihja mirë procedurat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të turnit, dhe gjatë asaj kohe që kam qenë nuk kam ushtruar kontrolle të tilla, por vetëm i kam mbikëqyrur nga larg".*

552. **Rezulton se në datë 04.01.2022,** Lahert Sulo zhvillon me përdoruesin e numrit të telefonit 0683873674 një bisedë, ku ky shtetas i prezantohet si shoku i Kolit dhe i kërkon Lehertit te shikoje ne sistemin TIMS emrin *Nikolin Marashi* duke i dërguar edhe fotografi pas kërkesës se Laertit, por që rezulton e fshirë. Ndër të tjera bashkëbiseduesi i prezantuar si "shoku i Kolit" i thotë se *nga data 12 e ka me lëviz*, ndërsa për emrin që i ka dërguar, duke nënkuptuar Nikolin Marashin, sipas bisedës, Laerti pasi ka kryer verifikimet në sistem i thotë, ***"Nuk ka gjë o shok***". Bashkëbiseduesi: "***Ok Po kaloj nesër ka Bardhi".*** *Laerti:* ***natën.***

553. **Në datë 13.02.2022** zhvillon përsëri bisedë me këtë shtetas i cili i prezantohet përsëri si shoku i Kolit dhe i kërkon ta takoje në Shkodër. Laerti i thotë se është në Kukës pasi ka lëvizur me detyrë nga Shkodra. Bashkëbiseduesi i shkruan*: "desha me të dhën nja dy emra"*, ndërsa Laerti i përgjigjet: " *mis nis, këtu i ke shok?", dhe ai i përgjigjet*: "*Ok mirë do i nis këtu një jam vete dhe një shok timin ka bere një pasosh (Paspporte) greke desha me i kontrollu, a e sakte dokumenti, se ka ba tashi".* Në vijim komunikimi *: 674: Jo jam kusho i Kolit unë po të shkruaj te teli këtij shokut. Laeti: Aha ok. Koli: Do takoi nga afër.* Në datë 25.01.2022 Laerti i kthen përgjigje: "*Nuk ka gjë*" . Ndër të tjera konstatohet se në komunikim shtetasi me nr. cel *+674* ndërkohë që i ka dërguar një fotografi datë 13.01.2022 ora 12:02 min, ndër të tjera i thotë: "*....te lutem ma kontrollo edhe ketë kjo e jemja...edhe po shifemi te shtunën për atë tjetrën.* Laerti: *Mi nis çfarë do te kontrollosh.+674: Mia (mua) a jam ne kërkim se deshta me lëviz. Laerti: Ma nis tendën. +674: Kjo është e jemja .Laerti:Ok.* Në orën 03:52 min po të datës 02.01.2022 i kthen sms Laerti: *Ka gjë.*

554. Po ashtu nga këqyrja e telefonit rezulton se në datë 02.01.2022 ora 10:57 min në aplikacionin whatsapp shtetasi i regjistruar me emrin "*Tani Durrës*" i dërgon Lahert Sulos këtë sms: "*Rofsh. Është nusja e një shokur ngushtë me kalamajt aty Morin po ska prokurë Zajmin Vasjari. Njihet si personazh publik. Nuk e lejn pa prokur. Shife njeher po ke mundësi.". Laerti*: *Kur do kthehet*: *Tani Durrës:Ja ta pyes, 2 dit, dt 4 ka kthim.Laerti: Ok çfarë makine ka ose jepi nr tim të flas me të. Tani Durrës: Renxh Rover "AA001UD"....Laerti: Ok.*" Menjëherë më pas ora 11:00 Laert Sulo ja kalon (forword) me sms targën e automjetit të shtetases si porosi për ta ndihmuar punonjësit të policisë Emilton Asllanaj me detyrë përgjegjës turni në P.K.K Morine duke i thënë*:" Ndihmojë pak është duke ikur për ne Kosove, duhet ta njohësh, Zajmina Vasjari".Emiltoni: "Tani direkt, jepi numrin tmë marri."*

555. Duke iu referuar të dhënave të marra nga sistemi TIMS të cilat administrohen në faqet 348- 352 të volumit 5 të akteve të hetimit, rezulton se shtetasja Zajmina Ago Vasjari në muajin janar 2021 rezulton se ka dalje nga Republika e Shqipërisë me automjetin me targa AA001UD, në datë 02.01.2022 në orën 11.13 dhe hyrje në datë 04.01.2022, në orën 15.06 minuta, por të dy këto lëvizje të saj, si dalja ashtu edhe hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton se janë kryer në pikën e kalimit kufitar Murriqan dhe jo në atë Morinë, Kukës.

556. Nga këqyrja e aparatit celular të të pandehurit Fatri Iseberi, janë konstatuar një numër i konsiderueshëm dokumentesh identifikimi të dërguara nga shtetas dhe kolegë të aplikacionin whatsapp si dhe fotografime dhe filmime të të dhënave të personave të ndryshme, si më poshtë: (i) Konstatohet se në datë 08.4.2022 ora 07:57 min në këtë folder është administruar fotografia, e cila ka përmbajtje një kartë identiteti të shtetasit Luan Saraçi, i dtl, 30.05.1986. Nga verifikimi në sistemin TIMS me të dhënat e këtij shtetasi shfaqen gjeneralitetet dhe te dhënat për datat e kalimit në kufi. Rezulton se ky shtetas ka dalje nga R.Sh-ja ne date 04.04.2022. Mbas kësaj date, ka hyrje ne R.Sh datë 08.02.2022, ora 09:00 dhe janë kryer veprimet ne sistem nga punonjësi i policisë "SHEMAT". Sipas regjistrimit, kalimi është bërë me një automjet pa targa, me nr.shasie, "TMBHS26Y54222113" dhe në rubrikën shënime të sistemit TIMS thuhet: "*U kalua për veprime doganore*". Po në të njëjtën datë ora 09:30 rezulton të ketë një hyrje tjetër në R.Sh

veprim i cili është kryer nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi duke e regjistruar në orën 09;31 min. Nga shënimet e kryera ne sistem thuhet se ky shtetas ka kaluar me automjet pa targa, me nr shasie, "TMBHS26Y654222113", dhe tek rubrika shënime thuhet, "*U kalua për veprime doganore*". Sipas të dhënave paraqitur më sipër rezulton që ky shtetas në datë 08.04.2022 ka udhëtuar drejt shtetit të Kosovës por nuk është regjistruar në sistemin TIMS.

557. Nga këqyrja e aparatit telefonik celuluar të të pandehurit Reni Dokolli, sipas procesverbalit të këqyrjes më datë 21.03.2022, ndër të tjera, rezultojnë komunikimet si vijon: Biseda e kryer në aplikacionin whatsapp nga punonjësi i policisë Reni Dokolli me shtetasin e shënuar në kontakte si "Jon Ramovi", përdorues i numrit 0697402456, datë 06.03.2022, ora 08:27 min, të cilit Reni i dërgon fotografi të pajisjeve përgjuese, duke i thënë se janë edhe me kartë memorie. Ndër të tjera i thotë*: Reni:...ishte dhe me fishe karikimi...ishte dhe me karte memorie", Joni: Videot e sa ditëve kishte regjistru?,Reni: ishte 32 G kishte 9-10 dite"*.. . Ndër të tjera e pyet nëse janë pajisje që janë të lidhura me whatsapp pasi duan të sigurohen nëse janë transmetuar pamje filmike, fjalë për fjalë. Në vijim në datën 08.03:2022, ora 12:38, Reni Dokolli bën bisedë me shtetasin Jon Ramovi, me përmbajtje si më poshtë: *Reni: Jon ajo si qark pa kart memorien, a ka shans me pas video aty të ruajtura? Joni: Se besoj. 80% do thoja jo, se prandaj ja kna vu vendin e kartës së memories. Reni: Ok, rrofsh ngaqë do i dorëzojmë, për të shikuar origjinën e pajisjeve edhe të jena të sigurt ata ta prishim qarkun apo jo?*

558. Po ashtu nga këqyrja e komunikimeve në aplikacionin whatsapp, rezulton se në datë 16.03.2022 punonjësi i policisë Reni Dokolli ka dërguar me video pamje filmike kontaktit të tij shënuar si "Diana Toçila" e cila është sipas verifikimit të numrit të kontaktit, e pandehura Elidjana Toçila, pamje në të cilat shihet se ku në sedilen e parë të një automjet shfaqen një parash prerje *50-euro. Bashke me videon i shkruan "Ja kshu kapen", ndërsa Elidjana i përgjigjet "A va mostre ti", " A lekt e shpive të nazmies"," Ore ruaji mos i harxho kot, e do na duhen për avokat" ndërsa Reni i përgjigjet "...i kam lën lekt për avokat unë kam mbaru pun..këto jan për tu prish para se të arrestohem.* Po ashtu, nga këqyrja e telefonit konstatohet biseda e kryer me të pandehurin Laert Sulo, i cili në datën 08.03.2022 i ka dërguar dokumentin fotografi të pasaportës së një shtetasi dhe një kopje të dokumentit të mjetit të tij.

559. Po nga këqyrja rezulton edhe biseda e datës 01.03.2022 ku gjatë bisedës kontakti "Cabe Duraku" i thotë se do të kalojë për në Kosovë një kushëririn e tij pa u regjistruar dhe biseda mes tyre në lidhje me këtë fakt është si vijon: *Cabe Duraku : A ke mhb me ata të kosovës, Reni: Varet për ca. Cabe Duraku: Me kalu andej pa regjistru, prej punës. Reni: Ca pune ke fillu. Cabe Duraku: jo për mu për një kushërirë. Reni: Ca kushërire me shkb. Cabe duraku: po jo mor bish, se rri jasht. Nejse flasim nesër. Reni: Ok shifena nesër në dark.*

560. Po ashtu, nga kqryeja janë evidentuar edhe bisedat e kryera me shtetasin e shënuar në kontakte si "Valon Ahmeti Zvicer" me nr cel +41792070363 me të cilin në datë 12.02.2022 ka kryer këtë bisedë: *Valon Ahmeti Zvicer: Kam nje pytje. Ti qe je kufitar.Reni: Po vlla me thuaj. Valon Ahmeti Zvicer: Shif jam tu shku Kumanove ne maqedoni. Kam mar ça pluma. A kan skaner ne kabina ata ?.Apo veq po dyshun te nalin. Reni: Tani me dyshu te fusin edhe ne skaner. Reni: Mesa di un kan skaner. Po veç po dyshuan. Valon Ahmeti Zvicer: Dmth ne kabin nuk ka*

rezik. Reni: Jo aty jo. Valon Ahmeti Zvicer: E mir pra ne regull. Valon Ahmeti Zvicer: Flm Shum.".

561. Në përgjigje të kërkesës me nr. 64 prot., datë 20.04.2022, për ndihmë të ndërsjelltë juridike të Prokurorisë së Posaçme, dërguar autoriteteve të drejtësisë në Kosovë nëpërmjet kërkesës më nr. 1681/1 prot., datë 24.07.2022, autoritetet kosovare kanë kthyer përgjigjen e përcjellë nëpërmjet shkresës me nr. reference MD/DBGJ/2933/mk/22/DBJN/2022/348 me datë 17.06.2022 të Ministrisë së Drejtësisë. Konkretisht në përgjigjen me nr. 25/2022, datë 17.06.2022 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, referohet se :"*Me datën 23.05.2022 Ju kemi drejtuar kërkesë për ndihmë të nevojshme Inspektoratit Policor të Kosovës, Departamenti i Hetimeve, për të siguruar të dhënat e cekura si në kërkesën, letër porosinë e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Tiranë. Më datë 06.06.2022 nga Inspektorati Policor i Kosovës, Departamenti i Hetimeve, kemi pranuar raportin informuese nr. ref. IPK/DH/17/22/VP-NJN.28/2022 me të cilin informohemi se gjatë zbatimit të masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike dhe vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video në vende publike, bazuar në urdhrat e Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti Special, nuk ka evidentuar ndonjë rast i cili do të përbënte provë apo indicie për përfshirje të punonjësve të policisë nga Republika e Shqipërisë në aktivitete të kundërligjshme në pikën kufitare Vermicë..* ". Kësaj përgjigje i janë bashkëlidhur materiale filmike (audio dhe video) si dhe transkriptime të tyre, nga të cilat, referuar përgjigjes së sipër referuar të autoriteteve gjyqësore të Kosovës, nuk paraqiten raste të implikimit të punonjësve të policisë së palës shqiptare në veprime të kundërligjshme, në periudhën nga data 18.02.2022 (ne të cilin referon transkriptimi i parë) dhe në vijim.

562. Në përfundim të hetimeve, pas komunikimit të akuzës, të gjithë të pandehurit janë pyetur në këtë cilësi lidhur me faktet objekt akuze. Sipas procesverbaleve të pyetjes së të pandehurit, për secilin prej tyre, rezulton si vijon:

563. I pandehuri **Sazan Ibra**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

564. I pandehuri **Xhafer Elezi**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 04.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.* Më herët, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime ai ka dhënë shpjegime në datë 28.06.2022, të cilat janë referuar në faktet e çështjes, përshkruar më sipër në vendim.

565. I pandehuri **Klevis Salkurti**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

566. **Atli Jashari**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 11.10.2022, lidhur me faktin dhe akuzën ka shpjeguar se :"Për sa i përket akuzës u njoha dhe sqaroj se nuk kam dakord me akuzën e ngritur dhe i përmbahem thënieve të dhëna në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Përveç atyre dua të saktësoj se natën kur është shoqëruar dhe janë kryer veprimet hetimore me shtetasin Altin Laçi unë kam qenë oficeri i gatshëm në DVP Kukës, sipas një grafiku të miratuar nga Drejtori i Policisë së Qarkuat. Rreth orëve të vona të*

kësaj datë mua me ka njoftuat salla operative apo shefi nuk më kujtohet saktësisht se kush, duke më vënë në dijeni se shoqërohet një automjet në Komisariat nga patrulla e policisë nga shtati Bicaj për në Kukës. Më është dhënë urdhër të kryhen veprimet. Pasi futet automjeti në ambientet e Drejtorisë e verifikoj paraprakisht dhe brenda në automjet gjendeshin rreth 23 goma të përdorura si dhe gjela e pula. E pyes drejtuesin e mjetit nëse kishte dokument..[11]*.".* I pandehuri Atli Jashari ka dhënë shpjegime edhe në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në datë 27.06.2022, në prezencë të mbrojtësit të tij.

567. I pandehuri **Sule Onuzi**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 07.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

568. I pandehuri **Shpëtim Cenaj**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 07.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

569. I pandehuri **Reni Dokolli**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë10.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.* Më herët, në kuadër të procedimit penal të zhvilluar lidhur me momentin e gjetjes dhe heqjes së pajisjeve përgjuese në datë 21.03.2022, ai është pyetur dhe ka dhënë deklarime në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, duke deklaruar se *:"Në datë 06.03.2022 unë kam qenë i planizuar trup shërbimi në kontrollin e vijës së dytë, për automjete, nga ora 20.00 deri ditën e nesërme në datë 07.03.2022, ora 08.00 e mëngjesit. Me orë fiks nuk më kujtohet por më ka thirrur përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli duke më thënë që afrohu te kabina nr.4 sepse kondicioneri nuk punon. Kur u afrova përgjegjësi më thotë se në krahun e djathtë të kondicionerit ka një dritë blu që po pulson, dritë të cilën e pashë dhe unë. Bëmë disa prova duke fikur siguresat dhe me pult se mos e rregullonim. Kthehem në vijën e dytë, marr nga dy kaçavida dhe shkova përsëri te kabina nr.4, hoqa kondicionerin, jap plotësisht dhe në pjesën mbrapa vura re një pajisje e cila nuk kishte lidhje me kondicionerin....Gjatë kësaj kohe unë i kam mbështjellë më një copë letre dhe i kam lanë mbi tavolinën e kabinës nr.4. Unë nuk kam dijeni për kartat e memories së këtyre pajisjeve, unë thjesht i kam nxjerrë nga kondicioneri dhe i kam lënë mbi tavolinë...".*

570. E pandehura **Rezarta Lako**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

571. I pandehuri **Lahert Sulo**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

572. I pandehuri **Muhamet Cengu**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 12.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

573. I pandehuri **Halim Shehu**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 12.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

574. I pandehuri **Haqif Halilaj**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 12.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

575. I pandehuri **Emilton Asllanaj**, *sipas procesverbalit të pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, ka shpjeguar se :"Kam filluar punë në PKK Morinë me 03.12.2021. Kam qenë një muaj në trajtim në Tiranë dhe në datë 08.04.2022 jam ndaluar nga AMP me dyshimin*

---

[11] *(shih volumin 54, faqe 1 deri në 5)*

se kam kryer korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksion publik. Detyra ime ka qenë përgjegjës turni dhe nuk kam pasur ndikim unë as tek kontrollorët dhe sipas procedurave standard të punës përgjegjësi I turnit nuk ka punonjës policie në varësi. Për dy fakte të cilat unë akuzohem do të jap shpjegime të hollësishme përpara prokurorit pasi të njihem me provat e dosjes për të cilën unë akuzohem, pasi në dijeninë time asnjëra fabul nuk përbën vepër penale."

576. I pandehuri **Arjan Sokoli**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë11.10.2022, ka shpjeguar se :"Akuzën e dëgjova, e kuptoj dhe unë duka të shprehem se kam qenë i punësuar si kontrollor pranë PKK Morinë. Gjatë gjithë periudhës së punës jam përpjekur të përmbush me korrektësi detyrat e mia funksionale. Në lidhje me faktet që më atribuohen shprej vullnetin tim të sqaroj prokurorinë se në asnjë rast të vetëm nga ato të evidentuara nga prokuroria nuk kam kërkuar para në këmbim të ofrimit të lehtësirave për të lejuar kalimin e pasagjerëve. Si në rastet e datës 10.02.2022, 20.02.2022 ashtu edhe në rastet e datës 22.02.2022, siç vërtetohet dhe nga përmbajtja e transkriptimit të përgjimeve në asnjë rast unë nuk kam kërkuar para në këmbim të favorizimit të lehtësimit të kalimit. Ne çdo rast kërkesat për të verifikimin e dokumentacionit kanë qene të parashikuara në udhëzime apo VKM në fuqi qe përcaktojnë listën e dokumenteve të detyrueshme për tu verifikuar nga ana jonë si kontrollor në pikën kufitare. Pra unë nuk kam shkelur ligjin duke favorizuar njerëz të cilët nuk plotësonin kriteret ligjore për të kaluar. Kërkimi dhe verifikimi i testeve anticovid ka qenë një kërkesë ligjore e domosdoshme për tu verifikuar si rrjedhojë e pandemisë covid 19. Po kështu pjesa që interpretohet si presion dua të sqaroj me përgjegjësi përpara prokurorisë dhe ligjor se nuk ka qenë e tillë, por kërkesa që diktoheshin nga udhëzimet që përcaktojnë listën e dokumenteve që unë duhej të verifikoja si kontrollor. Unë në çdo rast nuk kam kërkuara para apo përfitime materiale për të përmbushur detyrat funksionale. Prej vitesh kam punuar në strukturat e policisë së shtetit i vetëdijshëm që në asnjë rast nuk kam shkelur ligjin për të përfituar para apo të mira materiale. Nuk ka asnjë rast të vetëm të dokumentuar përgjatë gjithë kohës që hetoi prokuroria që unë të kem favorizuar për të kaluar njerëz me rekorde kriminale apo njerëz që sipas ligjit duhej t'iu ndalohej kalimi. Në fund dua të them se ndihem shume keq psikologjiskëshit për vetën , si i padënuar më parë, si punonjës i policisë së shtetit, për bashkëshorten dhe dy fëmijët në shkollë, për gjithë këtë situatë që më ka ndodhur."*

577. I pandehuri **Avni Tërshalla**, *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 28.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.* Më herët, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas procesverbalit me datë 28.06.2022, ai ka deklaruar se :"*Për sa më pyetët nga ana juaj unë sqaroj së në detyrën e shoqëruesit të qenit unë kam rreth 25 vite që punoj, ndërsa në PKK Morinë unë kam shumë vite që kam kryer të njëjtën detyrë. Dua të sqaroj se si shoqërues qeni unë nuk kam detyrë të merrem me kontrollin e pasagjerëve në kabina por për sa i përket rastit të konstatuar unë kam shkuar në kabinë për të marrë një shishe ujë për të pirë. Mua nuk më kujtohet si rast dhe nuk kam parë gjë. Unë punoj shoqërues qeni dhe këtë detyrë kam kryer gjatë gjithë karrierës sime në polici. Të me pyesësh se çfarë detyrimesh kam ndaj punës sime që jam dhe i specializuar, përgjigjem. Por për raste të tjera si ky që ju më pyesni unë nuk kam informacion si veprohet..*".

578. I pandehuri **Dashnor Braha,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

579. I pandehuri **Arben Goçi,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

580. E pandehura **Mimoza Shahinaj (Ismaili),** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

581. I pandehuri **Vehbi Nerguti,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

582. I pandehuri **Bedri Duraku,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

583. I pandehuri **Arben Kastrati,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

584. E pandehura **Elidjana Toçila,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 04.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime për faktin apo akuzën por ka parashtruar qëndrimin e saj për kompetencën lëndore dhe tokësore të Prokurorisë së Posaçme.*

585. I pandehuri **Fatri Braha,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 10.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

586. I pandehuri **Urim Lami,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 10.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

587. I pandehuri **Kapllan Dogjani,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 11.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

588. I pandehuri **Fatri Iseberi,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 06.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

589. I pandehuri **Endrit Uka,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

590. E pandehura **Xhuliana Maksutaj,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 07.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

591. I pandehuri **Fran Kaçorri,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 04.10.2022, ka deklaruar :"Veprën penale e dëgjova, e kuptova dhe nuk jam dakord përsa i përket akuzës, pasi jo vetëm që jam i pafajshëm, por e ndjej që jam i pafajshëm. Pas një periudhë 36 vjeçare në Policinë e Shtetit me funksione të ndryshme drejtuese, në këtë periudhë katër mujore në drejtimin e Dr. Vendore Kukës, kam kryer vetëm detyrën në zbatim të ligjit dhe rezultatet kanë treguar, qoftë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nga Departamenti i Kufirit, pasi në analizën mujore jam vlerësuar për përmirësimin dhe rezultate të larta për këtë periudhë të shkurtër. Nuk e di pse duhet të më njoftohet akuza për një vepër penale që ka filluar që në vitin 2019 për hetimet në PKK Kukës, në dy episodet që u përmendëm, siç e kam shpjeguar dhe në memon drejtuar Prokurorisë së Posaçme, kam kryer vetëm detyrën në zbatim të ligjit. Dua të cilësoj episodin e parë në lidhje me dy shtetaset e huaja, pasi në momentin që bëhet fjalë nuk ka qenë për të kaluar por për të verifikuar nëse kanë vizë për të hyrë në Republikën e Shqipërisë dhe rezulton se ato kanë hyrë në Shqipëri por jo nga PKK Kukës. Në lidhje me*

episodet e tjera kam dhënë shpjegimet dhe nga verifikimet e oficerit të AMP kanë rezultuar të sakta shpjegimet e mia dhe kam qenë në përmbushje të detyrës dhe jo në shpërdorim të saj. Sic kam bërë me dije pranë oficeres së AMP, mesazhet e mia kane qene për arsye verifikimi dhe jo për arsye favorizimi siç është interpretuar nga oficerja e AMP...". Me herët, në datë 12.04.2022, i pandehuri Fran Kaçorri ka dhënë shpjegime edhe në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, duke shpjeguar në të njëjtën mënyrë në lidhje me faktet e çështjes.

592. I pandehuri **Artan Redhaj,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 04.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.* Me herët, në datë 18.07.2022 ai ka dhënë shpjegime në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shpjegime të cilët janë referuar në rrethanat e faktit më sipër në këtë vendim.

593. I pandehuri **Gëzim Duraku,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 11.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime.*

594. I pandehuri **Ani Hoxholli,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime lidhur me faktin por deklaron se: "Unë u njoha me aktin e përfundimit të hetimit dhe me aktin e njoftimit të akuzës dhe sqaroj se nuk jam dakord me veprën penale për të cilën unë akuzohem. E deklaroj veten time të pafajshëm ndërsa në lidhje me rastet për të cilat unë akuzohem do të jam sqarime në seancë gjyqësore." (vol 93)*

595. E pandehura **Vojsava Selmani,** *sipas procesverbalit te pyetjes në cilësinë e të pandehurit në datë 05.10.2022, ka shpjeguar se :"E kuptojmë akuzën por nuk e pranoj dhe do jap shpjegime në lidhje me ato episode. Theksoj faktin se unë kam filluar punë në PKK Kukës në fund të nëntorit në vitin 2021, jo me kërkesën time pasi kam qenë në një pozicion tjetër pune dhe jam emëruar në PKK Kukës. Dy javë pas emërimit kam bërë takim me drejtorin Fran Kaçorri dhe i kam kërkuar të largohem nga ai pozicion me arsyen që nuk e bëj dot këtë detyrë. ..Nuk ishte punë që unë e doja dhe ishte shumë e lodhshme. Behët fjalë për datat 16.02.2022 dhe 19.02.2022, theksoj se kam qenë ndihmës inspektore. Në datën 16.02.2022 kam qenë me kolegun Arben Kastrati dhe veprimi i kryer prej meje siç thuhet dhe në aktin e njoftimit të akuzës nuk ka asnjë element korrupsioni.. Para as nuk kam kërkuar ryshfet dhe as nuk kam pranuar ryshfet. Gjithashtu nuk jemi në kushtet që të kemi deklarim të personit që ka dhënë, si ka dhënë dhe pse ja ka dhënë. Nuk na rezulton që ky shtetas të ketë pasur mangësi në dokumentacion dhe nuk ka asnjë të dhënë që i është bërë favor në kundërshtim me detyrën. Në kushtet kur s'ka mangësi nuk i është bërë asnjë favor në kundërshtim me detyrën. Në kushtet që s'ka mangësi nuk i është bërë asnjë lloj presioni për të paguar lekë. Sa i përket veprimeve të kolegut tjetër në momentin që unë kam hyrë për ta zëvendësuar nga ana ime nuk është konstatuar asnjë veprim korruptiv. Për sa i përket episodit të datës 19.02.2020, ora 10.10, në lidhje me 5 euro që ka qenë tek tastiera, nuk e mbaj mend saktësisht por mund të jetë lënë edhe prej meje. Unë e kam marrë dhe kam dalë për kafe. Dua të theksoj që unë jam e martuar me kosovar dhe paratë në portofolin tim kryesisht janë euro pasi aty ka biznes ai dhe paratë që përdorim në jetën e përditshme janë euro. Rroga ime nuk mjafton për të jetuar, madje një javë dhe paratë për familjen, për fëmijët, për qiranë në Tiranë, mua mi mundëson bashkëshorti dhe janë në euro. Madje në një kontroll rutine të portofolit tim atë ditë mund të gjendeshin dhe 200 euro plus minus, pasi siç shpjegova më lart*

bashkëshorti im është kosovar dhe paratë që më jep janë në euro. Në lidhje me episodin e datës 19.02.2022, në orën 13.08, unë dua të sjell në vëmendje që prej fillimit të punës sime në PKK Kukës kam bërë le te them gabime pa dashje në punë, të tilla si harrim të kartave të identitetit ose dokumenteve të vaksinimit të shtetasve që kalonin kufirin pasi tastierat duke qenë të vjetra nuk ishin në kushtet e tyre më të mira, madje po të shkoni ti shikoni nëse nuk i kanë nderuar, kanë marrë formë harkimi. Dhe unë pasi bëja verifikimin në sistem shpesh kam harruar tua kthej pas dokumentet, duke bërë kështu dhe kthimin shpesh pas të shtetasve duke më thënë që kanë harruar kartat në kabinë. E ndodhur në këto kushte më ishte bërë si ves me tepër lëvizja e tastierës nga meraku mos harroja ndonjë dokument të shtetasve. E njëjta situatë është edhe për sa i përket orës 13.26.14 të po kësaj datë. Pra lëvizja e tastierës ka qenë veç nga meraku i harresës së kthimit pas të kartave të ID të shtetasve. Lidhur me orën 13.32.57 të po kësaj datë janë veprime të kryera nga kolegu Duraku, janë veprime që sipas aktit të akuzës thuhet që ja ka marrë një shtetasi kosovar, nuk kam asnjë dijeni. Në këtë moment ka qenë momenti i nderimit me kolegun Gëzim, dhe mbaj mend që më ka thënë po ikën për të ngrënë dhe unë i kam thënë "kafe, kafe", pasi kam dalë për kafe dhe cigare. Janë edhe dy raste 11.38.20 ku thuhet se merr 5 euro nga shtetasi për dokument vaksinimi, nuk është e vërtetë. Ujësi e thashë jam e martuar me kosovar dhe dua të them dhe tim atë dhe xhaxhain i kam dëshmorë në Kosovë. Shkollën po ashtu e kam kryer në Kosovë dhe në këto kushte kurrsesi nuk do iu beja presion shtetasve kosovarë për 5 euro për të kaluar kufirin sepse unë njihem në atë shtet më mirë se në Shqipëri. Ka pasur shumë momente kur më thonë aman na ndihmo dhe në këto kushte unë ose do shkelja ligjin dhe do bëhesha e mirë me këta shtetas ose do zbatoja ligjin dhe do bëhesha e keqe dhe kjo ka qenë një ndër arsyet që kam kërkuar të lëviz nga ky pozicion pune. Kam punuar në patrullë dy vjet në Kosovë dhe nuk kam patur kurrë probleme me afera korruptive dhe nuk e besoj se ka ndonjë shtetas ankesë për mua për aq vite punë sa kam në polici. Në episodin e datës 15.02.2022, ora 16.18 dua të them se shtetasi që ka bërë këtë veprim unë e njoh dhe quhet Hamdi Malshahu por unë e thërras Alban. E kam takuar rreth orës 12.00 të kësaj datë dhe duke qenë se unë cigaret i marr në Kosovë, sa të vinte bashkëshorti, i kam dhënë 5 mijë lekë për të më marrë cigare. Dhe ai nuk mi ka sjellë, si ka blerë dhe më ka kthy lekët. Nuk është logjike që unë të korruptohesha me 5 mijë lekë. "E pyetur për episodin e datës 15.02.2022 ora 16.03.30 kur ka qenë në kabinë bashkë me kolegun e saj Arben Kastrati ajo shpjegon *:"Më duket se kishin kaluar afatin te mujor të qëndrimit në shtetet e Bashkimit Evropian, jashtë shtetit shqiptar, ku nuk lejohet qëndrimi më shumë se tre muaj...Nuk mbaj mend të kem kryer një veprim të tillë (sqarim e pyetur për eurot që shtetasi ka lënë në këtë moment)....Unë shtetasin në fjalë (Hamdi Malshahu) e njoh dhe kur ka ikur në Prishtinë i kam dhënë një pesë mijë lesh për cigare. Kur u kthye më jep përsëri pesë mijë lekëshin pasi nuk kishte gjetur cigare. Unë këtë shtetas e njoh qëkur kam punuar patrullë në Kokës por nuk kam ushtruar ndonjë kontroll ndaj tij pasi nuk kam dyshuar. "E pyetur për episodin e datës 19.02.2022 kur zëvendëson kolegun e saj Fatri Iseberi dhe merr nga tastiera poshtë 5 euro ajo shpjegon :"Këto janë para të cilat unë i kam patur të miat dhe i mbaj poshtë tastierës që ti përdor për të blerë ndonjë gjë jashtë shërbimit. Në datë ...Nuk ka të bëjë me*

ryshfetin mund të kenë treguar dokumente spitali apo ndonjë dokument tjetër dhe unë i kam lejuar të udhëtojnë...".

596. Sa i përket akuzave të ngritura ndaj secilit prej të pandehurve, të cilat rezulton të jenë të njëjta me ato për të cilat gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar për dërgimin e çështjes në gjyq me vendimin nr. 123 regjistri, datë 02.12.2022, pas paraqitjes së fakteve të çështjes, Prokuroria, në aktet e komunikimit të akuzës për secilin të pandehur, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe po ashtu edhe në konkluzionet përfundimtare, argumenton në drejtim të veprimeve dhe mosveprimeve që konfigurojnë anën objektive të veprës penale për të cilën akuzohet secili prej të pandehurve, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

597. Sa i përket akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 259 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, argumentohet, ndër të tjera, se : "*Pra, rezulton e provuar se të pandehurit Laert Sulo, Ani Hoxholli, Emilton Hasllanaj, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Isiberi, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismailaj), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami (Elezi), Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuliana Maksutaj, Ylber Hoxha, Bedri Duraku, Avni Tershalla, Arben Goçi, Shpëtim Cenaj dhe Sulë Onuzi, kanë konsumuar elementet e veprës "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 259 dhe 25 i Kodit Penal, kjo për këto arsye: Së pari, personat pandehur me veprimet e mos veprimet e tyre në periudha të ndryshme kohore, bazuar edhe në porositë e kryera në formë favoresh nga shtetas të ndryshëm lejojnë kalimin e kufirit të shtetasve pa u regjistruar në sistemin TIMS, kryejnë kërkime në sistemin TIMS për persona të cilët mund të paraqesin rrezikshmëri shoqërore, të cilët i kontrollonin dhe jepnin informacione nëse janë në kërkim apo jo. Veprime të cilat kryhen kundrejt marrjes se ryshfetit duke u takuar më pas me këta shtetas. Po ashtu, paraqiten raste ku për shkak të kompetencave që i jep detyra funksionale, ushtrojnë ndikim tek vartësit e vet për favorizimin dhe mos regjistrimin e shtetasve në kufi siç janë rastet e cituara me sipër kundrejt përgjegjësve të turnit, Emilton Asllanaj, Artan Redhaj dhe Ani Hoxholli ku në vijim këta punonjës në kundërshtim dhe në shkelje të plotë ligjit kanë kryer veprime për kalimin në kufi të shtetasve, pa u regjistruar në sistemin TIMS apo duke ju shmangur kontrollit kufitar. Së dyti, nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundra ligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video, nëpërmjet aplikimit të metodave speciale të përgjimit të bisedave në kabinat e kontrollorëve në hyrje të Shqipërisë, në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës. Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policisë Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime korruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri- tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro. Shuma e përfitimit rezulton nga 350 euro deri në 400 euro, ndonjë ditë shkon edhe më tepër, kjo, bazuar në llojin e veprimit të kundërligjshëm që kryhet nga punonjësi i*

policisë, siç është konstatuar tek rastet e lejimit të mallrave kontrabandë dhe shmangies së kontrollit të vijës së dytë, ku drejtuesi i automjetit është konstatuar të lërë ryshfet në shumën 200 euro për një kalim. Për veprimin e mos regjistrimit të shtetasve ne sistemin Tims, pavarësisht nëse ka apo nuk ka probleme të regjistruara në sistem, pagesa varion nga 60 euro deri në 70 euro për person, kur ka patur disa persona, deri ne tre, pagesa ka rezultuar deri ne 300 euro. Po ashtu, për veprimin e kundërligjshëm të lejimit të shtetasve të huaj për udhëtimin e tyre drejt Shqipërisë, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit ose në mungesë të autorizimit nga pronari për përdoruesin e mjetit, pagesa varion nga 5 euro, 19 euro, 20 euro për person. Po ashtu, pagesat për veprimin e mos regjistrimit të automjeteve të shtetasve të ndryshëm në kufi, të cilat në shumë raste rezulton se janë automjete me problem, si dhe personave që i transportojnë këto automjete, variojnë nga 50 euro deri ne 100 euro për person. Se treti, nga aktet është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turnit të tyre, ku çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim. Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçantë pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit.".

598. Në lidhje akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 244 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, argumentohet se : "*Pra, rezulton e provuar se personat e pandehur Klevis Salkurti, Xhaferr Elezi, Alti Jashari dhe Sazan Ibra, kanë konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Kjo për këto arsye: Së pari, personi pandehur Klevis Salkurti ka hyre në biseda dhe tenton të bëjë kompromise me qëllim përfitimin material në formë monetare për vete dhe për persona të tjerë, duke negociuar për mbylljen e çështjes së Robert Saraçit, të cilit i është kapur automjeti me mallra kontrabandë. (Biseda e datës 16.05.2021 me Sazan Ibra). Së dyti, personi i pandehur Xhaferr Elezi dyshohet për ndikim të paligjshëm ndaj punonjësit të policisë Atli Jashari e në bashkëpunim me të më tej ndaj punonjësve të Prokurorisë me qëllim mbylljen e hetimeve ndaj shtetasit Robert Saraçi. Së treti, personi nën Sazan Ibra ka konsumuar elemente të veprës penale, "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", duke bërë kompromise gjithashtu me shtetasin Robert Saraçi për pagimin e shumave monetare kundrejt funksionarëve publike për mbylljen e çështjes kundrejt shtetasit Robert Saraçi dhe shtetasit Altin Laçi kapur në flagrancë me mallra kontrabandë për llogari të shtetasit Robert Saraçi. Së katërti, personi pandehur Klevis Salkurti ka hyrë në biseda dhe tenton të bëjë kompromise me qëllim përfitimin material në formë monetare për vete dhe për*

persona të tjerë, duke negociuar për mbylljen e çështjes se Robert Saraçit, të cilit i është kapur automjeti me mallra kontrabandë.".

599. Në lidhje akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, argumentohet se : "*Nga të dhënat e përftuara si rezultat i veprimeve hetimore të kryera për shtetasit Fran Kaçorri, Halim Shehu, Artan Rredhaj dhe Fatri Iseberi rezulton e provuar se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Konkretisht Fatri Iseberi, me detyrë, kontrollor në P.K.K Morinë ka kryer në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim të ngushtë edhe me kolegë të tij, por më konkretisht punonjësin e policisë Halim Shehu, favorizimin e shtetasve për kalimin pa pengesa të kufirit duke shmangur tërësisht procedurat e kontrollit kufitar e madje në shumë raste në bashkëpunim me punonjës të palës Kosovare, kundrejt përfitimit monetar. Destinacioni i këtyre shtetasve të cilët favorizohen prej tyre janë vendet e Bashkimit Evropian me qëllim emigracionin ekonomik e në disa raste duke përdorur si rrugë kalimi tranzit edhe shtetin Turk. Po ashtu, përveç sa janë konstatuar një sërë bisedash me interes për favorizimin e shtetasve të ndryshëm kryesisht ata që kanë lidhje shoqërore me ta për kalimin e mallrave kontrabandë në kufi pa kryer procedurat doganore të cilat shkojnë rast pas rasti dhe i blejnë në Kosovë, si pjesë këmbimi automjetesh, mallra ushqimorë të ndryshëm etj. Po nuk është vetëm kjo veprimtaria e paligjshme e tyre ata shfrytëzojnë çdo rast për shtetas të cilët janë me shënime në sistemin TIMS dhe kanë problematika për kalimin e kufirit, për marrje ryshfeti apo favorizimin e tyre. Fatri Iseberi dhe Halim Shehu po ashtu, në mënyrë të vazhdueshme kanë ndihmuar vëllain e Fatriut, Ardian Iseberin që të kalojë mallra nga Kosova drejt Shqipërisë duke mos kryer procedurat zhdoganojë nëpërmjet ndikimit të tyre tek doganierët. Mallrat e cilat janë pjesë këmbimi automjetesh, goma automjetesh si dhe automjete të vjetra të cilat nuk disponojnë asnjë dokumentacion dhe ky i fundit i reklamon dhe i shet online, duke mos deklaruar as fitimet pasi nuk kryen kontrata për shitjen e tyre. Po ashtu në vijim të komunikimeve dhe veprimeve hetimore të kryera janë siguruar të dhëna se vëllai punonjësit Fatri Iseberi nuk kalon mallra vetëm për vetën e tij por duke patur këtë ndihmë dhe akses në policinë kufitare ai kryen transporte mallrash edhe për persona të tjerë siç është rasti i shtetasit Robert Saraçi dhe vëllait të tij Ervis Saraçit të cilët disponojnë servis makinash dhe mallrat për furnizimin e këtyre servilëve i marrin kryesisht nga Kosova duke shmangur kundrejt dhënies së ryshfetit procedurat doganore. Ndërsa në episodin e datës 21.02.2022, për të pandehurin Fran Kaçorri Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Kukës, ka rezultuar e provuar se ka favorizuar dhe lejuar kalimin e kufirit për disa shtetas të lartpërmendur, në kundërshtim me ligjin nr.71/2016, neni 14, "Për kontrollin e kufirit shtetëror" duke ushtruar ndikim te punonjësit e palës kosovare. Gjithashtu, më datë 24.02.2022 rezulton e provuar se me ndikimin e Fran Kaçorrit dhe me veprimin e punonjësit të policisë Laert Sulo ju është shmangur veprimi i regjistrimit të shtetasve të ndryshëm, në sistemin TIMS si në hyrje dhe në dalje të R.Sh-së."*

VLERËSIMI I GJYKATËS

600. Për të mbajtur përgjegjësi për një vepër penale, vepra penale duhet të përcaktohet si e tillë në ligj, në respektim të parimit të ligjshmërisë sanksionuar në nenin 29, pika 1 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se :" *1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare*" dhe nenin 7, pika 1 të KEDNJ [12], parim i cili përbën element thelbësor të shtetit të së drejtës. Në referim të këtyre dispozitave, çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj si e tillë dhe individi duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë ekzistencën dhe përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, të kuptojë se çfarë veprimesh apo mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Referuar nenit të sipërcituar të Kushtetutës, neni 29 i saj ka përcaktuar se veprat penale mund dhe duhet të parashikohen si të tilla vetëm me ligj. Në mbështetje të këtij parimi dhe në respektim të rezervës ligjore të përcaktuar nga norma kushtetuese, Kodi Penal në nenin 1 të tij ka parashikuar se: "*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat në pjesën e posaçme të këtij Kodi*", ndërsa në nenin 2 evokohet norma kushtetuese duke përcaktuar se : "*Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.*" Në pjesën e posaçme të Kodit Penal janë përcaktuar llojet e veprave penale dhe masat e dënimit për secilën prej tyre. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale ka rëndësi thelbësore, si parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë, në mënyrë që një person të merret në përgjegjësi penale, e më pas ndaj tij të zbatohet sanksioni penal, sipas figurës së veprës penale konkrete të kryer prej tij. Në këtë këndvështrim, sipas legjislacionit penal, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet dhe mosveprimet e tij të konfigurohen elementët e një vepre penale konkrete, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal, në momentin që ndodh fakti konkret. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca dhe provueshmëria e njëkohshme për të gjithë elementët e saj të cilët janë: *objekti i veprës penale; ana objektive; subjekti dhe ana subjektive*. Ekzistenca dhe provueshmëria e njëkohshme, duke përmbushur standardin e të provuarit "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*" sipas përcaktimeve të nenit 390, pika 1 të K.Pr.P, duhet të rezultojnë për të katër elementët e figurës së veprës penale pasi, mungesa e ekzistencës ose provueshmërisë qoftë dhe e njërit prej tyre, passjell pamundësinë e marrjes se personit nën përgjegjësi penale dhe eventualisht deklarimin fajtor të tij dhe zbatimin e një sanksioni penal. Në këtë këndvështrim, në gjykimin e themelit, gjykata verifikon ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe vlerëson

---

[12] *Në nenin 7 të KEDNJ parashikohet se: "1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale....".*

provueshmërinë e vetë kësaj të fundit dhe përgjegjësinë e të pandehurit në raport me veprën konkrete.

601. Gjithashtu, gjykata vlerëson se në procesin penal prokurori ka për detyrë të bindë gjykatën mbi ekzistencën dhe provueshmërinë e të gjithë elementëve që përbëjnë figurën e veprës penale konkrete, si në drejtim të elementeve të anës objektive ashtu edhe ato të anës subjektive të saj. Barra e provës në drejtim të organit të akuzës në këtë rast, rrjedh nga detyrimi për respektimin e parimit të *prezumimit të pafajësisë së të pandehurit*, parashikuar shprehimisht nga neni 30 i Kushtetutës, në të cilin përcaktohet se: "*Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.*", neni 6, paragrafi 2 i KEDNJ me të cilin parashikohet se "*Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*", dhe neni 4[13] i K.Pr.Penale në të cilin evokohet në mënyrë të shprehur ky parim. Në këtë këndvështrim, prokurori ka detyrimin të provojë para gjykatës marrëdhënien juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal material që ka cenuar i pandehuri, veprimin dhe/ose mosveprimin e kryer prej tij, pasojat e veprës penale, lidhjen shkakësore ndërmjet veprimeve dhe/ose mosveprimeve dhe pasojave të ardhura, mënyrën e kryerjes së veprës penale, vendin, kohën, formën e fajit me të cilën është kryer vepra penale. Lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, parim i cili dikton edhe përcaktimin e barrës së provës për organin e akuzës në procesin penal, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj shprehet se :" *Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (shih vendimin nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*[14] ". Në lidhje me konceptin e barrës së provës në procesin

---

[13] *Në nenin 4 të K.Pr.Penale parashikohet se :"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. 2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm."*

[14] *Vendimi nr. 68, datë 14.11.2016 i Gjykatës Kushtetuese. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr. 13 date 24.04.2018, ku ndër të tjera arsyeton se :" Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar parimin e prezumimit të pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (shih vendimin nr.68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të së pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (shih vendimin nr.68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). GJEDNJ-ja ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (shih vendimet për çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014 të GJEDNJ-së)." Në vendimin nr. 17 datë 02.02.2022, Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë parim argumenton se :"*

penal, edhe GJEDNJ në praktikën e saj ka konfirmuar se *parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që, teksa përmbushin detyrat e tyre, anëtarët e gjykatës nuk nisen nga paramendimi se i pandehuri e ka kryer aktin që i vihet në ngarkim; barra e provës rëndon mbi akuzën dhe dyshimi është në favor të të akuzuarit. Për më tepër, i takon kësaj të fundit që t'i tregojë të interesuarit se çfarë do t'i vihet në ngarkim – në mënyrë që t'i japë atij rastin për ta përgatitur e parashtruar si duhet mbrojtjen e vet – dhe që të paraqesë prova të mjaftueshme për të mbështetur një deklarim fajësie*[15]. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ ka theksuar se *prezumimi i pafajësisë shkelet në qoftë se barra e provës përmbyset duke kaluar nga akuza te mbrojtja*[16]. Në këtë këndvështrim, në procesin penal, nga organi i akuzës kërkohet të provohet *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri dhe përkundrejt këtij detyrimi, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, pasi i takon organit të akuzës që të sjellë prova të mjaftueshme dhe të tilla që të jenë të afta të krijojnë tek gjykata bindjen e brendshme dhe objektive, të bazuar në të dhënat që ofrojnë provat e marra në gjykim, se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit

---

Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (shih vendimet nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). ". Po ashtu në vendimin nr. 12, datë 24.04.2018 Gjykata Kushtetuese argumenton ndër të tjera se :"Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (shih vendimin nr.68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të së pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (shih vendimin nr.68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). GJEDNJ-ja ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i Konventës. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014). Në çështjen Karaman kundër Gjermanisë, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime. 9. Është detyrim i organit të akuzës që bashkë me dërgimin e një çështjeje për gjykim të paraqesë edhe provat mbi të cilat e mbështet akuzën. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë në praktikë i parimit të prezumimit të pafajësisë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sepse ky parim detyron akuzën që të provojë fajësinë e të pandehurit, e çliron këtë të fundit nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtë të zgjedhë mbrojtjen më të përshtatshme për të, të bëjë ose jo deklarime, të kërkojë prova dhe të marrë pjesë aktivisht në shqyrtimin e tyre, duke kërkuar që provat e dyshimta të interpretohen gjithmonë në favorin e tij (shih vendimin nr.50, datë 01.11.2012 të Gjykatës Kushtetuese). ".

[15] *Çështja Barberà, Messegué e Jabardo kundër Spanjës, datë 06.12.1988, Çështja Janosevic kundër Suedisë, datë 23.07.2002.*

[16] *Vendimi i GJEDNJ në çështjen Telfner kundër Austrisë, aplikimi nr. 33501/96, vendim i datës 20.06.2001.*

Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: "*Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.*". Bazuar në jurisprudencën e GjEDNj, parimi i prezumimit të pafajësisë është interpretuar në kuptimin që gjykatat: *(1)* nuk duhet të fillojnë procesin gjyqësor me bindjen se i pandehuri e ka kryer veprën penale (krimin) për të cilin akuzohet; *(2)* se barra e provës i takon organit të akuzës; *(3)* se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit; dhe *(4)* se gjykata duhet ta mbështesë vendimin e saj në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet provuar nga organi i akuzës[17].

602. Vlerësimi i gjykatës mbi provat kalon në një proces kompleks, të kujdesshëm dhe racional, nëpërmjet të cilit provat të cilat plotësojnë standardin e ligjshmërisë së marrjes së tyre në kuptim të nenit 151 të K.Pr.P, çmohen dhe vlerësohen në drejtim të të dhënave që ofrojnë mbi faktin penal në raport me besueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, vlerën provuese të tyre dhe përputhjen me njëra-tjetrën. Në nenin 152 të K.Pr.Penale parashikohet se: "*1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.*", ndërsa në nenin 380 të K.Pr.Penale parashikohet se: "*1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.*" Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se çdo provë duhet të vlerësohet në unitet me provat e tjera dhe se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, pasi në të kundërt nuk do të kishim çmuarje të provave, proces i cili kalon në një ekzaminim të kujdesshëm në drejtim të vërtetësisë, mjaftueshmërisë së provave në raport me faktin mbi të cilin ato japin të dhëna, dhe vlerësimin nëse të dhënat që japin provat e marra, në tërësinë e tyre, lejojnë nxjerrjen e një përfundimi të vërtetë për ekzistencën e faktit për të cilin ato janë mbledhur si dhe aftësinë e tyre për të formuar bindjen e brendshme të gjykatës, bindje e cila duhet të jetë racionale dhe objektive, e mbështetur në të dhënat që rezultojnë nga vlerësimi tërësor dhe i kujdesshëm i çdo prove të marrë gjatë gjykimit.

603. Krijimi i bindjes së brendshme të gjykatës mbi elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale dhe autorësinë e të pandehurit, formësohet mbi bazë ne të dhënave që japin të gjitha provat e marra gjatë gjykimit dhe jo vetëm një provë e vetme. Kjo pasi një provë e vetme, në parim nuk është e aftë të mbështesë në mënyrë të plotë dhe të pakundërshtueshme faktin për të cilin ajo referon. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë se Kodi i Procedurës Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti edhe nëpërmjet indicjeve, por vetëm në se ato janë disa të tilla dhe janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë, vërtetësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Në lidhje me procesin e çmuarjes dhe vlerësimit të provave,

---

[17] *Vendimi i GJEDNJ në çështjen Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, kërkesa nr. 10590/83, vendimi i datës 6 dhjetor 1988 (77).*

në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.175, datë 21.06.2022, ndër të tjera argumentohet se: "*Procesi i çmuarjes së vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave marra gjatë gjykimi penal duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, që përbën një nga parimet bazë të sistemit akuzator. Për shkak të rëndësisë që paraqet si një parim themelor i këtij sistemi, garantimi i respektimit të këtij parimi është ngritur në nivelin kushtetues duke u parashikuar si i tillë, neni 30 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas kësaj mënyre formulimi "Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë". Elementët përbërës të këtij parimi kushtetues përcaktohen në mënyrë më të hollësishme në nenin 4 të KPP. Në aspektin e provueshmërisë së fajësisë në lidhje me një akuzë penale, kjo dispozitë vendos standardin e të provuarit, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që në rast se ekziston duhet të vlerësohet në favor të pandehurit, me pasojë deklarimin e tij si të pafajshëm*[18]."

604. Në rastin konkret, para se të marrë në analizë faktet e çështjes në raport me analizën ligjore të figurës së veprës penale, për faktet që lidhen me veprat penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 248 të Kodit Penal, gjykata evidenton se fakti objekt akuze për secilin prej të pandehurve (*duke iu referuar aktit të komunikimit të akuzës, kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në të njëjtën mënyrë edhe konkluzioneve përfundimtare me shkrim të paraqitura nga organi i akuzës*), për shumicën prej të pandehurve, rezulton të jetë formuluar në mënyrë të përgjithshme, duke iu referuar në tërësi fakteve të renditura në parashtrimin e fakteve të çështjes dhe provave dhe duke mos specifikuar ne mënyrë të specifike secilin fakt në raport me secilin të pandehur në mënyrë eksplicite. Kjo mënyrë e paraqitjes së fakteve objekt akuze, bën që gjykata që gjykon çështjen në themel, në mungesë të instrumenteve ligjore për saktësimin, qartësimin dhe individualizimin e fakteve objekt akuze për secilin të pandehur dhe rrjedhimisht edhe vlerësimin e nevojës për ngritjen e akuzës për çdo fakt penal, kur ata qëndrojnë me vete, pavarësisht se mund te kenë te njëjtin kualifikim ligjor, pavarësisht ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm apo gjykim i shkurtuar si në rastin konkret*), do të duhet të marrë në analizë dhe të vlerësojë në tërësi të gjitha faktet që lidhen me secilin të pandehur, duke analizuar konfigurimin e elementeve të figurës së veprës penale konkrete në secilin prej tyre, edhe në rastet kur faktet janë disa dhe të ndara në kohë nga njëri-tjetri.

605. Në këtë këndvështrim, në lidhje faktet në të cilat referojnë akuzat për veprat penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 248 të Kodit Penal, rezulton se pavarësisht se objekt i akuzës

---

[18] *Në vijim, në këtë vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë argumentohet se :" Mënyra e vlerësimit të provave sipas këtij standardi dhe rëndësia që paraqet respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë gjatë gjykimit penal, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, është theksuar në vijimësi edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane Për Drejtat e Njeriut GJEDNJ-së), konkretisht në vendimin nr.47, datë 07.11.2011 Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar se: "Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej cilit është "in dubio pro reo", pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit... Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë dhe barrën e provës në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, dhe se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (shih vendimet 23, datë 23.7.2009, dhe nr.9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese).".*

janë, në shumicën e rasteve, më shumë se një fakt/ngjarje, organi i akuzës, duke vlerësuar mekanizimin e zhvillimit të tyre të njëjtë si dhe mendimin kriminal si unik dhe te njëjtë, ka ngritur akuzë për secilin të pandehur, vetëm një herë. Në këtë këndvështrim, e kushtëzuar nga mungesa e mjeteve procedurale për të vepruar në drejtim të saktësimit të akuzave apo eventualisht të ngritjes së një akuze të re gjatë gjykimit të çështjes në themel, nëse kjo do të rezultonte e nevojshme, gjykata e themelit merr në analizë të gjitha faktet objekt akuze për secilin të pandehur, duke i vlerësuar ato në raport me akuzën e ngritur. Në këtë vlerësim, gjykata që shqyrton çështjen në themel, mban në konsideratë qëndrimin e GJEDNJ në çështjen *Karaman kundër Gjermanisë*[19], në të cilin gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se *gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime.*".

606. **Lidhur me veprën penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*,** për të cilën akuzohen të pandehurit *Lahert Sulo, Ani Hoxholli, Emilton Asllanaj, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Iseberi, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku, Avni Tërshalla, Arben Goçi, Reni Dokolli, Shpëtim Cenaj dhe Sulë Onuzi*, në nenin 259 të Kodit Penal, parashikohet se: "*Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.*[20]". Duke iu referuar fakteve të çështjes, rezulton se ato kanë ndodhur para se ligji nr. 43/2021, që ka ndryshuar edhe formulimin e nenit 259[21] të Kodit Penal. të hynte në fuqi në datë 01.06.2021. Në lidhje me formulimin e dispozitës gjykata konstaton se në përmbajtje të saj nuk ka ndryshime thelbësore lidhur me format e kryerjes së veprës penale apo elemente të tjerë të saj, por dispozita ka pësuar ndryshime, duke u organizuar tashmë në dy paragrafë, vetëm mbi bazën e vlerës materiale të përfitimit të parregullt si dhe ka ndryshime në masën e dënimit.

607. Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se kualifikimi i faktit penal të bërë nga organi i akuzës sipas nenit 259, pika 1 i Kodit Penal, pas ndryshimeve, është bërë në mënyrë të drejtë dhe në respektim të parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues përcaktuar shprehimisht në nenin 29,

---

[19] *Vendimi i GJEDNJ në çështjen Karaman kundër Gjermanisë, me datë 27 shkurt 2014*

[20] *Neni 259 i Kodit Penal është ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021, ligj i cili në nenin 5 të tij parashikon se :" Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 qershor 2021".*

[21] *Neni 259 i Kodit Penal, para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021, ka pasur këtë formulim:" Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.".*

pika 3 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se "*3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese*", dhe nenin 3, pika 3 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se "*Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.*". Në respektim të këtij parimi të rëndësishëm të ligjit penal material, i cili vjen në përputhje edhe me frymën dhe qëllimin e nenit 7 të KEDNJ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, kanë konkluduar se: "*Nga përmbajtja e këtij paragrafi, sipas të cilit, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale, arrihet në përfundimin se, në rastet kur, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i disfavorshëm se ligji që është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të personit që e ka kryer atë, gjykatat detyrohen të zbatojnë këtë të dytin d.m.th. ligjin e mëvonshëm, i cili është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes. Ky detyrim rrjedh nga fakti që, në rastin konkret, ligji i mëvonshëm përmban dispozita, të cilat janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale ose, duke përdorur terminologjinë kushtetuese, duhet thënë se, ligji i mëvonshëm është ligj penal favorizues dhe pikërisht për këtë arsye, ai ka fuqi prapavepruese.*". Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në vijimësi ka evokuar zbatimin e këtij parimi, duke arsyetuar se: "*Gjykata rithekson se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.04.2007; nr.35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për* personin *që ka kryer veprën penale*[22]*.*". Duke iu referuar llojit dhe masës së dënimit të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, sipas formulimit të tij në kohën e kryerjes së veprës penale në rastin konkret, me formulimin e mëvonshëm të saj (*në momentin e ngritjes së akuzës dhe gjykimit të çështjes*), rezulton se në nenin 259 të Kodit Penal, para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021 parashikohej dënimi *me burgim nga dy deri në tetë vjet,* ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 259, pg 1, pas ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021, parashikohet dënimi *me burgim nga dy deri në tre vjet.* Referuar të dy dispozitave, në planin krahasimor në raport me përcaktimin se cila prej tyre është më favorizuese, rezulton se *(i)* të dy dispozitat parashikojnë të njëjtin lloj dënimi, atë më

---

[22] *Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 29.02.2022. Në të njëjtën mënyrë shprehet Gjykata edhe në vendimet nr. 12, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014*

burgim; *(ii)* të dy dispozitat parashikojnë të njëjtën masë dënimi në minimum, atë me dy vite burgim dhe *(iii)* secila dispozitë parashikon masë të ndryshme dënimi me burgim në maksimum, përkatësisht me tetë dhe tre vite burgim. Në këto kushte, gjykata vlerëson se në respektim të parimit kushtetues të zbatimit të ligjit penal favorizues, në rastin konkret dispozita më e favorshme është ajo e mëvonshme, e cila parashikon masë më të ulët dënimi me burgim në maksimum. Për këto arsye dispozita e zbatueshme në rastin konkret, është ajo e parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, pas ndryshimeve që kjo dispozitë ka pësuar, me ligjin nr. 43/2021 dhe këtë këndvështrim, kualifikimi i faktit penal nga ana e organit të akuzës vlerësohet se është bërë në mënyrë të drejtë dhe në respektim të ligjit penal material.

608. **Në lidhje me objektin e veprës penale,** ***"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"***, ai konsiston në mbrojtjen e posaçme që legjislacioni penal ka parashikuar për marrëdhëniet juridike që synojnë të mbrojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë, juridikë apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Nga kjo vepër penale mund të cenohen si parimet kryesore të funksionimit të administratës publike ashtu edhe interesat e ligjshme të shtetit, interesat e personave juridike dhe fizikë konkretë apo edhe interesi publik në përgjithësi. Qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike, si dhe ruajta e besimit që individët kanë tek subjektet që ushtrojnë detyra publike, të cilat duhet të ushtrohen në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës, duke i shërbyer interesit publik, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në nenin 107, pg 1 i Kushtetutës parashikohet se :" *1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.*". Ndërkohë në nenin 2, pika 1 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" parashikohet se "*1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore.*". Në këtë këndvështrim, ushtrimi i një detyre apo funksioni publik (*përfshirë këtu edhe funksionin e klasifikuar nga ligji si funksion shtetëror*) duhet të udhëhiqet vetëm nga zbatimi i ligjit, mbrojtja dhe përmbushja e interesit publik dhe jo nga interesa private apo interesa të tjera të cilat nuk ndjekin një qëllim të tillë, pra mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

609. Në mënyrë specifike, në lidhje me policinë e shtetit dhe subjektet që ushtrojnë funksione në strukturën e saj, në ligjin nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, sa i përket misionit, në nenin 2 të ligjit parashikohet se :" *Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.*", ndërsa në drejtim të përcaktimit të statusit të strukturës së policisë së shtetit dhe funksionit të zyrtarëve që ushtrojnë detyra në përbërje të saj, në nenin 4, pika 1 të ligjit parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit* ***është institucion i administratës shtetërore****, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për*

çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.". Kjo dispozitë parashikon qartësisht se policia e shtetit është institucion i administratës shtetërore dhe për pasojë zyrtarët që ushtrojnë funksione brenda kësaj strukture janë subjekte që ushtrojnë funksione shtetërore, të cilët në ushtrimin e këtyre funksioneve, me rëndësi thelbësore për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, udhëhiqen nga parimet e përcaktuara qartësisht në nenin 5 të ligjit në të cilin parashikohet shprehimisht se :" *Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj, janë: a) ligjshmëria; b) mosdiskriminimi; c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ç) proporcionaliteti; d) pavarësia operacionale; dh) paanshmëria politike; e) integriteti, merita dhe profesionalizmi; ë) transparenca; f) ruajtja e informacionit të klasifikuar; g) kontrolli dhe llogaridhënia.*". Lidhur me statusin e punonjësve të policisë së shtetit të cilët ushtrojnë detyrën e tyre në strukturën për kufirin dhe migracionin, kjo strukturë është qartësisht pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit dhe për pasojë i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 108/2014, duke qenë një strukturë e saj, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 5 të ligjit në të cilin parashikohet se "*5. Në varësi të Drejtorit të Policisë së Shtetit bëjnë pjesë edhe struktura të veçanta, që ushtrojnë veprimtarinë në gjithë territorin ose në pjesë të veçanta të tij.*" dhe nenit 21, pika 1 të po këtij ligji në të cilin parashikohet se :" 1. *Në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*". Referuar kuadrit ligjor si më sipër, rezulton se veprimtaria e punonjësve të policisë së shtetit, pjesë e strukturës për kufirin dhe migracionin, përbën veprimtari shtetërore e cila përfshihet në marrëdhëniet juridike të mbrojtura nga legjislacioni penal, edhe në kuptim të objektit të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

610. Veç sa më sipër, veprimtaria e strukturës së policisë së shtetit për kufirin dhe migracionin, është e normuar edhe nëpërmjet një ligji specifik i cili është ligji nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, në nenin 5, pika 2 të të cilit përcaktohet si autoriteti përgjegjës për kontrollin kufitar pikërisht kjo strukture, duke parashikuar në mënyrë të shprehur se :" *1. Kontrolli kufitar është nën juridiksionin administrativ të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. 2.* ***Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit****, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*", ndërkohë që në nenin 6[23]

---

[23] *Në nenin 6 të ligjit nr. 71/2016, parashikohet se :" 1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen. 2. Rojat kufitare, në kuadër të verifikimit kufitar, duhet t'u japin nëpunësve të doganave apo nëpunësve të çdo autoriteti tjetër përgjegjës që operon në kufirin shtetëror mundësinë e kryerjes së verifikimeve të përbashkëta me ta, kur këta janë të pranishëm gjatë verifikimit kufitar. Rregullat për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar: a) të verifikojnë: i) origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit; ii) në rast dyshimi të arsyeshëm, identitetin e mbajtësit të dokumenteve të udhëtimit ose vizës, duke krahasuar identifikuesit biometrikë të depozituar në çdo bazë të dhënash, përveç ADN-së, me personin që po verifikohet; b) të sekuestrojnë dokumente udhëtimi, të cilat kanë tregues që justifikojnë dyshimin*

dhe 7[24] të ligjit përcaktohen qartësisht kompetencat e policisë kufitare në kufi dhe brenda territorit. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, gjejnë zbatim një sërë aktesh nënligjore që normojnë punën e punonjësve të strukturës së policisë kufitare dhe posacërisht atyre që ushtrojnë funksionon në Pikat e Kalimit Kufitar dhe Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar të cilat detajojnë procedurat standarde që zbatohen prej tyre gjatë kontrollit dhe verifikimit kufitar[25].

---

se: i) dokumenti i udhëtimit ose viza te dokumenti i udhëtimit është e falsifikuar ose e rremë; ii) janë përdorur për të siguruar informacion të rremë për një person. Nëse vërtetohet se një dokument i sekuestruar nuk është objekt i ndonjë mase të parashikuar nga Kodi Penal, u dorëzohet autoriteteve kompetente, për aq kohë sa është i nevojshëm sekuestrimi dhe, më pas, i kthehet personit ose shtetit që ka lëshuar dokumentin. 4. Rojat kufitare, për arsye të kontrollit të qarkullimit kufitar dhe për të kryer kontrollin kufitar, kanë të drejtë të hyjnë në çdo ngastër toke dhe në të gjithë ujërat, si dhe të drejtojnë automjetet në çdo rrugë, për sa kohë kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre. 5. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt. 6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë, gjithashtu, të drejtën t'u refuzojnë daljen personave: a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi; b) për të cilët ka një urdhër gjykate që ndalon daljen nga Republika e Shqipërisë; c) që duan t'i fshihen ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit apo ekzekutimit të dënimit me burgim; ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë, ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur, ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale; d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën "ç" të kësaj pike; dh) të cilët, gjatë daljes nga Republika e Shqipërisë, përdorin dokumentin e një personi tjetër ose dokument të falsifikuar; e) të cilët janë të regjistruar në dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër dhe, gjatë daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, nuk janë të shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit janë regjistruar. 7. Rojat kufitare kanë të drejtë të zbatojnë me forcë masat e përmendura në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni.".

[24] Në nenin 7 të po këtij ligji parashikohet se :" 1. Policia e Kufirit dhe e Migracionit ka të drejtë që, në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë, të marrë masa për të zbuluar të huajt që qëndrojnë ose që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme, si dhe të parandalojë, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkufitar. 2. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të verifikojë dhe të intervistojë persona, të verifikojë sende dhe mjete transporti, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim ndalimin e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit të paligjshëm të të huajve në Republikën e Shqipërisë. 3. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka, gjithashtu, të drejtë të ndërmarrë veprime hetimore dhe procedurale në rastet e veprave penale që lidhen me kufirin, përveç atyre veprave që janë përcaktuar të ndiqen posaçërisht nga struktura të tjera të Policisë ose agjenci të tjera.".

[25] Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 71/2016 janë miratuar edhe një sërë aktesh të tjera nënligjore të tilla si : (i) Urdhër nr. 163, dt. 08.02.2018, "Procedura e Punës për organizimin, planizimin dhe kryerjen e shërbimit në SPK&M, sipas situatës dhe analizës së riskut"; (ii) Urdhër nr.164, dt.08.02.2018 "Procedurat e Punës për mbikëqyrjen e kufirit"; (iii) Urdhër nr.165, dt. 08.02.2018 "Procedurat e Punës për verifikimin kufitar në P.K.K e PPKK"; (iv) Urdhër nr.166, dt.08.02.2018 "Procedurat e Punës për verifikimin e trafikut tokësor, trafikut ajror, detar e liqenor në Kufi"; (v) Urdhër nr.167, dt. 08.02.2018 "Procedura e Punës për lehtësimin e verifikimeve kufitare"; (vi) Urdhër nr.168 dt. 08.02.2018 -"Procedura Standarde për refuzimin e hyrjes në kufi të RSH-së të shtetasit të huaj". (vii) Urdhër nr. 169 dt. 08.02.2018 "Procedura Standarde të Punës për refuzimin e daljes së shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kufi"; (viii) Urdhër nr. 175 dt. 08.02.2018 - "Procedura e Regjistrimit në Sistemin TIMS të verifikimit që kryhet për kontrollin e hyrje-daljeve". (ix) Urdhër nr. 170 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për trajtimin e shtetasve të huaj me leje qëndrimi". (x) Urdhër nr. 171 dt. 08.02.2018 - "Procedura Standarde e punës për lëshimin e vizave në kufi dhe anulimin e tyre". (xi) Urdhër nr. 172 dt. 08.02.2018 - "Procedurat standarde për përzgjedhjen e shtetasve të huaj të parregullt dhe masat që merren". (xii) Urdhër nr. 173 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për zgjatjen e qëndrimit mbi afatin e përcaktuar ligjor të shtetasit të huaj". (xiii) Urdhër nr. 174 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për vlerësimin e aplikimeve për vizë në Shqipëri të shtetasve të huaj". (xiv) Urdhër nr. 176 dt. 08.02.2018 - "Procedurat standarde për largimin/dëbimin e shtetasit të huaj me qëndrim të parregullt në RSH". (xv) Urdhër nr. 1294/1, datë 17.05.2016, "Procedura e punës për zbulimin e lëndëve radioaktive; (xvi) Urdhër nr. 18378, datë 08/08/2017, "Procedurat standarde të punës që drejtojnë përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe mjeteve të transportit që kalojnë kufijtë e Republikës së Shqipërisë me anë të skanerave fiks dhe të lëvizshëm".

611. Po ashtu në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.09.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 09.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*". Po ashtu, në zbatim të ligjit nr. 71/2016, në lidhje me verifikimet e përbashkëta kufitare, gjen zbatim Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 26.10.2016 "Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare", i cili parashikon rregulla specifike për kontrollin e përbashkët kufitar, me qëllim kryerjen e verifikimit sipas parimit një ndalesë një verifikim, në funksion të lehtësimit të kalimit të kufirit, si dhe për të siguruar një verifikim sa më të efektshëm dhe me pjesëmarrjen e të gjitha autoriteteve përgjegjëse që veprojnë ne pikën përkatëse të kalimit kufitar. Ndërkohë, lidhur me procedurat e kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë me Kosovën, në kohën që janë zhvilluar ngjarjet objekt i këtij procedimi, zbatohej edhe marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "*Për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar*", ratifikuar me ligjin nr. 24, datë 18.04.2019, në të cilën ndër te tjera, në nenin 5[26] të marrëveshjes parashikohen rregulla të përbashkëta për kontrollet kufitare në hyrje dhe në dalje, ndërsa në nenin 1, nën titullin "Përkufizime", ndër të tjera, në pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 përkufizohen termat e përbashkëta për verifikimin kufitar, vendin e hyrje, vendin e daljes, zonën e përbashkët të kalimit kufitar, nëpunësit dhe sanksionohet parimi "një ndalesë një kontroll"[27].

---

[26] *Në nenin 5 të marrëveshjes, nën titullin "Kontrollet kufitare në hyrje – dalje", parashikohet se :" 1. Shtetasit, automjetet dhe mallrat, të cilët hyjnë dhe/ose dalin nga territori i Palëve, u nënshtrohen kontrolleve të përbashkëta nga autoritetet përkatëse përgjegjëse vetëm një herë, bazuar në parimin "një ndalesë një kontroll", në hyrje dhe dalje njëri pas tjetrit, sipas legjislacionit kombëtar të secilës palë dhe në përputhje me këtë marrëveshje, në vendet e caktuara për këtë qëllim. 2. Pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në dalje, oficerët/nëpunësit e shtetit të daljes nuk janë më të autorizuar të kryejnë veprime të lidhura me kalimin e kufirit. Sidoqoftë, nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në hyrje ka dyshime për vepra penale ose nëse konstatohet se një person, i cili duhet arrestuar ndodhet në zonë, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes. 3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi i kontrollit me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta. 4. Personat të cilët refuzohen nga oficerët /punonjësit e shtetit të hyrjes, nuk mund të refuzohen të kthehen në shtetin e daljes/origjinës. 5. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes. 6. Të ardhurat e mbledhura nga oficerët e shtetit fqinj në formën e tarifave zyrtare për qëllime të procedurave të kalimit të kufirit në shtetin territorial, kthehen në vendet e tyre respektive dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit. Të hollat dhe letrat me vlerë të sekuestruara nga nëpunësit e secilës nga palët gjatë kryerjes së kontrollit doganor, si dhe mallrat ose mjetet e sekuestruara duhet të trajtohen sipas legjislacionit të palës konstatuese dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit. 7. Gjatë zbatimit të masave të përmendura në paragrafët 4–6, nëpunësit e Palëve informojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën.".*

[27] *Në nenin 1 të marrëveshjes parashikohet se :" Për qëllime të kësaj marrëveshjeje: "Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar" – pika e autorizuar për kalimin e kufirit, ku autoritetet e Palëve ushtrojnë verifikime të përbashkëta kufitare. 2. "Verifikimi kufitar" – kontrolli i kryer në PPKK, në mënyrë që personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat të plotësojnë kushtet për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve. 3. Vendi i hyrjes – pala*

612. Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", ajo përbën një element të domosdoshëm për përgjegjësinë penale, pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm nuk mund të ketë vepër penale e për pasojë nuk mund të ketë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, nga ana objektive kryhet me veprime aktive të kundërligjshme të shfaqura në forma të ndryshme, të cilat përcaktohen nga vetë dispozita dhe konkretisht nëpërmjet *kërkimit* ose *marrjes*, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthortë, të çfarëdo përfitimi të parregullt nga ana e funksionarit publik, për vete ose për persona të tjerë, me qëllimin për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin. Po ashtu, kjo vepër mund të konfigurohet edhe në formën e *pranimit të një oferte apo premtimi*, nga personi që ushtron funksione publike, premtim apo ofertë që vjen nga një përfitimi i parregullt, për vete ose për persona të tjerë, me qëllimin për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij. Format e kryerjes së veprës penale dhe termat që ligjvënësi ka përdorur për përcaktimin e këtyre formave nuk gjejnë një përkufizim në legjislacionin tonë penal, por janë tërësisht të njëjta me ato të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat në referim të neneve 5, 116, pika 1 dhe 122, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, janë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim por gjithashtu, kanë shërbyer si bazë për përditësimin dhe përshtatjen e legjislacionit tonë penal, nëpërmjet ndryshimeve që ka pësuar ndër vite[28].

613. Në referim të sa më sipër, gjykata merr në analizë format me të cilat konkretizohet/shfaqet ana objektive e veprës penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike. Konkretisht : *(i) kërkimi* si formë e kryerjes së kësaj vepre penale, nënkupton një shfaqje vullneti të njëanshëm, në formën e një veprimi të kryer nga funksionari publik, veprim i cili në

---

kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në hyrje. 4. Vendi i daljes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në dalje. 5. Zona e pikës së përbashkët të kalimit kufitar, këtej e tutje ZPPKK – zona e përcaktuar sipas legjislacionit të vendit pritës, ku nëpunësit e të dy palëve janë të autorizuara të kryejnë verifikimin kufitar, sipas kompetencave. 6. Nëpunës – janë personat të cilët kryejnë detyrat e tyre si përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për kontrollin kufitar, si edhe ata përgjegjës për mbikëqyrjen e shërbimeve të autorizuara nga secila Palë Kontraktuese. 7. Mallrat – mallrat, mjetet e transportit dhe vlerat materiale që u nënshtrohen rregullave doganore. 8. Parimi "një ndalesë një kontroll" – verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat. 9. "Vendi pritës" – pala në territorin e së cilës ngrihet PPKK-ja dhe kryhen verifikimi kufitar nga nëpunësit e palëve.".

[28] *Konventa Penale për Korrupsionin, e Këshillit të Evropës, miratuar në Strasburg në datë 27.01.1999, ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 24.06.2001, në nenin 3 parashikon se :" Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë të asaj Pale, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mos vepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.". Në të njëjtët terma, Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, miratuar në Nju Jork më 31 tetor 2003, ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.3.2006, në nenin 15 të saj parashikon se :" Secili shtet palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepra penale, kur kryhet me qëllim: a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare. b) kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare.".*

perceptimin e personit të cilit i drejtohet, i jep atij të kuptojë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar se duhet të paguajë me qëllim që të realizohet veprimi ose mosveprimi i kërkuar. Pra duhet të rezultojë se forma e shfaqjes së vullnetit të funksionarit, nëpërmjet *kërkimit*, të perceptohet qartë nga një njeri i zakonshëm si një veprim që i kundër drejtohet atij, pikërisht me ketë qëllim. *(ii) marrja,* si formë e kryerjes së veprës, është pranimi i vullnetshëm i një përfitimi të parregullt nga ana e funksionarit publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndërmjetësimin e personave të tjerë, të cilët janë persona që kanë lidhje me funksionarin *(familjare, shoqërore, biznesi, etj.)* edhe nëse ky përfitim mund të mos jetë kërkuar paraprakisht prej tij; *(iii) pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt*, konkretizohet nëpërmjet shprehjes së vullnetit pranues ose miratues në lidhje me një ofertë apo premtim që i bëhet funksionarit publik. Të tria këto forma, kërkimi, marrja ose pranimi, mund të konkretizohen drejtpërdrejt nga ose në drejtim të funksionarit publik, ose në mënyrë të tërthortë, pra në rastet kur veprimi korruptiv në secilën formë të tij, realizohet nëpërmjet ndërmjetësimit nga persona të tjerë, pavarësisht nëse përfituesi apo pranuesi i përfitimit të parregullt është vetë personi që ushtron funksionin publik apo një person i ndryshëm prej tij, pra një i tretë. Ndërkohë termi *"për vete ose për persona të tjerë"* nënkupton se përfitues mund të jetë vetë personi subjekt i veprës penale të korrupsionit pasiv, por mund të jenë edhe persona të tjerë, pasi përfitimi i parregullt jo domosdoshmërish kërkohet, merret ose pranohet nga funksionari publik, por mund të përfitohet edhe nga persona të tjerë të tillë si familjarë të tij, të afërm, të njohur të tij, subjekte tregtare apo entitete të tjera (*organizata, formacione private, politike, etj.*) më të cilët vetë funksionari ka lidhje ose ndan interesa të caktuara. Në këtë rast është e rëndësishme të vërtetohet apo rezultojë se funksionari, subjekti i veprës penale, së paku duhet të jenë në dijeni të këtij veprimi, dhe në mënyrë të shprehur apo të heshtur pranon ose lejon që përfitimi i parregullt të shkojë në dobi *të tretëve të lidhur me të.*

614. Po ashtu, që të konsumohet vepra penale e korrupsionit pasiv, duhet që funksionari publik të kryejë veprën penale me veprime aktive ose mosveprime të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, "*çdo lloj përfitimi të parregullt*" të tillë si para apo përfitime të tjera materiale ose jo materiale, favore, përfitim të shërbimeve apo privilegjeve të parregullta, për vete ose për persona të tjerë, gjithnjë me qëllim për të kryer ose mos kryer, një veprim që lidhet me detyrën apo funksionin e tij[29]. Pra në qendër të anës objektive të kësaj vepre panele qëndron konfigurimi i një shkëmbimi të kundërligjshëm dhe të ndërsjelltë, në të cilin veprimet ose mosveprimet e funksionarit publik, konkretizuar nëpërmjet kërkimit, marrjes ose pranimit të një përfitimi të parregullt, për vete ose për të tretë, qëndrojnë përkundrejt dhënies së një përfitimi të tillë nga një subjekt i jashtëm, përkundrejt kryerjes ose moskryerjes nga ana e funksionarit të një detyre që lidhet me funksionin e tij publik. Kjo vepër konsiderohet e kryer si në rastin kur funksionari publik kryen ose nuk kryhen një detyrë në respektim të ligjit, ashtu

---

[29] *Në lidhje me kryerjen ose moskryerjen e funksioneve nga zyrtari publik, në nenin 19 të Konventës "Abuzimi me funksionet" përcaktohet si : "Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepër penale, kur kryhet me qëllim abuzimin me funksionet ose pozicionin, që është kryerja ose moskryerja e një akti, duke thyer ligjin, nga një nëpunës publik në ushtrimin e funksioneve të tij ose të saj, për qëllimin e marrjes së një avantazhi të parregullt për vete ose për një person tjetër apo subjekt."*

edhe kur ai e kryen këtë detyrë nëpërmjet një forme në dukje të ligjshme dhe të rregullt, por që gjithnjë duhet të ketë lidhje me marrëdhënien e ndërsjelltë të shkëmbimit të parregullt të dakordësuar apo pranuar më herët. Në lidhje me këtë aspekt, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 139, datë 22.11.2017, ndër të tjera arsyeton se: *"Me qëllim dallimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në raport me veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit apo funksionarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, Kolegji vlerëson se në veprën penale të shpërdorimit të detyrës, personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta, vepron në kundërshtim me ligjin. Ndërsa <u>në veprën penale të korrupsionit pasiv, personi kërkon ose merr përfitime për të kryer ose mos kryer një veprim që ka lidhje me detyrën, por që nuk vepron domosdoshmërisht në kundërshtim me detyrën e tij.</u> Si element i përbashkët i këtyre veprave penale është 'përfitimi i parregullt për vete ose për të tretë', nga ana e personit që mban një funksion publik."*[3031].

615. Po ashtu në drejtim të anës objektive, vepra penale e korrupsionit pasiv, konsiderohet e kryer që në momentin që vërtetohet kërkimi, marrja dhe/ose pranimi i një përfitimit të parregullt, pavarësisht nga ardhja e pasojave të tjera, pra edhe pa u realizuar në fakt shkëmbimi i të mirave materiale ose jo materiale, pasi referuar formave me të cilat kjo vepër kryhet, të cilat qëndrojnë të pavarura nga njëra tjetra, mjafton vetëm që të arrihet një marrëveshje në formë premtimi për përfitime të parregullta të dyanshme, edhe pa marrjen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes palëve, gjithnjë nëse funksionari ka dijeni rreth saj dhe marrëveshja korruptive, dijeni e cila mund të rezultojnë ose të nxirret edhe nga rrethanat. Lidhur me dijeninë dhe qëllimin, neni 28 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, parashikon qartësisht se: "*Dijenia dhe qëllimi i kërkuar si element i një vepre penale, i parashikuar në pajtim me këtë Konventë, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.*".

616. Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në nenin 12 të Kodit Penal parashikohet se: "*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç*". Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe për pasojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe

---

[30] *Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 484, datë 19.05.2010, ku ndër të tjera arsyetohet: "Dispozitat e nenit 248 dhe 259 të K.Penal, janë të vendosura në seksionin e dytë të kreut të VIII të K.Penal që trajton veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë. Këto vepra kanë objekt të njëjtë dhe konkretisht ato marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror, si dhe të drejtat dhe liritë e personit, por nga ana objektive; ndërsa krimi i parashikuar nga neni 248 i K.Penal, kryhet me veprime në kundërshtim me përmbushjen e detyrës, <u>krimi i parashikuar nga neni 259 i K.Penal mund të kryhet edhe me veprime jo në kundërshtim me detyrën, por këto veprime apo mos veprime subjekti i kryen për shkak të marrjes ose kërkimit të një përfitimi material.</u> Po kështu, nëse në dispozitën e nenit 248 të K.Penal, qëllimi për fitim mund të mos jetë element i domosdoshëm i figurës së krimit, tek dispozita e nenit 259 të K.Penal, <u>qëllimi, pra kërkimi ose marrja e çfarëdo përfitimi të parregullt ose pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale.</u>".*

[31] *Pavarësisht se vendimi i sipërcituar i Kolegjit Penal i referohet veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, në nivel teorik analiza e bërë në këtë vendim ka vlerë të njëjtë edhe në raport me veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal pasi elementet e anës objektive të të dy veprave, posaçërisht format e kryerjes së tyre, janë të formuluara në mënyrë tërësisht të njëjtë.*

përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere të domosdoshme : *(i)* Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe *(ii)* të jetë i përgjegjshëm. Këto dy elementë thelbësorë për kualifikimin e një personi si subjekt i veprës penale përcaktohen përkatësisht, mosha nga neni 12[32] i Kodit Penal dhe sa i përket përgjegjshmërisë, në nenin 17 të Kodit parashikohet se: "*Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale*". Ligji përcakton se mund të procedohen penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, pra që zotërojnë të paktën një ndërgjegje minimale, të tillë që të jenë të aftë të kontrollojnë dhe kuptojnë veprimet qe kryejnë, rëndësinë e tyre dhe pasojat e mundshme, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet forma e fajësisë. Në këtë drejtim, ligjvënësi ka përjashtuar nga përgjegjësia penale, për shkak të turbullimeve të gjendjes mendore, vetëm ato raste kur rezultojnë dhe provohen në mënyrë kumulative këto kushte: *(i)* të rezultojë e provuar se personi vuan nga një turbullim psikik ose neuropsikik; *(ii)* ky turbullim të ketë cenuar tërësisht ekuilibrin mendor të tij dhe *(iii)* turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen.

617. Në rastin konkret, të pandehurit e akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, janë të gjithë punonjës së strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet. Konkretisht, sikurse është referuar në analizën e objektit të veprës penale, më sipër në këtë vendim, policia e shtetit, është institucion i administratës shtetërore, sikurse parashikohet shprehimisht në nenin 4 pika 1 te ligjit nr. 108/2014, në të cilin sanksionohet shprehimisht se :" 1. *Policia e Shtetit <u>është institucion i administratës shtetërore</u>, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike*". Po ashtu në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar, struktura e policisë së shtetit për kufirin dhe migracioni, ngarkohet drejtpërdrejt me përgjegjësi dhe për pasojë me pushtet shtetëror për zbatimin e këtij ligji dhe

---

[32] *Në nenin 12 të Kodit Penal parashikohet se :" Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.".*

përmbushjen e qëllimit të tij, duke u përcaktuar në mënyrë të shprehur autoriteti publik i kësaj strukture, për pasojë edhe punonjësve të saj, në referim të nenit 5, pika 2 të këtij ligji ku është përcaktuar se :"*2.Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*". Po ashtu, në rregulloren për policinë e shtetit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*".

618. Sa më sipër, rezulton se punonjësit e strukturës së policisë së shtetit të cilët ushtrojnë funksionet ne Policinë Kufitare, në nivel qendror dhe vendor, janë subjekte që plotësojnë kushtet për tu klasifikuar si funksionarë publike dhe për pasojë, plotësojnë kushtin e posaçëm për të qenë subjekte të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në këtë konkluzion gjykata mban në konsideratë edhe përkufizimin e bërë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit[33], në nenin 2, shkronja a) të së cilës termi *nëpunës publik* përkufizohet në këtë mënyrë: "*a) "Nëpunës publik" është: (i) çdo person që mban në post legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor në një shtet palë, i emëruar ose i zgjedhur, i përhershëm ose i përkohshëm, i paguar ose i papaguar, pavarësisht nga kohëzgjatja e shërbimit të personit; (ii) çdo person tjetër që ushtron një funksion publik, duke përfshirë në agjenci publike ose ndërmarrje publike, ose që kryen një shërbim publik, sipas përcaktimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në sferën përkatëse të ligjit në shtetin palë; (iii) çdo person tjetër të përcaktuar si "nëpunës publik" në ligjin e brendshëm të shtetit palë, megjithatë, për qëllimet e disa masave specifike që parashikohen në kapitullin II të kësaj Konvente, "nëpunës publik" është çdo person që ushtron një funksion publik ose jep një shërbim publik sipas parashikimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në fushën përkatëse të ligjit të shtetit palë.*".

619. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale ***"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"***, në nenin 14 të Kodit Penal parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer **me faj**. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*" Me anë subjektive të figurës së veprës penale kuptohet qëndrimi psikik dhe i ndërgjegjshëm që mban personi, kundrejt veprës së kryer prej tij dhe pasojave që vijnë nga kryerja e veprës. Në respektim të parimit të fajësisë në të drejtën penale materiale, duhet që subjekti aktiv i saj jo vetëm të jetë i përgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës por kërkohet dhe që ai te veprojë me faj. Faji, duke qenë një element që formohet në ndërgjegjen e personit është e vështirë të konfigurohet por ai në çdo rast vlerësohet nga mënyra se si shfaqet dhe materializohet në veprimet apo mosveprimet e tij, që përbëjnë edhe anën objektive të veprës penale për të cilën akuzohet. Pra, pavarësisht se mendimi apo akti i vullnetit për kryerjen e një

[33]*Ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13 mars 2006*

vepre penale formohet në ndërgjegjen e personit, mënyra se ai ai e shfaq atë në botën e jashtme, qartëson këtë vullnet të brendshëm të tij, duke bërë të mundur përcaktimin e ekzistencës së tij dhe formën konkrete të fajit në çdo rast.

620. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në çdo rast kryhet me dashje, çka do të thotë që subjekti ka vetëdije të plotë mbi kundërligjshmërinë e veprimit të tij si dhe është i ndërgjegjshëm (ka dijeni) që subjekti tjetër, jep ose ofron një përfitim të parregullt, pra tek subjekti aktiv i kësaj vepre rezulton dijenia e tij se *marrja apo pranimi i një përfitimi të tillë, është në korrelacion më dhënien apo premtimin e një të treti në drejtim të tij apo personave të lidhur me të.* Kërkimi, marrja apo pranimi i një ofertë për një përfitim të parregullt, në çdo rast duhet të konkretizohet nëpërmjet elementëve të anës objektive të veprës penale dhe duket të shoqërohet me ekzistencën e vullnetit dhe dijenisë së personit që ushtron funksione publike mbi këtë operacion/veprimtari të shfaqur në botën e jashtme nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme dhe penalisht të dënueshme. Po ashtu, element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal është dhe qëllimi i cili duhet të konfigurohet dhe të rezultojë i qartë nga tërësia e rrethanave dhe veprimeve ose mosveprimeve nëpërmjet të cilave shfaqet vullneti i subjektit në botën e jashtme. Qëllimi, konkretizuar nëpërmjet kërkimit, marrjes së çfarëdo përfitimi të parregullt apo pranimit të një propozimi apo oferte të parregullt, për vete ose për të tjerë, nga personi që ushtron funksione publike, është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale.

621. Duke iu referuar akuzës për të gjithë të pandehurit të cilët akuzohen për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1, në bashkëpunim, gjykata merr në analizë institutin e bashkëpunimit, i cili në nenin 25 të Kodit Penal përkufizohet si: *"Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre."*. Në lidhje me rrethanën rënduese të *"bashkëpunimit"*, ligjvënësi ka sanksionuar në nenin 25 të Kodit Penal, kuptimin e institutit të bashkëpunimit, sipas së cilit, kërkohet bashkekzistenca e dy elementeve të rëndësishëm: *(i) së pari*, vepra penale të jetë kryer nga dy ose më shumë persona dhe *(ii) së dyti*, vepra penale të jetë kryer në marrëveshje ndërmjet tyre, marrëveshje e cila duhet të konfigurohet në anën subjektive të veprës dhe të shfaqet si e tillë duke u konkretizuar në elementet që përbëjnë anën objektive të saj. Në lidhje me institutin e bashkëpunimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.4, datë 15.04.2011, kanë arritur në përfundimin se: *"Sikurse u analizua më sipër, nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal. Nga pikëpamja e anës subjektive kërkohet gjithashtu marrëveshja e këtyre personave në kryerjen e veprës penale"*. Në të njëjtin vendim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: *"Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non: 1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash); 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale; 3.dhënia e një kontributi relevant në kryerjen e veprës penale*

nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se karakteristikë e veprës penale të kryer në bashkëpunim është uniteti i anës subjektive të veprës penale të kryer në bashkëpunim. Verifikimi i katër elementeve të mësipërm bën që vepra penale të cilësohet e kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuara në gjykim". Në vendimin si më sipër, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material dhe/ose moral në kryerjen e veprës penale. Në këtë drejtim doktrina ka pranuar se për të qenë në kushtet e bashkëpunimit, "*... mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues ...*". Në këtë logjikë përfshihen si veprimet *ex ante*, ashtu edhe ato *ex post* të autorit në kryerjen e veprës penale, me kushtin që të kenë ndikuar apo të kenë synuar pasojën kriminale[34]. Për të cilësuar kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal, qoftë si rrethanë cilësuese kur parashikohet nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal si e tillë, qoftë si rrethanë rënduese, është e rëndësishme që veprimet dhe/ose mosveprimet, pjesë e anës objektive të veprës penale, të dëshmojnë qartë veprimin e dy ose më shumë personave në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dhënien e kontributit të përbashkët ose relevant të secilit prej tyre, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal, mbi bazën e një marrëveshje paraprake ose të arritur aty për aty, në mënyrë të shprehur ose të heshtur mes bashkëpunëtorëve, por që ka në fokus të përhershëm, deri në realizimin e qëllimit kriminal, veprimin e përbashkët ose komplementar të secilit bashkëpunëtor në funksion të të njëjtit qëllim kriminal.

622. Në vijim gjykata merr në analizë faktet objekt akuze për secilin të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259 pg 1, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, duke i vlerësuar ato në raport me analizën e mësipërme në drejtim të vërtetimit dhe provueshmërisë së objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

---

[34] *Me herët, në vendimin unifikues nr.1, datë 26.03.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë arritur në përfundimin se: "Marrëveshja, qe është një nga elementet e domosdoshëm për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, madje më kryesori, mund të vendoset jo vetëm midis organizatorit, ekzekutorit, shtytësit dhe ndihmësit që përbën formën klasike të bashkëpunimit. Ajo mund të vendoset edhe midis vetë ekzekutorëve të veprës penale, (në rastet kur ata janë dy ose më shumë persona) dhe në këtë rast do të ndodhemi para bashkëpunimit për të kryer vepër penale në formën e bashkekzekutorit të saj. Për të patur këtë formë bashkëpunimi, kërkohet që, secili nga personat qe marrin pjesë në realizimin e veprës penale, ose thënë ndryshe, secili nga bashkekzekutorët, të kryejë veprime që të kenë lidhje të drejtë për drejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar nga të gjithë të tjerët dhe që vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga secili prej bashkekzekutoreve d.m.th secili nga bashkekzekutoret me veprimin apo veprimet e tij, të marrë pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale. Në të njëjtën kohë, kërkohet që veprimet e secilit prej bashkekzekutoreve, të jenë rezultat i realizimit jo i dëshirave individuale te tij, por të jenë rezultat i realizimit të vullnetit teë përbashkët të të gjithë bashkekzekutorëve të një veprimtarie të caktuar, konkrete, kriminale."*

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit LAHERT SULO

623. Lidhur me të pandehurin **Lahert Sulo**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, gjykata krijoi bindjen e brendshme të bazuar në prova se i pandehuri Lahert Sulo ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën akuzohet në lidhje me ngjarjen e datës 26.12.2021 ku rezulton se ka kërkuar nga shtetasi Ahmet Kuçanaj, një shumë parash, ofruar prej këtij të fundit, pas kërkimit, në masën 60 euro, në funksion të regjistrimit të tij dhe automjetit të tij, në sistemin TIMS në rubrikën e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

624. Ky fakt rezulton i provuar nga përmbajta e komunikimit të tij me shtetasin Ahmet Kuçanaj në aplikacionin whatsapp, dokumentuar nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Lahert Sulo në procesverbalin e datës 21.03.2022, ku rezulton komunikim mes tyre i datës 26.12.2021, zhvilluar në harkun kohor 09.43-09.45 a.m (paradite), ndërkohë që rezulton se ky shtetas, sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, në orën 08.23 ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Murriqan me mjetin me targa "BL 541109". Ky komunikim përkon edhe me veprimin e regjistruar në sistemin TIMS në orën 12.34 minuta, veprim ky që nga këqyrja e sistemit TIMS është regjistruar në datë 28.12.2021 pasi data e daljes dhe data e regjistrimit janë të ndryshme. Mos përkimi i këtyre të dhënave që si rregull, duhet të shënohen në të njëjtin moment që shtetasi paraqitet në sportel për të kaluar kufirin dhe kryen procedurat e regjistrimit, parë së bashku me bisedën e zhvilluar mes shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe të pandehurit Lahert Sulo ku në telefonin e këtij të fundit dërgohet fotografi si dhe targa e mjetit, së bashku me bisedën që shoqëron këtë komunikim ku Lahert Sulo i drejtohet me fjalët "Sa euro i bie", ndërsa Ahmeti i përgjigjet "60 euro" dhe Laherti i përgjigjet "Ok", pasuar nga veprimet e kryera në sistemin TIMS pikërisht për këtë shtetas dhe me automjetin përkatës, targa e së cilit dërgohet me sms. Këto fakte japin të dhëna të mjaftueshme se i pandehuri Lahert Sulo ka kërkuar dhe më tej ka pranuar marrjen e shumës 60 euro kundrejt veprimeve që ka kryer në lidhje me regjistrimin në procedurat e kalimit në kufirin dalës për shtetasin Ahmet Kuçanaj.

625. Rezulton e provuar se i pandehuri Lahert Sulo në cilësinë e punonjësit të pikës së kalimit kufitar Morinë, Kukës, pavarësisht se referuar pozicionit të tij të punës si shef i Stacionit të PKK, nuk ka pasur për detyrë funksionale të drejtpërdrejtë të kryejë përpunimin dhe regjistrimin në sistem të të dhënave të shtetasve që kalojnë kufirin tokësor, rezulton se në funksion të regjistrimit të daljes së shtetasit Ahmet Kuçanaj nga PKK Morinë në datë 26.12.2021, para se të ndodhë dhe të regjistrohet ky veprim në sistem (dalja) veprim i cili rezulton se është regjistruar në sistemin elektronik dy ditë më vonë, kërkon, nëpërmjet pyetjes *"Sa euro?"* dhe pranon pasi bashkëbiseduesi i përmend shumën 60 euro, duke thënë OK, ***marrjen e shumës përkatëse në vlerën 60 euro për të kryer veprimet e kërkuara nga bashkëbiseduesi, shtetasi Ahmet Kuçanaj.***

626. Veprimi i marrë përsipër kundrejt shumës së rënë dakord në komunikimin mes tij dhe shtetasit Ahmet Kuçanaj, pavarësisht se veprimet në sistemin TIMS në rubrikën "*Detaje për daljen*" rezulton të jenë kryer nga një përdoruesi i shënuar me kodin "KS_IMP", i cili nuk është

verifikuar për identitetin e tij, përmban dy forma të realizimit të anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, konkretizuar nga ana objektive nëpërmjet *kërkimin*, duke iu drejtuar shtetasit Ahmet Kuçanaj, pasi ky i fundit i ka dërguar targën e automjetit dhe foto të pasaportës së tij, me fjalët "Sa euro", pasuar nga *pranimi* i ofertës për përfitim të paligjshëm, pasi shtetasi i ofron shumën "60 euro", duke rënë dakord nëpërmjet miratimit me fjalët "Ok". Në ketë formë i pandehuri Lahert Sulo ka demonstruar një shfaqje vullneti për marrjen e një përfitimi të paligjshëm, kundrejt kryerjes së një veprimi të kryer nga funksionari publik, veprim i cili në perceptimin e personit të cilit i drejtohet, i jep atij të kuptojë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar se duhet të paguajë me qëllim që të realizohet veprimi ose mosveprimi i kërkuar. Në rastin konkret rezulton se sjellja dhe veprimet e të pandehurit kanë krijuar të shtetasi Ahmet Kuçanaj pikërisht këtë perceptim, pasuar më pas nga shfaqja e vullnetit të këtij të fundit, pikërisht nëpërmjet ofrimit të shumës konkrete.

627. Ky veprim i kryer nga i pandehuri, duke kërkuar dhe pranuar pagimin e një shumë parash, konkretisht në vlerën 60 euro, kundrejt kryerjes së veprimeve për regjistrimin e shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe mjetit të tij, në sistemin elektronik që pasqyron veprimet e kalimit në kufi të shtetasve, pavarësisht nëse kjo ngjarje (*pra kalimi real në kufi*) ka ndodhur ose jo (*pra nëse është kryer një regjistrim fiktiv*) përmban qartësisht elementë të anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pika 1 i Kodit Penal, konkretizuar në drejtim të anës objektive nëpërmjet *kërkimit* dhe më pas *pranimit* të një përfitimi të parregullt, në funksion të përmbushjes së interesit të kërkuesit Ahmet Kuçanaj për regjistrimin e këtij veprimi në sistemin përkatës. Edhe në rast se regjistrimi i kalimit të këtij shtetasi në kufi do të kishte ndodhur për shkak të kalimit real të tij në datën dhe orën e përcaktuar, pasqyruar në sistemin TIMS, fakt që vihet në dyshim për shkak të mospërputhjes së datës së daljes me datën e regjistrimit të këtij veprimi në sistem, të cilat kanë një diferencë prej 2 ditësh (*dalja përkon me datën 26.12.2021 ndërsa regjistrimi i këtij veprimi përkon me datën 28.12.2021*) përsëri, kërkimi dhe pranimi i një shume parash në funksion të kryerjes së këtij veprimi të kërkuar, përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës nga ana e punonjësit të policisë dhe përmban qartësisht elementët e anës objektive të veprës penale të "*Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

628. Ky veprim i konkretizuar nëpërmjet formave që përbëjnë anën objektive të veprës penale konkrete, ka cenuar marrëdhëniet juridike të marra në mbrojte në mënyrë të posaçme nga Kodi Penal nëpërmjet figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 pg 1 i Kodit Penal, pasi në referim të parashikimeve të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 26.10.2016 "Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare", nga ana e të pandehurit Lahert Sulo janë cenuar rregullat për verifikimin kufitar, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 6 në të cilin parashikohet se :"*Verifikim kufitar është veprimtari që kryhet në pikën e kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për të dalë prej tij.*". Po ashtu në nenin 5 të ligjit përcaktohen autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar, duke përcaktuar në mënyrë të posaçme në pikën 2 se :"*Detyrat*

e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjen kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktua në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.", ndërsa në nenin 6 të këtij ligji përcaktohen në mënyrë specifike dhe të detajuar kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në kufi, ndërsa në nenin 13 të ligjit, lidhur me verifikimet kufitare, në pikën 1 të të cilit përcaktohet se "*Të gjitha lëvizjet ndërkufitare në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i verifikimeve kufitare nga rojat kufitare.*", ndërsa në nenin 14 të ligjit parashikohet se :"*1. Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga: a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e, veçanërisht, me: i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit; ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit; iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë; b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse. Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit...*". Në rastin konkret, pavarësisht zbatimit ose jo të lehtësimit të verifikimeve kufitare sipas parashikimeve të nenit 17 të ligjit, zbatimit të parimit "*një ndalesë- një verifikim*" sipas parashikimeve të pikës 1 të VKM nr. 745/2016, apo zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për menaxhimin e integruar të kufirit mes dy shteteve, asnjë prej këtyre regjimeve të përgjithshme apo të posaçme për verifikimin dhe/ose kontrollin kufitar nuk "*lejon*" marrjen përsipër dhe/ose kryerjen e veprimeve për regjistrimin e shtetasve apo mjeteve me të cilat at udhëtojnë, në kundërshtim me ligjin pikërisht nga punonjësit të cilët kanë në kuptim të legjislacionit të sipër referuar, cilësinë e rojës kufitare. Nëpërmjet kërkimit dhe pranimit të një shumë parash, kundrejt kryerjes së veprimeve për regjistrimin e daljes së shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe mjetit të tij, në dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës së këtij të fundit, veprim i cili rezulton të jetë regjistruar ne sistemin elektronik dy ditë më vonë se sa vetë data e daljes e pasqyruar në sistem, i pandehur Lahert Sulo, në cilësinë e shefit të stacionit të PKK Morinë, me detyra të posaçme për të mbikëqyrur dhe garantuar zbatimin e ligjit në lidhje me menaxhimin e kufirit në këtë pikë të kalimit kufitar, ka kryer veprime të kundërshtim me ligjin, të cilat përmbajnë qartësisht elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

629. Në drejtim të anës subjektive, gjykata vlerëson se në rastin konkret, rezulton se i pandehuri Lahert Sulo ka vepruar me dashje direkte, të shfaqur së jashtmi nëpërmjet kërkimit dhe pranimit të një përfitimi të paligjshëm, në masën e 60 eurove, në funksion të kryerjes së veprimeve të regjistrimit për kalimin në kufi të shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe mjetit të tij, sipas kërkesës së këtij të fundit.

630. Sa i përket subjektit, në rastin konkret, referuar analizës së bërë më sipër në këtë vendim lidhur me elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri Lahert Sulo përmbush kushtet e përgjithshme për të qenë subjekti i kësaj vepre penale në kuptim të nenit 12 dhe 17 të Kodit Penal. Kjo pasi rezulton se ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale në referim të nenit 12 dhe nuk rezulton asnjë e dhënë që të hedhë dyshime mbi prezencën e elementëve që vënë në dyshim përgjegjshmërinë e tij, duke vlerësuar se në kuptim të nenit 17 të Kodit Penal, i pandehuri është i përgjegjshëm.

631. Në raport me kushtet e posaçme për të qenë subjekti veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se, referuat edhe analizës së bërë më sipër në këtë vendim, i pandehuri Lahert Sulo, në cilësinë e punonjësit të policisë së shtetit dhe posaçërisht në pozicionin e shefit të stacionit të PKK Morinë, është funksionar publik në referim të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, pasi ushtron funksione publike, ka qenë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotëson kushtet për të qenë subjekt i posaçëm i veprës penale për të cilën akuzohet[35].

632. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata konkludon se i pandehuri **Lahert Sulo**, duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, paragrafi 1 i Kodit Penal, pasi rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në ngjarjen e datës 26.12.2021 në lidhje me kërkimin dhe pranimin e një shume prej 60 euro nga shtetasi Ahmet Kuçanaj, kundrejt kryerjes prej të pandehurit të veprimeve të kundërligjshme dhe në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, sa i përket regjistrimit të shtetasit Ahmet Kuçanaj dhe mjetit të tij, në dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Morinë.

633. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Lahert Sulo është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Lahert Sulo në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në vlerën 60 euro nga shtetasi Ahmet Kuçanaj, kundrejt kryerjes së veprimeve të kërkuara nga ky i fundit për regjistrimin e daljes së tij dhe mjetit të tij në sistemin elektronik që pasqyron lëvizjet në dalje të shtetase nga territori i R. Shqipërisë, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

---

[35] *Shih analizën lidhur me subjektin e veprës penale ne paragrafët 606-622 të vendimit*

634. Në këtë konkluzion gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk referohet nga akuza dhe as rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën tej çdo dyshimi të arsyeshëm se rrethana rënduese e bashkëpunimit, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

635. Sa i përket fakteve të tjera që referohen nga organi i akuzës në rrethanat e faktit në raport me të pandehurin Lahert Sulo, gjykata pasi i analizoi dhe vlerësoi në raport me provat e administruara në gjykim dhe parashikimet e ligjit, vlerëson se ato nuk përmbajnë elementë të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal për të cilën akuzohet i pandehuri, për sa vijon:

636. Në lidhje me faktin që nga akuza referohet si "*fshehje e provave*" në lidhje me pajisjet përgjuese, në bashkëpunim me vartësit, gjykata vlerëson se kjo veprimtari, pra e gjithë veprimtaria e punonjësve të PKK Morinë, pas zbulimit dhe heqjes së pajisjeve të regjistrimit të instaluara në kabinat e kësaj pike të kalimit kufitar, rezulton se ka qenë objekt i një procedimi penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës me nr. 113, viti 2022 për veprën penale "*Ndërhyrje e padrejtë në jetën private*", parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal. Sipas akteve të administruara në gjykim, referuar me sipër në rrethanat e faktit në këtë vendim, përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Kukës me shkresën nr. 767/1 prot., datë 21.04.2022, rezulton se veprimet e punonjësve të policisë dhe personave të tjerë të cilët kanë ndërhyrë për heqjen apo dëmtimin e pajisjeve përgjuese, përbëjnë faktin objekt hetimi në kuadër të këtij procedimi penal. Nga aktet e këtij procedimi, rezulton se sa i përket të pandehurit Lahert Sulo, ai pasi është informuar nga vartësit e tij, ka informuar për këtë fakt (*gjetjen dhe heqjen e pajisjeve*) eprorin e tij, drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Kukës Fran Kaçorri, i cili më pas me shkresën e datës 06.03.2022 ka informuar për këtë ngjarje Drejtorin i Departamentit, dhe më pas është informuar edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Në këto fakte, në raport me akuzën e ngritur ndaj të pandehurit Lahert Sulo për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, nga Prokuroria e Posaçme nuk referohet ndonjë elementët që dëshmon veprime të kundërligjshme të konkretizuar në kërkimin, marrjen ose pranimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm nga ana e të pandehurit. Po ashtu në fakt i tillë nuk rezulton as nga tërësia e provave të administruara në gjykim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se në këtë fakt nuk rezulton prezenca e asnjë elementi që të krijojnë minimalisht dyshim të arsyeshëm për prezencën e elementeve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Veprimet apo mosveprimet e tij në raport me këto fakte janë objekt i procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës dhe do të duhet të vlerësohen pikërisht nga ky organ që ka zhvilluar hetime në drejtim të këtij fakti.

637. Në lidhje me faktin që konsiston në dërgimin nga shtetasi Fran Kaçorri, me detyrë drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Kukës, në aplikacionin whatsapp në telefonin celular të të pandehurit Lahert Sulo të targës së automjetit "*AB232CK*", mjeti i cili nga

Prokuroria referohet se i përket shtetasit Besmir Salillari, i cili sipas akuzës ka kaluar në PKK Morinë pa u regjistruar në sistemin TIMS, nëpërmjet veprimeve të ndihmës së dhënë nga i pandehuri Lahert Sulo. Nga tërësia e provave të administruara në lidhje më këtë fakt, nuk rezulton provueshmëria e vetë faktit dhe po ashtu nuk evidentohet asnjë element që hedh dritë mbi veprime që përmbajnë elementë të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal për të cilën akuzohet ky i pandehur. Në lidhje me këtë fakt, nga tërësia e provave të administruara që konsistojnë në *të dhënat e marra nga sistemi TIMS, të dhënat e marrja nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Lahert Sulo, pyetja në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime të shtetasve Lahert Sulo dhe Fran Kaçorri, pyetja në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale e shtetasit Pëllumb Salillari*, rezulton se shtetasi Besmir Salillari, për të cilin referohet se ka kaluar kufirin pa u regjistruar në sistemin TIMS, ka dalje nga Republika e Shqipërisë në një kohë shumë më të hershme se sa viti 2022 në të cilin konsiston fakti konkret dhe sipas dëshmisë së shtetasit Pëllumb Salillari, babai i tij, referohet se ky shtetas së bashku me bashkëshorten jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nuk kanë hyrë apo dalë në territorin e Republikës së Shqipërisë në vitin 2022 dhe konkretisht në kohën në të cilën lokalizohen ngjarjet e referuara në faktet objekt shqyrtimi, duke lënë në ketë mënyrë mundësinë e kalimit "pa u regjistruar në kufi" të shtetasit Besmir Salillari, sikurse përshkruhet në faktin e sjellë për gjykim nga Prokuroria, në nivelin e një hipoteze.

638. Në lidhje me faktin që konsiston në komunikimin e të pandehurit me shtetasin Fran Kaçorri në datë 24.02.2022, ku ky i fundit i ka dërguar emrin dhe targën e automjetit të shtetasit Florian Budina, në këtë fakt nuk referohet asnjë element që jep të dhëna mbi prezencën e formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, që konsistojnë në kërkimin, marrjen apo pranimin e një ofertë të kundërligjshme, në funksion të mos përmbushjes së rregullt të detyrës nga ana e të pandehurit. Nga të dhënat që ofrojnë provat e administruara në gjykim lidhur me këtë fakt, dhe konkretisht *deklarimet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime të shtetasve Fran Kaçorri dhe Lahert Sulo, deklarimet në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale të shtetasve Florian Budina, Xhulia Rrapaj dhe Pëllumb Salillari, si dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS*, nuk rezulton që shtetasi Florian Budina të ketë kaluar kufirin në drejtim të Kosovës në datën e referuar në të cilën zhvillohet komunikimi. Nga provat rezulton se mjeti i referuar në komunikim është përdorur nga shtetasja Xhulia Rrapaj, e cila deklaron se ka kaluar kufirin në drejtim të Kosovës duke kaluar më prioritet për shkak të gjendjes së saj jo të mirë shëndetësore, por nuk referohet dhe as rezulton në asnjë moment, sipas të dhënave që ofrojnë provat e administruara, që ajo të ketë kaluar kufirin më prioritet (*pa pritur në radhë*) kundrejt kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm nga ana e të pandehurit Lahert Sulo. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se në faktin e referuar, si pjesë e tërësisë së fakteve që Prokuroria e Posaçme referon në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në konkluzionet përfundimtare, nuk evidentohet prej saj por as rezulton nga provat e administruara, prezenca e ndonjë elementi që hedh dritë mbi prezencën e elementeve të veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në drejtim të të pandehurit Lahert Sulo.

639. Në lidhje me konstatimin e bisedave të kryera nga i pandehuri Lahert Sulo me shtetasin Naim Byberi në datë 01.02.2022 ku rezulton se i janë dërguar targat e katër automjeteve , të cilat më pas ai ja ka përcjellë vartësit të tij, të pandehurit Ani Hoxholli duke i thënë që janë porosi e Naim Byberit dhe nëse vijnë në turnin e tij, duhet ti ndihmojë të kalojnë, nga ana e Prokurorisë së Posaçme, pavarësisht se referohen si fakte, nuk evidentohet në asnjë moment prezenca e ndonjë elementi që konsiston në kërkimin, marrjen apo pranimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga i pandehuri Lahert Sulo, vetë apo në bashkëpunim me të pandehurin Ani Hoxholli, në shkëmbim të "ndihmës" së kërkuar për ti ndihmuar të kalojnë kufirin. Nga provat e administruara dhe konkretisht deklarimet e të pandehurit Lahert Sulo, të dhënat e marra nga këqyrja e telefonit të tij, të dhënat e marra nga sistemi TIMS, nuk rezultojnë të dhëna për kalimin e këtyre mjeteve dhe të personave që i kanë këto mjete në pronësi (*sipas sistemit TIMS janë verifikuar pronaret e tre nga katër mjetet e referuara dhe konkretisht rezultojnë se tre nga mjetet janë përkatësisht në pronësi të shtetasve Vladimir Pepkolaj, Sulejman Gjakrosa dhe Ardian Barxho*) në muajin shkurt të vitit 2022 në të cilin referon biseda si më sipër. Përveçse nuk është vërtetuar fakti se këto mjete dhe përdoruesit e regjistruar të tyre kanë kaluar kufirin në datën e referuar, edhe nëse një fakt i tillë do të pranohej për një moment se është vërtetuar të ketë ndodhur, në këtë fakt/ngjarje, nuk referohet nga akuza asnjë element që konfiguron një nga format e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në drejtim të të pandehurit Lahert Sulo në bashkëpunim e të pandehurin tjetër që referohet në këtë fakt, konkretisht të pandehurin Ani Hoxholli.

640. Në lidhje me faktin që lidhet me komunikimin e të pandehurit Lahert Sulo me të pandehurin Fran Kaçorri, ku ky i fundit i ka dërguar në datë 22.02.2022 të emrave të shtetasve Aida Topalli, Miranda Meta, Frenki Zotkaj dhe Marviks Shantoja, për të cilat prokuroria në faktet e çështjes referon se janë sportiste që do të kalojnë në PKK Morinë, në hyrje, në datë 22.02.2022, nga tërësia e provave të administruara rezulton e qartë se ky fakt është tërësisht i konfonduar dhe në kundërshtim me të dhënat që ofrojnë provat e administruara në gjykim. Nga tërësia e provave dhe konkretisht, *deklarimet e të pandehurit Fran Kaçorri, deklarimet në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale të shtetases Aida Topalli dhe shtetasit Arben Saliu, si dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS*, rezulton se katër emrat e referuar në këtë komunikim nuk janë sportistë të cilët do të kalojnë ose kanë kaluar kufirin në drejtim të R.Sh në datën 22.02.2022, por janë të katërt punonjës të një televizioni të cilët, në kuadër të realizimit të një emisioni investigativ, kanë udhëtuar në drejtim të Kosovës në datë 22.02.2022. Në lidhje me komunikimin që referon në kalimin e volejbollisteve të një ekipi kosovar, në drejtim të Shqipërisë, dy prej të cilëve siç referohet nën komunikime dhe deklarimet e administruara, janë të huaja dhe nuk kanë leje qëndrimi në Kosovë, pavarësisht realizimit të bisedës së referuar, nuk rezulton që të kenë kaluar nga pika e kalimit kufitar Morinë në datën përkatëse dhe as në ndonjë datë tjetër. Nga ana e Prokurorisë, në paraqitjen e faktit, biseda lidhur me sportistët është asociuar në mënyrë të gabuar në emrat e shtetasve Aida Topalli, Miranda Meta, Frenki Zotkaj dhe Marviks Shantoja, dhe po ashtu nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim për të verifikuar apo provuar prezencën e ndonjë veprimi ose mosveprimi të kundërligjshëm dhe për më tepër

përkundrejt kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të paligjshëm nga ana e të pandehurit Lahert Sulo, vetë apo në bashkëpunim me kolegët e tij.

641. Në lidhje me komunikimet e të pandehurit Lahert Sulo me shtetasit e identifikuar në komunikimet në whatsapp, si Nikolin Marashi (*biseda e datës 04.01.2022*) apo personi që referohet në bisedë si shoku i këtij të fundit (*shoku i Kolit sipas bisedave*) *(bisedat e datave 13.01.2022 dhe 13.02.2022*) të cilëve i pandehuri Lahert Sulo, sipas komunikimeve të zhvilluara ju kthen përgjigje sa i përket pasjes ose jo të shënimeve në sistem, nga provat e administruara gjatë gjykimit ka rezultuar kryerja e këtyre komunikimeve dhe dhënia e informacioneve të kërkuara, por nuk identifikohet dhe as referohet në asnjë moment prezenca e ndonjë nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, konkretizuar nëpërmjet kërkimit, marrjes ose pranimit të një përfitimit të parregullt prej tij në këmbim të dhënies së informacionit përkatës. Po ashtu nuk rezulton të jenë kryer verifikime në sistemin TIMS për të verifikuar se nga cili përdorues janë aksesuar, nëse janë aksesuar, të dhënat lidhur me këta shtetas. Në kushtet kur në këto fakte të referuara si pjesë e tërësisë së faktit penal nga ana e Prokurorisë, nuk është evidentuar prej kësaj të fundit asnjë element i kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të paligjshëm, si pjesë e domosdoshëm e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se këto veprime të të pandehurit mbeten të vlerësueshme në drejtim të respektimit të disiplinës dhe etikës në punë të tij por nuk përmbajnë dhe as referojnë ndonjë të dhënë për prezencën e elementëve të figurës së veprës penale për të cilën Prokuroria e Posaçme ka ngritur akuzë ndaj të pandehurit Lahert Sulo.

642. Në lidhje me komunikimin e datës 02.01.2022 me kontaktin e regjistruar në telefonin e tij si "Tani Durrës", që lidhet me kalimin në kufi të shtetases Zajmina Vasjari, për të cilën referohet në bisedë se nuk ka prokurë nga prindi tjetër për fëmijët e saj të mitur, komunikim të cilin i pandehuri Lahert Sulo ja ka përcjellë të pandehurit Emilton Asllanaj duke i kërkuar ta ndihmojë për të kaluar në kufi, referuar të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, *posaçërisht të dhënat e marra nga sistemi TIMS*, rezulton se kjo shtetase në datën e referuar në të cilën zhvillohet komunikimi si më sipër nuk ka të regjistruar as hyrje dhe as dalje në pikën e kalimit kufitar Morinë. Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se ajo ka dalje në datë 02.01.2022 dhe hyrje në datë 04.01.2022 por këto lëvizje të saj janë regjistruar dhe kryer nga Pika e Kalimit Kufitar Murriqan dhe jo nga Pika e Kalimit Kufitar Morinë ku ushtron detyrën i pandehuri Lahert Sulo dhe i pandehuri Emilton Asllanaj. Për pasojë, pavarësisht komunikimit të gjetur në telefonin e të pandehurit Lahert Sulo me shtetasin e regjistruar në kontakte si "Tani Durrës" dhe më pas me vartësin e tij, të pandehurin Emilton Asllanaj, rezulton se shtetasja Zajmina Vasjari në datat në të cilat referon komunikimi ka të regjistruar dalje dhe hyrje nga territori i Republikës së Shqipërisë nga një pikë tjetër e kalimit kufitar, të ndryshme nga PKK Morinë ku ushtron detyrën i pandehuri Lahert Sulo dhe vartësi i tij i pandehuri Emilton Asllanaj. Po ashtu gjykata evidenton se, përves sa me sipër, në prova e administruara lidhur me këtë ngjarje, nuk referohet nga Prokuroria në asnjë moment prezenca e veprimeve aktive të kundërligjshme, të kryera me dashje, vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë, për të

pandehurin Lahert Sulo, në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm, si forma të kryerjes së veprës penale për të cilën ai akuzohet.

643. Në lidhje me komunikimin e gjetur në telefonin e të pandehurit Lahert Sulo me të pandehurin tjetër Halim Shehu, sa i përket situatës ku referohet se një shtetas i huaj ka bërë një denoncim pasi punonjësit e PKK Morinë i kanë kërkuar 5 euro, referuar bisedës së zhvilluar mes tij dhe Halim Shehut dhe mes tij dhe Fran Kaçorrit, referohet se Laherti ka kryer veprime për verifikimin e këtij fakti por sipas tij, asnjëri prej punonjësve nuk e pranon si fakt dhe biseda mes tyre mbyllet pasi Frani i kërkon që punonjësit të bëjnë raport shërbimi. Prokuroria e Posaçme, lidhur me këtë fakt, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, referon se "*Të dy punonjësit e policisë si Fran Kaçorri si Laert Sulo kanë detyrimin ligjor që denoncimin e shtetasit për mitë marrje ta vënë në dispozicion të organeve kompetente Prokurorisë ose Shërbimit Për Çështjet e brendshme dhe Ankesat për fillimin e hetimit penal*[36]". Në lidhje me këtë komunikim në deklarimet e të pandehurit Fran Kaçorri referohen me detaje veprimet e kryera nga ai dhe i pandehuri Lahert Sulo për verifikimin e faktit në lidhje me kërkimin e një shumë prej 5 euro shtetasit kosovar dhe denoncimin e kryer prej këtij shtetasi. Gjykatës nuk i rezulton, asht sikurse edhe nga prokuroria nuk evidentohet asnjë element që konsiston në kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm nga i pandehuri Lahert Sulo, vetë apo në bashkëpunim me persona të tjerë, në lidhje me shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj situate. Nëse ai dhe koleget e tij kanë ndjekur rrugën e duhur për trajtimin e rastit (*pra hetimin dhe referimin e rastit në rrugën administrative apo paraqitjen e kallëzimit penal për të*) është një çështje që i përket vlerësimit të punonjësve të policisë në rang hierarkik për të vlerësuar nëse janë kushtet ligjore dhe faktike për ekzistencën e një fakti që përbën një fakt të kallëzueshëm penalisht. Për sa kohë që nuk është evidentuar asnjë element që lidhet me konkretizimin e formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet i pandehuri, gjykata vlerëson se faktet që lidhen me këtë ngjarje, nuk përmbajnë elementë të veprës penale.

644. Në lidhje me komunikimin e tij të datës 26.12.2021 me të pandehurin Artan Rredhaj i cili ushtronte detyrën e përgjegjësit të turnit në PKK Morinë, ku rezulton se Laherti i ka dërguar targën e një automjeti dhe i ka kërkuar që të ndihmojë personin që udhëton me ketë mjet për të kaluar nga pala Kosovare, nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se targa e dërguar me sms nuk rezulton e regjistruar ne dalje të R.Sh në datë 26.12.2021. Në deklarimet e tij në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime Artan Rredhaj lidhur me këtë bisedë pranon se ka zbatuar një porosi të shefit të tij Lahert Sulo për të ndihmuar shtetasin që udhëtonte me automjetin, targa e se cilit i është dërguar me sms, pa pritur radhën e PKK Morinë por nuk rezulton që ky i fundit, të ketë kryer asnjë veprim apo mosveprim që lidhet me regjistrimin ose jo të daljes së shtetasit apo mjetit përkatës në sistemin TIMS, pasi në dalje shtetasit regjistrohen nga pala kosovare. Referohet dhe rezulton se ky komunikim dhe faktet e referuara në të kanë ndodhur dhe pranohen edhe nga i pandehuri tjetër Artan Rredhaj në deklarimet e tij, por nuk rezulton dhe as evidentohet nga Prokuroria, ndonjë element që të hedhë dritë mbi prezencën e

---

[36] *Konkluzionet përfundimtare, faqe 136*

elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet i pandehuri.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ARBEN KASTRATI

645. Lidhur me të pandehurin **Arben Kastrati**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Arben Kastrati ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "trup shërbimi fizik" në ngjarjet e datave 15.02.2022 dhe 23.02.2022. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Arben Kastrati, në bashkëpunim me persona të tjerë, kolegë të tij, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, në ngjarjet e datave 15 shkurt dhe 23 shkurt 2022. Arrihet ky konkluzion pasi:

646. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 15/02/2022 kontrollori Arben Kastrati, është dokumentuar dhe pasqyruar edhe në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike, marrja prej tij e një kartëmonedhe të vlerës 5/euro gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve kosovarë ndër të cilët, referuar të dhënave të verifikuara në sistemin TIMS në raport me orarin e veprimeve fiksuar nga pamjet filmike, kanë qene shtetasit Granit Tërnava, Labinot Tërnavaj dhe persona të tjera bashkudhëtarë me ta, veprim që pavarësisht se nuk evidentohet qartë në komunikimin mes tyre, rezulton të jetë kryer për shkak të tolerimit të tij duke mos ju kërkuar shtetasve kosovare testet lidhur me vaksinimin kundër Covid-it, sikurse veprohet prej tij në rastet e tjera, brenda së njëjtës ditë;

647. *Së dyti* është dokumentuar me pamje filmike dhe regjistrim audio, komunikimi dhe momenti gjatë të cilit ai ka marrë një kartëmonedhë euro, prerja e së cilës nuk dallohet qartë nga pamjet, gjatë përpunimit të dokumenteve të një tjetër shtetasi kosovar, i cili nuk është identifikuar por nga pamjet filmike dhe procesverbali i këqyrjes dokumentohet fakti se kartëmonedha i është dhënë nëpërmjet futjes së saj në dokumente, veçimit dhe fshehjes së saj nga kontrollori në tavolinën e punës dhe marrjen e saj pas largimit të shtetasve, dokumentet e të cilave janë përpunuar në këtë moment;

648. *Së treti,* në harkun kohor 16.03 minuta të kësaj date, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve shqiptarë, nga bashkëbisedimi rezulton se ata kanë problematikë lidhur me shkeljen e kohës së qëndrimit, duke kaluar *"100 ditshin"*, sikurse referon biseda. Shtetasi, dokumentacioni i të cilit përpunohet në këtë moment, sipas të dhënave të sistemit TIMS, është shtetasi shqiptar Olsi Syziu i cili udhëton së bashku me shtetasin e huaj Adams Gjon Bulakh. Në bisedën dhe

ngjarjet e zhvilluara është prezent, krahas kontrollorit Arben Kastrati, edhe e pandehura, kontrollorja Vojsava Selmani dhe nga biseda e zhvilluar mes këtyre të fundit por edhe ajo e zhvilluar mes tyre dhe shtetasit Olsi Syziu, rezulton e qartë se për shkak të problematikës së konstatuar për tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE, mbi 100 ditë, kundrejt mos bërjes së shënimit në pasaportë, punonjësit e policisë Arben Kastrati dhe Vojsava Selmani, kanë kërkuar dhe marrë nga ky shtetas një shumë eurosh, vlera e të cilës nuk pasqyrohet qartë nga pamjet filmike por rezulton *ngjyra e kartëmonedhës* (*përshkruar në procesverbal si e kuqërremtë*) dhe veprimi i dhënies së kësaj shume punonjësit në shërbim Arben Kastrati. Ky veprim që konsiston në kërkimin dhe marrjen e ryshfetit në kombin të mos përmbushjes së rregullt të detyrës dhe tolerimit të shtetasve për të kaluar kufirin pa ju bërë shënime mbi tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE-së, rezulton se është realizuar me veprime të përbashkëta dhe komplementare të të dy punonjësve të policisë në bashkëpunim me njëri tjetrin. Ky fakt rezulton i qartë nga biseda e transkriptuar në procesverbalin përkatës, ku ndër të tjera, Arben Kastrati i drejtohet udhëtarit në sportel me fjalët "*Po ca me i ba këtij djalit me i ba i shënim këtu?*", "*Do ti bej një kontroll mjetit*" dhe me tej vijon duke i thënë se "*I ka kalu afati qysh në 2019.*". Pas këtij momenti ndërhyn e pandehura Vojsava Selmani duke iu drejtuar me fjalët "*Jo pra për pesë vite ndalim dalje nga Shqipëria*". Në vijim, pasi është fiksuar nga pamjet filmike dhënia e kartëmonedhës nga shtetasit të cilët janë duke u përpunuar nga kontrollori Arben Kastrati, ky i fundit i drejtohet me fjalët "*Jo jo se asht shumë mik, jo jo, për zotin jo. Pash kryt janë shumë bre.*" dhe me pas Vojsava i drejtohet me fjalët "*Faleminderit, hajd rrugë të mbarë*", duke vijuar në drejtim të kolegut me fjalët "*E bre po ka pas makinë 80 mije euro bre.*". *(iv)* në orën 15.13 min të po kësaj date nga pamjet filmike është fiksuar sërish kontrollori Arben Kastrati i cili gjatë përpunimit të shtetasve kosovarë Zoje Alimetaj, Granit Maliqi, Dion Koçiu dhe Elvis Maliqi, ka konstatuar mungesë të dokumenteve lidhur me vaksinimin e tyre si dhe mungesë të letërnjoftimit për shtetasin Dion Kaçiu, si dhe mungesë të autorizimit për përdorimin e automjetit, dhe ndër të tjerat i drejtohet me fjalët "*A i botë gati vaksinat mor? I bot mor gati?*". Pas këtyre fjalëve merr në dorë një letër të mbyllur brenda të cilës sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, rezulton se ka pranuar dhe marrë një shumë parash të cilat për shkak të pamjes së kufizuar nuk janë identifikuar në prerjen e tyre të saktë.

649. *Së katërti,* në datë 23.02.2022, ora 18.25, nga pamjet filmike të kamerës të vendosur në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Arbën Kastrati, janë regjistruar ne audio dhe video komunikime mes tij dhe kolegut të tij Bedri Duraku ku bisedojnë për shumën 10 euro që i kanë marrë një shtetasi për shkak të lejimit të kalimit në kufi të një skafi. Nga biseda e zhvilluar mes këtyre dy punonjësve të PKK, ndër të tjera Bedri Duraku i thotë "*Qe kaloj skafet..10 euro bre..*", ndërsa Arben Kastrati i përgjigjet "*Ja morra dhe unë 10 euro*", "*Kosht kenë një makinë e atij oficerit e kishte pasë karton të kuq*", ndërsa Bedri Duraku vijon me fjalët "*Dhjete euroshi, atje te cepi.*". Nga të dhënat e sistemit TIMS dhe komunikimi mes tyre nuk mund të identifikohet shtetasi të cilit i kanë marrë secili nga 10 euro dhe as koha në të cilën është lokalizuar dhe zhvilluar kjo ngjarje, për të gjykuar më tej mbi ndodhjen, vërtetësinë dhe provueshmërinë e plotë të saj. Për pasojë, kjo bisedë e zhvilluar mes të pandehurve Arben Kastrati dhe Berdi

Duraku, duke qenë se nuk mund të konfirmohet me të dhëna të marra nga provat e tjera dhe për pasojë, rezulton e pamundur të lokalizohet minimalisht në një moment kohor, për të përcaktuar qartë nëse dhe si ka ndodhur, nuk mund të konkludohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka ndodhur dhe gjatë kësaj ngjarje (*të papërcaktuar në kohë dhe hapësirë*), punonjësit e policisë që zhvillojnë këtë bisedë kanë kërkuar, marrë apo pranuar para apo përfitim të kundërligjshëm nga një shtetas.

650. *Së pesti*, rezulton nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio i datës 23.02.2022, ora 18.56, se në vendin e shërbimit të kontrollorit Gëzim Duraku, referohet se ndodhet edhe i pandehuri Arbën Kastrati. Gjatë kësaj kohë, në përpunimin e dokumenteve të shtetasit, të identifikuar sipas të dhënave të sistemit TIMS si shtetasi Leonit Hoxha dhe bashkudhëtareve të tij të cilët nuk rezulton te jene regjistruar në sistem, është konstatuar se disa nga dokumentet që ata kanë paraqitur kanë afat vlefshmërie të përfunduar. Për këtë arsye shtetasi i jep kontrollorit Gëzim Duraku, një shumë parash të cilën ai e fut në xhep, prerja e së cilës nuk duket e qartë në pamjet filmike, shumë të cilën pas largimit të udhëtarëve, ai e nxjerr se bashku me shuma të tjera nga xhepi, i numëron dhe me pas i fut përsëri në xhep. Pavarësisht se ne ketë episod, sipas pamjeve filmike referohet prezenca e të pandehurit Arben Kastrati, nuk rezultojnë veprime të këtij të fundit në drejtim të pjesëmarrjes në kryerjen e veprimeve qe përmbajnë elemente të veprës penale për kolegun e tij ne shërbim, të pandehurin Gëzim Duraku.

651. *Së gjashti,* në po këtë datë, në orën 18.38 është fiksuar nga pamjet filmike se i pandehuri Arben Kastrati ka përpunuar dy karta identiteti ndërkohë që udhëtari i përgjigjet "*Jo mo vëlla jam tek pullë*", dhe po ashtu nga procesverbali i këqyrjes se pamjeve filmike dhe transkriptimit të bisedave, rezultojnë biseda mbi tejkalimin e afatit të qëndrimit 90 ditë në vendet e BE. Pasi përfundon veprimet e përpunimit të dy dokumenteve, rezulton se ai zgjat dorën në sportel dhe merr nga udhëtari i identifikuar dhe regjistruar në sistem si shtetasi Bekim Hajdini, një shumë prej 50 euro të cilën e fut në xhep. Nga biseda e zhvilluar dhe pamjet filmike, rezulton se ai ka përpunuar dy dokumente ndërkohe që shtetasi në sportel i përgjigjet se është i vetëm, pra njëri nga dokumentet e përpunuara i përket një shtetasi i cili nuk është paraqitur fizikisht në pikën e kalimit kufitar.

652. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datë 15.02.2022 dhe 23.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Arben Kastrati, ka pranuar dhe marrë para në formë ryshfeti nga shtetasit e huaj dhe shqiptarë të përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pa dokumente, me dokumente të cilave ju ka përfunduar afati i vlefshmërisë, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit apo dokumenteve të përdorimit të automjeteve, kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit për shtetasit që rezulton se kanë kaluar afatin 90/ditor të qëndrimit në vendet e BE, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me

detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

653. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit, në mënyrë të tërthortë, marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe në disa raste pamundësisë së regjistrimit të tyre në sistemin TIMS, për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme të udhëtimit. Marrja dhe pranimi i shumave të parave (euro) të dhëna nga shtetasit përkundrejt tolerimit të bërë nga i pandehuri Arben Kastrati, në një rast rezulton se është kryer në bashkëpunim me të pandehurën Vojsava Selmani (*ngjarja e datës 15.2.2022 ora 16.03*). Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Arben Kastrati, në bashkëpunim, në një episod në bashkëpunim me të pandehurën Vojsava Selmani, evidentohet qartë në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili qartësisht përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Arben Kastrati.

654. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Arben Kastrati, në një episod së bashku të pandehurën Vojsava Selmani, evidentuar si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penalë, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre. Po ashtu në një prej episodeve, rezulton se i pandehuri Arben Kastrati ka vepruar në bashkëpunim me kolegen e tij, duke ndikuar secili prej tyre, nëpërmjet mënyrës së komunikimit dhe veprimit të përbashkët, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

655. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Arben Kastrati, ka vepruar

me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

656. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Kastrati përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Arben Kastrati ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

657. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Kastrati është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Kastrati në cilësinë e tij si pjesë ë strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

658. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Arben Kastrati**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurën Vojsava Selmani (*ngjarja e datës 15.2.2022 ora 16.03*) dhe i vetëm në episodet e tjera të provuara, si me sipër.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ARJAN SOKOLI

659. Lidhur me të pandehurin **Arjan Sokoli**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Arjan Sokoli ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datave 10.02.2022, 20.02.2022 dhe 22.02.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Arjan Sokoli, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, në ngjarjet e datave 10.02.2022, 20.02.2022 dhe 22.02.2022. Arrihet ky konkluzion pasi:

660. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar nga kamera nr.7, në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 10.02.2022 kontrollori Arjan Sokoli, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio se kontrollori është duke përpunuar në orën 10.37 min, dokumentet e tre shtetasve kosovarë. Më këta shtetas gjatë përpunimit ai i pyet për dokumentacionin e vaksinimit, pronësinë e mjetit më të cilin udhëtonin dhe gjatë bisedës i drejtohet me fjalët "*Naimi një tash duhet me hap krahun, Naimi duhet me pa procedurat atje..*", "*..të bëj procedurat, ti shkruaj informacionin Tiranë ose skam ca të bëj.*" Dhe në vijim të komunikimit lidhur me problematiken që ai i bën prezent shtetasve, i drejtohet me fjalët "*Nëqoftëse kini po nuk kini ma kini borxh një birrë...*". Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS në raport me harkun kohor kur zhvillohet ngjarja sipas pamjeve filmike janë përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë Mukades Kurteshi, Rrahim Berisha dhe Fatmir Berisha. Në këtë rast nga provat e administruara nuk është evidentuar në ndonjë moment marrja pse pranimi i ndonjë përfitimi nga këta shtetas, por nga mënyra se si ka komunikuar me ta punonjësi i policisë Arjan Sokoli, rezulton e qartë dhe e provuar forma e kërkimit të përfitimit të paligjshëm prej tij, përkundrejt tolerimit të udhëtarëve lidhur e problematikat përkatëse të konstatuara, sipas bisedës.

661. *Së dyti* është fiksuar nga pamjet filmike momenti në të cilin, në datë 10.02.2022, ora 10.58 kontrollori Arjan Sokoli ndërsa është duke përpunuar dokumente të një shtetasi dhe zhvillon me

të bisedë për kalimin e mallrave për llogari të një shtetasi i cili në bisedë thirret si "Flor Camaj". Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS në këtë hark kohor rezulton se janë përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë Liridon Bajrami dhe Milot Pozhegu, ndër të cilët shtetasi Liridon Bajrami, sipas sistemit TIMs rezulton se udhëton me mjetin fugon me targa 01583NJ dhe ka të regjistruara hyrje dhe dalje të shpeshta në kufi me këtë mjet transporti mallrash. Nga pamjet filmike dhe biseda e zhvilluar mes tij dhe kontrollorit Arjan Sokoli nuk është konstatuar dhënia e ndonjë shumë parash por rezulton qartë kërkimi i tyre nga kontrollori, në funksion të tolerimit të kalimit të mallrave për llogari të shtetasit të identifikuar në bisedat e tyre si "Flori ose Flor Camaj". Kërkimi i parave në këmbim të këtyre favoreve, rezulton qartë, kur gjatë bisedës dhe në kontekstin e saj i pandehuri Arjan Sokoli drejtohet, ndër të tjera, me fjalët *:"..mos më bëj telefon se e kam gjith natën në përgjim, ça malli të kesh hajde dhe më thuaj, mos më merr në telefon...", "Unë sot jam hajde kaloj kur të duash, nesër nuk kam shanse", "Mos me mer në telefon mos ja ... nënën", "unë të ndihmoj sa jam këtu, nuk hyj në pazar", ndërkohë që shtetasi i thotë "sa lek"* dhe Arjan Sokoli i përgjigjet: *"10 lek, 1000 unë sa kam mundësi", "O zotëri sa herë të vish hape krahun e bisedojmë, telefonat i kemi në përgjim gjithë natën. Në qoftë se të ka çu me çu mallin hajde sa jam unë këtu jo në telefon, unë të shërbej sa kam mundësi, sot jam unë der në 8 të të darkës".* Pra në këtë rast rezulton të jetë vërtetuar një nga format e anës objektive të veprës penale dhe konkretisht kërkimi i favoreve (parave) në këmbim të favorizimit të shtetasit për kalimin e mallrave në kufi, pavarësisht nëse ky aktivitet është kryer ose jo në vijim.

662. *Së treti,* në datë 20.02.2022, në kabinën nr.4, ku kryen shërbimin kontrollori Arjan Sokoli, nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, është dokumentuar qartë marrja prej tij e një shumë prej 5 euro, në këmbim të favorizimit për të kaluar në kufi pa pasur dokumentet për dy dozat e vaksinave, të shtetaseve të cilët, sipas verifikimit të kryer në sistemin TIMS, janë shtetasit kosovarë Mustaf Cekini dhe Enis Cekini. Marrja e kartëmonedhës 5/euro sipas pamjeve filmike vjen pas zhvillimit të bisedës mes tyre ku kontrollori i kërkon paraqitjen e dokumenteve për dozën e dytë të vaksinimit ndërkohë që shuma 5 euro nxirret prej tij nga pasaporta e shtetasit, të cilën pasi merr kartëmonedhën ia kthen serish dhe i lejon vijimin e udhëtimit. Në vijim kontrollori Arjan Sokoli, gjatë përpunimit të dokumenteve të pesë shtetasve kosovarë, të cilët sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS rezulton të jenë shtetasit Abdurrahman Murtezaj, Abdyl Rexhaj , Remiz Shala, Ylber Myrtezaj, të cilëve në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit, është regjistruar momenti kur merr prej tyre, vendosur midis dokumenteve të mjetit, shumë prej 10 euro, duke i lejuar vijimin e urdhërimit. Pas këtij momenti, në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike referohet se vjen kolegu i tij i identifikuar si Muhahet Cengu por nuk evidentohet ndonjë komunikim apo veprim i tij në realizimin e faktit si më sipër, dhe as prezenca e tij në momentin kur shtetasit e përpunuar nga Arjan Sokoli i kanë dhënë atij shumat 5 dhe 10 euro.

663. *Së treti,* në datë 22.02.2022, ora 09.53, në kabinën nr.4 ku është duke kryer shërbimin kontrollor Arjan Sokoli, sipas pamjeve filmike, të dhënave të sistemit TIMS mbi veprimet e kryera në këtë moment kohor dhe bisedës së transkriptuar zhvilluar mes tij dhe qytetarit të identifikuar në biseda me emrin Zenel, rezulton se ai ka kërkuar para prerje tij duke iu drejtuar,

ndër të tjera me fjalët "*Pse s'ke futur në pasaportë naj gjë ,e nalë...kur të ja fusësh naj gjë në mes..futja naj gjë ndërmjet e mos me e pa sistemi hiç..*", dhe më pas merr prej tij shumën 10 euro të cilën e nxjerr nga pasaporta duke iu drejtuar, ndër të tjera me fjalët "*..dajë, hajd rrugë të mbarë..evallah edhe prej jush..*". Nga biseda rezulton se kërkimi dhe dhënia e shumës së parave (10 euro) behët kundrejt mos regjistrimit në sistem të shtetasit, fakt i cili konfirmohet dhe nga të dhënat e sistemit TIMS i cili në këtë hark kohor nuk ka të regjistruar dokumentet e ndonjë shtetasi të përpunuar në kufi ndërkohë që rezulton e qartë se kontrollori Arjan Sokoli merr dhe verifikon, por pa i regjistruar në sistem dokumentet e shtetasit në sportel. Po në datë 22.02.2022, ora 19.24, kontrollori Arjan Sokoli është fiksuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio duke komunikuar me shtetasin Shkodran Sahit dhe Gabriel Derri, të dhënat e të cilëve rezultojnë nga sistemi TIMS në hyrje, në këtë hark kohor. Këtyre shtetasve ai i kërkon dokumentet lidhur me mjetin dhe ndër të tjera, i drejtohet me fjalët "*A ke licensë për transport mjetesh dhe autorizim.*", "*nuk lejohet me kalu doganën pa licensë dhe autorizim*", ndërkohë që pasi i japin një kartëmonedhë prerje 20 euro, i drejtohet me fjalët "*Ku ishte autorizimi a?*" dhe i lejon të kalojnë. Shumë e marrë nga shtetasit, pas largimit të tyre rezulton nga pamjet filmike se e merr nga poshtë monitorit ku e kishte vendosur më parë dhe e fut në xhepin e tij.

664. Lidhur me ngjarjet e fiksuara nga pamjet video dhe regjistrimi audio në datë 10.02.2022, ora 16.31, 16.54, 18.19 dhe 17.03 minuta. kur në përpunim të dokumenteve në shërbim është kontrollorja Mimoza Shahinaj dhe ato të datës 22.02.2022 ora 10.46 kur në shërbim është punonjësi i policisë Urim Lami, pavarësisht se nga procesverbalet e këqyrjes se pamjeve filmike dhe/ose regjistrimi audio referohet prezenca e të pandehurit Arjan Sokoli, nuk rezultojnë veprime aktive të tij për të marrë pjesë në veprimet korruptive të kryera nga kolegët e tij. Në disa raste identifikohet vetëm prezenca e tij, në një rast kërkimi i tij për të ardhur në kabinë nga kolegia Mimoza Shahinaj dhe në një rast një bisedë e zhvilluar mes këtyre të dyve mbi një shumë parash që Mimoza do të marrë në datën 29, siç referon biseda, nga një shtetas që sipas bisedës ka kaluar kohën e qëndrimit, por nuk ka rezultuar dhe as është verifikuar ndonjë veprim i të pandehurit Arjan Sokoli për pjesëmarrjen në këtë veprimtari që në raport me kohën kur zhvillohet biseda (datë 10.02.2022) rezulton se i përket së ardhmes, pra datës 29 siç referohet në bisedë.

665. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datë 10.02.2022, 20.02.2022 dhe 22.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Arjan Sokoli, ka kërkuar dhe/ose ka marrë para në formë ryshfeti nga shtetasit kosovarë të përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit për shtetasit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me

detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

666. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Arjan Sokoli është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Arjan Sokoli në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

667. Në këtë konkluzion gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

668. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Arjan Sokoli, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

669. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Arjan Sokoli, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të

veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

670. Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri Arjan Sokoli përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Arjan Sokoli ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

671. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Arjan Sokoli është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Arjan Sokoli, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

672. Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Arjan Sokoli**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, por nuk rezulton se provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai e ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet në bashkëpunim.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit DASHNOR BRAHA

673. Lidhur me të pandehurin **Dashnor Braha**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Dashnor Braha ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 08.02.2022, në bashkëpunim me të pandehurit Muhamet Cengu, 09.02.2022, 10.02.2022, 16.02.2022, 17.02.2022, 22.02.2022, 24.02.2022 dhe 25.02.2022.* Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Bashnor Baha, vetëm dhe në një nga episodeve në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Muhamet Cengu, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

674. Së pari, nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 2 ku ka kryer shërbimin në datë 08.02.2022 i pandehuri Dashnor Braha, ndërkohë që është prezent edhe i pandehuri tjetër Muhamet Cengu, në orën 17.45 është fiksuar dhe regjistruar biseda e kryer mes Muhametit dhe një shtetasi që qëndron në përpunim në kabinën ku kryen shërbimin Dashnor Braha, ku Muhameti i drejtohet me fjalët "*Hajde futi brenda në çantë*", ndërsa shtetasi i drejtohet me fjalët "*100 mijë lekë, pjesën tjetër euro do ti jap më pas*" dhe ndërkohë Muhameti i përgjigjet "*Jo jo 100 mije lekë*". Punonjësi i policisë i drejtohet me fjalët "*100 mijë leke", "edhe dhetë mije të tjera ma tepër*" ndërsa shtetasi i përgjigjet "*Skam mo*", ndërkohe që shihet se kontrollon xhepat e tij për para të tjera. Nga pamjet filmike është fiksuar momenti kur shtetasi i jep shumën e parave punonjësit e policisë që qëndron tek dera e kabinës identifikuar si Muhamet Cengu. Në vijim pamjet filmike kanë fiksuar se, pas dhënies së shumës së parave, shtetasi i jep dokumentet e tij kontrollorit në shërbim Dashnor Braha dhe ky i fundit ja mban atë mbi tavolinë duke mos vijuar përpunimin e dokumentacionit. Shtetasi dokumentet e të cilit janë mbajtur dhe përpunuar nga kontrollori në shërbim Dashnor Braha në këtë hark kohor, ndërkohë që prezent në kabinë dhe fiksuar duke i kërkuar dhe marrë shumën e referuar në biseda prej 100 mije lekësh është edhe i pandehuri Muhamet Cengu, sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezulton të ketë qenë shtetasi kosovar Ahmet Ferati i cili ka udhëtuar me mjetin fugon me targa "AB480 ET", dhe nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ka kalime të shpeshta në kufi si dhe një shënim të anuluar,

si i proceduar për veprën penale "Trafikimi i armeve dhe municioneve". Në këtë rast të dy punonjësit e policisë, Dashnor Braha dhe Muhamet Cengu, me veprime aktive të kundërligjshme kanë ushtruar presion dhe më pas kanë marrë një shumë parash të referuar në biseda si 100 mije leke, dhe të fiksuar dhënia e parave sipas pamjeve filmike, nga shtetasi kosovar Ahmet Ferati, në bashkëpunim me njëri tjetrin. Në po këtë datë, 08.02.2022, para se të zhvilloheshin ngjarjes si më sipër, nga pamjet filmike dhe procesverbali i këqyrjes së tyre, është fiksuar se punonjësi i policisë Muhamet Cengu, teksa i lë shërbimin kolegut të tij Dashnor Braha, nxjerr nga xhepi dhe numëron një shumë parash, prej të cilave disa monedha i hedh në një çantë që qëndron në tavolinën e punës, por nuk rezultojnë të dhëna për marrjen e këtyre shumave nga ndonjë shtetas apo veprime si pasojë e të cilave këto para janë siguruar prej tij apo të pandehurit tjetër Dashnor Braha që merr shërbimin dhe nderohet me kolegun. Po në këtë datë, është dokumentuar me pamje filmike dhe regjistrim audio, komunikimi dhe momenti gjatë të cilit ai ka marrë një kartëmonedhë euro, prerja e së cilës nuk dallohet qartë nga pamjet, gjatë përpunimit të dokumenteve të një tjetër shtetasi kosovar, i cili nuk është identifikuar por nga pamjet filmike dhe procesverbali i këqyrjes dokumentohet fakti se kartëmonedha i është dhënë nëpërmjet futjes së saj në dokumente, veçimit dhe fshehjes së saj nga kontrollori në tavolinën e punës dhe marrjen e saj pas largimit të shtetasve, dokumentet e të cilave janë përpunuar në këtë moment;

675. *Së dyti,* në datë 09.02.2022, në orën 21.35 minuta, në kabinën nr.4 ku është duke kryer shërbimin kontrollori Dashnor Braha, nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, rezulton se ai, gjatë përpunimit të dokumentacionit për tre karta identiteti, merr dhe një fletë formati a4 nga e cila nxjerr një kartëmonedhë 10 euro, të cilën e vendos para pajisjes skaner. Pasi kryen këto veprime nuk rezulton të kryeje verifikimin dhe regjistrimin e tre dokumenteve të identifikimit në sistem por bisedon me shtetasin në sportel duke iu drejtuar me fjalët "*Avash, avash mos ik atje. E kam seriozisht, me u nal kush rrugës jo..ban ndonjë gabim rrugës edhe ke lloj lloj budallenjsh...**Sami eee.....**Ke marrë kopje ti vari l...", "nuk pyet kërkush për këto, fare...vaksinat".* Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS në orarin që zhvillohet ngjarjes e filmuara si më sipër, nuk rezulton që të jetë kryer regjistrim i dokumenteve të udhëtarëve në sistem, sikurse rezulton edhe nga pamjet filmike që punonjësi i policisë Dashnor Braha merr tre karta identiteti por pasi merr shumën 10 euro brenda fletës së formatit, nuk kryen asnjë veprim për skanimin dhe regjistrimin e dokumenteve në sistemin TIMS.

676. *Së treti,* në datë 10.02.2022, sipas pamjeve filmike, regjistrimit audio dhe të dhënave të verifikuara në sistemin TIMS, ka rezultuar se në kabinën ku është duke kryer shërbimin kontrollori Dashnor Braha, në orën 09.16 minuta, paraqitet në sportel një shtetas i cili brenda njërit prej dokumenteve që i jep, ka vendosur një kartëmonedhë 5 euro të cilën ja jep kontrollorit bashkë me dokumentet. Sipas të dhënave të sistemit TIMS rezulton se shtetasi që i ka dhënë këto para është shtetasi kosovar Selami Dvorani, por nuk rezulton qëllimi i dhënies së tyre pasi nuk është zhvilluar ndonjë komunikim gjatë këtij procesi. Po në këtë datë, në orën 08.31 minuta, ndërkohë që në kabinën e shërbimit të kontrollorit Dashnor Braha gjendet edhe kolegu i tij Kapllan Dogjani, identifikuar sipas numrit identifikues që mban uniformë, Dashnor Braha përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Kadri Krasniqi për të cilin, sipas bisedës së zhvilluar

me Dashnor Brahën rezulton se ka mungesë të dokumentacionit për dozën e dytë të vaksinës. Pamjet filmike kanë fiksuar momentin kur gjatë kësaj bisede, pasi hap dokumentet qe i ka dhënë shtetasi në sportel, Dashnor Braha merr prej tyre një kartëmonedhe 10 euro. Në rastin konkret, pavarësisht se identifikohet prezenca e kolegut të tij, të pandehurit Kapllan Dogjani në pamjet filmike, nuk evidentohet ndonjë veprim i këtij te fundit për kryerjen e veprimit të kërkimit dhe marrjes nga shtetasi kosovar Kadri Krasniqi të shumës 10 euro, por rezulton se ky veprim është kryer nga i pandehuri tjetër Dashnor Braha. Po në datë 10.02.2022, ora 06.29, nga pamjet filmike të kamerës të vendosur në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Dashnor Braha, rezulton se gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasit Arian Sopi, ky i fundit i jep bashkë me dokumentet e tij një kartëmonedhe prej 5/euro, të cilin kontrollori pasi e shikon e merr dhe e fut ne xhepin e tij. Gjatë kohës që zhvillohen këto veprime ai i drejtohet shtetasit, ndër të tjera me fjalët :"*Nuk e e merr ti pa me vjedh një kamer.*","*Ik mos e vraj mendjen, tu rit nera rrugë të mbarë...*". Në vijim, në orën 06.33, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve, të cilët sipas verifikimeve ne sistemin TIMS rezultojnë të jenë shtetasit kosovarë Faton Dragusha dhe Elis Zega, kontrollori Dashnor Braha, zhvillon me njërin prej tyre këtë bisedë : ***BrahaD**: Ç'e këtë kartë Astrit Gashi, këtu thotë Nazmi Maloku, unë su ni bie në të vëlla se ku e ke marrë këtë makinë ti? Këtu thotë Elbasan Unik. A mundesh me ma sqaru.* ***Shtetasi**: Po, unë këtë kerr e kam marrë vella... - nuk kuptohet- ... do shkoj në ambasadë.* ***BrahaD**: Unë të besoj, ju paguani lek se s'ta jep kush pa lek dhe nuk shifni se çfarë merrni, hajde ulu ti në vendin tim shif Astrit Gashi, thot Astrit Gashi nuk ekziston kurrkund, këtu thotë Elbasan UNIK shif ça thotë këtu, duhet të shkruaj dhe në librezë citu ,këtu thotë Nazmi Maloku, këtu Astrit Gashi. Sun i bie në të kësaj makine ju ini tu shkue për hall ,unë pa fol me shefin këtë makinë nuk e nxjerr. Kam pas rast që e kanë gjet në Shkodër dhe më kanë pyet mue pse e ke lëshuar ti zotri. Shtetasi: Normal normal. BrahaD: I kanë çuar makinat në Shkodër dhe i kanë shit, hape krahun atje dhe do flas me shefin Shtetasi:....ka kamera...BrahaD: Unë e di që shkon për hall, nuk e... ke fajin ti or, nuk shikojmë se japim lek dhe çfarë marrim, do ta zgjidhim.* Në vijim të kësaj praktike të përpunimit të dokumenteve, sipas pamjeve filmike rezulton se në orën 06:52:56 ky shtetas është paraqitur në kabinë dhe i ka dhënë kontrollorit Dashnor Braha një kartëmonedhë të prerjes 5 euro të cilën Dashnori në fillim e ka vendosur poshtë tastierës dhe gjatë kësaj kohe zhvillohet biseda si vijon: *BrahaD: Ti në ambasade je tu shku or babush s'di qysh me ja bo me tle këtu....Shtetasi KS: Aa. BrahaD: Bonja qysh të dush, edhe ik o babush, ca me te bo me te lenë këtu. Shtetasi KS:....nuk kam shumë. BrahaD:Aaa po shif sa të dush o babush. ShtetasiKS:A mi jep dokumentet...".* Sipas pamjeve filmike dhe bisedës së zhvilluar rezulton se shuma 5 euro është kërkuar nga Dashnor Braha dhe është dhënë nga shtetasi kosovar për shkak të problematikës që kontrollori ka konstatuar në lidhje m e dokumentacionin e përdorimit të mjetit, por që pas dhënies së shumës së parave, ai lejohet të udhëtojë nga i pandehuri Dashnor Braha, pavarësisht mangësisë apo problemeve që vetë ky i fundit ka konstatuar në lidhje me dokumentacionin e mjetit. Po në datë 10.02.2022, ora 06.53, kontrollori Dashnor Braha, sipas pamjeve filmike, regjistrimit audio dhe verifikimit të të dhënave lidhur me udhëtaret e përpunuar në këtë orar në sistemin TIMS, rezulton se ka përpunuar dokumentet e shtetasit Hashim Jorgji të cilit i drejtohet me fjalët "*fute*

një dhjetëshe aty, një dhjetëshe të kuqe, kthehu mbrapsht". Pamjet filmike nuk kanë fiksuar shumë e dhënë por rezulton qartë nga komunikimi i zhvilluar kërkimi prej të pandehurit i shumës 10 euro, shprehur me fjalët "*Fute një dhjetshe aty..*".

677. *Së katërti*, në datë 16.02.2022, ora 13.42, në kabinën hyrëse me nr. 4, është konstatuar momenti kur në kabinën e shërbimit ndodhet kontrollori Fatri Braha dhe më pas vjen kontrollori Dashnor Braha për të marrë shërbimin. Gjatë këtyre momenteve, Fatri Braha i cili është ende në shërbim, gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi kosovar, për të cilin sipas bisedës konstaton mungesë të dokumenteve të vaksinimit, , i kërkon atij të hapë krahun dhe të paraqitet në kabinë, ndërkohë që i mban edhe dokumentet. Në këtë moment në kabinë futet i pandehuri Dashnor Braha për të marrë shërbimin dhe sipas pamjeve filmike ai zëvendëson Fatriun në tavolinën e punës dhe ky i fundit vazhdon të qëndrojë ne këmbë. Në këtë moment në kabinë paraqitet shtetasi kosovar i cili i jep Fatri Brahës një kartëmonedhe 5 euro, dhe pas këtij momenti Fatriu i jep dokumentet ndërkohe që Dashnor Braha tashmë në shërbim nuk kryen asnjë veprim për regjistrimin e dokumenteve të udhëtarit. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se shtetasit e regjistruar në këtë janë shtetasit Liridon dhe Shkurtesa Lugalliu. Në këtë episod, pavarësisht se sipas pamjeve filmike rezulton se ndërkohë që Fatri Braha mes shuëmn 5 euro nga shtetasi dhe i jep atij dokumentet e udhëtimit që kishte përpunuar me herët, nuk rezulton që i pandehuri Dashnor Braha të ketë kryer ndonjë veprim aktiv të kundërligjshëm për të ndikuar në realizimin e këtij fakti penal nga kolegu i tij. Po nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio i kamerave në datë 16.02.2022, ora 13.00 rezulton se punonjësi i policisë në shërbim Dashnor Brasha përpunon dokumentet e shtetasve Visar Breznica, Daniel Smolka dhe Florim Krasniqi ndërkohe që i jepet dhe nej liste me pasagjere me logon "Arditi Tours" dhe nga biseda me shtetasin ai i thotë se ka 31 pasagjerë të cilët nuk rezulton të jenë regjistruar, por nuk është regjistruar ndonjë veprim që dokumentin kërkimin, dhënien apo pranimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm nga kontrollori. Po në këtë datë, në orën 13.22, pamjet filmike kanë regjistruar momentin kur një shtetas në sportel, se bashku me dokumentet i ka dhënë shumë prej 20 eurosh, e cila bie mbi tastiere dhe merret nga kontrollori Dashnor Braha. Sipas të dhënave të sistemit TIMS shtetasi që ka dhënë këtë shumë dhe ka kaluar në këtë hark kohor ne kufi është shtetasi kosovar Sadi Perashi. Në vijim në orën 13.38 po të datës 16.02.2022, gjatë përpunimit të dokumentacionit nga kontrollori Dashnor Braha, nga pamjet filmike fiksohet se brenda dokumenteve ai i ka vendosur shumën prej 200 euro. Nuk rezulton se te jetë zhvilluar ndonjë bisede mes tyre duke pamundësuar identifikimin e arsyes se dhënies se kësaj shume por ndërkohe nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se shtetasi që ka kaluar në këtë hark kohor ne kufi dhe për pasojë, ka dhënë se bashkë me dokumentacionin edhe shumën përkatëse në drejtim të kontrollorit Dashnor Braha, është shtetasi kosovar Murteza Krasniqi.

678. *Së pesti,* nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rezulton se në datë 17.02.2022 ora 21.40 punonjësi i policisë në shërbim Dashnor Braha, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasit kosovar Bujar Krasnici, pasi i drejtohet ndër të tjera me fjalët "*..no no kthehuni mbrapa...*", gjatë marrjes së pasaportës së tij, e hap atë dhe në brendësi të saj gjendet shuma 10 euro të cilën e merr dhe e fsheh poshtë tastierës së kompjuterit

në tavolinën e punës. Nga bidesa nuk është e qartë arsyeja e marrjes së kësaj shume por rezulton se bashkë me të udhëtonte edhe një shtetas tjetër serb, i cili nuk rezulton në sistem.

679. *Së gjashti,* në datë 22.02.2022, ora 08.01, në kabinën nr. 6 ku është duke kryer shërbimin kontorllori Dashnor Braha, përpunohen dokumentet e dy shtetasve kosovarë, njërin nga të cilët në bisedë i referohet me emrin Hajdar Nika. Kontrollori konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit kundër Covid dhe iu kërkon të paraqesin dokumentacion për dy dozat e vaksinës. Ndër të tjera në bisedë i drejtohet edhe me fjalët "*Pa lekë s'ke shanc ti po hë..*", si dhe duke ju bërë të ditur se testi kushton 20 euro. Nuk është fiksuar nga pamjet filmike dhënia e ndonjë shume parash. Ndërkohë, gjatë kryerjes së shërbimit në datë 24.02.2022, ora 09.26 është fiksuar nga pamjet filmike se kontrollori Dashnor Braha merr para nga shtetasi Blerim Deliu i paraqitur në sportel, në këmbim të lejimit të udhëtimit në mungesë të autorizimit të mjetit, por nuk referohet shuma. Po në këtë datë, në orën 09.34, nga pamjet filmike fiksohet marrja nga kontrollori Dashnor Braha të dy kartëmonedhave prerje 20 euro nga dy shtetas kosovarë të paraqitur në sportel, përkundrejt lejimit të udhëtimit të tyre në mungesë të dokumentacionit.

680. *Së shtati,* në datë 25.02.2022, ora 20.03, ndërkohë që në shërbim është kontrollori Dashnor Braha, paraqitet shtetasi kosovar Shkëlqim Mexhuani i cili i jep për përpunim tre karta identiteti dhe dokumentet e mjetit. Në dialogun e transkriptuar të zhvilluar mes tyre, rezulton se ai i kërkon librezën e automjetit dhe dokumentacionin e vaksinave dhe konstaton se nuk kanë dokumentacion për dozën e dytë dhe i drejtohet me fjalët "*...Jo jo vallai njom ke dhon, është me nji dhe duhet me dy vaksina babush, merrni makinën dilni çaty në nji vend dhe hajde babush...*", dhe ndërkohe mban dokumentet duke i vendosur në një anë të tavolinës së punës. Më pas dëgjohet që një person hyn në kabinë dhe vijon dialogu dhe ndër të tjera, i drejtohet qytetarit me fjalët "*Si t'keni qef..*" dhe në këtë moment i jep dokumentet ndërsa shtetasi i drejtohet me fjalët "*..qe nji kafe për ty...*", ndërsa kontrollori i përgjigjet "*Për qef? Po patë dëshirë po s'pate..*", "*Ta boft zoti mar..rruge t'marr..avash avash..*". Pamjet filmike nuk kanë fiksuar shumën e dhënë por rezulton qartë ofrimi i mitës në funksion të lejimit të kalimit pa dokumentacionin që vetë kontrollori i ka kërkuar me herët si dhe pranimi i këtij të fundit të kësaj oferte, duke i dhënë në këmbim dokumentacionin dhe duke lejuar udhëtimin e shtetasve.

681. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 08.02.2022, 09.02.2022, 10.02.2022, 16.02.2022, 17.02.2022, 22.02.2022, 24.02.2022 dhe 25.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Dashnor Braha ka kërkuar, dhe ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pa dokumente të plota lidhur me udhëtimin e shtetasve apo pa dokumente të rregullta për lejimin e kalimit të mjeteve si dhe kundrejt mos regjistrimit në sistem, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit apo dokumenteve të përdorimit të automjeteve, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe

konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

682. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit, në mënyrë të tërthortë, marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe në disa raste kundrejt mos regjistrimit të tyre në sistemin TIMS. Marrja dhe pranimi i shumave të parave (euro) të dhëna nga shtetasit përkundrejt tolerimit të bërë nga i pandehuri Dashnor Braha, në një rast dhe konkretisht në atë të datës 08.02.2022 raste rezulton se është kryer në bashkëpunim me kolegun e tij dhe konkretisht të pandehurin Muhamet Cengu. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Dashnor Braha, në bashkëpunim me të pandehurin Muhamet Cengu në një prej episodeve, evidentohet qartë në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili qartësisht përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Dashnor Braha.

683. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Dashnor Braha, ndër të cilat edhe në një prej episodeve (*atë të datës 08.02.2022*) së bashku me të pandehurin Muhamet Cengu, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre. Po ashtu në një prej këtyre episodeve, siç rezultoi më sipër, i pandehuri Dashnor Braha ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Muhamet Cengu, duke ndikuar secili prej tyre, nëpërmjet mënyrës së komunikimit dhe veprimit të përbashkët, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

684. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Dashnor Braha, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të

PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

685. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Dashnor Braha përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Dashnor Braha ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

686. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Dashnor Braha është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Dashnor Braha, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

687. Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Dashnor Braha**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione*

publike" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Muhamet Cengu në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 08.02.2022, ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të kryera në datat 8, 9, 10, 16, 17, 22, 24 dhe 25 shkurt 2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ENDRIT UKA

688. Lidhur me të pandehurin **Endrit Uka**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datave 13.02.2022, 17.02.2022 dhe 25.02.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Endrit Uka, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, në ngjarjet e datave 13.02.2022, 17.02.2022 dhe 25.02.2022. Arrihet ky konkluzion duke vlerësuar sa vijon:

689. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar nga kamera nr.6, në kabinën nr. 2 ku ka kryer shërbimin në datë 11.02.2022 kontrollori Endrit Uka, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio është duke përpunuar dokumentacionin e një shtetasi kosovar me të cilën bisedon mbi mungesën e dokumentacionit për një pasagjere që udhëton me të, dhe midis tyre zhvillohet kjo bisedë :*E.Uka: Si e ka emrin ajo...Mbiemrin?..Hajde u kry eee, Shtetasi : Këto me ditët e qëndrimit mos i regjistro, se kur të shkoj në Rinës del i paregjistrum.* Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS në orarin në të cilin është zhvilluar, sipas pamjeve filmike, biseda si më sipër, nuk rezulton të jenë regjistruar shtetas të përpunuar në këtë hark kohor. Po ashtu nuk evidentohen nga procesverbali i këqyrjes së pamjeve filmike dhe biseda e transkriptuar kërkimi apo marrja e ndonjë shumë parash në këtë ngjarje.

690. *Së dyti,* nga pamjet filmike të regjistruar në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh në datë 13.02.2022, ora 10.20 minuta, rezulton se punonjësi i policisë në shërbim Endrit Uka, bisedon me një shtetas që paraqitet në sportel dhe dorëzon pasaportën, duke i kërkuar dokumentet e vaksinimit, dhe i bën me dije se duhen dy ndërkohë që sipas fjalëve të tij, rezulton se udhëtarët kanë vetëm një dozë të vaksinës. Ndër të tjera, duke i kthyer dokumentin shtetasit i drejtohet me fjalët "*Se di qysh me ja ba se a ba problem për zotin. Rregulloje pak..*", dhe pasi merr sërish pasaportën nga shtetasi, e hap dhe nxjerr prej andej 5 euro të cilat i merr. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS dhe të dhënat e marra prej tij rezulton se në këtë orë janë përpunuar

dokumentet e shtetasit Shpëtim Avdyli. Nga këto të dhëna që ofrojnë provat rezulton e qartë se i pandehuri Endrit Uka ka kërkuar dhe me pas ka marrë 5 euro nga shtetasi, me qëllim lejimin e tij të kalojë kufirin ndërkohe që nuk ka dokumentacion për dorën e dytë të vaksinimit, kërkuar me herët nga vetë kontrollori. Po në datë 13.02.2022, në orën 17.46 min, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit kosovar Zija Rexha, nga pamjet filmike konstatohet se bashkë me dokumentet ky i fundit ka futur në to 5 euro, të cilat merren nga kontrollori gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, përkundrejt problemeve që ky shtetas ka me dokumentet e vaksinimit dhe kartonin jeshil të mjetit. Gjatë bisedës, ndër të tjera, Endrit Uka dëgjohet t'i thotë : *E.Uka : E shef që na e bone dhuratën deri në fund, ndërsa shtetasi i përgjigjet : Një kafe kom me ta dhanë unë..*".

691. *Së treti,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, përshkruar në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve dhe transkriptimit të bisedave si dhe verifikimet dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, në datë 17.02.2022, gjatë kohës që në shërbim ka qenë i pandehuri Endrit Uka, janë regjistruar një sërë rastesh ku ai kërkon dhe/ose merr shuma parash nga shtetasit që paraqiten në sportel, kundrejt tolerimit për të kaluar kufirin në mungesë të dokumentacionit përkatës, ose për problematika të ndryshme të tij. Konkretisht: (i) në orën 19.16 minuta në kabinën nr. 4 pamjet filmike kanë fiksuar marrjen prej tij të shumës 10 euro nga shtetasi i verifikuar në sistem si Jeton Harizi, i cili sipas bisedës së zhvilluar me kontrollorin rezulton se nuk ka dokumente të plota vaksinimi; (ii) në orën 19.37 minuta, pamjet filmike kanë fiksuar marrjen prej tij të shumës 10 euro nga shtetasit e verifikuar nga të dhënat e sistemit TIMS si Albion Shabani dhe Dren Rexhepi, të cilët sipas bisedës së zhvilluar rezulton se nuk kanë dokumentacion për dozën e dytë të vaksinës. Në bisedë e sipër Endrit Uka i përmend edhe fjalën "kafe" dhe rezulton se ka marrë prjej tyre shumën 10 euro; (iii) në orën 19.22 minuta nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, rezulton se i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Ramadan Morina dhe Dineta Berisha, për shkak të mungesës së dokumentacionit të testeve kundër covid, është fiksuar qartë se merr prej tyre shumë 10 euro dhe i lejon të vijojnë udhëtimin; (iv) në orën 08.37 minuta, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve kosovarë Edvin Mushla dhe Dashnor Sokoli, i drejtohet atyre ndër të tjera me fjalët "Në daci me na i lanë një kafe mirë, se nuk bën pa vaksina, se na i kontrollojnë" dhe pas këtij momenti rezulton se merr prej tyre 5 euro duke i lejuar të vijojnë udhëtimin; (v) në orën 08.41 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Fatlind Hyseni dhe Bleron Ahmeti, konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit dhe ju drejtohet me fjalët "*Një kafe mua citu dhe ikni*". Pas këtyre fjalëve, hap një dokument para skanerit, nxjerr një kartëmonedhë 5 euro dhe lejon shtetasit të vijojnë udhëtimin; (vi) në orën 09.12 Endrit Uka gjatë përpunimit të doukenteve të shtetasve të cilët sipas sistemit TIMS rezulton te jene Agron Ajdini, Miran Ajdini dhe Erxhan Ajdini, për shkak të mungesës së dokumenteve të vaksinimit, merr shumën 10 euro deh i lejon të vijojnë udhëtimin; (vii) në orën 10.38 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Milot Bunjaku, konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit dhe i drejtohet me fjalët "*Të paktën një kafe na e jep*". Pas këtyre fjalëve, nxjerr nga një dokument një kartmonedhe 5 euro dhe lejon shtetasin të vijojnë udhëtimin; (viii) në orën

11.20 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Erblin Rexhepi dhe personave të tjerë që udhëtojnë me të për të cilët konstatohet se nuk kanë një dokument për të cilin Endrit shprehet se është shumë problem. Më pas konstatohet se mes dokumenteve merr një shumë parash, por që nuk rezulton qartë prerja dhe i lejon të vijojnë udhëtimin; (ix) në orën 11.32 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Agim dhe Altin Selmani, konstaton mungesë të dokumenteve të vaksinimit dhe problematikë në dokumentacionin e mjetit në bisedë e sipër i drejtohet duke përmendur edhe fjalën "kafe" dhe nga pamjet filmike fiskohet marrja prej tij e shumës 10 euro; (x) në orën 11.37 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Ferat Feratai dhe Ramoz Panoxha, konstaton mungesë të dokumenteve të mjetit dhe merr prej tyre, të futur në mes të dokumenteve një kartëmonedhë e cila duket të jetë frangë zvicerane, por që nuk mund të identifikohet prerja për shkak të pamjeve të kufizuara. (xi) në orën 14.20 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Jeton dhe Valdrin Hoti, konstaton mungesë të dokumenteve të vaksinimit dhe në bisedë e sipër i drejtohet me fjalët "qysh do ja bëjmë", dhe "ndreqe citu", duke i dhënë dokumentet. Pasi rimerr dokumentin, nga pamjet filmike fiksohet teksa e hap dhe merr prej andej një kartëmonedhë 5 euro; (xii) në orën 14.29 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Getoar Bytyqi dhe shtetasit Ardit Krasniqi, konstaton mungesë të dokumenteve të vaksinimit dhe në bisedë e sipër i drejtohet me fjalët "*qysh me ja bë*", duke i dhënë dokumentet, shoqëruar me fjalët "*fute çitu*". Pasi rimerr dokumentin, nga pamjet filmike fiksohet teksa e hap dhe merr prej andej një kartëmonedhë 5 euro, (xiii) në orën 14.42 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Mentor Kokallari, me të cilin sipas bisedës ndodhen në mjet edhe persona të tjerë, fiksohet të marrë brenda dokumenteve një kartëmonedhë 5 euro. Në sistemin TIMS është regjistruar vetëm shtetasi si më sipër, ndërkohë që personat e tjerë që udhëtojnë me të nuk janë regjistruar. (xiv) në orën 15.28 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Fatlind Xhemajli, teksa hap dokumentet ne tavolinën e punës, merr prej andej 5 euro dhe i vendos poshtë tastierës së kompjuterit; (xv) në orën 15.49 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e një shtetasi për të cilin nuk rezulton të ketë kryer regjistrimin në sistemin TIMS, i drejtohet me fjalët "Ti je pa dokumente dhe i prish punë asaj..". Nga pamjet filmike rezulton se ka marrë prej këtij shtetasi, për të cilin për shkak të mos regjistrimit në sistem nuk mund të identifikohet, monedha metalike, të cilat po ashtu nuk mund të përcaktohen në vlerë; (xvi) në orën 14.06 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Fisnik Halimi dhe Arbias Krasniqi, ju bën me dije atyre mungesën e dokumentacionit "autorizim" për automjetin dhe ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton marrja prej tij e shumës 5 euro, duke i lejuar të vijojnë udhëtimin; (xvii) në orën 17.36 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Dielli Rizvanolli, i bën me dije atyre mungesën e dokumentacionit të vaksinimit dhe ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton marrja prej tij e shumës 5 euro, duke e lejuar të vijojnë udhëtimin; (xviii) në orën 18.01 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasi kosovar Rinor Bytyçi, për të cilin konstaton mungesën e dokumentacionit "autorizim" për automjetin dhe i drejtohet me

fjalët "*si do ja bëjmë*". Ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton marrja prej tij e një kartëmonedhë prerja e të cilës nuk mund të përcaktohet për shkak të pamjeve të paqarta, duke e lejuar të vijojë udhëtimin; (xix) në orën 18.25 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Taulant Palushi dhe Visar Ademaj, për të cilët konstaton mungesën e dokumentacionit të vaksinimit dhe dëgjohet teksa i drejtohet me fjalët "*si do ja bëjmë*". Ndërkohë, nga pamjet filmike rezulton marrja e dokumenteve brenda të cilave shihet kartëmoendha 5 euro e cila merret nga kontrollori duke i lejuar të vijojnë udhëtimin; (xx) në orën 18.38 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Mazlum Maloku, Shpat Tabaku dhe Gani Ahmeti, Nga pamjet filmike rezulton marrja prej tij e një kartëmonedhë 5 euro e cila i jepet nëpërmjet vendosjes brenda pasaportës së shtetasit Mazllum Maloku, por nuk rezulton arsyeja e dhënies së kësaj shume; (xxi) në orën 18.50 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e një shtetasi i cili, kundrejt mos regjistrimit në sistem shihet se i jep një shumë prej 2000 lekësh shqiptare, por që mungesa e regjistrimit e cila duket te ketë qenë shkaku i dhënies së shumës, nuk ka mundësuar identifikimin e shtetasit që e ka dhënë këtë shumë; (xxii) në orën 19.16 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Jeton Hajrizi dhe Kastriot Hajrizi, për të cilin konstaton mungesën e dokumentacionit te vaksinimit, merr prej tyre 10 euro, duke e lejuar të vijojë udhëtimin; (xxiii) në orën 19.22 minuta, i pandehuri Endrit Uka, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Ramadan Morina dhe Doneta Berisha, për të cilët konstaton mungesën e dokumentacionit "autorizim" për mjetin, merr prej tyre 10 euro, duke i lejuar të vijojnë udhëtimin. Sa më sipër, rezulton qartësisht e provuar se në datë 17.02.2022, i pandehurit Endrit Uka, në 23 raste, ka kërkuar dhe/ose marrë nga shtetasit e përpunuar prej tij ne sportel, shuma të ndryshme parash (euro, lek dhe franga zvicerane) përkundrejt tolerimit të tyre për të kaluar në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit, dokumentacionit të mjeteve apo përkundrejt mos regjistrimit të hyrjes së tyre në R.Sh në sistemin TIMS.

692. *Së katërti,* nga këqyrja e pamjeve të kamerës nr. 207 datë 25.02.2022, në orën 15.57, konstatohet që i pandehuri Endrit Uka, teksa po përpunon një mjet dhe bisedon me shoferin i cili është shtetasi kosovar *Murat Mecini*, i drejtohet, ndër të tjera, me fjalët: *ndrit Uka: Po pra po, s'ke mujt po ca me t'thon shoku...19.09.21, ku je tu shku? Hec shifi dhe njiher, (i jep një dokument dhe ja merr pra në moment pas disa sekondash). Personi: Deri n'Fier.* Sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, në këtë moment shoferi ja ka dhënë dokumentin *(dallohet mbishkrimi ILIRIA)* ku konstatohet që në orën 15.57.53 kontrollori nxjerr një kartëmonedhë për të cilën nuk duket prerja, dhe e hedh shpejt para skanerit. Në këtë moment kontrollori i jep të gjitha dokumentet shoferit dhe i thotë që të iki, duke iu drejtuar me fjalët "*...hajde mirupafshim!" Shtetasi: Faleminderit.* Në këtë moment kontrollori Endrit Uka shihet se me dorën e djathtë e merr kartëmonedhën.

693. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 13.02.2022, 17.02.2022 dhe 25.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara mes të pandehurit Endrit Uka dhe shtetasve të përpunuar prej tij në pikën hyrëse, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së

pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Endrit Uka, ka kërkuar dhe/ose ka marrë para në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

694. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk rezulton asnjë fakt për veprimin e tij në bashkëpunim me ndonjë person tjetër dhe as evidentohet prezenca e ndonjë punonjësi tjetër policie gjatë zhvillimit të ngjarjeve objekt akuze ndaj të pandehurit Endrit Uka. Për pasojë gjykata vlerëson se nuk rezulton dhe as provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Endrit Uka është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Endrit Uka në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

695. Në arritjen e këtij konkluzioni, gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, ekziston dhe për më tepër të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

696. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Endrit Uka, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së

tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

697. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Endrit Uka, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

698. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Endrit Uka përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Endrit Uka ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

699. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Endrit Uka është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.

750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Endrit Uka, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

700. *Sa më sipër u arsyetua,* gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Endrit Uka**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit FATRI ISEBERI

701. Lidhur me të pandehurin **Fatri Iseberi**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datave 15.02.2022, 16.02.2022, 17.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022, 03.03.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon të theksojë të K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Fatri Iseberi, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në mos përmbushje të rregullt të detyrës së tij lidhur me verifikimin dhe regjistrimin e shtetasve që kalojnë kufirin në hyrje të R.Sh, në ngjarjet e datave 15.02.2022, 16.02.2022, 17.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022, 03.03.2022. Arrihet ky konkluzion duke vlerësuar sa vijon:

702. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4, në hyrje të R.Sh, ku ka kryer shërbimin në datë 15.02.2022 kontrollori Fatri Iseberi, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio se në orën 13.11 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentacionin e shtetasit kosovar Esat Ibishi, me të cilën bisedon mbi mungesën e dokumentacionit të vaksinimit/testimit kundër covid-it, ndër të tjra i drejtohet me fjalët : *Fatriu: Si kalove, pak dokumentet e makinës, testet, vaksinat...F.Iseberi : Duhet me bo testet...F.Iseberi: Pa test..edhe ne në punë jena..njanën ta pranoj po jo të gjitha vëlla, se tashi, shko banë nji test..Nga je ti?..F.Iseberi: Po tashi pronar po...pa test as ni kafe..kështu pronar je ti aaa?, shtetasi: ni kafe po. Fatriu: Hajde bre...Fatriu: Ik vazhdo tash.". Si e ka emrin*

ajo...Mbiemrin?..Hajde u kry eee, Shtetasi : Këto me ditët e qëndrimit mos i regjistro, se kur të shkoj në Rinës del i paregjistrum. Gjatë kësaj bisede ka marrë nga shtetasi 5 euro duke e ljuar të vijojnë udhëtimin ne mungesë të dokumentacionit të cilin ia kishte kërkuar me herët vetë kontrollori Fatri Iseberi. Po në datë 15.02.2022, ora 13.21 minuta, rënka përpunon dokumentet e disa shtetasve, nga bisedat e zhvilluara iu evidenton se kanë mungesë në lidhje me dokumentacionin e vaksinimit dhe ndër të tjera i thotë : *Fatriu: Duhet me u kthy me shku me bo testet,... Fatriu: Ndaçshkoni bani nadej, ndaç shkoni bani knej, nga të doni, s'muëm me dhanë lekë me pague test ty...Po unë ca me bo unë, o zotëri tashi nuk ban, nuk ban..Jo knen jo andej, knej ban 20 euro...".* Nga pamjet filmike rezulton se shtetasi pasi lëviz automjetin e tij afrohet përsëri tek kabina dhe pasi i jep pasaportën, aty i ka vendosur një shumë parash por që nuk mund të dallohet qartë prerja e kartëmonedhës. Pas këtij momenti Fatriu i drejtohet me fjalët : *A do me dal dikun e mos pagu asnji send aaa? Ku e ki kafen?, ndërsa shtetasi ia kthen "po skam".* Pasi largohet pak shtetasi kthehet përsëri dhe i jep një kartëmonedhë 5 euro dhe disa monedha ndërsa Fatriu i thotë "*Jo vëlla jo. Shko bane test, dy veta këtu, mos ja fut kot tashi...mos u tall me ne pasha zotin*", ndërsa shtetasi i përgjigjet "*nuk kam*". Ky shtetas kthehet përsëri ne kabinë në orën 13.29 minuta sipas pamjeve filmike dhe i jep pasaportën brenda së cilës kontrollori shikon 5 eurot dhe monedhat metalike. Sipas verifikimit të të dhënave të sistemit TIMS në këtë hark kohor rezulton se shtetasi që ka marrë pjesë në veprimet si më sipër është Milaim Sylaj. PO në datë 15.02.2022 në orën 12.28, sipas pamjeve filmike shihet kontrollori Fatri Iseberi, i cili gjatë përpunimit të dokumenteve te shtetasve Qëndrim Krapi dhe Burim Makolli, merr prej tyre 5 euro, por nuk rezultojnë biseda mes tyre për shkak të mos regjistrimit audio.

703. *Së dyti,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, përshkruar në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve dhe transkriptimit të bisedave si dhe verifikimet dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, në datë 16.02.2022, gjatë kohës që në shërbim ka qenë i pandehuri Fatri Iseberi, janë regjistruar një sërë rastesh ku ai kërkon dhe/ose merr shuma parash nga shtetasit që paraqiten në sportel, kundrejt tolerimit për të kaluar kufirin në mungesë të dokumentacionit përkatës, ose për problematika të ndryshme të tij. Konkretisht: (i) në orën 20.02 minuta pamjet filmike kanë fiksuar marrjen prej tij të shumës 5 euro nga shtetasi Daver Pampuku, dhe së bashku me të rezulton se kanë udhëtuar edhe disa shtetas të tjerë. Sipas bisedës së zhvilluar me kontrollorin rezulton se nuk kanë dokumente të plota vaksinimi; (ii) në orën 20.09 minuta, pamjet filmike kanë fiksuar marrjen prej tij të shumës 10 euro nga një shtetas i cili nuk rezulton i regjistruar në sistemin TIMS, ndërkohë që rezulton se i janë dorëzuar dy karta identiteti së bashku me shumën 10 euro, por kontrollori nuk ka kryer veprime për verifikimin dhe regjistrimin e tyre ndërsa rezulton se ka marrë shumën 10 euro; (iii) në orën 20.17 minuta nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio, rezulton se i pandehuri Fatri Iseberi, teksa përpunon dokumentet e disa shtetasve, dëgjohet që zhvillon kete bisede : Shtetasi : *O shef a mund ta lë një kafe? Fatri Iseberi: Po....dy veta pa test. Shtetasi:....ka 20 euro, ...shkojm deri atje e vijmë qysh thu ti? Fatri Iseberi: Ti boll djalë i mirë je. ..shko merrni makinën e rregulloni letrat e hec hajt merri këtu. Hec vrap. Shtetasi ; Me u rregullu mirë a? Fatri Iseberi: O babush ...tani hajde këtu hajde këtu, jo me u ngushtu sa të keni mundësi. Dakord, Hajd. Shtetasi: Dakord.* Ndërsa zhvillohet kjo

bisede, pamjet filmike kanë fiksuar veprimet e kontrollorit Fatri Iseberi i cili ju mban një dokument në dukje leje qarkullimi dhe pas disa minutash shtetasi i cili komunikonte me të, vjen përsëri dhe i hedh mbi tavolinë disa fletë dokumentesh (formati A-4), midis tyre ndodhen dy kartëmonedha 20-euro. Nga verifikimi, nuk konstatohen të jenë kryer veprime në sistemin TIMS, për mjetin apo dokumentet e tyre. (iv) Në orën 23:20 min po të datës 16.02.2022, në sportelin e kabinës nr.4 paraqitet një shtetas të cilin punonjësi i policisë me emrin Fatri Iseberi e pyet se *çfarë ka ngarkuar* dhe i përgjigjet se ka ngarkuar *kabulla* dhe ndërkohë bashkë me dokumentin pasaportë i jep dhe 50 euro, duke i lënë mbi tavolinë. Gjatë këtyre ngjarjes, mes tyre zhvillohet kjo bisedë: *Fatri Iseberi: Çabere ti. Ça ke ngarkue? Shtetasi: Kablla, kablla.* Nga verifikimi ne sistemin TIMS, rezulton se nuk ka regjistrim shtetasish shqiptare nga punonjësi i policisë Fatri Iseberi por në këtë orë ka udhëtuar me automjetin tip kamion shtetasi maqedonas *Tair Megdi* i cili është edhe shtetasi që ka dhënë shumën 50 euro kundrejt punonjësit të policisë Fatri Iseberi. (v) Në orën 20:45 min datë 16.02.2022 në kabinën nr. 4 hyrje R.Sh pamjet filmike kanë fiksuar kontrollorin Fatri Iseberi teks dhe merr në dorë një mbajtëse dokumentesh me kapak ngjyre blu, brenda se cilës ka euro por që nuk mund të përcaktohet prerja dhe, gjatë komunikimit me shtetasin me mbajtëse dokumentesh ngjyre blu, vijnë katër shtetas të tjerë të cilët, për shkak se nuk kishin pasur vaksinat ju kishte mbajtur dokumentet më herët, dhe konkretisht dy pasaporta dhe dy karta identiteti dhe i kishte dërguar të bënin test. E pyet njërin prej tyre *si e pate emrin sepse ta harrova.* Shuma prej 10-te eurosh e dhënë nga njëri prej shtetasve ka bërë Fatri Iseberin që të vijojë të mos lejojë shtetasit kosovare të udhëtojnë, ndërkohë nga pamjet filmike konstatohet se në krahun e majtë të tavolinës së punës mban ende dokumentet e shtetasve të cilëve ju ka kërkuar që të hapin krahun me automjet, dokumente të cilat dorëzohen prej punonjësit të policisë vetëm kur njeri prej tyre hyn brenda kabinës e i jep diçka. Dhe ndërkohe i thotë:"*...Shko tek makina rregulloje dhe eja mos të shofin. Nama nji dokument këtu se asht pa regjistru".* Në orën 20:50 min afrohet përsëri tek kabina shtetasi të cilit Fatriu i kishte mbajtur dokumentet në kabinë e pasi i jep diçka dhe Fatriu i kthen dokumentet e njëkohësisht duke i thotë se *nëse e pyet njeri të thotë se i kishte pas dokumentet e vaksinimit.* Nuk evidentohet ne kete rast nga pamjet shuma e parave të dhëna po rezulton qartë kërkimi i saj nga kontrollori Fatri Iseberi.

704. *Së treti,* nga këqyrja e pamjeve të kamerës nr. 207, në kabinë hyrëse me nr. 4, në datë 17.02.2022, ora 08.28 minuta, konstatohet që i pandehuri Fatri Iseberi, teksa po përpunon dokumentet e shtetasve të paraqitur në sportel të cilëve ju drejtohet, ndër të tjera me fjalët "*nuk kini dokumente dhe do ktheheni mbrapsht në Suedi*" si dhe ju mban dokumentet duke i vendosur në krahun e djathtë të tavolinës së punës. Ne vijim të bisedës i drejtohet njërit prej tyre me fjalët "*Florentin kthehu në Suedi...200 euro*". Sipas të dhënave të verifikuara në sistemin TIMS, rezulton se ne këtë moment kohor ka përpunuar dokumentet e shtetasit Florentin Gajraku dhe nga pamjet filmike, rezulton se në mes të njërit prej dokumenteve janë të vendosura disa kartëmonedha euro të cilat pasi i shikon, Fatriu i drejtohet serish shtetasit duke i thënë edhe shifrën 200, disa herë. Nga biseda rezulton se kërkimi i kësaj shume lidhet me faktin se shtetasit i kishte mbaruar leja e qëndrimit. Po në këtë datë 17.02.2022 ora 08:29:11, Në sportel paraqitet

një shtetas kosovar i cili dorëzon dokumentet e identifikimit. Fatriu fillon ta intervistoje duke i kërkuar edhe dokumentet e vaksinimit ose testin *Pcr*. Në vijim, në mungesë të tyre i kërkon shtetasit kosovar *një kafe duke u shprehur në 10-euro*. Biseda e zhvilluar midis tyre është si vijon: *Fatri Iseberi: Si ini ju , si kaluat ju, atëherë vaksinën testin ju lutem...Fatri Iseberi: hajde një ditë tjetër , veç me be testin shpejt e shpejt ..Shtetasi: (nuk kuptohen fjalët). Fatri Iseberi: Ec s'ke ça me bë veç me bë testin dhe me ardhë...Fatri Iseberi: Ose fute një dhjetëshe këtu (zgjat një dokument)..Shtetasi:... nuk kuptohet...Fatri Iseberi: Jo jo kështu ju mësoj keq ju (zgjat dorën merr dokumente dhe eurot i vendos përballë aparaturës së skanerit) .. mirupafshim.* Në intervalin kohor që zhvillohet biseda si më sipër, nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se punonjësi i policisë Fatri Iseberi, ka kryer përpunimin e dokumenteve të shtetasit *Sinan Ahmeti* i cili në mungesë të testit kundër Covid i ka dhënë punonjësit të policisë Fatri Iseberi shumën 10-të euro.

705. *Së katërti*, nga këqyrja e pamjeve të kamerës në kabinë hyrëse me nr. 4, në datë 19.02.2023, ora 10.10 minuta, shihet punonjësja e policisë në shërbim Vojsava Selmani zëvendësohet nga një punonjës tjetër i cili ka rezultuar të jetë Fatri Iseberi. Vojsava Selmani, referuar pamjeve filmike, dallohet duke marrë çantën për të dalë nga kabina dhe dëgjohet që thotë *do pi kafe*. Kolegu i jep një kartëmonedhë 5 euro të cilën Vojsava e cila ndodhej poshtë tastierës. Në bisedën e regjistruar përmenden fjalët në *"tastiere"* dhe punonjësja fjalën *"veç një"*. Kartëmonedhën të cilën pasi ja jep kolegu e merr dhe largohet nga kabina. Në këtë episod nuk rezulton ndonjë element që jep të dhëna për kryerjen e ndonjë vepre penale nga i pandehurit Fari Iseberi apo kolegia e tij.

706. *Së pesti,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio dhe video i datës 23.02.2022, ka rezultuar se në orën 17.05, është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë Fatri Iseberi dhe ndërkohe hyn në kabinë edhe kolegu i tij i identifikuar si Gezim Duraku, i cili fillon e numëron një shumë parash të prerjeve të ndryshme, të cilat me pas i fut në xhep e largohet. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për kryerjen e veprimeve që përmbajnë elementë të veprës penale në lidhje me këtë ngjarje. Në vijim, po në datë 23.02.2022, ora 17:05:13, është serish duke kryer shërbimin punonjësi i policisë Fatri Iseberi, i cili është fiksuar nga pamjet filmike teksa i merr një shtetasi në sportel shumën 20-të euro pasi ky shtetas nuk dispononte kartonin jeshil të automjetit. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS, rezulton se prej tij nuk janë kryer veprime regjistruese por verifikuese të dokumentacionit të këtij shtetasi nga ana e punonjësit të policisë, për këtë arsye, nuk është bërë e mundur identifikimi i tij.

707. *Së gjashti*, nga këqyrja e pamjeve të kamerës në kabinë hyrëse me nr. 4, regjistrimi audio dhe verifikimet e kryera ne sistemin TIMS, ka rezultuar se punonjësi i policisë në shërbim Fatri Iseberi, në datë 27.02.2022, (i) në orën 09:15:10 në përpunim të dokumenteve të shtetasit *Erhan Pomaku,* i kërkon dhe i merr këtij shtetasi 10 euro, ndërkohë që bisedon me të për mungesë dokumentesh; (ii) në orën 11:39:48 *Fatri Iseberi,* pasi i ka marrë pasaportën një shtetasi të paidentifikuar (për shkak të filmimeve të kufizuara të pajisjes përgjuese), shihet teksa ia kthen kundrejt pagesës prej 40 euro (dy kartëmonedha 20 euro), (iii) në orën 11:44:05, në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të pa identifikuar, i kërkon ryshfet duke biseduar për parregullsi

dokumentesh, dhe ndër te tjera, dëgjohet Fatriu duke i thënë shtetasit "*shumë faleminderit*", por nuk është identifikuar nga pamjet shuma e marrë apo arsyeja e saktë e kërkimit të saj. (iv) në orën 11:53, kontrollori Fatri Iseberi është duke bërë përpunim të dokumenteve të shtetasit kosovar, të identifikuar nëpërmjet sistemit TIMS si *Ilir Morina* dhe midis tyre zhvillohet biseda si më poshtë: *Fatri Iseberi: ..O më fal se ta harrova emrin...Ilir Morina: ...nuk dëgjohet...Fatri Iseberi: O Ilir ti e ke fut edhe kafen këtu o Ilir.* Nga pamjet filmike, dokumentuar edhe në procesverbalin e këqyrjes, dallohet në mes të pasaportës një kartëmonedhë prerje 5 euro të cilën e hedh në tavolinë, dhe më pas e merr dhe e fut në xhep. (v) në orën 09:15:10, Fatri Iseberi, i cili është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të paidentifikuar, të cilit i kërkon ryshfet duke i bërë presion për parregullsi dokumentesh. Në orën 09:54:40 futet në kabinë një shtetas dhe zhvillojnë ketë bisedë: *Shtetasi: ...a bën?. Fatri Iseberi: Amos janë pak apo kaq të ka bë zemra!? Shtetasi: Për rrugë.* Sipas pamjeve filmike duket shtetasi i cili fut dorën në xhep dhe nxjerr një kartëmonedhë prerje 10 euro dhe e hedh në tavolinën e punës të Fatriut ndërsa ai i drejtohet me fjalët *"...ani ani, faleminderit shumë."* Sa më sipër, nga të dhënat që ofrojnë provat e referuara, rezulton e qartë se në ngjarjet e kësaj datë Fatri Isberi ka kërkuar dhe/ose marrë shuma parash nga shtetasit e paraqitur në sportel përkundrejt lejimit te udhëtimit të tyre.

708. *Së shtati*, nga këqyrja e pamjeve të kamerës në kabinë hyrëse me nr. 4, regjistrimi audio dhe verifikimet e kryera ne sistemin TIMS, ka rezultuar se punonjësi i policisë në shërbim Fatri Iseberi, në datë 03.03.2022, ora 11.02 minuta, është në përpunim të dokumenteve të një shtetasi të identifikuar sipas sistemit TIMS si *Agron Berisha*, të cilit i kërkohet doza e dytë e vaksinës. Në bisedën e tyre dëgjohet shtetasi që i drejtohet kontrollorit me fjalët *"si me ja bë tashi"* dhe përgjigja e kontrollorit Fatri Iseberi i cili i drejtohet me fjalët "*me ta lëshu pa regjistru.. apo mos me e bërë testin fare .. dhe bëj një zgjidhje ti,...apo e bëjmë zgjidhjen ne"*, por nuk rezulton të janë evidentuar veprimet konkrete pasi pamjet e kamerës kanë qenë të kufizuara. Po ashtu Fatri Iseberi dëgjohet kur i thotë se "*testi kushton 20 Euro*" si dhe shprehjen "*Djali duket shënosh e mirë*", si dhe "*E bëjmë zgjidhjen këtu vetë*". Nga biseda e zhvilluar rezulton kërkimi në mënyrë të tërthortë i mitës, duke iu referuar kontekstit të komunikimit të tyre, pavarësisht se nuk është fiksuar dhe provuar marrja e ndonjë shumë parash.

709. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022, 16.02.2022, 17.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022, 03.03.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara mes të pandehurit Fatri Iseberi dhe shtetasve të përpunuar prej tij në pikën hyrëse, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Fatri Iseberi, ka kërkuar dhe/ose ka marrë para në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me

detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

710. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk rezulton asnjë fakt për veprimin e tij në bashkëpunim me ndonjë person tjetër dhe as evidentohet prezenca e ndonjë punonjësi tjetër policie gjatë zhvillimit të ngjarjeve objekt akuze ndaj të pandehurit Fatri Iseberi. Për pasojë gjykata vlerëson se nuk rezulton dhe as provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Fatri Iseberi është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Fatri Iseberi në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pika 1 i Kodit Penal.

711. Në arritjen e këtij konkluzioni, gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, ekziston dhe për më tepër të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

712. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Fatri Iseberi, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

713. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Fatri Iseberi, ka vepruar me

dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

714. Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Fatri Iseberi ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

715. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

716. *Sa më sipër u arsyetua,* gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Fatri Iseberi**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit FATRI BRAHA

717. Lidhur me të pandehurin **Fatri Braha**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Fatri Braha ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 08.02.2022, 12.02.2022, 16.02.2022 dhe 24.02.2022* . Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Fatri Braha, vetëm dhe në një nga episodeve në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Arben Goçi në një episod të datës 08.02.2022, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

718. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 08.02.2022 i pandehuri Fatri Braha, në orën 17.45, ndërkohë që është duke përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë , ndër të cilët sipas të dhënave të sistemit TIMS edhe shtetasi kosovar Lavdim Halili, Fatri Braha ju kërkon dokumentacionin e mjetit dhe dokumentacionin lidhur me testet kundër Covid, duke iu drejtuar ndërkohë që konstaton mungesë të tyre, me fjalët "*Ku e ki autorizimin për makinën? Je shume i parregullt, hape krahun një herë*", ndërsa shtetasi kosovar e pyet "*A ban në librezë me i fut?*" dhe Fatiu i përgjigjet "*Po or ti.*". Nga pamjet filmike pas kësaj bisede, është fiksuar momenti kur shtetasi kosovar i jep një kartëmonedhë 5 euro, të cilën Fatriu e merr dhe e vendos para pajisjes skaner dhe sapo largohen shtetasit e merr. Po në këtë datë, në orën 15.28 minuta Fatri Braha, teksa përpunon dokumentacionin e shtetasit, të verifikuar sipas shënimeve të sistemit TIMS si Ardian Balaj, konstaton se bashkudhëtarja e këtij shtetasi nuk ka marrë me vete dokumente identifikimi dhe po ashtu konstatohet mungesë dokumentacioni për testet e Covid. Në bisedë e sipër, shtetasi i drejtohet me fjalët : *Shtetasi: ke harru dokumentet e vaksinën. Pa test pa dokumente; Fatri Braha: Ca me bo? Ket e ke po kartën se ka vajza? Shtetasi : aa; Fatri Braha: Ajo cika nuk ka kartë me vete...Fatri Braha: Ca të kesh dëshirë, me zor jo..me dëshirë po*". Në vijim të kësaj bisede, nga pamjet filmike është fiksuar momenti kur shtetasi i jep 10 euro të cilat Fatriu i merr dhe i vendos para pajisjes skaner, duke i lejuar të kalojnë kufirin ndërkohe që në sistemin TIMS ka regjistruar vetëm shtetasin Ardian Balaj ndërsa shtetasja (vajza) të cilës i referohen në bisedë se i mungon dokumenti i identifikimit, nuk është e regjistruar në sistem pikërisht për shkak të

mungesë së dokumentacionit për të cilin, në këmbim të shumës së marrë, Fatri Braha e lejon të udhëtojë pa u regjistruar. Po në datë 8.2.2022, në orën 16.21 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi shqiptar, zhvillohet biseda gjatë së cilës shtetasi i thotë se do të ike sërish në Gjermani, sepse ka makinë tjetër për të sjellë. Ndër të tjera, Fatri Braha i thotë : *Janë hi shumë makina or djalë. Sa makina ke pru në Shqipëri ti?...Fatri Braha: Po s'lejohet mbi tre or mik. Shtetasi: Po si s'lejohet o..Fatri Braha: 1,2,3,4,5,6 çi ke këto makina...ke ndonjë gjë në makinë?..Në makinë ndonjë gjë që nuk lejohet ke?...Do qesësh kafe..a nuk ke gjë?...Shyqyr."* Ndërkohë përgjigjet e shtetasit ndërsa Fatriu i drejtohet me fjalët si më sipër, nuk dëgjohen por nga pamjet filmike, në kabinën ku është Fatri Braha, shihet teksa hyn një koleg tjetër i tij dhe ndërkohë që vijon bisedën me shtetasin i drejtohet kolegut të tij duke e thërritur, me fjalët : *Fatriu: O Arben..e ka prurë krejt makina ky, sjell makina ky.. O Arben?.* Ndërkohë, kolegu i identifikuar sipas procesverbalit të këqyrjes si Arben Goçi i drejtohet shtetasit duke e pyetur se nga është ndërsa Fatriu vijon ti shpjegoje kolegut të tij bisedën me shtetasin duke i treguar se i ka thënë që nuk lejohen mbi tre makina. Gjatë kohës që zhvillohet kjo bisedë mes dy punonjësve Fatri Braha dhe Arben Goçi dhe shtetasit në sportel, ky i fundit hedh ne tavolinën e kontrollorit një pasaporte të cilën, pasi Fatriu e hap, merr prej saj një kartëmonedhë 10 euro. Sipas të dhënave në sistemin TIMS, rezulton se nga Fatri Braha është bërë shënimi "*Ju kalua doganës për veprim*" dhe shtetasi që rezulton të jetë përpunuar në këtë hark kohor është Rigert Lleshi. I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale ky shtetas tregon rrethanat e faktit të ndodhur në datë 8/2/2022 duke treguar se pas verifikimit të dokumenteve ka kaluar për verifikim tek dogana, por mohon dhënien e shumës 10 euro të fiksuar nga pamjet filmike. Në po këtë datë, në orën 17.11 minuta, teksa përpunon dokumentet e disa shtetasve kosovarë, Fatri Braha i kërkon dokumentet e vaksinimit dhe ndërsa konstaton se nuk i kanë, merr prej njërit nga shtetasit pasaportën brenda së cilës gjenden 10 euro të cilat i vendos para pajisjes skaner. Sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, shtetasit që kanë dhënë këtë shumë, për shkak të mospasjes së dokumentacionit të vaksinimit, janë shtetasit kosovarë Arsim Jakupi dhe Bleon Hajdini.

719. *Së dyti*, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, rezulton se në datë 12.02.2023, teksa është në shërbim në i pandehuri Fatri Braha, në orën 13.55 minuta, ndërsa komunikon me një shtetas, ndër dokumentet që po përpunon mbi tavolinë, dallohet një shumë 10 euro e dhënë nga ky shtetas, të cilit në fundi drejtohet e fjalët "Për mua ik, je i lire, po gjete autobus..". Nuk rezultojnë të dhëna dhe shënime në sistemin TIMS për këtë shtetas për të mundësuar identifikimin e tij por ndërkohë nga pamjet filmike rezulton marrja e shumës 10 euro nga Fatriu, edhe pse rezulton e paqartë arsyeja. Po në këtë datë, në orën 13.58 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve kosovarë Driton dhe Liridon Paluca, , pasi i kërkon dokumentet e vaksinimit, nga pamjet filmike është fiksuar se kur hap njërën prej pasaportave, Fatri Braha merr prej aty 10 euro. Në të dy këto ngjarje rezulton e qartë marrja prej të pandehurit e shumave të parave nga shtetasit që paraqiten në sportel, kundrejt lejimit të kalimit pa dokumentacionin që ai vetë ka kërkuar me herët për vaksinimin apo për arsye të tjera.

720. *Së treti,* nga pamjet filmike, procesverbali i transkriptimit të komunikimeve dhe verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se punonjësi i policisë në shërbim Fatri Braha, ka kërkuar

ose ka marrë nga shtetasit që ka përpunuar në pikën hyrëse, shuma parash kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumenteve të kërkuara dhe konkretisht: (i) në orën 09.11 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Fatmir, Naser dhe Fidan Lushtaku dhe Ejup Gashi, teksa ju kërkon dokumentacionin e vaksinimit, nga pamjet filmike rezulton se ka marrë prej tyre një kartëmonedhë e cila nuk dallohet nga pamjet filmike për prerjen e saj, por rezulton e qartë se Fatriu i kthen një nga dokumentet dhe pasi e rimerr atë nga shtetasit, merr kartëmonedhën të cilën e hedh para pajisjes skaner; (ii) në orën 10.06 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Valdrin Mehmeti dhe Gramos Garica, ndër te tjera i kërkon të hapin krahun dhe pak momente me vone njeri prej tyre shihet që hyn në kabinë dhe i jep 10 euro. Para se të ndodhë ky veprim, Fatri ndër të tjera i drejtohet me fjalët "*Duhen dy vaksina dhe një kafe.*", duke kërkuar kështu në mënyrë të qartë para të cilat me tej i ka marrë prej tyre, siç rezulton nga pamjet filmike. (iii) në orën 16.26 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit Festim Hoxha, për shkak të mangësive të konstatuara për dokumentet e vaksinimit, ky shtetas i jep 50 euro, të cilat Fatriu i fut poshtë tastierës së kompjuterit dhe menjëherë sapo shtetasi largohet, i merr ato. (iv) në orën 16.33 minuta, gjatë përpunimit në hyrje të shtetasit Enver Hajrizaj, rezulton nga biseda se bashkë më të udhëtojnë edhe tre shtetas të tjerë, ndërkohë që në sistemin TIMs janë regjistruar vetëm Enver Harizaj dhe një shtetas tjetër. Ndërkohe që zhvillojnë bisedën mbi dokumentacionin e mjetit, dokumentacionin e vaksinimit dhe mungesën e hyrje daljeve të këtyre shtetasve në kufi, pamjet filmike kanë fiksuar momentin kur i jepen kartëmonedha prerja e të cilave nuk rezulton në pamjet filmike, dhe pas marrjes së tyre Fatriu i drejtohet me fjalët "*Kaq, kaq mjafton*". (v) në orën 10.27 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasve kosovarë Shpreson Hoti, Besjan Bylykbashi dhe Agim Mazreku, Fatri Braha i kërkon dokumentet e vaksinimit dhe po ashtu, për shkak të mungesës së këtij dokumentacioni që ka njëri prej udhëtareve, Fatriu shihet teksa shkund një dokument/fletë prej nga merr një kartëmonedhe të cilën e vendos para pajisjes skaner dhe i lejon të vijojnë udhëtimin. (vi) Në orën 10.45 minuta, teksa përpunon dokumentacionin e shtetasve Armend Ali dhe Armend Haziri, konstaton sipas bisedës së zhvilluar, mungesë të dozës së dytë të vaksinës dhe shtetasit shihen që vendosin brenda njëres prej pasaportave 10 euro, të cilat ja japin kontrollorit. (vii) Në orën 10.45 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve kosovarë Gramoz Kosumi, Amir Rama dhe Irfan Lugaliu, midis kontrollorit Fatri Braha dhe njërit prej tyre, zhvillohet ndër të tjera kjo bisede: *Fatriu:Qysh me e ba pa vaksina pa gja? Shtetasi KS: Nuk kuptohen fjalet. Fatriu: Ku keni me shku ju?...pa vaksina asht gjynah.....nje dokument Amiri. Amir Rama:...qysh me bo pa vaksina po i ken me bo test...*". Kjo bisedë e zhvilluar mes tyre, shoqërohet me dhënien, sipas pamjeve filmike, të shumës 5 euro, kundrejt tolerimit për të kaluar kufirin në mungesë të dokumenteve që vetë kontrollori iu kishte kërkuar më herët. (vii) në orën 10.57 minuta , pamjet filmike kanë fiksuar momentin e dhënies së shumës 5 euro të pandehurit Fatri Braha nga shtetasit e përpunuar në këtë moment, të cilët sipas sistemit TIMS rezulton të jenë Ymer Kushaj, Criton Balaj, Avni Gashi, Hatip Maliqi dhe Femi Gashi, për të cilët nga biseda e zhvilluar, rezulton se kontrollori ka konstatuar mungesa në dokumentacionin e vaksinimit. (viii) në orën 11.01 minuta të po kësaj datë, teksa përpunon dokumentet e shtetasve, te regjistruar në sistemin TIMS, Florim Krasniqi

dhe Gazmet Aliu, sipas pamjeve filmike rezulton se Fatri Braha, pasi hap dokumentacionin e mjetit merr prej aty 10 euro të cilat i hedh para pajisjes skaner. (ix) në orën 11.43, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasit Alban Berisha, gjatë bisedës Fatriu i thotë që do ti futë makinën për kontroll nga skaner, duke iu drejtuat ndër të tjera, me fjalët : *Fatriu: A ke gjo në makinë me ta bo nji kontroll? Albani: Nuk kam gje. Fatriu : A ke kohë me prit pak ....me shku nëe makin e me prit pak aaaa? A jeni bashkë aaa?. Albani:.....fjale qe nuk kuptohen. Fatriu: Ah ca mafiozinja kontroll të makines atje ne skaner e me prit eee..Fatriu:...me hy atje ne ksaner, po kam frike se ka shume rradhe a kupton.* Ndërkohe që zhvillon këtë bisedë, pamjet filmike kanë fiksuar momentin kur Fatri Braha, ka marrë një kartëmonedhe të cilën e ka hedhur para pajisjes skaner, brenda një prej dokumenteve që ka në verifikim. (xi) në orën 12:23 deri në orën 12:24 po të datës 16.02.2022 Fatri Braha ka përpunuar dokumentet e tre shtetasve maqedonas të cilët udhëtonin me të njëjtin automjet të cilëve, përveç kërkesës për teste Covidi, Fatriu dëgjohet t'i thotë edhe njërit prej tyre që je pa test e ndër të tjera i thotë, " *ti je pa test".....me bjer një 20-teshe mu hajt".* Shtetasit që janë përpunuar në këtë interval kohor dhe që Fatri Braha i kërkon para, sipas sitemit TIMS janë Burim Temaj, Tahir Temaj dhe Shkëlqim Kajdomqaj. (xii) po në datën 16.02.2022 ora 12:26 Fatri Braha gjate kontrollit të një shtetasi, bashkë me dokumentet merr një dosje ngjyrë blu dhe po ashtu dëgjohet që shtetasit kosovar të cilin në një moment e thërret Ardian, ti kërkojë edhe testin kundër covidit, por që ky i fundit rezulton që mos ta disponojë. Punonjësi i policisë Fatri Braha i mban dokumentet derisa shtetasi kosovar rezulton që t'i japë para e pas kësaj punonjësi i policisë e lejon që të vazhdojë udhëtimin. Nga verifikimi në sistemin TIMS në këtë orën rezulton që ai ketë kryer përpunimin e dokumentave të shtetasve kosovarë Ardian Ismaili dhe Amir. (xiii) në orën 12:29 minuta, Fatri Braha ka përpunuar dokumentet e shtetasve shqiptarë Bajram Ismailaja dhe Sonila Karameto dhe nga pamjet filmike rezulton shuma e parave konstatohet e vendosur brenda dokumenteve dhe është parë nga punonjësi i policisë gjatë përpunimit të tyre. (xiv) në orën 12:37 min, të datës 16.02.2022 punonjësi i policisë Fatri Braha është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi tjetër kosovar të cilin e thërret në emër pasi i shikon dokumentin e identifikimit i thotë "***Shyqyr"*** dhe i pyet nëse i kanë vaksinat. Në mangësi të testeve Covid ata i japin Fatriut 5 Euro. Nga verifikimi në sistemin Tims rezulton se në këtë kohë janë përpunuar dokumentet e shtetasit Shyqyri Hasani i cili, në mungesë të testit, i ka dhënë 5-euro. (xv) në orën 15:59 min të datës 16.02.2022, në sportel paraqiten dy shtetas kosovare ku nga biseda kuptohet se janë edhe me fëmijët e tyre të mitur. Njëri prej tyre thërritet nga punonjësi i policisë Fatri Braha me emrin Avdi dhe në vijim ai ju kërkon test anti covid edhe për fëmijët e mitur që janë së bashku me ta. Në mungesë të testeve brenda lejes se qarkullimit te mjetit shtetasi rezulton të ketë futur 5-euro, të cilat Fatriu i hedh para pajisjes skaner dhe menjëherë sa ata largohen e merr. Nga verifikimi në sistem rezulton se shtetasi që ka dhënë këtë shumë parash dhe ka kaluar në kufi në këtë hark kohor, është Avdi Syla. (xvi) në orën 13:25, në sportel paraqitet një familje kosovare e cila jep dokumentet e Identifikimit karta identiteti për verifikim. Në bisedë e sipër me ta dëgjohet që Fatri Braha t'i thotë njërit prej tyre se dokumenti i identifikimit ka dy vjet që i ka skaduar. Pastaj ju thotë që të hapin krahun e të vijë njëri tek kabina, por pas ndërhyrjes se një shtetasi ku i dëgjohet vetëm zëri

jua kthen dokumentet pas disa minutash. Sipas verifikimit të kryer, në këtë harko kohor nuk rezulton të jenë kryer regjistrime në sistemin TIMS për këta dy shtetas nga ky punonjës policie. Po ndërkohe sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike nuk është evidentuar dokumentimi i marrjes së ndonjë shumë parash. (xvii) në orën 13:31 min, të datës 16.02.2022, Fatri Braha është duke përpunuar dokumentet e shtetasit Beqir Mazreku dhe, sipas pamjeve filmike të këqyrura, rezulton se në mesin e dokumenteve të jetë futur një kartëmonedhë 5-euro e cila vendoset para pajisjes skanuese nga punonjësi i policisë. (xviii) në oren 13:42 min të datës 16.02.2022 gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit kosovar Liridon Lugalliu. Fatriu i kërkon vaksinat ose testin kundër Covid-19 të cilin shtetasit nuk e disponojnë testin për këtë arsye Fatri Braha i kërkon drejtuesit të automjetit që të hapë krahun dhe të vijë të paraqitet në kabinë duke i mbajtur njëkohësisht dokumentet e duke i kaluar në krahun tjetër të tavolinës së punës. Ndërkohë që shtetasi është duke hapur krahun me automjet, sipas pamjeve filmike te këqyrura, referohet se në kabine vjen dhe ulet një koleg tjetër i Fatriu i cili e zëvendëson atë në shërbim dhe që është verifikuar të jetë kontrollori Dashnor Braha, ndërsa Fatri Braha vijon duke qëndruar në këmbë po brenda në kabinë. Në momentin që vjen, shtetasi i jep 5 euro dhe vetëm atëherë Fatriu ja jep dokumentet për të vijuar udhëtimin ne Shqipëri. Nga verifikimi ne sistemin TIMS rezulton se shtetasit që janë përpunuar në këtë ore janë Liridon Llugaliu dhe Shkurtesa Llugaliu, ndërsa fëmija i vogël për të cilin flitet gjatë bisedës nuk është regjistruar në sistemin TIMS. Në vijim për disa momente punonjësi i policisë Fatri Braha zëvendësohet në kabinë nga kolegu tij Dashnor Braha. (xix) në orën 16:13 min, po të datës 16.02.2022, punonjësi i policisë Fatri Braha merr në sportel dokumentet e tre shtetasve kosovare për verifikim. Konstatohet se kalon në skaner vetëm njërin dokument dhe dy të tjerë nuk i regjistron, gjatë kësaj kohe dëgjohet t'ju thotë se për fëmijën mbi gjashtë vjeç duhet testi i Covid-it, pasi kështu kanë urdhrin e marrë nga eprorët. Në vijim konstatohet se shtetasi kosovar i fut brenda pasaportës një kartëmonedhë 20 euro të cilën ja jep kontrollorit. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në këtë interval kohor Fatri Braha ka përpunuar dokumentet e shtetasit Bajram Sinani, ndërsa dy shtetasit e tjerë që kanë qenë së bashku me të nuk janë regjistruar në sistemin TIMS. (xx) në orën 16:45, po të datës 16.02.2022, Fatri Braha rezulton se ka marrë nga një tjetër shtetas një kartëmonedhë 5 euro, të cilën punonjësi i policisë e hedh para pajisjes skaner por nuk konstatohet të jetë kryer veprime regjistruese ose verifikuese në sistemin TIMS nga ku mund të bëhej edhe identifikimi i shtetasit mitëdhënës. (xxi) në orën 17:53, po të datës 16.02.2022 min në sportel paraqitet një shtetas tjetër dhe dorëzon dokumentet, ku brenda dokumentit konstatohet të ketë futur 10 euro, të cilat merren nga punonjësi i policisë Fatri Braha dhe ndërkohe kalohet në pajisjen skaner një kartë identiteti shqiptare. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton është regjistruar dokumenti i shtetasit Flamur Kapaj. I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi Flamur Kapaj, i cili ndër të tjera, lidhur me këtë fakt ka deklaruar se :"....*për rastin që na ka ndodhur në datë 16.02.2022, po është e vërtetë që edhe kam dhënë edhe ndonjë prerje euro, kartëmonedha ë vogla 5-çe ose, por meqenëse unë e bëj shpesh atë rrugë, dhe për të mos na krijuar vonesa ka raste që i le dhe ndonjë kartëmonedhë të vogël të pinë kafe*". (xxii) në orën 19:20 Fatri Braha vijon të marrë në përpunim dokumente të shtetasve të huaj ku ndërkohe, sipas

procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, konstatohet se dëgjohet zëri i një gruaje të cilën e pyet nëse ka bërë test ose vaksinë dhe në mungesë të testit kundër Covid dhe të vaksinës shtetasja i vendos brenda dokumentit pasaportë një kartëmonedhë euro. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se në këtë orë janë përpunuar dokumentet e shtetaseve kosovarë Festina Bajcinica dhe Klatrina Berisha, (xxiii) në orën 19:21 min paraqesin dokumentet edhe tre shtetas të tjerë dhe punonjësi i policisë Fatri Braha i pyet sesa veta janë, ndërsa ata i përgjigjen 3. Nga pamjet filmike rezulton se pavarësisht se ka në dorë dokumentet (pasaportat e tre personave) ai kalon në sistem për regjistrim vetëm njërën prej tyre dhe po ashtu konstatohet se merr një kartëmonedhe për të cilën nuk dallohet prerja, të cilën e hedh poshtë në drejtim të monitorit të kompjuterit Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se nuk është hedhur në sistem asnjë nga dokumentet e tre shtetasve kosovarë, të cilët sipas pamjeve filmike kanë kaluar kufirin në këtë orë. (xxiv) në orën 19:27 min vijon me tej me pasagjerët e radhës të cilët i pyet sesa vetë janë. Ata i përgjigjen 4 por nga verifikimi në sistemin TIMS, rezulton se janë regjistruar vetëm dy shtetas kosovare e konkretisht Lumni Menxhiqi dhe Arjanit Neziri. Vijon duke iu kërkuar dokumentacion për vaksinat dhe ndërkohe shihet të hyjë nga dera një shtetas, dokumentet e të cilit i kishte mbajtur me herët ne anë të tavolinës së punës, dhe pasi i lë diçka sipër tavolinës, terheq me dorë dokumentin e mjetit të tij, ndërkohë që Fatri Braha e falënderon. Pra, në datë 16.02.2022, nga të gjitha rastet e pasqyruara për të cilat ka kryer përpunimin e dokumentacionit në pikën hyrëse, rezulton nga pamjet filmike, komunikimet e regjistruar audio dhe të dhënat e marra në sistemin TIMS, se punonjësi i policisë Fatri Braha, në 23 prej këtyre rasteve ka kërkuar dhe/ose marrë para (prerje të ndryshme euro) nga shtetasit në funksion të tolerimit të kalimit të tyre pa dokumentacion të plotë identifikimi, vaksinimi ose kundrejt mos regjistrimit të tyre rregullisht ne systemin TIMS.

721. *Së katërti,* nga pamjet filmike, procesverbali i transkriptimit të komunikimeve dhe verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se punonjësi i policisë në shërbim Fatri Braha në datë 24.02.2022, në 9 raste, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve në pikën hyrëse tëkalimit kufitar, ka kërkuar dhe marrë nga shtetasit shuma të ndryshme parash. Konkretisht në orën 10.35 minuta, sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio provohet se ka kërkuar dhe marre nga shtetasi Ahemt Berisha 5 euro, kundrejt mungesës së dokumentacionit të vaksinimit. Në orën 10.39 minuta, ka marrë për të njëjtin shkak nga shtetasi Astrit Dragusha shumën prej 10 euro. Në orën 10.47 minuta, po për të njëjtin shkak merr nga shtetasi Liman Qenaj 20 euro. Në orën 09.51 minuta, në mungesë të dokumentacionit të kërkuar "autorizim mjeti" merr nga shtetasi Artan Dobroshi 5 euro. Në orën 09.58 minuta, kërkon dhe merr nga shtetasit Arlind Jashari dhe Jon Haliti shumat 10 dhe 5 euro, dhe ndërkohe dëgjohet të zhvillohet mes tyre kjo bisedë: *Fatriu: Vaksinat, qysh i keni? Qysh me ja bo ? Kush ësht ky? ... Degjove!?....veç po ta....Hajt tu rrit nera.* Dhe ndërkohe shihet ne pamjet filmike teksa zgjat dorën nga sporteli dhe merr nje letër apo dokument të palosur, cilin kur e hap në mes të saj është një kartëmonedhë me ngjyrë rozë në kafe, prerje 10 euro. Në orën 10.16 minuta merr nga shtetasi Edi Desku shumën 50 euro kundrejt mos regjistrimit në sistem të pasagjerit që udhëtonte me këtë shtetas. Në orën 11.49 minuta, merr 50 euro nga shtetasi Agron Frrokaj ndërsa në orën 12.26 minuta shihet teksa

merr nga shtetasi Armend Ramizi, për mungesë të dokumentacionit të vaksinimit, shumën prej 10 euro.

722. Sa më sipër, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *08.02.2022, 12.02.2022, 16.02.2022 dhe 24.02.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri Fatri Braha, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pa dokumente të plota lidhur me udhëtimin, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të saj në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

723. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë si dhe marrjes së shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion. Marrja dhe pranimi i shumave të parave (euro) të dhëna nga shtetasit, në një rast dhe konkretisht në atë të datës 08.02.2022, rezulton se është kryer nga ky i pandehur, në bashkëpunim me kolegun e tij Arben Goçi, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Fatri Braha, në bashkëpunim me kolegun e tij Arben Goçi në një prej episodeve të datës 08.02.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Fatri Braha

724. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Fatri Braha, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 08.02.2022) në bashkëpunim me të pandehurin Arben Goçi, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht e vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre. Po ashtu në një prej këtyre episodeve, siç rezultoi më sipër, e pandehura ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Arben Goçi, duke ndikuar secili prej tyre, në masë të ndryshme, në realizimin e qëllimit të kundërligjshëm, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

725. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Fatri Braha, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

726. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Braha përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Fatri Braha ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

727. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Braha është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është*

unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal..." si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Braha, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

728. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Fatri Braha**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Arben Goçi, në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 08.02.2022, ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të kryera në datat 08.02.2022, 16.02.2022 dhe 24.02.2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit GËZIM DURAKU

729. Lidhur me të pandehurin **Gëzim Duraku**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datave 12.02.2022,13.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022 dhe 28.02.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Gëzim Duraku, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, në ngjarjet e datave 12.02.2022, 13.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022 dhe 28.02.2022. Arrihet ky konkluzion pasi:

730. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 12.02.2022 kontrollori Gëzim Duraku, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio se kontrollori gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve, ka kërkuar dhe marrë shuma parash në funksion të tolerimit të kalimit të kufirit, përpos problemeve të konstatuara prej tij për mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Konkretisht, në orën 20.08 minuta, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasit Endrit Hashani, sipas verifikimit në sistemin TIMS, ku së bashku me të udhëtonin edhe shtetaset Agnesa Siminica dhe Rezart Hasanaj, ka marrë prej tyre 5 euro. Në orën 20.10 minuta, teksa përpunon dokumentacionin e shtetasit Pjetër Gjergji i kërkon autorizimin e mjetit, dhe ndërkohe zhvillon me të këtë bisedë:

Gëzimi: Makinën e ke me autorizim a me qira aaa...Eduart Vukaj. Pjetër:... nuk kuptohet. Gëzimi: Eduarti, Eduart Vukaj në rregull qenka. Pjetër: vaksinën e kam. Gëzimi: E ke në rregull, po autorizim? Pjetër: Se kam për zotin. Gëzimi: Pse? Pjetër: nuk e kam..... Gëzimi: Po ke me kalu në kufi..... Sa për kafe or ti... Ta prift zoti mbarë. Ndërkohë që zhvillon këtë bisedë, ku nëpërmjet fjalës "kafe" rezulton e qartë kërkimi i mitës, hap dokumentet e shtetasit dhe merr prej aty një kartëmonedhë 20 euro. Në orën 20.54 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit Patrik Thaqi, i kërkon dokumentacionin e vaksinimit dhe dëgjohet ti thotë, ndër të tjera: *Gëzimi: Hap krahun pastaj të vish ti maresh." Gëzimi: Se a e di se kanë kaluar shumë për ndjekje penale këta që kanë testin në celular se nuk lejohet, testi duhet me vule origjinale, hape krahun".* Pas dy minutash shtetasi kosovar Patrik Thaqi futet brenda në kabinë dhe Gëzimi i jep dokumentet duke i thënë "*meri çato dhe ta bëftë zoti mbarë", "jo në telefon se është bërë problem*", dhe në këtë moment vendos një kartëmonedhe euro mbi një shtresë ngjyrë të kuqe mbi tavolinë. Në orën 20.58 minuta, teksa përpunon dokumentacionin e shtetasit Halim Kryeziu, konstatohet sipas pamjeve filmike se hap një dokument, libreze mjeti, dhe merr disa kartëmonedha, dhe ndërkohe i drejtohet me fjalët *: Gëzimi: janë shumë or ti janë shumë ti ke fëmijë te shtëpia nuk shkon ajo punë....". Në vijim palos kartëmonedhat, i vendos në librezën e automjetit dhe ja kthen këtij shtetasi duke përsëritur: Gëzimi: nuk shkon ajo punë dhe unë kam fëmijë te shtëpia dhe ti", "veç për një kafe",* duke mbajtur kështu vetëm një kartëmonedhë 10 euro. Në orën 21:09 minuta teksa përpunon dokumentet e një shtetasi i cili sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS ka rezultuar të jetë shtetasi Kushtrim Kryeziu, i drejtohet me fjalët "*Nga po shkon o Kushtrim vaksinën e ke bërë apo jo", "Autorizim ke bërë apo jo", "pa autorizim nuk lejohet", "a je i Prizrenit a i Gjilanit fut një kafe këtu"*, dhe shihet ndërkohë duke i zgjatur librezën e mjetit e duke i thënë po ashtu: "*...fut një kafe këtu me na respektu dhe hec, mos ta ndje*". Pra pavarësisht se nuk përcaktohet shuma e marrë, nga komunikime dhe veprimet e të pandehurit rezulton qartë kërkimi i mitës nga ky shtetas.

731. *Së dyti*, në datë 13.02.2022, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, rezulton se në orën 08.10 minuta, teksa përpunon dokumentacionin e një shtetasi, i kërkon atij kafe dhe shtetasi ja jep duke i futur në lejen e qarkullimit një kartëmonedhë 5 euro. Ndërkohë që ndodhin këto veprime, ndër të tjera, kërkimi rezulton nga fjalët me të cilat ai i drejtohet qytetarit dhe veprimet që pasojnë këto fjalë dhe konkretisht: *Gëzimi: Mirë pa problem....Për kafe a keni punu të paktën. Ahahah shife am librezën. Shtetasi: Për kafe. Gëzimi: Po.* Në orën 08.22 minuta, është regjistruar një bisedë mes tij dhe një kolegu, por që nuk rezulton të jetë referuar si i identifikuar nga procesverbali i këqyrjes së pamjeve dhe transkriptimit të regjistrimit audio me emrin Hasan Kovaçi, ku ata bisedojnë në lidhje me "kalim mallrash dhe shtetasish". Sipas bisedës, ndër te tjera rezulton se kolegu i tregon një ngjarje që i ka ndodhur atij duke iu drejtuar me fjalët : *Gëzimi: Po se imagjinova mor. Hasani: Ooo ti o ekstrem, kalon komplet me kontrabandë ne nuk e dimë me çfarë, nuk o puna jonë. Gëzimi: ...e kam kalu tha unë . Hasani: Po shko mor knej se s'ka kurrë n'jeten teme. Hasani: E di u kry puna....kur po thu ti unë e kam kalu. Gëzimi: eee e di çdo me thane qe ne spo e dimë ...po shkoj der tek i madhi po shkoj..Ik bre budall. Hasani: S'kena shans me e nal or ti ...nje sekond bre.*

Gëzimi: Tre muaj ka bërë burg Hasani për qito lojansh kështu. Hasani: Po sun i thom jo o shok. Gëzimi:...me rast kondrabandë nuk ka shnas në botë edhe nëse ta hedh dogana. Hasani:...ka kalu qetë Bilbil Veseli. Gëzimi: Kur e ka kalu mor. Hasani: E kan kthe e kan kalu të Kosova. Gëzimi: Po ska shans mo Gëzim. Më tëj, pas disa momentesh mes tyre transkriptohet biseda si vijon: *Gëzimi: Unë duhet me e lënë e mo na del ndonjë llaf e na e bën të vështir. Hasani: U tha u krye. Gëzimi: Po fiki këto. Hasani: Po fiki. Gëzimi: Der në ça ore?.Hasani: Der në 8:20.... Nga posht nga posht ... çaty. Gëzimi: duhet me i bë dhe nja tre të tjera...një 800.. jo nuk duhet me imagjinu se është problem me...Hasani: Kush? Po s'imagjinoj or ti ooo ekstrem. Gëzimi:... me kontrabandë u pa puna jonë e keni praktik nuk gjendet kund në botë... u kry puna. Hasani: ... Dhe unë e kam provue...Gëzimi: Ej e di çdo me thënë. Hasani: As unë nuk e di unë der te i madhi më çon.... Gëzimi: Unë me e dit se ka dalë gjak çatenaj thonë ik. Hasani: Me ke flet, se unë e di se kam bë tre muj burg ,tre muj burg, se nuk i them jo o shok se di rreshtin unë po se hyn në parkexh me kontrabandë ky është shanc i madh me jetë me jetë ta jap. Gëzimi: Edhe se ta hedh dogana. Hasani: Po.* Nga kjo bisedë dhe debati i zhvilluar mes dy punonjësve të policisë, rezulton se ata bisedojnë mbi veprimtari mallrash kontrabandë që kalojnë dhe kryhen në atë pikë kufitare për të cilën ata janë në dijeni por nuk referohet një ngjarje konkrete e cila të mund të vlerësohet në raport me elementet e figurës së veprës penale për të cilën procedohet apo të ndonjë vepre tjetër penale. Për më tepër që ky komunikim nuk i është nënshtruar asnjë verifikimi apo hetimi te mëtejshëm, përveç regjistrimit të bisedës mes kolegëve, nga të cilët Hasan Kovaçi nuk është marrë i pandehur në kuadër të këtij procedimi penal.

732. *Së treti*, në datë 19.02.2022, Gëzim Duraku gjatë shërbimit, është fiksuar nga pamjet filmike në dy raste duke marrë para nga shtetasit dhe konkretisht, në orën 13.22 minuta kërkon "kafe" (*siç i drejtohet shtetasit në komunikim*) dhe merr nga shtetasi Alban Mici 5 euro. Në procesverbalin e këqyrjes referohet se kjo ngjarje zhvillohet në bashkëpunim me të pandehurën tjetër Vojsava Selmani por nuk është evidentuar nga këqyrja e pamjeve filmike se cilat janë veprimet konkrete të saj në realizimin e qëllimit kriminal, përveç fjalëve të Vojsavës që i drejtohet kolegut duke i thënë "*Çfarë thoshte ai*" dhe po ashtu referohet se Gëzimi shumën 5 euro e ka marrë jashtë kabinës ku është Vojsava dhe kur ka hyrë aty ka vendosur një kartëmonedhë 5 euro në tavolinë. Në orën 13.53 të kësaj datë, Gëzim Duraku shihet sërish të marrë 5 euro nga një shtetas për të cilin konstatohet mungesë e dokumentacionit të vaksinimit dhe po ashtu, nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se nuk e ka regjistruar hyrjen e tij në sistem.

733. *Së katërti*, në datë 23.02.2022 janë regjistruar 15 nga episodet e referuar në faktin penal, në të cilat punonjësi i policisë në shërbim Gëzim Duraku, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve, kërkon dhe marr shuma parash (euro) nga shtetasit për shkak të mungesës apo mangësive të dokumentacionit të tyre. Këto fakte rezultojnë të qarta nga pamjet filmike që dokumentojnë veprimet e tij dhe të shtetasve mitëdhënës, nga komunikimi i regjistruar audio si dhe nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS. Konkretisht në orën 11.19 minuta, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasit Toni Jovchevski ka marrë nga ky i fundit 10 euro, për shkak të mos regjistrimit të bashkudhëtarit të tij në sistem. Në orën 13.46 minuta ka marrë nga një shtetas

me emrin "Paulo" siç i drejtohet, një shumë 5 euro dhe ndërkohe rezulton se nuk e ka regjistruar kalimin e tij në sistem. Në orën 13.18 minuta, ka marrë një shumë eurosh që nuk duken qartë sipas procesverbalit të këqyrjes së regjistrimit video, nga shtetasi Dardan Aliu, përkundrejt lejimit të udhëtimit pa dokumentacion mbi vaksinimin. Në orën 13.22 dokumentohet e njëjta veprimtari e tij, ku merr një shumë parash që nuk mund të përcaktohen nga pamjet, përkundrejt lejimit të kalimit të nje mjeti me rimorkio por pa dokumentacion por, për shkak të mos regjistrimit në sistem, nuk mund të përcaktohet mitëdhënësi. Në orën 15.19 minuta, sipas pamjeve filmike, ka marrë një shumë prej 2000 lekësh nga një shtetasi si paraqitur ne sportel, të cilat ky i fundit ja ka dhënë së bashku me dokumentet. Shumën kontrollori Gëzim Duraku e merr nga dokumentet dhe e vendos poshtë tastierës së kompjuterit dhe ndërkohë i kthen shtetasit dokumentet dhe e lejon të kalojë, pa kryer veprime regjistrimit të tij në sistem. Në orën 15 e 27 minuta fiksohet duke marrë 10 euro nga një shtetas në sportel duke e lejuar të udhëtojë përkundrejt mungesës së dokumentacionit të vaksinimit. Në orën 16.08 minuta, duke kontrolluar dokumentet e një shtetasi, i hap ato dhe merr një kartëmonedhë, duke ia kthyer serish dhe duke e lejuar të udhëtoje, por nuk rezulton e qartë shuma si dhe mitëdhënësi pasi nuk ka të dhëna nga sistemi TIMS. Në orën 17.34 minuta sërish gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Betim Sinani, mes dokumenteve merr një kartëmonedhë euro dhe e lejon te kalojë me mungesë të dokumenteve të vaksinimit. Në orën 17.50 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Fatlind Morina dhe Mybegjel Rashica, konstatohet se ai merr nga dokumentet e mjetit te tyre një kartëmonedhë euro. Në orën 17.45 minuta sërish merr një shumë 5 euro nga një shtetas, përkundrejt mos regjistrimit të tij në sistemin IMTS. Në orën 17.54 minuta të po kësaj dite, sipas pamjeve filmike shihet teksa merr 10 euro, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Erolind Muqja, shumë të cilën pasi e merr e vendos përballë skanerit dhe më pas e merr dhe e fut ne xhepin e xhupit të tij. Në orën 17.58 minuta, sipas pamjeve filmike rezulton se Gëzim Duraku shihet teksa merr, pasi hap dokumentet që i dorëzohen nga udhëtarët ne sportel, shumën 5 euro në një rast dhe shumën 10 euro në një rast të dytë. Po kështu, në orën 18.00 rezulton ti ketë marrë shtetasit që paraqitet në sportel, verifikuar në sistemin TIMS si Orest Halili, një kartëmonedhë 500 lekë. Në orën 18.04 minuta, duke përpunuar dokumentet e shtetasit Eruoland Hodaj i drejtohet ndër te tjera me fjalët " *një kafe, na e qet, eee..*" dhe pas këtyre fjalëve vijon kontrollin e dokumenteve por nuk duket dhënia e ndonjë shumë parash, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike. Në orën 18.16 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentet e shtetasit Artan Gashi, ndër të tjera, zhvillon këtë bisedë: *Gezimi :...Hajde një herë nga një kafe një herë...hajde na qit nga një kafe një herë nga një birre një here...Futi ç'tu ...Hajde një herë...hajde një herë...Shtetasi :Do një birrë ? Gezimi: Po or ti! Shtetasi: Se pi birrën une, or ti...Gezimi:Vere ç'e ktu dhe i drejton librezen e mjeti.* Gjatë kësaj bisede, sipas pamjeve filmike shihet teksa shtetasi merr librezën dhe i fut një kartëmonedhë dhe ja jep përsëri kontrollorit. Kontrollori pasi merr dokumentin nga shtetasi e hap atë dhe prej saj nxjerr një kartëmonedhën 50 euro dhe e vendos atë përpara aparatit të skanimit të dokumenteve dhe i thotë shtetasit në sportel "*...Ej, a i dhe me qef, apo jo? ...se ma dhe si me nerva ai ...", dhe pas këtyre fjalëve* i jep dokumentet shtetasit, merr kartëmonedhën që e ka lënë aty dhe e fut në xhepin e djathtë të

xhupit. Në orën 13.56 minuta, duke përpunuar dokumentet e një shtetasi të cili i drejtohet me emrin Leoind, zhvillon me të këtë bisedë: *Gëzimi: O Labinot. A i ke vaksinat? Shtetasi: Po. Gëzimi: Autorizim për makinën? Shtetasi: Po. Gëzimi: Po, po. Shtetasi: Ok. Gëzimi: Në rregull...edhe atij i ka mbaru regjistrimi....a e ka? Shtetasi: E ka. Gëzimi: Ku e ka?...S'lejohet me dokument të mbarum s'lejohet...nuk i merr sistemi...ku do shkoni?...Gëzimi:....qite kerrin atje edhe hajde këtu.* Pas këtij dialogu, sipas pamjeve filmike të pasqyruara në procesverbalin këqyrjes, Gëzimi i mban dokumentet dhe i kalon nga ana tjetër e tavolinës ndërsa shtetasi hyn nga dera e kabinës dhe në këtë kohë Gëzim Duraku i jep dokumentet ndërsa ai dallohet t'i japë para ku ky i fundit e fut në xhep, por nuk mund të përcaktohet prerja e kartëmonedhës. Referohet se në këtë ngjarje, është prezent në kabinë edhe punonjësi i policisë Arben Kastrati por ndërkohe nuk evidentohen dhe rezultojnë veprime të tij në funksion të realizimit të këtij veprimi, të kryer nga kolegu i tij në shërbim Gëzim Duraku dhe në këto kushte, rezulton e pamundur të përcaktohet dhe vlerësohet se si ai mund të këtë marrë pjesë, se bashku me të pandehurin Gëzim Duraku, në realizimin e qëllimit kriminal në lidhje me këtë episod. Sipas të dhënave të sistemit TIMS shtetasi që ka dhënë para dhe ka qenë në verifikim në këtë hark kohor rezulton te jetë Leonit Hoxha.

734. *Së pesti,* në datë *27.*02.2022, ndërsa është në shërbim i pandehuri Gëzim Duraku rezulton se në dy episode ka kërkuar dhe marrë para (euro) nga shtetasit e përpunuar prej tij në pikën hyrëse. Konkretisht, në orën 09.40 minuta, teksa përpunon kartat e identitetit të dy shtetasve, pasi ja kthen ato shtetasit në sportel, ky i fundit u fut në xhep dhe nxjerr prej andej kartëmonedha euro të cilat ja lën në tavolinë kontrollorit ndërsa ky i fundit zgjat dorën, i merr dhe i fut në xhepin e tij. Në orën 12.25 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit, i cili sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS rezulton të jetë shtetasi Osman Hoxha, konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit. Nga pamjet filmike rezulton se i tregon tre opsione, duke i renditur si opsion të tretë atë që, sipas kontrollorit është në dorën e tij. Nuk është fiksuar nga pamjet dhe regjistrimi audio marrja e ndonjë shumë parash por rezulton qartë kërkimi, nga tërësia e veprimeve dhe fjalëve që ai ju drejton në komunikim me shtetasit. Në vijim, në orën 13.57 minuta, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrje së tyre, referohet se në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë Gëzim Duraku. Sipas pamjeve filmike duket se në kabinë futet një punonjës tjetër policie i identifikuar si Bedri Duraku i cili e zëvendëson kontrollorin Gëzim Duraku për një periudhë kohe të shkurtër. Sipas pamjeve filmike, por pa regjistrim audio, duket kontrollori Gëzim Duraku i cili pasi i liron postin e punës inspektori Bedri Durakut, del pas monitorit të kompjuterit dhe fut dorën e djathtë në xhepin e djathtë të tij duke nxjerrë një tufë kartëmonedhash euro dhe i hedh në shesh, poshtë këmbëve të tij dhe duke u përkulur në gjunjë fillon i merr ato një nga një duke i palosur dhe numëruar i fut përsëri në xhepin e djathtë. Më pas afrohet, merr telefonin mbi tavolinë dhe largohet nga kabina. Gjatë kohës që kontrollori Gëzim Duraku i nxjerr dhe numëron kartëmonedhat e ndryshme që i kishte grumbulluar më parë në xhepin e tij, është i pranishëm edhe punonjësi i policisë inspektor Bedri Duraku i cili e

zëvendëson atë në shërbim. Nuk rezulton që në këto veprime të jetë konstatuar ndonjë veprim i përbashkët i tyre për kërkim, marrje apo pranim mite nga ndonjë shtetas.

735. Së gjashti, në datë 28.02.2022, gjatë shërbimit të kontrollorit Gëzim Duraku, janë evidentuar dhe provuar një rast te marrjes së parave nga shtetasit që përpunon në sportel dhe konkretisht : Në orën 21.09 minuta, .sipas pamjeve filmike është regjistruar kontrollor Gëzim Duraku duke i kërkuar shtetasit kosovar Marol Demiri para pasi konstaton se nuk ka autorizim për mjetin dhe po ashtu rezulton nga pamjet filmike të këqyrura se ka marrë prej tij shumën 20 euro. Në orën 21.22 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentacionin e një shtetasi, zhvillon me të nje bisedë, ku ndër të tjera i thotë : *Gëzimi: E kie të ...rregull makinën ej... e kie të rregull...ta regullova e ke pa merak, kudo me shku e kie.... sikur të jeshë vetë në të (keshtu dëgjohet)... ta futa, ta futa me numër praktike...për veten tate ta keshe ...ta dishë... Shtetasi: Muhametin e kam djalë tezje. Gëzimi: Muhametin...! Djale tezje ëëë ?...Me nusen e Muhametit une jam...I kam nënat motra...(qesh) . Shtetasi: Hajt shenet...Gëzimi: Njatjeta.* Përveç kësaj bisede, nuk rezulton ga provat ndonjë veprim për kërkim apo marrje mite në raport me komunikimin dhe veprimet e kryera gjatë përpunimit të dokumenteve të këtij shtetasi. Në vijim, në orën 21.35 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasve, të cilët referohen si shtetas belgë, i thotë atyre se këto dokumente nuk njiheshin nga sistemi. Sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS rezulton se në këtë hark kohor janë përpunuar dokumentet e shtetasve Taulant dhe Argjend Pira, por në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike nuk evidentohet qartësisht kërkimi apo marrja e ndonjë shumë parash nga këta shtetas.

736. Në lidhje me faktet e parashtruara për të pandehurin **Gëzim Duraku**, përveç sa më sipër u provua, referohet në faktin objekt akuze edhe në lidhje me ngjarjen e kallëzuar nga shtetasi Nikollë Alija i cili ka bërë kallëzim penal për veprime korruptive të punonjësve të policisë kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë duke parashtruar në kallëzim se *në datë 28.10.2020, rreth orës 12:00, së bashku me dy djemtë e tij dhe djalin e baxhanakut kanë qenë duke u kthyer nga Kosova për në Shqipëri nëpërmjet P.K.K Morinë dhe në kohën kur kanë qenë duke kryer procedurat e kontrollit në hyrje të Shqipërisë, nga punonjësit e policisë së P.K.K Morinë i është kërkuar që t'i nënshtrohen kontrollit të veçantë në vijën e dytë së bashku me bagazhet e tyre. Sipas kallëzuesit, njëri prej punonjësve që ka kryer kontrollin e personave dhe të bagazheve, i ka lejuar që të vazhdonin me procedurat e mëtejshme, pasi nuk kishin probleme, ndërsa në këtë kohë, afër tyre është afruar një tjetër punonjës policie, i cili ka urdhëruar rikontroll të personave, të bagazheve dhe të automjetit. Ky punonjës policie, pasi ka konstatuar se në automjetin e tyre gjendeshin disa lule artificiale, me vlerë monetare të vogël, ka filluar të ushtrojë presion, po ashtu duke i thënë se ka probleme për kalimin e kufirit, pasi ndaj tij në sistemin Tims ekzistonte një ekspuls, ndërkohe që shtetasi Nikollë Alija e ka sqaruar se ky ekspuls e ka humbur vlefshmërinë e tij që në vitin 2016, por pavarësisht sqarimeve, punonjësi i policisë ka këmbëngulur se që ta lejonte të kalonte, duhej të paguante me doemos diçka. Në këto rrethana të imponuara, shtetasi Nikollë Alija kallëzon faktin se është detyruar t'i japë 10 euro, por duke parë shumën e tyre, punonjësi i policisë ka mbetur i pakënaqur. Shtetasi Nikollë Alija i ka nxjerrë dhe një kartëmonedhë dhjetëmijë lekëshe, por që sipas tij, punonjësi i policisë nuk i*

ka marrë. Në lidhje me rastin konkret të kallëzuesit Nikollë Alija, sipas verifikimeve të kryera për të parë se cilët punonjës policie kanë qenë të planizuar me shërbim në P.K.K Morinë dhe ata që kanë marrë pjesë në veprimet kontrolluese të vijës së dytë me këtë shtetas, ka rezultuar se kallëzuesi Nikoll Alija është regjistruar në hyrje të Shqipërisë së bashku me shtetasit Ani Alija, Kevin Alija dhe Ramazan Musi në orën 11:52 min dhe janë përpunuar në sistem nga përdoruesi "BRAHAD" (dashnor Braha). Po kështu rezulton se shtetasi Nikollë Alija është kaluar për kontroll në vijën e dytë dhe është përpunuar nga "DURAKUG" (Gëzim Duraku). Nga verifikimet e mëtejshme ka rezultuar se në datë 28.10.2020 në intervalin kohor ora 08:0 deri në orën 20:00 kanë qenë të planizuar me shërbim punonjësit e policisë, Ideal Lami me detyrë përgjegjës turni, Azem Nerguti, Kapllan Dogjani, Dashnor Braha, Gëzim Beqiraj dhe Arben Kastrati me detyrë trup shërbimi fizik dhe Ermal Muça, Armelino Bendaj, Avni Tershalla dhe Ardit Shira, me detyrë trup shërbimi.

737. Gjykatës i rezulton se veprimet për verifikimin e faktit të kallëzuar nga shtetasi Nikollë Alija janë kufizuar vetëm në sa u përshkrua më sipër, duke mos u kryer hetime të mëtejshme për të provuar përtej çdo dyshimi te arsyeshëm se fakti ka ndodhur dhe se cili prej punonjësve që, sipas të dhënave, rezultojnë se kanë qenë në shërbim në turnin kur ka ndodhur ngjarja, është personi që ka kërkuar dhe ka marrë para nga shtetasi Nikollë Alija. Në këto kushte, kur ky fakt rezulton vetëm deri në një shkalë verifikimi, pa vijuar me tej në drejtim të individualizimit të subjektit që mund të këtë kryer veprimet që referohen, ky fakt penal nuk mund të përcaktohet saktësisht se nga cili prej te pandehurve është kryer, e për pasojë, nuk mund të përcaktohet dhe konkludohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, edhe se është kryer nga i pandehuri Gëzim Duraku.

738. Po ashtu, në faktin e parashtruara nga Prokuroria referohen të dhëna për komunikime telefonike të tij (nga numri i vendosur në përgjim 0694106325), të zhvilluara në datat 22.01.2021, 24.01.2021, me dy shtetas. Konkretisht në datë 22.01.2021 dhe 24.01.2021 rezulton se ai komunikon ne telefonin me shtetasin që përdor numrin 0683270741, ku nga konteksti i bisedës komunikojnë në lidhje me kalimin në kufi pa u regjistruar të një shtetasi. Ka rezultuar se bashkëbiseduesi është shtetasi Alban Uku, i cili i pyetur në lidhje me këtë bisedë, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, në datë 25.05.2022, ka deklaruar ndër të tjera:"...*Po unë e kam kryer këtë bisedë dhe me thënë të drejtën unë për shkak se isha duke kryer procedurat e fejesës në Kukës kisha menduar që të shkoja deri në Kosovë që të respektoja familjaret e gruas dhe familjen time me një drekë, por për shkak se nuk e kisha të sigurt nëse do të shkoja nuk e kisha diskutuar me eproret, këtë edhe për shkak se ceremonia e fejesës është diçka familjare dhe nuk kam dëshirë që të merrej vesh. Unë thjesht e kisha në plan që të shkoja, por në të vërtetë nuk kam shkuar dhe nuk kam udhëtuar për në Kosovë. Dua të sqaroj se kjo bisedë me Gëzim Durakun është kryer edhe për shkak se unë si punonjës policie i ri në atë moment nuk kisha dijeni që për të udhëtuar 24 orë në Kosove duhej marrë leje direkt nga eprori dhe udhëton lirshëm. Jam informuar po atë ditë dhe e kisha lënë që nëse do të shkoja në Kosovë do njoftoja eprorin tim për të marrë leje por në të vërtetë nuk ka m shkuar.*

739. Lidhur me këtë fakt, gjykata konstaton se midis të pandehurit Gëzim Duraku dhe shtetasit Alban Uku kryhet një bisedë për kalim pa u regjistruar të këtij t e fundit ose personave të njohur te tij, në kufirin dalës, në drejtim të Kosovës, por nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera hetimore për të vërtetuar nëse ky fakt ka ndodhur dhe po ashtu nëse punonjësi i policisë Gëzim Duraku ka qenë në shërbim në ditën që referon komunikimi dhe ka kryer veprime të kundërligjshme në përmbushje të qëllimit të kësaj bisede që ai zhvillon me shtetasin Alban Uku. Në raport me akuzën e ngritur ndaj të pandehurit Gëzim Duraku, konkretisht për veprën penale të parashikuar nga neni 251/1 i Kodit Penal, nuk referohet nga Prokuroria, dhe po ashtu nuk konstatohet nga gjykata, në këtë fakt, elemente të anës objektive të veprës penale objekt akuze, të konkretizuar në kërkimin, marrje ose pranimin e ndonjë përfitimit të kundërligjshëm nga i pandehuri Gëzim Duraku.

740. Sa më sipër u analizua, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 12.02.2022,13.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022 dhe 28.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Gëzim Duraku, ka kërkuar dhe/ose ka marrë apo pranuar para në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit për shtetasit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

741. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Gëzim Duraku është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Gëzim Duraku në veprimet e konkretizuara për kërkimin, marrjen ose pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

742. Në këtë konkluzion gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të

veprës penale. Në këtë këndvështrim gjykata vlerëson se pranua në tre raste, sipas procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, e kolegeve të tij ndërsa ai kryen shërbimin dhe regjistrohen rastet e mitëmarrës, nuk provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm bashkëpunimin e tij më këta të fundit, pasi nuk evidentohen veprime aktive të kundërligjshme të kolegeve të tij, në drejtim të realizimit me veprime të përbashkëta ose komplementare, të të njëjtit qëllim kriminal.

743. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Gëzim Duraku, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

744. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Gëzim Duraku, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

745. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Gëzim Duraku përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale,

përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Gëzim Duraku ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

746. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Gëzim Duraku, është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Gëzim Duraku, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

747. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Gëzim Duraku**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, për faktet penale të provuara, analizuar më sipër në këtë vendim, të ndodhura në datat 12.02.2022,13.02.2022, 19.02.2022, 23.02.2022, 27.02.2022 dhe 28.02.2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit KAPLLAN DOGJANI

748. Lidhur me të pandehurin **Kapllan Dogjani**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datave 12.02.2022, 20.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022 dhe 28.02.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon të theksojë aë

K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Kapllan Dogjani, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në mospërmbushje të rregullt të detyrës së tij lidhur me verifikimin dhe regjistrimin e shtetasve që kalojnë kufirin në hyrje të R.Sh, në ngjarjet e datave 12.02.2022, 20.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022 dhe 28.02.2022. Arrihet ky konkluzion duke vlerësuar sa vijon:

749. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën në hyrje të R.Sh, ku ka kryer shërbimin në datë 12.02.2022 kontrollori Kapllan Dogjani, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio se në orën 18.52 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentacionin e shtetasit kosovar Granit Binjaku, sipas verifikimeve dhe të dhënave të marra nga sistemi TIMS mbi përpunimin e dokumenteve në kufirin hyrës në këtë moment kohor, me të cilin bisedon mbi mungesën e dokumentacionit të vaksinimit/testimit kundër covid-it. Gjatë bisedës, pamjet filmike tregojnë qartë se ka marrë nga shtetasi një kartëmonedhë 5 euro të cilën fillimisht e ka fshehur poshtë aparatit të skanimit dhe më pas e ka marrë ka marrë. Në orën 18.14 minuta, gjatë përpunimit të dokumentacionit të disa shtetasve, zhvillohet mes tyre dhe kontrollorit një bisedë gjatë së cilës udhëtarët thonë se kanë me vete një qen, ndërsa punonjësi i policisë Kapllan Dogjani i thotë se nuk lejohen qentë, dhe ndërkohe biseda ndër te tjera, vijon si më poshtë: *Dogjani: Ke me vete ndonjë gjë send a jo?Olsit: një qen. Dogjani: Ça qëni?. Olsit: Qen Sharr. Dogjani: Pasaportën. Olsit:Jo. Dogjani: Nuk lejohet, qeni bën 1000Euro, a do me bë trafik kafshësh ti aaa?Olsi: Ç'a trafiku. Dogjani: E di do ta mbash për tregti ti po nuk lejohet, le qe kanë ikur dhe ata të bujqësis tani, veterinerat. Olsit: ...jap një kafe. Dogjani: Po s'bën o figur or ti djalë, Benardo, jo Benardo, Olsit. Ku e çon qenin? Dogjani: Ec.Olsit: Natën.* Në zhvillim e sipër të kësaj bisedë, kontrollori Kapllan Dogjani hap dokumentet e shtetasit dhe prej andej merr një kartëmonedhe 1000 lekë, duke i lejuar të vijojnë udhëtimin. Nga verifikimi i kryer dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se personi që ka kaluar në këtë interval kohor në kufi, është shtetasi Olsit Siriteanu dhe bashkë me të shtetasi Bernard Malaj, por sipas bisedës së zhvilluar nga ku rezulton që kontrollori i drejtohet ne emër "Olsit" rezulton se shuma 1000 lekë është dhënë nga ky i fundit dhe dokumentohet të jetë marrë nga Kapllan Dogjani. I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Olsit Sirteanu, ka pranuar se në këtë datë ka qenë duke kaluar kufirin bashkë me kunatin e tij, shtetasin Bernard Malaj. Ai shpjegon se e ka pyetur punonjësin e policisë ne pikën hyrëse për procedurat qe ndiqen për te kaluar një qen në kufi por nuk ka hasur problematika të tjera, ndërkohë që deklaron se :"..*Unë nuk kam patur ndonjë problematikë, me dokumentacionin vetëm kur kam dalë nga P.K.K Morinë më është kërkuar testi i Covidit të cilin e kam patur fotografi në celular dhe ja kam treguar punonjësit të policisë që ka qenë me shërbim në kufi. Nuk kam patur ndonjë qen me vete dhe nuk i kam dhënë ryshfet punonjësit të policisë, por mund ti kem dhënë dhjetë mijë lekë për informacionin që më ka dhënë në lidhje me pyetjet për qenin".*". Pavarësisht deklarimeve të

shtetasit, nga pamjet filmike dhe biseda e zhvilluar mes tyre, rezulton e provuar dhënia prej tij e shumës 1000 lekë në drejtim të punonjësit në shërbim Kapllan Dogjani dhe marrja e kësaj shume nga ky i fundit.

750. *Së dyti,* në datë 12.02.2022, ora 18.36, sipas pamjeve filmike, regjistrimit audio dhe të dhënave të marra nga sistemi TIMS, rezulton se kontrollori në shërbim Kapllan Dogjani, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Maksim Domi, Omer Basha dhe Eduard Peposhi, merr nga shtetasi Maskim Domi 10 euro, të cilat i merr pasi hap dokumentet e udhëtimit që ai i ka dorëzuar, shumë të cilën e vendos para aparaturës së skanimit dhe me pas e ka marrë duke iu drejtuar pas këtij veprimi me fjalët "*Tu rrit ndera, hajvalla*". I pyetur lidhur më këtë ngjarje, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi Maksim Domi, ndër te tjera, ka deklaruar se :"...*Unë nuk kam dhënë lekë ndonjë herë, e pranoj se të dy shtetasit kanë qenë pasagjerët e mi, por rryshfet nuk kam dhënë.....nuk kam dijeni se kush mund të ketë dhënë shumën e rryshfetit prej 10-të euro*". Pavarësisht këtij deklarimi, dhënia e shumës 10 euro në këtë rast, rezulton e qartë nga pamjet filmike, pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes së tyre. Po në datë 12.02.2022, ora 18.40, gjatë përpunimit të dokumenteve kontrollori Kapllan Dogjani dëgjohet ti kërkojë udhëtarëve ne sportel dokumentet e vaksinimit dhe ndër te tjera, njërit prej udhëtarëve i drejtohet me emrin "Flak", por nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS nuk rezulton të ketë regjistruar dokumentacionin për një shtetas me këtë emër, ndërkohë që me të, ndër të tjera, zhvillon edhe këtë bisedë :" *Shtetasi: nuk e kam me vete a mundet me telefon me ma dërgu axha? Dogjani: Veç duhet prezent...ose duhet me u kthy duhet me shku me e marrë...S'është puna atje puna është se si ta regjistroj unë, unë dua ta regjistroj ose duhet me shkel ligjin e ta lë pa regjistruar me të bë nder a më kupton a jo, çi kjo është mundësia ime dy ose të regjistroj ose të lë pa regjistruar... Hajdeni ça me të bë duhet me kthy me e mar... Bjema dhe kartën tënde nëqoftëse hajde një udhë e dy punë."* Nga sa më sipër rezulton qartë kërkimi, në mënyrë të tërthortë i mitës nga kontrollori kundrejt mos regjistrimit dhe tolerimit të kalimit pa dokumentet e vaksinimit, ndërkohe që nga pamjet filmike, shihet se gjatë përpunimit të dokumenteve, kontrollori Kapllan Dogjani merr një kartëmonedhë 5 euro të cilën e fsheh tek pajisja skaner. Nga të dhënat e marra në sistemin TIMS rezulton se janë regjistruar në këtë orar shtetasit Andi Nuredini dhe Dea Kahrimani, ndërkohe që shtetasi me të cilin bisedon dhe i drejtohet me emrin "Flak" nuk rezulton te jete regjistruar në sistem.

751. *Së treti,* në datë 20.02.2022, ora 12.43 minuta, në kabinë nr. 4 në të cilën siç rezulton, ka qenë duke kryer shërbimin kontrollori Kapllan Dogjani, gjatë bisedës me shtetasit kosovarë të paraqitur në sportel rezulton se ai iu merr atyre 5 /euro për shkak se nuk kanë autorizimin për përdorimin e mjetit. Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se ne këtë hark kohor janë përpunuar dokumentet e shtetasve Daut Muharremi, Jahir Muharremi dhe Driton Balaj, njëri prej të cilëve është edhe personi që ka dhënë shumën 5 /euro në drejtim të të pandehurit Kapllan Dogjani, kundrejt tolerimit për të kaluar kufirin në mungesë të autorizimit për përdorimin e mjetit.

752. *Së katërti,* në datë 21.02.2014, në orën 20.17 minuta, në kabinën hyrëse nr. 4, në të cilën është duke ushtruar shërbimin kontrollori Kapllan Dogjani, gjatë përpunimit të dokumenteve të

udhëtarëve, konstatohet se gjatë përpunimit të dokumenteve të udhëtareve, ai ju kërkon dokumentet e vaksinimit dhe pasi shtetasit konstatohen se nuk i kanë, i kërkon të hapin krahun konstatohet t'ju japë një dokument mbrapsht dhe t'ju thotë, "*Fute nji kafe qitu*"... "*Kafe të mirë se ska ça bën*". Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS, në këtë hark kohor rezulton se ka përpunuar dokumentet e shtetasit Ekrem Veseli ndërkohë që nga biseda rezulton se udhëtarët kanë qenë më shumë se një, por nuk rezulton të jenë regjistruar në sistem. Nuk rezulton nga provat marrja e ndonjë shumë parash por nga komunikimi, si më sipër referuar, rezulton e qartë se i pandehuri Kapllan Dogjani i kërkon, në mënyrë jo të drejtpërdrejte, duke iu drejtuar me fjalët "kafe" i kërkon para në këmbim të tolerimit për kalimin e kufirit pavarësisht mungesës së dokumenteve që vetë kontrollori ka kërkuar. Pak minuta më vonë, në orën 20.20, të po kësaj date, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve, të cilët sipas sistemit TIMS rezulton të jenë shtetasit Saimir Seferi, Bledi Seferi dhe Sulë Seferi, rezulton se këta shtetas, sipas bisedës së zhvilluar, kanë pasur mallra në fugonin me të cilin udhëtojnë. Në bisedë kontrollori Kapllan Dogjani i thotë të shkojnë në polici për kontroll dhe ju mban dokumentet të cilat i vendos midis ekranit të kompjuterit dhe skanerit. Pas dy minutash njëri prej shtetasve, shihet teksa kthehet në sportel për të marrë dokumentet dhe në këtë moment kontrollori Kapllan Dogjani, dëgjohet ti kërkojë mitë duke iu drejtuar me fjalët: "*a ke ndonjë "kafe"* , *"a ke ndonjë respekt, do të çoj për kontroll poshtë....*" . Gjithashtu dëgjohet shtetasi ti thotë "*për zotin*" dhe "*për kokë të fëmijëve, do të jap unë për allahun e madh*". Nuk rezulton nga provat marrja e ndonjë shumë parash por nga komunikimi, si më sipër referuar, rezulton e qartë se i pandehuri Kapllan Dogjani i kërkon, kërkon para në këmbim të tolerimit për kalimin e kufirit pavarësisht problematikës së konstatuar lidhur me sendet që transportojnë në mjetin me të cilin këta shtetas udhëtojnë.

753. *Së pesti*, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS në lidhje me ngjarjen e shënuar në datë 22.02.2022, ora 08.05, rezulton se në shërbim në kabinën hyrëse nr. 4 është kontrollori Kapllan Dogjani, ndërsa përpunon dokumentet e shtetasve, të cilët sipas sistemit TIMS rezulton të jene shtetasit kosovarë Liridon Pajaziti, Hajrulla Goza dhe Skendër Sadria, për të cilët rezulton nga biseda se kontrollori konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit. Gjatë bisedës nga pamjet filmike shihet se shtetasi në sportel i zgjat një kartëmonedhë, për të cilën nuk dallohet prerja. Sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, referohet se gjatë kësaj kohe ka qenë prezent në kabinë edhe punonjësi i policisë Halim Shehu, por nuk referohet ndonjë veprim i tij në lidhje me ngjarjen si më sipër. Po në datë 22.02.2022, ora 08.09 minuta, në vijim në shërbim rezulton të jetë kontrollori Kapllan Dogjani, i cili shihet duke përpunuar dokumentet enje shtetasi, i cili sipas të dhënave të sistemit TIMS rezulton te jetë shtetasi Arton Sejdiu. Gjatë bisedës kontrollori i thotë që duhet të kalojë në vijën e dytë për kontroll por ndërkohë i kërkon dhe dokumentacionin e testit kundër covid. Për shkak të këtyre mangësive, gjatë zhvillimit të bisedës shtetasi i jep kontrollorit 5 euro të cilat, sipas pamjeve filmike, shihet se i merr kontrollori Kapllan Dogjani.

754. *Së gjashti,* në datën 28.02.2022, gjatë shërbimit në kabinën nr. 4 , në hyrje të R.SH, rezulton se ka qenë në shërbim kontrollori Kapllan Dogjani, i cili në orën 18.37 minuta, sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio, rezulton se ka konstatuar mangësi duke i bërë me dije

udhëtarëve se kanë një siguracion mjetit të përfunduar dhe shtetasja pasagjere ne mjet që është shqiptare, ka tejkaluar kohën e qëndrimit jashtë territorit për më tepër se tre muaj. Pas komunikimit mes tyre lidhur me këtë problematikë, në orën 18.45, sipas pamjeve filmike, kontrollori i ka vendosur dokumentet e tyre ne anën e djathtë të tavolinës së tij dhe nuk ka vijuar përpunimin e tyre, ndërkohë që një person i drejtohet me fjalët "*He shefi*" dhe Kapllani i thotë "*dil para mos më rri mas shpine*". Në vijim biseda e regjistruar është si më poshtë:" *K.Dogjani: Kjo vula e fundit a e ke pa , po ta kallzoj se e ke at njerzillik me ta kallzu ...që ka dal prej Shqiprie....edhe sot ka bo tre muj e 23 dit e 22 dit. Personi: Aaaaa!? Un kujtova t'Kosovës. Ça me bo? Ne kem tu ik deri n'Laç te nji mik i joni. K.Dogjani: Ae ja bo shenimin, ca me ja bo... nji shënim duhet me e bo, ka shum neshje kjo pun, e për pes vjet si lejohet me dal prej Shqiprie....për her t'par udhton me të?.Personi:...qe, mo mir po t'rrespektoj..nuk osh diçka se na nal ajo..., t'betohena aman, për zotin."* Sipas pamjeve filmike teksa zhvillohet kjo bisedë, shihet që mbi tavolinë hidhet një kartëmonedhë, me ngjyrë rozë, në dukje paund britanik, dhe Kapllani në këtë moment merr dhe dokumentet e tjera që janë në tavolinë dhe ja jep personit, duke iu drejtuar me fjalët *"...ësht turp tashi" ndërsa shtetasi që ja ka dhënë i thotë " Un më shum sa ti, ma bon hallall."* Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS, rezulton se në këtë moment janë përpunuar dokumentet e shtetasve Uendi Dybeli dhe Arben Kurtishi, të cilën kanë dhënë edhe shumë e parave, si më sipër.

755. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 12.02.2022, 20.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022 dhe 28.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara mes të pandehurit Kapllan Dogjani dhe shtetasve të përpunuar prej tij në pikën hyrëse, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri, ka kërkuar dhe/ose ka marrë para në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve, moskalimit të tyre për kontroll në rast të transportimit të mallrave apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

756. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk rezulton asnjë fakt për veprimin e tij në bashkëpunim me ndonjë person tjetër dhe as evidentohet prezenca e ndonjë punonjësi tjetër policie gjatë zhvillimit të ngjarjeve objekt akuze ndaj të pandehurit Kapllan Dogjani. Për pasojë gjykata vlerëson se nuk rezulton dhe as provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Kapllan Dogjani është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga

provat, rezulton se i pandehuri Kapllan Dogjani në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pika 1 i Kodit Penal. Në arritjen e këtij konkluzioni, gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, ekziston dhe për më tepër të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

757. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Kapllan Dogjani, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

758. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Kapllan Dogjani, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

759. Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri Kapllan Dogjani përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien

subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Kapllan Dogjani ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

760. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Kapllan Dogjani është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Kapllan Dogjani, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

761. *Sa më sipër u arsyetua,* gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Kapllan Dogjani**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në ngjarjet e datave 12.02.2022, 20.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022 dhe 28.02.2022, por nuk rezultojnë të dhëna, për më tepër të provuara nën standardin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" se ka vepruar në ndonjë moment në bashkëpunim me persona të tjerë.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurës MIMOZA SHAHINAJ (Ismaili)

762. Lidhur me të pandehurën **Mimoza Shahinaj**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë në ngjarjet e datave 10.02.2022 dhe 26.02.2022, por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon të theksojë se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, e pandehura Mimoza Shahinaj, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në mos përmbushje të rregullt të detyrës së saj lidhur me verifikimin dhe regjistrimin e shtetasve që kalojnë kufirin në hyrje të R.Sh, në ngjarjet e datave 10.02.2022 dhe 26.02.2022. Arrihet ky konkluzion duke vlerësuar sa vijon:

763. Së pari, nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën në hyrje të R.Sh, ku ka kryer shërbimin në datë 10.02.2022 kontrollorja Mimoza Shahinaj, rezulton e provuar se në orën 08.56 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentacionin e shtetasit, i cili sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezulton të jetë Elbert Palushi, ai i jep 5 euro, duke ju drejtuar me fjalët "Nji kafe" dhe Mimoza e merr këtë shumë, duke e falënderuar. Në orën 10.18 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentet e shtetasve Naser Krasniqi dhe Qendrese Buzhala, gjatë përpunimit të dokumenteve , shihet teksa merr nga pasaporta 5 euro dhe i vendos para aparatit të skanimit. Nga biseda rezulton se kontrollorja i ka kërkuar mite duke iu drejtuar me fjalët "*Ah po ti paske për të na dhënë kafe, paske për tu martu, deri këtu në rregull...*", ndërkohe që më herët i ka pyetur për dokumentet e vaksinimit. Në orën 10.02 minuta të po kësaj date, në kabinë hyrëse nr. 4 ku është duke vijuar shërbimin kontrollorja Mimoza Shahinaj, nga pamjet filmike rezulton se në përpunim dokumentesh ajo veçon prej tyre një kartëmonedhë, por nuk rezulton për shkak të pamjeve të kufizuara, shuma e saj. Po ashtu sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS rezulton se në këtë orë ka përpunuar dokumentet e shtetasit shqiptar Gazmir Gjoka. Në episodin e datës 10.02.2022, ora 18.19 minuta, Mimoza Shahinaj, teksa është duke kryer shërbimin, në sportel paraqiten shtetas të cilët Mimoza i pyet se sa vetë janë dhe ata i përgjigjen tre. Nga pamjet filmike rezulton se ajo nxjerr nga dokumentet qe i kane dhënë këta shtetas shumën 10 euro të cilën shihet se e fut poshtë tastierës dhe ndërkohë nuk kryen regjistrimin e dokumenteve ne sistem. Në episodet si më sipër, rezulton se kontrollorja Mimoza Shahinaj, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në datë 10.02.2022, në disa epiosde shihet te kërkoje, marrë ose pranojë shuma parash nga shtetasit që paraqiten në sportel, kundrejt mos regjistrimit të tyre në pikën hyrëse, tolerimit për të vijuar udhëtimin kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit apo për arsye të tjera të cilat nuk identifikohen për shkak të mungesës apo paqartësisë së komunikimit mes saj dhe udhëtareve ne sportel.

764. Së dyti, po në datë 10.02.2022, në tre episode të ndryshme janë regjistruar audio dhe video, komunikime të saj me koleget apo qytetarë, si më poshtë; (i) Në orën 17.03 minuta të po kësaj date, sipas regjistrimi audio, rezulton se Mimoza zhvillon bisedë me një koleg të sajin dhe qytetarin e paraqitur për të kaluar, të cilin, siç rezulton nga komunikimi, e ka kthyer më parë duke mos e lejuar të kalojë. Qytetari largohet nga sporteli dhe rikthehet ne orën 17.15 minuta, duke komunikuar sërish me kontrolloren. Nga biseda rezulton se ajo ka konstatuar problematika lidhur me dokumentacionin e mjetit. Ndërkohë gjatë kësaj kohe referohet se vjen një koleg i saji dhe në përfundim, sipas komunikimeve te Mimozës me qytetarin dhe me kolegun e saj, rezulton se ky shtetas do të përpunohej nga kontrollori tjetër me emrin "Arjan" sipas bisedave. Sipas veprimeve dhe bisedave të zhvilluara, nuk referohet dhe po ashtu nuk rezulton që kontrollorja Mimoza Shahinaj të ketë kërkuar apo marrë ndonjë shumë parash nga ky person, e vetme apo në bashkëpunim me kolegët e saj. (ii) në orën 20.05 minuta, teksa është duke kryer shërbimin, ajo komunikon me kolegun e saj të Kosovës. Me të cilin bisedojnë mbi regjistrimin e "daljes" se një shtetasi me pasaporte maqedonase, por pavarësisht bisedës, në të cilën rezulton e qartë se Mimoza ka komunikuar me shtetasin që kërkon këtë "regjistrim fiktiv të daljes" në pikën e kalimit kufitar, dhe bisedon me kolegun e saj kosovar për ta kryer këtë veprim ky i fundit, nuk rezulton te jetë vërtetuar dhe provuar prezenca e formave t kryerjes së veprës penale për të cilën ajo akuzohet, nëpërmjet kërkimit, marrjes apo pranimit, për vetë ose për të tjerë, të ndonjë shumë parash apo shpërblimi tjetër. Në rastin konkret mes dy punonjës ve të policisë flitet por një ngjarje që i përket së ardhmes, por që nuk provohet se ka ndodhur pasi veprimet hetimore për të rast janë kufizuar vetëm në këto biseda të cilat flasin për një ngjarje të mundshme, por të paprovuar se ka ndodhur. Po ashtu, në orën 16.54 minuta të datës 10.02.2022, ndërsa ka qenë duke përpunuar dokumentet e shtetasve kontrollorja Mimoza Shahinaj, gjatë marrjes së dokumentit (pasaportë) tërheq diçka nga pasaporta dhe e fut poshtë tastierës së kompjuterit të punës dhe vijon me regjistrimin në sistem të dokumentit. Nuk rezultojnë komunikime mes saj dhe udhëtarit në sportel, përveç përshëndetjeve, dhe nga verifikimi në sistemin TIMS, rezulton se në këtë orën është regjistruar shtetasi Ahmet Ferati. Në këtë rast, nga procesverbali i këqyrjes së pamjeve filmike referohet se ajo ka marrë dhe ka futur poshtë tastierës shumën 5 euro, por ky fakt nuk rezulton i qartë, madje edhe në procesverbal përshkruhet si *"ryshfet i ngjashëm me 5 euro"*). Në këtë rast veprimet që rezultojnë nga pamjet filmike, pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes, paraqitet tepër te kufizuara dhe për pasojë, nuk mund të dëshmojë në kufijtë e provueshmërisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se veprimi që ka kryer kontrollorja, ka konsistuar saktësisht në marrjen dhe fshehjen e "mitës" së marrë prej saj. Po ashtu, në datë 10.02.2022, ora 16.31 minuta, është regjistruar një komunikim mes saj dhe kolegut të saj Arjan Sokoli mbi një shumë parash që Mimoza do të marrë në datën 29, siç referon biseda, nga një shtetas që sipas bisedës ka kaluar kohën e qëndrimit, por nuk ka rezultuar dhe as është verifikuar ndonjë veprim konkret i të pandehurit Arjan Sokoli apo të pandehurës Mimoza Shahinaj për realizimin dhe konkretizimin e kësaj veprimtarie për të cilën bisedojnë, veprimtari e cila, në raport me kohën kur zhvillohet biseda (datë 10.02.2022) rezulton se i përket së

ardhmes, pra datës 29 siç referohet në bisedë, e për pasojë nuk mund të provohet se ka ndodhur nëpërmjet një bisede të zhvilluar kohë më parë.

765. *Së treti,* nga të dhënat që ofrojnë pamjet filmike, transkriptimit i regjistrimit audio, këqyrja e pamjeve filmike dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, rezulton se në datë 26.02.2022, teksa është duke përpunuar dokumentet e shtetasit Xhenis Vataj, kontrollorja Mimoza Iamaili teksa konstaton se shtetasi nuk ka dokumente vaksinimi, ndër të tjera, i drejtohet me fjalët "*Fut një kafe meqenëse je tu shku për qetësim dhe hec... Fut një kafe çitu dhe hec, spo ta prishi terezinë po faktikisht pa vaksinë pa test nuk lejohet ta them me sinqeritet, ti në daç shko bëne, e bën edhe atje nëqofte se do rrish gjatë, më jep edhe letërnjoftimin që të bëjmë regjistrimin...Mirupafshim*". Ndërkohë që zhvillohet kjo bisede, nga e cila rezulton qartë kërkimi i mitës nga kontrollorja Mimoza Shahihan, sipas pamjeve filmike, rezulton se ajo hap një dokument ku ishin vendosur 5 euro dhe i vendos poshtë aparatit celular. Po në këtë datë, në orën 17.05 minuta, teksa shihet duke përpunuar dokumentet e shtetasit, Armend Shabani dhe personave që udhëtojnë në të njëjtin automjet me të, pamjet filmike kanë regjistruar marrjen prej saj të shumës 10 euro, për shkak të mungesës së dokumentacionit të vaksinimit, konstatuar këtyre shtetasve. Në orën 17.08 minuta, sipas pamjeve filmike, shihet kontrollorja Mimoza Shahinaj e cila teksa përpunon dokumentet e shtetasve Murrlan Bicinica dhe Erdon Karciu, dhe kur hap dokumentet merr 10 euro te cilat sërish i vendos poshtë aparatit të saj celular. Në orën 17.28 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasve Edmond Kamberaj, Besnik Telalu dhe Harris Krasniqi, ju drejtohet me fjalët "*Hë mo çuna ndonjë raport apo vaksinë nuk më thatë, vetëm shoferi..hë mo çuna..na futi këtu*", dhe ndërsa thotë këto fjalë i zgjat një librezë automjet, nga e cila pasi e rimerr, nxjerr një kartëmonedhë 5 euro. Pra rezulton i qartë kërkimi dhe njëherësh marrja e mitës nga punonjësja e policisë në shërbim Mioza Shahinaj. Në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike referohet se prezent në një moment gjatë zhvillimit të kësaj ngjarje ka qenë edhe punonjësi i policisë Urim Lami por nuk identifikohet asnjë veprim apo mosveprim i tij në drejtim të faktit konkret. Po në këtë datë, në orën 12.29 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit Durim Seferi, nga pamjet filmike rezulton qartë se Mimoza merr prej tij 5 euro, pasi më herët ka konstatuar mungesë të dokumenteve të rregullta të mjetit dhe i është drejtuar, ndër të tjera, me fjalët "*A e dini që s'lejohet pa autorizim?*".

766. Sa më sipër, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 10.02.2022 dhe 26.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara mes të pandehurës Mimoza Shahinaj dhe shtetasve të përpunuar prej saj në pikën hyrëse, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se e pandehura, ka kërkuar dhe ka marrë para nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumenteve të vaksinimit, dokumenteve të përdorimit të automjeteve apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në

ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

767. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk rezulton asnjë fakt për veprimin e saj në bashkëpunim me ndonjë person tjetër. Prezenca e kolegeve të saj në episode të caktuara apo komunikimi mes tyre ne episode të tjera, nuk mund të vlerësohet si element bashkëpunimi, në funksion të kryerjes së veprës penale, i provuar në kufirin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Për pasojë gjykata vlerëson se nuk rezulton dhe as provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurës Mimoza Shahinaj është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se e pandehura Mimoza Shahinaj në veprimet e konkretizuara për kërkimin dhe pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pika 1 i Kodit Penal. Në arritjen e këtij konkluzioni, gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, ekziston dhe për më tepër të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale.

768. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurës Mimoza Shahinaj, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se e pandehura është tërësisht e vetëdijshme për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

769. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në

plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se e pandehura Mimoza Shahinaj, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

770. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se e pandehura Mimoza Shahinaj përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është e përgjegjshme, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, e pandehura Mimoza Shahinaj ka qenë punonjëse e strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

771. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se e pandehura Mimoza Shahinaj është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së saj, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit të veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se e pandehura Mimoza Shahinaj, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë,

plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

772. *Sa më sipër u arsyetua,* gjykata arrin në përfundimin se e pandehura **Mimoza Shahinaj**, duhet të deklarohet fajtore për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në ngjarjet e datave 10.02.2022 dhe 26.02.2022, por nuk rezultojnë të dhëna, për më tepër të provuara në standardin "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*" se ka vepruar në ndonjë moment në bashkëpunim me persona të tjerë.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit MUHAMET CENGU

773. Lidhur me të pandehurin **Muhamet Cengu**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datës 08.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Dashnor Braha, dhe i vetëm ne ngjarjet e datave 10.02.2022, 12.02.2022,20.02.2022, 28.02.2022 dhe 04.03.2022.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Muhamet Cengu, në ngjarjet e datave *në ngjarjet e datës 08.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Dashnor Braha, dhe i vetëm ne ngjarjet e datave 10.02.2022, 12.02.2022,20.02.2022, 28.02.2022 dhe 04.03.2022*, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

774. *Së pari,* nga pamjet filmike, vetëm video, regjistruar në kabinën nr.4, ku ka kryer shërbimin në datë 08.02.2022, në kabinën nr. 2, ku ka kryer shërbimin në datë 08.02.2022 i pandehuri Dashnor Braha, ndërkohë konstatohet se është prezent edhe i pandehuri tjetër Muhamet Cengu, në orën 17.45 është fiksuar dhe regjistruar biseda e kryer mes Muhametit dhe një shtetasi që qëndron në përpunim në kabinën ku kryen shërbimin Dashnor Braha, ku Muhameti i drejtohet me fjalët "*Hajde futi brenda në çantë*", ndërsa shtetasi i drejtohet me fjalët "*100 mijë lekë, pjesën tjetër euro do ti jap më pas*" dhe ndërkohë Muhameti i përgjigjet "*Jo jo 100 mije lekë*". Punonjësi i policisë i drejtohet me fjalët "*100 mijë leke*", "*edhe dhetë mije të tjera ma tepër*" ndërsa shtetasi i përgjigjet "*Skam mo*", ndërkohe që shihet se kontrollon xhepat e tij për para të tjera. Nga pamjet filmike është fiksuar momenti kur shtetasi i jep shumën e parave punonjësit e policisë që qëndron tek dera e kabinës identifikuar si Muhamet Cengu. Në vijim pamjet filmike kanë fiksuar se, pas dhënies së shumës së parave, shtetasi i jep dokumentet e tij kontrollorit në shërbim Dashnor Braha dhe ky i fundit ja mban atë mbi tavolinë duke mos vijuar

përpunimin e dokumentacionit. Shtetasi dokumentet e të cilit janë mbajtur dhe përpunuar nga kontrollori në shërbim Dashnor Braha në këtë hark kohor, ndërkohë që prezent në kabinë dhe fiksuar duke i kërkuar dhe marrë shumën e referuar në biseda prej 100 mije lekësh është edhe i pandehuri Muhamet Cengu, sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezulton të ketë qenë shtetasi kosovar Ahmet Ferati i cili ka udhëtuar me mjetin fugon me targa "AB480 ET", dhe nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ka kalime të shpeshta në kufi si dhe një shënim të anuluar, si i proceduar për veprën penale "Trafikimi i armeve dhe municioneve". Në këtë rast të dy punonjësit e policisë, Dashnor Braha dhe Muhamet Cengu, me veprime aktive të kundërligjshme kanë ushtruar presion dhe më pas kanë marrë një shumë parash të referuar në biseda si 100 mije leke, dhe të fiksuar dhënia e parave sipas pamjeve filmike, nga shtetasi kosovar Ahmet Ferati, në bashkëpunim me njëri tjetrin. Në po këtë datë, 08.02.2022, para se të zhvilloheshin ngjarjes si më sipër, nga pamjet filmike dhe procesverbali i këqyrjes së tyre, është fiksuar se punonjësi i policisë Muhamet Cengu, teksa i lë shërbimin kolegut të tij Dashnor Braha, nxjerr nga xhepi dhe numëron një shumë parash, prej të cilave disa monedha i hedh në një çantë që qëndron në tavolinën e punës, por nuk rezultojnë të dhëna për marrjen e këtyre shumave nga ndonjë shtetas apo veprime si pasojë e të cilave këto para janë siguruar prej tij apo të pandehurit tjetër Dashnor Braha që merr shërbimin dhe nderohet me kolegun.

775. *Së dyti,* në datë 12.02.2022, në orën 15.00, në kabinën nr.4 ku është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë Muhamet Cengu, teksa përpunon dokumentet e nje shtetasi kosovar, i merr atij 10 euro për shkak të mangësive në dokumentet e vaksinimit, duke iu drejtuar ndërkohë më fjalët : "*s'bën në celular se na duan me fotokopje*". Në këtë datë, në orën 15.08 minuta, teksa përpunon dokumentet e një shtetasi, nga pamjet filmike dhe biseda e transkriptuar audio, rezulton se ai konstaton mungesë të dokumenteve të mjetit, dhe ndërkohe, pasi hap dokumentet që shtetasit i kane dhënë, shihet teksa nxjerr 20 euro, të cilat i lëshon tek tastiera dhe pas disa momentesh i merr. Nga pamjet filmike rezulton se nuk ka kryer regjistrimin e dokumenteve te shtetasve ne sistem. Në orën 09.45 minuta, në kabinën nr. 4 ku është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë Muhamet Cengu, sipas pamjeve filmike, është konstatuar se kontrollori në shërbim Muhamet Cengu nuk kryen veprime verifikuese për dokumentacionin në sistemin TIMS, për shumë shtetas që kalojnë kufirin, por i pyet verbalisht nëse kanë vaksinat e pasagjerët i thonë po, ai ju përgjigjet, ***"Ec, ec".*** Po ashtu nga pamjet filmike referohet se prezent në kabinë është edhe punonjësi i policisë Avni Tërshalla për disa momente. Gjatë kohës që në sportel paraqitet një shtetas për përpunim të dokumentacionit, punonjësi i policisë Muhamet Cengu e pyet nëse i kanë bërë të dyja dozat e vaksinës por pasi asi i merr para, për mungesën e këtyre dokumenteve kontrollori e porosit se si duhet te përgjigjen nëse i kontrollon dikush gjatë rrugës. Sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, për shkruhet se, Muhamet Cengu, "*...vendos dokumentet në krahun e djathtë të tavolinës së punës, në afërsi të pultit të kondicionerit dhe këto dokumente i merr kolegu kur largohet nga kabina dëgjohet kur i thotë kontrollorit pi një kafe dhe kontrollori ka në dorën e majtë një kartëmonedhë te prerjes 5-Euro e cila dyshohet të jetë dhënë nga shtetasit për kontrollorin e policisë Muhamet Cengu. Marrë ryshfeti nga kolegu prezent në kabinë Avni Tërshalla*". Sipas të dhënave të sistemit TIMS, nuk rezulton që në këtë

orar të jenë regjistruar në sistem nga Muhamet Cengu persona që janë përpunuar në pikën hyrëse. Nga pamjet filmike dhe procesverbali i transkriptimit të komunikimeve evidentohet dialogu mes Muhamet Cengut dhe shtetasit kosovar ne sportel por nuk rezultojnë qartë veprime të punonjësit tjetër të policisë Avni Tërshalla për kërkimin, marrjen apo pranimin e shumave të parave nga shtetasit, në bashkëpunim me Muhamet Cengun. Rezulton se ai ka qenë disa momente prezent në kabinë dhe po ashtu fiksohet teksa largohet nga kabina dhe i thotë kolegut të tij Muhamet Cengu "*Pi një kafe*", ndërkohë që nuk referohet dhe as rezulton se ka marrë apo kërkuar nga ndonjë qytetar para në këmbim, të ndonjë favorizimi në kalimin e kufirit. Në vijim, në orën 09:49 min punonjësi i policisë Muhamet Cengu gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi kosovar, i kërkon para për shkak mungesës së dokumenteve të plota te vaksinimit, duke iu drejtuar ndër të tjera, me fjalët: *M. Cengu: Hec përpara hajde merri dokumentet këtu,* dhe njëkohësisht i mban dokumentet e udhëtimit. Në vijim shtetasi të cilit i janë mbajtur dokumentet vjen tek sporteli dhe dëgjohet t'i thotë policit: "*40 ero hajt,*" *Muhameti: Faleminderit.* Pavarësisht se nuk është fiksuar nga pamjet filmike marra e shumës, provohet saktësisht kërkimi dhe minimalisht ofrimi i saj nga qytetari dhe pranimi nga i pandehuri Muhamet Cengu. Po në datë 12.02.2022, në orën 09.52 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit Ardit Bajaziti, rezulton se kërkon dhe merr para, kundrejt regjistrimit të një mjeti në pikën hyrëse. Ky element, si kërkimi ashtu dhe marrja e parave, rezulton qartë edhe nga komunikimi mes tij dhe shtetasit, ku ndër te tjera, i drejtohet me fjalët : *Ardit: Ore do ta bëj me doganë për zotin se andej jam liçens në Shqipëri unë. Cengu: Ej o njësh se nuk lejohet kështu o njësh. Ardit: do ta bëj me doganë për zotin. Cengu: Qysh me ja bë,a do me u regjistru ky këtu?... Ardit: po pra do ta regjistrosh në emrin e atij jo në emrin tim. Cengu: Po në emrin e atij po nuk lejohet pa autorizim. Ardit: E di unë që nuk lejohet pa autorizim. Cengu: Ç'a me bë unë. Ardit: Të jap dhe ndonjë kafe tjetër unë pa le të ikim mos na vono për zotin, pa me atë punoj unë me Gjermanin, Luksenburgun. Cengu: Ma jep pak, fut diçka këtu kujdes dil ka dera, a është me targa makina a pa targa?Ardit: Pa targa. Cengu:Pa targa ë. Ardit: O vëlla doli makina iku. Cengu: po targat ku i ke?. Ardit: Po targat i mori mbrapa ai në Kosovë. Polici: po qysh me e regjistru do e ndal dogana makinën pa targa. Arditi: në emrin e atij shkruaje... nuk kuptohet, ore ta kaloj ai kosovari makina ime me targa shqiptare. Cengu: hajde lene një kafe, ku i ke targat..".* Nga kjo bisede rezulton e qartë se Muhameti ka lejuar dhe kryer regjistrimin e mjetit ndërkohe që nuk ka ndjekur procedurën në lidhje me zhdoganimin e tij ose minimalisht, ka regjistruar një mjet ne sistem në emër të një shtetasi tjetër, siç ka kërkuar edhe shtetasi në sportel dhe kundrejt këtij veprimi rezulton qartësisht se ka pranuar ofertën e tij për ti dhënë para si dhe i ka marrë ato, pasi rezulton qartë ta udhëzoje se si duhet t'ia japë, duke i thënë *"Ma jep pak, fut diçka këtu kujdes dil ka dera".* Po në datë 12.02.2022, ora 16.47 minuta, rezulton se ka marrë nga shtetasi Dritan Latifi shumën 5 euro pasi i ka kërkuar më herët dokumentet e vaksinimit. Në orën 18.54 minuta, është fiksuar teksa merr 10 euro nga një shtetas në sportel, duke mos e regjistruar atë në sistem. Në orën 19.09 minuta, rezulton se gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Arber Ejupi, merr prej tij 5 euro përkundrejt tolerimit për kalimin e kufirit lidhur me dokumentet e vaksinimit. Në orën 19.12 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Besart Spanca, i kërkon atij

para duke i marrë 5 euro, për shkak të mungesës së dokumenteve të vaksinimit. Në orën 17.41 minuta shihet teksa merr nga shtetasi i përpunuar ne këtë hark kohor Dardan Arifi, shumen 5 euro. Ne orën 11.22 minuta gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve në sportel, ju kërkon dhe më pas shihet teksa merr para prej tyre, duke iu drejtuar, ndër të tjera me fjalët : "*Nuk dua kështu se e fotokopjojmë...., s'po ju kthej mbrapsht se është tu më ardhë keq, por fusni një kafe ç'itu.*". Në orën 11.36 minuta të po kësaj date gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve në sportel, ai i kërkon para, duke iu drejtuar ndër të tjera, me fjalët "*...Kena kontroll rrugës, që dalin e kontrollojnë këto dhe dalin të kontrollojnë ty thuaj i ka kontrollu kufiri dhe më kanë ngelë aty ose më kan ra dikund. Ec pak para dhe hajde meri dokumentet, se s'du me të kthy mbrapa.*".

776. *Së treti*, në datë 12.02.2023, në orën 16.00 të datës 12.02.2022, është regjistruar një bisede mes Muhametit dhe një shtetasi që vjen në sportel, nga konteksti i të cilës kuptohet se ai i kërkon punonjësit e policisë Muhamet Cengu, një vërtetim fiktiv për datën 11.02.2022 (një ditë me parë) ku sipas tij në këtë vërtetim të pasqyrohej se në PKK-Morinë, ka kaluar një shtetas nga Kosova me një pjesë makinerie me qëllim për ta riparuar në Durrës. Nga pamjet filmike shihet se ky vërtetim i kërkuar, plotësohet me shkrim dore nga punonjësi i policisë Muhamet Cengu dhe ndërsa plotësohet ky dokument, dëgjohen fjalët :" *Cengu: Sa kushton ajo...i them bash çitash e kam shok të ngushtë.. sa kushton ajo? Tregoma në foto. Shtetasi :350 euro, një kafe po ta qes. Cengu: për ça është kjo....Shtetasi: Po pjesë e pirunit...Cengu: Po duhet me i thënë këtij....Cengu: Po sot ka kaluar?Shtetasi: Jo sot dije dije. Cengu: Sot më datë njëmbëdhjet i dyti shtetasi si quhet, më jep kartën e identitetit a e ke. Shtetasi: Dritan MilotiCengu: Shtetasi kosovar.. me ça mjeti a i ke targat. Shtetasi; me çëtë që është aty KEDI pik A...Cengu: Shtetasi Kosovar me mjetin KEDI transporton për në Shqipëri në servis një pjesë, ça pjese është?Shtetasi: Si i thoni ju atij që çon paletat?Cengu: Pirun.. një pjesë të pirunit për servis (vazhdon duke shkruar) në Durrës. Polici: Data e kthimit?Shtetasi: Sot. Cengu: data e kthimit nesër në datë 12.2.2022. Shtetasi: A i madh je..*". Nga të dhënat e marra në sistemim TIMS lidhur me ketë fakt, ka rezultuar se shtetasi Dritan Miloti që përmendet në këtë komunikim, gjatë plotësimit të vërtetimit me shkrim nga kontrollori Muhamet Cengu, nuk ka hyrje dalje në kufi në datat e referuara. Në këtë episod rezulton se punonjësi i policisë Muhamet Cengu, kundrejt lëshimit të vërtetimit përkatës, që pasqyron të dhëna të cilat nuk lidhen me të dhënat që përmban sistemi TIMS, pranon mitë, duke kryer atë shërbim që i kërkohet nga qytetari kundrejt premtimit për ti dhënë "kafe" sikurse referohet ne bisede por marrja nuk ka rezultuar te jete fiksuar në këtë moment dhe nuk rezulton te jete ne shumën 350 euro siç referon akuza, pasi nga kontesti i bisedës rezulton e qarte se shifra 350 euro është çmimi i pjesës se këmbimit për të cilën ai bisedon me qytetarin. Po në datë 12.02.2022, ora 14.12, rezulton se gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Shkëlqim Bajrami, i merr këtij të fundit 5 euro për shkak të mungesës së konstatuar të autorizimit për përdorimin e mjetit. Në orën 13.21 minuta, rezulton se i ka marrë 10 euro një shtetasi për të cilin nuk ka kryer asnjë veprim regjistrimi në sistemin TIMS. Në orën 11.46 minuta, rezulton se ka marrë 5 euro nga shtetasi Mehdi Thaqi, të cilin shihet teksa e nxjerr nga libreza e mjetit që udhëtari në sportel i ka dorëzuar. Në orën 11.55 minuta ka marrë nga

shtetasi Ilir Halili shumën 5 euro, të cilët në të njëjtën mënyrë, e merr nga dokumentet dhe menjëherë pasi largohet shtetasi e tërheq më dorë drejt vete. Në orën 11.57 minuta, ka kërkuar dhe ka marrë gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Leon Abimi dhe personave të tjere që udhëtonin me të por nuk janë regjistruar në sistem, shumë 5 euro. Në orën 12.58 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Salim Xhebaxhi, i kërkon atij mitë duke iu drejtuar ndër të tjera me fjalët "*Autorizimin e ke pa vulë", "rregulloje, rregulloje*" dhe i kthen dokumentin të cilin pasi e rimerr nxjerr prej aty 10 euro. Në orën 12.02.2022, gjatë përpunimi të dokumenteve të disa shtetasve të cilët nga verifikimi në sistemim TIMS rezulton se nuk i ka regjistruar, merr 5 euro, pasi me parë i është drejtuar duke kërkuar mitë, me fjalët "*Lësho një kafe", "Ta kthej kusurin ta kthej*".

777. Ndërkohë, në orën 14.16 minuta të datës 12.02.2022 nga regjistrimi audio dhe video, rezulton që Muhamet Cengu i jep kolegut te tij Avni Tërshall një kartëmonedhë, duke shkëmbyer këtë dialog : "*Muhameti : Merri këto nga unë...Avniu : Hë të lumtë krahu të lumtë, hë hallall.*" Në këtë episod nuk dokumentuar marrja prej tij te ndonjë shume parash nga shtetasit që kalojnë kufirin, vetëm apo në bashkëpunim me kolegun e tij Avni Tërshalla.

778. Së katërti, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se në datë 16.02.2022 punonjësi i policisë në shërbim në kabinën hyrëse nr.4, i identifikuar si Muhamet Cengu ka kërkuar dhe/ose ka marrë shuma parash nga shtetasit që ka përpunuar në pikën hyrëse, kundrejt tolerimit të tyre për të kaluar kufirin kundrejt mangësive të dokumentacionit të konstatuar dhe konkretisht : Në orën 08.34 minuta, teksa shihet se përpunon dokumentet e shtetasve, i pyet këta të fundit nëse duan të regjistrohen ose jo, dhe pavarësisht se nuk dokumentohet dhënia e ndonjë shumë parash, në bisedë dëgjohet Muhameti që i drejtohet me fjalët "*A s'ke lek te huj*" dhe shtetasi i përgjigjet "*Jo jo s'kam*". Në sistemin TIMS rezulton të jetë regjistruar vetëm shoferi i autobusit Muarem Kamber dhe një pasagjer me emrin Mustafa Kaljisi, ndërkohë që pasagjeret e tjerë nuk janë regjistruar prej tij. Në orën 08.57 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasve Liridon Bruti dhe Gabriele Pasco, ka konstatuar mungesë të testeve kundër covid dhe ka kërkuar dhe marrë para prej tyre, duke iu drejtuar teksa merr shumë e parave nga dokumentet me fjalët :Muhamet Cengu: "*edhe 10-te..... Hajd shnet.*". Në orën 12.08 minuta, teksa kryen përpunimin e dokumenteve të shtetasit Suard Domi, dëgjohet ti thotë "*Hajde njëherë*", në vijim brenda në kabinë hyn një tjetër punonjës policie i cili po ashtu e thërret shtetasin që është ne sportel të hyje brenda kabinës. Menjëherë sa hyn brenda kabinës dëgjohet se atij i ushtrohet presion për para ndërsa ai betohet se nuk ka më tepër para dhe në vijim dalin jashtë bashkë me punonjësin tjetër të policisë, i cili nga procesverbali i këqyrjes nuk rezulton te jetë përcaktuar se cili është. Punonjësi i policisë i cili e fut shtetasin brenda në kabinë i thotë:, "*Hajde hajde këtu ti ca mbarove pune"* dhe kur hyn shtetasi i thotë, "*Bjer 10-mijë lekë këtu*".....Shtetasi: " *Pasha zotin skam, rregullohena me vonë".* Nga këqyrja konstatohet t'i japë para brenda kabinës por e merr shtetasin dhe dalin jashtë serish. Është thirrur dhe pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasi Suart Domi i cili ka deklaruar "*...Rasti konkret nuk me kujtohet por me pare, para se te arrestoheshin punonjësit, mua më kanë kontrolluar dhe më kanë futur edhe ne skaner dhe me kanë kontrolluar. Nuk me kane kërkuar*

leke ne ndonjë rast dhe nuk me kujtohet si rast.". Në lidhje me këtë rast, në kushtet kur nga provat nuk rezulto se cili është punonjësi i policisë që ka futur brenda në kabinë shtetasin dhe i ka kërkuar para, nuk mund të konkludohet mbi mundësinë e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së të pandehurit Muhamet Cengu në lidhje me këtë ngjarje. Përveç kësaj, nuk rezulton te jene referuar dhe individualizuar fjalët më të cilat vetë Muhameti i është drejtuar këtij shtetasi, për të konkluduar nëse veprimet e punonjësve të policisë (*Muhamet dhe kolegu u paidentifikuar gjatë hetimit*) kanë vepruar së bashku në funksion të arritjes së një qëllimi të përbashkët kriminal. Në orën 16.20 minuta, nga pamjet filmike shihet teksa kontrollori Muhamet Cengu merr një kartëmonedhë e cila në procesverbalin e këqyrjes përshkruhet si "e ngjashme me 100 paud", dhe nuk rezulton që në këtë hark kohor të jetë regjistruar personi që ka kaluar kufirin dhe ka dhënë këtë kartëmonedhë. Në orën 17.31 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Kujtim Krasniqi shihet te marrë prej tij 10 euro ndërkohe që me herët i drejtohet ndër te tjera, me fjalët "*Futi qitu një kafe*", pra duke i kërkuar mitë. Në orën 10.09 minuta shihet teksa merr nga shtetasi në sportel 5 euro, të cialt ihsin vendpsir nga shtetasi brenda dokumenteve që i jep kontrollorit dhe ndërkohë, nga sistemi TIMS rezulton se ka përpunuar në këtë orë dokumentet e shtetasit Ilir Berisha. Në orën 10.20 minuta, teksa përpunon dokumentet e një shtetasi të cilin nuk e ka regjistruar ne sistem, shihet që merr 5 euro. Në orën 11.23 minuta, ndërsa është duke përpunuar dokumentet e shtetasit, i cili sipas të dhënave të marra nga sistemi rezulton te jetë Fetah Sahiti, i merr 5 euro, të vendosura brenda dokumenteve që shtetasi i jep dhe i kërkon edhe 10 euro të tjera, duke ia kthyer dokumentin mbrapsht me qëllim vendosjen e tyre. Pas këtij momenti rimerr dokumentin dhe merr prej aty shumën. Në orën 09.42 minuta, merr serish 5 euro nga shtetasi që ka në përpunim dhe ky i fundit, ndërkohe që i jep dokumentet i drejtohet me fjalët "Qyrë një kafe". Në orën 11.46 minuta, teksa është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi kosovar, për të cilin nuk kanë rezultuar shënime në rubrikën hyrje në sistem, merr prej tij një kartëmonedhe që në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike përshkruhet si preje 100 euro. Në orën 13.08 minuta shihet teksa merr shumën 20 euro nga shtetasit në sportel, ndërkohë që nuk ka kryer veprimet e përpunimit dhe regjistrimit të dokumenteve të këtij shtetasi në sistem. Në orën 13.27 minuta shihet teksa merr shumën 10 euro nga shtetasi Edi Hoxhaj i regjistruar ne sistemin TIMS, ndërkohë që nuk rezulton te jene përpunuar dhe regjistruar personat e tjerë që udhëtojnë me të. Në orën 14.23 minuta, gjatë përpunimit te dokumenteve të shtetasve Naheri Kryeziu dhe Valentina Qoqaj, merr ne dy momente nga 5 euro prej tyre. Në orën 14.41 minuta shihet teksa merr 10 euro nga personi i paraqitur ne sportel, kundrejt mos regjistrimit të dokumenteve të tij në sistem. Në orën 08.32 minuta nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio dëgjohet t'iu kërkojë "kafe" udhëtareve, duke marrë prej tyre shumën 5 euro, sipas pamjeve filmike. Në orën 09.45 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasve Besim Ramnabaja dhe Idriz Gashi, ka marrë prej tyre 5 euro të cilat ia kishin vendosur në pasaportë. Në orën 09.54 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Ekrem Rashica, shihet se ka marre, nëpërmjet vendosjes në dokumentet e udhëtimit, një kartëmonedhë për te cilën nuk përcaktohet prerja, kundrejt mos regjistrimit në sistem të pasagjereve që ushtrojnë me këtë shtetas. Pra në datë 20.02.2022, rezulton se pothuajse gjatë gjithë kohës së shërbimit të tij, në orare të ndryshme, kontrollori

Muhamet Cengu kërkon dhe/ose merr apo pranon shuma parash nga shtetasit që paraqiten për të kaluar kufirin hyrës për në Shqipëri, kundrejt mos regjistrimit të tyre ne sistem apo kundrejt tolerimit prej tij për të kaluar kufirin, pavarësisht mungesës së dokumenteve të udhëtimit, vaksinimit apo dokumenteve të mjeteve.

779. *Së pesti*, në datë 28.02.2022, nga pamjet video dhe regjistrimi audio si dhe të dhënat e marra në sistemin TIMS, kanë rezultuar katër raste në të cilat kontrollori në shërbim Muhamet Cengu, provohet se ai kërkon dhe merr nga shtetasit e përpunuar në pikën hyrëse shuma parash. Konkretisht në orën 09.01 minuta gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Zade Sylejmnai, i ka marrë 5 euro, të cilat fillimisht i fut poshtë tastierës dhe pas largimit të shtetasit nga sporteli i merr. Në orën 09.08 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasve Granit Krasniqi dhe Dardan Jupolli, i ka kthyer atyre dokumentet duke ju drejtuar me fjalët "*rregullojeni..*" dhe pasi rimerr dokumentin, nxjerr prej aty kartëmonedhën 20 euro. Në orën 10.26 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit Muhamet Jasari, i drejtohet me fjalët "*A ban me na respektu me nje pafe tashi? Hajd!*" dhe ndërkohe shihet shtetasi që i jep 5 euro të cilat merren nga kontrollori Muhamet Cengu. Në orën 10.47 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Armir Cengu, ka marrë prej tij 2 mije lekë. Në orën 16.37 minuta, është fiksuar në tjetër moment i dyshimet për marrje parash por nuk dokumentohet qartë. Në orën 16.41 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasve kosovarë Nexhmendin Sopi dhe Hamdi Ibrahimi, në një fletë të bardhe të cilën e vendos para pajisjes skaner, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike përshkruhet se " dallohet që shtetasi ti japë ryshfet" por nuk rezulton nga pamjet te jetë bërë e dukshme ndonjë kartëmonedhë apo regjistruar biseda që bëjnë të besueshëm këtë fakt. Në orën 16:53 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e disa shtetasve, ndër të cilët edhe Ekrem Hajdari që është i vetmi që është regjistruar në sistem, shihet se Muhameti Ngre tastierën e kompjuterit, veprim i cili në procesverbalin e këqyrjes përshkruhet si " veprim i cili kryhet pas çdo rasti marrje ryshfeti" por nuk evidentohet ndonjë kartëmonedhë apo shumë e marrë si dhe kërkimi i saj nga biseda e kryer.

780. *Së gjashti,* në datë 04.03.2022, janë dokumentuar nga regjistrimi video, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, se kontrollori në shërbim Muhamet Cengu ka kërkuar ose ka marrë para nga udhëtaret dhe konkretisht: Në orën 11.196 minuta, teksa përpunon dokumentet e një shtetasi, kërkon para, *duke ju drejtuar ndër të tjera me fjalët : Cengu M: A ke për të ma dhënë librezën...Librezen a ke për të ma dhënë? Shtetasi: Po. Cengu M: A ke tuj na e fut noj birre në të, a jo? Shtetasi: Ëeee.Cengu M: A je tuj na qëras me ndonjë birrë ajo? Shtetasi: Po, po...Cengu M: Po fute me libreze more...ne Kosovë pse të lënë me bo dorëheqje o njish.* Sipas pamjeve filmike dhe verifikimit të kryer në sistemin TIMS, rezulton se nuk kryen veprimet për regjistrimin e dokumenteve ne sistem. Në orën 11.28 minuta, merr një sasi kartëmonedhash, pro që nuk dallohet nga pamjet prerja e tyre, nga shtetasi që ka në përpunim në sportel, i cili sipas të dhënave të sistemit TIMS rezulton te ketë qenë Petrit Basha. Në orën 12.06 minuta, teksa përpunon dokumentet te shtetasit Burim Kadriu, i kërkon atij para, duke iu drejtuar, ndër të tjera, me fjalët : *Cengu M: autorizim per makinën keni ? Shtetasi:...Jo, bre . Cengu M: Po pse ske marre bre ?Gengu M: Po mire shifet si je...apo....Ec pak para, hajde meri*

dokumentat dhe ketë radhe do të kaloj hrën tjeter s'kalo." Pasi kontrollori mbaron përpunimin e tij shtetasi, ky u fundit shihet teksa kthehet dhe i jep një kartëmonedhë kontrollorit, i cili ngre tastjerën e kompjuterit dhe e vendos nën të. Në orën 12.06 minuta, shihet teksa merr nga nje shtetas një shumë prej 1000 lekësh të cilën e vendos në tastieren e kompjuterit. Në orën 10.24 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit kosovar Reshat Qela, i kërkon atij para duke ju drejtuar me fjalët : *Cengu M: Si kalove c'ar bone...nga po shkon...çar eshte ai...A ka noj kafe ore...Shtetasi: C'farë ? Cengu M: Kafe, kafe a ka a?"*, dhe sapo mbaron regjistrimin në sistem të shtetasit, Muhamet Cengu shihet teksa ngre tastierën dhe vendos diçka nën të.

781. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *08.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Dashnor Braha, dhe i vetëm ne datat 10.02.2022, 12.02.2022,20.02.2022, 28.02.2022 dhe 04.03.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri Muhamet Cengu, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pavarësisht se në një pjesë të raste nuk identifikohet qartë arsyeja konkrete, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

782. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 08.02.2022, në një prej episodeve, rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurin Dashnor Braha, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date rezulton dhe pjesëmarrja e këtij të fundit në realizimin e qëllimit kriminal. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit, në bashkëpunim me kolegun e tij, të pandehurin Dashnor Braha, sipas ngjarjeve të zhvilluara në datë 08.02.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Muhamet Cengu.

783. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Muhamet Cengu, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 8.2.2022) në bashkëpunim me kolegët e tij, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës,

duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

784. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Muhamet Cengu, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, është në dijeni dhe bashkëpunon në një rast edhe me kolegun e tij Dashnor Braha, për arritjen e qëllimit.

785. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se i pandehuri Muhamet Cengu përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Muhamet Cengu ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

786. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Muhamet Cengu është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion

duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Muhamet Cengu, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

787. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Muhamet Cengu**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Dashnor Braha, në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 08.02.2022 ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të provuara, analizuar më sipër në presën që lidhet me anën objektive të veprës penale.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurës ELIDJANA TOÇILA

788. Lidhur me të pandehurën **Elidjana Toçila**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Elidjana Toçila ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollore, *në ngjarjet e datave 13.02.2022, 01.03.2022, në bashkëpunim me të pandehurin Haqif Halilaj dhe të pandehurin Ani Hoxholli dhe datë 05.03.2022.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, e pandehura Elidjana Toçila, vetëm dhe në një nga episodet në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Haqif Halilaj, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej saj gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

789. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën ku ka kryer shërbimin në datë 13.02.2022, ora 11.27 minuta, e pandehura Elidjana Toçila, rezulton se gjatë përpunimit të dokumentacionit të një shtetasi kosovar, kontrollorja i kërkon dokumentet e vaksinimit dhe në momentin që shtetasi konstatohet se nuk i ka ato, i kërkon të hapë krahun dhe vijon përpunimin

e udhëtarëve të tjerë. Në vijim shtetasi kosovar i konstatuar me mungesë të dokumenteve të vaksinimit dhe, pas komunikimit më të, në tavolinën e punës së kontrollores pamjet filmike fiksojnë vendosjen e një kartëmonedhe 5 euro në anë të pajisjes skanuese, ndërkohe që ajo i drejtohet punonjësit tjetër të policisë që është paraqitur pas këtij momenti, identifikuar si Halim Shehu duke i thënë se ka mbaruar punë vetë. Këto veprime të saj, ndër të tjera, sipas bisedave të transkriptuara, janë shoqëruar edhe me fjalët që ajo i drejtohen shtetasit kosovar duke i thënë "*Unë nuk e di, mua më duhen dokumentet ta verifikoj, Pa dokumente nuk...nuk lejohet, ti s'ke çfarë njëherë, të paktën ta kishe..*", "*...jo jo të duhen vaksinat, hape krahun ta mendojmë njëherë, vazhdo të lutem hape krahun..*", "*Prit aty sa të vijë shefi të bisedosh me shefin..*" *dhe ndërkohe shtetasi i drejtohet me fjalët "A me ta qit një kafe...*", ndërsa pasi është fiksuar vendosja e shumës 45 euro pranë pajisjes skanuese dhe më pas vjen "shefi" siç referohet ne bisedë, ajo i drejtohet atij me fjalët "*Mbarova punë, mbarova vetë.*". Në këtë rast rezulton e qartë se kontrollorja Elidjana Toçila ka pranuar dhe marrë nga shtetasi kosovar 5 euro në funksion të lejimit të udhëtimit të tij pa dokumente vaksinimi, ndërkohe që pavarësisht se evidentohet ardhja e punonjësit e tjerë të identifikuar si Halim Shehu, rezulton se ky fakt ka ndodhur pas marrjes së shumës, dhe nuk rezulton nga komunikimet pjesëmarrja e këtij të fundit në veprimet e kryera nga e pandehura Elidjana Toçila në lidhje me këtë ngjarje.

790. *Së dyti,* në datë 01.03.2022, ora 09.21 minuta , në kabinën ku është duke kryer shërbimin e tij punonjësi i policisë Haqif Halilaj, nga pamjet filmike rezulton se është futur e pandehura Elidjana Toçila e cila sipas pamjeve, fiksohet etka nxjerr nga xhepi i saj një sasi kartëmonedhash të palosura të cilat ja jep Haqif Halilajt. Më pas në orën 09.30 në këtë kabinë ku ende qëndron në shërbim Haqif Halilaj futet punonjësi tjetër Ani Hoxholli, me detyrë përgjegjës grupi, dhe mes këtyre të fundit zhvillohet kjo bisedë: *Ani Hoxholli: .....komplet ..? Haqif Halilaj:....të gjitha duke përfshirë edhe Anin, ..e ja dhashë, thashë me e heq qafet,...nga s'të shkon mendja he nanaën,..po më kërkojnë ato për deklarim e hiq. Ani Hoxholli: -e pa trnaskiptueshme- Haqif Halili: ...ë...edhe komandanti tha se, a ta pyes..(nuk kuptohet qartë).* Në vijim në prën 09.31 minuta, në kabinën ku zhvillohen ngjarjet si më sipër, futet punonjësja tjetër e identifikuar si Rezarta Lako me detyrë kontrollore, e cila fiksohet nga pamjet filmike duke nxjerrë para nga xhepi të cilat ja jep kontrollorit Haqif Halilaj, ndërkohë që prezent në kabinë vijon të jetë ende përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli. Rezarta Lako, sipas procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve të regjistruar video dhe audio, pasi dëgjohet kontrollori Halilaj teksa thotë " *...në rregull, ja mora atij .....dhe ja dhashë Mondit.....me paguar arkëtarin bre, e thashë të ja qojmë, në rast se i ke..?"* nxjerr kartëmonedhat dhe ja jep këtij të fundit, ndërkohë që pas këtij momenti, mes punonjësit Haqif Halilaj dhe përgjegjësit të turnit Ani Hoxholli është transkriptuar edhe biseda si vijon: *Haqif Halilaj:....se di, këto grupet tjera a mbaruan punë,.....unë mbarova me ta, se ndoshta mbaron punë sot me drejtorin...!? Ani Hoxholli: ..duhet të kenë mbaru, Haqif Halilaj :...se data 1 sot..!".* Lidhur me këto veprime dhe arsyen e dorëzimit të shumës së parave siç fiksojnë pamjet filmike, e pandehura Elidjana Toçila nuk rezulton të ketë dhënë shpjegime, pasi e pyetur në cilësinë e të pandehurës, sipas procesverbalit te pyetjes me datë 04.10.2022, nuk ka dhënë shpjegime për faktin apo akuzën por ka parashtruar

qëndrimin e saj për kompetencën lëndore dhe tokësore të Prokurorisë së Posaçme[37]. Lidhur me këtë episod dhe ngjarjet që kanë ndodhur në këtë datë në kabinën ky kryen shërbimin i pandehuri Haqif Halilaj, duke iu referuar dinamikës së ngjarjes, veprimeve të kryera nga e pandehura Elidjana Toçila dhe në vijim nga e pandehura tjetër Rezarta Lako e cila kryen po të njëjta veprime në drejtim të kontrollorit Haqif Halilaj, si dhe biseda e zhvilluar nga ky i fundit me përgjegjësin e turnit, në mungesë edhe të një shpjegimi relevant mbi shkaqet e dorëzimit të këtyre shumave tek kontrollori Halilaj, gjykata vlerëson se ky fakt dëshmon kryerjen e veprimeve në bashkëpunim mes të pandehurve Elidjana Toçila, Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, ky e pandehura Elidjana Toçila dorëzon paratë e marra tek kolegu i saj, dhe mbi këto shuma të grumbulluara zhvillohen më tej bisedat mes Haqif Halilajt dhe Ani Hoxhollit mbi arsyet e mbledhjes së këtyre parave, çka tregon qartë kryerjen e veprimeve nga punonjësit e policisë si më sipër, në bashkëpunim më njëri tjetrin.

791. *Së treti*, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, rezulton se në datë 05.03.2022, ora 10.05 minuta, teksa është në shërbim punonjësja e policisë Elidjana Toçila, duke përpunuar dokumentacionin e shtetasit Jener Spahiu i cili udhëton me mjetin autobus me targa "05939FO", në bisedën mes tyre referohet se ka 46 pasagjerë në mjet. Ndërkohë kontrollorja pas merr dokumentin e drejtuesit të mjetit, nxjerr nga ky dokument kartëmonedhën 5 euro, e merr atë dhe e vendos poshtë tastierës së kompjuterit, duke vijuar me regjistrimin e dokumentit vetëm për drejtuesin e mjetit. Pas largimit të shtetasit, pamjet filmike kanë fiksuar të pandehurën teksa merr shumë 5 euro nga poshtë tastierës ku e kishte vendosur më parë dhe e fut në xhep.

792. *Së katërti,* sipas faktit penal të parashtruar nga Prokuroria, dhe provave të administruara, referohet edhe komunizmi mes saj dhe të pandehurit Reni Dokolli, sipas procesverbalit të këqyrjes së komunikimeve të këtij të fundit në telefonin e tij, se Reni i ka dërguar një foto ku shihet në sedijen e një makinë një shumë parash e përbërë nga kartëmonedha 50 euro. Lidhur me këtë fakt, nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Reni Dokolli dhe posaçërisht e komunikimeve të tij në aplikacionin whatsapp, rezulton se në datë 16.03.2022 punonjësi i policisë Reni Dokolli ka dërguar me video pamje filmike kontaktit të tij shënuar si "Diana Toçila" e cila është sipas verifikimit të numrit të kontaktit, e pandehura Elidjana Toçila, pamje në të cilat shihet se ku në sediljen e parë të një automjet shfaqen një parash prerje *50-euro.* Bashke me videon i shkruan *"Ja kshu kapen", ndërsa Elidjana i përgjigjet "A va mostre ti", " A lekt e shpive të nazmies", " Ore ruaji mos i harxho kot, e do na duhen për avokat" ndërsa Reni i përgjigjet "...i kam lën lekt për avokat unë kam mbaru pun..këto jan për tu prish para se të.arrestohem.*" Në lidhje me këtë fakt të referuar nga Prokuroria, nuk evidentohet ndonjë veprim ose mosveprim i të pandehurës Elidjana Toçila, në të cilin të konfigurohen elementet e figurës së veprës penale për të cilën ajo akuzohet apo elementë të ndonjë figure tjetër të veprës penale, përpos komunikimit të saj me të pandehurin Reni Dokolli me të cilin janë kolegë dhe nga bisedat në tërësinë e tyre, sipas procesverbalit të këqyrjes, rezulton se kanë komunikim të vazhdueshëm shoqëror.

---

[37] *Procesverbali i pyetjes së të pandehurës Elidjana Toçila, volumi 80.*

793. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *13.02.2022, 01.03.2022, 05.03.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se e pandehura Elidjana Toçila, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pa dokumente të plota lidhur me udhëtimin, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të saj në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të saj, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

794. Po ashtu rezulton se këto veprime të saj, janë kryer kundrejt kërkimit, në mënyrë të tërthortë, marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ajo ka lejuar kalimin e tyre në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion. Marrja dhe pranimi i shumave të parave (euro) të dhëna nga shtetasit, në një rast dhe konkretisht në atë të datës 01.03.2022, rezulton se është kryer nga kjo e pandehur, në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj datë, rezulton qartësisht se ajo dorëzon tek kontrollori Haqif Halilaj një shumë parash të cilat, sipas bisedës ë zhvilluar mes këtij të fundit dhe të pandehurit Ani Hoxholli duket qartësisht se janë të marra nga e pandehura nga shtetasit që kalojnë në kufi dhe dorëzohen tek Haqifi për tu ndarë më pas. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurës Elidjana Toçila, në bashkëpunim me kolegët e saj në ngjarjet e datës 01.03.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura Elidjana Toçila.

795. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurës Elidjana Toçila, ndër të cilat në një prej episodeve (*atë të datës 01.03.2022*) në bashkëpunim me të pandehurit Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se e pandehura është tërësisht e vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre. Po ashtu në një prej këtyre episodeve, siç rezultoi më sipër, e pandehura ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurit Hqqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, duke ndikuar secili prej tyre, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

796. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se e pandehura Elidjana Toçila, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

797. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se e pandehura Elidjana Toçila përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është e përgjegjshme, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, e pandehura Elidjana Toçila ka qenë punonjëse e strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

798. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se e pandehura Elidjana Toçila është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së

shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se e pandehura Elidjana Toçila, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

799. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se e pandehura **Elidjana Toçila**, duhet të deklarohet fajtore për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurit Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 01.03.2022, ndërkohë që ka vepruar e vetme në episodet e tjera të kryera në datat 13.02.2022 dhe 05.03.2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit HAQIF HALILAJ

800. Lidhur me të pandehurin **Haqif Halilaj**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 15.02.2022, dhe 01.03.2022, në këtë të fundit në bashkëpunim me të pandehurin Ani Hoxholli dhe Elidjana Toçila si dhe të pandehurën Rezarta Lako.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Haqif Halilaj, vetëm në ngjarjet e datës 01.03.2022 dhe në bashkëpunim me koleget e tij, në ngjarjet e datave 15.02.2022 dhe 23.02.2023, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej saj gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

801. *Së pari,* nga pamjet filmike, vetëm video, regjistruar në kabinën nr.4, ku ka kryer shërbimin në datë 15.02.2022, ora 07.45 minuta, punonjësi i policisë në shërbim, i identifikuar si Haqif Halilaj, rezulton se merr një shumë parash, por që për shkak të mungesës së audios në regjistrim si dhe për shkak se jepen dhe merren të mbledhura, nuk dallohet prerja e tyre, nga shtetasi dokumentacionin e të cilit ka përpunuar në këtë moment, që sipas sistemit TIMS rezulton të jetë Musa Ahmeti. Në vijim, në orën 07.48 të po kësaj datë, pamjet filmike pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes (vetëm video) dokumentojnë marrjen prej tij të një kartëmonedhe 5

euro gjatë përpunimit të dy kartave të identitetit kosovare. Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se shtetasit që janë përpunuar në këtë hark kohor dhe që i kanë dhënë kontrollorit Haqif Halilaj 5 eurot e fiksuara nga pamjet filmike, janë shtetasit kosovarë Luan Shala dhe Arbenit Beqiraj. Në orën 07.53 të po kësaj datë, pamjet filmike kanë fiksuar kontrollorin në shërbim Haqif Halilaj i cili teksa përpunon dokumentet e shtetasit kosovar Jordan Memia dhe gjatë kontrollit të dokumenteve, shihet se midis tyre kontrollori merr një kartëmonedhë, prerja e së cilës nuk përcaktohet për shkak se nga pamjet filmike rezulton se kontrollori i ka mbajtur dhe tërhequr ato para kompjuterit të punës. Nuk rezulton të jetë transkriptuar komunikimi mes tyre për të identifikuar arsyen e pranimit të shumës së parave nga shtetasi Jordan Memia.

802. *Së dyti,* po në datë 15.02.2022, në orën *08:13:46 min*, ndërkohë që vijon shërbimin kontrollori Haqif Halilaj, regjistrimi video dhe audio i transkriptuar evidenton se ai thërret kolegun e tij, dhe pasi ai vjen ne kabinën e shërbimit, vendos në tavolinën e punës një kartëmonedhë 50 euro të cilën shihet se e merr Haqif Halilaj. Ndërkohë që ndodh ky veprim, mes tyre është zhvilluar biseda si më poshtë: *Haqif Halilaj: Mbarova unë me Ilirin. Punonjësi tjetër që vjen në kabinë: Atë lej unë ty këto t'ja japësh... (koha kur i hedh mbi tavolinë 50-euro). Haqif Halilaj: Po mo lej. Punonjësi tjetër: Ma kryj ti mos ta nij hiç (ndërkohë pamjet filmike tregojnë se i vendos edhe një 50-tëshe euro tjetër mbi tavolinë të cilat merren të dyja nga punonjësi i Haqif Halilaj).* Sipas pamjeve filmike, shihet se ndërkohë që Haqif Halilaj përpunon dokumente në sistem, në sportel nuk ka udhëtarë që të shihet se janë duke u përpunuar dhe kanë dorëzuar dokumentet pranë tij. Ndërkohë që ai vijon përpunimin e pasaportës, në kabinën e shërbimit të tij vjen një punonjës tjetër policisë dhe ndërkohë zhvillohet një komunikim, me kolegun e ardhur rishtas të cilit ai i thërret me emrin "Arben". Midis tyre është transkriptuar biseda në vijim: *Haqif Halilaj: O Arben, O Arben. Arbeni: Po.* Në këtë moment shihet Haqif Halilaj që i jep 50 euro dhe i drejtohet me fjalët*: Haqif Halilaj: Halimi ééé* . Bisedaj vijon *: Arbeni: Arjani? Haqif Halilaj: Po. Une ti, Ylberi, Halimi, No koment me të tjerët. Arbeni: - Fjalë që nuk kuptohen- Haqif Halilaj: Thashë unë ti Ylberi edhe Halimi, tjeter kush jo, Ok ne rregull. Janë dhënë...që mos dalim dh...Arbeni: Jo jo edhe unë i thashë 100 mijë lekë kam bërë gjynah...e takova poshtë tek dogana. Haqif Halilaj: Po no koment me të tjerët. Arbeni: Jo Jo jo.* Nga pamjet filmike rezulton se punonjësi i policisë, i cili thërritet Arben dhe për të cilën referon ngjarja dhe komunikimit si më sipër, mban numrin identifikues, "05578" dhe nga verifikimi në sistem rezulton të jetë Arben Goçi. Në bisedën mes tyre përmenden emrat e punonjësve "Ylber, Halim, Arjan" por nuk rezulton që nga pamjet filmike, apo prova të tjera, të jetë identifikuar se cili ka qenë punonjësi që ka hyre me herët se sa Arben Goçi në kabinën e shërbimit të kontrollorit Halilaj dhe i ka lënë këtij të fundit dy herë, nga 50 euro si dhe nuk identifikohet qartë qëllimi, duke pamundësuar përcaktimin e prezencës së elementeve të veprës penale, sa kohë nuk ka të dhëna nga prova të tjera, veç këtyre veprimeve dhe komunikimit mes vetë punonjësve të policisë në këtë rast.

803. *Së treti*, në datë 23.02.2022, në kabinën ku është duke kryer shërbimin kontrollori Haqif Halilaj, në harkun kohor 07.41 minuta deri në 06.12 minuta, në kabinën ku është duke kryer shërbimin kontrollori Haqif Halilaj, janë zhvilluar disa biseda të tij me kolegun e tij që vjen në

kabinë, dhe që sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve referohet se nga uniforma rezulton se mban gradën nën/Komisar, dhe që në bazë të gradës referohet se është përgjegjës turni, por nuk rezulton të jetë identifikuar se cili nga kolegët e tij është saktësisht. Jaën regjistruar audio dhe video tre episode komunikimi mes tyre, të cilat paraqiten si vijon: Në orën ***07:41:09,*** teksa që është duke punuar kontrollori Haqif Halilaj, në kabinën e shërbimit të tij, është futur një person me uniformë policie i cili mban gradën nën komisar dhe mes tyre zhvillohet kjo bisedë: *Haqif Halilaj: Ej, po Arjani, kishte maru punë, ne akshm promë ....promë ëëë...N/Komisari: Po bre, po ...Promë...Haqif Halilaj: Jo bre, se kaloi ai Nexhi...katër i kish marrë (duke treguar dhe kartër gishta të dorës së djathtë) katërdhjetë mij lekë...Nexhit... ai (Arjani) i kish marrë katërdhjetë mij lekë...Nexhit me furgon...Ej shi se me që është ky ketu... Ylberi se s'vej mo, për ç'et muje, ti dajme dhe ato të SHKB-së ...atje poshtë ...Ti heqim dhe ato qafe...Qysh thu ti ? ... se bën vaki... se s'kena datë tjeter ...se data 23 është sat... 28 ka muaji, qysh thu ?N/Komisari: Po a'ngjon ky, a jo!.Haqif Halilaj: Po ket e vendosin na, or ti....A ti dha lekët, a jo...N/Komisari: Gjysma lekë, gjysma euro....Haqif Halilaj: Ok... pra që ti ndajmë....Na për ti dhënë i kena.N/Komisari: Sa kemi për të dhënë... nga njëqind ëëë....Haqif Halilaj: 100 (njëqind) si grup. N/Komisari: Ani, ani ...250 euro i kam unë...Haqif Halilaj: Po mirë...".* Pak minuta më vonë, në orën 07.56 minuta, dëgjohet se zhvillohet një bisedë, midis kontrollorit dhe punonjësit të policisë me gradën N/Komisar, me këtë përmbajtje: N/Komisari: *A s'të tha gjë, për ju të dyve pramë ai, për atë... për grupin ...4 (katër) grupe nga 70 euro, 280 euro... promë 170,...20 mijë lekë, tha...Haqif Halilaj: Aaa.....Halimi...A do ti marri komandanti ...a do ti marri.* N/Komisari: *...250 euro i kam unë. Haqif Halilaj: Po pse, pak janë aaa...!N/Komisari: 220 do Halimi ... Haqif Halilaj: Nga 40 (katërdhjetë) lekë...ja dhashë tashti...pyete, a do ti majë komandanti, a s'do ti majë ...tashi i dhashë. N/Komisari: Mirë, ti i dhe katërdhjetë (40)... Haqif Halilaj: Po kallzoj që unë i kam dhënë....* Pas kësaj bisede punonjësi tjetër largohet nga kabina. Pak minuta më vonë, *në orën 06:12:05* në kabinën që janë instaluar mjetet e përgjimit me nr.6 dhe ku është duke punuar kontrollori Haqif Halilaj, hyn një me person me uniformë policie dhe me graden e N/Komisarit dhe referohet në procesverbalin e këqyrjes dhe transkriptimit të komunikimit se flet me dialekt jugor, dhe mes tij dhe Haqifit zhvillohet kjo bisede: N/*Komisari: Ku kishte qenë "shqipoja". Halilaj: Sa kalon Abedin Oruçin....N/Komisari: Aha.. ai o...,po qe kthyer në Rinas. Halilaj: Po ç'aty kishin qënë, tha... e pashë që nuk e nalën, tha...nejta, nja dy minuta tek Abedin Oruçi, tha dhe e pashë që kaloi dhe u ktheva....N/Komisari: Me një fjalë, ata se ndalën...Halilaj: Jo....Tre herë kanë shkuar more, me marrë një....N/Komisari: Sot....Halilaj: Po ore ...A shkoj një herë në darkë në orën nëntë, me at Matoshin ...promë, me Shehin, dy ...tash në mëngjes, tre...tre herë... do me ja lënë nja 20 euro...Ja lomë pas darke, ma vonë...Ej nuk është djali i keq, ai...Nuk është djali keq...".* Referuar këtyre komunikimeve, rezulton se kontrollori Haqif Halilaj ndërsa është duke kryer shërbimin, komunikon në tre episode të ndryshme me tre punonjës policie, kolege të tij, por nuk evidentohen ngjarje konkrete në të cilat është zhvilluar veprimtaria e kërkimit, marrjes ose pranimit të përfitimeve të paligjshme prej tij apo në bashkëpunim me secilin nga këta tre kolegë të tij me të cilat zhvillon bisedat. Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se përmbajtja e këtyre bisedave përbën indicje mbi veprimtarinë e

kundërligjshme objekt akuze, e cila mbështet të dhënat që rezultojnë nga provat, në rastet e tjera të konstatuara për këtë të pandehur, por nuk përbejnë provë për të provuar nëpërmjet tyre, një fakt penal konkret në ngarkim të këtij të pandehuri apo kolegëve me të cilët zhvillon bisedat e referuara më sipër, të cilët rezulton të mos jenë identifikuar saktësisht se cilët janë.

804. *Së treti,* në datë 01.03.2022, ora 09.21 minuta, sipas regjistrimit video dhe audio, pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes dhe transkriptimit, evidentohet se, në kabinën ku është duke kryer shërbimin e tij punonjësi i policisë Haqif Halilaj, është futur e pandehura Elidjana Toçila e cila sipas pamjeve, fiksohet etka nxjerr nga xhepi i saj një sasi kartëmonedhash të palosura të cilat ja jep Haqif Halilajt. Më pas në orën 09.30 në këtë kabinë ku ëndë qëndron në shërbim Haqif Halilaj futet punonjësi tjetër Ani Hoxholli, me detyrë përgjegjës grupi, dhe mes këtyre të fundit zhvillohet kjo bisedë: *Ani Hoxholli: .....komplet ..? Haqif Halilaj:....të gjitha duke përfshirë edhe Anin, ..e ja dhashë, thashë me e heq qafet,...nga s'të shkon mendja he nanën,..po më kërkojnë ato për deklarim e hiq. Ani Hoxholli: -e pa transkriptueshme- Haqif Halili: ...ë...edhe komandanti tha se, a ta pyes..(nuk kuptohet qartë).* Në vijim në orën 09.31 minuta, në kabinën ku zhvillohen ngjarjet si më sipër, futet punonjësja tjetër e identifikuar si Rezarta Lako me detyrë kontrollore, e cila fiksohet nga pamjet filmike duke nxjerrë para nga xhepi të cilat ja jep kontrollorit Haqif Halilaj, ndërkohë që prezent në kabinë vijon të jetë ende përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli. Rezarta Lako, sipas procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve të regjistruar video dhe audio, pasi dëgjohet kontrollori Halilaj teksa thotë " *...në rregull, ja mora atij .....dhe ja dhashë Mondit.....me paguar arkëtarin bre, e thashë të ja qojmë, në rast se i ke..?"* nxjerr kartëmonedhat dhe ja jep këtij të fundit, ndërkohë që pas këtij momenti, mes punonjësit Haqif Halilaj dhe përgjegjësit të turnit Ani Hoxholli është transkriptuar edhe biseda si vijon: *Haqif Halilaj:....se di, këto grupet tjera a mbaruan punë,.....unë mbarova me ta, se ndoshta mbaron punë sot me drejtorin...!? Ani Hoxholli: ..duhet të kenë mbaru, Haqif Halilaj :...se data 1 sot..!".* Lidhur me këto episode dhe ngjarjet që kanë ndodhur në këtë datë në kabinën ky kryen shërbimin i pandehuri Haqif Halilaj, duke iu referuar dinamikës së ngjarjes, veprimeve të kryera nga e pandehura Elidjana Toçila dhe në vijim nga e pandehura tjetër Rezarta Lako e cila kryen po të njëjta veprime në drejtim të kontrollorit Haqif Halilaj, si dhe biseda e zhvilluar nga ky i fundit me përgjegjësin e turnit, në mungesë edhe të një shpjegimi relevant mbi shkaqet e dorëzimit të këtyre shumave tek kontrollori Halilaj, gjykata vlerëson se ky fakt dëshmon kryerjen e veprimeve në bashkëpunim mes të pandehurve Heqif Halilaj me të pandehurit Elidjana Toçila, Rezarta Lako dhe Ani Hoxholli, ku të pandehurit Haqif Halilaj në shërbim i dorëzohen nga dy punonjëset e tjera shuma parash dhe ndërkohë ai zhvillon në këtë kontekst bisedat e transkriptuara me përgjegjësin e turnit Ani Hoxholli mbi këto shuma të grumbulluara dhe mbi arsyet e mbledhjes së këtyre parave, çka dëshmon kryerjen e veprimeve nga punonjësit e policisë si më sipër, në bashkëpunim më njëri tjetrin.

805. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *15.02.2022, 23.02.2023 dhe në ngjarjet e datës 01.03.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Ani Hoxholli dhe Elidjana Toçila si dhe të pandehurën Rezarta Lako*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e

pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri Haqif Halilaj, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pavarësisht se nuk identifikohet qartë arsyeja konkrete, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të saj, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

806. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi,. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 01.03.2022 rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë Rezarta Lako, Elidjana Toçila dhe Ani Hoxholli, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date si dhe indicjet që referojnë komunikimet mes tij dhe tre përgjegjësve të turnit (*te papërcaktuar se cilët kanë qenë konkretisht*), japin të dhëna mbi mënyrën e veprimit dhe rolin e të pandehurit Haqif Halilaj në mbledhjen e shumave të parave nga disa prej punonjësve *(konkretisht të pandehurat Elidjana Toçila dhe Rezarta Lako*) në funksion të ndarjes së tyre në drejtim të punonjësve të tjerë, të papërcaktuar, sipas bisedave të zhvilluara prej tij me përgjegjësit e turnit në datë 23.02.2023 si dhe bisedave të zhvilluara me përgjegjësin e turnit Ani Hoxholli në datë 01.03.2022,nga të cilat rezulton edhe dijenia dhe pjesëmarrja e këtij të fundit në realizimin e qëllimit kriminal. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Haqif Halilaj, në bashkëpunim me kolegët, sipas ngjarjeve të zhvilluara në datë 01.03.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Haqif Halilaj.

807. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Haqif Halilaj, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 01.03.2022) në bashkëpunim me kolegët e tij, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre dhe po ashtu, është në dijeni dhe bashkëpunon me koleget e tij për mbledhjen e shumave të parave të marra nga këta të fundit, në funksion të rindarjes së tyre, sipas një skeme që përmendet qartë në komunikimet e tij me eproret (përgjegjësit e turnit në datat 23.02.20222 dhe 01.03.2022) pavarësisht se nuk është arritur të provohet fakti se në drejtim të

cilit prej punonjësve të policisë shkojnë këto para të grumbulluara. Po ashtu në këto episode, siç rezultoi më sipër, i pandehuri Haqif Halilaj ka vepruar në bashkëpunim me koleget e tij, duke ndikuar secili prej tyre, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

808. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Haqif Halilaj, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, është në dijeni dhe bashkëpunon me koleget e tij për grumbullimin e shumave të parave, në funksion të ndarjes së tyre sipas skemës që rezulton nga komunikimet e zhvilluara midis tyre.

809. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se i pandehuri Haqif Halilaj përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Haqif Halilaj ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

810. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Haqif Halilaj është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Haqif Halilaj, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

811. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Haqif Halilaj**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurit Rezarta Lako, Elidjana Toçila dhe Ani Hoxholli, në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 01.03.2023 ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e datës 15.02.2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurës REZARTA LAKO

812. Lidhur me të pandehurën **Rezarta Lako**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollore, *në ngjarjet e datave 17.02.2022 dhe 01.03.2022, në bashkëpunim në këtë datë me të pandehurit Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se e pandehura Rezarta Lako, në ngjarjet e datës 01.03.2022 dhe në bashkëpunim me koleget dhe në ngjarjen e datës 17.02.2022 ka marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej saj gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

813. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr.4, ku ka kryer shërbimin në datë 17.02.2022, ora 10.47 minuta, punonjësja e policisë në shërbim, e identifikuar si Rezarta Lako, rezulton se merr një shumë parash prej 5 eurosh gjatë përpunimit të dokumenteve te shtetasve në sportel, pasi siç rezulton nga regjistrimi video dhe audio nuk kishte dokument identifikimi me vete por e ka pasur atë vetëm të fotografuar në telefonin e tij celular. Nga procesverbali i këqyrjes së pamjeve filmike referohet se prezent është në këtë kohë edhe një punonjës tjetër policie (nga uniforma referohet se mban një yll në të) i cili i thotë "*Mbrapsht, ktheje mbrapsht*", por ndërkohë pamjet filmike dokumentojnë se Rezarta Lako shihet që ka marrë shumën 5 euro të cilën e vendos në hapësirën mes tastierës se kompjuterit dhe disa momente me pas e merr. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ky shtetas nuk është regjistruar në sistem, pasi siç rezulton nga regjistrimi video, ai nuk kishte me vete dokumentin e identifikimit, për te mundësuar skanimin, regjistrimin dhe kalimin e rregullt te kufirit.

814. *Së dyti,* në datë 01.03.2022, ora 09.21 minuta, sipas regjistrimit video dhe audio, pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes dhe transkriptimit, evidentohet se, në kabinën ku është duke kryer shërbimin e tij punonjësi i policisë Haqif Halilaj, është futur e pandehura Elidjana Toçila e cila sipas pamjeve, fiksohet etka nxjerr nga xhepi i saj një sasi kartëmonedhash të palosura të cilat ja jep Haqif Halilajt. Më pas në orën 09.30 në këtë kabinë ku ëndë qëndron në shërbim Haqif Halilaj futet punonjësi tjetër Ani Hoxholli, me detyrë përgjegjës grupi, dhe mes këtyre të fundit zhvillohet kjo bisedë: *Ani Hoxholli: .....komplet ..? Haqif Halilaj:....të gjitha duke përfshirë edhe Anin, ..e ja dhashë, thashë me e heq qafet,...nga s'të shkon mendja he nanën,..po më kërkojnë ato për deklarim e hiq. Ani Hoxholli: -e pa transkriptueshme- Haqif Halili: ...ë...edhe komandanti tha se, a ta pyes..(nuk kuptohet qartë).* Në vijim në orën 09.31 minuta, në kabinën ku zhvillohen ngjarjet si më sipër, futet punonjësja tjetër e identifikuar si **Rezarta Lako** me detyrë kontrollore, e cila fiksohet nga pamjet filmike duke nxjerrë para nga xhepi të cilat ja jep kontrollorit Haqif Halilaj, ndërkohë që prezent në kabinë vijon të jetë ende përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli. Rezarta Lako, sipas procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve të regjistruar video dhe audio, pasi dëgjohet kontrollori Halilaj teksa thotë " *...në rregull, ja mora atij .....dhe ja dhashë Mondit.....me paguar arkëtarin bre, e thashë të ja qojmë, në rast se i ke..?"* nxjerr kartëmonedhat dhe ja jep këtij të fundit, ndërkohë që pas këtij momenti, mes punonjësit Haqif Halilaj dhe përgjegjësit të turnit Ani Hoxholli është transkriptuar edhe biseda si vijon: *Haqif Halilaj:....se di, këto grupet tjera a mbaruan punë,.....unë mbarova me ta, se ndoshta mbaron punë sot me drejtorin...!? Ani Hoxholli: ..duhet të kenë mbaru, Haqif Halilaj :...se data 1 sot..!".* Lidhur me këto episode dhe ngjarjet që kanë ndodhur në këtë datë në kabinën ky kryen shërbimin i pandehuri Haqif Halilaj, duke iu referuar dinamikës së ngjarjes, veprimeve të kryera nga e pandehura Elidjana Toçila dhe në vijim nga e pandehura tjetër Rezarta Lako e cila kryen po të njëjta veprime në drejtim të kontrollorit Haqif Halilaj, si dhe biseda e zhvilluar nga ky i fundit me përgjegjësin e turnit, në mungesë edhe të një shpjegimi relevant mbi shkaqet e dorëzimit të këtyre shumave tek kontrollori Halilaj, gjykata vlerëson se ky fakt dëshmon kryerjen e veprimeve në bashkëpunim mes të pandehurve Heqif Halilaj me të pandehurën Rezarta Lako dhe Ani Hoxholli, ku të pandehurit Haqif Halilaj në shërbim i dorëzohen nga dy

punonjëset e tjera shuma parash dhe ndërkohë ai zhvillon në këtë kontekst bisedat e transkriptuara me përgjegjësin e turnit Ani Hoxholli mbi këto shuma të grumbulluara dhe mbi arsyet e mbledhjes së këtyre parave, çka dëshmon kryerjen e veprimeve nga punonjësit e policisë si më sipër, në bashkëpunim më njëri tjetrin.

815. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datën *17.02.2022 dhe në ngjarjet e datës 01.03.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Ani Hoxholli dhe Haqif Halilaj*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se e pandehura Rezarta Lako, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka marrë shuma parash në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pavarësisht se mungesave ne dokumentacion, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të saj, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

816. Po ashtu rezulton se këto veprime te saj, janë kryer kundrejt marrjes dhe pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ajo ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 01.03.2022 rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date si dhe indicjet që referojnë komunikimet mes tij dhe tre përgjegjësve të turnit me të pandehurin Haqif Halilaj me herët (*te papërcaktuar se cilët kanë qenë konkretisht*), japin të dhëna mbi mënyrën e veprimit dhe rolin e të pandehurit Haqif Halilaj në mbledhjen e shumave të parave nga disa prej punonjësve, ndër të cilët edhe e pandehura Rezarta Lako, në funksion të ndarjes së tyre në drejtim të punonjësve të tjerë, të papërcaktuar, sipas bisedave të zhvilluara prej të pandehurit Haqif Halilaj me përgjegjësit e turnit në datë 23.02.2023 si dhe bisedave të zhvilluara me përgjegjësin e turnit Ani Hoxholli në datë 01.03.2022, nga të cilat rezulton edhe dijenia dhe pjesëmarrja e këtij të fundit në realizimin e qëllimit kriminal. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurës Rezarta Lako, në bashkëpunim me kolegët, sipas ngjarjeve të zhvilluara në datë 01.03.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura Rezarta Lako.

817. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurës Rezarta Lako, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 01.03.2022) në bashkëpunim me kolegët e saj, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se e pandehura është tërësisht e vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr

dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre dhe po ashtu, është në dijeni dhe bashkëpunon me koleget për mbledhjen e shumave të parave, në funksion të rindarjes së tyre, sipas një skeme që përmendet qartë në komunikimet e tij me eproret dhe të pandehurin dhe bashkëpunëtorin e saj Haqif Halilaj (*përgjegjësit e turnit në datat 23.02.2022 dhe 01.03.2022*) pavarësisht se nuk është arritur të provohet fakti se në drejtim të cilit prej punonjësve të policisë shkojnë këto para të grumbulluara. Po ashtu në këto episode, siç rezultoi më sipër, e pandehura Rezarta Lako ka vepruar në bashkëpunim me koleget, duke ndikuar secili prej tyre, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

818. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se e pandehura Rezarta Lako, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, është në dijeni dhe bashkëpunon me koleget për grumbullimin e shumave të parave, në funksion të ndarjes së tyre sipas skemës që rezulton nga komunikimet e zhvilluara midis tyre.

819. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se e pandehura Rezarta Lako përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, e pandehura Rezarta Lako ka qenë punonjëse e strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe

migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

820. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se e pandehura Rezarta Lako është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se e pandehura Rezarta Lako, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

821. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se e pandehura **Rezarta Lako**, duhet të deklarohet fajtore për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurit Haqif Halilaj dhe Ani Hoxholli, në një prej episodeve, konkretisht atë të datës 01.03.2023 ndërkohë që ka vepruar e vetme në episodin e datës 17.02.2022.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit URIM LAMI

822. Lidhur me të pandehurin **Urim Lami**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Vehbi Nerguti, 16.02.2022 në bashkëpunim e të pandehurën Xhuljana Maksutaj, si dhe në ngjarjet e datave 22.02.2022, 23.02.2022, 26.02.2022, dhe 02.03.2022.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat

duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Urim Lami, në ngjarjet e datave *14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Vehbi Nerguti, 16.02.2022 në bashkëpunim e të pandehurën Xhuljana Maksutaj, si dhe në ngjarjet e datave 22.02.2022, 23.02.2022, 26.02.2022, dhe 02.03.2022*, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

823. *Së pari,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio kryer në kabinën hyrëse nr.4, në datë 14.02.2022, në orën **09.35** minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve, të cilët sipas të dhënave të sistemit TIMS, rezulton të jetë shtetasi shqiptar Arbi Sopaj, kontrollori Urim Lami shihet teksa nxjerr nga një zarf një kartëmonedhe 5 euro të cilën e fut poshtë tastierës dhe e merr më pas. Në orën 09.52 minuta, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, referohet se ndërsa është duke punuar në kabinë Urim Lami, aty gjendet edhe punonjësi i policisë Emilton Asllanaj i cili siç përshkruhet nga pamjet, mban një telefon në dorë. Më herët në orën 09.51 minuta, kontrollori Urim Lami ka marrë në mes të dokumenteve që ka në përpunim një kartëmonedhë 5 euro, të cilën e vendos tek tastiera dhe e merr me pas. Ai pyet shtetasin në sportel për dokumentet e vaksinimit dhe përmned në komunikimin me të shumën 5 euro, duke zhvilluar ndër të tjera këtë bisedë: *Urim Lami: Ke vaksinë e duhet me ba edhe test s'duhet me te leju me kalu pa leju me kalu pas test ...ku do ..nuk degjohet llamarinat. Shtetasi; Nuk dëgjohet .... ka test me ba këtu. Urim Lami: Nja 20 njezët po njëherë. Shtetasi...Nuk dëgjohet. Urim Lami: Hajt pra që mbaje... Nuk dëgjohet ...5 euro.. per 20 shkon e ben atje...".* Gjatë kësaj kohe referohet se brenda në kabinë është edhe i pandehuri tjetër Emilton Asllanaj, përgjegjësi i turnit, por nuk referohen të dhëna për veprime të tij apo komunikime, në drejtim të vlerësimit mbi dijeninë dhe bashkëpunimin e tij me të pandehurin Urim Lamin ë realizimin e këtij episodi, ndërkohe që rezulton e qartë se i pandehuri Urim Lami pasi ka biseduar me shtetasin në sportel për vaksina,t ka marrë shumën 5 euro prej shtetasit Dritan Hasani, sipas të dhënave të regjistruar në sistem në këtë moment kohor.

824. *Së dyti,* në orën **13.03** minuta, po të datës 14.02.2022, në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh, ndërsa është në shërbim në kabinën nr.4 kontrollori Vehbi Nerguti, shihet që hyn në të Urim Lami dhe I lë mbi tavolinë dy kartëmonedha 5 euro, por nuk ka komunikim mes tyre. Në vijim, në orën **15.15** minuta të po kësaj date, ku shihet se përpara kontrollorit të policisë në shërbim Vehbi Nerguti, hyn kontrollori tjetër Urim Lami, i cili sapo ulet në karrige nxjerr nga xhepi një shumë parash të prerjeve të ndryshme në dukje si kartëmonedha në euro të cilat pasi i numëron, bën ndarjen e tyre, një pjesë i fut në xhep përsëri dhe pjesën tjetër i mban në dorën e djathtë, së bashku me kapelën e policisë. Pasi qëndron për një periudhe prej disa minutash në kabinë kontrollori Urim Lami lëviz prej saj. Në këtë dinamike veprimesh, mes tyre zhvillohet dhe ky komunikim *Urim Lami: Jane ba nga 40 Euro. Vehbi Nerguti: Mos ki merak* . Në orën **18.50** minuta të datës 14.02.2022, nga pamjet filmike rezulton se në shërbim në kabinën hyrëse është kontrollori Urim Lami dhe aty hyn dhe ulet në karrige edhe kolegu i tij Vehbi Nerguti, i cili shihet teksa fut ne portofolin e tij një kartëmonedhë 50 euro. Më pas Vehbiu shihet teksa

nxjerr nga portofoli një kartëmonedhë 20 euro dhe nga xhepi një tjetër 10 euro, të cilat pasi çohet ja jep kontrollorit në shërbim Urim Lami. Nga verifikimet e kryera ne sistemin TIMS, është konstatuar se kontrollori Urim Lami në këtë hark kohor kryen veprime ne sistem me llogarinë e kolegut te tij Vehbi Nerguti dhe rezulton se janë regjistruar në sistem shtetasit Deljaj Demiraj dhe Sherife Demiraj. Po nga pamjet filmike, regjistruar në kabinën ku ka kryer shërbimin në datë 14.02.2022 i pandehuri Urim Lami, ndërkohë konstatohet se është prezent edhe i pandehuri tjetër Vehbi Nerguti, në orën **19.34** minuta është fiksuar dhe regjistruar biseda e kryer mes tyre si më poshtë : *Urim Lami dëgjohet teksa numëron: .... njëzet qind,* Ndërsa Vehbi Nerguti, lidhur me shtetasin që është në sportel dëgjohet ti thotë Vehbi Nerguti; *Mos ka ndonjë arme pa leje. Urim Lami: Ne rregull është pa he. Vehbi Nerguti...po..por...* Ndërkohë që zhvillohet kjo bisedë, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike shihet se Urim Lami ulet përballë Vehbi Nergutit dhe sapo ulet në karrige, nxjerr nga xhepi i pantallonave një shumë të konsiderueshme parash të prerjeve të ndryshme, si në euro e lekë dhe fillon e i numëron e pastaj iu fut përsëri në xhepin e pantallonave. Me pas, kontrollori Urim Lami nxjerr një shumë tjetër parash, nga xhepi i xhaketës policore dhe fillon e i numëron edhe këto. Pasi i numëron, i fut në xhepin e xhaketës. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rezulton se në këtë hark kohor që zhvillohen ngjarjet dhe komunikimi si më sipër, kontrollori Vehbi Nerguti, ka përpunuar dokumentet e shtetasve Siderela Lybeshari, Ingli Lybeshari dhe me pas Adrian Demiri. Nga gjithë dinamika e ngjarjeve, në disa momente të ndryshme kohore gjatë kësaj datë, rezulton qartë se të pandehurit Vehbi Nerguti dhe Urim Lami, kanë vepruar në bashkëpunim me njëri tjetrin, për kërkimin dhe marrjen shumave të parave nga shtetasit të cilën kalojnë kufirin në pikën hyrëse, madje në disa momente shihen të numërojnë dhe grumbullojnë shuma parash, duke diskutuar më njëri tjetrin dhe sa ato janë bërë deri në atë moment.

825. *Së treti*, në datë 16.02.2022, në kabinën hyrëse ku ka qenë e instaluar pajisja përgjuese, me regjistrimi audio dhe video me nr. 7, ka rezultuar e provuar se kanë qenë prezent e pandehura Xhuljana Maksutaj duke kryer shërbimin e kontrollorit dhe përballë asaj ka qenë kontrollori tjetër, i pandehuri Urim Lami. Sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio, rezulton se në kabinën përkatëse vjen nga dera kryesore një shtetas i cili ju kërkon punonjësve të policisë prezent në kabinë që të mos e vonojnë, ndërkohe që rezulton nga pamjet filmike se në tavolinën e punës Xhuliana Maksutaj ka katër pasaporta të vendosura në anën e djathtë të saj ndërkohë që vijon përpunimin e shtetasve të tjerë në sportel. Shtetasi i drejtohet kontrollores në shërbim Xhuliana Maksutaj me fjalët " *Të lutem mos na vono ma", ndërsa dëgjohet Urim Lami që thotë " O Xhul ça me bo?" dhe Xhuliana përgjigjet "Ça me bo.*". Sipas pamjeve filmike është fiksuar momenti kur shtetasi në fjalë i ka dhënë kontrollorit Urim Lami 50 euro dhe në këtë moment ky i fundit merr dhe i jep dokumentet që Xhuliana kishte në tavolinën e punës. Pasi largohet shtetasi shihet Urim Lami teksa i jep Xhulianës 50 eurot e marra nga shtetasi dhe i thotë "*O Xhul merri këto.*". Më pas Xhuliana zëvendësohet ne shërbim nga Urim Lami dhe shihet teksa hap çantën e saj dhe fillon të rregullojë një shumë eurosh që i ka të çrregullta në çantën e saj. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS në harkun kohor që zhvillohet kjo ngjarje, nuk mundësohet identifikimi i mitëdhënësit pasi nga pamjet rezulton se në këtë kohë Xhuliana nuk ka kryer skanimin dhe

regjistrimi e dokumenteve të tij në sistem, por i ka mbajtur ato në cepin e tavolinës, duke ia kthyer më pas kolegu i saj Urim Lami, vetëm pasi ka marrë nga qytetari 50 euro, të cilat ja ka dhënë Xhulianës. Në këtë episod rezulton qartësisht e provuar se punonjësit e policisë, të pandehurit Urim Lami dhe Xhuliana Maksutaj kanë vepruar në bashkëpunim me njëri tjetrin, çka rezulton e qarte dhe e provuar nga dinamika e veprimeve dhe komunikimit të zhvilluar mes tyre.

826. *Së katërti*, në pamjet filmike, regjistrimin audio të transkriptuar dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, për datën 22.02.2022, rezultojnë tre episode në të cilat i pandehuri Urim Lami, gjatë kryerjes së detyrës së tij, ka kërkuar dhe marrë nga shtetasit në sportelin e pikës hyrëse, në kabinën nr.4, shuma parash për lejimin e kalimit të tyre në kufi. Konkretisht në orën 10.46 minuta, gjatë kohës që përpunon dokumentet e shtetasve, të cilët sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, rezulton të kenë qenë shtetasit Sejdi Krasniqi dhe Behar Bilali, shihet se, sapo merr në dorë pasaportat e tyre, ju drejtohet me fjalët :"...*duhet me shku me e marrë ej ...mere në telefon a ka telefon... ça me bë duhet krye me kohë... a si të kalosh këtu pastaj shko ku të duash, unë jam problemi këtu,....ti çfarë mundësie do?....hajde gjeje ti pra mundësinë, hajde gjeje ti pra mundësinë, qe librezën hë*.....ndërsa qytetari dëgjohet duke i thënë "....*a bën....?*", ndërsa Urimi[38] i përgjigjet "...*po hajd pra s'po ta prishim çejfin mbasi ke qejf ti...s'po ta prishim...*". Në momentin që zhvillohet ky komunikim, nga pamjet filmike shihet qartë teksa qytetari në sportel i zgjat një librezë me ngjyrë të bardhë ku brenda saj shihet një kartëmonedhe 10 euro, të cilën kontrollori i merr e le mbi tavolinë dhe i kthen dokumentet duke mos kryer veprime në sistem, dhe ndërsa i kthen librezën i thotë :"...*qe librezën... hajt pra ecni me kujdes, avash – avash rrugës mos t'u ndalin të tjerët rrugës, hajt pra*". Në orën 10.46 minuta të po kësaj date, gjatë kohës që përpunon dokumentet e shtetasit Suart Domi, nga pamjet filmike rezulton se ky shtetas teksa i jep dokumentet kontrollorit Urim Lami, ka futur ne to një kartëmonedhë 5 euro, te cilën Urimi pasi hap dokumentet e merr, e le mbi tavolinën e punës dhe vijon përpunimin e dokumenteve ne sistem. Po ashtu dëgjohet shtetasi duke i shqiptuar targën e automjetit për të cilin flet edhe për një problematikë dokumentesh. Në orën 19.12 minuta, të po kësaj datë gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Fahrije Gessner dhe Fadil Berisha, të cilit Urimi, pasi i merr dokumentet dëgjohet ti drejtohet me fjalët :".. *më ke dhënë shumë dokumente, pasaportë Kosove, të Serbisë kartë të Serbisë, mjafton një dokument sepse të gjitha bëjnë..", "O Fadil, a keni testin kundra Covitit"*. Në këtë monument shtetasi i jep Urimit një dokument me ngjyrë të kuqe në të cilin shihet një kartëmonedhë 20 euro, të cilën ai e merr dhe më pas i kthen dokumentet shtetasit duke e përshëndetur.

827. *Së pesti,* në datë 23.02.2022, në orën 20.30 minuta, teksa kryen shërbimin e tij në kabinën hyrëse nr. 4, ka rezultuar se kontrollori Urim Lami gjatë përpunimit të dokumenteve të dy shtetasve kosovarë, për shkak të mungesës së dokumenteve të vaksinimit , i merr atyre 5 euro. Nga të dhënat e marra nga sistemi rezulton se shtetasit që i kanë dhënë këtë shumë kontrollorit

---

[38] *Në procesverbalin e këqyrjes pasqyrohet emri Arjan Sokoli, por referuar pamjeve filmike dhe të dhënave të pasqyruara në procesverbal, rezulton se ky është gabim material pasi në asnjë moment në përshkrimin e kësaj ngjarje nuk evidentohet dhe referohet të ketë qenë prezent në kabinën e shërbimit shtetasi Arjan Sokoli.*

Lami, të cilën ai ë ka marrë duke i lejuar të vijojnë udhëtimin, janë shtetasit kosovarë Tringa Gorcaj dhe Nezit Hamiti.

828. *Së gjashti,* në datë 26.02.2022, nga të dhënat që japin pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, në kabinën hyrëse nr. 4 ka qenë duke kryer shërbimin i pandehuri Urim Lami i cili ka marrë dhe/ose pranuar nga shtetasit, në nëntë raste, para për ti lejuar ata të kalojnë kufirin pa kryer veprimet e nevojshme apo në mungesë të dokumenteve të rregullta. Konkretisht në orën 15.51 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Butrint Islami, Rabije Veseli dhe Bujar Islami konstaton mungese të autorizimit për mjetin dhe shihet teksa merr diçka prej tyre, te cilën e fut poshtë tastierës, dhe pas largimit te tyre e merr, por nuk mund te dallohet prerja dhe shuma. Pavarësisht se rezultojnë veprime te ngjashme me ato që kontrollori kryen ne rastet e tjera, ne kushtet kur nuk është transkriptuar biseda që dokumenton kërkimin e ndonjë shume parash apo edhe marrja e saj, duke u evidentuar minimalisht prezenca e një kartëmonedhë, nuk mund te konkludohet se ky fakt provohet se ka ndodhur ne kete episod. Në orën 15.20 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Adnan Berisha dhe personave që udhëtojnë me të, i ka pyetur për dokumentet e vaksinimit dhe dëgjohet qe ata i përgjigjen se nuk i kanë të plota. Gjatë diskutimit me shtetasit në sportel për mënyrën se si duhet të veprojnë, shihet teksa i jep librezën e mjetit duke i thënë "*Shifni një kodë citu*", dhe pasi e rimerr librezën prej tyre, e hap dhe merr prej aty 10 euro, duke ia rikthyer serish librezën dhe dokumentet. Në orën 17.29 minuta gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Mustaf Islami, rezulton se i ka marrë këtij të fundit 5 euro. Në orën 19.59 minuta, ka marrë nga shtetasit në sportel 10 euro, të vendosura nga shtetasi brenda pasaportës që i ka dhënë për regjistrim. Në orën 09.51 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Shpëtim Imeri, etj, shihet teksa ju drejtohet me fjalët "*Ti je ne rregull ai tjetri nuk është në rregull*", " *Po qysh do me bë hë...*", dhe ndërkohe shihet që ka marrë prej tyre një kartëmonedhë 10 euro. Në orën 13.51 minuta, teksa ka përpuqur dokumentet e shtetasve Fiqiri Cenaj etj, rezulton se pasi hap dokumentit "leje qarkullimi" merr prej aty 10 euro. Në orën 14.35 minuta, nga apmjet filmike shihet teksa merr nga dokumentet qe po përpunon një shume prej 5 eurosh, por nuk janë regjistruar biseda për te konkluduar mbi shkakun.

829. *Së shtati,* në datë 26.02.2022, ora 17.28 minuta, është evidentuar edhe ne rast kur në sportel shërbimi është kontrollorja Mimoza Shahinaj, e cila teksa përpunon dokumentet e shtetasve Edmond Kamberaj, Besnik Telalu dhe Harris Krasniqi, ju drejtohet me fjalët *"Hë mo çuna ndonjë raport apo vaksinë nuk më thatë, vetëm shoferi..hë mo çuna..na futi këtu*", dhe ndërsa thotë këto fjalë i zgjat një librezë automjet, nga e cila pasi e rimerr, nxjerr një kartëmonedhë 5 euro. Në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve filmike referohet se prezent në një moment gjatë zhvillimit të kësaj ngjarje ka qenë edhe punonjësi i policisë Urim Lami por nuk identifikohet asnjë veprim apo mosveprim i tij në drejtim të faktit konkret të kryer nga kolegia e tij Mimoza Shahinaj.

830. *Së teti*, në datë 02.03.2022, na kabinën në të cilën është ushtron shërbimin në pikën hyrëse kontrollori Urim Lami, janë konstatuar disa raste në të cilat ai, më të njëjtin mekanizëm veprimi siç ka rezultuar me sipas, kërkon, merr ose pranon shuma parash nga shtetasit që kalojnë kufirin

hyrës për në Shqipëri. Konkretisht, sipas pamjeve filmike, regjistrimit audio dhe të dhënave të marra në sistemin TIMS, rezulton se, në orën 14.07 minuta, gjatë përpunimit të shtetasve në kufi, të identifikuar nga të dhënat e hedhura në sistemin TIMS si Florida Cargu, e cila udhëton me mjetin me targa 05343GD, dhe sipas bisedave të regjistruara rezulton se udhëton me një person tjetër në makinë, por që nuk rezulton të jetë përpunuar dhe regjistruar rregullisht në sistem, kontrollori Urim Lami i drejtohet me emrin "Lazim", ai i drejtohet me fjalët "*O Lazim, nami çe këtu..pa shife..*" dhe ndërkohë shtetasi dëgjohet ti drejtohet dikujt tjetër që udhëton me të me fjalët "*Nami njëqind euro*". Nuk rezulton te jete dokumentuar plotësisht në këtë rast kërkimi dhe dhënia e shumë së parave. Në orën 16.31, 15.55 dhe 15.52 minuta janë regjistruar sërish dy raste kërkimi dhe marrje parash nga shtetasit, por nga procesverbali i këqyrjes së pamjeve filmike referohet se kontrollori Urim Lami është larguar nga kabina dhe shërbimi kryhet nga një kontrollor tjetër, i cili në orën 16.31 dhe 15.52 minuta nuk referohet si i identifikuar ndërsa në orën 15.55 minuta referohet te ketë qenë kontrollori Vehbi Nerguti. Në orën 17.10 minuta, rezulton se kontrollori Urim Lami, është kthyer në shërbim dhe gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi i kërkon mitë , duke iu drejtuar ndër të tjera me fjalët : *Urim Lami: Po pse, ç'kaq kafe të vogel dhe ti... Çar e kie këtë... pronarin e kerrit....Merdare si e ka emrin ky pronari i kerrit? Urim Lami: Djalë Kukësi...I kuj kahut, je ti...Si mo dhe çe kaq kafen e vogël ti...pajsh zotin!...çi kaq kafe të vogel dhe ?...aaa.....Urim Lami: Po mos, kerri është me problem ?...Jam tuj e regjistru unë...me ardh kush me e verifiku me nxjerri punë...mos jetë kerri i vjedhun...?".* Ndërkohë që zhvillohet kjo bisedë nga e cila rezulton se ai qartësisht kërkon mitë nga shtetasi, është përpunuar në sistem dokumentacioni i shtetasit Mirsad Rekaliu. Në orën 18.21 minuta, sërish kontrollori në shërbim Urim Lami gjatë bisedës me udhëtarin që ka në përpunim dëgjohet të kërkojë mitë duke iu drejtuar ndër të tjera, me fjalët "*fute nji kafe*", dhe ndërkohë i zgjat dokumentet. Nga të dhënat e sistemit TIMS personi i regjistruar ne sistem në këtë moment është Emin Ademi, të cilit siç rezulton kontrollori Urim Lami, në mënyrë të tërthorte, duke iu drejtuar me fjalët "kafe" i ka kërkuar para pavarësisht se nuk evidentohet momenti i marrjes së tyre.

831. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Vehbi Nerguti, 16.02.2022 në bashkëpunim e të pandehurën Xhuljana Maksutaj, si dhe në ngjarjet e datave 22.02.2022, 23.02.2022, 26.02.2022, dhe 02.03.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri Urim Lami, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak së tij, ka kërkuar dhe/ose ka marrë shuma parash në formë mite nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit, në mungesë të dokumentacionit të rregullt të mjeteve, kundrejt mos regjistrimit në sistem apo në një pjesë të raste nuk identifikohet qartë arsyeja konkrete, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht

me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

832. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit dhe/ose marrjes apo pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 14.02.2022,rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurin Vehbi Nerguti ndërsa në ngjarjen e datës 16.02.2022 rezulton se janë kryer në bashkëpunim me të pandehurën Xhuliana Maksutaj, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e këtyre datave rezulton edhe pjesëmarrja e këtyre shtetasve në realizimin e qëllimit kriminal. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit, në bashkëpunim me koleget e tij ne ngjarjet e datave 14 dhe 16 shkurt 2022, me vete me secilin prej tyre, evidentohen dhe rezultojnë të qarta nga veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Urim Lami.

833. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Urim Lami, ndër të cilat në disa prej episodeve (ato të datës 14.02.2022 dhe datës 16.02.2022) në bashkëpunim me kolegët e tij, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht e vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

834. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Urim Lami, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, në dy raste dhe në bashkëpunim me të pandehurit Vehbi Nerguti (në disa episode të datës 14.02.2022) dhe me të pandehurën Xhuliana Maksutaj (në një episod të datës 16.02.2022).

835. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se i pandehuri Urim Lami përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Urim Lami ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

836. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Urim Lami është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Urim Lami, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

837. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Urim Lami**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Vehbi Nerguti ne ngjarjet e datës 14.02.2022 dhe me të pandehurën Xhuliana Maksutaj në

ngjarjen e datës 16.02.2022, ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të provuara, analizuar më sipër në presën që lidhet me anën objektive të veprës penale.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit VEHBI NERGUTI

838. Lidhur me të pandehurin **Vehbi Nerguti**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, 22.02.2022, 23.02.2022 dhe 02.03.2022.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Urim Lami, në ngjarjet e datave *në ngjarjet e datave 14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, 22.02.2022, 23.02.2022 dhe 02.03.2022*, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

839. *Së pari,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio kryer në kabinën hyrëse nr.4, në datë 14.02.2022, në orën 10.33 minuta, teksa kryen shërbimin në kabinën hyrëse nr.4, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit në sportel, pasi merr prej tij një pasaporte shqiptare, në mes të saj shihet një kartëmonedhë 20 euro të cilën punonjësi i policisë Vehbi Nerguti e merr dhe ndërkohë nuk fut në përpunon pasaportën ku ishte kjo kartëmonedhë por vijon me një dokument tjetër. Rezulton nga sistemi TIMS se në këtë orë ai ka regjistruar dokumentet e shtetasve Donat Meholli, në orën 11.44 minuta, por me herët kur rezulton të kenë ndodhur ngjarjet si më sipër, nuk ka regjistruar shtetas shqiptarë në hyrje, ndërkohe që nga pamjet filmike shihet që shtetasi në sportel i jep pikërisht pasaporte shqiptare, së bashku me 20 euro të cilat merren nga kontrollori. Në orën 11.16 minuta të po kësaj datë, nga të dhënat që ofrojnë provat e marra në gjykim, rezulton se kontrollori Vehbi Nerguti, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Besrat Berisha, në kabinën e tij hyn një grua e cila shihet ti lerë mbi tavolinë 10 euro të cilat merren prej tij dhe nga bisedat rezulton se shkak ka qenë mungesa e dokumenteve të vaksinimit. Në orën 11.06 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e disa shtetasve kosovarë te cilat sipas sistemit TIMS rezultojnë te jene Adem Ajeti etj, rezulton se brenda njërës prej pasaportave janë vendosur 5 euro të cilat merren nga i pandehuri dhe vendosen poshtë tastierës.

840. *Së dyti,* në orën **13.03** minuta, po të datës 14.02.2022, në kabinën nr. 4 në hyrje të R.Sh, ndërsa është në shërbim në kabinën nr.4 kontrollori Vehbi Nerguti, shihet që hyn në të Urim Lami dhe i lë mbi tavolinë dy kartëmonedha 5 euro, por nuk ka komunikim mes tyre. Në vijim, në orën **15.15** minuta të po kësaj date, ku shihet se përpara kontrollorit të policisë në shërbim

Vehbi Nerguti, hyn kontrollori tjetër Urim Lami, i cili sapo ulet në karrige nxjerr nga xhepi një shumë parash të prerjeve të ndryshme në dukje si kartëmonedha në euro të cilat pasi i numëron, bën ndarjen e tyre, një pjesë i fut në xhep përsëri dhe pjesën tjetër i mban në dorën e djathtë, së bashku me kapelën e policisë. Pasi qëndron për një periudhe prej disa minutash në kabinë kontrollori Urim Lami lëviz prej saj. Në këtë dinamike veprimesh, mes tyre zhvillohet dhe ky komunikim *Urim Lami: Jane ba nga 40 Euro. Vehbi Nerguti: Mos ki merak* . Në orën **18.50** minuta të datës 14.02.2022, nga pamjet filmike rezulton se në shërbim në kabinën hyrëse është kontrollori Urim Lami dhe aty hyn dhe ulet në karrige edhe kolegu i tij Vehbi Nerguti, i cili shihet teksa fut ne portofolin e tij një kartëmonedhë 50 euro. Më pas Vehbiu shihet teksa nxjerr nga portofoli një kartëmonedhë 20 euro dhe nga xhepi një tjetër 10 euro, të cilat pasi çohet ja jep kontrollorit në shërbim Urim Lami. Nga verifikimet e kryera ne sistemin TIMS, është konstatuar se kontrollori Urim Lami në këtë hark kohor kryen veprime ne sistem me llogarinë e kolegut te tij Vehbi Nerguti dhe rezulton se janë regjistruar në sistem shtetasit Deljaj Demiraj dhe Sherife Demiraj. Po nga pamjet filmike, regjistruar në kabinën ku ka kryer shërbimin në datë 14.02.2022 i pandehuri Urim Lami, ndërkohë konstatohet se është prezent edhe i pandehuri tjetër Vehbi Nerguti, në orën **19.34** minuta është fiksuar dhe regjistruar biseda e kryer mes tyre si më poshtë : *Urim Lami dëgjohet teksa numëron: .... njëzet qind,* Ndërsa Vehbi Nerguti, lidhur me shtetasin që është në sportel dëgjohet ti thotë Vehbi Nerguti*; Mos ka ndonjë arme pa leje. Urim Lami: Ne rregull është pa he. Vehbi Nerguti...po..por...* Ndërkohë që zhvillohet kjo bisedë, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike shihet se Urim Lami ulet përballë Vehbi Nergutit dhe sapo ulet në karrige, nxjerr nga xhepi i pantallonave një shumë të konsiderueshme parash të prerjeve të ndryshme, si në euro e lekë dhe fillon e i numëron e pastaj iu fut përsëri në xhepin e pantallonave. Me pas, kontrollori Urim Lami nxjerr një shumë tjetër parash, nga xhepi i xhaketës policore dhe fillon e i numëron edhe këto. Pasi i numëron, i fut në xhepin e xhaketës. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, rezulton se në këtë hark kohor që zhvillohen ngjarjet dhe komunikimi si më sipër, kontrollori Vehbi Nerguti, ka përpunuar dokumentet e shtetasve Siderela Lybeshari, Ingli Lybeshari dhe me pas Adrian Demiri. Nga gjithë dinamika e ngjarjeve, në disa momente të ndryshme kohore gjatë kësaj datë, rezulton qartë se të pandehurit Vehbi Nerguti dhe Urim Lami, kanë vepruar në bashkëpunim me njëri tjetrin, për kërkimin dhe marrjen e shumave të parave nga shtetasit të cilën kalojnë kufirin në pikën hyrëse, madje në disa momente shihen të numërojnë dhe grumbullojnë shuma parash, duke diskutuar më njëri tjetrin dhe sa ato janë bërë deri në atë moment.

841. *Së treti*, në datë 22.02.2022, ndërsa kryen shërbimin në pikën hyrëse, kontrollori Vehbi Nerguti, në kabinën e tij futet një person i cili mban në dorë një dokument mjeti. Kontrollori i cili është duke biseduar në telefon, në përfundim të saj, komunikon me shtetasin në kabinë duke i thënë, ndër të tjera,: *Vehbi Nërguti: pse ke ardhë..?Shtetasi: ke dhe një birrë. Vehbi Nerguti: Çaa...?Shtetasi: një birrë ej..".* Ndërsa zhvillojnë këtë dialog, kontrollori i merr dokumentin dhe pasi e hap atë, merr një kartëmonedhë 2.000 leke që ndodhej brenda dokumentit dhe ndërkohë shtetasi i drejtohet me fjalët : Shtetasi: "*..bëje në emër të atij".* Nga sistemi TIMS rezulton se mjeti është regjistruar në emër të shtetasit Dashamir Vehapaj, por nga biseda dhe veprimet si më

sipër, rezulton e qartë se mjeti është regjistruar në emër të një personi që nuk është shtetasi i paraqitur në kabinën e kontrollorit, prej të cilit ai pranon dhe me pas merr 2000 lekë, për të kryer veprimin e kërkuar.

842. *Së katërti,* nga pamjet filmike të datës 23.02.2022, ora 21.28 minuta, shihet teksa kontrollori në shërbim Vehbi Nerguti, i jep shtetasit ne sportel lejen e qarkullimit të mjetit dhe pasi shtetasi ja rikthen brenda saj Vehbiu gjen dhe merr shumën 5 euro. Gjatë këtij episodi, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike evidentohet edhe prezenca e punonjësit të policisë Namik Mata por nuk evidentohet ndonjë veprim apo mosveprim i këtij te fundit ne drejtim te realizimit te ngjarjes së përshkruar me sipër. Në orën 21.29 minuta, shihet teksa Vehbiu pasi përpunon një dokument identifikimi ja jap Namik Matës që ndodhej në kabinë dhe ky i fundit largohet, por sërish nuk evidentohet ndonjë element për të vlerësuar prezencën ose jo te elementeve të veprës penale në këtë ngjarje. Në orën 20.20 minuta të po kësaj datë, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Xhevdet Morina, por ndërkohë mban ne duar dhe kontrollon edhe dokumente te huaja, merr prej tyre shumën 5 euro dhe ja kthen shtetasve në sportel. Në orën 20.34 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve Tringa Gorcaj dhe Nezir Hamiti, për shkak të mungesës së testeve kundër covidi, pranon dhe merr prej tyre shumën 5 euro duke i lejuar të vijojnë udhëtimin. Në orën 15.55 minuta, teksa përpunon dokumentet e shtetasit Albert Trimi, i drejtohet atij duke i kërkuar mitë dhe konkretisht me fjalët "*Çar bonë mo...ku i ki ja 10 euro ti...hajd...ja dhjetë euro letër ku i kie...*". Pavarësisht se nuk rezulton nga pamjet filmike marrja e shumës, rezulton qartësisht kërkimi i saj nga i pandehuri Vehbi Nerguti.

843. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në lidhje me *ngjarjet e datave 14.02.2022 në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, 22.02.2022, 23.02.2022 dhe 02.03.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se i pandehuri Vehbi Nerguti, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak së tij, ka kërkuar dhe/ose ka marrë shuma parash në formë mite nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit, në mungesë të dokumentacionit të rregullt të mjeteve, kundrejt mos regjistrimit në sistem apo në një pjesë të raste nuk identifikohet qartë arsyeja konkrete, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

844. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit dhe/ose marrjes apo pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 14.02.2022,rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date, rezulton qartë bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e të dy të pandehurve në realizimin e fakteve penale objekt akuze, të provuara në

gjykim. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit, në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Urim Lami në ngjarjet e datës 14.02.2022 , evidentohet dhe rezulton e qartë nga veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Vehbi Nerguti.

845. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Vehbi Nerguti, ndër të cilat në disa prej episodeve (ato të datës 14.02.2022) në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Urim Lami, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht e vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

846. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Vehbi Nerguti, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, në disa raste të datës 14.02.2022 dhe në bashkëpunim me të pandehurit Urim Lami.

847. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Vehbi Nerguti përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale,

përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Vehbi Nerguti ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

848. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Vehbi Nerguti është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Vehbi Nerguti, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

849. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Vehbi Nerguti**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, ne ngjarjet e datës 14.02.2022, ndërkohë që ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të provuara, analizuar më sipër në presën që lidhet me anën objektive të veprës penale.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurës XHULJANA MAKSUTAJ

850. Lidhur me të pandehurën **Xhuljana Maksutaj**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollor, *në ngjarjet e datave 16.02.2022 në bashkëpunim e të të pandehurin Urim Lami, si dhe në ngjarjet e datës 18.02.2022.* Gjykata

vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se e pandehura Xhuljana Maksutaj, në ngjarjet e datave *16.02.2022 në bashkëpunim e të të pandehurin Urim Lami, si dhe në ngjarjet e datës 18.02.2022*, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

851. *Së pari,* nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio kryer, në datë 16.02.2022, në kabinën hyrëse ku ka qenë e instaluar pajisja përgjuese, me regjistrimi audio dhe video me nr. 7, ka rezultuar e provuar se kanë qenë prezent e pandehura Xhuljana Maksutaj duke kryer shërbimin e kontrollorit dhe përballë asaj ka qenë kontrollori tjetër, i pandehuri Urim Lami. Sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio, rezulton se në kabinën përkatëse vjen nga dera kryesore një shtetas i cili ju kërkon punonjësve të policisë prezent në kabinë që të mos e vonojnë, ndërkohë që rezulton nga pamjet filmike se në tavolinën e punës Xhuliana Maksutaj ka katër pasaporta të vendosura në anën e djathtë të saj ndërkohë që vijon përpunimin e shtetasve të tjerë në sportel. Shtetasi i drejtohet kontrollores në shërbim Xhuliana Maksutaj me fjalët " *Të lutem mos na vono ma", ndërsa dëgjohet Urim Lami që thotë " O Xhul ça me bo?" dhe Xhuliana përgjigjet "Ça me bo.*". Sipas pamjeve filmike është fiksuar momenti kur shtetasi në fjalë i ka dhënë kontrollorit Urim Lami 50 euro dhe në këtë moment ky i fundit merr dhe i jep dokumentet që Xhuliana kishte në tavolinën e punës. Pasi largohet shtetasi shihet Urim Lami teksa i jep Xhulianës 50 eurot e marra nga shtetasi dhe i thotë "*O Xhul merri këto.*". Më pas Xhuliana zëvendësohet ne shërbim nga Urim Lami dhe shihet teksa hap çantën e saj dhe fillon të rregullojë një shumë eurosh që i ka të çrregullta në çantën e saj. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS në harkun kohor që zhvillohet kjo ngjarje, nuk mundësohet identifikimi i mitëdhënësit pasi nga pamjet rezulton se në këtë kohë Xhuliana nuk ka kryer skanimin dhe regjistrimi e dokumenteve të tij në sistem, por i ka mbajtur ato në cepin e tavolinës, duke ia kthyer më pas kolegu i saj Urim Lami, vetëm pasi ka marrë nga qytetari 50 euro, të cilat ja ka dhënë Xhulianës. Në këtë episod rezulton qartësisht e provuar se punonjësit e policisë, të pandehurit Xhuliana Maksutaj dhe Urim Lami, kanë vepruar në bashkëpunim me njëri tjetrin, çka rezulton e qartë dhe e provuar nga dinamika e veprimeve dhe komunikimit të zhvilluar mes tyre.

852. *Së dyti,* në pamjet filmike, regjistrimin audio të transkriptuar dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS, për datën 18.02.2022, në kabinën hyrëse nr.4 ku ka qenë duke kryer shërbimin kontrollorja Xhuljana Maksutaj, rezultojnë dy episode në të cilat ajo, gjatë kryerjes së detyrës, ka kërkuar dhe marrë nga shtetasit në sportelin e pikës hyrëse, shuma parash për lejimin e kalimit të tyre në kufi. Konkretisht në orën 09.21 minuta, gjatë kohës që përpunon dokumentet e shtetasve, të cilët sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, rezulton të ketë qenë shtetasi Granit Binjakaj dhe bashkudhëtarja e tij Kaltrine Zeqiraj, dëgjohet ti pyesë për dokumentet e vaksinimit dhe Graniti i përgjigjet se vajza i ka ndërsa ai jo. Dhe ndërkohe që i përgjigjet se vajza do të

kalojë ndërsa ai jo, shihet shtetasi që i jep para, , por pa qenë e mundur të identifikohet shuma dhe gjatë këtij veprimi Xhuljana i drejtohet me fjalët "*Jepmja me terezi*". Pasi ndodh ky veprim dhe shtetasit largohen, nga pamjet filmike shihet teksa e pandehura merr një çante dhe e vendos atë në krahun e majtë të tavolinës së punës, pasi dorën poshtë tastierës, merr aty diçka dhe e fut të palosur në çantë. Pavarësisht se në këtë episod nuk rezulton shuma e kërkuar dhe marrë, veprimet e të pandehurës në tërësi dhe komunikimi i saj me shtetasit, tregon qartë minimalisht pranimin prej saj të mitës, në funksion të tolerimit të shtetasit Granit Binjakaj të kalojë kufirin pa pasur dokumente vaksinimi të cilat i janë kërkuar nga vetë kontrollorja Xhuljana Maksutaj. Në vijim, në orën 19.44 minuta, teksa vijon shërbimin në kabinën hyrëse nr. 4, kohë gjatë së cilës sipas sistemit TIMS ka përpunuar dokumentet e shtetasve Ibrahim Xhaferi, Valton Qovanaj dhe Hadis Xhaferi, nga pamjet filmike shihet e pandehura Xhuliana Maksutaj teksa hap një librezë mjeti të dhënë nga shtetasit dhe merr prej andej një kartëmonedhë 10 euro të cilën e fut sërish në çantën e saj me ngjyrë të zezë.

853. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *16.02.2022 në bashkëpunim e të të pandehurin Urim Lami, si dhe në ngjarjet e datës 18.02.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se e pandehura Xhuljana Maksutaj, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka kërkuar dhe/ose ka marrë shuma parash në formë mite nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit apo dhe për arsye që nuk identifikohen qartësisht, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

854. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit dhe/ose marrjes apo pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 16.02.2022,rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami ndërsa në ngjarjen e datës 18.02.2022 rezulton se janë kryer prej saj e vetme. Lidhur me ngjarjet e datës 16.02.2022 ku ajo ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Urim Lami, gjykata arrin në konkluzionin se ata kanë vepruar në bashkëpunim, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date rezulton qartë pjesëmarrja dhe bashkëpunimi, nëpërmjet veprimit të përbashkët, i të dy të pandehurve, në funksion të realizimit të qëllimit. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurës, në bashkëpunim me kolegun e saj ne ngjarjen e datës 16.02.2022, evidentohet dhe rezulton qartë nga veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura Xhuljana Maksutaj.

855. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurës Xhuljana Maksutaj, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 16.02.2022) në bashkëpunim me Urim Lamin, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se e pandehura Xhuljana Maksutaj është tërësisht e vetëdijshme për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

856. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se e pandehura Xhuljana Maksutaj, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ajo ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, në një rast dhe në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami (në një episod të datës 16.02.2022).

857. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se e pandehura Xhuljana Maksutaj përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është e përgjegjshme, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, e pandehura Xhuljana Maksutaj ka qenë punonjëse e strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i

ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

858. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se e pandehura Xhuljana Maksutaj është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se e pandehura Xhuljana Maksutaj, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

859. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se e pandehura **Xhuljana Maksutaj**, duhet të deklarohet fajtore për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami në ngjarjen e datës 16.02.2022, ndërkohë që ka vepruar e vetme në episodet e tjera të provuara në datë 18.02.2022, analizuar më sipër në presën që lidhet me anën objektive të veprës penale.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurës VOJSAVA SELMANI

860. Lidhur me të pandehurën **Vojsava Selmani**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në PKK Morinë si kontrollore, *në ngjarjet e datës 15.02.2022, në një episod në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati dhe në ngjarjet e datës 19.02.2022.* Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se e pandehura Vojsava Selmani, në ngjarjet e datave *në ngjarjet e datës 15.02.2022, në një episod në bashkëpunim me të pandehurin Arben*

Kastrati dhe në ngjarjet e datës 19.02.2022, ka kërkuar, marrë ose pranuar shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij gjatë kalimit të kufirit në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Arrihet ky konkluzion pasi:

861. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 15/02/2022, rezulton se punonjësi i policisë në shërbim është kontrollori Arben Kastrati. Në harkun kohor 16.03 minuta të kësaj date, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasve shqiptarë, nga bashkëbisedimi rezulton se ata kanë problematikë lidhur me shkeljen e kohës së qëndrimit, duke kaluar "*100 ditshin*", sikurse referon biseda. Shtetasi, dokumentacioni i të cilit përpunohet në këtë moment, sipas të dhënave të sistemit TIMS, është shtetasi shqiptar Olsi Syziu i cili udhëton së bashku me shtetasin e huaj Adams Gjon Bulakh. Në bisedën dhe ngjarjet e zhvilluara si më sipër sipas pamjeve filmike, rezulton se është prezent, krahas kontrollorit Arben Kastrati, edhe e pandehura, kontrollorja Vojsava Selmani dhe nga biseda e zhvilluar mes këtyre të fundit por edhe ajo e zhvilluar mes tyre dhe shtetasit Olsi Syziu, rezulton e qartë se për shkak të problematikës së konstatuar për tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE, mbi 100 ditë, kundrejt mos bërjes së shënimit në pasaportë, punonjësit e policisë Arben Kastrati dhe Vojsava Selmani, në bashkëpunim me njëri tjetrin, kanë kërkuar dhe marrë nga ky shtetas një shumë eurosh, vlera e të cilës nuk pasqyrohet qartë nga pamjet filmike por rezulton *ngjyra e kartëmonedhës* (*përshkruar në procesverbal si e kuqërremtë*) dhe veprimi i dhënies së kësaj shume punonjësit në shërbim Arben Kastrati. Ky veprim që konsiston në kërkimin dhe marrjen e ryshfetit në kombin të mos përmbushjes së rregullt të detyrës dhe tolerimit të shtetasve për të kaluar kufirin pa ju bërë shënime mbi tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE-së, rezulton se është realizuar me veprime të përbashkëta dhe komplementare të të dy punonjësve të policisë Vojsava Selmani dhe Arben Kastrati, në bashkëpunim me njëri tjetrin. Ky fakt rezulton i qartë nga biseda e transkriptuar në procesverbalin përkatës, ku ndër të tjera, Arben Kastrati i drejtohet udhëtarit në sportel me fjalët "*Po ca me i ba këtij djalit me i ba i shënim këtu?*", "*Do ti bej një kontroll mjetit*" dhe me tej vijon duke i thënë se "*I ka kalu afati qysh në 2019.*". Pas këtij momenti ndërhyn në këtë bisedë e pandehura Vojsava Selmani duke iu drejtuar shtetasit me fjalët "*Jo pra për pesë vite ndalim dalje nga Shqipëria*". Në vijim, pasi është fiksuar nga pamjet filmike dhënia e kartëmonedhës nga shtetasit të cilët janë duke u përpunuar nga kontrollori Arben Kastrati, ky i fundit i drejtohet me fjalët "*Jo jo se asht shumë mik, jo jo, për zotin jo. Pash kryt janë shumë bre.*" dhe me pas Vojsava i drejtohet me fjalët "*Faleminderit, hajd rrugë të mbarë*", duke vijuar në drejtim të kolegut me fjalët "*E bre po ka pas makinë 80 mije euro bre.*". Në orën 16.18 minuta po të datës 15.02.2022, ndërsa kryen shërbimin në kabinën hyrëse numër 4 kontrollorja Vojsava Selmani, gjatë verifikimit të pasaportës që shtetasi i jep, shihet që merr prej saj një shumë prej 5 eurosh të cilën e merr, por nuk rezulton shkaku i marrjes së saj.

862. *Së dyti*, në datë 19.02.2022, gjatë kohës që në shërbim është e pandehura Vojsava Selmani, në kabinën hyrëse nr.4, rezultojnë disa raste ne të cilat ajo kërkon, merr ose pranon shuma parash nga shtetasit që ka përpunuar në pikën hyrëse dhe konkretisht: Në orën 13.08 minuta, gjatë komunikimit me shtetasin në sportel, dëgjohet ti drejtohet me fjalët "*...gjeje ku të duash,*

pa vaksinë mos më hajd herë tjetër.", dhe ndërkohe shihet teksa në këtë moment ngre tastierën e kompjuterit, pavarësisht se nuk rezulton të duket marrja e ndonjë shumë parash, por ndërkohë në orën 13.26 minuta, teksa ka përpunuar dokumentet e shtetasit Ermir Zesalla, pasi i kërkon dokumentin e vaksinimit i drejtohet me fjalët "*Pse se ke o Ermir.*" Dhe përsërit të njëjtin veprim me tastierën e kompjuterit, duke e lejuar të vijojnë udhëtimin. Në orën 11.38 po të datës 19.02.2022, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetasit të cilin e thërret me emrin Ardian, rezulton se ka konstatuar mungesë të dokumentacionit të vaksinimit dhe shihet teksa kryen të njëjtat veprime për lëvizjen me tastierën, pasi më herët i ka mbajtur atij dokumentet duke i vendosur në tavolinën e saj dhe duke i kërkuar të hapë krahun. Nga verifikimi i kryer ne sistemin TIMS nuk rezulton ta ketë regjistruar shtetasin në fjalë dhe po ashtu nuk rezulton nga pamjet filmike shuma, përveç veprimeve të njëjta që lidhen me vendosjen e "diçkaje" poshtë tastierës. Në orën 12.48 minuta, gjatë përpunimit të dokumenteve të shtetases Dijana Dragidella, rezulton e qarte se mes dokumenteve qe ajo i ka dhënë, ka vendosur një shumë 10 euro e cila merrte nga e pandehura Vojsava Selamani.

863. *Së treti*, në datë 19.02.2022, Gëzim Duraku gjatë shërbimit, është fiksuar nga pamjet filmike në dy raste duke marrë para nga shtetasit dhe konkretisht, në orën 13.22 minuta kërkon "kafe" (*siç i drejtohet shtetasit në komunikim*) dhe merr nga shtetasi Alban Mici 5 euro. Në procesverbalin e këqyrjes referohet se kjo ngjarje zhvillohet në bashkëpunim me të pandehurën tjetër Vojsava Selmani por nuk është evidentuar nga këqyrja e pamjeve filmike se cilat janë veprimet konkrete të saj në realizimin e qëllimit kriminal, përveç fjalëve të Vojsavës që i drejtohet kolegut me fjalët "*Çfarë thoshte ai*" dhe po ashtu referohet se Gëzimi shumën 5 euro e ka marrë jashtë kabinës ku është Vojsava dhe kur ka hyrë aty ka vendosur një kartëmonedhë 5 euro në tavolinë.

864. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022, në një episod në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati dhe në ngjarjet e datës 19.02.2022, në të paktën njërën prej tyre ku provohet qarte se ka marrë 10 euro, dhe duke përjashtuar si të dyshimta dhe të pa provuara përtej çdo dyshimi të arsyeshëm episodet e tjera ku nuk rezulton minimalisht evidentimi i kartëmonedhave, pavarësisht shumës së tyre, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se e pandehura Vojsava Selmani, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka kërkuar dhe/ose ka marrë shuma parash në formë mite nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit apo dhe për arsye që nuk identifikohen qartësisht, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse për në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

865. Po ashtu rezulton se këto veprime të tij, janë kryer kundrejt kërkimit dhe/ose marrjes apo pranimit të shumave monetare të dhëna nga shtetasit, veprime pas të cilave ai ka lejuar kalimin e tyre në kufi. Marrja dhe pranimi i shumave të parave të dhëna nga shtetasit që kalojnë në kufi, në ngjarjet e datës 15.02.2022,rezulton të jenë kryer në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati ndërsa në ngjarjen e provuar të datës 19.02.2022 rezulton se janë kryer prej saj e vetme. Lidhur me ngjarjet e datës 15.02.2022 ku ajo ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Arben Kastrati, gjykata arrin në konkluzionin se ata kanë vepruar në bashkëpunim, pasi nga provat që referojnë në ngjarjet e kësaj date rezulton qartë pjesëmarrja dhe bashkëpunimi, nëpërmjet veprimit të përbashkët të të dy të pandehurve, në funksion të realizimit të qëllimit. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurës, në bashkëpunim me kolegun e saj ne ngjarjen e datës 15.02.2022, evidentohet dhe rezulton qartë nga veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura Vojsava Selmani.

866. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurës Vojsava Selmani, ndër të cilat në një prej episodeve (atë të datës 15.02.2022) në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se e pandehura Vojsava Selmani është tërësisht e vetëdijshme për sjelljen e kundërligjshme të saj, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës, duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

867. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se e pandehura Vojsava Selmani, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ajo ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror dhe po ashtu, në një rast dhe në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati (në një episod të datës 15.02.2022).

868. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se e pandehura Vojsava Selmani përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është e përgjegjshme, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, e pandehura Vojsava Selmani ka qenë punonjëse e strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

869. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se e pandehura Vojsava Selmani është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se e pandehura Vojsava Selmani, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

870. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se e pandehura **Vojsava Selmani**, duhet të deklarohet fajtore për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Arben Kastrati në ngjarjen e datës 15.02.2022 dhe e vetme në ngjarjet e datës 19.02.2022, në të

paktën njërën prej tyre ku provohet qarte se ka marrë 10 euro, dhe duke përjashtuar si të dyshimta dhe të pa provuara përtej çdo dyshimi të arsyeshëm episodet e tjera ku nuk rezulton minimalisht evidentimi i kartëmonedhave, pavarësisht shumës së tyre, analizuar më sipër në presën që lidhet me anën objektive të veprës penale.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit BEDRI DURAKU

871. Lidhur me të pandehurin **Bedri Duraku**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si "kontrollor" në ngjarjet e datës *11.02.2022,* por nuk rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që kjo vepër të jetë kryer prej tij në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Bedri Duraku, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, në ngjarjet e datës *11.02.2022*. Arrihet ky konkluzion pasi:

872. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën hyrësë ku ka kryer shërbimin në datë 11.02.2022 kontrollori Dedri Duraku, është evidentuar nga pamjet filmike dhe regjistrimi audio se kontrollori gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve, të cilët sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS rezulton të jenë shtetasit Burim Bajrami, Naim Metolli dhe Vladimit Gashi, ka pranuar të marrë prej tyre një shumë parash, prerja e së cilës nuk rezulton e saktësuar nga pamjet filmike, por që shihet qartë se është e vendosur mes njërës prej pasaportave dhe kontrollori e merr, e vendos poshtë tastierës së kompjuterit dhe vijon përpunimin e dokumenteve. Po ashtu nga pamjet filmike rezulton të jetë i qartë momenti kur ai tërheq kartëmonedhën e marrë prej tyre, nga poshtë tastierës ku e kishte vendosur më herët. Në orën 13.41 minuta, gjatë përpunimit të shtetasve në kufirin hyrës, shihet teksa shtetasi i paraqitur ne sportel bashkë me dokumentet e identifikimit i jep 50 euro, brenda një dokumenti dhe ndërkohe rezulton se kontrollori i kërkon dokumentet e vaksinimit dhe kartonin jeshil të mjetit. Sipas të dhënave që pasqyrohen në procesverbalin e këqyrjes së pamjeve referohet se shtetasi në sportel është i huaj, fakt që konfirmohet plotësisht nga të dhënat e regjistruar në sistemin TIMs në këtë moment kohor, ku rezulton se është përpunuar në pikën hyrëse dokumentacioni i shtetasit çek Dejan Ristic. Pra rezulton e qartë se në të dy këto momente kohore kontrollori në shërbim Bedri Duraku pranon dhe merr nga shtetasit në sportel, shuma parash gjatë kohës që përpunon dokumentet e tyre në pikën hyrëse, nëpërmjet të njëjtit mekanizëm, nëpërmjet futjes dhe marrjes së tyre ndërmjet dokumenteve që përpunon. Në orën 15.47 minuta po të datës 11.02.2022, nga

pamjet filmike rezulton se kontrollori në shërbim Bedri Duraku merr një sasi të madhe dokumentesh në përpunon, midis të cilave edhe disa letra të bardha dhe teksa hap njërën nga pasaportat shihet qarte teksa merr prej aty një shumë 10 euro. Ndërkohë në këtë moment, bisedon me udhëtarët në sportel duke iu drejtuat me fjalët si më poshtë: *B.Duraku: A ke letërnjoftim, a pasaporte aa? Shtetasi: Kam .A munesh me na nimu mos me na regjistru. B.Duraku: Te tre mo? Shtetasi: Po. B.Duraku: Pa 100.....jo shok jo. B.Duraku: Po bjere mo.....(për disa sekonda bisedë që nuk kuptohet). B.Duraku: Tre vete tre pasaporta, mos me te regjistru tre vete? Nje person jo tre. Je shume larg. Shume larg je." Ndërkohë që i thotë këto fjalë hap njërën prej pasaportave dhe shikon shumen e parave që është aty Brenda. Sipas pamjeve filmike rezulton se pasi i shtyn paratë me dorë para pajisje skaner, ndërkohe i thotë "Je larg, larg je"... "O djale je shumë larg një person mos me u regjistru 50 euro bën". B.Duraku: O djale unë s'po du me ju prish punë, po një person mos me u regjistru 50-euro bën, ik kesaj rradhe ....nuk ke hy në Shqipni, kështu që një person për mos me teee..50 euro. Kështu që ju tre veta ...".* Gjatë kësaj bisede pamjet filmike kanë dokumentuar marrjen prej tij të parave që ka nxjerrë nga pasaportat e shtetasve duke i futur poshtë tastierës që ka vendosur tek skaneri ndërkohë që pasaportat ua kthen, pasi erdhi pasagjeri i radhës. Përpunon pasagjerin e radhës dhe paratë që ka vendosur në cep të tastierës i tërheq. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS, në harkun kohor që zhvillohet kjo dinamikë ngjarjesh nuk ka persona të regjistruar në pikën hyrëse, çka përkon dhe vërteton saktësisht përmbushjen e qëllimit perse tre shtetasit i kanë dhënë shumë 10 euro si dhe kërkimin prej kontrollorit të një shumë me të madhe parash. Në vijim, në orën 13.10 minuta, teksa sipas të dhënave të sistemit TIMS rezulton se ka përpunuar dokumentet e shtetasve Auron Popova, Gentian Ajazi dhe Faton Halimi, nga pamjet filmike duke që nxjerr dhe merr nga pasaportat që përpunon një kartëmonedhe 10 euro.

873. *Së dyti*, në datë 23.02.2022, ora 18.25, nga pamjet filmike të kamerës të vendosur në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Arbën Kastrati, janë regjistruar ne audio dhe video komunikime mes tij dhe kolegut të tij Bedri Duraku ku bisedojnë për shumën 10 euro që i kanë marrë një shtetasi për shkak të lejimit të kalimit në kufi të një skafi. Nga biseda e zhvilluar mes këtyre dy punonjësve të PKK, ndër të tjera Bedri Duraku i thotë "*Qe kaloj skafet..10 euro bre..*", ndërsa Arben Kastrati i përgjigjet "*Ja morra dhe unë 10 euro*", "*Kosht kenë një makinë e atij oficerit e kishte pasë karton të kuq*", ndërsa Bedri Duraku vijon me fjalët "*Dhjete euroshi, atje te cepi.*". Nga të dhënat e sistemit TIMS dhe komunikimi mes tyre nuk mund të identifikohet shtetasi të cilit i kanë marrë secili nga 10 euro dhe as koha në të cilën është lokalizuar dhe zhvilluar kjo ngjarje, për të gjykuar më tej mbi ndodhjen, vërtetësinë dhe provueshmërinë e plotë të saj. Për pasojë, kjo bisede e zhvilluar mes të pandehurve Arben Kastrati dhe Berdi Duraku, duke qenë se nuk mund të konfirmohet me te dhëna të marra nga provat e tjera dhe për pasojë, rezulton e pamundur të lokalizohet minimalisht në një moment kohor, për të përcaktuar qartë nëse dhe si ka ndodhur, nuk mund të konkludohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ka ndodhur dhe gjatë kësaj ngjarje (*të papërcaktuar në kohë dhe hapësirë*), punonjësit e policisë që zhvillojnë këtë bisedë kanë kërkuar apo marrë para nga një shtetas.

874. *Së treti,* në datë *27.*02.2022, në orën 13.57 minuta, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrje së tyre, referohet se në kabinën ku është instaluar pajisja përgjuese nr. 6, konstatohet se është duke kryer shërbim punonjësi i policisë Gëzim Duraku. Sipas pamjeve filmike duket se në kabinë futet një punonjës tjetër policie i identifikuar si Bedri Duraku i cili e zëvendëson kontrollorin Gëzim Duraku për një periudhë kohe të shkurtër. Sipas pamjeve filmike, por pa regjistrim audio, duket kontrollori Gëzim Duraku i cili pasi i liron postin e punës inspektori Bedri Durakut, del pas monitorit të kompjuterit dhe fut dorën e djathtë në xhepin e djathtë të tij duke nxjerrë një tufë kartëmonedhash euro dhe i hedh në shesh, poshtë këmbëve të tij dhe duke u përkulur në gjunjë fillon i merr ato një nga një duke i palosur dhe numëruar i fut përsëri në xhepin e djathtë. Më pas afrohet, merr telefonin mbi tavolinë dhe largohet nga kabina. Gjatë kohës që kontrollori Gëzim Duraku i nxjerr dhe numëron kartëmonedhat e ndryshme që i kishte grumbulluar më parë në xhepin e tij, është i pranishëm edhe punonjësi i policisë inspektor Bedri Duraku i cili e zëvendëson atë në shërbim. Nuk rezulton që në këto veprime të jetë konstatuar ndonjë veprim i përbashkët i tyre për kërkim, marrje apo pranim mite nga ndonjë shtetas.

875. *Sa më sipër u analizua,* nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datë 11.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këtë datë, rezulton se punonjësi i policisë Bedri Duraku, ka kërkuar ose ka pranuar para në formë ryshfeti nga shtetasit e përpunuar në hyrje në PKK Morinë, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, kundrejt mungesës së dokumenteve të vaksinimit apo kundrejt moskryerjes së shënimeve sipas ligjit për shtetasit në sistemin TIMS, në mos përmbushje të rregullt të detyrës funksione të tij në drejtim të kontrollit dhe regjistrimit të rregullt të shtetasve gjatë kalimit në PKK, ne pjesën hyrëse në RSH. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", dhe posaçërisht nenin 5, pika 2, nenin 6, pika 1, 3, 6, nenin 14 , pika 1 dhe 2 dhe nenin 16, pika 1.

876. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se, duke iu referuar në tërësi të dhënave që japin provat e administruara dhe vlerësuara në raport me faktin penal si më sipër, nuk vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale nga ana e të pandehurit Bedri Duraku është kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga të dhënat që rezultojnë nga provat, rezulton se i pandehuri Bedri Duraku në veprimet e konkretizuara për kërkimin, marrjen ose pranimin e përfitimit të paligjshëm në rastet si më sipër, nuk rezulton e provuar se ka vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, mbi bazën e një marrëveshje të mëparshme apo të arritur aty për aty, të shprehur ose të heshtur, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal që cenon objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

877. Në këtë konkluzion gjykata i referohet faktit se bashkëpunimi, duke u reflektuar si në elementet që konkretizohet në elementë që qëndrojnë në anën objektive ashtu dhe në ato që përbëjnë anën subjektive të veprës penale, duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në

rastin konkret nuk rezulton nga provat e administruara, asnjë e dhënë e plotë që buron nga provat, e aftë që të bindë gjykatën se rrethana rënduese e bashkëpunimit, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm si në drejtim të anës objektive ashtu edhe në drejtim të anës subjektive të veprës penale. Në këtë këndvështrim, gjykata vlerëson se pranua në tre raste, sipas procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, e kolegeve të tij ndërsa ai kryen shërbimin dhe regjistrohen rastet e mitëmarrës, nuk provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm bashkëpunimin e tij më këta të fundit, pasi nuk evidentohen veprime aktive të kundërligjshme të kolegeve të tij, në drejtim të realizimit me veprime të përbashkëta ose komplementare, të të njëjtit qëllim kriminal.

878. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Bedri Duraku, në disa episode të provuara si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje kërkon, merr dhe pranon shuma monetare, përkundrejt mos përmbushjes së rregullt të detyrës së tij duke toleruar kalimin e shtetasve në kufi, pa kryer në përputhje me ligjin procedurën e përpunimit dhe/ose regjistrimit të rregullt të tyre.

879. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Bedri Duraku, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit që ai ka përpunuar në pjesën hyrëse të PKK morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

880. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Bedri Duraku përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të

përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Bedri Duraku ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

881. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Bedri Duraku, është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Bedri Duraku, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

882. ***Sa më sipër u arsyetua,*** gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Bedri Duraku**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, për faktet penale të provuara, analizuar më sipër në këtë vendim, të ndodhura në datë 11.02.2022, ndërsa nuk rezulton bashkëpunimi i tij në kryerjen e veprës penale me të pandehurit e tjerë, provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në prova, pavarësisht komunikimit të tij me njërin prej kolegëve apo prezencën e tij në kabinën e shërbimit ndërsa një tjetër koleg i tij ka kryer veprën penale në një episod.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ARBEN GOÇI

883. Lidhur me të pandehurin **Arben Goçi**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Arben Goçi ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë në ngjarjet e datës 08.02.2022, në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Braha. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Arben Goçi, në bashkëpunim me persona të tjerë, kolegë të tij, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar në PKK Morinë, në këmbim të lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, duke bashkëpunuar me të pandehurin Fatri Braha në ngjarjet e datës 08.02.2022. Arrihet ky konkluzion pasi:

884. *Së pari,* nga pamjet filmike, video dhe audio, regjistruar në kabinën nr. 4 ku ka kryer shërbimin në datë 8.2.2022, në orën 16.21 minuta, në kabinën hyrëse ku konstatohet të jetë duke kryer shërbimin kontrollori Fatri Braha, shihet teksa është duke përpunuar dokumentet e një shtetasi shqiptar, zhvillohet biseda gjatë së cilës shtetasi i thotë se do të ike sërish në Gjermani, sepse ka makinë tjetër për të sjellë. Ndër të tjera, Fatri Braha i thotë : *Janë hi shumë makina or djalë. Sa makina ke pru në Shqipëri ti?...Fatri Braha: Po s'lejohet mbi tre or mik. Shtetasi: Po si s'lejohet o..Fatri Braha: 1,2,3,4,5,6 çi ke këto makina...ke ndonjë gjë në makinë?. Në makinë ndonjë gjë që nuk lejohet ke?...Do qesësh kafe..a nuk ke gjë?...Shyqyr."* Ndërkohë përgjigjet e shtetasit ndërsa Fatriu i drejtohet me fjalët si më sipër, nuk dëgjohen por nga pamjet filmike, në kabinën ku është Fatri Braha, shihet teksa hyn një koleg tjetër i tij dhe ndërkohë që vijon bisedën me shtetasin i drejtohet kolegut të tij duke e thërritur, me fjalët : *Fatriu: O Arben..e ka prurë krejt makina ky, sjell makina ky.. O Arben?.* Ndërkohë, kolegu i identifikuar sipas procesverbalit të këqyrjes si Arben Goçi i drejtohet shtetasit *duke e pyetur se nga është* ndërsa Fatriu vijon ti shpjegoje kolegut të tij bisedën me shtetasin duke i treguar se i ka thënë që nuk lejohen mbi tre makina. Gjatë kohës që zhvillohet kjo bisedë mes dy punonjësve Fatri Braha dhe Arben Goçi dhe shtetasit në sportel, ky i fundit hedh ne tavolinën e kontrollorit një pasaporte të cilën, pasi Fatriu e hap, merr prej saj një kartëmonedhë 10 euro. Sipas të dhënave në sistemin TIMS, rezulton se nga Fatri Braha është bërë shënimi "*Ju kalua doganës për veprim*" dhe shtetasi që rezulton të jetë përpunuar në këtë hark kohor është Rigert Lleshi. I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale ky shtetas tregon rrethanat e faktit të ndodhur në datë 8/2/2022 duke treguar se pas verifikimit të dokumenteve ka kaluar për verifikim tek dogana, por mohon dhënien e shumës 10 euro të fiksuar nga pamjet filmike. Sa rezulton nga të dhënat si më sipër, referuar provave të administruara në gjykim, rezulton se në ngjarjen gjatë së cilës shtetasit Rigert Lleshi i janë kërkuar para dhe më pas, siç rezulton nga pamjet i janë marrë 10 euro, në kabinë

kanë qenë prezent i pandehuri Fatri Braha dhe i pandehuri Arben Goçi, ku rezulton nga bisedat se të dy bashkë, në dijeni të problematikës së konstatuar sipas tyre, për këtë shtetas, komunikojnë me të dhe i prezantojnë problematikën, duke i lënë të kuptojë që duhet të paguajë, siç në fakt ndodh, veprimtari e cila realizohet me pjesëmarrjen dhe kontributin e përbashkët të të dy të pandehurve, pavarësisht se në shërbim në përpunimin e dokumenteve për këtë shtetas ka qenë Fatri Braha.

885. *Së dyti,* në datë 15.02.2022, në orën *08:13:46 min*, ndërkohë që vijon shërbimin kontrollori Haqif Halilaj, regjistrimi video dhe audio i transkriptuar evidenton se ai thërret kolegun e tij, dhe pasi ai vjen ne kabinën e shërbimit, vendos në tavolinën e punës një kartëmonedhë 50 euro të cilën shihet se e merr Haqif Halilaj. Ndërkohë që ndodh ky veprim, mes tyre është zhvilluar biseda si më poshtë: *Haqif Halilaj: Mbarova unë me Ilirin. Punonjësi tjetër që vjen në kabinë: Atë lej unë ty këto t'ja japësh... (koha kur i hedh mbi tavolinë 50-euro). Haqif Halilaj: Po mo lej. Punonjësi tjetër: Ma kryj ti mos ta nij hiç (ndërkohë pamjet filmike tregojnë se i vendos edhe një 50-tëshe euro tjetër mbi tavolinë të cilat merren të dyja nga punonjësi i Haqif Halilaj).* Sipas pamjeve filmike, shihet se ndërkohë që Haqif Halilaj përpunon dokumente në sistem, në sportel nuk ka udhëtarë që të shihet se janë duke u përpunuar dhe kanë dorëzuar dokumentet pranë tij. Ndërkohë që ai vijon përpunimin e pasaportës, në kabinën e shërbimit të tij vjen një punonjës tjetër policisë dhe ndërkohë zhvillohet një komunikim, me kolegun e ardhur rishtas të cilit Haqifi i thërret me emrin "Arben". Midis tyre është transkriptuar biseda në vijim: *Haqif Halilaj: O Arben, O Arben. Arbeni: Po.* Në këtë moment shihet Haqif Halilaj që i jep 50 euro dhe i drejtohet me fjalët: *Haqif Halilaj: Halimi ëëë* . Bisedaj vijon : *Arbeni: Arjani? Haqif Halilaj: Po. Une ti, Ylberi, Halimi, No koment me të tjerët. Arbeni: - Fjalë që nuk kuptohen- Haqif Halilaj: Thashë unë ti Ylberi edhe Halimi, tjeter kush jo, Ok ne rregull. Janë dhënë...që mos dalim dh...Arbeni: Jo jo edhe unë i thashë 100 mijë lekë kam bërë gjynah...e takova poshtë tek dogana. Haqif Halilaj: Po no koment me të tjerët. Arbeni: Jo Jo jo.* Nga pamjet filmike rezulton se punonjësi i policisë, i cili thërritet Arben dhe për të cilën referon ngjarja dhe komunikimit si më sipër, mban numrin identifikues, "05578" dhe nga verifikimi në sistem rezulton të jetë Arben Goçi. Në bisedën mes tyre përmenden emrat e punonjësve "Ylber, Halim, Arjan" por nuk rezulton që nga pamjet filmike, apo prova të tjera, të jetë identifikuar se cili ka qenë punonjësi që ka hyre me herët se sa Arben Goçi në kabinën e shërbimit të kontrollorit Halilaj dhe i ka lënë këtij të fundit dy herë, nga 50 euro si dhe nuk identifikohet qëllimi, nga bisedat apo veprimet qe dokumentohen nga provat e administruara ne gjykim, duke pamundësuar kështu përcaktimin dhe provueshmërinë e prezencës së elementeve të veprës penale, sa kohë nuk ka të dhëna nga prova të tjera, veç këtyre veprimeve dhe komunikimit mes vetë punonjësve të policisë në këtë rast.

886. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datë 08.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi TIMS si dhe të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike të fiksuara nga kamerat në këto data, rezulton se punonjësi i policisë Arben Goçi, në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Braha, kanë kërkuar, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke i

krijuar problematikë shtetasit në sportel lidhur me mjetet që ai konstatohet se ka kaluar edhe më herët, dhe më pas kanë pranuar dhe marrë para nga shtetasi i përpunuar në PKK Morinë në këtë datë, sipas faktit më sipër, kundrejt tolerimit të kalimit të tij kufi, pavarësisht problematikës që vetë këta punonjës i kanë prezantuar shtetasit. Këto veprime të kundërligjshme të tij, bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe konkretisht me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar".

887. Po ashtu rezulton se këto veprime janë konkretizuar nëpërmjet kryer kundrejt kërkimit, në mënyrë të tërthortë, marrjes dhe pranimit të shumës monetare të dhënë nga shtetasit, pavarësisht nëse problematika që ata i kanë prezantuar shtetasit lidhur me kalimin e mjeteve është ose jo e bazuar. Marrja dhe pranimi i shumave të parave (euro) të dhëna nga shtetasi në këtë rast është realizuar në saje të bashkëpunimit dhe kontributit të dhënë nga të dy të pandehurit në bashkëpunim me njëri tjetrin. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Arben Goçi, në bashkëpunim, evidentohet qartë në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili qartësisht përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Arben Goçi.

888. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në respektim të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Arben Goçi, në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Braha, evidentuar si më sipër, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje pranon shuma monetare, pavarësisht nëse problematika që i prezantohet shtetasit (mitëdhënësit) në këtë rast është e vërtetë ose jo. Veprimi në bashkëpunim në këtë rast është realizuar duke ndikuar secili prej të pandehurve, nëpërmjet mënyrës së komunikimit dhe veprimit të përbashkët, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur në mënyrë të heshtur, aty për aty, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

889. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Arben Goçi, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve

të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke marrë përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror, pavarësisht nëse këto problematika janë ose jo reale. Në rastin konkret gjykata vlerëson se mënyra se si është komunikuar me shtetasin dhe të pandehurit me njëri tjetrin në prezencë të shtetasit në sportel, kanë dështmuar qartë evidentimin e një problematike për kalimin ën kufi, prezantuar shtetasit në fjalë duke i treguar, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por tërësisht të kuptueshme, se duhet të paguajë për të kaluar kufirin, ashtu siç dhe në fakt ka ndodhur ku evidentohet dhënia prej tij e shumës 10 euro, dhe marrja e saj nga punonjësit e policisë Arben Goçi dhe Fatri Braha.

890. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Goçi përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Arben Goçi ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

891. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 228-240 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Goçi është person i cili ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës së tij, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin

e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Arben Goçi në cilësinë e tij si pjesë ë strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për tu klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal.

892. Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Arben Goçi**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Braha në ngjarjen e datës 08.02.2022, analizuar më sipër.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ANI HOXHOLLI

893. Lidhur me të pandehurin **Ani Hoxholli**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së në PKK Morinë *në ngjarjen e datës 01.03.2022, në bashkëpunim me të pandehurin Haqif Halilaj, Elidjana Toçila dhe Rezarta Lako*. Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Ani Hoxholli, në ngjarjet e datës 01.03.2022, në bashkëpunim me koleget e tij ka bashkëpunuar me ta në marrjen dhe pranimin e shumave të parave, nga shtetasit që kalojnë në PKK Morinë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e provave dhe konkretisht, pamjet filmike të evidentuara dhe përshkruara në procesverbalin e këqyrjes së tyre, bisedat e regjistruara audio të transkriptuara në procesverbalin përkatës, rezulton e provuar se në datë 01.03.2022, ora 09.21 minuta, në kabinën ku është duke kryer shërbimin e tij punonjësi i policisë Haqif Halilaj, kanë ndodhur veprimet si më poshtë: *(i)* rezulton se në këtë kabinë është futur e pandehura Elidjana Toçila e cila sipas pamjeve, fiksohet teksa nxjerr nga xhepi i saj një sasi kartëmonedhash të palosura të cilat ja jep Haqif Halilajt; *(ii)* në orën 09.30 në këtë kabinë evidentohet prezenca e përgjegjësit të turnit/grupit Ani Hoxholli, dhe sipas regjistrimit audio të transkriptuar, mes këtyre të fundit zhvillohet kjo bisedë: *Ani Hoxholli: .....komplet ..? Haqif Halilaj:....të gjitha duke përfshirë edhe Anin, ..e ja dhashë, thashë me e heq qafet,...nga s'të shkon mendja he nanën,..po më kërkojnë ato për deklarim e hiq. Ani Hoxholli: -e pa transkriptueshme- Haqif Halili: ...ë...edhe komandanti tha se, a ta pyes..(nuk kuptohet qartë). (iii)* Sipas pamjeve filmike rezulton se, në vijim në orën 09.31 minuta, në kabinën ku zhvillohen ngjarjet si më sipër, futet punonjësja tjetër e policisë e identifikuar si Rezarta Lako me detyrë kontrollore, e cila fiksohet qartë nga pamjet filmike duke nxjerrë para nga xhepi të cilat ia dorëzon Haqif Halilaj, ndërkohë që prezent në kabinë teksa

zhvillohet kjo ngjarje vijon të jetë ende përgjegjësi i turnit Ani Hoxholli; *(iv)* sipas procesverbalit të transkriptimit të komunikimeve të regjistruar video dhe audio, pasi dëgjohet kontrollori Halilaj teksa thotë " *...në rregull, ja mora atij .....dhe ja dhashë Mondit.....me paguar arkëtarin bre, e thashë të ja qojmë, në rast se i ke..?"* e ndërsa thuhen këto fjalë nga Haqifi, shihet Rezarta e cila ndërkohë nxjerr kartëmonedhat dhe ja jep këtij të fundit; (v) Pas këtij momenti, sipas procesverbalit të transkriptimit të regjistrimit audio dhe këqyrjes së pamjeve video, rezulton se mes punonjësit Haqif Halilaj dhe përgjegjësit të turnit Ani Hoxholli është transkriptuar biseda si vijon: *Haqif Halilaj:....se di, këto grupet tjera a mbaruan punë,.....unë mbarova me ta, se ndoshta mbaron punë sot me drejtorin...!? Ani Hoxholli: ..duhet të kenë mbaru, Haqif Halilaj :...se data 1 sot..!".*

894. Lidhur me këto episode dhe ngjarjet që kanë ndodhur në këtë datë në kabinën ky kryen shërbimin i pandehuri Haqif Halilaj, interval kohor gjatë të cilit qëndron në këtë kabinë edhe përgjegjësi i turnit Ano Hoxholli i cili komunikon me të pandehurin Haqif Halilaj, duke u evidentuara përmbajtja e bisedave siç u referua më sipër, duke iu referuar dinamikës së ngjarjes, veprimeve të kryera nga e pandehura Elidjana Toçila dhe në vijim nga e pandehura tjetër Rezarta Lako e cila kryen po të njëjta veprime duke nxjerrë dhe dorëzuar shuma parash tek kontrollori Haqif Halilaj, ndërkohë që prezent është përgjegjësi i turnit Ano Hoxholli, si dhe biseda e zhvilluar në dinamikë të këtyre ngjarjeve mes këtyre dy të fundit, në mungesë edhe të një shpjegimi relevant mbi shkaqet e dorëzimit të këtyre shumave tek kontrollori Halilaj, gjykata vlerëson se ky fakt dëshmon kryerjen e veprimeve në bashkëpunim mes të pandehurve Haqif Halilaj me të pandehurit Elidjana Toçila, Rezarta Lako dhe Ani Hoxholli, ku të pandehurit Haqif Halilaj i dorëzohen nga dy punonjëset e tjera shuma parash dhe ndërkohë ai zhvillon në këtë kontekst bisedat e transkriptuara me përgjegjësin e turnit Ani Hoxholli mbi këto shuma të grumbulluara dhe mbi arsyet e mbledhjes së këtyre parave, çka dëshmon kryerjen e veprimeve nga punonjësit e policisë si më sipër, në bashkëpunim më njëri tjetrin.

895. I pandehuri Ani Hoxholli, pavarësisht se nuk rezulton të kryejë veprime konkrete të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë shumë parash nga shtetasit, pasi për shkak të detyrës së tij (përgjegjës grupi/turni) ai nuk kryen përpunim të drejtpërdrejtë të shtetasve që paraqiten për të kaluar kufirin në sportele, referuar mënyrës se si ka vepruar, pretencës së tij gjatë "dorëzimit" të shumave të parave nga dy kontrolloret, si dhe kontekstit dhe përmbajtjes së bisedës së zhvilluar ndërkohë që ndodhin këto veprime me të pandehurin Haqif Halilaj, rezulton e qartë se ka dijeni të plotë dhe bashkëpunon me punonjësit përkatës, në realizimin e kësaj veprimtarie, pavarësisht se nuk kanë rezultuar të dhëna të provuara, mbi destinacionin e saktë të këtyre shumave të parave të mbledhura me dijeni të plotë dhe në prezencë të tij, por bisedat e zhvilluara dëshmojnë qartë qëllimin e mbledhjes së tyre si dhe dinamikën e veprimit të punonjësve të policisë kufitare që evidentohen në ngjarjet e kësaj datë, ku rezulton qartë bashkëpunimi i tyre dhe kryerja e veprimeve komplementare në funksion të realizimit të qëllimit kriminal.

896. *Së dyti*, referuar faktit objekt akuze, gjykata vlerëson se, në lidhje me faktin që referon në bisedat e kryera nga i pandehuri Lahert Sulo me shtetasin Naim Byberi në datë 01.02.2022 ku rezulton se i janë dërguar targat e katër automjeteve , të cilat më pas ai ja ka përcjellë vartësit të

tij, të pandehurit Ani Hoxholli duke i thënë që janë porosi e Naim Byberit dhe nëse vijnë në turnin e tij, duhet ti ndihmojë të kalojnë, nga ana e Prokurorisë së Posaçme, pavarësisht se referohen si fakte, nuk evidentohet në asnjë moment prezenca e ndonjë elementi që konsiston në kërkimin, marrjen apo pranimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga i pandehuri Lahert Sulo, vetë apo në bashkëpunim me të pandehurin Ani Hoxholli, në shkëmbim të "ndihmës" së kërkuar për ti ndihmuar të kalojnë kufirin. Nga provat e administruara dhe konkretisht deklarimet e të pandehurit Lahert Sulo, të dhënat e marra nga këqyrja e telefonit të tij, të dhënat e marra nga sistemi TIMS, nuk rezultojnë të dhëna për kalimin e këtyre mjeteve dhe të personave që i kanë këto mjete në pronësi (*sipas sistemit TIMS janë verifikuar pronaret e tre nga katër mjetet e referuara dhe konkretisht rezultojnë se tre nga mjetet janë përkatësisht në pronësi të shtetasve Vladimir Pepkolaj, Sulejman Gjakrosa dhe Ardian Barxho*) në muajin shkurt të vitit 2022 në të cilin referon biseda si më sipër. Përveçse nuk është vërtetuar fakti se këto mjete dhe përdoruesit e regjistruar të tyre kanë kaluar kufirin në datën e referuar, edhe nëse një fakt i tillë do të pranohej për një moment se është vërtetuar të ketë ndodhur, në këtë fakt/ngjarje, nuk referohet nga akuza asnjë element që konfiguron një nga format e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në drejtim të të pandehurit Ani Hoxholli, vetëm apo në bashkëpunim me të pandehurin tjetër që referohet në këto fakte Lahert Sulo.

897. *Sa më sipër*, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datat *01.03.2022*, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, dinamika e sjelljes dhe veprimeve të të pandehurit, pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike tregojnë qartë se i pandehuri Ani Hoxholli, ka bashkëpunuar me të pandehurit e tjerë Haqif Halilaj, Rezarta Lako dhe Elidjana Toçila, në marrjen e shumave të parave nga shtetasit, gjatë ushtrimit të detyrës së këtyre të fundit në PKK Morinë, pavarësisht se nuk evidentohen veprime të drejtpërdrejta të tij në kërkimin, marrjen apo pranimin e këtyre shumave nga shtetasit. Dinamika e ngjarjeve të zhvilluara, siç rezulton nga provat e analizuara më sipër, dëshmon jo vetëm dijeninë e të pandehurit Ani Hoxholli mbi këtë veprimtari të punonjësve por edhe bashkëpunimin e tij dhe angazhimin e drejtpërdrejtë e cila rezulton e qartë nga prezenca dhe roli i tij në fazën kur këto para grumbullohen, me qëllim " shpërndarjen" e tyre sikurse rezulton qartë nga bisedat që ai ka zhvilluar me të pandehurin Haqif Halilaj. E kundërta, pra mungesa minimalisht e dijenisë së tij dhe po ashtu e bashkëpunimit të tij në këtë veprimtari, do të duhej të ishte shoqëruar me veprime të kundërta që do të konsistonin në marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve për raportimin/kallëzimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme dhe penalisht të ndëshkueshme të punonjësve dhe jo bashkëpunim të tij në realizimin e këtij aktiviteti të kundërligjshëm.

898. Në vlerësimin lidhur me sa më sipër, gjykata thekson se roli dhe pjesëmarrja e të pandehurit Ani Hoxholli në realizimin e faktit penal objekt akuze, pavarësisht se nuk konkretizohet dhe dëshmohet nga veprime direkte te kërkimit, marrjes apo pranimit të mitës prej tij personalisht nga shtetasit që përpunohen në kufirin hyrës, provohet qartësisht në rolin e bashkëpunëtorit të punonjësve konkrete që kanë kryer këto veprime. Mënyra se si janë zhvilluar ngjarjet në këtë datë, veprimet konkrete dhe sjellja e të pandehurit Ani Hoxholli dhe të pandehurve të tjerë të përfshirë në rastin konkret, të dhënat e qarta që japin komunikimet e tij me

të pandehurin Haqif Halilaj pikërisht mbi këtë aktivitet të kundërligjshëm, të vlerësuara këto të fundit në cilësinë e indicjeve të rëndësishme, të besueshme të të përputhura me njëra tjetrën, parë nën optikën e parashikimeve të nenit 152, pika 2 të K.Pr.Penale në të cilin përcaktohet se "*Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*", krijojnë bindjen se ai jo vetëm ka qenë në dijeni por ka bashkëpunuar në realizimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme të bashkëpunëtoreve të tij, e cila qartësisht përmban elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohen secili prej tyre, parashikuar nga neni 259, pl në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Në lidhje me vlerën dhe peshën e indicjeve në drejtim të provueshmërisë së një fakti penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 179, datë 23.06.2022, ndër të tjera arsyeton se :"...*Kjo do të thotë se indicjet që të mund të vlejnë për të vërtetuar ekzistencën e një fakti duhet të plotësojnë tre kushte: të jenë të rëndësishme që do të thotë të jenë të vlefshme në ofrimin e një të dhëne faktike, të japin një fakt që ka rëndësi për objektin e të provuarit, të jenë të sakta, që do të thotë të mos jenë evazive e të tilla që nuk ofrojnë diçka që duket e qartë, në përputhje me njëra tjetrën që do të thotë që të merren parasysh duhet që indicjet të jenë jo në kundërshtim me njëra-tjetrën. Pra, njësimi i vlerës provuese të provës direkte me atë indirekte do të mund të bëhet vetëm në qoftë se ato janë pa të meta dhe në qoftë se nuk ka dyshim për përputhje mes tyre.....Që të argumentohet në mënyrë të saktë pohimi i parimit të "përtej dyshimit të arsyeshëm", duhet që indicjet, në kuptim të nenit 152 të KPP të përmbushin të tre elementët kumulativë. Vlerësimi i tyre sigurisht kalon në procesin e bindjes së brendshme të gjyqtarit profesionist, i cili nëpërmjet përvojës profesionale e maksimave të saj bën vlerësimin nëpërmjet logjikës dhe argumenteve, duke vlerësuar elementin faktik/indicjen si provë që vërteton një fakt. Në thelb të këtij vlerësimi është parimi se në mungesë të qoftë edhe njërës prej tyre, provat nuk mund të ngrihen në shkallën e provës së përshtatshme për të themeluar përgjegjësinë penale. Për më tepër, procesi i vlerësimit të tyre ndahet në dy momente të dallueshme: i pari synon të konstatojë shkallën më të madhe ose më të vogël të ashpërsisë dhe saktësisë së secilit prej tyre, i konsideruar i veçuar, i dyti konsiston në një ekzaminim global dhe unitar që synon të shpërbëjë paqartësi relative.*".

899. Në rastin konkret, gjykata vlerëson se të dhënat që japin *(i)* pamjet filmike dokumentuar dhe pasqyruar në procesverbalin e këqyrjes së tyre dhe *(iii)* regjistrimi audio i komunikimeve dhe bisedave të zhvilluara, pasqyruar në postverbalin e transpirimit të tyre, në lidhje me ngjarjen e datës 01.03.2022, në elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, në raport me vlerësimin në drejtim të përfshirjes së të pandehurit Ani Hoxholli në këtë veprimtari të kundërligjshme, për sa kohë nuk evidentojnë veprime të drejtpërdrejta të tij në kërkimin, marrjen apo pranimin e mitës nga shtetasit që kalojnë kufirin, nuk përbejnë provë të drejtpërdrejtë, por përbëjnë në raport me akuzën në ngarkim të tij, indicje të cilat janë të sakta, të rëndësishme dhe plotësisht të përputhura me njëra tjetrën, si dhe të besueshme në drejtim të mbështetjes së akuzës sa i përket dijenisë dhe pjesëmarrjes së tij në realizimin e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet. Në mbështetje të sa më sipër, gjykata konsideron edhe faktin që asnjëri prej katër të pandehurve të përfshire në ngjarjet objekt akuze të zhvilluara ne datë 01.03.2022 nuk ka dhënë një shpjegim të besueshëm dhe relevant mbi arsyen e marrjes dhe

grumbullimit të këtyre shumave të parave në kabinën ku është prezent i pandehuri Ani Hoxholli dhe i pandehuri tjetër Haqif Halilaj, për të kundërshtuar në këtë mënyrë atë çka rezulton nga provat dhe të dhënat që ato japin, se dorëzimi dhe grumbullimi i këtyre shumave, behet pikërisht për arsyen që rezulton e qartë në bisedat mes këtyre dy të pandehurve, për ti rindarë në drejtim te eprorëve apo personave të tjerë, ecuri e cila nuk ka rezultuar te jete hetuar dhe provuar me tej, por ndërkohë ngjarjet e zhvilluara dhe të vërtetuara, sikurse u analizuar më sipër, janë të mjaftueshme për të bindur gjykatën për prezencën dhe provueshmërinë e elementeve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal dhe bashkëpunimin e te paktën të pandehurve të evidentuara në këtë ngjarje, në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen, në bashkëpunim me njëri tjetrin.

900. Gjykata vlerëson elementët e anës objektive të veprës penale, analizuar më sipër, në raport edhe me rolin dhe funksionin e të pandehurit në PKK Morinë, duke konsideruar këtu edhe pretendimin e tij gjatë gjykimit se nuk ka qenë detyrë funksionale e tij kontrolli mbi veprimtarinë e punonjësve (kontrollorëve) dhe as përpunimi i qytetarëve në pikën hyrëse, për shkak të pozicionit të tij të punës si përgjegjës turni dhe jo si kontrollor, sikurse janë të pandehurit e tjerë. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se : *Së pari*, rezulton se i pandehuri Ani Hoxholli, në cilësinë e përgjegjësit të turnit, pavarësisht detyrave specifike në drejtim të organizimit të punës, mban cilësinë e punonjësit të policisë kufitare i cili, pavarësisht pozicionit të punës, ka për detyrë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit"[39][40], i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar"[41], i ndryshuar, të garantojë dhe sigurojë regjimin e ligjshëm të hyrje daljes së shtetasve në kufi si dhe të parandalojë kryerjen e veprave penale jo vetëm nga çdo shtetas, por për më tepër në funksion të detyrës së tij si epror në raport me kontrolloret që në rastin konkret janë vartësit e tij, të garantojnë ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre, dhe posaçërisht të veprojë në rast se konstaton kryerjen prej tyre të veprimtarisë të kundërligjshme, e posaçërisht nëse kjo veprimtari përbën vepër penale[42]. Në rastin konkret, rezulton se i pandehuri, me veprimet e tij, duke u përfshirë në veprime bashkëpunuese me punonjësit e policisë të cilët

---

[39] *Në nenin 18, pika 1, shkronjat ë) dhe f) të ligjit nr. 108/2014, ndër të tjera parashikohet se :".1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:....ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;"*

[40] *Në nenin 21, të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" parashikohet se "1. Në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit organizohet në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal."*

[41] *Në nenin 5 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" parashikohet se :" 2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.", ndërsa në nenin 6 të po këtij ligji, ndër të tjera, parashikohet se :" 1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen....".*

[42] *Në nenin 18, pika 1, shkronja c) të ligjit nr. 108/2014, parashikohet se :" 1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:... c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;".*

veprojnë në mënyrë të kundërligjshme duke konsumuar elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, ka vepruar në kundërshtim me detyrimet që përkufizojnë kryerjen e ligjshme të detyrës së tij si punonjës i policisë së shtetit, posaçërisht i strukturës për kufirin dhe migracionin, pavarësisht detyrave funksionale të tij në raport me pozicionin e shërbimit sipas rregullores së brendshme apo akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij në pozicionin konkret. Arrihet ky konkluzion pasi referuar legjislacionit si më sipër, dhe posaçërisht nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*", rezulton se policia e shtetit, përfshirë edhe policinë kufitare, organizohet mbi bazë hierarkie, por kjo hierarki, nuk përjashton çdo punonjës të policisë së shtetit për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në ligjin "Për policinë e shtetit" apo ligje të tjera që veprojnë në fusha të ndryshme, sikurse është në rastin konkret ligji "Për kontrollin kufitar" dhe tërësia e akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të këtyre ligjeve[43]. *Së dyti*, në raport me elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, pavarësisht se në rastin konkret nuk identifikohen veprimet e drejtpërdrejta të të pandehurit në kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë shume parash drejtpërdrejt nga qytetarët që kalojnë kufirin, në mos përmbushje të detyrës për kontrollin dhe kalimin e ligjshëm të kufirit, gjykata vlerëson se veprimet e të pandehurit Ani Hoxhollli, të cilat siç rezulton nga sa u analizua më sipër, nuk kufizohen vetëm në dijeninë dhe mosveprimin e tij në lidhje me veprimtarinë korruptive të kontrollorëve, në faktin që lidhet me datën 01.03.2022, por nga vlerësimi tërësor i

---

[43] *Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 71/2016 janë miratuar edhe një sërë aktesh të tjera nënligjore të tilla si : (i) Urdhër nr. 163, dt. 08.02.2018, "Procedura e Punës për organizimin, planizimin dhe kryerjen e shërbimit në SPK&M, sipas situatës dhe analizës së riskut"; (ii) Urdhër nr.164, dt.08.02.2018 "Procedurat e Punës për mbikëqyrjen e kufirit"; (iii) Urdhër nr.165, dt. 08.02.2018 "Procedurat e Punës për verifikimin kufitar në P.K.K e PPKK"; (iv) Urdhër nr.166, dt.08.02.2018 "Procedurat e Punës për verifikimin e trafikut tokësor, trafikut ajror, detar e liqenor në Kufi"; (v) Urdhër nr.167, dt. 08.02.2018 "Procedura e Punës për lehtësimin e verifikimeve kufitare"; (vi) Urdhër nr.168 dt. 08.02.2018 -"Procedura Standarde për refuzimin e hyrjes në kufi të RSH-së të shtetasit të huaj". (vii) Urdhër nr. 169 dt. 08.02.2018 "Procedura Standarde të Punës për refuzimin e daljes së shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kufi"; (viii) Urdhër nr. 175 dt. 08.02.2018 - "Procedura e Regjistrimit në Sistemin TIMS të verifikimit që kryhet për kontrollin e hyrje-daljeve". (ix) Urdhër nr. 170 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për trajtimin e shtetasve të huaj me leje qëndrimi". (x) Urdhër nr. 171 dt. 08.02.2018 - "Procedura Standarde e punës për lëshimin e vizave në kufi dhe anulimin e tyre". (xi) Urdhër nr. 172 dt. 08.02.2018 - "Procedurat standarde për përzgjedhjen e shtetasve të huaj të parregullt dhe masat që merren". (xii) Urdhër nr. 173 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për zgjatjen e qëndrimit mbi afatin e përcaktuar ligjor të shtetasit të huaj". (xiii) Urdhër nr. 174 dt. 08.02.2018 - "Procedura standarde për vlerësimin e aplikimeve për vizë në Shqipëri të shtetasve të huaj". (xiv) Urdhër nr. 176 dt. 08.02.2018 - "Procedurat standarde për largimin/dëbimin e shtetasit të huaj me qëndrim të parregullt në RSH". (xv) Urdhër nr. 1294/1, datë 17.05.2016, "Procedura e punës për zbulimin e lëndëve radioaktive; (xvi) Urdhër nr. 18378, datë 08/08/2017, "Procedurat standarde të punës që drejtojnë përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe mjeteve të transportit që kalojnë kufijtë e Republikës së Shqipërisë me anë të skanerave fiks dhe të lëvizshëm".*

të dhënave që japin provat, vlerësuar në raport me veprimtarinë e këtij të pandehuri në nivelin e indicjeve të rëndësishme, të besueshme dhe të përputhura me njëra-tjetrën, tregojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e tij në këtë veprimtari së bashku me kontrollorët përkatës, pavarësisht nëse shumat parave nga këta të fundit janë marrë në këmbim të mos përmbushjes së rregullt të detyrës apo pa ndonjë shkak të tillë, ku fakt nuk ka rendësi thelbësore për vlerësimin e faktit në raport me elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259,pg 1 i Kodit Penal, pasi në lidhje me këtë vepër penale mjafton të vërtetohet një nga format, kërkimi, marrja ose pranimi, i një shpërblimi në funksion të dhënies së shërbimit publik, pavarësisht nëse kjo përbën ose jo mos përmbushje të rregullt të detyrës nga punonjësit publikë.

901. Ngjarjet e zhvilluara në datë 01.03.2022, dinamika e tyre dhe veprimet e secilit të pandehur të përfshirë në këtë episod, po ashtu edhe e të pandehurit Ani Hoxholli, tregojnë qartë mënyrën e veprimit dhe rolin e tij në mbledhjen e shumave të parave nga disa prej punonjësve në funksion të ndarjes së tyre në drejtim të punonjësve të tjerë, të papërcaktuar, sipas bisedave të zhvilluara prej tij me të pandehurin Haqif Halilaj, nga të cilat rezulton jo vetëm dijenia por provohet qartë pjesëmarrja e këtij të fundit në realizimin e qëllimit kriminal. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Ani Hoxholli, në bashkëpunim me kolegët, sipas ngjarjeve të zhvilluara në datë 01.03.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Ani Hoxholli. Në drejtim të vlerësimit të elementeve të bashkëpunimit, veç sa më sipër, gjykata mban në konsideratë edhe faktin se gjatë kryerjes së një vepre penale në bashkëpunim, nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëpunëtoret të veprojnë të gjithë së bashku dhe të kryejnë të njëjtat veprime konkrete në drejtim të realizimit të veprës penale pasi sipas roleve përkatëse, veprimet e tyre mund te jenë edhe komplementare, por të nevojshme ër arritjen e qëllimit final. Pra jo gjithmonë, të gjithë personat që veprojnë në bashkëpunim më njeri tjetrin, do te shfaqen së bashku duke vepruar për kryerjen e çdo veprimi në funksion të realizimit të veprës. E rëndësishme në vlerësimin mbi prezencën e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, që dëshmon ndër të tjera, edhe elementët e bashkëpunimit, është evidentimi dhe provueshmëria e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në veprime të përbashkëta ose komplementare, në funksion të realizimit të të njëjti qëllim.

902. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në referim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Ani Hoxholli, kryer në bashkëpunim me kolegët e tij, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr pjesë në këtë veprimtari të kundërligjshme dhe të ndëshkueshme penalisht, duke qenë në dijeni dhe duke bashkëpunuar me koleget e tij për mbledhjen e shumave të parave të marra nga këta të fundit, në funksion të rindarjes së tyre, sipas një skeme që përmendet qartë në komunikimet e tij me eproret,

pavarësisht se nuk është arritur të provohet fakti se në drejtim të cilit prej punonjësve të policisë shkojnë këto para të grumbulluara. Po ashtu në këtë ngjarje, siç rezultoi më sipër, i pandehuri Ani Hoxholli ka vepruar në bashkëpunim me koleget e tij, duke ndikuar secili prej tyre, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur mes tyre, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

903. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Ani Hoxholli, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke bashkëpunuar me kontrolloret, të cilët kanë marrë ose pranuar përfitime të parregullta të dhëna nga shtetasit e përpunuar në pjesën hyrëse të PKK Morinë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror pasi roli i tij evidentohet qartë në fazën e grumbullimin të shumave të parave, në funksion të ndarjes së tyre sipas skemës që rezulton nga komunikimet e zhvilluara midis tyre.

904. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se i pandehuri Ani Hoxholli përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Ani Hoxholli ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

905. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, në paragrafët 607-622 të këtij vendimi, gjykata vlerëson se i pandehuri Ani Hoxholli është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Ani Hoxholli, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

906. *Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Ani Hoxholli**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurit Rezarta Lako, Elidjana Toçila dhe Haqif Halilaj, në faktin penal të ndodhur në datë 01.03.2022, analizuar më sipër në këtë vendim.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit EMILTON ASLLANAJ

907. Lidhur me të pandehurin **Emitlon Asllanaj**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzë për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publikë", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259, pg 1 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim (paragrafët 607-622) vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Emilton Asllanaj është e bazuar dhe provohet.

908. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Emilton Asllanaj, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare dhe pozicionin e përgjegjësit të turnit në pikën e kalimit kufitar Morinë, evidentohet në disa momente të këtij fakti penal, të cilat analizohen nga gjykata me vete, në vijim.

909. *Së pari*, prezenca e të pandehurit Emilton Asllanaj është evidentuar në ngjarjen e datës 14.02.2022 ora 09.35 të ndodhur në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Urim Lami. Referuar pamjeve filmike dhe regjistrimit audio të kryer në kabinën hyrëse nr.4, në datë 14.02.2022, në orën 09.52 minuta, referohet se ndërsa është duke punuar në kabinë Urim Lami, aty gjendet edhe punonjësi i policisë Emilton Asllanaj i cili siç përshkruhet nga pamjet, mban një telefon në dorë. Më herët në orën 09.51 minuta, kontrollori Urim Lami ka marrë në mes të dokumenteve që ka në përpunim një kartëmonedhë 5 euro, të cilën e vendos tek tastiera dhe e merr me pas. Ai pyet shtetasin në sportel për dokumentet e vaksinimit dhe përmend në komunikimin me të shumën 5 euro, duke zhvilluar ndër të tjera këtë bisedë: *Urim Lami: Ke vaksinë e duhet me ba edhe test s'duhet me te leju me kalu pa leju me kalu pas test ...ku do ..nuk degjohet llamarinat. Shtetasi; Nuk dëgjohet .... ka test me ba këtu. Urim Lami: Nja 20 njezët po njëherë. Shtetasi...Nuk dëgjohet. Urim Lami: Hajt pra që mbaje... Nuk dëgjohet ...5 euro.. per 20 shkon e ben atje...".* Gjatë kësaj kohe referohet se brenda në kabinë është edhe i pandehuri tjetër Emilton Asllanaj, përgjegjësi i turnit, por nuk referohen të dhëna për veprime të tij apo komunikime, në drejtim të vlerësimit mbi dijeninë dhe bashkëpunimin e tij me të pandehurin Urim Lamin e realizimin e këtij episodi, ndërkohe që rezulton e qartë se i pandehuri Urim Lami pasi ka biseduar me shtetasin në sportel për vaksinat, ka marrë shumën 5 euro prej shtetasit Dritan Hasani, sipas të dhënave të regjistruar në sistem në këtë moment kohor. Po ashtu, sipas pamjeve filmike dhe procesverbalit të këqyrjes së tyre, referohet se I pandehuri Emilton Asllanaj ka hyrë në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Urim Lamin ë orën 09.52 minuta, ndërsa veprimet e të pandehurit Lami për kërkimin e mitës dhe marrjen, nëpërmjet një zarfi të cilin e vendos poshtë tastierës, të shumës 5 euro nga shtetasi në sportel, kanë ndodhur më herët se sa prezenca e tij të evidentohej Brenda në kabinën e kontrollorit. Po ashtu gjykata evidenton se nuk rezulton asnjë komunikim, veprim apo sjellje, që të dëshmojë minimalisht dijeninë e tij në këtë rast mbi veprimin e kundërligjshëm të të pandehurit tjetër, e për me tepër bashkëpunimin e tij në kryerjen e veprës penale në këtë episode.

910. *Së dyti,* fakti objekt akuze për të pandehurin Emilton Asllanaj referon edhe në komunikimin e datës 02.01.2022 mes të pandehurit Lahert Sulo me një shtetas dhe më pas më të pandehurin Emilton Asllanaj. Konkretisht nga këqyrja e komunikimeve të të pandehurit Sulo, me kontaktin e regjistruar në telefonin e tij si "Tani Durrës", që lidhet me kalimin në kufi të shtetases Zajmina Vasjari, për të cilën referohet në bisedë se nuk ka prokurë nga prindi tjetër për fëmijët e saj të mitur, komunikim të cilin i pandehuri Lahert Sulo ja ka përcjellë të pandehurit Emilton Asllanaj duke i kërkuar ta ndihmojë për të kaluar në kufi, referuar të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, *posaçërisht të dhënat e marra nga sistemi TIMS*, rezulton se kjo shtetase në datën e referuar në të cilën zhvillohet komunikimi si më sipër nuk ka të regjistruar as hyrje dhe as dalje në pikën e kalimit kufitar Morinë. Nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se ajo ka dalje në datë 02.01.2022 dhe hyrje në datë 04.01.2022 por këto lëvizje të saj janë regjistruar dhe kryer nga Pika e Kalimit Kufitar Murriqan dhe jo nga Pika e Kalimit Kufitar Morinë ku ushtron detyrën i pandehuri Lahert Sulo dhe i pandehuri Emilton Asllanaj. Për pasojë, pavarësisht komunikimit të gjetur në telefonin e të

pandehurit Lahert Sulo me shtetasin e regjistruar në kontakte si "Tani Durrës" dhe më pas me vartësin e tij, të pandehurin Emilton Asllanaj, rezulton se shtetasja Zajmina Vasjari në datat në të cilat referon komunikimi ka të regjistruar dalje dhe hyrje nga territori i Republikës së Shqipërisë nga një pikë tjetër e kalimit kufitar, të ndryshme nga PKK Morinë ku ushtron detyrën i pandehuri Lahert Sulo dhe vartësi i tij i pandehuri Emilton Asllanaj. Po ashtu gjykata evidenton se, përves sa me sipër, në prova e administruara lidhur me këtë ngjarje, nuk referohet nga Prokuroria në asnjë moment prezenca e veprimeve aktive të kundërligjshme, të kryera me dashje, vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë, për të pandehurin Emilton Asllanaj, në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm, si forma të kryerjes së veprës penale për të cilën ai akuzohet. Pra lidhur me këtë fakt, nga tërësia e provave të administruara dhe të vlerësuara në raport me njëra tjetrën, pavarësisht komunikimit të konstatuar mes të pandehurit Emilton Asllanaj me të pandehurin Lahert Sulo, nuk evidentohet dhe as rezulton ndonjë veprim konkret i tij për të mundësuar "lejimin e kalimit pa dokumente të rregullta në kufi" të shtetases Zajmina Vasjari, pasi rezulton tërësisht e provuar nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS se kjo shtetase në këto data ka kaluar kufirin nga një pikë tjetër e kalimit kufitar dhe jo nga pika e kalimit kufitar Morinë ku ushtronte detyrën i pandehuri Emilton Asllanaj.

911. *Së treti,* duke konsideruar mos konkretizimin dhe formulimin në mënyrë tërësore dhe të përgjithshme të fakteve objekt akuze të bërë nga ana e Prokurorisë, në lidhje me ato fakte që evidentohen në drejtim të akuzës së ngritur ndaj të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të pandehurin Emilton Asllanaj, për veprën penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal (*të cilat referojnë në ngjarjet e ndodhura në vitin 2022 dhe të dokumentuara kryesisht nëpërmjet regjistrimit audio dhe video të kamerave të instaluara në kabinat e pikës hyrëse*) gjykata çmon të marrë në analizë, akuzën e formuluar dhe faktet në të cilat ajo referon në raport me atë çka provohet ose jo në veprimet dhe mosveprimet konkrete të këtij të pandehuri. Konkretisht, pas paraqitjes tërësore të përmbajtjes së provave (*të dhënave të regjistrimeve audio dhe video, të dhënave të sistemit TIMS dhe deklarimeve*) në lidhje me ngjarjet e vitit 2022, Prokuroria në aktin e komunikimit të akuzës për çdo të pandehur, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në mënyrë identike edhe në konkluzione përfundimtare[44], Prokuroria e mbështet akuzën, ndaj të

---

[44] *Shih konkluzionet përfundimtare, faqe 263,264,265, ku në mënyrë të plotë, lidhur me akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 259 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, argumentohet se :"....**Pra,** rezulton e provuar se të pandehurit Laert Sulo, Ani Hoxholli, **Emilton Asllanaj**, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Isiberi, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismailaj), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami (Elezi), Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuliana Maksutaj, Ylber Hoxha, Bedri Duraku, Avni Tershalla, Arben Goçi, Shpëtim Cenaj dhe Sule Onuzi, kane konsumuar elementet te vepres "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 259 dhe 25 i Kodit Penal, kjo për këto arsye:**Së pari,** personat pandehur me veprimet e mos veprimet e tyre në periudha të ndryshme kohore, bazuar edhe në porositë e kryera në formë favoresh nga shtetas të ndryshëm lejon kalimin e kufirit të shtetasve pa u regjistruar në sistemin TIMS, kryen kërkime në sistemin TIMS për persona të cilët mund të paraqesin rrezikshmëri shoqërore, të cilët i kontrollonin dhe jepnin informacione nëse janë në kërkim apo jo. Veprime të cilat kryhen kundrejt marrjes se ryshfetit duke u takuar më pas me këta shtetas. Po ashtu, paraqiten raste ku për shkak të kompetencave që i jep detyra funksionale, ushtron ndikim tek vartësit e vet për favorizimin dhe mos regjistrimin e shtetasve në kufi siç janë rastet e cituara me sipër kundrejt përgjegjësve të turnit, **Emilton Asllanaj,** Artan Redhaj dhe Ani Hoxholli ku në vijim këta punonjës në kundërshtim*

gjithë të pandehurve, për pasojë edhe ndaj të pandehurit Emilton Asllanaj në këto argumente: Sipas Prokurorisë, ***(i)*** *nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundërligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video...Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policisë Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime koruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri- tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro...(ii) është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turni të tyre, ku çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim. Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçantë pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e*

---

dhe në shkelje të plotë ligjit kanë kryer veprime për kalimin në kufi të shtetasve, pa u regjistruar në sistemin TIMS apo duke ju shmangur kontrollit kufitar. (Kjo pjese pavarësisht se paraqitet në analizën tërësore duket se ka lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Lahert Sulo dhe të pandehurit ***Emilton Asllanaj****, Artan Redhaj dhe Ani Hoxholli dhe jo me të pandehurit e tjere- shënim i gjykatës).****Së dyti,*** *nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundërligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston* ***në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video****, nëpërmjet aplikimit të metodave speciale të përgjimit të bisedave në kabinat e kontrollorëve në hyrje të Shqipërisë, në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës. Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policisë Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime koruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro. Shuma e përfitimit rezulton nga 350 euro deri në 400 euro, ndonjë ditë shkon edhe më tepër, kjo, bazuar në llojin e veprimit të kundra ligjshëm që kryhet nga punonjësi i policisë, siç është konstatuar tek rastet e lejimit të mallrave kontrabandë dhe shmangies së kontrollit të vijës së dytë, ku drejtuesi i automjetit është konstatuar të lërë ryshfet në shumën 200 euro për një kalim. Për veprimin e mos regjistrimit të shtetasve ne sistemin Tims, pavarësisht nëse ka apo nuk ka probleme të regjistruara në sistem, pagesa varion nga 60 euro deri në 70 euro për person, kur ka patur disa persona, deri ne tre, pagesa ka rezultuar deri ne 300 euro. Po ashtu, për veprimin e kundërligjshëm të lejimit të shtetasve të huaj për udhëtimin e tyre drejt Shqipërisë, në mungesë të dokumentacionit të vaksinimit ose në mungesë të autorizimit nga pronari për përdoruesin e mjetit, pagesa varion nga 5 euro, 19 euro, 20 euro për person. Po ashtu, pagesat për veprimin e mos regjistrimit të automjeteve të shtetasve të ndryshëm në kufi, të cilat në shumë raste rezulton se janë automjete me problem, si dhe personave që i transportojnë këto automjete, variojnë nga 50 euro deri ne 100 euro për person.* ***Së treti,*** *nga aktet është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turni të tyre, ku* ***çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim.*** *Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçante pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit".*

përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit.". Në lidhje me këtë element të akuzës, gjykata vlerëson se, nga tërësia e provave të administruara në gjykim, vlerësuar në raport me njëra tjetrën si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, ky mekanizëm i përshkruar nga Prokuroria në akuzën e ngritur, nuk arrin të provohet, përveçse në mënyrë të pjesshme në ngjarjen e datës 01.03.2022 në të cilën janë përfshire të pandehurit Ani Hoxholli, Haqif Halilaj, Rezarta Lako dhe Xhulajana Maksutaj. Në lidhje me të pandehurit e tjerë, përfshirë edhe të pandehurin Emilotn Asllanaj në rastin konkret, nuk evidentohen dhe për pasojë as provohen, minimalisht ekzistenca e veprimeve konkrete për realizimin e këtij mekanizmi nga ana e këtij të pandehuri, duke bërë më tej të pamundur vlerësimin mbi provueshmërinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të kundërligjshmërisë së veprimeve në këndvështrim të përmbajtjes ose jo të elementëve të veprës penale dhe të bashkëpunimit të tij me të pandehurit e tjerë. Në këtë këndvështrim, gjykata evidenton se është e qartë se (i) nga mënyra se si është vepruar në disa raste, (ii) fakti që në këto veprime të kundërligjshme janë përfshire një numër i lartë punonjësish si dhe (iii) duke ju referuar shtrirjes kohore të veprimeve të tyre në një periudhë relativisht të gjatë, krijohen dyshime të arsyeshme mbi mundësinë e ekzistencës dhe funksionimit të këtij mekanizmi veprimi për të cilin referon Prokuroria, por duke gjykuar mbi atë çka provat ofrojnë egzaktësisht në provat e administruara në gjykim, gjykata vlerëson se ky element i akuzën nuk arrin të provohet plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në provat e administruara, duke mbetur në këtë mënyrë në nivelin e një dyshimi, mbi të cilin do të duhej të ishte hetuar me tej. Për më tepër, në raport me të pandehurin Emilton Asllanaj nuk rezulton që në asnjë moment në tërësinë e faktit dhe provave mbi të cilat ai mbështetet, të ketë rezultuar kryerja prej tij e ndonjë veprimi në drejtim të realizimit të kësaj skeme për kryerjen e veprës penale. Vetëm fakti që ai është përgjegjës turni në kohën që kanë ndodhur ngjarjet objekt akuze, për të cilat u gjetën fajtore një pjesë e të pandehurve, nuk mund të shërbejë si bazë për të ngarkuar atë me përgjegjësi penale pasi përgjegjësia penale, është konkrete dhe individuale dhe nuk mund të ravijëzohet në mënyrë absolute mbi bazë prezumimi. Për këto arsye, gjykata vlerëson se këto elementë të akuzës së ngritur, në drejtim të vlerësimit të përfshirjes dhe me tej përgjegjësisë penale të të pandehurit Emilton Asllanaj në rastin konkret, nuk mund të përbëjnë bazë për përcaktimin e fajësisë së tij, për sa kohë që nuk rezulton minimalisht evidentimi i prezencës dhe ndonjë veprimi konkret të tij në gjithë faktin penal objekt akuze lidhur me zhvillimin e ngjarjeve që përbejnë këtë mekanizëm, sipas akuzës së ngritur nga Prokuroria.

912. Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e veprës penale dhe përgjegjësinë e të pandehurit Emilton Asllanaj për veprën penale për të cilën akuzohet, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit

Penal, analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim[45]. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike që garantojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë, juridike apo të shtetit; (ii) Anën objektive të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal konkretizohet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme të shfaqura në formën e kërkimit, marrjes ose pranimit të çdo lloj përfitimi apo oferte të kundërligjshme nga zyrtari publik, për vetë ose për të tjerë, me qëllim për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën dhe funksionin e tij publik. Pra që te konsiderohet e kryer nga pikëpamja e anës objektive kjo vepër penale, mjafton vërtetimi qoftë dhe vetëm i njërës nga këto forma të kryerjes së saj. (iii) Subjektin e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) ana subjektive e veprës penale e cila karakterizohet nga prezenca e elementit faj, pasi subjekti jo vetëm duhet të jetë i përgjegjshëm por duhet dhe që të veprojë me faj si dhe të konfigurohet dhe të rezultojë qëllimi i kryerjes së kësaj vepre, i cili konsiston në përvetësimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga ana e subjektit.

913. Në rastin konkret, në të tre faktet që i atribuohen të pandehurit Emilton Asllanaj, analizuar më sipër në këtë vendim, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Konkretisht:

914. Në faktin që lidhet me ngjarjen e datës 14.02.2022 ku evidentohet prezenca e të pandehurit Emilton Asllanaj në kabinën e shërbimit të kontrollorit Urim Lami, ndërkohë që para se të shfaqet prezenca e tij, provohet se Urim Lami ka kërkuar dhe marrë nga shtetasit që ka përpunuar në pikën hyrëse një shumë parash, nuk rezulton nga provat asnjë veprim ose mosveprim i të pandehurit Emilton Asllanaj për përfshirjen e tij në realizimin e këtij fakti penal. Në këtë rast, nga provat rezulton se (i) veprimet e të pandehurit Urim Lami për kërkimin e mitës nga shtetasit kanë ndodhur në një moment kohor me te hershëm se sa të evidentohet prezenca e të pandehurit Emilon Asllanaj në vendin ku ndodhen këto ngjarje; (ii) nuk ka asnjë element që buron nga provat që të provojë pjesëmarrjen e tij, në çdo formë (me fjalë, veprime etj.) në realizimin e këtij fakti penal; (iii) nuk ka asnjë të dhënë që burrin nga provat që dëshmon

---

[45] *Katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal janë analizuar në mënyrë të hollësishme në paragrafët 607-622 me sipër në këtë vendim.*

minimalisht edhe dijeninë e tij mbi këtë fakt të ndodhur pasi, siç referohet nga vete procesverbali i këqyrjes së pamjeve filmike ai ka hyrë në kabinë pasi kjo ngjarje ka ndodhur dhe po ashtu i pandehuri Urim Lami e ka marrë shumën përkatëse nga shtetasi me zarf, duke e fshehur, dhe duke bërë në këtë mënyrë objektivisht të pamundur qoftë edhe dijeninë e të pandehurit Emilton Asllanaj që vjen më vonë, mbi këtë veprim të kolegut të tij. Pra në lidhje me ketë fakt, nga të dhënat që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, në lidhje me ketë fakt penal, rezulton e qartë se nuk ka asnjë element të besueshëm dhe për më tepër të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i pandehuri Emilton Asllanaj ka kërkuar, marrë, ose pranuar, vetë apo bashkëpunim me të pandehurin Urim Lami, ndonjë shumë parash apo çdo lloj përfitimi tjetër të paligjshëm nga shtetasi konkret. Në këtë kontekst gjykatës i rezulton se në lidhje me këtë fakt nuk rezulton asnjë e dhënë që të provojë prezencën e veprimeve aktive të kundërligjshëm të të pandehurit Emilton Asllanaj në funksion të konkretizimit të ndonjërës prej formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën ai akuzohet.

915. Në lidhje me ngjarjen e datës 02.01.2022, sa i përket komunikimit të tij me të pandehurin Lahert Sulo dhe kryerjen e veprimeve për favorizimin e kalimit në kufi të shtetases Zajmina Vasjari në mungesë të dokumenteve (prokurës) për fëmijët e mitur, sikurse referon akuza, gjykata vlerëson se nga provat e administruara u provua qartësisht se fakti nuk ekziston. Kjo pasi pavarësisht këtij komunikimi, nga provat e marra dhe konkretisht të dhënat e sistemit TIMS rezulton se kjo shtetase në këto data ka kaluar kufirin nga PKK Murriqan, duke bërë objektivisht të pamundur atë çka referon akuza, pra kryerjen e veprimeve aktive të kundërligjshme nga i pandehuri Asllanaj për favorizimin e kalimit tę saj në kundërshtim me ligjin, nga PKK Morinë. Pra nga provat e administruara rezulton tërësisht e qartë se ky fakt nuk provohet se ekziston. Edhe nëse do të rezultonte se ka ndodhur, përsëri nuk evidentohet në asnjë moment në faktin objekt akuze, konkretizimi i ndonjë nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën ia pandehuri akuzohet, dhe konkretisht kërkimi, marrja apo pranimi prej tij e ndonjë përfitimi të kundërligjshëm. Ajo çka rezulton lidhur me këtë fakt, është vetëm komunikimi i tij me të pandehurin Lahert Sulo, i cili në vetvete nuk mund të përbëjë vepër penale dhe nuk mund të provojë ekzistencën e kësaj të fundit sikurse referon akuza.

916. Në lidhje me "akuzën" e atribuuar në mënyrë të përgjithshme, në tërësinë e saj, mbi mekanizmin e kundërligjshëm dhe të organizuar mbi bazën e të cilit kryhej korrupsioni në PKK Morinë (shih me sipër) gjykata vlerëson se jo vetëm provueshmëria e këtij mekanizmi mbetet e pa provuar në mënyrë të plotë (përveç një rasti ku ai provohet pjesërisht) por nuk rezulton që në asnjë moment të evidentohen dhe individualizohen veprime të kundërligjshme të të pandehurit Emilton Asllanaj në lidhje me këtë fakt. Kjo "akuzë" e formuluar në mënyrë të përgjithshme, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen në përgjegjësi penale dhe dënimin e këtij të pandehuri, për sa kohë mbetet në nivel hipotetik dhe nuk rezulton të konkretizohet dhe të provohet në asnjë moment, nga tërësia e provave të administruara, se cilat janë veprimet konkrete te këtij të pandehurit, të lokalizuar në kohë dhe në hapësirë, si dy elemente thelbësore që karakterizojnë ekzistencën e faktit penal, në raport me ketë "akuzë" të referuar në mënyrë të përgjithshme.

917. Sa më sipër, gjykata vlerëson se në të tre elementet në të cilët konsiston akuza ndaj të pandehuri Emilton Asllanaj, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të ritheksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin Emilton Asllanaj, gjykata vlerëson se jo vetëm që ndodhemi në kushtet kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit por ndodhemi para situatës kur ky fakt nuk provohet se ka ndodhur (në episodin e dytë të analizuar).

918. Sa më sipër, në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Emilton Asllanaj në të tre faktet që i atribuohen, te jete kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij publike.

919. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronjat b) dhe d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Emilton Asllanaj duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti përbën vepër penale (lidhur me ngjarjen e dytë analizuar më sipër) dhe po ashtu nuk provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet (në lidhje me faktin e parë dhe të tretë), për sa kohë që nuk provohen elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit RENI DOKOLLI

920. Lidhur me të pandehurin **Reni Dokolli**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzë për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publikë", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259, pg 1 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim (paragrafët 607-622) vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Reni Dokolli është e bazuar dhe provohet.

921. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Reni Dokolli, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare në pikën e kalimit kufitar Morinë, evidentohet në disa momente të këtij fakti penal, të cilat analizohen nga gjykata me vete, në vijim.

922. *Së pari*, lidhur me faktin që konsiston në gjetjen, heqjen dhe dorëzimin e pajisjeve përgjuese të vendosura në kabinat hyrëse të PKK Morinë, fakt ky i ndodhur në datë 08.03.2022, nga provat e administruara rezulton se (i) këto pajisje janë hasur dhe gjetur nga i pandehuri Reni Dokolli dhe së bashku me persona të tjerë janë hequr nga vendi ku ishin vendosur duke ndërprerë kështu regjistrimi e mëtejshëm audio dhe video të realizuar në kuadër të këtij procedimi penal; (ii) rezulton se i pandehuri Reni Dokolli, sipas komunikimeve të tij të evidentuara nga këqyrja e telefonit të tij, ka komunikuar me kontaktin "Jon Ramovi" gjatë datës 08.03.2022 dhe në ditët ne vijim, për të kuptuar se çfarë janë këto pajisje të gjetura dhe nëse janë vetëm regjistruese apo edhe transmetuese të të dhënave në kohë reale; (iii) rezulton se këto pajisje janë dorëzuar prej tij tek eproret, por ka pasur dyshime se ato janë dorëzuar të dëmtuara, ose janë dëmtuar më vonë; (iv) në lidhje me ketë ngjarje, rezulton e provuar se ka qenë objekt i procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës me nr. 113, viti 2022 për veprën penale "*Ndërhyrje e padrejtë në jetën private*", parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal. Referuar këtyre të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim, në lidhje me faktin që nga akuza referohet si "*fshehje e provave*" në lidhje me pajisjet përgjuese, në bashkëpunim me kolegët e tij, gjykata vlerëson se kjo veprimtari, pra e gjithë veprimtaria e punonjësve të PKK Morinë, pas zbulimit dhe heqjes së pajisjeve të regjistrimit të instaluara në kabinat e kësaj pike të kalimit kufitar, rezulton se ka qenë objekt i një procedimi penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës me nr. 113, viti 2022 për veprën penale "*Ndërhyrje e padrejtë në jetën private*", parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal dhe sipas akteve të administruara në gjykim, referuar me sipër në rrethanat e faktit në këtë vendim, përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Kukës me shkresën nr. 767/1 prot., datë 21.04.2022, rezulton se veprimet e punonjësve të policisë dhe personave të tjerë të cilët kanë ndërhyrë për heqjen apo dëmtimin e pajisjeve përgjuese, përbëjnë faktin objekt hetimi në kuadër të këtij procedimi penal. Në këto fakte, në raport me akuzën e ngritur ndaj të pandehurit Reni Dokolli për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, nga Prokuroria e Posaçme nuk referohet ndonjë elementët që dëshmon veprime të kundërligjshme të konkretizuar në kërkimin, marrjen ose pranimin e ndonjë përfitimi të

paligjshëm nga ana e të pandehurit. Po ashtu në fakt i tillë nuk rezulton as nga tërësia e provave të administruara në gjykim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se në këtë fakt nuk rezulton prezenca e asnjë elementi që të krijojnë minimalisht dyshim të arsyeshëm për prezencën e elementeve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Reni Dokolli. Veprimet apo mosveprimet e tij në raport me këto fakte janë objekt i procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës dhe do të duhet të vlerësohen pikërisht nga ky organ që ka zhvilluar hetime në drejtim të këtij fakti.

923. *Së dyti,* lidhur me faktin që referon në komunikimet e tij me kontaktin e shënuar në telefonin e tij si "Valon Ahmeti Zvicër" ky nga konteksti i komunikimit mes tyre rezulton ai e pyet mbi pajisjet skanuese që disponohen në pikat e kalimit kufitar pasi siç referon në bisedë Valoni do të kalojë disa "plumba", dhe Reni i përgjigjet lidhur me këtë pyetje të tij mbi pajisjet skanuese, gjykata vlerëson se kjo bisedë e tyre nuk jep të dhëna mbi një ngjarje konkrete, të pozicionuar në kohë dhe në hapësirë, e cila të përmbajë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, pra atë të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike". Në këtë fakt nuk evidentohet asnjë element që bën të besueshëm prezencën e ndonjërës nga format e kryerjes së kësaj vepre penale në aspektin e anës objektive të saj dhe konkretisht kërkimi, marrja, apo pranimi i çdo përfitimi ose oferte te kundërligjshme nga funksionari publik, për shkak të detyrës së tij. Lidhur me parashtrimin që bën akuza mbi prezencën e faktit penal në atë që formulohet saktësisht si "...punonjësi i policisë Reni Dokolli përveçse me dhënien e informacionit, ka detyrimin për të raportuar dhe parandaluar këtë veprimtari të kundërligjshme, në cilësinë e punonjësit të policisë së shtetit", Gjykata vlerëson se ky fakt nuk përmban elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Ky fakt mund të përmbajë elemente të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal apo elemente të përgjegjësisë disiplinore për punonjësin e policisë, por në drejtim të veprës penale, në kushtet kur përveç këtij komunikimi, nuk është kryer asnjë veprim hetimor në drejtim të vërtetimit të faktit penal konkret, gjykata vlerëson se prezenca vetëm enjë bisede të tillë mes personave që rezulton se kanë një marrëdhënie shoqërore/miqësore me njëri tjetrin, nuk mund të përbëjë vepër penale pasi nuk rezulton të jetë hetuar në drejtim të faktit nëse kjo bisedë është konkretizuar në veprime apo mosveprime që përmbajnë elementët e një vepre penale konkrete.

924. *Së treti,* sipas faktit penal të parashtruar nga Prokuroria, dhe provave të administruara, referohet edhe komunizmi mes të pandehurës Elidjana Toçila dhe të pandehurit Reni Dokolli, sipas procesverbalit të këqyrjes së komunikimeve të këtij të fundit në telefonin e tij, nga ku rezulton se Reni i ka dërguar një foto ku shihet në sedijen e një makinë një shumë parash e përbërë nga kartëmonedha 50 euro. Lidhur me këtë fakt, nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Reni Dokolli dhe posaçërisht e komunikimeve të tij në aplikacionin whatsapp, rezulton se në datë 16.03.2022 punonjësi i policisë Reni Dokolli ka dërguar me video pamje filmike kontaktit të tij shënuar si "Diana Toçila" e cila është sipas verifikimit të numrit të kontaktit, e pandehura Elidjana Toçila, pamje në të cilat shihet se ku në sediljen e parë të një automjet shfaqen një parash prerje *50-euro.* Bashke me videon i shkruan *"Ja kshu kapen", ndërsa Elidjana i përgjigjet "A va mostre ti", " A lekt e shpive të nazmies"," Ore ruaji mos i harxho kot, e do na*

duhen për avokat" ndërsa Reni i përgjigjet "...i kam lën lekt për avokat unë kam mbaru pun..këto jan për tu prish para se të arrestohem." Në lidhje me këtë fakt të referuar nga Prokuroria, nuk evidentohet ndonjë veprim ose mosveprim i të pandehurve Reni Dokolli dhe Elidjana Toçila, në të cilin të konfigurohen elementet e figurës së veprës penale për të cilën ata akuzohen apo elementë të ndonjë figure tjetër të veprës penale, përpos komunikimit të tyre, të zhvilluar në kuadër të një sërë komunikimesh të vazhdueshme dhe intensive që rezultojnë nga procesverbali i këqyrjes së telefonit, dhe që rezultojnë të jenë biseda mes kolegësh të cilët kanë komunikim të vazhdueshëm shoqëror dhe miqësor. Veç këtyre bisedave, nuk rezulton të jetë administruar asnjë prove tjetër e cila të japë të dhëna në mbështetje të akuzës së ngritur në lidhje me këtë fakt se këto para, të dërguara nëpërmjet një video në rrjetet e komunikimit, janë marrë apo pranuar nga Reni Dokolli, në moment kohor, në një vend të caktuar, nga një shtetas, në formën e mitës.

925. Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e veprës penale objekt akuze dhe përgjegjësinë e të pandehurit Reni Dokolli, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim[46]. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike që garantojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë, juridike apo të shtetit; (ii) Anën objektive të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal konkretizohet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme të shfaqura në formën e kërkimit, marrjes ose pranimit të çdo lloj përfitimi apo oferte të kundërligjshme nga zyrtari publik, për vetë ose për të tjerë, me qëllim për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën dhe funksionin e tij publik. Pra që te konsiderohet e kryer nga pikëpamja e anës objektive kjo vepër penale, mjafton vërtetimi qoftë dhe vetëm i njërës nga këto forma të kryerjes së saj. (iii) Subjektin e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) Ana subjektive e veprës penale e cila karakterizohet nga prezenca e elementit faj, pasi subjekti jo vetëm duhet të jetë i përgjegjshëm por duhet dhe që të veprojë me faj si dhe të konfigurohet dhe të rezultojë qëllimi i kryerjes së kësaj vepre, i cili konsiston në përvetësimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga ana e subjektit.

---

[46] *Katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal janë analizuar në mënyrë të hollësishme në paragrafët 607-622 me sipër në këtë vendim.*

926. Në rastin konkret, në të tre faktet që i atribuohen të pandehurit Reni Dokolli, analizuar në drejtim të ekzistencës dhe/ose provueshmërisë së tyre, më sipër në këtë vendim, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Konkretisht:

927. Në faktin që lidhet me ngjarjen e datës 08.03.2022 ku i pandehuri akuzohet se ka "Dëmtuar dhe fshehur pjesërisht (kartat e memories)" pajisjet përgjuese që janë gjetur prej tij në kabinat hyrëse të PKK Morinë, vendosur në kuadër të këtij procedimi penal, gjykata vlerëson se në faktet që lidhen me ketë ngjarje nuk evidentohet nga akuza dhe për pasojë nuk rezulton as na provat ndonjë element që tregon prezencën e ndonjërës nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën ai akuzohet në kuadër të këtij procedimi. Këto fakte dhe rrethana qartësisht referojnë në elementë që lidhen me një vepër penale tërësisht të ndryshme, dhe po ashtu rezulton e provuar se ky fakt/kjo ngjarje përbën objekt të procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Kukës me nr. 113, viti 2022 për veprën penale "*Ndërhyrje e padrejtë në jetën private*", parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal. Pra në lidhje me këtë episod të faktit penal objekt akuze, gjykata nuk konstaton jo vetëm nga vlerësimi i provave, por as nga analiza e faktit të bërë nga organi i akuzës, prezencën e ndonjë elementi që jep të dhëna për ekzistencën e një fakti penal që mund të kualifikohet sipas nenit 259 të Kodit Penal, për të cilin akuzohet i pandehuri Reni Dokolli në kuadër të këtij gjykimi.

928. Në lidhje me faktin që konsiston në komunikimin e tij me të pandehurën Elidjana Toçila dhe dërgimin në drejtim të sa të një video ku shfaqen disa kartëmonedha 50 euro, për të cilat akuza referon se janë para që ndodhen në automjetin e të pandehurit dhe janë marrë në formë mite prej tij gjatë ushtrimit të detyrës në PKK Morinë, gjykata vlerëson se, nga provat e administruara, rezulton se (i) nga i pandehuri Reni Dokolli i është dërguar, në bisedë e sipër, bisedë e cila rezulton e zhvilluar në një kontekst miqësor dhe shoqëruar me nota humori me të pandehurën Elidiana Toçila, një video që përmban pamje kartëmonedhash 50 euro; (ii) nuk rezulton asnjë provë që të dëshmojë se kjo video është bërë në mjetin e të pandehurit dhe se këto para ndodhën pikërisht në këtë automjet siç referon akuza; (iii) nuk rezulton asnjë prove apo e dhënë se këto para janë në posedim të tij dhe se videoja e dërguar mund të mos jete një video e marrë nga burime të tjera (internet etj); (iv) nuk rezulton asnjë provë apo e dhënë se këto para, edhe nëse janë në posedim të të pandehurit, janë para të cilat janë marrë prej tij në formë mitë, gjatë ushtrimit të detyrës në PKK Morinë; (v) nuk rezulton asnjë provë apo e dhënë që të dëshmojë marrjen e këtyre parave në një moment të lokalizuar në aspektin hapësinor dhe kohor (vendi dhe koha) gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj nga ana e të pandehurit. Pra edhe nëse për një moment do të merrej i mirëqenë fakti se kjo shumë parash që duhet në video është në posedim prej të pandehurit, nuk ka asnjë të dhënë që të dëshmojë dhe të provojë se ajo është siguruar prej tij për shkak të kryerjes së ndonjë veprimi të paligjshëm gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë kontekst gjykatës i rezulton se në lidhje me këtë fakt nuk rezulton asnjë e dhënë që të provojë prezencën e veprimeve aktive të kundërligjshëm të të pandehurit Reni Dokolli në

funksion të konkretizimit të ndonjërës prej formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën ai akuzohet. Për më tepër në lidhje me këtë fakt, fakti penal objekt akuze, nuk ka të përcaktuar elementet e qenësishëm të tij të cilët janë vendi dhe koha, pa të cilët nuk mund të gjykohet minimalisht mbi ekzistencën e tij si fakt dhe aq më tepër për natyrën penale të tij apo provueshmërinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Pra në vlerësim të gjykatës, ky fakt i referuar nga akuza, nuk provohet se ekziston.

929. Në lidhje me komunikimet e tij me shtetasin "Valon Ahmeti Zvicër", gjykata vlerëson se në tërësinë e faktit që lidhet me këto komunikime, nuk rezulton asnjë e dhënë për prezencën e elementeve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal pasi nuk evidentohet dhe as rezulton e provuar prezenca e ndonjërës nga format e saj sikundër është kërkimi, marrja apo pranimi i ndonjë përfitimi apo oferte të paligjshme nga i pandehurit, për shkak të funksionit të tij publik dhe gjatë ushtrimit të tij.

930. Sa më sipër, gjykata vlerëson se në të tre elementet në të cilët konsiston akuza ndaj të pandehuri Reni Dokolli, nuk ekzistojnë dhe për pasojë nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të ritheksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin Reni Dokolli, gjykata vlerëson se jo vetëm që ndodhemi në kushtet kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit por ndodhemi para situatës kur ky fakt nuk provohet se ka ndodhur (siç është rasti i pasqyruar në episodin e dytë të analizuar).

931. Sa më sipër, në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Reni Dokolli në të tre faktet që i atribuohen, te ketë kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij publike.

932. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronjat b) dhe d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Reni Dokolli duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti përbën vepër penale dhe po ashtu nuk provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit AVNI TËRSHALLA

933. Lidhur me të pandehurin **Avni Tërshalla**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzën e kryerjes së veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publikë", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259, pg 1 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim (paragrafët 607-622) vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Avni Tërshalla është e bazuar në prova.

934. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Avni Tërshalla, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare dhe pozicionin "shoqëruesit të qenit të kufirit", sikurse ka deklaruar në shpjegimet e dhëna prej tij në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në datë 28.06.2022, në pikën e kalimit kufitar Morinë, evidentohet në disa momente të këtij fakti penal, të cilat analizohen nga gjykata me vete, në vijim.

935. *Së pari*, prezenca e të pandehurit Avni Tërshalla është evidentuar në ngjarjen e datës 12.02.2022 ***ora 14.16 minuta***, të ndodhur në kabinën ku kryen shërbimin kontrollori Muhamet Cengu. Sipas pamjeve filmike dhe regjistrimit audio rezulton se në orën 14.16 minuta Muhamet Cengu i cili është në shërbim në kabinën hyrëse, i jep kolegut te tij Avni Tërshalla një kartëmonedhë, duke shkëmbyer këtë dialog mes tyre : "*Muhameti : Merri këto nga unë...Avniu : Hë të lumtë krahu të lumtë, hë hallall.*" Në këtë episod nuk është dokumentuar marrja prej tij e ndonjë shume parash nga shtetasit që kalojnë kufirin, vetëm apo në bashkëpunim me kolegun e tij Avni Tërshalla dhe aq më tepër bashkëpunimi i këtij të fundit me Muhametin, në realizimin e ndonjë fakti konkret, që përmban elementet e veprës penale për të cilën akuzohet ky i pandehur.

936. *Së dyti*, evidentohet sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, prezenca e tij për disa momente në kabinën e shërbimit të Muhamet Cengut, në datë 12.02.2022, *në orën 09 e 46 minuta*, Konkretisht konstatohet se në kabinë vijon ende të kryejë shërbim punonjësi i policisë Muhamet Cengu dhe ndërkohë i pranishëm është edhe një koleg i tij me nr. identifikues 05657,

referuar në procesverbalin e këqyrjes se i përket të pandehurit Avni Tërshalla. Gjatë kësaj kohe konstatohet të kalojnë një numër i konsiderueshëm shtetasish për të cilët punonjësi i policisë Muhamet Cengu nuk kryen veprime verifikuese për dokumentacionin në sistemin TIMS por i pyet verbalisht nëse kanë vaksinat dhe pasagjerët i thonë po, ndërsa ai ju përgjigjet, *"Ec, ec"*. Gjatë kohës që në sportel paraqitet një shtetas për përpunim të dokumentacionit, punonjësi i policisë Muhamet Cengu e pyet nëse i kanë bërë të dyja dozat e vaksinës dhe po ashtu e pyet nëse testet i disponojnë edhe fëmijët, mbi gjashtë vjeç. Pasi merr një shumë prej 5 euro, kontrollori Muhamet Cengu i porosit që po të kapi kush në rrugë t'i thotë i kam harruar te policia ose më kanë humb edhe dokumentet. Sipas të dhënave të sistemit TIMS, nuk rezulton që në këtë orar të jenë regjistruar në sistem nga Muhamet Cengu persona që janë përpunuar në pikën hyrëse. Nga pamjet filmike dhe procesverbali i transkriptimit të komunikimeve evidentohet dialogu mes Muhamet Cengut dhe shtetasit kosovar ne sportel por nuk rezultojnë qartë veprime të punonjësit tjetër të policisë Avni Tërshalla për kërkimin, marrjen apo pranimin e shumave të parave nga shtetasit, në bashkëpunim me Muhamet Cengun. Rezulton se ai ka qenë disa momente prezent në kabinë dhe po ashtu fiksohet teksa largohet nga kabina dhe i thotë kolegut të tij "*Pi një kafe*", ndërkohë që nuk referohet dhe as rezulton se ka marrë apo kërkuar nga ndonjë qytetar para në këmbim, të ndonjë favorizimi në kalimin e kufirit.

937. I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas procesverbalit me datë 28.06.2022, lidhur me faktin Avni Tërshalla ka deklaruar se :"*Për sa më pyetët nga ana juaj unë sqaroj së në detyrën e shoqëruesit të qenit unë kam rreth 25 vite që punoj, ndërsa në PKK Morinë unë kam shumë vite që kam kryer të njëjtën detyrë. Dua të sqaroj se si shoqërues qeni unë nuk kam detyrë të merrem me kontrollin e pasagjerëve në kabina por për sa i përket rastit të konstatuar unë kam shkuar në kabinë për të marrë një shishe ujë për të pirë. Mua nuk më kujtohet si rast dhe nuk kam parë gjë. Unë punoj shoqërues qeni dhe këtë detyrë kam kryer gjatë gjithë karrierës sime në polici. Të me pyesësh se çfarë detyrimesh kam ndaj punës sime që jam dhe i specializuar, përgjigjem. Por për raste të tjera si ky që ju më pyesni unë nuk kam informacion si veprohet..*"

938. Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale të të pandehurit Avni Tërshalla për veprën penale për të cilën akuzohet, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim[47]. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike që garantojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të

---

[47] *Katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal janë analizuar në mënyrë të hollësishme në paragrafët 607-622 me sipër në këtë vendim.*

personave fizikë, juridike apo të shtetit; (ii) Anën objektive të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal konkretizohet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme të shfaqura në formën e kërkimit, marrjes ose pranimit të çdo lloj përfitimi apo oferte të kundërligjshme nga zyrtari publik, për vetë ose për të tjerë, me qëllim për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën dhe funksionin e tij publik. Pra që te konsiderohet e kryer nga pikëpamja e anës objektive kjo vepër penale, mjafton vërtetimi qoftë dhe vetëm i njërës nga këto forma të kryerjes së saj. (iii) Subjektin e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) ana subjektive e veprës penale e cila karakterizohet nga prezenca e elementit faj, pasi subjekti jo vetëm duhet të jetë i përgjegjshëm por duhet dhe që të veprojë me faj si dhe të konfigurohet dhe të rezultojë qëllimi i kryerjes së kësaj vepre, i cili konsiston në përvetësimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga ana e subjektit. Ndërkohë që të provohet kryerja e kësaj vepre penale në bashkëpunim, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal, duhet të rezultojnë të provuara në drejtim të anës objektive veprimet e përbashkëta ose komplementare të dy ose më shumë të pandehurve në realizimin e elementeve të anës objektive, mbi bazën e një marrëveshje të shprehur apo të heshtur mes tyre, konkretizuar në kryerjen e veprimeve me te cilat realizohet vepra penale dhe në aspektin subjektiv, ekzistenca e dashjes tek secili prej tyre dhe po ashtu e një qëllimi të përbashkët në drejtim të realizimit të veprës penale.

939. Në rastin konkret, në të dy faktet që i atribuohen të pandehurit Avni Tërshalla, analizuar më sipër në këtë vendim, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet në veprimet dhe mosveprimet e tij, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, të kryer në këtë rast nga i pandehuri tjetër Muhamet Cengu. Në këto dy ngjarje rezultojnë veprimet e të pandehurit, kontrollorit në shërbim Muahmet Cengu, të cilat janë vlerësuar në raport me faktin penal atribuuar këtij të fundit, por nuk rezulton në asnjë moment pjesëmarrja me veprime aktive të kundërligjshme, të çdo lloji (fjalë, veprime, sjellje etj.) e të pandehurit Avni Tërshalla në realizimin e këtyre fakteve penale, në bashkëpunim me të pandehurin Muhamet Cengu. Konkretisht:

940. Në faktin që lidhet me ngjarjen e orës 14.16 minuta të datës 12.02.2022, rezulton e provuar se (i) na kabinën përkatëse ka qenë prezent i pandehuri Muhamet Cengu dhe aty ka shkuar edhe i pandehuri Avni Tërshalla; (ii) nuk rezulton që gjatë kësaj kohe nga asnjëri prej të pandehurve të jenë përpunuar udhëtarë në sportel dhe as te jetë kërkuar, marrë apo pranuar nga asnjëri prej tyre ndonjë përfitim i paligjshëm; (iii) rezulton se kontrollori Muhamet Cengu i ka dhënë kolegut të tij Avni Tërshalla një kartëmonedhe duke i thënë "*merri këto nga unë*" dhe Avniu e falënderon dhe largohet. Pra faktet që rezultojnë nga provat e administruara lidhur me ketë moment kohor së pari, nuk ofrojnë asnjë të dhënë për ndodhjen e një fakti me natyre penale

gjatë kohës që i pandehuri Avni Tërshalla është në kabinën ku kryen shërbimin kolegu i tij Muhamet Cengu dhe , së dyti, dhënia prej këtij të fundit e një kartëmonedhë kolegut, e vetme si fakt, nuk përmban elementet e ndonjë vepre penale e aq me tepër të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

941. Në lidhje me ngjarjen e dytë të shënuar në datë 12.02.2022, në orën 09.46 minuta, nga provat e administruara, rezulton se (i) Muhemet Cengu në shërbim ka kërkuar dhe ka marrë nga në shtetas i paraqitur në sportel një shumë prej 5 euro; (ii) në kohën që zhvillohet kjo ngjarje evidentohet prezenca në kabinë edhe e të pandehurit Avni Tërshalla; (iii) nuk rezulton nga pamjet filmike apo regjistrimi audio asnjë veprim apo komunikim mes të pandehurit Avni Tërshalla me personat e përfshirë në këtë fakt, në funksion të realizmit të faktit penal të kryer nga kolegu i tij; (iv) përveç prezencës së evidentuar na kabinë, për të pandehurin Avni Tërshalla nuk ka asnjë të dhënë që burrin nga provat që dëshmon pjesëmarrjen e tij me veprime aktive të kundërligjshme, së bashku me të pandehurin Muhamet Cengu në realizimin e faktit penal konkret; (v) provat e administruara nuk referojnë asnjë element të besueshëm dhe për më tepër të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i pandehuri Avni Tërshalla ka kërkuar, marrë, ose pranuar, vetë apo bashkëpunim me të pandehurin Muhemt Cengu, ndonjë shumë parash apo çdo lloj përfitimi tjetër të paligjshëm nga shtetasi konkret. Në këtë kontekst gjykatës i rezulton se në lidhje me këtë fakt nuk rezulton asnjë e dhënë që të provojë kryerjen e veprimeve aktive të kundërligjshëm të të pandehurit Avni Tërshalla në funksion të konkretizimit të ndonjërës prej formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën ai akuzohet.

942. Sa më sipër, gjykata vlerëson se në të dy ngjarjet në të cilat referon akuza ndaj të pandehuri Avni Tërshalla, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet, të kryera prej tij apo në bashkëpunim me të pandehurin tjetër Muhamet Cengu. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin Avni Tërshalla, gjykata vlerëson se nuk provohet kryerja prej tij e veprimeve aktive të kundërligjshme që materializojnë një nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet dhe për pasojë, as

bashkëpunimin e tij me të pandehurin tjetër Muahmet Cengu në drejtim të realizimit të faktit penal objekt akuze. Vetëm prezenca e të pandehurit në një moment që nga kolegu i tij është realizuar një veprim korruptiv, e pa shoqëruar me asnjë element tjetër për të provuar rolin e të pandehurit në realizimin e këtij fakti, nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të vlerësuar prezencën e elementeve të bashkëpunimit të tij me të pandehurin tjetër.

943. Sa më sipër, në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal për këtë të pandehur, dhe as prezenca e elementeve të mjaftueshëm dhe të provuar për kryerjen prej tij të veprimeve komplementare apo mbështetëse në raport me veprimet e kryera nga kolegu i tij, që të dëshmojnë qartë dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kontributin e tij në realizimin e veprës penale në cilësinë e bashkëpunëtorit, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Avni Tërshalla në të dy faktet që i atribuohen, te ketë kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij publike.

944. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronja d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Avni Tërshalla duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen, në raport me veprimet dhe mosveprimet e tij, elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit SULE ONUZI

945. Lidhur me të pandehurin **Sule Onuzi**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzën e kryerjes së veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publikë", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259, pg 1 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim (paragrafët 607-622) vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Sule Onuzi është e bazuar në prova.

946. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Sule Onuzi, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare, evidentohet :

947. *Së pari* rezulton vetëm një moment ku është regjistruar biseda mes tij dhe të pandehurit tjetër Halim Shehu. Kjo bisedë është zhvilluar në datë 24.02.2021 dhe në komunikimin mes të dy të pandehurve, nga konteksti i bisedës rezulto se të dy punonjësit e policisë komunikojnë lidhur me një shtetas që ka kaluar në një kohë më të hershme dhe pyesin njëri tjetrin nëse ka lënë gjë atë ditë, ndër të tjera përmendin edhe fjalën euro. Kjo bisedë, prova e vetme në lidhje me të pandehurin Sulë Onuzi, nuk rezulton të jetë e mbështetur me asnjë provë tjetër dhe po ashtu nuk rezulton të japë të dhëna të sakta minimalisht për të mundësuar pozicionimin në kohë dhe në hapësire të faktin për të cilin Prokuroria ka akuzuar të pandehurin për veprën penale konkrete. Nga tërësia e komunikimit, rezulton vetëm që dy të pandehurit (Sulë Onuzi dhe Halim Shehu) komunikojnë me njëri tjetrin duke tentuar të sqarojnë një situatë lidhur me një person që ka kaluar në një moment të pacaktuar kohor të të shkuarës dhe që nuk rezulton e provuar se ka të bëjë me ndonjë shtetas që ka kaluar kufirin dhe është toleruar nga punonjësit kundrejt mitës. Kjo bisedë, e vetme, në vlerësim të gjykatës jep të dhëna minimale edhe në raport me dyshimin e arsyeshëm i cili duhet të jetë i bazuar në prova, por nuk mund të arrijë të provojë, për më tepër përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ndodhjen e një fakti që përmban elementet e një vepre penale, kur minimalisht nuk është pozicionuar fakti penal i pretenduar në kohë dhe në hapësire, elementë këto të qenësishëm për të gjykuar mbi aspekte të tjera të ekzistencës së veprës penale.

948. *Së dyti*, duke konsideruar mos konkretizimin dhe formulimin në mënyrë tërësore dhe të përgjithshme të fakteve objekt akuze të bërë nga ana e Prokurorisë, në lidhje me ato fakte që evidentohen në drejtim të akuzës së ngritur ndaj të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të pandehurin Sule Onuzi, për veprën penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal gjykata çmon të marrë në analizë, akuzën e formuluar dhe faktet në të cilat ajo referon në raport me atë çka provohet ose jo në veprimet dhe mosveprimet konkrete të këtij të pandehuri. Konkretisht, pas paraqitjes tërësore të përmbajtjes së provave (*të dhënave të regjistrimeve audio dhe video, të dhënave të sistemit TIMS dhe deklarimeve*) në lidhje me ngjarjet e vitit 2022, ndërkohë që i pandehuri Sule Onuzi nuk rezulton të shfaqet në asnjë moment në faktet që lidhen me ngjarjet e këtij viti, Prokuroria në aktin e komunikimit të akuzës për çdo të pandehur, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në mënyrë identike edhe në konkluzione përfundimtare[48], Prokuroria e mbështet akuzën, ndaj të gjithë të pandehurve, për pasojë edhe ndaj të pandehurit Sulë Onuzi në këto argumente: Sipas Prokurorisë, ***(i)*** *nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundërligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video...Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policisë Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime koruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri- tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro...(ii) është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të*

---

[48] *Shih konkluzionet përfundimtare, faqe 263,264,265, referuar më sipër në ketë vendim.*

kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turni të tyre, ku çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim. Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçantë pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit.". Në lidhje me këtë element të akuzës, gjykata vlerëson se, nga tërësia e provave të administruara në gjykim, vlerësuar në raport me njëra tjetrën si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, ky mekanizëm i përshkruar nga Prokuroria në akuzën e ngritur, nuk arrin të provohet, përveçse në mënyrë të pjesshme në ngjarjen e datës 01.03.2022. Në lidhje me të pandehurit e tjerë, përfshirë edhe të pandehurin Sulë Onuzi në rastin konkret, nuk evidentohen dhe për pasojë as provohen, minimalisht prezenca dhe kryerja prej tij e ndonjë veprimi konkret për realizimin e këtij mekanizmi nga ana e këtij të pandehuri, duke bërë më tej të pamundur vlerësimin mbi provueshmërinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të kundërligjshmërisë së veprimeve në këndvështrim të përmbajtjes ose jo të elementëve të veprës penale dhe të bashkëpunimit të tij me të pandehurit e tjerë.

949. Në këtë këndvështrim, gjykata evidenton se, është e qartë se (i) nga mënyra se si është vepruar në disa raste, (ii) fakti që në këto veprime të kundërligjshme janë përfshire një numër i lartë punonjësish si dhe (iii) duke ju referuar shtrirjes kohore të veprimeve të tyre në një periudhë relativisht të gjatë, krijohen dyshime të arsyeshme mbi mundësinë e ekzistencës dhe funksionimit të këtij mekanizmi veprimi për të cilin referon Prokuroria, por duke gjykuar mbi atë çka provat ofrojnë egzaktësisht provat e administruara në gjykim, gjykata vlerëson se ky element i akuzën nuk arrin të provohet plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në provat e administruara, duke mbetur në këtë mënyrë në nivelin e një dyshimi, mbi të cilin do të duhej të ishte hetuar me tej. Për më tepër, në raport me të pandehurin Sulë Onuzi nuk rezulton që në asnjë moment në tërësinë e faktit dhe provave mbi të cilat ai mbështetet, të ketë rezultuar minimalisht prezenca dhe aq me tepër kryerja prej tij e ndonjë veprimi në drejtim të realizimit të kësaj skeme për kryerjen e veprës penale. Vetëm fakti që ai është punonjës i policisë në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë dhe ndaj tij rezulton një komunikim i vetëm telefonik me një prej të pandehurve të tjerë, i pozicionuar madje në vitin 2021 dhe jo në ngjarjet e vitit 2022 në të cilat Prokuroria evidenton këtë mekanizëm veprimi, nuk mund të shërbejë si bazë për të ngarkuar atë me përgjegjësi penale mbi një "pjesëmarrje" inegzitente në raport më këtë të pandehur, referuar fakteve që sjellin provat e administruara në gjykim. Thënë këtë gjykata thekson se përgjegjësia penale, është konkrete dhe individuale dhe nuk mund të ravijëzohet në mënyrë absolute mbi bazë prezumimi. Për këto arsye, gjykata vlerëson se këto elementë të akuzës së ngritur, në

drejtim të vlerësimit të përfshirjes dhe me tej përgjegjësisë penale të të pandehurit Sulë Onuzi në rastin konkret, nuk mund të përbëjnë bazë për përcaktimin e fajësisë së tij, për sa kohë që nuk rezulton minimalishtt evidentimi i prezencës dhe ndonjë veprimi konkret të tij në gjithë faktin penal objekt akuze lidhur me zhvillimin e ngjarjeve që përbejnë këtë mekanizëm, sipas akuzës së ngritur nga Prokuroria.

950. Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale të të pandehurit Sulë Onuzi për veprën penale për të cilën akuzohet, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim[49]. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike që garantojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë, juridike apo të shtetit; (ii) Anën objektive të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal konkretizohet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme të shfaqura në formën e kërkimit, marrjes ose pranimit të çdo lloj përfitimi apo oferte të kundërligjshme nga zyrtari publik, për vetë ose për të tjerë, me qëllim për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën dhe funksionin e tij publik. Pra që te konsiderohet e kryer nga pikëpamja e anës objektive kjo vepër penale, mjafton vërtetimi qoftë dhe vetëm i njërës nga këto forma të kryerjes së saj. (iii) Subjektin e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) ana subjektive e veprës penale e cila karakterizohet nga prezenca e elementit faj, pasi subjekti jo vetëm duhet të jetë i përgjegjshëm por duhet dhe që të veprojë me faj si dhe të konfigurohet dhe të rezultojë qëllimi i kryerjes së kësaj vepre, i cili konsiston në përvetësimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga ana e subjektit. Ndërkohë që të provohet kryerja e kësaj vepre penale në bashkëpunim, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal, duhet të rezultojnë të provuara në drejtim të anës objektive veprimet e përbashkëta ose komplementare të dy ose më shumë të pandehurve në realizimin e elementeve të anës objektive, mbi bazën e një marrëveshje të shprehur apo të heshtur mes tyre, konkretizuar në kryerjen e veprimeve me te cilat realizohet vepra penale dhe në aspektin subjektiv, ekzistenca e dashjes tek secili prej tyre dhe po ashtu e një qëllimi të përbashkët në drejtim të realizimit të veprës penale.

---

[49] *Katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal janë analizuar në mënyrë të hollësishme në paragrafët 607-622 me sipër në këtë vendim.*

951. Në rastin konkret, në të dy faktet që i atribuohen të pandehurit Sulë Onuzi, analizuar më sipër në këtë vendim, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet në veprimet dhe mosveprimet e tij, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në faktin e parë referohet vetëm një bisedë mes tij dhe të pandehurit Halim Shehu mbi një ngjarje të ndodhur më herët në kohë, por nuk është kryer asnjë veprim tjetër për të vërtetuar faktin objekt bisede mes tyre dhe për të bërë minimalisht pozicionin e tij në kohë dhe në hapësire, elementë këto të qenësishëm të anës objektive të veprës penale. Pa u përcaktuar dhe provuar se fakti konkret ka ndodhur (pra ngjarja për të cilën zhvillohet biseda mes tij dhe të pandehurit Halim Shehu në datë 24.02.2021) është objektivisht e pamundur të vlerësohet nëse ai përmban elementët e një vepre penale.

952. Në lidhje me "akuzën" e atribuuar në mënyrë të përgjithshme, në tërësinë e saj, mbi mekanizmin e kundërligjshëm dhe të organizuar mbi bazën e të cilit kryhej korrupsioni në PKK Morinë (shih me sipër) gjykata vlerëson se jo vetëm provueshmëria e këtij mekanizmi mbetet e pa provuar në mënyrë të plotë (përveç një rasti ku ai provohet pjesërisht, analizuar më sipër) por nuk rezulton që në asnjë moment të evidentohen prezenca e të pandehurit Sulë Onuzi në ndonjë moment të zhvillimit të këtij fakti dhe për pasojë mungojnë tërësisht evidentimi i veprimeve të kundërligjshme të këtij të pandehuri në drejtim të realizimit të këtij fakti. Kjo "akuzë" e formuluar në mënyrë të përgjithshme, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen në përgjegjësi penale dhe dënimin e këtij të pandehuri, për sa kohë mbetet në nivel hipotetik dhe nuk rezulton të konkretizohet dhe të provohet në asnjë moment, nga tërësia e provave të administruara, se cilat janë veprimet konkrete të të pandehurit Sulë Onuzi, të lokalizuar në kohë dhe në hapësirë, si dy elemente thelbësore që karakterizojnë ekzistencën e faktit penal, në raport me ketë "akuzë" të referuar në mënyrë të përgjithshme.

953. Sa më sipër, gjykata vlerëson se në të tre elementet në të cilët konsiston akuza ndaj të pandehuri Sulë Onuzi, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të ritheksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit *("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,)* ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin

konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin Sulë Onuzi, gjykata vlerëson se jo vetëm që ndodhemi në kushtet kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit por ndodhemi para situatës kur ky fakt nuk provohet se ka ndodhur.

954. Në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Sulë Onuzi në të dy faktet që i atribuohen, te ketë kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij publike.

955. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronjat b) dhe d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Sulë Onuzi duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti objekt akuze ka ndodhur dhe për pasojë, nuk mund të provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit SHPËTIM CENAJ

956. Lidhur me të pandehurin **Shpëtim Cenaj**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzën e kryerjes së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publikë*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259, pg 1 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim (paragrafët 607-622) vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Shpëtim Cenaj është e bazuar në prova.

957. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Shpëtim Cenaj, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare, me detyrë "përgjegjës turni" në PKK Morinë, evidentohen fakte që referojnë në komunikimet telefonike të përgjuara të tij në dy periudha kohor, ato të zhvilluara gjatë muajit dhjetor 2020 dhe më tej ato të zhvilluara në fillim të vitin 2021, të cilat merren në analizë me vete për shkak se nuk rezulton të kenë lidhje me njeri tjetrin, si vijon :

958. *Së pari* gjatë muajit dhjetor 2020 dhe konkretisht duke filluar nga data 09.12.2020 deri në datë 13.12.2020 rezulton të jenë regjistruar biseda mes tij dhe shtetasit Altin Beqiri, referuar si epror i tij në atë periudhë dhe mes tij dhe bashkëshortes së tij. Në këto biseda rezulton se ne muajin dhjetor 2020 i pandehuri Shpëtim Cenaj është caktuar të ushtrojnë në mënyrë të përkohshme detyrën e shefit të stacionit të PKK Morinë (nga data 09.12.2020 deri në datë 23.12.2020 siç rezulton nga biseda e tij me Altin Beqirin) dhe ky fakt i komunikohet nga shtetasi Altin Beqiri ne një bisedë telefonike të datës 09.12.2020. Një ditë me pas është regjistruar një bisedë tjetër e tij me këtë shtetas ku nuk rezulton ndonjë e dhënë për ngjarje që mund të lidhen me akuzën ndaj këtij të pandehuri. Në vijim në datat 10, 11 dhe 13 dhjetor 2020 janë regjistruar komunikime të Shpëtim Cenajt me bashkëshorten e tij ku ata bisedojnë ndër te tjera për çështjen e shërbimeve (pagesat për shërbimet e tij) dhe po ashtu përmendin fjalët "*respekte të vogla*" dhe ndër të tjera në komunikimet e tij me bashkëshorten përdoren fjalë të cilat hedhin dyshime mbi veprime të mundshme të kundërligjshme të tij, të tilla si "*..Për ato të tjera se di ndonjë gjë të vogle do e marr...*", "*..Ai deshtë me ju thanë shiko nja katër përgjegjësa që i marrin lekët këta...edhe me ju thanë që do i jepni nga pjesa ime kaq në ditë, e disha pjesën time...*", "*....Ai i ka porosit të gjithë, që atë ditë që ka ik i ka marrë në telefon tak, tak, tak u ka thanë. -Me atë pjesën time mos të luj njeri hajt njatjeta....tha njoni se shava une, nga keta policet qysh mor tha asht tu na ardh turp per me te lane pa gja tha, sdi gja tha baj ca të dush, sdi do ta bajme dicka. Me e pa dit kasha mbush edhe 15 ditet e lejes...*", "*...Atë planin e realizova unë atë që të thashë.....një dyshe nga tonat mi dhanë a kupton?....*". Këto komunikime të zhvilluara mes tij dhe bashkëshortes së tij në ditët e para që ka marrë detyrën e shefit të stacionit siç rezulton nga bisedat e tyre, krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi veprimtari të mundshme të kundërligjshme të tij, apo mbi mendimet që i ka se çfarë do të realizoje gjatë ushtrimit të kësaj detyre, por nuk japin asnjë të dhënë mbi fakte konkrete, të provuara se kanë ndodhur. Kjo pasi hetimi në këtë drejtim është kufizuar vetëm në përgjimin e komunikimeve telefonike, duke mos u kryer asnjë veprim hetimor në kohë realë që zhvillohen këto biseda, për të vërtetuar dhe më tej mbledhur prova mbi ngjarje të mundshme të kundërligjshme të kryera nga ky i pandehur apo bashkëpunëtorë të tjerë të mundshëm të tij. Të dhënat që japin komunikimet e përgjuara, të vetme dhe të pa mbështetura mbi asnjë provë tjetër, mund të krijojnë vetëm një dyshim të arsyeshëm por edhe ky në nivel minimal, mbi veprime të kundërligjshme të së ardhmes (*në raport me kohën kur zhvillohen bisedat*) por nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim hetimor në drejtim të verifikimit nëse këto "mendime" të këtij të pandehuri, ndarë më bashkëshorten e tij në biseda, janë realizuar dhe për pasojë, përbëjnë ose jo fakte mbi të cilat mund të pozicionohet kryerja e një vepre penale konkrete.

959. *Së dyti*, fakti penal objekt akuze ndaj të pandehurit Shpëtim Cenaj, referon edhe në disa biseda të përgjuara të tij, zhvilluara në muajt janar, mars dhe prill 2021. Gjatë muajit janar janë regjistruar biseda të tij në datat 23.01.2021, 24.01.2021 nga të cilat rezulton vetëm komunikimi i tij me dy shtetas, të cilët komunikojnë shkurtimisht për tu takuar dhe nga konteksti duket se janë në PKK Morinë, por nuk rezulton ndonjë e dhëne që të krijojë dyshime mbi ndonjë veprimtari të kundërligjshme. Në datë 30.01.2021 rezulton komunikimi i tij me një shtetas ku ky i fundit i

kërkon të verifikoje mbi një shtetas me të dhënat "*Alan Henrique Ferreira Bastos Soares*" por nuk rezultojnë të dhëna mbi ndonjë veprimtari të kundërligjshme. Po ashtu nuk rezulton të jenë kryer veprime mbi regjistrimin e hyrje djalleve të mundshme të këtij shtetasi me këto të dhëna, për të mundësuar verifikimin nëse në lidhje me ketë subjekt është kryer nga i pandehuri ndonjë veprim që mund të krijojnë dyshime. Në datat 02.03.2021 dhe 05.03.2021 sërish rezultojnë biseda me dy shtetas, njëri prej të cilëve i drejtohet si "shef Gëzimi" ndërsa i dyti është një person që interesohet për të kaluar kufirin, nga të cilat nuk rezulton ndonjë e dhënë mbi veprime të kundërligjshme. Në datë 06.03.2021 rezulton se ka zhvilluar një bisede me të pandehurin Halim Shehu ku rezulton që Shpëtimi i komunikon Halimit se një shtetas që është njohje e një kolegut të tyre do të shkojë ta takojë dhe më pas rezulton komunikimi i tij me shtetasin vetë, mbi bisedën që ka zhvilluar me herët me Halimin. Nuk rezulton as nga kjo bisedë ndonjë e dhënë mbi veprime të kundërligjshme. Në datë 15.04.2021 rezulton se ka kryer një komunikim me shtetasin Saliko Dautaj ku ky i fundit i tregon se ka një mik të tij që udhëton nga Kosova por djali i tij nuk ka pasaportën me vete, ndërsa Shpëtimi i thotë që nuk ka problem dhe e udhëzon se ku te drejtohet në kthim. Nuk rezulton të jenë kryer verifikime apo veprime për të verifikuar nëse ky shtetas i referuar në bisede, i cili rezulton edhe i paidentifikuar, ka kaluar kufirin sikurse bisedohet mes të pandehurit dhe personit tjetër. Po ashtu janë regjistruar komunikime mes tij dhe personi tjetër në datë 16.03.2021 ku rezulton se bashkëbiseduesi i kërkon ndihmë për një problematike që ka hasur në kufi e cila zgjidhet sipas bisedës vijuese, por nuk rezulton te jetë identifikuar minimalisht shtetasi, e me tej problematika, për të vlerësuar nëse ka ndodhur një fakt i kundërligjshëm në këtë drejtim. Pra sa rezulton nga tërësia e komunikimeve te regjistruara mes të pandehurit Shpëtim Cenaj dhe personave të tjerë në muajt janar dhe mars 2021, evidentohen komunikimet mes tyre, ku në një pjesë të këtyre komunikimeve referohet në lidhje me ngjarje që kanë të bëjnë me kalimin në kufi të shtetasve apo problematika të ngjashme, por këto komunikime mund të vlerësohen vetëm në kuadër të dyshimeve të arsyeshme, në një nivel minimal, dhe jo të tilla që të provojnë ndodhjen e një fakti penal. Nuk rezulton të jetë hetuar në drejtim të asnjë prej situatave që vetë Prokuroria referon në këto komunikime, me qëllim vërtetimin nëse ka ndodhur ndonjë fakt që mund të përmbajë elementet e veprës penale. Vetëm evidentimi i këtyre komunikimeve, pas asnjë të dhënë apo provë që të mbështesë dhe provoje se pari ndodhjen e faktit dhe më tej ekzistencën e elementeve të veprës penale ne te, nuk mund të shërbejnë si bazë për marrjen në përgjegjësi penale dhe dënimin e një personi.

960. *Së treti,* nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Shpëtim Cenaj, sipas procesverbalit të këqyrjes me datë 28.06.2022, referohen disa biseda të tij të zhvilluara me shtetasin Zija Sula (*të cilit në komunikime Shpëtimi i drejtohet me fjalët "z.Drejtor*) ku sipas komunikimeve, rezulton se Zijai i kërkon të ndihmojë që të mos vonohet në pikën e kalimit kufitar një person që udhëton me një mjet, për të cilin i dërgon targën me sms. Nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim hetimor për të verifikuar kalimin ose jo të personit që udhëton me këtë mjet, e me tej për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë problematikë të tij për kalimin në kufi. Po ashtu nuk evidentohet asnjë e dhënë mbi kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë përfitimi të kundërligjshëm në këtë drejtim. Në të njëjtën situatë rezulton edhe komunikimi i tij i datës 06.10.2021 me të pandehurin

Halim Shehu ku i dërgohen prej tij targat e tre mjeteve, por nuk referohet asnjë e dhënë që të ngrejë dyshime mbi veprimtari të kundërligjshme të tij apo të pandehurit tjetër Halim Shehu lidhur me këtë komunikim.

961. *Së katërti*, nga këqyrja e telefonit të të pandehurit Shpëtim Cenaj, sipas procesverbalit të këqyrjes me datë 28.06.2022, referohen disa biseda të tij me kontaktin "Shkumbin G Muja" e kryer në datë 20.12.2020 ku rezulton se Shkumbini i ka kërkuar informacion mbi një shtetas nëse ka ndalese udhëtimi dhe Shpëtimi i kthen përgjigje, por nuk rezulton asnjë e dhënë mbi kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë përfitimi të kundërligjshëm në lidhje me ketë fakt.

962. *Së pesti*, duke konsideruar mos konkretizimin dhe formulimin në mënyrë tërësore dhe të përgjithshme të fakteve objekt akuze të bërë nga ana e Prokurorisë, në lidhje me ato fakte që evidentohen në drejtim të akuzës së ngritur ndaj të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të pandehurin Shpëtim Cenaj, për veprën penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal gjykata çmon të marrë në analizë, akuzën e formuluar dhe faktet në të cilat ajo referon në raport me atë çka provohet ose jo në veprimet dhe mosveprimet konkrete të këtij të pandehuri. Konkretisht, pas paraqitjes tërësore të përmbajtjes së provave (*të dhënave të regjistrimeve audio dhe video, të dhënave të sistemit TIMS dhe deklarimeve*) në lidhje me ngjarjet e vitit 2022, ndërkohë që i pandehuri Shpëtim Cenaj nuk rezulton të shfaqet në asnjë moment në faktet që lidhen me ngjarjet e këtij viti, Prokuroria në aktin e komunikimit të akuzës për çdo të pandehur, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në mënyrë identike edhe në konkluzione përfundimtare[50], Prokuroria e mbështet akuzën, ndaj të gjithë të pandehurve, për pasojë edhe ndaj të pandehurit Shpëtim Cenaj në këto argumente: Sipas Prokurorisë, ***(i)*** *nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundërligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video...Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policisë Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime koruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri- tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro...(ii) është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turni të tyre, ku çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim. Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçantë pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të*

---

[50] *Shih konkluzionet përfundimtare, faqe 263,264,265, referuar më sipër në ketë vendim.*

qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit.". Në lidhje me këtë element të akuzës, gjykata vlerëson se, nga tërësia e provave të administruara në gjykim, vlerësuar në raport me njëra tjetrën si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, ky mekanizëm i përshkruar nga Prokuroria në akuzën e ngritur, nuk arrin të provohet, përveçse në mënyrë të pjesshme në ngjarjen e datës 01.03.2022. Në lidhje me të pandehurit e tjerë, përfshirë edhe të pandehurin Shpëtim Cenaj në rastin konkret, nuk evidentohen dhe për pasojë as provohen, minimalisht prezenca dhe kryerja prej tij e ndonjë veprimi konkret për realizimin e këtij mekanizmi nga ana e këtij të pandehuri, duke bërë më tej të pamundur vlerësimin mbi provueshmërinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të kundërligjshmërisë së veprimeve në këndvështrim të përmbajtjes ose jo të elementëve të veprës penale dhe të bashkëpunimit të tij me të pandehurit e tjerë. Në këtë këndvështrim, gjykata evidenton se, është e qartë se (i) nga mënyra se si është vepruar në disa raste, (ii) fakti që në këto veprime të kundërligjshme janë përfshire një numër i lartë punonjësish si dhe (iii) duke ju referuar shtrirjes kohore të veprimeve të tyre në një periudhë relativisht të gjatë, krijohen dyshime të arsyeshme mbi mundësinë e ekzistencës dhe funksionimit të këtij mekanizmi veprimi për të cilin referon Prokuroria, por duke gjykuar mbi atë çka provat ofrojnë egzaktësisht provat e administruara në gjykim, gjykata vlerëson se ky element i akuzën nuk arrin të provohet plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në provat e administruara, duke mbetur në këtë mënyrë në nivelin e një dyshimi, mbi të cilin do të duhej të ishte hetuar me tej. Për më tepër, në raport me të pandehurin Shpëtim Cenaj nuk rezulton që në asnjë moment në tërësinë e faktit dhe provave mbi të cilat ai mbështetet, kryesisht referuar ngjarjeve të zhvilluara gjatë vitit 2022, të ketë rezultuar minimalisht prezenca dhe aq me tepër kryerja prej tij e ndonjë veprimi në drejtim të realizimit të kësaj skeme për kryerjen e veprës penale.

963. Vetëm fakti që ai është punonjës i policisë në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë dhe ndaj tij rezultojnë komunikimet telefonike të analizuara më sipër, të zhvilluara gjatë vitit 2020 dhe 2021, me kolege dhe persona të ndryshëm, nuk mund të përligjë përfshirjen e tij edhe në ngjarjet e vitit 2022 në të cilat Prokuroria evidenton këtë mekanizëm veprimi, dhe nuk mund të shërbejë si bazë për të ngarkuar atë me përgjegjësi penale mbi një "pjesëmarrje" në raport më këtë të pandehur, referuar fakteve që sjellin provat e administruara në gjykim. Thënë këtë gjykata thekson se përgjegjësia penale, është konkrete dhe individuale dhe nuk mund të ravijëzohet në mënyrë absolute mbi bazë prezumimi. Për këto arsye, gjykata vlerëson se këto elementë të akuzës së ngritur, lidhur me ngjarjet e vitit 2022, në drejtim të vlerësimit të përfshirjes dhe me tej përgjegjësisë penale të të pandehurit Shpëtim Cenaj në rastin konkret, nuk mund të përbëjnë bazë për përcaktimin e fajësisë së tij, për sa kohë që nuk rezulton minimalisht evidentimi i prezencës dhe ndonjë veprimi konkret të tij në gjithë faktin penal objekt akuze lidhur me zhvillimin e ngjarjeve që përbejnë këtë mekanizëm, sipas akuzës së ngritur nga Prokuroria.

964. Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale të të pandehurit Shpëtim Cenaj për veprën penale për të cilën akuzohet, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal,

analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim[51]. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike që garantojnë autoritetin, ligjshmërinë dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike dhe subjekteve që ushtrojnë funksione publike si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë, juridike apo të shtetit; (ii) Anën objektive të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal konkretizohet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme të shfaqura në formën e kërkimit, marrjes ose pranimit të çdo lloj përfitimi apo oferte të kundërligjshme nga zyrtari publik, për vetë ose për të tjerë, me qëllim për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën dhe funksionin e tij publik. Pra që te konsiderohet e kryer nga pikëpamja e anës objektive kjo vepër penale, mjafton vërtetimi qoftë dhe vetëm i njërës nga këto forma të kryerjes së saj. (iii) Subjektin e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) ana subjektive e veprës penale e cila karakterizohet nga prezenca e elementit faj, pasi subjekti jo vetëm duhet të jetë i përgjegjshëm por duhet dhe që të veprojë me faj si dhe të konfigurohet dhe të rezultojë qëllimi i kryerjes së kësaj vepre, i cili konsiston në përvetësimin e një përfitimi të kundërligjshëm nga ana e subjektit. Ndërkohë që të provohet kryerja e kësaj vepre penale në bashkëpunim, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal, duhet të rezultojnë të provuara në drejtim të anës objektive veprimet e përbashkëta ose komplementare të dy ose më shumë të pandehurve në realizimin e elementeve të anës objektive, mbi bazën e një marrëveshje të shprehur apo të heshtur mes tyre, konkretizuar në kryerjen e veprimeve me te cilat realizohet vepra penale dhe në aspektin subjektiv, ekzistenca e dashjes tek secili prej tyre dhe po ashtu e një qëllimi të përbashkët në drejtim të realizimit të veprës penale.

965. Në rastin konkret, në të gjithë elementet e faktit në të cilat rezulton se referohet prezenca dhe komunikimet telefonike të të pandehurit Shpëtim Cenaj, analizuar më sipër, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet në veprimet dhe mosveprimet e tij, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Komunikimet telefonike të tij, vetëm disa prej tyre, referojnë të dhëna të cilat mund të përbënin bazë për organin e akuzës për të hetuar në drejtim të verifikimit nëse faktet mbi të cilat referojnë bisedat kanë ndodhur, dhe vetëm nëse do të vërtetohej se kishin ndodhur, të hetohej ne drejtim të kualifikimit dhe

---

[51] *Katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal janë analizuar në mënyrë të hollësishme në paragrafët 607-622 me sipër në këtë vendim.*

provueshmërisë së tyre si fakte penale. Në rastin konkret, komunikimet e te pandehurit me kolege dhe persona të tjerë, duke iu referuar edhe kontekstit të tyre ku nuk rezulton në asnjë rast te jete formësuar kërkimi, marrja apo pranimi i ndonjë përfitimi të kundërligjshëm të tij gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës, nuk mund të shërbejnë si bazë për përcaktimin e fajësisë së tij. Për më tepër pa u konkretizuar dhe lokalizuar na kohë dhe hapësire një apo disa ngjarje konkrete, të cilat sipas akuzës përbëjnë vepër penale, rezulton objektivisht e pamundur të vlerësohet mbi prezencën ose jo te elementeve të veprës penale në to dhe ekzistencës ose jo te provave të mjaftueshme për vërtetimin e tyre dhe përcaktimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit në raport me këto fakte. Në këtë rast akuza mbështetet vetëm ne komunikimet telefonike dhe ngjarjet "e pavërtetuara" dhe të pa provuara se kanë ndodhur realisht, duke qëndruar të dhënat që japin komunikimet telefonike të të pandehurit vetëm ne kuadrin e dyshimit, por pa u vërtetuar se realisht kanë ndodhur, e për më tepër në kufijtë e të provuarit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" jo vetëm të ekzistencës së faktit penal por edhe të fajësisë së të pandehurit në raport me to.

966. Në përfundim gjykata vlerëson se këto komunikime telefonike, pavarësisht përmbajtjes së tyre, të vetme dhe të pa mbështetura në asnjë provë tjetër, mund të shërbejnë vetëm si indicje, por nuk mund të shërbejnë në asnjë moment si prova për të provuar faktin penal dhe elementet e tij, si dhe akuzën e ngritur ndaj të pandehurit në lidhje me to. Si të tilla, pra si indicje, në kuptim të parashikimeve të nenit 152 të K.Pr.Penale ato do të duhej të mbështeteshin me të dhëna të marra nga të tjera indicje, për të vlerësuar përputhshmërinë, besueshmërinë, saktësinë e tyre, në drejtim të të provuarit të faktit për të cilin referojnë. Te vetme, këto të dhëna nuk mund të jenë të afta të provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementet e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit në raport me ketë vepër.

967. Sa i përket "akuzës" së atribuuar në mënyrë të përgjithshme, në tërësinë e saj, mbi mekanizmin e kundërligjshëm dhe të organizuar mbi bazën e të cilit kryhej korrupsioni në PKK Morinë (shih me sipër) gjykata vlerëson se jo vetëm provueshmëria e këtij mekanizmi mbetet e pa provuar në mënyrë të plotë (përveç një rasti ku ai provohet pjesërisht, analizuar më sipër) por nuk rezulton që në asnjë moment të evidentohen roli i të pandehurit Shpëtim Cenaj në ndonjë moment të zhvillimit të këtij fakti dhe për pasojë mungojnë tërësisht evidentimi i veprimeve të kundërligjshme të këtij të pandehuri në drejtim të realizimit të këtij fakti i cili, nga mënyra se si është formuluar duke se referon se tepërmi në ngjarjet e zhvilluara gjatë vitit 2022. Kjo "akuzë" e formuluar në mënyrë të përgjithshme, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen në përgjegjësi penale dhe dënimin e këtij të pandehuri, për sa kohë mbetet në nivel hipotetik dhe nuk rezulton të konkretizohet dhe të provohet në asnjë moment, nga tërësia e provave të administruara, se cilat janë veprimet konkrete të të pandehurit Shpëtim Cenaj, të lokalizuar në kohë dhe në hapësirë, si dy elemente thelbësore që karakterizojnë ekzistencën e faktit penal, në raport me ketë "akuzë" të referuar në mënyrë të përgjithshme.

968. Sa më sipër, gjykata vlerëson se në gjithë elementet në të cilët konsiston akuza ndaj të pandehuri Shpëtim Cenaj, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të ritheksojë se, barrën e

provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin, gjykata vlerëson se jo vetëm që ndodhemi në kushtet kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit por ndodhemi para situatës kur ky fakt nuk provohet se ka ndodhur në të vërtetë.

969. Sa më sipër, në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Shpëtim Cenaj në të gjitha faktet që i atribuohen, te ketë kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të ***kërkimit, marrjes apo pranimit të ndonjë përfitimi të kundërligjshëm gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij publike.***

970. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronjat b) dhe d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Shpëtim Cenaj duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti objekt akuze ka ndodhur dhe për pasojë, nuk mund të provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit HALIM SHEHU

971. Lidhur me të pandehurin **Halim Shehu**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë

ushtrimit të detyrës së në PKK Morinë, në disa episode. Gjykata vlerëson se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se i pandehuri Haim Shehu ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet në disa momente, ndërkohe që nuk vërtetohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm edhe një pjesë e fakteve (episodeve) që referojnë për këtë vepër penale, dhe konkretisht:

972. *Së pari*, në ngjarjet e datës 13.02.2022, rezulton se i pandehuri Halim Shehu ka bashkëpunuar me te pandehurin Ylber Hoxha (*i cili gjykohet në një procedim të lidhur, për shkak të ndarjes së çështjes në ngarkim të tij gjatë seancës paraprake*) në kërkimin dhe pranimin e një shumë parash, nga shtetasi që ka qenë duke kaluar kufirin në PKK Morinë. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e provave dhe konkretisht, pamjet filmike të datës 13.02.2022 të evidentuara dhe përshkruara në procesverbalin e këqyrjes së tyre, bisedat e regjistruara audio në datë 13.02.2022, të transkriptuara në procesverbalin përkatës, rezulton e provuar se në 13.02.2022, ora 10.42 minuta, në kabinën ku është duke kryer shërbimin punonjësi i policisë Ylber Hoxha, provohet se kanë ndodhur veprimet si më poshtë: *(i)* rezulton se në këtë kabinë është duke kryer përpunimin e dokumenteve të një shtetasi kosovar kontrollori Ylber Hoxha. Shtetasi i kërkon Ylberit dokumentin e tij pasi e ka harruar dhe punonjësi i policisë i thotë që të kthehet mbrapsht; *(ii)* në orën 09.45 minuta në këtë kabinë evidentohet prezenca e përgjegjësit të turnit/grupit Halim Shehu, i cili, sikurse rezulton nga pamjet filmike si dhe përshkruhet në procesverbalin e këqyrjes së tyre, ka qenë prezent në kabinën ku ushtron detyrën Ylber Hoxha, për një kohë të gjatë; *(iii)* gjatë kohës që shtetasi kosovar kthehet dhe kërkon dokumentin e tij, nga regjistrimi audio rezulton se Ylber Hoxha i drejtohet Halimit duke e pyetur se çfarë ti bëjnë qytetarit ndërsa evidentohet se Halimi i përgjigjet duke i thënë merri *kafen* dhe pas këtij momenti, Ylberi i drejtohet qytetarit duke i thënë të fusë një kafe në dokumente. Konkretisht, gjatë kësaj kohe, ndërkohe që zhvillohen ngjarjet dhe prezent në kabinën e kontrollorit është edhe i pandehuri Halim Shehu, midis Ylberit, Halimit dhe shtetasit, është zhvilluar një bisedë, ku ndër të tjera *evidentohet* ky komunikim : *Shtetasi : e kam harrue pasaportën; Ylberi: Prej ka je ti, me ça merresh? Shtetasi: Unë jetoj në ....(e pakuptueshme)....Ylberi: (i drejtohet Halimit) Ça me i ba këtij? Halimi: Duhet me pagu. Ylberi: Shko fute një kafe qetu bre...Shko futë mor një kafe në letra.*"; *(iv)* pas këtij momenti shtetasi kosovar largohet dhe për pak momente shihet teksa i jep diçka Ylberit, por nga pamjet filmike nuk evidentohet se çfarë dhe po ashtu u le mbi tavolinë dokumentet e bashkudhëtareve të tij; *(v)* nga të dhënat e verifikuara në sistemin TIMS, evidentuar në procesverbalin e këqyrjes, nuk rezulton se në këtë hark kohor të jenë regjistruar shtetas në hyrje nga kontrollori në shërbim Ylber Hoxha, pikërisht për shkak të problematikës që kishte personi të cilit ju kërkua "kafe" i cili siç deklaron në bisedë, ka harruar dokumentin e udhëtimit e për pasojë nuk mund të regjistrohet rregullisht në sistem.

973. Lidhur me ketë ngjarje të ndodhur në kabinën ky kryen shërbimin punonjësi i policisë Ylber Hoxha, interval kohor gjatë të cilit rezulton se qëndron në këtë kabinë edhe përgjegjësi i

turnit Halim Shehu, i cili komunikon me të pandehurin Ylber Hoxha, duke u evidentuara përmbajtja e bisedës siç u referua më sipër, duke iu referuar dinamikës së ngjarjes, veprimeve të kryera, fjalëve të drejtuara nga të dy punonjësit e policisë në drejtim të shtetasit në sportel, si dhe biseda e zhvilluar në dinamikë të këtyre ngjarjeve mes këtyre dy të fundit, gjykata vlerëson se rezulton e provuar se i pandehuri Halim Shehu, në bashkëpunim me të pandehurin Ylber Hoxha kanë kërkuar nga shtetasi në sportel, në mënyrë të tërthorte por qartësisht të kuptueshme, duke iu drejtuar me fjalët "*Duhet me pagu*" (Halimi) dhe "*Shko fute një kafe në letra*" (Ylberi), i kanë kërkuar shtetasit të paraqitur në sportel mitë në funksion të lejimit të kalimit të tij në kufi megjithëse ka mungesë të dokumentit të identifikimit, siç vete shtetasi e pohon, duke pamundësuar regjistrimin, kontrollin dhe përpunimin e rregullt të tij në pikën hyrëse.

974. *Së dyti*, duke iu referuar fakteve penale të evidentuara në lidhje me këtë të pandehur, sa i përket ngjarjeve të datës 15.02.2022, ora 08:13:46 min, në të cilat rezulton se ndërkohë që vijon shërbimin kontrollori Haqif Halilaj, regjistrimi video dhe audio i transkriptuar evidenton se ai thërret kolegun e tij, dhe pasi ai vjen ne kabinën e shërbimit, vendos në tavolinën e punës një kartëmonedhë 50 euro të cilën shihet se e merr Haqif Halilaj. Ndërkohë që ndodh ky veprim, mes tyre është zhvilluar biseda si më poshtë: *Haqif Halilaj: Mbarova unë me Ilirin. Punonjësi tjetër që vjen në kabinë: Atë lej unë ty këto t'ja japësh... (koha kur i hedh mbi tavolinë 50-euro). Haqif Halilaj: Po mo lej. Punonjësi tjetër: Ma kryj ti mos ta nij hiç (ndërkohë pamjet filmike tregojnë se i vendos edhe një 50-tëshe euro tjetër mbi tavolinë të cilat merren të dyja nga punonjësi i Haqif Halilaj).* Sipas pamjeve filmike, shihet se ndërkohë që Haqif Halilaj përpunon dokumente në sistem, në sportel nuk ka udhëtarë që të shihet se janë duke u përpunuar dhe kanë dorëzuar dokumentet pranë tij. Ndërkohë që ai vijon përpunimin e pasaportës, në kabinën e shërbimit të tij vjen një punonjës tjetër policisë dhe ndërkohë zhvillohet një komunikim, me kolegun e ardhur rishtas të cilit Halimi i thërret me emrin "Arben". Midis tyre është transkriptuar biseda në vijim: *Haqif Halilaj: O Arben, O Arben. Arbeni: Po.* Në këtë moment shihet Haqif Halilaj që i jep 50 euro dhe i drejtohet me fjalët*: Haqif Halilaj: Halimi ëëë* . Bisedaj vijon *: Arbeni: Arjani? Haqif Halilaj: Po. Une ti, Ylberi, Halimi, No koment me të tjerët. Arbeni: - Fjalë që nuk kuptohen- Haqif Halilaj: Thashë unë ti Ylberi edhe Halimi, tjeter kush jo, Ok ne rregull. Janë dhënë...që mos dalim dh...Arbeni: Jo jo edhe unë i thashë 100 mijë lekë kam bërë gjynah...e takova poshtë tek dogana. Haqif Halilaj: Po no koment me të tjerët. Arbeni: Jo Jo jo.* Nga pamjet filmike rezulton se punonjësi i policisë, i cili thërritet Arben dhe për të cilën referon ngjarja dhe komunikimit si më sipër, mban numrin identifikues, "05578" dhe nga verifikimi në sistem rezulton të jetë Arben Goçi. Në bisedën mes tyre përmenden emrat e punonjësve "Ylber, Halim, Arjan" por nuk rezulton që nga pamjet filmike, apo prova të tjera, të jetë identifikuar se cili ka qenë punonjësi që ka hyre me herët se sa Arben Goçi në kabinën e shërbimit të kontrollorit Halilaj dhe i ka lënë këtij të fundit dy herë, nga 50 euro si dhe nuk identifikohet qartë qëllimi, duke pamundësuar përcaktimin e prezencës së elementeve të veprës penale, sa kohë nuk ka të dhëna nga prova të tjera, veç këtyre veprimeve dhe komunikimit mes vetë punonjësve të policisë në këtë rast.

975. *Së treti*, nga pamjet filmike, regjistrimi audio dhe të dhënat e marra nga sistemi TIMS në lidhje me ngjarjen e shënuar në datë 22.02.2022, ora 08.05, rezulton se në shërbim në kabinën hyrëse nr. 4 është kontrollori Kapllan Dogjani, ndërsa përpunon dokumentet e shtetasve, të cilët sipas sistemit TIMS rezulton të jene shtetasit kosovarë Liridon Pajaziti, Hajrulla Goza dhe Skendër Sadria, për të cilët rezulton nga biseda se kontrollori konstaton mungesë të dokumentacionit të vaksinimit. Gjatë bisedës, nga pamjet filmike shihet se shtetasi në sportel i zgjat një kartëmonedhë, për të cilën nuk dallohet prerja. Sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike, referohet se gjatë kësaj kohe ka qenë prezent në kabinë edhe punonjësi i policisë Halim Shehu, por nuk referohet ndonjë veprim i tij në lidhje me ngjarjen si më sipër si dhe nuk mund të konkludohet referuar të dhënave të kufizuara që japin provat lidhur me ketë ngjarje, se Halim Shehu ka parë veprimet e kryera nga kontrollori dhe i ka lejuar ato, apo ka bashkëpunuar me të në realizimin e këtyre veprimeve.

976. *Së katërti,* në lidhje me komunikimin e gjetur në telefonin e të pandehurit Lahert Sulo me të pandehurin Halim Shehu, sa i përket situatës ku referohet se një shtetas i huaj ka bërë një denoncim pasi punonjësit e PKK Morinë i kanë kërkuar 5 euro, referuar bisedës së zhvilluar mes tyre (Halim Shehu dhe Lahert Sulo) dhe mes Lahert Sulos dhe Fran Kaçorrit, referohet se i pandehuri Lahert Sulo ka kryer veprime për verifikimin e këtij fakti por sipas tij, asnjëri prej punonjësve nuk e pranon si fakt dhe biseda mes tyre mbyllet pasi Frani i kërkon që punonjësit të bëjnë raport shërbimi. Në lidhje me këtë komunikim në deklarimet e të pandehurit Fran Kaçorri referohen me detaje veprimet e kryera nga ai dhe i pandehuri Lahert Sulo për verifikimin e faktit në lidhje me kërkimin e një shumë prej 5 euro shtetasit kosovar dhe denoncimin e kryer prej këtij shtetasi. Gjykatës nuk i rezulton, ashtu sikurse edhe nga prokuroria, asnjë element që konsiston në kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë përfitimi të paligjshëm nga i pandehuri Halim Shehu lidhur me ketë rast, vetë apo në bashkëpunim me persona të tjerë, në lidhje me shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj situate. Nëse ai dhe koleget e tij (*eprorët Lahert Sulo dhe Fran Kaçorri*) kanë ndjekur rrugën e duhur për trajtimin e rastit (*pra hetimin dhe referimin e rastit në rrugën administrative apo paraqitjen e kallëzimit penal*) është një çështje që i përket vlerësimit të punonjësve të policisë në rang hierarkik për të vlerësuar nëse janë kushtet ligjore dhe faktike për ekzistencën e një fakti që përbën një fakt të kallëzueshëm penalisht. Për sa kohë që nuk është evidentuar asnjë element që lidhet me konkretizimin e formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet i pandehuri, gjykata vlerëson se faktet që lidhen me këtë ngjarje, nuk përmbajnë elementë të veprës penale për të pandehurin Halim Shehu.

977. *Së pesti,* nga të dhënat e administruara lidhur me komunikimet e zhvilluara mes tij dhe personave të tjerë, gjatë vitit 2021, provohet se punonjësi i policisë Halim Shehu ka ndihmuar për të kaluar kufirin pa kryer procedurat e regjistrimit si në dalje ashtu dhe në hyrje të Republikës së Shqipërisë shtetasin Fatmir Allaraj dhe djalin e tij Bledar Allaraj, gjatë muajit janar të vitit 2021, dhe në një moment në këto biseda, duhet qartë se ai e udhëzon që të takojë një koleg të tijin i cili në udhëtimin e Fatmir Allarajt në drejtim të Kosovës në datë 13.01.2021 nuk rezulton të jetë vërtetuar se cilin ka qenë bashkëpunëtori i tij ndërsa në udhëtimin e këtij shtetasi

në datë 24.01.2021 rezulton të ketë qenë i pandehuri Fartri Iseberi, siç referon vetë biseda e zhvilluar mes Halimit dhe Fatmir Allarajt. Për ndihmën që i ka dhënë për të kaluar kufirin në datë 13.01.2021 pa u regjistruar në kufi, rezulton qartë se Halimi kërkon që Fatmiri ti japë personit që do të dalë ta prese një shumë prej 30 eurosh, duke e specifikuar qartë në komunikimin e tij këtë shumë dhe konkretisht i drejtohet me fjalët *"...Halimi: Aty del e pin një cigare e vjen vetë të gjen ai. Fatmiri: E ML-ja e bardhë, AB 307 AG. Halimi: 307 ML e bardhë. Edhe nji ashtu, një ashtu...nji, nji tridhjetëshe euro, jo ma shumë...Fatmiri: Sa të thush ti. Halimi: Nji tridhjetëshe. Qysh qitash jam tu të thon unë....Halimi:* ***Në një flij, një njëzeteshe, një dhjetëshe..jo ma shumë****, hajd. Fatmiri: Po bre ni flij, ni flij. Halimi : Hajde shok të përshëndes.... "*. Pra në këtë epidod komunikimi që referon në ngjarjen e datës 13.01.2021 ku shtetasi Fatmir Allaraj ka kaluar kufirin pa u regjistruar rregullisht dhe për këtë ka kërkuar ndihmën e të pandehurit Halim Shehu, rezulton se ky i fundit i ka kërkuar dhënien e një shumë 30 euro në drejtim të punonjësit që do të dalë të ndihmojë. Ky fakt, kalimi pa kryer procedurat e regjistrimit të paktën për shtetasin Fatmir Allaraj (*pasi bisedat referojnë të dhëna se ai ka kaluar kufirin së bashku me persona të tjerë*) me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu rezulton plotësisht i provuar nga (i) përmbajtja e komunikimeve telefonike te zhvilluara mes tij dhe shtetasit Fatmir Allaraj të zhvilluara një ditë para ngjarjes, në datë 12.01.2021 dhe në ditën e ngjarjes në datë 13.01.2021; (ii) të dhënat e verifikuara dhe të marra nga sistemi TIMS administruar nëpërmjet procesverbalit përkatës, nga të cilat rezulton se qëllimi për të cilin ky komunikim zhvillohet, pra kalimi në kufi pa kryer procedurën e rregullt të kalimit dhe regjistrimit të shtetasit Fatmir Allaraj ka ndodhur pasi për këtë shtetas nuk rezulton regjistrim i hyrje daljeve të tij në kufi që prej vitit 2019; (iii) nga deklarimet e vetë shtetasit Fatmir Allaraj i cili i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale pranon komunikimet me të pandehurin dhe faktin se është ndihmuar dhe asistuar prej tij për të kaluar kufirin, disa herë, ndër të cilat edhe episodi në fjalë, pa u regjistruar ai dhe djali i tij Bledar Allaraj në kufi, ky i fundit për shkak të statusit të azilantit politik që kishte në vendin ku jetonte, arsye për të cilën nuk duhet të regjistrohej në kufi, ndërsa për vetë Fatmitin nuk rezultojnë arsye, por rezulton qartësisht se ai ka kaluar kufirin si në dalje dhe në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e rregullta dhe ligjore te regjistrimit dhe përpunimit në kufi, me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu.

978. *Së gjashti*, nga komunikimet e zhvilluara gjatë muajit maj 2021 mes tij dhe një personi tjetër të cilin në komunikimet i drejtohet me emrin "Xhevat" biseda të zhvilluara në disa dite gjatë këtij muaji, diskuton me të lidhur me veprimtarinë e favorizimit të kalimit ne drejtim të Kosovës të disa mallrave të llojit "tapete" të shtetasve që në biseda i referohet si "Besim" dhe "Oti" dhe ne komunikimet e tij me bashkëbiseduesin e tij, Halimi tregon qarte se ka kërkuar para në këmbim të favorizimit dhe dhënies së ndihmës për kryerjen e kësaj veprimtarie, madje diskutojnë dhe se nuk kanë renen dakord për "pazarin" në raport me sasinë dhe llojin e mallit, ku ndër te tjera rezulton se i drejtohet bashkëbiseduesit duke i thënë:" *Halimi: Po kishin lënë ato çunat unë, veç me ju marrë ndonjë lek e hiç mos me u marrë me të...Xhevati: Po bre, po bre....Halimi:Janë pare të lehtë ato i kalojnë me njëherë. Këto e puna një i vogël, një i madh, një*

çfarë vlere me i vënë çfarë. Xhevati: Mesataren, mesataren i madh i vogël, vetëm thuj për numur, plus minus i bi mjedisit se sa për numër.", "....Halimi: edhe me i tanë atij sa pagun ee? Xhevati: Po or ti sa paguni për copë?Halimi:Sa copë janë e sa paguni, sa jeni të gatshëm paguni për cope? Xhevati :Or ti sa paguani për copë thuaj, njatjeta. Se ku merren, qysh merren?. Halimi: Ta diskutojmë vetë mirë e ke ti.","... Halimi:Degjo mik edhe tash thotë, unë fola me atë klientin, klienti ka me ashtu 200 unë dhe 200 nuk ban, po ashtu fol edhe një here me te. Unë qi tash po ja jap Otit i them direkt nuk mundem..Xhevati:Ore ti se janë tapeta nuk janë tu kalu i thuaj pak. Paguaje doganën i thuaj te shikojmë sa te bëjnë...Halimi:Jo jo jam tu pa mos me ja kry si pune....:. Lidhur me këto fakte, rezulton se nga ana e të pandehurit Halim Shehu, siç ai vete referon ne bisedat e regjistruara, ka kontaktuar dhe biseduar me personat që intereson për te kaluar mallrat në drejtim të Kosovës, madje diskuton me bashkëbiseduesin e tij edhe për pagesa të caktuar për të favorizuar dhe ndihmuar këtë veprimtari, por nuk rezulton që ndodhja e këtij fakti të jetë vërtetuar në një moment të ardhshëm, pra pas zhvillimit të këtyre bisedave. Këto biseda japin të dhëna të cilat krijojnë dyshim të arsyeshëm të bazuar mbi angazhimin e të pandehurit në këtë veprimtari të kundërligjshme kundrejt përfitimeve materiale, siç ai vete referon në bisedat përkatëse, por nuk rezulton që të jetë kryer asnjë veprim hetimor për te vërtetuar nëse kjo veprimtari ka ndodhur dhe nëse i pandehuri ka kërkuar, marrë apo pranuar shpërblimin që referon në funksion të kryerjes së detyrës së tij dhe në lidhje me këtë detyre. Në këto kushte, bisedat e përgjuara në lidhje me këtë fakt tregojnë për mendimin e te pandehurit për tu angazhuar në një veprimtari e cila duket se do të jetë e kundërligjshme, por nuk janë zhvilluar hetime në drejtim të vërtetimit nëse kjo veprimtari ka ndodhur ose jo në të vërtetë.

979. Po ashtu edhe kërkimi si një nga format e kryerjes së veprës penale, pavarësisht se në bisedat mes tij dhe bashkëbiseduesit referohen shifra parash, nuk është vërtetuar se ka ndodhur duke u shprehur nga i pandehuri ne drejtim te subjektit që do të përfitojë nga favorizimi i tij për shkak të detyrës. Në këtë kontekst, kur nuk rezulton të jetë kryer hetim dhe as të jenë marrë prova në drejtim të provueshmërisë se ky fakt penal ka ndodhur, në pamundësi të përcaktimit të tij në kohë dhe në hapësire , si dy elemente të qenësishme për ekzistencën e veprës penale, nuk mund te vlerësohet mbi prezencën ose jo te elementeve të veprës penale mbi një fakt hipotetik, që i përket te ardhmes në raport me kohën kur zhvillohen bisedat, dhe për me tepër, që nuk është provuar se ka ndodhur pasi hetimi mbi këtë fakt ka ndalur vetëm në regjistrimin e këtyre komunikimeve.

980. *Së shtati,* duke konsideruar mos konkretizimin dhe formulimin në mënyrë tërësore dhe të përgjithshme të fakteve objekt akuzë të bërë nga ana e Prokurorisë, në lidhje me ato fakte që evidentohen në drejtim të akuzës së ngritur ndaj të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të pandehurin Halim Shehu, për veprën penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal (*të cilat referojnë në ngjarjet e ndodhura në vitin 2022 dhe të dokumentuara kryesisht nëpërmjet regjistrimit audio dhe video të kamerave të instaluara në kabinat e pikës hyrëse*) gjykata çmon të marrë në analizë, akuzën e formuluar dhe faktet në të cilat ajo referon në raport me atë çka provohet ose jo në veprimet dhe mosveprimet konkrete të këtij të pandehuri. Konkretisht, pas paraqitjes tërësore të përmbajtjes së provave (*të dhënave të regjistrimeve audio dhe video, të*

dhënave të sistemit TIMS dhe deklarimeve) në lidhje me ngjarjet e vitit 2022, Prokuroria në aktin e komunikimit të akuzës për çdo të pandehur, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në mënyrë identike edhe në konkluzione përfundimtare[52],, Prokuroria e mbështet akuzën, ndaj të gjithë të pandehurve, për pasojë edhe ndaj të pandehurit Halim Shehu në këto argumente: Sipas Prokurorisë, ***(i)*** *nga aktet e administruara është evidentuar veprimtaria e kundraligjshme e punonjësve të policisë kufitare të lartpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, që konsiston në marrjen e ryshfetit në 313 raste të dokumentuara me pamje filmike audio e video...Nga hetimi janë grumbulluar të dhëna së në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë Kukës, nga ana e punonjësve të policisë kufitare që kanë kryer shërbimin, me detyrë Trup Shërbimi, Ndihmës Specialist Kontrollor, Përgjegjës Turni, Shef Stacioni i Policise Kufitare, kanë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme veprime koruptive duke kërkuar dhe marrë ryshfet personave të ndryshëm, në bashkëpunim me njëri- tjetrin kanë përfituar shuma të konsiderueshme në euro...(ii) është evidentuar mekanizimi i kryerjes së këtij aktiviteti të kundërligjshëm nga ana e punonjësve të policisë gjatë shërbimit të turni të tyre, ku çdo përgjegjës turni në përfundim të shërbimit ditor cakton një punonjës police me detyrë kontrollor, i cili mbledh shumën e ryshfetit nga secili punonjës në shërbim. Nga kjo shumë nxirret si formë ryshfeti dhe rezulton e provuar se ndahet në mënyrë të veçantë pjesa për Shefin e Stacionit të Policisë dhe pjesa për Drejtorinë e Qarkut. Secili përgjegjës turni ka grupin e tij të punës, zgjedh punonjësit që atij i duken më të përshtatshëm për të punuar, me qëllim sigurimin e përfitimeve sa më të larta. Pra, analiza e veprimeve të kryera nga personat pandehur të krijohet bindja e brendshme se veprimtaria e të gjithë punonjësve të dokumentuar në veprime korruptive krijohet bindja se ajo konsiston vetëm në marrjen e ryshfetit duke e kthyer në qëllimin kryesor të qëndrimit të këtyre punonjësve në atë detyrë duke e kthyer atributin që ju jep detyra funksionale si mjet vetëm për qëllime përfitimi e jo si detyrim për zbatimin e ligjit.*". Në lidhje me këtë element të akuzës, gjykata vlerëson se, nga tërësia e provave të administruara në gjykim, vlerësuar në raport me njëra tjetrën si dhe në përputhje me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, ky mekanizëm i përshkruar nga Prokuroria në akuzën e ngritur, nuk arrin të provohet, përveçse në mënyrë të pjesshme në ngjarjen e datës 01.03.2022 në të cilën janë përfshire të pandehurit Ani Hoxholli, Haqif Halilaj, Rezarta Lako dhe Xhulajana Maksutaj. Në lidhje me të pandehurit e tjerë, përfshirë edhe të pandehurin Halim Shehu në këtë rast, evidentohen dhe provohen veprime të kundërligjshme të të pandehurve të cilët përmbajnë elemente te bashkëpunimit të tyre në disa raste (*për ato raste kur të pandehurit janë gjetur fajtore për kryerjen e veprës ne bashkëpunim siç analizohet më sipër në vendim për secilin prej tyre*) por nuk rezulton i provuar mekanizmi i përshkruar nga ana e Prokurorisë në akuzën e ngritur. Është e qartë se (i) nga mënyra se si është vepruar në disa raste, (ii) fakti që në këto veprime të kundërligjshme janë përfshire një numër i lartë punonjësish si dhe (iii) duke ju referuar shtrirjes kohore të veprimeve të tyre në një periudhë relativisht të gjatë, krijohen dyshime të arsyeshme mbi mundësinë e ekzistencës dhe funksionimit të këtij mekanizmi veprimi për të cilin referon Prokuroria, por duke gjykuar vetëm mbi atë çka provat ofrojnë ekzaktesisht,

[52] *Shih konkluzionet përfundimtare, faqe 263,264,265, referuar më sipër në këtë vendim.*

gjykata vlerëson se ky element i akuzën nuk arrin të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në provat e administruara, duke mbetur në këtë mënyrë në nivelin e një dyshimi të arsyeshëm, mbi të cilin do të duhej të ishte hetuar me tej. Për këto arsye, gjykata vlerëson se këto elementë të akuzës së ngritur, në drejtim të vlerësimit të përgjegjësisë penale të të pandehurit Halim Shehu në rastin konkret, nuk mund të përbëjnë bazë për përcaktimin e fajësisë së tij, për sa kohë që nga provat rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm përfshirja dhe pjesëmarrja e tij vetëm në ngjarjen e datës 13.02.2022 ku ai ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Ylber Hoxha, duke realizuar nëpërmjet kërkimit, anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet si dhe kryerja prej tij ve veprimeve aktive të kundërligjshme për kërkimin e përfitimit të kundërligjshëm, në dobi të një të treti, në ngjarjen e datës 13.01.2021.

981. *Sa më sipër*, gjykata vlerëson se, nga të dhëna që ofrojnë pamjet audio dhe video të regjistruara në datë 13.02.2022, bisedat e transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara, dinamika e sjelljes dhe veprimeve, pasqyruara në procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike tregojnë qartë se i pandehuri Halim Shehu, ka bashkëpunuar me të pandehurin Ylber Hoxha, në kërkimin e mitës nga shtetasi që ka qenë në sportel në këtë moment kohor, pa dokument identifikimi, veprime këto të kryera nga të dy të pandehurit, gjatë ushtrimit të detyrës në PKK Morinë, pavarësisht se nuk evidentohen veprime të drejtpërdrejta të marrjes apo pranimit të ndonjë shume parash nga i pandehuri Halim Shehu, drejtpërdrejt nga shtetasi. Po ashtu, lidhur me ngjarjen e datës 12.01.2021, rezulton e qartë nga komunikimi i tij me shtetasin Fatmir Allaraj se ai i kërkon një shumë parash, në drejtim të një personi të tretë, koleg i tij i cili do të dalë për të ndihmuar shtetasin Fatrmir Allaraj për të kaluar kufirin pa u regjistruar, por nuk mund të vlerësohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ka vepruar me dijeninë dhe bashkëpunimin e kolegut të tij (*të paidentifikuar nga provat e marra*) mbi kërkimin e kësaj shume, pasi ajo çka rezulton nga provat është vetëm fakti se ai, në komunikim të drejtpërdrejtë kërkon këtë shumë, por nuk provohet momenti i marrjes apo pranimit të saj nga kolegu, për të gjykuar mbi elementet e mundshëm të bashkëpunimit.

982. Në drejtim të bashkëpunimit të tij në rastin në të cilin ka vepruar së bashku me të pandehurin Ylber Hoxha, Gjykata vlerëson se nga dinamika e ngjarjeve të zhvilluara, siç rezulton nga provat e analizuara më sipër, dëshmon jo vetëm dijeninë e të pandehurit Halim Shehu mbi këtë veprimtari që është duke kryer në prezencë të tij kontrollori Ylber Hoxha por edhe angazhimin e tij të drejtpërdrejtë në lidhje me realizimin e këtij fakti, cila rezulton e qartë nga prezenca dhe roli i tij në fazën që ky fakt penal është duke u zhvilluar. E kundërta, pra mungesa minimalisht e dijenisë së tij dhe po ashtu e bashkëpunimit të tij në këtë veprimtari, do të duhej të ishte shoqëruar me veprime të kundërta që do të konsistonin në marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve për raportimin/kallëzimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme dhe penalisht të ndëshkueshme të punonjësit dhe jo bashkëpunim të tij në realizimin e këtij aktiviteti të kundërligjshëm.

983. Mënyra se si janë zhvilluar ngjarjet në të dy episodet e analizuara më sipër, veprimet konkrete dhe sjellja e të pandehurit Halim Shehu dhe të pandehurit tjetër të përfshirë në rastin

konkret (*për ngjarjen në të cilën ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Ylber Hoxha*), të dhënat e qarta që japin komunikimet e tij me këtë të pandehur, në prezencë të qytetarit në sportel. pikërisht mbi këtë aktivitet të kundërligjshëm, si dhe veprimet e tij të drejtpërdrejta në kërkimin e mitës ne rastin tjetër, parë nën optikën e parashikimeve të nenit 152 të K.Pr.Penale krijojnë tek gjykata bindjen e brendshme dhe objektive, të bazuar në prova, se i pandehuri ka bashkëpunuar në realizimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme me të pandehurin Ylber hoxha në njërin episod dhe i vetëm ne episodin tjetër, të analizuar më sipër në këtë vendim, veprime aktive të kundërligjshme të cilat a qartësisht përmbajnë elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet, parashikuar nga neni 259, pl në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

984. Gjykata merr në analizë elementët e anës objektive të veprës penale, analizuar më sipër, në raport edhe me rolin dhe funksionin e të pandehurit në PKK Morinë, duke konsideruar këtu edhe fakti se, duke qenë në cilësinë e përgjegjësit të turnit, nuk ka qenë detyrë funksionale e tij përpunimi i qytetarëve në pikën hyrëse, për shkak të pozicionit të tij të punës si përgjegjës turni dhe jo si kontrollor, sikurse janë të pandehurit e tjerë. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se : *Së pari*, rezulton se i pandehuri Halim Shehu, në cilësinë e përgjegjësit të turnit, pavarësisht detyrave specifike në drejtim të organizimit të punës, mban cilësinë e punonjësit të policisë kufitare i cili, pavarësisht pozicionit të punës, ka për detyrë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit"[53][54], i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar"[55], i ndryshuar, të garantojë dhe sigurojë regjimin e ligjshëm të hyrje daljes së shtetasve në kufi si dhe të parandalojë kryerjen e veprave penale jo vetëm nga çdo shtetas, por për më tepër në funksion të detyrës së tij si epror në raport me kontrolloret që në rastin konkret janë vartësit e tij, të garantojnë ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre, dhe posaçërisht të veprojë në rast se konstaton kryerjen prej tyre të veprimtarisë të kundërligjshme, e posaçërisht nëse kjo veprimtari përbën vepër penale[56]. Në rastin konkret, rezulton se i pandehuri, me veprimet e tij, duke u përfshirë në veprime bashkëpunuese me punonjësit e policisë të cilët veprojnë në mënyrë të kundërligjshme duke konsumuar elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i

---

[53] Në nenin 18, pika 1, shkronjat ë) dhe f) të ligjit nr. 108/2014, ndër të tjera parashikohet se :"*.1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:....ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;*"

[54] Në nenin 21, të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" parashikohet se "1. *Në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit organizohet në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal.*"

[55] Në nenin 5 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" parashikohet se :" *2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*", ndërsa në nenin 6 të po këtij ligji, ndër të tjera, parashikohet se :" *1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen....*".

[56] Në nenin 18, pika 1, shkronja c) të ligjit nr. 108/2014, parashikohet se *:" 1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:... c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;".*

Kodit Penal, ka vepruar në kundërshtim me detyrimet që përkufizojnë kryerjen e ligjshme të detyrës së tij si punonjës i policisë së shtetit, posaçërisht i strukturës për kufirin dhe migracionin, pavarësisht detyrave funksionale të tij në raport me pozicionin e shërbimit sipas rregullores së brendshme apo akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij në pozicionin konkret. Arrihet ky konkluzion pasi referuar legjislacionit si më sipër, dhe posaçërisht nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*", rezulton se policia e shtetit, përfshirë edhe policinë kufitare, organizohet mbi bazë hierarkie, por kjo hierarki, nuk përjashton çdo punonjës të policisë së shtetit për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në ligjin "Për policinë e shtetit" apo ligje të tjera që veprojnë në fusha të ndryshme, sikurse është në rastin konkret ligji "Për kontrollin kufitar" dhe tërësia e akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të këtyre ligjeve[57]. *Së dyti*, në raport me elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, pavarësisht se në rastin konkret nuk identifikohen veprimet e drejtpërdrejta të të pandehurit në kërkimin, marrjen apo pranimin e ndonjë shume parash drejtpërdrejt nga qytetarët që kalojnë kufirin, në mos përmbushje të detyrës për kontrollin dhe kalimin e ligjshëm të kufirit, gjykata vlerëson se veprimet e të pandehurit Halim Shehu, të cilat siç rezulton nga sa u analizua më sipër, nuk kufizohen vetëm në dijeninë dhe mosveprimin e tij në lidhje me veprimtarinë korruptive të kontrollorit, në faktin që lidhet me ngjarjen e ndodhur ne kohën që është në shërbim kontrollori Ylber Hoxha, por nga vlerësimi tërësor i të dhënave që japin provat, mbi komunikimin dhe sjelljen e tij gjatë kohës që ka ndodhur ngjarja dhe posaçërisht ndërhyrja në bisede me fjalët e drejtpërdrejta që tregojnë kërkimin e mitës (*është shprehur në dinamikën e zhvillimit të faktit me fjalët "Duhet me pagu"*) tregojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e tij në këtë veprimtari së bashku me kontrollorin përkatës, pavarësisht nëse shuma e parave është marrë ose jo nga ky u fundit në përmbushje ose mos përmbushje të rregullt të detyrës së tij pasi, në vlerësim të gjykatës, ku element nuk ka rendësi thelbësore për vlerësimin e faktit në raport me elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 259,pg 1 i Kodit Penal, pasi në lidhje me këtë vepër penale mjafton të vërtetohet një nga format, kërkimi, marrja ose pranimi, i një shpërblimi në funksion të dhënies së shërbimit publik, pavarësisht nëse kjo përbën ose jo mos përmbushje të rregullt të detyrës nga punonjësit publikë.

985. Ngjarjet e zhvilluara në datë 13.02.2022, dinamika e tyre dhe veprimet e të dy të pandehurve të përfshirë në këtë episod, tregojnë qartë mënyrën e veprimit dhe rolin bashkëpunues të tij në realizimin e të njëjtit qëllim të kundërligjshëm me të pandehurit tjetër Ylber Hoxha. Veprimet aktive të kundërligjshme të të pandehurit Halim Shehu, në bashkëpunim

---

[57] *Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 71/2016 janë miratuar edhe një sërë aktesh të tjera nënligjore, të referuar më sipër në këtë vendim.*

me të pandehurin Ylber Hoxha, për ngjarjen e datës 13.02.2022, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Halim Shehu. Në drejtim të vlerësimit të elementeve të bashkëpunimit, veç sa më sipër, gjykata mban në konsideratë edhe faktin se gjatë kryerjes së një vepre penale në bashkëpunim, nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëpunëtoret të veprojnë të gjithë së bashku dhe të kryejnë të njëjtat veprime konkrete në drejtim të realizimit të veprës penale pasi sipas roleve përkatëse, veprimet e tyre mund te jenë edhe komplementare, por të nevojshme në arritjen e qëllimit final. Pra jo gjithmonë, të gjithë personat që veprojnë në bashkëpunim më njeri tjetrin, do te shfaqen së bashku duke vepruar për kryerjen e çdo veprimi në funksion të realizimit të veprës. E rëndësishme në vlerësimin mbi prezencën e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, që dëshmon ndër të tjera, edhe elementët e bashkëpunimit, është evidentimi dhe provueshmëria e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në veprime të përbashkëta ose komplementare, në funksion të realizimit të të njëjti qëllim.

986. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në referim të nenit 14 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se në rastin konkret, në veprimet e të pandehurit Halim Shehu, kryer në njërin prej episodeve në bashkëpunim, janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me qellim përfitimi. Arrihet ky konkluzion pasi, nga tërësia e veprimeve aktive të kundërligjshme që konfigurojnë elementet e anës objektive të veprës penale, rezulton e qartë se i pandehuri është tërësisht i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme të tij, dhe pavarësisht kësaj, me dashje merr pjesë në këtë veprimtari të kundërligjshme dhe të ndëshkueshme penalisht. Po ashtu në një prej episodeve, siç rezultoi më sipër, i pandehuri Halim Shehu ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Ylber Hoxha, duke ndikuar secili prej tyre, në realizimin e qëllimit të veprës penale, mbi bazën e një marrëveshje të arritur mes tyre, e cila dëshmohet nga mënyra e veprimit dhe sjellja e të pandehurve.

987. Sa i përket qëllimit, në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, kërkimi ose marrja i çfarëdo përfitimi të parregullt, apo pranimi i një oferte të parregullt është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale. Qëllimi i veprës penale, duke qenë një element që formësohet dhe qëndron në botën e brendshme e subjektit, mund të perceptohet vetëm në momentin që shfaqet së jashtmi, duke u qartësuar nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme të zhvilluara në psikikën e personit materializohen veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Kështu, në plotësim të këtij elementi, pra qëllimit, gjykata çmon se i pandehuri Halim Shehu, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, nëpërmjet kërkimit të përfitimeve të parregullta nga shtetasit e përpunuar në PKK Morinë, për vete ose për të tjerë, përkundrejt tolerimit për kalimin e tyre pa zbaruar parashikimet e ligjit që normon kalimin e ligjshëm dhe të rregullt të kufirit shtetëror.

988. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal,* gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Halim Shehu ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

989. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurve në rastin konkret, gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu, në cilësinë e tij si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

990. *Sa më sipër u arsyetua,* gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Halim Shehu**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 259, pg 1 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin

Ylber Hoxha, në faktin penal të ndodhur në datë 13.02.2022, ndërkohe që ka vepruar i vetëm në faktin e ndodhur në datë 13.01.2021, analizuar më sipër në këtë vendim.

Lidhur me veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për të cilën akuzohet i pandehurit Artan Rredhaj si dhe po këtë vepër penale, të kryer në bashkëpunim, për të cilën akuzohen të pandehurit Halim Shehu dhe Fatri Iseberi.

991. Lidhur me veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" në nenin 248 të Kodit Penal, parashikohet se :*"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.".* ***Kjo vepër ka për objekt*** mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura me ligj ose me akte normative me fuqinë e ligjit, të cilat garantojnë veprimtarinë e rregullt e normale të shtetit, institucioneve, shërbimeve publike, si dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe të shtetit, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal dhe kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve dhe akteve normative me fuqinë e ligjit. Neni 248 i K. Penal është një dispozitë *"blankete"* e cila i referohet akteve ligjore që normojnë punën/funksionin e personit që ushtron funksione publike në çdo rast konkret[58].

992. Në rastin objekt shqyrtimi, marrëdhëniet juridike të mbrojtura posaçërisht nga ligji janë ato të përcaktuara në legjislacionin në normon objektin e veprimtarisë së policisë së shtetit në tërësi dhe të policisë kufitare në veçanti, të rregulluara në mënyrë të posaçme në ligjin nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar. Konkretisht në ligjin nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, në lidhje me funksionet dhe detyrat e policisë së shtetit, në nenin 2 përcaktohet misioni i kësaj strukture, duke u sanksionuar se :" *Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e*

---

[58] *Në lidhje me figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.14, datë 17.01.2023, argumenton se: "Kolegji ri sjell në vëmendje se, vepra penale e "Shpërdorimit të detyrës" është një dispozitë blankete, pasi ajo i referohet akteve ligjore që normojnë mënyrën e përmbushjes së rregullt të detyrës, nga ana e personit që ushtron funksione publike. Në këtë kuptim, për ligjvënësin cenimi i këtyre marrëdhënieve konsiderohet vepër penale, e parashikuar si e tillë nga neni 248 i Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, që të ekzistojë vepra penale duhet që: - Të vërtetohet shkelja e dispozitave ligjore, që normojnë detyrat e nëpunësit shtetëror apo publik – kjo do të thotë se ka një ligj apo normë (qoftë edhe akt nënligjor i dalë në zbatim të ligjit), që përcakton elementët që duhet të respektojë funksionari publik në përmbushjen e rregullt të detyrës/funksionit të tij.- Të vërtetohet se i pandehuri me veprime aktive ose mosveprime të kundërligjshme, ka sjellë pasoja të rënda në dëm të shtetit ose të shtetasve, të cilat konsistojnë në dëme materiale apo shkelje të të drejtave themelore të shtetasve (jeta, shëndeti apo prona e tyre). Gjithashtu, si në çdo vepër penale për të marrë në përgjegjësi personin e dyshuar për këtë vepër, duhet patjetër të ekzistojë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimit apo mosveprimit të të pandehurit dhe ardhjes së pasojës kriminale. - Të vërtetohet se, kjo vepër penale është kryer me dashje dhe me qëllim përfitimi material ose jo material të padrejtë, apo vërtetim i cenimit të interesave të ligjshme të shtetit ose të shtetasve.- Të vërtetohet se, subjekti i veprës penale është i posaçëm - duhet të ketë atribute dhe aftësi të provuara, për të ushtruar shërbimin publik apo detyrën shtetërore përkatëse. (Shih vendimin nr. 161 datë 09.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*

personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.", ndërkohë që në nenin 17, pika 1, në lidhje me detyrat e policisë së shtetit, ndër të tjera, përcaktohet, se :" *1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë: .....ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë; ....i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;*[59]". Në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, sa i përket detyrave të punonjësve të policisë së shtetit që ushtrojnë funksionin pranë kësaj strukture, në nenin 5, pika 2 parashikohet se :" *2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*", ndërsa në nenin 6[60] të këtij ligji përcaktohen në mënyrë të

---

[59] *Në nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, parashikohet se :" 1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë: a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private; b) ruan rendin dhe sigurinë publike; c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre; ç) organizon fushata ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun; d) koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional; dh) identifikon, siguron dhe trajton në ambientet e saj, personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masë s së sigurimit me vendim gjykate, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; e) mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor; ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë; g) identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë; gj) administron dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion; h) ruan dhe siguron personalitetet e larta shtetërore dhe të huaja, si dhe objektet e rëndësisë së veçantë; i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;*

[60] *Në nenin 6 të ligjit nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, parashikohet se :" 1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen. 2. Rojat kufitare, në kuadër të verifikimit kufitar, duhet t'u japin nëpunësve të doganave apo nëpunësve të çdo autoriteti tjetër përgjegjës që operon në kufirin shtetëror mundësinë e kryerjes së verifikimeve të përbashkëta me ta, kur këta janë të pranishëm gjatë verifikimit kufitar. Rregullat për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar: a) të verifikojnë: i) origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit; ii) në rast dyshimi të arsyeshëm, identitetin e mbajtësit të dokumenteve të udhëtimit ose vizës, duke krahasuar identifikuesit biometrikë të depozituar në çdo bazë të dhënash, përveç ADN-së, me personin që po verifikohet; b) të sekuestrojnë dokumente udhëtimi, të cilat kanë tregues që justifikojnë dyshimin se: i) dokumenti i udhëtimit ose viza te dokumenti i udhëtimit është e falsifikuar ose e rremë; ii) janë përdorur për të siguruar informacion të rremë për një person. Nëse vërtetohet se një dokument i sekuestruar nuk është objekt i ndonjë mase të parashikuar nga Kodi Penal, u dorëzohet autoriteteve kompetente, për aq kohë sa është i nevojshëm sekuestrimi dhe, më pas, i kthehet personit ose shtetit që ka lëshuar dokumentin. 4.*

detajuar detyrat e policisë kufitare, ndër të cilat, në lidhje me përpunimin e shtetasve që kalojnë kufirin, përcaktojnë në mënyrë specifike se :"*1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda..... 6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë, gjithashtu, të drejtën t'u refuzojnë daljen personave: a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi; .....ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë, ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur, ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale; d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën "ç" të kësaj pike.....".* Ndërkohë, lidhur me verifikimin kufitar, pavarësisht regjimit që zbatohet në raste specifike, në nenin 13, pika 1 të këtij ligji parashikohet se :" *1. <u>Të gjitha lëvizjet ndërkufitare në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i verifikimeve kufitare nga rojat kufitare</u>.*" , ndërsa në nenin 14, pikat 1 dhe 2[61] të ligjit normohen procedurat lidhur me verifikimin kufitar

---

Rojat kufitare, për arsye të kontrollit të qarkullimit kufitar dhe për të kryer kontrollin kufitar, kanë të drejtë të hyjnë në çdo ngastër toke dhe në të gjithë ujërat, si dhe të drejtojnë automjetet në çdo rrugë, për sa kohë kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre. 5. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt. 6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë, gjithashtu, të drejtën t'u refuzojnë daljen personave: a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi; b) për të cilët ka një urdhër gjykate që ndalon daljen nga Republika e Shqipërisë; c) që duan t'i fshihen ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit apo ekzekutimit të dënimit me burgim; ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë, ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur, ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale; d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën "ç" të kësaj pike; 5 dh) të cilët, gjatë daljes nga Republika e Shqipërisë, përdorin dokumentin e një personi tjetër ose dokument të falsifikuar; e) të cilët janë të regjistruar në dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër dhe, gjatë daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, nuk janë të shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit janë regjistruar. 7. Rojat kufitare kanë të drejtë të zbatojnë me forcë masat e përmendura në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni.".

[61] *Neni 14, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 71/2016 parashikojnë në lidhje me verifikimin kufitar minimal të shtetasve se "1. Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga: a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e, veçanërisht, me: i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit; ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit; iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë; b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse. Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit. 2. Të huajt, krahas verifikimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, janë subjekt i verifikimeve tërësore në hyrje dhe në dalje, të cilat konsistojnë në verifikimin e plotësimit të të gjitha kushteve për kalimin e kufirit shtetëror. 3. Verifikimet kufitare tërësore në hyrje përbë-hen nga: a) verifikimi i të huajit nëse ai posedon, për kalimin e kufirit shtetëror, një dokument 8 udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, të shoqëruar me vizë ose leje qëndrimi, kur kjo kërkohet nga legjislacioni; b) këqyrja e plotë e dokumentit për ndonjë shenjë falsifikimi, sajimi apo tjetërsimi; c) shqyrtimi i vulave të hyrjeve/daljeve në dokumentin e udhëtimit, duke i krahasuar me të dhënat në bazat e të dhënave të hyrjeve/daljeve, për të verifikuar nëse i huaji ka tejkaluar afatin e autorizuar të qëndrimit në territorin e vendit; ç) verifikimi i dokumentacionit për nisjen, destinacionin dhe arsyen e qëndrimit të personit; d)*

minimal të personave, të huaj ose shqiptare, në kufirin hyrës dhe dalës të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me kontrollin mbi mjetet e udhëtimit, në nenin 16 të këtij ligji parashikohet se :" *1. Verifikimi i sendeve përfshin sendet personale që zotëron personi që kalon kufirin shtetëror. 2. Në rast se ka dyshime për sende ose objekte të ndaluara të fshehura ose për të verifikuar identitetin e një personi, roja kufitare i kërkon personit të paraqesë të gjitha sendet që ka në zotërim për të bërë të mundur që objektet të këqyren nga brenda dhe jashtë.* "Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, sikurse është referuar më sipër në këtë vendim, janë miratuar një sërë aktesh nënligjore që disiplinojnë punën e *rojave kufitare*, pra të punonjësve të policisë së shtetit që ushtrojnë detyrën në pikat e kalimit kufitar, dhe që gjejnë zbatim në lidhje me aspekte të ndryshme të kësaj procedure, dispozita të cilat do të referohen në mënyrë specifike në analizën e anës objektive të veprës penale në lidhje me faktet objekt akuze, në vijim të vendimit.

993. Në drejtim të ***anës objektive*** të veprës penale, e cila është e domosdoshme për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale, elementët e anës objektive të figurës së veprës penale shfaqen <u>nëpërmjet veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm dhe konkretizohen në mënyrën e kryerjes së saj</u>. Elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal konsistojnë në kryerjen ose moskryerjen e veprimeve a mosveprimeve, në kundërshtim me ligjin, të cilat duhet të përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës dhe veprimin e subjektit të veprës penale në kundërshtim me ligjin[62], të cilat duhet ti sjellin personit që ushtron funksione publike ose personave të tjerë, përfitime materiale ose jo materiale të kundërligjshme ose të dëmtojnë interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

994. *Në lidhje me* ***subjektin*** *e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës"*, në referim të neneve 12, 17 dhe 248 të K. Penal, subjekti i kësaj vepre hyn në kategorinë e subjekteve të posaçme, pasi përveç kushteve të përgjithshme për të qenë subjekti i veprës penale (*mosha dhe përgjegjshmëria*) subjekti i posaçëm është ai i cili është ngarkuar me ligj me një detyrë publike apo shtetërore (*zyrtar publik ose person që ushtron një funksion publik*) dhe që kryen veprën penale në saje ose për shkak të kësaj detyre apo funksioni publik, duke e shpërdoruar atë dhe duke vepruar në kundërshtim me ligjin.

---

verifikimi i të huajit nëse ai ka mjete të mjaftueshme financiare për kohën dhe qëllimin e qëndrimit, si dhe për kthimin në vendin e origjinës apo për kalimin transit në një vend të tretë ku i lejohet të hyjë ose verifikimi se ai është në gjendje t'i sigurojë këto mjete financiare në mënyrë të ligjshme.".

[62] *Në lidhje me terminologjinë "mos përmbushje të rregullt të detyrës", Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.2, datë 12.01.2023, arsyeton se "Në interpretimin e shprehjes "në kundërshtim me ligjin, që përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës", Kolegji i referohet edhe jurisprudencës kushtetuese, konkretisht vendimit nr. 7/2013 të Gjykatës Kushtetuese ku është argumentuar se: "Termi "ligj" i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit "ligj" në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t'u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe nga ana tjetër orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore.".*

995. Sa i përket cilësive të posaçme të punonjësve të policisë së shtetit e posaçërisht atyre të strukturës së kufirit dhe migracionit, sikurse është analizuar më sipër, në të njëjtën mënyrë si për subjektin e posaçëm të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (*analizuar më sipër në këtë vendim, paragrafët 606-622*), gjykata vlerëson se punonjësit e strukturës së policisë së shtetit që ushtrojnë funksionet në strukturën për kufirin dhe migracionin, përmbushin kushtet për tu klasifikuar si subjekte të posaçme, që ushtrojnë funksion publik. Ky konkluzion arrihet duke u referuar në parashikimet e neneve 4 pika 1 te ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar, në të cilin sanksionohet shprehimisht se :" 1. *Policia e Shtetit <u>është institucion i administratës shtetërore</u>, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike*", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar në të cilin parashikohet se:" *2.Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*" si dhe në rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, ku në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*". Sa më sipër, rezulton se punonjësit e strukturës së policisë së shtetit të cilët ushtrojnë funksionet në Policinë Kufitare, në nivel qendror dhe vendor, janë subjekte që plotësojnë kushtet për tu klasifikuar si funksionarë publike dhe për pasojë, ***plotësojnë kushtin e posaçëm për të qenë subjekte të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.***

996. Në drejtim të ***anës subjektive*** të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, kjo figurë e veprës penale realizohet me dashje të drejtpërdrejtë e cila konkretizohet në dijeninë e subjektit se veprimet ose mosveprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës së tij. Po ashtu duhet të ekzistojë vullneti, dëshira e pandehurit për t'i kryer këto veprime ose mosveprime si dhe të konfigurohet qëllimi që konsiston në përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të ose për persona të tjerë, ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridikë.

997. Duke iu referuar akuzës për të pandehurit Halim Shehu dhe Fatri Iseberi, të cilët akuzohen për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në bashkëpunim, gjykata merr në analizë institutin e bashkëpunimit, i cili në nenin 25 të Kodit Penal përkufizohet si: *"Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre."*. Në lidhje me rrethanën rënduese të *"bashkëpunimit"*, ligjvënësi ka sanksionuar në nenin 25 të Kodit Penal, kuptimin e institutit të bashkëpunimit, sipas së cilit, kërkohet bashkekzistenca e dy elementeve të rëndësishëm: *(i) së pari*, vepra penale të jetë kryer nga dy ose më shumë persona dhe *(ii) së dyti*, vepra penale të jetë kryer në marrëveshje ndërmjet tyre, marrëveshje e cila duhet të konfigurohet në anën subjektive të veprës dhe të shfaqet si e tillë duke u konkretizuar në elementet që përbëjnë anën objektive të saj. Në lidhje me institutin e bashkëpunimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.4, datë

15.04.2011, kanë arritur në përfundimin se: *"Sikurse u analizua më sipër, nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal. Nga pikëpamja e anës subjektive kërkohet gjithashtu marrëveshja e këtyre personave në kryerjen e veprës penale"*. Në të njëjtin vendim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: *"Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non: 1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash); 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale; 3.dhënia e një kontributi relevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se karakteristikë e veprës penale të kryer në bashkëpunim është uniteti i anës subjektive të veprës penale të kryer në bashkëpunim. Verifikimi i katër elementeve të mësipërm bën që vepra penale të cilësohet e kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuara në gjykim"*. Në vendimin si më sipër, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material dhe/ose moral në kryerjen e veprës penale. Në këtë drejtim doktrina ka pranuar se për të qenë në kushtet e bashkëpunimit, *"... mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues..."*. Në këtë logjikë përfshihen si veprimet *ex ante*, ashtu edhe ato *ex post* të autorit në kryerjen e veprës penale, me kushtin që të kenë ndikuar apo të kenë synuar pasojën kriminale[63]. Për të cilësuar kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal, qoftë si rrethanë cilësuese kur parashikohet nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal si e tillë, qoftë si rrethanë rënduese, është e rëndësishme që veprimet dhe/ose mosveprimet, pjesë e anës objektive të veprës penale, të dëshmojnë qartë

---

[63] *Me herët, në vendimin unifikues nr.1, datë 26.03.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë arritur në përfundimin se: "Marrëveshja, qe është një nga elementet e domosdoshëm për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, madje më kryesori, mund të vendoset jo vetëm midis organizatorit, ekzekutorit, shtytësit dhe ndihmësit që përbën formën klasike të bashkëpunimit. Ajo mund të vendoset edhe midis vetë ekzekutorëve të veprës penale, (në rastet kur ata janë dy ose më shumë persona) dhe në këtë rast do të ndodhemi para bashkëpunimit për të kryer vepër penale në formën e bashkekzekutorit të saj. Për të patur këtë formë bashkëpunimi, kërkohet që, secili nga personat qe marrin pjesë në realizimin e veprës penale, ose thënë ndryshe, secili nga bashkekzekutorët, të kryejë veprime që të kenë lidhje të drejtë për drejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar nga të gjithë të tjerët dhe që vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga secili prej bashkekzekutoreve d.m.th secili nga bashkekzekutoret me veprimin apo veprimet e tij, të marrë pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale. Në të njëjtën kohë, kërkohet që veprimet e secilit prej bashkekzekutoreve, të jenë rezultat i realizimit jo i dëshirave individuale te tij, por të jenë rezultat i realizimit të vullnetit teë përbashkët të të gjithë bashkekzekutorëve të një veprimtarie të caktuar, konkrete, kriminale."*

veprimin e dy ose më shumë personave në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dhënien e kontributit të përbashkët ose relevant të secilit prej tyre, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal, mbi bazën e një marrëveshje paraprake ose të arritur aty për aty, në mënyrë të shprehur ose të heshtur mes bashkëpunëtorëve, por që ka në fokus të përhershëm, deri në realizimin e qëllimit kriminal, veprimin e përbashkët ose komplementar të secilit bashkëpunëtor në funksion të të njëjtit qëllim kriminal.

998. Në vijim gjykata merr në analizë faktet objekt akuze për secilin të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (për dy prej tyre) duke i vlerësuar ato në raport me analizën e mësipërme në drejtim të vërtetimit dhe provueshmërisë së *objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive* të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në funksion të këtij vlerësimi, gjykata e gjen me vend të evidentojë se, sa i përket akuzës lidhur me veprën penale të shpërdorimit të detyrës për të cilën akuzohen të pandehurit Artan Rredhaj, Halim Shehu dhe Fatri Iseberi, referuar aktit të komunikimit të akuzës për secilin nga këta të pandehur, kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura nga Prokuroria, rezulton se kjo akuzë është ngritur duke argumentuar, ndër të tjera, se : *"Në rastin konkret, rezulton e provuar se të pandehurit Halim Shehu, Artan Rredhaj dhe Fatri Iseberi kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo për këto arsye:*[64] ***Së pari*** *të pandehurit Fatri Iseberi dhe Halim Shehu, në*

---

[64] *Prokuroria në konkluzione përfundimtare lidhur me faktet objekt akuze për figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën janë akuzuar të pandehurit në këtë proces Halim Shehu, Fatri Iseberi dhe Artan Rredhaj, argumenton, në disa pjesë të konkluzioneve, pas referimit të përmbajtjes së provave dhe të dispozitave të ligjit "Për kontrollin kufitar", se kjo akuzën konsiston në :"* ***Së pari,*** *i pandehuri* ***Fatri Iseberi,*** *me detyrë, kontrollor në P.K.K Morinë ka kryer në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim të ngushtë edhe me kolegë të tij por më konkretisht punonjësin e policisë* ***Halim Shehu,*** *favorizimin e shtetasve për kalimin pa pengesa të kufirit duke shmangur tërësisht procedurat e kontrollit kufitar e madje në shumë raste në bashkëpunim me punonjës të palës Kosovare, kundrejt përfitimit monetar. Destinacioni i këtyre shtetasve të cilët favorizohen prej tyre janë vendet e Bashkimit Evropian me qëllim emigracionin ekonomik e në disa raste duke përdorur si rrugë kalimi tranzit edhe shtetin Turk. Po ashtu, përveç sa janë konstatuar një sërë bisedash me interes për favorizimin e shtetasve të ndryshëm kryesisht ata që kanë lidhje shoqërore me ta për kalimin e mallrave kontrabande në kufi pa kryer procedurat doganore të cilat shkojnë rast pas rasti dhe i blejnë në Kosovë, si pjesë këmbimi automjetesh, mallra ushqimorë të ndryshëm etj. Po nuk është vetëm kjo veprimtaria e paligjshme e tyre ata shfrytëzojnë çdo rast për shtetas të cilët janë me shënime në sistemin TIMS dhe kanë problematika për kalimin e kufirit, për marrje ryshfeti apo favorizimin e tyre, siç është rasti i një shtetasi-Kosovar të ndaluar në kufi, i cili ka qenë me shënimin "Alert", në sistemin TIMS i cili duhej të ndalohej për qëllime ekstradimi pasi ishte person i cili dyshohej për Vjedhje. Në bashkëpunim me njëri tjetrin Fatriu dhe Halimi i japin ndihmë këtij shtetasi për fshehjen e telefonave celulare e madje i gjejnë taksi shoqërueses së këtij shtetasi me qëllim transportimin e shpejtë drejt Tiranës. Fatri Iseberi dhe Halim Shehu po ashtu, në mënyrë të vazhdueshme kanë ndihmuar vëllain e Fatriut, Ardian Iseberin që të kalojë mallra nga Kosova drejt Shqipërisë duke mos kryer procedurat doganore nëpërmjet ndikimit të tyre tek doganierët. Mallrat e cilat janë pjesë këmbimi automjetesh, goma automjetesh si dhe automjete të vjetra të cilat nuk disponojnë asnjë dokumentacion dhe ky i fundit i reklamon dhe i shet online, duke mos deklaruar as fitimet pasi nuk kryen kontrata për shitjen e tyre. Po ashtu në vijim të komunikimeve dhe veprimeve hetimore të kryera janë siguruar të dhëna se vëllai punonjësit Fatri Iseberi nuk kalon mallra vetëm për vetën e tij por duke patur këtë ndihmë dhe akses në policinë kufitare ai kryen transporte mallrash edhe për persona të tjerë siç është rasti i shtetasit Robert Saraci dhe vëllait të tij Ervis Saracit të cilët disponojnë servis makinash dhe mallrat për furnizimin e këtyre serviseve i marrin kryesisht nga Kosova duke shmangur kundrejt dhënies së rryshfetit procedurat doganore... Nga të dhënat e përftuara si rezultat i veprimeve hetimore të kryera për shtetasit* ***Fran Kaçorri, Halim Shehu, Artan Rredhaj dhe***

bashkëpunim me njëri tjetrin dhe në momente te ndryshme kohor, kanë favorizuar kalimin e shtetasve ne pikën e kalimit kufitar në ndalnim të parashikimeve të ligjit dhe kateve nënligjore, për shkak të problematikave me dokumentacionin ose ndalesave që këta shtetas kanë pasur për të kaluar kufirin; ***Se dyti****, Fati Iseberi ka ndihmuar vëllain e tij Ardian Iseberi dhe personat me të cilët ky i fundit ka lidhje, për kalimin ën kohë të ndryshme të mallrave kontrabande në piken e kalimit kufitar;* ***Së treti****, i pandehuri Artan Rredhaj akuzohet për ngjarjen e datës 26.12.2021 ku sipas akuzës, me porosi të të pandehurit Lahet Sulo ka ndihmuar për të kaluar kufirin një shtetas, targën e automjetit të të cilit ja ka dërguar Laherti.".*

999. Duke iu referuar akuzës së ngritur dhe fakteve të përfshira në të për secilin të pandehur, marrë në konsideratë faktin që për të pandehurit Halim Shehu dhe Fatri Iseberi veprimtaria objekt akuze është e shtrirë në kohë dhe nuk është përcaktuar nga prokuroria në mënyrë tejet koncize, në drejtim të përcaktimit se cilat fakte apo ngjarje për të cilat referojnë provat, janë konsideruar nga ky organ si fakte që përbëjnë egzaktësisht akuzën në ngarkim të secilit të pandehur, gjykata do të analizojë të gjithë elementet dhe të dhënat që janë përfshirë në faktin objekt akuze, komunikuar secilit prej tyre, për shkak të mungesës së një mjeti procedural të aplikueshëm gjatë gjykimit të çështjes në themel, për të vepruar në drejtim të qartësimit dhe saktësimit të akuzës.

Lidhur me akuzën ndaj të pandehurit HALIM SHEHU

1000.Lidhur me të pandehurin **Halim Shehu**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo

---

Fatri Iseberi *rezulton e provuar se kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale "**Shpërdorimi i detyrës**". Konkretisht* ***Fatri Iseberi****, me detyrë, kontrollor në P.K.K Morinë ka kryer në mënyrë të vazhdueshme në* ***bashkëpunim të ngushtë edhe me kolegë të tij****, por më konkretisht punonjësin e policisë* ***Halim Shehu****, favorizimin e shtetasve për kalimin pa pengesa të kufirit duke shmangur tërësisht procedurat e kontrollit kufitar e madje në shumë raste në bashkëpunim me punonjës të palës Kosovare, kundrejt përfitimit monetar. Destinacioni i këtyre shtetasve të cilët favorizohen prej tyre janë vendet e Bashkimit Europian me qëllim emigracionin ekonomik e në disa raste duke përdorur si rrugë kalimi tranzit edhe shtetin Turk. Po ashtu, përveç sa janë konstatuar një sërë bisedash me interes për favorizimin e shtetasve të ndryshëm kryesisht ata që kanë lidhje shoqërore me ta për kalimin e mallrave kontrabandë në kufi pa kryer procedurat doganore të cilat shkojnë rast pas rasti dhe i blejnë në Kosovë, si pjesë këmbimi automjetesh, mallra ushqimorë të ndryshëm etj. Po nuk është vetëm kjo veprimtaria e paligjshme e tyre ata shfrytëzojnë çdo rast për shtetas të cilët janë me shënime në sistemin TIMS dhe kanë problematika për kalimin e kufirit, për marrje ryshfeti apo favorizimin e tyre.* ***Fatri Iseberi dhe Halim Shehu*** *po ashtu, në mënyrë të vazhdueshme kanë ndihmuar vëllain e Fatriut, Ardian Iseberin që të kalojë mallra nga Kosova drejt Shqipërisë duke mos kryer procedurat doganore nëpërmjet ndikimit të tyre tek doganierët. Mallrat e cilat janë pjesë këmbimi automjetesh, goma automjetesh si dhe automjete të vjetra të cilat nuk disponojnë asnjë dokumentacion dhe ky i fundit i reklamon dhe i shet online, duke mos deklaruar as fitimet pasi nuk kryen kontrata për shitjen e tyre. Po ashtu në vijim të komunikimeve dhe veprimeve hetimore të kryera janë siguruar të dhëna se vëllai punonjësit Fatri Iseberi nuk kalon mallra vetëm për vetën e tij por duke patur këtë ndihmë dhe akses në policinë kufitare ai kryen transporte mallrash edhe për persona të tjerë siç është rasti i shtetasit Robert Saraçi dhe vëllait të tij Ervis Saraçit të cilët disponojnë servis makinash dhe mallrat për furnizimin e këtyre serviseve i marrin kryesisht nga Kosova duke shmangur kundrejt dhënies së ryshfetit procedurat doganore.. Kështu, në plotësim të këtij elementi të pandehurit Fran Kaçorri, Halim Shehu, Artan Rredhaj dhe Fatri Iseberi rezulton e provuar se kanë vepruar me dashje të drejtpërdrejtë në rastin konkret, pasi kanë parashikuar karakterin e kundërligjshëm të veprimeve të tyre dhe me ndërgjegje kanë vepruar, duke favorizuar persona të ndryshëm për të kaluar kufirin shtetëror pa i'u nënshtruar kontrollit sipas ligjit.".*

dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Halim Shehu ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si punonjës i policisë kufitare, me detyrë "përgjegjës turni" në disa episode të zhvilluara gjatë vitit 2020 dhe 2021, në drejtim të favorizimit dhe ndihmës së dhënë shtetasve për të kaluar kufirin shtetëror, në hyrje dhe në dalje të tij, pa kryer procedurat e rregullta të përpunimit të shtetasve në kufi, dhe në disa prej episodeve të faktit penal, rezulton se ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurit tjetër Fatri Iseberi. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve vetëm kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Halim Shehu, i vetëm në disa raste dhe në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Iseberi në disa të tjera, ka shpërdoruar detyrën duke ndihmuar/favorizuar shtetas të ndryshëm që, pa kryer procedurat e rregullta të përpunimit dhe verifikimit kufitar, të kalojnë kufirin shtetëror në PKK Morinë. Arrihet ky konkluzion pasi:

1001.*Së pari*, rezulton e provuar se punonjësi i policisë Halim Shehu ka ndihmuar për të kaluar kufirin pa kryer procedurat e regjistrimit si në dalje ashtu dhe në hyrje të Republikës së Shqipërisë shtetasin Fatmir Allaraj dhe djalin e tij Bledar Allaraj, gjatë muajit janar të vitit 2021, dhe në një moment në këto biseda, duhet qartë se ai e udhëzon që të takojë një koleg të tijin i cili në udhëtimin e Fatmir Allarajt në drejtim të Kosovës në datë 13.01.2021 nuk rezulton të jetë vërtetuar se cilin ka qenë bashkëpunëtori i tij ndërsa në udhëtimin e këtij shtetasi në datë 24.01.2021 rezulton të ketë qenë i pandehuri Fartri Iseberi, siç referon vetë biseda e zhvilluar mes Halimit dhe Fatmir Allarajt. Për ndihmën që i ka dhënë për të kaluar kufirin në datë 13.01.2021 pa u regjistruar në kufi, rezulton qartë se Halimi kërkon që Fatmiri ti japë personit që do të dalë ta presë një shumë prej 30 eurosh, duke e specifikuar qartë në komunikimin e tij këtë shumë dhe konkretisht i drejtohet me fjalët *"...Halimi: Aty del e pin një cigare e vjen vetë të gjen ai. Fatmiri: E ML-ja e bardhë, AB 307 AG. Halimi: 307 ML e bardhë. Edhe nji ashtu, një ashtu...nji, nji tridhjetëshe euro, jo ma shumë...Fatmiri: Sa të thush ti. Halimi: Nji tridhjetëshe. Qysh qitash jam tu të thon unë....Halimi:* ***Në një flij, një njëzeteshe, një dhjetëshe..jo ma shumë****, hajd. Fatmiri: Po bre ni flij, ni flij. Halimi : Hajde shok të përshëndes.... "*. Pra në këtë episod komunikimi që referon në ngjarjen e datës 13.01.2021 ku shtetasi Fatmir Allaraj ka kaluar kufirin pa u regjistruar rregullisht dhe për këtë ka kërkuar ndihmën e të pandehurit Halim Shehu, rezulton se ky i fundit i ka kërkuar dhënien e një shumë 30 euro në drejtim të punonjësit që do të dalë të ndihmojë. Ky fakt, kalimi pa kryer procedurat e regjistrimit të paktën për shtetasin Fatmir Allaraj (*pasi bisedat referojnë se ai ka kaluar kufirin së bashku me persona të tjerë*) me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu rezulton plotësisht i provuar nga *(i)* përmbajtja e komunikimeve telefonike te zhvilluara mes tij dhe shtetasit Fatmir Allaraj të zhvilluara një ditë para ngjarjes, në datë 12.01.2021 dhe në ditën e ngjarjes në datë 13.01.2021; *(ii)* të dhënat e verifikuara dhe të marra nga sistemi TIMS administruar nëpërmjet procesverbalit përkatës, nga

të cilat rezulton se qëllimi për të cilin ky komunikim zhvillohet, pra kalimi në kufi pa kryer procedurën e rregullt të kalimit dhe regjistrimit të shtetasit Fatmir Allaraj ka ndodhur pasi për këtë shtetas nuk rezulton regjistrim i hyrje daljeve të tij në kufi që prej vitit 2019; *(iii)* nga deklarimet e shtetasit Fatmir Allaraj i cili, i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, pranon komunikimet me të pandehurin dhe faktin se është ndihmuar dhe asistuar prej tij për të kaluar kufirin, disa herë, ndër të cilat edhe episodi në fjalë, pa u regjistruar ai dhe djali i tij Bledar Allaraj në kufi, ky i fundit për shkak të statusit të azilantit politik që kishte në vendin ku jetonte, arsye për të cilën nuk duhet të regjistrohej në kufi, ndërsa për vetë Fatmirin nuk rezultojnë arsye, por rezulton qartësisht se ai ka kaluar kufirin si në dalje dhe në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e rregullta dhe ligjore te regjistrimit dhe përpunimit në kufi, me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu. Ky episod në të cilin vërtetohet se Halim Shehu jo vetëm ka ndihmuar shtetasin Fatmir Allaraj të kalojë kufirin por rezulton e qartë se në këmbim të këtij favorizimi, ka kërkuar, në këtë rast për të tjerë (*për personin që do ta presë Fatmirin në kufi për ta asistuar*) një shumë parash të përbërë nga 30 euro, nga gjykata vlerësohet se përmban qartësisht elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal dhe për pasojë është konsideruar dhe vlerësuar nga gjykata në faktet penale që lidhen me akuzën ndaj të pandehurit për këtë vepër penale. Në analizën e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ky episod i ndodhur në datë 13.01.2021, sillet për të bërë të kuptueshme vazhdimësinë e kësaj veprimtarie të tij në ndihmë të shtetasit Fatmir Allaraj për ti mundësuar kalimin e kufirit në dalje dhe në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e regjistrimit dhe përpunimit të rregullt të shtetasve në kufi, i cili ka ndodhur edhe ne një datë të mëvonshme dhe që në vlerësim të gjykatës përmban qartësisht elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për të cilën akuzohet i pandehuri. Lidhur me këtë fakt, *në ngjarjen e dytë*, që lidhet me kalimin e tij dhe djalit të tij Bledar Allaraj në kufi në datë 24.01.2021, rezulton se ndihma që Halimi i ofron për të kaluar kufirin pa u regjistruar, për shkak se ai siç referon në biseda nuk ndodhet në pikën e kalimit kufitar, është realizuar me ndihmën e kolegut të tij Fatri Iseberi, pasi vetë Halimi në bisede i thotë shtetasit Fatmir Allaraj se do të dalë ta presë Fatriu. Në këtë episod rezulton se provuar se Halimi, me bashkëpunimin e kolegut të tij Fatri Iseberi, ka asistuar dhe ndihmuar shtetasin Fatmir Allaraj dhe djalin e tij Bledar Allaraj të kalojnë kufirin pa u regjistruar, në kundërshtim me ligjin, por nuk rezulton e provuar që në këmbim të këtij favori të jenë kërkuar, marrë apo pranuar para apo përfitime të tjera të kundërligjshme prej tij apo kolegut të tij. Ky fakt, kalimi në mënyrë të kundërligjshme dhe pa iu nënshtruar procedurave të rregullta të përpunimit dhe regjistrimit të shtetasve në kufi, në ngjarjen e datës 24.01.2021, me ndihmën e të pandehurit Halim Shehu në bashkëpunim me kolegun e tij Fatri Iseberi, rezulton i provuar nga : *(i)* përmbajtja e komunikimeve telefonike te zhvilluara mes tij dhe shtetasit Fatmir Allaraj dhe djalit të tij me të pandehurin Halim Shehu, të zhvilluara në datë 24.01.2021; *(ii)* nga të dhënat e verifikuara dhe të marra nga sistemi TIMS administruar nëpërmjet procesverbalit përkatës, nga të cilat rezulton se qëllimi për të cilin ky komunikim zhvillohet, pra kalimi në kufi pa kryer procedurën e rregullt të kalimit dhe regjistrimit të shtetasit Fatmir Allaraj dhe Bledar Allaraj ka ndodhur pasi për këta dy shtetas nuk

rezulton regjistrim i hyrje daljeve në kufi përkatësisht prej vitit 2019 për Fatmirin dhe prej vitit 2013 për Bledarin; *(iii)* nga deklarimet e vetë shtetasit Fatmir Allaraj i cili i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale pranon komunikimet me të pandehurin dhe faktin se është ndihmuar dhe asistuar prej tij për të kaluar kufirin, disa herë, ndër të cilat edhe episodi në fjalë, pa u regjistruar ai dhe djali i tij Bledar Allaraj në kufi, ky i fundit për shkak të statusit të azilantit politik që kishte në vendin ku jetonte, arsye për të cilën nuk duhet të regjistrohej në kufi, ndërsa për vetë Fatmitin nuk rezultojnë arsye, por rezulton qartësisht se ai ka kaluar kufirin si në dalje dhe më pas në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e rregullta dhe ligjore te regjistrimit dhe përpunimit në kufi, me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu i cili në këtë rast ka vepruar se bashku me të pandehurin Fatri Iseberi, pavarësisht se nuk rezultojnë të jenë dokumentuar komunikime të drejtpërdrejta të këtij të fundit mbi ngjarjet e kësaj date.

1002.*Së dyti,* nga komunikimet e zhvilluara mes Halim Shehut me një shtetas të cilin në bisede e thërret me emrin *Selami*, zhvilluar në datat 24.01.2021 dhe 27.01.2021, nga konteksti i bisedës rezulton se shtetasi i kërkon ndihmë për të mundësuar kalimin e një shtetasi tjetër, të njohur të tij, pa u regjistruar në dalje dhe Halimi, pasi komunikon me të mbi këtë fakt në datë 24.01.2021, i bën me dije se është me leje dhe bien dakord që të bisedojnë dhe realizojnë këtë veprim kur ai te kthehet në punë. Referuar komunikimi i zhvilluar mes tyre pas disa ditësh dhe konkretisht në datë 27.01.2021 dhe konteksti i bisedës së zhvilluar, rezulton se Halimi i udhëzon që ne sedo te ketë problem të shkojë tek një punonjës i policisë së Kosovës të cilit i referohet si "*shef Vullneti*" dhe pas bisedës së zhvilluar Selami i dërgon *sms* duke i thënë "*Faleminderit, kaluam pa problem*".

1003.*Së treti,* marrja përsipër e realizimit të kalimit të një shtetasi në kufirin hyrës me Republikën e Shqipërisë pa u regjistruar, rezulton edhe nga biseda që Halim Shehu ka zhvilluar në datë 28.04.2021 me shtetasin i cili është identifikuar si Besim Gjoka, ku ky i fundit i kërkon ndihmë për të kaluar një të afërm të tij pa u regjistruar në hyrje R.Sh dhe Halimi në kontekstin e kësaj bisede i përgjigjet :"*Me këto probleme eee.Ok s'është problem vetëm kur të afrohesh afër me thuaj. Besimi: Ok ok se do ndalem aty dhe vij vetë unë e të them. Ose ca ore e merr shërbimin ti se vjen në orën 08.30 më vjen mua ai, nga ora 07.30 mund të kaloj unë aty me të taku të iki andej....*". Kalimi i shtetasit që referohet në bisedën mes tyre nuk rezulton të jetë verifikuar më tej nëse ka ndodhur por në raport me faktin penal objekt akuze, vlerësohet nga gjykata si indicje, që jep të dhëna mbi një veprimtari të njëjtë dhe të shtrirë në kohë të të pandehurit Halim Shehu në lidhje me ketë aktivitet, pra favorizimin e shtetasve të ndryshëm për të kaluar kufirin pa u regjistruar dhe përpunuar rregullisht, në hyrje dhe dalje, për shkak të problematikave që ata kanë dhe për të cilin kërkojnë asistencën dhe ndihmën e Halimit për të mos kryer procedurat e regjistrimit. Ndërkohë me këtë shtetas rezulton se ka serish komunikim ne datë 06.05.2021 ku rezulton qartë se shtetasi Besim Gjoka është duke udhëtuar drejt kufirit dhe komunikon me Halimin, ku ndër të tjera, pasi mbërrin, Halimi i thotë "*Qatje ku jam unë në këmbë, atje vjen direkt ti dhe vetëm dokumentin tënd, e ato të tjerët, ini tu shku me përcjellë juve, vetëm një është prej atyre tu shku në Angli qe kaq.*". Fakti që ky shtetas është favorizuar nga Halimi për të mos u regjistruar në kufi në këtë <u>*episod të dytë*</u> të datës 06.05.2021, rezulton i

provuar përveç bisedës së zhvilluar mes tyre edhe nga të dhënat e mara nga sistemi TIMS, nga ku rezulton se shtetasi Besim Gjoka nuk është regjistruar në sistemin TIMS të informacionit në dalje të R.Sh por të njëjtën ditë figuron i regjistruar në hyrje të R.Sh-së datë 06.05.2021 ora 09:21 min me automjetin me targa,"AA467LY". Ndërsa rezulton se në dalje të R.Sh-së si pasagjer në të njëjtin automjet nuk është regjistruar asnjë shtetas, ndërkohë që në bisedat e zhvilluara mes tij dhe Halim Shehut, si më sipër, referohet se ka pasur me vete, pra pasagjerë, persona të tjerë, të cilët sipas bisedave të tyre, kanë si destinacion shtetin anglez dhe rezulton e qartë se është Halimi ai që i ka pritur dhe mundësuar kalimin e tyre në kufi pa u regjistruar dhe përpunuar rregullisht sipas procedurave standarde të përpunimit të shtetasve në kufi.

1004.*Së katërti*, rezulton e provuar se në datë 01.05.2021 i pandehuri Halim Shehu komunikon me shtetasin Vllaznim Maloku ku nga biseda rezulton se ky i fundit është duke kaluar kufirin hyrës për në Shqipëri, dhe Halimi e udhëzon se ku dhe si duhet të kalojë. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ky shtetas nuk është regjistruar në kufirin hyrës në këtë datë, por nga biseda e zhvilluar me Halimin rezulton se ai kalon dhe kërkon ndihmën e këtij të fundit për të kaluar për në Shqipëri, ku siç rezulton ka kaluar pa u regjistruar rregullisht.

1005.*Së pesti,* e njëjta situatë dhe sjellje e të pandehurit Halim Shehu rezulton edhe në lidhje me bisedën e zhvilluar mes tij dhe shtetasit Andrin Shehu në datë 05.05.2021 ku rezulton se ky i fundit e telefonon ndërkohë që është në shërbim dhe Halimi i përgjigjet duke iu drejtuar me fjalët "*O Din...qe te kabina se kam hyrë vetë se ka shumë punë, hajde këtu dhe pyet ku është Halimi, <u>të çoj me kry qat punën tende,</u> hajd...*". Pra rezulton qartë se ai e udhëzon të shkojë tek kabina ku ai vetë ndodhet dhe pavarësisht se nga biseda nuk rezulton se çfarë ka kërkuar saktësisht shtetasi, nga të dhënat e marra nga sistemi TIMS rezulton se ai nuk është i regjistruar në hyrje në këtë datë, ku siç rezulton nga biseda me Halimin ka hyrë për në Shqipëri dhe me ndihmën e Halimit nuk është regjistruar rregullisht në pikën hyrëse.

1006.*Së gjashti,* referuar komunikimeve telefonike të tij të datës 17.05.2021 me shtetasin e identifikuar si Gazment Thaçi, rezulton nga konteksti i bisedës së Halimi është në punë, dhe shtetasi i kërkon që ta takojë sepse siç i drejtohet "*kam një njeri për andej*", pra ka për të kaluar një shtetas në kufi. Ky shtetas i prezanton në bisedë problematikën që ka shtetasi që do të kalojë në kufi dhe i kërkon që të mundësoje kalimin e tij pa u regjistruar në sistem, dhe ndërkohe Halimi i drejtohet me fjalët "*Nejse a është punë azili a problem tjetër*", dhe me pas lenë takimin, duke iu drejtuar i pandehuri me fjalët "*Në tetë shihena, hajde me mend në krye*". Kjo ngjarje nuk rezulton të jetë verifikuar nëse ka ndodhur, por në vlerësim të gjykatës, pavarësisht se komunikimi i zhvilluar nuk përbën provë të plotë për të vërtetuar faktin, përbën indicje e cila vlerësohet në raport me provat e tjera, në drejtim të vlerësimit tërësor mbi mekanizmin dhe sjelljen e të pandehurit në raport me veprimtarinë e vazhdueshme të tij për favorizimin dhe dhënien e ndihmës së shtetasve të ndryshëm, për kalimin në kufi pa kryer procedurat e regjistrimit dhe përpunimit të rregullt. Në të njëjtin kontekst vlerësohet dhe biseda e zhvilluar mes tij dhe shtetasit Arsen Zejneli në datë 19.05.2021, ku ndër të tjera rezulton se Arseni i kërkon që të ndihmojë një të njohur të tij që do të vijë nga Kanadaja dhe duhet të kaloje kufirin pa u regjistruar pasi në Kanada është prezantuar si azilant politik. Në bisedë e sipër, Halimi i

thotë "*Halimi: Kur vjen e kështu me fol tamam shpejt e shpejt, e kuptoj, fol. Arseni: Më datë 04 qershor do me hy në Shqipëri, a e kalojmë dot? Më thuaj çfarë duhet, çfarë s'duhet edhe. Halimi: Pa problem, pa problem fare, ne për të qesim, hajde mirupafshim. Më shkruaj në whatsapp*". Edhe ky komunikim, i pashoqëruar më prova të tjera, në vlerësim të gjykatës nuk mund të vlerësohet si provë në lidhje me ndodhjen e faktit për të cilin referon konteksti i bisedës, por përbën indicje të vlerësuar nga gjykata, në drejtim të vlerësimit tërësor mbi mekanizmin dhe sjelljen e të pandehurit në raport me veprimtarinë e vazhdueshme të tij për favorizimin dhe dhënien e ndihmës së shtetasve të ndryshëm, për kalimin në kufi pa kryer procedurat e regjistrimit dhe përpunimit të rregullt.

1007.*Së shtati,* në datë 21.05.2021, rezulton se i pandehuri Halim Shehu në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Iseberi, kanë ndihmuar për të kaluar kufirin pa u regjistruar ne sistem dhe pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të verifikimit kufitar shtetasin Judmir Kashari dhe familjaret e tij (*prindërit dhe bashkëshorten*). Ky fakt rezulton tërësisht i provuar nga *(i)* përmbajtja e komunikimeve të zhvilluara mes Fatri Iseberit dhe Halim Shehut në orën 19.41 të datës 21.05.201 ku Fatriu i tregon për problemin e shtetasit Judmir Kashari dhe ndër të tjera i thotë "*Tu ardh të tuneli tashi, ti jap numrin e të të marri ty ne telefon*"; *(ii)* sipas të dhënave të komunikimeve telefonike te përgjuara, pasqyruar në procesverbalin përkatës, rezulton Pas kësaj bisede Fatriu rezulton se komunikon me shtetasin dhe i jep numrin e Halimit duke i thënë ndër te tjera "*I thuaj që jam miku i Fatriut. Mik shpie se me ka vdek axha dije, takoje, ku je tani?*"; *(iii)* pas kësaj bisede, rezulton e provuar se shtetasi Judmir Kashari telefonon Halim Shehun dhe ndër te tjera bisedojnë për problematiken që ai ka duke zhvilluar ndër te tjera këtë dialog : "*Halimi: Vetëm nusja e ka problemin? Judmiri: Jo prindërit janë se unë e kam marrë shtetësinë, po skam kalu akoma që ta kaloj kështu që ta shkel e kupton? Thashë ta lejoj vetëm për prindërit. Po me makinë jam duhet me kalu unë me makinë. Halimi: Si është problemi fol në telefon s'është problem. Judmiri : Prinderit i kam vetëm. Halimi: Janë të dy prindërit që duan të ikin andej? Judmiri: Po.Halimi: Ti vetë s'ke probleme? Judmiri: Unë vetë skam problem, mirë është që as unë mos me u shkrujt me kalu kështu siç kam kalu gjithmonë.....Halimi: Vetem kaloje uren e Kukësit nja tre km dhe ndalo diku, çfarë makine ke edhe nje here çfarë targash..Judmiri: Targa Belgjike Ford Tranzit. Halimi: Vetëm hape krahun se erdha menjëherë...*"; *(iv)* pasi zhvillojnë bisedën si më sipër, ku rezulton e qartë problematika që shtetasi ka dhe pse ka kërkuar ndihmën e Fatriut dhe më pas të Halimit, si dhe pas lënë të takohen sapo ai të mbërrije në kufi, në orën 20.31 minuta, Halim Shehu ka komunikuar sërish me këtë shtetas duke e porositur se si duhet të veprojë në sportel, duke i thënë ndër të tjera: "*Halimi: dëgjo vëllain është shumë e rëndësishme, ti mos e nxjerr dokumentin tënd, vetëm të atij nipit a ca pate të kushëririt..Judmiri: Po.Halimi: Edhe nëse nuk merresh vesh se vij unë fizikisht atje Halimi:Vetëm do ta mbash mend atje ku ndalem unë, numëroji kabinat 1.2.3 Atje ku hy unë fiksoje..Judmiri: Në rregull s'ka problem..Halimi: Edhe mbaje telefonin gati kur të thirri unë. Mbaje mend vendin se ku do të shkosh. Edhe kur të shkosh te kabina do thuash a je Shefkiu? Unë jam djali i tezes së Halimit kushëriri. Judmiri: Ok hajt.Halimi: Vëlla, vëlla dokumentin e kushëririt jo tendin, fare tëndin nuk do e nxjerrësh...Judmiri: Ok në rregull.*". Pas kësaj bisede e telefonin sërish duke i thënë

:"....*Kushëriri i Halimit jam thuaj, unë s'duhet me u regjistru thuaj fare, këtë kushëririn thuaj regjistroje.....*"; *(v)* nga të dhënat e verifikuara dhe marra nga sistemi TIMS, referuar edhe kontekstit të bisedave të zhvilluara më sipër nga të cilat rezulton qartë se shtetasi Judmir Kashari dhe bashkudhëtarët e tij (*ndër të cilët prindërit siç referon biseda mes tyre*) kanë kaluar kufirin në këtë datë, rezulton se shtetasi Judmir Kashasri nuk është regjistruar në sistem as në dalje dhe as në hyrje gjatë muajit maj të vitit 2021 kur zhvillohen ngjarjet si më sipër. *(vi)* po ashtu nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se as prindërit e tij shtetasit Besim dhe Manushaqe Kashari nuk janë të regjistruar në sistemin TIMS as në dalje as në hyrje gjatë muajit maj 2021 ndërkohe që nga bisedat rezulton e qarte se ata kanë kaluar kufirin bashkë me të birin në datën që zhvillohen komunikimet telefonike si më sipër; *(vii)* nga pyetja në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale Judmir Kashari, sipas procesverbalit të pyetjes me datë 21.05.2021, konfirmohet fakti se gjatë muajit maj 2021 shtetasi Judmir Kashari ka hyre se bashku me prindërit e tij ne kufi ne drejtim te Shqipërisë dhe po ashtu është larguar sërish pas rreth 20 ditësh siç deklaron, dhe ky kalim është bërë nga pika e kalimit kufitar Morinë. Po ashtu në deklarime te tij konfirmohet fakti se ka kaluar kufirin pa u regjistruar me ndihmën e punonjësve të policisë, duke deklaruar ndër të tjera se :" *Unë në atë pikë kalimi kufitar kam pat njohur një punonjës policie i cili quhej Fatri, te cilin e kisha njohur para shumë vitesh në Belgjikë dhe kur kaloj në kufi në P.K.K Morinë e kam takuar rastësisht duke shkëmbyer edhe numrat e telefonit. Kur kam bërë në plan për të ikur përsëri pas rreth njëzetë ditësh pasi kisha hyrë, ditën që do të ikja kam telefonuar Fatriun dhe i them se dua të kaloj në P.K.K Morinë, dhe nuk kisha dëshirë të regjistrohesha në sistem, pasi kisha hyrë pa vendosur shënime në pasaportë dhe sistem. Atë ditë po udhëtoj me automjetin tip Ford me targa Belge, "XKT177". Automjeti ka qenë i imi dhe bashkë me mua kanë qenë të dy prindërit e mi dhe një kushëriri tim i cili quhej Alban Shaholli. Fatriu kur i telefonova më thotë që jam në një vaki por do lidhesh me nje kushëririn tim duke më dhënë edhe numrin e telefonit i cili quhej Halim. Halimi më ndihmoi të kaloja tek kontrolli kufitar Kosovar pasi me sa kuptova ai kishte komunikuar më parë dhe nuk punonjësit e policisë Kosovare nuk më ushtruan asnjë kontroll. Me sa më kujtohet është regjistruar vetëm kusheriri tim Alban Shaholli ndërsa unë me prindërit e mi nuk jemi regjistruar".*

1008.*Së teti,* në datë 22.05.2021 rezulton se Halim Shehu ka ndihmuar për të kaluar kufirin ne drejtim të Kosovës shtetasin Gerdi Xhanari, në mungesë të një dokumenti të vlefshëm udhëtimi. Ky fakt provohet nga tërësia e të dhënave që rezultojnë nga *(i)* komunikimi i datës 21.05.2021 me shtetasin Gerdi Xhanari ku ky i fundit e pyet nëse mund të udhëtojë në drejtim të Kosovës ndërkohe që nuk ka dokument identifikimi pasi i ka futur për ti rinovuar ato dhe Halimi i përgjigjet "*Ligjërisht jo po kur do me dale shoqërisht e ke derën të hapur*", dhe me tej bisedojnë për kalimin e tij një ditë më pas, pra në datë 22.05.2021; *(ii)* komunikimi i zhvilluar mes Halimit dhe shtetasit Amir Onuzi mbi këtë fakt ne date 22.05.2021, pra ditën e udhëtimit, ku ndër të tjera, rezulton ky komunikim që qartëson dinamikën e ngjarjes :"*Halimi: Mirëmëngjesi Drejtor. Amiri: Tungjatjeta. Halimi: Një mësuesit të Akademisë edhe shok edhe mësues i kish kalu afati i pasaportës dhe tu ik për në Kosovë edhe ja dhashë emrin tënd edhe të dajës Ahmet, Daja Ahmet e kryen ndoshta po veç kot me e pas nëse ka nevojë. Amiri: Po në paça mundësi me dal prej këtu,*

se skam dalë prej këtu .Halimi: Jo jo s'jam tu thanë me dalë bre burrë veç i kam shkrujt mesazh i kam thënë ke Amirin dhe Ahmet Kabashin, Edhe i shkrujta dajës Ahmet, tha pa problem thjesht po të them mos u bëj bajat se je njeri i nderum. Amiri: U kry hajt."; (iii) deklarimet e shtetasit Gerti Xhanari dokumentuar në procesverbalin e pyetjes, në të cilat ai konfirmon bisedën e kryer me Halimin dhe kontekstin e saj por deklaron se ka hequr dorë na udhëtimi për të cilin ka biseduar me Halimin dhe nuk e ka kryer këtë udhëtim; *(iv)* deklarimet e shtetasit Amir Onuzi i cili konfirmon njohjen me te pandehurin Halim Shehu dhe me shtetasin Ahmet Kabashi, punonjës i policisë së Kosovës në pikën e kalimit kufitar, i cili përmendet ne bisedën e tij me Halimin, por lidhur me ngjarjen konkrete nuk jep shpjegime duke deklaruar se nuk e mban mend si fakt. *Sa më sipër*, rezulton e provuar se Haim Shehu ka ofruar dhe dhënë ndihmën dhe asistencën e tij për shtetasin Gerti Xhanari, për kalimin e kufirit në mungesë të dokumentacionit të vlefshëm të udhëtimit nga ky i fundit, pavarësisht deklarimeve të tij se ai ka hequr dorë nga ky udhëtim, por që nga komunikimet telefonike të datës 21.05.2022 dhe 22.05.2022 rezulton se qartë se ky udhëtim, dhe për pasojë edhe kalimi i kufirit pa dokumente të rregullta dhe të vlefshme, ka ndodhur.

1009.*Së nënti,* për faktet që lidhen me të pandehurin Halim Shehu, rezultojnë edhe një sërë komunikimesh të tij me disa shtetas të zhvilluara në muajin maj 2021 mbi veprimtarinë për kalimin e tapeteve në drejtim të Kosovës, kur rezulton qartë se Halimi diskuton për ta kryer ketë veprimtari duke përmendur edhe shifrat përkatëse që do të duhet ti paguhen kundrejt favorizimit të kësaj veprimtarie, por nuk rezulton te jetë vërtetuar se faktet për të cilat referojnë këto biseda të kenë ndodhur, për të mundësuar vlerësimin e tyre ne raport me elementet e veprës penale për të cilën procedohet apo të ndonjë vepre tjetër penale. Nga këto biseda, të zhvilluara në disa ditë, me një kontakt të cilit i drejtohet në komunikim me emrin "Xhevat" rezultojnë komunikime të tij të cilat krijojnë dyshim të arsyeshëm se i pandehuri Halim Shehu ka biseduar me shtetas të ndryshëm mbi aktivitetin e kalimit të mallrave (*tapete në rastin konkret*) nga Shqipëria në Kosove, duke ofruar ndihmën e tij në drejtim të favorizimit të kësaj veprimtarie, kundrejt shmangies së procedurave doganore, por nga ana tjetër hetimi në lidhje me këto fakte nuk ka vijuar për të dokumentuar nëse ky aktivitet ka ndodhur në të ardhmen (*pas bisedave*) dhe nëse në këtë aktivitet i pandehuri Halim Shehu ka kryer veprime apo mosveprime të kundërshtim me ligjin. Përveç bisedave telefonike të përgjuara, është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale edhe bashkëbiseduesi i tij i identifikuar si shtetasi Xhevat Muja, i cili lidhur me këto fakte, ka deklaruar se: "*Unë Halim Shehun e kam kunat pasi ka marrë motrën time për nuse..... Unë me shtetasin Odise Cërriku që e thërrasin shkurt Odi jam takuar dhe njohur në panair në Stamboll së bashku me Besim Murturi, shtetas kosovar dhe jeton në Prishtine, ndërsa Odi jeton në Elbasan dhe ka një dyqan që shet tapeta dhe perde. Edhe unë vete kam një dyqan në Kukës dhe merrem duke shitur perde dhe rrugica. Për sa i përket bisedës së kryer unë e kam telefonuar Halimin dhe sepse e kam pyetur sesi mund ta bëjmë për ta ndihmuar pasi Odi me kishte thënë se Odit i kishte ardhur një pjesë malli nga Stambolli në Elbasan dhe një pjesë prej 200 e ca kg duhet të çohej në Kosovë tek Besi dhe unë e kam pyetur Halimin se si mund t'ia bënin për ta ndihmuar. Me sa mbaj mend unë kjo punë nuk është kryer, pasi Halimi më tha që*

nuk bëhet. Jo nuk kam bërë pazar për dhënie ryshfeti, unë vetëm ju kam thënë që do ta pyes kunatin për në dogane si mund ta bëjmë që ti ndihmojmë...". Sa më sipër, rezulton se komunikimet telefonike të referuara nga Prokuroria në faktin objekt akuze, ndaj të pandehurit Halim Shehu, lidhur me aktivitetin e kalimit të këtyre mallrave në pikën e kalimit kufitar, në vlerësim të gjykatës nuk kalon kufirin e dyshimit të arsyeshëm mbi një aktivitet të mundshëm për të ndodhur, në raport me kohen kur janë zhvilluar komunikimet, por që nuk provohet se ka ndodhur realisht, duke mos u vërtetuar kështu dy nga elementet thelbësore dhe të qenësishëm të anës objektive të veprës penale që lidhen me përcaktimin e vendit dhe kohës. Pa u përcaktuar këto dy elemente vete ndodhja e faktit mbetet e dyshimtë, dhe për pasojë nuk mund të vlerësohet në drejtim të fakteve të provuara objekt akuze në lidhje me këtë të pandehur.

1010.*Sa më sipër,* gjykata vlerëson se rezultoi e provuar se i pandehuri Halim Shehu, gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i policisë kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, në disa episode të ndodhura në vitin 2020 dhe 2021, dy prej të cilave në bashkëpunim më të pandehurin tjetër Fatri Iseberi, ka asistuar dhe ndihmuar shtetas të ndryshëm për të kaluar kufirin me Kosovën, si në hyrje ashtu edhe në dalje, pa u regjistruar në sistemin TIMS dhe pa iu nënshtruar procedurave të rregullta të përpunimit të shtetasve në kufirin hyrës dhe dalës të Republikës së Shqipërisë. Në këto veprime dhe mosveprime të tij konkretizohet dhe provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm jo vetëm mos përmbushja e rregullt e detyrës prej tij në cilësinë e "*rojës kufitare*" në kuptim të nenit 2, pika 565 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", por provohet se ia ka kryer veprime aktive të kundërligjshme për të mundësuar kalimin e shtetasve në kufirin shtetërore (në drejtimin hyrës dhe dalës) ndërkohë që është në dijeni të problematikes që shtetasit kanë për kalimin e kufirit në drejtim të mungesës së dokumentacionit apo nevojës së tyre për të mos iu nënshtruar kontrollit dhe verifikimi kufitar ashtu sikurse normon ligji dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

1011. Kjo veprimtari e të pandehurit Halim Shehu, në drejtim të veprimeve dhe mosveprimeve që konkretizojnë elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet, analizuar më sipër në këtë vendim, bie ndesh me ushtrimin e rregullt të detyrës së tij dhe konkretisht me parashikimet e nenit nenin 17, pika 1, shkronjat ë), f) dhe i) të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" i ndryshuar në të cilin parashikohet se:" *1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë: .....ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë; ....i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.".* Në lidhje me detyrat konkrete në drejtim të përpunimit të shtetasve që kalojnë kufirin, si në drejtimin hyrës ashtu edhe në atë dalës të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, në nenin 5, pika 2 të të cilit përcaktohet si autoriteti përgjegjës

---

[65] *Në nenin 2, pika 5 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, parashikohet se :" 5. "Roja kufitare" është çdo punonjës i Policisë Kufitare dhe të Migracionit, i caktuar në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror për të kryer detyra të kontrollit kufitar në përputhje me këtë ligj.".*

për kontrollin kufitar pikërisht kjo strukture, pjesë e së cilës është edhe i pandehuri Halim Shehu, duke parashikuar në mënyrë të shprehur se :" *2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*", ndërkohë që në nenin 6[66] dhe 7[67] të ligjit përcaktohen qartësisht kompetencat e policisë kufitare në kufi dhe brenda territorit, ku në lidhje me përpunimin e shtetasve në pikën 1 dhe 3 të nenit 6 përcaktohet shprehimisht se :" *1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda... 3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar: a) të verifikojnë: i) origjinalitetin e dokumenteve të*

---

[66] *Në nenin 6 të ligjit nr. 71/2016, parashikohet se :" 1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen. 2. Rojat kufitare, në kuadër të verifikimit kufitar, duhet t'u japin nëpunësve të doganave apo nëpunësve të çdo autoriteti tjetër përgjegjës që operon në kufirin shtetëror mundësinë e kryerjes së verifikimeve të përbashkëta me ta, kur këta janë të pranishëm gjatë verifikimit kufitar. Rregullat për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar: a) të verifikojnë: i) origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit; ii) në rast dyshimi të arsyeshëm, identitetin e mbajtësit të dokumenteve të udhëtimit ose vizës, duke krahasuar identifikuesit biometrikë të depozituar në çdo bazë të dhënash, përveç ADN-së, me personin që po verifikohet; b) të sekuestrojnë dokumente udhëtimi, të cilat kanë tregues që justifikojnë dyshimin se: i) dokumenti i udhëtimit ose viza te dokumenti i udhëtimit është e falsifikuar ose e rremë; ii) janë përdorur për të siguruar informacion të rremë për një person. Nëse vërtetohet se një dokument i sekuestruar nuk është objekt i ndonjë mase të parashikuar nga Kodi Penal, u dorëzohet autoriteteve kompetente, për aq kohë sa është i nevojshëm sekuestrimi dhe, më pas, i kthehet personit ose shtetit që ka lëshuar dokumentin. 4. Rojat kufitare, për arsye të kontrollit të qarkullimit kufitar dhe për të kryer kontrollin kufitar, kanë të drejtë të hyjnë në çdo ngastër toke dhe në të gjithë ujërat, si dhe të drejtojnë automjetet në çdo rrugë, për sa kohë kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre. 5. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt. 6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë, gjithashtu, të drejtën t'u refuzojnë daljen personave: a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi; b) për të cilët ka një urdhër gjykate që ndalon daljen nga Republika e Shqipërisë; c) që duan t'i fshihen ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit apo ekzekutimit të dënimit me burgim; ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë, ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur, ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale; d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën "ç" të kësaj pike; dh) të cilët, gjatë daljes nga Republika e Shqipërisë, përdorin dokumentin e një personi tjetër ose dokument të falsifikuar; e) të cilët janë të regjistruar në dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër dhe, gjatë daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, nuk janë të shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit janë regjistruar. 7. Rojat kufitare kanë të drejtë të zbatojnë me forcë masat e përmendura në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni.".*

[67] *Në nenin 7 të po këtij ligji parashikohet se :" 1. Policia e Kufirit dhe e Migracionit ka të drejtë që, në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë, të marrë masa për të zbuluar të huajt që qëndrojnë ose që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme, si dhe të parandalojë, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkufitar. 2. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të verifikojë dhe të intervistojë persona, të verifikojë sende dhe mjete transporti, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim ndalimin e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit të paligjshëm të të huajve në Republikën e Shqipërisë. 3. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka, gjithashtu, të drejtë të ndërmarrë veprime hetimore dhe procedurale në rastet e veprave penale që lidhen me kufirin, përveç atyre veprave që janë përcaktuar të ndiqen posaçërisht nga struktura të tjera të Policisë ose agjenci të tjera.".*

udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit;.. ".

1012. Po ashtu, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, gjejnë zbatim një sërë aktesh nënligjore që normojnë punën e punonjësve të strukturës së policisë kufitare dhe posaçërisht atyre që ushtrojnë funksionon në Pikat e Kalimit Kufitar dhe Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar të cilat detajojnë procedurat standarde që zbatohen prej tyre gjatë kontrollit dhe verifikimit kufitar[68]. Referuar kuadrit ligjor si më sipër, në raport me faktet që provojnë veprimet konkrete të të pandehurit Halim Shehu, rezulton se ai ka kryer veprime aktive të kundërligjshme, duke i dhënë ndihme dhe asistencë konkrete shtetasve të ndryshëm, në disa episode sikurse është analizuar më sipër në këtë vendim, për të kaluar kufirin duke shmangur kontrollin dhe verifikimin e rregullt kufitar sipas ligjit ose duke mundësuar kalimin e tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vlefshëm, në kundërshtim të hapur me detyrën e tij funksionale si punonjës i policisë kufitare dhe "rojës kufitare" në kuptim të ligjit të posaçëm nr. 71/2016, i ngarkuar drejtpërdrejt nga ky ligj me detyrën për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, pjesë e së cilit është edhe regjimi i kalimit dhe përpunimit të rregullt dhe ligjor te shtetasve që kalojnë kufirin si në hyrje ashtu edhe në dalje të Republikës së Shqipërisë.

1013. Lidhur me procedurat e kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë me Kosovën, në kohën që janë zhvilluar ngjarjet objekt i këtij procedimi, rezulton se në ketë kohë zbatohej edhe marrëveshja e përbashkët ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "*Për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar*", ratifikuar me ligjin nr. 24, datë 18.04.2019. Në këtë marrëveshje, në nenin 5[69] parashikohen rregulla të përbashkëta për kontrollet kufitare në hyrje dhe në dalje, ndërsa në nenin 1, nën titullin "*Përkufizime*", ndër të tjera, në pikat 2, 3, 4, 5,

---

[68] *Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 71/2016 janë miratuar edhe një sërë aktesh të tjera nënligjore te referuara më sipër në këtë vendim.*

[69] *Në nenin 5 të marrëveshjes, nën titullin "Kontrollet kufitare në hyrje – dalje", parashikohet se :" 1. Shtetasit, automjetet dhe mallrat, të cilët hyjnë dhe/ose dalin nga territori i Palëve, u nënshtrohen kontrolleve të përbashkëta nga autoritetet përkatëse përgjegjëse vetëm një herë, bazuar në parimin "një ndalesë një kontroll", në hyrje dhe dalje njëri pas tjetrit, sipas legjislacionit kombëtar të secilës palë dhe në përputhje me këtë marrëveshje, në vendet e caktuara për këtë qëllim. 2. Pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në dalje, oficerët/nëpunësit e shtetit të daljes nuk janë më të autorizuar të kryejnë veprime të lidhura me kalimin e kufirit. Sidoqoftë, nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në hyrje ka dyshime për vepra penale ose nëse konstatohet se një person, i cili duhet arrestuar ndodhet në zonë, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes. 3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi i kontrollit me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta. 4. Personat të cilët refuzohen nga oficerët /punonjësit e shtetit të hyrjes, nuk mund të refuzohen të kthehen në shtetin e daljes/origjinës. 5. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes. 6. Të ardhurat e mbledhura nga oficerët e shtetit fqinj në formën e tarifave zyrtare për qëllime të procedurave të kalimit të kufirit në shtetin territorial, kthehen në vendet e tyre respektive dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit. Të hollat dhe letrat me vlerë të sekuestruara nga nëpunësit e secilës nga palët gjatë kryerjes së kontrollit doganor, si dhe mallrat ose mjetet e sekuestruara duhet të trajtohen sipas legjislacionit të palës konstatuese dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit. 7. Gjatë zbatimit të masave të përmendura në paragrafët 4–6, nëpunësit e Palëve informojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën. ".*

6 dhe 8 përkufizohen termat e përbashkëta për verifikimin kufitar, vendin e hyrjes, vendin e daljes, zonën e përbashkët të kalimit kufitar, nëpunësit përgjegjës si dhe sanksionohet parimi "një ndalesë një kontroll"[70]. Sipas kësaj marrëveshje të përbashkët, shtetasit do të përpunohen në dalje nga punonjësit e PKK të Kosovës ndërsa në hyrje nga punonjësit e PKK të Shqipërisë, por ajo çka duhet theksuar është se kjo marrëveshje nuk shmang detyrimin ligjor të rojave kufitare të dy vendeve për të ushtruar detyrën e tyre në rast se konstatojnë situata apo fakte që mund të cenojnë legjislacionin përkatës te tyre, në lidhje me kontrollin kufitar, nëse shtetasit janë në pikën dalëve të secilit shtet, duke shmangur në këtë mënyrë tërësisht kontrollin e çdo shteti palë mbi kufirin e tij në drejtimin dalës. Nga përmbajtja e marrëveshjes, në nenin 1, pika 8 të saj, parimi "një ndalesë një kontroll" përkufizohet si vijon: "*Parimi "një ndalesë një kontroll" – verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat.*", duke mos nënkuptuar se ky parim pas sjell mos kryerjen e asnjë procedure apo kontrolli ose verifikimi, posaçërisht ne rastet me risk (pra kur ka dyshime për kundërligjshmëri) të rojeve kufitare në pikën dalëse të shtetit respektiv palë të marrëveshjes. Për me tepër, vetë marrëveshja në fjalë referon detyrimin për zbatimin e legjislacionit të secilit shtet palë në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin kufitar, duke përcaktuar shprehimisht në nenin 4 të saj se :"*Të gjitha aktet nënligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-së do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës palë kontraktuese. 2. Veprimtaritë e kryera në ZPPKK nga nëpunësit e shtetit fqinj, kryhen në përputhje me legjislacionin e këtij shteti dhe do të konsiderohen si të kryera në territorin e këtij shteti...*".

1014.*Sa më sipër*, gjykata vlerëson se, zbatimi i kësaj marrëveshje të përbashkët mes shteteve, nuk mund të përligjë mos ushtrimin në mënyrë të rregullt të detyrës nga punonjësit e policisë kufitare të Republikës së Shqipërisë, gjatë procedurave të daljes së shtetasve në kufi. Për më tepër në rastin konkret, vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri Halim Shehu, nuk rezulton të jete kryer nëpërmjet mosveprimit të tij, por është konkretizuar me veprime aktive të kundërligjshme për të mundësuar kalimin e parregullt të shtetasve në kufi, qoftë ai hyrës ose dalës, dhe për pasojë, pavarësisht se cili prej punonjësve të tjerë, në pikën hyrëse apo dalëve në momentin që ka ndodhur ngjarja, ka qenë në cilësinë e kontrollorit, kjo nuk përjashton nga

---

[70] *Në nenin 1 të marrëveshjes parashikohet se :" Për qëllime të kësaj marrëveshjeje: "Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar" – pika e autorizuar për kalimin e kufirit, ku autoritetet e Palëve ushtrojnë verifikime të përbashkëta kufitare. 2. "Verifikimi kufitar" – kontrolli i kryer në PPKK, në mënyrë që personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat të plotësojnë kushtet për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve. 3. Vendi i hyrjes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në hyrje. 4. Vendi i daljes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në dalje. 5. Zona e pikës së përbashkët të kalimit kufitar, këtej e tutje ZPPKK – zona e përcaktuar sipas legjislacionit të vendit pritës, ku nëpunësit e të dy palëve janë të autorizuara të kryejnë verifikimin kufitar, sipas kompetencave. 6. Nëpunës – janë personat të cilët kryejnë detyrat e tyre si përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për kontrollin kufitar, si edhe ata përgjegjës për mbikëqyrjen e shërbimeve të autorizuara nga secila Palë Kontraktuese. 7. Mallrat – mallrat, mjetet e transportit dhe vlerat materiale që u nënshtrohen rregullave doganore. 8. Parimi "një ndalesë një kontroll" – verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat. 9. "Vendi pritës" – pala në territorin e së cilës ngrihet PPKK-ja dhe kryhen verifikimi kufitar nga nëpunësit e palëve.".*

përgjegjësia vetë të pandehurin, i cili mbart të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mbajtjen prej tij të pozicionit të *rojës kufitare* ne kuptim të ligjit nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore te dala në bazë dhe për zbatim të tij.

1015. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, lidhur me ngjarjet e datave 24.01.2021 dhe 21.05.2021, gjykata vlerëson se nga dinamika e zhvillimit të tyre dhe të dhënat që ofrojnë provat mbi të cilat mbështetet provueshmëria e këtyre fakteve, rezulton e provuar se i pandehuri Halim Shehu në dy këto episode ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Iseberi. Veprimet aktive të kundërligjshme të tyre, në ngjarjet që referojnë në këto dy momente kohore, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Halim Shehu.

1016. Në drejtim të vlerësimit të elementeve të bashkëpunimit, veç sa më sipër, gjykata mban në konsideratë edhe faktin se gjatë kryerjes së një vepre penale në bashkëpunim, nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëpunëtoret të veprojnë të gjithë së bashku dhe të kryejnë të njëjtat veprime konkrete në drejtim të realizimit të veprës penale pasi sipas roleve përkatëse, veprimet e tyre mund te jenë edhe komplementare, por të nevojshme për arritjen e qëllimit final. Pra jo gjithmonë, të gjithë personat që veprojnë në bashkëpunim më njeri tjetrin, do te shfaqen së bashku, në të njëjtën kohë, duke vepruar për kryerjen e çdo veprimi në funksion të realizimit të veprës. E rëndësishme në vlerësimin mbi prezencën e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, që dëshmon ndër të tjera, edhe elementët e bashkëpunimit, është evidentimi dhe provueshmëria e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në veprime të përbashkëta ose komplementare, në funksion të realizimit të të njëjtit qëllim.

1017. *Në drejtim të anës subjektive*, nga tërësia e provave të administruara dhe vlerësuara, të cilat dëshmojnë veprimet konkrete të kundërligjshme të kryera nga i pandehuri Halim Shehu, në referim të parashikimeve të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret rezulton e provuar se i pandehuri Halim Shehu, ka vepruar me dashje direkte, pasi ai ka pasur dijeni të plotë se veprimet dhe mosveprimet konkrete të kryera prej tij përbejnë jo vetëm mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij por edhe sjellje të kundërligjshme dhe të dënueshme. Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale të *"Shpërdorimit të detyrës"*, kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë. Në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin konkret dashja e drejtpërdrejtë evidentohet në këto tre aspekte: (i) dijenia nga ana e të pandehurit që veprimet ose mosveprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës; (ii) dëshira e të pandehurit për t'i kryer këto veprime ose mosveprime dhe (iii) kryerja e veprimeve ose mosveprimeve nga i pandehuri me qëllim realizimin e përfitimeve materiale ose jo materiale të padrejta, për vete ose për të tjerë, ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

1018.Në rastin konkret, nga dinamika e provuar e veprimeve aktive të kundërligjshme të të pandehurit Halim Shehu, me anë të së cilave është materializuar ana objektive e veprës penale për të cilën ai akuzohet rezulton qartësisht e provuar se (i) ai ka pasur dijeni të plotë se veprimet e tij bien në kundërshtim me ligjin, dijeni kjo e cila rezulton e qartë nga detyra që ai mban, arsimimi, kohëzgjatja e kryerjes së detyrës që prezumon edhe njohjen e mire dhe te plote te kuadrit ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm, si dhe detyrimi ligjor që çdo punonjës ka për të pasur dijeni mb I detyrën funksionale të tij dhe parametrat e kryerjes së saj brenda kufijve të ligjit dhe në shërbim të interesit publik; (ii) rezulton se ai i ka kryer veprimet aktive te kundërligjshme me dëshirë dhe vullnet tërësisht të lire dhe të pavesuar si dhe (iii) rezulton i qartë qëllimi i kryerjes së tyre, në funksion të favorizimit të shtetasve për të kaluar kufirin pa u regjistruar apo në mungesë të dokumenteve të nevojshme dhe pa kryer procedurat e rregullta te përpunimit dhe kontrollit kufitar, qëllim i cili përveçse realizohet duke përmbushur interesat e këtyre te fundit, njëherësh dëmton interesat e ligjshme të shtetit.

1019.*Sa më sipër*, gjykata konkludon se i pandehuri Halim Shehu, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ka parashikuar karakterin e dënueshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke kryer veprime në kundërshtim me ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë dhe detyrën funksionale të tij, duke dëmtuar kështu interesat e ligjshme të shtetit dhe duke sjellë përfitime të padrejta për të tretë.

1020. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Halim Shehu ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

1021. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurit në rastin konkret, gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te

veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Halim Shehu, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

1022.*Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Halim Shehu**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Shpërdorimi i detyrës*" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Fatri Iseberi, në faktin penal të ndodhur në datat 24.01.2021 dhe 21.05.2021, ndërkohe që rezulton se ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të analizuar më sipër në këtë vendim.

Lidhur me akuzën ndaj të pandehurit FATRI ISEBERI

1023.Lidhur me të pandehurin **Fatri Iseberi**, gjykata vlerëson se, nga analiza e provave të referuara më sipër në këtë vendim, të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 25 të Kodit Penal, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në PKK Morinë si punonjës i policisë kufitare, në disa episode të zhvilluara gjatë vitit 2020 dhe 2021, në drejtim të (i) favorizimit dhe ndihmës së dhënë shtetasve për të kaluar kufirin shtetëror, në hyrje dhe në dalje të tij, pa kryer procedurat e rregullta të përpunimit të shtetasve në kufi, dhe në disa prej episodeve të faktit penal, rezulton se ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurit tjetër Halim Shehu si dhe (ii) të dhënie së informacioneve dhe ndihmës konkrete për shtetasit që kryejnë veprimtarinë e kalimit të mallrave në pikën e kalimit kufitar ku ai ushtonte funksionin e tij, në drejtim të Shqipërisë, në mënyrë të kundërligjshme, duke shmangur procedurat e rregullta të kontrollit kufitar të mallrave dhe kontrollin doganor të tyre. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë se K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve vetëm kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë, saktësisë dhe përputhshmërisë me njëra-tjetrën. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata çmon se, i pandehuri Fatri Iseberi, i vetëm në disa raste dhe në bashkëpunim me të pandehurin Halim Shehu në disa të tjera, ka shpërdoruar detyrën duke ndihmuar/favorizuar shtetas të ndryshëm që, pa kryer procedurat e rregullta të përpunimit dhe verifikimit kufitar, të kalojnë

kufirin shtetëror në PKK Morinë dhe po ashtu, ka shpërdoruar detyrën duke favorizuar dhe mbështetur veprimtarinë e shtetasve të tjerë, ndër të cilët edhe vëllai i tij Ardian Iseberi, për kalimin e mallrave në mënyrë të kundërligjshme në kufi. Arrihet ky konkluzion pasi:

1024.*Së pari*, rezulton se provuar se në bashkëpunim me të pandehurin Halim Shehu dhe duke kryer pikërisht atë çka i është kërkuar prej tij, ka ndihmuar dhe asistuar shtetasin Fatmir Allaraj për të kaluar kufirin, në hyrje dhe në dalje të, pa u regjistruar ai dhe djali i tij Bledar Allaraj, ky i fundit për shkak të statusit të azilantit politik që kishte në vendin ku jetonte, arsye për të cilën nuk duhet të regjistrohej në kufi, ndërsa për vetë Fatmirin nuk rezultojnë arsye, por rezulton qartësisht se ai ka kaluar kufirin si në dalje dhe në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e rregullta dhe ligjore te regjistrimit dhe përpunimit në kufi, me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu dhe të pandehurit Fatri Iseberi. Konkretisht nga provat që referojnë në ngjarjen e datës 24.01.2021, rezulton se ndihma që Halimi i ofron për të kaluar kufirin pa u regjistruar Fatmir Allarajt dhe personave që udhëtojnë me të, për shkak se ai siç referon në biseda nuk ndodhet në pikën e kalimit kufitar, është realizuar me ndihmën dhe bashkëpunimin e të pandehurit Fatri Iseberi, pasi vetë Halimi në bisede i thotë shtetasit Fatmir Allaraj se do të dalë ta presë Fatriu. Në këtë episod rezulton se provuar se Halimi, me bashkëpunimin e kolegut të tij Fatri Iseberi, ka asistuar dhe ndihmuar shtetasin Fatmir Allaraj dhe djalin e tij Bledar Allaraj të kalojnë kufirin pa u regjistruar, në kundërshtim me ligjin, por nuk rezulton e provuar që në këmbim të këtij favori të jenë kërkuar, marrë apo pranuar para apo përfitime të tjera të kundërligjshme prej tij apo kolegut të tij. Ky fakt, kalimi në mënyrë të kundërligjshme dhe pa iu nënshtruar procedurave të rregullta të përpunimit dhe regjistrimit të shtetasve në kufi, në ngjarjen e datës 24.01.2021, me ndihmën e të pandehurit Halim Shehu në bashkëpunim me kolegun e tij Fatri Iseberi, rezulton i provuar nga *: (i)* përmbajtja e komunikimeve telefonike te zhvilluara mes tij dhe shtetasit Fatmir Allaraj dhe djalit të tij me të pandehurin Halim Shehu, të zhvilluara në datë 24.01.2021*; (ii)* nga të dhënat e verifikuara dhe të marra nga sistemi TIMS administruar nëpërmjet procesverbalit përkatës, nga të cilat rezulton se qëllimi për të cilin ky komunikim zhvillohet, pra kalimi në kufi pa kryer procedurën e rregullt të kalimit dhe regjistrimit të shtetasit Fatmir Allaraj dhe Bledar Allaraj ka ndodhur pasi për këta dy shtetas nuk rezulton regjistrim i hyrje daljeve në kufi përkatësisht prej vitit 2019 për Fatmirin dhe prej vitit 2013 për Bledarin; *(iii)* nga deklarimet e vetë shtetasit Fatmir Allaraj i cili i pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale pranon komunikimet me të pandehurin dhe faktin se është ndihmuar dhe asistuar prej tij për të kaluar kufirin, disa herë, ndër të cilat edhe episodi në fjalë, pa u regjistruar ai dhe djali i tij Bledar Allaraj në kufi, ky i fundit për shkak të statusit të azilantit politik që kishte në vendin ku jetonte, arsye për të cilën nuk duhet të regjistrohej në kufi, ndërsa për vetë Fatmitin nuk rezultojnë arsye, por rezulton qartësisht se ai ka kaluar kufirin si në dalje dhe më pas në hyrje të R.Sh, pa kryer procedurat e rregullta dhe ligjore te regjistrimit dhe përpunimit në kufi, me ndihmën dhe asistencën e të pandehurit Halim Shehu i cili në këtë rast ka vepruar se bashku me të pandehurin Fatri Iseberi, pavarësisht se nuk rezultojnë të jenë dokumentuar komunikime të drejtpërdrejta të këtij të fundit mbi ngjarjet e kësaj date.

1025.*Së dyti,* në datë 21.05.2021, rezulton se i pandehuri Fatri Iseberi në bashkëpunim me të pandehurin Halim Shehu, kanë ndihmuar për të kaluar kufirin pa u regjistruar ne sistem dhe pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të verifikimit kufitar shtetasin Judmir Kashari dhe familjaret e tij (*prindërit dhe bashkëshorten*). Ky fakt rezulton tërësisht i provuar nga *(i)* përmbajtja e komunikimeve të zhvilluara mes Fatri Iseberit dhe Halim Shehut në orën 19.41 të datës 21.05.201 ku Fatriu i tregon për problemin e shtetasit Judmir Kashari dhe ndër të tjera i thotë "*Tu ardh të tuneli tashi, ti jap numrin e të të marri ty ne telefon*"; *(ii)* sipas të dhënave të komunikimeve telefonike te përgjuara, pasqyruar në procesverbalin përkatës, rezulton Pas kësaj bisede Fatriu rezulton se komunikon me shtetasin dhe i jep numrin e Halimit duke i thënë ndër te tjera "*I thuaj që jam miku i Fatriut. Mik shpie se me ka vdek axha dije, takoje, ku je tani?*"; *(iii)* pas kësaj bisede, rezulton e provuar se shtetasi Judmir Kashari telefonon Halim Shehun dhe ndër te tjera bisedojnë për problematiken që ai ka duke zhvilluar ndër te tjera këtë dialog : "*Halimi: Vetëm nusja e ka problemin? Judmiri: Jo prindërit janë se unë e kam marrë shtetësinë, po skam kalu akoma që ta kaloj kështu që ta shkel e kupton? Thashë ta lejoj vetëm për prindërit. Po me makinë jam duhet me kalu unë me makinë. Halimi: Si është problemi fol në telefon s'është problem. Judmiri : Prinderit i kam vetëm. Halimi: Janë të dy prindërit që duan të ikin andej? Judmiri: Po.Halimi: Ti vetë s'ke probleme? Judmiri: Unë vetë skam problem, mirë është që as unë mos me u shkrujt me kalu kështu sic kam kalu gjithmonë....Halimi: Vetem kaloje uren e Kukësit nja tre km dhe ndalo diku, cfare makine ke edhe nje here çfare targash..Judmiri: Targa Belgjike Ford Tranzit. Halimi: Vetem hape krahun se erdha menjëherë...*"; *(iv)* pasi zhvillojnë bisedën si më sipër, ku rezulton e qartë problematika që shtetasi ka dhe pse ka kërkuar ndihmën e Fatriut dhe më pas të Halimit, si dhe pas lënë të takohen sapo ai të mbërrije në kufi, në orën 20.31 minuta, Halim Shehu ka komunikuar sërish me këtë shtetas duke e porositur se si duhet të veprojë në sportel, duke i thënë ndër të tjera: "*Halimi: dëgjo vëllain është shumë e rëndësishme, ti mos e nxjerr dokumentin tënd, vetëm të atij nipit a ca pate të kushëririt..Judmiri: Po.Halimi: Edhe nëse nuk merresh vesh se vij unë fizikisht atje Halimi:Vetëm do ta mbash mend atje ku ndalem unë, numëroji kabinat 1.2.3 Atje ku hy unë fiksoje..Judmiri: Në rregull s'ka problem..Halimi: Edhe mbaje telefonin gati kur të thirri unë. Mbaje mend vendin se ku do të shkosh. Edhe kur të shkosh te kabina do thuash a je Shefkiu? Unë jam djali i tezes së Halimit kushëriri. Judmiri: Ok hajt.Halimi: Vëlla, vëlla dokumentin e kushëririt jo tendin, fare tëndin nuk do e nxjerrësh...Judmiri: Ok në rregull.*". Pas kësaj bisede e telefonin sërish duke i thënë :"*....Kushëriri i Halimit jam thuaj, unë s'duhet me u regjistru thuaj fare, këtë kushëririn thuaj regjistroje.....*"; *(v)* nga të dhënat e verifikuara dhe marra nga sistemi TIMS, referuar edhe kontekstit të bisedave të zhvilluara më sipër nga të cilat rezulton qartë se shtetasi Judmir Kashari dhe bashkudhëtarët e tij (*ndër të cilët prindërit siç referon biseda mes tyre*) kanë kaluar kufirin në këtë datë, rezulton se shtetasi Judmir Kashasri nuk është regjistruar në sistem as në dalje dhe as në hyrje gjatë muajit maj të vitit 2021 kur zhvillohen ngjarjet si më sipër. *(vi)* po ashtu nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se as prindërit e tij shtetasit Besim dhe Manushaqe Kashari nuk janë të regjistruar në sistemin TIMS as në dalje as në hyrje gjatë muajit maj 2021 ndërkohe që nga bisedat rezulton e qarte se ata kanë kaluar kufirin bashkë me të birin në datën që zhvillohen

komunikimet telefonike si më sipër; *(vii)* nga pyetja në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale Judmir Kashari, sipas procesverbalit të pyetjes me datë 21.05.2021, konfirmohet fakti se gjatë muajit maj 2021 shtetasi Judmir Kashari ka hyre se bashku me prindërit e tij ne kufi ne drejtim te Shqipërisë dhe po ashtu është larguar sërish pas rreth 20 ditësh siç deklaron, dhe ky kalim është bërë nga pika e kalimit kufitar Morinë. Po ashtu në deklarime te tij konfirmohet fakti se ka kaluar kufirin pa u regjistruar me ndihmën e punonjësve të policisë, duke deklaruar ndër të tjera se :" *Unë në atë pikë kalimi kufitar kam pat njohur një punonjës policie i cili quhej Fatri, te cilin e kisha njohur para shumë vitesh në Belgjikë dhe kur kaloj në kufi në P.K.K Morinë e kam takuar rastësisht duke shkëmbyer edhe numrat e telefonit. Kur kam bërë në plan për të ikur përsëri pas rreth njëzetë ditësh pasi kisha hyrë, ditën që do të ikja kam telefonuar Fatriun dhe i them se dua të kaloj në P.K.K Morinë, dhe nuk kisha dëshirë të regjistrohesha në sistem, pasi kisha hyrë pa vendosur shënime në pasaportë dhe sistem. Atë ditë po udhëtoj me automjetin tip Ford me targa Belge, "XKT177". Automjeti ka qenë i imi dhe bashkë me mua kanë qenë të dy prindërit e mi dhe një kushëriri tim i cili quhej Alban Shaholli. Fatriu kur i telefonova më thotë që jam në një vaki por do lidhesh me nje kushëririn tim duke më dhënë edhe numrin e telefonit i cili quhej Halim. Halimi më ndihmoi të kaloja tek kontrolli kufitar Kosovar pasi me sa kuptova ai kishte komunikuar më parë dhe nuk punonjësit e policisë Kosovare nuk më ushtruan asnjë kontroll. Me sa më kujtohet është regjistruar vetëm kusheriri tim Alban Shaholli ndërsa unë me prindërit e mi nuk jemi regjistruar".*

1026.*Së treti,* nga përgjimi i komunikimeve të zhvilluara nga i pandehuri Fatri Iseberi me shtetasin Ardian Çali (Iseberi) i cili është vëllai i tij, si dhe midis këtij të fundit me shtetasit Robert Saraçi, Rasim Spada dhe persona të tjerë të cilët ka rezultuar se merren me veprimtarinë e transportimit të gomave të përdorura nga Kosova për në Shqipëri, për llogari të shtetasit Robert Saraçi i cili ka një servis në qytetin e Dibrës, në të cilin i shet gomat, rezultojnë të dhëna se në dhjetor 2020 dhe me pas gjatë vitit 2021, shtetasi Ardian Çali dhe personat e tjerë të angazhuar në këtë veprimtari, kanë kryer shumë herë transport të gomave në drejtim të Shqipërisë, duke kaluar në kufi, veprimtari për të cilën është në dijeni i pandehuri Fatri Iseberi i cili rezulton se herë pas here i jep informacion vëllait të tij mbi punonjësit që janë në shërbim, mbi oraret në të cilat duhet të kalojë apo dhe mbi mënyrën se di duhet të veprojë për të zhvilluar këtë veprimtari.

1027.Rezulton e provuar, nga tërësia e komunikimeve të zhvilluara mes tyre, se i pandehuri Fatri Iseberi jo vetëm që është në dijeni mbi veprimtarinë e kalimit të kundërligjshëm të sendeve (*në këtë rast gomave të përdorura*) në kufi nga vëllai i tij por edhe nga personat e tjerë që punojnë së bashku e të dhe me shtetasin Robert Saraçi, me të cilin rezulton se vete Fatriu komunikon herë pas here gjatë kësaj kohe, por në disa raste, në komunikimet me vëllain e tij duket se i jep atyre informacionet e nevojshme lidhur me kohën dhe mënyrën se kur dhe si duhet të veprojnë për të kaluar në kufi me qëllim që të mos ndalohen ne kryerjen e këtij aktiviteti të kundërligjshëm.

1028.Në një rast rezulton se ai vetë ka qenë në sportel, duke kryer shërbimin si kontrollor, ndërkohë që kalon shtetasi Rasim Spada, person i cili ka rezultuar e provuar se bashkëpunon me Ardian Iseberi në këtë veprimtari kundërligjshme. Konkretisht, në bisedën e zhvilluar mes Ardianit dhe Rasimit në datë 26.12.2020, rezulton se gjatë kalimit në kufi të Rasimit me gomat

që ka sjellë, ka qenë në shërbim Fatri Iseberi i cili, sipas bisedës rezulton se e ka pyetur dhe është vënë në dijeni se ai kishte goma në makinë, dhe ka lejuar kalimin e tij pasi Rasimi në bisedë e sipër i është përgjigjur se *ka goma dhe janë të vëllait të tij* (pra të Ardianit).

1029.Po ashtu, në tërësinë e bisedave të cilat tregojnë qartë angazhimin e tij për të lehtësuar këtë veprimtari të kryer nga vëllai i tij dhe personat që bashkëpunojnë me të, zhvillohet edhe komunikimi i datës 27.12.2020 nga konteksti i të cilit, parë se bashku e komunikimet e tjera të zhvilluara në këtë datë, Fatriu i thotë që të kalojë para se ai të lërë shërbimin dhe ndër të tjera, zhvillojnë me sms këtë komunikim :" *Ardian Iseberi: "M'thirri ai flokshi mja kalue nja 2 goma kamioni a te vij tja kaloj me makij te atij renxhroverin se makina ime si zen." F.Iseberi: "hajde".Ardiani: "Ok";* Fatriu*: "te 4 jam aty ku hyn ka 2"; Ardiani: "Ok se hala sa afrue aty";*Fatriu*: "para ores 11:30 se bi me pushu pastaj"; Ardiani: "Ishalla po vjen deri qat here se me thirri tha nuk vonohem".* Po ashtu, në tërësinë e komunikimeve lidhur me këtë veprimtari, mbi angazhimin e të pandehurit Fatri Iseberi, veç të tjerash, jep të dhëna edhe komunikimi i zhvilluar mes tyre në datë 29.12.2020 ku komunikojnë mbi mënyrën se si ka kaluar Ardiani në kufi në atë dite dhe faktin që i ka dhënë dikujt një shumë parash për këtë fakt, dhe konkretisht : *F.Iseberi: He mor.A.Iseberi: Kallëzoj Halimit thuj mbaje (fjalë që nuk kuptohet) tridhjetë mijë lekë ban po mos i thu. F.Iseberi: A kalove? A.Iseberi: Kalova ja dhashë 30 mijë lekëshin.".*

1030.Nga përmbajtja e të gjitha bisedave të zhvilluara mes personave, për një kohë të gjatë, ndërkohë që kjo veprimtari zhvillohet, ndër të cilët edhe punonjësi i policisë Fatri Iseberi, vëllai i tij Ardian Iseberi, shtetasi Robert Saraçi dhe persona të tjerë të cilët komunikojmë me ta në lidhje me veprimtarinë e kalimit të gomave në pikën e kalimit kufitar Morinë, në drejtim të Shqipërisë, rezultojnë të dhëna se kjo veprimtari është zhvilluar e shtrire në një kohë të gjatë nga shtetasi Robert Saraçi, me te cilin rezulton se ka njohje dhe komunikime të drejtpërdrejta për këtë veprimtari i pandehuri Fatri Iseberi si dhe shtetasi Ardian Iseberi, vëllai i të pandehurit, si dhe persona të tjerë që veprojnë për llogari të tyre. Këto komunikime, të shtrira në kohë, japin të dhëna të qarta mbi dinamikën e zhvillimit të kësaj veprimtarie dhe qëndrueshmërinë e saj, si dhe rolin e të pandehurit Fatri Iseberi në këtë veprimtari i cili, nëpërmjet informacioneve që jep si dhe në disa raste nëpërmjet moskryerjes së detyrës së tij duke qenë vetë në shërbim ndërkohë që këta persona apo bashkëpunëtorët e tyre zhvillojnë këtë veprimtari, ka shpërdoruar detyrën e tij si punonjës i policisë së shtetit dhe posaçërisht si punonjës i policisë kufitare.

1031.Referuar fakteve dhe rrethanave që rezultojnë nga tërësia e këtyre komunikimeve të zhvilluara në një hark kohor disa mujor, gjykata vlerëson se në lidhje me këto fakte të kundërligjshme, nuk rezulton që të jenë hetuar dhe proceduar personat e përfshirë në këtë veprimtari në lidhje me kryerjen prej tyre të veprave penale të përfshira në seksionin V të Kodit Penal, "*Krime në fushën e doganave*" dhe konkretisht për veprat penale që lidhen me kontrabandën. Për pasojë, ndihma dhe asistenca apo veprimet konkrete për lejimin e lehtësimin e kësaj veprimtarie, të kryera nga i pandehuri Fartri Iseberi nuk mund të vlerësohen në drejtim të prezencës së elementëve të ndonjë nga këto figura të veprës penale në cilësinë e bashkëpunëtorit, për sa kohë që nuk rezulton që hetimet në këtë drejtim të jetë thelluar dhe zhvilluar në mënyrë që të vërtetoheshin plotësisht elementet e ndonjërës nga këto vepra penale të posaçme.

1032.Por, ndërkohe në veprimet dhe mosveprimet e tij të kundërligjshme, që kanë krijuar lehtësi, kanë dhënë informacion dhe ndihmë për personat që ushtrojnë këtë veprimtari të kundërligjshme, ndër të cilët edhe vëllai i tij, tregojnë qartë për rolin e Fatri Iseberit si ndihmës në këtë veprimtari dhe për pasojë, shpërdorimin e detyrës prej tij, duke cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat që rregullojnë regjimit e kontrollit kufitar në lidhje me kalimin e rregullt dhe të ligjshëm të mallrave në kufi, dhe duke provuar në këtë mënyrë prezencën e elementëve të anës objektive për të cilën ai akuzohet.

1033.*Referuar fakteve si më sipër*, rezultoi e provuar se i pandehuri Fatri Iseberi, gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i policisë kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, në disa episode të ndodhura në vitin 2020 dhe 2021, dy prej të cilave në bashkëpunim më të pandehurin tjetër Fatri Iseberi, ka asistuar dhe ndihmuar shtetas të ndryshëm për të kaluar kufirin me Kosovën, si në hyrje ashtu edhe në dalje, pa u regjistruar në sistemin TIMS dhe pa iu nënshtruar procedurave të rregullta të përpunimit të shtetasve në kufirin hyrës dhe dalës të Republikës së Shqipërisë. Po ashtu rezulton e provuar se, gjatë fundit të vitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021, ai ka asistuar dhe ndihmuar, nëpërmjet informimit, udhëzimit apo duke i lejuar drejtpërdrejt ndërkohë që është duke kryer shërbimin, personat që ushtrojnë veprimtarinë e futjes së mallrave kontrabandë në piken e kalimit kufitar, veprimtari kjo që ka rezultuar se ushtrohet nga vëllai i tij dhe një sërë personash të tjerë që bashkëpunojnë ose jo me të, për llogari të shtetasit Robert Saraçi.

1034. Në këto veprime dhe mosveprime të tij konkretizohet dhe provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm jo vetëm mos përmbushja e rregullt e detyrës prej tij në cilësinë e "*rojës kufitare*" në kuptim të nenit 2, pika 571 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", por provohet se ia ka kryer veprime aktive të kundërligjshme për të mundësuar kalimin e shtetasve në kufirin shtetërore (në drejtimin hyrës dhe dalës) ndërkohë që është në dijeni të problematikes që shtetasit kanë për kalimin e kufirit në drejtim të mungesës së dokumentacionit apo nevojës së tyre për të mos iu nënshtruar kontrollit dhe verifikimi kufitar ashtu sikurse normon ligji dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij si dhe, me ka kryer veprime aktive të kundërligjshme në funksion të dhënies së ndihmës për kalimin e kundërligjshëm të mallrave (*gomave të përdorura dhe në disa raste dhe pjese mjetesh*) në pikën e kalimit kufitar ku ai ushtron funksionin e tij.

1035. Kjo veprimtari e të pandehurit Fatri Iseberi, në drejtim të veprimeve dhe mosveprimeve që konkretizojnë elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet, analizuar më sipër në këtë vendim, bie ndesh me ushtrimin e rregullt të detyrës së tij dhe konkretisht me parashikimet e nenit nenin 17, pika 1, shkronjat ë), f) dhe i) të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" i ndryshuar në të cilin parashikohet se:" *1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë: .....ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e*

---

[71] *Në nenin 2, pika 5 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, parashikohet se :" 5. "Roja kufitare" është çdo punonjës i Policisë Kufitare dhe të Migracionit, i caktuar në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror për të kryer detyra të kontrollit kufitar në përputhje me këtë ligj.".*

Shqipërisë; ....i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.". Në lidhje me detyrat konkrete në drejtim të përpunimit të shtetasve që kalojnë kufirin, si në drejtimin hyrës ashtu edhe në atë dalës të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, në nenin 5, pika 2 të të cilit përcaktohet si autoriteti përgjegjës për kontrollin kufitar pikërisht kjo strukture, pjesë e së cilës është edhe i pandehuri Halim Shehu, duke parashikuar në mënyrë të shprehur se :" *2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.*", ndërkohë që në nenin 6 dhe 7 [72]të ligjit përcaktohen qartësisht kompetencat e policisë kufitare në kufi dhe brenda territorit, ku në lidhje me përpunimin e shtetasve në pikën 1 dhe 3 të nenit 6 përcaktohet shprehimisht se :" *1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda... 3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar: a) të verifikojnë: i) origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit;..".* Në lidhje me detyrat që konsistojnë në kontrollin dhe përpunimin e mjeteve dhe të sendeve në pikën e kalimit kufitar, në nenin 15 të po këtij ligji parashikohet se :" 1. *Verifikimi i sendeve përfshin sendet personale që zotëron personi që kalon kufirin shtetëror. 2. Në rast se ka dyshime për sende ose objekte të ndaluara të fshehura ose për të verifikuar identitetin e një personi, roja kufitare i kërkon personit të paraqesë të gjitha sendet që ka në zotërim për të bërë të mundur që objektet të këqyren nga brenda dhe jashtë. 3. Verifikimi i mjeteve të transportit përfshin inspektimin me sy, nga brenda dhe nga jashtë, të mjeteve të transportit dhe verifikimin në bazat përkatëse të të dhënave...".*

1036. Po ashtu, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, gjejnë zbatim një sërë aktesh nënligjore që normojnë punën e punonjësve të strukturës së policisë kufitare dhe posaçërisht atyre që ushtrojnë funksionon në Pikat e Kalimit Kufitar dhe Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar të cilat detajojnë procedurat standarde që zbatohen prej tyre gjatë kontrollit dhe verifikimit kufitar si të shtetasve ashtu edhe të sendeve dhe mjeteve të transportit[73]. Referuar kuadrit ligjor si më sipër, në raport me faktet që provojnë veprimet konkrete të të pandehurit Fatri Iseberi, rezulton se ai ka kryer veprime aktive të kundërligjshme, duke i dhënë ndihme dhe asistencë konkrete shtetasve të ndryshëm, në disa episode sikurse është analizuar më sipër në këtë vendim, për të kaluar kufirin duke shmangur kontrollin dhe verifikimin e rregullt kufitar sipas ligjit ose duke mundësuar kalimin e tyre në kufi, në mungesë të dokumentacionit të vlefshëm, në kundërshtim të hapur me detyrën e tij funksionale si punonjës i policisë kufitare dhe "rojës kufitare" në kuptim të ligjit të posaçëm nr. 71/2016, i ngarkuar drejtpërdrejt nga ky ligj me detyrën për kontrollin dhe

---

[72] *Referuar përmbajtja e dispozitave më sipër në këtë vendim*

[73] *Referuar kuadri nënligjor më sipër në ketë vendim*

mbikëqyrjen e kufirit, pjesë e së cilit është edhe regjimi i kalimit dhe përpunimit të rregullt dhe ligjor te shtetasve që kalojnë kufirin si në hyrje ashtu edhe në dalje të Republikës së Shqipërisë.

*1037.*Po ashtu rezulton e provuar se ai jo vetëm ka qenë në dijeni të plotë të veprimtarisë së zhvilluar nga shtetasit Robert Saraçi, Ardian Iseberi, Rasim Spada etj., për kalimin e mallrave në mënyrë të kundërligjshme në pikën e kalimit kufitar, por rezulton e provuar se ka dhënë ndihmën dhe kontributin e tij për realizimin me sukses të kësaj veprimtarie të kundërligjshme, për një kohë të gjatë, në mos përmbushje dhe shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave që rregullojnë regjimin dhe kontrollin kufitar të mjeteve dhe sendeve.

*1038.*Lidhur me procedurat e kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë me Kosovën, në kohën që janë zhvilluar ngjarjet objekt i këtij procedimi, rezulton se në ketë kohë zbatohej edhe marrëveshja e përbashkët ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "*Për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar*", ratifikuar me ligjin nr. 24, datë 18.04.2019. Në këtë marrëveshje, në nenin 5[74] parashikohen rregulla të përbashkëta për kontrollet kufitare në hyrje dhe në dalje, ndërsa në nenin 1, nën titullin "*Përkufizime*", ndër të tjera, në pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 përkufizohen termat e përbashkëta për verifikimin kufitar, vendin e hyrjes, vendin e daljes, zonën e përbashkët të kalimit kufitar, nëpunësit përgjegjës si dhe sanksionohet parimi "një ndalesë një kontroll"[75]. Sipas kësaj marrëveshje të përbashkët, shtetasit do të përpunohen në dalje nga punonjësit e PKK të Kosovës ndërsa në hyrje nga punonjësit e PKK të Shqipërisë, por ajo çka duhet theksuar është se kjo marrëveshje nuk shmang detyrimin ligjor të rojave kufitare të dy vendeve për të ushtruar detyrën e tyre në rast se konstatojnë situata apo fakte që mund të cenojnë legjislacionin përkatës te tyre, në lidhje me kontrollin kufitar, nëse shtetasit janë në pikën dalëve të secilit shtet, duke shmangur në këtë mënyrë tërësisht kontrollin e çdo shteti palë mbi kufirin e tij në drejtimin dalës. Nga përmbajtja e marrëveshjes, në nenin 1, pika 8 të saj, parimi "një ndalesë një kontroll" përkufizohet si vijon: "*Parimi "një ndalesë një kontroll" – verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat.*", duke mos nënkuptuar se ky parim pas sjell mos kryerjen e asnjë procedure apo kontrolli ose verifikimi, posaçërisht ne rastet me risk (pra kur ka dyshime për kundërligjshmëri) të rojeve kufitare në pikën dalëse të shtetit respektiv palë të marrëveshjes. Për me tepër, vetë marrëveshja në fjalë referon detyrimin për zbatimin e legjislacionit të secilit shtet palë në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin kufitar, duke përcaktuar shprehimisht në nenin 4 të saj se :"*Të gjitha aktet nënligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-së do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës palë kontraktuese. 2. Veprimtaritë e kryera në ZPPKK nga nëpunësit e shtetit fqinj, kryhen në përputhje me legjislacionin e këtij shteti dhe do të konsiderohen si të kryera në territorin e këtij shteti...*".

---

[74] *Referuar përmbajtja e dispozitës më sipër në këtë vendim*

[75] *Referuar përmbajtja e dispozitës më sipër në këtë vendim*

1039.*Sa më sipër*, gjykata vlerëson se, zbatimi i kësaj marrëveshje të përbashkët mes shteteve, nuk mund të përligjë mos ushtrimin në mënyrë të rregullt të detyrës nga punonjësit e policisë kufitare të Republikës së Shqipërisë, gjatë procedurave të daljes së shtetasve në kufi apo gjatë procedurës së hyrjes së tyre me mjetet përkatëse, në kufirin përkatës të shtetit palë. Për më tepër në rastin konkret, vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri Fatri Iseberi, nuk rezulton të jete kryer nëpërmjet mosveprimit të tij, por është konkretizuar me veprime aktive të kundërligjshme për të mundësuar kalimin e parregullt të shtetasve në kufi, qoftë ai hyrës ose dalës, dhe për pasojë, pavarësisht se cili prej punonjësve të tjerë, në pikën hyrëse apo dalëve në momentin që ka ndodhur ngjarja, ka qenë në cilësinë e kontrollorit, kjo nuk përjashton nga përgjegjësia vetë të pandehurin, i cili mbart të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mbajtjen prej tij të pozicionit të *rojës kufitare* ne kuptim të ligjit nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore te dala në bazë dhe për zbatim të tij. Po ashtu, veprimtaria e tij në drejtim të dhënies së ndihmës dhe lejimit në disa raste, duke qenë në shërbim në pozicionin e kontrollorit, të kalimit te mjeteve pa kryer procedurat standarde të kontrollit dhe përpunimit të tyre, kur rezulton e qartë nga provat se ka pasur dijeni të plotë se në to ka pasur sende për të cilat do të duhej të ushtronte kontroll, është realizuar me veprime aktive të kundërligjshme, të cilat kanë cenuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në lidhje me kalimin dhe regjimin e përpunimit të mallrave në kufirin hyrës te Republikës së Shqipërisë.

1040. Në lidhje me rrethanën e kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, lidhur me ngjarjet e datave 24.01.2021 dhe 21.05.2021, gjykata vlerëson se nga dinamika e zhvillimit të tyre dhe të dhënat që ofrojnë provat mbi të cilat mbështetet provueshmëria e këtyre fakteve, rezulton e provuar se i pandehuri Fatri Iseberi në dy këto episode ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Halim Shehu. Veprimet aktive të kundërligjshme të tyre, në ngjarjet që referojnë në këto dy momente kohore, evidentohen në veprimet e përbashkëta dhe/ose komplementare të tyre si dhe në bisedat që shoqërojnë këto veprime, të cilat tregojnë qartë bashkëpunimin e tyre në funksion të arritjes së qëllimit të kundërligjshëm, i cili përmban elementët e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Fatri Iseberi.

1041. Në drejtim të vlerësimit të elementeve të bashkëpunimit, veç sa më sipër, gjykata mban në konsideratë edhe faktin se gjatë kryerjes së një vepre penale në bashkëpunim, nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëpunëtoret të veprojnë të gjithë së bashku dhe të kryejnë të njëjtat veprime konkrete në drejtim të realizimit të veprës penale pasi sipas roleve përkatëse, veprimet e tyre mund te jenë edhe komplementare, por të nevojshme për arritjen e qëllimit final. Pra jo gjithmonë, të gjithë personat që veprojnë në bashkëpunim më njeri tjetrin, do te shfaqen së bashku, në të njëjtën kohë, duke vepruar për kryerjen e çdo veprimi në funksion të realizimit të veprës. E rëndësishme në vlerësimin mbi prezencën e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, që dëshmon ndër të tjera, edhe elementët e bashkëpunimit, është evidentimi dhe provueshmëria e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në veprime të përbashkëta ose komplementare, në funksion të realizimit të të njëjtit qëllim.

1042.*Në drejtim të anës subjektive*, nga tërësia e provave të administruara dhe vlerësuara, të cilat dëshmojnë veprimet konkrete të kundërligjshme të kryera nga i pandehuri Fatri Iseberi, në

referim të parashikimeve të nenit 14 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se "*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.*", gjykata vlerëson se në rastin konkret rezulton e provuar se i pandehuri, ka vepruar me dashje direkte, pasi ai ka pasur dijeni të plotë se veprimet dhe mosveprimet konkrete të kryera prej tij përbejnë jo vetëm mos përmbushje të rregullt të detyrës funksionale të tij por edhe sjellje të kundërligjshme dhe të dënueshme. Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale të "*Shpërdorimit të detyrës*", kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë. Në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin konkret dashja e drejtpërdrejtë evidentohet në këto tre aspekte: (i) dijenia nga ana e të pandehurit që veprimet ose mosveprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës; (ii) dëshira e të pandehurit për t'i kryer këto veprime ose mosveprime dhe (iii) kryerja e veprimeve ose mosveprimeve nga i pandehuri me qëllim realizimin e përfitimeve materiale ose jo materiale të padrejta, për vete ose për të tjerë, ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

1043.Në rastin konkret, nga dinamika e provuar e veprimeve aktive të kundërligjshme të të pandehurit Fatri Iseberi, me anë të së cilave është materializuar ana objektive e veprës penale për të cilën ai akuzohet rezulton qartësisht e provuar se (i) ai ka pasur dijeni të plotë se veprimet e tij bien në kundërshtim me ligjin, dijeni kjo e cila rezulton e qartë nga detyra që ai mban, arsimimi, kohëzgjatja e kryerjes së detyrës që prezumon edhe njohjen e mire dhe te plote te kuadrit ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm, si dhe detyrimi ligjor që çdo punonjës ka për të pasur dijeni mbi detyrën funksionale të tij dhe parametrat e kryerjes së saj brenda kufijve të ligjit dhe në shërbim të interesit publik; (ii) rezulton se ai i ka kryer veprimet aktive te kundërligjshme me dëshirë dhe vullnet tërësisht të lire dhe të pavesuar si dhe (iii) rezulton i qartë qëllimi i kryerjes së tyre, në funksion të favorizimit të shtetasve për të kaluar kufirin pa u regjistruar apo në mungesë të dokumenteve të nevojshme dhe pa kryer procedurat e rregullta te përpunimit dhe kontrollit kufitar, qëllim i cili përveçse realizohet duke përmbushur interesat e këtyre te fundit, njëherësh dëmton interesat e ligjshme të shtetit. Po ashtu rezulton i qartë qëllimi i tij në drejtim të lejimit, favorizimit dhe dhënies së ndihmës në veprimtarinë e kundërligjshme të futjes së mallrave në pikën e kalimit kufitar Morinë, pasi rezultojnë një sërë komunikimesh te qarta dhe të vazhdueshme të tij me shtetasit e përfshirë në këtë veprimtari, ku del qartë roli i tij dhe qëllimi i përfshirjes dhe angazhimit të tij në këtë veprimtari, me qëllime përfitimi për personat e përfshire dhe duke dëmtuar me dashje interesat e shtetit në drejtim të cenimit të rregullave për importimin dhe përpunimin doganor të mallrave në Republikën e Shqipërisë, apo futjen e mallrave të ndaluara sikurse është rasti i gomave të përdorura të automjeteve.

1044.*Sa më sipër*, gjykata konkludon se i pandehuri Fatri Iseberi, ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ka parashikuar karakterin e dënueshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke kryer veprime në kundërshtim me ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë dhe detyrën funksionale të tij, duke dëmtuar kështu interesat e ligjshme të shtetit dhe duke sjellë përfitime të padrejta për të tretë.

1045. *Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi përmbush kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë penale, pasi në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kuptim të nenit 17 të këtij Kodit është i përgjegjshëm, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë në drejtim të vlerësimit lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë, veç kushteve të përgjithshme për qenien subjekt i veprës penale, figura e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal parashikon se subjekti i kësaj vepre penale është i posaçëm, çka do të thotë që përveç kushteve të përgjithshme, duhet që subjekti të ketë edhe cilësitë e posaçme, çka do të thotë që duhet të ketë cilësitë e një subjekti që ushtron funksion publik dhe e ka përdorur këtë cilësi për kryerjen e veprës penale konkrete. Konkretisht, subjekti aktiv i kësaj vepre penale, përveç cilësisë si person që ushtron funksione publike, duhet të zotërojë autoritet publik, të njohur me ligj për shkak të detyrës së ai kryen. Në rastin konkret, i pandehuri Fatri Iseberi ka qenë punonjës i strukturës së policisë së shtetit, posaçërisht të strukturës për kufirin dhe migracionin në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë. Punonjësit e policisë së shtetit, pjesë e strukturës së posaçme për kufirin dhe migracionin, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar dhe ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, ushtrojnë funksione publike, janë pjesë e një strukture të administratës publike që ushtron funksione shtetërore dhe për pasojë, plotësojnë kushtet për të qenë subjekte të posaçme të veprës penale për të cilën akuzohet.

1046. Sikurse është referuar në analizën lidhur me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në raport me cilësitë e të pandehurit në rastin konkret, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi është person që ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publiku të njohur nga ligji, për shkak të detyrës, të cilin e ka përdorur në funksion të realizimit te veprës penale. Arrihet ky konkluzion duke iu referuar parashikimeve të neneve 4, pika 1 të ligjit nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, ndryshuar me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020, në lidhje me strukturën e policisë së shtetit për kufirin, në nenin 16, pika 1, shkronja c), parashikohet se :" *1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor, si më poshtë:... c) Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit janë struktura që organizohen në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal...*" si dhe analizës së bërë në raport me legjislacionin e referuar, më sipër në këtë vendim. Për këto arsye, gjykata vlerëson se i pandehuri Fatri Iseberi, në cilësinë e saj si pjesë e strukturës së policisë kufitare, është subjekt që plotëson kushtet për t'u klasifikuar si funksionar publik dhe për pasojë, plotëson kushtin e posaçëm për të qenë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

1047.*Sa më sipër u arsyetua*, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri **Fatri Iseberi,** duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të "*Shpërdorimi i detyrës*" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e kryer në bashkëpunim sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal dhe konkretisht në bashkëpunim me të pandehurin Halim Shehu, në faktin penal të ndodhur në datat 24.01.2021 dhe 21.05.2021, ndërkohe që rezulton se ka vepruar i vetëm në episodet e tjera të analizuar më sipër në këtë vendim pasi nuk rezultojnë të provuar, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementet që

karakterizojnë bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale, në aspektin e anës objektive dhe subjektive të saj.

Lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurit ARTAN RREDHAJ

1048.Lidhur me të pandehurin **Artan Rredhaj**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzën e kryerjes së veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga nenet 248 i Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim, vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Artan Rredhaj është e bazuar në prova.
1049.Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Artan Rredhaj, në cilësinë e punonjësit të policisë kufitare dhe pozicionin "përgjegjësit të turnit", evidentohet vetëm në një moment të faktit penal, i cili merret në analizë nga gjykata në vijim:
1050.*Së pari*, emri i të pandehurit Artan Rredhaj, referuar faktit penal objekt akuze dhe objekt procedimi në tërësinë e tij, rezulton vetëm në një komunikim që ka rezultuar nga këqyrja e komunikimeve, pas sekuestrimit të aparatit telefonik të të pandehurit Lahert Sulo. Sipas këtij procesverbali, rezulton se shefi i stacionit Lahert Sulo, në datë 26.12.2021 i ka dërguar me sms një targë automjeti të pandehurit Artan Rredhaj dhe konkretisht targën *"AA070NV"*, duke zhvilluar mes tyre dialogun si më poshtë: *Lahert Sulo: Për 5 minuta janë atje, ndihmoje pak pe nga pala Kosovare. Artan Rredhaj: Ok, çfarë makine eshte shef? Lahert Sulo*: *Nuk e di cfare tip mjeti është...Artan Rredhaj*: *Ok se jam vete ketu....*ora 10:29 min *Artan Rredhaj*: Kaloi shefi. Lahert Sulo: *Ok Faleminderit.* Lidhur me këtë fakt, nga të dhënat e marra këqyrura në sistemin TIMS, ka rezultuar se në datë 26.12.2021 targa e mësipërme nuk figuron e regjistruar në sistem. Në deklarimet e tij në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime Artan Rredhaj lidhur me këtë bisedë pranon se ka zbatuar një porosi të shefit të tij Lahert Sulo për të ndihmuar shtetasin që udhëtonte me automjetin, targa e se cilit i është dërguar me sms, pa pritur radhën e PKK Morinë por nuk rezulton që ky i fundit, të ketë kryer asnjë veprim apo mosveprim që lidhet me regjistrimin ose jo të daljes së shtetasit apo mjetit përkatës në sistemin TIMS, pasi në dalje shtetasit regjistrohen nga pala kosovare. Referohet dhe rezulton se ky komunikim dhe faktet e referuara në të kanë ndodhur dhe pranohen edhe nga i pandehuri tjetër Artan Rredhaj në deklarimet e tij, por nuk rezulton dhe as evidentohet nga Prokuroria, ndonjë element që të hedhë dritë mbi prezencën e elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet i pandehuri pasi nuk evidentohen veprime apo mosveprime të kundërligjshme të tij përveç ndihmës që i ka dhënë një shtetasi, të kërkuar nga kolegu i tij, për të kaluar kufirin pa pritur gjatë në radhë. Nuk evidentohet në faktin objekt akuze asnjë element lidhur me ndonjë problematike apo ndalim të shtetasit që udhëton me këtë mjet për të kaluar kufirin, përveç faktit që rezulton i provuar se i pandehuri Artan Rredhaj e ka ndihmuar atë të

kalojë drejt vendit të përpunimit të mjeteve dhe udhëtareve nga punonjësit të policisë kosovare, pa pritur radhën.

1051.Duke konsideruar mos konkretizimin dhe formulimin në mënyrë tërësore dhe të përgjithshme të fakteve objekt akuzë të bërë nga ana e Prokurorisë, në lidhje me ato fakte që evidentohen në drejtim të akuzës së ngritur ndaj të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të pandehurin Artan Rredhaj, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për të cilën akuzohet ky i pandehur, duke qenë se ai nuk referohet dhe as identifikohet ne asnjë moment tjetër (përveç sa me sipër) të faktit penal, gjykata do të marrë në analizë vetëm faktin konkret objekt akuze ndaj tij.

1052.Gjykata në drejtim të vlerësimit mbi ekzistencën e përgjegjësisë penale të të pandehurit Artan Rredhaj, për veprën penale për të cilën akuzohet, merr në analizë faktet si më sipër, në raport me katër elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, analizuar në aspektin teorik më sipër në këtë vendim. Që të provohet ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjësia e të pandehurit për veprën konkrete për të cilën ai akuzohet, duhet që të vërtetohen dhe provohen njëherësh, pra në mënyrë kumulative, të katër elementet e figurës së veprës penale dhe konkretisht : (i) *Objekti* i veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal i cili konsiston në mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura me ligj ose me akte normative me fuqinë e ligjit, të cilat garantojnë veprimtarinë e rregullt e normale të shtetit, institucioneve, shërbimeve publike, si dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe të shtetit, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal dhe kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve dhe akteve normative me fuqinë e ligjit; (ii) *Anën objektive* të veprës penale e cila përbën elementet të domosdoshëm të figurës së veprës penale pasi nëse nuk ka veprim ose mosveprim të kundërligjshëm dhe të dënueshëm penalisht, nuk mund te ketë vepër penale dhe për pasojë përgjegjësi penale. Vepra penale e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal konkretizohet veprimeve a mosveprimeve, në kundërshtim me ligjin, të cilat duhet të përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës dhe veprimin e subjektit të veprës penale në kundërshtim me ligjin[76], të cilat duhet ti sjellin personit që ushtron funksione publike ose personave të tjerë, përfitime materiale ose jo materiale të kundërligjshme ose të dëmtojnë interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë. (iii) *Subjektin* e veprës penale i cili duket të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i

---

[76] *Në lidhje me terminologjinë "mos përmbushje të rregullt të detyrës", Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.2, datë 12.01.2023, arsyeton se "Në interpretimin e shprehjes "në kundërshtim me ligjin, që përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës", Kolegji i referohet edhe jurisprudencës kushtetuese, konkretisht vendimit nr. 7/2013 të Gjykatës Kushtetuese ku është argumentuar se: "Termi "ligj" i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit "ligj" në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t'u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe nga ana tjetër orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore.".*

përgjegjshëm në kuptim të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal, si dhe të gëzojë cilësinë e një personi që ushtron funksione publike si dhe (iv) *Ana subjektive* e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e cila realizohet me dashje të drejtpërdrejtë e cila konkretizohet në dijeninë e subjektit se veprimet ose mosveprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës së tij. Po ashtu duhet të ekzistojë vullneti, dëshira e pandehurit për t'i kryer këto veprime ose mosveprime si dhe të konfigurohet qëllimi që konsiston në përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të ose për persona të tjerë, ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridikë.

1053.Në rastin konkret, në të vetmin fakt/ngjarje që i atribuohet të pandehurit Artan Rredhaj, analizuar më sipër në këtë vendim, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet në veprimet dhe mosveprimet e tij, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në lidhje më këtë fakt, nga provat e administruara, të vetmit elementë që rezultojnë të provuar janë (i)komunikimi i tij me kolegun e tij Lahert Sulo dhe dërgimi prej këtij të fundit i targës së një mjeti duke i kërkuar të pandehurit ta ndihmojë; (ii) dhënia e ndihmës nga i pandehuri Artan Rredhaj sikurse ai vetë pranon në deklarimet e tij, që shtetasi që udhëtonte me këtë mjet, të kalonte pa pritur gjatë në radhë, në drejtim të pikës së kalimit kufitar të Kosovës si dhe (iii) mos pasqyrimi i kalimit të këtij mjeti, targa e të cilit rezulton nga provat nga punonjësit e palës kosovare në pikën dalëse të PKK Morinë, në sistem si mjet që ka kaluar në dalje të R.Sh në këtë datë që zhvillohet biseda.

1054.Duke vlerësuar secilin nga këto fakte, me vete dhe së bashku me njëri tjetrin, në raport me elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, gjykatës nuk i rezulton prezenca e asnjë veprimi apo mosveprimi të kundërligjshëm, i cili përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës nga ana e të pandehurit Artan Rredhaj. Po ashtu, në drejtim të anës subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme, duhet të të synojnë dhe të realizojnë qëllimin e veprës penale, që konsiston në faktin se duhet ti sjellin personit që ushtron funksione publike ose personave të tjerë, përfitime materiale ose jo materiale të kundërligjshme ose të dëmtojnë interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë. Në rastin konkret, dhënia e ndihmës apo asistenca që i pandehuri i ka ofruar një shtetasi për të kaluar kufirin pa pritur gjatë në radhë, nuk rezulton të përbëjë një veprim të ndaluar apo të kufizuar nga ligji nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", i ndryshuar, apo aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij dhe po ashtu nuk rezulton ti ketë krijuar këtij shtetasi ndonjë avantazh të kundërligjshëm, përveç kalimit në kufi disa momente me herët se sa do të mund të kalonte nëse do të priste radhën.

1055.Prokuroria në analizën e këtij fakti, referon se ky veprim përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës në raport me parashikimet e nenit 14[77] të ligjit nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar" në

[77] Në nenin 14 të ligjit nr. 71/2016 parashikohet se :" 1. *Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i* ***verifikimit kufitar minimal****, i cili përbëhet nga: a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i*

të cilin, nën titullin "Verifikimi kufitar i personave", parashikohen procedurat e verifikimit kufitar minimal të personave, verifikimit kufitar tërësor në hyrje, verifikimit kufitar tërësor në dalje si dhe rastet dhe procedurat e aplikimit të verifikimit në vijën e dytë. Në rastin konkret, nuk rezulton që i pandehuri Artan Rredhaj, me detyre përgjegjës turni në PKK Morinë, të ketë pasur për detyrë të ushtrojnë kontrollin kufitar minimal apo tërësor në dalje të shtetasit konkret, pasi ky verifikim, mbi bazën e parashikimeve të nenit 17 të ligjit, zbatimit të parimit "*një ndalesë- një verifikim*" sipas parashikimeve të pikës 1 të VKM nr. 745/2016, apo zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për menaxhimin e integruar të kufirit mes dy shteteve, në dalje ushtrohet nga pala kosovare.

---

vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e, veçanërisht, me: i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit; ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit; iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë; b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse. Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit. 2. Të huajt, krahas verifikimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, janë subjekt i verifikimeve tërësore në hyrje dhe në dalje, të cilat konsistojnë në verifikimin e plotësimit të të gjitha kushteve për kalimin e kufirit shtetëror. 3. ***Verifikimet kufitare tërësore në hyrje përbëhen*** *nga: a) verifikimi i të huajit nëse ai posedon, për kalimin e kufirit shtetëror, një dokument 8 udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, të shoqëruar me vizë ose leje qëndrimi, kur kjo kërkohet nga legjislacioni; b) këqyrja e plotë e dokumentit për ndonjë shenjë falsifikimi, sajimi apo tjetërsimi; c) shqyrtimi i vulave të hyrjeve/daljeve në dokumentin e udhëtimit, duke i krahasuar me të dhënat në bazat e të dhënave të hyrjeve/daljeve, për të verifikuar nëse i huaji ka tejkaluar afatin e autorizuar të qëndrimit në territorin e vendit; ç) verifikimi i dokumentacionit për nisjen, destinacionin dhe arsyen e qëndrimit të personit; d) verifikimi i të huajit nëse ai ka mjete të mjaftueshme financiare për kohën dhe qëllimin e qëndrimit, si dhe për kthimin në vendin e origjinës apo për kalimin transit në një vend të tretë ku i lejohet të hyjë ose verifikimi se ai është në gjendje t'i sigurojë këto mjete financiare në mënyrë të ligjshme. 4.* ***Verifikimet kufitare tërësore në dalje*** *përbëhen nga: a) verifikimi nëse personi posedon një vizë të vlefshme, në qoftë se kjo kërkohet, përveçse kur ai mban një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar në Republikën e Shqipërisë ose dokumente të tjera që autorizojnë qëndrim apo rihyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) verifikimi nëse personi ka shkelur afatin e lejuar të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në qoftë se ai është subjekt i një afati të limituar qëndrimi. 5. Përjashtimisht, shtetasit e Bashkimit Evro-pian, Zonës Ekonomike Evropiane, Zvicrës, Andorrës, Monakos dhe San-Marinos, si dhe të huajt që janë familjarë të tyre dhe që gëzojnë të drejtën e Bashkimit Evropian për lëvizje të lirë ose që janë familjarë të shtetasve shqiptarë, në rast se identiteti dhe lidhjet familjare të tyre provohen, i nënshtrohen verifikimit minimal. Përkufizimi i anëtarëve të familjes në ligjin për të huajt është i vlefshëm, gjithashtu, dhe për këtë ligj. 6. Personat, që janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, në bazë të analizës së riskut dhe në mënyrë josistematike, mund t'i nënshtrohen verifi-kimit tërësor. 7. Nëse, nga rezultatet e verifikimit në vijën e parë, konsiderohen të nevojshme verifikime të mëtejshme, personit i kërkohet t'i nënshtrohet verifikimit në vijën e dytë, i cili mund të përfshijë verifikime të hollësishme personale, verifikime të hollësishme të sendeve në posedim dhe inspektime të hollësishme të automjetit. 8. Aty ku janë kushtet, verifikimet e vijës së dytë kryhen në ambiente të përshtatura posaçërisht për këtë qëllim. 9. Të gjithë personat, që janë subjekt i verifikimit në vijën e dytë, informohen me shkrim për qëllimin dhe procedurat që ndiqen gjatë këtij verifikimi, në një gjuhë që e kuptojnë apo që ka arsye për të besuar se e kuptojnë ose në një mënyrë tjetër efektive. Informacioni pasqyron të drejtën që ka personi, subjekt i verifikimit në vijën e dytë, për të kërkuar emrin ose numrin e identifikimit të rojës kufitare që kryen verifikimin tërësor në vijën e dytë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri shtetëror. Përmbajtja e këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. 10. Si përjashtim nga rregullat e përgjithshme të verifikimit kufitar, për kategori të caktuara personash dhe mjetesh transporti zbatohen rregulla të veçanta, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".*

1056.Po ashtu, nga provat e administruara, nuk rezulton në këtë rast asnjë e dhënë për prezencën e ndonjë shkaku të tillë si p.sh mungesë dokumentacioni apo kundërligjshmëri në kalimin e shtetasit që udhëton me mjetin përkatës, çka do ta vendoste të pandehurin Artan Rredhaj para detyrimit ligjor të ushtrimit të kompetencave të tij si punonjës i policisë kufitare dhe pozicionin e rojës kufitare në kuptim të ligjit të posaçëm, për të ushtruar kontroll dhe për të mos lejuar kalimin e këtij shtetasi në kundërshtim me ligjin. Në rastin konkret, fakti i vetëm i provuar është se ai ka ndihmuar shtetasin, sipas kërkesës së kolegut të tij, të kalojë pa pritur gjate në radhë, fakt i cili, në vlerësim të gjykatës nuk rezulton të ketë cenuar në asnjë pikë parashikimet e nenit 14 të ligjit nr.71/2016 apo ndonjë dispozitë tjetër ligjore dhe nuk përbën veprim apo mosveprim të kundërligjshëm nga ana e të pandehurit dhe në mospërputhje të rregullt të detyrës prej tij.

1057.Edhe nëse ky parashtrim i bërë nga akuza do të merret i mirëqenë, duke pranuar për një moment prezencën e elementëve të anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, në rastin konkret mungon tërësisht lidhja shkakësore e kësaj sjelle me prezencën e ndonjë qëllimi të kundërligjshëm, i cili përbën element të qenësishëm të anës subjektive të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës". Konkretisht, në drejtim të qëllimit, në rastin konkret në raport me figurën e kësaj vepre panele, ai konsiston në përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të ose për persona të tjerë, ose për të dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridikë. Në këto rrethana, edhe nëse do të pranohej logjika e ndjekur nga akuza se veprimet e tij përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës, sërish fakti nuk do të përbente vepër penale pasi nuk konfigurohet dhe as provohet asnjë aspekt që bën të besueshëm dhe të provuar pikërisht qëllimin e veprës penale objekt akuze, element i qenësishëm i anës subjektive të saj.

1058.*Sa më sipër*, gjykata vlerëson se në faktin në të cilin referon akuza në rastin konkret, ndaj të pandehurit Artan Rredhaj, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe për pasojë, në vlerësim të gjykatës, fakti objekt akuze nuk përbën vepër penale. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës..*". Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (*"akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt*) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin Artan Rredhaj, gjykata vlerëson se nuk provohet kryerja

prej tij e veprimeve aktive të kundërligjshme që materializojnë një nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet.

1059.Në përfundim, në kushtet kur nuk provohen elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për këtë të pandehur, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj (subjektit, objektit) është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Artan Rredhaj në faktin që i atribuohen, te ketë kryer veprime apo mosveprime aktive të kundërligjshme dhe në mos përmbushje të rregullt të detyrës së tij.

1060.Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronja d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri Artan Rredhaj duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen, në raport me veprimet dhe mosveprimet e tij, elementët e anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale për të cilën ai akuzohet.

Lidhur me akuzën ndaj të pandehurve Atli Jashari, Sazan Ibra, Klevis Salkurti dhe Xhafer Elezi, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1, pg 1 i Kodit Penal.

1061. Në lidhje me veprën penale të "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", në nenin 245/1, pg 1[78] të Kodit Penal parashikohet se: *"Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, personit që premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit."*. Para analizës në lidhje me elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, gjykata evidenton faktin se faktet objekt akuze ndaj të pandehurve *Atli Jashari, Sazan Ibra, Xhafer Elezi dhe Klevis Salkurti*, të cilët akuzohen për kryerjen e kësaj vepre penale kanë

---

[78] *Neni 245/1 është ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 14 maj 2021. Lidhur me hyrjen në fuqi në nenin 5 të ligjit nr. 34/2021 parashikohet se :"Ky ligj hyn në fuqi në datë 1 qershor 2021". Para ndryshimeve të pësuara më këtë ligj, neni 245/1 i Kodit Penal ka pasur këtë formulim :"Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.".*

ndodhur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve që ka pësuar kjo dispozitë me ligjin nr. 43/2021, i cili ka hyrë në fuqi në datë 1 qershor 2021, sikurse parashikohet shprehimisht në nenin 5 të vetë këtij ligji. Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se kualifikimi i faktit penal të bërë nga organi i akuzës sipas nenit 245/1 pika 1 i Kodit Penal, pas ndryshimeve është bërë në mënyrë të drejtë dhe në respektim të parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues përcaktuar shprehimisht në 29, pika 3 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se "*3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese*", dhe nenin 3, pika 3 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se "*Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.*". Në respektim të këtij parimi të rëndësishëm të ligjit penal material, i cili vjen në përputhje edhe me frymën dhe qëllimin e nenit 7 të KEDNJ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, kanë konkluduar se "*Nga përmbajtja e këtij paragrafi, sipas të cilit, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e te cilit janë me te favorshme për personin qe ka kryer veprën penale, arrihet në përfundimin se, ne rastet kur, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i disfavorshëm se ligji që është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të personit që e ka kryer atë, gjykatat detyrohen të zbatojnë ketë të dytin d.m.th. ligjin e mëvonshëm, i cili është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes. Ky detyrim rrjedh nga fakti që, ne rastin konkret, ligji i mëvonshëm përmban dispozita, të cilat janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale ose, duke përdorur terminologjinë kushtetuese, duhet thënë se, ligji i mëvonshëm është ligj penal favorizues dhe pikërisht për ketë arsye, ai ka fuqi prapavepruese Megjithatë, duhet venë në dukje fakti që fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit te tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment, është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, faze e cila, duke u bazuar në sa u thanë me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se, nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar, ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal, të formës së prerë, të gjykatave të huaja penale, sikurse është rasti objekt gjykimi*". Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në vijimësi ka evokuar zbatimin e këtij parimi, duke arsyetuar se "*Gjykata rithekson se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.04.2007; nr.35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale; ligji i ri që nuk*

dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin *që ka kryer veprën penale*[79]*.".* Duke iu referuar llojit dhe masës së dënimit të parashikuar për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, sipas formulimit të tij në kohën e kryerjes së veprës penale në rastin konkret, me formulimin e mëvonshëm të saj (*në momentin e ngritjes së akuzës dhe gjykimit të çështjes*), rezulton se në nenin 245/1, pg 1 të Kodit Penal, para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021 parashikohej dënimi *me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet,* ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 pg 1, pas ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021, parashikohet dënimi *me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.* Referuar të dy dispozitave, në planin krahasimor në funksion të përcaktimit se cila prej tyre është më favorizuese, rezulton se *(i)* të dy dispozitat parashikojnë të njëjtin lloj dënimi, atë më burgim; *(ii)* të dy dispozitat parashikojnë të njëjtën masë dënimi në minimum, atë me 6 muaj burgim dhe *(iii)* secila dispozitë parashikon masë të ndryshme dënimi me burgim në maksimum, përkatësisht me 3 dhe 1 vit burgim. Në këto kushte gjykata vlerëson se, në respektim të parimit kushtetues të zbatimit të ligjit penal favorizues, në rastin konkret dispozita më e favorshme është ajo e mëvonshme, e cila parashikon masë më të ulët dënimi me burgim në maksimum. Për këto arsye dispozita e zbatueshme është ajo e parashikuar nga neni 245/1 pg 1, pas ndryshimeve që kjo dispozitë ka pësuar, me ligjin nr. 43/2021 dhe këtë këndvështrim, kualifikimi i faktit penal nga ana e organit të akuzës vlerësohet se është bërë në mënyrë të drejtë dhe në respektim të ligjit penal material.

1062. Në lidhje me objektin e veprës penale, "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", nga mënyra se si është formuluar kjo dispozitë e Kodit Penal, rezulton se qëllimi i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale e parashikuar në nenin 245/1 të Kodit Penal, është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike, ruajtja e besimit që individët kanë tek funksionarët publikë se këto detyra apo funksione do të ushtrohen në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës duke i shërbyer me përpikmëri vetëm interesave publikë, në mënyrë të paanshme, objektive dhe në respektim të ligjit. Në bazë të nenit 107/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit dhe në këtë këndvështrim, ushtrimi i detyrës publike duhet të udhëhiqet vetëm nga respektimi i ligjit dhe shërbimi ndaj interesave publike, dhe jo i atyre interesave të tjera private të shkëmbimit që nuk duhet të mbivendosen apo të prevalojnë ndaj interesave publike. Vepra penale e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, është pozicionuar nga ligjvënësi në kreun VIII, nën titullin "Krime kundër autoritetit të shtetit", në seksionin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, shtuar në Kodin Penal për herë të parë me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, në përmbushje të angazhimeve të Republikës së Shqipërisë, pas ratifikimit të Konventës penale të Këshillit të Evropës për korrupsionin[80], duke

---

[79] *Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 29.02.2022. Në të njëjtën mënyrë shprehet Gjykata edhe në vendimet nr. 12, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014*

[80] *Ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001*

iu nënshtruar më pas ndryshimeve, për të përmbushur angazhimet e shtetit pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit[81]. Konventa Penale e Këshillit të Evropës për Korrupsionin, në nenin 12 të saj parashikon se :"*Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qellim premtimin, dhënien ose ofrimin, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon cilitdo që siguron ose konfirmon se është i aftë të ushtroje ndikim në vendimmarrjen e cilitdo personi të referuar në nenet 2, 4, 5, 6, 9, 10, 11, në përputhje me këtë dispozitë, kur avantazhi që nuk i takon është për atë vetë apo për te tjerë, sikurse dhe kërkimi, marrja ose pranimi i ofertës ose premtimi i një avantazhi të tillë, në përputhje me këtë ndikim,* ***pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose jo ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar çon ose jo në rezultatin e synuar.***". Nëpërmjet këtij parashikimi, Konventa imponon për shtetet palë marrjen e masave legjislative jo vetëm për ndëshkimin e veprave penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv, por edhe të atyre veprimeve që favorizojnë ose nxisin këtë të fundit. Kriminalizimi i kësaj vepre penale, duke zbatuar detyrimet që burojnë nga Konventa, synon të parandalojë rrethin e ngushtë të zyrtarëve apo të subjekteve politike, duke ndaluar ndikimin e paligjshëm të atyre që janë afër me zyrtarin dhe ushtrimin e pushtetit publik a privat dhe që përfitojnë favore të parregullta prej pushtetit. Në të njëjtën mënyrë, në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, në nenin 18, nën titullin "Trafikimi i influencave", parashikohet se "*Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim: a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik ose çdo personi tjetër, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, e një avantazhi të parregullt, me qëllim që nëpunësi publik ose personi të keqpërdorë influencën e tij të vërtetë ose të prezumuar me qëllim që të merret nga një organ administrativ ose publik i shtetit palë i një avantazhi të parregullt për nxitësin e parë të këtij akti ose për çdo person tjetër. b) kërkimi ose pranimi nga një nëpunës publik ose një person tjetër, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, të një avantazhi të parregullt për vetë ose një person tjetër, me qëllim që nëpunësi publik ose personi të keqpërdorë influencën e tij ose të saj të vërtetë ose të prezumuar me qëllim që të përftohet nga një organ administrativ ose publik i shtetit palë i në avantazhi të parregullt*". Në referim të sa më sipër, gjykata vlerëson se kjo figurë e veprës penale, në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, ka për qëllim të marrë në mbrojtje marrëdhëniet juridike që garantojnë ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me ligjin dhe interesin publik si dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe të shtetit, duke përbërë një figurë të veprës penale e cila në parim, paraprin veprat penale të korrupsionit dhe bën pjesë në kategorinë e veprave të kësaj natyre në kuptim të akteve ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit.

1063. Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", gjykata vlerëson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Që të kemi konfigurimin e veprës penale të ushtrimit të

---

[81] *Ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006*

ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme në një nga këto forma, konkretisht *(i)* duke premtuar për t'i ofruar, *(ii)* propozuar ose *(iii)* dhënë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt personit, i cili premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Nga ana pasive kërkohet që subjekti të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Në këtë rast shkaku i përfitimit të parregullt qëndron në propozimin, premtimin ose dhënien apo kërkimin, marrjen apo pranimin, e përfitimit të parregullt, për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të krijimit të një marrëdhënie të kundërligjshme midis korruptuesit dhe të korruptuarit, pra jo për shkak të ushtrimit apo mos ushtrimit të detyrës së nëpunësit publik. Në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal nuk parashikohet lidhja midis ushtrimit të detyrës midis funksionarit publik dhe ushtruesit të ndikimit të paligjshëm, pasi sjellja e subjektit aktiv që kryen ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndodh më përpara në kohë dhe qëndron e pavarur në raport me marrëdhënien korruptive midis të ndërmjetësuarit dhe funksionarit publik[82]. Në dallim nga veprat penale të korrupsionit ku *premtimi, propozimi* ose *dhënia*, i drejtohet personit që ushtron funksionin publik, në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, i drejtohet personit që premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm. Në thelb vepra penale e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm pasiv, është një vepër penale *paraprake dhe përgatitore* në raport me veprën penale të korrupsionit aktiv, sepse krijon kushtet që personi që merr përsipër se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, të avancoj më tej me veprimet e tij duke i premtuar, propozuar ose

---

[82] Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 139, datë 22.11.2017 lidhur me anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal në raport me veprën penale që lidhet me korrupsionin pasiv (në rastin konkret atë të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, ndër të tjera arsyeton se : *"Që të kemi konfigurimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, nga ana objektive kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme: 1) nga ana aktive, duke premtuar për t'i ofruar, ose propozuar ose dhënë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt personit, i cili premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Ndërsa nga ana pasive: 2) kërkohet që subjekti aktiv të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Dallimi midis nenit 245/1 të Kodit Penal dhe nenit 319/ç, qëndron në shkakun e përfitimit të parregullt, në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, përfitimi i parregullt jepet apo kërkohet për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të krijimit të një marrëdhënie të kundërligjshme midis korruptuesit dhe të korruptuarit, pra jo për shkak të ushtrimit apo mos ushtrimit të detyrës së nëpunësit publik. Në rastin e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal nuk parashikohet lidhja midis ushtrimit të detyrës midis funksionarit publik dhe ushtruesit të ndikimit të paligjshëm, pasi sjellja e subjektit aktiv që kryen ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndodh më përpara dhe jashtë kryerjes së marrëdhënies korruptive midis të ndërmjetësuarit dhe të korruptuarit (pactum sceleris)."*.

dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik.

1064. ***Në lidhje me subjektin e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal,*** rezulton se ai është i përgjithshëm, çka do thotë se duhet të përmbushe kushtet thelbësore të parashikuara nga ligji material penal në lidhje me moshën për përgjegjësi penal sipas parashikimeve të nenit 12 të Kodit Penal, si dhe kushtin e përgjegjshmërisë në kuptim të nenit 17 të këtij Kodi.

1065. ***Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale***, gjykata vlerëson se vepra penale e "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejte, çka do të thotë se subjekti i veprës penale duhet të veprojë me vullnet dhe ndërgjegje të plotë për të ndikuar në veprimtarinë e një subjekti funksionar publik, me qëllim përfitimi të parregullt për vete ose për persona të tjerë, veprime të cilat cenojnë të autoritetin e shtetit dhe veprimtarinë e rregullt të organeve të tij *(dashja direkte)*. Ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Në këtë këndvështrim veprimet e subjektit të veprës penale duhet të konkretizojnë dhe dëshmojnë në botën e jashtme vullnetin e tij për të vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, duke parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, me qëllim ushtrimin e ndikimit të paligjshëm tek personi që ushtron funksione publike.

1066. Gjykata vlerëson faktet që kanë rezultuar nga provat e administruara në gjykim, në raport me elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet secili prej te pandehurve, si më sipër, duke mbajtur në konsideratë: (i) parimin e ligjshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 29, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ dhe nenin 1 të Kodit Penal; (ii) standardin e provueshmërisë në procesin penal, sipas të cilit ekzistenca dhe provueshmëria e njëkohshme, duke përmbushur standardin e të provuarit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" sipas përcaktimeve të nenit 390, pika 1 të K.Pr.P, duhet të rezultojnë për të katër elementët e figurës së veprës penale pasi, mungesa e ekzistencës ose provueshmërisë qoftë dhe e njërit prej tyre, passjell pamundësinë e marrjes se personit nën përgjegjësi penale dhe eventualisht deklarimin fajtor të tij dhe zbatimin e një sanksioni penal; (iii) parimin e barrës së provës sipas të cilit prokurori ka për detyrë të bindë gjykatën mbi ekzistencën dhe provueshmërinë e të gjithë elementëve që përbëjnë figurën e veprës penale konkrete, si në drejtim të elementeve të anës objektive ashtu edhe ato të anës subjektive të saj, parim që ky derivon nga parimi i prezumimit të pafajësisë sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës, nenit 6, pg 2 të KEDNJ dhe neni 483 i K.Pr.Penale. Po ashtu, në vlerësimin e fakteve që rezultojnë nga provat në raport me elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, gjykata bën vlerësimin e tyre, në saje të një procesi kompleks, të kujdesshëm dhe racional, nëpërmjet të cilit provat të cilat plotësojnë standardin e ligjshmërisë së marrjes së tyre në kuptim të nenit 151 të K.Pr.P, do të çmohen dhe vlerësohen në

drejtim të të dhënave që ofrojnë mbi faktin penal në raport me besueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, vlerën provuese të tyre dhe përputhjen me njëra-tjetrën, sipas përcaktimeve të nenit 152 dhe 380 të Kodit të Procedurës Penale[84].

1067. ***Referuar sa më sipër, në raport me të pandehurit Atli Jashari, Sazan Ibra dhe Xhafer Elezi,*** Gjykata krijoi bindjen e brendshme se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se secili nga këta të pandehur e ka konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohet nga ana e prokurorisë. Gjykata çmon gjithashtu të theksojë se vetë teksti i K.Pr.Penale, në nenin 152/2 të tij, lejon provueshmërinë e ekzistencës së një fakti në rast të indicjeve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, duke nënkuptuar kështu domosdoshmërish praninë e dy apo më shumë indicjeve, të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e rëndësisë; saktësisë; dhe përputhmërisë me njëra-tjetrën.

1068. Mbështetur në këto rregulla, Gjykata çmon se, i pandehuri **Atli Jashari** ka pranuar një shumë të hollash për të ndihmuar shtetasin Robert Saraçi në lidhje e trajtimin e çështjes për të cilën ai ishte i interesuar pranë Prokurorisë së Rrethit Kukës si dh epër kthimin e mjetit të sekuestruar në kuadër të këtij procedimi penal. Kjo për këto arsye: (i) ***Së pari***, nga biseda e zhvilluar në datë 17.05.2021 mes shtetasit Robert Saraçi dhe të pandehurit Sazan Ibra dhe më pas më të pandehurin Klevis Salkurti, rezulton se ky i fundit i ka dhënë Robertit numrin e telefonit të të pandehurit Atli Jashari, dhe pas komunikimit ai ka lënë të takohet me të. (ii) ***Së dyti***, rezulton se pas takimit, për të cilin nuk ka prova të drejt drejtpërdrejta por komunikimet telefonike përbëjnë indicje që japin të dhëna të sakta dhe të besueshme për realizimin e tij, nga komunikimi i shtetasit Robert Saraçi me vëllain e tij Erjon Saraçi, rezulton se Roberti ka takuar "oficerin" që rezulton që ka dijeni për çështjen dhe në bisedë referohet se i ka dhënë atij një shumë parash me qëllim që të "flasë" pra ndikojë tek prokurori për të zgjidhur çështjen. Konkretisht mes këtyre shtetasve zhvillohet kjo bisedë e transkriptuar në procesverbalin përkatës : *"Roberti: Më thotë ky oficeri që nuk do të bisedojmë me asnjë, do ta mbyllë ai çdo gjë edhe me prokurorin e çështjes do të flasë ai. Unë po i lë paraprakisht një 300 mijë lekësh. Erjoni:Jo 200 lëri njëherë..Roberti:Po ca 200 ai do shkojë të flasë edhe me Prokurorin..... Erjoni:Ok leri 300....".* (iii) ***Së treti***, me herët, në datë 16.05.2021, në bisedat e regjistruar të zhvilluara mes Sazan Ibres i cili gjithashtu interesohet për të zgjidhur problemin e Robert Saraçit, dhe Xhafer Elezit, janë zhvilluar biseda që lidhen me këtë ngjarje dhe pikërisht me kryerjen e bisedave dhe "dhënien e një shume parash" në drejtim të oficerit që ka çështjen i cili rezulton te jete Atli Jashari për të ndikuar ky i fundit në zgjidhjen e problemit. Ndër të tjera në bisedat e zhvilluara në datë 16.05.2021 duke i kërkuar të mundësojnë takimin me Atli Jasharin (oficerin referuar bisedës në të cilën përmendet saktësisht emri i personit që do të takojnë) ditën e nesërme, pra në datë 17.05.2021, i thotë : *Sazani:A të vij nesër me të mos bejmë ndonjë punë.....Sazani:Po mirë bisedoje njëherë atë dhe një kafe tha i japim..Xhaferi:Po po me kë më Atlinë? Sazani: Po ai e ka në dorë se ka ba atë. Nuk i ka bo ato letrat më duket. Xhaferi: Si ka be e? Sazani: Jo shif një*

[84] Në këtë pjesë te vendimit janë referuar shkurtimisht elementet përkatës, të cilët janë analizuar nga gjykata në mënyrë më të zgjeruar në paragrafët 601 dhe 604 të këtij vendimi, analiza e cila është e njëjtë në raport m vlerësimin e gjykatës mbi secilin fakt penal dhe përgjegjësinë penale të secilit prej të pandehurve.

herë mos ja nxjerrim se. Xhaferi:Qe po hy në lidhje me Atlinë një herë ti them. Sazani: Shife një herë dhe thua, premtoji ndonjë gjë ndonjë kafe....". (iv) ***Së katërti***, në bisedat e përgjuara të zhvilluara në datë 17.05.2021 mes Sazan Ibrës dhe Robert Saraçit rezulton nga një sms e dërguar prej tij në drejtim të Roberit, se ata do të udhëtojnë drejt Kukësit, pasi në mesazh Sazani drejtohet me fjalët :"*O Bert jam me Kastriotin na gjeje makinën të takojmë prokurorin e Kuksit".*". (iv) ***Së katërti,*** nga aktet e dosjes që lidhet me procedimin penal për të cilin interesohet shtetasi Robert Saraçi, dhe konkretisht aktet e përcjella nga Prokuroria e Rrethit Kukës me shkresën nr. 1763/1 prot.,datë 20.06.2022, rezulton se në kohën që zhvillohen ngjarjet si më sipër, aktet e procedimit penal që lidhet me ngjarjen e datës 10.05.2021, deri në datë 18.05.2021 janë kryer dhe administruar nga i pandehuri Atli Jashari në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka bërë edhe referimin e tyre në prokurori. (v) ***Së pesti***, nga tërësia e komunikimeve të zhvilluara në muajin qershor 2021, rezulton se Atli Jashari ka kryer komunikime të drejtpërdrejta me shtetasin Robert Saraçi dhe e ka takuar atë në momente të ndryshme kohore. Konkretisht rezultojnë komunikimet e datës 01.06.2021 (ku Roberti komunikon me Atliun nga numri i regjistruar ne emër të bashkëshortes së tij) ku ndër të tjera i jep informacion se çështja sipas tij është pushuar, duke iu drejtuar ndër të tjera me fjalët :" *Roberti: Qysh bohet mo shoku im më kanë thërrit ditën e enjte andej?Atliu:...Ja se do të them unë se e kanë, tashi dalin vendimet se e kanë pushuar..Roberti:A të vij të takoj ditën e enjte njëherë të pimë kafe?...".* Ndërkohë që sipas akteve të procedimit penal të administruar në cilësinë e provës rezulton se kërkesa për pushimin e çështjes është hartuar nga Prokurori muaj më vonë se sa zhvillohet kjo bisedë dhe konkretisht në muajin nëntor 2021. Po ashtu nga bisedat e zhvilluara mes tyre rezulton se janë takuar në Kukës dhe kanë konsumuar kafe së bashku. Këto komunikime të tyre, tregojnë qartë jo vetëm njohjen por dhe veprimtarinë e të pandehurit Atli Jashari për të ndihmuar shtetasin Robert Saraçi për të zgjidhur problemin që ia kishte në lidhje me procedimin penal, edhe pse Atliu tashmë nuk kishte më asnjë atribut ligjor mbi veprimet hetimore pasi prej datës 18.05.2021 dhe në vijim ato rezulton të jenë kryer nga një tjetër oficer i policisë gjyqësore.

1069. Duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga provat si më sipër referuar, disa prej të cilave (*komunikimet e të tretëve ku nuk është i përfshire në mënyrë direkte i pandehuri Atli Jashari por flitet për të*) vlerësohen nga gjykata se përbëjnë indicje, të cilat të vlerësuara në raport me njëra tjetrën dhe me provat e marra në gjykim, vlerësohet të jene të sakta dhe në unitet me to në kuptim të nenit 152 të K.Pr.Penale, krijojnë tek gjykata bindjen e brendshme, të bazuar në provat e administruara në gjykim dhe të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, se i pandehuri Atli Jashari, ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal duke premtuar dhe siguruar se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm tek personi që ushtron funksione publike (*në këtë rast tek personat që trajtojnë çështjen për të cilën interesohet Robert Saraçi dhe të pandehurit e tjerë)* pavarësisht se nuk provohet, sikurse prokuroria parashtron në faktin objekt akuze, se ky ndikim ka ndodhur realisht pasi rezulton se kërkesa e prokurorisë për pushimin e çështjes daton disa muaj me vone se sa zhvillohen ngjarjet në fjalë dhe për me tepër është miratuar duke u vlerësuar si e ligjshme, me vendimin gjyqësor të formës së prere dhe

konkretisht me vendimin nr. 1531/503, datë 29.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Po ashtu, në kushtet kur rezulton se i pandehuri Atli Jashari në lidhje me çështjen në fjalë ka kryer vetëm veprimet e para hetimore dhe nuk ka pasur më asnjë tagër apo mundësi "ta zgjidhë" vetë atë, shuma e parashtruar se është dhënë nga Robert Saraçi, premtuar dhe përmendur një ditë më parë në bisedat midis Sazan Ibres dhe Xhafer Elezit, nuk mund të kolaudohet se është kërkuar dhe marrë prej tij, por në kushtet kur nga tërësia e të dhënave të administruara rezulton se ai ka marrë përsipër të ushtrojë ndikim të funksionaret që trajtojnë ligjërisht çështjen përkatëse, gjykata vlerëson se shuma e parave (përfitimit të kundërligjshëm) ka të dhëna se është propozuar prej tij me qëllim ofrimin e saj më vijim pikërisht personave që ndikonin për të zgjidhur çështjen.

1070. Në lidhje me të pandehurin Atli Jashari, rezulton se akuza ka referuar në faktet e çështjes (*referuar akuzës së komunikuar të pandehurit, kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare*) edhe një fakt tjetër që lidhet me disa komunikime të zhvilluara ndërmjet tij me një shtetas i cili interesohet për të marrë informacion dhe një dokument (autorizim të përkthyer dhe noterizuar) nga dosja e shtetasit që në biseda referohet me emrin Rasim Llapashtica. Këto komunikime të zhvilluara në muajin maj 2021 japin të dhëna se Atli Jashari, në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, ka komunikuar me këtë shtetas, i cili sipas deklarimit të Atliut ka qenë avokati i shtetasit Rasim Llapashtica, referojnë dhe japin të dhëna për veprime të të pandehurit për të ndihmuar apo asistuar shtetasin me të cilin komunikon për të marrë dokumentin që ndodhet në dosje apo kopje të tij por nuk japin asnjë të dhënë të vlerësueshme në drejtim të prezencës së elementëve të veprës penale për të cilën ai akuzohet apo për elementë të ndonjë vepre tjetër penale.

1071. Po ashtu, në faktin që i referohet të pandehurit Atli Jashari, referohet edhe komunikimi i tij i datës 25.05.2021 me shtetasin Tonik Kaci, që siç rezulton është koleg i tij, dhe ky i fundit e pyet mbi faktin që ka thirrur për të pyetur shtetasin që referohet ne bisedë me emrin Edison Skënderaj. Veç kësaj bisede, lidhur me ketë çështje është administruar me shkresën nr. 726/1 prot., datë 21.04.2022 të Prokurorisë së Rrethit Kukës praktika e procedimit penal ndaj shtetasit Edison Skënderaj, nga ku rezulton se ky person është proceduar për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal dhe me urdhrin penal nr. 27, datë 25.05.2021 të prokurorit është deklaruar fajtor dhe dënuar për këtë vepër penale. Rezulton nga aktet se oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer hetimin në lidhje me këtë procedim është i pandehurit Atli Jashari, por nuk rezulton asnjë e dhënë për ndonjë veprim të kundërligjshëm të tij në drejtim të veprës penale për të cilën procedohet apo për ndonjë vepër tjetër penale. Komunikimi me shtetasin Tonin Kaci për këtë fakt rezulton krejtësisht i zakonshëm, dhe nuk ka asnjë të dhënë të vlerësueshme në drejtim të prezencës së ndonjë veprimi të kundërligjshëm nga ana e të pandehurit Atli Jashari lidhur me këtë fakt që përmendet në faktet penale lidhur me këtë të pandehur.

1072. Në këtë drejtim, sikurse është analizuar më sipër në këtë vendim gjyqësor lidhur me veprat penale për të cilat procedohen të pandehurit e tjerë, gjykata është e obliguar të marrë në shqyrtim dhe të analizojë çdo fakt të referuar nga ana e organit të akuzës, në mungesë të ndonjë mjeti procedural për të kërkuar saktësimin e saj nga organi i akuzës, gjatë gjykimit të çështjes në

themel, kur faza e seancës paraprake gjatë së cilës ligjvënësi ka parashikuar mjetet procedurale për saktësimin e akuzës tashmë është përmbyllur, për sa kohë që akuza e formular ndaj të gjithë të pandehurve, rrjedhimisht edhe ndaj të pandehurit Atli Jashari, është e paqartë dhe e pa konkretizuar por referon të gjitha faktet që japin provat, ku rezulton i përfshirë ky i pandehur.

1073. Në lidhje me të pandehurit Sazan Ibra dhe Xhafer Elezi, në drejtim të provueshmërisë së elementëve të anën objektive të veprës penale për të cilën akuzohen, gjykata vlerëson se në veprimet e secili prej tyre, rezulton e provuar se ata kanë premtuar dhe propozuar dhënien e një shumë parash, të identifikuar në bisedat e tyre në mënyrë të tërthortë me fjalën "kafe" në drejtim të shtetasit Atli Jashari, me qëllim ushtrimin e ndikimit të këtij të fundit të prokurori që ka pasur në procedim çështjen penale për të cilën interesohet shtetasit Roberet Saraçi (*lidhje e drejtpërdrejtë e Sazan Ibres dhe nëpërmjet këtij të fundit është konstatuar dhe interesohet për të fakt edhe i pandehuri Xhafer Elezi i cili nga ana e tij nuk rezulton e provuar se njeh Robertin drejtpërdrejt*). Ky fakt rezulton nga tërësia e të dhënave që japin provat e administruara në gjykim në lidhje më këtë fakt penal dhe konkretisht : (i) *Së pari*, nga përmbajtja e komunikimeve te zhvilluara nga shtetasi Robert Saraçi rezulton se ai vendoset ne kontakt me të pandehurin Sazan Ibra, me ndërmjetësimin e personave të tjerë, pasi ka ndodhur ngjarja e datës 11.05.2021, objekt i procedimit penal që do të zhvillohej në vijim pranë Prokurorisë së rrethit Kukës; (ii) *Së dyti*, rezulton se në datë 17.05.2021 Robert Saraçi ka komunikuar me të pandehurin Sazan Ibra dhe kanë lënë që të takohen me njëri tjetri dhe për këtë takim të zhvilluar, për të cilin nuk ka prova të drejtpërdrejta, jep të dhëna mbi bisedat e zhvilluara mes Robertit dhe Sazanit, komunikimi i tij, pra Robertit me të pandehurin Klevis Salkurti, ku ndër të tjera Roberti i thotë Klevisit se *me atë vlerë që i ka kërkuar ai me marrë, blen fugon të ri*. Ky i fundit e pyet se sa i ka kërkuar dhe Roberti i thotë *se janë shumë, janë mbi 500 mijë lekë*, kjo për të ndihmuar për të marrë mbrapsht fugonin.; (iii) *Së treti*, nga përmbajtja e komunikimeve të zhvilluara në datë 16.05.2021 me të pandehurin Xhafer Elezi, rezulton se Sazan Ibra komunikon mbi mundësinë e takimit të oficerit me emrin "Atli" dhe për këtë duket se kërkon ndërmjetësimin e Xhafer Elezit dhe mes tyre, zhvillohet ndër te tjera edhe biseda gjatë së cilës propozohet dhënia e shpërblimit në këmbim të këtij ndikimi që do të ushtrojë Atliu dhe konkretisht komunikojnë si më poshtë: *"...Sazani:A të vij nesër me të mos bejmë ndonjë punë. Xhaferi: Po nesër sikur vonohet më shumë se ditët e tjera Sazan ....Sazani: Po mirë kur të dush ti, 11, 12 or ti...Xhaferi: po mirë mbas orës 12 e mbas nise, s'mbaroj dot përpara. Sazani:Po mirë bisedoje njëherë atë <u>dhe një kafe tha i japim</u>.. Xhaferi:Po po me kë më Atlinë? Sazani: Po ai e ka në dorë se ka ba atë. Nuk i ka bo ato letrat më duket. Xhaferi: Si ka be e? Sazani: Jo shif një herë mos ja nxjerrim se. Xhaferi:Qe po hy në lidhje me Atlinë një herë ti them. Sazani: Shife një herë dhe thua, premtoji ndonjë gjë ndonjë kafe. Xhaferi: Mirë, mirë ajde ti them të më dalë me një numër tjetër në telefon.." duke vijuar komunikimin në një moment të mevonshëm të po kësaj datë, ku ndër të tjera thuhet: "Sazani: Hë Drejtor. Xhaferi:Degjo, nesër jo. Atlia është te shtëpia. Sazani: po.Xhaferi: Po i paska cu në prokurori ato ai. Sazani: Pse i ka cu në prokurori aaa?Xhaferi:Po në prokurori, po duhet, nesër jo tha të kallzoj unë se kur me ashtu, se do me mar urdhërin e prokurorit, tha se pa marrë urdhërin se bëj dot.Sazani: Dakord, mirë pra që ti them edhe*

ketij.Xhaferi: Po thuj atij që të do bisedojmë, do jemi në kontakt tha të kallzoj unë tha Atlia vetë....". (iii) *Së treti*, nga aktet e dosjes që lidhet me procedimin penal për të cilin interesohet shtetasi Robert Saraçi dhe për llogari të tij edhe Sazan Ibra dhe Xhafer Elesi, sipas komunikimeve si më sipër, dhe konkretisht aktet e përcjella nga Prokuroria e Rrethit Kukës me shkresën nr. 1763/1 prot.,datë 20.06.2022, rezulton se në kohën që zhvillohen ngjarjet si më sipër, aktet e procedimit penal që lidhet me ngjarjen e datës 10.05.2021, deri në datë 18.05.2021 janë kryer dhe administruar nga i pandehuri Atli Jashari në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka bërë edhe referimin e tyre në prokurori. (iv) *Së katërti*, në deklarimet e tyre të pandehurit Atli Jashari dhe Xhafer Elezi pranojnë se kanë zhvilluar mes tyre biseda në kohën që zhvillohen ngjarjet si më sipër, pavarësisht se referojnë se kanë komunikuar vetëm në lidhje me interesimin e thjeshte mbi gjendjen e procedimit penal për të cilin interesohen, por ndërkohë nga komunikimet e zhvilluara mes personave të përfshirë në këtë ngjarje, rezulton qartë se të pandehurit Sazan Ibra dhe Xhafer Elezi, kanë kryer veprime aktive të kundërligjshme nëpërmjet marrjes përsipër dhe premtimit të përfitimeve të kundërligjshme në drejtim të të pandehurit Atli Jashari ,me qëllim ushtrimin prej këtij te fundit të ndikimit për zgjidhjen e çështjes për të cilën ata tregojnë interes.

1074. Duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga provat si më sipër referuar, disa prej të cilave (*komunikimet ku nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt të pandehurit Xhafer Elezi ose Saan Ibra*) vlerësohen nga gjykata se përbëjnë indicje, të cilat të vlerësuara në raport me njëra tjetrën dhe me provat e marra në gjykim, vlerësohet të jene të sakta dhe në unitet me to në kuptim të nenit 152 të K.Pr.Penale, krijojnë tek gjykata bindjen e brendshme, të bazuar në provat e administruara në gjykim dhe të vlerësuara në unitet me njëra tjetrën, se të pandehurit Sazan Ibra dhe Xhafer Elezi, kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal duke propozuar dhënien e përfitimit të paligjshëm ndaj personit i cili premton se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm (Atli Jashari) tek personi që ushtron funksione publike (në këtë rast prokurori përkatës) pavarësisht se nuk provohet, sikurse prokuroria parashtron në faktin objekt akuze, se ky ndikim ka ndodhur realisht pasi rezulton se kërkesa e prokurorisë për pushimin e çështjes daton disa muaj me vone se sa zhvillohen ngjarjet në fjalë dhe për me tepër është miratuar duke u vlerësuar si e ligjshme, me vendimin gjyqësor të formës së prere dhe konkretisht me vendimin nr. 1531/503, datë 29.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

1075. *Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale. Gjykata* vlerëson se, vepra penale e "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*" parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë, dhe e rëndësishme është që autori i saj të veprojë me vullnet dhe ndërgjegje të plotë për të ndikuar në veprimtarinë e një subjekti funksionar publike me qëllim përfitime të parregullta për vete ose për persona të tjerë, veprime të cilat cenojnë të autoritetin e shtetit dhe veprimtarinë e rregullt të organeve të tij *(dashja direkte)*. Kështu, në plotësim të këtij elementi, Gjykata çmon se të pandehurit Atli Jashari, Xhafer Elezi dhe Sazan Ibra, kanë vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ata kanë parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tyre dhe kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke propozuar një përfitim të parregullt

në drejtim të personit që siguron se mund të ushtrojë ndikim tek funksionari publik (për të pandehurit Xhefer Elezi dhe Sazan Ibra propozimi i tyre referohet në drejtim të të pandehurit Atli Jashari ndërsa për të pandehurin Atli Jashari, propozimi referohet në drejtim të prokurorit të çështjes, pavarësisht se asnjë prej këtyre elementeve nuk ka arritur të provohet se ka ndodhur realisht, por arritja e këtij qëllimi (ndikimit) apo ardhja e pasojave, referuar parashikimeve të nenit 245/1 të K.Pr.Penale nuk janë të qenësishme për ekzistencën e veprës penale.

1076. ***Në lidhje me subjektin e veprës penale.*** Në rastin konkret, të pandehurit Atli Jashari, Xhafer Elezi dhe Sazan Ibra në kohën e kryerjes së veprës penale rezulton se kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale në referim të nenit 12/1 të Kodit Penal, dhe për pasojë, kanë qenë madhore e të përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që të pandehurit të vuajnë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tyre mendor dhe për pasojë nuk kanë qenë në gjendje të kontrollojnë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryen vepër penale, për pasojë janë të përgjegjshëm në kupitm të nenit 17 të Kodit Penal. Me veprimet e tyre provohet që ata kanë qenë të aftë të posedojnë aftësi intelektuale dhe volitive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tyre dhe t'a kontrollojnë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se të pandehurit janë të përgjegjshëm penalisht në referim të parashikimeve të neneve 12 dhe 17 të Kodit Penal.

1077. Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se të pandehurit **Atli Jashari, Xhafer Elezi dhe Sazan Ibra**, duhet të deklarohen fajtorë për veprën penale të *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 1 i Kodit Penal, pasi secili, me veprimet individuale të tij, sikurse rezultoi nga vlerësimi i provave të administruara në gjykim, ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet.

1078. Lidhur me të pandehurin **Klevis Salkurti**, rezulton se Prokuroria ka ngritur ndaj tij akuzën e kryerjes së veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit te paligjshëm ndaj personave qe ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga nenet 245/1, pg 1 i Kodit Penal. Gjykata nga vlerësimit tërësor i të dhënave që rezultojnë nga provat e administruara gjatë gjykimit, në raport me katër elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, analizuar më sipër në këtë vendim vlerëson se nuk rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se akuza ndaj të pandehurit Klevis Salkurti është e bazuar në prova.

1079. Duke iu referuar në tërësi fakteve të bëra prezent nga prokuroria në akuzën njoftuar të pandehurit si dhe në faktin penal objekt gjykimi, sipas kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura, rezulton se i pandehuri Klevis Salkurti, akuzohet për kryerjen e veprimeve për ushtrim ndikimi të paligjshëm tek i pandehuri Atli Jashari për të zgjidhur problemin e shtetasit Robert Saraçi lidhur me procedimin penal që zhvillohej pranë Prokurorisë së Rrethit Kukës dhe kthimin e mjetit për të cilin ky shtetas është i interesuar.

Nga provat e administruara, në drejtim të të pandehurit Klevis Salkurti rezulton përfshirja e tij vetëm në një bisedë e cila rezulton të jetë zhvilluar në kontestin e përshkruan më sipër në rrethanat e faktit të përshkruara më sipër, dhe konkretisht biseda e tij e datës 17.05.2021 ora 8.53

minuta (paradite) zhvilluar mes tij dhe të pandehurit tjetër Sazan Ibra. Gjatë kësaj bisede rezulton se (i) i pandehuri Klevis Salkurti është në dijeni të situatës për të cilën interesohet shtetasi Robert Saraçi në lidhje me procedimin penal; (ii) ai komunikon me të pandehurin Sazan Ibra duke i bërë me dije se ka komunikuar më herët gjatë asaj ditë me shtetasin Robert Saraçi; (iii) Sazani i komunikon se do të shkojë të interesohet për problemin e Robert Saraçit sepse është vënë në dijeni se çështja ka kaluar në prokurori ndërsa Klevisi dëgjohet ti thotë në këtë kontekst që të mos merret me këtë gjë pasi Roberti nuk përgjigjet më shumë se aq, siç shprehet sepse aq i bën vetë mjeti që kërkon ti kthehet. Konkretisht midis të tjerash mes Klevis Salkurtit dhe Sazan Ibres thuhen këto fjalë: "...*Sazani: Po jam tu shku një herë se i kanë kaluar letrat në Prokurori o burr. Klevisi: Po leje se i kanë kaluar letrat sun të bëjmë gjë atje neve.... i:Pse? Klevisi: Edhe ai nuk përgjigjet më shumë sesa e diskutuam dje neve...Sazani:Jo jo jam tu shku ta takoj se kam fut një shok tek prokurori.Klevisi:Jo mor burrë mos u lodh se nuk jep me shumë sesa aq, se aq i bën makina atij, leje mos u lodh fare.. Sazani: Epo mirë pra....Klevisi: Se më tha kshu, kshu tha, unë tha aq e kam ble makinën, le ta mbajnë makinën, s'po më duhet. Sazani:Mirë o komandant hajt..*". Këto janë aspektet e vetme që rezultojnë nga ky komunikim në të cilin është përfshirë i pandehuri Klevis Salkurti dhe nuk rezulton të jete administruar asnjë provë apo e dhënë tjetër që të dokumentojë kryerjen prej tij te veprimeve aktive të kundërligjshme në funksion të ushtrimit të ndikimit të kundërligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Këto të dhëna që rezultojnë nga komunikimi i vetëm i përgjuar mes tij dhe të pandehurit tjetër Sazan Ibra krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi angazhimin e tij në këtë ngjarje por nuk rezulton që të jetë kryer asnjë veprim hetimor i mëtejshëm në drejtim të gjetjes dhe administrimit të provave të cilat vërtetojnë ndodhjen e një fakti që përbën vepër penale në të cilën ky shtetas është angazhuar, nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme me të cilat konkretizohet ana objektive e veprës penale për të cilën akuzohet. Në këto kushte, i vetëm, ky komunikim mes tij dhe të pandehurit Sazan Ibra, provon dijeninë e të pandehurit Klevis Salkurti në lidhje me problematikën e shtetasit Robert Saraçi dhe veprime të mundshme të të pandehurve të tjerë, ku dhe kjo e fundit nuk rezulton dhe nuk provohet saktësisht, por nuk mund të shërbejë si bazë për të mbështetur akuzën ndaj këtij të pandehuri. Kjo pasi në të dhënat që rezultojnë nga ky komunikim, nuk evidentohen dhe për pasojë nuk provohen, për më tepër në nivelin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" të paktën një nga format e kryerjes së veprës penale për të cilën ai akuzohet dhe konkretisht kryerja e veprimeve aktive të kundërligjshme duke premtuar për t'i ofruar, propozuar ose dhënë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt personit, i cili premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike. Nga ana pasive kërkohet që subjekti të kryejë veprën penale nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme, duke kërkuar, marrë ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, nga personi që ka kërkuar këtë veprim. Në këtë rast shkaku i përfitimit të parregullt qëndron në propozimin, premtimin ose dhënien apo kërkimin, marrjen apo pranimin, e përfitimit të parregullt, për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të krijimit të një marrëdhënie të kundërligjshme midis korruptuesit dhe të korruptuarit, pra jo për shkak të ushtrimit apo mos

ushtrimit të detyrës së nëpunësit publik. Në rastin konkret, nga biseda e vetme që rezulton e provuar se i pandehuri Klevis Salkurti ka zhvilluar me të pandehurin Sazan Ibra, në kontekstin e zhvillimit të faktit konkret, nuk rezulton të evidentohet dhe as të provohet prezenca e elementëve të anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet.

1080. Në rastin konkret, në të gjithë elementet e faktit në të cilat rezulton se referohet vetëm një komunikim telefonik mes tij dhe te pandehurit Sazan Ibra, si dhe konteksti dhe përmbajtja e vetë këtij komunikimi, analizuar më sipër, gjykata vlerëson se nuk rezultojnë të jenë prezent elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet në veprimet dhe mosveprimet e tij, pasi nuk evidentohen dhe as rezultojnë veprime ose mosveprime të kundërligjshme të tij të cilat ravijëzojnë prezencën e ndonjë forme të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Komunikimet telefonike të tij, vetëm në një moment kohor, referojnë të dhëna të cilat mund të përbënin bazë për organin e akuzës për të hetuar me tej nëse ky i pandehur është përfshirë në veprime të ofrimit, propozimit apo dhënies së përfitimeve të kundërligjshme në drejtim të personit që premton se mund të ushtroje ndikim tek një person që ushtron funksione publike, dhe vetëm nëse do të vërtetohej angazhimi i të pandehurit në një veprimtari të tillë, të hetohej ne drejtim të kualifikimit dhe provueshmërisë së tyre si fakte penale në raport me veprimet e të pandehurit konkret. Në rastin konkret, komunikimi i te pandehurit, duke iu referuar edhe kontekstit dhe përmbajtjes së tij, nuk ofron të dhëna mbi veprime të kundërligjshme të të pandehurit Klevis Salkurti në drejtim të realizimit të elementeve të anës objektive të veprës penale për të cilën akuzohet. Në këtë rast akuza mbështetet vetëm mbi një komunikim telefonik të izoluar dhe të vetëm, ndërsa mbetet e pa provuar se i pandehurit Klevis Salkurti është angazhuar konkretisht në veprime aktive të kundërligjshme. Ky komunikim telefonik minimalisht mund të krijojë dyshim të arsyeshëm por nuk konkretizon dhe nuk përmban në vetmeve elemente që japin të dhëna mbi prezencën e elementeve të veprës penale për të cilën ai akuzohet, e për më tepër nuk mund të ngrihet në kufijtë e të provuarit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" jo vetëm të ekzistencës së faktit penal por edhe të fajësisë së të pandehurit në raport me të.

1081. Në përfundim gjykata vlerëson se komunikimi telefonik në të cilin rezulton se referohen të dhëna për të pandehurin Klevis Salkurti, duke konsideruar edhe përmbajtjen e vetë këtij komunikimi, nuk përbën as indicje dhe për me tepër provë, në raport me këtë të pandehur për të vërtetuar akuzën e ngritur ndaj tij. Te vetme, këto të dhëna nuk mund të jenë të afta të provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementet e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit në raport me ketë vepër.

1082. *Sa më sipër*, gjykata vlerëson se në faktet në të cilët konsiston akuza ndaj të pandehuri Klevis Salkurti, nuk rezultojnë dhe nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale për të cilën ai akuzohet. Në këtë drejtim, gjykata e gjen me vend të ritheksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri konkret. Ndodhur në këto kushte, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga

neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *"1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit."*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: *"Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës.."*. Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në rastin konkret, nga analiza e të gjitha provave të cilat japin të dhëna mbi të pandehurin (komunikimi telefonik i tij me të pandehurin Sazan Ibra), gjykata vlerëson se jo vetëm që ndodhemi në kushtet kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit por ndodhemi para situatës kur ky fakt nuk provohet se ka ndodhur në të vërtetë në raport me të pandehurin Klevis Salkurti.

1083.Në kushtet kur për të pandehurin Klevis Salkurti nuk provohen elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, pasur parasysh se katër elementët e figurës së veprës penale duhet të provohet se ekzistojnë në mënyrë të njëkohshme, që të provohet ekzistenca e veprës penale, Gjykata vlerëson se analiza e mëtejshme e elementeve të tjerë të saj është e padobishme, për sa kohë që, sikurse u analizua më sipër, nuk provohet që i pandehuri Klevis Salkurti, te ketë kryer veprime të kundërligjshme të konkretizuara në drejtim të realizimit të anën objektive të veprës penale për të cilën akuzohet.

1084.Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388, shkronjat b) dhe d) të K.Pr.Penale çmon se i pandehuri **Klevis Salkurti** duhet të deklarohet i pafajshëm pasi nuk rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti objekt akuze ndaj tij ka ndodhur dhe për pasojë, nuk mund të provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, për sa kohë që nuk provohen elementët objektive të figurës së veprës penale të cilët shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale dhe në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtyre elementëve, vlerësimi mbi provueshmërinë e elementëve të anës subjektive të saj, mbetet i panevojshëm duke qenë se elementët e figurës së veprës penale në tërësinë e tyre kanë karakter kumulativ, çka do të thotë të mungesa e provueshmërisë qoftë vetëm për një prej tyre, bën që figura e veprës penale të mos provohet në tërësinë e saj.

IV. CAKTIMI DHE INDIVIDULIZIMI I DËNIMIT

1085. Në përcaktimin dhe individualizimin e dënimit penal për çdo të pandehur, gjykata mban në konsideratë, përveç parimeve të përgjithshme të së drejtës penale, parimet e veçanta që lidhen ne institutin e dënimit penal dhe konkretisht parimin e ligjshmërisë, parimin e individualizimit të dënimit, parimi i dobishmërisë apo domosdoshmërisë së dënimit si dhe parimin e humanizmit, të përcaktuara këto në nenin 1/c të Kodit Penal në të cilin parashikohet shprehimisht se: *"Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të se drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve si dhe të humanizmit"*. Po ashtu, dënimi penal duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë

që të realizojë qëllimin e tij që konsiston në riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore, duke përmbushur në këtë mënyrë dy funksionet kryesore të tij: *(i)* funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale, pasi kërcënimi se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar ndërmarrjen e veprimeve që bien në kundërshtim me normat penale dhe *(ii)* funksioni i parandalimit të posaçëm, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës, pasi duke zbatuar sanksionin penal ndaj tij, synohet edukimi i tij në mënyrë që, pas kryerjes së dënimit, të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime që cenojnë marrëdhëniet juridike të mbrojtura nga legjislacioni penal dhe për pasojë, të dënueshme. Në referim të nenit 47 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se "*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*", gjykata në përcaktimin dhe individualizimit e dënimit në rastin konkret, mban në konsideratë, për secilin të pandehur, sa vijon:

1086. Për të pandehurin Lahert Sulo, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se kjo vepër penale paraqet një nivel rrezikshmërie shoqërore jo tepër të lartë, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të ketë shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga ana e të pandehurit. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale. Në këtë drejtim gjykata mban në konsideratë, faktin se i pandehuri rezultoi se nuk ka qenë i dënuar më parë, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, moshën (41 vjeç), gjendjen familjare të të pandehurit i cili rezulton të jetë prind i dy fëmijëve të mitur, sipas akteve të gjendjes civile të administruara në dosje; (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të autorit të saj. Në rastin konkret gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin Lahert Sulo dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1087. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Lahert Sulo** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit

Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Lahert Sulo me 1 vit e 4 muaj burgim.

1088. Për të pandehurin Ani Hoxholli, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kenë shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, moshën (35 vjeç), gjendjen familjare të të pandehurit si dhe gjendjen shëndetësore të prindërve të tij referuar nga mbrojtja në konkluzione përfundimtare dhe nevojën e tyre për kujdes të vazhdueshëm nga ana e të pandehurit; (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1089. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Ani Hoxholli** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Ani Hoxholli me 1 vit e 4 muaj burgim.

1090. Për të pandehurin Halim Shehu, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe 248 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike këto vepra penale marrin në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për secilën vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe dënimin me burgim deri në shtatë vjet, për*

veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal). (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprave penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kenë shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprave penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe kryerjen e secilës prej tyre, në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila vlerësohet duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, moshën (46 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij. Në këtë vlerësim gjykata mban në konsideratë faktin që niveli i rrezikshmërisë së të pandehurit, në raport me personalitetin e tij dhe mënyrën se si ka kryer veprat penale, nuk mund të vlerësohet si i ulet, për shkak të se ai u gjet fajtor për kryerjen e dy veprave penale, të kryera secila prej tyre në bashkëpunim, të cilat nga mënyra se si janë kryer, rezulton se shtrihen në kohë, gjatë veprimtarisë së tij në ushtrimin e detyrës, çka tregon prezencën e një niveli rrezikshmërie shoqërore (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal. (vi) Së gjashti, gjendjen shëndetësore të tij referuar rrethanave të bëra prezent nga mbrojtësi në konkluzione përfundimtare si dhe referuar akteve të administruara në këtë drejtim në dosjen e seancës paraprake.

1091. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Halim Shehu** duhet të dënohet për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, me një masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita dhe konkretisht me 2 vite burgim, ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, gjykata vlerëson se masa e përshtatshme e dënimit është ajo me 2 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55, pg 1 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri duhet të dënohet me një masë te vetme dënimi dhe konkretisht me 2 vite e 6 muaj burgim, duke u mbështetur në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal, si dhe duke vlerësuar se dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprave penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm për këto vepra penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Halim Shehu me 1 vit e 8 muaj burgim.

1092. ***Për të pandehurin Arben Kastrati, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe

rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, moshën (53 vjeç) dhe gjendjen familjare të të pandehurit; (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1093. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Arben Kastrati** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Arben Kastrati me 1 vit e 4 muaj burgim.

1094. ***Për të pandehurin Arjan Sokoli, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, moshën (53 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij, qenien prind i dy fëmijëve duke pasur përgjegjësi për mirërritjen e tyre; (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1095. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Arjan Sokoli** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës

penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Arjan Sokoli me 1 vit e 4 muaj burgim.

1096. Për të pandehurin Dashnor Braha, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (55 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1097. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Dashnor Braha** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Dashnor Braha me 1 vit e 4 muaj burgim.

1098. Për të pandehurën Elidjana Toçila, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se e pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë si

dhe moshën e saj (41 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1099. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se e pandehura **Elidjana Toçila** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e saj, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehura, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht e pandehura Elidjana Toçila me 1 vit e 4 muaj burgim.

1100. Për të pandehurin Endrit Uka, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (27 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1101. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Endrit Uka** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Endrit Uka me 1 vit e 4 muaj burgim.

1102. Për të pandehurin Fatri Iseberi, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe 248 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike këto vepra penale marrin në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji

penal përcakton për secilën vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 259/1 dhe dënimin me burgim deri në shtatë vjet, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprave penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kenë shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprave penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila vlerësohet duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (36 vjeç) e tij dhe gjendjen familjare të tij, ku nga certifikata familjare e paraqitur nga mbrojtësi në konkluzione përfundimtare rezulton se është baba i tre fëmijëve te mitur. Në këtë vlerësim gjykata mban në konsideratë faktin që niveli i rrezikshmërisë së të pandehurit, në raport me personalitetin e tij dhe mënyrën se si ka kryer veprat penale, nuk mund të vlerësohet si i ulet, për shkak të se ai u gjet fajtor për kryerjen e dy veprave penale, të kryera, njëra prej tyre në bashkëpunim, të cilat nga mënyra se si janë kryer, rezulton se shtrihen në kohë, gjatë veprimtarisë së tij në ushtrimin e detyrës, çka tregon prezencën e një niveli rrezikshmërie shoqërore jo të ulët (v) ***Së pesti,*** në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata mban në konsideratë faktin që për të pandehurin dhe veprën penale të kryer prej tij, nuk rezulton prezenca e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal. (vi) ***Së gjashti***, gjendjen shëndetësore të prindërve dhe bashkëshortes së tij, referuar rrethanave të bëra prezent nga mbrojtësi në konkluzione përfundimtare si dhe referuar akteve të administruara në këtë drejtim në dosjen gjyqësore.

1103. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Fatri Iseberi** duhet të dënohet me një masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal dhe konkretisht me 2 vite burgim, ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 248, në lidhje me menin 25 të Kodit Penal duhet të dënohet me 2 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55, pg 1 i Kodit Penal, gjykata vlerëson se i pandehuri duhet të dënohet me një masë te vetme dënimi dhe konkretisht me 2 vite e 6 muaj burgim, duke u mbështetur në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal, si dhe duke vlerësuar se dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprave penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm për këto vepra penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Fatri Iseberi me 1 vit e 8 muaj burgim.

1104. Për të pandehurin Fatri Braha, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për

këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (40 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1105. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Fatri Braha** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Fatri Braha me 1 vit e 4 muaj burgim.

1106. ***Për të pandehurin Gëzim Duraku, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (59 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1107. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Gezim Duraku** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të

përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Gëzim Duraku me 1 vit e 4 muaj burgim.

1108. Për të pandehurin Haqif Halilaj, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (59 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1109. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Haqif Halilaj** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Haqif Halilaj me 1 vit e 4 muaj burgim.

1110. Për të pandehurin Kapllan Dogjani, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kenë shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (43 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij, qenien prind i tre fëmijëve nga të cilët njëri në moshë të mitur; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1111. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Kapllan Dogjani** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Kapllan Dogjani me 1 vit e 4 muaj burgim.

1112. ***Për të pandehurën Mimoza Shahinaj (Ismaili), gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se e pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë si dhe moshën e saj (39 vjeç) dhe gjendjen familjarë të saj posaçërisht qenien nënë e dy fëmijëve; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1113. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se e pandehura **Mimoza Shahinaj** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e saj, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehura, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht e pandehura Mimoza Shahinaj me 1 vit e 4 muaj burgim.

1114. ***Për të pandehurin Muhamet Cengu, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***,

pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të ketë shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (45 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1115. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Muhamet Cengu** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Muhamet Cengu me 1 vit e 4 muaj burgim.

1116. ***Për të pandehurën Rezarta Lako, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se e pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë si dhe moshën e saj (32 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1117. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se e pandehura **Rezarta Lako** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e saj, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehura, rehabilitimit, si dhe parandalimit të

përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht e pandehura Rezarta Lako me 1 vit e 4 muaj burgim.

1118. Për të pandehurin Urim Lami, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti,*** pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kete shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti,*** kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti,*** rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (51 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij ku nga certifikata familjare rezultoi se është baba i tre fëmijëve; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1119. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Urim Lami** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Urim Lami me 1 vit e 4 muaj burgim.

1120. Për të pandehurin Vehbi Nerguti, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti,*** pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të ketë shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti,*** kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti,*** rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (49 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij ku nga certifikata familjare rezultoi se është baba i

tre fëmijëve; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1121. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Vehbi Nerguti** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Vehbi Nerguti me 1 vit e 4 muaj burgim.

1122. ***Për të pandehurën Vojsava Selmani, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se e pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë, moshën e saj (34 vjeç) dhe qënien e saj nënë e dy fëmijëve të mitur; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1123. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se e pandehura **Vojsava Selmani** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e saj, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehura, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht e pandehura Vojsava Selmani me 1 vit e 4 muaj burgim.

1124. ***Për të pandehurën Xhuljana Maksutaj, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër

penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kane shkaktuar pasoja tepër të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se e pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë dhe moshën e saj (31 vjeç); (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal.

1125. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se e pandehura **Xhuljana Maksutaj** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e saj, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehura, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht e pandehura Xhuljana Maksutaj me 1 vit e 4 muaj burgim.

1126. ***Për të pandehurin Bedri Duraku, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari***, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim)*. (ii) ***Së dyti***, pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të ketë shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (53 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij ku nga certifikata familjare rezultoi se është baba i tre fëmijëve; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal. (vi) ***Së gjashti*** gjendjen shëndetësore të babait dhe bashkëshortes së tij, referuar akteve të paraqitura nga mbrojtja së bashku me konkluzionet përfundimtare.

1127. ***Sa më sipër u arsyetua***, gjykata çmon se i pandehuri **Bedri Duraku** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret

që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Bedri Duraku me 1 vit e 4 muaj burgim.

1128. Për të pandehurin Arben Goçi, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit : (i) Së pari, mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga dy deri në tre vjet burgim).* (ii) ***Së dyti,*** pasojat e veprës penale të cilat në rastin konkret kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar mirëfunksionimin dhe ligjshmërinë e organeve të administratës shtetërore dhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek administrata publike por nuk rezulton që të kete shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti,*** kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim. (iv) ***Së katërti,*** rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët duke konsideruar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, moshën (54 vjeç) dhe gjendjen familjare të tij ku nga certifikata familjare rezultoi se është baba i dy fëmijëve; (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal. (vi) ***Së gjashti*** gjendjen shëndetësore të tij dhe të babait të tij, referuar akteve të paraqitura nga mbrojtja së bashku me konkluzionet përfundimtare.

1129. Sa më sipër u arsyetua, gjykata çmon se i pandehuri **Arben Goçi** nuk paraqet një rrezikshmëri shoqërore të lartë dhe masa e dënimit e kërkuar nga prokurori prej 2 (dy) vitesh burgim, masë dënimi e cila përkon me minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete, është një masë e përshtatshme dënimi, e cila në vlerësim të gjykatës, mbështetet në kushtet dhe kriteret që përcaktojnë dhe individualizojnë dënimin, sipas parashikimeve të neneve 47-50 të Kodit Penal. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret, si dhe do të shërbejë për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, aplikohet ulja e dënimit të caktuar me 1/3 duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Arben Goçi me 1 vit e 4 muaj burgim.

1130. Për të pandehurit Atli Jashari, Sazan Ibra dhe Xhafer Elezi, gjykata mban në konsideratë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për secilin prej tyre: (i) Së pari, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal, duke konsideruar marrëdhëniet juridike që kjo vepër penale merr në mbrojtje në mënyrë të posaçme por edhe marzhet e dënimit që vetë ligji penal përcakton për këtë vepër penale (*dënimin me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit)* si dhe marrëdhëniet juridike që ajo merr në mbrojtje. (ii) ***Së dyti,*** pasojat e veprës penale e cila, në rastin konkret nuk rezulton që të ketë

shkaktuar pasoja të rënda. (iii) ***Së treti***, kryerjen e veprës penale me dashje direkte si formë e fajësisë nga secili prej te pandehurve. (iv) ***Së katërti***, rrezikshmërinë e autorit të veprës penale e cila rezulton e ulët për të tre të pandehurit, duke konsideruar asnjëri prej tyre nuk rezulton te ketë qenë i dënuar me pare. Po ashtu gjykata mban në konsideratë moshën dhe gjendjen familjare për secilin të pandehur. Konkretisht i pandehuri Atli Jashari rezulton se është 62 vjeç, baba i një fëmijë të rritur dhe po ashtu bashkëshortja e tij rezulton se ka probleme shëndetësore, sipas akteve të paraqitura nga mbrojtja bashkë me konkluzionet përfundimtare. I pandehuri Xhafer Elezi rezulton se është 70 vjeç, ndërsa i pandehuri Sazan Ibra rezulton se është i moshës 55 vjeç. Në këtë drejtim gjykata mban në konsideratë fakti që secili prej të pandehurve është i padënuar më parë. (v) ***Së pesti,*** mungesën e rrethanave rënduese të përcaktuara si të tilla në nenin 50 të Kodit Penal. (vi) ***Së gjashti*** faktin që për secilin nga këta të pandehur, ndaj të cilëve është aplikuar në kuadër të këtij procedimi penal masa e sigurimit personal "Arrest në shtëpi", caktuar me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nga përllogaritja e kohës së qëndrimit nën zbatimin e kësaj mase sigurimi, në referim të parashikimeve të nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 57 të Kodit Penal, secili prej tyre ka kryer një masë dënimi e cila përshin masën maksimale të dënimit që parashikon neni 245/1 pg 1 i Kodit Penal, me një vit burgim, pas aplikimit të ulës së 1/3 së dënimit për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale. Për këto arsye, gjykata vlerëson se masa e dënimit për secilin të pandehur me një vit burgim, është e përshtatshme dhe mbi këtë masë dënimi, as aplikimit të uljes së 1/3 së masës së dënimit, në respektim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, gjykata konstaton se masa e dënimit përfundimtar të caktuar, rezulton të jetë kryer për shkak të përllogaritjes në të të kohës së zbatimit ndaj secilit prej të pandehurve të masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi".

1131. Lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë, në nenin 59, pika 1 të Kodit Penal, parashikohet se :" *1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte ligjore: *(i)* në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vendos dënimin përfundimtar të të pandehurit më një masë dënimi jo më të lartë se pesë vjet burgim dhe *(ii)* gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet ose ekziston një ose disa nga rrethanat në vijim: - I pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore; - I pandehuri është i mitur apo i moshuar (rrethana që lidhen me moshën); - I pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta; - I pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional;- I pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familje; - I pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese;- I pandehuri ka pasur një

sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale. Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton, se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, pra aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal mund të bëhet qoftë kur vërtetohet një apo disa nga rrethanat e mësipërme[85]. Në referim të sa më sipër, si dhe duke konsideruar elementët e analizuar nga gjykata në lidhje me të pandehurit në pjesën e caktimit dhe individualizimit të dënimit, kushtet dhe rrethanat familjare dhe personale të tyre, rrezikshmërinë ulët në raport me veprën penale për të cilën të pandehurit u gjeten fajtor, masën e dënimit të aplikuar dhe masën e dënimit të mbetur pa vuajtur, pas përllogaritjes së kohës së zbatimit ndaj secilit të pandehur të masave të sigurimit, gjykata vlerëson se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e mbetur të dënimit, dhe vënien në provë të të pandehurve Lahert Sulo, Ani Hoxholli, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqig Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili) Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku, Arben Goçi. Për të gjithë të pandehurit si më sipër, gjykata vlerëson se ka vend për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal dhe vënien në provë të secilit të pandehur, për një kohë të barabartë me dyfishin e kohës së dënimit me burgim të dhënë. Përcaktimi i kohës së provës, duke iu referuar masës së dënimit të dhënë dhe jo masës së dënimit me burgim të pezulluar (pjesës së pavuajtur të dënimit) sikurse u pretendua nga disa prej mbrojtësve të të pandehurve, bëhet në respektim të parashikimeve të nenit 59, pika 3 të Kodit Penal, në të cilin parashikohet në mënyrë të shprehur se :"*Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kokës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.*". Referuar kësaj dispozitë, rezulton e qartë se koha e provës përcaktohet në raport me kohën e dënimit me burgim të dhënë dhe jo atë të mbetur pa vuajtur, mbi të cilën aplikohet pezullimin i ekzekutimit.

1132. Në kushtet e aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim për të pandehurit Lahert Sulo, Ani Hoxholli, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka,

---

[85] Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 151, datë 18.06.2014, ndër të tjera shprehet se: "*Nga interpretimi logjik e literal i kësaj dispozite, së pari evidentohet se zbatimi i nenit 59 të K.Penal është në diskrecion të gjykatës, e cila nëse çmon se plotësohet një ose disa nga kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë vendos aplikimin e saj. Nga ana tjetër, në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative* kushtet *si më poshtë vijon: Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite si rrezikshmëria e pakët e personit, autorit të veprës, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternativë jo kumulativë. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre së bashku me kushtin tjetër, të poshtë renditur; Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 me masën e dënimit të dhënë nga gjykata (kur jep dënim me burg deri në pesë vjet) dhe jo me atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të K.Penal për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i K.Penal, duhet të evidentohet ekzistenca e njërit prej kushteve alternativë të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni dhe gjykata të ketë caktuar një dënim deri në pesë vjet burgim.*".

Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqig Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku, Arben Goçi, gjykata në respektim të parashikimeve të nenit 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstaton shuarjen e masave së sigurimit personal "*Arrest në burg*" ose "Arrest në shtëpi", parashikuar nga nenet 238 dhe 237 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurve me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

1133. Lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurit Halim Shehu dhe Fatri Iseberi, gjykata, duke konsideruar se në raport me këta të pandehur, të deklaruar fajtore për kryerjen e dy veprave penale, konsideruar natyrën e veprave penale të kryera nga secili prej tyre, shtrirjen kohore tyre e cila tregon vazhdimësi, si dhe nivelin e rrezikshmërisë shoqërore vlerësuar në raport me veprat penale për të cilat secili nga këta të pandehur u gjet fajtor nga gjykata, vlerëson se nuk rezulton që secili prej tyre të paraqesë një nivel të ulët të rrezikshmërisë shoqërore, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kushtin për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, që lidhet me prezencën e rrethanave që dëshmojnë "rrezikshmëri të pakët të personit", referuar veprave penale të kryera nga secili prej të pandehurve dhe rrezikshmërisë shoqërore të tyre në raport me këto vepra penale, si dhe faktin që secili prej tyre u gjet fajtor për kryerjen e dy veprave penale gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës. Rrezikshmëria shoqërore e të pandehurve Halim Shehu dhe Fatri Iseberi vlerësohet se nuk është *e pakët* në kuptim të nenit 59 të Kodit Penal. Mungesa e këtij kushti, pamundëson vlerësimin e prezencës së rrethanave të tjera alternative që kërkohen për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, të tilla si mosha, gjendja familjare, sociale, shëndetësore, etj., të dhëna këto të cilat gjithsesi janë marrë në konsideratë nga gjykata në përcaktimin dhe individualizimin e masës së dënimit për secilin të pandehur.

1134. *Në lidhje me aplikimin e dënimit plotësues në drejtim të heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike* për të pandehurit të cilët u konkludua për deklarimin fajtor të tyre për kryerjen e veprave penale respektive, në nenin 35 të Kodit Penal parashikohet se: "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një kohë jo më pak se pesë vjet, <u>jepet detyrimisht</u> ndaj personit që ka kryer një krim, që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim, për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike mund të jepet për një kohë nga tre deri në pesë vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga një deri në tre vjet, kur është caktuar dënimi deri në tre vjet burgim.*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike jepet në mënyrë të detyrueshme dhe për një kohë jo më pak se pesë vjet ndaj personit që ka kryer një krim që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim për të cilin gjykata ka caktuar një dënim jo më pak se dhjetë vjet, pavarësisht faktit nëse ka kryer apo jo një vepër penale që lidhet me detyrën. Kur krimi shoqërohet me njërën prej këtyre alternativave caktimi i dënimit plotësues është i detyrueshëm.

1135. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike synon sigurimin e normalitetit të veprimtarisë së organeve dhe institucioneve shtetërore e publike, parandalimin e krimeve në këtë

fushë shumë të rëndësishme të organizimit shtetërore. Kjo masë shtrënguese jepet ndaj atyre personave që kryejnë krime duke shpërdoruar funksionin publik, të cilat shkaktojnë jo vetëm pasoja me karakter pasuror ose personal, por edhe pasoja me karakter politik e shoqëror, dëmtojnë ose ulin autoritetin e këtyre organeve dhe institucioneve në sytë e publikut, dobësojnë besueshmërinë e tyre. Referuar nenit 35 të Kodit Penal, për aplikimin e këtij dënimi plotësues, kërkohet që i pandehuri të ketë kryer një vepër penale që lidhet me detyrën e tij, që do të thotë se që të aplikohet në mënyrë të detyrueshme ky dënim plotësues duhet që vepra penale të jetë kryer për shkak ose në saje te një detyre ose funksioni publik. Në rastin konkret gjykata, duke konsideruar natyrën e veprave penale për të cilat të pandehurit u deklaruan fajtorë, të cilat bëjnë pjesë në kreun e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore, vlerëson se ka vend për aplikimin e këtij dënimi plotësues kundrejt të gjithë te pandehurve të cilët u gjetën fajtore dhe dënuan për kryerjen e këtyre veprave penale.

1136. ***Lidhur me sendet e sekuestruara***, gjykata bazuar në nenin 190, pika 1, shkronja a) dhe 391 të K.Pr.Penale vlerëson se duhet të disponohet sipas kërkesës së prokurorit për shumat monetare dhe konkretisht *(i)* shumën e parave prej 51,200 (pesëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë dhe 800 (tetëqind) euro sekuestruar shtetasit *Arben Kastrati*, *(ii)* shumën e parave prej 4,600 (katër mijë e gjashtëqind) lekë sekuestruar shtetasit *Urim Lami*, *(iii)* shumën e parave prej 105 (njëqind e pesë mijë) lekë, 230 (dyqind e tridhjetë) euro, 100 (njëqind) Rial dhe 100 (njëqind dollar) sekuestruar shtetasit *Fatri Iseberi*, (iv) shumën e parave prej 1700 (një mijë e shtatëqind) lekë sekuestruar shtetasit *Arben Goçi*, (v) shumën e parave prej 11, 300 (njëmbëdhjetë mijë e treqind lekë) dhe 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro sekuestruar shtetasit *Vehbi Nerguti*,(vi) shumën e parave prej 6000 (gjashtë mijë lekë) sekuestruar shtetasit *Fatri Braha*, të cilat duhet të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit, në kushtet kur të pandehurit të cilëve ju janë sekuestruar ato, u deklaruan fajtore për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 259/1 i Kodit Penal. Në lidhje me sendet e tjera të sekuestruara, të cilat përbëjnë sende personave të sekuestruara të pandehurve, në referim të nenit 190 pika 1, shkronja ç) të K.Pr.Penale, duket ti kthehen personave që ju përkasin.

1137. *Sa i përket shpenzimeve gjyqësore*, në kushtet kur të pandehurit u shpallën fajtorë dhe u dënuan për veprat penale për të cilat edhe ishin akuzuar, në bazë të neneve 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale, të pandehurit duhet të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe ato gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 112, 151, 152, 190, 261, 379, 380, 381, 383,388, 389, 390, 393, 405, 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 25, 35, 47-50, 259 dhe 245/1, 248, 59, 60 të Kodit Penal,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lahert Sulo** akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni

259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

2. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Lahert Sulo** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4** muaj burgim.
3. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Lahert Sulo** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
4. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Lahert Sulo** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Lahert Sulo** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
6. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Lehert Sulo** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ani Hoxholli**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.
8. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Ani Hoxholli** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.
9. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Ani Hoxholli** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
10. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Ani Hoxholli** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
11. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Ani Hoxholli** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
12. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Ani Hoxholli** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**
13. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Emilton Asllanaj** akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal, pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
14. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale,

caktuar ndaj të pandehurit **Emilton Asllanaj** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

15. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Emilton Asllanaj** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

16. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Halim Shehu** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

17. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Halim Shehu** për kryerjen e veprës penale të *"Shpërdorimi i detyrës", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

18. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Halim Shehu** dënohet me një dënim të vetëm prej **2 vite e 6 muaj** burgim.

19. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Halim Shehu** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 8 muaj** burgim.

20. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe i pandehuri **Halim Shehu** do te vuajë pjesën e mbetur të dënimit me burgim në një burg të sigurisë së zakonshme.

21. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Halim Shehu** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

22. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Kastrati** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

23. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Arben Kastrati** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

24. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Arben Kastrati** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj),** me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

25. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Arben Kastrati** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

26. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Arben Kastrati** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

27. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Arben Kastrati** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

28. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arjan Sokoli** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike",* parashikuar nga neni

259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

29. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Arjan Sokolii** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

30. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Arjan Sokoli** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

31. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Arjan Sokoli** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

32. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Arjan Sokoli** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

33. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Arjan Sokoli** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

34. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Dashnor Braha** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

35. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Dashnor Brahai** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4** muaj burgim.

36. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Dashnor Braha** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

37. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Dashnor Braha** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

38. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Dashnor Braha** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

39. Deklarimin fajtore të të pandehurës **Elidjana Toçila** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" e kryer ne bashkëpunim* ,parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me **2 vite** burgim.

40. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurës **Elidjana Toçila** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

41. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurës **Elidjana Toçila** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

42. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurës **Elidjana Toçila** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

43. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Elidjana Toçila** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

44. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Endrit Uka** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

45. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Endrit Ukai** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

46. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Endrit Uka** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

47. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Endrit Uka** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

48. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Endrit Uka** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

49. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Iseberi** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

50. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Iseberi** për kryerjen e veprës penale të *"Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim* parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

51. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Fatri Iseberi** dënohet me një dënim të vetëm prej **2 vite e 6 muaj burgim.**

52. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Fatri Iseberii** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 8 muaj** burgim.

53. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe i pandehuri **Fatri Iseberi** do të vuajë

pjesën e mbetur të dënimit me burgim në një burg të sigurisë së zakonshme.

54. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Fatri Iseberi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

55. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatri Braha** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" ne bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

56. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Fatri Braha** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4** muaj burgim.

57. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Fatri Braha** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

58. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Fatri** Braha me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

59. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Fatri Braha** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

60. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Fatri Braha** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

61. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Artan Redhaj** akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Shpërdorimi i detyrës",* parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

62. Bazuar në nenin 261, 267/2 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Pezullimi ushtrimit të një detyre a shërbimi publik"*** parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Artan Rredhaj** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

63. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gëzim Duraku** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"* ,parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penaldhe dënimin e tij me **2 vite** burgim.

64. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Gëzim Durakui** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

65. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Gëzim Duraku** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

66. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Gëzim Duraku** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

67. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Gëzim Duraku** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

68. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Haqif Halilaj** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

69. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Haqif Halilaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 vit e 4 muaj** burgim.

70. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Haqif Halilaj** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

71. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Haqif Halilaj** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

72. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Haqif Halilaj** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

73. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Kapllan Dogjani** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike",* parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

74. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Kapllan Dogjani**i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

75. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Kapllan Dogjani** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

76. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Kapllan Dogjani** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

77. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Kapllan Dogjani** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

78. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Kapllan Dogjani** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

79. Deklarimin fajtore të të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 vite burgim.

80. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

81. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

82. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

83. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Mimoza Shahinaj (Ismaili)** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

84. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Muhamet Cengu** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penaldhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

85. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Muhamet Cengui** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

86. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Muhamet Cengu** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

87. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Muhamet Cengu** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

88. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Muhamet Cengu** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

89. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Muhamet Cengu** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

90. Deklarimin fajtore të të pandehurës **Rezarta Lako** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" e kryer ne bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 vite burgim.

91. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurës **Rezarta Lakoi** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

92. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurës **Rezarta Lako** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

93. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurës **Rezarta Lako** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

94. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Rezarta Lako** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

95. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Urim Lami** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

96. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Urim Lamii** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

97. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Urim Lami** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

98. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Urim Lami** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

99. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Urim Lami** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

100. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Urim Lami i** hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

101. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vehbi Nerguti** për kryerjen e veprës penale të

penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 vite burgim.

113. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurës **Xhuljana Maksutaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

114. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurës **Xhuljana Maksutaj** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

115. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurës **Xhuljana Maksutaj** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

116. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Xhuljana Maksutaj** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

117. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bedri Duraku** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike",* parashikuar nga neni 259, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

118. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Bedri Duraku**i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

119. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Bedri Duraku** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

120. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Bedri Duraku** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

121. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Bedri Duraku** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

122. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Bedri Duraku** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

123. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Avni Tërshalla** akuzuar për kryerjen e

"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

102. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Vehbi Nerguti** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

103. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Vehbi Nerguti** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

104. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Vehbi Nerguti** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

105. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Vehbi Nerguti** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

106. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Vehbi Negruti** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

107. Deklarimin fajtore të të pandehurës **Vojsava Selmani** për kryerjen e veprës penale të *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" në bashkëpunim* ,parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 vite burgim.

108. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurës **Vojsava Selmanii** ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

109. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurës **Vojsava Selmani** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

110. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtepi*", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurës **Vojsava Selmani** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

111. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Vojsava Selmani** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

112. Deklarimin fajtore të të pandehurës **Xhuljana Maksutaj** për kryerjen e veprës

veprës penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

124. Bazuar në nenin 261, 267/2 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Pezullimi ushtrimit të një detyre a shërbimi publik"*** parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Avni Tërshalla** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

125. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Goçi** akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penaldhe dënimin e tij me 2 vite burgim.

126. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Arben Goçi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

127. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit për pjesën e pavuajtur të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Arben Goçi** për një periudhë kohe prej **2 vite e 8 muaj (32 muaj)**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

128. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Arben Goçi** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

129. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Arben Goçi** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

130. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Arben Goçi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

131. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Reni Dokolli** akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

132. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Reni Dokolli** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

133. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Reni Dokolli** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.

134. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Shpëtim Cenaj** akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në*

bashkëpunim, parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

135. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit *"Arrest në Shtepi"*, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit caktuar ndaj të pandehuritShpëtim **Cenaj** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

136. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Sulë Onuzi** akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim,* parashikuar nga neni 259, pg. 1 dhe 25 i Kodit Penal pasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

137. Bazuar në nenin 261, 267/2 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik"*** parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Sulë Onuzi** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

138. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Atli Jashari** për kryerjen e veprës penale *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike",*parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 i Kodit Penaldhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

139. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Atli Jashari** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim.

140. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Arrest në shtëpi"*** parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Atli Jashari** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

141. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Atli Jashari** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

142. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Klevis Salkurti** akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike",* parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 i Kodit Penalpasi nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

143. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Arrest në shtëpi"*** parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Klevis Salkurti** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

144. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhafer Elezi** për kryerjen e veprës penale *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike",* parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 i Kodit Penaldhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

145. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Xhafer**

Elezi i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim.

146. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Arrest në shtëpi"*** parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Xhafer Elezi** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

147. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Xhafer Elezi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

148. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Sazan Ibra** për kryerjen e veprës penale *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 245/1, pg. 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

149. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Sazan Ibra** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim.

150. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit ***"Arrest në shtëpi"*** parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Sazan Ibra** me vendimin nr. 29, datë 03.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

151. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Sazan Ibra** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh.**

152. Në zbatim të nenit 190, pika 1, shkronja ç) të K.Pr.Penale, *pajisjet dhe mjetet teknike të përdorura për kryerjen e përgjimit ambiental* nga ana e policisë gjyqësore, t'i kthehen Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

153. Në bazë të nenit 190 pika 1, shkronja ç) të K.Pr.Penale, të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara: *(i)*një aparat telefoni celular i markës "Olimpia", me ekran me ngjyrë të zezë dhe tastierë me ngjyrë të kuqe, me kartën SIM 0694106825 i shtetasit ***Gëzim Duraku***, *(ii)* një aparat telefoni celular i markës "Apple", model S6, me ekran dhe kapak ngjyrë të zezë me kartë sim 0699736530 i shtetases ***Vojsava Selmani***, *(iii)* një aparat telefoni celular i markës "Iphone 11", me ngjyrë të zezë, me numër IMEI: 35392210450993, me kartë sim 0684033558 i shtetasit ***Vehbi Nerguti***, *(iv)* një aparat telefoni celular i markës "Samsung", tip A12, ngjyrë i zi, me nr. IMEI 356086275344074, me kartë sim 0694106383 si dhe 0682411704 i shtetasit ***Arben Kastrati***, *(v)* një aparat telefoni celular i markës "Samsung", tip A70, ngjyrë i zi, me nr. IMEI1-352029112718047/01, me kartë sim 0694115447 i shtetasit ***Fatri Iseberi*** dhe një portofol ngjyrë të zezë e shtetasit ***Fatri Iseberi***, *(vi)* një aparat celular i markës "Samsung Galaxy A31", me nr. IMEI 355871115432101 dhe nr. IMEI 355872115432109, me kartë sim 0688815000 në emër të shtetasit ***Endrit Uka***,*(vii)* një aparat celular i markës "Iphone S6", me ngjyrë të bardhë përpara në emër të shtetasit ***Atli Jashari***, *(viii)* një aparat celular i markës "Redmi", me ngjyrë blu, me nr.sim 0693200288, në emër të shtetasit ***Artan Redhaj***, *(ix)* një aparat celular i markës "Samsung Galaxy", në emër të shtetases ***Xhuljana Maksutaj***, *(x)* një Aparat celular i markës "Samsung A70", me sim kartë 0694447565, në emër të shtetasit ***Arjan Sokoli***,*(xi)*një aparat celular i markës "Samsung A10", ngjyrë e

zezë, me këllëf të zi, me nr. IMEI 352696110327730 në emër të shtetasit ***Erjon Saraçi***, *(xii)* një aparat celular i markës "Samsung", me ngjyrë të zezë, me IMEI 351832194975505, me sim kartë 0676466593, në emër të shtetasit ***Shpëtim Cenaj***, *(xiii)* një aparat celular i markës "Samsung" me ngjyrë të zezë, në emër të shtetasit ***Sazan Ibra***, *(xiv)* një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit ***Bedri Duraku***, *(xv)* një aparat celular në emër të shtetasit ***Arben Goçi***, *(xvi)* një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit ***Muhamet Cengu***, *(xvii)* një aparat celular i markës "Nokia", në emër të shtetasit ***Haqif Halilaj***, dhe një aparat celular i markës "Samsung", në emër të shtetasit ***Haqif Halilaj***, **t'i kthen personave që ju përkasin.**

154. Bazuar në nenin 190, pika 1, gërma 'a' të K.Pr.Penale dhe nenin 36 të Kodi Penal, provat materiale te sekuestruara dhe konkretisht *(i)* shumën e parave prej 51,200 (pesëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë dhe 800 (tetëqind) euro sekuestruar shtetasit *Arben Kastrati*, *(ii)* shumën e parave prej 4,600 (katër mijë e gjashtëqind) lekë sekuestruar shtetasit *Urim Lami*, *(iii)* shumën e parave prej 105 (njëqind e pesë mijë) lekë, 230 (dyqind e tridhjetë) euro, 100 (njëqind) Rial dhe 100 (njëqind dollar) sekuestruar shtetasit *Fatri Iseberi*, (iv) shumën e parave prej 1700 (një mijë e shtatëqind) lekë sekuestruar shtetasit *Arben Goçi*, (v) shumën e parave prej 11, 300 (njëmbëdhjetë mijë e treqind lekë) dhe 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro sekuestruar shtetasit *Vehbi Nerguti*,(vi) shumën e parave prej 6000 (gjashtë mijë lekë) sekuestruar shtetasit *Fatri Braha*, **të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit**.

155. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurve të cilët deklarohen fajtorë, në mënyrë solidare.

156. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe shërbimet e policisë gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.

157. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 (pesëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, më datë 21.02.2023.

GJYQTARE	**GJYQTAR**	**GJYQTARE**
IRENA GJOKA	**ERJON ÇELA**	**RUDINA PALLOJ**

SEKRETARE

DILA DOÇI

SHËNIM: Bazuar në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale, (Ndryshuar me ligjin nr.35/2017), pika 3, gërma "a", për bashkëtëpandehurit Endrit Uka, Artan Rredhaj dhe Gëzim Duraku, për të cilët Gjykata e Posacme e e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka dhënë vendimin penal me nr.15, datë 21.02.2023, rezulton se të pandehurit Endrit Uka, Artan Rredhaj dhe Gëzim Duraku, nuk kanë paraqitur ankim, gjithashtu edhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të sipërcituar për të pandehurin Endrit Uka, Artan Rredhaj dhe Gëzim Duraku dhe pas përfundimit të afatit ligjor 15 (pesëmbëdhjetë) ditor të së drejtës për të ushtruar ankim pas marrjes dijeni nga palët për vendimin, vendimi merr formë të prerë më datë 05.06.2023, vetëm për të pandehurit Endrit Uka, Artan Rredhaj dhe Gëzim Duraku.

KRYESEKRETARE

JOLANDA NASUFI

TIRAN

SHËNIM: Kundër vendimit nr. 15 Vendimi, datë 21.02.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kane bërë ankim Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar, te pandehurit Atli Jashari, Lahert Sula, Ani Hoxholli, Halim Shehu, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Tocila, Fatri Iseberi, Fatri Braha, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku, Arben Goci, Xhefaer Elezi, Sazan Ibra, Emilton Asllanaj, Avni Tershalla, Reni Dekolli, Shpetim Cenaj, Sule Osmani, Klevis Salkurti, apel kundërshtues i pandehuri Emilton Asllanaj, nëpërmjet mbrojtësve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 50 datë 22.11.2023, ka vendosur:

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr. 15, datë 21.02.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me kete ndryshim:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ani Hoxholli për kryerjen e veprës penale "*Moskallëzimi i krimit*", e parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 (një) vit e 3 (tre) burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Ani Hoxholli i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 10 (dhjetë) muaj burgim;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/2 i Kodit Penal, për një kohë prej 2 (dy) vitesh, për të pandehurin Ani Hoxholli;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Reni Dokolli për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 259/1 dhe 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Reni Dokolli i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim;
- Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Reni Dokolli për një periudhë kohe të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/1 i Kodit Penal, për një kohë prej 5 (pesë) vitesh, për të pandehurin Reni Dokolli;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Avni Tërshalla për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 259/1 dhe 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Avni Tërshalla i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim;
- Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Avni Tërshalla për një periudhë kohe të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/1 i Kodit Penal, për një kohë prej 5 (pesë) vitesh, për të pandehurin Avni Tërshalla;
- Të pandehurit Lahert Sulo, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava

Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku dhe Arben Goçi vihen në provë për një periudhë kohë të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata.

2. Shpenzimet e gjykimit edhe në apel i ngarkohen të pandehurve soldarisht.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.

KRYESEKRETARE

Jolanda NASUFI

Me urdhër dhe me delegim

Sekretare Sfaelda ÇUKAJ

Tiranë më datë: 24.11.2023

K/ SEKRETARE
JOLANDA NASUFI

2 Prençi!
2. Mara!
dt. 24.11.2023

PROKURORIA E POSAÇME TIRANË
Nr. 0233 Prot.
Datë 24.11.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KRIMIN E ORGANIZUAR TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 43 Regjistri Themeltar
Datë 05.07.2023

Nr. 50 Vendimi
Datë 22.11.2023

SHKURTIM VENDIMI

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesuese: **Engert Pëllumbi**
Anëtare: **Nertina Kosova**
Anëtare: **Igerta Hysi**

më datë 22.11.2023, mori në shqyrtim në seancë publike, në prani të sekretares gjyqësore Olta Sinanaj, çështjen penale me nr.43 Regjistri Themeltar, datë regjistrimi 05.07.2023, që i përket:

KËRKUESE: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët **Vladimir Mara** dhe **Dritan Prençi**.

I PANDEHUR: **1.Atli Jashari,** i biri i Nazmi dhe Fatime, lindur në datë 24.01.1961, në Dibër dhe banues në Tiranë, rruga "Don Bosko", me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.

I PANDEHUR: **2.Lahert Sulo,** i biri i Shkëlqim dhe Rajmonda, lindur në datë 01.12.1981, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Kadri Roshi", lagja "Kazhar-Yzberisht", shk.2, ap.2, kati 4, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **3.Ani Hoxholli,** i biri i Xhemal dhe Vjollca, lindur në datë 29.11.1987, në Përrenjas dhe banues në Pogradec, me adresë: Rruga "Migjeni", nd.2, h.1, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **4.Emilton Asllanaj,** i biri i Ismet dhe Shpresa, lindur në datë 21.03.1989, në Pukë dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga "Muhamet Deliu", nd.8,

h.18, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **5.Halim Shehu,** i biri i Azem dhe Hurme, lindur në datë 17.05.1976, lindur dhe banues në Kukës, me arsim të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e kryer në bashkëpunim dhe "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **6.Arben Kastrati,** i biri i Bajram dhe Gjule, lindur në datë 29.08.1970, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Barakat, nd.10, h.1, 8501, Kukës, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **7.Arjan Sokoli,** i biri i Ahmet dhe Fatime, lindur në datë 02.09.1970, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Fshati Canaj, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **8.Dashnor Braha,** i biri i Ali dhe Hyrie, lindur në datë 05.12.1968, në Bicaj, Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Metralugu, nd.21, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **9.Elidjana Toçila,** e bija e Xhevahir dhe Vitori, lindur në datë 22.08.1981, në Gramsh dhe banuese në Tiranë, me adresë: Rruga "Jordan Misja", me arsim të lartë, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **10.Endrit Uka,** i biri i Arben dhe Luljeta, lindur në datë 13.10.1995, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja "Iliria", nd.12, h.3, ap.8, Kukës, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **11.Fatri Iseberi,** i biri i Bari dhe Shemsije, lindur në datë 13.03.1986, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Shtiqen, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e kryer në bashkëpunim dhe "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 dhe neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **12.Fatri Braha,** i biri i Ruzhdi dhe Resmije, lindur në datë 09.04.1983, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja nr.6, nd.11, h.1, ap.11, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **13.Artan Redhaj,** i biri i Myfyt dhe Sadushe, lindur në datë 11.01.1972, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Lidhja e Prizrenit, me arsim të lartë, me gjendje civile i ve, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

I PANDEHUR: **14.Gëzim Duraku,** i biri i Haxhi dhe Hyrije, lindur në datë 12.09.1964, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja "11 Tetori", nd.6, h.2, ap.2, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **15.Haqif Halilaj,** i biri i Elmaz dhe Lihe, lindur në datë 15.04.1964 në Kukës dhe banues në Kamëz, me adresë: Lagja "Roma", nd.28, h.33, ap.10, Kamëz, Tiranë, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **16.Kapllan Dogjani,** i biri i Qazim dhe Xhemile, lindur në datë 06.01.1980, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja 16, nd.2/1, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **17.Mimoza Shahinaj (Ismaili),** e bija e Reshat dhe Sabrije, lindur në datë 27.05.1983, në Fushë-Arrëz dhe banuese në Tiranë, me adresë: Lagja

"Altin Basha", Njësia Administrative nr.6, 1027, nd.7, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile e martuar, me gjendje gjyqësore e padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **18.Muhamet Cengu,** i biri i Qemal dhe Rabije, lindur në datë 26.03.1977, në Shtiqen, Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja Meteori, nd.5, h.1, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, me gjendje civile i martuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **19.Rezarta Lako,** e bija e Refat dhe Gjylo, lindur në datë 08.02.1991, në Përmet dhe banuese në Tiranë, me adresë: Kashar-Yzberisht, lagja "Loni Ligori", nd.15, ap.21, Tiranë, me arsim të mesëm, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **20.Urim Lami,** i biri i Islam dhe Xharije, lindur në datë 08.09.1971, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë : lagja "Dëshmorët", nd.5, h.5, ap.4, Kukës, me arsim te mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **21.Vehbi Nerguti,** i biri i Shukri dhe Fatime, lindur në datë 12.04.1974, në Gjegjan, Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja "Isa Boletini", nd.11, h.1, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **22.Vojsava Selmani,** e bija e Xhevahir dhe Shpresa, lindur në datë 17.04.1988, në Bajram Curri dhe banuese në Tiranë, me adresë: Rruga "Mahmut Alushi", nd.29, h.1, ap.2, Dajt, Linzë, Tiranë, me gjendje civile e martuar, me gjendje gjyqësore e padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **23.Xhuljana Maksutaj,** e bija e Kastriot dhe Zenepe, lindur në datë 01.02.1992, në Gjergjove, Skrapar, dhe banuese në Tiranë, me adresë:

Shkozë, nd.319, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile beqare, me gjendje gjyqësore e padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **24. Bedri Duraku,** i biri i Xhezair dhe Fate, lindur në datë 28.05.1969, në Morinë, Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja "Dituria", nd.47, h.2, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **25. Avni Tërshalla,** i biri i Hajredin dhe Hane, lindur në datë 28.10.1969, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Krenz, nd.18, h.1, ap.5, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **26. Arben Goçi,** i biri i Man dhe Mire, lindur në datë 06.08.1968, në Vlahen, Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Lagja "Ushtarakët", nd.18, h.1,ap.5, 8501, Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje gjyqësore i padënuar, me gjendje civile i martuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **27. Reni Dokolli,** i biri i Isuf dhe Nazmije, lindur në datë 14.02.1993, në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **28. Shpëtim Cenaj,** i biri i Qemal dhe Kadime, lindur në datë 30.12.1964, në Kukës dhe banues në rruga "Pasho Hysa", nd.26/1, h.1. Njësia Administrative 1, Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K. Penal.

I PANDEHUR: **29. Sulë Osmani,** i biri i Demit dhe Sheme, lindur në datë 01.06.1967, në Nangë dhe banues në Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259/1 në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I PANDEHUR: **30. Klevis Salkurti,** i biri i Gani dhe Tefta, lindur në datë 22.05.1990, në Rashnapojë, Dibër dhe banues në Dibër, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.

I PANDEHUR: **31. Xhefaer Elezi,** i biri i Bislim dhe Shine, lindur në datë 30.08.1952, në Kukës dhe banues në Kukës, me adresë: Poliklinika, nd.3, h.5, Kukës, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K.Penal.

I PANDEHUR: **32. Sazan Ibra,** i biri i Eles dhe Fellanza, lindur në datë 06.03.1967, në Lezhë dhe banues në Peshkopi, me adresë: rruga "Dine Hoxha", nd.2, h.13, ap.1, Peshkopi, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1/1 i K. Penal.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi dëgjoi palët dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, bazuar në nenet 112, 428, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", 435, pika 1, dhe 485, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 15, datë 21.02.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ani Hoxholli për kryerjen e veprës penale "*Moskallëzimi i krimit*", e parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 1 (një) vit e 3 (tre) muaj burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Ani Hoxholli i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 10 (dhjetë) muaj burgim;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/2 i Kodit Penal, për një kohë prej 2 (dy) vitesh, për të pandehurin Ani Hoxholli;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Reni Dokolli për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 259/1 dhe 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Reni Dokolli i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim;

- Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Reni Dokolli për një periudhë kohe të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/1 i Kodit Penal, për një kohë prej 5 (pesë) vitesh, për të pandehurin Reni Dokolli;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Avni Tërshalla për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 259/1 dhe 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim;
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodi të Procedurës Penale, të pandehurit Avni Tërshalla i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim;
- Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Avni Tërshalla për një periudhë kohe të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata;
- Dhënien e dënimit plotësues "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike*", e parashikuar nga neni 35/1 i Kodit Penal, për një kohë prej 5 (pesë) vitesh, për të pandehurin Avni Tërshalla;
- Të pandehurit Lahert Sulo, Arben Kastrati, Arjan Sokoli, Dashnor Braha, Elidjana Toçila, Endrit Uka, Fatri Braha, Gëzim Duraku, Haqif Halilaj, Kapllan Dogjani, Mimoza Shahinaj (Ismaili), Muhamet Cengu, Rezarta Lako, Urim Lami, Vehbi Nerguti, Vojsava Selmani, Xhuljana Maksutaj, Bedri Duraku dhe Arben Goçi vihen në provë për një periudhë kohë të barabartë me dyfishin e pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit të dhënë nga gjykata.

2. Shpenzimet e gjykimit edhe në apel i ngarkohen të pandehurve soldarisht.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij.
4. **U shpall në Tiranë, sot më datë 22.11.2023.**

GJ Y Q T A R E	**GJ Y Q TA R E**	**GJ Y Q T A R**
Igerta HYSI	**Nertina KOSOVA**	**Engert PËLLUMBI**
d.v	**d.v**	**d.v**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT PËR KRIMET E ËNDËRRUARA TË ORGANIZUARA
KËRTETOHET NJËSIA
ORIGJINALIN
K/SEKRETARE
LINDITA MYRTJA